

KOMBET E

BASHKUARA



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen
Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje
të Rënda të së Drejtës Humanitare
Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e
ish-Jugosllavisë prej Vitit 1991

Lënda Nr.: IT-05-87-T

Data: 26 shkurt 2009

Originali: anglisht

NË DHOMËN GJYQËSORE

Para: Gjykatësit Iain Bonomy, Kryegjykatës
Gjykatësit Ali Nawaz Chowhan
Gjykatëses Tsvetana Kamenova
Gjykatëses Janet Nosworthy, Gjykatëse Rezervë

Ushtrues i Detyrës së Sekretarit: Z. John Hocking

Aktgjykim: 26 SHKURT 2009

PROKURORI

k.

MILLAN MILLUTINOVIQIT
NIKOLLA SHAINOVIQIT
DRAGOLUB OJDANIQIT
NEBOJSHA PAVKOVIQIT
VLADIMIR LLAZAREVIQIT
SRETEN LLUKIQIT

PUBLIK

AKTGJYKIM

Vëllimi 2 prej 4

Zyrës së Prokurorit:

Z. Thomas Hannis

Z. Chester Stamp

Avokatëve të të Akuzuarve:

Z. Eugene O'Sullivan dhe Z. Sillobodan Zeçeviq për Z. Millan Millutinoviq

Z. Toma Fila dhe Z. Vladimir Petroviq për Z. Nikolla Shainoviq

Z. Tomislav Vishnjq dhe Z. Norman Sepenuk për Z. Dragolub Ojdaniq

Z. John Ackerman dhe Z. Aleksandar Aleksiq për Z. Nebojsa Pavkoviq

Z. Mihajlo Bakraç dhe Z. Gjuro Çepiq për Z. Vladimir Llazareviq

Z. Branko Llukiq dhe Z. Dragan Ivetiq për Z. Sreten Llukiq

| | |
|---|----------|
| VII. KRIMET E PRETENDUARA NË AKTAKUZË | 5 |
| A. PEJA | 5 |
| 1. Akuzat në Aktakuzë..... | 5 |
| 2. Rrethanat..... | 5 |
| 3. Ngjarjet në qytetin e Pejës më 27 dhe 28 mars 1999..... | 9 |
| 4. Shkatërrimet në Pejë | 18 |
| 5. Konkluzionet faktike..... | 21 |
| B. DEÇAN..... | 21 |
| 1. Akuzat në Aktakuzë..... | 21 |
| 2. Rrethanat..... | 22 |
| 3. Ngjarjet në komunën e Deçanit në fund të marsit 1999..... | 22 |
| 4. Konkluzione..... | 30 |
| C. GJAKOVË..... | 30 |
| 1. Akuzat në Aktakuzë..... | 30 |
| 2. Dëshmitarët kryesorë | 32 |
| 3. Rrethanat..... | 38 |
| 4. Forcat e RFJ-së/Serbisë në Gjakovë | 39 |
| 5. Aksionet e UÇK-së dhe NATO-s në Gjakovë | 42 |
| a. Bombardimi i Gjakovës nga NATO-ja..... | 42 |
| b. Veprimtaria e UÇK-së në Gjakovë..... | 43 |
| 6. Ngjarjet në qytetin e Gjakovës..... | 46 |
| a. Shkatërrimi i ndërtesave dhe dhuna..... | 46 |
| b. Ngjarjet në lagjen e Qerimit, 1 dhe 2 prill 1999 | 52 |
| c. Eksodi i shqiptarëve kosovarë nga qyteti i Gjakovës | 55 |
| d. Ngjarjet në qytetin e Gjakovës në maj 1999..... | 56 |
| e. Konkluzione..... | 57 |
| 7. Fshatrat e tjera në komunën e Gjakovës | 59 |
| a. Konkluzionet mbi pretendimet në lidhje me fshatrat e Gjakovës..... | 64 |
| 8. Operacioni në Luginën e Caragojt dhe luginat përreth (27 dhe 28 prill 1999)..... | 64 |
| a. Zanafilla dhe komandimi i operacionit në Luginën e Caragojt | 65 |
| b. Zhvillimi i operacionit në Luginën e Caragojt..... | 70 |
| i. Dobroshti dhe Ramoci | 72 |
| ii. Meja dhe Korenica | 74 |
| (A) Zhvendosja, zbulimi, dhe ekzaminimi i kufomave..... | 83 |
| iii. Shpërngulja e shqiptarëve kosovarë prej Luginës së Caragojt..... | 86 |
| c. Konkluzione..... | 88 |
| D. PRIZRENI | 94 |
| 1. Akuzat në Aktakuzë..... | 94 |
| 2. Rrethanat..... | 94 |
| 3. Pirana | 97 |
| 4. Landovica..... | 102 |
| 5. Sërbica, Retia e Poshtme, Retia, dhe Randobrava..... | 103 |
| 6. Qyteti i Prizrenit (Dushanova)..... | 105 |
| E. RAHOVEC..... | 112 |
| 1. Akuzat në Aktakuzë..... | 112 |
| 2. Rrethanat..... | 114 |
| 3. Celina | 117 |
| a. Sulmi kundër Celinës më 25 mars 1999 | 118 |
| b. Kufomat në Celinë..... | 126 |
| c. Konkluzione..... | 127 |
| 4. Bellacërka | 128 |
| a. Sulmi kundër Bellacërkës më 25 mars 1999..... | 130 |
| b. Varrimi i kufomave..... | 138 |
| c. Kalimi në Shqipëri | 140 |

| | |
|---|-----|
| d. Provat kriminalistike..... | 140 |
| e. Konkluzione..... | 142 |
| 5. Shkatërrimi i xhamive në Celinë dhe Bellacërkë..... | 143 |
| a. Celina..... | 143 |
| b. Bellacërka..... | 145 |
| 6. Krusha e Vogël..... | 146 |
| a. Operacionet në zonën e Krushës së Vogël..... | 147 |
| b. Sulmi mbi Krushën e Vogël më 25 mars 1999..... | 148 |
| c. Provat kriminalistike..... | 156 |
| d. Konkluzione..... | 157 |
| 7. Krusha e Madhe..... | 159 |
| 8. Nagafç..... | 160 |
| a. Konkluzione..... | 165 |
| 9. Brestoc..... | 165 |
| F. SUHAREKË..... | 166 |
| 1. Akuzat në Aktakuzë..... | 166 |
| 2. Dëshmitarët kryesorë..... | 167 |
| 3. Rrethanat..... | 169 |
| 4. Ngjarjet e qytetit të Suharekës të përfshira në Aktakuzë..... | 171 |
| a. DPB-ja e Suharekës..... | 172 |
| b. Ngjarjet në qytetin e Suharekës pak para dhe më 25 mars 1999..... | 173 |
| c. Vrasjet në qytetin e Suharekës më 26 mars 1999..... | 177 |
| d. Xhamia në Suharekë..... | 183 |
| e. Shpërngulja nga Suhareka..... | 184 |
| f. Hetimet në lidhje me ngjarjet në qytetin e Suharekës..... | 187 |
| g. Provat kriminalistike..... | 188 |
| 5. Shpërngulja nga Bellanica..... | 190 |
| 6. Konkluzione..... | 195 |
| a. Vrasjet e familjes Berisha në qytetin e Suharekës..... | 195 |
| b. Shpërngulja nga qyteti i Suharekës..... | 198 |
| c. Dëmtimet e xhamisë në qytetin e Suharekës..... | 199 |
| d. Shpërnguljet nga Bellanica..... | 199 |
| G. SKËNDERAJ..... | 202 |
| 1. Akuzat në Aktakuzë..... | 202 |
| 2. Dëshmitarët kryesorë..... | 203 |
| 3. Rrethanat..... | 204 |
| 4. Provat për krimet e akuzuara..... | 207 |
| a. Vrasjet në Izbicë..... | 207 |
| i. Dëshmitë e dëshmitarëve okularë..... | 207 |
| ii. Veprimet e UJ-së/MPB-së në atë zonë në kohën kur ndodhën vrasjet..... | 216 |
| iii. Hetimet e kryera nga autoritetet e RFJ-së/Serbisë..... | 219 |
| iv. Prova që identifikojnë viktimat..... | 221 |
| b. Dhuna seksuale në Qirez..... | 227 |
| i. Rrëfimet e dëshmitarëve okularë..... | 227 |
| ii. Veprimet e UJ-së/MPB-së në zonë..... | 232 |
| iii. Provat që identifikojnë viktimat..... | 236 |
| c. Shpërngulja nga fshatrat e Skënderajt..... | 237 |
| d. Shkatërrimi i xhamisë së Qirezit..... | 243 |
| 5. Konkluzione..... | 244 |
| a. Shpërnguljet nga komuna..... | 244 |
| b. Vrasjet në Izbicë..... | 246 |
| c. Dhuna seksuale në Qirez..... | 250 |
| d. Shkatërrimi i xhamisë së Qirezit..... | 251 |
| H. MITROVICA..... | 252 |
| 1. Akuzat në Aktakuzë..... | 252 |

| | |
|--|-----|
| 2. Rrethanat..... | 253 |
| 3. Qyteti i Mitrovicës..... | 255 |
| 4. Fshatrat e tjera në komunën e Mitrovicës..... | 258 |
| 5. Konkluzione..... | 263 |
| I. VUSHTRRIA..... | 264 |
| 1. Akuzat në Aktakuzë..... | 264 |
| 2. Rrethanat..... | 265 |
| 3. Ngjarjet në qytetin e Vushtrrisë..... | 268 |
| 4. Sulmet kundër fshatrave në verilindje të qytetit të Vushtrrisë dhe vrasjet në kolonë..... | 270 |
| 5. Vrasjet e tjera..... | 283 |
| 6. Hetimi i vrasjeve në kolonë..... | 284 |
| 7. Konkluzione..... | 285 |
| J. PRISHTINA..... | 287 |
| 1. Akuzat në Aktakuzë..... | 287 |
| 2. Rrethanat..... | 288 |
| 3. Ngjarjet në qytetin e Prishtinës gjatë bombardimeve të NATO-s..... | 293 |
| a. Largimi i shqiptarëve kosovarë nga qyteti i Prishtinës..... | 303 |
| b. Dhuna seksuale..... | 315 |
| 4. Fshatrat në komunën e Prishtinës..... | 318 |
| 5. Konkluzione..... | 319 |
| K. GJILANI..... | 320 |
| 1. Akuzat në Aktakuzë..... | 320 |
| 2. Rrethanat..... | 321 |
| 3. Përlepnica..... | 323 |
| 4. Zhegra, Lladova, Llashtica, dhe Nosala..... | 329 |
| 5. Konkluzione..... | 338 |
| L. FERIZAJ..... | 339 |
| 1. Akuzat në Aktakuzë..... | 339 |
| 2. Rrethanat..... | 339 |
| 3. Fshatrat Bibaj dhe Sojevë..... | 342 |
| 4. Mirosala dhe fshatrat përreth..... | 348 |
| 5. Starasella..... | 351 |
| 6. Konkluzione..... | 355 |
| M. KAÇANIK..... | 356 |
| 1. Akuzat në Aktakuzë..... | 356 |
| 2. Rrethanat..... | 358 |
| 3. Kotlina..... | 362 |
| a. Ngjarjet më 9 mars 1999..... | 363 |
| b. Ngjarjet më 24 mars 1999..... | 365 |
| c. Konkluzione..... | 377 |
| 4. Shkatërrimi i xhamisë në Kotlinë..... | 380 |
| 5. Shkatërrimi i xhamisë në Ivajë..... | 380 |
| 6. Kaçanik..... | 382 |
| a. Konkluzione..... | 385 |
| 7. Fshatrat Sllatinë dhe Vataj..... | 385 |
| a. Sulmi më 13 prill 1999..... | 387 |
| b. Konkluzione..... | 390 |
| 8. Stagovë..... | 391 |
| a. Ngjarjet e 21 majit 1999..... | 392 |
| b. Konkluzione..... | 395 |
| 9. Lisnajë..... | 396 |
| a. Ngjarjet më 5 maj 1999..... | 396 |
| b. Ngjarjet më 25 maj 1999..... | 397 |
| c. Konkluzione..... | 399 |

| | |
|---|-----|
| N. PASQYRË E PËRGJITHSHME E NGJARJEVE | 400 |
| O. KONKLUZIONE LIGJORE | 410 |
| 1. Peja..... | 411 |
| 2. Deçani | 412 |
| 3. Gjakova..... | 413 |
| a. Qyteti i Gjakovës | 413 |
| b. Fshatrat e komunës së Gjakovës | 414 |
| 4. Prizreni..... | 416 |
| 5. Rahoveci | 417 |
| a. Celina..... | 418 |
| b. Bellacërka | 419 |
| c. Krusha e Vogël | 420 |
| 6. Suhareka..... | 420 |
| 7. Skënderaj..... | 422 |
| 8. Mitrovica..... | 424 |
| 9. Vushtrria | 425 |
| a. Qyteti i Vushtrrisë..... | 425 |
| b. Pjesët e tjera të komunës së Vushtrrisë..... | 426 |
| 10. Prishtina | 427 |
| 11. Gjilani | 429 |
| 12. Ferizaj | 430 |
| 13. Kaçaniku | 431 |
| a. Kotlina | 431 |
| b. Qyteti i Kaçanikut..... | 431 |
| c. Vataj..... | 432 |
| d. Lisnaja..... | 432 |
| P. PËRPIEKJET PËR FSHEHJEN E KRIMEVE | 433 |
| 1. Zhvarrosja i kufomave | 435 |
| 2. Transporti dhe rivarrosja i kufomave..... | 440 |
| a. Incidenti i lumit Danub | 440 |
| b. Rivarrosja e kufomave | 444 |
| c. Transportimi i kufomave | 447 |
| 3. Hetimet e MPB-së..... | 452 |
| 4. Implikimi i zyrtarëve jashtë MPB-së..... | 456 |
| 5. Ekzaminimi i kufomave | 457 |
| a. Ekzaminimet mjeko-ligjore në Kosovë | 457 |
| b. Ekzaminimet mjeko-ligjore jashtë Kosovës | 461 |
| i. Batajnica..... | 462 |
| ii. Petrovo Sella..... | 465 |
| 6. Konkluzion..... | 466 |

VII. KRIMET E PRETENDUARA NË AKTAKUZË

A. PEJA

1. Akuzat në Aktakuzë

1. Aktakuza i ngarkon të akuzuarit me përgjegjësi për dy kategori të ndryshme të krimeve kundër njerëzimit që pretendohet se janë kryer në qytetin e Pejës dhe në komunën me të njëjtin emër, më 27 dhe 28 mars 1999 dhe rreth këtyre datave: dëbim dhe zhvendosje të dhunshme. Pretendimet konkrete janë përfshirë në Paragrafin 72(e) të Aktakuzës, i cili thotë:

Më 27 dhe 28 mars 1999 ose rreth këtyre datave, në qytetin e Pejës, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë shkonin shtëpi më shtëpi duke detyruar shqiptarë të Kosovës të largoheshin. Disa shtëpive iu vu zjarri dhe u pushkatuan disa njerëz. Në çdo rrugë u vendosën ushtarë dhe policë të cilët i drejtonin shqiptarët e Kosovës drejt qendrës së qytetit. Kur njerëzit erdhën në qendrën e qytetit, ata pa makina apo mjete transporti u detyruan të hipnin nëpër autobusë apo kamionë dhe u çuan në qytetin e Prizrenit dhe pastaj drejt kufirit me Shqipërinë. Në dalje të qytetit të Prizrenit, shqiptarët e Kosovës u detyruan të zbritnin prej autobusëve dhe të ecnin rreth 15 kilometra deri te kufiri me Shqipërinë, ku, para se të kalonin kufirin, u urdhëruan t'u dorëzonin letërnjoftimet forcave të RFJ-së dhe të Serbisë.¹

2. Rrethanat

2. Komuna e Pejës gjendet në Kosovën perëndimore në kufi me Malin e Zi, me komunën e Deçanit në jug dhe komunën e Istogut në verilindje. Radovan Paponjaku, shef i policisë së qarkullimit rrugor në SPB-në e Pejës gjatë periudhës që mbulohet nga Aktakuza, dëshmoi se në qytetin e Pejës qyteti kryesor në komunë, ishin diku midis 50.000 dhe 70.000 banorë, dhe se përbërja etnike ishte 75 deri 80 për qind shqiptarë të Kosovës dhe 20 deri 25 për qind etni të tjera.² Ai gjithashtu deklaroi se vetëm një e treta e popullatës joshqiptare ishte serbe.³

3. Dëshmitë kryesore në lidhje me ngjarjet konkrete që përbëjnë bazën e pretendimeve në paragrafin 72(e) të Aktakuzës u dhanë nga Edison Zatriqi dhe Ndrec Konaj, banorë shqiptarë kosovarë të Pejës, të paraqitur nga Prokuroria, dhe nga Paponjaku, i paraqitur nga Mbrojtja e Llukiqit. Ekziston një kundërshti e thellë midis Prokurorisë dhe Mbrojtjes, të cilën Dhoma do t'a shqyrtojë më poshtë për të treguar se si e ka zgjidhur këtë kundërshti.

¹ Aktakuza, para. 72(e).

² Radovan Paponjak. T-24597 (19 mars 2008).

4. Siç është thënë më lart në Pjesën VI.B, Bislim Zyrapi, i cili ishte shef i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së nga nëntori 1998 deri në prill 1999, dëshmoi se Zona Operative e Dukagjinit e UÇK-së apo Zona Operative 3, përfshinte komunën e Pejës.⁴ Sidoqoftë, UÇK-ja kontrollonte gjatë tërë kohës vetëm pjesë të vogla të secilës prej zonave operative, zakonisht pjesë malore dhe zona kodrinore. Ajo ishte gjithashtu e pranishme në "zona fushore" të disa komunave, duke përfshirë edhe ato të Zonës së Dukagjinit.⁵

5. Sipas Zyrarit, gjatë qershorit 1998 pati luftime sporadike të intensitetit të ulët midis UÇK-së dhe forcave të RFJ-së dhe Serbisë në Zonën e Dukagjinit. Sidoqoftë, gjendja ndryshoi nga korriku deri në tetor 1998, gjatë ofensivës së verës të kryer nga UJ-ja dhe MPB-ja, që është përshkruar në Pjesën VI.B më lart, kur luftimet u ashpërsuan.⁶ Radovan Paponjak, dëshmia e të cilit mbi veprimet e UÇK-së në atë zonë përputhet me provat e tjera, tregoi se, edhe pse në fund të verës së vitit 1998 UÇK-ja ishte mundur, ajo u riorganizua dhe përforcua në fund të vitit 1998 dhe fillim të vitit 1999 dhe vazhdoi me "sulmet terroriste" kundër civilëve dhe pjesëtarëve të armatës dhe policisë, disa prej të cilave ndodhën në komunën e Pejës.⁷ Paponjaku gjithashtu dëshmoi se të gjithë SPB-të në Kosovë mbanin lista për incidentet që lidheshin me sigurinë; më tej këto lista lidheshin me dosjet e çështjeve individuale. Ai tha se kjo listë më vonë u quajt "dosja e Kosovës dhe Metohisë."⁸ Lista përmbante kapituj për ngjarjet që kishin lidhje me sigurinë dhe në të cilat kishte të vrarë si rezultat i konfliktit të armatosur, krimet kundër shqiptarëve, krimet kundër serbëve, dhe ngjarjet në lidhje me sigurinë që kishin të bënin me rrëmbime dhe persona të zhdukur.⁹

6. Dhoma dëgjoi nga dëshmitarë të ndryshëm se rrugët që çonin në Pejë ishin nën kontroll të UÇK-së gjatë pjesës më të madhe të vitit 1998 dhe fillim të vitit 1999,¹⁰ dhe se fshatrat e

³ Radovan Paponjak, T. 24579-24580 (Y19 mars 2008).

⁴ Bislim Zyrapi, T. 5932, 5934, 5967 (6 nëntor 2006), T. 6018-6021, 6049 (7 nëntor 2006), T. 6258, 6267-6268 (10 nëntor 2006); P2469 (hartat me zonat e ndryshme operative të UÇK-së); *shih gjithashtu* P2453 (procesverbali i mbledhjes së Shtabit të UÇK-së të Zonës së Dukagjinit), f. 2.

⁵ Bislim Zyrapi, T. 5967-5968 (6 nëntor 2006).

⁶ Bislim Zyrapi, T. 5939-5940 (6 nëntor 2006).

⁷ Radovan Paponjak, D1603 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 mars 2008), para. 34, T. 24539, T. 24547-24548 (19 mars 2008); Radojica Nikçević, T. 23242-23243 (26 shkurt 2008); Dragan Zhivaleviq, 6D1606 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 mars 2008), para. 14.

⁸ Radovan Paponjak, T. 24543-24544 (19 mars 2008).

⁹ Radovan Paponjak, T. 24544-24548 (19 mars 2008).

¹⁰ Radovan Paponjak, 6D1603 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 mars 2008), para. 16; Lubivoje Joksiq, T. 21977-21978 (8 shkurt 2008); John Crosland, T. 9919 (8 shkurt 2007), 3D510 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 qershor 2006), para. 63, Shtojca B; Dragan Zhivaleviq, 6D1606 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 mars 2008), para. 11. *Shih gjithashtu* 4D141 (Raport luftimi i Armatës së 3-të, 9 gusht 1998), f. 3; 6D698 (Urdhër i PrK, 5 shtator 1998), f. 1, gjithashtu e pranuar si P1101.

shqiptarëve të Kosovës ishin baza të UÇK-së ose të kontrolluara nga ajo.¹¹ Gjithashtu, Dhoma dëgjoi dëshmi për disa incidente që kishin ndodhur në komunën e Pejës dhe në vetë qytetin gjatë kësaj kohe, disa nga të cilët iu atribuuan UÇK-së. Në njërin nga incidentet e përmendura nga dëshmitarë të ndryshëm u vranë së paku katër të rinj serbë dhe u plagosën disa të tjerë në kafenenë Panda Bar në qytetin e Pejës, në dhjetor 1998.¹²

7. Zyrapi konfirmoi se, në fund të marsit 1999, UÇK-ja kishte disa brigada në Zonën e Dukagjinit.¹³ Dhoma është bindur se faktikisht në komunën e Pejës ka pasur prani të fortë të UÇK-së në vitin 1998 dhe në periudhën menjëherë para fillimit të bombardimeve të NATO-s dhe ngjarjeve që pretendohen në Aktakuzë.

8. Zona e Pejës ishte në zonën e përgjegjesisë së Brigadës së 125-të të Motorizuar të Korpusit të Prishtinës me komandant Dragan Zhivanoviqin.¹⁴ Batalioni i Blinduar i Brigadës së 125-të të Motorizuar ishte i vendosur në këtë komunë dhe komanda e tij ishte në fshatin Raushiq, që gjendet në jug të qytetit të Pejës, deri më 26-27 mars 1999 kur u zhvendos në hotel Metohija në qytetin e Pejës.¹⁵ Brigada qëndroi në qytet së paku deri më 11 prill 1999.¹⁶ Ditari i luftës i Brigadës së 125-të të Motorizuar gjithashtu bën fjalë për praninë e njësive të brigadës në qytetin e Pejës që nga 27 marsi 1999.¹⁷ Zhivanoviqi konfirmoi praninë e njërës prej njësive të tij në qytet më 27 dhe 28

¹¹ Radovan Paponjak, 6D1603 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 mars 2008), para. 35.

¹² Radovan Paponjak, T. 24537-24542, 24549 (19 mars 2008), Radojica Nikçeviq, T. 23231, 23237, 23240-23243, 23246-23258 (26 shkurt 2008), T. 23284-23285 (27 shkurt 2008); 5D980 (Raport luftimi i Komandës së Zonës Ushtarake dërguar Armatës së 3-të, 5 prill 1999), f. 1; P636 (shembuj të mosrespektimit të Rezolutës 1199 të KSKB: Shtojca DZ-3 e deklaratës së Drewienkiewicz-it), f. 6; 6D1537 (Përmbledhje e incidenteve të sigurisë në Kosovë prej 1 janarit 1998 deri në qershor 2001 në zonën e MPB-së së Pejës, 20 nëntor 2003); 6D112 (Raport i OSBE/KVM-së mbi respektimin e armëpushimit nga palët në Kosovë, 12 mars 1999), f. 2; P1100 (raporti i Shtabit të MPB-së dërguar MPB-së së Serbisë, 27 mars 1999) f. 5. *Shih gjithashtu* 6D1637 (Raporti i US-KDOM-it, 14 prill 1999) f. 2, 4; 6D1638 (Raporti i US-KDOM-it 13 prill 1999) f. 3. Karol John Drewienkiewicz, P2508 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 qershor 2000), para. 89; P407 (Libri i Kaltër i OSBE/KVM); *shih gjithashtu* P634 (Kronologjia e ngjarjeve kryesore në Kosovë nga 15 tetori deri më 18 prill 1999); Michael Philips, T. 11902-19093 (19 mars 2007); Shaun Byrnes, T. 12241 (17 prill 2007); Lubivoje Joksiq, T. 21983 (8 shkurt 2008); Millivoje Mihajloviq 6D1530 (deklarata e dëshmitarit e datës 6 mars 2008), para. 29; Shaun Byrnes, T. 12267 (17 prill 2007); Frederick Abrahams, T. 1020-1021 (7 gusht 2006).

¹³ Bislim Zyrapi, T. 6258-6259 (10 nëntor 2006); P2447 (harta me pozicionet e UÇK-së).

¹⁴ Dragan Zhivanoviq, T. 20439 (17 janar 2008), T. 20532-20533 (18 janar 2008) (Ai konfirmoi se njëri nga dy batalionet e brigadës së tij ishte i stacionuar në Pejë në kohë paqeje); Millan Kotur, T. 20801-20802 (22 janar 2008); Zllatomir Peshiq, T7272 (24 nëntor 2006); *shih gjithashtu* P1246 (Urdhri i Brigadës së 125-të të Motorizuar, 4 prill 1999), f. 2.

¹⁵ P2802 (Ditari i luftës i Batalionit të Blinduar të Brigadës së 125-të të Motorizuar), f. 1-2; *shih gjithashtu, për shembull* 5D697 (Vërejtje e Brigadës së 125-të të Motorizuar, 22 mars 1999), f. 1; 5D708 (Urdhër i Brigadës së 125-të të Motorizuar, 24 mars 1999), f. 3; 5D699 (Urdhër i Brigadës së 125-të të Motorizuar, 26 mars 1999). *Shih gjithashtu* P1579 (Harta e Kosovës).

¹⁶ P2802 (Ditari i luftës i Batalionit të Blinduar të Brigadës së 125-të të Motorizuar), f. 2-11; *shih gjithashtu* P2616 (Ditari i luftës i Batalionit të Blinduar të Brigadës së 125-të të Motorizuar, 24-31 mars 1999), f. 4; 6D1543 (Raport mbi dëbimin e dhunshëm të shqiptarëve, përndjekjen e tyre mbi baza racore, dhe konfiskimin e dokumenteve të tyre personale, maj 2002), f. 2-3.

¹⁷ P2802 (Ditari Luftë i Batalionit të Blinduar të Brigadës së 125-të të Motorizuar), f. 2-11.

mars.¹⁸ Ai gjithashtu tha se atje gjithashtu ndodheshin Detashmenti i 177-të i Mbrojtjes Territoriale dhe një kompani nga Divizioni i 113-të i Mbrojtjes Territoriale.¹⁹ Këto njësi u larguan nga qyteti dikur nga mesi i prillit 1999.²⁰

9. Një raport i KVM-së për periudhën 20-21 shkurt 1999 konstatonte se UJ-ja kishte "rekrutuar një numër të vogël rezervistësh për shërbim ushtarak në garnizonin e Pejës" dhe se këta individë mund të identifikoheshin nga "uniformat e tyre të tipit të vjetër".²¹ Paponjaku konfirmoi se forcat rezerviste të UJ-së në zonën e Pejës u mobilizuan në fund të marsit 1999, por shtoi se, për shkak se procesi i mobilizimit ishte i ngadalshëm, kishte prani të madhe të rezervistëve në qytete. KVM-ja raportoi se disa nga këta rezervistë "tregonin mungesë disipline sa i përket dukjes së uniformës, sjelljes, dhe mbajtjes së armëve dhe pajisjeve".²²

10. Rrjedhimisht, është e qartë se në kohën para fillimit të fushatës së bombardimeve të NATO-s në komunën e Pejës kishte prani të UJ-së dhe se, nga 27 marsi deri në mesin e prillit 1999, forcat e UJ-së ishin të stacionuara në qytetin e Pejës. Forcat e UJ-së përfshinin edhe një numër rezervistësh.

11. Radojica Nikçeviq i cili ishte anëtar i PJP-së të SPB-së së Pejës, dëshmoi se ishin pesë toga të PJP-së në SPB në atë kohë: dy në Pejë, një në Istog, një në Gjakovë, dhe një në Klinë. Kompania e tij e PJP-së kishte 80 pjesëtarë, të cilët ishin ndarë në pesë toga.²³

12. Sipas Paponjakut, pas fillimit të bombardimeve të NATO-s më 24 mars 1999, njësitë organizative të SPB-së së Pejës u zhvendosën në vendndodhje rezervë, u mobilizuan policë rezervistë dhe në Pejë u shtua lëvizja e njerëzve me uniforma.²⁴ Forcat rezerviste të policisë në Pejë gjithashtu përfshinin serbë vendas.²⁵ Paponjaku deklaroi se nuk kishte dallim në dukje midis policëve të rregullt dhe rezervistëve sepse ata kishin të njëjtat uniforma, mbanin të njëjtat armë, dhe kryenin të njëjtat detyra.²⁶

¹⁸ Dragan Zhivanoviq, T. 20471 (17 janar 2008).

¹⁹ Dragan Zhivanoviq, T. 20496-20497 (17 janar 2008); *shih gjithashtu* Radovan Paponjak, T. 24551 (19 mars 2008).

²⁰ Dragan Zhivanoviq, T. 20496-20497 (17 janar 2008); *shih gjithashtu* 5D712 (Urdhri i Brigadës së 125-të të Motorizuar, 7 prill 1999), f. 2, i referohet Detashmentit të 113-të të Mbrojtjes Territoriale si një njësi që duhet të kryejë detyra me Brigadën e 125-të të Motorizuar.

²¹ P675 (raporti I OSBE/KVM-së për periudhën 20-21 shkurt 1999), f. 3.

²² Radovan Paponjak, 6D1603 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 mars 2008), para. 71.

²³ Radojica Nikçeviq, T. 23232 (26 shkurt 2008).

²⁴ Radovan Paponjak, 6D1603 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 mars 2008), para. 40, 50.

²⁵ Radovan Paponjak, T24568 (19 mars 2008).

²⁶ Radovan Paponjak, T24569 (19 mars 2008).

13. Vladimir Iliqi, pjesëtar i Brigadës së 122-të Ndërhyrëse të PJP-së, paraqiti dëshmi plotësuese për përforcimet e SPB-së së Pejës nga brigada e tij, e cila ishte dërguar nga Beogradi.²⁷ Ajo arriti në Kosovë në qershor 1998 dhe u nda në dy grupe, secili me nga 400 ushtarë, megjithëse ky numër u zvogëlua më vonë.²⁸ Njëra, nën komandën e Dragan Zhivaleviqit, u dërgua në zonën e Podujevës kurse tjetra, në të cilin fillimisht ishte edhe Iliqi, u dërgua në zonën e SPB-së së Pejës dhe komandohej nga Boshko Buha, zëvendës i Zhivaleviqit.²⁹ Dragan Zhivaleviq e konfirmoi këtë dëshmi, duke shpjeguar se Brigada e 122-të Ndërhyrëse e PJP-së u quajt më vonë Detashmenti i Beogradit ose Detashmenti i 21-të apo 22-të i PJP-së.³⁰

14. Nikçeviqi dëshmoi se policët e SPB-së së Pejës kishin "uniforma te rregullta" që përbëheshin prej xhaketës dhe pantallonave të kaltra, këmishës së kaltër të çelë, dhe rripit të zi.³¹ Siç është diskutuar në Pjesën VI.A më lart në lidhje me PJP-në në përgjithësi, pjesëtarët e njësiteve të PJP-së në Pejë kishin uniforma të kaltra kamuflimi deri në fillim të shtatorit 1998, kur ato u zëvendësuan me uniforma të blerta kamuflimi me shenja të policisë në mëngë.³² Si Nikçeviqi, po ashtu edhe Iliqi thanë se mbajtja e uniformave jostandarde ishte e ndaluar, por pranuan se disa, sidomos rezervistët, mund ta kenë thyer këtë rregull dhe se shamitë mund të jenë mbajtur nga pjesëtarët e PJP-së për shkak të vapës.³³

3. Ngjarjet në qytetin e Pejës më 27 dhe 28 mars 1999

15. Edison Zatriqi, i cili në vitin 1999 ishte drejtor/pronar i firmës "Flamingo Tours", e cila kishte tre autobusë udhëtarësh, dëshmoi se, një ditë para fillimit të bombardimeve të NATO-s, ai u urdhërua nga policia që të shkonte në garazhin ku mbante autobusët. Kur mbërriti aty rreth orës 11:30 paradite, dy policë vendorë, të cilët i njihte, e urdhëruan t'i ndizte autobusët. Pasi e bëri këtë, ata i thanë se ishte i lirë të shkonte. Ai kërkoi një dokument që vërtetonte se i ishin marrë autobusët. Kur njëri nga policët reagoi duke i kthyer automatikun, Zatriqi, natyrisht u largua. Ai nuk e

²⁷ Vladimir Iliqi, T. 24319-24321 (17 mars 2008).

²⁸ Vladimir Iliqi, T. 24322, T. 24369-24370 (17 mars 2008).

²⁹ Vladimir Iliqi, T. 24322, 24383-24384 (17 mars 2008); Dragan Zhivaleviq, 6D1606 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 mars 2008), para. 6.

³⁰ Dragan Zhivaleviq, 6D1606 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 mars 2008), para. 6.

³¹ Radojica Nikçeviq, T. 23235 (26 shkurt 2008).

³² Dragan Zhivaleviq, 6D1606 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 mars 2008), para. 8; Radojica Nikçeviq, T23236 (26 shkurt 2008); Vladimir Iliqi, T. 24323-24324, 24377-24378 (17 mars 2008) *shih gjithashtu* Radojica Nikçeviq, T. 23274 (27 shkurt 2008).

³³ Radojica Nikçeviq, T23237-23282 (26 shkurt 2008), T. 23275 (27 shkurt 2008); P1596 (fotografi e aktiviteteve të organizatave të armatosura të RFJ-së dhe Serbisë); Vladimir Iliqi, T. 24326 (17 mars 2008).

raportoi incidentin në SPB-në vendore meqenëse policët në fjalë ishin oficerë të lartë dhe çdo ankesë do të ishte e kotë.³⁴

16. Zatriqi gjithashtu dëshmoi se, më 26 dhe 27 mars 1999, kishte qëndruar në bodrumin e shtëpisë së tij në lagjen e Sahat Kullës në qytetin e Pejës. Në ditën e dytë, ai kishte parë në lagjen e tij civilë të armatosur, të cilët i kishte njohur si fqinjë të tij serbë, dhe njerëz të tjerë në uniforma të kaltra dhe të zeza të kamuflimit.³⁵ Rreth orës 06:30 të mëngjesit ai kishte parë "ushtarakë serbë" të vendosur në oborrin e spitalit dhe të shkollës së mesme kur kishin filluar të granatonin me topa lagjen e Kapeshnicës.³⁶ Edhe pse Dragan Zhivanoviq mohoi se njësitet e Brigadës së 125-të të Motorizuar e kishin përdorur spitalin, shkollën, apo ndonjë godinë të ngjashme në qytetin e Pejës "për qëllime ushtarake dhe si pozicione për hapje zjarri," ai pranoi se UJ-ja e kishte vendosur korpusin mjekësor aty.³⁷ Dhoma Gjyqësore e beson rrëfimin e Zatriqit në lidhje me granatimin e Kapeshnicës nga afërsia e atij vendi.

17. Zatriqi tregoi se, rreth orës 07:30 të mëngjesit të së njëjtës ditë, ai dhe familja e tij shkuan në shtëpinë e hallës/tezës së tij në lagjen e Jarinës në qendër të qytetit. Ai pa njerëz në rrugë me fëmijë dhe me çanta, por nuk ai nuk dinte se çfarë po ndodhte.³⁸ Në mbrëmje, ai pa një dritë reflektori duke përshkuar qytetin dhe dëgjoji të shtëna gjatë tërë natës.³⁹

18. Të nesërmen në mëngjes, Zatriqi e familja e tij ishin ende në shtëpinë e hallës/tezës kur një polic me uniformë të kaltër kamuflimi kaloi përgjatë rrugës në atë lagje dhe i urdhëroi njerëzit të largoheshin nga shtëpitë e tyre brenda pesë minutash.⁴⁰ Zatriqi shpjegoi se polici i drejtohej njerëzve kolektivisht. As ai, e as ndonjë njeri tjetër nga shtëpia në të cilën ai ishte nuk kishte folën drejtpërdrejtë me policin. Në të dy hyrjet e lagjes ishin vendosur nga dy makina të policisë.⁴¹ Zatriqi vendosi të largohej së bashku me familjen nga qyteti i Pejës atë mëngjes sepse kishte frikë për jetën e tyre.⁴²

³⁴ Edison Zatriqi, P2347 (deklarata e dëshmitarit e datës 20 qershor 2001), f. 2, T. 4422-4423 (29 shtator 2006).

³⁵ Edison Zatriqi, T. 4414-4415 (29 shtator 2006).

³⁶ Edison Zatriqi, P 2347 (deklarata e dëshmitarit e datës 20 qershor 20010, F. 2. *Shih gjithashtu* Lubivoje Joksiq, T. 21978 (8 shkurt 2008).

³⁷ Dragan Zhivanoviq, T. 20471 (17 janar 2008). Ekzistenca a qendrës mjekësore në Pejë gjithashtu konfirmohet nga shënimi i datës 29 mars 1999 në Ditarin e Luftës të Brigadës së 125-të të Motorizuar; P2616 (Ditari i Luftës i Brigadës së 125-të të Motorizuar), f. 10-12.

³⁸ Edison Zatriqi, P2347 (deklarata e dëshmitarit e datës 20 qershor 2001), f. 2.

³⁹ Edison Zatriqi, P2347(deklarata e dëshmitarit e datës 20 qershor 2001), f. 3.

⁴⁰ Edison Zatriqi, T. 4415-4417 (29 shtator 2006).

⁴¹ Edison Zatriqi, T. 4420 (29 shtator 2006).

⁴² Edison Zatriqi, P2347 (deklarata e dëshmitarit e datës 20 qershor 2001), f. 3

19. Ata u nisën me dy makina dhe iu bashkuan kolonës së gjatë të makinave dhe njerëzve të cilët lëviznin në drejtim të Rozhajës në Mal të Zi.⁴³ Përgjatë gjithë rrugës kishte policë dhe civilë të armatosur në udhëkryqe dhe policët e drejtonin kolonën për në Mal të Zi dhe Shqipëri. Ai nuk pa pjesëtarë të UJ-së duke bërë një gjë të tillë.⁴⁴ Ai dëshmoi më tej se, në udhëkryqin e parë, 100 ose 200 metra pasi i ishte bashkuar kolonës në Pejë, pa njërin nga autobusët e tij të mbushur me njerëz nga qyteti të cilën e ngiste një burrë me uniformë të kaltër kamuflimi.⁴⁵ Ai pa edhe autobusë të tjerë të mbushur me njerëz.⁴⁶ Përveç disa provokimeve gjatë rrugës, ata nuk patën probleme dhe shkuan me makinë drejt në Rozhajë, në Mal të Zi.⁴⁷

20. Dhoma vëren se në deklaratën e tij fillestare të marrë në vitin 2001 Zatriqi nuk përmend se i kishte parë autobusët e tij në atë kohë, po deklaroi se nuk i pa prej momentit të konfiskimit nga policia e deri kur u kthye në Kosovë në korrik 1999.⁴⁸ Sidoqoftë, në një shtesë të kësaj deklarate të bërë në vitin 2002, ai e korrigjoi deklaratën e tij të mëparshme duke shtuar se i kishte parë autobusët plot me njerëz para se të linte Pejën dhe ai e përsëriti këtë gjatë dëshmisë së tij me gojë. Ai nuk u pyet për këtë mospërputhje dhe Dhoma pranon se kur u largua nga Peja, ai pa së paku njërin nga autobusët e tij, pasi i ishin marrë nga pjesëtarët e MPB-së.

21. Ndrec Konaj, gjithashtu shqiptar i Kosovës dhe banor i këtij qyteti, i cili më parë kishte qenë inspektor ndërtimi, dha dëshmi të ngjashme duke përmendur një grup të madh njerëzish që u detyruan të linin Pejën më 27 dhe 28 mars 1999. Më 27 mars, ai ishte me familjen e tij dhe rreth 19 njerëz të tjerë në shtëpinë e të atit në lagjen Karragaç. Diku nga ora 2 pasdite, 20 "paraushtarakë serbë" të armatosur erdhën në lagje dhe nja 15 prej tyre hynë në oborrin e të atit, shtinë drejt derës së shtëpisë dhe i urdhëruan të gjithë të niseshin në drejtim të Malit të Zi duke iu dhënë pesë minuta kohë. Konaj dhe familja e tij vepruan sipas urdhrit dhe filluar të ecnin rrugëve të qytetit në një grup prej rreth 25 njerëzish. Ata u ndalën nga "dy ushtarë të ushtrisë" me uniforma kamuflimi, njëri prej të cilëve ishte i armatosur. Ushtarët i ndanë burrat nga gratë dhe fëmijët dhe kërkuan 150 marka gjermane nga Konaj. Pasi morën paratë, ushtarët i thanë grupit "që të ikin prej këtu" dhe ndërkohë ndaluan një grup tjetër që po vinte pas tyre.⁴⁹

⁴³ Edison Zatriqi, P2347 (deklarata e dëshmitarit e datës 20 qershor 2001), f. 3

⁴⁴ Edison Zatriqi, T. 4424-4425 (29 shtator 2006).

⁴⁵ Edison Zatriqi, T. 2347 (shtesë e deklaratës së dëshmitarit të datës 29 janar 2002), f. 2, T. 4417 (29 shtator 2006).

⁴⁶ Edison Zatriqi, T. 4414-4415 (29 shtator 2006).

⁴⁷ Edison Zatriqi, P2347 (deklarata e dëshmitarit e datës 20 qershor 2001), f. 3, T. 4424 (29 shtator 2006).

⁴⁸ Edison Zatriqi, P2347 (deklarata e dëshmitarit e datës 20 qershor 2001) f. 2.

⁴⁹ Ndrec Konaj, P2372 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 qershor 2001), f. 3.

22. Më tej Konaj dëshmoi se ata si grup shkuan drejt një pompe benzine dhe se ai pa një makinë të UJ-së dhe një tjetër të MPB-së.⁵⁰ Më pas grupi u ndal nga shtatë "policë," të cilët i pyetën se ku po shkonin, të cilëve Konaj iu përgjigj se po shkonin në lagjen e Jarinës. Dy nga policët ishin me uniforma kamuflimi.⁵¹ Policët i thanë grupit se ata mund të lëviznin vetëm përgjatë rrugëve dytësore dhe jo përmes qendrës së qytetit dhe se duhej të shkonin në drejtim të Malit të Zi.⁵²

23. Grupi vazhdoi rrugën duke u përpjekur të arrinte në qendrën tregtare të qytetit deri kur u ndal nga dy makina prej të cilave dolën nëntë burra. Ata "nuk dukeshin ushtarë të rregullt sepse i kishin fytyrat e ngjyrosura, por ishin me veshje civile." Ata ishin "keqtrajtues" dhe e goditën Konajn në shpinë dhe në fytyrë me kondak pushke. Ungji i Konajt u godit në këmbë dhe u rrëzua përtokë. Njëri nga ata u tha "Kërkuat NATO-n dhe Klintonin, le t'ju shpëtojnë ata tani."⁵³ Konaj dëshmoi se grupi i tij vazhdoi ecjen përgjatë rrugëve dytësore në drejtim të Malit të Zi dhe se, kur iu afruan stacionit të policisë, i cili është afër stacionit të autobusëve, u ndalën përsëri nga "policë" të veshur me uniforma të ndryshme kamuflimi, të cilët i pyetën se ku po shkonin.⁵⁴ Kur Konaj iu shpjegoi se po shkonin në lagjen Jarinë, njëri nga policët i tha grupit se "nuk ka rrugë tjetër për ju, përveçse për në Mal të Zi."⁵⁵ Ndërkohë që grupi vazhdoi rrugën për në stacion të autobusëve, Konaj pa tre ose katër persona me uniformë në secilën anë të rrugës prej pompës së benzinës e deri te stacioni i autobusëve në Pejë që nuk i lejonin të hynin në asnjë nga rrugët anësore.⁵⁶

24. Rreth orës 16:00, Konaj dhe një grup prej rreth 25 njerëzish mbërritën në një shtëpi më afër stacionit të autobusëve që ishte e një miku dhe vendosën ta kalonin natën aty. Afërsisht pas një ore, Konaj pa nga një dritare e shtëpisë se si një grup prej rreth "14 vetësh me uniforma të zeza dhe me maska" trokitën në derën e një shtëpie aty afër. Një civil serb vendas, i cili ishte me grupin e personave të maskuar, hyri në shtëpi me ta dhe doli prej saj me një kuti. Më pas ata u larguan të gjithë. Pastaj Konaj tregoi se gjatë gjithë natës pa se si digjeshin shtëpitë në zonën rreth shkollës së mesme dhe dëgjoi të shtëna.⁵⁷

25. Gjithashtu Konaj tregoi për ngjarjet e ditës së nesërme – 28 mars 1999 – kur ai dhe familja e tij u dëbuan nga qyteti. Ai tregoi se si atë mëngjes pa turma njerëzish nëpër rrugë të cilët ishin dëbuar nga zona rreth kishës katolike dhe të cilët i thanë atij se ishin urdhëruar të shkonin në Mal të

⁵⁰ Ndrec Konaj, P2372 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 qershor 2001), f. 3, T. 4889, 4895-4900 (16 tetor 2006).

⁵¹ Ndrec Konaj, P2372 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 qershor 2001), f. 3, T. 4911 (16 tetor 2006).

⁵² Ndrec Konaj, *shih* P2372 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 qershor 2001), f. 3, T. 4911 (16 tetor 2006).

⁵³ Ndrec Konaj, P2372 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 qershor 2001), f. 3

⁵⁴ Ndrec Konaj, T. 4912 (16 tetor 2006).

⁵⁵ Ndrec Konaj, P2372 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 qershor 2001), f. 3, T. 4911-4912 (16 tetor 2006).

⁵⁶ Ndrec Konaj, P2372 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 qershor 2001), f. 3, T. 4889-4890 (16 tetor 2006).

⁵⁷ Ndrec Konaj, P2372 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 qershor 2001), f. 4.

Zi. Konaj vendosi ta linte shtëpinë në të cilën kishte kaluar natën me gruan dhe dy vajzat e tij. Ata iu bashkuan turmës në rrugë dhe morën udhën për në Mal të Zi.⁵⁸ Gjatë rrugës ai pa policë, forca ushtarake, dhe forca të tjera me uniforma të cilët ai i përshkroi si "paraushtarakë" të vendosur në hyrje të çdo rruge "për të kthimin pas të [penguar kolonën e njerëzve]."⁵⁹ Më tej ai përshkroi se si afër shkollës ekonomike, një grup prej rreth 30 policësh dhe paraushtarakësh e ndaloi turmën dhe i drejtoi njerëzit që ishin në këmbë në drejtim të qendrës së qytetit duke lejuar vetëm ata me makina që të vazhdonin në drejtim të Malit të Zi.⁶⁰

26. Meqë ishin në këmbë, Konaj dhe familja e tij u kthyen prapa në sheshin në qendër të Pejës rreth orës 09:30 ose 10:00 paradite. Aty ndodheshin forca të mëdha "policore dhe paraushtarake" dhe mijëra njerëz që kishin ardhur nga lagje të ndryshme të qytetit, si dhe së paku 20 kamionë dhe autobusë. "Komandanti i kontrollit të trafikut," të cilin ai e njihte por nuk ia dinte emrin, qëndronte në qendër të sheshit me megafon dhe urdhëroi ndarjen e burrave nga gratë dhe fëmijët dhe hipjen e grave dhe fëmijëve në autobusë që ishin atje. Sidoqoftë për shkak të panikut në turmë, ndarja nuk u bë. Konaj pa familje të tëra që hipën në autobusë, të cilët u nisën tri herë në drejtim të Prizrenit.⁶¹

27. Rreth orës 07:00 në mbrëmje, tre tanke ushtarake hynë në qendër të qytetit, dy nga të cilët i drejtuan tytat në drejtim të turmës duke shkaktuar frikë të madhe. Pas rreth një ore, tanket u larguan. Gjithashtu në ato momente u ndërpre rryma elektrike në qytet.⁶² Më vonë në mbrëmje, kamionët dhe autobusët u kthyen të zbrazët dhe u mbushën përsëri me njerëz. Konaj, familja e tij, dhe rreth 100 njerëz të tjerë hipën në autobusin e fundit i cili u nis nga Peja atë natë. Kushëriri i tij dhe një mik i tij fillimisht nuk u lejuan të hipnin në autobus nga shoferi i cili, sipas Konajt, ishte "paraushtarak i armatosur." Mirëpo pasi miku i Konajt i dha para, shoferi i lejoi të hipnin. Atmosfera në autobus ishte "e tmerrshme" dhe njerëzit në autobus nuk e dinin se ku po i dërgonin.⁶³

28. Më tej Konaj përshkroi se si kolona e autobusëve shkoi në drejtim të jugut dhe u ndal në një postbllok përballë stacionit të policisë në qytetin e Gjakovës, ku ishte një grup i madh civilësh, paraushtarakësh, dhe policësh që rrihnin disa burra me kondakët e pushkëve. Ai gjithashtu pa një grup të përzier civilësh, paraushtarakësh dhe policësh duke rrahur njerëzit në automjetin para autobusit të tyre. Ai dëgjoi shoferin e autobusit të tyre duke u fjalosur me një nga civilët serbë dhe

⁵⁸ Ndrec Konaj, P2372 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 qershor 2001), f. 4, T. 4912 (16 tetor 2006).

⁵⁹ Ndrec Konaj, P2372 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 qershor 2001), f. 4, T. 4890 (16 tetor 2006).

⁶⁰ Ndrec Konaj, P2372 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 qershor 2001), f. 4, *shih gjithashtu* T. 4894, 4910 (16 tetor 2006).

⁶¹ Ndrec Konaj, P2372 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 qershor 2001), f. 4.

⁶² Ndrec Konaj, P2372 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 qershor 2001), f. 4, T. 4894, 4912-4913 (16 tetor 2006).

⁶³ Ndrec Konaj, P2372 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 qershor 2001), f. 4-5, T. 4914 (16 tetor 2006).

duke i thënë atij se kishte "urdhër t'i dërgoj këta njerëz në Prizren dhe askush nuk guxon të dalë nga autobusi." Autobusi u lejua të vazhdonte rrugën me pjesën tjetër të kolonës në drejtim të Prizrenit. Ata mbërritën në Prizren diku midis orës 01:00 dhe 01:30 pas mesnate dhe u ndalën te udhëkryqi që çon në kalimin kufitar të Vërbnicës (Morinës). Shoferi iu tha njerëzve në autobusin në të cilin ishte Konaj, të dilnin nga autobusi, duke shtuar, "Shkoni në Shqipëri, ky nuk është vendi juaj. Këtu është Serbia e Madhe." Konaj pa "policë dhe ushtarakë" në anën tjetër të rrugës në vendin ku ishin ndalur.⁶⁴

29. Pastaj erdhën së paku shtatë autobusë të zbrazët për t'i marrë njerëzit, njëri prej të cilëve drejtohej nga një njeri i armatosur "me uniformë ushtarake." Konaj dhe familja e tij hipën në autobusin e fundit, i cili i çoi deri te kalimi kufitar ku zbritën nga autobusi. Shoferi iu tha të shkonin në rrugës kryesore sepse vendi ishte i minuar. Konaj dhe grupi i tij filluan të ecnin në drejtim të kufirit me Shqipërinë. Te kalimi kufitar, Konaj pa shumë policë të cilët iu thoshin njerëzve t'i hidhnin të gjitha dokumentet e identifikimit në një kuti druri e cila kishte shumë dokumente dhe targa makinash. Burrat dhe çantat e grave u kontrolluan, por Konaj ia doli t'i fshihte dokumentet e tij. Ky grup u lejua të kalonte në Shqipëri në mëngjesin e 29 marsit 1999.⁶⁵ Prej 27 deri më 29 mars, Konaj dhe familja e tij nuk hëngrën ushqim.⁶⁶

30. Dhoma e ka bërë të ditur shqetësimin e saj për refuzimin gati irracional të shqiptarëve të Kosovës për të pranuar shkallën e veprimtarisë së UÇK-së. Konaj është një nga këta dëshmitarë, i cili nuk pranoi se ishte në dijeni të sulmit famëkeq të UÇK-së kundër policëve serbë në korrik të vitit 1998 në fshatin Loxhë afër shtëpisë së tij, ku u kryen rrëmbime dhe gjymtime, deri në ndërhyrjen e trupi gjykues. Për shkak të josingëritetit të tij, Dhoma ka qenë tepër e kujdesshme gjatë vlerësimit të besueshmërisë së tij në lidhje me ngjarjet e rëndësishme të vitit 1999. Si rezultat, Dhoma erdhi në përfundimin se dëshmia e tij për ngjarjet e marsit 1999 është e besueshme duke pasur parasysh se ajo përputhet me dëshmitë e tjera të përmendura në këtë pjesë.

31. Radovan Paponjaku konfirmoi se faktikisht pati shpërngulje të madhe të popullatës, por dha një shpjegim të ndryshëm nga Zatriqi dhe Konaj në lidhje me arsyet e largimit të njerëzve nga ajo zonë në fund të marsit. Paponjaku dëshmoi se pas fillimit të bombardimeve të NATO-s, ai konstatoi më shumë "lëvizje njerëzish dhe makinash nëpër rrugë," por pretendoi se nuk i kujtohej ndonjë ngjarje e veçantë më 27 dhe 28 mars.⁶⁷ Ai pranoi se shqiptarët e Kosovës po largoheshin nga

⁶⁴ Ndrec Konaj, P2372 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 qershor 2001), f. 5.

⁶⁵ Ndrec Konaj, P2372 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 qershor 2001), f. 5, T. 4913 (16 tetor 2006).

⁶⁶ Ndrec Konaj, P2372 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 qershor 2001), f. 5.

⁶⁷ Radovan Paponjak, T. 24551-24552 (19 mars 2008).

shtëpitë e tyre masivisht dhe shkuan kryesisht në drejtim të Malit të Zi dhe Shqipërisë në kolona të organizuara. Sidoqoftë, sipas Paponjakut, kjo ndodhi sepse ata donin t'u iknin bombardimeve të NATO-s, që po goditnin shtëpitë e tyre.⁶⁸ Ai tha se askush nga ushtria apo policia nuk i kishte urdhëruar civilët të shkonin për në Shqipëri.⁶⁹

32. Të dhënat e dokumentuara të bombardimeve të NATO-s mbi objektivat në komunën e Pejës nuk mbështesin shpjegimin e Paponjakut. Shënimet në ditarin e luftës të Batalionit të Blinduar të Brigadës së 125-të të Motorizuar për 26, 27, 28, dhe 29 mars tregojnë qartë se ato ditë nuk ka pasur sulme.⁷⁰ Bombardimi i parë i regjistruar në ditarin e luftës është në datën 30 mars, ku lexohet se forcat e UJ-së "u tërhoqën nga pozicionet që ishin bombarduar një natë më parë."⁷¹ Shënimi për atë datë gjithashtu u referohet dy vendeve që ishin sulmuar, Bellopoja që ndodhet në periferi të qytetit të Pejës, dhe Zagërmja që ndodhet në jug të Bellopojës.⁷² Lista e "incidenteve dhe pasojave të bombardimeve të NATO-s" për territorin e SPB-së së Pejës, e nënshkruar nga Paponjaku, regjistron dëmin e parë në atë zonë të ketë ndodhur më 31 mars 1999.⁷³ Një raport lufte i Brigadës së 125-të të Motorizuar përmban edhe të dhëna për bombardimin e kazermës së UJ-së në Pejë e cila, së bashku me MPB-në e Pejës, ishin të vetmit shembuj konkretë të dhënë nga Paponjaku që kishin ndodhur më 1 prill 1999.⁷⁴

33. Duke pasur parasysh të gjithat këto të dhëna dhe faktin se, as Zatriqi, as Konaj nuk përmenden bombardimet e NATO-s si faktor që kishte kontribuar në largimin e tyre nga Peja më 27 dhe 28 mars 1999, Dhoma hedh poshtë shpjegimet e Paponjakut në lidhje me lëvizjen e popullatës në atë zonë. Shpjegimi i tij gjithashtu diskreditohet keqazi prej pretendimit të tij se nuk kishte forca të UJ-së apo civilë serbë të armatosur në qendër të Pejës në fund të marsit 1999.⁷⁵ Ditari i luftës ka të regjistruar praninë e njërive të brigadës në qytet që nga data 27 mars 1999,⁷⁶ dhe aty lexohet se më 28 mars 1999, "disa nga forcat tona morën pjesë në spastrimin e një pjese të qytetit të shkolla fillore dhe Asllan Çesma,⁷⁷ që përputhet me dëshmitë e Konajt dhe Zatriqit.

⁶⁸ Radovan Paponjak, 6D1603 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 mars 2008), para. 46.

⁶⁹ Radovan Paponjak, 6D1603 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 mars 2008), para. 54.

⁷⁰ P2802 (Ditari i Luftës i Batalionit të Blinduar të Brigadës së 125-të të Motorizuar) f. 1-3.

⁷¹ P2802 (Ditari i Luftës i Batalionit të Blinduar të Brigadës së 125-të të Motorizuar) f. 4-5.

⁷² P2802 (Ditari i Luftës i Batalionit të Blinduar të Brigadës së 125-të të Motorizuar) f. 5.

⁷³ 6D1557 (Lista e incidenteve dhe pasojave të bombardimeve të NATO-s në territorin e SPB-së së Pejës nga 24 mars deri më 10 qershor 1999).

⁷⁴ P2038 (Raport luftimi i Brigadës së 125-të të Motorizuar drejtuar PrK-së dërguar më 1 prill 1999), f. 1. *Shih gjithashtu* Radovan Paponjak, 6D1603 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 mars 2008), para. 43; Radojica Nikçeviq, T. 23243 (26 shkurt 2008).

⁷⁵ Radovan Paponjak, T. 24575, 24585 (19 mars 2008).

⁷⁶ P2802 (Ditari i Luftës i Batalionit të Blinduar të Brigadës së 125-të të Motorizuar) f. 2-11.

⁷⁷ P2802 (Ditari i Luftës i Batalionit të Blinduar të Brigadës së 125-të të Motorizuar) f. 3.

34. Përkundër pretendimit të tij se nuk i kujtohet ndonjë ngjarje e veçantë në Pejë më 27 dhe 28 mars 1999, Paponjaku dëshmoi se, si rezultat i raporteve që mori në fund të marsit në lidhje me lëvizjen e njerëzve në qytet dhe rrethinë e cila pengonte qarkullimin, ai dërgoi patrulla për drejtimin e qarkullimit në qendër të qytetit dhe më vonë shkoi edhe vetë atje. Kur mbërriti në qendër të qytetit, ai pa mijëra shqiptarë të Kosovës të mbledhur atje. Disa njerëz iu drejtuan turmës në shqip me megafon, por ai nuk kuptoi se çfarë thoshin; sidoqoftë, atij iu duk se gjendja kontrollohej në mënyrë të organizuar.⁷⁸ Edhe pse ishte oficeri më i lartë i SPB-së së Pejës atje,⁷⁹ ai nuk bëri asgjë për trajtimin e situatës dhe nuk i foli turmës.⁸⁰ Sidoqoftë, gjatë kohës kur ishte në qendër të qytetit, njerëzit iu afruan dhe e pyetën se a mund të shkonin në Gjakovë, Mal të Zi, apo Prishtinë dhe nëse "do të kishin kufizime për ta sa i përket lëvizjes."⁸¹ I pyetur se për çfarë arsye mund të ishte mbledhur turma në qendër të qytetit të Pejës ato ditë, Paponjaku u përgjigj se nuk e dinte pse mund të ishin mbledhur dhe pse po iknin nga qyteti, por supozoi se e bënë këtë për të njëjtën arsye si gjithë të tjerët: "frika nga bombardimet, sulmet, dhe konflikti me terroristë."⁸²

35. Për Dhomën Gjyqësore ky version i ngjarjeve nuk është bindës. Meqenëse ai ishte polici më i lartë për qarkullimin në Pejë në atë kohë, dëshmia e Konajt sugjeron se ai që kishte tentuar t'i ndante burrat nga gratë e fëmijët në sheshin e qytetit më 28 mars dhe që i kishte urdhëruar njerëzit të hipnin në autobusë për t'i çuar në kufi, kishte qenë vetë Paponjaku. Fakti se Paponjaku pranoi vetë se kishte qenë në qendër të qytetit afërsisht në atë kohë dhe se kishte biseduar me njerëzit në turmë e mbështet këtë dëshmi.

36. Paponjaku gjithashtu pretendoi se e vetmja lëvizje njerëzish që mund të ketë pasur lidhje me UJ-në dhe MPB-në e komunës së Pejës ishte zhvendosja e civilëve nga zonat ku ishin dislokuar njësitë luftarake për t'i mbrojtur ata nga operacionet luftarake dhe se kjo ishte bërë për të gjithë popullatën, pa dallim etnik.⁸³ Mirëpo, ditari i luftës i Batalionit të Blinduar të Brigadës së 125-të të Motorizuar, i cili ishte njësia kryesore e UJ-së e dislokuar në atë zonë gjatë asaj kohe, përmban vetëm shënimin se më datën 26 mars 1999 "bandat terroriste shqiptare" vepronin në pjesën perëndimore të qytetit të Pejës dhe se "njësitë u dislokuan për të bllokuar pjesën jugore të Pejës nga drejtimi i fshatit Raushiq," dhe se më 27 mars "gjatë ditës pati konfrontime me bandat terroriste

⁷⁸ Radovan Paponjak, 6D1603 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 mars 2008), para. 55, T. 24553-24554, 24573 (19 mars 2008).

⁷⁹ Radovan Paponjak, 6D1603 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 mars 2008), para. 55, T. 24575 (19 mars 2008).

⁸⁰ Radovan Paponjak, T. 24553, 24573-24574 (19 mars 2008).

⁸¹ Radovan Paponjak, T. 24555 (19 mars 2008).

⁸² Radovan Paponjak, T. 24577-24578 (19 mars 2008).

⁸³ Radovan Paponjak, 6D1603 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 mars 2008), para. 53.

shqiptare."⁸⁴ Asnjë operacion tjetër nuk është shënuar në Pejë apo rrethinë gjatë atyre ditëve.⁸⁵ Dhoma Gjyqësore nuk dëgjoi ndonjë dëshmi që konfirmonte se civilët po shpërnguleshin në këtë komunë për t'i mbrojtur.

37. Paponjaku gjithashtu mohoi praninë e përforcuar të policisë në qendër të Pejës në atë kohë.⁸⁶ Ai dëshmoi se ishin vetëm katër patrulla, secila me dy apo tre vetë, që ishte minimumi i nevojshëm për rregullimin e qarkullimit,⁸⁷ dhe shpjegoi se ato ditë mund të kenë qenë rreth 20-30 policë në qendër të qytetit.⁸⁸ Më tej ai shtoi se kishte "patrulla të rregullta" në qendër të Pejës, në tri pikat ose postbllloqet e tyre të përhershme: një në drejtim të Patriarkanës së Pejës, një në drejtim të Gjakovës, dhe e treta në drejtim të Mitrovicës.⁸⁹ Policët në këto postbllloqe përpiqeshin të ndihmonin lëvizjen e makinave dhe udhëtarëve.⁹⁰ Paponjaku mohoi fuqimisht se policia kontrollonte kahun e lëvizjes së popullatës ose kufizonte destinacionet se ku mund të shkonin.⁹¹ Ai pranoi se patrullat e policisë që mbikëqyrnin largimin e njerëzve, posaçërisht në postblllokun në Savine Vode në rrugën për në Kullë, ku kishte pjesëtarë të policisë së qarkullimit rrugor, policisë së përgjithshme, dhe policisë për ndjekjen e krimeve,⁹² i ndalnin automjetet për të kontrolluar njerëzit në to.⁹³ Megjithatë, ai deklaroi se policia e SPB-së së Pejës nuk i kishte përcjellë "refugjatët" deri në kufi,⁹⁴ dhe pohoi se "si shef i Degës së Qarkullimit Rrugor e kontrollova personalisht punën e punëtorëve të degës sime dhe e pashë me sytë e mi. Policët kanë vepruar në mënyrë ligjore."⁹⁵ Ai theksoi se efektiviteti i policisë "punoi sipas urdhrave të marra për rregullimin e qarkullimit trafikun përgjatë rrugës dhe mbi të gjitha për mbrojtjen e jetës dhe sigurisë së njerëzve dhe pasurisë dhe parandalimin e sjelljeve kriminale të grupeve të veçanta".⁹⁶

38. Në orvatje për të përgënjeshtuar provat në lidhje me bartjen e njerëzve me autobusë nga qendra e Pejës, Paponjaku tha se autobusët nuk mund të hynin në qendër të qytetit për shkak të rregullave të qarkullimit në fuqi në atë kohë.⁹⁷ Sidoqoftë, duket se ky pretendim bie në kundërshtim

⁸⁴ P2802 (Ditari i Luftës i Batalionit të Blinduar i Brigadës së 125-të të Motorizuar), f. 1-2.

⁸⁵ P2802 (Ditari i Luftës i Batalionit të Blinduar i Brigadës së 125-të të Motorizuar).

⁸⁶ Radovan Paponjak 6D1603 (deklarata e dëshmitarit 14 mars 2008), para. 59, T. 24552 (19 mars 2008).

⁸⁷ Radovan Paponjak 6D1603 (deklarata e dëshmitarit 14 mars 2008), para. 59, T. 24552 (19 mars 2008).

⁸⁸ Radovan Paponjak, T. 24575 (19 mars 2008).

⁸⁹ Radovan Paponjak, T. 24553, 24574 (19 mars 2008).

⁹⁰ Radovan Paponjak, T. 24553 (19 mars 2008).

⁹¹ Radovan Paponjak, 6D1603 (deklarata e dëshmitarit 14 mars 2008), para. 60.

⁹² Radovan Paponjak, T. 24580-24581 (19 mars 2008).

⁹³ Radovan Paponjak, T. 24579 (19 mars 2008).

⁹⁴ Radovan Paponjak, T. 24581 (19 mars 2008).

⁹⁵ Radovan Paponjak, 6D1603 (deklarata e dëshmitarit 14 mars 2008), para. 63.

⁹⁶ Radovan Paponjak, 6D1603 (deklarata e dëshmitarit 14 mars 2008), para. 58.

⁹⁷ Radovan Paponjak, T. 24556 (19 mars 2008).

me "Raport mbi dëbimin e dhunshëm të shqiptarëve, përndjekjen e tyre mbi baza racore dhe konfiskimin e dokumenteve të tyre personale," të shkruar nga ai në vitin 2002, në të cilin lexohet se shqiptarët e Kosovës u tubuan në qendër të Pejës rreth orës 10:00 paradite më 27 mars 1999 dhe se "ata kishin sjellë makinat te vendtubimi (autobusë, kamionë, traktorë, makina). Pasi ishin tubuar, shqiptarët u larguan me automjete apo në këmbë në drejtime të ndryshme."⁹⁸ Më tej, Paponjaku shpjegoi se "autobusët qarkullonin mjaft rregullisht në atë kohë dhe kishte autobusë që shkonin për në Beograd dhe pjesë të tjera të vendit" dhe sqaroi se "mund të shkohej në Mal të Zi, Prizren, Gjakovë dhe kishte autobusë urbanë dhe ndërurbanë. Njerëzit i përdornin autobusët normalisht."⁹⁹ Ai gjithashtu deklaroi se autobusët për transportimin e shqiptarëve të Kosovës deri në kufi nuk i organizoi policia,¹⁰⁰ dhe se nuk pa forcat e FRJ-së/Serbisë duke hipur civilë nëpër kamionë më 27 dhe 28 mars 1999.¹⁰¹

39. Dhoma Gjyqësore i pranon dëshmitë e paraqitura në rrëfimet përputhëse të Zatriqit dhe Konajt, të cilat mbështetën edhe nga prova shkresore. Në ndryshim nga dëshmitë e tyre, dëshmia e Paponjakut ishte në shumë pika mospërputhëse me të dhënat nga dokumentet e asaj kohe. Dhoma mendon se dëshminë së tij i mungon sinqeriteti dhe e konsideron jo të besueshme këtë dëshmi.¹⁰²

4. Shkatërrimet në Pejë

40. Si Edison Zatriqi, po ashtu edhe Ndrec Konaj u kthyen në Pejë pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Kumanovës, pasi kishin qenë i pari në Mal të Zi dhe i dyti në Shqipëri. Zatriqi dëshmoi se u kthye më 26 korrik 1999 dhe e gjeti shtëpinë dhe zyrën e biznesit krejtësisht të djegur. Gjithashtu ai i gjeti tre autobusët e tij në garazh ku i ishin konfiskuar; edhe ata ishin djegur.¹⁰³ Ishin shkatërruar edhe nja 10 autobusë të tjerë.¹⁰⁴ Ai mësoi nga miqtë dhe kolegët e tij se autobusët ishin djegur nga policia serbe.¹⁰⁵ Megjithëse Radovan Paponjaku dëshmoi se autobusët e Zatriqit ishin të parkuar afër punëtorisë/garazhit i cili përdorej për parkimin e automjeteve të policisë, të cilave u ra zjarri më 24 ose 25 mars 1999 i cili u përhap aq shumë sa kishte "djegur tërësisht" edhe autobusët e Zatriqit, ky shpjegim alternativ për dëmtimin e makinave nuk u përmend fare gjatë marrjes në

⁹⁸ 6D1543 (Raport mbi dëbimin e dhunshëm të shqiptarëve, përndjekja e tyre në baza racore, dhe konfiskimi i dokumenteve të identifikimit, maj 2002), f. 2.

⁹⁹ Radovan Paponjak, T. 24556 (19 mars 2008).

¹⁰⁰ Radovan Paponjak, T. 24584 (19 mars 2008).

¹⁰¹ Radovan Paponjak, T. 24586 (19 mars 2008).

¹⁰² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 404.

¹⁰³ Edison Zatriqi, P2347 (deklarata e dëshmitarit e datës 20 qershor 2001), f. 2-3, T. 4418 (29 shtator 2006).

¹⁰⁴ Edison Zatriqi, T. 4424 (29 shtator 2006).

¹⁰⁵ Edison Zatriqi, P2347 (deklarata e dëshmitarit e datës 20 qershor 2001), f. 2-3, T. 4418 (29 shtator 2006).

pyetje të Zatriqit nga Mbrojtja.¹⁰⁶ Zatriqi nuk ka qenë dëshmitar okular i djegies së autobusëve, por pretendimi i Paponjakut për rrethanat dhe datën e shkatërrimit është në kundërshtim me dëshminë e Zatriqit se kishte parë një nga autobusët e tij të mbushur me njerëz duke u larguar nga Peja më 28 mars 1999, të cilën Dhoma e ka pranuar si të vërtetë.

41. Përveç pronës së tij, Zatriqi vuri re se shtëpitë e shumë shqiptarëve të Kosovës ishin djegur dhe shkatërruar, por nuk pa asnjë shtëpi të serbëve, të dëmtuar. Ai gjithashtu pa se ishin shkatërruar shumë objekte fetare ishin shkatërruar, sidomos ishin shkatërruar tërësisht Xhamia e Çarshisë, Xhamia e Kuqe në Kapeshnicë, dhe Xhamia e Hamamit.¹⁰⁷ Konaj konfirmoi se kur u kthye në Pejë, pa se shumë shtëpi ishin shkatërruar dhe se xhamitë gjithashtu ishin dëmtuar.¹⁰⁸

42. Përveç dëshmimeve të dëshmitarëve okularë, Dhoma dëgjoji edhe dëshminë e Andrés Riedlmayer-it, ekspert i ftuar nga Prokuroria, i cili paraqiti një raport mbi shkatërrimin e trashëgimisë kulturore në Kosovë në vitet 1998-1999.¹⁰⁹ Ai dëshmoi se nga marsi 1998 deri në tetor 1999 në komunën e Pejës u dëmtuan shumë objekte fetare.¹¹⁰

43. Duke e kundërshtuar dëshminë e Riedlmayer-it në përgjithësi, Mbrojtja e Pavkoviqit vuri në dukje se ai nuk ishte as ekspert ushtarak, e as nuk kishte kualifikim teknik në këtë "fushë," kurse bashkautori i këtij raporti, Andrew Herscher, është arkitekt. Mbrojtja e Pavkoviqit pretendon se asnjëri prej tyre nuk është i kualifikuar si ekspert që të përcaktojë kohën dhe mënyrën e shkatërrimit të dëmeve.¹¹¹ Ajo vë në dukje se dëshmitari i përbashkët i Mbrojtjes si ekspert për trashëgiminë kulturore, Branimir Jokiç, dëshmoi se nuk ishte në gjendje të dallonte asnjë metodologji të përdorur nga Riedlmayer-i në raportin e tij dhe se raporti nuk ishte hartuar sipas standardeve profesionale.¹¹² Sipas Mbrojtjes së Pavkoviqit, Dhoma Gjyqësore nuk duhet t'u kushtojë rëndësi thashethemeve të përmendura në raportin e Riedlmayer si burime sepse ato nuk janë të verifikuara.¹¹³ Ajo gjithashtu pretendon se në lidhje me shkakun e disa dëmtimeve Riedlmayer ka nxjerrë përfundime duke u bazuar vetëm në fotografi dhe se kjo përbën standard jobindës për t'u bazuar nga një dëshmitar ekspert dhe ka pak apo aspak vlerë për Dhomën Gjyqësore.¹¹⁴

¹⁰⁶ Radovan Paponjak, T. 24593-24596 (19 mars 2008).

¹⁰⁷ Edison Zatriqi, T. 4418 (29 shtator 2006).

¹⁰⁸ Ndrec Konaj, T. 4890-4891 (16 tetor 2006). *Shih gjithashtu* P407 (Libri i Kaltër i OSBE/KVM-së).

¹⁰⁹ P1789 (Akt ekspertizë e Andrés Riedlmayer-it)

¹¹⁰ Andrés Riedlmayer, T. 5506-5507 (30 tetor 2006), *shih gjithashtu* T. 5514-5515 (30 tetor 2006), T. 5593, 5599-5600 (31 tetor 2006), T. 5625, 5628-5633 (1 nëntor 2006), P1550 (pjesë nga P1789), f. 13.

¹¹¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit në Gjykim, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 668.

¹¹² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit në Gjykim, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 667.

¹¹³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit në Gjykim, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 669.

¹¹⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit në Gjykim, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 670.

44. Riedlmayer-i dëshmoi se hetimi dhe zbulimi i autorëve të dëmtimeve ishte qëllim dytësor në lidhje me detyrën e tij parësore për evidentimin e dëmeve.¹¹⁵ Dhoma vëren se Riedlmayer-i nuk i vizitoi personalisht të gjitha objektet e përmendura në paragrafin 77(d) të Aktakuzës. Për ato objekte të cilat nuk i vizitoi, ai u bazua në një varg burimesh dytësore, ndër të tjera fotografitë dhe arkivin e të dhënave të marra nga "International Management Group," të cilat ai vetë i vë në pikëpyetje në raportin e tij.¹¹⁶ Ai pranoi se nuk është ekspert ushtarak dhe se nuk është kualifikuar lidhur me zjarrvënien apo municionet, por tha se kishte përvojë në ekzaminimin e ndërtesave të dëmtuara dhe se në rrethana të caktuar është i aftë të zbulojë shkakun a dëmtimeve të tilla.¹¹⁷

45. Ekspert i përbashkët i Mbrojtjes, Branimir Jokiq, i cili është profesor historie, u përqendrua në kritikën ndaj metodologjisë së përdorur nga Riedlmayer dhe Herscher dhe nuk bëri personalisht asnjë ekzaminim të ndërtesave që përmenden në raport për të provuar saktësinë e përfundimeve të tyre. Ai pranoi se nuk ishte ekspert i objekteve fetare myslimane. Në aktekspertizën dhe dëshminë e tij ai demonstroi një qasje tejet teorike, dhe u kufizua në hollësi të tilla si a ishin ndërtesat përkatëse të regjistruara si xhami dhe nuk ishte i gatshëm të diskutonte në mënyrë realiste dhe me logjikë të shëndoshë çështjen e dëmtimit të ndërtesave.¹¹⁸ Si rezultat, Dhoma Gjyqësore e konsideroi dëshminë e tij me pak ose aspak vlerë, gjatë përcaktimit nëse një godinë ishte faktikisht objekt fetar apo shkallën e dëmtimit të objekteve fetare.

46. Përgjithësisht Dhoma i konsideron aktekspertizën dhe dëshminë e Riedlmayer-it në si ndihmesë në përcaktimin e shkallës së dëmtimit të ndërtesave në fjalë, por në lidhje me shkakun e dëmtimeve kanë ndihmuar vetëm në një numër të kufizuar rastesh. Dhoma e gjykoi të nevojshme të analizonte në hollësi të gjitha provat përkatëse për çdo ndërtesë për të cilat ekzistojnë akuzat e dëmtimit ose shkatërrimit në mënyrë që të vendoste se çfarë peshe t'u kushtonte përfundimeve të aktekspertizës dhe dëshmisë së Riedlmayer-it. Këto fakte analizohen më poshtë në pjesët për secilën komunë.

47. Aktakuza nuk parashtroi akuza konkrete për shkatërrimin e ndonjë xhamie ose objekti fetar a monumenti kulturor në qytetin e Pejës. Gjithashtu, nuk ka prova për rrethanat e dëmtimit ose shkatërrimit dhe autorët e dëmtimit ose të shkatërrimit të objekteve të kësaj komune të përmendura nga Riedlmayer-i dhe xhamive të përmendura nga Zatriqi dhe Konaj. Provat ekzistuese nuk i mundësojnë Dhomës të nxjerrë ndonjë përfundim në lidhje me dëmtimin e pronës në Pejë.

¹¹⁵ Andrés Riedlmayer, T. 5534 (31 tetor 2006).

¹¹⁶ Andrés Riedlmayer, T. 5538 (31 tetor 2006); P1789 (aktekspertizë e Andrés Riedlmayer-it), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 34-35.

¹¹⁷ Andrés Riedlmayer, T. 5601-5602 (31 tetor 2006).

5. Konkluzionet faktike

48. Dhoma Gjyqësore konkludon se më 27 dhe 28 mars 1999 një numër i konsiderueshëm i shqiptarëve kosovarë në qytetin e Pejës u dëbuan drejtpërsëdrejti nga shtëpitë e tyre. Shumë nga këta njerëz u detyruan të shkonin në Shqipëri ose Mal të Zi. Dhoma nuk ka dyshim se forcat e UJ-së dhe të policisë, në bashkëpunim me civilë serbë të armatosur dhe forca të tjera jo të rregullta, vepruan së bashku në Pejë për të kontrolluar drejtimin e lëvizjes së banorëve shqiptarë të Kosovës në drejtim të Shqipërisë dhe Malit të Zi. Këto operacione nuk mund të kryheshin pa planifikim dhe bashkëveprim të konsiderueshëm. Rrjedhimisht Dhoma përfundon se dëbimi i popullatës shqiptare kosovare të qytetit u bë në mënyrë të organizuar duke përdorur forcat dhe mjetet të kontrolluara nga autoritetet e RFJ-së dhe qeverisë së Serbisë, ndër të cilat edhe UJ-ja dhe MPB-ja.

B. DEÇAN

1. Akuzat në Aktakuzë

49. Aktakuza i ngarkon të akuzuarit me përgjegjësi për tri kategori të ndryshme të krimeve kundër njerëzimit të cilat pretendohet se janë kryer në komunën e Deçanit: dëbim, zhvendosje e dhunshme, dhe përndjekje. Përndjekja e pretenduar thuhet se është materializuar nëpërmjet "dhunës seksuale nga forcat e RFJ-së dhe Serbisë kundër shqiptarëve kosovarë, veçanërisht kundër femrave."¹¹⁹

50. Akuzat konkrete janë parashtruar në paragrafin 72(1) të Aktakuzës, ku lexohet:

Më 29 mars 1999 ose rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë rrethuan dhe sulmuan fshatin Beleg dhe fshatra të tjera përreth në komunën e Deçanit. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë shkuan shtëpi më shtëpi dhe u thanë fshatarëve që t'i lëshonin shtëpitë e tyre menjëherë. Pastaj këto forca plaçkitën dhe dogjën shtëpitë. Disa burra, gra dhe fëmijë u nxorën nga shtëpitë e tyre dhe u mblodhën në një fushë të afërt në fshatin Beleg. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë urdhëruan të gjithë burrat dhe gratë që të zhvisheshin dhe tërë prona e tyre personale u konfiskua. Burrat u ndanë nga gratë dhe fëmijët dhe u çuan në bodrumin e një ndërtese afër fushës. Gratë dhe fëmijët u urdhëruan që të

¹¹⁸ *Shih për shembull* Branimir Jokiq, T. 2583-25875, 25878-25880, 25921-25921 (23 prill 2008).

¹¹⁹ Aktakuza, para. 77(c).

shkonin në një ndërtesë tjetër. Gjatë natës, së paku tri gra u dhunuan seksualisht. Të nesërmen, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë u thanë fshatarëve që të largoheshin nga fshati në kamionë dhe traktorë dhe të shkonin në Shqipëri.¹²⁰

2. Rrethanat

51. Komuna e Deçanit shtrihet në Kosovën perëndimore midis Pejës dhe Gjakovës dhe kufizohet me Shqipërinë edhe me Malin e Zi. Pjesa perëndimore e komunës është malore me disa fshatra që ndodhen në rrugët që lidhin Kosovën me Shqipërinë. Popullata e kësaj zone është thuhet e gjitha shqiptare kosovare.¹²¹ Gjatë tërë vitit 1998, Deçani ishte rrugë që UÇK-ja e përdorte për transportimin e armëve dhe njerëzve të stërvitur në kampe në Shqipërinë veriore për në Kosovë.¹²² Për këtë arsye autoritetet e RFJ-së/Serbisë ishin të interesuara ta kishin këtë komunë nën kontroll.¹²³ Raportet e MPB-së tregojnë se në vitin 1998 pati sulme të rregullta të UÇK-së kundër pozicioneve të MPB-së dhe UJ-së, kryesisht në fshatrat Prejlep dhe Drenoc.¹²⁴ Në vitin 1999 vazhduan përlëshjet sporadike midis UÇK-së dhe forcave të RFJ-së/Serbisë në Deçan.¹²⁵

3. Ngjarjet në komunën e Deçanit në fund të marsit 1999

52. Dhoma gjyqësore dëgjoi nga tre dëshmitarë të Prokurorisë për ngjarjet në fund të marsit 1999 në fshatrat e Drenocit dhe Belegut, që të dy në komunën e Deçanit në lindje dhe juglindje të qytetit të Deçanit. Ata ishin Mehmet Mazrekaj, i cili ishte kryeplak i fshatit dhe mësues nga Drenoci, K58, amvisë shqiptare e Kosovës nga i njëjti fshat, dhe K20, grua e re shqiptare e Kosovës, e cila u dhunua seksualisht më 29 mars 1999. Dhoma ka analizuar me kujdes besueshmërinë e këtyre dëshmitarëve, duke marrë parasysh ndër të tjera kundërshtimet që i janë bërë dëshmimeve të tyre gjatë fazës së pyetjeve nga Mbrojtja dhe në dosjet përfundimtare të palëve, si dhe përputhshmërinë me dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë dhe provat dokumentare. Dhoma vëren se

¹²⁰ Aktakuza, para 72(l).

¹²¹ P615 (Atlasi i Kosovës), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 7; Vladimir Llazareviq, T. 17761 (6 nëntor 2007).

¹²² John Crosland, 3D505 (transkripto nga *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 8023-8024; Vladimir Llazareviq, T. 17761 (6 nëntor 2007); Bozhidar Filiq, T. 23930-23931 (7 mars 2008).

¹²³ John Crosland, T. 9919 (8 shkurt 2007); 3D505 (transkript nga *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-t); Vladimir Llazareviq, T. 17761 (6 nëntor 2007); Mehmet Mazrekaj, T. 5816 (3 nëntor 2006); P1101 (Komanda e PrK-së për Shpërngulje, 5 shtator 1998).

¹²⁴ 6D491 (SPB në Gjakovë, plotësues i kallëzimit penal, 21 shtator 1998).

¹²⁵ 6D1014 (Raport i MPB-së në Prizren, 20 janar 1999); 6D1017 (Raport i MPB-së në Prizren, 28 janar 1999); 3D99 (Raport i incidenteve të UÇK-së në Kosovë, KVM); 6D1233 (Pasqyrë prej e MPB-së e zhvillimeve të sigurisë, 25 mars 1999), f. 4; 6D1234 (Pasqyrë prej e MPB-së e zhvillimeve të sigurisë, 26 mars 1999), f. 3; 6D614 (Pasqyrë prej MPB-së e veprave penale të evidentuara, 1 korrik 1998 deri 20 qershor 1999), f. 699/581; Radovan Zlatkoviq, 6D1627 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 prill 2008); para. 30; Dragan Zhivanoviq, T. 20469 (17 janar 2008).

të Akuzuarit nuk kanë ftuar asnjë dëshmitar për përgënjeshttrimin e dëshmime të K20-ës dhe K58-ës apo të Mazrekajt në lidhje me ngjarjet konkrete që ndodhën në Beleg nga 28 deri më 30 mars 1999. Dëshmia e Dragan Zhivanoviqit nuk ishte e bazuar në përjetim të drejtpërdrejtë personal të ngjarjeve në Beleg dhe Dhoma u jep përparësi dëshmime të drejtpërdrejta të K20-ës, K58-ës dhe të Mazrekajt. Në dëshminë e saj për këto ngjarje, K20-a i la Dhomës përshtypje si dëshmitare e besueshme. Edhe pse dëshmia e saj ndryshonte në disa hollësi nga dëshmia që kishte dhënë gjatë gjykimit të Millosheviqit, gjatë fazës së pyetjeve nga Mbrojtja ajo ofroi shpjegime bindëse mospërputhjet e përmendura. Kishte disa mospërputhje midis dëshmisë së K58-ës dhe dëshmime të Mazrekajt dhe K20-ës, për shembull në lidhje me datën e saktë të ngjarjeve në Beleg, por ajo pranoi se kujtesa e saj për hollësitë e vogla mund të ishte zbehur me kalimin e kohës.¹²⁶ Edhe pse Mazrekaj ishte i mjegullt në përgjigjet e tij në lidhje me UÇK-në dhe Dhoma e konsideron si jo të besueshëm në lidhje me shkallën e aktivitetit të UÇK-së në atë zonë, dëshmia e tij në lidhje me ngjarjet kryesore tij përputhej me dëshmitë e K20-ës dhe K58-ës. Përputhshmëria e përgjithshme e këtyre tri dëshmime e çon Dhomën në përfundim se ato janë përgjithësisht të besueshme dhe ajo i pranon ato.

53. K58-a dhe Mehmet Mazrekaj dëshmuar se, më 27 mars 1999, policia hyri në Drenoc dhe i përzuri banorët shqiptarë kosovarë të fshatit si dhe refugjatë prej fshatrave të tjera si Glllogjani dhe Sllupi.¹²⁷ Si pasojë, K58-a dhe banorët e tjerë të Drenocit shkuan në fshatin e afërt të Belegut.¹²⁸ Megjithëse Mazrekaj dhe K58-a deklaruan se fshatarët "u detyruan" ose "u përzunë" nga Drenoci, nuk ka dëshmi për ndonjë akt dhune të kryer kundër tyre gjatë kësaj kohe. Mazrekaj gjithashtu tha se "evakuimi" i fshatit u bë nga policia me pretekstin se priteshin bombardime të NATO-s.¹²⁹ Në ditarin e luftës së Brigadës së 125-të të Motorizuar, zona e përgjegjësisë e së cilës përfshinte fshatrat përreth Deçanit përfshirë edhe Drenocin dhe Belegun, është shënuar se pritej një sulm ajror i NATO-s më 27 mars 1999, por nuk thuhet se ku.¹³⁰ Në ditar gjithashtu shkruhet se më 27 apo 28 mars 1999 nuk pati sulme të NATO-s në zonën e përgjegjësisë së Brigadës së 125-të të Motorizuar.¹³¹

¹²⁶ K58, T. 7438 (29 nëntor 2006).

¹²⁷ K58, P2550 (deklarata e dëshmitarit e datës 2 shkurt 2000), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 12; Mehmet Mazrekaj, T. 5810 (3 nëntor 2006). Dhoma vëren se K20-a dhe Mehmet Mazrekaj përmendën të njëjtës datë për ngjarjet kryesore të përshkruara këtu. K58-a dëshmoi se forcat e RFJ-së/Serbisë arritën në Drenoc më 26 mars 1999. Sidoqoftë, ajo dëshmoi se i kishte harruar datat e sakta duke marrë parasysh kohën e gjatë që ka kaluar, K58, T. 7483 (29 nëntor 2006). Rrjedhimisht, datat e dhëna nga K20 dhe Mazrekaj janë të sakta duke pasur parasysh rrjedhën e ngjarjeve dhe datën e përcaktuar kur civilët u larguan nga Belegu.

¹²⁸ K58, P2550 (deklarata e dëshmitarit e datës 2 shkurt 2000), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 12-13; T. 7483 (29 nëntor 2006).

¹²⁹ Mehmet Mazrekaj, T. 5801-5803 (2 nëntor 2006).

¹³⁰ P2616 (Ditari i luftës i Brigadës së 125-të të Motorizuar), f. 8-10.

¹³¹ P2616 (Ditari i luftës i Brigadës së 125-të të Motorizuar), f. 8-10.

54. Fshatarët e shpërngulur arritën në Beleg diku nga ora 04:00 pasdite më 27 mars 1999.¹³² Edhe K58-a edhe Mazrekaj dëshmuar se atë ditë pati të shtëna.¹³³ Pasi e kaluan natën në Beleg, Mazrekaj pa të nesërmen ardhjen e forcave të armatosura të cilat i përshkroi si ushtri, polici, dhe paraushtarakë.¹³⁴ Gjatë fazës së pyetjeve nga Mbrojtja, Mazrekaj tha se pjesëtarët e UJ-së kishin uniforma dhe maska. Ai i dallonte "paraushtarakët" prej faktit se, megjithëse kishin "rroba ushtarake," ishin më të vjetër se ushtarët e rregullt të UJ-së.¹³⁵ Dhoma vëren se vullnetarët e inkuadruar në UJ gjatë bombardimeve të NATO-s gjithashtu përfshinin edhe grupe paraushtarake,¹³⁶ dhe se rezervistët e UJ-së, të cilët mund të kenë pasur vullnetarë të tillë, ndonjëherë vishnin uniforma të UJ-së me elemente jostandarde si kapela e maska si dhe nganjëherë kishin mjekra të gjata.¹³⁷

55. K20-a përshkroi ardhjen në Beleg të "policisë serbe dhe ushtarëve serbë" ose "të policisë dhe ushtrisë serbe" të shoqëruar me automjete të blinduara më 28 mars.¹³⁸ Ajo pa autoblanda dhe armë të rënda në fshat,¹³⁹ dhe përmendi "pëllumba në rreth" që i kishte parë në armën e një ushtari të UJ-së, që përputhet me dy shqiponja të bardha në sfond të kuq në emblemën e UJ-së.¹⁴⁰ Gjithashtu, kur iu tregua tabela me fotografi, ajo i identifikoi forcat e MPB-së me uniforma të PJP-së.¹⁴¹ K58-a dëshmoi se ushtria dhe policia erdhën më 27 mars dhe se u kthyen përsëri në mëngjesin e 28 marsit.¹⁴²

56. Ditari i luftës i Brigadës së 125-të të Motorizuar konfirmon se UJ-ja ishte duke kryer operacione në Deçan gjatë asaj kohe dhe se ishte angazhuar në operacione luftarake për t'i "dhënë

¹³² Mehmet Mazrekaj, P2374 (deklarata e dëshmitarit e datës 2 shkurt 2004), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 5

¹³³ K58, T. 7470, 7483-7484 (29 nëntor 2006); P2550 (deklarata e dëshmitarit e datës 2 shkurt 2000), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 13. K58-a dëshmoi se Belegu u granatua vazhdimisht më 28 mars. Megjithatë, ajo e pranoi se i ishte zbehur kujtesa për data konkrete dhe asnjë nga dëshmitarët e tjerë nuk përmendi granatim të Belegut. Rrjedhimisht, Dhoma nuk e pranon dëshminë e saj për granatimin e Belegut. *Shih gjithashtu* Mehmet Mazrekaj, P2374 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 shtator 2004), f. 20.

¹³⁴ Mehmet Mazrekaj, T. 5808-5809 (3 nëntor 2006).

¹³⁵ Mehmet Mazrekaj, T. 5809 (3 nëntor 2006).

¹³⁶ *Shih për shembull* një urdhër të Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë që lejon pjesëtarët e grupeve paraushtarake të bëhen vullnetarë nëse i përmbushin kërkesat e kontrollit, P1479 (Urdhër për Vullnetarët, 7 prill 1999), f. 3; dhe dëshmia e Branko Gajiqit se grupi paraushtarak "Pauk" e shmangu procedurën e pranimit dhe u inkuadrua në Brigadën e 125-të të Motorizuar, Branko Gajiq, T. 15308-15312 (10 shtator 2007).

¹³⁷ K73, T. 3310 (13 shtator 2006); P1599 (fotografi e forcave të armatosura të RFJ-së dhe Serbisë).

¹³⁸ K20, P2669 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 qershor 1999), f. 2; P2670 (transkript nga *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 2515-2516, 2519-2520 (e mbyllur me vulë).

¹³⁹ Ajo përshkroi ardhjen e kamionëve të ushtrisë, armëve si BRDM-2, Praga, dhe BOV-3 artileri kundërajrore të përdorura nga njerëz me uniforma të kaltra dhe të blerta kamufli. K20, P2669 (deklarata e dëshmitares e datës 9 qershor 1999), f. 2, 5, P2670 (transkript nga *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 2521 (e mbyllur me vulë);

¹⁴⁰ K20, P2670 (transkript nga *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 2521 (e mbyllur me vulë).

¹⁴¹ P2670 (transkript nga *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 2518-2519 (e mbyllur me vulë); P1326 (prova materiale me mostra të ndryshme të uniformave të përdorura nga njësitë e UJ-së dhe MPB-së), foto 6.

përkrahje" forcave të MPB-së.¹⁴³ Komandanti i atëhershëm i Brigadës së 125-të Motorizuar, Dragan Zhivanoviq, gjithashtu konfirmoi se në fund të marsit 1999 UJ-ja vepronte në zonën e Deçanit, por deklaroi se e vetmi luftim me UÇK-në në atë kohë kishte ndodhur më 29 mars në fshatin e afërt të Pozharit, ku UJ-ja kishte dërguar tre tanke në ndihmë të MPB-së.¹⁴⁴ Mazrekaj gjithashtu dëshmoi se kishte pasur një ballafaqim midis UÇK-së dhe "ushtarëve serbë" në atë zonë në atë kohë.¹⁴⁵ Bazuar në përshkrimin e efektivit të bërë nga K20-a, Mazrekaj, dhe K58-a, në konfirmimin e pranisë së UJ-së në atë zonë në ditarët e luftës, dhe në dëshmitë e tjera të përmendura më lart, Dhoma është bindur se pjesëtarët e UJ-së, përfshirë rezervistët e UJ-së, të cilët përshkruhen si paraushtarakë, dhe MPB-ja, përfshirë dhe PJP-në, mbërritën në Beleg më 28 mars 1999 ose rreth kësaj date.

57. Në një raport të KVM-së për incidentet me UÇK-në lexohet se më 22 mars 1999, UÇK-ja dëboi pesë familje serbe nga fshati Lloqan, që është afër Drenocit,¹⁴⁶ Mazrekaj pranoi se ata serbë ishin larguar nga fshati, por tha se nuk kishte dijeni për incidentin e pretenduar.¹⁴⁷ Përveç këtij incidenti mbi aktivitetin e UÇK-së në atë zonë, nuk ka prova të tjera për aktivitetin e UÇK-së në Beleg në periudhën midis 26 dhe 29 mars 1999.¹⁴⁸ Për më tepër, K20-a dëshmoi se nuk kishte forca të UÇK-së në Beleg edhe pse ishte e pranishme në atë zonë.¹⁴⁹

58. Rreth orës 6 të mëngjesit më 29 mars, K20-a dhe familja e saj u urdhëruan nga një polic që të shkonin në bodrumin e një shtëpie tjetër në fshat, në të cilën mbaheshin rreth 300 njerëz – përfshirë shumë fëmijë -- nga Belegu, Carrabregu, Drenoci, dhe Sllup.¹⁵⁰ Shumica e tyre ishin gra a fëmijë, meqë burrat e këtyre fshatrave kishin ikur ditët e mëparshme.¹⁵¹ Sidoqoftë, rreth 60 burra

¹⁴² K58, T. 7469 (29 nëntor 2006); P2550 (deklarata e dëshmitarit e datës 2 shkurt 2000), f. 2-4.

¹⁴³ P2616 (Ditari i luftës i Brigadës së 125-të të Motorizuar), f. 10; shih gjithashtu P2802 Ditari i Luftës i Batalionit të Blinduar të Brigadës së 125-të të Motorizuar, f. 3-4.

¹⁴⁴ Dragan Zhivanoviq, T. 20469-20470 (17 janar 2008); P2616 (Ditarë i Luftës i Brigadës së 125-të të Motorizuar), f. 10; P615 (Atlasi i Kosovës), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 21.

¹⁴⁵ Mehmet Mazrekaj, P2374 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 shtator 2004), f. 5; T. 5837-5838 (3 nëntor 2006). Mazrekaj tha se kishte dëgjuar se UÇK-ja kishte vrarë 18 "ushtarë serbë" në këtë incident, shifër të cilën Dhoma e konsideron të ekzagjeruar.

¹⁴⁶ 3D99 (Raport mbi incidentet e UÇK-së në Kosovë, KVM), f. 6.

¹⁴⁷ Mehmet Mazrekaj, T. 5851-5852 (3 nëntor 2006).

¹⁴⁸ Ka prova për prani të UÇK-së në Beleg në vitin 1998; 6D698 (Urdhri i PrK-së, 5 shtator 1998), gjithashtu e pranuar si P1101; 6D776 (Lista e vendeve të evakuara nga UÇK-ja në Kosovë), f. 3; 6D103 (deklarata e Iber Alajt e datës 20 gusht 1998); *shih sidoqoftë* K20, P2670 (transkript nga *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 2556 (e mbyllur me vulë). *Shih gjithashtu* 6D1014 (Raport i MPB-së së Prizrenit, 20 janar 1999); 6D1017 (Raport i MPB-së së Prizrenit, 28 janar 1999).

¹⁴⁹ K20, P2670 (transkript nga *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 2556 (e mbyllur me vulë). *Shih gjithashtu* P1969 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 28 mars 1999), f. 1.

¹⁵⁰ K20, T. 10055 (9 shkurt 2007); P2669 (deklarata e dëshmitares e datës 9 qershor 1999), f. 2-3, P2670 (transkript nga *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 2521 (e mbyllur me vulë).

¹⁵¹ K20, P2669 (deklarata e dëshmitares e datës 9 qershor 1999), f. 6.

kishin mbetur dhe u zunë nga forcat e RFJ-së/Serbisë.¹⁵² Gjatë ditës, i gjithë grupi i shqiptarëve kosovarë u çuan në një fushë, ku disa prej tyre u kontrolluan nga forcat e RFJ-së/Serbisë kurse të tjerët u dërguan në bodrum për t'u kontrolluar.¹⁵³ K20-a përshkroi rrahjen e një shqiptari kosovar para syve të saj sepse i kishte folur komandantit kur ai e kishte pyetur për prejardhjen duke i thënë se ishte shqiptar.¹⁵⁴ Edhe Mehmet Mazrekaj i cili ishte në mesin a atyre që mbaheshin në bodrum në atë kohë, u rrah dhe më vonë u zhvesh dhe u kontrollua nga një polic trafikë nga Deçani, të cilin ai e njohte si ish-nxënës të tij dhe i cili ishte me uniformë të policisë së rregullt.¹⁵⁵ K58-a gjithashtu konfirmoi se kishte parë Mazrekajn duke u rrahur dhe keqtrajtuar nga një polic.¹⁵⁶ Mazrekaj gjithashtu pa policinë dhe "paraushtarakët" duke i rrahur e keqtrajtuar burrat e tjerë.¹⁵⁷

59. Mazrekaj, K20-a, dhe K58-a dëshmuar edhe për vrasjen ndër të tjerë të Qazim Hulajt, Daut Aliçkajt, Nezir Vishajt, dhe Naim Vishajt gjatë grumbullimit të popullatës së Belegut nga policia dhe "paraushtarakët." Edhe pse asnjë nga këto vrasje nuk figuron si vrasje në Aktakuzë, dëshmitë në lidhje me to janë qenësore për Dhomën gjatë shqyrtimit të gjendjes në fshat dhe rrethanave të largimit të shqiptarëve kosovarë të pranishëm në fund të marsit 1999. K58-a përshkroi se si kishte parë kur kishin qëlluar me armë në faqe Nezir Vishajn në kohën kur me urdhër të policisë ajo dhe një grup prej rreth 100 vetësh ishin duke dalë nga shtëpia e Naim Vishajt në Beleg.¹⁵⁸ Në lidhje me Daut Aliçkajn, K58-a tha se e kishte parë kur ra përtokë pasi polici që kishte shtënë kundër Nezir Vishajt, shtiu edhe kundër tij.¹⁵⁹ Mazrekaj dëshmoi se e kishte parë kufomën e Daut Aliçkajt që dergej midis dy shtëpive.¹⁶⁰ Mazrekaj dëgjoi se Qazim Hulaj ishte vrarë nga forcat e RFJ-së/Serbisë duke ikur nga një shtëpi në Beleg dhe se Daut Aliçkaj gjithashtu ishte vrarë.¹⁶¹ Një grua e cila ishte mbajtur në bodrum i tha K20-ës se babai dhe një kushëri i saj ishin vrarë nga policia dhe ushtria.¹⁶² Gjithashtu K20-a dëgjoi nga një person tjetër i mbajtur me të në bodrum se "serbët" kishin vrarë dy burra nga Belegu në kohën kur ata po dorëzoheshin.¹⁶³

¹⁵² K20, P2669 (deklarata e dëshmitares e datës 9 qershor 1999), f. 6.

¹⁵³ K20, P2669 (deklarata e dëshmitares e datës 9 qershor 1999), f. 3-4; Mehmet Mazrekaj, P2374 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 shtator 2004), f. 7; K58, P2550 (deklarata e dëshmitarit e datës 2 shkurt 2000), f. 5.

¹⁵⁴ K20, P2670 (transkript nga *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 2523 (e mbyllur me vulë).

¹⁵⁵ Mehmet Mazrekaj, T. 5810, 5834 (3 nëntor 2006), P2374 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 shtator 2004), f. 7.

¹⁵⁶ K58, T7487 (29 nëntor 2006), K58, P2550 (deklarata e dëshmitarit e datës 2 shkurt 2000), versioni elektronik f. 15.

¹⁵⁷ Mehmet Mazrekaj, T. 5810 (3 nëntor 2006); *shih gjithashtu* K58, P2550 (deklarata e dëshmitares e datës 2 shkurt 2000), f. 5.

¹⁵⁸ K58, P2550 (deklarata e dëshmitares e datës 2 shkurt 2000), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 13-14.

¹⁵⁹ K58, P2550 (deklarata e dëshmitares e datës 2 shkurt 2000), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 14.

¹⁶⁰ Mehmet Mazrekaj, P2374 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 shtator 2004), f. 9.

¹⁶¹ Mehmet Mazrekaj, P2374 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 shtator 2004), f. 6-7.

¹⁶² K20 P2670 (transkript nga *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 2521 (e mbyllur me vulë).

¹⁶³ K20, P2699 (deklarata e dëshmitares e datës 9 qershor 1999), f. 3.

60. Pasditen e 29 marsit, shqiptarët kosovarë të arrestuar u urdhëruan të dilnin jashtë nga bodrumi dhe u keqtrajtuuan sërish.¹⁶⁴ K20-a dëshmoi se u çuan në një fushë të afërt. Gjatë rrugës, policë dhe nja 100 ushtarë i kërcënuan me armë të rënda dhe disa nga burrat u rrahën me pushkë.¹⁶⁵ Të gjithë fshatarët "u kontrolluan" se mos kishin para të fshehura dhe iu morën të gjitha dokumentet dhe gjërat me vlerë.¹⁶⁶ Gjatë kësaj kohe, gratë u urdhëruan të zhvisheshin dhe u kontrolluan dhe pas kësaj u kthyen te fusha, shpesh me rrobat e tyre në duar, ku u lanë të prisnin në shi deri në muzg.¹⁶⁷ Sidoqoftë, K58-a dëshmoi se disa nga sendet e konfiskuara, përfshirë bizhuteri dhe flori që ishte marrë nga gratë, iu kthyen fshatarëve të nesërmen.¹⁶⁸ Rrjedhimisht, Dhoma nuk konsideron se këto dëshmi nuk vërtetojnë pretendimin e plaçkitjes.

61. Kur ra nata, gratë, ndër të cilat edhe K20-a dhe K58-a, u çuan në dy dhoma dhe një ahur apo stallë në oborr të një shtëpie në Beleg.¹⁶⁹ Më vonë atë natë, dy ose tre ushtarë të UJ-së dhe një polic, së paku njëri prej të cilëve fliste shqip,¹⁷⁰ hynë në njërën nga dhomat ku mbaheshin gratë dhe thanë se iu duheshin "vajza" për të pastruar.¹⁷¹ Disa gra më të moshuara dolën vullnetare, por ushtarët përdorën elektrikët e dorës për të zgjedhur pesë gra ose vajza më të reja.¹⁷² K20-a, një nga pesë të zgjedhurat, shpjegoi se si, pasi iu kishin ofruar cigare dhe iu kishin drejtuar dritën në fytyrë, ushtarët i kishin thënë dy prej vajzave të ktheheshin në dhomë.¹⁷³ Tre vajzat e mbetura u çuan në një shtëpi tjetër.¹⁷⁴

¹⁶⁴ Mehmet Mazrekaj, T5810 (3 nëntor 2006).

¹⁶⁵ K20, P2669 (deklarata e dëshmitares e datës 9 qershor 1999), f. 3-4, K20, P2670 (transkript nga *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 2523-2524 (e mbyllur me vulë).

¹⁶⁶ K20, P2670 (transkript nga *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 2524-2525 (e mbyllur me vulë), P2669 (deklarata e dëshmitares e datës 9 qershor 1999), f. 4; K58 P2550 (deklarata e dëshmitarit e datës 2 shkurt 2000), versioni elektronik f. 14-17, K58, T. 7468 (29 nëntor 2006).

¹⁶⁷ K20, P2669 (deklarata e dëshmitares e datës 9 qershor 1999), f. 4; K58, P2550 (deklarata e dëshmitarit e datës 2 shkurt 2000), f. 5; Mehmet Mazrekaj, P2374 (deklarata e dëshmitares e datës 18 shtator 2004), f. 8.

¹⁶⁸ K58, P2550 (deklarata e dëshmitares e datës 2 shkurt 2000), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 16-17; K58, T7468 (29 nëntor 2006).

¹⁶⁹ K20, P2670 (transkript nga *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T2525-2526 (e mbyllur me vulë); K58, P2550 (deklarata e dëshmitarit e datës 2 shkurt 2000), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 16.

¹⁷⁰ K20, P2670 (transkript nga *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 2526-2527 (e mbyllur me vulë); K58, P2550 (deklarata e dëshmitarit e datës 2 shkurt 2000), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 16.

¹⁷¹ K20, P2670 (transkript nga *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 2527 (e mbyllur me vulë), P2669 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 qershor 1999), f. 4; K58, P2550 (deklarata e dëshmitarit e datës 2 shkurt 2000), f. 6, 16; K58, T. 7467, 7477 (29 nëntor 2006).

¹⁷² K20, P2670 (transkript nga *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 2527 (e mbyllur me vulë); K58, P2550 (deklarata e dëshmitarit e datës 2 shkurt 2000), f. 6.

¹⁷³ K20, P2669 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 qershor 1999), f. 4, P2670 (transkript nga *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T2527 (e mbyllur me vulë).

¹⁷⁴ K20, P2669 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 qershor 1999), f. 4-5, P2670 (transkript nga *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T2527-2528 (e mbyllur me vulë).

62. K20 u çua në banjë vetëm dhe një ushtar e zhveshi me forcë dhe e përdhanoi.¹⁷⁵ Gjatë kohës së këtij incidenti, polici dhe ushtarët e tjerë qëndronin në pragun e derës dhe nganjëherë e ndriçonin pamjen me llambë.¹⁷⁶ Kur kishte mbaruar ushtari i parë, K20 kishte tentuar të vishej, por polici e kishte goditur me shuplakë dhe ajo e kishte humbur vetëdijen përkohësisht. Më tej ajo u përdhunua nga ushtari i dytë, dhe më pas nga i treti.¹⁷⁷ Edhe pse polici i tha se ushtari i tretë do të ishte i fundit, një ushtar i katërt hyri në banjë nga korridori dhe e përdhanoi.¹⁷⁸ K20-a nuk ishte në gjendje të përshkruante ndonjë ushtar në veçanti, por dëshmoi se të gjithë kishin uniforma të blerta kamuflimi, disa me emblema, dhe të gjithë flisnin serbisht.¹⁷⁹ Kur po e përdhunonin në banjë, K20-a dëgjoi një të tjerë nga dy vajzat e tjera të cilat ishin marrë në shtëpi me të duke ulëritur në dhomën tjetër.¹⁸⁰ Kur K20-a u lejua të largohej nga shtëpia, polici i cili fliste shqip i tha se "UÇK-ja kishte bërë më zi se ata. Ti mund t'i përballosh ata."¹⁸¹ Kur po largohej, ajo e dëgjoi edhe vajzën e dytë nga dy vajzat e tjera të zgjedhura duke ulëritur. Afërsisht pas një gjysmë ore pasi ishte kthyer aty ku mbaheshin gratë e tjera, u kthye njëra nga dy vajzat e tjera, kurse tjetra erdhi pak më vonë. E para tha se nuk i kishin kërkuar të bënte gjë, e dyta tha se e kishin detyruar të fshinte, por dukej e "humbur."¹⁸² K20-a konkludoi se edhe dy vajzat e tjera ishin përdhunuar sepse "ulërimat e tyre ishin të njëjta si ulërimat e mia kur po më përdhunonin."¹⁸³

63. K58 përshkroi se si, në kohën që K20 dhe dy vajzat e tjera kishin qenë jashtë dhomës, "paraushtarakët" zgjodhën gra të tjera të reja të cilët erdhën në dhoma katër ose pesë herë, derisa ishin marrë rreth 20 gra dhe vajza të reja, kurse e fundit u kthye rreth orës 5 të mëngjesit.¹⁸⁴ Këto vajza u kthyen të tronditura dhe duke qarë dhe K58-a dëgjoi një të tjerë prej tyre kur i tha nënës së vet se ishte përdhunuar.¹⁸⁵

64. Rrëfimi bindës i K20-ës për vuajtjet e saj, i mbështetur nga dëshmia e K58-ës, e bind Dhomën se ajo u përdhunua nga ushtarët e UJ-së. Në rrethanat e përshkruara nga K20-a dhe K58-a, ku gra të reja u përzgjedhën dhe u morën për periudha të gjatë kohore gjatë natës, dhe bazuar në

¹⁷⁵ K20, P2670 (transkript nga *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 2529-2530 (e mbyllur me vulë).

¹⁷⁶ K20, P2670 (transkript nga *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 2531 (e mbyllur me vulë).

¹⁷⁷ K20, P2669 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 qershor 1999), f. 5, P2670 (transkript nga *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 2531 (e mbyllur me vulë).

¹⁷⁸ K20, P2669 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 qershor 1999), f. 5.

¹⁷⁹ K20, P2669 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 qershor 1999), f. 5, P2670 (transkript nga *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 2538-2540 (e mbyllur me vulë).

¹⁸⁰ K20, P2669 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 qershor 1999), f. 6.

¹⁸¹ K20, P2669 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 qershor 1999), f. 5.

¹⁸² K20, P2669 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 qershor 1999), f. 6.

¹⁸³ K20, P2669 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 qershor 1999), f. 6, P2670 (transkript nga *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 2532 (e mbyllur me vulë).

¹⁸⁴ K58, P2550 (deklarata e dëshmitarit e datës 2 shkurt 2000), f. 6.

përshkrimet e K20-ës të ulërimave që kishte dëgjuar të dy grave të reja që ishin marrë së bashku me të, Dhoma konsideron se i vetmi përfundim logjik që mund të nxirret është se edhe këto dy të reja se paku janë dhunuar seksualisht dhe se gruaja të cilën e dëgjoi K58-a gjithashtu ishte përdhunuar.

65. Gratë u mbajtën në shtëpi deri në orën 8 ose 9 të nesërmen në mëngjes, 30 mars 1999, kur u urdhëruan nga një polic, të cilin K20-a e përshkroi si "Komandanti," të largoheshin nga fshati për në Shqipëri.¹⁸⁶ K58-a tregoi se grave iu tha: "Shkoni në Shqipëri – vetë e kërkuat NATO-n."¹⁸⁷ Të udhëhequr nga tri autoblanda (një ushtarake dhe dy policore), fshatarët e shpërngulur u vunë në kolonë dhe u detyruan të largoheshin, kurse 10 nga burrat më të vjetër u lejuan të shkonin me kolonën dhe t'i ngisnin traktorët.¹⁸⁸ Sidoqoftë, 40-50 burra (disa nga Drenoci dhe Sllupi) u mbajtën atje dhe që atëherë nuk është dëgjuar më asgjë për ta.¹⁸⁹

66. Dragan Zhivanoviqi dëshmoi se nuk ishte e mundur që ndonjë autoblandë e UJ-së të ketë qenë në atë vend sepse në atë kohë njësia e tij (Brigada e 125-të e Motorizuar) nuk kishte autoblanda në atë zonë.¹⁹⁰ Mirëpo, duke u bazuar në dëshmitë e besueshme të Mazrekajt dhe K20-ës se UJ-ja ishte e pranishme në Beleg, Dhoma konkludon se autoblandat e UJ-së dhe MPB-së ishin të pranishme në fshat më 28 dhe 29 mars 1999.

67. Shqiptarët kosovarë nga Drenoci, Belegu, dhe fshatrat e tjera të afërta vazhduan në drejtim të jugut në kolonë me rreth 1.000 njerëz të shpërngulur deri në Kukës, Shqipëri.¹⁹¹ Gjatë rrugës ata u ndaluan shpesh nga pjesëtarë të MPB-së dhe UJ-së, të cilët iu kërkuan dokumente identifikimi, të cilat ua kishin marrë në Beleg.¹⁹² Gjithsesi Mazrekaj e la kolonën dhe shkoi në Isniq në veri të qytetit të Deçanit në kërkim të familjes së tij. Ai dhe familja e tij udhëtuan për në Shqipëri kur

¹⁸⁵ K58, T. 7468 (29 nëntor 2006); K58, P2550 (deklarata e dëshmitarit e datës 2 shkurt 2000), f. 6.

¹⁸⁶ K20, P2669 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 qershor 1999), f. 6.

¹⁸⁷ K58, P2550 (deklarata e dëshmitarit e datës 2 shkurt 2000), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 17; K20, P2669 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 qershor 1999), f. 6; K20, P2670 (transkript nga *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 2533 (e mbyllur me vulë).

¹⁸⁸ Mehmet Mazrekaj, T. 5811-5813 (3 nëntor 2006); K20, P2699 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 qershor 1999), f. 2.

¹⁸⁹ K20, P2670 (transkript nga *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 2533 (e mbyllur me vulë), P2669 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 qershor 1999), f. 6; K58, T. 7468 (29 nëntor 2006), P2550 (deklarata e dëshmitarit e datës 2 shkurt 2000), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 16.

¹⁹⁰ Dragan Zhivanoviq, T. 20471 (17 janar 2008).

¹⁹¹ Mehmet Mazrekaj, T. 5811-5812 (3 nëntor 2006); Mehmet Mazrekaj, P2374 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 shtator 2004), f. 10; K20, P2669 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 qershor 1999), f. 6; K58, P2550 (deklarata e dëshmitarit e datës 2 shkurt 2000), f. 7.

¹⁹² K58, P2550 (deklarata e dëshmitarit e datës 2 shkurt 2000), f. 7; Mehmet Mazrekaj, T. 5813 (3 nëntor 2006).

"serbët" filluan ta bombardonin Isniqin.¹⁹³ Rrugës ai pa policë në një urë në Gjakovë duke konfiskuar dokumentet e identifikimit të shqiptarëve kosovarë që po iknin.¹⁹⁴

4. Konkluzione

68. Dhoma konkludon se, më 28 mars 1999 ose rreth kësaj date, pjesëtarët e MPB-së, përfshirë edhe ata të PJP-së dhe UJ-së dhe rezervistët "paraushtarakë" të UJ-së, mbërritën në Beleg dhe ndaluan, keqtrajtuuan, dhe zhveshën e kontrolluan burrat shqiptarë kosovarë të atij fshati dhe fshatrave përreth, sulmuan fizikisht disa burra shqiptarë kosovarë, dhe konfiskuan dokumentet e identifikimit të fshatarëve. Më 29 mars 1999 ose rreth asaj date, së paku katër gra të reja të cilat ishin ndaluar, u morën nga disa pjesëtarë të UJ-së dhe MPB-së dhe u çuan në një godinë, ku dy nga ato u përdhunuan dhe dy të tjerat u dhunuan seksualisht. Të nesërmen, fshatarët u detyruan të linin Belegun dhe të shkonin për në Shqipëri, megjithëse një numër burrash u mbajtën aty.

69. Dhoma është bindur se UJ-ja dhe MPB-ja nuk ishin të angazhuara në luftime me UÇK-në në Beleg në atë kohë dhe se në atë zonë nuk kishte sulme të NATO-s. Ajo konkludon se pjesëtarët e UJ-së dhe MPB-së vepronin së bashku në Deçan për të siguruar dhe kontrolluar drejtimin e lëvizjes së shqiptarëve kosovarë të cilët i kishin dëbuar. Rrjedhimisht Dhoma konkludon se dëbimi i grupit të shqiptarëve kosovarë nga Belegu u krye në mënyrë të organizuar duke përdorur forcat dhe mjetet nën kontrollin e autoriteteve shtetërore të RFJ-së dhe Serbisë, ndër të cilat UJ-ja dhe MPB-ja.

C. GJAKOVË

1. Akuzat në Aktakuzë

70. Aktakuza i ngarkon të Akuzuarit me përgjegjësi për tri kategori shkeljesh themelore që pretendohen se janë kryer më komunën e Gjakovës nga 24 marsi 1999 deri më 11 maj 1999: shpërngulje të dhunshme, vrasje, dhe përndjekje.

71. Pretendimet faktike konkrete në lidhje me Gjakovën janë paraqitur në paragrafët 27(h) dhe 75(g) dhe (h) të Aktakuzës, ku parashtrahet vijon:

Në mars të vitit 1999, popullsia e qytetit të Gjakovës ishte rritur dukshëm për shkak të ardhjes së një numri të madh njerëzish të shpërngulur brenda vendit, të cilët ishin larguar nga fshatrat e tyre për t'i ikur granatimit të qëllimshëm të forcave të RFJ-së dhe të Serbisë gjatë vitit 1998 dhe për t'i ikur konfliktit të

¹⁹³ Mehmet Mazrekaj, P2374 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 shtator 2004), f. 10

¹⁹⁴ Mehmet Mazrekaj, P2474 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 shtator 2004), f. 10; Mehmet Mazrekaj, T. 5838 (3 nëntor 2006).

armatosur midis këtyre forcave dhe anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Lëvizja e vazhdueshme e këtyre personave të shpërngulur brenda vendit u shpeshtua pas datës 24 mars 1999, kur, pas dëbimeve me dhunë nga qyteti i Gjakovës, shumë njerëz të shpërngulur brenda vendit u kthyen nga qyteti i Gjakovës në fshatra përreth, por u dëbuan përsëri prej këtyre fshatrave nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë. Këto forca serbe kontrolluan dhe bashkërenduan lëvizjen e këtyre njerëzve të shpërngulur brenda vendit tek udhëtonin nga këto fshatra në qytetin e Gjakovës dhe anasjelltas dhe më në fund drejt kufirit midis Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë. Personat që udhëtonin në këmbë u dërguan drejtpërsëdrejti nga qyteti i Gjakovës në ndonjërin prej disa vendkalimeve kufitare. Njerëzit që udhëtonin me automjete së pari iu drejtuan qytetit të Prizrenit para se t'i afroreshin kufirit dhe të kalonin kufirin me Republikën e Shqipërisë.¹⁹⁵

Prej 24 marsit 1999 apo rreth kësaj date, deri më 11 maj 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë filluan të detyronin banorët e Gjakovës të largoheshin. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë shpërndaheshin nëpër qytet dhe shkonin shtëpi më shtëpi, duke urdhëruar shqiptarët kosovarë të largoheshin nga shtëpitë e tyre. Në disa raste, u vranë njerëz dhe shumë njerëz u kërcënuan me vdekje. Shumë shtëpi dhe dyqane të shqiptarëve kosovarë u dogjën, kurse ato të serbëve u mbrojtën. Më 24 mars 1999, xhamia e vjetër në Rogovë dhe lagja historike e Gjakovës që përfshinte çarshinë e vjetër, Xhaminë e Hadumit dhe Bibliotekën Islamike ngjitur me të, ishin ndër disa objekte kulturore që u shkatërruan dukshëm ose plotësisht. Gjatë periudhës prej 2 deri më 4 prill 1999, mijëra shqiptarë kosovarë, banorë të Gjakovës dhe të fshatrave përreth, iu bashkuan një kolone të gjatë njerëzish në këmbë apo me vetura, kamionë dhe traktorë, dhe shkuan në kufirin me Shqipërinë. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i drejtuan të ikurit në rrugë të caktuara që më parë, dhe në postblloqe policore gjatë rrugës, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë iu konfiskuan shumicës së shqiptarëve kosovarë letërnjoftimet dhe targat e makinave. Në disa raste për transportimin e njerëzve deri në kufirin me Shqipërinë u përdorën kamionët e Ushtrisë Jugosllave.¹⁹⁶

Për më tepër, në fund të marsit dhe në prill të vitit 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë dëbuan me dhunë banorët shqiptarë kosovarë të shumë fshatrave të komunës së Gjakovës, duke përfshirë fshatrat Dobrosh, Korenicë dhe Mejë. Shumë prej këtyre banorëve më vonë u urdhëruan ose u lejuan të ktheheshin në vendbanimet e tyre, vetëm për t'u dëbuar përsëri nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë. Në orët e hershme të mëngjesit të datës 27 prill 1999 ose rreth asaj kohe, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë filluan një sulm masiv kundër popullatës shqiptare kosovare të luginave të Caragojt, Erenikut dhe Travës (komuna e Gjakovës) për të dëbuar popullatën prej kësaj treve, duke përfshirë banorët e mbetur të fshatrave të lartpërmendura. U dislokuan një numër i madh ushtarësh dhe policësh dhe u ngritën disa postblloqe. Në Mejë, Korenicë dhe Orizë, një numër i madh dhe ende i pacaktuar burrash civilë, shqiptarë të Kosovës, u ndanë nga turma e fshatarëve që po iknin, u rrëmbyen, dhe u vranë. Gjatë tërë ditës, fshatarët e kërcënuar drejtpërsëdrejti nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë dilnin nga shtëpitë e tyre dhe u bashkëngjiteshin disa kolonave të refugjatëve me traktorë, qerre me kuaj dhe makina dhe më në fund kaluan në Shqipëri. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i

¹⁹⁵ Aktakuza, para. 72(h).

¹⁹⁶ Aktakuza, para. 72(h)(i)

konfiskuan letërnjoftimet e shumë shqiptarëve të Kosovës para se të kalonin kufirin.¹⁹⁷

Në orët e vona të mbrëmjes të datës 1 prill 1999 ose rreth asaj kohe, dhe duke vazhduar në orët e hershme të mëngjesit të 2 prillit 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë filluan një aksion kundër lagjes Qerimi të Gjakovës. Gjatë një periudhe prej disa orësh, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë hynë me forcë në shtëpitë e shqiptarëve të Kosovës në lagjen Qerimi, vranë banorët dhe u vunë zjarr shtëpive. Dhjetëra shtëpi u shkatërruan dhe mbi 50 persona u vranë. Për shembull, në një shtëpi në Rrugën Millosh Gilliq Nr. 157, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë pushkatuan njerëzit që ishin brenda dhe pastaj i vunë zjarr shtëpisë. Si pasojë e pushkatimeve dhe të zjarreve të ndezura nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë vetëm në këtë vend, u vranë 20 shqiptarë të Kosovës, duke përfshirë 19 gra dhe fëmijë. (Emrat e të vrarëve në këtë vend janë radhitur në Listën G, që i bashkëngjitet kësaj aktakuze si shtojcë.)¹⁹⁸

Në orët e hershme të mëngjesit të datës 27 prill 1999 ose rreth asaj kohe, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë filluan një sulm masiv kundër popullatës shqiptare kosovare të luginave të Caragojt, Erenikut dhe Travës (komuna e Gjakovës) për të dëbuar popullatën prej kësaj treve. U dislokuan një numër i madh forcash të RFJ-së dhe të Serbisë dhe u ngritën disa postblloqe. Gjatë tërë ditës, fshatarët e kërcënuar drejtpërsëdrejti nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë dilnin nga shtëpitë e tyre dhe u bashkoheshin disa kolonave të refugjatëve me traktorë, qerre me kuaj dhe makina. Në Mejë, Korenicë dhe Orizë, një numër i madh dhe ende i pacaktuar burrash civilë, shqiptarë të Kosovës, u ndanë nga turma e fshatarëve që po iknin dhe u rrëmbyen. Shumë prej këtyre burrave u ekzekutuan menjëherë, dhe rreth 300 persona ende mungojnë. Dokumentet personale të së paku shtatë personave dhe kufomat e shumë prej 300 personave të cilët u panë për herë të fundit në Mejë më 27 prill 1999 u gjetën në një varr masiv të fshehtë në qendrën stërvitore të SAJ-së në Batajnicë afër Beogradit në Serbi.¹⁹⁹

72. Në vijim në Aktakuzë parashtrohet se vrasjet e pretenduara më lart në Gjakovë,²⁰⁰ si dhe "shkatërrimi apo dëmtimi pa shkak i objekteve fetare të shqiptarëve kosovarë,"²⁰¹ përfshirë xhamitë në Gjakovë, gjithashtu përbënin përndjekje.²⁰²

2. Dëshmitarët kryesorë

73. Një numër dëshmitarësh të thirrur nga Prokuroria dhe Mbrojtja dëshmuan në lidhje me krimet që pretendohet se janë kryer në Gjakovë gjatë periudhës kohore që ka lidhje me Aktakuzën. Disa prej tyre janë veçanërisht të rëndësishëm dhe Dhoma do të analizojë besueshmërinë dhe

¹⁹⁷ Aktakuza, para. 72(h)(ii).

¹⁹⁸ Aktakuza, para. 75(g).

¹⁹⁹ Aktakuza, para. 75(h).

²⁰⁰ Aktakuza, para. 76.

²⁰¹ Aktakuza, para. 77(d).

²⁰² Aktakuza, para. 77(d).

saktësinë e tyre e tyre para se të shqyrtojë dëshmitë materiale në lidhje me këtë komunë. Dëshmitë e dhëna nga çdo dëshmitar ose në lidhje me çdo dëshmitar përmenden në pikën përkatëse të pjesës dhe në disa raste, përmenden konkretisht në vlerësimet e mëposhtme.

74. K90 ka qenë ushtar i UJ-së i vendosur në Gjakovë. Gjatë dëshmisë me gojë, K90-a minimizoi pretendimet e bëra prej tij në deklaratën si dëshmitar në lidhje me pjesëmarrjen e UJ-së në veprime kriminale në Gjakovë, sidomos nëpërmjet kërkesës së tij për të zëvendësuar termat "dëbim" dhe "dëbuar" me shprehjet "shpërngulje" dhe "shpërngulur" në lidhje me sjelljen e UJ-së ndaj civilëve shqiptarë kosovarë. Mirëpo, dëshmia e tij përputhej me dëshmitë e dhëna nga dëshmitarë e tjerë. Për shembull, rrëfimi prej tij i djegies së godinave në qytetin e Gjakovës ishte në përputhje me dëshminë e dhënë nga Fuat Haxhibeqiri dhe përshkrimi prej tij i ngjarjeve që lidhen me Korenicën dhe Mejën gjatë operacionit të Luginës së Caragojt përputhej me dëshmitë e pjesëtarëve të tjerë të UJ-së, K73, dhe Nikë Perajt, si dhe civilëve Merita Deda dhe Lizane Malaj. Besueshmëria e tij u sulmua disa herë ndër të tjerë nga Vllatko Vukoviqi, por këto sulme ishin të pabazuara, siç do të shpjegohet këtu. Në mënyrë të ngjashme edhe kundërshtitë e tjera në lidhje me praninë e K90-ës gjatë operacionit në luginën e Caragojt ishin të bazuar në deklarata të individëve që nuk ishin ftuar si dëshmitarë dhe nuk janë përfshirë si prova.²⁰³ K90-a gjithashtu u kundërshtua në lidhje me rrëfimin e tij për plagosjen e tre pjesëtarëve të Batalionit të 2-të të Motorizuar të Brigadës së 549-të të Motorizuar më 27 prill, meqenëse në ditarin e luftës të kësaj njësie ishte shënuar se pjesëtari i tretë faktikisht ishte plagosur më 28 prill.²⁰⁴ Duke theksuar se dy nga tre personat të përmendur nga K90 u plagosën më 27 prill, Dhoma gjykon se kjo mospërputhje nuk diskrediton besueshmërinë e dëshmisë së tij. Rrjedhimisht, Dhoma konkludon se K90-a ishte përgjithësisht i besueshëm dhe i saktë në aspektet e deklaratave të tij si dëshmitar të cilat ai i rikonfirmoi në dëshminë e tij gojore.

75. Hani Hoxha ishte banor shqiptar kosovar i qytetit të Gjakovës. Dëshmia e tij në lidhje me ngjarjet në shtëpinë e Vejsëve në fillim të prillit 1999 e gjithashtu edhe rrëfimi i tij për largimin nga Kosova përputhej me dëshmitë e Lulzim Vejsës dhe Dren Cakës në çdo aspekt qenësor, me përjashtim të deklaratës së tij se dokumentet e identifikimit i ishin marrë në kalimin kufitar Qafë e Prushit. Dhoma vëren se, megjithëse në deklaratën e tij Vejsa nuk përmendi marrjen e dokumenteve, ai nuk u pyet për këtë gjatë dëshmisë me gojë. Për më tepër, në përputhje me Hoxhën, edhe K74-a përmendi marrjen e dokumenteve në këtë kalim kufitar. Rrjedhimisht, Dhoma e konsideron Hoxhën përgjithësisht të besueshëm dhe të saktë.

²⁰³ K90, T. 9438 (30 janar 2007) (seancë private).

76. Lulzim Vejsa dhe Dren Caka ishin banorë shqiptarë kosovarë të qytetit të Gjakovës. Rrëfimet e tyre të ngjarjeve në shtëpitë e Vejsëve ishin bindëse, ndërperputhëse dhe të mbështetura nga të dhënat kriminalistike në provat e kësaj çështjeje. Dhoma konkludon se të dy ishin të besueshëm dhe të saktë. Dhoma vlerëson veçanërisht faktin se Dren Caka ishte vetëm 10 vjeç në kohën e ngjarjeve për të cilat foli. Ai i la përshtypje Dhomës si një i ri i pjekur.

77. Merita Deda ishte banore shqiptare kosovare e Guskës, Gjakovë. Dëshmia e saj në lidhje me ngjarjet që ndodhën gjatë operacionit të Luginës së Caragojt në prill 1999 përputhej me dëshminë e Lizane Malajt dhe konfirmohej nga rrëfimet e K90-ës dhe K73-it. Për më tepër, dëshmia e saj përputhej me provat kriminalistike përkatëse. Për shkak të disa mospërputhjeve të përmendura midis dëshmisë së saj dhe deklaratave të mëparshme, Dhoma është mbështetur në dëshminë e Dedës vetëm në ato raste kur ajo konfirmohet nga prova të tjera.²⁰⁵

78. K73 ishte ushtar në UJ. Dëshmia e tij përputhej me dëshmitarët e tjerë që nuk kishin lidhje me të, përfshirë këtu edhe Merita Dedën, K90-ën, dhe Lizane Malajn. Ai ishte i sigurtë në identifikimin e uniformave dhe pajisjeve dhe pranoi çdo herë kur nuk dinte diçka. Ai gjithashtu fliste serbisht dhe shqip dhe vinte nga një familje oficerësh të UJ-së. Duhet të ketë qenë vështirë për të që të dëshmonte për krimet e kryera nga ushtarët e UJ-së dhe Dhoma gjykon se ky element e shton besueshmërinë e dëshmisë së tij. Për këto arsye, Dhoma e konsideron K73-in të besueshëm dhe të saktë.

79. Lizane Malaj ishte banore shqiptare kosovare e Korenicës, Gjakovë. Ajo i la përshtypje Dhomës si dëshmitare e besueshme. Dëshmia e saj në lidhje me ngjarjet gjatë operacionit në Luginën e Caragojt përputhej me dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë, përfshirë Merita Dedën. Gjithashtu, dëshmia e saj përputhej me provat kriminalistike të pranuar në këtë çështje. Rrjedhimisht Dhoma e pranon dëshminë e saj.

80. Martin Pnishi ishte banor shqiptar kosovar i fshatit Mejë në Gjakovë. Rrëfimi i Pnishit për operacionin në Luginën e Caragojt përputhej me rrëfimin e K90-ës dhe të Nikë Perajt. Një mospërputhje midis përshkrimit prej tij të gjendjes në Kosovë në vitin 1998 dhe të Merita Dedës nuk është i rëndësishëm, meqenëse ajo tregoi përjetimet e saj si vajzë e re, kurse ai foli më shumë

²⁰⁴ K90, T9330 (29 janar 2007), T. 9432 (30 janar 2007); P2019 (Ditari i Luftës i Batalionit të 2-të të Motorizuar të Brigadës së 549-të të Motorizuar), f. 11-12 (e mbyllur me vulë).

²⁰⁵ 3D2 (Raport nga Arkivi i Të Dhënave të ICG-së), f. 1; Merita Deda, T. 1412 (10 gusht 2006).

për gjendjen e përgjithshme.²⁰⁶ Rrjedhimisht, Dhoma e konsideron këtë dëshmitar të besueshëm dhe përgjithësisht të saktë.

81. Fuat Haxhibeqiri ishte banor shqiptar kosovar i qytetit të Gjakovës. Dhoma vëren se pjesa më e madhe e dëshmisë së Haxhibeqirit ishte e bazuar më shumë në thashetheme se sa në përjetime personale dhe disa pjesë të saj ishin të paqarta. Ajo është e gatshme të mbështetet në dëshminë e tij vetëm kur është e bazuar në përjetime personale të drejtpërdrejta ose kur përputhet me prova të tjera nga burime të pavarura, në pajtim me vendimin e datës 8 shtator 2006 për kufizimin e pranimit të disa pjesëve të dëshmisë së Haxhibeqirit.²⁰⁷

82. Nikë Peraj ka qenë oficer i Brigadës së 52-të të Raketave Artilerike të UJ-së, me prejardhje nga zona e Gjakovës. Në lidhje me operacionin në luginën e Caragojt, rrëfimi i tij ishte bindës dhe përputhej me rrëfimet e dhëna në mënyrë të pavarur nga banorët e zonës së Mejës dhe Korenicës, Lizane Malaj dhe Merita Deda, si dhe nga pjesëtarë të tjerë të UJ-së, K90 dhe K73. Peraj u kundërshtua gjatë pyetjeve nga Mbrojtja në lidhje me identitetin e oficerit të UJ-së i cili, sipas tij, e kishte shoqëruar më 27 prill 1999 kur ai ishte dëshmitar i disa incidenteve rreth Mejës. Peraj pranoi se ai kishte përdorur emrin e një oficeri tjetër të UJ-së për të mbrojtur identitetin e personit që në të vërtetë e kishte shoqëruar. Ai e kishte bërë këtë me kërkesën e këtij personi, Sergej Peroviq. Duke theksuar se pranimi u bë menjëherë dhe pa hezitim, Dhoma nuk gjykon se ky fakt dëmton besueshmërinë e tij në aspektet materiale. Kundërshtimet ndaj dëshmisë së Perajt nga dëshmitarë të tjerë ishin ose të mjegullta, ose të pabaza, si p.sh pretendimi se ai nuk mund të hynte në një postëkomandë të UJ-së për shkak të gradës së ulët.²⁰⁸ Në fakt, Peraj mund të hynte në postëkomandën e UJ-së në Gjakovë, e cila ishte pjesërisht e vendosur në qendrën kulturore, siç e pranoi edhe Zdravko Vintari, i cili ishte pjesëtar i UJ-së në të njëjtën njësi si edhe Peraj.²⁰⁹ Rrjedhimisht, Dhoma e konsideron Perajn përgjithësisht të besueshëm dhe të saktë.

83. Zdravko Vintari ishte shef i Organit të Informimit dhe Moralit në Brigadën e 52-të Artilerike të Raketave. Dëshmia e tij u përqendrua kryesisht në përgënjeshttrimin e dëshmisë së Nikë Perajt dhe, në këtë aspekt, deklaratat e tij mbështeteshin pjesërisht nga dokumentacioni i UJ-së, siç ishte për shembull deklarata se njësia e Nikë Perajt u vendos në qendrën e kulturës në

²⁰⁶ Martin Pnishi, T. 1520 (11 gusht 2006), *Shih gjithashtu* Merita Deda, T. 1416-1422 (10 gusht 2006).

²⁰⁷ *Prokurori k. Millosheviqit e të tjerëve*, Vendimi për Provat e Marra Përmes Fuat Haxhibeqirit, 8 shtator 2006 (ku deklarohet se "nuk do të merren parasysh dëshmitë me gojë të dhëna nga dëshmitari që janë përsëritje e të dhënave të marra nga ai përmes hetimeve të bëra nga KMDLNj (Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut), por vetëm ato që janë pjesë e përjetimeve të tij të drejtpërdrejta"), f. 6.

²⁰⁸ Goran Jevtović, T. 20365 (16 janar 2008).

²⁰⁹ Zdravko Vintari, 5D1394 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 dhjetor 2007), para. 20-21; Nikë Peraj, P2253 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 gusht 2006), para. 27, 67; P1086 (Ditari i Luftës i Brigadës së 52-të të Raketave Artilerike), f. 9.

Gjakovë më 1 prill 1999.²¹⁰ Sidoqoftë, sulmet e Vintarit kundër besueshmërisë së Perajt u diskredituan kryesisht gjatë pyetjeve nga Prokuroria, si në rastin e mungesës së habitshme të njohurive të tij kur u pyet në lidhje me hollësitë e shtëpisë në të cilën ishte vendosur një pjesë e njësisë së tij në qytetin e Gjakovës.²¹¹ Pretendimi i Vintarit se nuk kishte dijeni se UJ-ja kishte hapur zjarr gjatë operacionit në luginës së Caragojt është në kundërshtim me dëshminë e K73-ish si dhe me dokumentacionin e UJ-së që evidenton luftime nëpër fshatra, duke përfshirë edhe Korenicën.²¹² Edhe pse Dhoma e konsideron të besueshëm në disa aspekte, njohuritë e tij për aspekte të rëndësishme ishin të kufizuara.

84. Vllatko Vukoviqi, i cili ishte komandant i Batalionit të 2-të të Motorizuar të Brigadës së 549-të të Motorizuar të Korpusit të Prishtinës, nuk i krijoi Dhomës përshtypjen e një dëshmitari të besueshëm. I pyetur në lidhje me një dënim për mashtrim, Vukoviqi këmbënguli në pafajësinë e tij me gjithë dokumentin evidentues të këtij dënimi, sado të vogël.²¹³ Gjithashtu, ai mohoi edhe kuptimin e shënimeve në ditarin e luftës së njësisë së tij duke mos dhënë asnjë shpjegim bindës për pretendimet e tij.²¹⁴ Rrjedhimisht Dhoma e ka pranuar dëshminë e tij, përgjithësisht, vetëm në lidhje me aspekte të pakundërshtuara.

85. Po ashtu, Dhoma nuk e konsideroi dëshmitar të besueshëm Momir Stojanoviqin, i cili ishte shef i sektorit të sigurimit të Korpusit të Prishtinës. Pretendimet e Stojanoviqit se ai nuk kishte qenë i implikuar në urdhërimin e operacioneve të njësive të UJ-së kundërshtohen nga shënimet në ditarin e luftës të Batalionit të 52-të Policisë Ushtarake se më 13 prill 1999, Stojanoviqi, shef i sektorit të sigurimit të Korpusit të Prishtinës ngarkoi një kompani të formuar posaçërisht të këtij batalioni me detyrë pushtimin e një poste kufitare në Kamenicë.²¹⁵

86. Sergej Peroviqi, i cili kishte qenë shef i sigurimit në Brigadën e 52-të të Raketave Artilerike, konsiderohet dëshmitar krejtësisht i pabesueshëm. Për shembull, mohimi i tij se kishte parë 20 kufoma gjatë operacionit në Luginën e Caragojt është në kundërshtim me dëshminë e pavarur të Aleksandar Vasileviqit se Peroviqi i kishte raportuar për 20 kufoma në atë kohë.

²¹⁰ Zdravko Vintar, 5D1394 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 dhjetor 2007), para. 20; P1086 (Ditari i Luftës i Brigadës së 52-të të Raketave Artilerike), f. 9

²¹¹ Zdravko Vintar, T. 21050 (25 janar 2008).

²¹² P2019 (Ditari i Luftës i Batalionit të 2-të të Motorizuar të Brigadës së 549-të të Motorizuar), f. 11 (e mbyllur me vulë).

²¹³ Vllatko Vukoviqi, T. 21329-21330 (29 janar 2008).

²¹⁴ P2019 (Ditari i Luftës i Batalionit të 2-të të Motorizuar të Brigadës së 549-të të Motorizuar), f. 11 (e mbyllur me vulë); Vllatko Vukoviqi, T. 21417-21418 (30 janar 2008).

²¹⁵ P2297 (Ditari i Luftës i Batalionit të 52-të të Policisë Ushtarake), f. 6. *Shih gjithashtu* K73, P2440 (deklarata e dëshmitarit), para. 33, T. 3313-3317 (13 shtator 2006).

87. Radovan Zllatkoviqi, i cili kishte qenë hetues i krimeve në SPB-në e Gjakovës, dha dëshmi jobindëse të hetimit të tij në lidhje me 40 kufomat e gjetura afër Mejës, duke refuzuar të shprehej mbi implikimin e UJ-së dhe MPB-së në këto vrasje.²¹⁶ Gjithashtu, ai tha se nuk mori dijeni për vdekjen e 300 shqiptarëve kosovarë në operacionin e Luginës së Caragojt në atë kohë, që tregon se njohuritë e tij në lidhje me këto ngjarje ishin të kufizuara.²¹⁷ Rrjedhimisht, dëshmia e tij konsiderohet përgjithësisht jo e besueshme në lidhje me ngjarjet në Gjakovë.

88. Dragan Zhivanoviqi, ish-komandant i Brigadës së 125-të të Motorizuar, ishte i besueshëm për disa aspekte por më pak për disa të tjera, dhe orvatjet e tij për të zvogëluar përfshirjen e UJ-së në operacione bie ndesh me dëshmitë e K73-it dhe K90-ës. Rrjedhimisht, Dhoma nuk mbështetet në dëshminë e tij në tërësi, por u referohet pjesëve konkrete të saj që kanë rëndësi.

89. Ashtu sikurse Dragan Zhivanoviqi, Sasha Antiqi, ish-komandant i një kompanie të policisë ushtarake për detyra të posaçme në Batalionin e 52-të të Policisë Ushtarake, ishte më i besueshëm për disa aspekte e më pak për të tjerat, dhe tentoi të pakësonte implikimin e UJ-së në veprime në një mënyrë që binte ndesh me dëshmitë e pjesëtarëve të UJ-së ,K73 dhe K90. Sidomos, shpjegimi i tij se disa pleq shqiptarë kosovarë në Ramoc u urdhëruan të rrinin në qytet për t'u siguruar se pjesëtarët e UJ-së nuk do të hynin nëpër shtëpi nuk tingëlloi i besueshëm për Dhomen dhe ishte në kundërshtim me dëshminë e K73-it për fatin e këtyre burrave.²¹⁸ Dhoma nuk mbështetet në dëshminë e tij në tërësi, por u referohet pjesëve konkrete të saj që kanë rëndësi.

90. Millan Koturi ishte shef i këmbëtorisë në Korpusin e Prishtinës dhe shef i ekipit të Korpusit të Prishtinës për bashkëpunim me KVM-në. Edhe pse ishte i besueshëm për disa aspekte, ai ishte më pak i besueshëm për disa të tjera dhe tentoi të minimizonte përfshirjen e UJ-së në operacionin e Luginës së Caragojt. Për shembull, ai dëshmoi se në këtë operacion u përdorën vetëm një numër i vogël i policisë ushtarake dhe paraushtarakëve të UJ-së, që bie në kundërshtim me një raport të asaj kohe ku lexohet se një kompani vullnetare e Brigadës së 549-të të Motorizuar u përdorur për të kontrolluar terrenin.²¹⁹ Rrjedhimisht, Dhoma nuk mbështetet në dëshminë e tij në tërësi, por u referohet pjesëve konkrete të saj që kanë rëndësi.

91. Goran Jevtoviqi ishte shef i degës operative në postëkomandën pararojë të Korpusit të Prishtinës. Pretendimi i tij se përshkrimi prej Nikë Perajt i operacionit në Luginën e Caragojt ishte

²¹⁶ Radovan Zllatkoviqi, T. 25305-25307 (15 prill 2008).

²¹⁷ Radovan Zllatkoviqi, T. 25314 (15 prill 2008).

²¹⁸ Sasha Antiq, 5D1443 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para. 25. *Shih* dëshminë e K73-it më poshtë në lidhje me këtë incident.

"tërësisht jorealit" nuk qëndron duke pasur parasysh dëshmitë e ngjashme në lidhje me operacionin të dhëna nga dëshmitarët e UJ-së si K73 dhe K90, siç është përshkruar këtu.²²⁰ Për më tepër, Jevtoviqi tha se ai vetë nuk kishte marrë pjesë në këtë aksion dhe se dëshmia e tij në lidhje me aksionin ishte e bazuar në çfarë kishte dëgjuar dhe lexuar në raportet luftarake.²²¹ Rrjedhimisht, njohurive të tij për ngjarjet rreth këtij operacioni mund t'u jepet vetëm rëndësi e kufizuar. Në lidhje me Komandën e Përbashkët, Jevtoviqi ofroi rrëfime kontradiktore, një herë duke pretenduar se dinte natyrën e këtij organi e pastaj duke mohuar çdo njohuri për të.²²² Për këto arsye, Dhoma nuk e konsideron dëshmitar të besueshëm për pika të debatueshme.

92. Natyrisht, ka pasur raste kur Dhoma Gjyqësore ka pranuar dëshmitë e atyre të cilëve dëshmia iu është refuzuar më përgjithësisht. Përveç këtyre dëshmitarëve, kishte dhe të tjerë të cilët dëshmuuan në lidhje me pikat e diskutuara këtu. Besueshmëria dhe saktësia e tyre është diskutuar kur ka qenë e rëndësishme për një aspekt konkret të diskutuar në tekstin më poshtë.

3. Rrethanat

93. Komuna e Gjakovës gjendet në pjesën perëndimore të Kosovës, në kufi me Shqipërinë, në mes të komunave të Prizrenit (në jug) dhe Deçanit (në veri).²²³ Qyteti më i madh në komunë, që gjithashtu quhet Gjakovë, është përfaqësues në qendër të komunës në rrugën kryesore prej Prizrenit për në Pejë. Fshatrat e përmendura në Aktakuzë janë përgjithësisht në perëndim dhe jug të qytetit të Gjakovës, dhe Lugina e Caragojt është në perëndim të qytetit.²²⁴ I akuzuari Llazareviq e ka përshkruar atë si një luginë me gjatësi prej 10 deri 15 kilometrash dhe me gjerësi prej tre deri pesë kilometrash e shtrirë në një zonë pranë kufirit me Shqipërinë, në mes Gjakovës dhe Deçanit.²²⁵

94. Nuk vihet në dyshim se një numër i madh civilësh u larguan nga qyteti i Gjakovës dhe fshatrat e komunës gjatë periudhës prej marsit deri në maj 1999. Shumë nga këta civilë përfunduan në kalimin kufitar të Qafës së Prushit, në jugperëndim të qytetit të Gjakovës dhe në kalimin kufitar

²¹⁹ Millan Kotur, T. 20729-20730 (21 janar 2008); P2026 (Raport Luftimi i Brigadës së 125-të të Motorizuar, 29 prill 1999), f. 2; *shih gjithashtu* Dragan Zhivanoviq, T. 20589-20590.

²²⁰ Goran Jevtoviq, T. 20408-20409 (16 janar 2008).

²²¹ Goran Jevtoviq, T. 20412 (16 janar 2008).

²²² Goran Jevtoviq, T. 20381-20383 (16 janar 2008), *shih edhe* 5D1385 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 dhjetor 2007), para. 15.

²²³ P615 (Atlasi i Kosovës), f. 30.

²²⁴ P35 (Harta e Gjakovës)ë P615 (Atlasi i Kosovës), f. 30.

²²⁵ Vladimir Llazareviq, T. 17812 (7 nëntor 2007).

të Vërbnicës, në jug të Prizrenit, dhe kaluan në Shqipëri.²²⁶ Prokuroria pretendon se këto dëbime ishin pjesë e një operacioni të organizuar kundër popullatës civile të Gjakovës dhe gjatë të cilit u kryen krime të shumta kundër shqiptarëve të Kosovës.²²⁷ Ekipet e Mbrojtjes i kundërshtuan këto pretendime dhe shkakun e ikjes masive²²⁸ ia atribuojnë luftimeve midis forcave të RFJ-së/Serbisë dhe UÇK-së, dhe frikës nga bombardimet e NATO-s apo pretendojnë se nuk është vërtetuar që krimet janë kryer nga forca nën komandën e të akuzuarit përkatës.²²⁹

4. Forcat e RFJ-së/Serbisë në Gjakovë

95. Nuk vihet në dyshim se njësitë e UJ-së ishin të pranishme në Gjakovë që nga pranvera e vitit 1998 dhe gjatë tërë fushatës ajrore të NATO-s nga 24 marsi deri në mes të qershorit 1999.²³⁰ Njësitë kryesore të UJ-së që vepronin në Gjakovë gjatë kësaj periudhe ishin Brigada e 549-të e Motorizuar, Brigada e 52-të e Raketave Artilerike, Batalioni i 52-të i Policisë Ushtarake, dhe Brigada e 125-të e Motorizuar.

96. Elementë të Brigadës së 549-të të Motorizuar, e cila komandohej nga Bozhidar Deliqi, ishin të vendosura në Gjakovë gjatë vitit 1998 dhe 1999.²³¹ Batalioni i 2-të i Motorizuar i Brigadës së 549-të të Motorizuar ishte i vendosur në Zhub, fshat në jugperëndim të qytetit të Gjakovës afër vendkalimit kufitar të Qafës së Prushit,²³² nën komandën e Vllatko Vukoviqit.²³³ Gjatë tërë pjesës së fundit të marsit 1999, kjo njësi ishte e angazhuar në fshatrat përreth Gjakovës dhe e ndihmoi MPB-në në "spastrimin" e terrenit.²³⁴

97. Nga data 4 deri më 10 prill 1999, Batalioni i 2-të i Motorizuar ishte i angazhuar në sigurimin e kufirit me Shqipërinë në Gjakovë.²³⁵ Gjatë 10 ditëve të ardhshme, ditari i luftës i batalionit nuk përmban shënime për ndonjë operacion të Brigadës së 549-të në Gjakovë, por vëren se gjatë asaj

²²⁶ *Shih për shembull* Vllatko Vukoviq, 5D1442 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para. 44-të Nikë Peraj, T. 1574 (14 gusht 2006), P326 (harta e operacionit të Luginës së Caragojt); Mahmut Halimi, T. 4456-4457 (9 tetor 2006). Lizane Malaj dëshmoi se e kishte kaluar kufirin në Vërmicë më 28 prill 1999 dhe se vendkalimi quhet Vrbnica nga serbët dhe Qafa e Morinës nga shqiptarët. Lizane Malaj T. 1383-1384, 1391 (10 gusht 2006). Sipas P615 (Atlasi i Kosovës), f. 26, kufiri quhet Vrbnica/Vërmicë në anën serbe dhe Morinë në anën shqiptare.

²²⁷ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 430 *e në vijim*.

²²⁸ *Shih* Dosja Përfundimtare Gjyqësore e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 1069 *e në vijim*.

²²⁹ *Shih* Dosjen Përfundimtare Gjyqësore të Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para 359 *e në vijim*.

²³⁰ Momir Stojanoviq, T. 19703 (6 dhjetor 2007); 3D996 (Raport i Sektorit të Sigurimit të Komandës së PrK-së, 12 qershor 1998), f. 1.

²³¹ P2019 (Ditari i Luftës i Batalionit të 2-të të Motorizuar të Brigadës së 549-të të Motorizuar) (e mbyllur me vulë).

²³² P35 (Harta e qytetit të Gjakovës)

²³³ Vllatko Vukoviq, T. 21401 (30 janar 2008), 5D1442 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para. 2, 42-44. P2019 (Ditari i Luftës i Batalionit të 2-të të Motorizuar të Brigadës së 549-të të Motorizuar) f. 2 (e mbyllur me vulë).

²³⁴ P2019 (Ditari i Luftës i Batalionit të 2-të të Motorizuar të Brigadës së 549-të të Motorizuar), f. 4-6 (e mbyllur me vulë).

²³⁵ P2019 (Ditari i Luftës i Batalionit të 2-të të Motorizuar të Brigadës së 549-të të Motorizuar), f. 6-8 (e mbyllur me vulë).

kohe njësitë e tyre bombardoheshin nga NATO-ja. Më 19 prill, Batalioni i 2-të i Motorizuar bllokoi dhe bastisi fshatrat Poshtë, Lipofc, dhe Gërçinë, të cilët gjenden në jug të qytetit të Gjakovës afër kufirit me Shqipërinë.²³⁶

98. Brigada e 52-të e Raketave Artilerike u UJ-së, nën komandën e Millosh Gjoshanit dhe zëvendësit të tij Novica Stankoviçit, ishte gjithashtu e vendosur në qytetin e Gjakovës nga dhjetori 1998.²³⁷ Shtabi i kësaj brigade u zhvendos në shtëpinë e kulturës të qytetit të Gjakovës më 1 prill 1999 kurse armët e saj u vendosën në kodrën e Çabratit në afërsi, në pjesën perëndimore të qytetit.²³⁸ Brigada e 52-të e Raketave Artilerike mori pjesë në operacione së bashku me MPB-në, si më 1 prill 1999 kur ajo kapi 30 shqiptarë kosovarë duke ikur nga Gjakova dhe ia dorëzoi MPB-së,²³⁹ dhe gjithashtu bashkëveproi me njësi të tjera të UJ-së, si më 13 prill 1999 kur një togë xhenierësh u dërgua për të ndihmuar Batalionin e 2-të të Motorizuar për vendosjen e minave.²⁴⁰

99. Batalioni i 52-të i Policisë Ushtarake u vendos në Prishtinë gjatë fundit të marsit dhe prillit 1999, dhe veprimet e tij u përqendruan kryesisht në zonën e Prishtinës.²⁴¹ Sidoqoftë, Sasha Antiqi, i cili ishte komandant në batalion, dëshmoi se më 12 ose 13 prill 1999, nga batalioni u formua një kompani e cila u vu nën varësinë e Brigadës së 125-të të Motorizuar e u dërgua në zonën afër pikës kufitare të Koshares në veri të Gjakovës për të përforcuar mbrojtjen e kufirit nga sulmet e "terroristëve" prej Shqipërisë.²⁴² Në ditarin e luftës të Batalionit të 52-të të Policisë Ushtarake është shënuar se kompania u ngarkua nga shefi i degës së sigurimit të Korpusit të Prishtinës që të merrte pikën kufitare të Kamenica, detyrë të cilën ata e përmbushën.²⁴³

²³⁶ P2019 (Ditari i Luftës i Batalionit të 2-të Motorizuar të Brigadës së 549-të të Motorizuar), f. 10 (i mbyllur me vulë); P35 (Harta e Gjakovës).

²³⁷ *Shih* Nikë Peraj, P2248 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 prill 2000), f. 8, P2253 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 gusht 2006), para. 4. Nikë Peraj ka katër deklarata; tri deklarata, të datës 18 prill 2000, 12-15 shkurt 2001, dhe 8 maj 2002, u pranuan si prova si një provë e Prokurorisë. *Shih* Nikë Peraj, P2248 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 prill 2000), (deklarata e dëshmitarit e datës 15 shkurt 2001), (deklarata e dëshmitarit e datës 8 maj 2002). Deklarata e katërt është P2253 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 gusht 2006).

²³⁸ P1086 (Ditari i Luftës i Brigadës së 52-të të Raketave Artilerike), f. 9; P10 (Harta e Gjakovës).

²³⁹ P1086 (Ditari i Luftës i Brigadës së 52-të Raketave Artilerike), f. 9.

²⁴⁰ P1086 (Ditari i Luftës i Brigadës së 52-të Raketave Artilerike), f. 12.

²⁴¹ P2997 (shënimet e luftës të Batalionit të 52-të të Policisë Ushtarake), f. 1-3.

²⁴² Sasha Antiq, 5D1443 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para. 15, 5D1398 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para. 8 (e mbyllur me vulë). *Shih gjithashtu* P2297 (Ditari i Luftës i Batalionit të 52-të Policisë Ushtarake), f. 6.

²⁴³ P2297 (Shënimet e luftës të Batalionit të 52-të të Policisë Ushtarake), f. 6.

100. Gjatë fushatës ajrore të NATO-s, Brigada e 125-të e Motorizuar nën komandën e Dragan Zhivanoviçit u vendos në Gjakovës dhe ishte veçanërisht aktive në mbrojtjen e zonës kufitare afër Koshares nga 10 prilli e më tej.²⁴⁴

101. Në fillim të prillit 1999, edhe Detashmenti i Mbrojtjes Territoriale të Gjakovës u urdhërua të vepronte në qytetin e Gjakovës dhe ndër të tjera u ngarkua me detyrë të ruante kazermat e UJ-së dhe godinat e tjera kyçe në qytet, të organizonte patrulla të përbashkëta me forcat e MPB-së, dhe të merrte pjesë në aksionet kundër UÇK-së në atë zonë.²⁴⁵

102. Më 27 dhe 28 prill 1999, disa njësi të UJ-së së bashku me forcat e MPB-së, ndërmorën një operacion në Luginën e Caragojt në perëndim dhe pak më në veri të qytetit të Gjakovës.²⁴⁶ Njësitë konkrete që morën pjesë në operacion ishin Brigada e 52-të e Raketave Artilerike,²⁴⁷ Brigada e 549-të e Motorizuar,²⁴⁸ Brigada e 63-të Parashutiste,²⁴⁹ Brigada e 125-të e Motorizuar,²⁵⁰ Batalioni i 52-të i Policisë Ushtarake,²⁵¹ dhe Detashmenti i 73-i PJP-së i Mbrojtjes Territoriale.²⁵² Sidoqoftë, asnjë urdhër me shkrim për fillimin e këtij operacioni nuk është midis provave të kësaj çështjeje.

103. Megjithëse atasheu ushtarak britanik John Crosland dëshmoi se në vitin 1998 ai hasi forca në Gjakovë të cilat mendonte se ishin "paraushtarakë",²⁵³ Radovan Zllatkoviçi, i cili kishte punuar

²⁴⁴ Dragan Zhivanoviç, T. 20478 (17 janar 2008); 5D468 (Raporti Luftarak i Brigadës së 125-të të Motorizuar, 11 prill 1999).

²⁴⁵ 6D750 (Urdhri i PrK-s, 31 mars 1999).

²⁴⁶ 3D836 (Raport luftimi i Sektorit për Operacione dhe Çështje të Personelit i SCS-së, 1 maj 1999), f. 3; P1086 (Ditari i Luftës i Brigadës së 52-të të Raketave Artilerike), f. 33; P2019 (Ditari i Luftës i Batalionit të 2-të të Motorizuar të Brigadës së 549-të Motorizuar), f. 11-12 (e mbyllur me vulë); P2567 (Raport luftimi i Batalionit të 2-të të Brigadës së 549-të, 27 prill 1999) (e mbyllur me vulë); P2568 (Raport luftimi i Batalionit të 2-të të Brigadës së 549-të, 28 prill 1999) (e mbyllur me vulë).

²⁴⁷ Sergej Peroviç, T. 21086 (25 janar 2008), Millan Kotur, T. 20679-20682 (21 janar 2008).

²⁴⁸ P2019 (Ditari i Luftës i Batalionit të 2-të të Motorizuar të Brigadës së 549-të të Motorizuar), f. 11-12, (e mbyllur me vulë), Bozhidar Deliq, T. 19641 (6 dhjetor 2007); Sergej Peroviç, T. 21086 (25 janar 2008); P2567 (Raport luftimi i Batalionit të 2-të të Brigadës së 549-të, 27 prill 1999) (e mbyllur me vulë); P2568 (Raport luftimi i Batalionit të 2-të të Brigadës së 549-të, 28 prill 1999) (e mbyllur me vulë).

²⁴⁹ Millan Kotur, T. 20679 (21 janar 2008); Sasha Antiq, T. 21176 (28 janar 2008) (seancë private).

²⁵⁰ Vladimir Llazareviç, T. 18689-18690 (21 nëntor 2007); Sergej Peroviç, T. 21086 (25 janar 2008); Vllatko Vukoviç, T. 21343 (29 janar 2008); Dragan Zhivanoviç, T. 20587-20590 (18 janar 2008), *Shih gjithashtu* P2023 (Raport luftimi i Brigadës së 125-të të Motorizuar, 25 prill 1999); P2024 (Raport luftimi i Brigadës së 125-të të Motorizuar, 27 prill 1999); P2025 (Raport luftimi i Brigadës së 125-të të Motorizuar, 28 prill 1999), f. 2; P2026 (Raport luftimi i Brigadës së 125-të të Motorizuar, 29 prill 1999), f. 2.

²⁵¹ Sergej Peroviç, T. 21086-21087 (25 janar 2008); Millan Kotur, T. 20679, 20734 (21 janar 2008).

²⁵² *Shih* K73, T. 3304, 3327 (13 shtator 2006) (seancë e mbyllur); P2023 (Raport luftimi i Brigadës së 125-të të Motorizuar, 25 prill 1999).

²⁵³ John Crosland, P2645 (deklarata e dëshmitarit e datës 31 tetor 2006), para. 15.

në SPB-në e Gjakovës deri në maj 1999, deklaroi se në atë zonë nuk kishin vepruar paraushtarakë.²⁵⁴

5. Aksionet e UÇK-së dhe NATO-s në Gjakovë

a. Bombardimi i Gjakovës nga NATO-ja

104. Zdravko Vintari dëshmoi se, që nga fillimi i bombardimeve të NATO-s, në Gjakovë bombardimet e NATO-s vazhduan për 42 ditë me radhë.²⁵⁵ U goditën disa vendndodhje brenda qytetit të Gjakovës, ndër të cilat edhe kazerma e UJ-së në Erenik, një objekt i MPB-së, dhe lagjja e vjetër si dhe vende në zonën midis qytetit dhe kufirit në perëndim, duke shkaktuar një numër viktimitash civile.²⁵⁶

105. Siç është diskutuar më poshtë, disa raporte të pranura si dëshmi tregojnë se nga 24 deri më 28 mars 1999, NATO-ja goditi objektiva në Gjakovë.²⁵⁷ Më 28 mars, u shkatërruar qendra komunikuese statike e UJ-së në Gjakovë.²⁵⁸ Gjatë dy javëve të ardhshme, pasuan bombardime të herëpashershme ajrore në këtë komunë.²⁵⁹

106. Branko Kërگا, shef i atëhershëm i Administratës së Zbulimit në Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, dëshmoi se gjatë 9 - 10 prillit 1999 e deri më 26 maj 1999 UÇK-ja ndërmori një operacion tokësor të quajtur Shigjeta në zonën e Koshares, gjatë të cilit u dislokuan forca të mëdha për të depërtuar nga Shqipëria në territorin e Kosovës.²⁶⁰ Raportet luftarake të njëjstëve të UJ-së në atë zonë bënë ditur se bombardimet e NATO-s ishin intensifikuar dhe se UÇK-ja kishte filluar një operacion të madh për të depërtuar nga Shqipëria në brendësi të Gjakovës.²⁶¹ Në raportet e

²⁵⁴ Radovan Zllatkoviq, T. 25305 (15 prill 2008).

²⁵⁵ Zdravko Vintar, 5D1394 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 dhjetor 2007), para. 14.

²⁵⁶ Zdravko Vintar, 5D1394 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 dhjetor 2007), para. 14. *Shih gjithashtu* Radovan Zllatkoviq, 6D1627 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 prill 2008), para. 30, T. 25268 (14 prill 2008); 6D538 (kallëzim penal i SPB-së Gjakovës dërguar Prokurorit të Qarkut të Pejës për bombardimet të NATO-s, 30 mars 1999).

²⁵⁷ 5D231 (Raport luftimi i PrK-së, 28 mars 1999); P1086 (Ditari i Luftës i Brigadës së 52-të të Raketave Artilerike), f. 5; 6D1234 (Pasqyrë e Situatës së Sigurisë e SPB-së, 26 mars 1999); Radovan Zllatkoviq, 6D1627 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 prill 2008), para. 30; P2019 (Ditari i Luftës i Batalionit të 2-të të Motorizuar të Brigadës së 549-të të Motorizuar), f. 3 (e mbyllur me vulë); P1099 (raport mbi gjendjen i Shtabit të MPB-së, 28 mars 1999), f. 2; P1086 (Ditari i Luftës i Brigadës së 52-të Raketave Artilerike), f. 4.

²⁵⁸ Lubomir Angjelkoviq, T. 16407 (26 shtator 2007). *Shih gjithashtu* 5D197 (Raport luftimi i Qendrës Komunikuese të Korpusit të 52-të), f. 2.

²⁵⁹ P2019 (Ditari i Luftës i Batalionit të 2-të të Motorizuar të Brigadës së 549-të të Motorizuar) (e mbyllur me vulë).

²⁶⁰ Branko Kërگا, T. 16811-16812 (3 tetor 2007); Sasha Antiq, 5D1443 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para. 15.

²⁶¹ 5D984 (Raport luftimi i Komandës së Qarkut Ushtarak për Gjakovën, 11 prill 1999); 3D815 (Raport luftimi i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 10 prill 1999); 3D817 (Raport luftimi i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 12 prill 1999), f. 2; 3D819 (Raport luftimi i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 18 prill 1999); 3D821 (Raport luftimi i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 16 prill 1999).

mëvonshme të majit thuhej se më 29 prill, në zonën e Gjakovës u ndërmorën operacione kundër UÇK-së.²⁶² Dragan Zhivanoviqi dëshmoi se UJ-ja krijoi përshtypjen se ky ishte operacion i UÇK-së i përkrahur nga NATO-ja për të sulmuar nga Shqipëria dhe krijuar lidhje me pjesëtarët aktivë të UÇK-së në Luginën e Caragojt.²⁶³

107. Bombardimet e NATO-s vazhduan gjatë prillit 1999. Në një raport të UJ-së lexohet se më 14 prill bombat e NATO-s goditën një kolonë civilësh duke kaluar një urë në rrugën Gjakovë-Prizren.²⁶⁴ Zdravko Vintari dëshmoi se, pas këtij sulmi, në ndihmë të viktimave u dërgua një ekip i urgjencës mjekësore.²⁶⁵ Sipas Bozhidar Deliqit, gjatë bombardimit të prillit u vranë dhe u plagosën civilë shqiptarë kosovarë.²⁶⁶

108. Gjithashtu në prill 1999, në një raport luftarak të Komandës së Qarkut Ushtarak të Prishtinës ishte shënuar se bombat e NATO-s goditën një "kamp refugjatësh" në Gjakovë, duke vrarë dhe plagosur civilë.²⁶⁷ Në përputhje me këtë raport, Zllatkoviqi tha se një lagje me rreth 50 banorë të ardhur nga Krajina serbe në fshatin Mejë, që gjendet midis Gjakovës dhe fshatit Bistrazhin në rrugën për Prizren, ishte goditur gjatë bombardimeve të NATO-s rreth datës 20 prill.²⁶⁸

b. Veprimtaria e UÇK-së në Gjakovë

109. Dhoma dëgjoi dëshmi se UÇK-ja kishte vepruar në pjesë të ndryshme të komunës së Gjakovës, që ishte zonë kyçe në konflikt sepse nëpër të kalonin shumë rrugë furnizimi nga Shqipëria.²⁶⁹ John Crosland-i dëshmoi se në vitin 1998 UÇK-ja në zonën e Gjakovës ishte nën komandën e Ramush dhe Daut Haradinajt.²⁷⁰ Dhoma gjithashtu dëgjoi dëshmi nga Bislim Zyrapi se, gjatë vitit 1998 dhe 1999, brigadat e UÇK-së vepronin në këtë komunë.²⁷¹ Sipas një harte me shënime të Zyrarit, qyteti i Gjakovës ishte pjesë e zonës që kontrollohej nga UÇK-ja pikërisht para

²⁶² 3D836 (Raport luftimi i Shtabit të Përgjithshëm, 1 maj 1999); 3D838 (Raport luftimi i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 3 maj 1999); 3D839 (Raport luftimi i Shtabit të Përgjithshëm, 4 maj 1999); Dragan Zhivanoviq, T. 20482 (17 janar 2008).

²⁶³ Dragan Zhivanoviq, T. 20612 (18 janar 2008).

²⁶⁴ *Shih* 5D1158 (Raport luftimi i Brigadës së 52-të Artilerike, 14 prill 1999).

²⁶⁵ Zdravko Vintari, T. 21042-21043 (24 janar 2008).

²⁶⁶ Bozhidar Deliq, T. 19313 (29 nëntor 2007); 5D1242 (videofilmime).

²⁶⁷ 5D986 (Raport luftimi i Komandës së Qarkut Ushtarak, 21 prill 1999); 5D1159 (Raport luftimi i Brigadës së 52-të Artilerike, 21 prill 1999); 6D44 (raport i SPB-së së Gjakovës, 23 prill 1999), f. 2; 6D1251 (Pasqyrë e MPB-së e incidenteve të sigurisë, 15 prill 1999). *Shih gjithashtu* 6D295 (pjesë nga një videofilmim i Mejës, 14 prill 1999).

²⁶⁸ Radovan Zllatkoviq, T. 25273-25274, 25280-25281 (14 prill 2008). *Shih gjithashtu* 3D431 (Raport i Komandës së Qarkut Ushtarak, 21 prill 1999), f. 1.

²⁶⁹ John Crosland, T. 10008 (9 shkurt 2007).

²⁷⁰ John Crosland, T. 9865-9866 (8 shkurt 2007), 3D510 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 qershor 2006), para. 21.

²⁷¹ Bislim Zyrapi, T. 5932, 5967 (6 nëntor 2006).

fillimit të bombardimeve të NATO-s.²⁷² Njësitë e UÇK-së ishin në fshatrat përreth qytetit të Gjakovës, por jo në qytet.²⁷³

110. Në kundërshtim me dëshminë e Zyrapi, Radovan Zllatkoviqi dëshmoi se UÇK-ja ishte brenda në qytet që nga fillimi i bombardimeve të NATO-s dhe kontrollonte lagjet e Bllokut të Ri, Çabratit, zonën përreth spitalit në drejtim të lumit Erenik, dhe zonën e stacionit të autobusëve.²⁷⁴ Mirëpo Nikë Peraj dëshmoi se stacioni i autobusëve ishte zonë në të cilën MPB-ja dhe paraushtarakët lëviznin përreth duke djegur shtëpi, siç është treguar më poshtë.²⁷⁵ Fuat Haxhibeqiri tha gjatë fazës së pyetjeve nga Mbrojtja se UÇK-ja mund të ketë qenë në afërsi të qytetit të Gjakovës në fund të marsit 1999,²⁷⁶ por shtoi se luftimet midis UÇK-së dhe forcave të RFJ-së/Serbisë në qytetin e Gjakovës filluan më 7 maj 1999 në lagjen Kodra e Çabratit.²⁷⁷ Edhe pse pranoi se në fund të marsit 1999 UÇK-ja mund të ketë qenë në afërsi të Gjakovës, ai deklaroi se nuk kishte dëgjuar për ndonjë rast që ajo të kishte thyer ligjet e të drejtave të njeriut apo të kishte kryer krime.²⁷⁸

111. Sipas Momir Stojanoviqit dhe Bozhidar Deliqit, fshatrat e Batushës, Korenicës, Brovinës, Glllogjanit, Jabllanicës, Kralanit, Cërmjanit, dhe Becit, kontrolloheshin nga UÇK-ja që nga fillimi i vitit 1998.²⁷⁹ Deliqi shtoi se në vitin 1999 UÇK-ja e zgjeroi zonën nën kontrollin e saj.²⁸⁰

112. Më 3 prill 1999, Vlatko Vukoviqi lëshoi një urdhër që jepte hollësitë e një operacioni mbrojtës të shkallës së gjerë, në kundërpërgjigje të një sulmi të pritshëm nga forcat e UÇK-së nga Shqipëria.²⁸¹ Gjithashtu, siç është theksuar edhe më lart, forcat e RFJ-së/Serbisë parashikonin një sulm të UÇK-së të shkallës së gjerë të mbështetur nga NATO-ja rreth datës 10 prill 1999 në zonën kufitare në perëndim të qytetit të Gjakovës. I akuzuari Llazareviq, dëshmoi se në fakt kishte pasur një sulm tokësor të UÇK-së nga Shqipëria përgjatë rrugës Koshare-Morinë, i cili filloi më 9 prill 1999.²⁸² Po ashtu Bislim Zyrapi dëshmoi se një njësi e armëve të rënda e UÇK-së, me bazë në

²⁷² Bislim Zyrapi, T6021, 6049 (7 nëntor 2006), T. 6267-6268 (10 nëntor 2006); P2469 (harta e zonave operative të UÇK-së sipas dëshmitarit Bislim Zyrapi).

²⁷³ Bislim Zyrapi, T. 6264-6265 (10 nëntor 2006).

²⁷⁴ Radovan Zllatkoviq, 6D1627 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 prill 2008), para. 33.

²⁷⁵ Nikë Peraj, T. 1669-1670 (15 gusht 2006), T. 1800 (17 gusht 2006). *Shih gjithashtu* Nikë Peraj, P2253 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 gusht 2006), para. 15.

²⁷⁶ Fuat Haxhibeqiri, T. 1163, (8 gusht 2006).

²⁷⁷ Fuat Haxhibeqiri, T. 1078 (7 gusht) 2006).

²⁷⁸ Fuat Haxhibeqiri, T. 1163, 1166-1167 (8 gusht 2006).

²⁷⁹ Momir Stojanoviq, T. 19703 (6 dhjetor 2007); Bozhidar Delliq, T. 19275-19276 (28 nëntor 2007).

²⁸⁰ Bozhidar Deliq, T. 19275-19276 (28 nëntor 2007).

²⁸¹ 5D87 (Urdhër për Mbrojtje i Komandës së Grupit Luftarak 2, 3 prill 1999) (i mbyllur me vulë)

²⁸² Vladimir Llazareviq, T. 17987 (9 nëntor 2007). *Shih* 5D366 (Urdhër i PrK-së, 5 prill 1999); 5D195 (Urdhër i PrK-së, 15 prill 1999).

Shqipëri, duke filluar nga 9 prilli u dha mbështetje me artileri njësave të cilat vepronin në Kosovë në kuadër të Operacionit Shigjeta 1. Ai tha se zjarri i artilerisë ishte drejtuar kundër forcave të RFJ-së/Serbisë në Luginën e Caragojt.²⁸³ Gjithashtu, raportet nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Shkup bëjnë të ditur se, në kohën kur pritej ky sulm, më 11 prill 1999 ose pas kësaj date, forcat e UÇK-së hynë në qytetin e Gjakovës dhe filluan të bënin përparime në qytet.²⁸⁴

113. Goran Jevtoviç dëshmoi se të dhënat prej zbulimit tregonin UÇK-ja kishte forca përafërsisht sa një brigadë të vendosura në Luginën e Caragojt, të cilat sulmonin postbllloqet e MPB-së dhe kolonat e automjetet e UJ-së.²⁸⁵ I akuzuari Llazareviç gjithashtu dëshmoi se operacioni në Luginën e Caragojt, i cili është diskutuar më poshtë, filloi si kundërpërgjigje ndaj pranisë së "disa qindra terroristëve" në luginë.²⁸⁶ Dragan Zhivanoviç dëshmoi se pjesëtarët e UÇK-së që vepronin në atë zonë përziheshin me popullatën civile.²⁸⁷ Raportet e MPB-së dhe UJ-së tregojnë se UÇK-ja vazhdoi të vepronte në komunën e Gjakovës gjatë gjithë fushatës së NATO-s.²⁸⁸ Gjithashtu, Bislim Zyrapi konfirmoi se sulmet e UÇK-së në Gjakovë vazhduan deri në mes të majit në kuadër të operacionit Shigjeta 2, i cili u zhvillua në Koshare. Kundër forcave të RFJ-së/Serbisë në Luginën e Caragojt u hap përsëri zjarr artilerie.²⁸⁹

114. Mirëpo në kundërshtim me dëshmitë e mësipërme, K90-a dëshmoi se UJ-ja se e kishte ditur se UÇK-ja nuk ishte e pranishme në Mejë dhe Korenicë në fund të prillit 1999. Ai shpjegoi se zona midis dy fshatrave ishte e rrethuar dhe ruhej nga UJ-ja dhe si pasojë nuk kishte mundësi që në atë kohë ushtarët e UÇK-së të ishin në atë zonë apo të ishin në gjendje të shtinin kundër UJ-së.²⁹⁰ Po ashtu, Lizane Malaj, shqiptare kosovare nga Korenica, mohoi se UÇK-ja kishte vepruar në fshatin e saj, edhe pse bëri të ditur se kishte dëgjuar se në vitin 1998 "forcat serbe" kishin qëlluar kundër

²⁸³ Bislim Zyrapi, T. 6238-6239 (9 nëntor 2006).

²⁸⁴ 6D1637 (Raport i Ambasadës Amerikane në Shkup 13 prill 1999), f. 5; 6D1638 (Raport i Ambasadës Amerikane në Shkup, 11 prill 1999), f. 2; 6D1639 (Raport i Ambasadës Amerikane në Shkup, 19 prill 1999), f. 3.

²⁸⁵ Goran Jevtoviç, T. 20356-20357 (16 janar 2008). *Shih gjithashtu* P2019 (Ditari i luftës i Batalionit të 2-të të Motorizuar të Brigadës së 549-të të Motorizuar), f. 11-12 (e mbyllur me vulë).

²⁸⁶ Vlladimir Llazareviç, T. 18286-18287 (14 nëntor 2007). *Shih gjithashtu* P2023 (Raport luftimi i Brigadës së 125-të të Motorizuar dërguar PrK-së, 25 prill 1999), f. 2; Sergej Peroviç, 5D1396 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 janar 2008), para. 21.

²⁸⁷ Dragan Zhivanoviç, T. 20495-20496 (17 janar 2007). *Shih gjithashtu* Sergej Peroviç, 5D1396 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 janar 2008), para. 22-23.

²⁸⁸ P2011 (Urdhër i PrK-së, 20 maj 1999); 6D614 (Pasqyra e MPB-së e veprave të evidentuara penale, 1 korrik 1998 deri 20 qershor 1999), f. 734, para. 740; Radovan Zllatkoviç, 6D1627 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 prill 2008), para. 32.

²⁸⁹ Bislim Zyrapi, T. 6231, 6238-6239 (9 nëntor 2006).

²⁹⁰ K90, P2652 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 dhjetor 2002), para. 62-63.

pozicioneve të UÇK-së në Nec, Smolicë, Pacaj, Ramoc, dhe fshatra të tjera në Luginën e Caragojt.²⁹¹

115. Dhoma konkludon se në vitin 1998 dhe në fillim të vitit 1999 UÇK-ja ishte aktive në komunën e Gjakovës, dhe është bindur se në fund të marsit 1999 ajo kishte njëfarë pranie në qytetin e Gjakovës dhe rreth tij. Megjithëse UJ-ja kishte një prani të madhe në atë zonë gjatë fundit të vitit 1998 dhe deri në fund të fushatës së NATO-s në qershor të vitit 1999, ajo nuk kishte kontroll tërësor mbi këtë territor. Duke u bazuar në dëshminë e K90-ës, Dhoma gjithashtu konkludon se më 27 dhe 28 prill, prania e UÇK-së në Luginën e Caragojt ishte e kufizuar.

6. Ngjarjet në qytetin e Gjakovës

a. Shkatërrimi i ndërtesave dhe dhuna

116. Prokuroria pretendon se, gjatë marsit dhe fillimit të prillit 1999, forcat e UJ-së dhe MPB-së dogjën prona të shqiptarëve kosovarë dhe objekte kulturore dhe historike në qytetin e Gjakovës.²⁹² Mbrojtja e Llazareviqit dhe Llukiqit përgjigjen se djegia e shtëpive u shkaktua nga bombardimet e NATO-s, ose se nuk u shkaktua nga forcat nën kontrollin e të Akuzuarve.²⁹³ Po ashtu, në lidhje me pretendimet në Aktakuzë se forcat e RFJ-së/Serbisë shkatërruan një numër objektesh kulturore dhe fetare, Mbrojtja e Llazareviqit dhe Llukiqit mohojnë një shkatërrim të tillë dhe pretendojnë se, aty ku ndodhi shkatërrim i këtyre objekteve, ai ishte rezultat i bombardimeve të NATO-s dhe veprimeve të UÇK-së.²⁹⁴

117. Fuat Haxhibeqiri, i cili ishte banor i qytetit të Gjakovës, dëshmoi në lidhje me veprimet e forcave të RFJ-së/Serbisë në qytet në vitin 1998 dhe 1999. Ai tha se, nga gushti 1998 deri dikur më 1999, UJ-ja granatonte fshatrat e komunës përditë si edhe gjatë natës. Kjo shkaktoi ardhjen e njerëzve nga shumë fshatra në qytet.²⁹⁵ Po ashtu, Martin Pnishi dëshmoi se UJ-ja kishte granatuar fshatrat në perëndim të qytetit të Gjakovës nga pika strategjike siç ishte kodra e Çabratit.²⁹⁶ Haxhibeqiri gjithashtu tha se forcat policore dhe "paraushtarake" hynin nëpër fshatra, kërcënonin

²⁹¹ Lizane Malaj, T. 1341, 1358-1359 (10 gusht 2006). *Shih gjithashtu* Lizane Malaj, T. 1373-1375 (10 gusht 2006), P2232 (deklarata e dëshmitares e datës 1 shtator 2000), f. 2.

²⁹² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 430.

²⁹³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 359-374; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 1079-1080.

²⁹⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 374; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 1079-1080.

²⁹⁵ Fuat Haxhibeqiri, P2308 (deklarata e dëshmitarit e datës 28 gusht 2001), f. 5

²⁹⁶ Martin Pnishi, T. 1527 (11 gusht 2006).

ose arrestonin e pastaj rrihnin shqiptarë kosovarë meshkuj dhe i detyronin familjet e tyre të largoheshin.²⁹⁷

118. Është e pamohueshme se më 24 mars 1999, shumë ndërtesa në qendrën historike të qytetit të Gjakovës dhe në zonat e banimit përreth u shkatërruan ose u dëmtuan nga zjarri.²⁹⁸ Sidoqoftë, ekzistojnë versione të kundërta në lidhje me shkakun e këtyre shkatërrimeve. Banorët shqiptarë kosovarë të qytetit dëshmuuan se asnjë bombë e NATO-s që kishte shkatërruar objekte të UJ-së dhe MPB-së në qytet dhe rrethinë në ditët e para të bombardimeve, nuk goditi asnjë zonë civile.²⁹⁹ Sipas tyre zjarret që shkatërruan shumë ndërtesa në qendër të qytetit ishin shkaktuar qëllimisht nga forcat policore dhe paraushtarake serbe.³⁰⁰ Mirëpo Haxhibeqiri i cili fajësonte serbët, nuk kishte parë ndonjë nga këto forca duke i vënë zjarrin ndonjë ndërtesë, meqë ai në atë kohë ishte në lagjen Blloku i Ri, që gjendet në drejtim të jugut nga qendra e qytetit. Ai dëshmoi se natën e 24- 25 marsit kishte parë se si digjeshin shtëpitë në qytetin e vjetër.³⁰¹ Edhe Lulzim Vejsa deklaroi se ndërtesat i dogji policia, por pranoi se nuk i kishte parë personalisht, po vetëm kishte dëgjuar.³⁰² Nikë Peraj tha se kishte parë pjesëtarë të MPB-së dhe paraushtarakë duke u vënë zjarrin shtëpive në qytetin e Gjakovës afër stacionit të autobusëve para fillimit të bombardimeve të NATO-s, por nuk ishte në gjendje të jepte datë të saktë se kur kishte ndodhur kjo.³⁰³

119. Në kundërshtim me këto dëshmi, dëshmitarët e paraqitur nga Mbrojtja, të cilët ishin oficerë të UJ-së ose të MPB-së, të mbështetur nga dokumente të UJ-së dhe MPB-së, bënë të ditur se zjarret e natës së 24 dhe 25 marsit 1999 në pjesën e qytetit të Gjakovës të quajtur Qyteti i Vjetër, i cili shtrihet rrëzë kodrës së Çabratit, u shkaktuan nga bombardimet e NATO-s e jo nga zjarrvënja.³⁰⁴ Sipas këtyre burimeve, bombardimet e NATO-s dëmtuan shumë biznese dhe ndërtesa banimi si dhe

²⁹⁷ *Shih* Fuat Haxhibeqiri, P2308 (deklarata e dëshmitarit e datës 28 gusht 2001), f. 5. *Shih gjithashtu* Fuat Haxhibeqiri, T. 1068 (7 gusht 2006).

²⁹⁸ Fuat Haxhibeqiri, P2308 (deklarata e dëshmitarit e datës 28 gusht 2001), f. 6; P1789 (Aktekspertizë e Andrés Riedlmayer-it) (përmban fotografi të dëmtimeve që iu shkaktuan shumë objekteve kulturore); Andrés Riedlmayer, T. 5418-5420 (30 tetor 2006); Zdravko Vintar, T. 21040-21041 (24 janar 2008), 5D1394 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 dhjetor 2007), para. 16; 5D2 (Kallëzim penal, MPB, Pejë).

²⁹⁹ Fuat Haxhibeqiri, P2308 (deklarata e dëshmitarit e datës 28 gusht 2001), f. 5; Lulzim Vejsa, T. 4087 (27 shtator 2006). *Shih gjithashtu* Lulzim Vejsa, T. 4094 (27 shtator 2006).

³⁰⁰ Fuat Haxhibeqiri, P2308 (deklarata e dëshmitarit e datës 28 gusht 2001), f. 6; Lulzim Vejsa, P2350 (deklarata e dëshmitarit e datës 16 prill 1999), f. 2, T. 4085 (27 shtator 2006).

³⁰¹ Fuat Haxhibeqiri, P2308 (deklarata e dëshmitarit e datës 28 gusht 2001), f. 6.

³⁰² Lulzim Vejsa, P2350 (deklarata e dëshmitarit e datës 16 prill 1999), f. 2.

³⁰³ Nikë Peraj, T. 1669 (15 gusht 2006), T. 1800 (17 gusht 2006), P2253 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 gusht 2006), para. 15.

³⁰⁴ Zdravko Vintar, T. 21040-21041 (24 janar 2008), 5D1394 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 dhjetor 2007), para. 16; 5D2 (Kallëzim penal, MPB, Pejë); P1099 (raport mbi gjendjen i Shtabit të MPB-së, 28 mars 1999), f. 2; P1086 (Ditari i Luftës i Brigadës së 52-të të Raketave Artilerike), f. 4. *Shih gjithashtu* Radovan Zllatkoviq, 6D1627 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 prill 2008), para. 33.

shkaktuan një numër viktimash në njerëz.³⁰⁵ Në një raport të MPB-së lexohet se në natën e 24-25 marsit 1999, bombat e NATO-s ranë në pjesën e vjetër të qytetit të Gjakovës, duke shkaktuar zjarre që shkatërruan 220 godina.³⁰⁶ Një kallëzim penal i shkruar në lidhje me atë natë pohon se nga hetimet e një gjykatësi të gjykatës komunale në Gjakovë ishte nxjerrë përfundimi se një raketë e NATO-s kishte filluar një seri zjarresh, të cilat kishin djegur 220 shtëpi dhe kishin vrarë një numër banorësh.³⁰⁷ Zdravko Vintari tha se një bombë e NATO-s kishte goditur kodrën e Çabratit dhe kjo kishte filluar zjarret në qytetin e vjetër që gjendet në afërsi.³⁰⁸ Ai gjithashtu dëshmoi se më 24 mars aeroplanët e NATO-s bombarduan kazermat e UJ-së në skajin jugor të qytetit afër kishës katolike.³⁰⁹ Gjithashtu, në ditarin e luftës të Batalionit të 2-të të Motorizuar të Brigadës së 549-të të Motorizuar lexohet se më 26 mars gjatë sulmeve të NATO-s u godit depoja e lëndëve shpërthyesë në kazermën e vjetër të UJ-së në qytetin e Gjakovës duke vrarë katër banorë të qytetit.³¹⁰

120. Në lidhje me shkatërrimin e pretenduar të objekteve kulturore dhe fetare, raporti i András Riedlmayer-it dhe dëshmia e tij për komunën e Gjakovës u përqendruan në katër objekte, i pari prej të cilëve ishte pazari në qytetin e vjetër. Ai raportoi se pazari ishte dëmtuar rëndë më 24 mars 1999, duke i përshkruar dyqanet si tërësisht të djegura, pjesën historike të pazarit të shkatërruar, brendësinë e dyqaneve të djegura deri në tavan, dhe kulmet e tyre të shembura.³¹¹ Riedlmayer-i gjithashtu raportoi se autoritetet e RFJ-së/Serbisë pretendonin se dëmet ishin shkaktuar nga sulmet e NATO-s, por në aktekspertizën e tij ai nuk kishte konstatuar shenja të dëmeve të shkaktuara nga shpërthimet që do të ishin të pritshme nëse pazari do të kishte qenë goditur gjatë sulmeve; dëmtimet përputheshin me pasojat e djegies.³¹² Gjithashtu, raporti përmbante përmbledhjen e deklaratave të dy burimeve, vetëm njëri prej të cilëve është identifikuar, ku që të dy pretendonin se kishin qenë dëshmitarë kur forcat e MPB-së i kishin vënë zjarrin pazarit një natë pas fillimit të bombardimeve

³⁰⁵ Radovan Zllatkoviç, 6D1627 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 prill 2008), para. 30, 33, T. 25268 (14 prill 2008); 6D538 (Raport Penal nga Gjakova, 25 dhe 30 mars 1999); P1086 (Ditari i Luftës i Brigadës së 52-të të Raketave Artilerike), f. 5. *Shih gjithashtu* 5D231 (Raport luftimi i Komandës së PrK-së, 28 mars 1999).

³⁰⁶ 6D1234 (Pasqyrë e Situatës së Sigurisë e SPB-së, 26 mars 1999), *Shih gjithashtu* Radovan Zllatkoviç, 6D1627 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 prill 2008), para. 30.

³⁰⁷ 5D2 (Kallëzim Penal nga Gjakova, 30 mars 1999), f. 2.

³⁰⁸ Zdravko Vintar, T. 21040-21041 (24 janar 2008). *Shih gjithashtu* Radovan Zllatkoviç, 6D1627 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 prill 2008), para. 33.

³⁰⁹ Zdravko Vintar, 5D1394 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 dhjetor 2007), para. 16.

³¹⁰ P2019 (Ditari i Luftës i Batalionit të 2-të të Motorizuar të Brigadës së 549-të të Motorizuar), f. 3 (e mbyllur me vulë); P1099 (Raport mbi gjendjen i Shtabit të MPB-së, 28 mars 1999), f. 2; P1086 (Ditari i Luftës i Brigadës së 52-të Raketave Artilerike), f. 5; Radovan Zllatkoviç, 6D1627 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 prill 2008), para. 33.

³¹¹ P1797 (fotografi të pazarit dhe të rrugëve anësore); P1781 (Pjesë nga P1789 në lidhje me pazarin e vjetër në qytetin e Gjakovës), f. 1. *Shih gjithashtu* András Riedlmayer, T. 5500-5501 (30 tetor 2006).

³¹² P1781 (Pjesë nga P1789 në lidhje me pazarin e vjetër në qytetin e Gjakovës), f. 1; András Riedlmayer, T5497, 5500 (30 tetor 2006).

të NATO-s.³¹³ Edhe Fuat Haxhibeqiri deklaroi se pazari ishte djegur nga forcat e RFJ-së/Serbisë dhe se "qytetarët" kishin qenë dëshmitarë të kësaj, por ai nuk tha se e kishte parë vetë kur pazarit i ishte vënë zjarri.³¹⁴ Raporti i Branimir Jokiqit nuk përmend konkretisht vendndodhjet në Gjakovë të përshkruara nga Riedlmayer-i.³¹⁵

121. Objekti i dytë për të cilin raporton Riedlmayer-i është Xhamia e Hadumit në pjesën e vjetër të qytetit të Gjakovës. Ai tha se ajo ishte dëmtuar rëndë nga zjarri, pikturat dhe brendësia e kupolës ishin dëmtuar, dhe minareja ishte thyer.³¹⁶ Në aktekspertizën e tij ai pohonte se edhe ky incident kishte ndodhur në natën e 24 marsit 1999. Raporti përmbante edhe një përmbledhje të deklaratës së një banori vendas i cili kishte parë "serbë" duke i vënë zjarrin pazarit të vjetër dhe Xhamisë së Hadumit dhe theksonte se banorët vendas i kishin thënë se kishin parë 50 serbë me bidonë me naftë duke shkuar në drejtim të xhamisë.³¹⁷ Riedlmayer-i gjithashtu raportoi se "serbët" e kishin rrëzuar minarenë e xhamisë me raketahedhës më vonë, më 8 maj 1999. Si duket edhe këto të dhëna vijnë nga informatorët e tij.³¹⁸

122. Kjo përputhet me dëshminë e Fuat Haxhibeqirit, i cili tha se brendësia e xhamisë ishte djegur më 25 mars, edhe pse nuk deklaroi se e kishte parë personalisht djegien në atë datë. Sidoqoftë, ai deklaroi se më 8 maj 1999 kishte dëgjuar një shpërthim kur ishte në shtëpinë e tij afër xhamisë, pas të cilit përreth tij kishin rënë copa dhe ai pa se minareja e xhamisë ishte shkatërruar. Edhe pse Haxhibeqiri ia atribuonte këtë granatimit nga UJ-ja, ai nuk ishte në gjendje të shpjegonte se pse kishte arritur në këtë përfundim.³¹⁹

123. Objekti i tretë për të cilin Riedlmayer raportoi ishte Biblioteka e Hadum Sulejman Efendisë, një bibliotekë islamike në qendrën e vjetër të qytetit. Ai tha se ajo ishte djegur e tëra dhe kishte humbur e gjithë përmbledhja e dorëshkrimeve dhe arkiva islamike.³²⁰ Objekti i katërt për të cilin

³¹³ P1781 (Pjesë nga P1789 në lidhje me pazarin e vjetër në qytetin e Gjakovës), f. 2; András Riedlmayer, T. 5501-5502 (30 tetor 2006).

³¹⁴ Fuat Haxhibeqiri, T. 1200-1206 (8 gusht 2006).

³¹⁵ ID743 (Vlerësimi i Branimir Jokiqit i raportit, "The destruction of Cultural Heritage in Kosovo, 1998-1999" (Shkatërrimi i Trashëgimisë Kulturore në Kosovë, 1998-1999), nga Andrew Herscher dhe András Riedlmayer).

³¹⁶ P1782 (Pjesë nga P1789 në lidhje me Xhaminë e Hadumit), f. 1.

³¹⁷ P1782 (Pjesë nga P1789 në lidhje me komunën e Gjakovës), f. 2; P1782 (Pjesë nga 1789, në lidhje me Xhaminë e Hadumit), f. 2.

³¹⁸ P1782 (Pjesë nga P1789 në lidhje me Xhaminë e Hadumit), f. 2.

³¹⁹ Fuat Haxhibeqiri, P2308 (deklarata e dëshmitarit e datës 28 gusht 2001), f. 7. *Shih* Fuat Haxhibeqiri, T. 1077 (7 gusht 2006).

³²⁰ P1783 (Pjesë nga P1789 në lidhje me Bibliotekën e Hadum Sulejman Efendisë), f. 1.

Riedlmayer-i raportoi ishte Xhamia e Kel Hasan Agës në fshatin Rogovë, për të cilën do të flitet më poshtë gjatë diskutimit të ngjarjeve në fshatrat e komunës së Gjakovës.³²¹

124. Edhe pse Haxhibeqiri nuk pa njeri duke u vënë zjarrin shtëpive në natën e 24 - 25 marsit, ai dëshmoi se kishte parë forcat e policisë dhe "paraushtarakët" duke u vënë zjarrin shtëpive afër shtëpisë së tij në vazhdim të fushatës së NATO-s.³²² Çdo ditë, dy apo më shumë shtëpi ishin djegur në këtë mënyrë.³²³ Ai tha se forcat e RFJ-së/Serbisë gjithashtu kishin plaçkitur sende prej shtëpive në lagjen e tij, si p.sh pajisje nga zyra e një mjeku e cila ndodhej afër vendit ku ai kishte qenë i fshehur.³²⁴ Ai dëshmoi se forcat "paraushtarake" që u kishin vënë zjarrin këtyre shtëpive, kishin vija dhe shirita në veshjen e tyre. Mirëpo Haxhibeqiri ofroi përshtime mospërrthëse duke pohuar se policia mbante uniforma të kaltra, por gjithashtu uniforma ngjyrë ulliri.³²⁵

125. Lulzim Vejsa dhe K74 dëshmuar pavarësisht nga njëri-tjetri se, ndërsa ishin duke ecur nëpër qytetin e Gjakovës në fillim të prillit, panë se ishin djegur vetëm shtëpitë e shqiptarëve kosovarë.³²⁶ K90-a dëshmoi se në fillim të prillit 1999 shkoi me disa policë në qytetin e Gjakovës, dhe u vunë zjarrin shtëpive të shqiptarëve të Kosovës duke përdorur kanaçe spërkatëse për të ndezur zjarrin. Më vonë, ata u tërhoqën kur kishin filluar të binin bombat e NATO-s.³²⁷ Hani Hoxha tha se i kishte dëgjuar forcat e MPB-së duke thënë se " NATO-ja është shkaktari i kësaj" teksa po u vinin flakën shtëpive në qytetin e Gjakovës.³²⁸

126. Banorët e qytetit ofruan dëshmi të veprimeve të dhunshme të kryera kundër popullatës shqiptare kosovare. Hani Hoxha deklaroi se afërsisht me 27 mars dëgjoji vrasjet e dy fqinjëve të tij, Shefqet Pruthi dhe Avni Ferizi, të cilët gjithashtu banonin në zonën e Kullës në Gjakovë.³²⁹ Ai përshkroi se si, gjysmë i fshehur pas një dërrase në oborrin e tij, i kishte parë shtëpitë rreth tij duke u djegur. Ai kujtoi se si një automjet e kishte shpërthyer derën e oborrit të fqinjit të tij, Shefqet Pruthi, dhe se si personat në automjet i kishin vënë zjarrin shtëpisë së Pruthit. Pastaj, burrat e kishin ndjekur Shefqet Pruthin deri te një vend afër pesë metra nga vendi ku Hoxha ishte fshehur, ku ai kishte dëgjuar një zë të lartë në serbisht, "dil jashtë, do t'ua qijmë nënat shqiptare." Hoxha deklaroi

³²¹ P1784 (Pjesë nga P1789 në lidhje me Xhaminë e Kel Hasan Agës), f. 1.

³²² Fuat Haxhibeqiri, T. 1077 (7 gusht 2006).

³²³ Fuat Haxhibeqiri, P2308 (deklarata e dëshmitarit e datës 28 gusht 2001), f. 7. *Shih* Fuat Haxhibeqiri, T. 1077 (7 gusht 2006).

³²⁴ Fuat Haxhibeqiri, T. 1171-1172 (8 gusht 2006).

³²⁵ Fuat Haxhibeqiri, T. 1077 (7 gusht 2006), T. 1169-1170 (8 gusht 2006).

³²⁶ Lulzim Vejsa, P2350 (deklarata e dëshmitarit e datës 16 prill 1999), f. 3; K74, P2532 (deklarata e dëshmitarit), f. 4.

³²⁷ K90, P2652 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 dhjetor 2002), para. 35-37, T. 9378-9379 (30 janar 2007).

³²⁸ Hani Hoxha, P2267 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 prill 1999), f. 5.

³²⁹ Hani Hoxha, P2267 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 prill 1999), f. 2-3.

se kishte dëgjuar krisma dhe më vonë atë mbrëmje i kishin thënë se Pruthi ishte vrarë.³³⁰ Hoxha kujtoi se si, pas sulmit në shtëpinë e Pruthit, të njëjtët njerëz kishin shkuar në shtëpinë e fqinjët tjetër, Avni Ferizi, të cilin gjithashtu e kishin qëlluar me armë për vdekje.³³¹ Sipas Hoxhës, gratë e Shefqet Pruthit dhe Avni Ferizit shkuan të nesërmen në policinë vendore për të kërkuar fillimin e hetimeve, por policët e atjeshëm u kishin thënë "shkoni e ankohuni te NATO-ja". Megjithëse policia e vizitoi shkurtimisht skenën e vrasjeve, nuk u ndërmor asnjë këqyrje apo hetim.³³²

127. Sergej Peroviqi kundërshtoi rrëfimin e Hoxhës duke mohuar se kishte të dhëna për këto incidente në lagjen Kullë të qytetit të Gjakovës.³³³ Gjithsesi ai deklaroi se gjatë kësaj kohe kishte pasur të shtëna sporadike nga UÇK-ja në drejtim të njërive të UJ-së dhe MPB-së në Bllokun e Ri në qytetin e Gjakovës, por shtoi se luftimet ishin të përqendruara në pjesën e vjetër të qytetit.³³⁴ Radovan Zllatkoviqi konfirmoi se kishte dëgjuar për vdekjen e Shefqet Pruthit dhe Avni Ferizit, por pretendoi se gjithashtu kishte dëgjuar se shkak u kishin qenë zjarret e shkaktuara nga bombardimet e NATO-s.³³⁵ Një pasqyrë e MPB-së e incidenteve të sigurisë e shkruar në atë kohë gjithashtu ia atribuonte këto vdekje një bombe të NATO-s që kishte goditur godinën e MPB-së në Gjakovë.³³⁶

128. Fuat Haxhibeqiri dëshmoi në lidhje me një numër shqiptarësh kosovarë të cilët u vranë në qytet gjatë bombardimit të NATO-s.³³⁷ Ai pa disa kufoma nëpër rrugë, por nuk kishte qenë vetë dëshmitar i këtyre vrasjeve.³³⁸ Kur u pyet për viktimat që kishte parë, ai dëshmoi se në mesin e tyre ishte Urim Rexha, i cili ishte qëlluar në kokë rreth 27 marsit 1999.³³⁹ Ai gjithashtu përmendi një numër kufomash të tjera të cilat i kishte parë nëpër rrugë në maj 1999, siç është shpjeguar në hollësi më poshtë.

129. Ndrec Konaj, shqiptar kosovar nga Peja, dëshmoi për dhunën kundër shqiptarëve kosovarë në qytetin e Gjakovës në fillim të bombardimeve të NATO-s. Konaj dëshmoi për shpërnguljen e tij nga Peja së bashku me "mijëra" shqiptarë kosovarë të tjerë.³⁴⁰ Dhoma e konsideron rrëfimin e dëbimit dhe të udhëtimit të tij për në Shqipëri përgjithësisht të besueshëm. Ai u dërgua me një

³³⁰ Hani Hoxha, P2267 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 prill 1999), f. 2.

³³¹ Hani Hoxha, P2267 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 prill 1999), f. 2-3.

³³² Hani Hoxha, P2267 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 prill 1999), f. 3. *Shih gjithashtu* Hani Hoxha, T. 1554-1555, 1560 (11 gusht 2006).

³³³ Sergej Peroviq, T. 21100-21101 (25 janar 2008).

³³⁴ Sergej Peroviq, T. 21106 (25 janar 2008).

³³⁵ Radovan Zllatkoviq, 6D1627 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 prill 2008), para. 33.

³³⁶ 6D1235 (Pasqyrë e MPB-së e incidenteve të sigurisë), f. 2

³³⁷ *Shih* Fuat Haxhibeqiri, P2308 (deklarata e dëshmitarit e datës 28 gusht 2001), f. 3, T. 1113 (8 gusht 2006), T. 1292-1295 (9 gusht 2006).

³³⁸ Fuat Haxhibeqiri, T. 1175 (8 gusht 2006), T. 1292 (9 gusht 2006).

³³⁹ Fuat Haxhibeqiri, T. 1156-1157 (8 gusht 2006).

kolonë autobusësh në Prizren dhe, duke kaluar nëpër Gjakovë, autobusët u ndaluan në një postbllok përballë stacionit të policisë në qytet. Atje, Konaj pa pjesëtarë të policisë duke rrahur burrat në një grup të madh njerëzish me kondakë pushkësh. Gjithashtu, ai pa policë, paraushtarakë, dhe forca të tjera duke rrahur njerëzit në një automjet në të njëjtën kolonë në të cilën ishte duke udhëtuar edhe ai.³⁴¹

b. Ngjarjet në lagjen e Qerimit, 1 dhe 2 prill 1999

130. Aktakuza pretendon se në fillim të prillit 1999, në lagjen e Qerimit, në qytetin e Gjakovës u vranë mbi 50 njerëz. Disa dëshmitarë treguan në hollësi për vrasjet e kryera në këtë lagje më 1 dhe 2 prill 1999. Ndër ta ishin Dren Caka, djalë shqiptar kosovar nga ky qytet i cili në prill 1999 ishte 10 vjeç, Hani Hoxha, dhe Lulzim Vejsa.³⁴²

131. Në orët e hershme të mëngjesit të 2 prillit 1999, Caka ishte në bodrumin e shtëpisë së Vejsëve në rrugën Millosh Gilliq në lagjen e Qerimit së bashku me 20 njerëz të tjerë, të gjithë përveç njërit, ishin gra e fëmijë. Vejsa dhe Hoxha ishin lart me meshkuj shqiptarë kosovarë të tjerë.³⁴³ Gjatë fazës së pyetjeve nga Mbrojtja, Lulzim Vejsa mohoi se ishte pjesëtar i UÇK-së dhe tha se kushërinjtë dhe miqtë e tij kishin qëndruar në bodrumin e tij, jo për shkak të bombave të NATO-s, por nga frika e forcave të RFJ-së/Serbisë që ishin të vendosura në kodrën e Çabratit.³⁴⁴ Rreth orës 2 në mëngjes, një automjet e shpërtheu derën e oborrit të shtëpisë së Vejsëve. Hoxha dhe burrat e tjerë ikën përmes një daljeje prapa shtëpisë, ashtu siç ishin marrë vesh të vepronin në rast se forcat e RFJ-së/Serbisë do të hynin në oborr, sepse mendonin se kështu do zvogëlonin gjasat që të prekeshin gratë e fëmijët.³⁴⁵

132. Caka rrëfeu se si rreth gjashtë policë serbë hynë në ndërtesë dhe e pyetën grupin e njerëzve në bodrum se a ishin me UÇK-në, gjë të cilën ata e mohuan.³⁴⁶ Pas kësaj policët i urdhëruan të dilnin nga bodrumi dhe të shkonin lart në shtëpinë e Vejsëve.³⁴⁷ Caka i përshkroi policët se kishin të veshur uniforma të zeza dhe blu të mbyllët me motive dhe të armatosur me mitraloza të rëndë, AK-

³⁴⁰ Ndrec Konaj, P2372 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 qershor 2001), f. 4.

³⁴¹ Ndrec Konaj, P2372 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 qershor 2001), f. 5.

³⁴² *Shih* Dren Caka, T. 2630-2631 (31 gusht 2006).

³⁴³ Dren Caka, T. 2634-2635 (31 gusht 2006); Hani Hoxha, T. 1539-1540 (11 gusht 2006); IC24 (fotografi nga ajri të Rrugës Millosh Gilliq të shënuar nga Caka).

³⁴⁴ Lulzim Vejsa, T. 4086, 4089 (27 shtator 2006).

³⁴⁵ Hani Hoxha, P2267 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 prill 1999), f. 3-4; Dren Caka, T. 2636-2637 (31 gusht 2006); Lulzim Vejsa, P2350 (deklarata e dëshmitarit e datës 16 prill 1999), f. 2-3.

³⁴⁶ Dren Caka, T. 2636-2638 (31 gusht 2006); Lulzim Vejsa, P2350 (deklarata e dëshmitarit e datës 16 prill 1999), f. 2-3; Hani Hoxha, P2267 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 prill 1999), f. 4; Hani Hoxha, T. 1540 (11 gusht 2006).

³⁴⁷ *Shih* Dren Caka, T. 2636-2638 (31 gusht 2006); P2279 (diagrami i shtëpisë së Vejsajve).

47, dhe me revole "normale".³⁴⁸ Gjatë fazës së pyetjeve nga Mbrojtja, ai u pyet në lidhje me një deklaratën dhënë Prokurorisë, në të cilën ai e përshkruante policinë të veshur me uniforma kamuflimi të kaltra dhe jelekë antiplumb si ngjyrë e gjelbër dhe "bomba".³⁴⁹ Në gjyq ai deklaroi se uniformat ishin të kaltra dhe jo të gjelbra.³⁵⁰ Ai shtoi se një polic kishte kapelë, se armët e tyre dukeshin si AK-47, jo si pushkë, dhe se nuk kishte parë emblema në uniforma.³⁵¹ Ai shtoi se asnjë nga policët nuk ishte shqiptar.³⁵² Dhoma thekson se edhe në videofilmimin e bërë kur ai ndodhej në spital në Shqipëri pas incidentit Caka i përshkroi personat që hynë me forcë si policë dhe se ai gjithmonë i përshkroi ata si policë në deklaratat e mëvonshme.³⁵³

133. Teksa Hoxha, Vejsa, dhe shqiptarët kosovarë të tjerë po iknin nga shtëpia, keqbërësit me uniforma hapën zjarr.³⁵⁴ Hoxha dëgjoi zëra, duke përfshirë dhe lutjet, "Falëm, mos më vrit".³⁵⁵ Caka dëshmoi se policët në shtëpinë e Vejsajve shtinë kundër të pranishmëve, së pari mbi Flaka Hoxhën, pastaj mbi nënën e saj, gruan e "Lulit" dhe vajzën e tij foshnje, më tej mbi nënën e Cakës, dhe më pas shtinë gjithandej brenda dhomës. Edhe pse u plagos në krah, Caka shpëtoi dhe iku përmes dritares.³⁵⁶

134. Rreth orës 07:30 në mëngjes, burrat shqiptarë kosovarë, përfshirë Vejsën dhe Hoxhën, u kthyen në shtëpi, e cila ishte djegur dhe ishte shembur përdhe.³⁵⁷ Jashtë oborrit të shtëpisë së tij Vejsa pa tre burra, të cilat ai njihte që ishin policë vendas dhe fqinji i tij i tha se kishte pasur edhe të tjerë të pranishëm.³⁵⁸ Pastaj Hoxha shkoi në një shtëpi tjetër në të njëjtin oborr ku pa kufomën e djegur të dajës së dhëndrit të tij, Hysen Gashi.³⁵⁹ Në një shtëpi fqinje, Hoxha mësoi nga Dren Caka se të afërmit e tij ishin vrarë.³⁶⁰ Të tre dëshmitarët dëshmuan se gjithsej 20 njerëz ishin vrarë nga armët e zjarrit dhe djegia në shtëpinë e Vejsëve në rrugën Millosh Gilliq, duke përfshirë edhe nënën

³⁴⁸ Dren Caka, T. 2638-2639 (31 gusht 2006).

³⁴⁹ Dren Caka, 6D71 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 maj 2001), f. 4; Dren Caka, T. 2662 (31 gusht 2006).

³⁵⁰ Dren Caka T. 2662 (31 gusht 2006).

³⁵¹ Dren Caka T. 2663 (31 gusht 2006).

³⁵² Dren Caka T. 2664 (31 gusht 2006).

³⁵³ *Shih* P2278 (video regjistrimi i Cakajt i bërë pas incidentit në qytetin e Gjakovës); P2277 (përkthimi i videofilmimit të Cakës të bërë pas incidentit në qytetin e Gjakovës); Dren Caka, 6D71 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 maj 2001).

³⁵⁴ Hani Hoxha, P2267 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 prill 1999), f. 4, *Shih* Lulzim Vejsa, P2350 (deklarata e dëshmitarit e datës 16 prill 1999), f. 2-3.

³⁵⁵ Hani Hoxha, P2267 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 prill 1999), f. 4, T. 1541 (11 gusht 2006).

³⁵⁶ Dren Caka, T. 2644-2646 (31 gusht 2006), 6D71 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 maj 2001), f. 3-4.

³⁵⁷ Hani Hoxha, P2267 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 prill 1999), f. 4; Lulzim Vejsa, P2350 (deklarata e dëshmitarit e datës 16 prill 1999), f. 3.

³⁵⁸ Lulzim Vejsa, T. 4082-4084, 4092 (27 shtator 2006), P2350 (deklarata e dëshmitarit e datës 16 prill 1999), f. 3.

³⁵⁹ Hani Hoxha, P2267 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 prill 1999), f. 4, T. 1544 (11 gusht 2006).

³⁶⁰ Hani Hoxha, P2267 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 prill 1999), f. 4.

dhe motrën e vogël të Cakës.³⁶¹ Lulzim Vejsa humbi gruan, katër vajza, djalin, nënën, dhe motrën, ndërmjet të afërmeve të tjerë të vrarë në këtë sulm.³⁶² Hani Hoxha humbi gruan dhe dy vajza.³⁶³

135. K74-a dëshmoi se, më 2 prill 1999, "serbët" dogjën shtëpitë e shqiptarëve kosovarë të cilit ai i njihje në rrugën Millosh Gilliq, duke lënë të paprekura vetëm shtëpitë e serbëve.³⁶⁴ Sidoqoftë, gjatë dëshmisë me gojë, K74-a sqaroi se personalisht nuk kishte qenë dëshmitar i vrasjeve apo vënies së zjarrit shtëpive, por se kishte parë disa serbë vendas të armatosur duke bastisur lagjen dhe duke vjedhur dhe se për këtë arsye ai kishte nxjerrë përfundimin se ata ishin përgjegjës për vrasjet dhe djegiet e shtëpive.³⁶⁵ Duke marrë parasysh këtë përfundim, Dhoma nuk e konsideron K74-ën dëshmitar të besueshëm në lidhje me vrasjet në rrugën Millosh Gilliq, të pretenduara në aktakuzë.

136. Radovan Zlatković kundërshtoi aspekte konkrete të dëshmisë së Vejsës, përfshirë identifikimin prej tij të njërit prej policëve pjesëmarrës në sulm dhe pretendimin e tij se tre policë në uniforma të kaltra njëngjyreshe kishin qenë jashtë shtëpisë së djegur më 2 prill. Ai tha se uniformat të kaltra njëngjyreshe të përshkruara nga Vejsa i përkisnin shërbimit të zjarrfikësve.³⁶⁶ Sidoqoftë, Dhoma vëren se MPB-ja gjithashtu kishte uniforma të kaltra njëngjyreshe, siç janë përshkruar në nënpjesën VI.A.3 më lart. Gjithashtu, Dhoma vëren se dëshmia e drejtpërdrejt e Cakës për hyrjen e policisë në shtëpi natën e 1 prillit ishte se ata kishin uniforma kamuflimi të kaltra.

137. Provat kriminalistike në lidhje me këto vrasje janë përgatitur nga Dr. Eric Baccard, dëshmitar ekspert i paraqitur nga Prokuroria. Ai i mbështet konkluzionet e veta në lidhje me ngjarjet në rrugën Millosh Gilliq në një raport të përgatitur nga Dr. William C. Rodriguez III, i cili ekzaminoi kufomat në këtë vendngjarje dhe në varrezën e Gjakovës.³⁶⁷ Dr. Rodriguez konkludoi se, për shkak të djegies së madhe dhe copëzimit të kufomave, si dhe shpërndarjes së tyre, nuk ishte e mundur të përcaktohej numri i saktë i viktimave. Sidoqoftë, në raport ai konkludoi se "numri minimal i personave të raportuar... mund të shkojë deri në 20 individë": një mashkull i moshës madhore, disa femra të moshës madhore, shumë "persona të moshës jomadhore" (fëmijë), dhe disa

³⁶¹ Hani Hoxha, P2267 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 prill 1999), f. 4, f. 5-6; Dren Caka, T. 2635 (31 gusht 2006); Lulzim Vejsa, P2350 (deklarata e dëshmitarit e datës 16 prill 1999), f. 2-3

³⁶² Lulzim Vejsa, P2350 (deklarata e dëshmitarit e datës 16 prill 1999), f. 3.

³⁶³ Hani Hoxha, P2267 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 prill 1999), f. 5.

³⁶⁴ K74, P2532 (deklarata e dëshmitarit), f. 2.

³⁶⁵ K74, T. 7516-7517, 7523-7526 (29 nëntor 2006)

³⁶⁶ Radovan Zlatković, 6d1627 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 prill 2008), para. 35.

³⁶⁷ P1809 (raport përmbledhës i Eric Baccard-it), f. 15, 37-39. Raporti i Baccard përmban një pjesë që shqyrton provat e mbledhura nga ekspertë të një ekipi kriminalistik nga Shtetet e Bashkuara në rrugën Millosh Gilliq 157 dhe nga varreza e qytetit të Gjakovës më 25, 26, dhe 27 maj 1999. Ajo bazohet në aktekspertizën antropologjike dhe patologjike të përgatitur nga Dr. William C. Rodriguez III. *Shih gjithashtu* P249 (Ekzaminim dhe analizë kriminalistike e pjesëve të kufomave në Kosovë, 13 tetor 1999).

viktima të papërcaktuara.³⁶⁸ Në raportin e Baccard-it lexohet se për shkak se pjesët e kufomave ishin tejet të djegura dhe të skeletizuara, ishte e pamundshme të përcaktohej shkaku i vdekjeve apo lëndimeve.³⁶⁹ Dhoma thekson se emrat e 20 viktimave janë dhënë në Listën G të Aktakuzës.

c. Eksodi i shqiptarëve kosovarë nga qyteti i Gjakovës

138. Prokuroria pretendon se, gjatë dhe mbas operacionit në lagjen e Qerimit më 1 dhe 2 prill 1999, një numër i madh shqiptarësh kosovarë u detyruan të largoheshin nga shtëpitë e tyre dhe formuan kolona për të shkuar në Shqipëri. Prokuroria gjithashtu pretendon se gjatë rrugëtimit forcat e RFJ-së/Serbisë i keqtrajtuat këta njerëz dhe ua morën dokumentet personale.³⁷⁰ Mbrojtja e Llazareviqit kundërpërgjigjet se nuk është provuar se UJ-ja ishte e implikuar në dëbimin e civilëve nga kjo komunë ose se, ku ka pasur lëvizje të tilla të popullatës, kjo kishte ndodhur si rezultat i presionit nga UJ-ja.³⁷¹ Mbrojtja e Llukiqit pretendon se të gjitha largimet e civilëve u shkaktuan nga frika e bombardimeve të NATO-s e jo nga dëbimi me forcë.³⁷²

139. Pas vrasjeve në shtëpinë e Vejsëve, Hani Hoxha dhe Lulzim Vejsa u larguan nga qyteti i Gjakovës në një kolonë të gjatë në fillim të prillit 1999 së bashku me mijëra shqiptarë kosovarë që ishin duke ikur nga qyteti në atë kohë.³⁷³ Pjesëtarët e MPB-së dhe UJ-së ishin të vendosur në këndet e rrugëve dhe, sipas Hoxhës, në dalje të qytetit pjesëtarët e MPB-së i urdhëruan njerëzit në kolonë që t'i hidhnin dokumentet e identifikimit në një kuti të madhe.³⁷⁴ Rreth tri kilometra jashtë qytetit, pjesëtarët e UJ-së ndaluan disa njerëz nga kolona. Pasi i mbajtën rreth tri orë në fushë, i urdhëruan që të vazhdonin për në kufi me Shqipërinë.³⁷⁵ Hoxha tha se në vendkalimin kufitar në Qafë të Prushit policët i urdhëruan sërish që të dorëzonin dokumentet e identifikimit.³⁷⁶ Edhe pse ua kërkuan dokumentet e identifikimit dy herë, Hoxha ia arriti të mbante patentën e tij të shoferit.³⁷⁷ Edhe K74-a tha se i ishte bashkuar kolonës së njerëzve të shpërngulur që largoheshin nga qyteti i

³⁶⁸ P249 (Ekzaminim dhe analizë kriminalistike e pjesëve të kufomave në Kosovë), f. 9.

³⁶⁹ P1809 (raport përmbledhës i Eric Baccard-it), f. 39.

³⁷⁰ Dosja Përfundimtare Gjyqësore e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 430.

³⁷¹ Dosja Përfundimtare Gjyqësore e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 376.

³⁷² Dosja Përfundimtare Gjyqësore e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para 1082.

³⁷³ Hani Hoxha, P2267 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 prill 1999), f. 5, T. 1564 (11 gusht 2006); Lulzim Vejsa, P2350 (deklarata e dëshmitarit e datës 16 prill 1999), f. 3-4, T. 4081-4082 (27 shtator 2006). *Shih gjithashtu* Vllatko Vuković, 5D1442 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para. 42; P2019 (Ditari i Luftës i Batalionit të 2-të të Motorizuar të Brigadës 549-të të Motorizuar), f. 3-7 (i mbyllur me vulë); Vllatko Vuković, T. 21362 (30 janar 2008).

³⁷⁴ Hani Hoxha, P2267 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 prill 1999), f. 5, T. 1549, 1563-1364 (11 gusht 2006). *Shih gjithashtu* Lulzim Vejsa, T. 4081-4082 (27 shtator 2006).

³⁷⁵ Hani Hoxha, P2267 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 prill 1999), f. 5, T. 1549 (11 gusht 2006); Lulzim Vejsa, P2350 (deklarata e dëshmitarit e datës 16 prill 1999), f. 3-4. *Shih gjithashtu* Lulzim Vejsa, T. 4081-4082 (27 shtator 2006).

³⁷⁶ Hani Hoxha, P2267 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 prill 1999), f. 5. *Shih* Lulzim Vejsa, P2350 (deklarata e dëshmitarit e datës 16 prill 1999), f. 3-4, T. 4081-4082 (27 shtator 2006); K74, P2532 (deklarata e dëshmitarit), f. 6.

Gjakovës dhe se forcat e MPB-së e drejtuan këtë grup në drejtim të vendkalimit kufitar të Qafës së Prushit. Ai tha se në kufi policia u kërkoi dokumentet e identifikimit dhe ai dorëzoi letërnjoftimin, por e mbajti pasaportën të fshehur në trup.³⁷⁸

140. Hoxha shpjegoi se arsyeja për largimin nga shtëpia e tij në Gjakovë ishte se "forcat serbe" ia vranë familjen në shtëpinë e Vejsëve në rrugën Millosh Gilliq dhe ia shkatërruan shtëpinë, gjë që e bënë të kishte frikë për jetën e tij.³⁷⁹ Kur hyri në kolonë, shokët nga lagjja i treguan për njerëz të tjerë të vrarë në qytetin e Gjakovës dhe për shumë shtëpi duke u djegur.³⁸⁰ Dren Caka gjithashtu dëshmoi se pas vrasjes së familjes së tij në rrugën Millosh Gilliq, ai dhe anëtarët e mbetur të familjes u larguan nga qyteti i Gjakovës dhe u nisën për në Shqipëri, nëpërmjet vendkalimit kufitar të Qafës së Prushit, sepse kishin frikë nga policia në qytet.³⁸¹ Po ashtu K74-a deklaroi se u largua me familjen e tij për shkak se "serbët" i dogjën shtëpitë e shqiptarëve kosovarë dhe frikës se çfarë mund t'iu bënte policia. Ai tha se nuk kishte pasur frikë nga sulmet e NATO-s sepse ato godisnin vetëm objektiva ushtarake në qytetin e Gjakovës.³⁸² Hoxha deklaroi se as pjesëtarët e MPB-së, as pjesëtarët e UJ-së që kryenin dëbimin, nuk i kishin ofruar ndonjë ndihmë kolonës së të shpërngulurve shqiptarë kosovarë.³⁸³

d. Ngjarjet në qytetin e Gjakovës në maj 1999

141. Siç u përmend më lart, Fuat Haxhibeqiri tha se kishte parë kufoma shqiptarësh kosovarë në qytetin e Gjakovës gjatë tërë fushatës së NATO-s.³⁸⁴ Prej 7 deri më 11 maj 1999, ai pa forca të UJ-së, paraushtarake dhe të policisë kur hynë në pjesën perëndimore të Gjakovës dhe u vunë zjarrin disa objekteve private dhe plaçkitën disa dyqane.³⁸⁵ Këto forca vepruan në bashkëpunim gjatë këtij operacioni. Njerëzit u vranë në rrugë. Mirëpo Haxhibeqiri nuk ishte dëshmitar i asnjërës prej këtyre vrasjeve.³⁸⁶ I pyetur për kufomat e viktimave të cilat i kishte parë personalisht, ai dëshmoi se, nga 7 deri më 11 maj, ai kishte parë shtatë kufoma në distancë deri 50 metra nga shtëpia e tij dhe të gjitha kishin plagë nga armë zjarri. Ai e identifikoi njërin prej tyre si Ali Beqë Rama nga letërnjoftimi që e

³⁷⁷ Hani Hoxha, P2267 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 prill 1999), f. 5.

³⁷⁸ K74, P2532 (deklarata e dëshmitarit), f. 6.

³⁷⁹ Hani Hoxha, P2267 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 prill 1999), f. 5.

³⁸⁰ Hani Hoxha, P2267 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 prill 1999), f. 4.

³⁸¹ Dren Caka, T. 2654 (31 gusht 2006).

³⁸² K74, P2532 (deklarata e dëshmitarit), f. 6.

³⁸³ Hani Hoxha, P2267 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 prill 1999), f. 5.

³⁸⁴ Fuat Haxhibeqiri, P2308 (deklarata e dëshmitarit e datës 28 gusht 2001), f. 3, 7, T. 1113 (8 gusht 2006), T. 1292-1295 (9 gusht 2006).

³⁸⁵ *Shih* Fuat Haxhibeqiri, P2308 (deklarata e dëshmitarit e datës 28 gusht 2001), f. 8.

³⁸⁶ Fuat Haxhibeqiri, T. 1175 (8 gusht 2006), T. 1292-1293 (9 gusht 2006).

kishte pasur në xhep dhe mësoi se dy viktima të tjera ishin vëllezër me mbiemër Humaj, por nuk i dinte emrat e katër viktimave të tjera. Në një shteg afër shtëpisë së tezes/hallës së tij, ai pa edhe katër kufoma të tjera, njëra prej të cilave ishte e Florenc Sulejmanit; të gjithë ishin vrarë me armë zjarri.³⁸⁷

142. Siç është theksuar më lart, Radovan Zlatkoviç deklaroi se gjatë periudhës 7 - 11 maj UÇK-ja ishte aktive në Gjakovë dhe kishte pasur nën kontroll pjesë të qytetit.³⁸⁸ Po ashtu Haxhibeqiri pranoi se në fillim të majit 1999, në qytet pati luftime midis UÇK-së dhe forcave të RFJ-së/Serbisë.³⁸⁹ Në përputhje me këto dëshmi, raportet e MPB-së tregojnë se në maj 1999, në Gjakovë vazhduan operacionet e përbashkëta me UJ-në. Në një mbledhje të Shtabit të MPB-së për Kosovën më 11 maj 1999, një komandant i PJP-së raportoi se në operacionet në qytetin e Gjakovës ishin eliminuar shumica e "terroristëve" dhe se operacioni i "spastrimit" do të vazhdonte lagje për lagje. Ai deklaroi se operacione të ngjashme po kryheshin në qytetet e tjera në komunë në bashkëveprim me UJ-në. Ai gjithashtu theksoi se forcat e UJ-së ishin të padisiplinuara, duke shtuar se "pas çdo operacioni, rezervistët e UJ-së i digjnin shtëpitë dhe hynin në to," dhe se komandantët e UJ-së ishin informuar për këtë.³⁹⁰ Dhoma vëren se Mbrojtja e Llazareviçit mbështetet në këtë dokument në lidhje me çështjen e transferimit të vartësisë, por nuk bën komente në lidhje me pretendimet e komandantit të MPB-së se ushtarët e UJ-së dogjën shtëpi në qytetin e Gjakovës.³⁹¹

e. Konkluzione

143. Nuk vihet në dyshim se shumë ndërtesa në qendër të Gjakovës, përfshirë edhe pazarin e vjetër, u dëmtuan ose u shkatërruan nga zjarri në ditët e para të fushatës së NATO-s. Mirëpo, as Haxhibeqiri, as Vejsa nuk ishin në gjendje të dëshmonin si u shkaktuan këto zjarre. Gjithashtu, Prokuroria nuk ishte në gjendje të përjashtonte jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm mundësinë se zjarret atë natë u shkaktuan nga një flakë e shkaktuar nga bombat e NATO-s. Rrjedhimisht, Dhoma nuk mund të saktësojë se kush ua vuri zjarrin ndërtesave në qytetin e Gjakovës në natën e 24 marsit 1999, në rast se ka pasur zjarrvënie.

144. Dhoma konkludon se Xhamia e Hadumit në Gjakovë u shkatërrua më 8 maj 1999, siç është përshkruar nga Haxhibeqiri dhe konfirmuar nga Riedlmayer-i. Mirëpo, asnjëri nga këta dëshmitarë nuk ishte në gjendje të dëshmonte se kush kishte qenë përgjegjës për këtë shkatërrim. Rrjedhimisht,

³⁸⁷ Fuat Haxhibeqiri, T. 1292, 1295-1296 (9 gusht 2006).

³⁸⁸ Radovan Zlatkoviç, 6D1627 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 prill 2008), para. 32-33.

³⁸⁹ Fuat Haxhibeqiri, P2308 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 prill 1999), f. 5, T. 1078 (7 gusht 2006).

³⁹⁰ P1993 (procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 11 maj 1999), f. 6.

³⁹¹ *Shih* Dosjen Gjyqësore Përfundimtare të Llazareviçit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 801.

Dhoma konkludon se akuza e paraqitur në paragrafin 77(d) të Aktakuzës nuk është provuar në lidhje me Xhaminë e Hadumit në qytetin e Gjakovës. Shkatërimi i bibliotekës së Hadum Sulejman Efendisë nuk është përfshirë në akuzat për përndjekje të paraqitura në paragrafin 77(d) të Aktakuzës dhe Dhoma nuk dëgjoi ndonjë dëshmi në lidhje me përgjegjësit e djegies së saj. Si pasojë, Dhoma nuk ka nxjerrë ndonjë përfundim në lidhje me këtë objekt.

145. Përveç dëshmive që kanë konkretisht për zjarret e shkaktuara gjatës së 24 marsit, banorët e qytetit të Gjakovës gjithashtu dëshmuar se shtëpitë e shqiptarëve kosovarë vazhduan të digjeshin në fund të marsit dhe fillim të prillit 1999. Dëshmia e Haxhibeqirit se kishte parë forca policore dhe paraushtarake duke vënë zjarre gjatë bombardimeve të NATO-s përputhet me dëshminë e Nikë Perajt se kishte parë pjesëtarë të MPB-së dhe paraushtarakë duke u vënë zjarrin shtëpive në qytetin e Gjakovës, të cilët përdornin "bomba" për t'i ndezur më lehtë zjarret.³⁹² Në dëshminë e tij në lidhje me djegien e shtëpive në qytet së bashku me pjesëtarët e MPB-së, K90-a përmendi një praktike të përdorimit të kanaçeve spërkatëse për të ndezur zjarrin në godina. Dhoma vëren se kjo dëshmi mbështetet edhe nga rrëfimet e Vejsajt dhe K74-ës, të cilët thanë se djegiet ndodhën vetëm te shqiptarët kosovarë. Rrjedhimisht, Dhoma konkludon se MPB-ja së bashku me paraushtarakët ishin përgjegjës për djegien e shtëpive të shqiptarëve kosovarë në qytetin e Gjakovës në mars dhe prill 1999. E vetmja dëshmi e pjesëmarrjes së UJ-së në djegien e shtëpive të shqiptarëve kosovarë në qytetin e Gjakovës në atë kohë u ofrua nga K90-a, i cili dëshmoi se kishte marrë pjesë edhe vetë.

146. Rezervat e Dhomës në lidhje me dëshmitë kontradiktore të Peroviqit dhe Zllatkoviqit janë të parëndësishme sepse dëshmia e Hoxhës në lidhje me vrasjen e Pruthit dhe Ferizit nuk bazohet në përvojë të drejtpërdrejt personale të krimeve dhe Prokuroria nuk ofroi të tjera dëshmi në lidhje me këto vrasje. Rrjedhimisht, këto vrasje nuk janë provuar.

147. Dhoma i konsideron bindëse dëshminë e Haxhibeqirit se shumë shqiptarë kosovarë të vdekur ishin lënë nëpër rrugë dhe rrëfimin e Konajt se kishte parë një grup civilësh që rriheshin nga policët dhe paraushtarakët jashtë stacionit të policisë. Dhoma gjykon se këto veprime, së bashku me djegien e shtëpive të shqiptarëve kosovarë, kontribuuan në atmosferën e frikës dhe dhunës të krijuar në qytetin e Gjakovës nga MPB-ja dhe më vonë nga UJ-ja. Dhoma i konsideron të besueshme dëshmitë e Lulzim Vejsës, Hani Hoxhës, Dren Cakës, dhe K74-ës në lidhje me largimin nga qyteti i Gjakovës në fillim të prillit 1999. Ikja e tyre e befasishme nga qyteti u shpejtua për shkak të vrasjes së anëtarëve të familjeve të tyre nga forcat e MPB-së dhe frika nga veprimet e tjera të këtyre forcave. Gjithashtu, MPB-ja dhe UJ-ja drejtuan largimin e tyre së bashku me një numër të

³⁹² Nikë Peraj, T. 1669 (15 gusht 2006), T. 1800 (17 gusht 2006). *Shih gjithashtu* Nikë Peraj, P2253 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 gusht 2006), para. 15.

konsiderueshëm të shqiptarëve kosovarë të tjerë të qytetit dhe konfiskuan dokumentet e identifikimit të shumë prej këtyre njerëzve. Dhoma gjykon se dëshmia jo e drejtpërdrejtë e Haxhibeqirit se gjatë periudhës prej 7-11 maj kishte parë kufoma, nuk është e mjaftueshme për nxjerrjen e përfundimeve në lidhje me shkakun e vdekjes. Megjithëse është vërtetuar se ai pa shqiptarë kosovarë të vdekur, ka dëshmi që tregojnë për veprime të UÇK-së në qytet, në maj 1999 dhe, rrjedhimisht, ka mundësi që vrasjet të kenë qenë pjesë e operacioneve të ligjshme kundër UÇK-së. Gjithsesi Dhoma e pranon dëshminë e tij se MPB-ja vazhdoi me djegien dhe plaçkitjen e pronave të shqiptarëve kosovarë gjatë kësaj periudhe dhe se në maj 1999 edhe UJ-ja mori pjesë në zjarrvëniet në qytetin e Gjakovës.

148. Në lidhje me vrasjet në rrugën Millosh Gilliq, duke u bazuar në provat kriminalistike dhe dëshmitë e Dren Cakës, Lulzim Vejsës, dhe Hani Hoxhës, Dhoma konkludon se më 2 prill 1999 personat në vijim u vranë ose si pasojë e të shtënave të drejtpërdrejta me armë nga pjesëtarët e MPB-së ose si pasojë e drejtpërdrejtë se u ndodhën në shtëpinë e Lulzim Vejsës kur iu vu zjarri nga forcat e MPB-së: Dalina Caka, Delvina Caka, Diona Caka, Valbona Caka, Hysen Gashi, Doruntina Haxhiavdia, Egzon Haxhiavdia, Rina Haxhiavdia, Valbona Haxhiavdia, Flaka Hoxha, Shahindere Hoxha, Manushe Nuçi, Shirine Nuçi, Arlind Vejsa, Dorina Vejsa, Fetije Vejsa, Marigona Vejsa, Rita Vejsa, Sihana Vejsa, dhe Tringa Vejsa.

7. Fshatrat e tjera në komunën e Gjakovës

149. Prokuroria pretendon se gjatë fundit të marsit dhe fillimit të prillit 1999, forcat e RFJ-së/Serbisë shpërngulën me dhunë civilët nga fshatra të ndryshme të komunës së Gjakovës.³⁹³ Mbrojtja e Llazareviqit kundërpërgjigjet se nuk ka prova se UJ-ja ka marrë pjesë në dëbimin e civilëve nga kjo komunë.³⁹⁴ Mbrojtja e Llukiqit argumenton se çdo largim i tillë i civilëve ishte rezultat i frikës nga bombardimet e NATO-s e jo i dëbimeve të dhunshme.³⁹⁵

150. Merita Deda nga Guska, fshat i vogël në perëndim të qytetit të Gjakovës, dëshmoi se kishte dëgjuar se, më 25 mars 1999, forcat e UJ-së kishin hyrë në fshatrat e afërt të Devës dhe të Babait të Bokës dhe kishin ekzekutuar tetë civilë.³⁹⁶ Disa ditë më vonë në fund të marsit, një "komandant ushtrie" i cili quhej Dragan, erdhi në Guskë dhe u tha banorëve të largoheshin nga fshati brenda një

³⁹³ Aktakuza, para. 72 (h)(ii). *Shih gjithashtu* Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 434.

³⁹⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 376.

³⁹⁵ Dosja Përfundimtare Gjyqësore e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 1082.

³⁹⁶ Merita Deda, P2233 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 prill 2000), f. 2.

ore.³⁹⁷ Deda deklaroi sa, si rezultat i këtij urdhri, ajo dhe familja e saj, së bashku me banorët e tjerë të fshatit, morën traktorët dhe makinat dhe u nisën në drejtim të Korenicës.³⁹⁸ Gjatë tri javëve të ardhshme, Deda pa forca të UJ-së dhe policisë, të cilat kishin rrethuar fshatin, patrullonin Korenicën, dhe i urdhëruan banorët të rrinin në shtëpi.³⁹⁹

151. Lizane Malaj nga Korenica e përshkroi fshatin e saj si fshat me popullatë shqiptare kosovare, shumica e të cilëve ishin katolikë dhe disa myslimanë.⁴⁰⁰ Sipas Malajt, policia erdhi në fshat më 4 prill 1999. Tetë policë hynë në oborrin e shtëpisë së saj, njëri prej të cilëve e urdhëroi familjen e saj të largohej nga fshati dhe të shkonte në Shqipëri.⁴⁰¹ Ajo dëshmoi se policët kishin uniforma të kaltra policie, mbanin mitraloza dhe erdhën me autobllinda.⁴⁰² Familja a Malajt iu bind urdhrit dhe u largua nga fshati me traktor së bashku me 30 fshatarë të tjerë. Sidoqoftë, në fshatin Sufadoll, i cili gjendet rreth një kilometër nga Korenica, kolona u ndalua nga dy policë të tjerë dhe u urdhërua të kthehej në Korenicë.⁴⁰³ Malaj e njohu njërin nga policët i cili ishte Aca Miçunoviq, që cili kishte banuar më parë në Korenicë. Malaj dhe familja e saj u kthyen në Korenicë, ku e gjetën shtëpinë e padëmtuar.⁴⁰⁴ Mbrojtja e Llukiqit argumenton se ky fakt tregon se MPB-ja nuk kishte qëllim që t'i largonte civilët përgjithmonë nga Korenica dhe se dëbimi i Malajt dhe familjes së saj së bashku me 30 persona të tjerë ishte rast i izoluar i kryer nga individë të caktuar.⁴⁰⁵

152. Dëshmitari K90 dëshmoi se, gjatë prillit 1999, njësia e tij e UJ-së mori pjesë në urdhërimin e largimit të fshatarëve shqiptarë kosovarë nga shtëpitë e tyre në komunën e Gjakovës.⁴⁰⁶ K90-a mori pjesë në "shpërnguljen"⁴⁰⁷ e shqiptarëve kosovarë nga fshatrat në komunë; më konkretisht, ai mori pjesë në urdhërimin e dëbimit të njerëzve nga nëntë apo 10 fshatra në mesin e prillit 1999.⁴⁰⁸

³⁹⁷ Merita Deda, T. 1399 (10 gusht 2006), P2233 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 prill 2000), f. 2.

³⁹⁸ Merita Deda, P2233 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 prill 2000), f. 2. *Shih gjithashtu* Merita Deda, T. 1400 (10 gusht 2006).

³⁹⁹ Merita Deda, P2233 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 prill 2000), f. 3.

⁴⁰⁰ Lizane Malaj, T. 1307 (9 gusht 2006), P2232 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 shtator 2001), f. 2.

⁴⁰¹ Lizane Malaj, P2232 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 shtator 2001), f. 2, T. 1308 (9 gusht 2006), T. 1366 (10 gusht 2006).

⁴⁰² Lizane Malaj, P2232 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2000), f. 3, T. 1307-1308 (9 gusht 2006), T. 1372 (10 gusht 2006).

⁴⁰³ Lizane Malaj, P2232 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 shtator 2001), f. 2-3. *Shih gjithashtu* Lizane Malaj, T. 1308 (9 gusht 2006), T. 1368 (10 gusht 2006).

⁴⁰⁴ Lizane Malaj, P2232 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 shtator 2001), f. 3. *Shih gjithashtu* Lizane Malaj, T. 1368 (9 gusht 2006), T. 1368 (10 gusht 2006).

⁴⁰⁵ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 1118.

⁴⁰⁶ K90, P2652 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 dhjetor 2002), para. 41.

⁴⁰⁷ K90, P2652 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 dhjetor 2002), para. 41-45, T. 9271-9273 (29 janar 2007).

⁴⁰⁸ K90, P2652 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 dhjetor 2002), para. 44, T. 9297-9298 (29 janar 2007).

153. K90-a dëshmoi se, në pajtim me urdhrat që kishte ai u drejtohej fshatarëve në serbisht duke u thënë të largoheshin në drejtim të qytetit të Gjakovës dhe fshatrave përreth.⁴⁰⁹ Ai më tej shpjegoi se urdhrat që merrte njësia e tij për "shpërnguljen" e njerëzve nuk ishin asnjëherë me shkrim, po përcilleshin me gojë sepse autoritetet kishin përvojë nga Kroacia dhe Bosnja që urdhra të tilla të mos ishin me shkrim.⁴¹⁰ Ai gjithashtu tha se urdhrat e një rëndësie të tillë duhej të miratoheshin në nivelet më të larta sepse këto lloje urdhrash nuk mund të jepeshin vetëm nga komandantët vendorë. Për më tepër, këto urdhra gjithmonë kishin të bënin vetëm me fshatrat e shqiptarëve kosovarë⁴¹¹ Megjithëse ekzistonte përjashtimi që i lejonte komandantët vendorë të urdhëronin shpërnguljen e fshatarëve për hir të sigurisë së tyre, e në një rast të tillë urdhri jepej me shkrim, largimi i këtyre civilëve nuk justifikohet nga pikëpamja ushtarake.⁴¹² Gjatë dëshmisë gojore, K90-a deklaroi se komandanti i tij nuk urdhëroi asnjëherë "dëbimin" e fshatarëve dhe se ai u urdhërua t'i drejtonte "këta njerëz në drejtim të Gjakovës dhe fshatrat më afër Gjakovës."⁴¹³ Për më tepër, ai deklaroi se civilët ishin drejtuar në drejtim të Shqipërisë vetëm pasi NATO-ja kishte hedhur bomba thërrmuese.⁴¹⁴ Mirëpo kur iu tha se fshatarët i kishin larguar për shkak të bombardimeve të NATO-s dhe rrezikut të sulmit tokësor, ai nuk u pajtua me këtë tezë.⁴¹⁵ Edhe pse fillimisht në gjyq hezitoi të thoshte se civilët shqiptarë kosovarë ishin dëbuar, ai përfundimisht dëshmoi se "nëse e pastroni një fshat, ju i dëboni këta njerëz."⁴¹⁶

154. K90-a shpjegoi se "pasi i urdhëronim fshatarët të iknin, brenda orës fshati bëhej sikur ta kishte goditur bomba bërthamore" si rezultat i plaçkitjes, por saktësoi se jo e tërë njësia merrte pjesë në veprime të tilla, por vetëm individët të UJ-së.⁴¹⁷ Ai gjithashtu dëshmoi se në njësinë e tij individët që kapeshin duke vjedhur, procedoheshin dhe burgoseshin.⁴¹⁸

155. K90-a pranoi se njësia e tij kishte marrë pjesë në dëbimin/shpërnguljen e shqiptarëve kosovarë prej Zhubit në jugperëndim të qytetit të Gjakovës.⁴¹⁹ Ai tha se urdhri për largimin e banorëve të Zhubit kishte ardhur para mesit të prillit 1999, edhe pse data e saktë nuk është e qartë.⁴²⁰ Sidoqoftë, ai gjithashtu tha se banorët e fshatit nuk u urdhëruan të largoheshin, por shkuan

⁴⁰⁹ K90, T. 9302 (29 janar 2007).

⁴¹⁰ K90, P2652 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 dhjetor 2002), para. 41.

⁴¹¹ K90, P2652 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 dhjetor 2002), para. 41.

⁴¹² K90, P2652 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 dhjetor 2002), para. 42.

⁴¹³ K90, T. 9273 (29 janar 2007).

⁴¹⁴ K90, T. 9273 (29 janar 2007).

⁴¹⁵ K90, T. 9408 (30 janar 2007).

⁴¹⁶ K90, T. 9331 (29 janar 2007).

⁴¹⁷ K90, P2652 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 dhjetor 2002), para. 45.

⁴¹⁸ K90, T. 9303-9304 (29 janar 2007).

⁴¹⁹ K90, P2652 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 dhjetor 2002), para. 41-43, T. 9271, 9273, 9297-9298 (29 janar 2007).

⁴²⁰ K90, P2652 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 dhjetor 2002), para. 43.

vullnetarisht me njësinë e tij.⁴²¹ K89-a, gjithashtu ushtar i UJ-së i vendosur në zonën e Gjakovës, dëshmoi se diku rreth 10 ose 12 prillit 1999, pa tetë persona të vrarë në Zhub: burra dhe plaka me rroba civile. Mirëpo ai nuk kishte qenë dëshmitar i vrasjes së tyre.⁴²²

156. Vllatko Vukoviqi mohoi se njësia e tij kishte marrë pjesë në dëbimin e civilëve nga shumica e fshatrave dhe lagjeve përreth Gjakovës gjatë pjesës së parë të prillit 1999.⁴²³ Vukoviqi tha se, më 30 mars 1999, pa në hyrje të Zhubit civilë shqiptarë kosovarë të cilët ishin nisur për në Shqipëri dhe se i ndihmoi duke siguruar një automjet për t'i transportuar deri në kufi.⁴²⁴ Vukoviqi gjithashtu dëshmoi se, më 4 prill 1999, takoi një grup civilësh shqiptarë kosovarë në rrugën Gjakovë-Prizren, duke ikur nga Kosova.⁴²⁵ Ai tha se këta njerëz i kishin thënë se po iknin për shkak të bombardimeve të NATO-s dhe frikës nga UÇK-ja dhe rrjedhimisht mohoi se njësia e tij kishte marrë pjesë në dëbimin e civilëve.⁴²⁶ Sidoqoftë, siç është diskutuar më poshtë, Dhoma nuk e pranon se kjo ishte arsyeja për ikjen e kaq shumë shqiptarëve kosovarë nga Gjakova.

157. Vukoviqi gjithashtu tregoi se më 30 mars 1999 mori të dhëna nga zëvendësi i tij se më 27 dhe 29 mars 1999, 5.000 civilë ishin larguar nga Kosova në Shqipëri nëpër kalimin kufitar Qafa e Prushit.⁴²⁷ Vukoviqi dëshmoi se Batalioni i 2-të i Motorizuar i kishte ndihmuar civilët të kalonin përmes një fushe të minuar për të arritur të sigurtë në kufi. Sipas tij, gjatë periudhave 28-31 mars dhe 1-4 prill 1999, nga Kosova u larguan 12.000 civilë duke kaluar nëpër zonën e përgjegjësisë së Batalionit të 2-të të Motorizuar dhe nëpër kalimin kufitar Qafa e Prushit.⁴²⁸ Ai më tej tregoi për lëvizjet e mëdha të civilëve në rrugën Gjakovë-Prizren gjatë së njëjtës periudhë.⁴²⁹ Dokumentacioni i UJ-së konfirmon se në fund të marsit dhe fillim të prillit 1999 civilët u zhvendosën nga fshatrat e tyre në komunën e Gjakovës nga forcat e RFJ-së/Serbisë. Raporti ditor i luftimeve i Korpusit i Prishtinës i datës 31 mars 1999 shënon se, së bashku me MPB-në, forcat e UJ-së po "kanalizonin" civilët për në anën tjetër të kufirit me Shqipërinë.⁴³⁰ Goran Jevtoviqi, i cili e kishte shkruar raportin, shpjegoi se "kanalizim" kishte kuptimin se ata i kishin ndihmuar civilët që ta kalonin kufirin të

⁴²¹ K90, T. 9297-9298 (29 janar 2007).

⁴²² K89, T. 9144-9145 (25 janar 2007).

⁴²³ Vllatko Vukoviqi, 5D1401 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para. 102 (e mbyllur me vulë)

⁴²⁴ Vllatko Vukoviqi, T. 21400-21401 (30 janar 2008), 5D1442 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para. 43.

⁴²⁵ Vllatko Vukoviqi, T. 21394-21395 (30 janar 2008), 5D1442 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para 46.

⁴²⁶ Vllatko Vukoviqi, 5D1442 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para. 46, 50.

⁴²⁷ Vllatko Vukoviqi, 5D1442 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para 42. *Shih gjithashtu* P2019 (Ditari i Luftës i Batalionit të 2-të të Motorizuar të Brigadës së 549-të të Motorizuar), f. 3-7 (e mbyllur me vulë); Vllatko Vukoviqi, T. 21362 (30 janar 2008).

⁴²⁸ Vllatko Vukoviqi, 5D1442 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para 44.

⁴²⁹ Vllatko Vukoviqi, 5D1442 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para 45. *Shih* P2019 (Ditari i Luftës i Batalionit të 2-të të Motorizuar të Brigadës së 549-të të Motorizuar) (e mbyllur me vulë).

⁴³⁰ P2390 (Raport Luftimi i PrK-së, 31 mars 1999), para. 4.

sigurtë, meqë nuk kishin të drejtë ligjore t'i ndalonin që të largoheshin nga vendi.⁴³¹ Ditari i luftës i Batalionit të 2-të të Motorizuar për datën 2 prill shënon se trupat e UJ-së i larguan civilët nga fshatrat Goden dhe Zulfaj, që të dy fshatra në perëndim të Gjakovës afër kalimit kufitar Qafa e Prushit. Ky dëbim u bë me justifikimin se fshatarët kishin "dërguar sinjale me drita" dhe kishin demonstruar sjellje armiqësore.⁴³²

158. Në lidhje me këto largime, Radovan Zllatkoviç dëshmoi se nga Gjakova u larguan njëkohësisht civilë nga të gjitha kombësitë në momentin kur filloi bombardimi i NATO-s.⁴³³ Zllatkoviç gjithashtu tha se UÇK-ja i shfrytëzoi vështirësitë e shkaktuara nga bombardimet e NATO-s si p.sh ndërprerja e rrymës, për kryerjen e aksioneve të tyre dhe dha si shembull sulmin kundër automjetit të Kryqit të Kuq në Rakovinë më 1 prill 1999.⁴³⁴

159. Në lidhje me pretendimet për shkatërrimin e godinave në fshatrat e Gjakovës, Sabri Popaj, shqiptar kosovar nga Bellacërka në komunën e Rahovecit, dëshmoi se kishte qenë dëshmitar i hedhjes në erë të xhamisë në Rogovë më 28 mars 1999,⁴³⁵ në festën myslimane të bajramit në të njëjtën ditë kur u shkatërruan xhamitë në Celinë dhe Bellacërkë.⁴³⁶ Popaj shpjegoi se të tri xhamitë ndodheshin afër njëra tjetrës; Celina dhe Bellacërka janë vetëm një kilometër e gjysmë larg.⁴³⁷ Sidoqoftë, ai nuk pa se kush ishin autorët e shpërthimit që shkatërroi xhaminë e Rogovës.

160. Siç është përmendur edhe më lart, Batalioni i 2-të i Motorizuar i Brigadës së 549-të të Motorizuar kreu një operacion në Rogovë më 30 mars 1999.⁴³⁸ Bozhidar Deliqi, i cili është i lindur në Gjakovë, mohoi pretendimet se forcat e UJ-së nën komandën e tij shkatërruan xhami në disa vende, duke përfshirë edhe Gjakovën.⁴³⁹

161. Në aktekspertizën e tij, András Riedlmayer-i raporton për gjendjen e Xhamisë së Kel Hasan Agës në fshatin Rogovë. Raporti përshkruan se xhamia ishte e dëmtuar rëndë, me minarenë e hedhur në erë, me dëmtime të mëdha nga zjarri, një pjesë të madhe të strehës të rrëzuar, dhe me

⁴³¹ Goran Jevtoviç, 5D1385 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 dhjetor 2007), para. 21-22.

⁴³² P2019 (Ditari i Luftës i Batalionit të 2-të të Motorizuar të Brigadës së 549-të të Motorizuar), f. 6 (e mbyllur me vulë).

⁴³³ Radovan Zllatkoviç, 6D1627 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 prill 2008), para. 38.

⁴³⁴ Radovan Zllatkoviç, 6D1627 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 prill 2008), para. 31. *Shih* 6D614 (Pasqyrë e MPB-së e veprave penale, 1 korrik 1998 deri më 20 qershor 1999), f. 704, para 603.

⁴³⁵ Sabri Popaj, T. 5678-5679 (1 nëntor 2006). Dëshmia e Popajt në lidhje me xhamitë në Celinë dhe Bellacërkë (afër Rogovës) diskutohet në Pjesën VII.E më poshtë.

⁴³⁶ Sabri Popaj, T. 5640, 5678 (1 nëntor 2006).

⁴³⁷ Sabri Popaj, T. 5650, 5681 (1 nëntor 2006), 5762 (2 nëntor 2006), P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 11. *Shih gjithashtu* IC97 (e shënuar P1806 që tregon xhaminë e shkatërruar të Rogovës).

⁴³⁸ P2019 (Ditari i Luftës i Batalionit të 2-të të Motorizuar të Brigadës së 549-të të Motorizuar), f. 5 (e mbyllur me vulë).

⁴³⁹ Bozhidar Deliq, T. 19391 (29 nëntor 2007).

muret e jashtme të çara.⁴⁴⁰ Sipas banorëve të fshatit, "forcat serbe" e sulmuan xhaminë më 3 prill 1999.⁴⁴¹ Gjatë dëshmisë së tij gojore, Riedlmayer-it iu tregua një fotografi të xhamisë dhe ai përshkroi dëmtimet e saj.⁴⁴²

a. Konkluzionet mbi pretendimet në lidhje me fshatrat e Gjakovës

162. Dhoma është bindur se në fund të marsit dhe në prill 1999 shumë banorë civilë të fshatrave në komunën e Gjakovës, përfshirë edhe Korenicën dhe Guskën, u larguan nga shtëpitë e tyre dhe shkuan në Shqipëri. Sidoqoftë, në lidhje me dëbimin e fshatarëve nga Deva dhe Babai i Bokës rreth datës 29 mars 1999, duke marrë parasysh dëshminë e Merita Dedës e cila bazohej në të dhënat të tërthorta, Dhoma nuk ka nxjerrë asnjë përfundim. Dhoma gjithashtu konkludon se nuk është provuar përdorimi i forcë për t'i detyruar banorët e Guskës të largoheshin në fund të marsit 1999. Po ashtu nuk është provuar se shqiptarët kosovarë u shpërngulën përdhunshëm nga Zhubi.

163. Në lidhje me Korenicën, Dhoma mbështetet në dëshminë e Lizane Malajt dhe konkludon se më 4 prill 1999 pjesëtarët e MPB-së i larguan fshatarët me forcë nga shtëpitë e tyre. Dhoma pranon dëshminë e Malajt se kjo shpërngulje e dhunshme nuk u shkaktuar prej UÇK-së apo prej bombardimeve të NATO-s. Në lidhje me shpërnguljen e fshatarëve nga shtëpitë e tyre në këtë komunë, Dhoma merr në konsideratë dëshmitë posaçërisht të K90-ës, Vllatko Vukoviqit, dhe Goran Jevtoviqit, dhe pretendimet e përgjithshme për dëbimin e fshatarëve nga komuna e Gjakovës do t'i analizojë në konkluzionet e saj të paraqitura më poshtë për operacionin e Luginës së Caragojt.

164. Edhe pse është vërtetuar se Xhamia e Kel Hasan Agës në Rogovë si dhe dy xhami të tjera në afërsi të saj u dëmtuan rëndë më 28 mars 1999, Dhoma konkludon se nuk është zbuluar identiteti i shkaktarëve të dëmtimit.

8. Operacioni në Luginën e Caragojt dhe luginat përreth (27 dhe 28 prill 1999)

165. Më 27 dhe 28 prill 1999, UJ-ja dhe MPB-ja filluan një operacion të madh në tërë Luginën e Caragojt. Prokuroria akuzon se gjatë këtij operacioni, forcat e MPB-së dhe UJ-së shpërngulën me dhunë, vranë, dhe përdoqën civilët shqiptarë kosovarë të kësaj zone. Ajo pretendon se ky operacion synonte kryesisht popullatën civile të asaj zone.⁴⁴³ Prokuroria pretendon se gjatë operacionit, forcat e MPB-së dhe UJ-së vranë një grup prej më shumë se 300 vetësh.⁴⁴⁴ Mbrojtja e

⁴⁴⁰ P1784 (pjesë nga P1789 në lidhje me Xhaminë e Kel Hasan Agës), f. 1.

⁴⁴¹ *Shih* P1784 (pjesë nga P1789 në lidhje me Xhaminë e Kel Hasan Agës), f. 1-2.

⁴⁴² András Riedlmayer, T. 5469 (30 tetor 2006).

⁴⁴³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 451.

⁴⁴⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 456.

Llukiqit dhe Llazareviqit e kundërshtojnë këtë akuzë dhe pretendojnë se operacioni në Luginën e Caragojt ishte operacion legjitim kundër UÇK-së, që ishte ndërmarrë për shkak të veprimeve të vazhdueshme armiqësore të UÇK-së në atë zonë. Ekipet mbrojtëse të Llukiqit dhe Llazareviqit gjithashtu argumentojnë se Prokuroria nuk ka arritur të provojë se krimet u kryen gjatë operacionit të forcave nën komandën e individëve të akuzuar.⁴⁴⁵

166. Aktekspertizat kriminalistike evidentojnë zhvarrosjen e një numri të madh të kufomave të shqiptarëve kosovarë në vitin 2001 nga varret e përbashkëta në Batajnicë dhe Petrovo Sellë në Serbi.⁴⁴⁶ Është provuar se 287 kufoma ishin shqiptarëve kosovarë të cilët u zhdukën më 27 prill 1999 në Mejë dhe rreth saj, siç është dokumentuar nga Zyra e UNMIK-ut për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore. Një rishikim i provave në lidhje me kufomat nga rrethina e Mejës të gjetura në Batajnicë sugjeron se ata ishin të veshur me rroba civile dhe, aty ku mund të identifikoheshin shkak i vdekjes, shumica kishin vdekur nga plagët prej armëve të zjarrit dhe ishin meshkuj të moshës 15 deri 80 vjeçare. Nga 17 viktimat të cilat përmenden me emër në dëshmitë konkrete të dëshmitarëve Merita Deda, Lizane Malaj, dhe Martin Pnishi, 13 u identifikuan ndërmjet kufomave të gjetura në varret e përbashkëta në Batajnicë.

a. Zanafilla dhe komandimi i operacionit në Luginën e Caragojt

167. Edhe pse ka shumë prova që i janë paraqitur Dhomës në lidhje me operacionin në Luginën e Caragojt, asnjë urdhër me shkrim për fillimin e tij nuk është paraqitur si provë. Dhoma është bindur se operacioni është urdhëruar dhe komanduar me gojë dhe më tej do të analizojë rrethanat kontradiktore në lidhje me të.

168. Më 22 prill 1999, rreth orës 17:00, u vranë Millutin Prashçeviq, zyrtar vendor i MPB-së, dhe katër policë të tjerë në fshatin Mejë afër Gjakovës në skajin jugor të luginës së Caragojt.⁴⁴⁷ Po atë njëjtën ditë, nga Gjakova erdhën forcat e MPB-së në kolonë dhe hapën zjarr me armë automatike në drejtim të shtëpive përgjatë rrugës.⁴⁴⁸ K90-a dëshmoi se vrasja e pesë policëve shërbeu si shkak për dislokimin masiv të policisë në atë zonë dhe se brenda disa ditësh, erdhën 400

⁴⁴⁵ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 1069 *et seq*; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 359 *et seq*.

⁴⁴⁶ *Shih* Shtojca A; *shih* P2798 (lista e ZPZHK-së e personave të zhdukur); f. 24-29; P2454 (kopjet e aktekspertizave kriminalistike dhe vërtetimet e vdekjes të lëshuara nga ZPZHK-ja në Kosovë në lidhje me kufomat e bartura nga Batajnica dhe Petrovasella); P944 (kopjet e aktekspertizave kriminalistike dhe vërtetimet e vdekjes në lidhje me kufomat e bartura nga Batajnica); P942 (Dokumente në lidhje me vendin e zhvarrosjes në Batajnicë 02: aktautopsitë); P943 (Raportet e ZPZHK-së); P2394 (kopjet e aktekspertizave kriminalistike dhe vërtetimet e vdekjes të lëshuara nga ZPZHK-ja në Kosovë në lidhje me kufomat e bartura nga Batajnica, para 31 marsit 2005).

⁴⁴⁷ Martin Pnishi, P2236 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 prill 2000), f. 2, T. 1441-1442 (10 gusht 2006), T. 1457 (11 gusht 2006); 6D35 (Kallëzim penal i MPB-së drejtuar Prokurorit Publik të Gjakovës, 22 prill 1999), f. 2.

⁴⁴⁸ Martin Pnishi, T. 1442 (10 gusht 2006).

policë më shumë me rreth 10 autobusë dhe me makina civile, duke përfshirë pjesëtarë të PJP-së dhe njerëzit e Frenkit nga Dega e Sigurimit Shtetëror të MPB-së, JSO. K90-a i njohu njerëzit e Frenkit nga uniforma dhe sepse ata mbanin "kapelat e njohura të Frenkit."⁴⁴⁹

169. Nikë Peraj dëshmoi se, pak pas vrasjes së Prashçeviqit, në një shtëpi private në Gjakovë u mbajt një mbledhje joformale, në të cilën morën pjesë, ndërmyet të tjerëve, shefi i sigurimit të brigadës së tij, Brigada e 52-të e Raketave Artilerike, Sergej Peroviq, dhe shefi i degës së sigurimit të Korpusit të Prishtinës, Momir Stojanoviq.⁴⁵⁰ Peraj tregoi se, "gjatë mbledhjes, Stojanoviqi iu drejtua Miçunoviqit [komandanti i rezervistëve të UJ-së në Gjakovë] dhe Kovaçeviqit [shef i SPB-së në Gjakovë] duke i urdhëruar të kryenin një operacion në Luginën e Caragojt, ku duhej të eliminoreshin së paku 100 'koka' dhe të gjitha shtëpitë duhej të digjeshin si hakmarrje për vrasjen e Prashçeviqit."⁴⁵¹ Sipas Perajt, Stojanoviqi e përmendi miqësinë e ngushtë që kishte me të akuzuarin Pavkoviç dhe ofroi mbrojtjen e Miçunoviqit dhe Kovaçeviqit.⁴⁵² Peraj e përshkroi Stojanoviqin si "i njohur i tij" i cili i kishte thënë në fillim të marsit 1999 se forcat e RFJ-së/Serbisë do të spastronin etnikisht popullatën shqiptare kosovare në komunën e Gjakovës.⁴⁵³ Peraj tha se kishte qenë i pranishëm në atë moment sepse mbledhja u mbajt në të njëjtën godinë në të cilën ishte vendosur ai me njësinë e vet të sigurimit.⁴⁵⁴ Gjatë fazës së pyetjeve nga Mbrojtja, ai sqaroi se deklarata në lidhje me 100 kokat që duhej të eliminoreshin ishte bërë gjatë funeralit të Prashçeviqit dhe se ai nuk kishte marrë pjesë drejtpërsëdrejti në bisedë, por i kishte dëgjuar komentet që ishin bërë.⁴⁵⁵

170. Në të kundërt, Momir Stojanoviqi tha se ai nuk kishte marrë pjesë në ndonjë mbledhje të kësaj natyre.⁴⁵⁶ Ai dëshmoi se Peraj ishte "ndihmëskomandant për çështje të garnizonit," pozitë që nuk ia lejonte praninë në mbledhjet e komandës së brigadës.⁴⁵⁷ Stojanoviqi supozoi se Perajt i kishte bërë shantazh UÇK-ja për ta detyruar të bënte deklarata të rreme.⁴⁵⁸ Ai gjithashtu mohoi se i kishte urdhëruar njësitë e UJ-së që të dëbonin shqiptarët kosovarë ose të digjin ndërtesat. Ai dëshmoi se për operacionin e Luginës së Caragojt u vu në dijeni në mbrëmjen e 28 prillit 1999 nga

⁴⁴⁹ K90, T. 9313-9314 (29 janar 2007), P2652 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 dhjetor 2002), para. 47.

⁴⁵⁰ Nikë Peraj, P2253 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 gusht 2006), para. 59.

⁴⁵¹ Nikë Peraj, P2253 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 gusht 2006), para. 59, T. 1673 (15 gusht 2006).

⁴⁵² Nikë Peraj, P2253 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 gusht 2006), para. 60-61, T1780 (16 gusht 2006).

⁴⁵³ Nikë Peraj, P2253 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 gusht 2006), para. 57.

⁴⁵⁴ Nikë Peraj, P2253 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 gusht 2006), para. 62.

⁴⁵⁵ Nikë Peraj, T. 1779 (16 gusht 2006).|

⁴⁵⁶ Momir Stojanoviq, T. 19787-19788 (7 dhjetor 2007). *Shih gjithashtu* Sergej Peroviq, 5D1396 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 janar 2008), para. 18.

⁴⁵⁷ Momir Stojanoviq, T. 19786-19787 (7 dhjetor 2007). *Shih gjithashtu* Sergej Peroviq, 5D1396 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 janar 2008), para. 20.

⁴⁵⁸ Momir Stojanoviq, T. 19839 (7 dhjetor 2007). *Shih gjithashtu* Sergej Peroviq, 5D1396 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 janar 2008), para. 21.

shefi i sigurimit të Brigadës së 52-të të Raketave Artilerike. Ai tha se, me gjithë pozitën e tij pozitës së tij, nuk informohej në lidhje me përdorimin e policisë ushtarake për operacione, por merrte vetëm informata në lidhje me sigurinë.⁴⁵⁹

171. Sidoqoftë, pretendimet e Stojanoviçit për mospjesëmarrjen e tij në operacionet e njëjësive të UJ-së rrëzohen nga fakti se ditari i luftës i Batalionit të 52-të të Policisë Ushtarake përmban shënimin se, më 13 prill 1999, një kompani e formuar posaçërisht nga ky batalion "u ngarkua me detyrë" nga shefi i degës së sigurimit të Korpusit të Prishtinës për të zënë pikën kufitare në Kamenicë.⁴⁶⁰ Kjo demonstroi se Stojanoviçi ishte i implikuar drejtpërsëdrejti në operacionet dhe në dhënien e urdhrave njëjësive nën komandën e Korpusit të Prishtinës dhe duhet të ketë qenë i informuar për lëvizjen e tyre. Gjithashtu, Dhoma vëren se Peraj pranoi se biseda të cilën dëgjoi ai, nuk u bë në kuadrin e një mbledhjeje formale, kështu që pozita e tij në UJ nuk do të ishte pengesë për praninë e tij.

172. Vintari tha se Brigada e 52-të e Raketave Artilerike ishte e vendosur në qendrën kulturore në Gjakovë dhe jo në shtëpinë private të një shqiptari ku Peraj pretendonte se ishte mbajtur mbledhja për planifikimin e operacionit në Luginën e Caragojt.⁴⁶¹ Pretendimi i Vintarit mbështetet pjesërisht nga ditari i luftës i Brigadës së 52-të të Raketave Artilerike, në të cilin bëhet e ditur se shtabi i saj kishte kaluar në qendrën kulturore në Gjakovë më 1 prill 1999.⁴⁶² Mirëpo, kur u pyet për një shënim në ditar që i referohet kalimit të Brigadës nga "shtëpia e Marseniçit" në qendrën kulturore më 1 prill, Vintari tha se nuk dinte gjë për këtë shtëpi dhe nuk dha shpjegime bindëse se pse pjesëtarët e njëjësive së nuk mund të kishin qenë në shtëpi private.⁴⁶³

173. Millan Koturi dëshmoi se kishte marrë pjesë në mbledhjen koordinuese në përgatitje të operacionit në Luginën e Caragojt me shefin e SPB-së së Gjakovës, Kovaçeviçin.⁴⁶⁴ Ai dëshmoi se, në këtë mbledhje, Verolub Zhivkoviçi, komandant i postëkomandës pararojë dhe shef i shtabit të Korpusit të Prishtinës, lëshoi komandën luftarake për njësitë e UJ-së që të siguronin zonën e Caragojt.⁴⁶⁵

⁴⁵⁹ Momir Stojanoviç, T. 19858-19862 (7 dhjetor 2007).

⁴⁶⁰ P2297 (ditari i luftës të Batalionit të 52-të të Policisë Ushtarake), f. 6. *Shih gjithashtu* K73, P2440 (deklarata e dëshmitarit), para. 33, T. 3313-3317 (13 shtator 2006).

⁴⁶¹ Zdravko Vintari, 5D1394 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 dhjetor 2007), para. 20. *Shih gjithashtu* Sergej Peroviçi, 5D1396 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 janar 2008), para. 20.

⁴⁶² P1086 (Ditari i Luftës i Brigadës së 52-të të Raketave Artilerike), f. 9.

⁴⁶³ Zdravko Vintari, T. 21049-21051 (25 janar 2008).

⁴⁶⁴ Millan Koturi, T. 20680 (21 janar 2008). Ai nuk tregoi se kur ishte mbajtur kjo mbledhje.

⁴⁶⁵ Millan Koturi, T. 20682-20683 (21 janar 2008).

174. Nikë Peraj gjithashtu dëshmoi se, më 23 dhe 24 prill, Nikolla "Dragan" Miçunoviqi i tha se Lugina e Caragojt do të paguante "çmim shumë të lartë" për vrasjen e Millutin Prashçeviqit. Peraj theksoi se Prashçeviqi kishte qenë "kumbar" i Miçunoviqit.⁴⁶⁶ Ai tha se operacioni i Luginës së Caragojt kishte tri motive: eliminimin e pranisë së UÇK-së në atë zone, hakmarrjen për vrasjen e Prashçeviqit, dhe vrasjen e shqiptarëve kosovarë të cilët mund të shkonin në Shqipëri për stërvitje dhe të ktheheshin në Kosovë për të luftuar për UÇK-në.⁴⁶⁷ Ai dëshmoi se motivi i tretë ishte më i rëndësishmi dhe se ishte synimi kryesisht i forcave të policisë, paraushtarake dhe të Mbrojtjes Territoriale.⁴⁶⁸

175. Millan Koturi dëshmoi se motivi i operacionit ishte për t'iu kundërvënë kërcënimit nga UÇK-ja e jo për t'u hakmarrë për vrasjen e Prashçeviqit.⁴⁶⁹ Sasha Antiqi, i cili ishte komandant i Batalionit të 52-të të Policisë Ushtarake në atë kohë, dëshmoi ngjashëm se operacioni i Luginës së Caragojt ishte ndërmarrë për t'iu kundërvënë kërcënimit të lidhjes së forcave të UÇK-së në kufi me UÇK-në në Luginën e Caragojt.⁴⁷⁰ Kur u ballafaqua me një pjesë nga ditari i luftës ku lexohej se operacioni i Luginës së Caragojt kishte shkuar sipas planit, Jevtoviqi këmbënguli se nuk kishte pasur plan apo urdhër me shkrim në lidhje me operacionin në Luginën e Caragojt.⁴⁷¹

176. Në prill 1999, dëshmitari K73 u dislokua në komunën e Deçanit në veri të komunës së Gjakovës.⁴⁷² Komandanti i tij i tha se njësia e tij duhej të "pastronte" zonën nga shqiptarët kosovarë dhe t'i dërgonte të gjithë civilët shqiptarë kosovarë në drejtim të Korenicës në mënyrë që policia të mund t'i kapte pjesëtarët e UÇK-së, të cilët cilësoheshin "terroristë."⁴⁷³ K73-shi dëshmoi se ky ishte "preteksti" dhe se qëllimi i vetëm i operacionit ishte spastrimi i fshatrave nga shqiptarët kosovarë. Ai sqaroi deklaratën e vet gjatë marrjes në pyetje nga Dhoma duke thënë se nuk e kishte ditur se fshatarët do të vriteshin, por dinte se do të dëboheshin.⁴⁷⁴ Në lidhje me UÇK-në, ai deklaroi se asnjë

⁴⁶⁶ Nikë Peraj, P2253 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 gusht 2006), para. 58.

⁴⁶⁷ Nikë Peraj, T. 1731-1732 (16 gusht 2006).

⁴⁶⁸ Nikë Peraj, T. 1731-1732 (16 gusht 2006).

⁴⁶⁹ Millan Kotur, T. 20680-20681 (21 janar 2008).

⁴⁷⁰ Sasha Antiq, 5D1443 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para. 21. *Shih gjithashtu* Sergej Peroviç, 5D1396 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 janar 2008), para 22.

⁴⁷¹ Goran Jevtoviç, T. 20415-20416 (16 janar 2008); P1086 (Ditari i Luftës i Brigadës së 52-të Artilerike Raketore), f. 33.

⁴⁷² K73, P2440 (deklarata e dëshmitarit), para. 38, 40.

⁴⁷³ K73, P2440 (deklarata e dëshmitarit), para. 40, T. 3380 (14 shtator 2006) (seancë e mbyllur).

⁴⁷⁴ K73, P2440 (deklarata e dëshmitarit), para. 40, T. 3326 (13 shtator 2006) (seancë a mbyllur), T. 3382-3383 (14 shtator 2006) (seancë e mbyllur).

pjesëtar i saj nuk do të kishte shkuar vullnetarisht atje, sepse do të kishte qenë e pamundshme për t'i ikur forcave të UJ-së dhe MPB-së.⁴⁷⁵

177. Mirëpo Sasha Antiqi i kundërshtoi pretendimet e K73 duke dëshmuar se qëllimi i operacionit të Luginës së Caragojt ishte parandalimi i rrjedhës apo "përhapjes" së pjesëtarëve të UÇK-së të cilët kërkoheshin nga njësitë e MPB-së.⁴⁷⁶ Edhe Momir Stojanoviç deklaroi se UJ-ja nuk kishte urdhëruar dëbimin e civilëve nga fshatrat e tyre.⁴⁷⁷

178. Gjithashtu dëshmitë e dëshmitarëve ndryshojnë në lidhje me komandimin e këtij operacioni. Nikë Peraj tha se i Akuzuari Llazareviç e koordinoi operacionin së bashku me Goran Jevtoviçin nga postëkomanda pararojë e Korpusit të Prishtinës në qytetin e Gjakovës.⁴⁷⁸ Peraj shtoi se gjatë operacionit pa Millan Koturin dhe Novica Stankoviçin si përfaqësues të Komandës së Korpusit të Prishtinës në postëkomandën e Osek Hylës, prej nga shihet Lugina e Caragojt.⁴⁷⁹ Dhoma vëren se, më 11 prill 1999, Bateria e 1-rë e Përzierë e Brigadës së 52-të të Raketave Artilerike u pozicionua në sektorin e Osek Hylës.⁴⁸⁰ Postëkomanda e MPB-së u ngrit në fshatin e afërm të quajtur Duzhnje.⁴⁸¹

179. Millan Koturi kundërshtoi dëshminë e Perajt duke thënë se vetëm Zhivkoviç mund t'u jepte urdhra të gjithë njësitë të UJ-së të përfshira në operacion.⁴⁸² Dragan Zhivanoviç, Goran Jevtoviç, dhe Vllatko Vukoviç dëshmuar se u ngarkuar me detyrë për këtë operacion gojarisht nga Zhivkoviç, meqenëse në operacion merrnin pjesë vetëm toga të veçanta e jo brigada të plota.⁴⁸³ Mirëpo në një raport luftimesh të datës 27 prill 1999 që Brigada e 125-të e Motorizuar i dërgoi komandës së Korpusit të Prishtinës flitet për spastrimin e terrenit në Luginën e Caragojt "në pajtim me vendimin tuaj."⁴⁸⁴ Koturi dëshmoi se vendimi të cilit i referohet ky raport ishte vendim i komandantit të postëkomandës pararojë, Zhivkoviçit, dhe jo i Llazareviçit.⁴⁸⁵

⁴⁷⁵ K73, P2440 (deklarata e dëshmitarit), para. 40, *Shih gjithashtu* K73, T. 3326 (13 shtator 2006) (seancë e mbyllur), T. 3381-3382 (14 shtator 2006) (seancë e mbyllur).

⁴⁷⁶ Sasha Antiq, 5D1443 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para. 22, 23, T. 21156 (28 janar 2008).

⁴⁷⁷ Momir Stojanoviç, T. 19732 (6 dhjetor 2007).

⁴⁷⁸ Nikë Peraj, T. 1580-1582 (14 gusht 2006), P2253 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 gusht 2006), para. 63.

⁴⁷⁹ Nikë Peraj, T. 1629 (14 gusht 2006); Nikë Peraj, P2253 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 gusht 2006), para. 63.

⁴⁸⁰ P1086 (Ditari i Luftës i Brigadës së 52-të të Raketave Artilerike), f. 17.

⁴⁸¹ *Shih* Nikë Peraj, P2253 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 gusht 2006), para. 63; P326 (harta me shënime e zonës së Gjakovës).

⁴⁸² Millan Kotur, T. 20736 (21 janar 2008).

⁴⁸³ Dragan Zhivanoviç, T. 20587-20588 (18 janar 2008); Goran Jevtoviç, T. 20400-20401 (16 janar 2008); Vllatko Vukoviç, 5D1442 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para. 68-70.

⁴⁸⁴ P2024 (Raport luftimi i Brigadës së 125-të të Motorizuar dërguar Komandës së PrK-së, 27 prill 1999), f. 2.

⁴⁸⁵ Millan Kotur, T. 20733-20739 (21 janar 2008). *Shih gjithashtu* Goran Jevtoviç, T. 20402 (16 janar 2008).

b. Zhvillimi i operacionit në Luginën e Caragojt

180. Më 27 prill 1999, forcat e UJ-së dhe MPB-së të dislokuara në skajin verior të Luginës së Caragojt u nisën teposhtë luginës dhe arritën në Korenicë më 28 prill 1999.⁴⁸⁶ Brigada e 63-të Parashutiste e UJ-së përparoi përgjatë luginës në anën e majtë paralel me Batalionin e 52-të të Policisë Ushtarake, kurse Detashmenti i 73-të Territorial i PJP-së përparoi përgjatë vijës paralele në të djathtë.⁴⁸⁷ Millan Koturi tha se në spastrimin e terrenit morën pjesë kompanitë e PJP-së nga Gjakova dhe Prizreni, si dhe një kompani e Policisë Ushtarake të Batalionit të 52-të të Policisë Ushtarake dhe një njësi e Brigadës së 63-të Parashutiste.⁴⁸⁸

181. Vllatko Vukoviqi përdori hartën e zonës për të shënuar pozicionet e forcave të UJ-së pjesëmarrëse në operacion. Në përputhje me sa më sipër, ai shënoi pozicionin e Batalionit të 52-të të Policisë Ushtarake në mes të luginës, të Brigadës së 63-të Parashutiste në anën lindore, dhe të forcave të MPB-së në anën perëndimore.⁴⁸⁹ Gjithashtu, ai tregoi se Brigada e 125-të e Motorizuar ndodhej në zonën e Smonicës dhe se Brigada e 52-të e Raketave Artilerike ishte në dalje të qytetit të Gjakovës, në kodrën e Çabratit afër Osek Hylës. Vukoviqi tha se njësitë e PJP-së nga Gjakova dhe Peja ishin të angazhuara në kontrollimin e terrenit dhe shkatërrimin e UÇK-së ndërkohë që ai kishte angazhuar tri skuadra pushkatarësh, një skuadër të policisë ushtarake, dhe degë të tjera të logjistikës në Korenicë si pjesë e aksioneve antiterroriste të atjeshme.⁴⁹⁰

182. Sasha Antiqi, përshkrimi i kryerjes së operacionit prej të cilit përputhej në vija të trasha me përshkrimet e K73-shit, Nikë Perajt, dhe Vllatko Vukoviqit, tha se ai përdori dy njësi të Batalionit të 52-të të Policisë Ushtarake me 40 deri 50 ushtarë, që përparuan prej fshatit Dobrosh deri në Korenicë për të penguar rrjedhën apo "përhapjen" e pjesëtarëve të UÇK-së të cilët kërkoheshin nga njësitë e MPB-së.⁴⁹¹

⁴⁸⁶ Nikë Perajt tregoi se nga 27 deri më 28 prill 1999 forcat e UJ-së dhe MPB-së u pozicionuan dhe depërtuan përmes Luginës së Caragojt në drejtim të juglindjes diku prej Junikut e deri afër qytetit të Gjakovës. P326 (vrasjet në Mejë: harta e zonës me shënimet e dëshmitarëve). Kjo hartë është e ngjashme me hartën me shënimet e dëshmitarëve K73 dhe Antiq. Sidoqoftë, kjo hartë gjithashtu përmban edhe shënimet e lëvizjeve të refugjatëve. Kjo hartë e Luginës së Caragojt me shënimet e Nikë Perajt që tregonin madhësitë dhe lëvizjet e trupave të UJ-së dhe MPB-së iu tregua Jevtoviqit. Jevtoviqi tha se vlerësimet e Perajt ishin krejtësisht jorealiste. *Shih* Goran Jevtoviq, T. 20407-20409 (16 janar 2008); P2023 (Raport luftimi i Brigadës së 125-të të Motorizuar, 24 prill 1999). Sasha Antiqi i pasqyroj këto vërejtje në një hartë të shënuar si IC172. Sasha Antiq, T. 21153-21155 (28 janar 2008). Ai deklaroi se Brigada e 63-të Parashutiste kishte 30 deri 40 pjesëtarë në këtë operacion. Sasha Antiq, T. 21176 (28 janar 2008).

⁴⁸⁷ K73, P2440 (deklarata e dëshmitarit), para. 41; Nikë Perajt, P2253 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 gusht 2006); P2023 (Raport luftimi i Brigadës së 125-të të Motorizuar, 25 prill 1999), para. 65.

⁴⁸⁸ Millan Kotur, T. 20679-20680 (21 janar 2008). Ai dëshmoi se Batalioni i 52-të i Policisë Ushtarake të UJ-së zëvendësoi njësinë e PJP-së nga Peja meqenëse ajo nuk ishte në dispozicion.

⁴⁸⁹ IC174 (hartë e shënuar e Luginës së Caragojt, shënuar nga Vukoviqi më 29 janar 2008).

⁴⁹⁰ Vllatko Vukoviq, 5D1442 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para. 69.

⁴⁹¹ Sasha Antiq, 5D1443 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para. 22, 23, T. 21156 (28 janar 2008).

183. Sa i përket rolit të luajtur nga forca të ndryshme të UJ-së dhe MPB-së, Goran Jevtoviç dëshmoi se forcat e MPB-së ishin përgjegjëse për operacionet luftarake dhe kërkimore, kurse forcat pjesëmarrëse të UJ-së ishin përgjegjëse për mbulimin e krahëve të operacionit dhe rrugës Deçan-Gjakovë.⁴⁹² Mirëpo kjo dëshmi është në kundërshtim me përshkrimin e operacionit nga K73 dhe Nikë Peraj, përmendur më lart, dhe raportet e Brigadës së 125-të të Motorizuar, që bënë të ditur se një pjesë e brigadës u angazhua në "spastrimin" e Luginës së Caragojt nga pjesëtarët e UÇK-së.⁴⁹³ Dragan Zhivanoviç dëshmoi se termi "spastrim" i terrenit kishte të bënte vetëm me mbajtjen e bllokadës së këtyre zonave.⁴⁹⁴ Sidoqoftë, dokumentet e UJ-së tregojnë se njësitë e UJ-së nuk i kufizuan veprimet vetëm në mbulimin e krahëve të operacionit të njërive të MPB-së. Për shembull, ditari i luftës i Brigadës së 549-të të Motorizuar tregon se ajo veproi brenda fshatit Korenicë, ku pretendohet se janë kryer krime.⁴⁹⁵ Aty thuhet se, më 27 prill 1999, në orën 6 të mëngjesit, brigada bllokoi rrugën e fshatit Korenicë dhe më pas në orën 08:35 dikush nga një grup civilësh brenda Korenicës hapi zjarr kundër tyre.⁴⁹⁶ Për më tepër Millan Koturi dëshmoi se njësitë e UJ-së u angazhuan drejtpërdrejt në kontrollimin e terrenit, duke thënë se ato mbetën nën komandën e komandantit të Brigadës së 63-të Parashutiste, kurse forcat e MPB-së ishin nën komandën e komandantëve të policisë.⁴⁹⁷

184. Gjatë këtij operacioni postblloqet kontrolloheshin nga forcat e RFJ-së/Serbisë në atë zonë, siç përshkruhet më poshtë. Njëri prej tyre ndodhej në rrugën prej Dobroshit në Mejë, të cilën shqiptarët kosovarë të shpërngulur e përdornin për të udhëtuar në drejtim të jugut përgjatë Luginës së Caragojt. I dyti ishte i vendosur afër udhëkryqit në rrugën prej Korenicës në qytetin e Gjakovës, të cilën e përdornin shqiptarët kosovarë të shpërngulur nga Korenica dhe fshatrat përreth.⁴⁹⁸ Radovan Zllatkoviç konfirmoi se një postbllok i përzier u ngrit afër Mejës gjatë fushatës ajrore të

⁴⁹² Goran Jevtoviç, T. 20357 (16 janar 2008).

⁴⁹³ P2024 (Raport luftimi i Brigadës së 125-të të Motorizuar, 27 prill 1999), f. 2; P2025 (Raport luftimi i Brigadës së 125-të të Motorizuar, 27 prill 1999), f. 2; Dragan Zhivanoviç, T. 20589-20590 (18 janar 2008).

⁴⁹⁴ Dragan Zhivanoviç, T. 20589 (18 janar 2008).

⁴⁹⁵ P2019 (Ditari i Luftës i Batalionit të 2-të të Motorizuar të Brigadës së 549-të të Motorizuar), f. 11 (e mbyllur me vulë).

⁴⁹⁶ P2019 (Ditari i Luftës i Batalionit të 2-të të Motorizuar të Brigadës së 549-të të Motorizuar), f. 11 (e mbyllur me vulë); Vllatko Vukoviç, 5D1442 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para. 71.

⁴⁹⁷ Millan Kotur, T. 20703-20704 (21 janar 2008).

⁴⁹⁸ Nikë Peraj, T. 1578-1579 (14 gusht 2006); P326 (Vrasjet në Mejë, harta e zonës me shënimet e Nikë Perajt); IC8 (harta e Luginës së Caragojt me shënimet e Nikë Perajt më 14 gusht 2006). Peraj tha se postblloku ku kolonat me civilë nga Lugina e Caragojt dhe Korenica takoheshin, ishte në Orize. Dhoma vëren se fshatrat e Mejës dhe Orizes ishin të bashkuara. *Shih* Martin Pnishi, T. 1524 (11 gusht 2006). Rrjedhimisht Dhoma gjykon se Peraj e ka përdorur emrin Orize për të përshkruar udhëkryqin ku takohen rruga nga Korenica për në Gjakovë dhe rruga nga Juniku përgjatë Luginës së Caragojt. Radovan Zllatkoviç, T. 25293 (15 prill 2008). *Shih gjithashtu* 3D1128 (Raport luftimi i Armatës së 3-të drejtuar Shtabit të Përgjithshëm, 4 prill 1999), f. 3 (ku lexohet se në të gjitha rrugët e rëndësishme në Kosovë ishin ngritur postblloqe të përziera të ushtrisë dhe policisë).

NATO-s.⁴⁹⁹ Nikë Peraj dhe K73 thanë se operacioni i Luginës së Caragojt kishte për qëllim dëbimin e popullatës civile nga ajo zonë duke i drejtuar në këto dy postbllloqe, ku edhe ndodhën "masakrat."⁵⁰⁰ Martin Pnishi dëshmoi se postblloku i dytë afër Mejës, u përdor për ndarjen e burrave nga gratë e fëmijët dhe për konfiskimin e dokumenteve të identifikimit të tyre, siç përshkruhet më poshtë.⁵⁰¹

185. Në një raport të Korpusit të Prishtinës dërguar Komandës së Armatës së 3-të dhe Shtabit të Komandës së Lartë, bëhet e ditur se gjatë gjithë operacionit të Luginës së Caragojt nuk u vra asnjë ushtar, por se u plagosën 25 dhe se u vranë "dhjetëra terroristë".⁵⁰² Ky pohim përputhet me raportin e Brigadës së 125-të të Motorizuar të 29 prillit 1999, ku lexohet se operacioni ishte kryer me sukses dhe se ajo nuk kishte pësuar humbje përveç një plagosjeje të vogël.⁵⁰³ Në fakt, gjatë këtij operacioni u vra një ushtar sipas deklaratës së Sasha Antiqit, i cili përshkroi vrasjen e një ushtari nga njësia e tij në Ramoc.⁵⁰⁴ Ky bilanc përputhet më dëshminë e dhënë nga K73-shi se në natën e 27 prillit, gjatë një sulmi të rastësishëm në Ramoc, u vra një ushtar.⁵⁰⁵

i. Dobroshi dhe Ramoci

186. K73-shi tregoi se fshati i parë të cilin njësia e tij e "izoloi" më 27 prill ishte fshati Dobrosh në skajin verior të Luginës së Caragojt dhe "spastrimi etnik" vazhduar prej andej për dy ditë derisa mbërritën në Korenicë.⁵⁰⁶ Në ditën e parë ata dëbuan "qindra" civilë shqiptarë dhe u vunë zjarrin shtëpive të tyre.⁵⁰⁷ Nga dëshmia e K73-shit nuk del qartë nëse zjarrvënja ishte rezultat i urdhrit të drejtpërdrejtë, praktikës së zakonshme, apo indisiplinimit.⁵⁰⁸ Ai tha se kjo praktikohet zakonisht për të bërë të ditur pozicionet e njësive të ndryshme që ishin në radiokontakt ndërmjet tyre, duke përdorur si alternativë tymin e krijuar.⁵⁰⁹ Ai gjithashtu tha se civilët, ndër të cilët disa invalidë, u

⁴⁹⁹ Radovan Zlatković, T. 25293 (15 prill 2008).

⁵⁰⁰ Nikë Peraj, P2253 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 gusht 2006), para. 65; K73, P2440 (deklarata e dëshmitarit), para. 40, T. 3333 (13 shtator 2006).

⁵⁰¹ Martin Pnishi, P2236 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 mars 2002), f. 4.

⁵⁰² 6D1418 (raporti i PrK, 30 prill 1999), f. 1-2.

⁵⁰³ P2026 (Raport luftimi i Brigadës së 125-të të Motorizuar, 29 prill 1999), f. 2. Ky raport vëren se në këtë operacion u angazhua edhe një kompani vullnetarësh.

⁵⁰⁴ Sasha Antiq, 5D1443 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para. 26.

⁵⁰⁵ K73, P2440 (deklarata e dëshmitarit), para. 44, T. 3332 (13 shtator 2006) (seancë e mbyllur). *Shih gjithashtu* P2297 (ditar lufte i Batalionit të 52-të të Policisë Ushtarake), f. 12 ("Gjatë natës, humbëm ushtarin Zhelko (djali i Rajkos) TOSHIQ nga VP/Posta Ushtarake/8070/5, i cili u vra në sektorin e Ramocit".).

⁵⁰⁶ K73, P2440 (deklarata e dëshmitarit), para. 41.

⁵⁰⁷ K73, P2440 (deklarata e dëshmitarit), para. 42.

⁵⁰⁸ K73, P2440 (deklarata e dëshmitarit), para. 42, P2441 (deklarata e dëshmitarit e datës 10 shtator 2006), para. 8.

⁵⁰⁹ K73, T. 3329 (13 shtator 2006); *shih gjithashtu* K73, P2440 (deklarata e dëshmitarit), para. 42, P2441 (deklarata e dëshmitarit e datës 10 shtator 2006), para. 8.

lutën që të mos i dëbonin, por komandanti i Batalionit të 52-të të Policisë Ushtarake, Sasha Antiq, i urdhëroi të largoheshin.⁵¹⁰

187. K73-shi dëshmoi se në fund të ditës së parë të fushatës njësia e tij arriti në fshatin Ramoc dhe i nxori fshatarët nga shtëpitë e tyre në rrugë. Ishin rreth 50 civilë, për të cilët K73-shi u urdhërua që t'u thoshte të shkonin në Korenicë. Sasha Antiqi i pyeti nëse kishte pjesëtarë të UÇK-së në fshat, gjë të cilën ata e mohuan. Më tej Antiqi mori tre burra nga grupi dhe kishte thënë se do t'i mbante me njësinë së bashku me një shqiptar kosovar të cilin e kishin takuar në pyll, deri ditën e nesërme.⁵¹¹ Njerëzit e tjerë u nisën në drejtim të Korenicës. Pjesërisht në mbështetje të kësaj dëshmie është raporti i luftimit i Brigadës së 125-të të Motorizuar për datën 27 prill 1999, ku përmendet një kolonë civilësh të cilët "duan" të largohen nga sektori i Ramocit, ku UJ-ja ishte duke kryer operacione.⁵¹²

188. Gjatë natës së 27 prillit 1999 pati të shtëna dhe K73-shi tregoi se u vranë një ushtar i UJ-së dhe një pjesëtar i UÇK-së.⁵¹³ Mëngjesin e nesërm, Antiqi urdhëroi trupat të digjnin çdo shtëpi në fshat. K73-shi tha se kjo u bë në shenjë hakmarrjeje për vrasjen e ushtarit të UJ-së.⁵¹⁴

189. Antiqi i urdhëroi trupat e tij të shkonin në një fshat tjetër dhe të merrnin me vete katër shqiptarët e arrestuar kosovarë të Ramocit. Atje, atyre iu bashkua edhe një njësi e PJP-së.⁵¹⁵ Edhe pse ata iu përgjyruan ushtarëve të UJ-së që të mos i dorëzonin te PJP-ja, të katër iu dorëzuan PJP-së.⁵¹⁶ Një oficer i PJP-së i mori dhe i çoi në pyll rreth 20 metra nga vendi ku ishte K73-shi.⁵¹⁷ Më tej K73-shi dëgjoi komandantin e PJP-së kur i tha oficerit përmes radios që t'ua zgjidhte duart atyre burrave.⁵¹⁸ K73-shi mendoi ata do të liroheshin, por,

një minutë më vonë, dëgjuam krismat e armëve nga pylli. E pashë oficerin kur u kthye me lidhëset plastike [me të cilat kishin qenë të lidhura duart e burrave] në dorë. Oficeri dukej i kënaqur dhe i tha komandantit në praninë tonë: "U tregova i drejtë. U dhashë nga një cigare dhe ata pinin duhan dhe qanin sepse e kuptuan se çfarë do t'u ndodhte."⁵¹⁹

⁵¹⁰ K73, P2440 (deklarata e dëshmitarit), para. 42.

⁵¹¹ K73, P2440 (deklarata e dëshmitarit), para. 43.

⁵¹² P2024 (Raport luftimi i Brigadës së 125-të të Motorizuar, 27 prill 1999), f. 2.

⁵¹³ K73, P2440 (deklarata e dëshmitarit), para. 44, T. 3332 (13 shtator 2006) (seancë e mbyllur). *Shih gjithashtu* P2297 (ditar lufte i Batalionit të 52-të të Policisë Ushtarake), f. 12.

⁵¹⁴ K73, T. 3392, 3430–3431 (14 shtator 2006) (seancë e mbyllur), P2440 (deklarata e dëshmitarit), para. 44.

⁵¹⁵ K73, T. 3414 (14 shtator 2006) (seancë e mbyllur), P2440 (deklarata e dëshmitarit), para. 44.

⁵¹⁶ K73, P2440 (deklarata e dëshmitarit), para. 45, P2441 (deklarata e dëshmitarit e datës 10 shtator 2006), para. 6.

⁵¹⁷ K73, P2440 (deklarata e dëshmitarit), para. 45, T. 3427 (14 shtator 2006) (seancë e mbyllur).

⁵¹⁸ K73, P2440 (deklarata e dëshmitarit), para. 45.

⁵¹⁹ K73, P2440 (deklarata e dëshmitarit), para. 45.

190. Sasha Antiqi dëshmoi se kompania e tij e kaloi natën e 27 prillit në skaj të fshatit Ramoc dhe se të gjithë fshatarët me përjashtim të kryefamiljarëve të tri shtëpive u larguan dhe shkuan në qytetin e Gjakovës nga frika e bombardimeve të NATO-s.⁵²⁰ Dëshmia e Antiqit përputhet me atë të K73-shit në përshkrimin e një sulmi të UÇK-së kundër njësisë atë natë dhe të dorëzimit PJP-së të tre shqiptarëve kosovarë të moshuar që kishin mbetur në Ramoc dhe të një tjetri të cilin e kishin gjetur të fshehur në pyll. Sidoqoftë, Antiqi tha se kjo u bë për të zbuluar se a kishin qenë të implikuar në sulmin e një nate më parë.⁵²¹ Ai mohoi pretendimet e K73-shit se të katër shqiptarët kosovarë u mbajtën peng dhe u ekzekutuan në pyllin e afërt dhe tha se K73-shi nuk ishte në gjendje të shihte apo dëgjonte gjë në lidhje me atë incident për shkak të vendndodhjes së tij.⁵²²

191. Antiqi mohoi pretendimet në lidhje me angazhimin e UJ-së në këto fshatra; ai tha se qëllimi i saj nuk ishte të "spastrojë" fshatrat shqiptare kosovare dhe dëbojë civilët nga ajo zonë.⁵²³ Antiqi gjithashtu mohoi se shtëpive iu ishte vënë zjarri me qëllim për t'i "shënuar vijat të cilave iu përmbaheshin" apo për çfarëdo arsye tjetër.⁵²⁴ Ai shpjegoi se një praktikë e tillë nuk do të kishte kuptim sepse do t'i bënte ata cak të lehtë për bombardimet e NATO-s.⁵²⁵

ii. Meja dhe Korenica

192. Fshatrat e Korenicës dhe të Mejës shtrihen në skajin jugor të Luginës së Caragojt, në perëndim të qytetit të Gjakovës.⁵²⁶ Merita Deda, e cila udhëtoi nga Guska në Korenicë në fillim të prillit 1999, dëshmoi se më 27 prill forcat e armatosur serbe me uniforma hynë në oborrin e shtëpisë së Markajve në fshat dhe i urdhëruan të gjithë që ishin brenda të dilnin jashtë. Në oborr, burrat u ndanë nga gratë e pastaj u rrahën dhe ua morën sendet me vlerë. Gjithashtu ata u detyruan t'i ngrinin tre gishta si përhëndetje dhe të thërrisnin "Serbia" disa herë.⁵²⁷ Pas kësaj gratë u urdhëruan të largoheshin. Kur Deda ishte rreth 20 metra larg shtëpisë, ajo dëgjoi shkrepjen e armëve. Ajo u kthye dhe pa nëntë burra, ndër të cilët të atin, anëtarë të tjerë të familjes së saj, dhe fqinjët e saj të shtrirë përtokë.⁵²⁸ Deda dëshmoi se nuk pa më të gjallë asnjë prej këtyre burrave dhe se disa nga kufomat

⁵²⁰ Sasha Antiq, 5D1443 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para. 25.

⁵²¹ Sasha Antiq, 5D1443 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para. 26, 27, T. 21167–21168 (28 janar 2008) (seancë private).

⁵²² Sasha Antiq, 5D1398 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para. 33 (e mbyllur me vulë).

⁵²³ Sasha Antiq, 5D1398 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para. 20, 29 (e mbyllur me vulë), 5D1443 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para. 17.

⁵²⁴ Sasha Antiq, 5D1398 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para. 31 (e mbyllur me vulë), T. 21170 (28 janar 2008) (seancë private).

⁵²⁵ Sasha Antiq, 5D1398 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para. 31 (e mbyllur me vulë).

⁵²⁶ P615 (Atllasi i Kosovës), f. 9.

⁵²⁷ Merita Deda, T. 1400–1401, 1427 (10 gusht 2006), P2233 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 prill 2000), f. 3.

⁵²⁸ Merita Deda, P2233 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 prill 2000), f. 3, T. 1400–1401 (10 gusht 2006).

iu kthyen nga varret e përbashkëta në Batajnicë.⁵²⁹ Ajo tha se asnjë nga këta burra nuk kishte qenë pjesëtar i UÇK-së, por se familja e saj u sulmua sepse një kushëri i saj ishte anëtar i Partisë Liberale të Kosovës.⁵³⁰ Gjatë pyetjeve për Dedën Mbrojtja nuk e kundërshtoi pohimin e saj se asnjë nga anëtarët e familjes së saj nuk ishte në UÇK.

193. Në gjyq dhe në deklaratën e saj me shkrim dhënë Prokurorisë në vitin 2000, Deda bëri të ditur se pjesëtarët e UJ-së morën pjesë në rrahjet dhe vrasjet në oborrin e Markajve më 27 prill. Kur ajo u ballafaqua me një incizim pa datë të një interviste që i kishte dhënë Grupit Ndërkombëtar për Krizat, në të cilën ajo kishte thënë se dorasit ishin "policë serbë"⁵³¹, ajo këmbënguli se individët në oborrin e saj kishin qenë pjesëtarë të UJ-së.⁵³² Ajo shpjegoi se ata mbanin uniforma të ndryshme, ndër të cilat uniforma kamuflimi të gjelbra dhe bojë kafe, maska të zeza, shami, shami koke dhe shirita.⁵³³

194. Lizane Malaj dëshmoi ngjashëm se më 27 prill 1999, rreth orës 07:30, forca të armatosura serbe rrethuan shtëpinë e saj në Korenicë dhe më pas hynë në oborr. Këta njerëz ishin me uniforma të ushtrisë, policisë, dhe të paraushtarakëve.⁵³⁴ Ata urdhëruan djalin e saj Blerimin të shtrihej përtokë dhe bënë të njëjtën gjë me katër burrat e tjerë që ndodheshin në shtëpi, bashkëshorti i saj Vat Malaj, nipi i saj Arben Kabashi, vëllai i saj Nikollë Kabashi, djali i Kabashit – pra nipi i Malajt – Andrush Kabashi, dhe nipi i saj Engjëlli.⁵³⁵ Më tej, ata u thanë grave të largoheshin dhe të shkonin në Shqipëri.⁵³⁶ Malaj nuk donte të largohej por u detyrua. Kur ajo dhe gratë e tjera ishin rreth 50 metra larg nga shtëpia, ajo dëgjoji shumë krisma nga drejtimi i shtëpisë dhe djalin e saj duke vajtuar dhe hodhi sytë pas e pa shtëpinë e saj në flakë. Malaj tha se kishte provuar të kthehej, por një polic e ndaloi të kthehej.⁵³⁷ Ajo tha se asnjë nga meshkujt e familjes së saj nuk ishte në UÇK dhe se nuk kishin armë në shtëpi.⁵³⁸

⁵²⁹ Merita Deda, T. 1402 (10 gusht 2006). Kufomat e Mark Dedës, 47 vjeç, Pashk Dedës, 42 vjeç, Linton Dedës, 16 vjeç, Prend Markajt, 60 vjeç, Pashuk Markajt, 38 vjeç, Mark Markajt, 65 vjeç, Bekim Markajt, 23 vjeç, dhe Petrit Markajt, 27 vjeç, u gjetën në varret e përbashkëta në Batajnicë, përmendur në shtojcat e mëposhtme. Sidoqoftë, kufoma e Skënder Pjetrit nuk u identifikua në Batajnicë.

⁵³⁰ Merita Deda, P2233 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 prill 2000), f. 4.

⁵³¹ *Shih* 3D2 (Arkivi Elektronik i Incidenteve i Grupit Ndërkombëtar të Krizës– Merita Deda), f. 1.

⁵³² Merita Deda, T. 1400–1412, 1421 (10 gusht 2006), P2233 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 prill 2000), f. 4.

⁵³³ Merita Deda, T. 1401, 1403, 1427, 1428–1429 (10 gusht 2006), P2233 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 prill 2000), f. 3–4.

⁵³⁴ Lizane Malaj, T. 1310, 1319, 1322 (9 gusht 2006). *Shih* Lizane Malaj, P2232 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 shtator 2001), f. 3.

⁵³⁵ Lizane Malaj, T. 1310 (9 gusht 2006). *Shih gjithashtu* Lizane Malaj, P2232 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2000), f. 3–4.

⁵³⁶ Lizane Malaj, T. 1310 (9 gusht 2006).

⁵³⁷ Lizane Malaj, T. 1311 (9 gusht 2006), P2232 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2000), f. 4.

⁵³⁸ Lizane Malaj, P2232 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2000), f. 4, T. 1359 (10 gusht 2006).

195. Po ashtu si Deda, Malaj dëshmoi se më vonë mori kufomat e disa prej të afërmve të saj meshkuj prej të cilëve ishte ndarë.⁵³⁹ Ajo tha se në momentin që po jepte këtë dëshmi "rreth 73" burra nga fshati i saj ishin ende të zhdukur.⁵⁴⁰ Malaj dëshmoi se, përveç familjarëve më të afërt, ishin vrarë edhe fshatarë të tjerë të fshatit të saj duke shtuar "Klaudia, vajza e Marie Malajt, u vra... siç ishte duke ecur, pas shpine."⁵⁴¹

196. Malaj i përshkroi "parausharakët" që kishin marrë pjesë se kishin shumë armë, me mjekra, maska, dhe shirita në krahë dhe kishin uniforma të kaltra në kafe. Ajo i përshkroi policët të veshur me uniforma policie në ngjyrë të kaltër dhe të kaltër të çelët me shirita në krahë. Ajo i përshkroi forcat e tjera të pranishme si ushtarë, të veshur me uniforma bojë kafe e të gjelbra me shenja në krahë.⁵⁴² Disa nga pjesëtarët e të tri grupeve mbanin maska. Në lidhje me këtë përshkrim dhe pretendimin e Malajt për pjesëmarrjen e forcave të UJ-së, Mbrojtja e Llazareviqit këmbënguli se ishte në kundërshtim me dëshmitë e tjera, si ajo e K73-shit, i cili tha se njësia e tij asnjëherë nuk mbajti shirita gjatë operacioneve në vitin 1999, dhe se UJ-ja kishte uniforma ngjyrë ulliri të gjelbër e jo ngjyrë të gjelbër në kafe.⁵⁴³ Sidoqoftë, Dhoma thekson se Malaj bëri dallimin midis atyre që kishin shirita dhe atyre që kishin uniforma ngjyrë të gjelbër në kafe, të cilët ajo i përshkroi si pjesëtarë të UJ-së.

197. Vllatko Vukoviqi pohoi se disa njësi të Batalionit të 2-të të Brigadës së 549-të të Motorizuar u dërguan në zonën e Korenicës më 27 dhe 28 prill 1999, me urdhër gojor të Zhivkoviqit.⁵⁴⁴ Mirëpo në kundërshtim me dëshmitë e Malajt dhe Dedës, Vukoviqi tha se në orën 06:00 të datës 27 prill në Korenicë nuk kishte ushtarë nga njësia e tij.⁵⁴⁵ Vukoviqi gjithashtu kundërshtoi pretendimet se në ushtarët mblodhën civilët në Korenicë, në orën 06:30.⁵⁴⁶ Kur iu tregua ditari i luftës i Brigadës së 549-të të Motorizuar, ku përmendet ruajtja e varrezës në Korenicë në orën 06:00 të datës 27 prill, ai e kundërshtoi kuptimin e shënimit.⁵⁴⁷ Ai dëshmoi se varreza është në dalje të fshatit.⁵⁴⁸ Vukoviqi

⁵³⁹ Lizane Malaj, T. 1314–1315 (9 gusht 2006). *Shih gjithashtu* 6D13 (Letër-Padi Penale, 28 gusht 2001); Lizane Malaj, T. 1389 (10 gusht 2006). Kufomat e Blerim Malajt, Nikollë Kabashit, Arben Kabashit, Andrush Kabashit, dhe Vat Malajt ishin midis kufomave të gjetura në varret e përbashkëta në Batajnicë, përmendur në shtojcat e mëposhtme. Sidoqoftë, kufoma e nipit të saj, Engjëllit, mbiemri i të cilit nuk është dhënë, nuk është gjetur në Batajnicë.

⁵⁴⁰ Lizane Malaj, P2232 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 shtator 2001), f. 3.

⁵⁴¹ Lizane Malaj, T. 1389 (10 gusht 2006).

⁵⁴² Lizane Malaj, T. 1318–1321 (9 gusht 2006).

⁵⁴³ Dosja Përfundimtare Gjyqësore e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 398; K73, T. 3307 (13 shtator 2006) (seancë e mbyllur).

⁵⁴⁴ Vllatko Vukoviqi, T. 21332–21333 (29 janar 2008).

⁵⁴⁵ Vllatko Vukoviqi, T. 21333 (29 janar 2008), T. 21411–21412 (30 janar 2008).

⁵⁴⁶ Vllatko Vukoviqi, T. 21413–21414 (30 janar 2008).

⁵⁴⁷ P2019 (Ditari i Luftës i Batalionit të 2-të të Motorizuar të Brigadës së 549-të të Motorizuar), f. 11 (e mbyllur me vulë); Vllatko Vukoviqi, T. 21415–21417 (30 janar 2008).

⁵⁴⁸ Vllatko Vukoviqi, T. 21408 (30 janar 2008).

gjithashtu mohoi pretendimet se të shtënat në Korenicë ndodhur në të njëjtën ditë, në orën 07:00.⁵⁴⁹ Ai tha se ballafaqimi i parë i njesisë së tij me UÇK-në ndodhi në orën 08:30 afër varrezave, kur një togë iu kundërpërgjigj një grupi të UÇK-së të cilët hapën zjarr nga një grup civilësh.⁵⁵⁰

198. Vukoviqi dëshmoi se, kur njësia e tij u dislokua jashtë Korenicës më 27 dhe 28 prill, ata panë grupe civilësh duke u larguar nga fshati në drejtim të forcave të UJ-së. Kur u pyet se prej kujt iknin fshatarët, ai ia atribuoi këtë pranisë së UÇK-së në fshat.⁵⁵¹ Mirëpo Dhoma vë në dukje se ky pohim nuk përputhet me thënien se dikush brenda këtij grupi civilësh hapi zjarr mbi UJ-në dhe me shënimin në ditarin e luftës të Brigadës së 2-të të Mekanizuar të Brigadës së 549-të të Motorizuar, sipas të cilit një person brenda grupit të civilëve hapi zjarr kundër UJ-së.⁵⁵²

199. Dëshmia e K73-shit mbështet dëshmitë e Dedës dhe Malajt se forcat e UJ-së dhe MPB-së morën pjesë në operacionin e Luginës së Caragojt dhe kryen veprime kriminale. Ai dëshmoi se pas natës të kaluar në Ramoc, më 28 prill njësia e tij u urdhërua të shkonte në Korenicë.⁵⁵³ Duke iu afruar fshatit, ai pa se shumica e shtëpive po digjeshin.⁵⁵⁴ Sasha Antiqi kundërshtoi pretendimin K73 kishte qenë në gjendje të shihte fshatin duke u djegur, duke argumentuar se ai nuk ishte në gjendje t'a shihte Korenicën sepse ndodhej në pyll, 300 metra në veriperëndim të fshatit.⁵⁵⁵

200. Mirëpo K73-shi dëshmoi se ai vazhdoi në drejtim të Korenicës, e cila ishte zbratur nga civilët, por ishte plot me pjesëtarë të PJP-së.⁵⁵⁶ Ai u befusua nga mungesa e civilëve. Kur pyeti njërin nga policët se ku ishin civilët, ai i tha se shqiptarët kosovarë ishin dërguar "në udhëtim".⁵⁵⁷

201. Në përputhje me dëshminë e K73-shit është edhe dëshmia e K90-ës, i cili dëshmoi se, më 27 prill 1999, UJ-ja, duke përfshirë edhe njësinë e tij, morën urdhër të bënin sigurimin e zonës përreth Mejës dhe Korenicës. Pas sigurimit të zonës, u dislokuan forca të mëdha të policisë të cilat hynë në fshatra dhe shtinë pa shkak kundër shtëpive. K90-a shpjegoi se menjëherë pas largimit të fshatarëve nga shtëpitë, atyre iu vihej zjarri.⁵⁵⁸ Ai gjithashtu dëshmoi se Korenica "u spastrua", njerëzit u

⁵⁴⁹ Vllatko Vuković, T. 21412–21413 (30 janar 2008).

⁵⁵⁰ Vllatko Vuković, 5D1442 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para. 71, T. 21412–21414 (30 janar 2008); P2019 (Ditari i Luftës i Batalionit të 2-të të Motorizuar të Brigadës së 549-të të Motorizuar), f. 11 (e mbyllur me vulë).

⁵⁵¹ Vllatko Vuković, T. 21408 (30 janar 2008).

⁵⁵² *Shih* P2019 (Ditari i Luftës i Batalionit të 2-të të Motorizuar të Brigadës së 549-të të Motorizuar), f. 11 (e mbyllur me vulë).

⁵⁵³ *Shih* K73, T. 3421 (14 shtator 2006) (seancë e mbyllur).

⁵⁵⁴ K73, P2440 (deklarata e dëshmitarit), para. 46, T. 3333 (13 shtator 2006) (seancë e mbyllur).

⁵⁵⁵ Sasha Antiq, T. 21157–21160 (28 janar 2008) (seancë private). *Shih* K73, P2440 (deklarata e dëshmitarit), para. 46.

⁵⁵⁶ K73, T. 3437–3438 (14 shtator 2006) (seancë e mbyllur).

⁵⁵⁷ K73, T. 3333–3334 (13 shtator 2006) (seancë e mbyllur), T. 3424 (14 shtator 2006) (seancë e mbyllur). *Shih gjithashtu* K73, T. 3394–3395 (14 shtator 2006) (seancë e mbyllur).

⁵⁵⁸ K90, P2652 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 dhjetor 2002), para. 48, T. 9314–9315, 9328–9329 (29 janar 2007).

dëbuan dhe se nuk kishte të shtëna kundër policisë pasi zona ishte e rrethuar nga forcat e UJ-së.⁵⁵⁹ Ai dëshmoi se u plagosën tre ushtarë të njësisë së tij, por shtoi se ai mendonte se ishte pasojë e zjarrit të hapur nga policia, pasi UÇK-ja nuk ishte e pranishme në atë zonë.⁵⁶⁰

202. Martin Pnishi dëshmoi se më 27 prill 1999, rreth orës 07:00, forca të mëdha të policisë, ushtrisë, dhe forca të tjera erdhën befasisht në Mejë.⁵⁶¹ Dy pjesëtarë të MPB-së të shoqëruar nga dy "ushtarë rusë" i thanë të largohej nga shtëpia së bashku me familjen e tij sepse ata do t'a digjinin.⁵⁶² Oficerët e MPB-së mbanin maska dhe uniforma kamuflimi të gjelbra, kurse njëri prej tyre kishte grada në uniformë, që përbëheshin nga një shirit dhe një yll. Pnishi dinte se ata ishin pjesëtarë të MPB-së vendore. Dy burrat e tjerë flisnin në një gjuhë të cilën ai e identifikoi si rusishte,⁵⁶³ mirëpo ata mbanin të veshur të njëjtat pantallona dhe xhaketa ngjyrë hiri si të forcave paraushtarake serbe. Ata kishin mitraloza dhe thika të gjata.⁵⁶⁴ Pnishi tha se "ushtarët" kishin emblema në krahë.⁵⁶⁵ Pjesëtarët e MPB-së morën një urdhër përmes radios dhe më tej morën një shqiptar kosovar të cilin ai e njohte, Kolë Duzhmani, dhe e çuan në shtëpinë fqinje e cila ishte e vëllait të tij. Pnishi dëgjoi krisma armësh dhe më pas pa kur u vunë zjarrin shtëpisë. Pas 19 ditësh ai pa kufomën e Duzhmanit të bërë shoshë nga plumbat.⁵⁶⁶ Pnishi e shpjegoi mosprishjen e kufomës me faktin se e kishte ruajtur tymi i zjarreve.⁵⁶⁷

203. Rreth orës 10:30 të së njëjtës ditë, policët, ushtarët, dhe "paraushtarakët" u mbledhën afër shkollës. Ai e çoi granatën në shtëpinë e kumbarit, e cila ishte më larg nga udhëkryqi.⁵⁶⁸ Prej atje, Pnishi mund të shihte të shihte urën mbi lumin e Travës, e cila ishte larg rreth 50 metra. Dhoma vëren se gjatë fazës së pyetjeve nga Mbrojtja duke u bazuar në një hartë të vizatuar nga Mbrojtja e Ojdaniqit, Pnishi fillimisht hezitoi në dëshminë e tij, por pasi deklaroi se disa aspekte të hartës ishin

⁵⁵⁹ K90, P2652 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 dhjetor 2002), para. 62–63, T. 9314–9315, 9328–9329 (29 janar 2007).

⁵⁶⁰ K90, P2652 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 dhjetor 2002), para. 62–63, T. 9450 (30 janar 2007).

⁵⁶¹ Martin Pnishi, P2236 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 mars 2002), f. 2–3, T. 1443 (10 gusht 2006). Pnishi deklaroi se UJ-ja kishte tanke të vendosura në Kodrën e Çabratit, siç është përmendur më lart. Sidoqoftë, gjatë fazës së pyetjeve nga Mbrojtja, K72-shi tha se në Kodrën e Çabratit nuk kishte pasur tanke, por vetëm Praga dhe automjete të tjera ushtarake. K72, T. 5344–5345 (26 tetor 2006).

⁵⁶² Martin Pnishi, P2236 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 mars 2002), f. 3.

⁵⁶³ *Shih* Martin Pnishi, T. 1497 (11 gusht 2006).

⁵⁶⁴ Martin Pnishi, P2236 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 mars 2002), f. 3. Gjatë pyetjeve nga Prokuroria, Pnishi shpjegoi në lidhje me uniformat duke thënë se rusët kishin "uniforma të kaltra në të hirtë." *Shih* Martin Pnishi, T. 1456 (11 gusht 2006), T. 1523–1524 (11 gusht 2006).

⁵⁶⁵ Martin Pnishi, P2236 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 mars 2002), f. 5.

⁵⁶⁶ Martin Pnishi, P2236 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 mars 2002), f. 4; Martin Pnishi, T. 1444–1447 (10 gusht 2006).

⁵⁶⁷ Martin Pnishi, T. 1447 (10 gusht 2006), T. 1515–1516 (11 gusht 2006).

⁵⁶⁸ Martin Pnishi, P2236 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 prill 2000), f. 4, T. 1480–1481 (11 gusht 2006); IC6 (Harta e shënuar e Mejës).

gabim, ai i rrëfeu ngjarjet në përputhje me deklaratën e tij si dëshmitar.⁵⁶⁹ Ai i pa policët serbë kur çuar me forcë te ura shtatë të rinj. Një oficer i vrau të gjithë me mitraloz.⁵⁷⁰ Pnishi tha se një nga policët në këtë grup ishte Predrag Stojanoviqi, pjesëtar i policisë në Gjakovë.⁵⁷¹ Të shtatë kufomat u morën më 2 maj 1999 nga "bashkëpunëtorë" shqiptarë vendës dhe u dërguan në varrezën publike në Gjakovë.⁵⁷²

204. Më 27 prill 1999, Nikë Peraj shkoi nga qyteti i Gjakovës në zonën rreth Mejës për të ndihmuar banorët e atjeshëm për të cilët kishte dëgjuar se mbaheshin në polici.⁵⁷³ Ai dëshmoi se pranë shtëpisë së Hasanajve dhe një lëndine ndodhej një postbllok të cilin e kontrollonte MPB-ja.⁵⁷⁴ Ky ishte postblloku i parë në rrugën në të cilën civilëve të shpërngulur iu desh të kalonin gjatë operacionit në Luginën e Caragojt, përmendur më lart.⁵⁷⁵ Kur kaloi postbllokun, ai pa të shtrira 20 kufoma burrash që dergjeshin atje.⁵⁷⁶ Kokat e këtyre kufomave kishin djegie baruti në kokë, që tregonte se viktimat ishin ekzekutuar nga afër si në ekzekutim.⁵⁷⁷ Pasi i kishte parë kufomat, Peraj pa një oficer të MPB-së të cilin e njihnte që kishte radhitur 12 shqiptarë kosovarë pranë shtëpisë së Hasanajve. Sidoqoftë, oficeri i MPB-së i liroi ata kur Peraj dhe Sergej Peroviqi, i cili ishte me të në atë kohë, thirrën një njësi tjetër të UJ-së që të vinte dhe të fliste me të.⁵⁷⁸ Peraj tha se, së bashku me një oficer tjetër të UJ-së, vazhduan për në Osek Hylë dhe panë edhe 11 kufoma meshkujsh të moshës 20-50 vjeçare rreth 700 metra nga lëndina e Shyt Hasanajt.⁵⁷⁹ Pnishi gjithashtu dëshmoi se, dikur në qershor 1999 ai shkoi në një vend afër lëndinës së Shyt Hasanajt që ishte përdorur si vend ekzekutimi, ku pa gjurmë të 74 kufomave të djegura.⁵⁸⁰ K73-shi u pyet se a kishte parë kufoma në postblloqet në zonën e Luginës së Caragojt kur udhëtoi prej Korenicës në Junik më 28 prill. Ai

⁵⁶⁹ Martin Pnishi, T. 1464 (11 gusht 2006); 3D27 (Harta e zonës së Mejës nga Mbrojtja e Ojdaniqit).

⁵⁷⁰ Martin Pnishi, P2236 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 prill 2000), f. 4. *Shih gjithashtu* Martin Pnishi, T. 1448 (10 gusht 2006), T. 1493 (11 gusht 2006).

⁵⁷¹ Martin Pnishi, T. 1448 (10 gusht 2006).

⁵⁷² Martin Pnishi, P2236 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 prill 2000), f. 4, T. 1526 (11 gusht 2006).

⁵⁷³ Nikë Peraj, P2253 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 gusht 2006), para. 68. Edhe pse në deklaratat me shkrim të Perajt thuhet se ai shkoi në Mejë me major Zhivkoviqin, ai deklaroi se në të vërtetë kishte shkuar me kapiten Peroviqin, identitetin e të cilit Peroviqi kërkoi që Peraj ta mbante të fshehtë. *Shih* Nikë Peraj, T. 1685–1687 (15 gusht 2006) (seancë private).

⁵⁷⁴ Dhoma vëren se fshatrat Mejë dhe Orize ishin të bashkuara njëri me tjetrin. Martin Pnishi, T. 1524 (11 gusht 2006).

⁵⁷⁵ Nikë Peraj, T. 1578–1579 (14 gusht 2006); P326 (harta e shënuar e zonës së Gjakovës).

⁵⁷⁶ Nikë Peraj, P2253 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 gusht 2006), para. 73.

⁵⁷⁷ Nikë Peraj, P2253 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 gusht 2006), para. 74, P2248 (deklarata e dëshmitarit e datës 15 shkurt 2001), f. 17.

⁵⁷⁸ Nikë Peraj, P2253 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 gusht 2006), para. 76–79, T. 1677 (15 gusht 2006).

⁵⁷⁹ Nikë Peraj, P2253 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 gusht 2006), para. 79.

⁵⁸⁰ Martin Pnishi, P2236 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 prill 2000), f. 5.

mohoi të kishte parë kufoma, por shtoi se e kishte parë postbllokun nga autobusi në lëvizje.⁵⁸¹ Dhoma Gjyqësore gjykon se kjo dëshmi nuk i hedh poshtë dëshmitë okulare të Perajt dhe Pnishit.

205. Ndhimësshëfi i atëhershëm i Administratës së Sigurimit të UJ-së, Aleksandar Vasileviqi, dëshmoi duke mbështetur pjesërisht dëshminë e Nikë Perajt. Vasileviqi dëshmoi se Sergej Peroviqi, dëshmia e të cilit shqyrtohet më poshtë, i raportoi se në stacionin e autobusëve në Gjakovë ishin gjetur 20 kufoma.⁵⁸² Nuk është e qartë se kur e mori Vasileviqi këtë raport, por fakti se ai u rikthye në UJ më 27 prill 1999 tregon se ka ndodhur në këtë datë ose më vonë. Peroviqi e informoi Vasileviqin se në Gjakovë një kolonel i MPB-së i quajtur Kovaçeviq kishte udhëhequr një grup prej rreth 15 burrash të quajtur Legija.⁵⁸³ Ishte raportuar se këta njerëz kishin marrë pjesë në vrasjen e 20 shqiptarëve kosovarë dhe dëbimin e shqiptarëve kosovarë nga shtëpitë dhe vjedhjen e parave të tyre. Vasileviqi dëshmoi se në një mbledhje të degës së sigurimit të Korpusit të Prishtinës ai mori të dhëna që përputheshin me informacionin e marrë nga Peroviqi, fakt që vërtetonte se këto veprime ishin kryer.⁵⁸⁴

206. Sergej Peroviqi i mohoi disa aspekte të dëshmisë së Perajt, por pranoi se ishte me të më 27 prill.⁵⁸⁵ Ai konfirmoi se kishte pranuar ta shoqëronte Perajn që të vizitonte shtëpinë e tij afër qytetit të Gjakovës, por pretendoi se ishin ndaluar nga një grup i MPB-së pas fshatit Brekoc rrugës për në Mejë dhe se nuk kishte vazhduar rrugën me Perajn.⁵⁸⁶ Ai gjithashtu mohoi se kishte parë 20 kufoma në postbllokun e policisë afër shtëpisë së Hasanajve dhe ekzistencën e postbllokut, apo se njihje dikë me emrin Hasanaj.⁵⁸⁷

207. Megjithëse konfirmoi se puna e tij përfshinte mbledhjen e informatave mbi veprimtarinë kriminale të pjesëtarëve të Brigadës së 52-të të Raketave Artilerike, Peroviqi mohoi se i kishte raportuar Vasileviqit se kishte gjetur 20 kufoma afër stacionit të autobusëve në Gjakovë.⁵⁸⁸ Ai dëshmoi se në qershor 1999 në një mbledhje me Stojanoviqin dhe Vasileviqin i ishte kërkuar të verifikonte nëse vepronte në Kosovë një grup paraushtarak i quajtur "Legija" i udhëhequr nga një

⁵⁸¹ K73, T. 3422–3423 (14 shtator 2006).

⁵⁸² Aleksandar Vasileviq, T. 8698 (19 janar 2007) (seancë private), T. 9034 (24 janar 2007).

⁵⁸³ Aleksandar Vasileviq, T. 9034 (24 janar 2007), P2594 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 tetor 2006), para. 30 (e mbyllur me vulë).

⁵⁸⁴ Aleksandar Vasileviq, T. 9032 (24 janar 2007).

⁵⁸⁵ Sergej Peroviq, 5D1396 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 janar 2008), para. 24.

⁵⁸⁶ Sergej Peroviq, 5D1396 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 janar 2008), para. 24, T. 21091–21094 (25 janar 2008).

⁵⁸⁷ Sergej Peroviq, T. 21091–21094 (25 janar 2008).

⁵⁸⁸ Sergej Peroviq, T. 21094 (25 janar 2008).

kolonel i quajtur Kovaçeviq. Pasi kishte hetuar, ai nuk ishte në gjendje të konfirmonte këto pretendime.⁵⁸⁹

208. Siç është përshkruar më lart, postblloku i dytë ndodhej në udhëkryqin e rrugës Korenicë-Gjakovë aty ku ndahet rruga për Mejë.⁵⁹⁰ Ishte postblloku në të cilin kalonin njerëzit e shpërngulur nga Korenica rrugës për në qytetin e Gjakovës.⁵⁹¹ Martin Pnishi dëshmoi se në këtë postbllok ai pa burrat shqiptarë kosovarë të ndaheshin nga gratë dhe fëmijët dhe disa prej tyre të dërgoheshin te shkolla në hyrje të fshatit në anën e majtë. Ai gjithashtu pa se shqiptarët kosovarë u detyruan t'i hidhnin dokumentet e tyre të identifikimit.⁵⁹²

209. Më 27 dhe 28 prill, K90-a pa pjesëtarë të MPB-së kur ndalonin shqiptarët kosovarë të cilët kalonin në këtë postbllok dhe i ndanin burrat nga gratë dhe ua vidhnin paratë.⁵⁹³ Nga postëkomanda e UJ-së në rrugën që çon prej Korenicës në qytetin e Gjakovës te udhëkryqi me rrugën që çon për në Mejë, ai ishte në gjendje të shihte një numër të madh forcash policore në atë zonë si dhe rreth 500 shqiptarë të shpërngulur që dukej se "vinin nga të gjitha anët," dhe "shtëpitë që digjeshin nga të gjitha anët."⁵⁹⁴ Vllatko Vukoviqi gjithashtu dëshmoi se kishte parë nga postëkomanda civilë që kalonin përgjatë rrugës, por tha se ishin grupe të vogla.⁵⁹⁵

210. Sipas K90-ës, gratë dhe fëmijët që kalonin postbllokun u lejuan të vazhdonin rrugën në drejtim të qytetit të Gjakovës, kurse burrat u dërguan në grupe nën kërcënimin e armëve në oborrin e një shtëpie të afërme.⁵⁹⁶ Pastaj ata "u grumbulluan" në një shtëpi të shoqëruar nga pas nga policia. Edhe pse K90-a nuk ishte në gjendje t'i shihte më, ai dëgjoji të shtëna automatikësh për një kohë të gjatë, pas të cilave policët dolën nga godina. K90-a dëshmoi se "e kuptova pse hapën zjarr për kohë aq të gjatë. Ishte e qartë për mua se çfarë po ndodhte, burrat shqiptarë ishin vvarë."⁵⁹⁷ Ai pa së paku katër grupe burrash që u dërguan në këtë mënyrë në atë oborr. Më pas ai hyri në oborrin e shtëpisë dhe hodhi sytë brenda njërës prej ndërtesave, ku pa kufoma. Në deklaratën e tij si dëshmitar ai deklaroi se nuk ishte në gjendje të thoshte se sa kufoma mund të kishin qenë atje, por vetëm se ato

⁵⁸⁹ Sergej Peroviq, T. 21083 (25 janar 2008).

⁵⁹⁰ Dragan Zlatković, T. 25292–25294 (15 prill 2008); Nikë Peraj, T. 1578–1579 (14 gusht 2006); P326 (harta e shënuar e zonës së Gjakovës).

⁵⁹¹ Nikë Peraj, T. 1578–1579 (14 gusht 2006); P326 (harta e shënuar e zonës së Gjakovës); *shih gjithashtu* K90, P2652 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 dhjetor 2002), para. 54–55, 58–59; Martin Pnishi, T. 1448–1449 (10 gusht 2006). *Shih gjithashtu* IC120 (harta e Gjakovës e shënuar nga K90); IC3 (harta e Gjakovës e shënuar nga Martin Pnishi).

⁵⁹² Martin Pnishi, P2236 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 mars 2002), f. 4.

⁵⁹³ K90, P2652 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 dhjetor 2002), para. 54–55, 58–59, T. 9328–9329 (29 janar 2007). *Shih gjithashtu* IC120 (harta e Gjakovës e shënuar nga K90).

⁵⁹⁴ K90, P2652 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 dhjetor 2002), para. 52–53, T. 9270–9271 (29 janar 2007).

⁵⁹⁵ Vllatko Vukoviq, T. 21407–21408 (30 janar 2008); IC179 (harta e shënuar e zonës së Gjakovës).

⁵⁹⁶ K90, P2652 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 dhjetor 2002), para. 54–55, 58–59, 65.

⁵⁹⁷ K90, P2652 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 dhjetor 2002), para. 54–55, 58–59, 65.

kishin mbuluar dyshemenë.⁵⁹⁸ Sidoqoftë, gjatë dëshmisë me gojë, ai tha "ishin, të themi, jo më shumë se tre ose katër njerëz të shtrirë përtokë."⁵⁹⁹ Gjatë kohës që ishte në oborr, K90-a foli me një polic i cili i tha se po i masakronin shqiptarët, dhe bëri të qartë se "nuk ishte punë e tyre se çfarë po ndodhte."⁶⁰⁰ Më pas K90-a u kthye të postblloku në udhëkryqin afër postëkomandës së UJ-së, e cila ndodhej më tutje në rrugën kryesore për në Korenicë dhe pa një grup prej rreth 10 burrash që po vinin drejt tij prej postëkomandës. Këta burra ishin detyruar të këndonin këngë nacionaliste serbe dhe u dërguan në oborin e lartpërmendur prej nga K90-a dëgjoi sërish të shtëna armësh.⁶⁰¹ K90-a i raportoi eprorit të tij se çfarë kishte parë, i cili reagoi me zemërim, por nuk i raportoi askujt për incidentin.⁶⁰²

211. Më 27 ose 28 prill 1999, K90-a u urdhërua të shkonte në Mejë dhe t'i shoqëronte civilët deri në Gjakovë që të mos vriteshin nga policia. Së bashku me një ushtar tjetër, ai shoqëroi më shumë se 100 njerëz nga Meja deri te ura në hyrje të qytetit të Gjakovës. Në urë ndodhej një postbllok, ku njerëzit lejoheshin të kalonin sepse K90-a u tha policëve dhe ushtarëve që e ruanin postbllokun se ky ishte urdhër.⁶⁰³ Vukoviqi mohoi se K90-a ishte urdhëruar të shoqëronte civilët për t'i mbrojtur nga forcat e MPB-së dhe dëshmoi se K90-a nuk kishte qenë asnjëherë në postëkomandën e UJ-së, në rrugën midis Korenicës dhe udhëkryqit për në Mejë.⁶⁰⁴

212. Nikë Peraj dëshmoi se, ndërsa ai dhe Peroviqi po lëviznin rreth zonës së Mejës më 27 prill 1999, ata arritën në postbllokun të udhëkryqi pak para Mejës (postblloku i dytë), ku u ndaluan nga policët dhe paraushtarakë serbë.⁶⁰⁵ Pranë një ndërtese aty afër, ai pa katër kufoma burrash të moshës 20-30 vjeçare, të cilat kishin shenja gjaku dhe çizmësh.⁶⁰⁶ Mirëpo Peroviqi mohoi të kishte parë katër kufoma së bashku me Perajn në këtë postbllok, më 27 prill 1999.⁶⁰⁷

213. Gjatë fazës së pyetjeve nga Mbrojtja, Peraj tha se më 27 prill 1999 forcat e rregullta të UJ-së ishin të vendosura afër një vullkanizeri në skaj të Mejës, 400 metra nga postblloku.⁶⁰⁸ Sipas Perajt, ushtarakët profesionistë të UJ-së nuk kryen vrasje në këtë postbllok dhe se në fakt disa nga ata

⁵⁹⁸ K90, P2652 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 dhjetor 2002), para. 60.

⁵⁹⁹ K90, T. 9470 (31 janar 2007).

⁶⁰⁰ K90, P2652 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 dhjetor 2002), para. 60, T. 9330–9331 (29 janar 2007).

⁶⁰¹ K90, P2652 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 dhjetor 2002), para. 65.

⁶⁰² K90, P2652 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 dhjetor 2002), para. 61, T. 9331 (29 janar 2007).

⁶⁰³ K90, P2652 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 dhjetor 2002), para. 64.

⁶⁰⁴ Vlatko Vuković, T. 21346–21347 (29 janar 2008) (seancë private).

⁶⁰⁵ Nikë Peraj, P2253 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 gusht 2006), para. 68, T. 1576 (14 gusht 2006).

⁶⁰⁶ Nikë Peraj, P2253 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 gusht 2006), para. 69.

⁶⁰⁷ Sergej Perović, T. 21091–21094 (25 janar 2008).

⁶⁰⁸ Nikë Peraj, T. 1605 (14 gusht 2006), T. 1678 (15 gusht 2006), P2253 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 gusht 2006), para. 65. *Shih gjithashtu* IC8 (Harta e Luginës së Caragojt e shënuar nga Peraj më 14 gusht 2006).

shkuan te policët dhe paraushtarakët atje për të ndaluar vrasjen e shqiptarëve kosovarë.⁶⁰⁹ Në përputhje me këtë pohim, Martin Pnishi pa policë, ushtarë dhe paraushtarakë në postbllokun në Mejë dhe në zonën përreth.⁶¹⁰

214. Edhe pse Peraj dëshmoi se në postbllokun e Mejës nuk kishte pjesëtarë të UJ-së, ai dëshmoi se, në përgjithësi, "pjesëmarrësit në masakrën e Mejës ishin UJ-ja, MPB-ja, policia vendore, dhe paraushtarakët." Ai shtoi se përgjegjësia më e madhe për masakrat binte mbi Miçunoviqin, Koturin, dhe Kovaçeviqin nga MPB-ja.⁶¹¹ Nga dëshmia e Perajt shihet se ai nuk e konsideronte Mbrojtjen Territoriale pjesë të UJ-së. Sidoqoftë, ai pranoi se këto njësi ishin nën komandën e qarqeve ushtarake.⁶¹² Siç është përmendur në Pjesën VI.A, njësitë ushtarake të Mbrojtjes Territoriale, të cilat përbëheshin nga rezervistët, ishin pjesë e strukturave të UJ-së. Pjesëmarrja e MPB-së dhe pjesëtarëve të UJ-së në vrasjet e kryera në Mejë dhe rreth saj më 27 prill shqyrtohet më poshtë.

215. Në deklaratën si dëshmitar, Nikë Peraj i cilëson incidentet në Korenicë dhe Mejë si "masakra" si dhe përmend një liste të cilën ai pa Vintarin duke e daktilografuar natën e 27 prillit dhe në të cilën thuhet se 78 pjesëtarë të UÇK-së ishin vrarë në Korenicë dhe 68 në Mejë.⁶¹³ Sidoqoftë, më vonë në deklaratën e tij si dëshmitar ai thotë se e kishte parë këtë listë katër ditë pas ngjarjeve në Mejë.⁶¹⁴ Vintari mohoi të ketë daktilografuar ndonjëherë një raport të tillë.⁶¹⁵ Duke pasur parasysh këtë mospërputhje të datave të dhëna nga Peraj, Dhoma nuk nxjerr asnjë përfundim në lidhje me ekzistencën e kësaj liste.

(A) Zhvendosja, zbulimi, dhe ekzaminimi i kufomave

216. Në qershor 2002, UNMIK-u formoi Zyrën për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore (ZPZHK) me detyrë zbulimin e vendndodhjes së personave të zhdukur në Kosovë, identifikimin e kufomave të tyre, dhe kthimin e kufomave familjeve të të zhdukurve.⁶¹⁶ ZPZHK-ja në bashkëpunim me KNKK-në, krijuan një "listë përmbledhëse të personave të zhdukur" të cilën e aktualizonin rregullisht duke shfrytëzuar të dhënat e marra nga KNKK-ja, UNMIK-u, OSBE-ja, dhe shoqata të ndryshme të familjeve për të cilën synohej të ishte listë gjithëpërfshirëse e të dhënave të personave

⁶⁰⁹ Nikë Peraj, T. 1678 (15 gusht 2006).

⁶¹⁰ Martin Pnishi, P2236 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 mars 2002), f. 4.

⁶¹¹ Nikë Peraj, P2253 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 gusht 2006), para. 89–92, T. 1678, 1688 (15 gusht 2006); Martin Pnishi P2236 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 mars 2002), f. 4.

⁶¹² Nikë Peraj, P2253 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 gusht 2006), para. 12, T. 1594 (14 gusht 2006), 1679 (15 gusht 2006).

⁶¹³ Nikë Peraj, P2253 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 gusht 2006), para. 83.

⁶¹⁴ Nikë Peraj, P2253 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 gusht 2006), para. 86.

⁶¹⁵ Zdravko Vintar, 5D1394 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 dhjetor 2007), para. 22.

⁶¹⁶ Jose-Pablo Baraybar, P2794 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 nëntor 2006), f. 2.

të pagjetur pas konfliktit në Kosovë.⁶¹⁷ Lista e aktualizuar deri në tetor 2006, u pranua si provë në çështjen aktuale pa kundërshtime nga Mbrojtja përmes shefit të ZPZHK-së, Jose-Pablo Baraybar.⁶¹⁸ Aty evidentohet zhdukja e më shumë se 300 vetëve në zonën e Mejës, më 27 prill 1999. Dhoma është bindur se lista përbënte një bazë të përshtatshme dhe të besueshme mbi të cilën u kryen hetimet e mëtejshme kur u zhvarrosën kufomat nga varret e përbashkëta në Batajnicë afër Beogradit dhe u këqyrën nga viti 2001 e më tej. Raportet e këtyre ekzaminimeve konfirmojnë se 287 vetë të cilët ishin zhdukur në zonën e Mejës dhe të cilët janë në Listën H të Aktakuzës u identifikuar përmes provës së ADN-së dhe krahasimit të saj me anëtarët e gjallë të familjes.⁶¹⁹ Ndër 287 vetët e përmendur, janë edhe 13 individët e identifikuar me emër nga dëshmitarët okularë si të vrarë në Korenicë, siç është përshkruar më lart. Rrjedhimisht Dhoma është bindur se në sulmet në Mejë dhe Korenicë dhe përreth tyre më 27 prill 1999, të cilat u përshkruan nga dëshmitarët e mësipërm, u vranë së paku 287 shqiptarë kosovarë, secili prej të cilëve përmendet në Shtojcën A të këtij Aktgjykimi.

217. Prokuroria pretendon se përpjekjet e mëvonshme të forcave të RFJ-së/Serbisë për të larguar dhe fshehur kufomat provon se këto vrasje u kryen në kuadër të operacionit të përbashkët të UJ-së dhe MPB-së.⁶²⁰ Këto përpjekje do të analizohen tani.

218. Nikë Peraj dëshmoi se më 29 prill pa dy kamionë të ngarkuar me rreth 40 kufoma duke shkuar nga Meja në drejtim të qytetit të Gjakovës. Kufomat ishin të mbuluara me mushama, por ai i pa kur era ngriti mbulesën. Këta kamionë ishin të shoqëruar nga policia.⁶²¹ Sipas Perajt, "shefi i komisionit të spastrimit të zonës dhe mbledhjes së kufomave" ishte një inspektor i lartë sanitar i cili bashkëpunonte në komision me një major të UJ-së i quajtur Lubisha Zhivkoviç.⁶²² Ai tha se UJ-ja dhe MPB-ja kërkuan buldozerë pas masakrave të Mejës, kinse për rregullimin e rrugëve, por ai dyshoi se duheshin për heqjen e kufomave.⁶²³ Edhe Merita Deda dëshmoi se, më 27 prill 1999 kur

⁶¹⁷ Jose-Pablo Baraybar, P2794 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 nëntor 2006), f. 6.

⁶¹⁸ P2798 (lista e ZPZHK-së e personave të zhdukur).

⁶¹⁹ P2559 ((Plotësues i aktekspertizës); P2415 (Dokumente në lidhje me vendin e zhvarrosjes Batajnica 5: Aktautopsitë), f. 24–29; P2454 (Kopjet e aktekspertizave kriminalistike dhe vërtetimet e vdekjes të lëshuara nga ZPZHK-ja në lidhje me kufomat e bartura nga Batajnica dhe Petrovasella); P944 (Kopjet e aktekspertizave kriminalistike dhe vërtetimet e vdekjes të lëshuara nga ZPZHK-ja në lidhje me kufomat e bartura nga Batajnica); P942 (Dokumente në lidhje me vendin e zhvarrosjes Batajnica 02: Aktautopsitë); P943 (Raporte të ZPZHK-së); P2394 (Kopjet e aktekspertizave kriminalistike dhe vërtetimet e vdekjes të lëshuara nga ZPZHK-ja në lidhje me kufomat e bartura nga Batajnica, para datës 31 mars 2005).

⁶²⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 457.

⁶²¹ Nikë Peraj, P2253 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 gusht 2006), para. 86, 88, T. 1645 (15 gusht 2006).

⁶²² Nikë Peraj, P2253 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 gusht 2006), para. 87, T. 1784–1785 (16 gusht 2006).

⁶²³ Nikë Peraj, P2253 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 gusht 2006), para. 86, 88.

ishte në kolonë duke udhëtuar prej Korenicës në Mejë, ajo pa ushtarë të UJ-së duke ngarkuar tetë kufoma në një kamion të UJ-së, i cili u urdhërua të shkonte në Gjakovë.⁶²⁴

219. Dëshmitari K72 jetonte në Gjakovë dhe punonte si ekskavatorist. Dhoma e analizon dëshminë e tij në hollësi në Pjesën VII.P më poshtë, duke përfshirë dhe dëshminë në lidhje me operacionin e gërmimit për heqjen e kufomave të ura e Bistrazhinit nga mesi deri në fund të prillit 1999,⁶²⁵ në varrezat e Brekocit në dalje të Gjakovës afër kazermës së UJ-së në maj 1999,⁶²⁶ në fshatin Guskë, dhe në një pyll të afërt dikur në maj 1999.⁶²⁷ K72-shi tha se nuk kishte marrë pjesë në heqjen e kufomave të shqiptarëve kosovarë të vrarë në Mejë dhe Korenicë më 27 prill 1999.⁶²⁸ Sidoqoftë, ai sqaroi se e kishte bërë këtë deklaratë sepse nuk kishte qenë kurrë me makineri ndërtimi në Mejë apo Korenicë dhe shtoi se nuk e dinte nga kishin ardhur kufomat të cilat u urdhërua t'i zhvarroste në Bistrazhin, varrezat e Brekocit, dhe Guskë.⁶²⁹ Duke pasur parasysh dëshminë e K72-shit se në këto zhvarrime u nxorën shumë kufoma, dhe duke pasur parasysh se njerëzit panë kufomat e shqiptarëve kosovarë të vrarë në Mejë dhe Korenicë dhe përreth tyre duke u dërguar me kamionë në drejtim të qytetit të Gjakovës pas vrasjeve, si dhe duke marrë parasysh faktin se rreth 300 kufoma të shqiptarëve kosovarë të vrarë më 27 prill u gjetën më vonë në varret e përbashkëta të Batajnicës në Serbi, Dhoma është bindur se disa nga këto kufoma të zhvarrosura nga K72-shi ishin shqiptarë kosovarë të vrarë në Mejë dhe përreth saj më 27 prill.

220. Radovan Zllatkoviç dëshmoi se shërbimi operativ dhe shefi i Administratës së Policisë për krimet të SPB-së e informuan në fund të prillit 1999 se në Luginën e Caragojt ishin gjetur kufoma. Ai tha se këtë informacion ia kaloi një gjykatësi hetues dhe prokurorit publik të Pejës; ai tha se SPB-ja kreu hetime në vendin e ngjarjes gjatë një periudhe shtatëditëshe pa praninë e gjykatësit hetues.⁶³⁰ Ekipi i tij gjeti 20-25 kufoma në Ramoc, Ponoshec, Popoc, Korenicë, Nikovaz, Smonicë, Rracaj, Pacaj, dhe Junik.⁶³¹ Disa nga këto kufoma kishin rroba civile dhe disa uniforma të zeza dhe kamuflimi. Kufomat e pidentifikuar u varrosën në varrezat myslimane në Gjakovë. Në hetimin e

⁶²⁴ Merita Deda, P2233 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 prill 2000), f. 3.

⁶²⁵ Dhoma vëren se datat e dhëna nga K72-shi në lidhje me punën e bërë të ura e Bistrazhinit nuk ishin të sakta dhe mund të jenë të 27 prillit 1999.

⁶²⁶ K72, T. 5328 (26 tetor 2006).

⁶²⁷ K72, P2390 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 tetor 2005), para. 17–20 (e mbyllur me vulë).

⁶²⁸ K72, P2390 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 tetor 2005), para. 26 (e mbyllur me vulë).

⁶²⁹ K72, T. 5335 (26 tetor 2006).

⁶³⁰ Radovan Zllatkoviç, T. 25284–25285 (14 prill 2008); 6D1627 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 prill 2008), para. 39–42.

⁶³¹ Radovan Zllatkoviç, T. 25296–25297 (15 prill 2008).

vendit të ngjarjes morën pjesë tri ekipe të SPB-së,⁶³² ekipet e tjera gjetën së paku 10-15 kufoma.⁶³³ Mirëpo Zllatkoviçi dëshmoi se ai nuk e dinte se ishin gjetur mbi 300 kufoma.⁶³⁴

221. Kufomat e gjetura kishin plagë plumbash.⁶³⁵ Gjithsesi deri në fund të majit 1999 shkaku i vdekjes nuk ishte përcaktuar ende. Zllatkoviçi mendonte se ata mund të ishin vrarë në luftime.⁶³⁶ Megjithëse ishte planifikuar marrja në pyetje e pjesëtarëve të UJ-së apo të MPB-së të dislokuar në atë zonë, ajo nuk u bë asnjëherë.⁶³⁷ Zllatkoviçi deklaroi se largimi i tij nga ajo zonë e ndërpreu procedurën dhe edhe pjesëmarrësit e tjerë në hetim u detyruan të largoheshin me përfundimin e fushatës së NATO-s në qershor 1999.⁶³⁸

222. Dhoma gjithashtu ka marrë prova kriminalistike në lidhje me viktimat e Luginës së Caragojt nga raporte dhe dëshmi të shumta nga individët që ishin të pranishëm, që mbikëqyrën dhe morën pjesë në zhvarrosjen dhe identifikimin e kufomave nga varret e përbashkëta në Batajnicë prej vitit 2001 e më tej. Përshkrimi i provave kriminalistike të viktimave nga Gjakova, i cili u hartua dhe u paraqit nga Dr. Baccard, Dr. Dunjiq, Dr. Aleksandriq, dhe Dr. Sterenberg, përfshihet në Shtojcën A të këtij Aktgjykimi.

iii. Shpërngulja e shqiptarëve kosovarë prej Luginës së Caragojt

223. Nikë Peraj dëshmoi se, më 27 dhe 28 prill, një kolonë shqiptarësh kosovarë nga zona e Junikut dhe një tjetër nga Korenica u takuan në udhëkryqin e rrugës për në Gjakovë afër postbllokut të dytë. Prej andej, disa shkuan në drejtim të Shqipërisë nëpër Qafën e Prushit në jugperëndim të qytetit të Gjakovës, kurse të tjerët shkuan në drejtim të kalimit kufitar në Vërbnicë (Morinë), në komunën e Prizrenit.⁶³⁹

224. Pas vrasjes së familjes së saj, Merita Deda iu bashkua një kolone njerëzish që shkonin në drejtim të qytetit të Gjakovës.⁶⁴⁰ Ajo tregoi se përgjatë rrugës kishte pasur policë me uniforma ngjyrë qielli dhe të kaltër të mbylltë kamuflimi, por ata nuk merrnin pjesë në veprime ushtarake.⁶⁴¹ Ajo përshkroi udhëtimin e saj nga Korenica nëpër fshatin Mejë, ku pa shumë ushtarë të UJ-së dhe

⁶³² Radovan Zllatkoviçi, T. 25285 (14 prill 2008).

⁶³³ Radovan Zllatkoviçi, T. 25299 (15 prill 2008).

⁶³⁴ Radovan Zllatkoviçi, T. 25314 (15 prill 2008).

⁶³⁵ Radovan Zllatkoviçi, T. 25298 (15 prill 2008).

⁶³⁶ Radovan Zllatkoviçi, T. 25301 (15 prill 2008).

⁶³⁷ Radovan Zllatkoviçi, T. 25313–25314 (15 prill 2008).

⁶³⁸ Radovan Zllatkoviçi, T. 25313–25314 (15 prill 2008).

⁶³⁹ *Shih* P326 (vrasjet në Mejë, harta e zonës e shënuar nga Nikë Peraj); Nikë Peraj, T. 1573–1574 (14 gusht 2006).

⁶⁴⁰ Merita Deda, P2233 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 prill 2000), f. 3.

⁶⁴¹ Merita Deda, P2233 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 prill 2000), f. 5, T. 1427 (10 gusht 2006).

dëgjoji të shtëna dhe pastaj përgjatë Gjakovës dhe Bistrazhinit.⁶⁴² Sidoqoftë, ata që ishin në këmbë në kolonë u urdhëruan nga ushtarët e UJ-së te kodra e Gradishit pikërisht në jug të Bistrazhinit në rrugën për në Prizren, që të ktheheshin në fshatrat e tyre.⁶⁴³ Deda u kthye në Bistrazhin, ku qëndroi disa javë deri në ardhjen e forcave të NATO-s në Kosovë. Më pas ajo u kthye në Guskë ku pa se shtëpia e saj ishte plaçkitur dhe bagëtitë ishin vrarë.⁶⁴⁴

225. Lizane Malaj dëshmoi se, pas vrasjes së meshkujve të familjes së saj në Korenicë, ajo iu bashkua një kolone njerëzish të tjerë nga Korenica, të cilit ishin rreth 300-400 vetë.⁶⁴⁵ Ata u dërguan në qytetin e Gjakovës, ku pyetën se a mund të shkonin në fshatra të tjera në Kosovë. Ajo tha se forcat e policisë, ushtrisë, dhe të paraushtarakëve ishin të vendosura përgjatë tërë rrugës për në Shqipëri dhe e shoqëruan kolonën.⁶⁴⁶ Atyre iu tha se duhej të largoheshin nga Kosova ndryshe do të ekzekutoheshin. Ata ecën në këmbë deri te kalimi kufitar në Vërbnicë (Morinë) dhe hynë në Shqipëri më 28 prill 1999 dhe më tej vazhduan për në Kukës.⁶⁴⁷ Gjatë rrugës iu kërkuan dokumentet e identitetit, por, me sa pa, njerëzit nuk i kishin dokumentet personale me vete.⁶⁴⁸ Kur kolona arriti në kalimin kufitar në Vërbnicë (Morinë), ata takuan fshatarë të tjerë të shpërngulur nga Gjakova të cilët donin të kalonin kufirin. Atje policia përsëri u kërkoi dokumentet e identifikimit. Ajo tha se ishin të pranishëm edhe pjesëtarët e UJ-së. Ajo pa njerëzit kur dorëzonin dokumentet e tyre.⁶⁴⁹ Civilët që ishin me traktorë u detyruan të hiqnin targat para se të lejoheshin të vazhdonin për në Shqipëri. Malaj u kthye në Kosovë më 3 korrik 1999 dhe e gjeti shtëpinë "krejtësisht të djegur."⁶⁵⁰ Ajo theksoi se u largua nga Kosova për shkak se u dëbua dhe jo për shkak të bombardimeve të NATO-s.⁶⁵¹

226. Mbrojtja e Llazareviqit argumenton se dëshmia e dhënë nga Deda se njerëzit e kolonës në të cilën ishte ajo, u urdhëruan nga ushtarët e UJ-së të ktheheshin në fshatrat e tyre në Gradish më 28 prill 1999, hedh poshtë pretendimin e Prokurorisë se UJ-ja u përpoq të dëbonte shqiptarët kosovarë.⁶⁵² Mirëpo Dhoma thekson se K90-a dëshmoi se disa shqiptarë kosovarë nuk u larguan

⁶⁴² Merita Deda, P2233 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 prill 2000), f. 4.

⁶⁴³ Merita Deda, P2233 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 prill 2000), f. 4.

⁶⁴⁴ Merita Deda, P2233 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 prill 2000), f. 4.

⁶⁴⁵ *Shih* Lizane Malaj, T. 1311 (9 gusht 2006), P2232 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 shtator 2001), f. 3.

⁶⁴⁶ Lizane Malaj, P2232 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2000), f. 4. *Shih gjithashtu* Lizane Malaj, P2232 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 shtator 2001), f. 3.

⁶⁴⁷ *Shih* Lizane Malaj, P2232 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 shtator 2001), f. 5, T. 1378 (10 gusht 2006).

⁶⁴⁸ Lizane Malaj, P2232 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 shtator 2001), f. 3.

⁶⁴⁹ Lizane Malaj, P2232 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 shtator 2001), f. 5.

⁶⁵⁰ Lizane Malaj, P2232 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2000), f. 4, P2232 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 shtator 2001), f. 5.

⁶⁵¹ Lizane Malaj, P2232 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 shtator 2001), f. 5, T. 1385 (10 gusht 2006).

⁶⁵² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 384.

nga zonat në të cilat vepronte UJ-ja sepse kjo do ta linte UJ-në pa mbrojtjen e civilëve dhe rrjedhimisht të pambrojtur ndaj sulmeve të NATO-s. Ai tha se ky vendim ishte marrë në nivelin komandues të UJ-së.⁶⁵³ Momir Stojanoviç u pajtua pjesërisht me këtë pikëpamje, duke thënë se komandantët e Korpusit të Prishtinës nuk i dëbuan shqiptarët kosovarë sepse e dinin se popullata civile u siguronte mbrojtje nga bombardimet e NATO-s dhe se nëse largohej popullata civile, kjo e linte UJ-në të pambrojtur.⁶⁵⁴

227. Gjithsesi Goran Jevtoviç dëshmoi se faktikisht UJ-ja dhe MPB-ja i drejtuan civilët përtej kufirit për në Shqipëri dhe se kjo u bë për të siguruar mbrojtjen e tyre nga bombardimet e NATO-s dhe fushat e minuara të cilat ishin vendosur në atë zonë për të penguar sulmin tokësor të NATO-s.⁶⁵⁵ Edhe Vukoviç dëshmoi se Batalioni i 2-të i Motorizuar u urdhërua që të ndihmonte civilët të cilët donin të kalonin kufirin sepse zona pranë rrugës deri te kalimi kufitar ishte e minuar.⁶⁵⁶ Vukoviç dëshmoi se Komanda e Korpusit të Prishtinës e kishte urdhëruar që t'i lejonte civilët të largoheshin, mirëpo nuk ishte lëshuar urdhër me shkrim.⁶⁵⁷ Gjithashtu, Bozhidar Deliq dëshmoi në lidhje me gjendjen në pikat kufitare, duke thënë se civilët të cilët tentonin të kalonin kufirin shtetëror me Shqipërinë nga Gjakova, ndaloheshin, kontrolloheshin, dhe nëse ishin civilë të zakonshëm ktheheshin mbrapa në Gjakovë ose Prizren.⁶⁵⁸

c. Konkluzione

228. Pas shqyrtimit të të gjitha këtyre provave, Dhoma parashtroi konkluzionet e saj në lidhje me operacionin e Luginës së Caragojt. Dhoma konkludon se operacioni i Luginës së Caragojt nisi pjesërisht si përgjigje ndaj vrasjes së pesë policëve më 22 prill. Dëshmia e Nikë Perajt, të cilën Dhoma e pranon, sa u përket komenteve të bëra në praninë e tij gjatë një mbledhjeje joformale të oficerëve të lartë të UJ-së dhe MPB-së, tregon se një nga motivet për këtë operacion ishte hakmarrja kundër shqiptarëve kosovarë në këtë zonë. Dëshmia e K73-shit tregon se një motiv tjetër, gjithashtu i pretenduar edhe nga Perajt, ishte spastrimi i fshatrave të kësaj zone nga banorët e saj shqiptarë kosovarë. Duke marrë parasysh numrin e njësive të përfshira dhe nivelin nevojshëm të koordinimit për kryerjen e këtij spastrimi në Luginën e Caragojt, Dhoma është bindur se ky ishte një operacion i përbashkët dhe i organizuar i UJ-së dhe MPB-së, i kryer me dijeninë dhe miratimin e niveleve të larta të hierarkive komanduese të UJ-së dhe MPB-së, në të cilin morën pjesë edhe anëtarë të

⁶⁵³ K90, T. 9408 (30 janar 2007).

⁶⁵⁴ Momir Stojanoviç, T. 19732 (6 dhjetor 2007).

⁶⁵⁵ Goran Jevtoviç, 5D1385 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 dhjetor 2007), para. 21–22.

⁶⁵⁶ Vllatko Vukoviç, T. 21401 (30 janar 2008), 5D1442 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para. 42–44.

⁶⁵⁷ Vllatko Vukoviç, T. 21401–21402 (30 janar 2008).

⁶⁵⁸ Bozhidar Deliq, T. 19464 (4 dhjetor 2007).

grupeve paraushtarake. Dokumentacioni i UJ-së i diskutuar më lart, duke përfshirë edhe raportet e luftimit të Brigadës së 125-të e Motorizuar dërguar komandës së Korpusit të Prishtinës, konfirmon se operacioni u miratua nga komanda e Korpusit të Prishtinës.⁶⁵⁹

229. Dhoma pranon dëshmitë e K73-shit dhe K90-ës në lidhje me ngjarje gjatë operacionit të Luginës së Caragojt. Siç është përmendur më lart, K73-shi dëshmoi se në ditën e parë të operacionit të Luginës së Caragojt njësia e tij dëboi "qindra" civilë shqiptarë dhe u vuri zjarrin shtëpive të tyre.⁶⁶⁰ Edhe K90-a shpjegoi se, sapo fshatarët dilnin nga shtëpitë e tyre, shtëpive u vihej zjarri.⁶⁶¹ Duke marrë parasysh përshkrimet e K73-shit dhe K90-ës të djegieve të shtëpive të shqiptarëve kosovarë, Dhoma nuk e pranon dëshminë kontradiktore të Peroviqit dhe përfundon se kjo ishte praktikë tipike e operacionit në Luginën e Caragojt.⁶⁶²

230. Dhoma konkludon se gjatë operacionit të Luginës së Caragojt, forcat e UJ-së dhe MPB-së, duke vepruar bashkërisht, i dëbuan civilët shqiptarë kosovarë nga fshatrat e tyre dhe dërguan shumë prej tyre në Shqipëri. Kjo del nga dëshmitë e Lizane Malajt dhe Merita Dedës, të cilat thanë se kjo praktikë ishte e përhapur dhe e organizuar, nga dëshmia e K90-ës, i cili tha se dëbimi i shqiptarëve kosovarë nga fshatrat e tyre u krye nga UJ-ja në zbatim të urdhrave gojore, dhe nga dëshmia e K73-shit i cili tregoi për dëbimin e fshatarëve gjatë operacionit. Ky përfundim gjithashtu mbështetet nga dëshmitë e Martin Pnshit dhe Nikë Perajt në lidhje me ngjarjet në Mejë dhe Korenicë më 27 dhe 28 prill 1999. Shumë nga shqiptarët kosovarë të dëbuar u detyruan dhe kërcënuan me vdekje nga forcat e UJ-së dhe MPB-së që të shkonin në Shqipëri. Dhoma gjithashtu është bindur se këto dëbime ishin të dhunshme dhe përfshinë keqtrajtme dhe konfiskime të dokumenteve personale të të shpërngulurve. Në bazë të dëshmimeve, ndërmjet të cilave, të K73-shit dhe K90-ës, Dhoma konkludon se prania e UÇK-së në atë zonë më 27 dhe 28 prill 1999 nuk ishte e konsiderueshme dhe se operacioni i Luginës së Caragojt u përqendrua kryesisht kundër popullatës civile shqiptare kosovare. Duke marrë parasysh dëshmitë në lidhje me veprimet e forcave të UJ-së dhe MPB-së në komunën e Gjakovës gjatë fundit të marsit dhe fillimit deri në mes të prillit 1999, duke përfshirë edhe dëshminë e Fuat Haxhibeqirit shqyrtuar më lart, Dhoma konkludon se këto dëbime ishin pjesë e një praktike më të gjerë të shpërnguljes me dhunë të shqiptarëve kosovarë nga fshatrat e tyre në komunën e Gjakovës.

⁶⁵⁹ P2024 (Raport luftimi i Brigadës së 125-të të Motorizuar, 27 prill 1999); P2025 (Raport luftimi i Brigadës së 125-të të Motorizuar, 28 prill 1999), f. 2; P2026 (Raport luftimi i Brigadës së 125-të të Motorizuar, 29 prill 1999), f. 2.

⁶⁶⁰ K73, P2440 (deklarata e dëshmitarit), para. 42.

⁶⁶¹ K90, P2652 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 dhjetor 2002), para. 48.

⁶⁶² Sergej Peroviq, 5D1396 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 janar 2008), para. 25, T. 21081, 21101–21102 (25 janar 2008).

231. Duke iu referuar fshatrave konkrete në të cilat u kryen krime gjatë operacionit të Luginës së Caragojt, Dhoma konkludon se më 27 prill në Dobrosh, forcat e UJ-së i detyruan banorët të largoheshin nga fshati. Edhe pse K73-shi tha se njësia e tij kishte djegur shtëpitë e shqiptarëve kosovarë, ai nuk e përmendi Dobroshin dhe rrjedhimisht Dhoma nuk konkludon se ky fshat u dogj nga forcat e UJ-së.

232. Dhoma gjithashtu përfundon se, më 27 dhe 28 prill 1999 në Ramoc, UJ-ja i detyroi banorët të largoheshin nga fshati dhe i dorëzoi PJP-së katër fshatarë. Dhoma vëren se K73 pranoi se nuk i pa vrasjet në Ramoc, por se kishte qenë dëshmitar i ngjarjeve paraprijëse, dëgjoi të shtënat, dhe pa oficerin e MPB-së duke u kthyer më pas me lidhëset e duarve, dhe përfundon se i vetmi interpretim logjik është se këta fshatarë u ekzekutuan nga PJP-ja me dijeninë e forcave të pranishme të UJ-së.

233. Në lidhje me Korenicën, Dhoma kujton se raportet e UJ-së tregojnë se pjesëtarët e Brigadës së 549-të të Motorizuar u angazhuan në operacione në varrezën e Korenicës në të njëjtën ditë që Deda dhe Malaj thanë se kishin parë ushtarë të UJ-së në atë fshat.⁶⁶³ Bazuar në dëshmitë e Merita Dedës, Lizane Malajt, dhe K73-shit, Dhoma është bindur se më 27 prill 1999 pjesëtarët e MPB-së, përfshirë PJP-në, e UJ-së, përfshirë Brigadën e 549-të të Motorizuar dhe rezervistët, dhe paraushtarakët vranë një numër meshkujsh shqiptarë kosovarë gjatë operacionit të përbashkët dhe dëbuan me dhunë një numër civilësh shqiptarë kosovarë ndër të cilët edhe Merita Deda dhe Lizane Malaj, disa prej të cilëve u detyruan të shkonin në Shqipëri. Shqiptarët kosovarë të vrarë në shtëpinë e Markajve ishin Mark Deda, Linton Deda, Pren Markaj, Pashk Markaj, Mark Markaj, Bekim Markaj, dhe Petrit Markaj. Dhoma vëren se nuk ekzistojnë prova kriminalistike në lidhje me Skënder Pjetrin. Rrjedhimisht, ajo nuk është bindur se është provuar se Skënder Pjetri u vra në Korenicë më 27 prill 1999. Duke marrë parasysh dëshminë e Dedës se në familjen e saj nuk kishte pjesëtarë të UÇK-së, por se ata u sulmuan për shkak të lidhjeve të tyre politike dhe faktin se gjatë fazës së pyetjeve nga Mbrojtja ajo nuk u kundërshtua në këtë pikë, Dhoma konkludon se këta individë ishin civilë. Shqiptarët kosovarë të vrarë në shtëpinë e Malajve ishin Vat Malaj, Blerim Malaj, Arben Kabashi, Nikollë Kabashi, dhe Andrush Kabashi. Edhe pse Malaj mohoi se në familjen e saj kishte pjesëtarë të UÇK-së, ajo tha se kishte dijeni të kufizuar në lidhje me UÇK-në. Gjithsesi Dhoma është bindur se rrethanat e vrasjes së tyre tregojnë se në atë kohë këta individë nuk ishin të angazhuar në operacione luftarake.

234. Dhoma konkludon se më 27 prill 1999 forcat e UJ-së, MPB-së dhe paraushtarake hynë në fshatin Mejë dhe pjesëtarët e MPB-së vranë shtatë burra të pidentifikuar te ura mbi lumin Travë.

⁶⁶³ P2019 (Ditari i Luftës i Batalionit të 2-të të Motorizuar të Brigadës së 549-të të Motorizuar, 24 mars 1999 - 26 qershor 1999), f. 11 (e mbyllur me vulë).

Sidoqoftë, për shkak të dëshmime jobindëse në lidhje me gjendjen e kufomës së tij pas 19 ditësh, Dhoma nuk është bindur se është provuar se më 27 ose 28 prill 1999 këto forca vranë Kolë Duzhmanin.

235. Dhoma pranon dëshminë e Perajt se më 27 prill 1999 ai pa 20 kufoma te postblloku afër lëndinës së Hasanajve dhe 11 kufoma të tjera rreth 700 metra larg nga ky postbllok. Dhoma nuk e pranon mohimin e Peroviqit se nuk e shoqëri Perajn te postblloku dhe nuk pa ndonjë kufomë, sepse bie në kundërshtim me pohimin e pavarur të Vasileviqit se Peroviqi i kishte raportuar për 20 kufoma në atë zonë. Dhoma gjithashtu konkludon se në postbllokun në rrugën Korenicë-Gjakovë forcat e MPB-së morën së paku tre burra të paidentifikuar dhe i dërguan në oborrin e një shtëpie ku i vranë. Dhoma është bindur se më 27 prill 1999 K90-a ishte i pranishëm në Mejë dhe i pa vrasjet. Dëshmitë e K90-ës dhe Nikë Perajt në lidhje me ekzistencën e këtyre postblloqeve, së bashku me dëshminë e Martin Pnshit, përputheshin me informatat e dhëna nga K73-shi se civilët e dëbuar gjatë operacionit në Luginën e Caragojt kontrolltoheshin në skaj të luginës afër Korenicës. Është e qartë se kjo ishte pjesë e operacionit të Luginës së Caragojt dhe se UJ-ja i dha mbështetje MPB-së gjatë veprimeve të tyre në Mejë, siç është demonstruar në mes të tjerash edhe nga dëshmia e Nikë Perajt se pjesëtarët e njësisë të Mbrojtjes Territoriale, të komanduara nga Miçunoviqi i UJ-së, ishin përgjegjës për vrasjet në Mejë dhe rrethinë.

236. Bazuar në dëshmitë e mësipërme dhe provat kriminalistike nga varret e përbashkëta të Batajnicës, siç diskutohet në hollësi në Shtojcën A më poshtë, Dhoma konkludon se vrasjet konkrete në Mejë, Korenicë dhe fshatra të tjera në Luginën e Caragojt, më 27 prill 1999 të përshkruara nga Malaj, Deda, Pnishi, Peraj, dhe K90-a pasqyrojnë një masakër shumë më të madhe që ndodhi si pjesë e operacionit të Luginës së Caragojt të kryer nga pjesëtarët e UJ-së dhe MPB-së së bashku me pjesëtarët e grupeve paraushtarake, që rezultoi në vrasjen e së paku 287 shqiptarëve kosovarë. I vetmi përfundim logjik që mund të nxirret nga të gjitha provat është se shumë nga të vrarët ishin civilë ose nuk merrnin pjesë në luftime në momentin e vrasjes.

237. Duke marrë parasysh dëshmitë e Perajt, Dedës, Pnshit, dhe K72-shit, Dhoma konkludon se, pas operacionit të përbashkët të UJ-së/MPB-së në Luginën e Caragojt, kufomat e shumë shqiptarëve kosovarë të vrarë gjatë tij u dërguan nga forcat e UJ-së dhe MPB-së që vepruan në bashkëpunim, në varrezën publike në Brekoc të Gjakovës. Dëshmia e K72-shit në lidhje me zhvarrosjen e kufomave nga ky vend, siç përshkruhet në Pjesën VII.P më poshtë, dhe gjetja e mëvonshme e kufomave në varret e përbashkëta në Batajnicë e së paku 287 kufomave të shqiptarëve kosovarë të vrarë gjatë operacionit të Luginës së Caragojt, sidomos të kufomave të tetë individëve vrasjen e të cilëve e kishte parë Merita Deda dhe të pesë individëve vrasjen e të cilëve e kishte parë Lizane Malaj, e

kanë bindur Dhomën se këto kufoma u zhvendosën për të fshehur krimet e kryera gjatë këtij operacioni. Meqenëse K72-shi i kreu këto veprime nën drejtimin e MPB-s, duket se roli i UJ-së në zhvendosjen e kufomave për fshehjen e krimeve ka qenë më i kufizuar. Sidoqoftë, është vërtetuar se procesi i zhvarrosjes dhe zhvendosjes së kufomave u bë për të fshehur rezultatet e operacionit të përbashkët të UJ-së dhe MPB-së dhe fakti se MPB-ja ishte përgjegjëse për fshehjen e krimeve është provë e fortë e implikimit të forcave të saj në kryerjen e krimeve.

238. Rrjedhimisht, bazuar në provat kriminalistike dhe provat e tjera në lidhje me operacionin e Luginës së Caragojt të diskutuar më lart, Dhoma konkludon se 275 personat e mëposhtëm, emrat e të cilëve janë në Listën H të Aktakuzës u vranë nga forcat e UJ-së dhe MPB-së më 27 prill 1999 në fshatrat Mejë dhe Korenicë dhe në rrethinat e tyre (përveç 13 viktimave të përmendura më lart):

Mark Abazi; Pashk Abazi; Bekim Ademaj; Shemsi Ademaj; Isuf Ademi; Mazllum Ademi; Liridon Ahmetaj; Ahmet Ahmeti; Ahmet Ahmeti; Blerim Ahmeti; Hysen Ahmeti; Adem Aliaj; Agron Aliaj; Ali Aliaj; Sali Aliaj; Zenun Aliaj; Ymer Avdullahu; Avdyl Avdyli; Bajrush Avdyli; Hysen Avdyli; Muhedin Avdyli; Lavdim Bajraktari; Shaban Bajrami; Sylë Bajrami; Xhafer Bajrami; Xhavit Bajrami; Ali Bala; Bajram Bala; Mehmet Bala; Përparim Bala; Ragip Baliu; Demush Bardheci; Idriz Bardheci; Haki Batusha; Armend Beqaj; Bajram Beqaj; Bedri Beqaj; Brahim Beqaj; Dritan Beqaj; Emin Beqaj; Kujtim Beqaj; Milazim Beqaj; Ramadan Beqaj; Rasim Beqaj; Tafë Beqaj; Ymer Beqaj; Albert Beqiraj; Arsim Beqiraj; Sylë Beqiraj; Tahir Beqiraj; Halil Berisha; Avni Binaku; Binak Binaku; Ismet Bobi; Fiqrih Çuni; Muharrem Çuni; Sutki Çuni; Frrok Dedaj; Gjon Dedaj; Mikel Dedaj; Pjetër Dedaj; Deli Deliu; Ali Demaj; Agron Duzhmani; Frane Duzhmani; Gostin Duzhmani; Mikel Duzhmani; Gëzim Duzhmani; Manuel Duzhmani; Marjan Duzhmani; Pashk Duzhmani; Pal Duzhmani; Male Fazlia; Haxhi Fetaj; Lulzim Gashi; Brahim Gaxherri; Xhafer Gaxherri; Demë Gjocaj; Ardian Gjokaj; Asllan Golaj; Avdi Golaj; Idriz Golaj; Musa Gola; Ramë Golaj; Rexhë Golaj; Skënder Hadërgjonaj; Faik Hajredini; Hysni Hajredini; Qamil Hajredini; Gjon Hasanaj; Luan Hasanaj; Shyt Hasanaj; Mentor Haxhaj; Avdi Haxhiu; Florim Haxhiu; Tahir Haxhiu; Ardian Hoxha; Blendian Hoxha; Bajram Hoxha; Fitim Hoxha; Hajrullah Hoxha; Naim Hoxha; Ramiz Hoxha; Rifat Hoxha; Binak Hyseni; Hysni Ibrahimimi; Masar Idrizi; Demë Islamaj; Bajram Isufi; Isa Isufi; Besim Kameri; Gëzim Kameri; Muharrem Kamberi; Rrustem Kameri; Shpend Kameri; Nikollë Komani; Fran Komani; Pashk Komani; Mikel Kqira; Pashk Kqira; Luz Kqira; Albert Krasniqi; Pjetër Krasniqi; Mark Krasniqi; Ndue Krasniqi; Hasan Kuqi; Shpend Kuqi; Haki Kurtaj; Isa Kurtaj; Muhamet Kurtaj; Sami Kurtaj; Kllaudie Mala; Kolë Mala; Monika Mala; Blerim Maloku; Burim Maloku; Petrit Maloku; Ymer Maloku; Besim Malushaj; Shefki Mulashaj; Dede Markaj; Gëzim Marku; Gjovalin Markaj; Millan Markaj; Sokol Markaj; Agron Mehmeti; Arben Mehmeti; Gani Mehmeti; Hysen Mehmeti; Hysni Mehmeti; Muharrem Mehmeti; Quash

Mehmeti; Ramë Mehmeti; Sami Mehmeti; Marash Merturi; Bajram Meta; Ismet Miftari; Brahim Miroci; Fahredin Miroci; Isuf Miroci; Sokol Miroci; Kole Nrejaj; Ndue Ndue; Ahmet Neziri; Sokol Ndue; Sokol Nuza; Shpend Osmani; Avdyl Pajaziti; Smajl Pajaziti; Gani Pajaziti; Haxhi Pajaziti; Ismet Pajaziti; Mujë Pajaziti; Qerim Pajaziti; Shkelzen Pajaziti; Shpend Pajaziti; Zenel Pajaziti; Ukë Pepaj; Gaspër Pjetri; Ilirjan Pjetri; Ardian Prelaj; Driton Prelaj; Sokol Prelaj; Gjergj Prelaj; Tomë Prelaj; Pal Prendi; Prend Prendi; Sokol Prendi; Vitor Prendi; Hajdar Qestaj; Adem Rama; Bujar Rama; Nijazi Rama; Sadri Rama; Sezaj Rama; Zenun Rama; Zeqir Rama; Ramë Ramaj; Tahir Ramaj; Adem Rexha; Anton Rexhaj; Avni Rexha; Bashkim Rexha; Iber Rexha; Ruzhdi Rexha; Hamza Rexhaj; Isuf Rexhaj; Xhevdet Rexhaj; Bekim Rrustemi; Dan Rrustemi; Xhafer Rrustemi; Iber Sadiku; Ismet Sadiku; Osman Sadiku; Ramiz Sadiku; Sadik Sadiku; Hysni Sadriu; Rexhep Sadriu; Shaqir Sadriu; Osman Salihaj; Bajram Salihu; Beqir Selmanaj; Nexhat Selmanaj; Ali Selmani; Baki Selmani; Burim Selmani; Jonuz Selmani; Ujkan Selmani; Xhemë Selmani; Zenun Selmani; Demë Shala; Ismet Shehu; Agim Shehu; Ahmet Shehu; Bujar Shehu; Mehmet Shehu; Ramë Shehu; Elvis Shoshi; Gani Smajli; Filip Sokoli; Kastriot Sokoli; Kriste Sokoli; Simon Sokoli; Ismet Sylja; Rexhep Sylja; Bajram Sylja; Bajram Tahiraj; Halil Tahiraj; Isuf Tahiraj; Osman Tahiraj; Ramadan Tahiraj; Rrustem Tahiraj; Selman Tahiraj; Xhevdet Tahiraj; Ukë Xhemajli; Hasan Xhemajli; Isa Xhemajli; Miftar Xhemajli; Rifat Xhemajli; Xhemajl Xhemajli; Elez Ymeri; Halit Ymeri; Hasan Ymeri; Hysen Ymeri; Musa Ymeri; Xhafer Ymeri; Zenel Ymeri; Bajram Zenuni; Xhevat Zenuni; Zenel Zenuni; Hasan Zeqiri; Arbër Zyberi; Gani Zyberi; Skënder Zyberi.

239. Në lidhje me personat e tjerë emrat e të cilëve janë në Listën H të Aktakuzës, Dhoma konkludon se, edhe pse ka të ngjarë që ata të jenë vrarë gjithashtu më 27 prill në Mejë dhe Korenicë apo në rrethinën e tyre, kjo nuk është provuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm. Këta persona janë:

Pjetër Abazi; Male Ahmeti; Arben Aliaj; Afrim Avdyli; Mehmet Avdyli; Pajazit Avdyli; Ali Bajrami; Mentor Beqaj; Ahmet Berisha; Ismail Binaku; Istref Curri; Izet Curri; Shani Fazliaj; Lulzim Gashi; Hasan Gaxheri; Elson Hasanaj; Mitër Hasanaj; Ndue Hasanaj; Afrim Haxhiu; Fadi Hoxha; Gafurr Hykosmanaj; Ali Ibrahim; Pjetër Kacoli; Tom Kacoli; Lazër Krasniqi; Ilmi Kurpali; Anton Lleshi; Vilson Malaj; Esad Malushaj; Mehmet Mehmeti; Naim Nimanaj; Pashk Ndrejaj; Nrec Nrejaj; Idriz Pajaziti; Halil Pajaziti; Mark Palokaj; Gjergj Prendi; Robert Prendi; Mark Prendi; Leonard Prendi; Tahir Rexhaj; Esat Sahiti; Xhavit Salcaj; Nimon Salihu; Sherif Selmani; Shpend Selmani; Përparim Shoshi; Naser Shoshi; Gjergj Sokoli; Shpend Xhemajli; Alban Xhemajli; Ilija Xhemajli; Muharrem Xhemajli; Shkelzen Xhemajli; Gani Ymeri.

240. Dhoma vëren se emri i Mark Markajt është përmendur dy herë në Aktakuzë dhe konkludon se është gabim, siç përshkruhet në Shtojcën A më poshtë.

D. PRIZRENI

1. Akuzat në Aktakuzë

241. Aktakuza i ngarkon të Akuzuarit me përgjegjësi për tri kategori të ndryshme të krimeve kundër njerëzimit që pretendohet se janë kryer në komunën e Prizrenit: dëbim, zhvendosje e dhunshme, dhe përndjekje. Pretendohet përndjekja është kryer në formën e dhunës seksuale kundër grave shqiptare kosovare në komunën e Prizrenit, siç është përshkruar në paragrafin 72(b) dhe "shkatërrimi apo dëmtimi pa shkak i objekteve fetare të shqiptarëve kosovarë," duke përfshirë dëmtimin dhe/ose shkatërrimin e xhamisë në Landovicë.⁶⁶⁴

242. Pretendimet e veçanta janë paraqitur në Paragrafin 72(b) të Aktakuzës, ku parashtrohet:

Më 25 mars 1999, fshati Piranë u rrethua nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë me tanke dhe automjete ushtarake të ndryshme. Fshati u granatua dhe një numër banorësh u vranë. Më pas forcat e RFJ-së dhe të Serbisë hynë në fshat dhe i dogjën shtëpitë e shqiptarëve kosovarë. Pas sulmit, fshatarët e mbetur u larguan nga Pirana dhe shkuan në fshatrat përreth. Në fshatin Landovicë, një xhami e vjetër u dogj dhe u dëmtua rëndë nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë. Disa prej shqiptarëve kosovarë që po iknin në drejtim të Sërbicës, u vranë apo u plagosën nga snajperët. Më tej forcat e RFJ-së dhe të Serbisë filluan një ofensivë në zonën e Sërbicës, duke granatuar fshatrat Reti e Poshtme, Reti, dhe Randobravë. Fshatarët shqiptarë kosovarë u përzunë nga shtëpitë e tyre dhe u dërguan në kufirin me Shqipërinë. Prej 28 marsit 1999 në qytetin e Prizrenit, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë shkonin shtëpi më shtëpi, duke urdhëruar banorët shqiptarë të Kosovës të largoheshin. Ata u detyruan t'u bashkoheshin kolonave të automjeteve dhe të njerëzve që udhëtonin në këmbë drejt kufirit shqiptar. Gjatë rrugës, anëtarët e forcave të RFJ-së dhe të Serbisë rrahën dhe vranë meshkuj kosovarë shqiptarë, veçuan gra shqiptare kosovare nga kolona dhe i dhunuan gratë seksualisht. Në kufi, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë ua morën shqiptarëve të Kosovës letërnjoftimet.⁶⁶⁵

2. Rrethanat

243. Komuna e Prizrenit është në Kosovën jugore dhe kufizohet me Shqipërinë në anën perëndimore dhe Maqedoninë në anën lindore. Qyteti i saj kryesor gjithashtu quhet Prizren. Fshati i Landovicës është afërsisht tetë kilometra në veri të qytetit të Prizrenit në rrugën për Gjakovë, kurse Pirana është në të njëjtën rrugë tri kilometra në veri të Landovicës.⁶⁶⁶ Fshati Sërbicë është i ndarë në pjesën e epërme dhe të poshtme dhe është në lindje dhe juglindje, rreth tri kilometra lart Piranës.⁶⁶⁷

⁶⁶⁴ Aktakuza, para. 77(c) dhe 77(d).

⁶⁶⁵ Aktakuza, para. 72(b).

⁶⁶⁶ Rahim Latifi, T. 4959 (16 tetor 2006).

⁶⁶⁷ P615 (Atlasi i Kosovës); Rahim Latifi, T. 4985 (17 tetor 2006).

Retia e Poshtme, Retia, dhe Randobrava janë fshatra që gjenden më tutje në veri, afër komunës së Rahovecit.⁶⁶⁸

244. Në lidhje me krimet që pretendohet se u kryen në komunën e Prizrenit, Prokuroria paraqiti si dëshmitarë Rahim Latifin, Halil Morinën, Rexhep Krasniqin, dhe Hysni Kryeziun. Mbrojtja paraqiti si dëshmitarë, ndër të tjerë, Bozhidar Deliqin, Franjo Gllonçakun, dhe Nebojsa Ognjenoviqin. Edhe disa dëshmitarë të tjerë dëshmuar në lidhje me situatën në komunë në atë kohë. Siç është theksuar më parë në lidhje me dëshmitarët e tjerë, Dhoma Gjyqësore i sheh me skepticizëm mohimet përgjithësuese të shumë dëshmitarëve në lidhje me aktivitetin e UÇK-së në afërsi të shtëpive të tyre dhe, në këtë aspekt, nuk e konsideron Rahim Latifin të besueshëm përse i përket dëshmisë së tij në lidhje me praninë e UÇK-së në atë zonë dhe, rrjedhimisht gjykon se dëshmia e tij në përgjithësi meriton shqyrtim të vëmendshëm. Me gjithë pretendimet e Mbrojtjes së Pavkoviqit se deklarata e Hysni Kryeziut nuk mund të merret parasysh për shkak të korrigjimeve që ai kishte bërë,⁶⁶⁹ Dhoma gjykon se këto mospërputhje nuk janë qenësore dhe e konsideron atë përgjithësisht të besueshëm. Dëshmia e Kryeziut për dëbimin e tij nga Dushanova në fund të marsit 1999 ishte përgjithësisht përputhëse me dëshminë e Krasniqit, të cilin Dhoma e konsideron të besueshëm. Dhoma gjithashtu gjykon se disa aspekte të dëshmisë së Bozhidar Deliqit janë të besueshme, por nuk i konsideron përgjithësisht të besueshme dëshmitë e Franjo Gllonçakut dhe Nebojsa Ognjenoviqit. Sa herë që ka dalë e nevojshme, Dhoma ka shqyrtuar aspekte konkrete që lidhen me besueshmërinë dhe saktësinë e këtyre dëshmitarëve.

245. Dhoma dëgjoi dëshmi se në vitin 1998 dhe 1999 zona kufitare midis Prizrenit dhe Shqipërisë ishte vend i lëvizjeve dhe veprimeve të shumta të UÇK-së dhe veprimeve luftarake të ndërmarra si kundërpërgjigje nga forcat e MPB-së dhe UJ-së.⁶⁷⁰ Gjithashtu, duke u bazuar në dëshmitë, ndër të tjerë, të dëshmitarëve K54, K79, Hamide Fondaj, dhe Bozhidar Deliq, Dhoma Gjyqësore konkludon se rrugët kryesore nëpër komunë, nga Suhareka dhe Gjakova e deri në qytetin e Prizrenit, dhe prej aty deri në kufi me Shqipërinë e pastaj në Kukës në Shqipëri ishin rrugë

⁶⁶⁸ P615 (Atlasi i Kosovës).

⁶⁶⁹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 404.

⁶⁷⁰ *Shih për shembull* Joseph Maisonneuve, P2772 (deklarata e dëshmitarit e datës 10 mars 2000), para. 12–13; 3D134 (Sulmet terroriste në vitin 1999), para. 163; 3D136 (Raport i CC-së Prishtinë 15 nëntor 1998), f. 1; 3D137 (OSBE/KVM, Pasqyrë e përgjithshme e Qendrës Koordinuese 1, 18 janar 1999); 3D138 (Raport i TM-së Prizren, 3 mars 1999), f. 2. *Shih gjithashtu* John Crosland, T. 10008 (9 shkurt 2007); Bozhidar Deliq, T. 19275–19276 (28 nëntor 2007), 19558–19561 (5 dhjetor 2007); Tomisllav Mitiq, 5D1390 (deklarata e dëshmitarit e datës 27 dhjetor 2007), para. 50–51; Millosh Vojnoviq, T. 24172 (12 mars 2008); 6D1013 (Raport i MPB-së Prizren, 13 mars 1999), f. 5; 3D179 (Raport i KVM-së në lidhje me respektimin e armëpushimit prej palëve në Kosovë, 12 mars 1999), gjithashtu e pranuar si P444; Bislim Zyrap, T. 6043 (7 nëntor 2006); 4D87 (Raport i Komandës së PrK-së drejtuar Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 28 tetor 1998), f. 1; 3D139 (Raporti javor i UNHCR-së, 19 nëntor 1998); P2071 (Urdhër i PrK-së, 16 mars 1999); P2072 (Urdhër i Brigadës së 549-të të Motorizuar, 16 mars 1999); P1999 (Analizë e aksioneve të Brigadës së

kryesore të kalimit të shqiptarëve kosovarë të shpërngulur gjatë periudhës së përfshirë në Aktakuzë.⁶⁷¹

246. Bozhidar Deliqi dëshmoi se njësitë e Brigadës së 549-të të Motorizuar morën pjesë në të gjitha operacionet e përbashkëta me MPB-në në komunën e Prizrenit gjatë periudhës që ka lidhje me Aktakuzën.⁶⁷² Ai më tej pohoi se aksionet ishin të koordinuara ndërmjet UJ-së dhe MPB-së (PJP-së) në Prizren dhe dha si shembull një sulm të kryer kundër UÇK-së në zonën e fshatit Jeshkovë në jug të Prizrenit sipas një urdhri të lëshuar më 9 mars 1999.⁶⁷³ Një raport i MPB-së i datës 12 mars 1999 dhe dëshmitë e dëshmitarëve K54 dhe K82 e konfirmojnë këtë pohim.⁶⁷⁴ K54-a dhe K82-shi, të dy pjesëtarë të Brigadës së 549-të të Motorizuar, përshkruan aksionin në Jeshkovë dhe aksionet e tjera të ngjashme në të cilët kishin marrë pjesë.⁶⁷⁵ Në lidhje me Jeshkovën, të dy dëshmitarët treguan për sulmimin e fshatit nga forca të mëdha të përbashkëta të UJ-së dhe PJP-së. Në fillim fshati u granatua rreth 30 minuta me armë të rënda e më pas hyri këmbësoria. Gjatë këtij aksioni u vranë rreth 30 vetë.⁶⁷⁶ Edhe K54-a, edhe K82-shi thanë se kishin parë vetëm civilë të vdekur.⁶⁷⁷ Sidoqoftë, këto vrasje nuk janë përfshirë në Aktakuzë si krime dhe Dhoma nuk ka nevojë të nxjerrë konkluzione të veçanta në lidhje me to. Dhoma gjithashtu nuk e sheh të nevojshme të

549-të të Motorizuar, 18 mars 1999); 3D1051 (Raport i Komandës së Armatës së 3-të, 6 mars 1999), para. 2.4; P1998 (Raport dërguar PrK-së në lidhje me aksionet e njësisë të Brigadës së 549-të të Motorizuar, 12 mars 1999).

⁶⁷¹ *Shih për shembull*, K54, T. 10514 (26 shkurt 2007); Hamide Fondaj, P2283 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 qershor 2001), f. 3–5; Halit Berisha, P2326 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 gusht 2001), f. 4; K58, P2550 (deklarata e dëshmitarit e datës 2 shkurt 2000), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 17; K79, T. 9653–9655 (1 shkurt 2007), T. 9678–9679 (2 shkurt 2007); 5D113 (Raport i KVM-së 11 mars 1999), f. 1. *Shih gjithashtu* Bozhidar Deliq, T. 19313 (29 nëntor 2007); 5D1242 (Videofilmime); Nebojsja Ognjenoviq, T. 22882, 22885–22886 (20 shkurt 2008); P3153 (Lajm në internet i AFP-së, 30 mars 1999).

⁶⁷² Bozhidar Delliq, T. 19590 (5 dhjetor 2007). *Shih gjithashtu* P2166 (Procesverbali i mbledhjes në Belli Dvor i mbajtur më 29 tetor 1998), f. 5.

⁶⁷³ Bozhidar Delliq, T. 19472 (4 dhjetor 2007), T. 19541 (5 dhjetor 2007), T. 19669, 19679 (6 dhjetor 2007); P2067 (Urdhër i Brigadës së 549-të të Motorizuar, 9 mars 1999); P1998 (Raport i PrK-së në lidhje me aksionet e njësisë të Brigadës së 549-të të Motorizuar, 12 mars 1999). *Shih gjithashtu* 6D1013 (Raport i MPB-së Prizren, 13 mars 1999), f. 5.

⁶⁷⁴ 6D1007 (Raport i MPB-së nga Qendra e RDB-së Prizren, 12 mars 1999).

⁶⁷⁵ K82, T. 11802–11803 (15 mars 2007), T. 11746–11747, 11807 (15 mars 2007), P2863 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 shtator 2006), para. 6; K54, P2883 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 prill 2002), f. 4–5, P2677 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 8233–8236 (e mbyllur me vulë); P1998 (Raport dërguar PrK-së në lidhje me aksionet e njësisë të Brigadës së 549-të të Motorizuar, 12 mars 1999). *Shih gjithashtu* 5D112 (Raport i OSBE-së, KVM-së 11 mars 1999), f. 2.

⁶⁷⁶ K82, T. 11746–11747, 11807 (15 mars 2007), P2863 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 shtator 2006), para. 6; K54, P2883 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 prill 2002), f. 4–5, P2677 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 8233–8236 (e mbyllur me vulë); P1998 (Raport dërguar PrK-së në lidhje me aksionet e njësisë të Brigadës së 549-të të Motorizuar, 12 mars 1999). *Shih gjithashtu* 5D112 (Raport i OSBE-së, KVM-së 11 mars 1999), f. 2.

⁶⁷⁷ K54, T. 10580 (27 shkurt 2007), P2883 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 prill 2002), f. 5, P2677 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 8236 (e mbyllur me vulë); K82, T. 11747, 11805 (15 mars 2007), P2863 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 shtator 2006), para. 6. *Por shih* Millosh Vojnoviq, T. 24175 (12 mars 2008); 5D113 (Raport i OSBE-së, KVM-së 12 mars 1999), f. 1; 5D114 (Raport i KVM-së 13 mars 1999), f. 1.

zgjidhë kundërshtinë në lidhje me urdhrat e Deliqit që i paraprinë aksionit, të cilat mund të interpretohen si urdhra për të vrarë mospjesëmarrës në luftime në fshat .⁶⁷⁸

3. Pirana

247. Fshati Piranë gjendet në udhëkryqin i cili i lidh rrugën Prizren-Gjakovë me rrugën që çon për në Mamushë. Rahim Latifi, banor shqiptar kosovar i këtij fshati, dëshmoi se forcat e RFJ-së dhe Serbisë atje ishin vazhdimisht në lëvizje. Mirëpo, ai pretendoi se nuk kishte parë UÇK në atë zonë gjatë marsit ose prillit 1999 dhe se NATO-ja nuk e bombardoi asnjëherë Piranën në prill 1999.⁶⁷⁹ Sipas një raporti të Misionit Monitorues të Bashkësisë Evropiane (ECMM) i datës 3 mars 1999, Pirana kishte 220 shtëpi dhe afërsisht 2.300 banorë. Në raport gjithashtu thuhej se në atë kohë fshati kishte strehuar mbi 260 persona të shpërngulur brenda vendit nga Retia, Opterusha, Zoçishta, dhe Ratkoci. Aty gjithashtu theksohej se Pirana gjendej afër bastioneve të UÇK-së, por deri në atë kohë kishte qëndruar "larg problemeve të mëdha." Edhe pse ECMM-ja u informua se fshatarët nuk kishin lidhje me forcat e UÇK-së të vendosura në veri të fshatit, raporti shprehte dyshime mbi pamundësinë e fshatarëve për t'i raportuar UÇK-së lëvizjet e MPB-së. Monitoruesit e ECMM-së evidentuan dislokimin e forcave të mëdha të MPB-së në atë zonë dhe, si rezultat i "sulmit" nga këto forca, më 27 shkurt gati 85% e banorëve të Piranës ikën në drejtim të Mamushës, Medvecit, dhe qytetit të Prizrenit. Më tej këta njerëz u kthyen në shtëpitë e tyre edhe pse policia kishte ende patrulla të rregullta në atë zonë.⁶⁸⁰

248. OSBE/KVM-ja gjithashtu raportoi se më 10 mars 1999 60 për qind e grave dhe fëmijëve të Piranës e kishin lënë fshatin për shkak të rrezikut të aksionit të prishëm nga MPB-ja për të liruar një anëtar të rrëmbyer të MPB-së.⁶⁸¹ Sipas një raporti të KVM-së, UÇK-ja e kishte konfirmuar në mënyrë të tërthortë përfshirjen e saj në rrëmbim, por arsyeja për këtë ishte e paqartë.⁶⁸² Latifi dëshmoi se kishte dëgjuar për rrëmbimin, por nuk e dinte se kush ishte përgjegjës.⁶⁸³ Ai gjithashtu dëshmoi se, edhe pse familja e tij nuk ishte larguar nga shtëpia në atë kohë, "kishte panik gjatë

⁶⁷⁸ K54, P2883 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 prill 2002), f. 4–5, P2677 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 8233–8236 (e mbyllur me vulë).

⁶⁷⁹ Rahim Latifi, T. 4978–4979, 4983–4984, 4986 (17 tetor 2006). *Por shih* 6D2, 6D1632 (deklarata e dëshmitarit), para. 103.

⁶⁸⁰ 3D138 (raport ditor i ECMM-së, 3 mars 1999).

⁶⁸¹ 3D140 (raport i OSBE-së, KVM-së, 9 mars 1999), f. 3–4; 3D141 (raport i OSBE-së, KVM-së, 10 mars 1999), f. 2. Punëtori quhej Ymer Xhafiqi.

⁶⁸² 3D140 (raport i OSBE-së, KVM-së, 9 mars 1999), f. 1.

⁶⁸³ Rahim Latifi, T. 4972 (16 tetor 2006), T. 4976–4978 (17 tetor 2006).

gjithë kohës, pa ndalim, sepse sa herë lëviznin forcat njerëzit frikësoheshin. Edhe unë isha i frikësuar."⁶⁸⁴

249. Ndryshe nga Latifi, Bozhidar Deliqi dhe i Akuzuari Llazareviq dëshmuan se Pirana ishte bazë e UÇK-së dhe se nga ky fshat shpesh hapej zjarr në drejtim të rrugës Prizren-Gjakovë.⁶⁸⁵ Në një hartë të Kosovës me shënimet e Bislim Zyrapit që tregonin se ku kishte qenë e pranishme UÇK-ja dhe drejtimin e sulmit nga "forcat serbe" në fund të marsit 1999, Pirana është në skaj të zonës nën kontrollin e UÇK-së, pak para bombardimeve të NATO-s.⁶⁸⁶ Zyrapit nuk dëshmoi se a kishte qenë UÇK-ja e pranishme në fshat. Gjithsesi ai dëshmoi se Zona Operative 2 e UÇK-së, Zona e Pashtrikut, përfshinte komunat e Suharekës, Rahovecit, dhe Prizrenit.⁶⁸⁷

250. Duke marrë parasysh dëshminë e Zyrapit, provat dokumentare, si dhe mendimin e Dhomës Gjyqësore të paraqitur më lart se Rahim Latifi nuk është i besueshëm sa i përket dëshmisë së tij në lidhje me UÇK-në në Piranë dhe rrethinë, faktikisht Dhoma është bindur se UÇK-ja ka qenë e pranishme afër Piranës, nëse jo brenda në fshat, kur filloi bombardimi i NATO-s më 24 mars 1999.

251. Nuk ka dyshim se në fund të marsit forcat e UJ-së dhe MPB-së ndërmorën një operacion në disa pjesë të komunës së Prizrenit, përfshirë edhe fshatin Piranë dhe në komunat e Rahovecit dhe Suharekës.⁶⁸⁸ Në një urdhër të datës 23 mars nga Deliqi lexohet se UÇK-ja kishte baza në zonën e Retisë, si dhe në Studençan, Samodrezhë, Dobërdolan, dhe Pagarushë. Ndër të tjera urdhri kërkonte që Brigada e 549-të e Motorizuar në bashkëpunim me detashmentin e 37-të të PJP-së nga Nishi, kompaninë e 5-të të PJP-së nga Prizreni, dhe kompaninë e 4-të të PJP-së nga Gjakova, të hiqnin "bllokadën" e rrugës Suharekë-Gjakovë, të shkatërronin UÇK-në në Reti, dhe të vendosnin kontroll mbi territorin e kësaj zone. Aty gjithashtu thuhej se ndër qëllimet e tjera të operacionit ishin

⁶⁸⁴ Rahim Latifi, T. 4974 (16 tetor 2006), T. 4983 (17 tetor 2006).

⁶⁸⁵ Bozhidar Deliq, T. 19373 (29 nëntor 2007); Vlladimir Llazareviq, T. 17860 (7 nëntor 2007); 6D1013 (Raport i MPB-së Prizren, 13 mars 1999), f. 5. *Shih gjithashtu* Vllatko Vuković, 5D1442 (deklarata e dëshmitarit e datës 15 janar 2008), para. 18; P1100 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar MPB-së së Serbisë, 27 mars 1999), f. 4 (ku lexohet se më 25 mars 1999, në fshatin Piranë në drejtim të Optrushës në komunën e Prizrenit ndodhi një sulm "terrorist" dhe se në atë sulm u plagosën pesë pjesëtarë të UJ-së dhe SPB-së).

⁶⁸⁶ P2447 (Harta me shënimet e zonave të mbajtura nga UÇK-ja); P2469 (hartë me shënimet e zonave të ndryshme operative të UÇK-së); IC105 (Harta e zmadhuar me shënimet e Zyrapit).

⁶⁸⁷ Bislim Zyrapit, T. 5934, 5967 (6 nëntor 2006), T. 6258 (10 nëntor 2006); P2469 (hartë me shënimet e zonave të ndryshme operative të UÇK-së); P2459 (Protokoll i UÇK-së 20 shkurt 1999).

⁶⁸⁸ P2015 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 23 mars 1999). Në urdhër, UJ-ja urdhërohej që t'u jepte ndihmë forcave të MPB-së për shkatërrimin e "forcave terroriste shqiptare" (FTSH) në sektorin e Rahovecit, Suharekës, dhe Krushës së Madhe dhe Brigada e 549-të e Motorizuar urdhërohej të bashkëpunonte me MPB-në në një operacion kundër UÇK-së në Optrushë, Celinë, Krushë të Madhe, Krushë të Vogël, Piranë, Studençan, Sllapuzhan, Zojz, Medvec, dhe Peqan. *Shih gjithashtu* P1981 (Urdhër i Brigadës së 549-të të Motorizuar, 23 mars 1999); P1995 (Analizë e operacionit të Brigadës së 549-të të Motorizuar, 30 mars 1999).

shkatërrimi i UÇK-së në Piranë, marrja nën kontroll e Piranës, dhe bllokimi i zonës nga vendi ku lidhet rruga prej Sërbicës së Poshtme me rrugën Prizren-Gjakovë, e cila përfshin edhe Piranën.⁶⁸⁹

252. Bislim Zyrapi dëshmoi se, kur filloi bombardimi i NATO-s më 24 mars 1999, "forcat serbe" ndërmorën një sulm artilerik kundër pozicioneve të UÇK-së në zonat që ajo kontrollonte në atë kohë.⁶⁹⁰ Forcat e UÇK-së filluan tërheqjen nga pozicionet e tyre, së bashku me popullatën vendëse për shkaqe sigurie. Me fillimin e sulmeve të "forcave serbe" më 24 dhe 25 mars, popullata e Randobravës dhe Retisë së Poshtme u tërhoqën në Mamushë.⁶⁹¹ Nga dëshmia e tij del, edhe pse jo krejtësisht qartë, se kjo tërheqje u bë me urdhër të UÇK-së për të mbrojtur shqiptarët kosovarë të atjeshëm që të mos gjendeshin midis dy zjarreve gjatë luftimeve ndërmjet forcave të RFJ-së/Serbisë dhe UÇK-së. Sidoqoftë ai nuk dëshmoi se nëse edhe popullata e Piranës "u tërhoq" me UÇK-në

253. Një raport i datës 30 mars 1999 i Deliqt dërguar komandantit të Korpusit të Prishtinës evidenton se operacioni i përshkruar më lart u krye në datat 25-29 mars dhe qëllimet e tij u arritën, ku forcat e UÇK-së ishin "thyer" dhe ishte marrë nën kontroll të plotë territori nga rruga Prizren/Xërxë deri te rruga Suharekë-Rahovec. Gjithashtu, më 26 mars një pjesë e forcave të UÇK-së tentuan të çanin "rrethimin" e UJ-së dhe MPB-së në Piranë dhe një grup i pjesëtarëve të UÇK-së hapën zjarr nga fshati Landovicë. Raporti vëren se në operacion morën pjesë grupe të ndryshme luftarake të Brigadës së 549-të të Motorizuar, si dhe njësi të PJP-së me 1,020 pjesëtarë. Më 28 mars, u krye një "operacion spastrimi" në zonën përreth Retisë së Poshtme; dhe më 29 mars, territori ishte marrë tërësisht nën kontroll.⁶⁹² Koordinimi me forcat e MPB-së funksionoi mirë dhe forcat u komanduan nga "komanda e përbashkët" e MPB-së dhe UJ-së.⁶⁹³

254. Deliqt dëshmoi se më 25 mars 1999 detyra e brigadës së tij në koordinim me forcat e MPB-së, ishte bllokimi i "forcave terroriste" të Zonës Operative të Pashtrikut të UÇK-së. Bllokada shkonte përgjatë rrugës prej Piranës deri në Rogovë dhe, në anën tjetër, në jug të Piranës në drejtim të Sërbicës së Epërme dhe Sërbicës së Poshtme. Duhej të rrethoheshin "forcat terroriste" në zonën e Retisë, ku ishte edhe komanda e Brigadës së 124-t.⁶⁹⁴ Deliqt dëshmoi se "terroristët" i kishin mbrojtur me vendosmëri Retinë e Poshtme dhe të Epërme, Randobravën, Studençanin, dhe rrugën

⁶⁸⁹ P1981 (Urdhër i Brigadës së 549-të të Motorizuar, 23 mars 1999), f. 4–5.

⁶⁹⁰ Bislim Zyrapi, T. 5991 (7 nëntor 2006).

⁶⁹¹ Bislim Zyrapi, T. 5992 (7 nëntor 2006).

⁶⁹² P1995 (Analizë e operacionit të Brigadës së 549-të të Motorizuar, 30 mars 1999). *Shih gjithashtu* Bozhidar Deliq, T. 19349 (29 nëntor 2007).

⁶⁹³ P1995 (Analizë e operacionit të Brigadës së 549-të të Motorizuar, 30 mars 1999), f. 3, 5.

⁶⁹⁴ Bozhidar Deliq, T. 19347, 19358 (29 nëntor 2007); IC150 (Hartë e shënuar nga Bozhidar Deliq).

nëpër të cilën u tërhoqën së bashku me popullatën civile, përmes Dobërdolanit në drejtim të Pagarushës.⁶⁹⁵

255. Prokuroria paraqiti dëshminë e Rahim Latifit në lidhje me ngjarjet në Piranë më 25 mars 1999, largimin e tij nga fshati, dhe në fund udhëtimin e tij për në Shqipëri.⁶⁹⁶ Dëshmia e Latifit u konfirmua pjesërisht nga dëshmia me shkrim e Halil Morinës, tashmë i vdekur, nga Landovica, deklarata dhe dëshmia me gojë e të cilit në gjykimin e *Milloshëviqit* u pranuan si dëshmi në pajtim me Rregullin 92 *quater*.⁶⁹⁷

256. Sipas Latifit, herët në mëngjesin e 25 marsit 1999 Pirana u rrethua nga forcat e policisë dhe ushtrisë serbe. Ushtria granatoi nga drejtimi i Landovicës, por nuk shkaktoi dëme apo viktima.⁶⁹⁸ Më pas, forcat policore të veshura me uniforma kamuflimi bardheblu, hynë në fshat dhe filluan t'u vinin flakën shtëpive, e disa prej të cilëve përdorën një lloj 'arme dytytëshe' për këtë qëllim.⁶⁹⁹ Halil Morina konfirmoi se më 25 mars 1999, rreth orës 09:00 nga një kodër ku jetonte në Landovicë, ai pa shtëpitë duke u djegur në Piranë.⁷⁰⁰ Pavarësisht nga argumenti i parashtruar nga Mbrojtja e Llukiqit se përshkrimi i uniformave të policisë prej Latifit nuk përkonte me uniformat e policisë së rregullt,⁷⁰¹ Dhoma Gjyqësore konkludon se nuk ka arsye për të dyshuar në dëshminë e Latifit se forcat e përfshira në djegien e shtëpive ishin pjesëtarë të policisë. Në lidhje me këtë, aspekt, Dhoma thekson veçanërisht provat në lidhje me uniformat e ndryshme të policisë të përdorura nga njësi të ndryshme të MPB-së gjatë periudhës së mbuluar në Aktakuzë, të shqyrtuara në Nënpjesën VI.A.3 më lart, dhe se uniformat e kaltra të kamuflimit përdorëshin rregullisht nga policia.

257. Kur u ballafaqua me dëshminë e Latifit, Deliqi dëshmoi se Grupi Luftarak 1 i Brigadës së 549-të të Motorizuar hyri në Piranë më 25 mars 1999 dhe se duhej të shkonte në drejtim të fshatrave Medvec dhe Zojz. Sidoqoftë, ai theksoi se Latifi e kishte gabim kur thoshte se fshati u rrethua nga forcat e UJ-së sepse ata lëviznin në drejtimin jugperëndim/verilindje në drejtim të Zojzit dhe

⁶⁹⁵ Bozhidar Deliq, T. 19669 (6 dhjetor 2007).

⁶⁹⁶ Rahim Latifi T. 4956–4975 (16 tetor 2006); T. 4976–5011 (17 tetor 2006), P2381 (deklarata e dëshmitarit e datës 28 prill 1999), P2382 (transkript nga *Prokurori kundër Milloshëviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 3631–3657.

⁶⁹⁷ Halil Morina, P2522 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 tetor 2001), P2523 (transkript nga *Prokurori kundër Milloshëviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T) T. 870–957.

⁶⁹⁸ Rahim Latifi, T. 4962 (16 tetor 2006), P2381 (deklarata e dëshmitarit e datës 28 prill 1999), f. 2.

⁶⁹⁹ Rahim Latifi, T. 4960–4963 (16 tetor 2006); P2381 (deklarata e dëshmitarit e datës 28 prill 1999), f. 2; P2382 (transkript nga *Prokurori kundër Milloshëviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 3644–3646. Në lidhje me këtë, Dhoma tërheq vëmendjen te provat për përdorimin e të ashtuquajturve flakëhedhës, *Shih për shembull* Agim Jemini, P2338 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 korrik 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 10; Hamide Fondaj, T. 3838–3839 (25 shtator 2006), P2283 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 qershor 2001), f. 4; Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 3.

⁷⁰⁰ Halil Morina, P2523 (transkript nga *Prokurori kundër Milloshëviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 873, 908.

Medvecit dhe në drejtim të Randobravës.⁷⁰² Sipas Deliqit, nga shtëpitë në skajin verior të fshatit u hap zjarr kundër njësisë (Grupi Luftarak 1).⁷⁰³ Gjatë ditës, njësia arriti deri të vreshtat mbi fshat, por, meqenëse kundër tyre u hap zjarr nga Randobrava dhe Medveci, ata e kaluan natën e 25-26 marsit aty. Qëndresa dhe zjarri i UÇK-së ishin më pak në drejtim të fshatit Brestoc në komunën e Rahovecit.⁷⁰⁴ Deliqi dëshmoi se, natën e 25 marsit ai kaloi personalisht nëpër Krushë të Madhe dhe Nagafc, si dhe në Celinë në komunën e Rahovecit dhe se ndodhej ende në atë zonë kur u informua se ishte bombarduar kazerma e Prizrenit.⁷⁰⁵

258. Latifi gjithashtu dëshmoi se më 25 mars u largua nga Pirana së bashku me banorët e tjerë sepse "rreziku po afrohej." Disa nga ata shkuan në drejtim të Mamushës, kurse ai dhe të tjerët shkuan në drejtim të Sërbicës. Prej andej ai mundi të shihte se policia vazhdonte t'u vinte zjarrin shtëpive.⁷⁰⁶ Latifi gjithashtu tha se, duke ikur në drejtim të Sërbicës me grupin e tij, i kishin fishkëlyer plumbat pranë kokës dhe një burrë që ishte me ta ishte vrarë dhe një tjetër ishte plagosur.⁷⁰⁷

259. Bazuar në të gjitha provat, Dhoma Gjyqësore konkludon se më 25-29 mars 1999, në komunën e Prizrenit në një zonë ku përfshihej edhe fshati Piranë, u ndërmor një aksion në të cilin morën pjesë forcat e UJ-së dhe MPB-së. Dhoma gjithashtu konkludon se, bazuar në dëshminë e Latifit si dëshmitar okular e cila pjesërisht është konfirmuar nga Morina, Pirana u granatua nga ushtria dhe se më pas në fshat hynë forcat e policisë të cilat u vunë zjarrin shtëpive. Si pasojë popullata shqiptare kosovare iku dhe u strehua në fshatrat e afërta. Gjatë largimit nga fshati u vranë ose u plagosën disa banorë të fshatit. Me gjithë argumentin e Mbrojtjes së Llukiqit se prania e UÇK-së në Piranë ishte "arsye e mundshme për largimin e njerëzve nga shtëpitë e tyre,"⁷⁰⁸ ose se prania e tyre ishte arsye e sulmit të forcave të RFJ-së/Serbisë kundër fshatit,⁷⁰⁹ kjo nuk e ndryshon faktin se, si rezultat i veprimeve të përbashkëta të UJ-së dhe MPB-së duke e granatuar fillimisht fshatin dhe pastaj duke i përzënë banorët nëpërmjet djegies së shtëpive të tyre, civilët shqiptarë

⁷⁰¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 859.

⁷⁰² Bozhidar Deliq, T. 19372–19373 (29 nëntor 2007). *Por shih* K54, P2883 (deklarata e dëshmitarit e datës 25–26 prill 2002), f. 4.

⁷⁰³ Bozhidar Delliq, T. 19372–19373 (29 nëntor 2007); IC151 (Hartë e shënuar nga Delliqi). *Shih gjithashtu* K54, P2883 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 prill 2002), f. 5.

⁷⁰⁴ Bozhidar Deliq, T. 19374–19375 (29 nëntor 2007).

⁷⁰⁵ Bozhidar Deliq, T. 19375–19376 (29 nëntor 2007).

⁷⁰⁶ Rahim Latifi, T. 4963 (16 tetor 2006); P2381 (deklarata e dëshmitarit e datës 28 prill 1999), f. 2–3.

⁷⁰⁷ Rahim Latifi, T. 4964 (16 tetor 2006); P2381 (deklarata e dëshmitarit e datës 28 prill 1999), f. 3.

⁷⁰⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 163.

⁷⁰⁹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 856–857. *Shih gjithashtu* Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 409.

kosovarë u detyruan të largoheshin nga Pirana nga frika për jetët e tyre si rezultat i veprimeve të forcave të RFJ-së/Serbisë e jo për shkak të UÇK-së.

4. Landovica

260. Prova e vetme e paraqitur nga Prokuroria në lidhje me akuzat në rastin e fshatit Landovicë ishte dëshmia me shkrim e Halil Morinës, banor shqiptar kosovar i këtij fshati në atë kohë.⁷¹⁰ Sidoqoftë, vdekja e tij e mëvonshme para këtij procesi bën që dëshmia e tij për ngjarjet në Landovicë gjatë sulmit të 26 marsit të mos jetë bazë për të nxjerrjen e konkluzioneve përveç nëse konfirmohet nga prova të tjera. Kjo dëshmi paraqitet vetëm në lidhje me rastin e dëmtimit të xhamisë në atë vend. Rrjedhimisht këtu nuk janë dhënë hollësitë e dëshmisë së Morinës, me përjashtim të të dhënave që kanë lidhje me çështjen në fjalë.

261. Morina deklaroi se me 26 mars 1999, rreth orës 10:00, UÇK-ja vrau tre ushtarë të UJ-së në Landovicë.⁷¹¹ Rreth orës 11:00, "forca të përziera serbe," duke përfshirë UJ-në, policinë, dhe paraushtarakët, arritën në rrugën e asfaltuar jashtë fshatit të shoqëruar me dy tanke, autobllinda, Praga, dhe topa. Ata filluar t'i digjinim shtëpitë në skaj të fshatit. Ata nuk tentuan të hynin menjëherë në fshat, por filluan të granatonin. Pas granatimit, i cili zgjati deri në orën 15:00, "forcat e përziera serbe" hynë në fshat dhe vazhduan t'u vinin zjarrin shtëpive dhe të vrisnin njerëz.⁷¹² Nga vendi ku ishte fshehur aty afër, Morina pa xhaminë duke u djegur.⁷¹³

262. Të nesërmen Morina pa 20-30 ushtarë të UJ-së që erdhën përsëri në Landovicë. Një grup i këtyre ushtarëve me uniforma ushtarake hynë në xhami duke bartur diçka.⁷¹⁴ Ushtarët qëndruan në xhami tri deri katër minuta.⁷¹⁵ Rreth 10 minuta pasi kishin dalë nga xhamia, u dëgjua një shpërthim i fuqishëm dhe Morina pa kur u shemb minareja e xhamisë. Ai erdhi në përfundim se ushtarët e UJ-

⁷¹⁰ Sipas Morinës, në vitin 1999 Landovica nuk kishte banorë serbë, por vetëm shqiptarë kosovarë dhe disa romë. Halil Morina, P2523 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 870-871.

⁷¹¹ Halil Morina, P2522 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 tetor 2001), f. 2, P2523 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 874-877, 915-918, 920-921.

⁷¹² Halil Morina, P2522 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 tetor 2001), f. 2, P2523 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 877-883.

⁷¹³ Halil Morina, P2522 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 tetor 2001), f. 3.

⁷¹⁴ Halil Morina, P2522 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 tetor 2001), f. 4, P2523 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 896-897.

⁷¹⁵ Halil Morina, P2522 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 tetor 2001), f. 4, P2523 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 896-897.

së e kishin hedhur xhaminë në erë me minë.⁷¹⁶ Morina shpjegoi se minareja u shemb dhe shkatërroi kulmin e xhamisë.⁷¹⁷

263. Megjithëse Morina dëshmon se xhamia e Landovicës u dogj pjesërisht më 26 mars dhe u shkatërrua më 27 mars, Deliqi dëshmoi se njësitë e tij hapën zjarr në drejtim të xhamisë më 26 mars, por shtoi se u shkatërrua vetëm minareja, prej të cilës ishte hapur zjarr në drejtim të ushtrisë. Deliqi shpjegoi se atë ditë në Landovicë, dy ushtarë ishin vrarë dhe një ishte plagosur. Nuk ishte e mundur t'u jepej ndihmë të plagosurve dhe të merreshin kufomat për shkak të të shtënave që vinin nga xhamia.⁷¹⁸

264. Dëmtimi i konsiderueshëm i xhamisë së Landovicës është konfirmuar gjithashtu edhe në dëshminë e ekspertit të Prokurorisë, András Riedlmayer.⁷¹⁹ Riedlmayer-i e pa xhaminë gjatë vizitave të tij në Kosovë nga tetori 1999 deri në mars 2001 dhe e kategorizoi si "e dëmtuar rëndë." Në aktekspertizën e tij gjithashtu shënohet se dëmtimi ishte shkaktuar nga djegia e pjesëshme më 27 mars 1999, si dhe nga minimi dhe granatimi i minaresë.⁷²⁰ Sidoqoftë, duket se të dhënat e tij mbi mënyrën dhe kohën e dëmtimit të xhamisë kanë ardhur nga pjesëtarë të "bashkësisë myslimane" të atjeshme. Dhoma vëren se atij madje nuk iu kërkua as mendim nëse dëmtimi i konstatuar prej tij përputhej me këto dëshmi.

265. Dhoma mendon se thashethemet anonime të pjesëtarëve të "bashkësisë myslimane" nuk përbëjnë bazë të mjaftueshme për konfirmimin e dëshmisë së Morinës në lidhje me rrethanat e shkaktimit të dëmtimit. Rrjedhimisht, Dhoma konkludon se nuk janë vërtetuar pretendimet në lidhje me shkatërrimin e xhamisë në Landovicë.

5. Sërbica, Retia e Poshtme, Retia, dhe Randobrava

266. Latifi, i cili kishte ikur në Sërbicë nga Pirana me shqiptarë kosovarë të tjerë, dëshmoi se më 26 mars 1999 një grup policësh erdhën në Sërbicë dhe shtinë kundër traktorëve të tyre. Askush nuk u plagos.⁷²¹ Ai qëndroi një muaj në Sërbicë, dhe gjatë kësaj kohe policia erdhi shpesh, por nuk dëmtoi apo kërcënoi askënd. Pas tri javësh, Latifi dëgjoi nga të tjerët se kishte ardhur shefi i policisë së Prizrenit dhe i kishte urdhëruar të gjithë ata që nuk ishin nga Sërbica të largoheshin për në

⁷¹⁶ Halil Morina, P2522 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 tetor 2001), f. 4, P2523 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 897.

⁷¹⁷ P2523 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 928.

⁷¹⁸ Bozhidar Deliq, T. 19391 (29 nëntor 2007). *Shih gjithashtu* Millosh Vojnoviq, T. 24198 (12 mars 2008); P2574 (Ditari i Luftës i batalionit të blinduar të Brigadës së 549-të të Motorizuar), f. 1.

⁷¹⁹ András Riedlmayer, T. 5488-5489 (30 tetor 2006); P1803 (Fotografi e rrënojës së xhamisë së Landovicës).

⁷²⁰ P1777 (Pjesë nga P1789).

Shqipëri. Serbët vendas organizuan autobusë për t'i transportuar, por Latifi dhe familja e tij qëndruan në Sërbicë edhe 10 ditë të tjera sepse nuk kishte pasur vend në autobusë.⁷²² Dëshmia e Halil Morinës e konfirmon dëshminë e Latifit për ngjarjet në Sërbicë. Edhe pse ka ndryshime në datat e përmendura nga ai dhe nga Latifi, duke marrë parasysh kalimin e kohës që nga ato ngjarje, këto mospërputhje nuk i dëmtojnë qenësisht dëshmitë e këtyre dy dëshmitarëve. Morina deklaroi se, kur arriti në Sërbicë më 30 mars 1999 pasi kishte ikur nga Landovica nga frika, ai gjeti atje 800 njerëz nga Pirana. Ata ishin "dëbuar" më 25 mars.⁷²³ Më tej ai pohoi se më 8 prill në fshat erdhën "forca të përziera serbe," ushtarake dhe paraushtarake, dhe u thanë serbëve vendas se ishin tradhtarë pse kishin lejuar shqiptarët kosovarë të shpërngulur të strehoheshin në fshatin e tyre dhe se kishin 24 orë që t'i dëbonin këta njerëz.⁷²⁴ Më 9 prill, serbët vendas organizuan autobusë që t'i transportonin për në Zhur ata që nuk ishin banorë të Sërbicës. Serbët vendas ishin shoferë të këtyre autobusëve dhe u shoqëruan deri në Zhur nga policia. Nga Zhuri, atyre iu desh të ecnin gjashtë kilometra deri në kufi.⁷²⁵ Në kufi, policia kufitare i mori Morinës dokumentet e identifikimit dhe i hodhi në një grumbull.⁷²⁶

267. Edhe Latifi dëshmoi se më 25 prill 1999 "serbët" ndërmorën një ofensivë të madhe në zonën e Sërbicës, gjatë së cilës u granatuan fshatrat Piranë, Reti e Poshtme, Reti, dhe Randobravë. Të nesërmen, ai dhe familja e tij morën një autobus për 2.000 marka dhe serbët vendas i shoqëruan deri në Zhur. Më pas ata vazhduan për në kalimin kufitar në Vërbnicë (Morinë),⁷²⁷ ku ua konfiskuan dokumentet e identifikimit, përveç patentës së shoferit të Latifit, të cilën mundi t'a fshihte para se të kalonin në Shqipëri.⁷²⁸

268. Duke u bazuar në dëshmitë e Latifit dhe Morinës, Dhoma Gjyqësore konkludon se në prill 1999 "trupa të përziera serbe" i urdhëruan shqiptarët kosovarë të shpërngulur që ishin strehuar në

⁷²¹ Rrahim Latifi, T. 4992 (17 tetor 2006); P2381 (deklarata e dëshmitarit e datës 28 prill 1999), f. 3.

⁷²² Rrahim Latifi, T. 4964 (16 tetor 2006); T. 4993 (17 tetor 2006); P2381 (deklarata e dëshmitarit e datës 28 prill 1999), f. 3.

⁷²³ Halil Morina, P2523 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 901, 954, P2522 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 tetor 2001), f. 4.

⁷²⁴ Halil Morina, P2523 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 905, P2522 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 tetor 2001), f. 4.

⁷²⁵ Halil Morina, P2522 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 tetor 2001), f. 5, P2523 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 903-905. *Shih gjithashtu* Nebojsa Ognjenoviq, T. 22859 (20 shkurt 2008).

⁷²⁶ Halil Morina, P2522 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 tetor 2001), f. 5, P2523 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 905-906

⁷²⁷ Lizane Malaj dëshmoi se e kishte kaluar kufirin në Vërbnicë më 28 prill 1999 dhe se serbët e quajnë kalimin Vrbnica kurse shqiptarët Qafa e Morinës. Lizane Malaj, T. 1384, 1391 (10 gusht 2006). Sipas P615 (Atlasi i Kosovës), f. 14, kalimi kufitar quhet Vërmicë në anën serbe dhe Morinë në anën shqiptare.

⁷²⁸ Rrahim Latifi, P2381 (deklarata e dëshmitarit e datës 28 prill 1999), f. 3, P2382 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 3648-3649.

Sërbicë, të largoheshin për në Shqipëri. Pas kësaj, UJ-ja granatoi fshatrat në rrethinën e Sërbicës; Retinë e Poshtme, Retinë, dhe Randobravën. Shqiptarët kosovarë të strehuar në Sërbicë udhëtuan me autobusë të shoqëruar nga serbë vendas dhe nga policia deri në Zhur e më tej vazhduan deri në kufi me Shqipërinë. Në kufi, policia u mori shumë shqiptarëve kosovarë dokumentet personale, si p.sh të identifikimit. Sidoqoftë, nuk janë provuar akuzat e Aktakuzës në lidhje me shpërnguljen e dhunshme të shqiptarëve kosovarë nga Retia e Poshtme, Retia, dhe Randobrava.

6. Qyteti i Prizrenit (Dushanova)

269. Provat e paraqitura në mbështetje të akuzave përkitazi me Prizrenin kanë të bëjnë kryesisht me Dushanovën, të cilën dëshmitarët e përshkruan si lagje të qytetit.⁷²⁹ Rexhep Krasniqi dhe Hysni Kryeziu dhanë dëshmi okulare në lidhje me ngjarjet në Dushanovë, ku banonin që të dy në mars 1999.

270. Krasniqi, shqiptar kosovar i cili ishte punëtor fabrike, dëshmoi se para bombardimit të NATO-s, nuk kishte pasur tensione në Dushanovë.⁷³⁰ Me sa dinte ai, UÇK-ja nuk vepronte në atë zonë. Më 23 mars 1999, në fabrikën në të cilën punonte ai u vendosën 50 tanke të gjelbra si dhe topa të kalibrit 105 milimetra.⁷³¹ Në të njëjtën ditë, kolegët serbë i thanë Krasniqit se ushtarët u kishin thënë se nëse NATO-ja do të fillonte bombardimin, do t'i vrisnin të gjithë.⁷³² Në një raport të MPB-së të datës 28 janar 1999 thuhet se në atë kohë po bëheshin përpjekje për të krijuar një bazë të fuqishme "terroriste" në zonën e Dushanovës dhe se në Rahovec po dërgoheshin terroristë të rinj për stërvitje të cilët më pas u kthyen në Dushanovë me armë.⁷³³ Dhoma nuk ka dëgjuar dëshmi të tjera në mbështetje të këtij raporti.

271. Gjatë fazës së pyetjeve nga Mbrojtja, Krasniqi u pajtua me sugjerimin se kazerma e UJ-së në Prizren u bombardua nga NATO-ja më 24 mars 1999 dhe se më 27 dhe 28 mars u kryen bombardime të tjera jo fort larg nga godina e Kuvendit Komunal në Prizren, edhe pse duket se ai nuk ishte dëshmitar okular i këtyre bombardimeve, por dëgjoji vetëm shpërthimet.⁷³⁴ Kryeziu, shqiptar kosovar nga Dushanova i cili kishte punuar si berber dhe shofer, gjithashtu dëshmoi se

⁷²⁹ Rexhep Krasniqi, T. 4922 (16 tetor 2006); Bozhidar Delliq, T. 19387 (29 nëntor 2007); Hysni Kryeziu, T. 7543 (29 nëntor 2006); P2514 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 maj 1999 dhe korrigjimi i datës 19 shtator 2004), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8.

⁷³⁰ Rexhep Krasniqi, P2378 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 13.

⁷³¹ Rexhep Krasniqi, T. 4923, 4938 (16 tetor 2006), T. 4925 (16 tetor 2006); P2378 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 13.

⁷³² Rexhep Krasniqi, T. 4941-4943, 4953 (16 tetor 2006); P2378 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 13.

⁷³³ 6D1017 (Raport i MPB-së së Prizrenit, 28 janar 1999), f. 7.

⁷³⁴ Rexhep Krasniqi, T. 4937, 4949 (16 tetor 2006).

"kazerma serbe" u godit nga NATO-ja në orën 20:00, më 24 mars 1999.⁷³⁵ Deliqi dëshmoi se më 25 mars 1999 ai u informua se ishte bombarduar kazerma e UJ-së në Prizren.⁷³⁶ Gjithashtu, në një raport të Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme të Serbisë, i cili i përmbledh ngjarjet e evidentuara 27-28 mars 1999, shkruhet se më 26 Mars 1999 NATO-ja kishte sulmuar qendrën e komunikimit të UJ-së në terrenin e kazermës Car Dušan Silni në Prizren.⁷³⁷

272. K54-a, i cili në fillim të vitit 1999 ishte pjesëtar i Brigadës së 549-të të Motorizuar në Kosovë, gjithashtu konfirmoi se kazerma ushtarake në Prizren ishte goditur dhe shkatërruar menjëherë pas fillimit të bombardimeve të NATO-s. Si pasojë, ai dhe ushtarët e tjerë të njësisë së tij u shpërngulën në një "lokalitet" të afërt prej të cilit ata dëbuan banorët vendas dhe u vendosën në shtëpitë e tyre.⁷³⁸

273. Krasniqi përshkroi ngjarjet në Dushanovë më 28 mars 1999, kur pjesëtarët e policisë të veshur me uniforma të zeza luftarake dhe uniforma të kaltra kamuflimi, disa prej të cilëve kishin maska, erdhën në shtëpinë e tij dhe të vëllait.⁷³⁹ Në atë kohë, rreth 60 të shpërngulur nga Mamusha (afër Piranës) ishin strehuar nëpër shtëpi në Dushanovë. Policët erdhën në orën 16:30 ose 17:00.⁷⁴⁰ Ata kishin tanke të gjelbra me topa të kalibrit 105 milimetra mbi ta dhe armë kundërajrore, autoblanda të policisë, dhe xhipa të policisë me targa të Prizrenit.⁷⁴¹ Gjithashtu, në lagje kishte edhe forca të UJ-së, dhe të gjitha rrugët ishin të bllokuara nga ta dhe nga policia. Krasniqi dëshmoi se policët e thyen derën e hyrjes së shtëpisë së tij dhe hynë brenda duke thënë, "Shkoni në Shqipëri. Nuk ka vend për ju këtu."⁷⁴² Një polic e goditi Krasniqin disa herë në shpinë me kondak pushke dhe e kërcënoi se do të vritej nëse fliste. Policët gjithashtu rrahën gruan dhe familjarët e tjerë të tij dhe ua morën paratë dhe stollitë. Djalit të tij policët i morën letërnjoftimin.⁷⁴³ Sipas Krasniqit, policët u thanë se do t'i përzinin prej Kosovës ose do t'i "masakronin." Ata shtinin me armë në ajër

⁷³⁵ Hysni Kryeziu, T. 7555 (30 nëntor 2006); *Shih gjithashtu* Rrahim Latifi, T. 4986 (17 tetor 2006).

⁷³⁶ Bozhidar Delliq, T. 19376–19377 (29 nëntor 2007).

⁷³⁷ P1100 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar MPB-së së Serbisë, 27 mars 1999), f. 2.

⁷³⁸ K54, T. 10513–10514 (26 shkurt 2007), P2677 (transkriptim nga *Prokurorja kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT–02–54–T), T. 8245 (e mbyllur me vulë).

⁷³⁹ Rexhep Krasniqi, T. 4949 (16 tetor 2006), P2378 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 prill 1999), versioni elektronik f. 13.

⁷⁴⁰ Rexhep Krasniqi, T. 4949 (16 tetor 2006), P2378 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 prill 1999), versioni elektronik f. 13.

⁷⁴¹ Rexhep Krasniqi, T. 4923–4925 (16 tetor 2006), P2378 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 prill 1999), versioni elektronik f. 13.

⁷⁴² Rexhep Krasniqi, T. 4950, P2378 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 mars 1999), versioni elektronik f. 13. Ai tha se kjo ishte thënë nga policë me "maska të skiatorëve."

⁷⁴³ Rexhep Krasniqi, T. 4928–4930 (16 tetor 2006), P2378 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 mars 1999), versioni elektronik f. 13.

tërë kohën.⁷⁴⁴ Banorët serbë ishin larguar një natë më parë. Me gjithë argumentin e Mbrojtjes së Llukiqit se përshkrimi i uniformave prej Krasniqit nuk përkonte me uniformat e policisë së rregullt,⁷⁴⁵ Dhoma Gjyqësore konkludon se nuk ka arsye të dyshohet dëshmia e tij se forcat policore i detyruan atë dhe familjen e tij të largoheshin dhe i keqtrajtuuan. Në lidhje me këtë pikë, Dhoma veçanërisht thekson se oficerët e MPB-së kishin uniforma kamuflimi të kaltra gjatë periudhës së përfshirë në aktakuzë, shqyrtuar në Nënpjesën VI.A.3 më lart.

274. Krasniqi dëshmoi se e njëjta gjë ndodhi thuajse në çdo shtëpi në lagje. Si pasojë nga Dushanova u dëbuan rreth 4.000-5.000 njerëz dhe u formua një kolonë e cila u nis në drejtim të kufirit, disa me makina dhe të tjerët në këmbë. Në dalje të Dushanovës, Krasniqi pa disa djem të rinj duke kërcyer nga traktorët për t'i ikur policisë, të cilët shtinë drejt tyre me armë automatike. Ai pa tre persona duke u rrëzuar. Ai gjithashtu pa njerëz me uniforma kamuflimi dhe të zeza, të gjithë së bashku, duke u vënë zjarrin shtëpive të shqiptarëve kosovarë në prani të ushtrisë, e cila nuk bëri asgjë për t'i ndaluar.⁷⁴⁶

275. Krasniqi dëshmoi se kishte ecur gjashtë orë deri në kufirin me Shqipërinë, duke kaluar nëpër postblloqe të kontrolluara nga forca policore dhe ushtarake, dhe se kishte parë automjete të policisë duke shkuar poshtë e lart pranë kolonës gjatë tërë kohës. Ai kaloi nëpër fshatin Dobrushtë, pjesa më e madhe e të cilit ishte në flakë e pastaj nëpër Zhur dhe së fundi në kalimin kufitar në Vërbnicë (Morinë). Te kalimi kufitar ai njohu disa nga policët vendas nga Dushanova, duke përfshirë edhe komandantin e policisë kufitare. Këta policë nuk i keqtrajtuuan, por ndërsa njerëzit kalonin kufirin, atyre iu morën dokumentet e identifikimit. Meqenëse Krasniqi dhe familja e tij nuk kishin pasur kohë t'i marrin dokumentet e tyre para se të largoheshin, dokumentet e tyre nuk u morën.⁷⁴⁷

276. Hysni Kryeziu konfirmoi se popullata shqiptare kosovare e Dushanovës u dëbua më 28 mars 1999 pas ardhjes në orën 17:00 së një numri të madh "forcash ushtarake dhe policore" me tanke dhe autobllinda, të cilët filluan të qëllonin në ajër dhe drejt shtëpive.⁷⁴⁸ Këto forca thanë me zë të lartë gjëra si, "Kosova është e Serbisë, ju e keni vendin në Shqipëri."⁷⁴⁹ Kryeziu mohoi se UÇK-ja kishte qenë e pranishme në Dushanovë në atë kohë ose në çfarëdo kohe tjetër dhe tha se nuk kishte pasur

⁷⁴⁴ Rexhep Krasniqi, T. 4929, 4954 (16 tetor 2006), P2378 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 mars 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 13.

⁷⁴⁵ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 111 dhe 864.

⁷⁴⁶ Rexhep Krasniqi, T. 4930 (16 tetor 2006); P2378 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 mars 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 14.

⁷⁴⁷ Rexhep Krasniqi, P2378 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 mars 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 14.

⁷⁴⁸ Hysni Kryeziu, T. 7547 (29 nëntor 2006); P2514 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 maj 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 9; P1325 (Fotografi të automjeteve ushtarake).

⁷⁴⁹ Hysni Kryeziu, P2514 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 maj 1999 dhe korrigjimi i datës 19 shtator 2004), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 9.

sulme të UÇK-së kundër forcave të RFJ-së/Serbisë në atë zonë.⁷⁵⁰ Ai gjithashtu përshkroi largimin e të gjithë lagjes nga shtëpitë e tyre dhe nisjen në një kolonë, të cilës iu bashkua edhe ai. Rreth 500 metra nga shtëpia e tij, Kryeziu u ndalua nga policia, me të cilët ishte edhe një komandant policie vendas, të cilin e njohu edhe pse ai kishte pasur çorape najloni në kokë. Policët kërcënuan atë dhe familjen e tij. "Ushtarë" me "kapela çetnikësh" të zeza dhe me kokarda në to i thanë që ta linte makinën dhe e kërcënuan me thikë.⁷⁵¹ Ata ua morën makinën, stolitë, paratë, dhe dokumentet e tyre të identifikimit, të cilat ua grisën ose hodhën.⁷⁵² Kur gruaja e Kryeziut tentoi të merrte diçka nga bagazhi i makinës, ajo u godit me kondak pushke dhe humbi vetëdijen.⁷⁵³ Kryeziu tregoi se kishte parë policë dhe ushtarë të maskuar duke rrahur dy burra të cilët i njihte dhe duke u vënë zjarrin shtëpisë së tyre. Ai gjithashtu pa ushtarë me emblema të grupit paraushtarak Shqiponjat e Bardha në pjesën e epërme të mëngës së majtë të uniformave të tyre.⁷⁵⁴ Dhoma Gjyqësore nuk gjen arsye për të vënë në dyshim faktin se Kryeziu ishte në gjendje të identifikonte personalisht disa nga keqbërësit si pjesëtarë të policisë, sidomos pasi njërin prej tyre e njihte personalisht. Këto forca policore vepronin në bashkëpunim me forcat të tjera të armatosura, jo të rregullta dhe me uniforma.

277. Sipas Kryeziut, atij dhe të dëbuarve të tjerë iu desh të ecnin deri në kufi dhe gjatë rrugës u keqtrajtuat. Ai pa "ushtarë" duke u marrë grave stolitë dhe kur morën një foshnjë nga nënta e tij dhe e hodhën përtokë.⁷⁵⁵ Te kalimi kufitar, ai pa policë duke kërkuar para dhe duke marrë makinat, dokumentet dhe targat nga shqiptarët kosovarë që po largoheshin.⁷⁵⁶

278. Deliqi, Tomisllav Mitiqi, komandant i Degës Ushtarake në Prizren, oficeri i UJ-së Franjo Gllonçaku, dhe shefi i SPB-së së Prizrenit Millosh Vojnoviq deklaruan se Prizreni ishte plot me njerëz gjatë bombardimeve të NATO-s, duke përfshirë civilë, policë, ushtarë të UJ-së, dhe anëtarë të njësive të mbrojtjes Civile.⁷⁵⁷ Sidoqoftë asnjë nga këta dëshmitarë nuk u pyet e as nuk përmendi praninë e UÇK-së në qytet apo në lagjen e Dushanovës. Në fakt Deliqi mohoi se tanket e tij mund

⁷⁵⁰ Hysni Kryeziu, T. 7555–7556 (30 nëntor 2006); P2514 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 maj 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 9.

⁷⁵¹ Hysni Kryeziu, T. 7544 (29 nëntor 2006); P2514 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 maj 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 9.

⁷⁵² Hysni Kryeziu, T. 7544 (29 nëntor 2006); P2514 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 maj 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 9.

⁷⁵³ Hysni Kryeziu, T. 7567 (30 nëntor 2006).

⁷⁵⁴ Hysni Kryeziu, T. 7549 (29 nëntor 2006), P2514 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 maj 1999), dokumentacioni gjyqësor f. 9.

⁷⁵⁵ Hysni Kryeziu, T. 7570 (30 nëntor 2006), P2514 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 maj 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 9.

⁷⁵⁶ Hysni Kryeziu, P2514 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 maj 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 10.

⁷⁵⁷ Bozhidar Deliq, T. 19395 (4 dhjetor 2007); Franjo Gllonçak, T. 21117 (25 janar 2008), 5D1395 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 dhjetor 2007), para. 9; Millosh Vojnoviq, T. 24181 (12 mars 2008); Tomisllav Mitiq, 5D1390 (deklarata e dëshmitarit e datës 27 dhjetor 2007), f. 10. *Shih gjithashtu* 5D1242 (Videofilmime).

të kenë qenë dislokuar në Dushanovë në fund të marsit 1999.⁷⁵⁸ Kur u ballafaqua me dëshminë e Rexhep Krasniqit, Deliqi gjithashtu mohoi se 50 tanke dhe armë artilerike të kalibrit 105 milimetra ishin fshehur në fabrikën në të cilën punonte Krasniqi. Ai shpjegoi se ai kishte pasur gjithsej 31 tanke luftimi dhe asnjë nga ata nuk ishte në fabrikë dhe se njësia e tij nuk kishte pasur asnjëherë obusë të kalibrit 105 milimetra të përmendur nga Krasniqi.⁷⁵⁹ Edhe Franjo Gllonçaku, ushtar i Brigadës së 175-të të Këmbësorisë të UJ-së nga 25 marsi deri më 4 ose 5 prill 1999 dhe më pas i Brigadës së 549-të të Motorizuar,⁷⁶⁰ dëshmoi se në afërsi të Dushanovës nuk kishte njësi të artilerisë ose armë artilerike.⁷⁶¹ Mirëpo në ditarin e luftës të Batalionit të Artilerisë së Lehtë Kundërajrore Raketore thuhet se më 7 prill 1999, Batalioni i 3-të i Motorizuar zuri pozicion në Dushanovë, 700 metra në perëndim të fermës *Ekonomia* dhe bëri përgatitjet për luftë kundërajrore.⁷⁶²

279. Përkundrejt këtyre mohimeve të pranisë së tankeve dhe armëve të rënda në Dushanovë, në një raport të MPB-së për periudhën 30 prill - 5 maj 1999, lexohet se pozicionet e UJ-ës në Dushanovë ishin objektiv i përhershëm i aeroplanëve të NATO-s. Në raport gjithashtu thuhet se sulmet ajrore shkaktuan dëme të mëdha materiale, duke përfshirë shkatërrimin e armëve të UJ-së të vendosura në fshat, shkatërrimin e më shumë se 40 shtëpive dhe një numër biznesesh private.⁷⁶³ Pasi u ballafaqua me këtë dokument, Gllonçaku pranoi se gjatë sulmeve ajrore gjatë atyre ditëve u shkatërruan disa armë të Batalionit të Artilerisë së Lehtë Kundërajrore Raketore të Brigadës së 549-të të Motorizuar.⁷⁶⁴ Në dritën e këtyre provave dokumentare dhe rrëfimeve të dëshmitarëve okularë Krasniqi dhe Kryeziu, Dhoma Gjyqësore konkludon se, pas bombardimit të kazermës së UJ-së në Prizren, banorët shqiptarë kosovarë të Dushanovës u dëbuan nga shtëpitë e tyre nga forcat e policisë dhe të UJ-së në bashkëveprim dhe më tej UJ-ja zuri pozicione atje.

280. Mbrojtja e Llukiqit ftoi si dëshmitar Nebojsa Ognjenoviqin, i cili në fillim të vitit 1999 ishte komandant i stacionit të policisë kufitare në kalimin kufitar të Vërbnicës (Morinës).

⁷⁵⁸ Bozhidar Delliq, T. 19389–19390 (29 nëntor 2007).

⁷⁵⁹ Bozhidar Delliq, T. 19390 (29 nëntor 2007).

⁷⁶⁰ Franjo Gllonçak, T. 21122 (25 janar 2008); 5D1395 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 dhjetor 2007), para. 4–5.

⁷⁶¹ Franjo Gllonçak, T. 21116, T. 21119–21120 (25 janar 2008).

⁷⁶² P2575 (Ditari i Luftës i Batalionit të Artilerisë së Lehtë Kundërajrore Raketore të Brigadës së 549-të të Motorizuar), f. 7–8; Franjo Gllonçak, T. 21123 (25 janar 2008).

⁷⁶³ 6D1004, (Raporti i MPB-së për Prizrenin për periudhën 30 prill–5 maj 1999, 6 maj 1999), f. 4. Sidoqoftë, duhet të vërehet se kur kjo pjesë u lexua nga dëshmitari, ai përktheu fjalën *armë* si "armë artilerike." Franjo Gllonçak, T. 21121 (25 janar 2008). Më vonë, gjatë marrjes në pyetje, ai sqaroi përkthimin "Është armë kundërajrore e ushtrisë së Jugosllavisë, top me dy gryka i vendosur mbi automjete të quajtura Praga. Nuk është armë artilerike. Është armë e mbrojtjes kundërajrore." Franjo Gllonçak, T. 21138 (25 janar 2008). Lidhur me bombardimin e NATO-s, *shih gjithashtu* Franjo Gllonçak, 5D1395 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 dhjetor 2007), para. 9; 5D914 (Raport luftimi i Brigadës së 549-të të Motorizuar).

⁷⁶⁴ Franjo Gllonçak, T. 21121 (25 janar 2008).

Ognjenoviqi dëshmoi se që nga fillimi i sulmeve të NATO-s në këtë kalim kufitar filluan të vinin grupe të mëdha njerëzish për të kaluar kufirin. Për shkak të numrit të madh, policia kufitare nuk bëri kontrole fizike.⁷⁶⁵ Ai gjithashtu u kujtua se në kalimin kufitar foli me Hysni Kryeziun, i cili ishte fqinj i tij në vitin 1999. Sidoqoftë, në kundërshtim me dëshminë e Kryeziut, Ognjenoviqi tha se ai nuk pa ndonjë polic duke marrë para nga njerëzit, apo duke ua marrë makinat dhe dokumentet, ose duke ua hequr targat. Ai tha se po të kishte pasur incidente të tilla, ai do të kishte marrë masa kundër atyre që do të kishin bërë gjëra të tilla. Ai gjithashtu dëshmoi se askush nuk iu ankua në lidhje me sjelljen apo qëndrimin e policëve te kalimi kufitar.⁷⁶⁶

281. Ognjenoviqi gjithashtu pretendoi se shqiptarët kosovarë i kishin hedhur vetë dokumentet personale të identifikimit te kalimi kufitar ose afër tij dhe se punëtorët e kalimit kufitar i mblodhën dhe i vendosën në një dhomë. Dokumentet e automjeteve, targat, dhe patentat e shoferit iu dhanë SPB-së së Prizrenit, kurse dokumentet personale të identifikimit mbetën në një dhomë në godinën e pikës kufitare edhe pas tërheqjes së forcave të RFJ-së/Serbisë nga Kosova.⁷⁶⁷

282. Më tej Ognjenoviqi dëshmoi se më 27 mars 1999 një grup prej 97 vetësh arriti në kalimin kufitar në përpjekje për të kaluar në Shqipëri pa dokumentet e nevojshme të udhëtimit. Ai njohu disa nga këta njerëz dhe provoi t'i bindte të ktheheshin në shtëpi, por ata këmbëngulën duke i thënë se ishin larguar nga shtëpitë për shkak se NATO-ja kishte bombarduar pozicionet e UJ-së afër fshatit të tyre.⁷⁶⁸ Pas këshillimit me shefin e Administratës së Policisë Kufitare në Beograd, ai kontaktoi autoritetet kufitare shqiptare, që e informuan se të gjithë shqiptarët mund të kalonin në territorin shqiptar pa dokumente dhe kështu ai e lejoi grupin të kalonte kufirin.⁷⁶⁹

283. Sipas Ognjenoviqit njerëzit në këtë grup i thanë se dokumentet ua kishte marrë SPB-ja e Prizrenit. Ai i kishte telefonoi SPB-së pasi grupi e kishte kaluar kufirin, por u informua se ata nuk kishin mbajtur dokumente të tilla.⁷⁷⁰ Më vonë ai paraqiti një raport me shkrim në SPB-në e Prizrenit në lidhje me këtë incident. Në Notën Zyrtare lexohet se SPB-ja e Prizrenit dhe Administrata e Policisë Kufitare u informuan me telefon në lidhje me gjendjen para se grupi të lejohej të kalonte kufirin dhe se për këtë ishte dhënë leja.⁷⁷¹ Kur iu tregua Nota Zyrtare, Ognjenoviqi e ndërroi

⁷⁶⁵ Nebojsa Ognjenoviq, T. 22885–22886 (20 shkurt 2008).

⁷⁶⁶ Nebojsa Ognjenoviq, T. 22918–22919 (21 shkurt 2008).

⁷⁶⁷ Nebojsa Ognjenoviq, T. 22885, 22889–22891 (20 shkurt 2008).

⁷⁶⁸ Nebojsa Ognjenoviq, T. 22865–22866, 22887 (20 shkurt 2008).

⁷⁶⁹ Nebojsa Ognjenoviq, T. 22862–22864 (20 shkurt 2008), T. 22930–22931 (21 shkurt 2008). *Shih gjithashtu* 6D1497 (Raport Zyrtar 27 mars 1999).

⁷⁷⁰ Nebojsa Ognjenoviq, T. 22862–22864, 22867 (20 shkurt 2008), T. 22896–22897, 22904, 22938 (21 shkurt 2008). *Shih gjithashtu* 6D1497 (Raport zyrtar 27 mars 1999).

⁷⁷¹ Nebojsa Ognjenoviq, T. 22867 (20 shkurt 2008); T. 22896–22899 (21 shkurt 2008); P3086 (Notë zyrtare nga Stacioni Policor Kufitar në Vërmicë në lidhje me kalimin e personave nga Jugosllavia në Shqipëri, 27 mars 1999).

dëshminë dhe tha se faktikisht ai i kishte telefonuar SPB-së së Prizrenit përpara se grupi të kalonte kufirin.⁷⁷² Sidoqoftë, ai kishte telefonuar vetëm për t'i informuar se kishte ndodhur një incident te kalimi kufitar e jo t'i pyeste se a ishin dokumentet atje.⁷⁷³

284. Petar Dujkoviç, i cili ishte zëvendësshef i Administratës së Policisë Kufitare në Beograd,⁷⁷⁴ dëshmoi se ishte në dijeni për incidentin, por nuk e pa asnjëherë raportin e dërguar në zyrën e tij. Ai gjithashtu tha se kushdo në Beograd që mund ta kishte marrë këtë raport, kishte detyrë ta përcillte në zyrën përkatëse brenda administratës.⁷⁷⁵

285. Dhoma Gjyqësore nuk është bindur nga pretendimi i Ognjenoviçit se shumë shqiptarë kosovarë i hodhën dokumentet e tyre të identifikimit kur po kalonin kufirin për në Shqipëri. Edhe pse mund të ketë ndodhur në ndonjë rast, Dhoma konkludon se nuk ka arsye të vihen në dyshim dëshminë e Krasniçit dhe Kryeziut, si dhe dëshmitarëve okularë nga komunat e tjera, të cilët panë konfiskimin e dokumenteve të tjerëve ose atyre vetë ua morën dokumentet. Ajo gjithashtu e konsideron të pabesueshëm rrëfimin e tij në lidhje me incidentin e 27 marsit, kur ai pretendon se i kishte telefonuar SPB-së së Prizrenit në lidhje me dokumentet e mbajtura atje, dhe e ka marrë këtë parasysh gjatë vlerësimit të besueshmërisë së tij në përgjithësi. Për më tepër, sa i përket largimit të njerëzve nga qyteti i Prizrenit, pretendimi i tij se këta njerëz ikën nga Kosova për shkak të bombardimeve të NATO-s dhe luftimeve midis forcave të RFJ-së/Serbisë dhe UÇK-së nuk mbështetet nga dëshmitë e vetë të ikurve nga qyteti, nga provat në lidhje me objektivat e goditura nga NATO-ja në atë zonë, apo nga mungesa e provave në lidhje me veprimtarinë e UÇK-së.

286. Duke u bazuar në dëshminë e Krasniçit të mbështetur edhe nga Kryeziu Dhoma Gjyqësore rrjedhimisht konkludon se më 28 mars 1999 një numër i madh shqiptarësh kosovarë nga Dushanova, lagje e Prizrenit, u dëbuan nga shtëpitë e tyre dhe u dërguan në drejtim të Shqipërisë. Forcat e MPB-së dhe UJ-së bashkëvepruan në kryerjen e dëbimit dhe përcjelljen e popullatës deri në kufi. Ndër forcat e MPB-së, kishte edhe forca të tjera jo të rregullta ose to posaçme. Gjatë dëbimit, shqiptarët kosovarë u rrahën, u kërcënuan, dhe u grabitën dhe shtëpive iu vu zjarri. Rreth 4.000-5.000 njerëz formuan një kolonë dhe u keqtrajtuat edhe gjatë rrugës për në kufi. Në kalimin kufitar të Vërbnicës (Morinës), policët u morën shumë njerëzve në kolonë letërnjoftimet dhe dokumente të tjera personale.

⁷⁷² Nebojsa Ognjenoviç, T. 22902, 22904–22905 (21 shkurt 2008).

⁷⁷³ Nebojsa Ognjenoviç, T. 22904–22905, 22931 (21 shkurt 2008).

⁷⁷⁴ Emri i plotë i degës ishte "Administrata e Policisë Kufitare, Shtetasve të Huaj, dhe Çështjeve Administrative" Petar Dujkoviç, T. 23303 (27 shkurt 2008).

⁷⁷⁵ Petar Dujkoviç, T. 23409–23410 (28 shkurt 2008).

287. Dhoma Gjyqësore nuk dëgjoi dëshmi në lidhje me akuzat në Aktakuzë se nga kolona u morën gra shqiptare kosovare dhe u dhunuan seksualisht.

E. RAHOVEC

1. Akuzat në Aktakuzë

288. Pretendimet faktike në lidhje me Rahovecin përqendrohen mbi ngjarjet që thuhet se kanë ndodhur atje në mars dhe prill 1999. Shkeljet bazë si dëbimi dhe zhvendosja e dhunshme nga vendndodhje brenda komunës së Rahovecit të përfshira përkatësisht në Pikat 1 dhe 2, janë përshkruar në paragrafin 72(a) dhe 72(a)(i) të Aktakuzës si vijon:

Në mëngjesin e 25 marsit të vitit 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë rrethuan fshatin Celinë me tanke dhe autoblanda. Pasi granatuan fshatin, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë hynë në fshat dhe sistematikisht plaçkitën dhe grabitën çdo artikull me vlerë nga shtëpitë, iu vunë zjarr shtëpive dhe dyqaneve dhe shkatërruan xhaminë e vjetër. Shumica e fshatarëve shqiptarë kosovarë kishin ikur në një pyll të afërt para ardhjes së ushtrisë dhe policisë. Më 28 mars 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë detyruan mijëra njerëz që ishin strehuar në pyll të dilnin prej aty. Burrat u ndanë nga gratë, u rrahën, u plaçkitën, dhe atyre ua morën të gjitha letërnjoftimet. Pastaj burrat u detyruan të marshonin më këmbë për në Prizren dhe më në fund u detyruan të shkonin në Shqipëri.⁷⁷⁶

Më 25 mars 1999, një grup i madh shqiptarësh kosovarë shkoi në një mal afër fshatit Nagafc, gjithashtu në komunën e Rahovecit, për të shpëtuar prej sulmeve mbi fshatrat përreth. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i rrethuan dhe të nesërmen i urdhëruan të 8.000 njerëzit që kishin kërkuar strehim në mal, të largoheshin. Shqiptarët kosovarë u detyruan të shkonin në një shkollë aty afër dhe pastaj u shpërndanë me forcë nëpër fshatrat përreth. Pas tri apo katër ditësh, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë hynë në fshatra, shkuan shtëpi më shtëpi dhe urdhëruan njerëzit të dilnin jashtë. Më në fund, këta njerëz u kthyen me forcë në shtëpi dhe u urdhëruan që të mos dilnin. Më 2 prill 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë filluan të granatonin fshatrat, duke vrarë një numër njerëzish që po flinin nëpër traktorë dhe vetura. Ata që mbetën gjallë u nisën drejt kufirit me Shqipërinë. Kur arritën në kufi fshatarëve ua morën të gjitha letërnjoftimet. Gjatë dëbimeve, në tërë komunën e Rahovecit, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë në mënyrë sistematike dogjën shtëpi, dyqane, monumente kulturore dhe objekte fetare të shqiptarëve kosovarë. Disa xhami u shkatërruan, duke përfshirë xhamitë e Bellacërkës, Brestocit, Krushës së Madhe, dhe të tjera..⁷⁷⁷

289. Të Akuzuarit janë të akuzuar edhe për vrasje, sipas Pikave 3 dhe 4, në lidhje me ngjarjet të përshkruara në paragrafin 75(b) dhe (c) të Aktakuzës, ku lexohet:

⁷⁷⁶ Aktakuza, para. 72(a).

⁷⁷⁷ Aktakuza, para. 72(a)(i).

Më 25 mars 1999 apo rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë rrethuan dhe sulmuan fshatin Bellacërkë në komunën e Rahovecit. Shumë banorë të Bellacërkës ikën përgjatë lumit Belajë jashtë fshatit dhe u detyruan të kërkonin strehim afër një ure hekurudhore. Kur forcat e RFJ-së dhe të Serbisë iu afruan urës, ata hapën zjarr kundër një numri fshatarësh, duke vrarë 12 vetë, 10 prej tyre gra dhe fëmijë. Një fëmijë dyvjeçar mbeti gjallë pas këtij incidenti. Pastaj, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë urdhëruan fshatarët e tjerë të dilnin nga shtrati i përroit. Në këtë moment burrat dhe djemtë më të mëdhenj u ndanë nga pleqtë, gratë dhe fëmijët e vegjël. Më pas forcat e RFJ-së dhe të Serbisë urdhëruan burrat dhe djemtë më të mëdhenj të zhvisheshin dhe ua plaçkitën sistematikisht të gjithë artikujt me vlerë. Grave dhe fëmijëve u dhanë urdhër për t'u larguar drejt një fshati të afërt, të quajtur Xërxë. Një mjek nga Bellacërka u përpoq të fliste me një komandant të forcave sulmuese, por ai u vra me armë zjarri, ashtu si edhe nipi i tij. Më pas, burrat dhe djemtë e tjerë më të mëdhenj u urdhëruan të ktheheshin në shtratin e përroit. Pasi zbatuan urdhrin, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë hapën zjarr kundër këtyre burrave dhe djemve më të mëdhenj, duke vrarë rreth 65 shqiptarë kosovarë. Një numër burrash dhe djemsh më të mëdhenj mbetën gjallë pas këtij incidenti dhe persona të tjerë të cilët ishin fshehur në rrethinë gjithashtu e panë këtë incident. Gjithashtu, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë vranë edhe gjashtë burra të cilët i gjetën, të fshehur në një kanal vaditës të afërt.⁷⁷⁸

Më 25 mars 1999 apo rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë sulmuan fshatrat Krushë e Madhe dhe Krushë e Vogël në komunën e Rahovecit. Fshatarët e Krushës së Vogël u strehuan në një pyll afër Krushës së Vogël, ku patën mundësi të shihnin forcat e RFJ-së dhe të Serbisë që sistematikisht plaçkitnin dhe digjinin shtëpitë e tyre. Pastaj fshatarët u strehuan në shtëpinë e Sejdi Batushës, e cila gjendet në periferi të Krushës së Vogël. Gjatë paradites së 26 marsit, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i gjetën fshatarët. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë urdhëruan gratë dhe fëmijët të largoheshin dhe të shkonin në Shqipëri. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i ndaluan dhe bastisën burrat dhe djemtë dhe ua konfiskuan letërnjoftimet dhe artikujt me vlerë. Pastaj forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i urdhëruan burrat dhe djemtë, nën kërcënimin e vdekjes, të ecnin drejt një shtëpie të zbrazët në Krushën e Vogël. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i detyruan burrat dhe djemtë të hynin në këtë shtëpi. Kur burrat dhe djemtë ishin mbledhur brenda, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë hapën zjarr me mitraloz mbi ta. Pas të shtënave që zgjatën disa minuta, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i vunë zjarr shtëpisë për t'i djegur kufomat. Si pasojë e pushkatimeve dhe e zjarrit, vdiqën rreth 105 burra dhe djem shqiptarë kosovarë.⁷⁷⁹

290. Personat që pretendohet se janë vrarë në Bellacërkë janë në listën B dhe personat që pretendohet se janë vrarë në Krushë të Vogël janë në listën C.⁷⁸⁰ Sipas Pikës 5, të Akuzuarit janë përgjegjës për përndjekje, në formën e vrasjeve të përshkruara në paragrafin 75(b) dhe 75(c) dhe "shkatërrim ose dëmtim pa shkak të objekteve fetare" të shqiptarëve kosovarë, duke përfshirë xhamitë në Celinë, Bellacërkë, Brestoc, dhe Krushë të Madhe, siç është përshkruar në paragrafin 72(a) dhe 72 (a)(i) të Aktakuzës.

⁷⁷⁸ Aktakuza, para. 75(b).

⁷⁷⁹ Aktakuza, para. 75(c).

⁷⁸⁰ Gjatë gjykimit më 29 shtator 2006, Prokuroria tërhoqi akuzat në lidhje me Sefer Batushën, emri i të cilit figuron në Listën C të Aktakuzës. Mehmet Krasniqi, T. 4376–4377 (29 shtator 2006). rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore nuk do të nxjerrë asnjë përfundim në lidhje me këtë person.

2. Rrethanat

291. Komuna e Rahovecit shtrihet në pjesën jugperëndimore të Kosovës qendrore, me Prizrenin në jug, Gjakovën në perëndim, dhe Suharekën në lindje. Qyteti i saj kryesor, i cili gjithashtu quhet Rahovec, është në qendër të komunës, kurse fshatrat Celinë, Krushë e Madhe, Krushë e Vogël, Brestoc, Nagafc, dhe Bellacërkë janë në jug dhe jugperëndim, afër komunave të Prizrenit dhe Gjakovës.

292. Dhoma Gjyqësore dëgjoi dëshmi nga një numër dëshmitarësh të thirrur nga Prokuroria dhe Mbrojtja në lidhje me krimet që pretendohet se kanë ndodhur në komunën e Rahovecit.

293. Siç është diskutuar në Pjesën VI.B më lart, nga fundi i korrikut 1998, qyteti i Rahovecit ishte fushëbeteja e MPB-së dhe UJ-së kundër UÇK-së, që e zbraps në bazat e saj më në veri rreth Malishevës. Bislim Zyrapi dëshmoi se deri më 24 mars 1999, UÇK-ja kontrollonte pjesë të komunës së Rahovecit, e cila ishte pjesë e Zonës së Dytë Operative të UÇK-së, ku vepronin disa brigada të UÇK-së.⁷⁸¹

294. Një urdhër i Komandës së Korpusit të Prishtinës i lëshuar më 16 shkurt 1999, e përshkruante zonën e Malishevës në veri të Rahovecit si një nga bazat kryesore të UÇK-së në Kosovë.⁷⁸² Dëshmitë dhe provat dokumentare konfirmojnë se Shtabi Kryesor dhe komanda e Brigadës së 124-t të UÇK-së ishin të vendosura në Reti.⁷⁸³ Gjithashtu, ka prova se forcat e UÇK-së ishin të pranishme në fshatrat në jug të Brestocit më 1999.⁷⁸⁴ Bozhidar Deliqi dëshmoi se në vitin 1999 UÇK-ja "inskenonte" incidente çdo ditë dhe e zgjeruan territorin nën kontrollin e tyre në krahasim me

⁷⁸¹ Bislim Zyrapi, T. 5967 (6 nëntor 2006), T. 5991 (7 nëntor 2006), T. 6258–6259 (10 nëntor 2006); P2447 (Harta që tregon zonat nën kontrollin e UÇK-së); P2469 (Harta që tregon shtatë Zonat Operative, siç i ka treguar Bislim Zyrapi).

⁷⁸² P2808 (Urdhër i PrK-së, 16 shkurt 1999), f. 1.

⁷⁸³ 3D1048 (Raport i Komandës së Armatës së 3-të, 2 mars 1999), para. 2.5; P2808 (Urdhër i PrK-së, 16 shkurt 1999), f. 2; P2015 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 23 mars 1999), f. 1; 6D1013 (Raport i MPB-së së Prizrenit, 13 mars 1999), f. 3; Bozhidar Deliq, T. 19438 (4 dhjetor 2007); IC152 (Hartë e shënuar nga Bozhidar Deliqi); *Shih gjithashtu Vllatko Vuković, 5D1442 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para. 18.*

⁷⁸⁴ Bozhidar Delliq, T. 19438 (4 dhjetor 2007); P2015 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 23 mars 1999), f. 1.

territorin e kontrolluar më 1998.⁷⁸⁵ I akuzuari Llazareviq gjithashtu tha se në fillim të marsit 1999 u përshkallëzuan aktivitetet "terroriste" dhe aktivitetet e "rebelëve të armatosur".⁷⁸⁶

295. SPB-ja e Prizrenit kishte një DPB në Rahovec. Më 1999, Deliqi zakonisht mbante lidhje me shefin e SPB-së, Millosh Vojnoviq.⁷⁸⁷ Tomisllav Mitiqi, komandant i Degës Ushtarake në Prizren gjatë vitit 1998 dhe 1999, dëshmoi se Detashmenti i 101-të Territorial në Rahovec, ishte dislokuar në mes fshatrave Xërxë, Bellacërkë, Hoçë e Madhe, Oplotushë, dhe Reti. Në atë zonë kishte edhe skuadra të policisë rezerviste.⁷⁸⁸

296. Nuk ka dyshim se në fund të marsit 1999 forcat e UJ-së dhe MPB-së ndërmoren një operacion në disa pjesë të komunës së Rahovecit, si dhe të komunave të Prizrenit dhe Suharekës, siç është diskutuar më lart.⁷⁸⁹ Në zbatim të një urdhri të Komandës së Përbashkët të datës 23 mars 1999, Korpusi i përforcuar i Prishtinës dhe "popullata a armatosur joshqiptare" u urdhëruan që të ndihmonin forcat e MPB-së në bllokimin, thyerjen dhe shkatërrimin e UÇK-së.⁷⁹⁰ Urdhri gjithashtu e ngarkonte Brigadën e 549-të të Motorizuar me detyrë në një operacion të përbashkët me MPB-në për të sulmuar, thyer, dhe shkatërruar UÇK-në në akset e disa fshatrave, duke përfshirë Bellacërkën, Krushën e Madhe, dhe Brestocin.⁷⁹¹

297. Për zbatimin e këtij urdhri, një urdhër i Brigadës së 549-të të Motorizuar i datës 23 mars 1999 ndër të tjera kërkonte që Brigada e 549-të e Motorizuar, në bashkëpunim me Detashmentin e 37-të të PJP-së nga Nishi, kompaninë e 5-të të PJP-së nga Prizreni, dhe kompaninë e 4-t të PJP-së

⁷⁸⁵ Bozhidar Deliq, T. 19276 (28 nëntor 2007), T. 19441–19442 (4 dhjetor 2007); *Shih gjithashtu* 3D1041 (Raport i Komandës së PrK-së dërguar Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 19 janar 1999), f. 2; Branko Gajiq, T. 15233–15235 (7 shtator 2007); 5D878 (Raport i Brigadës së 549th të Motorizuar, 15 shkurt 1999); 6D1017 (Raport i MPB-së së Prizrenit, 28 janar 1999), f. 1–2; P444 (Raport i KVM-së në lidhje me respektimin e armëpushimit prej palëve prej palëve në Kosovë, 12 mars 1999), f. 4, gjithashtu i pranuar si 3D179; Tomisllav Mitiq, 5D1390 (deklarata e dëshmitarit e datës 27 dhjetor 2007), para. 11; 6D77 (Urdhër i UÇK-së, 24 shkurt 1999); 3D1040 (Raport i Komandës së PrK-së, 13 janar 1999), para. 2.2; 6D614 (Pasqyrë e veprave penale të evidentuara prej MPB-së, 1 korrik 1998 to 20 qershor 1999), f. 529, para. 47, f. 532, para. 56, f. 580, para. 50; 6D2, 6D1632 (deklarata e dëshmitarit), para. 96–97, 100.

⁷⁸⁶ Vladimir Llazareviq, T. 17859 (7 nëntor 2007); *Shih gjithashtu* 5D966 (Urdhër i Brigadës së 252-të të Blinduar, 9 maj 1999); Millosh Mandiq, 5D1391 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 janar 2008), para. 31, T. 20906–20907 (23 janar 2008), në lidhje me aksionet në maj 1999.

⁷⁸⁷ Bozhidar Delliq, T. 19344–19345 (29 nëntor 2007).

⁷⁸⁸ Tomisllav Mitiq, T. 20888–20889 (23 janar 2008), 5D1390 (deklarata e dëshmitarit e datës 27 dhjetor 2007), para. 20, 31.

⁷⁸⁹ P2015 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 23 mars 1999); P1981 (Urdhër i Brigadës së 549-të të Motorizuar, 23 mars 1999); P1995 (Analizë e operacioneve të Brigadës së 549-të të Motorizuar, 30 mars 1999); *Shih gjithashtu* P1926 (Raport luftimi i Armatës së 3-të dërguar Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 25–26 mars 1999), f. 3; 5D1357 (Raport luftimi i Komandës së PrK-së, 25 mars 1999).

⁷⁹⁰ P2015 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 23 mars 1999), f. 2.

⁷⁹¹ P2015 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 23 mars 1999), f. 3.

nga Gjakova që të hiqnin "bllokadën" e rrugës Suharekë-Rahovec, të shkatërronin UÇK-në në Reti, dhe të vendosnin kontroll mbi territorin e kësaj zone.⁷⁹²

298. Zyrapi dëshmoi se disa orë pas fillimit të fushatës së NATO-s, herët në mëngjesin e 25 marsit 1999, "forcat serbe" filluan një sulm kundër pozicioneve të UÇK-së.⁷⁹³ Në komunën e Rahovecit, këto forca sulmuan fshatrat Hoçë, Nagafc, dhe Nishor nga drejtimi i qytetit të Rahovecit. Forcat gjithashtu sulmuan edhe nga jugu, duke ardhur nga Pirana dhe duke lëvizur në drejtim të veriperëndimit për në Bellacërkë.⁷⁹⁴ Në atë moment, forcat e UÇK-së së bashku me popullatën e Randobravës dhe Retisë së Poshtme u tërhoqën në Mamushë, kurse UÇK-ja kaloi në territorin malor përreth fshatit Dobërdolan.⁷⁹⁵ Siç është thënë më lart në Pjesën VII.D, nga dëshmia e tij del, edhe pse jo plotësisht qartë, se kjo tërheqje ishte nën urdhrat dhe organizimin e UÇK-së për t'i mbrojtur shqiptarët kosovarë vendas që të mos gjendeshin midis dy zjarresh në luftimet e forcave serbe dhe UÇK-së.

299. Deliqi gjithashtu e konfirmoi këtë operacion dhe dëshmoi se detyra e brigadës së tij ishte që në bashkëpunim me forcat e MPB-së, të bllokonte UÇK-në. Konkretisht duhej të rrethohej komanda e Brigadës së 124-t të UÇK-së.⁷⁹⁶ Gjatë luftimeve në Reti, "terroristët" mbrojtën me vendosmëri zonën e Retisë së Epërme dhe të Poshtme, Randobravën, Studençanin, dhe rrugën nëpër të cilën ishin duke u tërhequr së bashku me popullatën civile, nëpër Dobërdolan në drejtim të Pagarushës.⁷⁹⁷

300. Deliqi dëshmoi se më 26 dhe 27 mars 1999, ai pa personalisht kolonat e civilëve duke lëvizur në drejtim të Neprebishtës, Mamushës, dhe më tej në Studençan, Dobërdolan, dhe Pagarushë. Ai gjithashtu pa kolonat duke u formuar në fshatrat Jançishtë dhe Marali dhe duke lëvizur në drejtim të Astrazupit.⁷⁹⁸ Mirëpo Deliqi nuk dha shpjegim për arsyen e largimit të njerëzve nga ajo zonë.

⁷⁹² P1981 (Urdhër i Brigadës së 549-të të Motorizuar, 23 mars 1999), f. 2–3. Dhoma vëren se aksioni duhej të kryhej në bashkëpunim me Detashmentin e 37-të të PJP-së, por Deliqi dëshmoi se në vend të tij MPB-ja dërgoi Detashmentin e 23-të të PJP-së. Bozhidar Delliq, T. 19679 (6 dhjetor 2007). *Shih gjithashtu* Vllatko Vukoviq, T. 21353 (30 janar 2008).

⁷⁹³ Bislim Zyrapi, T. 5989–5990 (7 nëntor 2006); P2447 (Hartë që tregon zonat e kontrolluara nga UÇK-ja).

⁷⁹⁴ Bislim Zyrapi, T. 5991 (7 nëntor 2006); P2447 (Hartë që tregon zonat e kontrolluara nga UÇK-ja).

⁷⁹⁵ Bislim Zyrapi, T. 5992–5994 (7 nëntor 2006); P2447 (Hartë që tregon zonat e kontrolluara nga UÇK-ja).

⁷⁹⁶ Bozhidar Delliq, T. 19358, 19370 (29 nëntor 2007); IC150 (Hartë e shënuar nga Bozhidar Delliq); *Shih gjithashtu* Vllatko Vukoviq, T. 21353 (30 janar 2008).

⁷⁹⁷ Bozhidar Deliq, T. 19669–19670 (6 dhjetor 2007).

⁷⁹⁸ Bozhidar Deliq, T. 19440–19441 (4 dhjetor 2007).

301. Siç është diskutuar më lart, në një raport të datës 30 mars 1999 që i dërgoi komandantit të Korpusit të Prishtinës, Deliqi pohonte se operacioni i përshkruar më lart u krye gjatë periudhës 25 - 29 mars dhe qëllimet e tij ishin arritur.⁷⁹⁹

302. Gjatë periudhës 30 mars – 3 prill në këtë komunë u krye një operacion tjetër, edhe këtë herë në zbatim të një urdhri të Komandës së Përbashkët.⁸⁰⁰ Korpusi i Prishtinës me përforcime dhe me banorë joshqiptarë të armatosur të Kosovës, u urdhëruan t'u ofronin mbështetje forcave të MPB-së në bllokimin, thyerjen dhe shkatërrimin e UÇK-së në zonën e përgjithshme të Malishevës.⁸⁰¹ Rrjedhimisht, Komanda e Korpusit të Prishtinës lëshoi një urdhër për forcat, duke përfshirë edhe Brigadën e 549-të të Motorizuar që të përgatiteshin për operacione në "zonën e përgjithshme" të Malishevës.⁸⁰² Më 29 mars, Deliqi lëshoi urdhrin përkatës për njësitë e tij duke i udhëzuar që të mbështesin forcat e MPB-së në thyerjen dhe shkatërrimin e UÇK-së në vijat Mali Grab-fshati Pagarushë, Hoçë e Madhe-Millanoviq-Jançishtë, dhe në aksin Rahovec-fshati Astrazup.⁸⁰³ Sipas analizës së këtij operacioni të bërë nga Deliqi, UÇK-ja u shkatërrua në zonën e përgjithshme Malishevë-Pagarushë-Bllacë dhe territori u mor tërësisht nën kontroll.⁸⁰⁴

3. Celina

303. Në fillim të vitit 1999, fshati Celinë kishte afërsisht 250 - 253 shtëpi me rreth 2.000 – 2.5000 banorë, të gjithë shqiptarë kosovarë.⁸⁰⁵ Konfigurimi i fshatit ishte i tillë që shtëpitë ishin në radhë të ndara njëra nga tjetra me mure midis tyre.⁸⁰⁶

304. Reshit Salihi, banor shqiptar kosovar i fshatit, dëshmoi se UÇK-ja nuk ishte e pranishme në fshat dhe as ai, apo ndonjë anëtar i familjes së tij nuk ishin pjesëtarë të UÇK-së.⁸⁰⁷ Edhe Agim Jemini, ish-kryeplak i Celinës, bëri të ditur se UÇK-ja nuk ishte e pranishme në fshat.⁸⁰⁸ Jemini dhe Salihi gjithashtu dëshmuuan se Celina nuk kishte qenë objektiv i ndonjë ofensive para fillimit të

⁷⁹⁹ P1995 (Analizë e aksionit të Brigadës së 549-të të Motorizuar, 30 mars 1999), f. 1, 3–5; *Shih gjithashtu* Bozhidar Delliq, T. 19348–19349 (29 nëntor 2007).

⁸⁰⁰ P1969 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 28 mars 1999), f. 1.

⁸⁰¹ P1969 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 28 mars 1999), f. 2.

⁸⁰² 5D339 (Urdhër i Komandës së PrK-së, 28 mars 1999), f. 1.

⁸⁰³ P2000 (Urdhër i Brigadës së 549-të të Motorizuar, 29 mars 1999), f. 2.

⁸⁰⁴ P2002 (Analizë e aksioneve të Brigadës së 549-të të Motorizuar, 30 mars [sic] 1999), f. 1. Dhoma vëren se data në dokument është 30 mars 1999, por Deliqi dëshmoi se ajo ishte gabim dhe se ishte nënshkruar pas kësaj date. *Bozhidar Deliq*, T. 19562 (5 dhjetor 2007).

⁸⁰⁵ Agim Jemini, T. 4232 (28 shtator 2006); Reshit Salihi, T. 4204 (28 shtator 2006), P2336 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 prill 1999), f. 2.

⁸⁰⁶ Reshit Salihi, P2336 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 prill 1999), f. 2.

⁸⁰⁷ Reshit Salihi, T. 4225 (28 shtator 2006), P2336 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 prill 1999), f. 5.

⁸⁰⁸ Agim Jemini, T. 4244 (28 shtator 2006).

bombardimit të NATO-s.⁸⁰⁹ Sidoqoftë, më 9 janar 1999, Jemini u takua me dy monitorues të KVM-së, të cilëve u shprehu ndjenjën e pasigurisë që kishin fshatarët për shkak se UJ-ja kishte vendosur një postbllok në hyrje të fshatit.⁸¹⁰ Jemini konfirmoi se fshatarët kishin kërkuar që të hiqej postblloku, por hodhi poshtë pohimin se ata ishin gati të përkrahnin çdo veprim të UÇK-së duke iu përgjigjur provokimit të UJ-së.⁸¹¹ Kur u ballafaqua me këto dëshmi, Deliqi tha se as UJ-ja, e as ndokush tjetër nuk kishte vendosur postbllok në Celinë.⁸¹² Siç diskutohet më poshtë, Dhoma Gjyqësore pranon dëshminë e Jeminit mbi ngjarjet në Celinë në atë kohë, që përputhet me dëshminë e Salihit, dhe rrjedhimisht gjykon se mohimi i gjerë i Deliqit në lidhje me ekzistencën e postbllokut nuk e diskrediton dëshminë e Jeminit.

305. Deliqi gjithashtu dëshmoi se para fillimit të bombardimeve të NATO-s, UÇK-ja kontrollonte zonën rreth Celinës.⁸¹³ Gjatë muajve të parë të vitit 1999, territori i Suharekës, Krushës së Madhe, dhe Rahovecit u vu gjithnjë e më shumë nën kontroll të UÇK-së. Rruga që shkon prej Suharekës për në Rahovec përmes Studençanit, u mbyll. Rruga prej Prizrenit për në Gjakovë ishte e hapur; sidoqoftë, kishte pasur sulme kundër automjeteve dhe patrullave të MPB-së përgjatë rrugës. Deliqi nuk përjetoi asnjë sulm kundër njësive të tij në atë zonë meqenëse ai përdorte rrugët.⁸¹⁴ Mirëpo Vllatko Vukoviqi, komandant i Batalionit të 2-të të Motorizuar të Brigadës së 549-të të Motorizuar tha se në vitin 1999, në Celinë kishte "forca terroriste".⁸¹⁵

a. Sulmi kundër Celinës më 25 mars 1999

306. Salihi dhe Jemini dëshmuuan se herët në mëngjesin e 25 marsit 1999 "forcat serbe" sulmuan Celinën. Fillimisht fshati u rrethua nga tanket, autobлиндat, dhe transportuesit e blinduar të UJ-së. Shumica e fshatarëve lanë shtëpitë. Dikur midis orës 05:00 dhe 05:30, UJ-ja filloi të granatonte fshatin, gjë që vazhdoi deri rreth orës 21:00 atë natë.⁸¹⁶ Sipas Jeminit, dukej se UJ-ja nuk kishte qëllim të godiste njerëzit në fshat, por vetëm t'i frikësonte.⁸¹⁷

⁸⁰⁹ Agim Jemini, T. 4244–4245 (28 shtator 2006); Reshit Salihi, P2336 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 prill 1999), f. 2.

⁸¹⁰ Agim Jemini, T. 4278 (28 shtator 2006).

⁸¹¹ Agim Jemini, T. 4278–4279 (28 shtator 2006).

⁸¹² Bozhidar Deliq, T. 19367 (29 nëntor 2007).

⁸¹³ Bozhidar Deliq, T. 19437 (4 dhjetor 2007); IC152 (Hartë e shënuar nga Bozhidar Deliqi); *Shih gjithashtu* Tomisllav Mitiq, T. 20894 (23 janar 2008).

⁸¹⁴ Bozhidar Deliq, T. 19367 (29 nëntor 2007).

⁸¹⁵ Vllatko Vukoviq, 5D1442 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para. 18, 29.

⁸¹⁶ Reshit Salihi, T. 4209–4210 (28 shtator 2006), P2336 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 prill 1999), f. 2; Agim Jemini, P2338 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 korrik 1999), f. 2, T. 4232–4234 (28 shtator 2006).

⁸¹⁷ Agim Jemini, P2338 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 korrik 1999), f. 2, T. 4245 (28 shtator 2006).

307. Salih dëshmoi se UJ-ja granatoi fshatin për një kohë dhe pastaj granatimi u ndal për një copë herë dhe gjatë kësaj kohe "forcat tokësore serbe" hynë në fshat. Pasi ishin tërhequr, granatimi filloi përsëri. Kjo rutinë u përsërit gjatë tërë ditës.⁸¹⁸

308. Jemini dëshmoi se shumica e pleqve, grave, dhe fëmijë u mbledhën në një grup; burrat më të rinj prej moshës 18 deri 40 vjeç, duke përfshirë edhe atë, qëndruan larg nga ky grup sepse menduan se do të ishin në shënjestër dhe u fshehën brenda fshatit.⁸¹⁹ Shumica e familjes së Salihit u larguan nga shtëpia për t'u fshehur në shtëpitë përreth dhe më vonë shkuan në pyll.⁸²⁰ Sidoqoftë, Salih, vëllezërit e tij Bajrami dhe Faiku, grua ja e Salihit, tri vajzat, dhe dy djemtë e vegjël qëndruan pas dhe më vonë atyre iu bashkua Miftar Zeqiri dhe 14 anëtarë të familjes së tij. Ata u fshehën së bashku në shtëpinë e tij.⁸²¹

309. Jemini hipi nën hapësirën nën kulmin e një shtëpie të re dhe u fsheh aty me kushëririn e tij Isuf Jeminin rreth 48 orë.⁸²² Ai ishte në gjendje të shihte rreth 80 për qind të fshatit sepse shtëpia ishte vetëm pjesërisht e ndërtuar dhe në kulm kishte një dritare.⁸²³ Rreth orës 09:00, "këmbësoria ushtarake" u afrua në këmbë në rresht për katër dhe brenda orës 10:00, e kishin rrethuar fshatin. Ishin rreth 500 "ushtarë" që hynë në fshat nga katër drejtime kryesore: Bellacërka, Krusha e Madhe, Rahoveci, dhe nga drejtimi i rrugës kryesore Gjakovë-Prizren.⁸²⁴

310. Jemini dëshmoi se forcat që ishin në Celinë i përkisnin UJ-së dhe MPB-së.⁸²⁵ Policët e pranishëm kishin të veshura uniforma kamuflimi të kaltra.⁸²⁶ Forcat e UJ-së kishin uniforma kamuflimi ngjyrë kafe në të gjelbër me emblema me shqiponjën dykrenore në krahun e majtë dhe "shiritat të ndryshëm në vende të ndryshme."⁸²⁷ Ata që dukej se ishin komandantë kishin kapela ngjyrë të gjelbër të mbyllët të tipit beretë kurse ushtarët kishin kapela të ngjashme me të "partizanëve." Të gjitha këto kapela kishin emblema me shqiponjë.⁸²⁸ Shumica prej tyre kishin armë

⁸¹⁸ Reshit Salih, P2336 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 prill 1999), f. 2.

⁸¹⁹ Agim Jemini, P2338 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 korrik 1999), f. 2.

⁸²⁰ Reshit Salih, P2336 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 prill 1999), f. 3, P2336 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 janar 2002), f. 2.

⁸²¹ Reshit Salih, P2336 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 prill 1999), f. 3.

⁸²² Agim Jemini, P2338 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 korrik 1999), f. 2; *Shih gjithashtu IC59* (Fotografi e shtëpisë së Agim Jeminit në Celinë dhe e vendit ku ishte fshehur gjatë ofensivës së 25 marsit 1999 (e shënuar si P2340)); Agim Jemini, T. 4236–4237 (28 shtator 2006).

⁸²³ Agim Jemini, P2338 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 korrik 1999), f. 2.

⁸²⁴ Agim Jemini, P2338 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 korrik 1999), f. 2.

⁸²⁵ Agim Jemini, P4271–4272 (28 shtator 2006).

⁸²⁶ Agim Jemini, P2338 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 korrik 1999), f. 2, P2338 (shitesë e deklaratës së dëshmitarit të datës 3 qershor 2002), T. 4271–4273 (28 shtator 2006).

⁸²⁷ Agim Jemini, T. 4232–4234, 4265 (28 shtator 2006).

⁸²⁸ Agim Jemini, P2338 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 korrik 1999), f. 2, T. 4275–4276 (28 shtator 2006).

automatike dhe revole. Disa kishin raketahedhës dhe disa bomba dore të varura në gjoks.⁸²⁹ Jemini bëri të ditur se disa nga pjesëtarët kishin uniforma të kaltra me shqiponjë dykrenore në gjoks. Sipas tij, këto uniforma ishin "uniforma të zakonshme policore", jo uniforma ushtarake⁸³⁰. Salihi dëshmoi se "forcat serbe" që hynë në fshat, ishin me uniforma "të zeza;" sidoqoftë, ai ishte shumë larg që t'i shihte emblemat në uniformat e tyre.⁸³¹ Këto forca hynë në fshat në autobllinda me rrota të shoqëruar me disa tanke, të cilët kishin zinxhirë në vend të rrotave.⁸³² Deliqi tha se të gjithë ushtarët e brigadës së tij kishin uniforma të quajtura M-89, kurse policia ushtarake kishte uniforma M-94, të cilat ishin uniforma kamuflimi të gjelbra.⁸³³ Dhoma Gjyqësore nuk pajtohet me pretendimet e Mbrojtjeve të Llukiqit dhe Llazareviqit se përshkrimet e uniformave nga Jemini dhe Salihi nuk përputhen me uniformat e përdorura në atë kohë nga UJ-ja dhe policia.⁸³⁴ Edhe dëshmitarë të tjerë thanë se uniformat e policisë ishin thuajse të zeza dhe Dhoma kujton se uniformat ngjyrë të kaltër të mbyllët mund të përshkruhen thuajse si të zeza.⁸³⁵ Mirëpo Dhoma thekson se forcat e para nga dëshmitarët mund të kenë përfshirë edhe rezervistë, vullnetarë, dhe forca të tjera jo të rregullta.

311. Salihi tha se pa "serbë" duke u vënë zjarrin shtëpive dhe ndërtesave në fshat, përfshirë dhe xhaminë e fshatit. Deri në fund të ditës, vetëm rreth 20 shtëpi nuk ishin prekur. Gjithashtu "serbët" hynë nëpër shtëpi, morën të gjitha gjërat me vlerë dhe i ngarkuan në automjetet e tyre. Pasi i mbushën automjetet e tyre, ata thyen ose dogjën çfarëdo gjëje të mbetur. "Forcat serbe" gjithashtu vodhën makina dhe traktorë. Njerëzit iknin nga shtëpitë e tyre dhe vraponin për t'u fshehur në pyllin përreth fshatit.⁸³⁶ Jemini dëshmoi se ushtarët u vendosën në pika të ndryshme përreth fshatit, me 20 deri 30 ushtarë në çdo pikë. Disa nga këto pika u mbajtën për rreth 12 orë deri në mesnatë; disa të tjerë qëndruan atje thuajse dy ditë. Gjatë tërë natës, ushtarët shtinin në ajër për t'i frikësuar fshatarët.⁸³⁷

312. Në orën 09:30 të atij mëngjesi, Jemini pa rreth 35 ushtarë duke e thyer portën e oborrit të tij brenda të cilit ishin pesë shtëpi, përfshirë edhe shtëpinë e re në të cilën ishte i fshehur. Pasi vranë

⁸²⁹ Agim Jemini, P2338 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 korrik 1999), f. 2.

⁸³⁰ Agim Jemini, T. 4269–4273 (28 shtator 2006), P2338 (shitesë deklaratës së dëshmitarit të datës 3 qershor 2002).

⁸³¹ Reshit Salihi, P2336 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 prill 1999), f. 2.

⁸³² Reshit Salihi, P2336 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 prill 1999), f. 2.

⁸³³ Bozhidar Delliq, T. 19367–19368 (29 nëntor 2007).

⁸³⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 42; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 846, 849.

⁸³⁵ *Shih, e.g.*, Reshit Salihi, P2336 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 prill 1999), f. 2–3, T. 4204–4205 (28 shtator 2006); Lutfi Ramadani, T. 4285–4286, 4294–4295, 4323–4324 (28 shtator 2006). Ramadani shpjegoi se uniformat e zeza nuk ishin krejtësisht të zeza; sidoqoftë, ai i quajti të zeza. Ramadani, T. 4364 (29 shtator 2006). *Shih gjithashtu* Nën pjesën VI.A.3.

⁸³⁶ Reshit Salihi, P2336 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 prill 1999), f. 2.

⁸³⁷ Agim Jemini, P2338 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 korrik 1999), f. 3.

qenin e tij, ata i bastisën të pesë shtëpitë dhe i vodhën të gjitha gjërat me vlerë.⁸³⁸ Komandantët e "ofensivës" ishin në një shtëpi që ishte rreth 10-12 metra përballë vendit ku ishte fshehur.⁸³⁹ Komandantët ishin në ballkon në katin e parë, përballë shtëpisë ku ishte i fshehur. Për këtë arsye Jemini ishte në gjendje t'i dëgjonte të gjitha bisedat e komandantëve.⁸⁴⁰ Ai gjithashtu i njohu ata nga fytyra se ishin ushtarë nga Rahoveci, por nuk i dinte emrat e tyre.⁸⁴¹ Nga ballkoni, komandantët mbikëqyrnin se çfarë ishte duke ndodhur në fshat.⁸⁴²

313. Disa nga ushtarët hynë në shtëpinë në të cilën ishte fshehur Jemini dhe kushëriri i tij dhe erdhën deri në katin nën ta dhe u vendosën pranë dritareve.⁸⁴³ Jemini ishte në gjendje të shihte këtë përmes një vrime në dysHEME që ndante dy katet e godinës.⁸⁴⁴ Në të njëjtën kohë, ai tha se ishte shumë vështirë për të dhe kushëririn e tij të lëviznin përreth nga frika se mos bënin zhurmë dhe zbuloheshin.⁸⁴⁵ Sidoqoftë, ai dhe kushëriri i tij nganjëherë i afroheshin dritares, por duke mbajtur një farë largësie të sigurtë, që të shihnin se çfarë po ndodhte jashtë.⁸⁴⁶ Ata mundën t'i hiqnin tjegullat nga kulmi për ta parë fshatin pa u dëgjuar nga ushtarët nën ta.⁸⁴⁷ Gjatë tërë ditës ai pa ushtarë që hynin nëpër shtëpi dhe grabisnin gjërat me vlerë dhe duke u vënë zjarrin shtëpive dhe shkollës.⁸⁴⁸

314. Gjithashtu Jemini mundi të dëgjonte bisedat që këta komandantë bënin me radio dore, si dhe përgjigjet që vinin përmes këtyre radiove.⁸⁴⁹ Gjatë tërë ditës, Jemini dëgjoi të dy komandantët duke

⁸³⁸ Agim Jemini, P2338 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 korrik 1999), f. 5.

⁸³⁹ Agim Jemini, P2338 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 korrik 1999), f. 2, T. 4235, 4247 (28 shtator 2006); *Shih gjithashtu* IC58 (Fotografi që tregon pamjen nga dritarja e tavanit).

⁸⁴⁰ Agim Jemini, P2338 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 korrik 1999), f. 3, T. 4235, 4245–4248 (28 shtator 2006); *Shih gjithashtu* IC58 (Fotografi që tregon pamjen nga dritarja e tavanit).

⁸⁴¹ Agim Jemini, P2338 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 korrik 1999), f. 2, T. 4277 (28 shtator 2006). *Por shih* Bozhidar Delliq, T. 19368 (29 nëntor 2007).

⁸⁴² Agim Jemini, T. 4248 (28 shtator 2006).

⁸⁴³ Agim Jemini, P2338 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 korrik 1999), f. 3, T. 4250–4252 (28 shtator 2006); *Shih gjithashtu* IC62 (Fotografi e shënuar nga Jemini për të treguar ku kishin qenë të vendosur ushtarët në shtëpinë e tij (e shënuar IC59)).

⁸⁴⁴ Agim Jemini, T. 4251 (28 shtator 2006).

⁸⁴⁵ Agim Jemini, T. 4252 (28 shtator 2006).

⁸⁴⁶ Agim Jemini, T. 4250 (28 shtator 2006).

⁸⁴⁷ Agim Jemini, T. 4256–4258, 4280–4281 (28 shtator 2006); *Shih gjithashtu* Agim Jemini, P2353 (transkriptim nga *Prokurorja kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 6562; IC63 (Fotografi që tregon shtëpinë e Agim Jeminit në Celinë që tregon pjesën e kulmit ku i kishte hequr tjegullat (e shënuar IC59)).

⁸⁴⁸ Agim Jemini, P2338 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 korrik 1999), f. 3, T. 4252–4256, 4279–4280 (28 shtator 2006); *Shih gjithashtu* P2340 (Fotografi e shtëpisë së Agim Jeminit në Celinë); P2339 (Fotografi që tregon pamjen nga dritarja e tavanit të shtëpisë së Agim Jeminit).

⁸⁴⁹ Agim Jemini, P2338 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 korrik 1999), f. 3, T. 4245 (28 shtator 2006).

u dhënë urdhra ushtarëve në Celinë. Duket se ata flisnin në gjuhë të koduar dhe ishte e vështirë të kuptoheshin urdhrat.⁸⁵⁰ Ushtarët qëndruan në shtëpi deri në mesnatë.⁸⁵¹

315. Rreth orës 15:00, Salihi, i cili ishte fshehur me vëllain e tij dhe Miftar Zeqirin dhe familjen e tij në fermën e tij, pa një numër të madh policësh serbë kur hynë në shtëpitë e afërta dhe u vunë zjarrin. Ata kishin uniforma të zeza dhe armë sulmi.⁸⁵² Vëllai i tij Bajrami u ngrit për të parë lëvizjet e policisë në anën tjetër të murit që i rrethonte.⁸⁵³ Në atë moment u shkrepën tri breshëri automatiku në drejtim të shtëpisë së tyre. Bajrami u godit dhe u vra në vend.⁸⁵⁴ Reshit Salihi vrapoi në shtëpinë fqinje në oborrin e Zeqirit dhe u fsheh në një gropë 90 centimetra të thellë. Pak më vonë, ai dëgjoji shumë breshëri automatiku dhe klithma grash dhe fëmijësh që vinin nga shtëpia e tij. Ai dëgjoji burra duke bërtitur në gjuhën serbe, të cilën ai e kuptonte pak. Njëri nga ata bërtiti, "Qëlloni, aty ka terroristë" dhe më pas filluan krismat e vazhdueshme për rreth 15 minuta. Pas kësaj gjithçka u qetësua.⁸⁵⁵ Reshit Salihi qëndroi i fshehur për disa orë të tjera dhe gjatë kësaj kohe ndjeu erën e tymit që vinte nga shtëpia e tij, që e bëri të mendonte se i ishte vënë zjarri.⁸⁵⁶ Pasi u bë terr ai doli nga vendi ku ishte fshehur dhe shkoi në pyll, ku takoi familjen e tij.⁸⁵⁷ Pas kthimit në Kosovë nga Shqipëria tre muaj më vonë, ai pa se i gjithë fshati ishte djegur.⁸⁵⁸

316. Kur u ballafaqua me dëshmitë e Salihit dhe Jeminit, Deliqi mohoi se kishte pasur ndonjë autobлиндë në njësinë e tij ose se forcat e tij kishin rrethuar apo granatuar Celinën.⁸⁵⁹ Sidoqoftë, "ndeshja e parë" midis UJ-së dhe UÇK-së ishte në fshatin Celinë.⁸⁶⁰ Më 25 mars, forcat policore "neutralizuan" UÇK-në në fshat dhe Deliqi pranoi se forcat e tij dhanë dhënë mbështetje të lehtë me artilerie, me drejtim mbi fshat përgjatë kodrave ku ndodheshin llogoret e UÇK-së, pa i dëmtuar shtëpitë në fshat.⁸⁶¹ Vllatko Vukoviq e konfirmoi këtë dëshmi dhe tha se nga fshati u hap "zjarr i dendur" në drejtim të skuadrës së majtë të tij dhe njësisë policore dhe se njësitë e tij iu përgjigjën zjarrit dhe se forcat "terroriste" ishin "thyer" dhe kishin ikur. Kur më vonë rreth orës 10:00 paradite,

⁸⁵⁰ Agim Jemini, P2338 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 korrik 1999), f. 3, T. 4248 (28 shtator 2006).

⁸⁵¹ Agim Jemini, P2338 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 korrik 1999), f. 3.

⁸⁵² Reshit Salihi, P2336 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 prill 1999), f. 3, T. 4204–4205 (28 shtator 2006).

⁸⁵³ Reshit Salihi, P2336 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 prill 1999), f. 3; *Shih gjithashtu* Reshit Salihi, T. 4228–4229 (28 shtator 2006).

⁸⁵⁴ Reshit Salihi, P2336 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 prill 1999), f. 3, T. 4207, 4212–4218 (28 shtator 2006).

⁸⁵⁵ Reshit Salihi, P2336 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 prill 1999), f. 3.

⁸⁵⁶ Reshit Salihi, P2336 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 prill 1999), f. 3.

⁸⁵⁷ Reshit Salihi, P2336 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 prill 1999), f. 3.

⁸⁵⁸ Reshit Salihi, T. 4208–4209 (28 shtator 2006).

⁸⁵⁹ Bozhidar Deliq, T. 19359, 19362–19363 (29 nëntor 2007).

⁸⁶⁰ Bozhidar Deliq, T. 19359 (29 nëntor 2007); IC150 (Hartë e shënuar nga Bozhidar Deliqi); *Shih gjithashtu* Vllatko Vukoviq, T. 21358 (30 janar 2008).

⁸⁶¹ Bozhidar Deliq, T. 19359, 19362–19363 (29 nëntor 2007); Vllatko Vukoviq, T. 21358–21359 (30 janar 2008).

ai kaloi nëpër fshat, policia tashmë e kishte kontrolluar fshatin dhe "terroristët" ishin "asgjësuar".⁸⁶² Vukoviqi tha se nuk kishte parë civilë në Celinë në atë kohë dhe as UJ-në apo policinë duke i djegur shtëpitë, shkatërruar xhamitë, ose duke e plaçkitur fshatin.⁸⁶³ Disa nga shtëpitë në skaj të fshatit ishin të përgatitura për luftë.⁸⁶⁴

317. Deliqi dëshmoi se një pjesë e forcave të tij kaluan nëpër Celinë rreth orës 10:00 paradite më 25 mars 1999 pas policisë në rrugën për në Bellacërkë. Gjithashtu, përmes fshatit kaloi edhe një togë mortajash 120-milimetërshe.⁸⁶⁵ Nuk ishte e vërtetë se ushtarët erdhën në rresht për katër. Në fshat nuk pati më qëndresë sepse UÇK-ja ishte tërhequr përgjatë rrugës prej Celinës në drejtim të Randobravës dhe Retisë së Poshtme.⁸⁶⁶

318. Dëshmitari SD1, oficer i UJ-së, mohoi se më 25 mars 1999 njësitë e tij zunë pozicionet në oborrin jashtë shkollës së Celinës. Në atë kohë, shkolla ishte e zbrazët dhe në atë zonë nuk kishte civilë. Mirëpo më vonë në dëshminë e tij ai tha se atë pasdite kishte parë civilë rreth 200 metra nga oborri i shkollës.⁸⁶⁷ Njësitë e tij nuk hapën zjarr me mortaja kundër Celinës atë ditë.⁸⁶⁸ Ai gjithashtu konfirmoi se kishte parë qindra civilë duke kaluar në rrugën prej Celinës për në Krushë të Madhe.⁸⁶⁹

319. Më 26 maj 1999, rreth orës 08:00, prindërit e Jeminit dhe anëtarë të tjerë të familjes u kthyen në shtëpi për ta kërkuar. Ata i thanë se ushtarët iu kishin bërë titur, i kishin grabitur, dhe ua kishin plaçkitur shtëpitë. Ushtarët kishin thënë se të gjithë duhej të shkonin në Xërxë.⁸⁷⁰ Më pas ai pa forca të tjera duke iu afruar fshatit nga rruga kryesore, duke përfshirë edhe një transportues ushtarësh me 12 policë të "forcave speciale." Ai mendoi se ishin njerëzit e Arkanit; ata kishin mjekra të gjata dhe kokat e rruara pa kapela. Kishin uniforma dhe shenja të ngjashme me ato të ushtarëve të një dite më parë, por me shirita të kuq të varur në krahun e majtë. Kishin armatim të

⁸⁶² Vllatko Vukoviq, T. 21358–21359, 21387 (30 janar 2008); Vllatko Vukoviq, 5D1442 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para. 27.

⁸⁶³ Vllatko Vukoviq, T. 21359 (30 janar 2008); Vllatko Vukoviq, 5D1442 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para. 27.

⁸⁶⁴ Vllatko Vukoviq, 5D1442 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para. 27.

⁸⁶⁵ Bozhidar Deliq, T. 19363–19364 (29 nëntor 2007).

⁸⁶⁶ Bozhidar Deliq, T. 19365, 19383 (29 nëntor 2007); *Shih gjithashtu* Vllatko Vukoviq, 5D1442 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para. 27.

⁸⁶⁷ SD1, T. 20228–20230 (13 dhjetor 2007) (seancë private).

⁸⁶⁸ SD1, T. 20229 (13 dhjetor 2007) (seancë private).

⁸⁶⁹ SD1, T. 20230–20231 (13 dhjetor 2007) (seancë private).

⁸⁷⁰ Agim Jemini, P2338 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 korrik 1999), f. 3.

ngjashëm, por gjithashtu kishin edhe thika të gjata në brez.⁸⁷¹ Këta individë nuk qëndruan në Celinë, po vazhduan për në Krushë të Madhe.⁸⁷²

320. Jemini qëndroi i fshehur në kulm, ku kishte qenë edhe një ditë më parë me kushëririn e tij, kurse prindërit e tij u fshehën në bodrum. Gjysmë ore më vonë, në fshat ishin rreth 200-300 ushtarë. Disa grupe kishin shirita të kuq sikurse ata që kishte parë më herët në kamion. Të tjerët kishin shirita të bardhë. Disa grupe kishin shami në kokë. Disa nga shamitë ishin të kuqe, kurse të tjerat me motive të ndryshme, por shumica ishin kryesisht të kuqe ose të zeza. Të gjithë kishin thika të gjata të ngjashme me ato që kishte parë më herët. Ata shkuan shtëpi më shtëpi.⁸⁷³

321. Rreth orës 09:30, rreth 30 ushtarë hynë në oborrin e tij dhe bastisën çdo shtëpi. Kur erdhën në katin e dytë të shtëpisë në të cilën ishte fshehur ai, ata zunë pozicionet afër dritareve dhe dukej se ruanin të tjerët. Në atë moment ai pa një grup prej shtatë-tetë njerëzish që hynë në shtëpi dhe nxorën jashtë pesë njerëz që ishin fshehur në bodrum. Ata ishin babai i tij Sadri Jemini, nëna Synavere Jemini, axha Shaip Jemini, djali i axhës Muharrem Jemini, dhe gruaja e axhës Zade Jemini. Fillimisht ushtarët u kërkua para e pastaj i çuan në drejtim të derës së oborrit.⁸⁷⁴ Kur kaluan shtëpinë tjetër, ushtarët i urdhëruan të ktheheshin majtas e kështu u gjendën në mes të dy shtëpive. Njëri nga ushtarët nxori revolen dhe e shkrepri një herë në ajër. Më pas ushtarët e tjerë hapën zjarr me armët e tyre automatike dhe të pestë ranë përtokë. Agim Jemini ishte i sigurt se ata kishin vdekur.⁸⁷⁵

322. Pas një kohe të shkurtër në oborr erdhi një kamion. Ushtarët vodhën gjërat me vlerë nga shtëpitë e Jeminëve dhe i ngarkuan në dy kamionë. Ata qëndruan në oborr deri në orën 01:00 të mëngjesit të nesërm. Gjatë tërë ditës, ata përdorën flakëdhës për të djegur çdo shtëpi që mund të digjej në fshat. Mbetën vetëm shtëpitë e raja që nuk mund të merrnin zjarr. Në oborrin e Jeminëve u dogjën tri shtëpi; ajo në të cilën ishte fshehur ai vetë dhe ajo të cilën e kishin përdorur komandantët ditën e mëparshme mbetën të paprekura.⁸⁷⁶ Gjatë tërë ditës Jemini dëgjoji krisma armësh automatike dhe klithma të burrave, grave, dhe fëmijëve. Pas largimit të ushtarëve, Jemini doli nga kulmi dhe

⁸⁷¹ Agim Jemini, P2338 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 korrik 1999), f. 4, T. 4261 (28 shtator 2006).

⁸⁷² Agim Jemini, T. 4268, 4274 (28 shtator 2006).

⁸⁷³ Agim Jemini, P2338 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 korrik 1999), f. 4.

⁸⁷⁴ Agim Jemini, T. 4281 (28 shtator 2006), P2338 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 korrik 1999), f. 4, P2338 (shitesë e deklaratës së dëshmitarit e datës 3 qershor 2002).

⁸⁷⁵ Agim Jemini, P2338 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 korrik 1999), f. 4; *Shih gjithashtu* IC60 (Fotografi e shtëpisë së Agim Jeminit në Celinë); Agim Jemini, T. 4238–4239 (28 shtator 2006).

⁸⁷⁶ Agim Jemini, P2338 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 korrik 1999), f. 4.

iku nga oborri dhe shkoi në Xërxë përmes Bellacërkës. Ai nuk mundi të kontrollonte kufomat e anëtarëve të familjes së tij sepse rreth 50 metra më tej ndodhej një grup ushtarësh.⁸⁷⁷

323. Reshit Salihi tha se ai dhe familja e tij qëndruan në pyll tri ditët e ardhshme dhe se në mëngjesin e ditës së katërt erdhën në këmbë një grup prej 40 policësh.⁸⁷⁸ Ata ishin të veshur në uniforma kamuflimi të kaltra dhe kishin shirita të bardhë në krahë dhe shami në ngjyrë të kaltër të mbyllët ose të gjelbra në kokë.⁸⁷⁹ Ata ishin të armatosur me pushkë sulmuese.⁸⁸⁰ Kur filluan t'i shkrepnin pushkët në ajër Salihi vendosi t'a nxirrte familjen e vet nga skaji i pyllit. Në atë moment atje ndodheshin shumë njerëz.⁸⁸¹ Policët i urdhëruan të ndaheshin në dy grupe, duke i ndarë gratë e fëmijët nga burrat. Më pas policët filluar t'i kontrollonin dhe iu kërkuan të dorëzonin gjërat me vlerë, paratë, dhe dokumentet e identifikimit. Ata kërcënuan se do ta vrisnin cilindro që do të tentonte të mbante ndonjë dokument. Pastaj "serbët" i mblodhën dokumentet në një grumbull dhe u vunë zjarrin.⁸⁸² Mbrojtja e Llukiqit pretendoi se përshkrimi i uniformave prej Salihit nuk përputhej me uniformat e policisë të përdorura në atë kohë.⁸⁸³ Mirëpo Dhoma kujton se shiritat me ngjyra të ndryshme përfshirë të bardhën, përdorëshin kohë pas kohe nga policët që vepronin në këtë komunë.⁸⁸⁴ Dhoma nuk përjashton mundësinë që me policinë të kenë qenë edhe forca të tjera jo të rregullta.

324. Salihi dëshmoi se një fshatar i quajtur Agim Ramadani (rreth 22 vjeç) u kontrollua dhe u detyrua të zhvishej deri në brez. Tre policë e larguan rreth 50 metra më tej dhe njëri nga ta i shkrepri tre plumba në kokë duke e lënë të vdekur.⁸⁸⁵ Burrat u urdhëruan t'i vinin duart mbi kokë. Të dy grupet u përcollën mbrapa në fshat në rresht për dy nën kërcënimin e armëve. Gjatë rrugës, disa nga njerëzit u shkëmbuan dhe u goditën me kondakë pushkësh. Në fshat ata iu dorëzuan një grupi policësh të tjerë të cilët ishin të veshur me uniforma të njëjta kamuflimi ngjyrë të kaltër dhe kishin

⁸⁷⁷ Agim Jemini, P2338 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 korrik 1999), f. 5.

⁸⁷⁸ Reshit Salihi, P2336 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 prill 1999), f. 3, T. 4206 (28 shtator 2006).

⁸⁷⁹ Reshit Salihi, P2336 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 prill 1999), f. 3, P2336 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 janar 2002), f. 2, T. 4206 (28 shtator 2006).

⁸⁸⁰ Reshit Salihi, P2336 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 prill 1999), f. 3.

⁸⁸¹ Reshit Salihi, T. 4220, 4223 (28 shtator 2006), P2336 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 prill 1999), f. 3.

⁸⁸² Reshit Salihi, P2336 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 prill 1999), f. 3–4.

⁸⁸³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 849; *Shih gjithashtu* Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit, 15 korrik 2008 (versioni konfidencial), para. 375.

⁸⁸⁴ *Shih, e.g.*, Isuf Zhuniqi, T. 4126 (27 shtator 2006); Mehmet Krasniqi, T. 4393–4394 (29 shtator 2006); K25, P2439 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 shtator 2001), f. 20; K73, T. 3306–3307 (13 shtator 2006) (seancë e mbyllur).

⁸⁸⁵ Reshit Salihi, P2336 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 prill 1999), f. 4.

shami të gjelbra në kokë.⁸⁸⁶ Policët i shoqëruan deri në rrugën kryesore që lidh Gjakovën me Prizrenin dhe i detyruan të ecnin në drejtim të Prizrenit, përsëri nën kërcënimin e armëve.⁸⁸⁷

325. Pasi një ecjeje prej rreth 30 minutash, grupi u ndal për gjashtë orë. Gjatë kësaj kohe, ata u mbajtën vazhdimisht nën kërcënimin e armëve. Policët vazhduan t'u kërkonin para dhe t'i keqtrajtonin.⁸⁸⁸ Rreth orës 16:00, ata u urdhëruan të hipnin në disa kamionë që kishin ardhur.⁸⁸⁹ Kamionët i çuan në Zhur, ku i urdhëruan të zbrisnin dhe të niseshin në këmbë për në Shqipëri. Salihi e kaloi atë mbrëmje në një kamp në Kukës, ku mundi të gjente gruan dhe dy vajzat e tij; të nesërmen ai dhe familja e tij e ngushtë u dërguan në një kamp refugjatësh në Tiranë.⁸⁹⁰

b. Kufomat në Celinë

326. Agim Jemini dëshmoi se dy ditë pas ikjes në Xërxë, ai u kthye në Celinë.⁸⁹¹ Gjatë ditës, ndërsa qëndronte i fshehur në ara, ai pa policë me uniforma të kaltra së bashku me "jev gj" duke i marrë kufomat. Ata mblodhën së paku 20-30 kufoma, përfshirë edhe kushërinjtë e vrarë të Jeminit.⁸⁹²

327. Sabri Popaj, banor shqiptar kosovar i Bellacërkës, dëshmoi se më 29 mars 1999 shkoi me Nazim Rexhepin në Celinë për të parë nëse ishte vrarë ndonjë nga kushërinjtë e tij. Ata shkuan në shtëpinë e Naim Rexhepit, ku gjetur kufomat e pesë njerëzve, të gjithë kushërinj të Nazim Rexhepit: Naim Rexhepi, Dërgut Rexhepi, Isa Rexhepi, Hysni (mbiemrin e të cilët Sabri Popaj nuk e dinte), dhe Adem Berisha nga Bellacërka. Shtëpia ishte djegur.⁸⁹³

328. Sabri Popaj dhe Nazim Rexhepi shkuan në një shtëpi tjetër, e cila ishte rreth 100 metra më larg dhe ishte e Njazi Rexhepit, ku gjetën 13 kufoma të njerëzve të cilët ishin ekzekutuar e pastaj ishin djegur. Vetëm dy nga kufomat ishin të identifikueshme; ata ishin Njazi Rexhepi dhe vëllai i tij Dever Rexhepi.⁸⁹⁴

⁸⁸⁶ Reshit Salihi, P2336 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 prill 1999), f. 4 (dëshmon se policët kishin të njëjtat uniforma kamuflimi në ngjyrë të kaltër), P2336 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 janar 2002), f. 2 (dëshmon se policët kishin shami ngjyrë të gjelbër të mbyllët në kokë e jo bereta të kaltra).

⁸⁸⁷ Reshit Salihi, P2336 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 prill 1999), f. 4.

⁸⁸⁸ Reshit Salihi, P2336 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 prill 1999), f. 4.

⁸⁸⁹ Reshit Salihi, P2336 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 prill 1999), f. 4, T. 4222–4223 (28 shtator 2006).

⁸⁹⁰ Reshit Salihi, P2336 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 prill 1999), f. 4, T. 4222–4223 (28 shtator 2006).

⁸⁹¹ Agim Jemini, P2338 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 korrik 1999), f. 5, P2338 (shitesë e deklaratës së dëshmitarit e datës 3 qershor 2002), T. 4266 (28 shtator 2006).

⁸⁹² Agim Jemini, P2338 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 korrik 1999), f. 5, T. 4266–4267 (28 shtator 2006).

⁸⁹³ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 8–9.

⁸⁹⁴ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 9.

329. Popaj gjithashtu dëshmoi se kishin gjetur shtatë kufoma meshkujsh në bodrumin e shtëpisë së Hamzës, mbiemrin e të cilit nuk e dinte.⁸⁹⁵ Gjithashtu në shtëpinë e një personi me emrin “Myftar”, ata gjetën 27 kufoma, në mesin e të cilave kishte burra, gra, vajza të reja, dhe foshnje. Kufomat u varrosën më pas. Popaj dëshmoi se ata gjetën edhe kufomat e dy vëllezërve në kopshtin e Jahir Rexhepit; Nazim Rexhepi i identifikoi ata si Hydajeti dhe Isa. Ata ishin vrarë me armë zjarri.⁸⁹⁶

330. Gjatë ditëve të ardhshme, një grup prej rreth 22-23 burrash, shumica prej tyre nga Celina, hynë në fshat gjatë natës për katër deri pesë orë dhe varrosën kufomat që gjetën.⁸⁹⁷ Këtij grupi i printe Jemini si kryeplak i Celinës në atë kohë.⁸⁹⁸ Popaj dëshmoi se më 30 mars 1999 grupi u kthye në Celinë dhe filloi varrimin e kufomave. Fillimisht u varrosën 13 kufoma nga garazhi në shtëpinë e Njazi Rexhepit dhe pesë kufomat nga bodrumi në oborrin e shtëpisë së Naim Rexhepit.⁸⁹⁹

331. Popaj dëshmoi se ata gjetën dhe varrosën gjithsej 85 kufoma, duke përfshirë 13 kufomat nga garazhi dhe pesë nga bodrumi. Të gjithë ishin vrarë me armë zjarri dhe disa nga kufomat më pas ishin djegur. Asnjë nga kufomat nuk kishte uniformë të UÇK-së ose armë.⁹⁰⁰ Agim Jemini dëshmoi se ata varrosën rreth 78 kufoma, 18 prej të cilave kishin qenë të djegura.⁹⁰¹

332. Edhe Popaj, dhe Jemini dëshmuuan se Jemini shënoi në një copë letër emrin, mbiemrin dhe vitin e lindjes sipas radhës dhe vendit ku ishin varrosur.⁹⁰² Ai i fuste copat përkatëse të letrës në nga një shishe 1.5-litërshe dhe i varroste me kufomën. Çdo varr u mbuluar me një copë plastike. Gjithashtu, ai filmoi shumicën e varreve me videokamer.⁹⁰³

c. Konkluzione

333. Dhoma Gjyqësore konstaton se UJ-ja dhe MPB-ja kryen një operacion në zonën e Celinës gjatë periudhës së përshkruar më lart. Dhoma nuk ka arsye të dyshojë në besueshmërinë e dëshmimeve shumë të detajuara dhe përputhëse të Jeminit dhe Salihit në lidhje me ngjarjet në Celinë më 25 mars 1999 dhe ditëve në vijim. Mohimet e përgjithshme të Deliqit dhe Vukoviqit se njësitë e tyre nuk i

⁸⁹⁵ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 9.

⁸⁹⁶ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 10.

⁸⁹⁷ Agim Jemini, P2338 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 korrik 1999), f. 5; Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 9–10.

⁸⁹⁸ Agim Jemini, P2338 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 korrik 1999), f. 5.

⁸⁹⁹ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 9.

⁹⁰⁰ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 10, T. 5677 (1 nëntor 2006).

⁹⁰¹ Agim Jemini, P2338 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 korrik 1999), f. 5.

⁹⁰² Agim Jemini, P2338 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 korrik 1999), f. 5; Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 10.

⁹⁰³ Agim Jemini, P2338 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 korrik 1999), f. 5.

kanë parë ngjarjet në fshat ose nuk kanë marrë pjesë në to edhe pse të dy pranojnë se kishin qenë të pranishëm në atë zonë gjatë asaj kohe, nuk janë të besueshme.

334. Dhoma Gjyqësore konkludon se më 25 mars 1999 UJ-ja e rrethoi Celinën dhe e granatoi fshatin. Forca të përziera të UJ-së dhe MPB-së, përfshirë dhe forca jo të rregullta, hynë në fshat dhe plaçkitën shtëpitë e u vunë zjarrin. Si pasojë, fshatarët ikën nga frika. Shumica ikën në pyll. Disa fshatarë u sulmuan dhe u vranë. Dhoma gjithashtu konkludon se oficerët e MPB-së shkuan në pyll ku ishin fshehur fshatarët dhe i ndanë burrat nga gratë. Shumë prej tyre i rrahën dhe ua grabitën gjërat me vlerë dhe dokumentet e identifikimit. Burrat u detyruan nën kërcënimin e armëve të shkonin për në Prizren dhe policia i sulmoi përsëri gjatë rrugës. Më pas ata u urdhëruan të hipin në kamionë, të cilat i transportuan në Zhur, ku u urdhëruan të zbrisnin dhe të vazhdonin në këmbë për në Shqipëri. Të tjerët si Jemini ikën nga frika.

335. Dhoma Gjyqësore konkludon se ka dëshmi të drejtpërdrejta nga Jemini se Sadri Jemini, Synavere Jemini, Shaip Jemini, Muharrem Jemini, dhe Zade Jemini u vranë nga forcat që vepruan në Celinë më 26 mars 1999. Dhoma gjithashtu dëgjoi dëshmi nga Salih, Popaj dhe Jemini se u vranë edhe të tjerë dhe se kur u kthyen në fshat ata gjetën shumë kufoma, disa nga të cilat ishin djegur. Mirëpo, nuk ka dëshmi të drejtpërdrejta për mënyrën e vdekjes së këtyre viktimave.⁹⁰⁴ Dhoma Gjyqësore thekson se vrasjet në Celinë nuk figurojnë në akuzat për vrasje të Aktakuzës, por konkludon se vrasjet e provuara, përfshirë ato të dy grave, kontribuan në atmosferën e terrorit të krijuar nga veprimet e forcave të RFJ-së dhe Serbisë

4. Bellacërka

336. Dhoma Gjyqësore dëgjoi se në fillim të vitit 1999, fshati Bellacërkë, i cili gjendet disa kilometra nga Celina, banohej tërësisht nga shqiptarë kosovarë dhe kishte rreth 350 shtëpi me rreth 2.800 banorë.⁹⁰⁵

337. Anëtar i KVM-së Joseph Maisonneuve dëshmoi se në fillim të vitit 1999 UÇK-ja ishte e pranishme në Bellacërkë.⁹⁰⁶ Sidoqoftë, Isuf Zhuniqi, bujk shqiptar kosovar nga Bellacërka, dëshmoi se UÇK-ja nuk kishte pasur asnjëherë bazë apo prani atje. Ai nuk i ishte bashkuar asnjëherë UÇK-së dhe nuk kishte qenë i interesuar t'i bashkohej.⁹⁰⁷ Vëllai i tij më i ri, Avni Zhuniqi, i cili nuk

⁹⁰⁴ *Shih gjithashtu* Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviçit, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 558.

⁹⁰⁵ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 maj 1999), f. 2, T. 4132 (27 shtator 2006); Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 2, T. 5691 (1 nëntor 2006).

⁹⁰⁶ Joseph Maisonneuve, T. 11141 (7 mars 2007).

⁹⁰⁷ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 maj 1999), f. 7; *Shih gjithashtu* Isuf Zhuniqi, T. 4119–4120, 4122, 4124, 4129–4131 (27 shtator 2006).

jetonte në Kosovë me të, kishte qenë pjesëtar i UÇK-së për rreth një vit dhe kishte marrë pjesë në luftime.⁹⁰⁸ Sabri Popaj, gjithashtu nga ky fshat, dëshmoi se ai dhe anëtarët e familjes së ngushtë nuk kishin qenë asnjëherë pjesëtarë të UÇK-së.⁹⁰⁹ Edhe ai mohoi me këmbëngulje praninë e UÇK-së në Bellacërkë.⁹¹⁰ Mirëpo në deklaratën me shkrim ai kishte thënë se në fshat ishin tre pjesëtarë të UÇK-së të cilët i njihnin të gjithë.⁹¹¹ Gjatë fazës së pyetjeve nga Mbrojtja, ai e ndërroi dëshminë e tij të mëhershme dhe shpjegoi se këta tre pjesëtarë të UÇK-së ishin nga Drenoci dhe jo nga Bellacërka.⁹¹² Në të kaluarën, ai dhe shumica e fshatit i kishin dhënë UÇK-së para dhe ushqime.⁹¹³ Popaj gjithashtu dëshmoi se ai e kishte ditur se UÇK-ja ishte e vendosur në fshatrat Reti dhe Drenoc.⁹¹⁴

338. Siç është vënë në dukje më parë, Dhoma Gjyqësore i sheh me skepticizëm mohimet e përgjithshme të shumë dëshmitarëve shqiptarë kosovarë në lidhje me veprimet e UÇK-së afër shtëpive të tyre. Ajo i konsideron dëshmitë e Zhuniqit dhe Popajt si shembuj të shmangies së pyetjeve në lidhje me UÇK-në, e cila duket qartë se kishte lidhje me zonën e Bellacërkës.⁹¹⁵

339. Isuf Zhuniqi dëshmoi se asgjë e rëndësishme nuk kishte ndodhur në fshat apo në afërsi të tij dhe se deri në fund të marsit 1999 atje nuk kishte prani të "forcave serbe".⁹¹⁶ Popaj dëshmoi se një javë para 25 marsit 1999, rreth 40 pjesëtarë të MPB-së dhe UJ-së erdhën me kamionë dhe autobllinda dhe qëndruan në Bellacërkë deri në mbrëmjen e 24 marsit 1999.⁹¹⁷ Disa nga ata kishin uniforma policore ngjyrë qielli kurse të tjerët uniforma ushtarake kamuflimi.⁹¹⁸

340. Pasi kishin arritur, ata filluan të hapnin llogore/bunkerë në kodrën mbi fshat dhe instaluan dy topa kundërajrorë atje.⁹¹⁹ Ata zunë shtëpinë e afërt të Nahit Fetoshit, duke e detyruar atë dhe 38 anëtarët e familjes së tij të largoheshin.⁹²⁰ Më 24 mars 1999, Popaj pa lëvizje të shumta dhe

⁹⁰⁸ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 maj 1999), f. 7.

⁹⁰⁹ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 2, T. 5714 (2 nëntor 2006).

⁹¹⁰ Sabri Popaj, T. 5694–5698 (1 nëntor 2006), 5735 (2 nëntor 2006); *Shih gjithashtu* Sabri Popaj, T. 5743–5744, 5746, 5773–5775 (2 nëntor 2006).

⁹¹¹ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 2, T. 5742–5744 (2 nëntor 2006).

⁹¹² Sabri Popaj, T. 5694–5698 (1 nëntor 2006).

⁹¹³ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 2; *Shih gjithashtu* Sabri Popaj, T. 5714 (2 nëntor 2006).

⁹¹⁴ Sabri Popaj, T. 5699 (1 nëntor 2006), 5735 (2 nëntor 2006).

⁹¹⁵ *Shih gjithashtu* Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 386, 559.

⁹¹⁶ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 maj 1999), f. 2, T. 4124 (27 shtator 2006).

⁹¹⁷ Sabri Popaj, T. 5653 (1 nëntor 2006), T. 5759–5761 (2 nëntor 2006), P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 2.

⁹¹⁸ Sabri Popaj, T. 5653 (1 nëntor 2006).

⁹¹⁹ Sabri Popaj, T. 5653 (1 nëntor 2006), P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 2.

⁹²⁰ Sabri Popaj, T. 5653 (1 nëntor 2006), P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 2, P2446 (shitesë e deklaratës së dëshmitarit e datës 5 qershor 2002).

veprimtari të UJ-së dhe MPB-së; ata lëviznin me kamionë dhe autoblanda në mes Xërxës, fshat që gjendet dy kilometra nga Bellacërka, dhe Rahoveci.⁹²¹ Bozhidar Deliqi, i cili dëshmoi se Bellacërka ishte bazë "terroristësh," mohoi ekzistencën e pozicioneve ushtarake afër fshatit. Ai gjithashtu tha se atje nuk ishte as hapja e llogoreve, as prania e pozicioneve ushtarake.⁹²²

a. Sulmi kundër Bellacërkës më 25 mars 1999

341. Shumë herët në mëngjesin e 25 marsit 1999, Zhuniqi dhe Popaj panë tanke të UJ-së duke hyrë në Bellacërkë.⁹²³ Dy nga këta tanke shkuan në oborrin e shkollës dhe qëndruan aty deri më 4 maj. Tre tanke shkuan drejt xhamisë dhe vazhduan në drejtim të kodrës mbi Celinë, ku edhe zunë pozicione.⁹²⁴ Në orën 04:00, UJ-ja dhe MPB-ja filluan të "qëllonin" nga bunkerët në kodër në drejtim të fshatit.⁹²⁵ Popaj dëshmoi se i interpretoi krismat si paralajmërim që të largoheshin nga shtëpitë dhe nga fshati.⁹²⁶ Ai i pa "forcat serbe" kur hynë në skajet e fshatit dhe u vunë zjarrin shtëpive duke përdorur benzinë dhe flakëhedhës.⁹²⁷ Po atë mëngjes, forcat policore filluar t'i vinin zjarrin fshatit.⁹²⁸

342. Me të dëgjuar krismat, fshatarët ikën. Popaj shoqëroi familjen e tij deri te shkolla e fshatit dhe pastaj u kthye në shtëpi.⁹²⁹ Zhuniqi dhe familja e tij shkuan dhe u fshehën në një arë në skaj të fshatit. Shumë nga fqinjët e tij, gjithsej rreth 200 njerëz, ishin mbledhur atje. Nga vendi ku ishte, ai i pa fshatarët duke u larguar nga fshati në drejtim të Celinës. Pas largimit të tankeve, të gjithë u kthyen në shtëpi.⁹³⁰

343. Rreth 15 minuta më vonë, Zhuniqi dëgjoi të shtëna automatiku nga jashtë dhe pa flakët që dilnin nga shtëpitë vetëm rreth 200 metra më tutje. Ai e mblodhi familjen përsëri dhe i nxori nga

⁹²¹ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 2.

⁹²² Bozhidar Delliq, T. 19355 (29 nëntor 2007), 19724 (6 dhjetor 2007).

⁹²³ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 maj 1999), f. 2, T. 4100–4102, 4112 (27 shtator 2006), P2332 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 6441; Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 3, T. 5652–5653 (1 nëntor 2006).

⁹²⁴ Sabri Popaj, T. 5652–5653, 5692–5693, 5709 (1 nëntor 2006), 5712–5713, 5768–5771 (2 nëntor 2006), P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 3; IC91 (Fotografi e shënuar e Bellacërkës); IC100 (Harta ajrore e shënuar e Bellacërkës); IC101 (Hartë ajrore e shënuar e Bellacërkës); Isuf Zhuniqi, P2331 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 maj 1999), f. 2, T. 4100–4102, 4112 (27 shtator 2006), P2332 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 6441–6442; IC53 (Fotografi e shënuar e Bellacërkës); *Shih gjithashtu* IC99 (Provë materiale e shënuar P615, Atlasi i Kosovës); Sabri Popaj, T. 5716–5720, 5722–5723 (2 nëntor 2006).

⁹²⁵ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 3, T. 5720–5721 (2 nëntor 2006).

⁹²⁶ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 3, T. 5741 (2 nëntor 2006).

⁹²⁷ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 3, T. 5771–5772 (2 nëntor 2006); IC102 (Hartë ajrore e shënuar e Bellacërkës) (tregon se ku hynë forcat serbe në fshat dhe filluan të digjinin shtëpitë).

⁹²⁸ Sabri Popaj, T. 5654 (1 nëntor 2006).

⁹²⁹ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 3.

⁹³⁰ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 maj 1999), f. 2; Isuf Zhuniqi, T. 4112 (27 shtator 2006).

shtëpia.⁹³¹ Ata shkuan te përroi i Belajës, i cili gjendej rreth 900 metra nga shtëpia e tij dhe kishte brigje të thepisura dhe të larta për t'u fshehur. Rreth 700 fshatarë u mblodhën te përroi.⁹³² Ata ecën rreth një kilometër në drejtim të Rogovës, duke u fshehur kohë pas kohe nga plumbat që dukej se shkrepeshin nga snajperët në drejtim të tyre. Duke ecur, ata dëgjonin të shtënat e armëve automatike dhe shpërthimet që vinin nga fshati.⁹³³

344. Popaj u kthye në shtëpinë e tij për të ushqyer lopët dhe dëgjoi klithma që vinin nga përroi i Belajës.⁹³⁴ Ai shkoi atje të shikonte dhe gjeti 14 njerëz, gjashtë prej të cilëve ishin të familjes Zhuniqi, përkatësisht, Çlirim Zhuniqi, Lumturie Zhuniqi, dhe dy vajzat dhe dy djemtë e tyre. Atje ishin edhe tetë anëtarë të familjes Spahiu nga Optrusha.⁹³⁵ Popaj i ndihmoi të kalonin përroit dhe i shoqëroi përgjatë përroit në drejtim të Rogovës. Pas rreth 600 metrash ata kërkuan të pushonin dhe kështu ai u kthye në shtëpi.⁹³⁶

345. Rrugës për në shtëpi, Popaj dëgjoi krisma nga snajperët në kodra. Ai u shtri dhe u zvarrit rreth 100 metra dhe u fsheh në një gropë. Nga ky vend, ai pa 12 policë në anën e tij të përroit dhe shumë të tjerë në anën tjetër duke ardhur nga drejtimi i Rogovës. Ata qëllonin me armë në ajër dhe në drejtim të përroit. Uniformat e tyre ishin "të përziera, ngjyrë të kaltër dhe ngjyrë ushtarake kamuflimi."⁹³⁷ Shumica e tyre kishin shirita me ngjyrë ose shami në kokë. Të gjithë kishin në duar doreza të ngushta plastike si ato që përdoren nga mjekët.⁹³⁸ Megjithëse Popaj shpjegoi se këta policë kishin pasur uniforma kamuflimi ngjyrë të "gjelbër", ai gjithashtu përshekroi perden e kaltër në sallën e gjyqit si "të gjelbër."⁹³⁹ Edhe pse Dhoma Gjyqësore e vërejti këtë mospërputhje, ajo konkludon se mund të mbështetet në identifikimin e të këtij grupi prej Popajt si pjesëtarë të policisë.

⁹³¹ Isuf Zhuniqi, T. 4111–4112 (27 shtator 2006), P2332 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 6450–6451.

⁹³² Fjalët "lumë" dhe "përrua" janë përdorur nga dëshmitari duke iu referuar lumit Bellajë. *Shih* Isuf Zhuniqi, T. 4102 (27 shtator 2006), P2331 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 maj 1999), f. 3.

⁹³³ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 maj 1999), f. 2–3, T. 4102–4103, 4113–4114 (27 shtator 2006); IC54 (Fotografi e lumit Bellajë me vendet ku ishin fshehur fshatarët dhe ku ishin policët); IC55 (Fotografi e fshatit Bellacërkë dhe lumit Bellajë me përroit dhe kanal in ujitës të shënuar).

⁹³⁴ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 3, T. 5662–5663 (1 nëntor 2006); IC92 (Fotografi e shënuar e Bellacërkës).

⁹³⁵ Familja Spahiu qëndroi me familjen Zhuniqi sepse fshati i tyre ishte shkatërruar nga "serbët" në korrik 1998. Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 3.

⁹³⁶ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 3.

⁹³⁷ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 3, T. 5753 (2 nëntor 2006). Gjatë rimarrjes në pyetje, ai shpjegoi se me shprehjen "paraustarakë" ai nënkuptonte personat që vrasin dhe ekzekutojnë njerëz të pafajshëm dhe fëmijë. Ai gjithashtu shpjegoi se personat që i kishte parë duke i ekzekutuar 74 njerëzit ishin "pjesë e policisë zyrtare". T. 5765–5767 (2 nëntor 2006) (theksimi është shtuar).

⁹³⁸ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 3, T. 5657 (1 nëntor 2006).

⁹³⁹ Sabri Popaj, T. 5657 (1 nëntor 2006), T. 5727 (2 nëntor 2006); *Shih gjithashtu* Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 837.

Në lidhje me këtë fakt, Dhoma gjithashtu merr parasysh dëshminë konfirmuese të Isuf Zhuniqit (shih më poshtë).

346. Prej vendit ku ishte i fshehur, i cili ishte rreth 120 metra më larg, Popaj pa policët kur iu afruan 14 njerëzve që kishte ndihmuar.⁹⁴⁰ Ai i dëgjoi policët duke u bërtitur, "Jua qifsha nënën" dhe "Kërkoni ndihmë nga NATO tani." Pas kësaj ata hapur zjarr kundër tyre me pushkë automatike. Edhe policët në anën tjetër të përroit shtinë kundër këtyre njerëzve. Krismat zgjatën më së shumti rreth një minutë. Më tej policët vazhduan të ecnin përgjatë përroit.⁹⁴¹

347. Sabri Popaj i ndoqi me sy policët që po ecnin. Pas një kohe të shkurtë, ai parë se policët në anën tjetër të rrugës kishin gjetur një plak i cili përpiquej të fshihej. Kjo ndodhi rreth 200 metra nga vendi ku ishte fshehur. Ai dëgjoi një breshëri të shkurtër automatiku dhe më pas policët kaluan mbi një urë të vogël hekurudhore mbi përrua. Policët në anën e tij të përroit kaluan në anën tjetër dhe vazhduan në drejtim të rrugës kryesore që lidh Prizrenin me Gjakovën. Më tej ai doli nga vendi ku kishte qenë i fshehur dhe shkoi te vendi ku kishte parë vrasjen e 14 personave. Ata kishin shumë gjak në trup dhe në rroba dhe vrima të plumbave në trup. Ai vazhdoi përgjatë anës së vet të përroit derisa pa në anën tjetër kufomën e Çalim Fetoshit, plak 66-vjeçar nga fshati Bellacërkë.⁹⁴² Dhoma Gjyqësore vëren se kjo viktimë nuk është në Shtojcën B të Aktakuzës.⁹⁴³

348. Isuf Zhuniqi i konfirmoi disa pjesë të dëshmisë së Popajt dhe dëshmoi se, pak kohë pasi ishte larguar nga fshati dhe duke ecur në përroit e Belajës në drejtim të Rogovës, ai dhe familja e tij mbërritën te ura hekurudhore. Ata u fshehën nën ose pas urës në një kanal ujitës ku qëndruan disa orë.⁹⁴⁴ Rreth orës 09:30, Zhuniqi pa një skuadër prej 16 policësh duke ardhur drejt tyre përgjatë të dy anëve të përroit, duke lëvizur në drejtim të urës.⁹⁴⁵ Ai njohu njërin nga policët të cilin e kishte parë në patrullim të zakonshëm në Rahovec.⁹⁴⁶ Policët ishin të veshur me uniforma kamuflimi të kaltra në të gjelbër me emblema në mëngë. Të gjithë kishin shirita të bardhë në krah dhe helmata të

⁹⁴⁰ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 3–4, T. 5655 (1 nëntor 2006), 5737 (2 nëntor 2006).

⁹⁴¹ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 4, T. 5655–5656 (1 nëntor 2006).

⁹⁴² Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 4.

⁹⁴³ Sabri Popaj, T. 5656, 5687 (1 nëntor 2006).

⁹⁴⁴ Isuf Zhuniqi, T. 4102–4103, 4114 (27 shtator 2006), P2331 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 maj 1999), f. 3; IC54 (Fotografi e lumit të Bellajës me vendet ku ishin fshehur fshatarët dhe ku kishin qenë policët); IC55 (Fotografi e fshatit Bellacërkë dhe lumit Bellajë ku është shënuar shtrati dhe kanali ujitës); IC56 (Fotografi e kanalit të ujitjes afër lumit Bellajë).

⁹⁴⁵ Isuf Zhuniqi, T. 4102, 4125 (27 shtator 2006), P2331 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 maj 1999), f. 3; IC54 (Fotografi e lumit Bellajë me vendet ku kishin qenë të fshehur fshatarët dhe policët).

⁹⁴⁶ Isuf Zhuniqi, T. 4107, 4124–4125 (27 shtator 2006), P2331 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 maj 1999), f. 3; *Shih gjithashtu* Isuf Zhuniqi, T. 4133–4134 (27 shtator 2006); P2335 (Përgjigjet ndaj Kërkesës së Prokurorisë për Ndihmë në lidhje me personat që mund të kenë shërbyer në UJ ose MPB dhe atyre që kanë status të rezervistit të MPB-së, 31 korrik 2006), f. 4, kërkesa 1105.

gjelbra dhe ishin të armatosur me pushkë sulmuese AK-47 dhe thika të gjata në brez. Disa nga ata kishin edhe revole.⁹⁴⁷ Nga përshkrimet e Popajt dhe Zhuniqit, Dhoma Gjyqësore është bindur se ky grup u përkiste forcave të MPB-së dhe, siç ka përmendur më lart, nuk e pranon pretendimin e Mbrojtjes së Llukiqit se shiritat e krahut nuk përdoreshin nga policia në atë kohë.⁹⁴⁸

349. Ndërsa policia ishte duke ardhur në drejtimin e tyre, Zhuniqi vuri re një grup njerëzish të përbërë prej dy familjesh që ende ecnin përgjatë rrjedhës së përroit. Këta njerëz nuk kishin mbërritur ende në vendin ku donin të fshiheshin nën urën hekurudhore. Policët ishin shumë afër prapa tyre, kur njëri bërtiti, "Zjarr!" Tre prej tyre hapën zjarr me automatikë. Ata që u vranë në vend ishin Çlirim Zhuniqi (kushëriri i Isufi Zhuniqit, i cili ishte afërsisht i së njëjtë moshë me të), gruaja e tij Lumnie Zhuniqi, vajza e tij Dardania (8 vjeç), djali Dardani (6 vjeç), djali tjetër (4 vjeç), dhe e gjithë familja e Xhemal Spahiut: Xhemali, gruaja e tij, një grua tjetër, dhe katër fëmijë të vegjël. Shumë më vonë ai zbuloi se vetëm djali 2-vjeçar i Çlirimit kishte shpëtuar. Gjatë të shtënave, plumbat vinin nga të dy anët e urës duke e bërë të pamundur ikjen për grupin kryesor me të cilin ishte fshehur Zhuniqi.⁹⁴⁹

350. Pas kësaj, policët u ndanë në dy grupe dhe morën pozicione për hapje zjarri në të dy brigjet e përroit. Njëri nga ata i urdhëroi të gjithë ata që fshiheshin me Zhuniqin, t'i vinin duart mbi kokë dhe të dilnin nga përroi e të hipnin në urën hekurudhore. Ai i urdhëroi të ndaheshin në tri grupe, njëri me gra dhe fëmijë të qëndronte mbi urë, kurse dy grupet me të gjithë burrat të qëndronin në dy anët e urës dhe të përroit. Burrat u urdhëruan të zhvisheshin deri në brekë.⁹⁵⁰

351. Polici të cilin Zhuniqi e njihte nga Rahoveci, i mori pasaportën nga xhaketa dhe i tha se "ma mirë të ishe i vdekur dhe nuk ka jetë për ty në Kosovë."⁹⁵¹ Polici ia grisi pasaportën, letërnjoftimin, dhe patentën e shoferit si dhe i mori 1.200 marka gjermane nga xhaketa. E njëjta gjë u ndodhi edhe burrave të tjerë, të cilët u urdhëruan gjithashtu të hiqnin qaforet, orët, dhe unazat dhe t'ua dorëzonin policëve. Pastaj kreu i policëve i urdhëroi të visheshin dhe të mblidheshin në një grup. Ai u tha grave dhe fëmijëve të largoheshin dhe të shkonin në trasenë hekurudhore në drejtim të Xërxës. Një

⁹⁴⁷ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 maj 1999), f. 3, T. 4106–4107, 4126–4128 (27 shtator 2006).

⁹⁴⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 832. *Shih, e.g.*, Reshit Salih, P2336 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 janar 2002), f. 2–3, T. 4206 (28 shtator 2006); Mehmet Krasniqi, T. 4393–4394 (29 shtator 2006); K25, P2439 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 shtator 2001), f. 20; K73, T. 3306–3307 (13 shtator 2006) (seancë e mbyllur).

⁹⁴⁹ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 maj 1999), f. 3, P2332 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 6455; *Shih gjithashtu* P94 (Fotografi të bëra para konfliktit të personave të vrarë në Bellacërkë).

⁹⁵⁰ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 maj 1999), f. 3–4.

⁹⁵¹ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 maj 1999), f. 4; *Shih gjithashtu* Isuf Zhuniqi, T. 4105 (27 shtator 2006).

mjek nga Bellacërka, Nisim Popaj, i tha kreut të grupit të policëve se ishin bujq të thjeshtë dhe jo pjesëtarë të UÇK-së. Si përgjigje, kreu i policëve e qëlloi me armë dhe e vrau. Pastaj, ai e ktheu pushkën në drejtim të nipit të mjekut, Shëndet Popaj, dhe e qëlloi me një plumb në kokë, duke e vrarë edhe atë në vend.⁹⁵²

352. I gjithë grupi i Zhuniqit prej rreth 65 burrash u urdhëruan të zbrisnin poshtë në përrua dhe në atë moment policët u urdhëruan të hapnin zjarr. Mandej të gjithë policët hapën zjarr me armë automatike. Zhuniqi u godit në krah dhe ra përtokë, me burrat e tjerë mbi të. Ai ishte në gjendje të ruante vetëdijen, por qëndroi pa lëvizur duke u shtirur i vdekur. Krismat vazhduan për rreth pesë minuta e pastaj Zhuniqi dëgjoi disa herë, "Ky ende merr frymë," pas së cilës dëgjonte një shkrepje të armës. Pas pak ai dëgjoi dikë që tha, "Mirë, tash janë të gjithë të vdekur, le të largohemi."⁹⁵³ Pasi qëndroi i shtrirë aty edhe 20 minuta kur u sigurua se policët kishin shkuar, ai u ngrit.⁹⁵⁴ Pasi këqyri përreth, Zhuniqi identifikoi 41 të vdekur.⁹⁵⁵ Përveç këtyre, në përrua ndodheshin edhe 11 kufoma të tjera, emrat e të cilave nuk i kujtoheshin.⁹⁵⁶

353. Zhuniqi identifikoi personat në fotografitë që iu treguan si personat e vrarë në këtë incident në Bellacërkë.⁹⁵⁷ Personat në fotografi në përgjithësi përputhen me personat në listën e dhënë në deklaratën e tij si dëshmitar. Emrat e dy personave në fotografi, më saktësisht të Rrustem Halit Popajt dhe Dhurata Çlirim Zhuniqit, nuk janë në deklaratën e tij si dëshmitar. Gjithsesi Zhuniqi pranoi se lista e tij nuk ishte e plotë sepse ai nuk mundi t'i identifikonte kufomat e 11 burrave në përrua. Sidoqoftë, nuk është e mundshme që Dhurata Çlirim Zhuniqi, një vajzë e vogël 9-vjeçare, të ketë qenë në mesin e këtyre 11 burrave.

354. Dëshmia e Zhuniqit mbi vrasjen e grupit të meshkujve në përroin e Belajës u konfirmua nga Popaj, i cili dëshmoi se, pasi pa kufomat e dy familjeve dhe të Halim Fetoshit, ai vuri re gjashtë ose shtatë policë që kishin dalë në urën hekurudhore rreth 200 metra larg prej tij.⁹⁵⁸ Me dylbitë që kishte, ai pa rreth 40 burra të mbledhur te ura nga gjashtë ose shtatë policë nën kërcënimin e armëve.⁹⁵⁹ Midis këtyre burrave Popaj njohu djalin e tij të madh, Shëndet Popajn. Më vonë, gruaja i

⁹⁵² Isuf Zhuniqi, P2331 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 maj 1999), f. 4.

⁹⁵³ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 maj 1999), f. 4.

⁹⁵⁴ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 maj 1999), f. 4–5.

⁹⁵⁵ *Shih* Shtojcën A.

⁹⁵⁶ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 maj 1999), f. 5–6.

⁹⁵⁷ Isuf Zhuniqi, T. 4104 (27 shtator 2006); P94 (Fotografi të bëra para konfliktit të personave të vrarë në Bellacërkë).

⁹⁵⁸ Sabri Popaj, T. 5658, 5662 (1 nëntor 2006); P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 4; *Shih gjithashtu* IC91 (Fotografi të shënuara të Bellacërkës); IC92 (Fotografi të shënuara të Bellacërkës).

⁹⁵⁹ Sabri Popaj, T. 5662–5664, (1 nëntor 2006); P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 4; *Shih gjithashtu* IC93 (Fotografi të shënuara të Bellacërkës).

tregoi se në atë grup meshkujsh kishin qenë edhe djali tjetër i tij, dy vëllezërit, dhe nipi i tij.⁹⁶⁰ Policët i kontrolluan burrat dhe ua morën gjërat me vlerë dhe dokumentet. Gjithashtu ata morën xhaketat e disa burrave dhe i hodhën në një grumbull e u vunë zjarrin. Pas kësaj, policët hapën zjarr me pushkë automatike.⁹⁶¹ Popaj shpjegoi se nga vendi ku ishte, nuk mundi të shihte se a ishin vrarë ata njerëz, por dëgjoi vetëm krismën e armëve.⁹⁶² Disa nga ata të cilët ishin qëlluar ende lëviznin dhe policët hapën zjarr përsëri për disa sekonda.⁹⁶³

355. Policët u larguan menjëherë pas incidentit. Ata shkuan përgjatë një kanali të vogël që largohej nga përroi në drejtim të Celinës. Pas rreth pesë minutash, Popaj dëgjuar përsëri krisma automatiku, por nuk mundi të shihte se çfarë kishte ndodhur, sepse policët ishin jashtë shikimit të tij.⁹⁶⁴ Sidoqoftë, siç shpjegohet më poshtë, ai më vonë zbuloi se atje ishin vrarë gjashtë persona dhe i gjeti kufomat e tyre rreth 85 metra nga vendi ku ishte vrarë grupi i madh.⁹⁶⁵

356. Popaj iu bashkua gruas dhe prindërve në trasenë hekurudhore rreth 40 metra nga ura dhe rreth 120 metra prej vendit të vrasjeve.⁹⁶⁶ Siç u përmend më lart, gruaja i tregoi se, përveç djalit të tij Shëndetit, midis meshkujve që i pa duke i vrarë kishin qenë edhe anëtarë të tjerë të familjes: djali tjetër i tij Agoni (14 vjeç), dy vëllezërit e tij Nazmiu (43 vjeç) dhe Nesimi (34 vjeç), dhe djali i vëllait, Remziu.⁹⁶⁷

357. Rrugës për në Xërxë, gruaja e Popajt vendosi të kthehej te përroi. Kur pas 20 minutash u kthye te Popaj dhe prindërit e tij, ajo u tregoi se nëntë vetë u kishin shpëtuar plumbave, Alban Popaj, Hysni Popaj, Feim Popaj, Dëfrim Zhuniqi, Sefer Popaj, Sezai Zhuniqi, Agron Zhuniqi, [emri nuk dihet] Zhuniqi (djali i Eshrefit), dhe Shukri Gashi.⁹⁶⁸ Së bashku me gruan dhe prindërit, Popaj shkoi në Xërxë në këmbë, dhe atje panë se kishin arritur edhe gratë, fëmijët dhe pleqtë e tjerë. Kur u treguan fshatarëve çfarë kishte ndodhur, një grup shkoi në vendin e ngjarjes me traktor dhe rimorkio dhe i prunë të shpëtuarit në Xërxë.⁹⁶⁹

⁹⁶⁰ Sabri Popaj, T. 5663 (1 nëntor 2006); P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 4–5.

⁹⁶¹ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 4.

⁹⁶² Sabri Popaj, T. 5665 (1 nëntor 2006).

⁹⁶³ Sabri Popaj, T. 5663–5665 (1 nëntor 2006); P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 4.

⁹⁶⁴ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 4.

⁹⁶⁵ Sabri Popaj, T. 5661–5662, 5673–5674 (1 nëntor 2006); *Shih gjithashtu* IC92 (Fotografi e shënuar e Bellacërkës); IC95 (Fotografi e shënuar e urës së Bellajës).

⁹⁶⁶ Sabri Popaj, T. 5664 (1 nëntor 2006), P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 4–5; *Shih gjithashtu* IC93 (Fotografi e shënuar e Bellacërkës).

⁹⁶⁷ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 5, T. 5739 (2 nëntor 2006).

⁹⁶⁸ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 5.

⁹⁶⁹ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 5, T. 5666–5667, 5669 (1 nëntor 2006).

358. Më 25 mars 1999, rreth orës 17:00, Sefer Zhuniqi dhe Zenel Popaj shkuan në shtëpinë ku ndodhej Sabri Popaj dhe i thanë se e kishin gjetur një djalë dyvjeçar në vendin e incidentit të parë të vrasjeve të cilën ai e kishte parë.⁹⁷⁰ Dy nga të shpëtuarit që i kishin sjellë në Xërxë – Hysni Popaj dhe Alban Popaj – vdiqën pak kohë më vonë.⁹⁷¹

359. Në mbështetje të këtyre dëshmimeve për vrasjet, Agim Jemini dëshmoi se, kur iku nga Celina në Xërxë më 26 mars 1999, ai kaloi pranë një vendi vrasjesh afër Bellacërkës në shtratin e lumit afër hekurudhës, ku pa një numër të madh kufomash të njerëzve nga Bellacërka me rroba civile; Jemini pa gjithsej rreth 40 kufoma.⁹⁷²

360. Më 26 mars 1999, Sabri Popaj u kthye në shtëpinë e tij për t'i nxjerrë bagëtitë në fushë. Shtëpia e tij dhe e prindërve të tij ishin shkatërruar plotësisht nga zjarri dhe të gjitha godinat në oborrin e shtëpisë ishin plaçkitur.⁹⁷³ Krismat në fshat vazhduan për një muaj të tërë. Gjatë kësaj kohe, "forcat serbe" hynin nëpër shtëpi dhe i plaçkitnin; ata i dogjën të gjitha shtëpitë e fshatit.⁹⁷⁴ Ai tha se gjatë periudhës 25 mars-2 prill 1999 në fshat nuk pati luftime midis UÇK-së dhe "forcave serbe".⁹⁷⁵

361. Vllatko Vukoviqi dhe SD1 mohuan se kishin dëgjuar apo parë gjë në lidhje me vrasjen e civilëve shqiptarë kosovarë në shtratin e lumit afër urës hekurudhore. Faktikisht Vukoviqi dëshmoi se ishte i bindur se një gjë e tillë nuk kishte ndodhur, sepse në atë kohë ai ishte në atë zonë.⁹⁷⁶

362. Kur Bozhidar Deliqi u ballafaqua me dëshmitë e Zhuniqit dhe Popajt, ai dëshmoi se forcat e tij nuk e rrethuan Bellacërkën më 25 mars 1999. Ai e gjykoi të nevojshme të shpjegonte se në terminologjinë ushtarake, rrethim do të thotë të rrethosh një territor nga të gjitha anët kurse fshati Bellacërkë nuk u rrethua asnjëherë. Mirëpo ai konfirmoi praninë e forcave të tij në atë zonë dhe dëshmoi se, më 25 mars 1999 në orën 05:00, Grupi Luftarak 2 nga brigada e tij kaloi nëpër fshat nga perëndimi në lindje deri te rrëza e kodrës së Amovcit, ku zunë pozicionet prej të cilave do të

⁹⁷⁰ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 5, P2446 (shitesë e deklaratës së dëshmitarit e datës 5 qershor 2002), T. 5649–5650 (1 nëntor 2006).

⁹⁷¹ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 5.

⁹⁷² Agim Jemini, P2338 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 korrik 1999), f. 5, T. 4239–4241 (28 shtator 2006); *Shih gjithashtu* IC61 (Provë materiale e shënuar P615, Atlasi i Kosovës).

⁹⁷³ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 5–6, P2446 (shitesë e deklaratës së dëshmitarit e datës 5 qershor 2002).

⁹⁷⁴ Sabri Popaj, T. 5741–5742 (2 nëntor 2006), P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 5–6, P2446 (shitesë e deklaratës e dëshmitarit e datës 5 qershor 2002).

⁹⁷⁵ Sabri Popaj, T. 5752 (2 nëntor 2006).

⁹⁷⁶ Vllatko Vukoviqi, T. 21358 (30 janar 2008); SD1, T. 20217–20218 (13 dhjetor 2007) (seancë private).

sulmonin Retinë.⁹⁷⁷ Deliqi pranoi se tre tanke kaluan nëpër fshat, por mohoi se tanket ishin dislokuar në oborrin e shkollës së fshatit, siç dëshmoi Popaj.⁹⁷⁸ Ai më tej tha se ushtria nuk kishte përdorur flakëhedhës që nga Lufta e Dytë Botërore.⁹⁷⁹ Deliqi gjithashtu dëshmoi se njësitë e tij pasuan lëvizjet e Detachmentit të e 23-të të PJP-së nëpër Bellacërkë për në Celinë.⁹⁸⁰ Deliqi kaloi personalisht nëpër Bellacërkë në mëngjesin e 25 marsit 1999, takoi komandantin vartës të tij, dhe më pas vazhdoi te vendi ku kishte vendosur se do të ishte postëkomanda e tij gjatë veprimeve luftarake nga 25 deri më 28 mars.⁹⁸¹ Ai kalonte nëpër fshat pas 25 marsit deri në fillim të prillit dhe pastaj përsëri në maj 1999 dhe nuk kishte konstatuar asnjë dëmtim atje.⁹⁸²

363. Vukoviqi konfirmoi se më 25 mars Grupi Luftarak 2 kaloi nëpër fshat dhe se atje nuk kishte civilë.⁹⁸³ Ai gjithashtu konfirmoi se para se të kalonte nëpër fshat, ai takoi Deliqin.⁹⁸⁴ Vukoviqi tha se kaloi përmes fshatit me rreth 120 njerëz, tri automjete luftarake me tre topa të kalibrit 30-milimetërsh, dy nga të cilët ishin të montuar, dhe katër ose pesë automjete që do të pozicionoheshin në vijën e tyre të bllokimit jashtë fshatit.⁹⁸⁵ Deliqi, Vukoviqi, dhe SD1 mohuan se forcat e UJ-së kishin ndërmarrë ndonjë veprim në fshat në atë kohë. Fshati ishte i qetë.⁹⁸⁶

364. Në kundërshtim me çfarë thuhet në urdhrin e Brigadës së 549-të dhe ditarin e luftës së Batalionit të 2-të Motorizuar në lidhje me këtë operacion, Vukoviqi dëshmoi se njësitë e tij nuk ishin angazhuar në veprime luftarake në Bellacërkë më 25 mars 1999.⁹⁸⁷ Zëvendësi i tij "praktikisht kopjoi" të dhënat nga urdhri në ditarin e luftës.⁹⁸⁸ Kur iu tregua i njëjti ditar lufte në të cilin thuhet se më 25 mars njësitë "bllokuan dhe spastruan" fshatrat Bellacërkë, Celinë, Nagafc, dhe një pjesë të

⁹⁷⁷ Bozhidar Deliq, T. 19354–19355, 19358–19359 (29 nëntor 2007), 19475–19476 (4 dhjetor 2007); IC150 (Hartë e shënuar nga Bozhidar Deliqi); *Shih gjithashtu* SD1, T. 20188–20189 (13 dhjetor 2007) (seancë private).

⁹⁷⁸ Bozhidar Deliq, T. 19356 (29 nëntor 2007).

⁹⁷⁹ Bozhidar Deliq, T. 19356 (29 nëntor 2007).

⁹⁸⁰ Bozhidar Delliq, T. 19474–19476 (4 dhjetor 2007); P1995 (Analizë e operacionit të Brigadës së 549-të të Motorizuar, 30 mars 1999), f. 3; IC154 (Hartë e shënuar nga Bozhidar Deliqi).

⁹⁸¹ Bozhidar Deliq, T. 19354–19355, 19358–19359 (29 nëntor 2007), 19475–19476 (4 dhjetor 2007); IC150 (Hartë e shënuar nga Bozhidar Deliqi); *Shih gjithashtu* SD1, T. 20188–20189 (13 dhjetor 2007) (seancë private). *Por shih* Vllatko Vukoviq, T. 21371–21373, 21380–21381 (30 janar 2008), 5D1442 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para. 21.

⁹⁸² Bozhidar Deliq, T. 19623 (5 dhjetor 2007).

⁹⁸³ Vllatko Vukoviq, 5D1442 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para. 22, T. 21379–21380 (30 janar 2008).

⁹⁸⁴ Vllatko Vukoviq, T. 21372–21373 (30 janar 2008), 5D1442 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para. 21; *Shih gjithashtu* IC175 (Hartë e shënuar nga Vllatko Vukoviqi); IC176 (Hartë e shënuar nga Vllatko Vukoviqi).

⁹⁸⁵ Vllatko Vukoviq, T. 21381 (30 janar 2008), 21459–21460 (31 janar 2008); IC177 (Hartë e shënuar nga Vllatko Vukoviqi); *Shih gjithashtu* IC175 (Hartë e shënuar nga Vllatko Vukoviqi); IC176 (Hartë e shënuar nga Vllatko Vukoviqi); IC181 (Fotografi e shënuar nga Vllatko Vukoviqi, që tregon rrugën të cilën kishte bërë njësia e tij).

⁹⁸⁶ Bozhidar Deliq, T. 19355 (29 nëntor 2007), 19475, 19477 (4 dhjetor 2007); Vllatko Vukoviq, 5D1442 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para. 21; SD1, T. 20199, 20204 (13 dhjetor 2007) (seancë private).

⁹⁸⁷ Vllatko Vukoviq, T. 21331 (29 janar 2008), 21360–21362 (30 janar 2008), 5D1442 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para. 23–24; P1981 (Urdhër i Brigadës së 549-të të Motorizuar, 23 mars 1999), para. 5.5; P2019 (Ditari i Luftës i Batalionit të 2-të të Motorizuar të Brigadës së 549-të të Motorizuar), f. 3 (e mbyllur me vulë).

Krushës së Madhe, SD1 dëshmoi se këmbësoria "kaloi nëpër" fshat në formacion luftarak pa ndonjë rezistencë dhe pa hapur zjarr, dhe se u larguan nga fshati.⁹⁸⁹ Ai gjithashtu shpjegoi se në zhargonin ushtarak kjo mund të përshkruhet si "spastrim" i fshatit.⁹⁹⁰

365. Vukoviqi gjithashtu tha se kreu i sigurimit e informoi se ata nuk e kishin kontrolluar fshatin meqenëse ky kontroll ishte kryer nga detashmenti i 23-të i PJP-së.⁹⁹¹ Ai me tej tha se për krimet që pretendohet se janë kryer në zonën e Bellacërkës, dëgjoi për herë të parë në vitin 2001 dhe se këto pretendime ishin absolutisht të rreme.⁹⁹²

366. SD1 gjithashtu shpjegoi se kur njësia e tij kaloi nëpër Bellacërkë në mëngjesin e 25 marsit 1999, ai nuk pa asnjë shtëpi të dëmtuar ose të djegur e as njësi të PJP-së; fshati ishte i braktisur.⁹⁹³ Pas kalimit nëpër fshat, ai zuri pozicion në një pikë të lartë.⁹⁹⁴

b. Varrimi i kufomave

367. Sabri Popaj dëshmoi se në mbrëmjen e 26 marsit ai dhe gruaja e tij dhe një fqinj u kthyen në vendin e ngjarjes dhe i nxorën kufomat në bregun e përroit. Të nesërmen, ata i mbështollën kufomat me mbulesë plastike dhe batanije. Në mbrëmje, ata, së bashku me të tjerët nga Bellacërka dhe Xërxa, filluan t'i varrosnin kufomat.⁹⁹⁵ Ishin gjithsej 38 kufoma. Popaj tregoi se 35 kufoma u varrosën në një varr të përbashkët rreth 20 metra nga përroi, afër vendit ku ishin vrarë pranë urës hekurudhore.⁹⁹⁶ Dy të tjerë, Isufi Popaj dhe Mehmet Popaj, babë e bir, u varrosën veças disa metra më larg me kërkesën e familjes së tyre.⁹⁹⁷ Hazer Popaj gjithashtu u varros veças.⁹⁹⁸

⁹⁸⁸ Vllatko Vukoviq, T. 21362–21363 (30 janar 2008).

⁹⁸⁹ P2019 (Ditari i Luftës i Batalionit të 2-të të Motorizuar të Brigadës së 549-të të Motorizuar), f. 3 (e mbyllur me vulë); SD1, T. 20220–20221, 20225–20226 (13 dhjetor 2007) (seancë private).

⁹⁹⁰ SD1, T. 20226–20227 (13 dhjetor 2007) (seancë private).

⁹⁹¹ Vllatko Vukoviq, 5D1442 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para. 21, T. 21357 (30 janar 2008).

⁹⁹² Vllatko Vukoviq, 5D1442 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para. 38; *Shih gjithashtu* 6D2, 6D1631 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 prill 2008), para. 60 (e mbyllur me vulë); 6D2, T. 25379–25380 (15 prill 2008) (seancë e mbyllur); 6D614 (Pasqyrë e veprave penale të evidentuara prej MPB-së, 1 korrik 1998 to 20 qershor 1999), f. 84, para. 187.

⁹⁹³ SD1, T. 20215–20217, 20229 (13 dhjetor 2007) (seancë private).

⁹⁹⁴ SD1, T. 20205–20206, 20209, 20212 (13 dhjetor 2007) (seancë private); IC163 (Hartë e shënuar nga SD1); *Shih gjithashtu* P1981 (Urdhër i Brigadës së 549-të të Motorizuar, 23 mars 1999), para. 5.5.

⁹⁹⁵ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 6.

⁹⁹⁶ *Shih* Sabri Popaj, T. 5673–5674 (1 nëntor 2006), T. 5748–5749 (2 nëntor 2006); IC94 (Fotografi e shënuar e urës së Bellajës).

⁹⁹⁷ *Shih* Sabri Popaj, T. 5673–5674 (1 nëntor 2006); IC94 (Fotografi e shënuar e urës së Bellajës).

⁹⁹⁸ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 6 dhe P2446 (shtesë e deklaratës së dëshmitarit e datës 5 qershor 2002).

368. Popaj i shkroi emrat e afërsisht 17 të vdekurve në copa të veçanta letre, të cilat i vendosi në shishe të vogla qelqi së bashku me kufomat. Ai gjithashtu bëri edhe një listë.⁹⁹⁹ Gjithsej u vranë 26 anëtarë të familjes së tij.¹⁰⁰⁰

369. Popaj ndihmoi edhe në varrosjen e një grupi prej 13 vetësh që u vranë të parët, si dhe gjashtë të tjerëve, përfshirë Sedat Popajn dhe Irfan Popajn. Sedat dhe Irfan Popaj dergjeshin në kanalin që çon nga përroi në drejtim të Celinës. Popaj shkoi në vendin e ngjarjes më 28 mars, rreth orës 03:00 me një llambë të vogël elektrike dhe i identifikoi dy kufomat. Ai gjeti edhe katër kufoma të tjera afër një druri aty afër.¹⁰⁰¹ Ato ishin nga Bellacërka; ai i njihte të gjithë shumë mirë: Hajrullah Begu (i cili kishte qenë hoxhë), Hysni Zhuniqi, dhe djemtë e xhaxhait të së tij, Mehdi Zhuniqi dhe Agim Zhuniqi. Ai supozoi se ata ishin vranë kur kishte dëgjuar të shtëna pesë minuta pas vrasjeve të para.¹⁰⁰²

370. Gjashtë kufomat u varrosën afër vendit ku u gjetën, rreth 70 metra nga varri i përbashkët.¹⁰⁰³ Të 13 kufomat të cilët Popaj i kishte parë fillimisht u varrosën në një varr të përbashkët në tokën e Sabri Popajt vetëm disa metra nga përroi, edhe këta afër vendit ku ishin vranë. Popaj bëri një listë me emrat e gjashtë kufomave sipas radhës në të cilën ishin vendosur në varr. Ai gjithashtu i shkroi emrat e tyre në copa letre të cilat i futi në xhepat e rrobave të tyre.¹⁰⁰⁴

371. Pas varrimit të gjashtë kufomave, Popaj shkoi në Celinë. Në një mal atje, ai gjeti kufomën e një të riu të moshës rreth 21- 22 vjeç me emrin Agim, gruaja e të cilit ishte nga Bellacërka. Popaj vuri re katër vrime plumbash në kraharorin e tij. Më 29 mars, rreth orës 04:00-05:00 ai e varrosur kufomën aty ku e kishte gjetur. Ai e kaloi pjesën tjetër të ditës në mal me familjen e gruas sepse ishte ditë dhe "serbët" ishin ende rrotull.¹⁰⁰⁵

372. Nga fundi i prillit 1999, Popaj gjithashtu gjeti kufomën e një vajze rreth 21- 22 vjeçe në një dhomë në katin përdhes të shtëpisë së Nuri Kelmendit në Bellacërkë. Ajo ishte lakuriq deri në brez; në pjesën e poshtme të trupit kishte pantallona me pika. Ajo kishte plagë thikash në gjinj dhe ishte qëlluar me plumb në pjesë e pasme të qafës. Gjithashtu kishte një plagë plumbi poshtë gjirit të

⁹⁹⁹ *Shih* Shtojca A.

¹⁰⁰⁰ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 7 dhe P2446 (shtesë e deklaratës së dëshmitarit e datës 5 qershor 2002).

¹⁰⁰¹ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 7.

¹⁰⁰² Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 8; *shih gjithashtu* Sabri Popaj, T. 5751–5752 (2 nëntor 2006).

¹⁰⁰³ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 8, T. 5674–5675 (1 nëntor 2006); *shih gjithashtu* IC95 (Fotografi e shënuar e urës së Bellajës).

¹⁰⁰⁴ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 8; *Shih* Shtojca A.

¹⁰⁰⁵ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 8.

majtë. Ai e varrosi kufomën e saj me ndihmën e dy burrave.¹⁰⁰⁶ Më vonë ajo u identifikua si Hadije Spahiu nga Rahoveci.¹⁰⁰⁷ Tri ditë më pas, ai gjeti edhe kufomën a një gruaje me emrin Sadije Kabashi rreth 90 vjeçare në një fushë në pronën e Nait Feroshit kur po shkonte për në Celinë. Ajo kishte një vrimë plumbi në këllk. Sabri Popaj supozoi se ajo ishte vrarë nga një snajper. Edhe kufomën e saj e varrosi me ndihmën e dy burrave.¹⁰⁰⁸

c. Kalimi në Shqipëri

373. Pas vrasjeve, Isufi Zhuniqi shkoi në Xërxë ku gjeti anëtarët e familjes së ngushtë dhe iu dha ndihma e parë. Ai ishte shumë i sëmurë për katër ditë me radhë. Mirëpo kur dëgjoji se policia ishte në afërsi të Xërxës, ai e la familjen dhe iku të fshihej në mal. Atje gjeti rreth 40 fshatarë nga Bellacërka, të cilët ishin fshehur atje. Ata ishin larguar nga fshati nëpërmjet një rruge tjetër. Ata i treguan se i gjithë fshati ishte shkatërruar dhe se vetëm dy shtëpi nuk ishin djegur.¹⁰⁰⁹

374. Natën e 31 marsit 1999, ai shkoi në Nagafc, ku ishin urdhëruar të mblidheshin shumë njerëz të shpërngulur nga fshatra të tjera. Më 1 prill, ai u kthye në Xërxë për të vizituar familjen por nuk guxoi të qëndronte atje sepse policia ishte e pranishme në fshat. Pas një ore, ai u kthye në Nagafc. Ngjarjet që përjetoi në Nagafc tregohen më poshtë.

375. Sabri Popaj u kthye që të banonte në Bellacërkë në maj 1999. Sidoqoftë, më 13 maj ai vendosi të largohej nga Kosova dhe të shkonte në Shqipëri. Ai u nis në këmbë në drejtim të Prizrenit me rreth 85 vetë të tjerë dhe mbërriti në kalimin kufitar të Vërbnicës (Morinës) në orën 17:00. Atje, ata u morën në pyetje nga rojet kufitare serbe, të cilët u kërkuan dokumentet dhe letërnjoftimet. Vetëm pesë prej tyre i dorëzuan. Rojet kufitare i hodhën dokumentet në zjarr para se t'i lejonin të kalonin në Shqipëri.¹⁰¹⁰

d. Provat kriminalistike

376. Dhoma Gjyqësore ka marrë prova kriminalistike në lidhje me vrasjet në Bellacërkë nga Dr. Eric Baccard, raporti i të cilit përmban një përshkrim të vendit të ngjarjes në Bellacërkë dhe ekzaminimin e tij nga një ekip mjeko-ligjor britanik të përbërë nga Prof. Dr. Peter Vanezis, shef i degës së Mjekësisë Ligjore dhe Kriminalistikës në Glasgow University, dhe Dr. Sue Black,

¹⁰⁰⁶ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 11–12.

¹⁰⁰⁷ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 11–12.

¹⁰⁰⁸ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 12, P2446 (shtesë e deklaratës së dëshmitarit e datës 5 qershor 2002).

¹⁰⁰⁹ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 maj 1999), f. 6.

¹⁰¹⁰ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 12, P2446 (shtesë e deklaratës së dëshmitarit e datës 5 qershor 2002), T. 5753 (2 nëntor 2006).

konsulente e patologjisë kriminalistike.¹⁰¹¹ Raporti i Baccard-it bazohet në dokumente mbështetëse ku përfshihet lista e identifikimit, deklaratat, hetimet patologjike të kufomave nga vendi i ngjarjes i shënuar BC001, dhe raportin e ekipit mjeko-ligjor britanik.¹⁰¹² Gjatë ekzaminimit pas vdekjes, u krye skanimi fluoroskopik dhe ekzaminimi i jashtëm.¹⁰¹³

377. Vendi i ngjarjes në Bellacërkë u nda në shtatë zona: Zona 1 ishte varri më i gjatë që përmbante 33 kufoma; Zona 2 ishte varr më i vogël që përmbante tri kufoma; Zona 3 ishte e gjithë zona brenda hapësirës së rrethuar me përjashtim të lumit; Zona 4 ishte lumi dhe shtrati i lumit brenda hapësirës së rrethuar; Zona 5 ishte një varr rreth 100 metra jashtë hapësirës së rrethuar që përmbante gjashtë kufoma; Zona 6 ishte një varr që përmbante 13 kufoma, që ishte rreth 600 metra nga lumi; Zona 7 ishte një varr që përmbante një kufomë, gjithashtu rreth 600 metra nga lumi.¹⁰¹⁴

378. Sipas raportit të ekipit mjeko-ligjor britanik, para se të fillonte ekzaminimi të afërmit identifikuan kufomat; ekzaminimet pas vdekjes filluan në një morg të përkohshëm të ngritur në një hambar në Bellacërkë.¹⁰¹⁵ Për shembull, raporti i ekipit britanik përmban deklaratën e policit britanik Clive Donner se ai kishte qenë në morg me Sabri Popajn, i afërm i viktimave, për t'i identifikuar kufomat.¹⁰¹⁶ Në dëshminë e tij, Baccard-i shpjegoi se ky ishte procesi normal i identifikimit.¹⁰¹⁷

379. Nga 30 qershori deri më 3 korrik 1999, ekipi mjeko-ligjor britanik kreu 54 ekzaminime pas vdekjes të 42 viktimave të identifikuara dhe 12 viktimave të paidentifikuara, siç evidentohet në Shtojcën A.¹⁰¹⁸ Nga 54 viktimat e zhvarrosura, 47 ishin meshkuj (përfshirë tre fëmijë) dhe shtatë femra (përfshirë katër fëmijë).¹⁰¹⁹ Raporti i Baccard-it konkludon se më shumë se 98 për qind e viktimave kishin vdekur si rezultat i plagëve nga armët e zjarrit. Numri i plagëve nga armët e zjarrit ishte nga 1ë deri në 13 për viktimë, por shumica e viktimave kishin gjashtë ose më pak plagë të

¹⁰¹¹ P1809 (Raport përmbledhës i Eric Baccard-it), f. 27; Eric Baccard, T. 10114–10115 (19 shkurt 2007).

¹⁰¹² Eric Baccard, T. 10116 (19 shkurt 2007); P1809 (Raport përmbledhës i Eric Baccard-it), f. 27; *shih gjithashtu* P97 (Aktzhvarrosje në lidhje me Bellacërkën).

¹⁰¹³ P1809 (Raport përmbledhës i Eric Baccard-it), f. 27.

¹⁰¹⁴ P97 (Aktzhvarrosje në lidhje me Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 37.

¹⁰¹⁵ P1809 (Raport përmbledhës i Eric Baccard-it), f. 27–28.

¹⁰¹⁶ P97 (Aktzhvarrosje në lidhje me Bellacërkën), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 48–49.

¹⁰¹⁷ Eric Baccard, T. 10117–10118 (19 shkurt 2007).

¹⁰¹⁸ P1809 (Raport përmbledhës i Eric Baccard-it), f. 15, 28; Eric Baccard, T. 10117 (19 shkurt 2007).

¹⁰¹⁹ P1809 (Raport përmbledhës i Eric Baccard-it), f. 28.

shkaktuara nga armët e zjarrit.¹⁰²⁰ Pika hyrëse në plagët nga armët e zjarrit më së shpeshti ishin në pjesën e përparme të trupit.¹⁰²¹

e. Konkluzione

380. Dhoma sërish konstaton se UJ-ja dhe MPB-ja kryen një operacion në zonën e Bellacërkës në kohën e ngjarjeve të përshkruara më lart. Dhoma pranon dëshmitë okulare shumë të detajuara dhe përputhëse të Zhuniqit dhe Popajt në lidhje me këto ngjarje. Deliqi, Vukoviqi, dhe SD1 konfirmuan praninë e UJ-së dhe të MPB-së në Bellacërkë dhe në afërsi të saj në atë kohë, por mohuan ngjarjet konkrete të përshkruara nga dëshmitarët okularë. Duke mohuar përgjithësisht dëshmimin prej tyre të këtyre ngjarjeve ose implikimin e tyre në ndonjë nga ngjarjet në fshat edhe pse pranojnë se kanë qenë në atë zonë në atë kohë, Deliqi dhe Vukoviqi e bëjnë të dyshimtë besueshmërinë e tyre dhe si pasojë Dhoma Gjyqësore nuk mund të mbështetet në dëshmitë e tyre lidhur me këto ngjarje. Rrjedhimisht Dhoma konkludon se më 25 mars 1999, tanket e UJ-së hynë në Bellacërkë dhe forcat e UJ-së dhe të MPB-së filluan të qëllonin në drejtim të fshatit, duke i detyruar banorët që të iknin. Qindra fshatarë ikën përgjatë përroit të Belajës.

381. Forcat e MPB-së vranë së paku 10 vetë të përroit, ndër të cilët gra e fëmijë, duke iu bërëtitur dhe duke i sharë. Një fëmijë 2-vjeçar i mbijetoi incidentit. Mbrojtja nuk paraqiti asnjë provë të drejtpërdrejtë për të shpjeguar vdekjen e këtyre njerëzve. Viktimat e vrara janë Xhemal Spahiu, Marigona Spahiu, Iliriana Spahiu, Lirim Spahiu, Qamile Spahiu, Çlirim Zhuniqi, Lumnie Zhuniqi, Dardan Zhuniqi, Dardane Zhuniqi, dhe Dhurata Zhuniqi.¹⁰²² Prokuroria nuk ka vërtetuar se Fiqri Spahiu dhe Labinot Spahiu, të cilët përmenden si viktima nga Bellacërka në Dosjen Gjyqësore Përfundimtare të saj, u vranë nga forcat e UJ-së ose të MPB-së më 25 mars 1999.¹⁰²³

382. Më pas policët urdhëruan fshatarët e mbetur në shtratin e përroit të ndaheshin në tri grupe, një me gra e fëmijë dhe dy të tjerat me të gjithë burrat që qëndronin në dy anët e urës dhe përroit. Policët i urdhëruan gratë e fëmijët të largoheshin në drejtim të Xërxës. Një mjek nga Bellacërka i foli kreut të grupit të policëve dhe u vra së bashku me të nipin. Pas kësaj, burrave iu grabitën gjërat me vlerë dhe u detyruan të hynin në përrua, ku u ekzekutuan. Dhoma Gjyqësore konkludon se në këtë incident u vranë së paku 42 burra, ata janë: Abdullah Begaj, Murat Berisha, Fadil Gashi, Musa Morina, Alban Popaj, Agon Popaj, Abdullah Popaj, Bedrush Popaj, Belul Popaj, Ethem Popaj, Hazer Popaj, Hysni Popaj, Isuf Popaj, Kreshnik Popaj, Lindrit Popaj, Mehmet Popaj, Mersel Popaj,

¹⁰²⁰ P1809 (Raport përmbledhës i Eric Baccard-it), f. 15, 29–30; Eric Baccard, T. 10116 (19 shkurt 2007).

¹⁰²¹ P1809 (Raport përmbledhës i Eric Baccard-it), f. 15, 31.

¹⁰²² *Shih* Shtojca A.

¹⁰²³ *Shih* Shtojca A.

Nazmi Popaj, Nisim Popaj, Rrustem Popaj, Sahid Popaj, Shëndet Popaj, Vehap Popaj, Xhavit Popaj, Abedin Zhuniqi, Bajram Zhuniqi, Bilall Zhuniqi, Destan Zhuniqi, Eshref Zhuniqi, Fatos Zhuniqi, Labinot Zhuniqi, Ibrahim Zhuniqi, Kasim Zhuniqi, Muhamet Zhuniqi, Muharrem Zhuniqi, Qamil Zhuniqi, Qemal Zhuniqi, Reshit Zhuniqi, Shemsi Zhuniqi, Ardian Fetoshi, Fatmir Fetoshi, dhe Hysni Fetoshi.¹⁰²⁴ Shtatë të tjerë të vrarë nga policia afër përroit ishin; Irfan Popaj, Sedat Popaj, Agim Zhuniqi, Hysni Zhuniqi, Medi Zhuniqi, Hajrullah Begu dhe Halim Fetoshi.¹⁰²⁵ Rrjedhimisht, duke u bazuar në provat kriminalistike dhe provat shtesë në lidhje me ngjarjet në Bellacërkë të diskutuara më lart, Dhoma konkludon se më 25 mars 1999, forcat e MPB-së vranë 25 vetë atje.

5. Shkatërrimi i xhamive në Celinë dhe Bellacërkë

383. Sabri Popaj dëshmoi se xhamitë në Celinë, Bellacërkë, dhe Rogovë u hodhën në erë më 28 mars 1999, në festën myslimane të Bajramit.¹⁰²⁶ Ai shpjegoi se Celina dhe Bellacërka janë rreth një kilometër e gjysmë larg njëra-tjetrës.¹⁰²⁷ Fillimisht ai pa kur hodhën në erë xhaminë e Celinës, pastaj xhaminë në Bellacërkë, e në fund xhaminë e Rogovës.¹⁰²⁸ Dhoma ka diskutuar shkatërrimin e xhamisë së Rogovës më lart në pjesën për komunën e Gjakovës.

a. Celina

384. Popaj dëshmoi se më 28 mars 1999 pa një Pincgauer/Landrover dhe një autobлиндë duke shkuar te xhamia e Celinës. Ai ishte lart në kodër dhe mund të shikonte mirë Celinën dhe rrethinën. Automjetet u ndalën afër xhamisë dhe prej tyre dolën policë të veshur me uniforma kamuflimi të kaltra dhe hynë në xhami ku qëndruan rreth një orë.¹⁰²⁹

385. Popaj dëshmoi se më pas ndodhi një shpërthim i madh dhe xhamia u hodh në erë tërësisht.¹⁰³⁰ Ai identifikoi xhaminë në fotografinë që iu tregua në gjykatë se ishte xhamia e Celinës.¹⁰³¹

386. Reshit Salihi dhe Agim Jemini konfirmuan shkatërrimin e xhamisë në Celinë; gjithsesi ata nuk e panë incidentin kur ndodhi. Salihi pa se ishte shkatërruar kur u kthye nga Shqipëria.¹⁰³²

¹⁰²⁴ *Shih* Shtojca A.

¹⁰²⁵ *Shih* Shtojca A.

¹⁰²⁶ Sabri Popaj, T. 5650, 5678, 5685 (1 nëntor 2006).

¹⁰²⁷ Sabri Popaj, T. 5679 (1 nëntor 2006), P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 11.

¹⁰²⁸ Sabri Popaj, T. 5650 (1 nëntor 2006).

¹⁰²⁹ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 11, T. 5685–5686 (1 nëntor 2006).

¹⁰³⁰ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 11, T. 5682 (1 nëntor 2006).

¹⁰³¹ Sabri Popaj, T. 5680 (1 nëntor 2006); *shih gjithashtu* P1800 (Fotografi e xhamisë në Celinë).

¹⁰³² Reshit Salihi, T. 4208–4209 (28 shtator 2006).

Jemini ndodhej në skaj të fshatit kur dëgjoi shpërthimin që kishte shkatërruar xhaminë; zhurma e shpërthimit ishte rreth një kilometër larg. Në mbrëmje, ai shkoi atje dhe e pa plotësisht të shkatërruar.¹⁰³³

387. András Riedlmayer-i e cilësoi gjendjen e xhamisë së Celinës si plotësisht të shkatërruar.¹⁰³⁴ Në aktekspertizën e tij thuhet se sipas bashkësisë myslimane, xhamia ishte djegur kurse gërmadha ishte rrafshuar me buldozer nga "serbët."¹⁰³⁵ Riedlmayer-i tha provat pamore të paraqitura në raport "përputhen" me vlerësimet e bëra nga bashkësia myslimane.¹⁰³⁶ Ai gjithashtu shpjegoi se, duke krahasuar fotografinë e xhamisë para shkatërrimit dhe regjistrin e kadastrës në lidhje me xhaminë me fotografitë e xhamisë së shkatërruar në raportin e tij, ai ishte në gjendje t'i identifikonte ato rrënoja se ishin të xhamisë së Celinës.¹⁰³⁷ Mirëpo ai nuk mund të nxirrte asnjë përfundim nga fotografitë se a kishte qenë djegur apo hedhur në erë xhamia para se të rrafshohej me buldozer.¹⁰³⁸

388. Ekspertit të përbashkët të mbrojtjes për trashëgimi kulturore, Branimir Jokiqit, iu treguan dy fotografi të ndryshme të xhamisë në Celinë dhe ai tha se, bazuar në këto fotografi, ishte e pamundshme të thuhej se çfarë godine ishte dhe se ai nuk ishte në gjendje të përcaktonte nëse ishin fotografi të së njëjtës godine.¹⁰³⁹ Jokiqi gjithashtu komentoi në lidhje me regjistrin e kadastrës të përdorur nga Riedlmayer-i duke thënë se ajo ishte regjistruar si "shtëpi" dhe se, zakonisht, nëse do të ishte xhami ose kishë, do të shënohej në regjistër si "monument" ose "objekt fetar."¹⁰⁴⁰ Gjithsesi Jokiqi pranoi se nuk e konsideronte veten ekspert në fushën e objekteve fetare islame.¹⁰⁴¹

389. Dhoma Gjyqësore kujton dëshminë e Bozhidar Deliqit në të cilën ai mohon praninë e forcave të tij në Celinë më 28 mars 1999 ose shkatërrimin e xhamisë në Celinë nga forcat e tij dhe thekson se nuk ka dëshmi për implikimin e UJ-së në këtë shkatërrim.¹⁰⁴²

¹⁰³³ Agim Jemini, T. 4242 (28 shtator 2006); *shih gjithashtu* P1800 (Fotografi e xhamisë në Celinë).

¹⁰³⁴ P1773 (Pjesë nga P1789 në lidhje me xhaminë e Celinës); András Riedlmayer, T. 5466 (30 tetor 2006).

¹⁰³⁵ P1773 (Pjesë nga P1789 në lidhje me xhaminë e Celinës).

¹⁰³⁶ András Riedlmayer, T. 5560–5561 (31 tetor 2006); *shih gjithashtu* IC89 (shënim në P1800); IC90 (shënim në P2445).

¹⁰³⁷ András Riedlmayer, T. 5463–5466 (30 tetor 2006); P2445 (Fotografi e xhamisë në Celinë); P1800 (Fotografi e xhamisë në Celinë); *shih gjithashtu* P2444 (Pjesë nga regjistri i kadastrës për xhaminë e Celinës); IC89 (shënime në 1800); IC90 (shënim në P2445).

¹⁰³⁸ András Riedlmayer, T. 5468 (30 tetor 2006); P1800 (Fotografi e xhamisë në Celinë).

¹⁰³⁹ Branimir Jokiq, T. 25863–25864, 25866 (22 prill 2008); *shih gjithashtu* P2445 (Fotografi e xhamisë në Celinë); P1773 (Pjesë nga P1789 në lidhje me xhaminë e Celinës).

¹⁰⁴⁰ Branimir Jokiq, T. 25873–25874 (23 prill 2008); P2444 (Pjesë nga regjistri kadastrës për xhaminë e Celinës).

¹⁰⁴¹ Branimir Jokiq, T. 25942–25943 (23 prill 2008).

¹⁰⁴² Bozhidar Delliq, T. 19383, 19391 (29 nëntor 2007).

390. Bazuar në dëshminë e Sabri Popajt, e cila pjesërisht u konfirmua nga Agim Jemini, Reshit Salihi, dhe Andrés Riedlmayer, Dhoma konkludon se xhamia në Celinë u shkatërrua më 28 mars 1999 nga forcat e MPB-së, të cilat përdorën njëfarë lënde shpërthyes.

b. Bellacërka

391. Gjithashtu Popaj dëshmoi për shkatërrimin e xhamisë në Bellacërkë po të njëjtën ditë. Ai ishte në arë, një pjesë e së cilës shtrihet në një kodër midis Celinës dhe Bellacërkës.¹⁰⁴³ Popaj shpjegoi se ai ndodhej në anën e kodrës që shihte fshatrat kur kishte dëgjuar shpërthimin. Ai pa në drejtim të fshatit dhe vuri se xhamia nuk ishte më atje.¹⁰⁴⁴ Popaj e identifikoi xhaminë në fotografinë e cila iu tregua në sallën e gjyqit si xhamia e Bellacërkës.¹⁰⁴⁵

392. Andrés Riedlmayer-i raportoi për gjendjen e xhamisë në Bellacërkë duke e përshkruar si të dëmtuar rëndë dhe tha se "xhamia ishte dëmtuar nga granatimi, minareja ishte hedhur në erë, dhe pjesa e brendshme ishte djegur."¹⁰⁴⁶ Riedlmayer shpjegoi se e konsideronte xhaminë "të dëmtuar rëndë" sepse kishte shumë dëmtime në kulm, brendësi dhe në muret e jashtme.¹⁰⁴⁷ Duke përdorur një fotografi të xhamisë në Bellacërkë, ai shpjegoi se, duke u bazuar në gërmadhat e minaresë, vrimës në godinë, dhe gjurmët e rrënojave të rena, minareja ishte hedhur në erë.¹⁰⁴⁸

393. Sidoqoftë Riedlmayer-i shpjegoi se ai nuk e kishte vizituar këtë xhami personalisht, por vetëm kishte marrë fotografi dhe të dhëna nga disa burime.¹⁰⁴⁹ Vlerësimi në aktekspertizën e tij u bë në bazë të fotografive dhe të të dhënave që i kishte marrë nga burime mediatike.¹⁰⁵⁰ Në raportin e tij ai gjithashtu përmend fotografi satelitore të Bellacërkës para dhe pas dëmtimit, të marra nga faqja e internetit e NATO-s.¹⁰⁵¹ Në fotografinë e parë satelitore të bërë më 11 mars 1999, ai identifikoi xhaminë, minarenë e lartë, një kubë të madhe, dhe disa kubë të vogla. Në fotografinë e dytë të bërë më 2 prill 1999, ai tregoi se minareja nuk dukej më.¹⁰⁵²

¹⁰⁴³ Sabri Popaj, T. 5679 (1 nëntor 2006), 5730 (2 nëntor 2006).

¹⁰⁴⁴ Sabri Popaj, T. 5679 (1 nëntor 2006).

¹⁰⁴⁵ Sabri Popaj, T. 5678–5679 (1 nëntor 2006); *shih gjithashtu* IC96 (provë materiale e shënuar P1792, që tregon xhaminë e Bellacërkës pa minare).

¹⁰⁴⁶ P1774 (Pjesë nga P1789 në lidhje me xhaminë e Bellacërkës).

¹⁰⁴⁷ Andrés Riedlmayer, T. 5473 (30 tetor 2006).

¹⁰⁴⁸ Andrés Riedlmayer, T. 5472–5473 (30 tetor 2006); P1792 (Fotografi e xhamisë së Bellacërkës).

¹⁰⁴⁹ Andrés Riedlmayer, T. 5473 (30 tetor 2006), 5563 (31 tetor 2006).

¹⁰⁵⁰ Andrés Riedlmayer, T. 5473 (30 tetor 2006), 5563 (31 tetor 2006).

¹⁰⁵¹ P1774 (Pjesë nga P1789 në lidhje me xhaminë e Bellacërkës); P98 (fotografi satelitore të xhamisë së Bellacërkës të vendosura në faqen e internetit të NATO-s); Andrés Riedlmayer, T. 5523 (31 tetor 2006).

¹⁰⁵² Andrés Riedlmayer, T. 5524 (31 tetor 2006); P98 (fotografi satelitore të xhamisë së Bellacërkës të vendosura në faqen e internetit të NATO-s).

394. Branimir Jokiqi dëshmoi se nuk dispononte të dhënat e nevojshme për të vlerësuar konkluzionet e Riedlmayer-it në lidhje me xhaminë në Bellacërkë dhe se nuk ishte në gjendje të vizitonte vendin.¹⁰⁵³

395. Deliqi i cili dëshmoi se më 25 mars 1999 kaloi me forcat e tij nëpër Bellacërkë, tha se në atë kohë xhamia dhe minareja ishin të padëmtuara. Ai kaloi pranë në rrugën nga Rahoveci rreth 300-500 metra nga xhamia dhe zakonisht minareja dukej nga ajo largësi. Ai nuk ishte në gjendje të përcaktonte me qartësi nëse ajo ishte a padëmtuar ditëve të tjera kur kaloi në prill dhe maj 1999, meqenëse nuk kishte shikuar për dëmtime të xhamisë.¹⁰⁵⁴ Deliqi mohoi se forcat e tij mund të kishin shkatërruar xhaminë në Bellacërkë.¹⁰⁵⁵ Kur iu tregua një fotografi e fshatit e bërë në qershor 1999, ai pranoi se, në atë kohë minareja nuk ishte atje.¹⁰⁵⁶

396. Dhoma Gjyqësore është bindur se xhamia në Bellacërkë u hodh në erë dhe, si rezultat u dëmtua rëndë. Sidoqoftë, për shkak të mungesës së dëshmive të drejtpërdrejta në lidhje me autorët, Dhoma nuk mund të konkludojë jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se xhamia u dëmtua nga forcat e RFJ-së/Serbisë.

6. Krusha e Vogël

397. Në fillim të vitit 1999, Krusha e Vogël kishte 70 shtëpi me rreth 400 banorë kosovarë shqiptarë dhe 23 shtëpi me banorë serbë.¹⁰⁵⁷ Mehmet Krasniqi (më parë i njohur si Mehmet Avdyli), banor shqiptar kosovar i fshatit, dëshmoi se përveç pesë personave, i gjithë fshati ishte popullatë civile.¹⁰⁵⁸ Këta pesë vetë ishin në UÇK, por kur vinin në shtëpi vishnin rroba civile dhe Krasniqi nuk i kishte parë kurrë me armë zjarri në fshat.¹⁰⁵⁹ Ai me tej dëshmoi se serbët dhe shqiptarët kosovarë bashkëjetonin pak a shumë mirë me njëri tjetrin dhe se fshati nuk u sulmua nga "forcat serbe" deri në ditën kur filluan sulmet e NATO-s.¹⁰⁶⁰

¹⁰⁵³ Branimir Jokiq, T. 25938–25939 (23 prill 2008).

¹⁰⁵⁴ Bozhidar Deliq, T. 19626, 19628 (5 dhjetor 2007), 19632–19633 (6 dhjetor 2007); IC155 (Fotografi e shënuar nga Bozhidar Deliq).

¹⁰⁵⁵ Bozhidar Deliq, T. 19391 (29 nëntor 2007).

¹⁰⁵⁶ Bozhidar Deliq, T. 19632–19633 (6 dhjetor 2007); IC155 (Fotografi e shënuar nga Bozhidar Deliq).

¹⁰⁵⁷ Mehmet Krasniqi, T. 4384–4385 (29 shtator 2006), P2341 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8.

¹⁰⁵⁸ Mehmet Krasniqi, T. 4367–4368 (29 shtator 2006), P2341 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8, (deklarata e dëshmitarit e datës 5 tetor 2001), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 2.

¹⁰⁵⁹ Mehmet Krasniqi, P2341 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 tetor 2001), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 2.

¹⁰⁶⁰ Mehmet Krasniqi, P2341 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8.

a. Operacionet në zonën e Krushës së Vogël

398. K25, ish-polic i cili në vitin 1998 dhe 1999 ishte pjesëtar i Detashmentit të 23-të të PJP-së, dëshmoi për operacionin e koordinuar në mars 1999 në komunat e Rahovecit dhe Prizrenit të përmendura më lart, në të cilat ai mori pjesë, konkretisht në Krushë të Vogël.¹⁰⁶¹

399. Forcat pjesëmarrëse në operacionin në zonën e Krushës së Vogël dhe Krushës së Madhe përfshinin PJP-në, rezervistët vendorë të MPB-së, dhe njësi vendore të MPB-së, që kishin mbështetjen e UJ-së.¹⁰⁶² Konkretisht një tank i UJ-së T-55 ishte në Krushë të Madhe dhe katër autoblanda BOV u dislokuan në pika të ndryshme përgjatë rrugës midis Krushës së Vogël dhe Krushës së Madhe.¹⁰⁶³ Zona e përgjithshme e përgjegjësisë e Detashmentit të 23-të të PJP-së ishte nga Krusha e Vogël deri në Xërxë dhe prej Xërxës në Bellacërkë.¹⁰⁶⁴ Anëtarët e njësisë së K25-s u urdhëruan të shkonin në Krushë të Vogël me qëllim që të mbanin bllokadën nga Rogova deri në Krushë të Vogël dhe të zmbarsnin "terroristët" në drejtim të Malishevës. Plani ishte që civilët të lëviznin drejt Prizrenit.¹⁰⁶⁵

400. K25-a e përshkroi operacionin pasues si operacion spastrimi, që do të thotë operacion për zmbarsjen e UÇK-në në drejtim të Malishevës dhe grumbullimin e popullatës civile ndërsa dilnin nga zona e operacionit dhe vendosjen e tyre prapa vijës së bllokadës në jugperëndim.¹⁰⁶⁶ UJ-ja synonte t'a vinte këtë zonë nën kontroll të plotë.¹⁰⁶⁷ Detyra e njësisë së K25-s ishte të ruante pjesë të rrugës së Prizrenit dhe të ishte e pranishme atje për të parandaluar infiltrimin e UÇK-së përmes vijave të tyre dhe grumbullimin e "refugjatëve" që dilnin nga fshatrat në rrugë. Më pas "refugjatët" duhej t'i dorëzoheshin forcave vendore të MPB-së. Vetë K25-a dorëzoi më shumë se 5.000 burra, gra e fëmijë. Nga ana e tyre forcat vendore të MPB-së i ndanë burrat nga gratë e fëmijët. Për gratë e fëmijët u organizua transport, kurse burrat u detyruan të ecnin.¹⁰⁶⁸ SPB-ja e Prizrenit ishte

¹⁰⁶¹ K25, T. 4656–4657 (11 tetor 2006) (seancë private), T. 4706–4708 (12 tetor 2006), P2439 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 shtator 2001), f. 8–19.

¹⁰⁶² K25, T. 4668–4674 (11 tetor 2006), P2439 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 shtator 2001), f. 6–11.

¹⁰⁶³ K25, P2439 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 shtator 2001), f. 10.

¹⁰⁶⁴ K25, P2439 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 shtator 2001), f. 8, 10, T. 4669 (11 tetor 2006); IC80 (Harta P109 e shënuar nga K25 që tregon pozicionet e njësisë së tij dhe njësite të tjera në operacionet Rahovec-Prizren).

¹⁰⁶⁵ K25, P2439 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 shtator 2001), f. 7–8.

¹⁰⁶⁶ K25, P2439 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 shtator 2001), f. 8–9, 11, T. 4744 (12 tetor 2006), P2527 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 7825, 7860–7862, 7867.

¹⁰⁶⁷ K25, P2439 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 shtator 2001), f. 11, P2527 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 7825, 7832.

¹⁰⁶⁸ K25, P2439 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 shtator 2001), f. 9, P2527 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 7826, 7834.

përgjegjëse për organizimin e transportit të këtyre njerëzve dhe u përdorën kamionë dhe autobusë civilë.¹⁰⁶⁹

401. K25-a qartësoi se gjatë periudhës 25-29 mars 1999, ai nuk hyri asnjëherë në Krushë të Vogël dhe nuk vuri re asgjë që ta paralajmëronte për vrasjen e një grupi të madh meshkujsh më 26 mars.¹⁰⁷⁰ Gjatë qëndrimit të tij afër fshatit, ai pa vetëm dy ose tri shtëpi duke u djegur.¹⁰⁷¹ Ai nuk pa "refugjatë" duke dalë nga Krusha e Vogël më 26 mars 1999.¹⁰⁷² Gjatë fazës së pyetjeve nga pala tjetër K25-a se UJ-ja nuk hapi zjarr nga tanket e veta të vendosura në Krushë të Madhe dhe Krushë të Vogël.¹⁰⁷³

b. Sulmi mbi Krushën e Vogël më 25 mars 1999

402. Mehmet Krasniqi i cili i la përshtypje Dhomës si dëshmitar i çiltër, dëshmoi se më 25 mars 1999 rreth orës 03:00 u zgjua nga zhurma e "tankeve ushtarake," autoblivande, Pragave, dhe artilerisë së rëndë në Krushë të Vogël. Ata ishin vendosur përgjatë rrugës Prizren-Gjakovës rreth 250 metra nga shtëpia e tij.¹⁰⁷⁴ Atë ditë, të gjithë shqiptarët kosovarë në fshat, përfshirë edhe Krasniqin dhe familjen e tij, ikën drejt pyjeve në mal.¹⁰⁷⁵ Kur filloi të agonte, tanket hapën zjarr në drejtim të malit. Forca të përziera ushtarake dhe paraushtarake hapën zjarr me artileri të rëndë mbi kokat e fshatarëve në drejtim të pyllit.¹⁰⁷⁶ Kjo zgjati rreth një orë dhe më pas ata filluan të digjin fshatin.¹⁰⁷⁷ Krasniqi gjithashtu pa forca të MPB-së duke marrë makinat dhe traktorët.¹⁰⁷⁸ Fshatarët serbë vendas morën pjesë në sulm së bashku me MPB-në dhe UJ-në.¹⁰⁷⁹

403. Lutfi Ramadani, gjithashtu banor shqiptar kosovar i Krushës së Vogël, i la përshtypje Dhomës si dëshmitar i besueshëm i cili dha dëshmi të sakta në lidhje me ngjarjet në fshat në fund të

¹⁰⁶⁹ K25, P2439 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 shtator 2001), f. 12, P2527 (transkript nga *Prokurori kundër Milloshëviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 7826–7827.

¹⁰⁷⁰ K25, T. 4698–4702, 4711–4712 (12 tetor 2006); IC83 (Harta P99, e shënuar nga K25, që tregon çfarë mund të shihej nga Krusha e Vogël nga shtëpia e Hajdarit).

¹⁰⁷¹ K25, P2439 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 shtator 2001), f. 17, T. 4698–4702 (12 tetor 2006).

¹⁰⁷² K25, P2439 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 shtator 2001), f. 17.

¹⁰⁷³ K25, T. 4717 (12 tetor 2006).

¹⁰⁷⁴ Mehmet Krasniqi, P2341 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 prill 1999), versioni elektronik f. 8, T. 4372–4373, 4382–4384 (29 shtator 2006); *Shih gjithashtu* IC73 (Shënimet e bëra nga Mehmet Krasniqi në P99 që përmban fotografi ajrore të Krushës së Vogël).

¹⁰⁷⁵ Mehmet Krasniqi, P2341 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8, T. 4372–4373 (29 shtator 2006).

¹⁰⁷⁶ Mehmet Krasniqi, P2341 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8, P2341 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 tetor 2001), versioni elektronik f. 2.

¹⁰⁷⁷ Mehmet Krasniqi, P2341 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8.

¹⁰⁷⁸ Mehmet Krasniqi, P2341 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 prill 1999, 5 tetor 2001, dhe 7 mars 2002), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8.

¹⁰⁷⁹ Mehmet Krasniqi, T. 4393 (29 shtator 2006).

marsit 1999. Ai konfirmoi se herët në mëngjes më 25 mars 1999 fshati u rrethua nga tanket, Prगत, armë artilerike kundërajrore, dhe autoblanda.¹⁰⁸⁰ Nga shtëpia e tij, e cila gjendej në skaj të fshatit, ai kishte qenë në gjendje të shihte rrugën Prizren-Gjakovë dhe pa se ajo ishte mbushur me tanke dhe armë artilerike.¹⁰⁸¹ Më pas MPB-ja hyri në fshat me autoblanda dhe filloi të qëllonte, hynte nëpër shtëpi dhe u vinte zjarrin.¹⁰⁸² MPB-ja kishte topa mbi autoblanda prej të cilëve u hap zjarr mbi fshatin.¹⁰⁸³ UJ-ja nuk përdori artilerinë, por "spastronte" terrenin.¹⁰⁸⁴ Ai pa forca me uniforma të ndryshme: disa i kishin te zeza, kurse të tjerët kishin uniforma kamuflimi shumëngjyrëshe. Ramadani shpjegoi se uniformat e zeza nuk ishin saktësisht të zeza; sidoqoftë ai i quante të zeza.¹⁰⁸⁵

404. Serbët e fshatit ndihmuan në djegien e shtëpive. Vendasit prinin duke treguar se cilat shtëpi ishin të shqiptarëve kosovarë. Ata gjithashtu morën pjesë në vrasjet në fshat.¹⁰⁸⁶ Ata kishin uniformat të "milicisë," por disa ishin pa uniforma. Ata kishin shami të bardha dhe të kuqe në kokë, si shirita të lidhur rreth kokës.¹⁰⁸⁷ Më tej Ramadani shpjegoi se serbët vendas kishin uniforma të ndryshme, të cilat ata i ndërronin shpesh; disa kishin uniforma të MPB-së, UJ-së, dhe uniforma të "paraushtarakëve" dhe ata gjithashtu kishin edhe uniforma të rezervistëve.¹⁰⁸⁸

405. Në lidhje me rezervistët e MPB-së, Ramadani tha se ata ndonjëherë i vishnin uniformat e veta e ndonjëherë jo; ai gjithashtu kishte parë rezervistë me uniforma të gjelbra.¹⁰⁸⁹ Ramadani tregoi emrat e disa prej serbëve vendas të implikuar, ndër të cilët edhe efektivë të rregullt të MPB-së, si Momçillo Nikoliqi, Sava Nikoliqi, dhe Gjorgje Cvetkoviqi.¹⁰⁹⁰ Kafeneja e Dimitrije Nikoliqit përdorej nga serbët civilë dhe me uniforma si vend i rregullt tubimi.¹⁰⁹¹ Gjatë ngjarjeve të 25 marsit

¹⁰⁸⁰ Lutfi Ramadani, T. 4284–4285, 4317 (28 shtator 2006).

¹⁰⁸¹ Lutfi Ramadani, T. 4284–4285 (28 shtator 2006), T. 4339–4340, 4354 (29 shtator 2006); IC68 (shënimet në fotografinë ajrore të Krushës së Vogël P99); IC70 (shënimet në fotografinë ajrore të Krushës së Vogël P99).

¹⁰⁸² Lutfi Ramadani, T. 4285–4286, 4317 (28 shtator 2006). Ramadani përdori shprehjen "milicia" për t'iu referuar MPB-së (policisë). *Shih* Lutfi Ramadani, T. 4334 (28 shtator 2006), T. 4343–4345, 4359–4360 (29 shtator 2006); *shih gjithashtu* IC71 (shënimet në fotografinë ajrore të Krushës së Vogël P99); IC72 (shënimet në fotografinë ajrore të Krushës së Vogël P99).

¹⁰⁸³ Lutfi Ramadani, T. 4344 (29 shtator 2006), 6D87 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 6721.

¹⁰⁸⁴ Lutfi Ramadani, T. 4344 (29 shtator 2006), 6D87 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 6721.

¹⁰⁸⁵ Lutfi Ramadani, T. 4285–4286 (28 shtator 2006), T. 4364 (29 shtator 2006).

¹⁰⁸⁶ Lutfi Ramadani, T. 4286–4287, 4325 (28 shtator 2006).

¹⁰⁸⁷ Lutfi Ramadani, T. 4286 (28 shtator 2006).

¹⁰⁸⁸ Lutfi Ramadani, T. 4287, 4321–4322, 4335 (28 shtator 2006), T. 4363–4365 (29 shtator 2006).

¹⁰⁸⁹ Lutfi Ramadani, T. 4320–4321 (28 shtator 2006).

¹⁰⁹⁰ Lutfi Ramadani, T. 4286–4287, 4320 (28 shtator 2006). Ai përmendi Dimitrije Nikoliqin, Ranko Nikoliqin, Momçillo Nikoliqin, Sava Nikoliqin, Sreto Thaqin, Zllatko Gjorgjeviqin, Gjorgje Cvetkoviqin, Ranko Petkoviqin, Çedomir Petkoviqin, Rasko Nikoliqin, Dragi Çvetkoviqin, dhe Sveta Tasiqin.

¹⁰⁹¹ Lutfi Ramadani, T. 4321 (28 shtator 2006), T. 4360–4362 (29 shtator 2006); *Shih gjithashtu* IC72 (shënime në fotografinë ajrore të Krushës së Vogël P99).

1999, MPB-ja ishte vendosur në shtëpinë e Nikoliqit.¹⁰⁹² Dhoma Gjyqësore vëren se të dhënat zyrtare të marra nga MPB-ja konfirmojnë dëshminë e Ramadanit në lidhje me anëtarët vendorë të MPB-së.¹⁰⁹³

406. Mehmet Krasniqi dëshmoi se gjatë sulmit ai pa tri lloje uniformash në Krushë të Vogël: paraushtarakët me uniforma kamuflimi me shirita të verdhë në anën e majtë të gjoksit dhe shirita të bardhë në pjesën e epërme të krahut; ushtarakët me pantallona të gjelbra kamuflimi dhe këmisha të gjelbra, MPB-ja me uniforma të kaltra kamuflimi dhe shirita të verdhë në krahë.¹⁰⁹⁴ Edhe pse fillimisht ai tha se kishte parë MPB-në me uniforma në të "verdhë" të mbyllët me lara, më vonë u bë e qartë se ai kishte menduar "kaltër" kur kishte thënë "verdhë."¹⁰⁹⁵ Krasniqi gjithashtu konfirmoi se pak para marsit 1999, shumë serbë të aftë fizikisht filluan të vishnin uniforma rezervistësh ose uniforma të tjera. Këta burra mbanin armë dhe udhëtonin me makina private e jo në makina të shënuara të policisë.¹⁰⁹⁶ Gjatë sulmit në fshat, ai i pa ata së bashku me UJ-në dhe MPB-në.¹⁰⁹⁷

407. Ramadani dëshmoi se banorët vendas ikën në drejtim të pyllit kur MPB-ja filloi të shtinte dhe t'u vinte zjarrin shtëpive.¹⁰⁹⁸ Shumica e fshatarëve, gjithsej rreth 500 a më shumë, u mbledhën në pyll. Ndërsa ishte i fshehur, Ramadani dëgjoi krisma armësh.¹⁰⁹⁹ Rreth orës 19:00, kur u bë ftohtë, Ramadani dhe fshatarët e tjerë, me përjashtim të dy familjeve të cilët mbetën aty, shkuan në shtëpinë e Sejdi Batushës në fshat, ku kaluan natën.¹¹⁰⁰

408. Në mëngjesin e 26 marsit, serbët e fshatit, të ndihmuar nga serbë "të tjerë" me uniforma policore, hapën zjarr dhe filluan plaçkitjen dhe bastisjen e shtëpive, duke marrë me vete gjërat më të

¹⁰⁹² Lutfi Ramadani, T. 4359–4361 (29 shtator 2006).

¹⁰⁹³ P2335 (Përgjigjet ndaj Kërkesës së Prokurorisë për Ndihmë në lidhje me personat që mund të kenë shërbyer në UJ ose MPB dhe të atyre që kanë pasur status të rezervistit të MPB-së, 31 korrik 2006), f. 2, kërkesa 1098; Çështje Provash, T. 4408–4410 (29 shtator 2006). *Shih gjithashtu* P2849 (të dhënat e kuadrit të MPB-së për Dimitrije Nikoliqin); P2850 (të dhënat e kuadrit të MPB-së për Zvezdan Nikoliqin); P2851 (të dhënat e kuadrit të MPB-së për Goran Nikoliqin); P2852 (të dhënat e kuadrit të MPB-së për Sllavisha Petkoviqin); P2853 (të dhënat e kuadrit të MPB-së për Goran Petkoviqin); P2854 (të dhënat e kuadrit të MPB-së për Sasha Gërkoviqin); John Sweeney, T. 4826–4827, 4871–4872 (13 tetor 2006), P2383 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 janar 2001), f. 8, 11–12; P2327 (Lista e shkruar me dorë e emrave të serbëve të cilët banonin në Krushë të Vogël); P2384 (videofilmime nga John Sweeney), video nr. 4. *Por shih* Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 871; Lutfi Ramadani, T. 4307 (28 shtator 2006); P2357 (listë e emrave të dhënë nga Lutfi Ramadani), f. 4.

¹⁰⁹⁴ Mehmet Krasniqi, P2341 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 tetor 2001), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 2, P2341 (deklarata e dëshmitarit e datës 7 mars 2002), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 5; *shih gjithashtu* Mehmet Krasniqi, T. 4373 (29 shtator 2006).

¹⁰⁹⁵ Mehmet Krasniqi, T. 4373 (29 shtator 2006).

¹⁰⁹⁶ Mehmet Krasniqi, T. 4388–4389 (29 shtator 2006).

¹⁰⁹⁷ Mehmet Krasniqi, T. 4393 (29 shtator 2006).

¹⁰⁹⁸ Lutfi Ramadani, T. 4287–4288, 4318 (28 shtator 2006); IC64 (shënimi i fotografisë ajrore të Krushës së Vogël P99).

¹⁰⁹⁹ Lutfi Ramadani, T. 4288 (28 shtator 2006).

¹¹⁰⁰ Lutfi Ramadani, T. 4288–4290 (28 shtator 2006); IC65 (shënimi i fotografisë ajrore të Krushës së Vogël P99).

vlefshme, traktorët, dhe makinat. Pasi i nxirrnin të gjitha gjërat me vlerë nga shtëpitë, ata u vinin zjarrin shtëpive.¹¹⁰¹ Kur një fshatar i quajtur Hysen Ramadani, i cili gjithashtu njihej si Hysen Kanjusha, shkoi të nxirrte lopët që të mund të kullosnin, "serbët" e kishin vrarë.¹¹⁰² Ramadani nuk mundi të shihte autorin e vrasjes.¹¹⁰³

409. Ndërsa po u vinin zjarrin shtëpive, MPB-ja iu afrua oborrit të Batushëve. Ata zunë pozicione në shtëpinë e Milaim Batushës.¹¹⁰⁴ Më pas urdhëruan Aziz Shehun që të shkonte e t'i mblidhte njerëzit që ishin ende të fshehur në pyll dhe t'i sillte në fshat. Ata i urdhëruan të gjithë që të dilnin në rrugën kryesore. Aty i ndanë gratë dhe fëmijët nga burrat. Djemtë e moshë 13-vjeçare e përmbi u urdhëruan t'i bashkoheshin grupit të burrave.¹¹⁰⁵ Në grupin e burrave përfshiheshin edhe pleqtë, rreth 14 adoleshentë, dy me të meta psikike, dhe dy burra të paralizuar, gjegjësisht, Liman dhe Sait Hajdari.¹¹⁰⁶ Një police me "uniformë të zeze policie" iu tha grave të shkonin në Shqipëri. Ato morën rrugën në drejtim të lumit Drin.¹¹⁰⁷

410. Krasniqi e konfirmoi përgjithësisht këtë dëshmi, duke dëshmuar se në mëngjesin e 26 marsit një grup prej rreth 15 policësh shkuan në pyll, ku ishin fshehur fshatarët. Krasniqi, i cili edhe vetë ishte me atë grup, pa tre anëtarë të MPB-së që kishin shirita të bardhë në krah dhe të cilët jepnin urdhra. Policët kishin uniforma të ndryshme.¹¹⁰⁸ Gratë dhe fëmijët u ndanë nga burrat e djemtë e vegjël dhe u urdhëruan të shkonin në Shqipëri. Afërsisht 110 burra dhe djem,¹¹⁰⁹ përfshirë edhe 13-vjeçarin Mehmet Shehu, 13-vjeçarin Xhelal Shehu, dhe ungjin 72-vjeçar të Mehmet Krasniqit, Avdyli Balin, u kontrolluan dhe ua morën paratë, letërnjoftimet, dhe kuletat.¹¹¹⁰

411. Si Krasniqi, po ashtu edhe Ramadani dëshmuar se pas largimit të grave, burrat u detyruan të binin në gjuhë me duart prapa koke.¹¹¹¹ Pastaj policët me "uniforma të zeza" i urdhëruan të

¹¹⁰¹ Lutfi Ramadani, T. 4290–4291 (28 shtator 2006).

¹¹⁰² Lutfi Ramadani, T. 4291, 4316 (28 shtator 2006); IC67 (shënimi i fotografisë ajrore të Krushës së Vogël P99).

¹¹⁰³ Lutfi Ramadani, T. 4292 (28 shtator 2006).

¹¹⁰⁴ Lutfi Ramadani, T. 4292 (28 shtator 2006).

¹¹⁰⁵ Lutfi Ramadani, T. 4292–4293 (28 shtator 2006).

¹¹⁰⁶ Lutfi Ramadani, T. 4296, 4299 (28 shtator 2006); Mehmet Krasniqi, P2341 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 9, T. 4373–4374, 4397 (29 shtator 2006).

¹¹⁰⁷ Lutfi Ramadani, T. 4294, 4323, 4324 (28 shtator 2006).

¹¹⁰⁸ Mehmet Krasniqi, P2341 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8, T. 4393–4394 (29 shtator 2006).

¹¹⁰⁹ Lutfi Ramadani, T. 4299 (28 shtator 2006).

¹¹¹⁰ Mehmet Krasniqi, P2341 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8; Lutfi Ramadani, T. 4295 (28 shtator 2006).

¹¹¹¹ Mehmet Krasniqi, P2341 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8; Lutfi Ramadani, T. 4295 (28 shtator 2006).

ngriheshin në këmbë dhe të rreshtoheshin në kolonë për tre. Policët sulmuan këdo që ngrinte kokën duke i shkelmuar.¹¹¹²

412. Më tej pjesëtarët e MPB-së e çuan grupin e meshkujve deri në stallën e një fshatari shqiptar të quajtur "Haxhi Batusha" ose "Qazim Batusha," e cila gjendej midis fshatit dhe pyllit.¹¹¹³ Gjatë rrugës në të cilën po ecnin, Ramadani pa një numër policësh, disa prej të cilëve i njihte.¹¹¹⁴ Stalla kishte dy kthina dhe një korridor dhe ishte e pabanuar e pa orendi.¹¹¹⁵ Rreth orës 11:00, grupin e burrave e futën në dy kthina të vogla të stallës.¹¹¹⁶

413. Krasniqi dëshmoi se dhoma në të cilën ishte kishte dy dritare në dy anët ngjitur me njëra-tjetrës dhe derën për në korridor.¹¹¹⁷ Ai ishte në anën e kundërt të dritareve dhe të derës.¹¹¹⁸ Ramadani gjithashtu dëshmoi se policët qëndruan jashtë.¹¹¹⁹ Pastaj policët hapën zjarr mbi burrat pa kurrfarë paralajmërimi.¹¹²⁰ Krasniqi ra në tokë menjëherë dhe u mbulua nga trupat. Plumbat erdhën nga dritaret dhe vazhduan për shumë minuta.¹¹²¹ Ramadani tha se më pas hyri një polic me pushkë dhe i vrau të gjithë ata që ngritën kokën.¹¹²²

414. Ndërsa ishte i shtrirë përtokë, Krasniqi dëgjoi një burrë, Shefqet Shehun, duke thirrur njërin nga serbët që mori pjesë në vrasje, Momçillo Nikoliqin, edhe pse Krasniqi nuk e pa Nikoliqin në atë moment.¹¹²³ Pas ndërprerjes së të shtënave, MPB-ja hodhi sanë mbi kufomat dhe u vuri zjarrin.¹¹²⁴

¹¹¹² Mehmet Krasniqi, P2341 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8; Lutfi Ramadani, T. 4295, 4324 (28 shtator 2006).

¹¹¹³ Krasniqi e quajti vendin "shtëpia e Haxhi Batushës" dhe shpjegoi: "Kur është ndërtuar, ajo ka qenë shtëpi dydhomëshe me korridor. Kur na çuan në të, një pjesë ishte e mbushur me sanë. Pjesa ku isha unë, në anën e djathtë, kishte sanë brenda. Kjo është arsyeja pse ndonjëherë e kemi quajtur stallë e ndonjëherë shtëpi." Mehmet Krasniqi, T. 4395–4396 (29 shtator 2006). Ramadani e quajti "stalla e Qazim Batushës." Lutfi Ramadani, T. 4295 (28 shtator 2006), 4350 (29 shtator 2006); IC66 (shënime në fotografinë ajrore të Krushës së Vogël P99); IC69 (shënime në fotografinë ajrore të Krushës së Vogël P99); 3D121 (Fotografi të zonës së Krushës së Vogël), f. 3 (fotografi e oborrit të shtëpisë së Batushës).

¹¹¹⁴ Lutfi Ramadani, T. 4299 (28 shtator 2006).

¹¹¹⁵ Mehmet Krasniqi, T. 4395 (29 shtator 2006); Lutfi Ramadani, T. 4298 (28 shtator 2006).

¹¹¹⁶ Mehmet Krasniqi, P2341 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8–9, T. 4396 (29 shtator 2006); *shih gjithashtu* Mehmet Krasniqi, T. 4373–4374, 4397 (29 shtator 2006); Lutfi Ramadani, T. 4299 (28 shtator 2006).

¹¹¹⁷ Mehmet Krasniqi, P2341 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 9; *shih gjithashtu* T. 4373–4374, 4397 (29 shtator 2006); Lutfi Ramadani, T. 4299 (28 shtator 2006).

¹¹¹⁸ Mehmet Krasniqi, P2341 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 9; *shih gjithashtu* T. 4373–4374, 4397 (29 shtator 2006); Lutfi Ramadani, T. 4299 (28 shtator 2006).

¹¹¹⁹ Lutfi Ramadani, T. 4300, 4327 (28 shtator 2006).

¹¹²⁰ Mehmet Krasniqi, P2341 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 9; *shih gjithashtu* T. 4373–4374, 4397 (29 shtator 2006); Lutfi Ramadani, T. 4300 (28 shtator 2006).

¹¹²¹ Mehmet Krasniqi, P2341 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 9; *shih gjithashtu* T. 4373–4374, 4397 (29 shtator 2006).

¹¹²² Lutfi Ramadani, T. 4300, 4328 (28 shtator 2006).

¹¹²³ Mehmet Krasniqi, T. 4373–4375, 4396 (29 shtator 2006).

Krasniqi ishte ende në fund të grumbullit të njerëzve të vdekur dhe të plagosur. Ai i shtyu trupat dhe u ngrit në këmbë. Ai arriti të ikte duke kërcyer nga një dritare anësore dhe vrapoi drejt shtëpisë së xhaxhait që ishte ngjitur dhe u fsheh në bodrum.¹¹²⁵

415. Ramadani nuk u godit asnjëherë gjatë të shtënave, por u dogj në anën e djathtë të trupit dhe të kokës.¹¹²⁶ Ai arriti të ikte përmes derës së hyrjes së bashku me dy burra të tjerë, Bajram Zylfiun dhe "Agimin."¹¹²⁷ Atij iu desh të shtynte kufomën e Sait Hajdarit, që ia kishte zënë rrugën, për të dalë jashtë.¹¹²⁸ Midis të vrarëve ishin djemtë e Ramadanit, Bajrami (14 vjeç) dhe Afrimi (27 vjeç), vëllai i vet Murat Ramadani (54 vjeç), dhe nipi Selajdin Ramadani (28 vjeç).¹¹²⁹

416. Krasniqi dëshmoi se më vonë doli nga bodrumi ku ishte fshehur për të parë çfarë po ndodhte jashtë, sepse donte të ikte në kodra. Ai pa pjesëtarë të MPB-së me uniforma të kaltra kamuflimi së bashku me civilë kur vodhën Mercedesin e bardhë të xhaxhait dhe kur përplasën një makinë tjetër në shtëpi.¹¹³⁰ Ai gjithashtu pa dy civilë serbë pa uniforma, Sllavisha Petkoviqin dhe Lubisha Stankoviqin, duke vënë kashtë të thatë mbi kufomat për ta shtuar zjarrin në stallë.¹¹³¹ Më pas Krasniqi u tërhoq në pyll, ku qëndroi afërsisht deri në mesnatë duke parë stallën në të cilën ishin vrarë burrat. Mbajtja gjallë e zjarrit vazhdoi deri në mesnatë. Ai qëndroi dy ditë në pyll, pasi prej aty ishte në gjendje të shikonte çfarë po ndodhte në fshat dhe MPB-ja ishte ende në afërsi. Fshati vazhdoi të digjej për disa ditë me radhë.¹¹³²

417. Pasi iku nga stalla që po digjej, Ramadani pa parë disa policë duke folur me njëri-tjetrin dhe disa serbë të fshatit, ndër të cilët Boshko Stankoviqi, Stanko Nikoliqi, Rade Nikoliqin, dhe Boshko Cvetkoviqi.¹¹³³ Ramadani dhe ata që e shoqëronin ikën përmes një rruge të paasfaltuar në drejtim të

¹¹²⁴ Mehmet Krasniqi, P2341 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 9, T. 4374–4376 (29 shtator 2006); Lutfi Ramadani, T. 4300, 4328 (28 shtator 2006).

¹¹²⁵ Mehmet Krasniqi, P2341 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 9, T. 4374–4376 (29 shtator 2006); *shih gjithashtu* P2343 (video e bërë gjatë intervistës si dëshmitar të Mehmet Krasniqit më 4 prill 1999) (tregon lëndimet e Krasniqit); Mehmet Krasniqi, T. 4368–4369 (29 shtator 2006).

¹¹²⁶ Lutfi Ramadani, T. 4301, 4313 (28 shtator 2006).

¹¹²⁷ Lutfi Ramadani, T. 4300–4301, 4305 (28 shtator 2006).

¹¹²⁸ Lutfi Ramadani, T. 4299–4300, 4311–4312 (28 shtator 2006); P101 (fotografi e karrocës së invalidëve), f. 1.

¹¹²⁹ Lutfi Ramadani, T. 4302 (28 shtator 2006).

¹¹³⁰ Mehmet Krasniqi, P2341 (deklarata e dëshmitarit e datës 7 mars 2002), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 9, 16, 6D89 (Deklarata e dëshmitarit Mehmet Krasniqi), f. 2.

¹¹³¹ Mehmet Krasniqi, P2341 (deklarata e dëshmitarit e datës 7 mars 2002), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 9, 16, T. 4398–4399 (29 shtator 2006).

¹¹³² Mehmet Krasniqi, P2341 (deklarata e dëshmitarit e datës 7 mars 2002), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 9, T. 4375 (29 shtator 2006).

¹¹³³ Lutfi Ramadani, T. 4301 (28 shtator 2006); *shih gjithashtu* John Sweeney, T. 4827–4829 (13 tetor 2006), P2383 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 janar 2001), f. 5; P2384 (videofilmime nga John Sweeney), video nr. 5.

Krushës së Madhe.¹¹³⁴ Ai qëndroi 10 ditë në malet afër Krushës së Vogël. Më pas ai shkoi në drejtim të lumit Drin dhe së bashku me katër vetë qëndroi pesë javë të tjera në "Bjeshkët e Hasit."¹¹³⁵

418. Para se të largohej për në Shqipëri, Krasniqi shkoi në fshatin Nagafc ku iu dha ndihmë mjekësore.¹¹³⁶ Rrugës për në Shqipëri, ai u ndal nga policë serbë në kalimin kufitar të Vërbnicës (Morinë) dhe u pyet se si ishte djegur. Ai u tha se shtëpia e tij kishte qenë duke u djegur dhe ai ishte lënduar kur po përpiqej të merrte batanijet. Policët e lidhën pas një ngrohësi të instaluar në mur, e akuzuan se ishte pjesëtar i UÇK-së, dhe i thanë se ishte lënduar nga predhat e tyre. Pas gjysmë ore e liruan.¹¹³⁷

419. Ramadani u kthye në Krushë të Vogël rreth datës 15 qershor 1999 dhe pa se të gjitha shtëpitë e shqiptarëve kosovarë ishin djegur, kurse shtëpitë e serbëve dhe romëve ishin në gjendje të mirë.¹¹³⁸ Ai shkoi në stallën e Batushës dhe pa se ishte hedhur në erë dhe ishte rrafshuar me buldozer. Ai gjeti këpucë të djegura, mëngë, dhe copa rrobash.¹¹³⁹

420. Gjithashtu Ramadani dëshmoi se personat e përmendur më poshtë qëndruan në shtëpi sepse besonin se askush nuk do t'i trazonte, por më 25 mars 1999 u dogjën në shtëpitë e veta: Sali Shyqri Shehu, Reshat Shyqri Shehu, Dervish Shyqri Shehu, Raif Shyqri Shehu, Nexhat Shyqri Shehu, Sejdi Emërllahu, Nazmi Rashkaj, Demir Nazmi Rashkaj, dhe Hisni Rashka.¹¹⁴⁰ Ramadani dëshmoi se ata gjetur skeletet e tyre të djegura, që i varrosën.¹¹⁴¹ Dhoma thekson se emrat e këtyre nëntë personave nuk janë në Shtojcën C të Aktakuzës dhe se Prokuroria shpjegoi se i kishte përmendur për të krijuar pasqyrë të plotë to provave.¹¹⁴²

421. Kur u kthye në shtëpi më 26 qershor 1999, Krasniqi shkoi në stallë së bashku me njerëz të tjerë nga fshati. Ata gjetën pjesë të një kafke, pjesë brinjësh dhe këmbësh si dhe këpucë. Sipas Krasniqit, "serbët e fshatit" përgjegjës për masakrën e kishin pastruar vendin dhe i kishin hedhur

¹¹³⁴ Lutfi Ramadani, T. 4302–4303 (28 shtator 2006).

¹¹³⁵ Lutfi Ramadani, T. 4304–4305 (28 shtator 2006).

¹¹³⁶ Mehmet Krasniqi, P2341 (deklarata e dëshmitarit e datës 7 mars 2002), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 9, 16, T. 4375–4376 (29 shtator 2006); Ali Hoti, T. 4148–4151 (27 shtator 2006).

¹¹³⁷ Mehmet Krasniqi, P2341 (deklarata e dëshmitarit e datës 7 mars 2002), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 9–10.

¹¹³⁸ Lutfi Ramadani, T. 4310 (28 shtator 2006); *shih gjithashtu* John Sweeney, T. 4821–4823, 4835 (13 tetor 2006).

¹¹³⁹ Lutfi Ramadani, T. 4311 (28 shtator 2006); P100 (Fotografitë e shtëpisë së Batushës të bëra nga ekipi kriminalistik britanik), f. 3–4; *shih gjithashtu* John Sweeney, P2383 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 janar 2001), f. 5.

¹¹⁴⁰ Lutfi Ramadani, T. 4307–4310 (28 shtator 2006); P2357 (lista me emra e dhënë nga Lutfi Ramadani), f. 4.

¹¹⁴¹ Lutfi Ramadani, T. 4308 (28 shtator 2006).

¹¹⁴² Lutfi Ramadani, T. 4308–4309 (28 shtator 2006).

mbetjet në lumin Drin.¹¹⁴³ Krasniqi e Ramadani dëshmuar se masakrës i shpëtuan këta persona: Mehmet Krasniqi, Lutfi Ramadani, Agim Asllani, Petrit Rashkaj, Bajram Zylfiu, Qamil Haki Shehu, Mehmet Ukë Krasniqi, dhe Sefer Batusha.¹¹⁴⁴

422. Mehmet Krasniqi dhe Lutfi Ramadani i identifikuan personat e vrarë në stallën e Haxhi Batushës.¹¹⁴⁵ Provat në lidhje me secilin nga këta persona diskutohet në Shtojcën A.

423. John Paul Sweeney, gazetar hulumtues, bëri dy dokumentarë në lidhje me ngjarjet në Krushë të Vogël.¹¹⁴⁶ Sweeney takoi mbijetuesit e vrasjeve në stallë; Mehmet Krasniqin (Avdyli), Lutfi Ramadanin, Bajram Zylfiun, dhe Qamil Shehun, dhe tha se të gjithë i dhanë rrëfime shumë të ngjashme në lidhje me incidentin. Këto rrëfime, të përshkruara nga Sweeney në deklaratën e tij përputhen me dëshmitë e Krasniqit dhe Ramadani të përshkruara më lart.¹¹⁴⁷

424. Qamil Shehu i tregoi Sweeney-t stallën ku kishin ndodhur vrasjet, por në vendin ku kishte qenë stalla ishte vetëm një krater. Qamil Shehu humbi rreth 40 anëtarë të familjes në këtë incident, përfshirë dy djem, tre vëllezër, dhe pesë nipa. I zoti i stallës humbi 22 anëtarë të familjes në masakër, përfshirë tre vëllezërit dhe djalin e madh.¹¹⁴⁸

425. Sweeney gjithashtu mblodhi fotografi të serbëve vendas dhe ua tregoi Qamil Shehut dhe Mehmet Krasniqit (Avdyli), të cilët identifikuan Sava Nikoliqin, Sveta Tasiqin, Momçillo Nikoliqin, dhe Dimitrije Nikoliqin. Ata identifikuan si njëri nga pjesëtarët e forcave të cilat morën pjesë në sulmin mbi fshat.¹¹⁴⁹ Ai gjithashtu dëshmoi se Krasniqi i kishte thënë se, kur po çonin grupin e meshkujve për në stallë, ai u kthye pas dhe pa Dimitrije Nikoliqin, Zvezdan Nikoliqin, Sava Nikoliqin, Sveta Tasiqin, dhe Momçillo Nikoliqin.¹¹⁵⁰

¹¹⁴³ Mehmet Krasniqi, T. 4377–4379 (29 shtator 2006); *shih gjithashtu* P102 (fotografi të vendvarrimit afër lumit Drin), f. 2.

¹¹⁴⁴ Mehmet Krasniqi, P2341 (deklarata e dëshmitarit e datës 7 mars 2002), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 12, T. 4376–4377 (29 shtator 2006); Lutfi Ramadani, T. 4299, 4343 (29 shtator 2006), 6D87 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 6723; P2357 (listë e emrave e dhënë nga Lutfi Ramadani), f. 4.

¹¹⁴⁵ Mehmet Krasniqi, P2341 (deklarata e dëshmitarit e datës 7 mars 2002), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 10–12, T. 4376–4377 (29 shtator 2006); Lutfi Ramadani, T. 4306 (28 shtator 2006); P2357 (listë e emrave e dhënë nga Lutfi Ramadani); José-Pablo Baraybar, P2794 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 nëntor 2006), para. 31; P2798 (listë e ZPZHK-së e personave të zhdukur).

¹¹⁴⁶ John Sweeney, T. 4813–4814 (13 tetor 2006), P2383 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 janar 2001), f. 2, 10.

¹¹⁴⁷ John Sweeney, P2383 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 janar 2001), f. 2, 7–8, 10, T. 4813–4814, 4819 (13 tetor 2006).

¹¹⁴⁸ John Sweeney, T. 4823–4824 (13 tetor 2006), P2383 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 janar 2001), f. 7–8; P2384 (video regjistruar të John Sweeney-t), video nr. 3.

¹¹⁴⁹ John Sweeney, T. 4827–4829 (13 tetor 2006), P2383 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 janar 2001), f. 5; P2384 (videofilmime nga John Sweeney), video nr. 5.

¹¹⁵⁰ John Sweeney, P2383 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 janar 2001), f. 8.

426. Sweeney gjithashtu dëshmoi se "dëshmitarët" i kishin thënë se, para masakrës kishin parë Dimitrije Nikoliqin, Zvezdan Nikoliqin, Sava Nikoliqin, Sveta Tasiqin, dhe Momçillo Nikoliqin duke i ndihmuar "trupat serbe" në tubimin e fshatarëve shqiptarë kosovarë. Ata ishin parë një ditë më herët duke i treguar shtëpitë shqiptare, të cilave më pas iu vu zjarri.¹¹⁵¹ Gjithashtu Ramadani tha se e kishte parë "Zllatko Gjorgjeviqin" me këtë grup.¹¹⁵²

427. Dhoma Gjyqësore konkludon se, edhe pse dëshmia e dhënë nga Sweeney bazohet në masë të madhe në rrëfime të tjerëve, Dhoma mund të mbështetet në këtë dëshmi meqenëse ajo konfirmon dëshmitë e tjera të drejtpërdrejta në lidhje me disa nga personat e implikuar në sulm.¹¹⁵³

428. Bozhidar Deliqi mohoi se forcat e tij hynë në fshatin Krushë e Vogël më 25 mars 1999, sepse ky fshat nuk ndodhej në aksin e forcave të tij. Sidoqoftë, ai pranoi se njësitë e MPB-së kaluan nëpër fshat dhe se kundër tyre u hap zjarr.¹¹⁵⁴

429. Më 26 mars 1999, Deliqi ndodhej pesë-gjashtë kilometra nga Krusha e Vogël, por mohoi se kishte mësuar se atë ditë ishin vrarë 105 shqiptarë kosovarë atje. Ai mësoi për këtë fakt në vitin 2000. Ai tha se, po të kishte dëgjuar se MPB-ja ishte implikuar në një incident të tillë, do ta kishte informuar menjëherë shefin e SPB-së.¹¹⁵⁵ Gjithsesi ai dëgjoi se një person, i quajtur Bllagojeviq, ishte dënua për këtë incident dhe krime të tjera.¹¹⁵⁶ Dhoma nuk ka marrë prova të tjera në mbështetje të këtij pretendimi.

c. Provat kriminalistike

430. Fatkeqësisht Dhoma Gjyqësore nuk ka marrë nga Dr. Eric Baccard prova kriminalistike në lidhje me vrasjet në Krushë të Vogël. Gjatë fazës së pyetjeve të Mbrojtjes për Eric Baccard-in, doli se provat kriminalistike në të cilat ishte bazuar aktekspertiza e tij kishin të bënin me Krushën e Madhe, të cilat i ishin dhënë gabimisht si prova të Krushës së Vogël.¹¹⁵⁷ Si pasojë të dhënat në aktekspertizën e tij kriminalistike për Krushën e Vogël faktikisht janë të bazuara në të dhënat që

¹¹⁵¹ John Sweeney, P2383 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 janar 2001), f. 8.

¹¹⁵² John Sweeney, P2383 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 janar 2001), f. 9.

¹¹⁵³ *Por shih* Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviçit, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 565.

¹¹⁵⁴ Bozhidar Deliq, T. 19371–19372 (29 nëntor 2007), 19724 (6 dhjetor 2007); IC151 (Hartë e shënuar nga Bozhidar Deliq); *shih gjithashtu* 6D1013 (Raport i MPB-së së Prizrenit, 13 mars 1999), f. 4; 5D887 (Raport zbulimi i Brigadës së 549-të të Motorizuar, 14 prill 1999).

¹¹⁵⁵ Bozhidar Deliq, T. 19376–19378 (29 nëntor 2007).

¹¹⁵⁶ Bozhidar Deliq, T. 19379 (29 nëntor 2007).

¹¹⁵⁷ Baccard-i e ka bazuar raportin e tij për Krushën e Vogël në raportin e Prof. Peter Vanezis dhe Dr. Sue Black. Raporti i Sue Black-ut është regjistruar si prova P110. Sipas konkluzioneve të Baccard-it, ekipi kriminalistik britanik bëri autopsi të katër viktimave; këto kufoma ishin të skeletizuara dhe të djegura dhe të pidentifikuara. Ishin një femër dhe tre meshkuj, njëri adoleshent dhe tre të rritur. Gjendja e këtyre kufomave e bëri të pamundshëm përcaktimin e shkakut të vdekjes. P1809 (Raport përmbledhës i Eric Baccard-it), f. 17.

kanë lidhje me Krushën e Madhe.¹¹⁵⁸ Rrjedhimisht Dhoma nuk është në gjendje të mbështetet në këtë raport në lidhje me vrasjet në Krushën e Vogël.

431. Dhoma gjithashtu pranoi disa raporte dhe fotografi nga policia e Mbretërisë së Bashkuar. Këto dokumente janë një sërë raporteve të veçanta për zhvarrosjet e ndërmarra në Krushë të Vogël në vende të ndryshme.¹¹⁵⁹ Sidoqoftë, raportet nuk identifikojnë asnjë nga viktimat e stallës, por përmendin fragmente eshtrash dhe materiali tjetër të gjetur në vende të ndryshme përgjatë lumit Drin dhe në afërsi të tij.¹¹⁶⁰

d. Konkluzione

432. Bazuar në dëshmitë përputhëse të Mehmet Krasniqit dhe Lutfi Ramadanit, të cilët Dhoma i konsideron të besueshëm dhe të saktë, pjesërisht të mbështetur nga provat dokumentare në lidhje me zonën e operacioneve të përbashkëta në atë zonë si dhe nga dëshmia e Deliqit përmendur më lart, Dhoma Gjyqësore konkludon se më 25 mars 1999 UJ-ja dhe MPB-ja së bashku me forca të tjera jo të rregullta si civilë të armatosur, sulmuar fshatin Krushë e Vogël. Edhe pse mohoi praninë e njërive të tjera në atë zonë, Deliqi konfirmoi se MPB-ja ishte angazhuar në atë fshat. Dhoma konkludon se kjo nuk është veçse një orvatje tjetër e Deliqit për të minimizuar ose mohuar rolin e UJ-së në incidente dhe përsëri e gjykon të pabesueshëm mohimin e pranisë së UJ-së prej tij. Dhoma gjithashtu konkludon se UJ-ja e granatoi fshatin e më pas forcat e MPB-së hynë në fshat dhe plaçkitën e dogjën shtëpitë. Fshatarët shqiptarë kosovarë ikën në pyll e pastaj u fshehën në shtëpinë e Sejdi Batushës. Dhoma është bindur se forcat pjesëmarrëse përfshinin edhe serbët vendas që ishin pjesëtarë të MPB-së dhe serbë të tjerë vendas. Ajo konkludon se të nesërmen policia dhe serbët a armatosur vazhduan me plaçkitjen, bastisjen dhe djegien e shtëpive. Policët i urdhëruan të gjithë njerëzit të dilnin në rrugën kryesore dhe i ndanë gratë e fëmijët nga burrat. Gratë u urdhëruan të shkonin për në Shqipëri. Së paku 111 burra, ndër të cilët adoleshentë, pleq, dhe invalidë mendorë dhe fizikë, u mblodhën dhe u keqtrajtuan, ua grabitën gjërat me vlerë dhe dokumentet e identifikimit, dhe i dërguan në një stallë të zbrazët, pronë e një fshatari shqiptar. Pjesëtarët e MPB-së shtinë përmes dritareve të stallës dhe vranë thujt të gjithë meshkujt brenda, e më pas u vunë

¹¹⁵⁸ Eric Baccard, T. 10201–10207 (20 shkurt 2007).

¹¹⁵⁹ Çështje Provash, T. 4882 (13 tetor 2006); P100 (fotografi të vendit të ngjarjes së shtëpisë së Batushës të bëra nga ekipi mjekoligjor britanik); P102 (fotografi të vendvarrimit afër lumit Drin); P103 (fotografi të vendvarrimit afër lumit Drin); P104 (fotografi të vendvarrimit afër lumit Drin); P105 (fotografi të materialit të gjetur përgjatë lumit Drin); P106 (fotografi të vendeve të ndryshme përgjatë lumit Drin dhe vendvarrimeve afër rrugës); P107 (fotografi të fshatit Zhur dhe lumit Drin); P110 (fotografi (vendi KV011) të një vendvarrimi të dyshuar te lumi Drin); P111 (fotografi të Ekipit Mjekoligjor Britanik të vendvarrimeve të mundshme rreth lumit Drin); P112 (Raport Mjekoligjor i Vendit të Krimin të Ekipit Mjekoligjor Britanik me fotografi të vendvarrimeve në rrugën e ikjes nga shtëpia e Batushës (vendet KV004 dhe KV005) dhe përshkrimet e mbetjeve skeletore, gjërave personale, gëzhojave, e tjera të gjetura në këto vende).

¹¹⁶⁰ Çështje Provash, T. 4882–4883 (13 tetor 2006).

zjarrin kufomave. Dhoma Gjyqësore nuk pranon se Deliqi dhe SD1 nuk kishin dijeni për këtë incident, megjithëse pranuan se kishin qenë në atë zonë apo në afërsi.

433. Bazuar në dëshmitë okulare të Mehmet Krasniqit dhe Lutfi Ramadanit, të cilat u mbështetën pjesërisht nga dëshmia e John Sweeney-it e bazuar në rrëfime të të tjerëve, Dhoma Gjyqësore konkludon se personat që vijnë nga pjesëtarët e MPB-së dhe serbë të tjerë të armatosur në stallën e Batushës më 26 mars 1999: Adem Asllani, Asim Asllani, Feim Asllani, Muharrem Asllani, Nexhat Asllani, Nisret Asllani, Perparim Asllani, Bali Avdyli, Enver Avdyli, Ahmet Batusha, Amrush Batusha, Asllan Batusha, Avdi Batusha, Bekim Batusha, Beqir Batusha, Burim Batusha, Enver Batusha, Feim Batusha, Mërgim Batusha, Haxhi Batusha, Lirim Batusha, Milaim Batusha, Muharremi Batusha, Njazi Batusha, Osman Batusha, Sejdi Batusha, Skifter Batusha, Sulejman Batusha, Zaim Batusha, Abaz Hajdari, Abedin Hajdari, Halil Hajdari, Halim Hajdari, Marsel Hajdari, Nazim Hajdari, Qamil Hajdari, Rasim Hajdari, Sahit Hajdari, Selajdin Hajdari, Shani Hajdari, Vesel Hajdari, Zenun Hajdari, Avdyl Limoni, Limon Limoni, Luan Limoni, Nehbi Limoni, Afrim Ramadani, Asllan Ramadani, Bajram Ramadani, Sabit Ramadani, Murat Ramadani, Ramadan Ramadani, Selajdin Ramadani, Kadri Rashkaj, Refki Rashkaj, Adnan Shehu, Arben Shehu, Arif Shehu, Bekim Shehu, Burim Shehu, Destan Shehu, Din Shehu, Dritan Shehu, Fadil Shehu, Flamur Shehu, emri nuk dihet Shehu (djali i Hazizit), emri nuk dihet Shehu (djali i Sinanit), Haxhi Shehu, Haziz Shehu, Ismail Shehu, Ismet Shehu, Mehmet Shehu, Mentor Shehu, Myftar Shehu, Nahit Shehu, Nehat Shehu, Sahit Shehu, Sami Shehu, Sefer Shehu, Shani Shehu, Shefqet Shehu, Sinan Shehu, Veli Shehu, Vesel Shehu, Xhafer Shehu, Xhavit Shehu, Xhelal Shehu, Afrim Zylfiu, Halim Zylfiu, Hamdi Zylfiu, Hamit Zylfiu, Hysen Zylfiu, Njazim Zylfiu, Islam Batusha, Sylë Batusha, Visar Batusha, Mehmet Berisha, Isni Hajdari, Anton Prenkaj, Nikollë Prenkaj, Halim Qollaku, Hamdi Qollaku, Hamit Qollaku, Xhelal Qollaku, Ajvaz Shehu, Kujtim Shehu, Nuredin Shehu, Selami Shehu, Shefqet Shehu, Visar Shehu, dhe Cenë Zylfiu.¹¹⁶¹

434. Nuk është dëshmuar se personat që vijnë, të përmendur në Listën C të Aktakuzës ose në Dosjen Përfundimtare Gjyqësore të Prokurorisë u vranë nga forcat e RFJ-së/Serbisë në Krushë të Vogël më 26 mars 1999: Hysni Hajdari, Hysen Ramadani, Demir Rashkaj, Nexhat Shehu, Sali Shehu, Xhelal Zylfiu, dhe Liman Hajdari.

¹¹⁶¹ *Shih* Shtojca A.

7. Krusha e Madhe

435. Në Aktakuzë pretendohet se në komunën e Rahovecit u shkatërruan disa xhami, përfshirë edhe xhaminë në Krushë të Madhe.¹¹⁶² Rrjedhimisht aty figuron vetëm një akuzë në lidhje me Krushën e Madhe, konkretisht, përndjekje përmes shkatërrimit të xhamisë. Dhoma Gjyqësore gjithashtu dëgjoi dëshmi në lidhje me situatën e përgjithshme në Krushë të Madhe, e cila ndodhet shumë afër Krushës së Vogël, si dhe mbi disa ngjarje konkrete atje. Meqenëse asnjë nga ato prova nuk lidhet me pretendimet në Aktakuzë, ato nuk do të analizohen në këtë pjesë.

436. Ali Hoti, mjek nga ky fshat, dëshmoi se herët në mëngjes më 25 mars 1999, Krusha e Madhe u rrethua nga të gjitha anët nga "forcat ushtarake serbe." Hoti e pa ngjarjen nga shtëpia e tij, e cila ndodhet rreth 50 - 60 metra nga rruga kryesore që lidh Prizrenin, Gjakovën dhe Rahovecin. Automjetet e UJ-së, si tanket, autobлиндat, Pragat, dhe automjetet e tjera përcjellëse, lëviznin përgjatë rrugës kryesore të fshatit. Automjetet drejtoheshin nga forca ushtarake me uniforma shumëngjyrëshe. Me të parë forcat, popullata iku nga fshati e frikësuar dhe u strehua në kodrat e afërme.¹¹⁶³

437. Deliqi, i cili dëshmoi se Krusha e Madhe ishte çerdhe "terroristësh", mohoi se forcat e tij hynë në fshat më 25 mars 1999 sepse fshati ndodhej në aksin e forcave të tij. Sidoqoftë, njësitë e MPB-së kaluan nëpër të dhe kundër tyre u hap zjarr.¹¹⁶⁴

438. Dhoma Gjyqësore dëgjoi nga Andrés Riedlmayer-i në lidhje me dëmtimin e xhamisë në fshat.¹¹⁶⁵ Raporti i Riedlmayer-it përshkruan gjendjen e xhamisë si "të dëmtuar rëndë" dhe raporton se "minareja ishte hedhur në ajër, duke shkaktuar një vrimë të madhe në murin anësor të xhamisë dhe dëmtime strukturore. Brendësia e xhamisë ishte dhunuar dhe ishte djegur pjesërisht."¹¹⁶⁶ Riedlmayer përfundoi se shkatërrimi i xhamisë ishte shkaktuar nga një shpërthim i madh.¹¹⁶⁷ Raporti i Riedlmayer gjithashtu evidenton se një grup shqiptar i të drejtave të njeriut ishte informuar se "ushtarët serbë" ishin parë duke djegur xhaminë.¹¹⁶⁸ Riedlmayer-i nuk kishte bërë personalisht

¹¹⁶² Aktakuza, para. 72(a)(i).

¹¹⁶³ Ali Hoti, T. 4141–4142, 4164 (27 shtator 2006).

¹¹⁶⁴ Bozhidar Deliq, T. 19371–19372 (29 nëntor 2007), 19724 (6 dhjetor 2007); IC151 (Hartë e shënuar nga Bozhidar Delliqi); *shih gjithashtu* 6D1013 (Raport i MPB-së së Prizrenit, 13 mars 1999), f. 4; 5D887 (Raport zbulimi i Brigadës së 549-të të Motorizuar, 14 prill 1999).

¹¹⁶⁵ P1789 (Aktekspertiza e Andrés Riedlmayer); *shih gjithashtu* Andrés Riedlmayer, T. 5419–5420 (30 tetor 2006).

¹¹⁶⁶ P1776 (Pjesë nga P1789 në lidhje me xhaminë e Krushës e Madhe), f. 1.

¹¹⁶⁷ Andrés Riedlmayer, T. 5482 (30 tetor 2006); P1776 (Pjesë nga P1789 në lidhje me xhaminë e Krushës së Madhe), f. 1; P1794 (fotografi të xhamisë së shkatërruar të Krushës së Madhe).

¹¹⁶⁸ P1776 (Pjesë nga P1789 në lidhje me xhaminë e Krushës së Madhe), f. 2.

vlerësimin e xhamisë, po i kishte nxjerrë përfundimet në bazë të fotografive dhe të të dhënave plotësuese të marra nga grupi shqiptar i të drejtave të njeriut.¹¹⁶⁹

439. Dëshmitari 6D2 tha se u informua për shkatërrimin e xhamisë në Krushë të Madhe dhe se ishte kryer hetimi i vendit të ngjarjes.¹¹⁷⁰ Ai gjithashtu theksoi se policia nuk kishte pajisje që mund të shkaktonin dëmtim të rëndë apo shkatërrim të ndërtesave.¹¹⁷¹

440. Bazuar në dëshmitë e 6D2-shit dhe Riedlmayer-it, Dhoma Gjyqësore konkludon se është vërtetuar se xhamia në Krushë të Madhe u dëmtua. Sidoqoftë, në mungesë të provave të drejtpërdrejta në lidhje me mënyrën e dëmtimit dhe autorët e dëmtimit, akuza në lidhje me xhaminë nuk është vërtetuar.

8. Nagafc

441. Ali Hoti dëshmoi se, më 25 mars 1999 ai iku nga Krusha e Madhe dhe shkoi në një luginë në zonën e Nagafcit.¹¹⁷² Hoti vlerësoi se në atë vend ishin mbi 20.000 njerëz nga fshatra të ndryshme.¹¹⁷³ Ai nuk tha se ndonjë forcë i kishte rrethuar njerëzit apo se kishte urdhëruar shpërnguljen.

442. Në mëngjesin e 26 marsit 1999, një grup njerëzish që ndodheshin në të njëjtën luginë filluan të largoheshin. Grupit i printe një plak, i cili kishte thënë Hotit se "dikush" u kishte thënë të shkonin në drejtim të Shqipërisë. Nga frika, të gjithë njerëzit në luginë, përfshirë edhe grupin e Hotit, u nisën drejt Nagafcit për të shkuar në Shqipëri.¹¹⁷⁴ Në hyrje të Nagafcit ku ndahet rruga, ata hasën "forcat serbe," të cilat u thanë të shkonin në qendër të Nagafcit dhe të mblidheshin në oborrin e shkollës, ku qëndruan dy orë.¹¹⁷⁵ Pasi pas dy orësh nuk ndodhi asgjë, njerëzit filluan të strehoheshin në shtëpitë e zbrazëta.¹¹⁷⁶

443. Hoti dëshmoi, se më 28 mars, tre burra me uniforma kamuflimi e zunë në rrugë dhe i kërkuan para. Ai u dha 700 - 800 marka gjermane. Njëri nga njerëzit me uniformë e detyroi Hotin t'i çonte në shtëpinë ku qëndronte, ku ishin rreth 80 njerëz. Ai i tha Hotit të mblidhte para nga burrat,

¹¹⁶⁹ Andrés Riedlmayer, T. 5565–5567 (31 tetor 2006).

¹¹⁷⁰ 6D2, 6D1631 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 prill 2008), para. 53 (e mbyllur me vulë).

¹¹⁷¹ 6D2, 6D1632 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 prill 2008), para. 62.

¹¹⁷² Ali Hoti, T. 4142–4143, 4196 (27 shtator 2006); IC57 (Shënimi i Ali Hotit të fshatit Krushë e Madhe në provën materiale P615, Atlasi i Kosovës).

¹¹⁷³ Ali Hoti, T. 4143–4144 (27 shtator 2006); IC57 (shënimi i Ali Hotit i fshatrave në komunën e Rahovecit në provën materiale P615, Atlasi i Kosovës).

¹¹⁷⁴ Ali Hoti, T. 4144–4145 (27 shtator 2006).

¹¹⁷⁵ Ali Hoti, T. 4145 (27 shtator 2006).

kurse vetë mblodhi para nga gratë e fëmijët.¹¹⁷⁷ Përveç këtij incidenti, gjatë qëndrimit të Hotit në Nagafc, atje nuk pati ushtarë.¹¹⁷⁸

444. Duke e konfirmuar pjesërisht dëshminë e Hotit, Vllatko Vukoviçi tha se hasi një grup prej rreth 200 civilësh të kombësisë shqiptare, të cilët ishin fshehur në shtratin e lumit Hoçë afër Nagafcit dhe u tha të ktheheshin në fshat, pasi të kishte kaluar ushtria.¹¹⁷⁹ Më vonë ai u informua nga komandanti i grupit të zjarrit se grupi kishte shkuar në fshatin Celinë.¹¹⁸⁰

445. Deliqi konfirmoi praninë e forcave të tij dhe tha se nga 25 marsi deri më 28 mars 1999, ata kaluan nëpër fshatin Nagafc. Në mbrëmjen e 25 marsit, ai kaloi nëpër një pjesë të fshatit rreth orës 19:00. Sidoqoftë, ai mohoi të kishte dëgjuar se dikush kishte rrethuar mijëra njerëz afër Nagafcit.¹¹⁸¹

446. Hoti qëndroi në Nagafc deri më 2 prill 1999, kur në orën 2 të mëngjesit u zgjua nga zhurma e një aeroplani që fluturonte shumë poshtë. Aeroplani e kishte bombarduar Nagafcin dhe i vuri zjarrin. Disa nga shtëpitë u shkatërruan dhe njerëzit u fshehën në bodrume. Disa njerëz u plagosën. Në shtëpinë ku ndodhej Hoti, kulmi u shemb dhe u thyen kornizat e dritareve. Hoti nuk e pa aeroplanin sepse në atë moment ishte terr, por dëgjoi zhurmë të madhe dhe pa dritë të fortë dhe zjarr që vinte nga aeroplani. Megjithëse kishte parë aeroplanë të NATO-s çdo natë që nga 24 marsi, ai kurrë nuk i kishte parë të fluturonin aq poshtë dhe zhurma ishte ndryshe. Për këtë arsye, Hoti konkludoi se aeroplani që bombardoi Nagafcin nuk ishte i NATO-s.¹¹⁸² Mirëpo ai nuk ishte në gjendje të konfirmonte aeroplani u përkiste forcave të RFJ-së dhe Serbisë.¹¹⁸³

447. Pas sulmit, Hoti shkoi shtëpi më shtëpi dhe mjekoi të plagosurit. Në shtëpinë e parë, ai gjeti pesë persona të plagosur dhe një të vdekur. Në një tjetër, ai gjeti të plagosur, përfshirë dhe një vajzë të vogël me këmbë të lënduar. Ishin vrarë rreth 50 vetë.¹¹⁸⁴

¹¹⁷⁶ Ali Hoti, T. 4146 (27 shtator 2006).

¹¹⁷⁷ Ali Hoti, T. 4158–4159, 4170 (27 shtator 2006).

¹¹⁷⁸ Ali Hoti, T. 4170–4171 (27 shtator 2006).

¹¹⁷⁹ Vllatko Vukoviç, 5D1442 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para. 30, T. 21389–21390 (30 janar 2008); IC178 (Hartë e shënuar nga Vllatko Vukoviç); *shih gjithashtu* Bozhidar Deliq, T. 19382 (29 nëntor 2007), 19440 (4 dhjetor 2007).

¹¹⁸⁰ Vllatko Vukoviç, 5D1442 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para. 30, T. 21392 (30 janar 2008) (seancë private).

¹¹⁸¹ Bozhidar Delliç, T. 19375–19376, 19382 (29 nëntor 2007).

¹¹⁸² Ali Hoti, T. 4153–4155 (27 shtator 2006).

¹¹⁸³ Ali Hoti, T. 4172 (27 shtator 2006), 4D25 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviçit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 3610.

¹¹⁸⁴ Ali Hoti, T. 4154, 4156 (27 shtator 2006).

448. Sabri Popaj gjithashtu dëshmoi se një natë nga fillimi i prillit rreth orës 01:30, kur ndodhej në Celinë, e cila është shumë afër Nagafcit, dëgjoi zhurmën e një aeroplani duke fluturuar në lartësi të ulët mbi kokat e tyre. Disa sekonda më vonë, ai dëgjoi katër shpërthime të fuqishme. Të nesërmen, ai dhe 11 burra të tjerë nga Celina shkuan për të hetuar shpërthimet. Në Nagafc, ku nuk kishte njerëz, ata panë një shtëpi të shkatërruar dhe katër të tjera të dëmtuara rëndë. Tjegullat dhe xhamat e shumicës së shtëpive ishin të thyer nga shpërthimi.¹¹⁸⁵

449. Rreth katër apo pesë ditë më vonë, Popaj dëgjoi se në shtëpinë e shkatërruar në Nagafc kishte kufoma dhe ai u kthye atje dhe ishte i pranishëm kur nga shtëpia e shkatërruar u nxorën kufomat e tre fëmijëve të vegjël. Më pas i treguan se në atë shtëpi u gjetën gjithsej tetë fëmijë dhe tri gra. Edhe emta e Sabri Popajt, Sanije Kastrati, u gjetur e vdekur në një shtëpi tjetër në Nagafc.¹¹⁸⁶

450. Sipas Popajt, aeroplani i cili kreu për sulmin ajror ishte i forcave të RFJ-së/Serbisë sepse "aeroplanët serbë" fluturonin ulët ndërsa aeroplanët e NATO-s fluturonin shumë më lart.¹¹⁸⁷ Popaj gjithashtu dëshmoi se në oborrin e shtëpisë së Elshanëve në Nagafc u gjetën copëra bombe me mbishkrim cirilik.¹¹⁸⁸ Ai nuk e dinte cilat shkronja cirilike ishin në këto copa.¹¹⁸⁹ Në vitin 1999, pjesëtarët apo hetuesit e KFOR-it ekzaminuan copërat dhe shkronjat cirilike dhe i fotografuan.¹¹⁹⁰

451. Isufi Zhuniqi gjithashtu dëshmoi se kur shkoi në Nagafc më 31 mars 1999, pa shumë njerëz të shpërngulur nga fshatrat të tjera të cilët ishin urdhëruar nga "serbët" të mblidheshin atje. Pas një apo dy ditësh në orën 2 të mëngjesit një aeroplan bombardoi.¹¹⁹¹ Zhuniqi tha se ishte MIG i UJ-së.¹¹⁹² Ai dëgjoi tri shpërthime të fuqishme në tri vende të ndryshme në Nagafc, njëri prej të cilëve ndodhi shumë afër tij. Ai ia dha vrapit, por u godit në kokë dhe u rrëzua pa vetëdije. Kur erdhi në vete më 3 prill, ai ishte dërguar në Kukës, Shqipëri.¹¹⁹³ Zhuniqi gjithashtu konfirmoi se edhe KFOR-i gjerman gjeti bombat me shkronja cirilike dhe se ai personalisht pa copëra me mbishkrime me shkronja cirilike kur u kthye në Nagafc.¹¹⁹⁴

¹¹⁸⁵ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 10, T. 5756 (2 nëntor 2006).

¹¹⁸⁶ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 10.

¹¹⁸⁷ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 qershor 1999), f. 10.

¹¹⁸⁸ Sabri Popaj, T. 5702–5704 (1 nëntor 2006), T. 5756–5757 (2 nëntor 2006).

¹¹⁸⁹ Sabri Popaj, T. 5758 (2 nëntor 2006).

¹¹⁹⁰ Sabri Popaj, T. 5703 (1 nëntor 2006), 5754–5755 (2 nëntor 2006).

¹¹⁹¹ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 maj 1999), f. 6.

¹¹⁹² Isuf Zhuniqi, T. 4121 (27 shtator 2006), P2332 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 6457–6458.

¹¹⁹³ Isuf Zhuniqi, P2331 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 maj 1999), f. 6, T. 4122 (27 shtator 2006).

¹¹⁹⁴ Isuf Zhuniqi, T. 4122–4123 (27 shtator 2006), P2332 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 6459.

452. Pas dëshmisë së Popajt dhe Zhuniqit, Prokuroria kërkoi ndihmën e NATO-s për raportet, fotografitë, apo të dhëna në lidhje me inspektimet apo konfiskime të mundshme prej KFOR-it të copave të bombave apo predhave në Nagafc rreth korrikut 1999. NATO-ja u përgjigj se nuk kishte material të rëndësishëm që do të mund të ndihmonte hetimin konkret.¹¹⁹⁵ Pas kërkesës së Dhomës Gjyqësore për më shumë të dhëna për copërat e bombave, Prokuroria dërgoi një hetues në Nagafc, i cili takoi Elshanin dhe bëri hetime. Elshani e informoi se nuk i kishte copërat e bombave sepse ua kishte dhënë tre oficerëve të KFOR-it gjerman të cilët e kishin vizituar Nagafcin në korrik 1999. Më pas hetuesi pyeti për Agim Krasniqin, shtëpia e të cilit është përballë shtëpisë së Elshanit. Krasniqi i dha hetuesit një copë të vogël të bombës e cila sipas tij e kishte goditur shtëpinë e tij në vitin 1999. Hetuesi e fotografoi këtë copë, por aty nuk shihen shkronja cirilike. Prokuroria gjithashtu bëri një rishikim të mostrave në dispozicion të saj për të parë nëse ka të arkivuara copa nga Nagafci. Megjithëse Prokuroria gjeti disa copëra bombash në koleksionin e saj të mostrave, në to nuk shihej mbishkrim cirilik e as nuk ishin regjistruar se ishin nga Nagafci.¹¹⁹⁶

453. Spasoje Smilaniqit, komandant i Forcave Ajrore dhe Mbrojtjes Kundërajrore të UJ-së në vitin 1999, iu tregua një videofilmim bërë nga Radio Televizioni i Serbisë, i cili pretendonte se tregonte shkatërrimin prej bombardimit në Nagafc.¹¹⁹⁷ Ai përfundoi se, duke parë dëmtimet, duhej të ishte përdorur ndonjë armë me presion të lartë, e cila krijon presion të lartë atmosferik dhe shpërthim të fuqishëm, siç janë bombat me oksigjen apo predhat thërrmuese si bombat kasetë.¹¹⁹⁸ Ai dëshmoi se videofilmimi tregonte motorin e raketës HARM 88, e cila sipas tij ishte përdorur së bashku me armë të tjera për të shkaktuar dëmet. Forcat e tij ajrore nuk kishin ekuipazhe të stërvitura për sulme të tilla e as aeroplanë apo armë për t'i kryer ato. Gjithashtu, forcat e tij nuk ishin në gjendje të kryenin sulme natën.¹¹⁹⁹

454. Deliqi, të cilit iu tregua i njëjti filmim, dëshmoi se nuk ishte e mundshme që UJ-ja të kishte bombarduar fshatin Nagafc sepse forcat ajrore nuk fluturonin në hapësirën ajrore të Kosovës në atë kohë. Aeroplanët e UJ-së të përdorur në fillim të luftës ishin aktivë kryesisht mbi Beograd. Ai gjithashtu tha se këta ishin aeroplanë gjuajtës me raketa për përdorim kundër aeroplanëve të armikut; aeroplanët e tyre nuk kishin bomba. Gjithsesi, ishte e pamundshme që aeroplanët e tyre të

¹¹⁹⁵ 3D515 (Përgjigja e NATO-s ndaj kërkesës e Prokurorisë në lidhje me inspektimet apo konfiskimin e mundshëm nga KFOR-i të copërave të bombave/predhave në Nagafc, 7 shkurt 2007).

¹¹⁹⁶ Raporti i Prokurorisë për Provat Fizike të Copërave të Bombave me Shtojcën A, 30 nëntor 2006, f. 1–3.

¹¹⁹⁷ 5D1242 (Videofilmim); Spasoje Smilaniq, T. 15759–15760 (17 shtator 2007). Dhoma vëren se Smilaniqit iu tregua videofilmimi me numër të provës materiale 3D710, i cili nuk është pranuar si provë, por përmban të njëjtat pamje sikurse ato në 5D1242. *Shih gjithashtu* Bozhidar Deliq, T. 19385–19386 (29 nëntor 2007).

¹¹⁹⁸ Spasoje Smilaniq, T. 15759 (17 shtator 2007).

¹¹⁹⁹ Spasoje Smilaniq, T. 15760 (17 shtator 2007).

fluturonin sepse NATO-ja kishte epërsi absolute në hapësirën ajrore.¹²⁰⁰ Ai gjithashtu tha se, në mëngjesin e 2 prillit 1999, NATO-ja bombardoi Nagafcin dhe se u shkatërruan disa shtëpi dhe u vranë shumë civilë, kurse të plagosurit u mjekuan në spitalin e Prizrenit. Ditën e nesërme SPB-ja e Prizrenit kreu hetime në vendin e ngjarjes dhe vërtetoi faktet.¹²⁰¹ Dhoma Gjyqësore nuk e ka marrë këtë raport. Deliqi tha se ai nuk ndodhej në Nagafc atë mëngjes, por shefi i SPB-së e informoi më vonë për incidentin dhe se ia treguan videofilmimin të njëjtën ditë.¹²⁰² Ai pa në film mbeturinat e një rakete kundër radarëve që përdoren nga NATO, por pranoi se dëmet nuk ishin shkaktuar vetëm nga ajo. Bombat të cilat ishin hedhur, më së shpeshti MK-82, zakonisht nuk lënë mbeturina ose gjurmë, përveç fletëve stabilizuese.¹²⁰³

455. Dëshmitari SD2 tha se, më 2 prill 1999, në fshatin Nagafc u gjetën 11 kufoma, viktima të bombardimit të NATO-s.¹²⁰⁴ Gjithashtu, një raport i MPB-së i datës 3 prill 1999 thotë se NATO-ja bombardoi fshatin Nagafc më 2 prill 1999, rreth orës 02:00. Në atë sulm u vranë njëmbëdhjetë vetë, katër prej të cilëve u identifikuan.¹²⁰⁵

456. Hoti gjithashtu dëshmoi se, një ditë pas sulmit, njerëzit e mbetur në Nagafc ikën nga fshati sepse kishin frikë nga ndonjë sulm tjetër. Ata u nisën me traktorë në drejtim të Krushës së Madhe dhe më tutje në drejtim të Shqipërisë.¹²⁰⁶ Në fshatin Landovicë ata u ngacmuan nga "forcat serbe." "Forcat serbe" ua morën plisat e bardhë tradicionalë që i mbajnë pleqtë dhe luajtën me to. Ata gjithashtu u thanë "Shkoni në Shqipëri. Kosova nuk është juaja. Nuk keni pse ktheheni. Këtu është tokë serbe."¹²⁰⁷

457. Kur mbërritën te kufiri me Shqipërinë, policët me rroba të kaltra ua morën dokumentet para se të kalonin kufirin për në Shqipëri më 3 prill 1999. Gjatë rrugës, ata panë forca ushtarake me uniforma kamuflimi. Në kufi, ata u detyruan të hiqnin targat e automjeteve dhe të dorëzonin të gjitha dokumentet personale dhe letërnjoftimet. Policët u thanë se arsyeja ishte se ato nuk do t'iu duheshin më sepse nuk do të ktheheshin kurrë më në Kosovë dhe do të jetonin në Shqipëri. Atyre iu tha se kjo ishte dhuratë nga NATO-ja dhe Clinton-i dhe se kishin gjetur atë që kishin kërkuar. Ata

¹²⁰⁰ 5D1242 (Videofilmime); Bozhidar Deliq, T. 19383–19385 (29 nëntor 2007).

¹²⁰¹ Bozhidar Deliq, T. 19383–19384 (29 nëntor 2007).

¹²⁰² Bozhidar Deliq, T. 19385 (29 nëntor 2007).

¹²⁰³ Bozhidar Deliq, T. 19386 (29 nëntor 2007).

¹²⁰⁴ 6D2, 6D1632 (deklarata e dëshmitarit), para. 61.

¹²⁰⁵ 6D1239 (Përmbledhje e MPB-së e ngjarjeve të lidhura me sigurinë të evidentuara nga 2 deri më 3 prill 1999, 3 prill 1999), f. 1.

¹²⁰⁶ Ali Hoti, T. 4155–4157 (27 shtator 2006).

¹²⁰⁷ Ali Hoti, T. 4156–4157 (27 shtator 2006).

thanë se Kosova është tokë serbe. Gjithashtu, policët në kufi konfiskuan makinat e mira të atyre që kalonin kufirin.¹²⁰⁸

a. Konkluzione

458. Dhoma Gjyqësore vëren se Popaj, Zhuniqi, dhe Hoti nuk ishin dëshmitarë të drejtpërdrejtë okularë të bombardimit në Nagafc, por dëgjuan zhurmën e bombave. Edhe pse dëshmitarët pretendojnë se kanë parë shkronja cirilike në mbeturinat e bombave, Dhoma nuk ka qenë në gjendje të konfirmojë këtë aspekt. Duke pasur parasysh dëshmitë kundërthënëse të Spasoje Smilaniqit, Bozhidar Deliqit, dhe SD2-shit, të cilët Dhoma gjykon se nuk mund t'i injorojë në lidhje me këtë ngjarje, Dhoma nuk pranon se dëshmitë e paraqitura vërtetojnë se forcat e RFJ-së/Serbisë janë përgjegjëse për bombardimin e fshatit më 2 prill 1999.¹²⁰⁹

459. Në lidhje me pretendimet për dëbimin nga mali afër Nagafcit më 25 mars 1999, Dhoma Gjyqësore vëren se i vetmi dëshmitar okular i dëgjuar në lidhje me këto akuza ishte Hoti. Dëshmitë e Zhuniqit, Deliqit, dhe Vukoviqit e mbështesin pjesërisht dëshminë e Hotit, por Hoti nuk dëshmoi se ishte rrethuar nga forcat e RFJ-së/Serbisë apo se ishte urdhëruar nga këto forca të largohet në fshatrat e afërta, siç pretendohet në Aktakuzë.¹²¹⁰ Rrjedhimisht, Dhoma konkludon se këto akuza nuk janë vërtetuar.

460. Sidoqoftë, bazuar në dëshminë e Hotit, është vërtetuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se njerëzit që u larguan nga fshati pas 2 prillit, gjatë rrugës për në kufirin me Shqipërinë u ngacmuan nga forca serbe të paidentifikuara dhe në kufi policia u konfiskoi dokumentet e identifikimit dhe gjëra të tjera.

9. Brestoc

461. Raporti i Riedlmayer-it përshkruan gjendjen e xhamisë në Brestoc si "thuajse të shkatërruar." Xhamia ishte plotësisht e djegur dhe minareja ishte e shkatërruar nga ballkoni e lart. Ai raportoi se, sipas "bashkësisë Islame," shkatërrimi ndodhi më 25 mars 1999. Një fotografi në raportin e tij tregon dëmtimin e xhamisë.¹²¹¹

¹²⁰⁸ Ali Hoti, T. 4157 (27 shtator 2006).

¹²⁰⁹ *Shih* Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 377, 396, 561.

¹²¹⁰ *Shih* Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 851.

¹²¹¹ P1775 (Pjesë nga P1789 në lidhje me xhaminë e Brestocit); P1793 (Fotografi e xhamisë); András Riedlmayer, T. 5481 (30 tetor 2006).

462. Meqenëse kjo është e vetmja dëshmi në lidhje me xhaminë, Dhoma Gjyqësore nuk mund të konkludojë se xhamia u dëmtua apo u shkatërrua nga forcat e RFJ-së/Serbisë, siç pretendohet në Aktakuzë.

F. SUHAREKË

1. Akuzat në Aktakuzë

463. Pretendimet konkrete në lidhje me komunën e Suharekës kanë të bëjnë me ngjarjet që thuhet se kanë ndodhur nga 25 marsi deri në prill 1999. Shkeljet bazë të dëbimit dhe zhvendosjes me dhunë, të përfshira përkatësisht në Pikën 1 dhe 2, janë përshkruar në paragrafin 72(d) të Aktakuzës si vijon:

Në mëngjesin e 25 marsit të vitit 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë rrethuan qytetin e Suharekës. Gjatë ditëve që pasuan, policët shkonin shtëpi më shtëpi, duke kërcënuar dhe sulmuar dhe duke vrarë banorët shqiptarë kosovarë dhe duke nxjerrë shumë njerëz nga shtëpitë e tyre nën tytën e pushkës. Shumë shtëpive dhe dyqaneve që ishin prona të shqiptarëve kosovarë, iu vu zjarri dhe një xhami në Suharekë u dëmtua. Gratë, fëmijët dhe pleqtë u larguan nga policia dhe pastaj një numër burrash u vranë nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë. Shqiptarët kosovarë u detyruan të iknin me kamionë, traktorë dhe rimorkio drejt kufirit me Shqipërinë. Kur po kalonin kufirin, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë u morën letërnjoftimet dhe të hollat shumë prej tyre.

(i). Më 31 mars 1999, rreth 80.000 shqiptarë kosovarë të shpërngulur nga fshatrat e komunës së Suharekës u mblodhën afër Bellanicës. Të nesërmen, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë e granatuan Bellanicën, duke detyruar të shpërngulurit të iknin drejt kufirit shqiptar. Para se ta kalonin kufirin, forcat e RFJ-së dhe Serbisë ua morën letërnjoftimet.

464. Të akuzuarit janë akuzuar gjithashtu edhe për vrasje, sipas Pikave 3 dhe 4, në lidhje me një incident të përshkruar në paragrafin 75(d) të Aktakuzës si vijon:

Më 26 mars 1999 ose rreth kësaj date, në orët e mëngjesit, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë rrethuan oborrin e familjes BERISHA në Suharekë (komuna e Suharekës). Tanket zunë pozicione afër shtëpive, dhe u pozicionuan drejt tyre. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë urdhëruan banorët të dilnin nga shtëpitë. Burrat u ndanë nga gratë dhe fëmijët dhe u vranë gjashtë anëtarë të familjes. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i çuan anëtarët e tjerë në drejtim të një kafeneje. Këta njerëz u futën në kafene, bashkë me tri grupe të familjes së gjerë të Berishëve. Më pas forcat e RFJ-së dhe të Serbisë hapën zjarr kundër njerëzve që ndodheshin brenda. Në kafene u hodhën edhe lëndë shpërthyes. Në këtë aksion u vranë së paku 44 civilë dhe u plagosën rëndë edhe të tjerë. Kufomat e viktimave u vendosën në platformën e një kamioni, i cili u nis në drejtim të Prizrenit. Tre individë të plagosur, të cilët u hodhën në kamion bashkë me kufomat, kërcyen prej kamionit gjatë rrugës për në Prizren. Kufomat nga vrasja e familjes BERISHA janë gjetur ndërkohë në dy vende: së pari në një poligon në komunën e Prizrenit dhe së dyti në një vendvarrim të përbashkët në qendrën e stërvitjes të SAJ-së në Batajnicë afër Beogradit në Serbi. (Të vrarët emrat e të cilëve dihen, janë renditur në Listën D, që i bashkëngjitet kësaj aktakuze si shtojcë.)

465. Sipas Pikës 5 të Aktakuzës, të Akuzuarit akuzohen edhe për përndjekje në lidhje me akuzat për vrasjet të përfshira në paragrafin 75(d) dhe për "shkatërrim dhe dëmtim pa shkak të objekteve fetare të shqiptarëve kosovarë," përfshirë edhe xhaminë në Suharekë, siç është përshkruar në paragrafët 72(d) dhe 77(d) të Aktakuzës.

2. Dëshmitarët kryesorë

466. Prokuroria dhe Mbrojtja paraqitën një numër dëshmitarësh për të folur për krimet konkrete që pretendohet se janë kryer në komunën e Suharekës dhe për situatën që mbretëronte atje në vitin 1998 dhe 1999. Gjatë përpilimit të konkluzioneve përfundimtare në lidhje me akuzat për vrasje dhe shpërngulje në qytetin e Suharekës, Dhoma është bazuar në dëshmitë e dhëna nga dëshmitarët e Prokurorisë në vijim: fshatarët vendas Halit Berisha, Hysni Berisha, dhe Shyhrete Berisha, si dhe rezervisti vendas i MPB-së, K83. Dhoma thekson se Mbrojtja nuk kundërshtoi gjerësisht asnjë nga këta dëshmitarë dhe nuk paraqiti dëshmi të tjera për t'i kundërshtuar dëshmitë e tyre. Gjithashtu Prokuroria paraqiti si dëshmitar Shefqet Zogajn, gazetar nga Bellanica, për të dëshmuar në lidhje me ngjarjet në qytetin e Suharekës. Sidoqoftë, Dhoma e konsideroi dëshminë e tij shpesh të paqartë dhe kontradiktore në vetvete dhe, rrjedhimisht, është bazuar shumë pak në të sa i përket qytetit të Suharekës.¹²¹²

467. Në lidhje me shpërnguljen e personave nga fshati Bellanicë pretenduar në Aktakuzë, dy dëshmitarët kryesorë okularë të Prokurorisë ishin Shefqet Zogaj dhe Hamide Fondaj. Duke marrë parasysh afërsinë e ngushtë të këtyre dy dëshmitarëve me UÇK-në si dhe hezitimin e tyre për të pranuar disa fakte në lidhje me praninë dhe veprimet e UÇK-së në atë zonë,¹²¹³ Dhoma i ka analizuar dëshmitë e tyre me kujdes të veçantë. Kjo posaçërisht vlen për Zogajn, dëshmia e të cilit gjatë fazës së pyetjeve nga Mbrojtja zbuloi jo vetëm se ai kishte qenë pjesëtar i UÇK-së por gjithashtu se ai kishte tendencë t'i zmadhonte gjërat dhe ta ndërronte dëshminë, që rezultoi në disa kontradikta të brendshme. Dëshmitë e këtyre dy dëshmitarëve shpesh ishin në kundërshtim me dëshmitë e dëshmitarëve më të saktë, siç ishte dëshmia e Bislim Zyrapit, të cilin Dhoma e konsideron dëshmitar të saktë dhe të besueshëm. Si rezultat, Dhoma e pranon dëshminë e Zogajt apo të Fondajt vetëm kur ajo mbështetet nga prova të tjera ose kur mund të konsiderohet pranim jokontradiktor

¹²¹² *Shih, për shembull*, Shefqet Zogaj, T. 5856–5859 (3 nëntor 2006), P2322 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 prill 1999), f. 2. *Shih gjithashtu* Shefqet Zogaj, T. 3781, 3803–3804 (22 shtator 2006), T. 5897–5898 (6 nëntor 2006), P2322 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 prill 1999), f. 3.

¹²¹³ Shefqet Zogaj, T. 5896–5897, 5906 (6 nëntor 2006); Hamide Fondaj, T. 3826, 3844–3846, 3849 (25 shtator 2006), P2283 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 qershor 2001), f. 2.

468. Dhoma dëgjoi disa dëshmitarë të paraqitur nga Mbrojtja, si Bozhidar Deliqi dhe Lubivoje Joksiqi, ndihmëskordinator i RDB-së në Kosovë, dëshmia e të cilëve kundërshtonte disa aspekte të dëshmimeve të dëshmitarëve të paraqitur nga Prokuroria në lidhje me Suharekën. Megjithëse Dhoma nuk pranoi gjithçka që thanë ata, ajo i konsideron disa pjesë të dëshmimeve të tyre të sakta, siç parashtrahet më poshtë.

469. Dhoma gjithashtu dëgjoi dëshmi nga ushtarët e UJ-së, K54 dhe K82, të paraqitur nga Prokuroria, në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në veprimet e UJ-së/MPB-së në komunën e Suharekës në fund të marsit 1999 dhe vrasjen e civilëve nga UJ-ja, duke përfshirë edhe vrasjet e kryera nga K82 personalisht, në fshatin Tërm.¹²¹⁴ Meqenëse këto vrasje nuk përfshihen në Aktakuzë, Dhoma nuk ka nevojë të nxjerrë konkluzione të hollësishme në lidhje me to. Faktikisht, ashtu siç përmendi Dhoma në disa raste gjatë gjyqimit, dëshmitë e këtyre dy dëshmitarëve kryesisht janë me interes për identifikimin e forcave që vepronin në komunën e Suharekës në atë kohë dhe për vlerësimin e situatës në komunë.¹²¹⁵

470. Dhoma vëren se K54-a dhe K82-shi në fazën e pyetjeve nga Mbrojtja u pyetën gjatë dhe dëshmia e tyre u kundërshtua gjerësisht nga Mbrojtja.¹²¹⁶ Në kuadër të sulmit mbi besueshmërinë e K54-ës dhe K82-shit, Mbrojtja e Llazreviqit ftoi Pavle Gavrilloviqin, i cili i kundërshtoi ata në pikat kryesore.¹²¹⁷ Sidoqoftë, pavarësisht nga këto kundërshtime, Dhoma i konsideron dëshmitë e K54 dhe K82 përgjithësisht të besueshme. Dëshmitë e tyre ishin kryesisht përputhëse në vetvete dhe pjesërisht mbështeten nga dokumentet e UJ-së që konfirmojnë praninë e njërive të tyre në atë zonë në atë kohë.¹²¹⁸ Gjithashtu, Dhoma e konsideron pranimin prej K82-shit se ka vrarë civilë shqiptarë kosovarë si shenjë pozitive e ndershmërisë së tij, përkundër dënimit për një shkelje që nuk ka të bëjë me këtë çështje. Si rezultat, Dhoma i konsideron dëshmitë e K54-ës dhe K82-shit përgjithësisht të besueshme. Në anën tjetër, pasi ka shqyrtuar me kujdes dëshminë e Pavle Gavrilloviqit përkundrejt dëshmimeve bindëse të këtyre dy dëshmitarëve, Dhoma e konsideron jobindëse dhe jo të besueshme.

¹²¹⁴ K82, T. 11734–11812 (15 mars 2007), P2863 (deklarata e dëshmitarit); K54, T. 10477–10550 (26 shkurt 2007), 10551–10636 (27 shkurt 2007), P2883 (deklarata e dëshmitarit).

¹²¹⁵ Vendimi mbi Mocionin e Përbashkët të Mbrojtjes për të Përfshirë Dëshmitarin K54 nga Dëshmimi në Gjykim, 15 shkurt 2007; Vendimi mbi Mocionin e Prokurorisë për Rishikim prej Dhomës Gjyqësore të "Vendim mbi Dëshminë e Paraqitur Përmes Dëshmitarit K82," Lëshuar më 3 tetor 2006, dhe Leje për Rithirrjen e Dëshmitarit K82, dhe Vendim Përfundimtar mbi Dëshminë e Paraqitur Përmes Dëshmitarit K54, 13 mars 2007. *Shih gjithashtu* K54, T. 10477–10490 (26 shkurt 2007).

¹²¹⁶ K82, T. 11754–11755 (seancë e hapur), 11757–11759 (seancë e hapur), 11761–11775 (15 mars 2007) (seancë private), P2315 (deklarata e dëshmitarit), para. 42–43 (e mbyllur me vulë). *Shih gjithashtu* 5D132 (e mbyllur me vulë); K82, 5D133 (deklarata e dëshmitarit) (e mbyllur me vulë). K54, T. 10527–10534, 10545–10548 (26 shkurt 2007).

¹²¹⁷ Pavle Gavrilloviq, T. 21181–21238 (28 janar 2008).

¹²¹⁸ P1981 (Urdhër i Brigadës së 549-të të Motorizuar, 23 mars 1999), f. 4; P1995 (Analizë e operacionit të Brigadës së 549-të të Motorizuar, 30 mars 1999), f. 5.

471. Një pjesë e dëshmisë së K79-s, pjesëtar i një njësie të PJP-së, kishte të bënte gjithashtu me komunën e Suharekës. Dhoma kishte rezerva për disa pjesë të dëshmisë dhe rrjedhimisht mbështetet vetëm pjesërisht në të, duke u kufizuar vetëm në pjesët e konfirmuara nga dëshmi të tjera.

3. Rrethanat

472. Suhareka është komunë e madhe që gjendet në pjesën jugore të Kosovës qendrore e kufizuar, ndër të tjera, me komunat e Rahovecit, Prizrenit, Klinës, dhe Ferizajt.¹²¹⁹ Në fillim të viteve '90, komuna kishte rreth 50.000 - 60000 banorë, 95 për qind ishin shqiptarë kosovarë dhe pesë për qind të tjerë ishin serbë dhe romë.¹²²⁰ Qyteti i Suharekës ishte qyteti më i madh në komunë me rreth 8.000 banorë,¹²²¹ dhe me degën e vetë të brendshme (DPB).¹²²² Fshatrat Reshtan, Studençan, Tërm, Dobërdolan, dhe Peqan, të cilat përmenden shpesh në këtë pjesë, janë në lindje të qytetit, kurse Bellanica, Duhla, dhe Billaca ndodhen në pjesën veriore të komunës.¹²²³

473. K83-shi dëshmoi se, që nga viti 1998, situata në komunën e Suharekës u keqësua. UÇK-ja ishte e vendosur në veri dhe lindje të qytetit në drejtim të Malishevës, Budakovës, dhe Krushicës së Epërme, kurse policia nuk kishte njerëz të mjaftueshëm për t'i kontrolluar këto zona.¹²²⁴ Patrullat e MPB-së sulmoheshin shpesh dhe në shumë raste rezultonin në policë të plagosur ose të vrarë.¹²²⁵ Si rezultat i mungesës së personelit policor, K83 u detyrua të punonte si polic me orar të plotë gjatë tërë vitit 1998. Ai patrullonte qytetin dhe fshatrat përreth. Patrullat bëheshin zakonisht me makina të blinduara të prodhimit rus të quajtura "Gazika." Përgjatë rrugëve kishte postbloqe policore për të parandaluar sulmet e UÇK-së dhe për të kontrolluar trafikun.¹²²⁶ "Betejat" me UÇK-në bëheshin tri deri pesë kilometra nga ndërtesa e DPB-së në Suharekë, në rrugën për Reshtan, por jo në qendër të qytetit. Gjithashtu K83-shi tha se nga Serbia erdhën përforcime ushtarake dhe policore që u vendosën në qytet dhe fshatrat përreth.¹²²⁷

¹²¹⁹ P615 (Atlas i Kosovës), f. 11, 18.

¹²²⁰ Halit Berisha, T. 3605 (20 shtator 2006). *Shih gjithashtu* K83, T. 3979 (26 shtator 2006).

¹²²¹ Halit Berisha, T. 3605 (20 shtator 2006).

¹²²² Millosh Vojnoviq, T. 24228–24229 (13 mars 2008), 6D1532 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 mars 2008), para. 3.

¹²²³ P615 (Atlas i Kosovës), f. 11.

¹²²⁴ K83, T. 3978–3979 (26 shtator 2006). *Shih gjithashtu* Millosh Vojnoviq, T. 24172 (12 mars 2008), 6D1532 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 mars 2008), para. 27–28; 6D787 (Notë zyrtare e mbledhjes midis Sreten Llukiqit dhe përfaqësuesve të KVM-së, 24 shkurt 1999).

¹²²⁵ K83, T. 3978 (26 shtator 2006).

¹²²⁶ K83, T. 3928–3930 (25 shtator 2006), T. 3975, 3999 (26 shtator 2006).

¹²²⁷ K83, T. 3929–3930, 3986 (25 shtator 2006).

474. Halit Berisha, banor shqiptar kosovar i qytetit të Suharekës, tregoi se që nga prilli 1998 përpara stacionit të policisë ishin vendosur dy mortaja.¹²²⁸ Ushtria nuk ishte vendosur në mënyrë të përhershme në qytet, po në afërsi në Biraç dhe në Qafë të Duhlës, dhe vetëm kalonte nëpër qytet.¹²²⁹ John Crosland-i dëshmoi se gjatë vizitës në Suharekë në shtator apo dhjetor 1998 atje kishte prani të madhe të MPB-së dhe UJ-së po ashtu si dhe në zonën e Bllacës dhe Duhlës në veri të Suharekës. Këto dy pozicione ndaheshin nga territori i kontrolluar nga UÇK-ja.¹²³⁰

475. Bozhidar Deliqi gjithashtu dëshmoi se nga qershori 1998, UÇK-ja kontrollonte fshatrat në trekëndëshin Suharekë-Prizren-Rahovec, duke përfshirë Studençanin, Samodrezhën, Maçitevën, dhe Budakovën, si dhe zonën përreth Suharekës.¹²³¹ Me gjithë praninë e vëzhguesve të KVM-së situata në vitin 1999 nuk u përmirësua, në fakt UÇK-ja e zgjeroi kontrollin mbi atë zonë.¹²³² Rrjedhimisht, në shkurt të vitit 1999, Deliqi përpiloi një raport mbi gjendjen e sigurisë për Komandën e Korpusit të Prishtinës, ku informonte se trafiku në rrugën Suharekë-Rahovec ishte çrregulluar plotësisht, se pjesë të rrugës ishin nën kontrollin e plotë të UÇK-së dhe se UÇK-ja kontrollonte thuajse tërë hapësirën ndërmjet Prizrenit, Suharekës, dhe Malishevës, sidomos zonën malore të Malit Millanovac.¹²³³

476. Sipas Bislim Zyrapi, komuna e Suharekës, ndër të tjera, i përkiste Zonës së Pashtrikut apo Zonës Operative 2 të UÇK-së, ku në fund të marsit 1999 ishin aktive disa brigada.¹²³⁴ Zona e Pashtrikut ishte jo vetëm zona më e madhe e UÇK-së në atë kohë, por ishte edhe vendndodhja e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, sipas raporteve të US KDOM-it.¹²³⁵ Zyrapi gjithashtu dëshmoi se, nga nëntori 1998 deri në prill 1999, njësitë e UÇK-së ishin të vendosura në periferi të qytetit të Suharekës, por jo në qytet. Kjo u konfirmua nga Bozhidar Deliqi, njësitë e të cilit ndodheshin në atë

¹²²⁸ Halit Berisha, T. 3606-3607 (20 shtator 2006); IC40 (Hartë që tregon vendin e mortajave). *Shih gjithashtu* Halit Berisha, P2326 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 gusht 2001), f. 2.

¹²²⁹ Halit Berisha, T. 3661 (20 shtator 2006).

¹²³⁰ John Crosland, T. 10051 (9 shkurt 2007). *Shih gjithashtu* Karol John Drewienkiewicz, T. 7828-7829 (4 dhjetor 2006).

¹²³¹ Bozhidar Deliqi, T. 19275-19277 (28 nëntor 2007). *Shih gjithashtu* Pjesët VI.B dhe VI.C.

¹²³² Bozhidar Deliqi, T. 19276 (28 nëntor 2007). *Shih, për shembull*, 5D251 (Letër nga Llazareviqi drejtuar Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 23 shkurt 1999); Vladimir Llazareviq, T. 17939-17940 (8 nëntor 2007).

¹²³³ Bozhidar Deliqi, T. 19276-19278 (28 nëntor 2007), T. 19367 (29 nëntor 2007); 5D878 (Raport i Brigadës së 549-të të Motorizuar drejtuar komandës së PrK-së në lidhje me gjendjen e sigurisë në zonën e saj të përgjegjësisë, 15 shkurt 1999), f. 1. *Shih gjithashtu* Millosh Vojnoviq, 6D1532 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 mars 2008), para. 31, 41.

¹²³⁴ Bislim Zyrapi, T. 5934, 5967 (6 nëntor 2006), T. 6258 (10 nëntor 2006); P2469 (Hartë ku tregohen zonat e ndryshme operative të UÇK-së); P2465 (Urdhër i UÇK-së i lëshuar nga Zona Operative e Pashtrikut, 7 mars 1999); P2447 (hartë që tregon pozicionet e UÇK-së); P2468 (vërtetim për marrjen e urdhrave nga brigadat e Zonës Operative të Pashtrikut, 10 janar 1999); P2459 (Mostër e urdhrave luftarakë të përdorur nga UÇK-ja ku figurojnë brigadat e Pashtrikut). *Shih gjithashtu* Joseph Maisonneuve, T. 11133 (6 mars 2007), P2772 (deklarata e dëshmitarit e datës 10 mars 2000), para. 15, shtojca MM2/B. *Shih gjithashtu* Pjesën VI.B.

¹²³⁵ 6D1635 (Raport i U.S. KDOM-it mbi UÇK-në, shkurt 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8.

zonë në atë kohë.¹²³⁶ Halit dhe Hysni Berisha, banorë të qytetit të Suharekës, pranuan se kishte prani të UÇK-së dy deri tri kilometra më larg, më konkretisht në Dobërdolan dhe Reshtan, por këmbëngulën se ajo prani nuk zgjerohej deri në qendër të qytetit.¹²³⁷ Sidoqoftë, K83-shi dëshmoi se edhe vetë qyteti konsiderohej i rrezikshëm për policinë dhe 6D2-shi dëshmoi se thuajse i gjithë qyteti, dhe territori përreth ishin në duart e UÇK-së.¹²³⁸ Duke marrë parasysh dëshmitë e tjera të përmendura në këtë paragraf, Dhoma gjykon se 6D2-shi e zmadhon ndikimin e UÇK-së në qytet.

477. Sipas një raporti të përpiluar nga Qendra e RDB-së në Prizren në janar 1999, shumica e fshatrave në territorin e komunës së Suharekës ishin nën kontrollin e UÇK-së, përfshirë Bellanicën, Lladrocin, Samodrezhën, Studençanin, Dobërdolanin, Bllacën, Peqanin, Semetishtën, dhe Nishorin.¹²³⁹ Raporti pretendonte se të gjitha këto fshatra shërbenin si brez sigurie për Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së në fshatin Breshan, duke e mbrojtur nga sulmet.¹²⁴⁰ Në mars 1999, sipas një dokumenti tjetër të RDB-së, Shtabi i Përgjithshëm në Breshan kishte një numër të madh pjesëtarësh të UÇK-së nën komandën e tij, të dislokuar në grupe në 40 fshatra anembanë komunës. UÇK-ja kishte pozicione të fortifikuara në veri dhe veriperëndim të qytetit të Suharekës.¹²⁴¹ Dhoma vëren se shumë dokumente të RDB-së përmendin mijëra ushtarë të UÇK-së në komunë. Sidoqoftë, edhe pse pranon se prania e UÇK-së në Suharekë ishte e konsiderueshme, Dhoma nuk mund të përcaktojë saktësisht numrin e këtyre forcave në atë zonë sepse dokumente të ndryshme të RDB-së japin shifra të ndryshme.

4. Ngjarjet e qytetit të Suharekës të përfshira në Aktakuzë

478. Siç do të diskutohet në më shumë hollësi në Pjesën VII.P më poshtë, pas zbulimit të një varri të përbashkët në Batajnicë afër Beogradit në vitin 2001 dhe zhvarrosjen të kufomave të gjetura atje, identifikimi i tyre zbuloi se disa prej tyre ishin anëtarë të familjes Berisha nga qyteti i

¹²³⁶ Bislim Zyrapi, T. 6265 (10 nëntor 2006); Bozhidar Delliq, T. 19439 (4 dhjetor 2007). Delliq gjithashtu shpjegoi se në disa fshatra, si në Reti, popullata civile ishte larguar që në shkurt 1999. Pas kësaj, fshati ishte përdorur nga një brigadë e UÇK-së si postëkomandë dhe si spital i UÇK-së. Bozhidar Delliq, T. 19441–19442 (4 dhjetor 2007).

¹²³⁷ Halit Berisha, T. 3713 (21 shtator 2006); Hysni Berisha, T. 4028 (26 shtator 2006). Vërejtje se Bozhidar Delliq dëshmoi se postblloku më i afërt i UÇK-së ishte në Reshtan, një deri dy kilometra nga qendra e qytetit të Suharekës. Bozhidar Delliq, T. 19439 (4 dhjetor 2007).

¹²³⁸ K83, T. 3979 (26 shtator 2006); 6D2, 6D1631 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 prill 2008), para. 58 (e mbyllur me vulë).

¹²³⁹ 6D1008 (Raport i Qendrës së RDB-së në lidhje me aktivitetet e UÇK-së në Suharekë, 8 janar 1999), f. 1; Lubivoje Joksiq, 6D1491 (deklarata e dëshmitarit e datës 28 janar 2008), para. 62. *Shih gjithashtu* 6D1010 (Raport i Qendrës së RDB-së në Prizren në lidhje me aktivitetet e UÇK-së në Suharekë, 11 janar 1999); 6D1635 (Raport i U.S. KDOM-it për UÇK-në, shkurt 1999), versioni elektronik f. 8. Raporti i U.S. KDOM-it i referohet Lladrocit dhe Semetishtës si postëkomanda të UÇK-së në komunën e Suharekës.

¹²⁴⁰ 6D1008 (Raport i MPB-së së Prizrenit, 8 janar 1999), f. 2. *Shih gjithashtu* 6D1010 (Raport i MPB-së së Prizrenit, 11 janar 1999), f. 1; 6D1014 (Raport i MPB-së së Prizrenit, 20 janar 1999).

¹²⁴¹ 6D1013 (Raport i MPB-së së Prizrenit, 13 mars 1999), f. 1–2.

Suharekës. Ky zbulim u bë shkak për nisjen e hetimeve mbi vrasjen e anëtarëve të kësaj familje. Disa dëshmitarë dëshmuuan në këtë çështje lidhur me mënyrën e vrasjes së shumë anëtarëve të familjes Berisha në fund të marsit 1999 në qytetin e Suharekës. Këto dëshmi jepen më poshtë.

a. DPB-ja e Suharekës

479. K83 dëshmoi se në fillim të vitit 1999, eprori i tij i parë në DPB-në e Suharekës ishte Nenad Jovanoviç.¹²⁴² Në stacionin e DPB-së ishin të pranishëm edhe dy oficerë të RDB-së, njëri prej të cilëve ishte Millorad (Mishko) Nishaviç, pronar i hotelit Boss në fshatin e afërm të Shirokës.¹²⁴³ Sidoqoftë, K83-shi e dinte se RDB-ja dhe RJB-ja kishin hierarki, arkiva kompjuterike të të dhënave, dhe kanale informacioni të veçanta brenda DPB-së.¹²⁴⁴ Rrjedhimisht sipas K83-shit, shefi i DPB-së nuk kishte pushtet mbi oficerët e RDB-së.¹²⁴⁵ Lubivoje Joksiç konfirmoi se RDB-ja kishte një "degë vendore" në qytetin e Suharekës. Ai gjithashtu konfirmoi se RDB-ja kishte sistemin e vet të pavarur të drejtimit dhe se askush nga RJB-ja nuk kishte pushtet mbi askënd në RDB.¹²⁴⁶

480. K83-shi i tha Dhomës se shumica e atyre që punonin në godinën e DPB-së ishin vendas nga komuna. Vetë Nishaviç ishte nga Suhareka dhe ishte i njohur në qytet, ku kishte disa biznese të tjera përveç hotelit. Më 12 shtator 1998, hoteli i tij u godit nga një predhë. Në një rast tjetër në vitin 1998, ai u qëlluar me armë zjarri dhe u plagos.¹²⁴⁷ K83-shi nuk ofroi ndonjë të dhënë mbi autorët e mundshëm të sulmeve dhe motivet e tyre.

481. DPB-ja e Suharekës ishte nën komandën e SPB-së së Prizrenit dhe, rrjedhimisht i raportonte asaj.¹²⁴⁸ Mirëpo në fund të marsit 1999, komunikimi midis tyre u ndërpre për 4 - 5 ditë pasi NATO-ja bombardoi ndërtesën e SPB-së në Prizren dhe e dëmtoi rëndë. Udhëtimi midis dy qyteteve ishte i mundshëm dhe komunikimi mbahej në këtë mënyrë. Gjithashtu, mbeti i pandërprerë funksionimi me disa lloje radiokomunikimi.¹²⁴⁹

¹²⁴² K83, T. 3932 (25 shtator 2006), T. 3991–3992 (26 shtator 2006).

¹²⁴³ K83, T. 3931–3932 (25 shtator 2006). Dhoma vëren mospërputhjen midis emrit të përdorur prej Shyrete Berishës për pronarin e Hotelit Boss ("Mishkoviç") dhe emrit të përdorur nga dëshmitarët e tjerë (Mishko Nishaviç). Dhoma është bindur se ky person është në fakt Millorad (Mishko) Nishaviç dhe se zonja Berisha e ka gabuar emrin e tij të vërtetë. Për këtë arsye, kur zonja Berisha përmend "Mishkoviçin" në dëshminë e saj, duhet të kuptohet se i referohet Nishaviçit.

¹²⁴⁴ K83, T. 3968 (26 shtator 2006).

¹²⁴⁵ K83, T. 3992–3993 (26 shtator 2006).

¹²⁴⁶ Lubivoje Joksiç, T. 21941–21942 (8 shkurt 2008). *Shih gjithashtu* Millosh Vojnoviç, T. 24228–24229 (13 mars 2008), 6D1532 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 mars 2008), para. 3–4.

¹²⁴⁷ K83, T. 3969, 3972–3973 (26 shtator 2006).

¹²⁴⁸ K83, T. 3969 (26 shtator 2006). *Shih gjithashtu* Millosh Vojnoviç, T. 24228–24229 (13 mars 2008), 6D1532 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 mars 2008), para. 3–4.

¹²⁴⁹ K83, T. 3982–3984, 4003–4004 (26 shtator 2006).

b. Ngjarjet në qytetin e Suharekës pak para dhe më 25 mars 1999

482. Pas mbërritjes në qytet, verifikuesit e KVM-së bujtën fillimit në hotelin Boss, pronë e Nishaviqit. Më vonë, ata u zhvendosën në një shtëpi e cila ishte pronë e familjes së Shyhrete Berishës, në të cilën deri në atë kohë kishin banuar ajo, burri i saj Nexhati, katër fëmijët, kunata e Nexhatit Fatimja, dhe familja e Fatimes.¹²⁵⁰ K83-shi dëshmoi se shpejt pas ardhjes së verifikuesve, popullata vendëse serbe filloi t'i shihte sikur mbanin anën e UÇK-së dhe e ndihmonin, e jo sikur punonin për qetësimin e situatës.¹²⁵¹ Më 20 mars 1999, verifikuesit e KVM-së u larguan nga Kosova, duke përfshirë edhe pikat e tyre në komunën e Suharekës. Pas largimit të tyre, Shyhrete Berisha dhe familja e saj u kthyen në shtëpinë e tyre.¹²⁵²

483. Ekzistojnë prova se më 22 mars 1999 serbi i quajtur Bogdan Llaziq u vra në një dyqan në qytetin e Suharekës. Gjithashtu ekzistojnë prova se pas këtij incidenti u vranë rreth 10 banorë shqiptarë kosovarë të qytetit.¹²⁵³ Dhoma pranoi si prova pjesë të një dokumenti të MPB-së ku gjendet një listë e veprave penale të evidentuara në Kosovë dhe masave të marra në lidhje me to gjatë periudhës 1 korrik 1998 - 20 qershor 1999, pjesë e cila iu treguan një dëshmitari në gjykatë dhe ai që në gjendje të jepte dëshmi të drejtpërdrejtë në lidhje me përmbajtjen e saj.¹²⁵⁴ Ky dokument gjithashtu përmend vrasjen e Bogdan Llaziqit nga pjesëtarë të panjohur të UÇK-së, por nuk përmend vrasjet e mëvonshme të shqiptarëve kosovarë.¹²⁵⁵

484. Bislim Zyrapi dëshmoi se më 24 mars 1999, ditën e fillimit të bombardimeve nga NATO-ja, "forcat serbe" nisën një sulm artilerik kundër pozicioneve të UÇK-së në këtë komunë.¹²⁵⁶ Një urdhër i Komandës së Përbashkët i datës 23 mars 1999, që është diskutuar më lart në pjesën në

¹²⁵⁰ K83, T. 3980–3981 (26 shtator 2006); Shyhrete Berisha, T. 3871, 3873–3874 (25 shtator 2006); P2346 (trungu familjar i familjes Berisha). Shyhrete Berisha e konfirmoi dëshminë e K83-shit se kur përfaqësuesit e KVM-së erdhën për herë të parë në Suharekë, ata i kishin zyrat në Hotelin Boss, pronë e personit, të cilit ajo iu referua gjatë dëshmisë së saj gojore si "Mishkoviq," dhe se ata u vendosën në shtëpinë e saj më vonë, në fund të vitit 1998. Gjatë fazës së pyetjeve nga Mbrojtja, Shyhrete Berisha mohoi se dinte gjë për fjalosjen midis burrit të saj dhe "Mishkoviqit" për shkak se KVM-ja ishte zhvendosur në shtëpinë e Berishëve. Përkundrazi, vëllai i burrit të saj ishte mik me "Mishkoviqin" dhe vëllain e Mishkoviqit. Shyhrete Berisha, T. 3911–3912, 3923 (25 shtator 2006). *Shih gjithashtu* Joseph Maisonneuve, T. 11178 (7 mars 2007).

¹²⁵¹ K83, T. 3980 (26 shtator 2006).

¹²⁵² Shyhrete Berisha, T. 3875 (25 shtator 2006); Hysni Berisha, P2282 (deklarata e dëshmitarit e datës 20 gusht 2001), f. 2.

¹²⁵³ Halit Berisha, T. 3707–3710 (21 shtator 2006); Hysni Berisha, P2282 (deklarata e dëshmitarit e datës 20 gusht 2001), f. 2; K83, T. 3985 (26 shtator 2006).

¹²⁵⁴ *Shih* Vendimin mbi Mocionin e Llukiqit për Rishikim të Vendimit të Dhomës Gjyqësore mbi Mocionin për Pranimin e Dokumenteve në Sallën Gjyqësore dhe Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit për Paraqitjen e Dosjeve Gjyqësore Përfundimtare, 2 korrik 2008, para. 30–31.

¹²⁵⁵ 6D614 (Pasqyrë prej MPB-së e veprave penale të evidentuara, 1 korrik 1998 to 20 qershor 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 692–693.

¹²⁵⁶ Bislim Zyrapi, T. 5991–5992 (7 nëntor 2006). *Shih gjithashtu* Millosh Vojnoviq, T. 24172 (12 mars 2008).

lidhje me komunat e Prizrenit e Rahovecit, e konfirmon këtë dëshmi.¹²⁵⁷ Më pas Bozhidar Deliqi lëshoi një urdhër për njësitë e Brigadës së 549-të të Motorizuar që, në bashkëpunim me PJP-në, të shkatërronin "FTSH-në" në sektorin e fshatit Reti, të hiqnin bllokadën e rrugës Suharekë-Rahovec, dhe të merrnin territorin nën kontroll.¹²⁵⁸ Urdhri përmendte pozitat e "FTSH-së" në zonën e përgjithshme të Retisë, Malit Millanovac, Studençanit, Samodrezhës, Dobërdolanit, dhe Pagarushës dhe më poshtë rendiste detyrat për njësitë e ndryshme. Asnjë nga urdhrat nuk parashikonte pjesëmarrjen e pjesëtarëve të DPB-së vendëse në këtë aksion. Ndër të tjera, Grupi Luftarak 5 i Brigadës së 549-të të Motorizuar duhej të hiqte bllokadën e rrugës e cila lidh fshatrat Reshtan, Studençan, dhe Samodrezhë. Pjesëmarrja e PJP-së përfshinte Detashmentin e 37-të të Nishit.¹²⁵⁹ Urdhri gjithashtu kërkonte trajtim "korrekt" të "popullatës civile besnike, sidomos refugjatët, dhe pronën e tyre," dhe i udhëzonte forcat "të hapin zjarr vetëm kundër objekteve të përdorura nga [UÇK-ja] për t'ju sulmuar."¹²⁶⁰ Millosh Vojnoviqi, i cili në atë kohë ishte shef i SPB-së së Prizrenit, dëshmoi se ai ishte në dijeni të këtij aksioni dhe se takohej përditë me Deliqin dhe me komandantin e Detashmentit të 37-të të PJP-së, Radosllav Mitroviqin, emri i koduar i cilit ishte "Çegar Një", për të diskutuar ecurinë e operacionit.¹²⁶¹ Në atë kohë, Mitroviqi dhe pjesë të detashmentit të tij ishin të vendosur në qytetin e Suharekës, në hotelin Ballkan.¹²⁶²

485. Si rezultat i këtyre zhvillimeve, u shtuan lëvizjet e policisë dhe "forcave të tjera serbe" në qytetin e Suharekës.¹²⁶³ Halit Berisha dëshmoi se këto forca kishin pushkë AK-47 dhe uniforma të ndryshme, më konkretisht, uniforma kamuflimi të kaltra ose të gjelbra, ose rroba civile të zeza me shami të ngjyrave të ndryshme në kokë.¹²⁶⁴ Atyre iu bashkuan civilët vendës serbë, të cilët gjithashtu kishin uniforma dhe armë.¹²⁶⁵ Sipas Hysni Berishës, këto forca në fillim u vendosurën në shkollën e lagjes, por më vonë u vendosën në "shkollën teknike" e cila ishte afër rrugës për në Reshtan.¹²⁶⁶ Shyhyre Berisha dëshmoi për autobusët plot me "ushtarë" dhe "policë" me uniforma të

¹²⁵⁷ P2015 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 23 mars 1999). *Shih gjithashtu* Millosh Vojnoviq, T. 24177–24179 (12 mars 2008).

¹²⁵⁸ Bozhidar Deliqi, T. 19678–19679 (6 dhjetor 2007); P1981 (Urdhër i Brigadës së 549-të të Motorizuar, 23 mars 1999).

¹²⁵⁹ P1981 (Urdhër i Brigadës së 549-të të Motorizuar, 23 mars 1999), f. 1–3.

¹²⁶⁰ P1981 (Urdhër i Brigadës së 549-të të Motorizuar, 23 mars 1999), f. 6.

¹²⁶¹ Millosh Vojnoviq, T. 24178–24179 (12 mars 2008), T. 24241–24242 (13 mars 2008); Lubinko Cvetiq, T. 8110 (7 dhjetor 2006); P1052 (plani i qendrës së komunikimit me emrat e koduar).

¹²⁶² K83, T. 3938–3939 (26 shtator 2006).

¹²⁶³ Halit Berisha, P2326 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 gusht 2001), f. 2, T. 3646–3647, 3654–3655 (20 shtator 2006); Hysni Berisha, P2282 (deklarata e dëshmitarit e datës 20 gusht 2001), f. 2.

¹²⁶⁴ Halit Berisha, P2326 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 gusht 2001), f. 2, T. 3646–3647, 3654–3655 (20 shtator 2006).

¹²⁶⁵ Halit Berisha, T. 3654–3656 (20 shtator 2006). *Shih gjithashtu* Tomisllav Mitiq, T. 20840–20841 (22 janar 2008), 5D1390 (deklarata e dëshmitarit e datës 27 dhjetor 2007), para. 25–26.

¹²⁶⁶ Hysni Berisha, P2282 (deklarata e dëshmitarit e datës 20 gusht 2001), f. 2.

ndryshme kamuflimi, të gjelbra dhe të kaltra, si dhe uniforma të gjelbra të zakonshme. Disa nga ata sillëshin më mirë dhe ishin më seriozë se të tjerët të cilët kishin shami në kokë dhe bërtisnin dhe qëllonin me armë në ajër.¹²⁶⁷

486. Herët në mëngjesin e 25 marsit 1999, forcat e Deliqit kishin kaluar nëpër Suharekë dhe u panë nga Halit Berisha. Si Deliqi, po ashtu edhe K83-shi dëshmuar se në atë kohë forcat e UJ-së nuk ishin të vendosura në qytet.¹²⁶⁸

487. Më 25 mars, rreth orës 6:30 të mëngjesit, 20-30 anëtarë të familjes Berisha, që jetonin në qendër të qytetit, kaluan pranë shtëpisë së Halit Berishës e cila gjendet pas ndërtesës së këshillit komunal dhe i thanë se afër shtëpisë së tyre ishin vrarë dhe ishin plaçkitur njerëz dhe se ata ishin duke ikur prej policisë dhe ushtrisë serbe.¹²⁶⁹ Halit Berisha konfirmoi se atë ditë kishte pasur luftime midis UÇK-së dhe "forcave serbe" në zonën në perëndim të Suharekës. midis Krushës së Madhe dhe Reshtanit.¹²⁷⁰ Ai e udhëzoi familjen e tij të ngushtë që të mblihdnin plaçkat dhe të shkonin në fshatin Savrovë, por vetë qëndroi aty me gruan dhe vëllain, Jashar Berishën, i cili punonte si shef i pikës së karburantit në qendër të qytetit.¹²⁷¹

488. Sipas Bislim Zyrapit, më 25 mars 1999 "forcat serbe" nga drejtimi i Rahovecit sulmuan fshatrat Nagafc dhe Hoçë në komunën e Rahovecit, dhe fshatin Nishor në komunën e Suharekës. Pas nisjes së sulmit, Zyrapit lëshoi një urdhër për largimin e banorëve të këtyre fshatrave që të largoheshin dhe UÇK-ja së bashku me banorët vendas filluan të tërhiqeshin.¹²⁷² Përfundimisht civilët dhe UÇK-ja u zhvendosën në territorin e fshatit Dobërdolan. Civilët vazhduan më tej në veri deri në Pagarushë, kurse UÇK-ja u tërhoq në male në zonën midis qyteteve të Rahovecit dhe Suharekës, më saktësisht, në kodrat mbi fshatin Dobërdolan që rrethojnë fshatin Semetishtë.¹²⁷³ Gjithashtu, analiza e datës 30 mars 1999 e bërë nga Deliqi pas operacionit u referohet veprimeve më 25 mars dhe pohon se UÇK-ja u tërhoq përgjatë rrugës Samodrezhë-Dobërdolan dhe përgjatë rrugës për në Pagarushë. Ky dokument gjithashtu bënte të ditur se, edhe pse kishte pasur rezistencë

¹²⁶⁷ Shyrete Berisha, T. 3877–3878 (25 shtator 2006). *Shih gjithashtu* P189 (Fotografite ajrore të Suharekës), f. 1.

¹²⁶⁸ Halit Berisha, T. 3661 (20 shtator 2006); Bozhidar Delliq, T. 19391 (29 nëntor 2007). *Shih gjithashtu* K83, T. 3998–3999 (26 shtator 2006); Tomisllav Mitiq, 5D1390 (deklarata e dëshmitarit e datës 27 dhjetor 2007), para. 29–30.

¹²⁶⁹ Halit Berisha, T. 3609–3610 (20 shtator 2006), P2326 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 gusht 2001), f. 2–3. Gjatë fazës së pyetjeve nga Mbrojtja, zotit Berisha iu tregua deklarata e tij në të cilën ai kishte thënë se ata po iknin nga "serbët." P2326 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 gusht 2001), f. 3. Ai u ballafaqua edhe me dëshminë e dhënë në gjyqin e Millosheviqit, ku kishte thënë se ata po iknin nga "policia serbe." Gjithsesi ai këmbënguli se policia dhe ushtria vepronin së bashku. Halit Berisha, T. 3657–3662 (20 shtator 2006).

¹²⁷⁰ Halit Berisha, T. 3713 (21 shtator 2006).

¹²⁷¹ Halit Berisha, P2326 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 gusht 2001), f. 3.

¹²⁷² Bislim Zyrapit, T. 5991–5992 (7 nëntor 2006).

¹²⁷³ Bislim Zyrapit, T. 5992–5994 (7 nëntor 2006); P2447 (hartë me pozicionet e UÇK-së, vija midis pozicioneve A dhe B tregon vendin ku ishte tërhequr UÇK-ja).

të fortë "përgjatë drejtimit Suharekë-Studençan," përfundimit UÇK-ja "ishte zmbarsur" nga fshati Reshtan para se të binte nata.¹²⁷⁴

489. Shyrete Berisha dëshmoi se në mëngjesin e 25 marsit 1999, tre "policë" me uniforma kamuflimi të gjelbra të cilët nuk i kishte njohur, vizituan atë dhe bashkëshortin e saj në shtëpi, e cila më parë kishte qenë zyrë e KVM-së.¹²⁷⁵ Policët kontrolluan ish-zyrën e KVM-së, rrahën burrin e zonjës Berisha duke e pyetur ku e kishte "babë Klintonin," dhe i kërkuan më shumë se 1.000 marka gjermane.¹²⁷⁶ Në të njëjtën kohë, një kamion u parkua para shtëpisë dhe policët po e ngarkonin me televizorë, ngrohës, kompjutera, dhe pajisje të tjera që ishin pronë e KVM-së dhe familjes Berisha.¹²⁷⁷ Zonja Berisha gjithashtu tha se në atë moment para shtëpisë së Agron Berishës, e cila është ngjitas me të sajën u parkua një "tank," – ajo e përshkroi ashtu, por duhet të ketë qenë autobлиндë.¹²⁷⁸

490. Pas largimit të policëve, Berishët shkuan në shtëpinë e Vesel Berishës, e cila ishte pas shtëpisë së tyre. Vesel Berisha ishte axha i Nexhatit; ai jetonte me gruan Havanë, tre djemtë e rritur, Sedatin, Bujarin, dhe Nexhmedinin, familjet e djemve, dhe babanë dhe nënën e tij. Gjithsej 25 anëtarë të familjes Berisha e kaluan natën e 25-26 marsit 1999 në shtëpinë e Vesel Berishës; Vesel Berisha nuk ndodhej në shtëpi në atë kohë.¹²⁷⁹ Sipas Shyrete Berishës, ata dëgjuan krisma armësh gjatë tërë natës.¹²⁸⁰

491. Dhoma nuk dëgjoi asnjë dëshmi e as Mbrojtja nuk paraqiti ndonjë dëshmi se ndonjë nga njerëzit e fshehur në shtëpinë e Vesel Berishës më 25 - 26 mars 1999, ishte luftëtar. Sipas dëshmisë së Shyrete Berishës, e cila nuk u kundërshtua nga Mbrojtja dhe të cilën Dhoma e konsideron të besueshme, të pranishëm në shtëpi ishin këta persona: Shyrete Berisha, Nexhat Berisha (burri i zonjës Berisha), Majlinda Berisha (vajza 15-vjeçare e zonjës Berisha), Herolinda Berisha (vajza 13-vjeçare e zonjës Berisha), Altin Berisha (djali 11-vjeçar i zonjës Berisha), Redon Berisha (djali një vjeç e gjysmë i zonjës Berisha), Fatime Berisha (kunata e Nexhatit), Faton Berisha (djali i Fatimes), Sherine Berisha (motra 17-vjeçare e Fatonit), Sebahate Berisha (gruaja e Fatonit), Ismet Berisha (djali 3-vjeçar i Fatonit), Eron Berisha (djali 10-muajsh i Fatonit), Hava Berisha (gruaja e Veselit),

¹²⁷⁴ P1995 (Analizë e operacionit të Brigadës së 549-të të Motorizuar, 30 mars 1999), f. 4. *Shih gjithashtu* Bislim Zyrapit, T. 5992–5994 (7 nëntor 2006).

¹²⁷⁵ Shyrete Berisha, T. 3879, 3914–3915 (25 shtator 2006).

¹²⁷⁶ Shyrete Berisha, T. 3879–3882, 3884 (25 shtator 2006).

¹²⁷⁷ Shyrete Berisha, T. 3882–3883 (25 shtator 2006).

¹²⁷⁸ Shyrete Berisha, T. 3885–3886 (25 shtator 2006); IC46 (Fotografi e shënuar nga zonja Berisha për të treguar vendin e "tankut").

¹²⁷⁹ Shyrete Berisha, T. 3886–3887 (25 shtator 2006); P2346 (trungu familjar i familjes Berisha).

¹²⁸⁰ Shyrete Berisha, T. 3915 (25 shtator 2006).

Sedat Berisha (djali i Veselit), Bujar Berisha (djali i Veselit), Nexhmedin Berisha (djali i Veselit), Flora Berisha (gruaja e Bujarit), Liri Berisha (gruaja shtatzënë 8-muajsh e Nexhmedinit), Vjollca Berisha (gruaja e Sedatit), Dafina Berisha (vajza 15-vjeçare e Sedatit), Drilon Berisha (djali 13-vjeçar i Sedatit), Gramoz Berisha (djali 8-vjeçar i Sedatit), Vlorjan Berisha (djali 17-vjeçar i Bujarit), Edon Berisha (djali 14-vjeçar i Bujarit), dhe Doruntina Berisha (vajza 4-vjeçare e Bujarit).

c. Vrasjet në qytetin e Suharekës më 26 mars 1999

492. Më 26 mars 1999, Shyrete Berisha pa dy tanke të vendosur në kodrat pas shtëpisë në të cilën ishte, të drejtuar nga shtëpia. Ajo gjithashtu pa lëvizje të mëdha të policëve dhe automjeteve nëpër qytet. Për këtë arsye Berishët menduan se dalja nga shtëpia apo ikja ishte e pamundshme.¹²⁸¹ Rreth mesditës, zonja Berisha pa një numër të madh policësh duke dalë nga stacioni i policisë. Ata mbanin uniforma të "ndryshme" dhe pushkë automatike. Disa nga ata ishin me rroba civile, por gjithsesi të armatosur. Të pranishëm ishin edhe disa romë. Ata u nisën në drejtim të shtëpisë.¹²⁸² Më pas zonja Berisha dëgjoi njërin prej tyre, Zoran Petkoviqin, duke thirrur Bujarin me emër. Nëna e Bujarit, Havaja, doli jashtë, por Petkoviqi vazhdoi të kërkonte Bujarin duke bërë titur se do t'i vrisnin të gjithë shqiptarët. Menjëherë pas daljes së Bujarit, u dëgjuan të shara dhe krisma armësh. Me të dëgjuar krismat, Berishët, disa prej tyre zbathur, filluar të klithnin dhe vrapuan drejt daljes së oborrit.¹²⁸³ Teksa vraponte me fëmijët e saj dhe vajzën e Sedatit, Dafinën, zonja Berisha pa Zoran Petkoviqin, zërin e të cilit e kishte njohur më herët.¹²⁸⁴ Pak momente më vonë, ajo pa para shtëpisë së Agron Berishës burrin e saj Nexhatin me "Mishkoviqin," i cili ishte i veshur me rroba civile të zeza.¹²⁸⁵ "Mishkoviqi" po i bërtiste Nexhatit. Një polic tjetër kapi Fatonin. Pas pak, ajo pa "Mishkoviqin" kur qëlloi Nexhatin me armë. Nëna e Fatonit, e cila ishte afër tij, kapi dorën e Fatonit dhe i tha policit që e mbante, të merrte atë në vend të djalit. Gjithashtu zonja Berisha pa një polic tjetër që kapi Sedatin.¹²⁸⁶ Ajo njohu edhe disa persona të tjerë të pranishëm.¹²⁸⁷ Sipas saj aksionit i prinin Zoran Petkoviqi dhe "Mishkoviqi".¹²⁸⁸

¹²⁸¹ Shyrete Berisha, T. 3887–3889 (25 shtator 2006).

¹²⁸² Shyrete Berisha, T. 3889–3891, 3919–3920 (25 shtator 2006).

¹²⁸³ Shyrete Berisha, T. 3891–3893 (25 shtator 2006).

¹²⁸⁴ Shyrete Berisha, T. 3894 (25 shtator 2006). Gjatë fazës së pyetjeve nga Mbrojtja, Shyrete Berisha u pyet se a kishte dijeni për incidentin midis KVM-së dhe nënës së Zoran Petkoviqit, Verës, e cila pretendohet se ishte goditur dhe lënduar nga një makinë e KVM-së. Shyrete Berisha pohoi se kishte dëgjuar për incidentin. Shyrete Berisha, T. 3917–3918 (25 shtator 2006).

¹²⁸⁵ Shyrete Berisha, T. 3894–3895, 3921 (25 shtator 2006); IC46 (Fotografi e shënuar nga Shyrete Berisha që tregon shtëpinë e Agron Berishës).

¹²⁸⁶ Shyrete Berisha, T. 3895–3896, 3913–3914 (25 shtator 2006).

¹²⁸⁷ Shyrete Berisha, T. 3921 (25 shtator 2006).

¹²⁸⁸ Shyrete Berisha, T. 3918 (25 shtator 2006).

493. Zonja Berisha dëgjoi dikë duke bërtitur "vritini, vritini" dhe pastaj pa Nexhmedinin afër saj, kur u rrëzua. Kur kuptoi se do t'i vrisnin të gjithë, ajo u tha fëmijëve të ndaheshin në dy grupe dhe të vraponin. Zonja Berisha ia dha vrapit me Herolindën në drejtim të pikës së karburantit, kurse Majlinda (e cila mbante Redonin), Dafina, dhe Altini vrapuan në drejtim tjetër.¹²⁸⁹ Te pika e karburantit, zonja Berisha dhe Herolinda takuan Jashar Berishën. Zonja Berisha i tregoi menjëherë se çfarë kishte ndodhur dhe vazhdoi të vraponte derisa mbërriti në një piceri aty afër, ku gjeti pjesën tjetër të familjes.¹²⁹⁰ Ajo foli me Avdi Berishën, i cili i tha se ishin mbledhur aty sepse ashtu u kishte thënë policia. Pak më vonë erdhën edhe fëmijët e tjerë të zonjës Berisha bashkë Lirinë. Në atë moment mbërritën një numër policësh dhe e urdhëruan të gjithë grupin, përfshirë edhe shumë anëtarë të tjerë të familjes Berisha, të hynin në piceri.¹²⁹¹

494. Pasi hynë brenda, policët serbë i thanë familjes Berisha të uleshin në tokë. Pastaj policët hapën zjarr dhe hodhën bomba në piceri. Pasi u ndalën të shtënat, ata hynë në ndërtesë dhe filluan t'i çonin kufomat për të parë se a kishte mbetur kush gjallë dhe i vrisnin. Shyrete Berisha ishte plagosur nga plumbat dhe ciflat e bombës dhe pastaj u qëllua edhe një herë. Sidoqoftë, ajo dhe dy të tjerë, Vjollca dhe Gramozi, mbetën gjallë pas sulmit.¹²⁹² Kufomat e të gjithë personave në piceri, përfshirë edhe tre mbijetuesit, u ngarkuan në kamion dhe u dërguan në drejtim të Prizrenit.¹²⁹³ Zonja Berisha, Vjollca, dhe Gramozi ia dolën të iknin nga kamioni gjatë rrugës; më pas dikush i mori dhe i dërgoi në fshatin e afërt, ku zonjës Berisha i mjekuan plagët.¹²⁹⁴

495. Edhe Halit Berisha dëshmoi për ngjarjet e 26 marsit 1999. Ai dëshmoi se atë mëngjes vëllai i tij Jashari shkoi në punë si zakonisht, edhe pse e kishte lutur të rrinte në shtëpi. Z. Berisha qëndroi në shtëpi. Nga mesdita Jashari i telefonoi dhe i tha të largohej sepse në qendrën tregtare të qytetit po vriteshin njerëz. Më pas Halit Berisha mblodhi rreth 200 vetë, fqinjë dhe anëtarë të familjes, dhe shkuan të fshiheshin në shkurret afër lumit të qytetit. Rreth orës 14:30, ai shkoi në shtëpinë e një shoku dhe i telefonoi të vëllait në pikën e karburantit. Jashari i tha se policët kishin vrarë Sedat,

¹²⁸⁹ Shyrete Berisha, T. 3896–3897 (25 shtator 2006); IC45 (Fotografi që tregon nga kishin vrapuar Zonja Berisha dhe fëmijët e saj).

¹²⁹⁰ Shyrete Berisha, T. 3898 (25 shtator 2006). Kjo godinë është përshkruar në mënyra të ndryshme gjatë dëshmive dhe në Aktakuzë, si bar, kafene, dhe si piceri. Dhoma Gjyqësore pranon se të gjithë këta terma janë përdorur për të përshkruar të njëjtin vend dhe do të përdorë termin "piceri", edhe në rastin kur dëshmitarët përdorin term tjetër. Shyrete Berisha, T. 3900 (25 shtator 2006); P117, f. 1–2 (fotografi të picerisë).

¹²⁹¹ Shyrete Berisha, T. 3899–3900 (25 shtator 2006). *Shih gjithashtu* P2346 (trungu familjar i familjes Berisha); P117, f. 1–2 (fotografi të picerisë).

¹²⁹² Shyrete Berisha, T. 3900–3903 (25 shtator 2006).

¹²⁹³ Shyrete Berisha, T. 3903 (25 shtator 2006). Gjatë fazës së pyetjeve nga Mbrojtja, zonja Berisha shpjegoi se kamioni ishte ndalur dhe ajo dëgjoi një zë që iu duk si i Vera Petkoviqit duke thënë: "Bir, a e mbarove punën?" Shyrete Berisha, T. 3918–3919 (25 shtator 2006).

¹²⁹⁴ Shyrete Berisha, T. 3903–3908 (25 shtator 2006). *Shih gjithashtu* P2344 (Fotografite e disa prej viktimave të pranishme në piceri).

Nexhat, dhe Bujar Berishën dhe se familjet e tyre ishin "masakruar" në qendrën tregtare të qytetit. Halit Berisha e luti Jasharin të largohej, por Jashari tha se do të vinte në shtëpi në orën 17:00 sepse ndihej i sigurt në punë. Z. Berisha foli sërish me vëllain në orën 16:30. Pas orës 17:30, ai u kthye në shtëpi që të shihte se a ishte kthyer Jashari, por nuk e gjeti. Të nesërmen në mëngjes, ai vizitoi një familje vendase serbe për t'i pyetur se a dinin se ku ndodhej Jashari, por ata nuk dinin gjë.¹²⁹⁵

496. Halit Berisha i përshkroi rrobat që i vëllai i tij i kishte pasur veshur në punë më 26 mars dhe shpjegoi se në korrik 1999 gjeti pjesë të këtyre rrobave në këmbën e vëllait të tij në një varr të përbashkët në poligonin e qitjes në Prizren. Gjithsesi kufoma e Jasharit nuk u gjet në atë kohë.¹²⁹⁶ Ajo u gjet më vonë në një varr të përbashkët në Batajnicë dhe u identifikuar në shtator 2006 përmes mostrës së gjakut të dhënë nga ai.¹²⁹⁷

497. Hysni Berisha gjithashtu dëshmoi se në mëngjesin e 26 marsit 1999 "serbët" filluan granatimin e zonave përreth qytetit të Suharekës nga kodra prapa saj. Kjo u konfirmua edhe nga Bozhidar Deliqi dhe Bislim Zyrap, të cilët dëshmuar, siç është përmendur më lart, për luftimet që u zhvilluan midis të UJ-së/MPB-së dhe UÇK-së në afërsi të qytetit. Rreth orës 07:00, Hysni Berisha pa disa policë duke dalë nga stacioni policor dhe duke shkuar në drejtim të shtëpisë përballë. Pas dy-tri orësh, ai dëgjoi krisma armësh që vinin nga afërsia e shtëpisë së Sedat Berishës dhe pa flakë dhe tym duke u ngritur nga ai vend. Meqë kjo vazhdoi deri në mbrëmje, ai dhe familja e tij qëndruan në shtëpi të tmerruar.¹²⁹⁸

498. Përveç dëshmive të këtyre anëtarëve të familjes Berisha, Dhoma gjithashtu dëgjoi dëshmi bindëse në lidhje me vrasjet në Suharekë nga polici K83, i cili mori pjesë në sulm. K83-shi dëshmoi se në mëngjesin e 26 marsit 1999, ai, Nenad Jovanoviqi, Radovan Tanoviqi, Sllagjan Çukariqi, dhe Miki Petkoviqi kishin qenë në një fushë duke patrulluar fshatin Gjinofc. Kur u kthyen në godinën e DPB-së në Suharekë, panë dy kamionë të parkuar përballë saj. Policët e Detashmentit të 37-të të PJP-së, i njohur si njësia e "Çegarit," po dilnin nga kamioni dhe u nisën në këmbë rrugës për në Reshtan. Komandanti i tyre, Radosllav Mitrovic, me emrin e koduar "Çegar 1" arriti me

¹²⁹⁵ Halit Berisha, P2326 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 gusht 2001), f. 3.

¹²⁹⁶ Halit Berisha, T. 3612 (20 shtator 2006), T. 3712 (21 shtator 2006); P133, (Fotografi e rrobave të gjetura në Batajnicë që i përkisnin Jashar Berishës), f. 6, KRA 1072. *Shih* Pjesën VII.P.

¹²⁹⁷ Halit Berisha, T. 3611–3614, 3636 (20 shtator 2006).

¹²⁹⁸ Hysni Berisha, P2282 (deklarata e dëshmitarit e datës 20 gusht 2001), f. 2.

landrover.¹²⁹⁹ Njësia e Çegarit kishte rreth 40 pjesëtarë të veshur me uniforma kamuflimi të gjelbra me jelekë ushtarakë kamuflimi, me fjalën "policia" shkruar me shkronja të bardha në shpinë.¹³⁰⁰

499. K83-shi dëshmoi se Mitroviqi shkoi te Jovanoviqi dhe filloi t'i bërtiste atij dhe të tjerëve që të mos bënin sehir, por të "lëviznin" dhe të shkonin pas njësisë. Jovanoviqi dhe të tjerët u befasuan, por shkuan me njësinë e Çegarit në drejtim të shtëpive të para në atë zonë dhe te shtëpia ku "kishte qenë më parë OSBE-ja,"¹³⁰¹ Çukariqi u tha të tjerëve të ndaleshin në anën e majtë dhe të djalhtë të shtëpisë që askush të mos shtinte në "ta."¹³⁰² Persona nga njësia e Çegarit u pozicionuan afër shtëpitë që ndodheshin rreth shtëpive të Berishëve, por nuk ishin me K83-shin dhe grupin e tij. Sidoqoftë, K83-shi konfirmoi se kishte pasur njëfarë "ndarje pune" apo "bashkëveprim" sepse grupi i K83-shit kishte bërë të mundur rrethimin e të gjitha shtëpive në atë zonë nga forcat policore. Vërtet, duke shikuar vizatimin e bërë nga K83-shi të lëvizjeve të njësisë së Çegarit, është e qartë se ata vërshuan atë zonë, duke e rrethuar plotësisht.¹³⁰³

500. Njësia e Çegarit hapi zjarr, edhe pse K83-shi nuk ishte në gjendje të jepte hollësi se kundër kujt kishin hapur zjarr dhe a iu përgjigj dikush këtij zjarri. Njësia e Çegarit vazhdoi më tej përgjatë rrugës së Reshtanit. K83-shi tha se ai ishte i frikësuar sepse "krismat vinin nga të gjitha anët" dhe ai nuk kishte ku të fshihej.¹³⁰⁴ Nuk ka dëshmi se ndokush hapi zjarr kundër pjesëtarëve të MPB-së. Me të filluar krismat, Jovanoviqi iku dhe i braktisi K83-shin, Çukariqin, Tanoviqin, dhe Petkoviqin.¹³⁰⁵ Në atë moment, K83-shi pa gra e fëmijë duke dalë nga shtëpia e Vesel Berishës dhe duke vrapuar në drejtim të qendrës tregtare. Ai shkoi te Tanoviqi dhe Çukariqi, të cilët ndodheshin prapa shtëpisë së Shyhrete Berishës dhe po kontrollonin letërnjoftimet e katër burrave.¹³⁰⁶ Katër burrat u rreshtuan me fytyrë nga muri. K83-shi u urdhërua të shkonte pas grave, fëmijëve, dhe pleqve dhe të raportonte për vendndodhjen e tyre. Pastaj ai pa kur Çukariqi dhe Tanoviqi vranë katër burrat.¹³⁰⁷

¹²⁹⁹ K83, T. 3939–3941 (26 shtator 2006); IC47 (Fotografi ajrore e shënuar e Suharekës (P2349) që tregon vendin e kamionëve (A), të landroverit (B), dhe të godinës së DPB-së). *Shih gjithashtu* Lubinko Cvetiq, T. 8110 (7 dhjetor 2006); P1052 (plani i qendrës së komunikimit që përmban emrat e koduar).

¹³⁰⁰ K83, T. 3933–3935 (25 shtator 2006), T. 3938 (26 shtator 2006).

¹³⁰¹ K83, T. 3940–3941 (26 shtator 2006).

¹³⁰² K83, T. 3942 (26 shtator 2006); IC47 (Fotografi ajrore e shënuar e Suharekës (P2349) që tregon vendqëndrimin e K83-shit pranë shtëpisë së Vesel Berishës (D)).

¹³⁰³ K83, T. 3987, 4000–4001 (26 shtator 2006); IC50 (IC47 e shënuar që tregon lëvizjet e njësisë së Çegarit).

¹³⁰⁴ K83, T. 3943 (26 shtator 2006).

¹³⁰⁵ K83, T. 3988 (26 shtator 2006).

¹³⁰⁶ K83, T. 3942–3945 (26 shtator 2006); IC47 (Fotografi ajrore e shënuar e Suharekës (P2349) që tregon vendqëndrimet e Tanoviqit dhe Çukariqit (E)).

¹³⁰⁷ K83, T. 3945, 3988 (26 shtator 2006).

501. K83-shi u nis në drejtim të stacionit të autobusëve dhe qendrës tregtare, siç ishte urdhëruar. Te stacioni i autobusëve pa një burrë dhe një plakë të plagosur në këmbë të shtrirë në trotuar.¹³⁰⁸ Ai shkoi në drejtim të rrugicës në të cilën ndodhej piceria.¹³⁰⁹ Ai pa rreth 35 - 40 gra e fëmijë, që dukej se ishin ngujuar në piceri.¹³¹⁰ K83-shi u kthye pas dhe u takua me Çukariqin dhe Tanoviqin dhe u tregoi se ku ndodheshin njerëzit. Ata i thanë të shkonte në kafenenë më të afërt dhe të sillte pije. Gjatë rrugës ai kaloi përsëri pranë burrit dhe gruas së plagosur të shtrirë në tokë. Ai mori dy shishe njëlitërshe me pije alkoolike nga kafeneja. Gjatë kohës që ishte atje, dëgjoji krisma. Kur u kthye në drejtim të picerisë, ai pa se të dy ishin qëlluar me plumba në kokë dhe ishin të vdekur. Sllagjan Çukariqi ndodhej afër tyre me pushkë në dorë.¹³¹¹

502. K83-shi, Çukariqi (i cili përdorte radion Motorola), Tanoviqi, dhe Petkoviqi, i pinë me shpejtësi dy shishe me pije alkoolike.¹³¹² Pastaj, Çukariqi nxori një bombë dore, u tha të tjerëve të fshiheshin dhe u nis në drejtim të picerisë. K83-shi nuk mund ta shihte picerinë nga vendi ku ishte, por dëgjoji zhurmën e thyerjes së dritares dhe pastaj një shpërthim. Në pritje që të largohej tymi, Çukariqi dhe Tanoviqi hapën zjarr me radhë brenda në piceri. Pastaj Tanoviqi hodhi brenda edhe një bombë dore dhe të dy vazhduan të shtinin. K83-shi dëshmoi se i kërkuan të merrte pjesë, por ai nuk ishte në gjendje dhe ata nuk këmbëngulën.¹³¹³

503. Më në fund ata i ndërprejnë të shtënat dhe piceria ra në heshtje. Çukariqi i tha Petkoviqit të rrinte në fillim të rrugicës dhe K83-shi të shkonte në fund që të mos i linin njerëzit të afroreshin.¹³¹⁴ Pas 15-20 minutash arritën Boban Vuksanoviqi, komandant vendas i mbrojtjes civile dhe (emri nuk dihet) Gjorgjeviqi, komandant i "Mbrojtjes Territoriale."¹³¹⁵ Gjysmë ore më vonë erdhi një kamion civil me katër persona brenda. Vuksanoviqi thirri një grup meshkujsh të njësisë së mbrojtjes civile, i cili përbëhej kryesisht nga të rinj afërsisht të moshës 15-vjeçare dhe burra afërsisht të moshës 50-60 vjeç. Çukariqi u tha se do t'i vriste nëse nuk i zbatonin urdhrat dhe nuk i ngarkonin kufomat në kamion. Pasi e mbushën, kamioni u nis në drejtim të Prizrenit. Menjëherë pas nisjes së të parit,

¹³⁰⁸ K83, T. 3946 (26 shtator 2006); IC47 (Fotografi ajrore e shënuar e Suharekës (P2349) që tregon vendndodhjen e dy personave të plagosur (F)).

¹³⁰⁹ IC47 (Fotografi ajrore e shënuar e Suharekës (P2349) që tregon rrugën që bëri K83-shi deri në piceri). *Shih gjithashtu* P117, faqe 2 (Fotografi e picerisë).

¹³¹⁰ K83, T. 3947-3948 (26 shtator 2006).

¹³¹¹ K83, T. 3948-3951 (26 shtator 2006); IC48 (IC47 e shënuar që tregon picerinë).

¹³¹² K83, T. 3951, 3955, 4005 (26 shtator 2006).

¹³¹³ K83, T. 3951-3954 (26 shtator 2006); IC49 (Fotografi ajrore e shënuar e Suharekës (P2349) që tregon vendqëndrimin e K83-shit).

¹³¹⁴ K83, T. 3954-3955 (26 shtator 2006); IC49 (Fotografi ajrore e shënuar e Suharekës (P2349) që tregon vendqëndrimet e Petkoviqit dhe K83-shit, përkatësisht (A) dhe (B)).

¹³¹⁵ Të dy personat u vranë më vonë nga UÇK-ja. K83, T. 3968 (26 shtator 2006).

mbërriti një kamion tjetër i zbrazët dhe njerëzit kishin vazhduar të ngarkonin në të kufomat e mbetura.¹³¹⁶

504. Kur po ngarkohej kamioni i dytë, K83-shi pa Jashar Berishën të cilin po e sillnin te piceria nga drejtimi i stacionit policor dhe pikës së karburantit.¹³¹⁷ Ai u soll me makinë i shoqëruar nga disa policë, njëri prej të cilëve ishte Todor Jovanoviq. Teksa po dilte nga makina, kamioni dhe kufomat që po ngarkoheshin dukeshin hapur. Pastaj atë e tërhoqën zvarrë në drejtim të picerisë ndërsa ai mudohej të lirohej. Jashari i tha Vuksanoviqit se nuk e meritonte këtë. Pas kësaj, Çukariqi e kapi për krahu, e shtyu në drejtim të picerisë dhe e vrau me automatik. Sipas K83-shit, ngjarjen e panë shumë dëshmitarë. Më tej kufoma e Jasharit iu shtua kufomave të ngarkuara në kamion. Pasi u ngarkuan të gjitha kufomat, kamioni u nis në drejtim të Prizrenit.¹³¹⁸ K83-shi qëndroi aty dhe pa Çukariqin kur urdhëroi ekipin e mbrojtjes civile që të hidhnin rërë e dhë në piceri për të mbuluar njollat e gjakut. Mirëpo kjo nuk ishte e mundshme sepse në rrethinë nuk kishte rërë. Pas largimit të Çukariqit, Tanoviqi qëndroi atje dhe i vuri zjarrin perdeve të dritareve të picerisë. Kjo nuk pati efekt të madh sepse gjithçka brenda saj ishte metalike dhe nuk digjej.¹³¹⁹

505. Të nesërmen K83-shi u udhëzua që t'i tregonte "mbrojtjes civile" se ku ishin kufomat e tjera të shpërndara nëpër qytet për t'u mbledhur. Një ekip hetuesish nga SPB-ja e Prizrenit bëri hetim para transportimit të kufomave dhe varrosjes në varre të veçanta me kod në varrezë, që ishte procedurë standarde për hetimin e vendeve të krimit dhe për varrime.¹³²⁰ Ekipi përfshinte Todor Jovanoviqin, personin i cili kishte sjellë Jashar Berishën në piceri një ditë më parë. K83-shi shkoi me ekipin te shtëpitë e Berishëve, ku gjetën kufomat e katër burrave që ishin vrarë një ditë më parë, por ekipi nuk u çua asnjëherë te piceria.¹³²¹ Pasi kishin vizituar shtëpitë e Berishëve, ata vazhduan në drejtim të godinës së policisë dhe pastaj në drejtim të Reshtanit, duke ndjekur rrugën që kishte përshkuar njësia e Çegarit një ditë më parë. Ata gjetën edhe kufoma të tjera në shtëpi të ndryshme, shumica e të cilave ishin meshkuj dhe të gjithë ishin vrarë me armë zjarri. K83-shi i tha Dhomës se shumë nga kufomat ishin civilë.¹³²² Rrugës për në Reshtan u hap zjarr mbi ekipin, i cili ishte me uniforma të rregullta të MPB-së dhe në makinë të rregullt të MPB-së. Sidoqoftë, K83-shi nuk u pyet se kush e kreu këtë sulm.¹³²³ Ai tregoi se kur u kthyen te shtëpitë e Berishëve më 28 mars 1999 ata

¹³¹⁶ K83, T. 3956–3959 (26 shtator 2006).

¹³¹⁷ K83, T. 3959–3960, 3989–3990 (26 shtator 2006).

¹³¹⁸ K83, T. 3959–3961 (26 shtator 2006).

¹³¹⁹ K83, T. 3961–3962 (26 shtator 2006).

¹³²⁰ K83, T. 3962–3963, 3970–3971 (26 shtator 2006).

¹³²¹ K83, T. 3970, 4001 (26 shtator 2006).

¹³²² K83, T. 3963–3966, 4003 (26 shtator 2006).

¹³²³ K83, T. 3970–3971 (26 shtator 2006).

gjetën një kufomë gruaje. Ajo ishte rreth 50-60 vjeçe dhe këmba dhe një pjesë e dorës ishin të djegur. K83-shi nuk ishte në gjendje të shpjegonte arsyen e pranisë së një kufome gruaje atje një ditë pas mbledhjes së katër kufomave të tjera. Bazuar në faktin se ekipi nuk shkoi në piceri, edhe pse në të ishte Jovanoviqi dhe udhërrëfyes ishte K83-shi të cilët ishin në dijeni të vrasjeve që kishin ndodhur atje, Dhoma gjykon se përgjithësisht ky hetim nuk u krye sipas procedurës normale.

506. K83-shi konfirmoi se në kohën e kryerjes së vrasjeve në piceri, në qytet nuk kishte prani të UJ-së.¹³²⁴ UJ-ja ishte e vendosur jashtë qytetit të Suharekës, në një vend strategjik të rëndësishëm në malin e afërt, të quajtur Duhël, ku sulmohej rregullisht nga UÇK-ja.¹³²⁵ Kjo përputhet me dëshmitë e Halit Berishës dhe Bozhidar Deliqit.

507. K83-shi gjithashtu deklaroi se në mëngjesin e 26 marsit 1999, para vrasjeve, ai u udhëzua nga përgjegjësi i ndërresës, siç bëhej zakonisht, por këto udhëzime nuk përfshinin urdhra për të vrarë njerëz apo për të shkuar në shtëpitë e Berishëve.¹³²⁶ Ai nuk kishte dijeni të ndonjë urdhri apo komande dhënë patrullës së tij për të vrarë dikë.¹³²⁷ Ai gjithashtu konfirmoi se, gjatë marrjes në pyetje nga autoritetet e Beogradit në lidhje me incidentin e familjes Berisha, kishte thënë se Berishët ishin gjaknxehtë dhe se ka të ngjarë që Çukariqi dhe Tanoviqi i urrenin sepse familja e tyre kishte qenë e afërt me vëzhguesit e KVM-së, që do të thotë se askush nuk mund t'i prekte.¹³²⁸ Ai konfirmoi se banorët e Suharekës flisnin për incidentin e Berishëve pas ngjarjes dhe se edhe ai vetë foli për të me bashkëpunëtorët dhe kolegët. Ai nuk dinte nëse eprorët e tij dëgjuam ndonjëherë prej këtyre bisedave, por besonte se eprori i tij i drejtpërdrejtë, Jovanoviqi, u vu në dijeni për incidentin më pas.¹³²⁹

d. Xhamia në Suharekë

508. Halit Berisha dëshmoi se, më 28 mars 1999 rreth orës 11:55, që ishte ditë Bajrami, dëgjoji një shpërthim dhe më pas nuk ishte në gjendje ta shihte minaren e xhamisë nga oborri i pasmë i shtëpisë.¹³³⁰ Ai u telefonoi fqinjëve, të cilët banonin "shumë afër" xhamisë dhe ata i thanë se e kishin parë minarenë kur ishte rrëzuar. Ata gjithashtu i treguan se kishin parë "ushtarë me uniforma" dhe një "Gazik" duke shkuar në drejtim të Biraçit, që është tri kilometra larg prej

¹³²⁴ K83, T. 3967 (26 shtator 2006).

¹³²⁵ K83, T. 3998–3999 (26 shtator 2006).

¹³²⁶ K83, T. 3975, 3999–4000 (26 shtator 2006).

¹³²⁷ K83, T. 3989 (26 shtator 2006).

¹³²⁸ K83, T. 3996–3997 (26 shtator 2006).

¹³²⁹ K83, T. 4002–4004 (26 shtator 2006).

¹³³⁰ P1807 (Fotografi të xhamisë). Halit Berisha, T. 3614–3615 (20 shtator 2006). Hysni Berisha gjithashtu kishte dëgjuar një shpërthim të fortë atë ditë. Hysni Berisha, P2282 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 mars 2002), f. 2.

Suharekës dhe ku ishte vendosur ushtria. Dhoma vëren se në këtë drejtim ndodhet edhe DPB-ja e Suharekës.¹³³¹ Disa minuta më vonë, edhe z. Berisha e pa këtë makinë duke shkuar në të njëjtin drejtim.¹³³²

509. Një nga objektet e shqyrtuara në aktekspertizën e András Riedlmayer ishte edhe xhamia në Suharekë, e cila në raport përshkruhet si e "dëmtuar lehtë," që do të thotë se nuk kishte pasur dëmtime që rrezikonin strukturën e saj.¹³³³ Riedlmayer-i dëshmoi se minareja e saj ishte shkatërruar si rezultat i shpërthimit brenda vetë minaresë.¹³³⁴ Ai e vizitoi vendin personalisht dhe bëri fotografi të xhamisë së dëmtuar. Ai gjithashtu foli me një person vendas, i cili i tha se minareja ishte shkatërruar nga "serbët" më 28 mars 1999, në ditën e Bajramit.¹³³⁵

510. Bozhidar Deliqi dëshmoi se forcat e tij nuk e kishin shkatërruar xhaminë në Suharekë.¹³³⁶ Nga ana e MPB-së, Dëshmitari 6D2 dëshmoi se MPB-ja nuk kishte artilerinë e duhur, pra mina dhe eksploziv, që mund të përdoret për të shkaktuar dëme të rënda ose për të shkatërruar një objekt të madh. Gjithashtu, ai tha se deri më 25 prill 1999 xhamia nuk ishte dëmtuar edhe pse duket se ai nuk ka qenë dëshmitar okular në atë datë.¹³³⁷

e. Shpërngulja nga Suhareka

511. Dhoma dëgjoi nga Hysni Berisha se më 27 mars 1999, pas vrasjeve në gjithë qytetin e Suharekës pati lëvizje të mëdha të forcave policore. Atë pasdite, Hysni Berisha i pa policët duke u vënë zjarrin shtëpive në jug të shtëpisë së tij. Më vonë ai u largua nga shtëpia e tij së bashku me familjen dhe qëndroi në bodrumin e shtëpisë së fqinjët me rreth 70-100 njerëz të tjerë. Rreth orës 3 të mëngjesit të nesërm ata shkuan në një shtëpi tjetër rreth dy kilometra më larg, ku qëndruan deri më 3 prill 1999.¹³³⁸ Më 3 prill, kur asaj shtëpie iu afruan forca të veshura me uniforma kamuflimi të kaltra, të cilët Hysni Berisha i përshkroi si "paraushtarakë," familja iku në një fushë të afërt.¹³³⁹ Ai

¹³³¹ IC47 (Fotografi e Suharekës).

¹³³² Halit Berisha, T. 3615, 3662–3669 (20 shtator 2006), T. 3698–3701 (21 shtator 2006), P2325 (transkript nga Prokurori kundër Millosheviqit, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 7456.

¹³³³ András Riedlmayer, T. 5425 (30 tetor 2006); P1779 (Pjesë nga P1789 në lidhje me xhaminë e Suharekës); P1807 (fotografi e xhamisë së Suharekës e bërë nga Riedlmayer-i).

¹³³⁴ András Riedlmayer, T. 5460–5461 (30 tetor 2006). Dhoma vëren se eksperti i Mbrojtjes për trashëgimi kulturore, Branimir Jokiqi, nuk e përmendi xhaminë e Suharekës në veçanti, por thjesht i kundërshtoi në përgjithësi metodat e përdorura nga Riedlmayer-i.

¹³³⁵ András Riedlmayer, T. 5462 (30 tetor 2006); P1779 (Pjesë nga P1789 në lidhje me xhaminë e Suharekës).

¹³³⁶ Bozhidar Deliq, T. 19391 (29 nëntor 2007).

¹³³⁷ 6D2, T. 25342–25343 (15 prill 2008), 6D1632 (deklarata e dëshmitarit), para. 62.

¹³³⁸ Hysni Berisha, P2282 (deklarata e dëshmitarit e datës 20 gusht 2001), f. 3.

¹³³⁹ Z. Berisha sqaroi se ai i quan këta njerëz "paraushtarakë" sepse ata nuk ishin polici e rregullt dhe nuk ishin nga ajo zonë. Hysni Berisha, P2282 (deklarata e dëshmitarit e datës 20 gusht 2001), f. 3. *Shih gjithashtu* Hysni Berisha, T. 4017–4018 (26 shtator 2006).

dëshmoi se këto forca shtinin kundër gjithçkaje dhe se i pa duke u vënë zjarrin shtëpive me flakëdhës së bashku me policinë dhe ushtrinë.¹³⁴⁰ Ai dhe të tjerët që ishin fshehur në fushë më në fund u rrethuan nga "paraushtarakët," të cilët u morën paratë dhe gjërat me vlerë, dhe i urdhëruan të shkonin në Shqipëri.¹³⁴¹ Më pas z. Berisha iu bashkua një kolone që shkonte në drejtim të Shqipërisë. Kolonës iu bashkuan gjithnjë e më shumë njerëz dhe kur mbërriti në Korishë (komuna e Prizrenit) ishte bërë afërsisht pesë kilometra e gjatë. Në Korishë kolona u ndalua dhe u detyrua të qëndronte atje për dy ditë. Pak pas mesnate më 4 prill 1999, erdhën dy xhipa me "paraushtarakë." Pesë prej tyre shkuan makinë më makinë në kolonë duke i plaçkitur njerëzit, përfshirë edhe Hysni Berishën. Ata u larguan, por u kthyen në mëngjes dhe u kërkuan përsëri para. Në atë kohë, z. Berisha pa gjithashtu qarkullim të vazhdueshëm të forcave policore dhe ushtarake me tanke dhe Praga nga Prizreni në drejtim të Suharekës. Ai dëgjoji granatim diku në afërsi. Duke kaluar pranë kolonës, këto forca i keqtrajtuuan njerëzit në mënyra të ndryshme, madje edhe shtinë drejt tyre.¹³⁴² Pasi u lejua të largohej nga Korisha, kolona u ndalua përsëri në hyrje të qytetit të Prizrenit. Sipas z. Berisha, Millan Shipka, ish-komandant policie nga Suhareka që ishte transferuar në MPB-në e Prizrenit, i urdhëroi njerëzit në kolonë të ktheheshin në shtëpi sepse kufiri ishte mbyllur.¹³⁴³ Z. Berisha dhe familja e tij u kthyen drejt e në shtëpinë e tyre në Suharekë, e cila ishte plaçkitur dhe djegur.¹³⁴⁴ Dhoma vëren se më 5 prill 1999, Shtabi i MPB-së u dërgoi urdhër të gjitha SPB-ve dhe detashmenteve të PJP-së në Kosovë që të mos lejonin civilët të largoheshin nga vendbanimet e tyre dhe të garantonin sigurinë e tyre.¹³⁴⁵

512. Më 7 maj 1999, një grup tjetër paraushtarakësh erdhën në qytetin e Suharekës në xhipa të ndryshëm dhe filluan të digjin dhe plaçkitnin shtëpitë në qytet. Më në fund disa prej tyre erdhën në shtëpinë e Hysni Berishës të armatosur me automatikë dhe të veshur me uniforma kamuflimi në ngjyrë të kaltër dhe të gjelbër me shami të bardha dhe të zeza në kokë. Ata i kërkuan z. Berisha ushqim dhe qirinj dhe e kërcënuan me thika. Këto forca u larguan nga qyteti pas dy ditësh.¹³⁴⁶

513. Më 21 maj 1999 Hysni Berisha u largua sërish nga Suhareka kur "paraushtarakët" shkuan në shtëpi dhe urdhëruan atë dhe familjen e tij të shkonin në Shqipëri. Ai i njohu këta njerëz se ishin vendas, njëri prej të cilëve punonte për policinë e rregullt, dhe të gjithë kishin uniforma kamuflimi

¹³⁴⁰ Hysni Berisha, P2282 (deklarata e dëshmitarit e datës 20 gusht 2001), f. 3, T. 4034–4035 (26 shtator 2006).

¹³⁴¹ Hysni Berisha, P2282 (deklarata e dëshmitarit e datës 20 gusht 2001), f. 3.

¹³⁴² Hysni Berisha, P2282 (deklarata e dëshmitarit e datës 20 gusht 2001), f. 3–4.

¹³⁴³ Hysni Berisha, P2282 (deklarata e dëshmitarit e datës 20 gusht 2001), f. 4. *Shih gjithashtu* Hysni Berisha, T. 4036–4037 (26 shtator 2006).

¹³⁴⁴ Hysni Berisha, P2282 (deklarata e dëshmitarit e datës 20 gusht 2001), f. 4–5.

¹³⁴⁵ 6D778 (Urdhër i Shtabit të MPB-së i nënshkruar nga Sreten Llukiqi, 15 prill 1999).

¹³⁴⁶ Hysni Berisha, P2282 (deklarata e dëshmitarit e datës 20 gusht 2001), f. 5.

të kaltra dhe armë automatike.¹³⁴⁷ Ai dhe gruaja e tij u larguan nga qyteti dhe arritën dy autobusë të shoqëruar nga policia, të cilët i ishin dukur se bartnin të burgosur. Atë mbrëmje Z. Berisha dhe familje e tij mbërritën në shtëpinë e emtës së gruas në qytetin e Prizrenit, ku ai bujti deri më 13 qershor 1999, ditën e kthimit të tij në Suharekë.¹³⁴⁸

514. Halit Berisha dëshmoi se më 28 mars 1999. rreth orës 18:00 fqinji tij serb i cili ishte polic rezervist, e paralajmëroi se duhej të ikte në Shqipëri se përndryshe do të vritej.¹³⁴⁹ Si rezultat, ai dhe gruaja e tij u larguan nga shtëpia rreth orës 19:00 dhe shkuan fillimisht në fshatin Savrovë e të nesërmen në fshatin Buzhalë, ku bujtën në një shtëpi me 130 njerëz të tjerë.¹³⁵⁰ Më 3 prill 1999, të gjithë u nisën sërish, këtë herë për në Prizren, por policia u tha të ktheheshin në Savrovë, dhe ashtu bënë. Përfundimisht ata u kthyen në Suharekë te emta e z. Berisha dhe më 7 prill z. Berisha shkoi dhe u fsheh në pyll me dy djemtë e tij. Më 2 maj 1999 ai shkoi sërish në shtëpinë e emtës së tij. Gjatë kësaj periudhe, gruaja e tij shkonte në shtëpinë e tyre e cila ishte plaçkitur, për të marrë ushqime. Më 21 maj 1999 rreth orës 10:00-10:30, gjashtë policë shkua në shtëpinë e emtës së tij. Njëri prej tyre, i njëjti që e kishte dëbuar Hysni Berishën nga shtëpia, i tha familjes se kishin 15 minuta të bëheshin gati dhe të niseshin për në Shqipëri dhe se "kurrë nuk do ta shihni më këtë tokë." Familja hipi në dy makina dhe iu bashkua një kolone me rreth 2.000 njerëz. Ata që nuk kishin automjete të veta u paraqitën në qendër të qytetit në Suharekë ku ishin bërë gati dy autobusë dhe dy kamionë për t'i bartur. Kolona udhëtoi në drejtim të Prizrenit dhe Zhurit dhe më në fund arriti në Morinë.¹³⁵¹ Policia kufitare u mori dokumentet e identifikimit, përfshirë edhe patentat e shoferit, dhe targat e makinave. Z. Berisha dëshmoi se, pasi kishin mbërritur në Kukës, Shqipëri, ata vunë re se kolona e tyre ishte shtuar në rreth 5.000 njerëz. Ai nuk u kthye në Suharekë deri më 23 qershor 1999.¹³⁵²

¹³⁴⁷ Hysni Berisha, P2282 (deklarata e dëshmitarit e datës 20 gusht 2001), f. 5. Z. Berisha shpjegoi se dikur para 21 majit 1999 shqiptarët që kishin makina u urdhëruan nga këta njerëz që t'i bashkoheshin një kolone prej rreth 5.000 vetësh. Ata të cilët nuk kishin makina duhej të mblidheshin te qendra tregtare ku i pritnin autobusët që t'i çonin në Shqipëri. Mirëpo në atë kohë z. Berisha vendosi mos t'i bashkohej kolonës dhe shkoi për të bujtur në një shtëpi tjetër. Gjatë natës, ai pa lëvizje të mëdha të "policisë" dhe kuptoi se ishte shume e rrezikshme të rrinte atje. Të nesërmen në mëngjes, më 21 maj 1999 ai u kthye në shtëpinë e tij për të marrë ushqime, por u kap nga të njëjtët persona që i kishin urdhëruar të gjithë të largoheshin. Njëri nga ata, Andrejeviqi, e pyeti pse nuk ishte larguar siç ishte urdhëruar. Pas kësaj këta persona u urdhëruan të largoheshin urgjentisht dhe kështu Z. Berisha mundi të kthehej te gruaja e vet. P2282 (deklarata e dëshmitarit e datës 20 gusht 2001), f. 6.

¹³⁴⁸ Hysni Berisha, P2282 (deklarata e dëshmitarit e datës 20 gusht 2001), f. 6.

¹³⁴⁹ Halit Berisha, T. 3648–3653 (20 shtator 2006).

¹³⁵⁰ Halit Berisha, P2326 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 gusht 2001), f. 4.

¹³⁵¹ Halit Berisha, P2326 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 gusht 2001), f. 4. Duhet rikujtuar se Lizane Malaj dëshmoi se kalimi quhet Vërbnicë nga serbët dhe Qafa e Morinës nga shqiptarët. Lizane Malaj, T. 1384 (10 gusht 2006). Sipas P615 (Atlasi i Kosovës), f. 14, kufiri quhet Vërmicë në anën serbe dhe Morinë në anën shqiptare.

¹³⁵² Halit Berisha, T. 3618–3619 (20 shtator 2006), P2326 (deklarata e dëshmitarit e datës 17 gusht 2001), f. 4.

515. Për një muaj pas vrasjes së familjes në piceri në qytetin e Suharekës, Shyrete Berisha jetoi në male dhe më pas lëvizi nëpër Kosovë në një kolonë me shqiptarë kosovarë të shpërngulur.¹³⁵³ Ata kaluan nëpër fshatrat Vraniq, Sopinë, dhe Bukosh në komunën e Suharekës. Në një rast traktorët e tyre u ndaluan të shkolla e Bukoshit nga "serbë" me uniforma, të cilët i ndanë burrat nga gratë. Pastaj ata u morën grave gjërat me vlerë dhe paratë dhe i larguan burrat. Sipas zonjës Berisha, këta burra, me përjashtim të pleqve, nuk u kthyen më.¹³⁵⁴ Më 6 maj 1999, zonja Berisha mbërriti me kolonën në kufirin shqiptar. Burra me uniforma në anën serbe të kufirit u kërkuan para, flori, dhe dokumentet e identifikimit. Pasi gratë u dhanë çfarë kishin me vete, kolona u lejua të kalonte në Shqipëri.¹³⁵⁵

516. Në konfirmim të dëshmimeve të të shpërngulurve nga qyteti i Suharekës, K79-a, pjesëtar i PJP-së, dëshmoi se dikur rreth 2 ose 3 prillit 1999 pa një kolonë të gjatë në rrugën Prizren-Suharekë. Kolona ishte rreth 30 kilometra me makina, traktorë, dhe kamionë plot me njerëz, të gjithë duke lëvizur në drejtim të Prizrenit.¹³⁵⁶

f. Hetimet në lidhje me ngjarjet në qytetin e Suharekës

517. Me t'u kthyer në Suharekë në qershor 1999, Hysni Berisha filloi hetimet e vrasjeve që kishin ndodhur gjatë konfliktit dhe vizitoi të gjitha vendet përkatëse, përfshirë picerinë, shtëpinë e Shyrete Berishës, dhe shtëpinë e Vesel Berishës.¹³⁵⁷ Gjithashtu ai vizitoi varrezën e Berishëve dhe pa 34 varre të reja. Fillimisht ai i bëri hetimet mbi bazë vullnetare, mirëpo kur në gusht 1999 në Suharekë u formua qeveria e përkohshme nga partia politike e UÇK-së,¹³⁵⁸ kjo qeveri e zyrtarizmi pozitën e tij.¹³⁵⁹ Detyrat e tij përfshinin punën në terren për identifikimin e viktimave civile.¹³⁶⁰ Ai përpiloi një listë të civilëve shqiptarë kosovarë nga komuna e Suharekës që ishin vrarë ose ishin zhdukur.¹³⁶¹

¹³⁵³ Shyrete Berisha, T. 3908 (25 shtator 2006).

¹³⁵⁴ Shyrete Berisha, T. 3908–3909 (25 shtator 2006).

¹³⁵⁵ Shyrete Berisha, T. 3910–3911 (25 shtator 2006).

¹³⁵⁶ K79, T. 9653–9655 (1 shkurt 2007).

¹³⁵⁷ Hysni Berisha, P2282 (deklarata e dëshmitarit e datës 20 gusht 2001), f. 6. Hysni Berisha dëshmoi se nuk kishte kualifikim formal për veprime hetimore. Hysni Berisha, T. 4019 (26 shtator 2006).

¹³⁵⁸ Qeveria e Përkohshme u formua nga Hashim Thaçi, ishte parti politike e UÇK-së dhe u shpërbë nga UNMIK-u në tetor 1999. Hysni Berisha, T. 4020 (26 shtator 2006).

¹³⁵⁹ Hysni Berisha, P2282 (deklarata e dëshmitarit e datës 20 gusht 2001), f. 2.

¹³⁶⁰ Hysni Berisha, T. 4021 (26 shtator 2006).

¹³⁶¹ Hysni Berisha, T. 4021–4023 (26 shtator 2006), P2282 (deklarata e dëshmitarit e datës 20 gusht 2001), f. 8; P2351 (Lista e personave të vrarë/zhdukur më 1998 dhe 1999).

518. Në gusht 1999, Hysni Berisha shoqëroi ekipin mjeko-ligjor britanik dhe i ndihmoi në identifikimin e rrobave dhe sendeve të gjetura në Prizrenin në poligonin e qitjes.¹³⁶² Më 19 shtator 1999, në atë vend u gjetën një numër artikujsh, si rroba, këpucë, dhe objekte të ndryshme. Ekipi mjeko-ligjor britanik i fotografoi dhe ua tregoi anëtarëve të familjes Berisha. Shumë nga këto sende u identifikuan si sende që u përkisnin anëtarëve të zhdukur të familjes, konkretisht Hanumshahe Berishës (81), Musli Berishës (63), Hamdi Berishës (54), Zelihe Berishës (50), Afrim Berishës (24), Violeta Berishës (22), Merita Berishës (10), Mirat Berishës (10), Jashar Berishës, Sofije Berishës (50), dhe Vesel Berishës (55).¹³⁶³ Kufomat e të gjithëve përveç treve, konkretisht Violeta Berishës, Mirat Berishës, dhe Zelihe Berishës, u gjetën dhe identifikuan më vonë në varrin e përbashkët në Batajnicë.

519. Halit Berisha ofroi të dhëna që dispononte si anëtar i një organizate shqiptare për personat e zhdukur dhe të vrarë, për numrin e njerëzve të vrarë dhe të zhdukur nga kjo komunë. Sipas këtyre të dhënave, numri i përgjithshëm i civilëve të vrarë në komunë gjatë konfliktit ishte 561, nga të cilët 176 janë të paidentifikuar dhe 152 nuk janë gjetur kurrë. Nga 152 personat e zhdukur, 31 janë nga familja Berisha.¹³⁶⁴

520. Dhoma gjithashtu pranoi si dëshmi një dokument të MPB-së që përmban të gjitha veprat penale të dokumentuara në Kosovë dhe masat e ndërmarra në lidhje me to gjatë periudhës nga 1 korriku 1998 deri më 20 qershor 1999. Sipas këtij dokumenti, më 30 mars 1999 u gjetën tetë kufoma në një rrugë të Suharekës që është quajtur "zonë e veprimeve të UÇK-së." Katër nga kufomat, tre burra dhe një grua, u gjetën në oborrin e një shtëpie, kurse tri të tjerat dergjeshin përpara një shtëpie tjetër, dhe një u gjet në një punishte marangozi. Sipas dokumentit, autorët e këtyre vrasjeve ishin të paidentifikuar.¹³⁶⁵ Në bazë të dëshmive të dëshmitarëve okularë, vendi i katër kufomave në oborr, tregon se ata ishin anëtarë të familjes Berisha.

g. Provat kriminalistike

521. K83-shi dëshmoi se vetëm një numër i vogël i anëtarëve të familjes Berisha të vrarë më 26 mars 1999 u varrosën në varrezën e Suharekës, kurse shumica u dërguan në Prizren dhe më vonë në

¹³⁶² Hysni Berisha, P2282 (deklarata e dëshmitarit e datës 20 gusht 2001), f. 8–9.

¹³⁶³ Hysni Berisha, T. 4010–4015 (26 shtator 2006), P2282 (deklarata e dëshmitarit e datës 20 gusht 2001), f. 8–9; P120 (Fotografi i poligonit të qitjes të UJ-së); P122, P123, P133, P134 (Fotografi të ndryshme të sendeve të gjetura në vendvarrimin e përbashkët në poligonin e qitjes); P125 (Fotografi të anëtarëve të familjes Berisha), foto 18. Dhoma Gjyqësore vëren se Vesel Berisha në listë nuk është Vesel Berisha në shtëpinë e të cilit natën e 25 marsit 1999 u fshehën zonja Berisha dhe 24 të tjerë. Ky është person tjetër me të njëjtin emër; ai është burri i Sofije Berishës.

¹³⁶⁴ Halit Berisha, T. 3716–3717 (21 shtator 2006).

Batajnicë. Dhoma ka marrë prova kriminalistike nga dy burime të ndryshme: materiale në lidhje me kufomat e zhvarrosura në Suharekë dhe materiale të tjera në lidhje me kufomat e zhvarrosura në Batajnicë afër Beogradit. Sa i përket kategorisë së parë, Dhoma dëgjoi dëshmi nga Dr. Eric Baccard, raporti i të cilit përmban një pjesë ku analizohen provat e mbledhura në varrezën e Suharekës në shtator 1999 nga ekspertët e ekipit mjeko-ligjor britanik.¹³⁶⁶ Raporti i Baccard-it bazohet në këto materiale: aktekspertizën antropologjike kriminalistike nga Dr. Sue Black të datës 2 nëntor 1999,¹³⁶⁷ dy aktautopsi të përgatitura nga Dr. Yvonne Milewski më 31 janar 2000,¹³⁶⁸ tri përmbledhje antropologjike të përgatitura nga Dr. Black më 6 shtator 1999,¹³⁶⁹ dhe raportet antropologjike nga Julie Roberts të 5 janarit 2000.¹³⁷⁰ Sipas Baccard-it, ndër kufomat e gjetura në varrezën e Suharekës, ndodheshin kufomat e së paku 18 vetëve, shumica prej të cilëve meshkuj dhe pleq.¹³⁷¹ Tre prej tyre u identifikuan se ishin të familjes Berisha, konkretisht, Faton Berisha, Fatime Berisha, dhe Sedat Berisha, të cilët janë identifikuar edhe nga Shyhrete Berisha se janë vrarë më 26 mars 1999 në qytetin e Suharekës.¹³⁷²

522. Burimi i dytë përbëhet prej raporteve të shumta dhe dëshmime të atyre që kanë qenë të pranishëm, kanë mbikëqyrur, apo kanë marrë pjesë në zhvarrosjen dhe identifikimin e kufomave

¹³⁶⁵ 6D2, 6D1632 (deklarata e dëshmitarit), para. 91; 6D614 (Pasqyrë e veprave penale të evidentuara prej MPB-së, 1 korrik 1998 - 20 qershor 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 62, para. 104. Dokumenti gjithashtu vëren se raporti iu dërgua gjykatësit hetues.

¹³⁶⁶ P1809 (Raport përmbledhës i Eric Baccard-it), f. 74–78.

¹³⁶⁷ P1809 (Raport përmbledhës i Eric Baccard-it), f. 74–75.

¹³⁶⁸ P129 (Aktautopsi: SCG/27/SR); P130 (Aktautopsi: SCG/28/SR).

¹³⁶⁹ P136 (Raport antropologjik i ekipit kriminalistik britanik); P137 (Përmbledhje antropologjike: SCG/33/SR); P2682 (Përmbledhje antropologjike: SCG/27/SR dhe SCG/28/SR).

¹³⁷⁰ P2683 (Raport antropologjike: analizë e SCG/33/SR).

¹³⁷¹ P136, (Raport antropologjik i ekipit kriminalistik britanik), f. 1; P1809 (Raport përmbledhës i Eric Baccard-it), f. 75. Shprehja "numër minimal i viktimave" është përdorur në raport kur eshtrat e disa viktimave janë të përziera dhe rrjedhimisht është e vështirë të përcaktohet identiteti i viktimave dhe numri i tyre. Dy eshtra të ndryshme mund të jenë nga e njëjta viktimë ose nga dy viktima të ndryshme dhe kjo krijon rrezikun e mbivlerësimit të numrit të viktimave në një vend. Për këtë arsye, në raportin e tij Baccard-i përdor termin "numër minimal i viktimave, që është kufiri i poshtëm nën të cilin nuk mund të shkohet." Me fjalë të tjera, ai tregon numrin më të vogël të mundshëm të viktimave në atë vend. *Shih* Eric Baccard, P2747 (transkripti nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 5281–5283.

¹³⁷² Eric Baccard, T. 10138 (19 shkurt 2007); P1809 (Raport përmbledhës i Eric Baccard-it), f. 76; P2682 (Përmbledhje antropologjike: SCG/27/SR dhe SCG/28/SR); P2683 (Raport antropologjike: analizë e SCG/33/SR); P136 (Raport antropologjik i ekipit kriminalistik britanik), f. 1. Kufomat e përmendura në këto raporte janë: Faton Berisha — SCG/27/SR, Fatime Berisha — SCG/28/SR, dhe Sedat Berisha — SCG/33c/SR. SCG/33/SR përbëhet nga një grumbull i mbetjeve skeletore të përziera dhe pjesërisht të djegura, të futura në një thes për kufoma. Meqenëse analiza antropologjike tregonte se ishin mbetjet e së paku katër personave, mostra u nda në katër grupe të mbetjeve skeletore, të analizuar nga Black, dhe të rianalizuara më pas nga Roberts. Sidoqoftë, në raportin e Baccard-it thuhet se ekzistojnë mospërputhje midis raporteve të përgatitura nga Black dhe nga Roberts, gjegjësisht se nuk është e qartë se SCG/33c/SR në raportin e Black-ut përkon me SCG/33/SR në raportin e Roberts-it. Për shkak të kësaj mospërputhjeje, në raportin e Baccard-it u përfshinë vetëm SCG/27/SR dhe SCG/28/SR dhe u përcaktua vetëm shkaku i vdekjes së tyre. P1809 (Raport përmbledhës i Eric Baccard-it), f. 76. Gjithsesi për arsye se Sedat Berisha u identifikua në bazë të këpucës së gjetur në këmbën e majtë (*Shih* P136), Dhoma pranon se njëra nga mbetjet e përziera i takon Sedat Berishës.

nga varret e përbashkëta në Batajnicë që nga viti 2001, siç përshkruhet në Pjesën VII.P më poshtë, konkretisht, Dushan Dunjiqi, Branimir Aleksandriqi, William Fulton, Jon Sterenberg, dhe Jose-Pablo Baraybar. Rezultatet e punës së tyre dhe identifikimet që ata kanë bërë të viktimave të Suharekës janë analizuar në Shtojcën A të Aktgjykimit.

523. Dhoma gjithashtu dëgjoi dëshmi nga Antonio Alonso, ekspert i identifikimit gjenetik, i cili analizoi mostrat nga disa prej kufomave të gjetura në Batajnicë. Gjatë vitit 2001, ai mori nga Dunjiqi 56 mbetje skeletore dhe nga KNPZH (Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur) mori 13 mostra reference të gjakut të anëtarëve të familjeve të njerëzve që pretendohet se janë vrarë në Suharekë për analizë gjenetike.¹³⁷³ Pas kryerjes së analizave, Alonso paraqiti tre raporte me rezultate.¹³⁷⁴ Ai identifikoi 21 viktima, emrat e disa prej të cilëve janë në Listën D të Aktakuzës, konkretisht Sofije Berisha, Vesel Berisha, Hava Berisha, Drilon Berisha, Redon Berisha, Melinda dhe/ose Herolinda Berisha, Musli Berisha, Fatmire Berisha, Besim Berisha, Granit dhe/ose Genc Berisha, Nexhmedin Berisha, Lirije Berisha e cila ishte shtatzënë, Afrim Berisha, Hamdi Berisha, njëra nga katër vajzat e Hamdi Berishës, dhe Jashar Berisha.¹³⁷⁵ Të gjitha këto viktima, përveç njëres, konkretisht Afrim Berisha, u identifikuan nga Shyhrete Berisha si persona që ajo i pa gjatë ngjarjeve të 26 marsit 1999, në qytetin e Suharekës.¹³⁷⁶

5. Shpërngulja nga Bellanica

524. Siç u përmend në paragrafin 467, dy dëshmitarët të cilët dëshmuan në lidhje me shpërnguljen e popullatës nga Bellanica ishin Shefqet Zogaj, gazetar nga Bellanica,¹³⁷⁷ dhe Hamide Fondaj, amvisë nga Peqani.¹³⁷⁸ Që të dy dëshmuan se më 20 ose 21 mars "forcat serbe" sulmuan Peqanin dhe fshatrat e afërta. Sulmi erdhi nga lindja, nga drejtimi i qytetit të Suharekës, Shirokës, Qafës së Duhlës, dhe Biraçit.¹³⁷⁹ Si pasoja, popullata filloi të lëvizte masivisht në drejtim të fshatrave në veri, si Nishori, Bellanica, dhe Baja.¹³⁸⁰ Sidoqoftë, të dy pranuan se zona e sulmuar,

¹³⁷³ Antonio Alonso, T. 6664–6665 (16 nëntor 2006).

¹³⁷⁴ Antonio Alonso, T. 6665–6666 (16 nëntor 2006); P2486 (Raport i Shërbimit Biologjik, 17 nëntor 2004).

¹³⁷⁵ Dhoma vëren se dy nga 21 identifikimet janë bazuar në një metodë me shkallë me të vogël dallimi dhe si rezultat Alonso u referohet atyre si "identifikime paraprake." Antonio Alonso, T. 6668–6669, 6674–6678 (16 nëntor 2006).

¹³⁷⁶ *Shih* Shtojca A.

¹³⁷⁷ Shefqet Zogaj, P2322 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 prill 1999), f. 2.

¹³⁷⁸ Hamide Fondaj, T. 3823–3865 (25 shtator 2006), P2283 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 qershor 2001).

¹³⁷⁹ Hamide Fondaj, P2283 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 qershor 2001), f. 3; Shefqet Zogaj, P2322 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 prill 1999), f. 2.

¹³⁸⁰ Shefqet Zogaj, T. 5879–5880 (3 nëntor 2006), P2322 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 prill 1999), f. 2.

ishte nën kontrollin e UÇK-së. Për shembull, thujse të gjitha shtëpitë në Peqan kishin nga një anëtar në UÇK, duke përfshirë edhe familjen e Fondajt, burri i së cilës ishte komandant në UÇK.¹³⁸¹

525. Gjatë fazës së pyetjeve të këtyre dëshmitarëve nga Mbrojtja, doli në pah se burri i Fondajt urdhëroi popullatën të largohej nga fshati dhe se disa ditë më vonë, më 28 mars, UÇK-ja u tërhoq në Bellanicë për shkak të luftimeve me forcat e RFJ-së/Serbisë.¹³⁸² Vladimir Marinkoviç, i cili ishte shef i organit të sigurimit të Brigadës së 15-të Blinduar, konfirmoi se në fund të marsit 1999 brigada e tij hasi afërsisht 1.000 njerëz të shpërngulur duke u larguar nga Baja të shoqëruar nga pjesëtarë të armatosur të UÇK-së me uniforma. Kur njësia raportoi çfarë kishte parë, ajo mori urdhër të kthehej në zonën e dislokimit pa hyrë në luftim me UÇK-në.¹³⁸³

526. Më 28 mars, Fondaj dhe familja e saj arritën në Bellanicë dhe panë se atje ishin mbledhur "mijëra e mijëra njerëz".¹³⁸⁴ Zogaj dëshmoi se në tri fshatrat, Bellanicë, Ngucat, dhe Lladroviq, ishin mbledhur gjithsej rreth 100.000 njerëz.¹³⁸⁵ Kur Zogaj u ballafaqua me dëshminë e Halit Berishës se e gjithë popullata e Suharekës ishte 60.000 dhe se ishte e pamundshme të mblidhen 100.000 njerëz në tri fshatra, vetëm në rast se e gjithë popullata e Suharekës dhe Malishevës do të mblidheshin atje, ai u përgjigj se vlerësimi i tij ishte i saktë.¹³⁸⁶

527. Siç u diskutua më lart në lidhje me komunat e Prizrenit dhe Rahovecit, më 28 mars 1999, Komanda e Përbashkët urdhëroi njësitë e Korpusit të Prishtinës që të ndihmonin forcat e MPB-së në shkatërrimin e "FTSH-së" në zonën e përgjithshme të Malishevës. Sipas këtij urdhri, përgjegjësia për komunën e Suharekës ishte ndarë midis Brigadës së 243-të të Mekanizuar dhe Brigadës së 549-të të Motorizuar.¹³⁸⁷ Po atë ditë, Komanda e Korpusit të Prishtinës lëshoi një urdhër ku i udhëzonte forcat, duke përfshirë edhe Brigadën e 549-të të Motorizuar, që të përgatiteshin për operacione në "zonën e përgjithshme" të Malishevës.¹³⁸⁸ Si rrjedhojë, më 29 mars Deliqi lëshoi urdhrin përkatës

¹³⁸¹ Hamide Fondaj, T. 3826–3827, 3844–3846, 3849 (25 shtator 2006), P2283 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 qershor 2001), f. 2; Shefqet Zogaj, P2322 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 prill 1999), f. 2. *Shih gjithashtu* 6D1013 (Raport i MPB-së së Prizrenit, 13 mars 1999), f. 1–2; 6D1017 (Raport i MPB-së së Prizrenit, 28 janar 1999), f. 6.

¹³⁸² Shefqet Zogaj, T. 3781–3787 (22 shtator 2006), T. 5881–5882 (3 nëntor 2006), P2323 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 qershor 2001), f. 3, P2324 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 3668–3669; Hamide Fondaj, T. 3846–3848, 3852–3854, T. 3862–3865 (25 shtator 2006), P2283 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 qershor 2001), f. 3; 6D76 (pjesë nga deklarata e Ylmet Fondajt e datës 28 gusht 2001).

¹³⁸³ Vladimir Marinkoviç, T. 20262–20263 (14 dhjetor 2007).

¹³⁸⁴ Hamide Fondaj, T. 3827–3828 (25 shtator 2006), P2283 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 qershor 2001), f. 3.

¹³⁸⁵ Shefqet Zogaj, T. 3779, 3787–3790, 3802–3803 (22 shtator 2006), T. 5859–5861 (3 nëntor 2006), T. 5900, 5922 (6 nëntor 2006), P2322 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 prill 1999), f. 4, P2323 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 qershor 2001), f. 2–3. *Shih gjithashtu* IC44 (harta e komunës së Suharekës në të cilën Zogaj ka shënuar vendndodhjet e tri fshatrave në fjalë); P2345 (fotografi e bërë nga Zogaj që tregon njerëzit e mbledhur në Bellanicë më 28 mars 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 11.

¹³⁸⁶ Shefqet Zogaj, T. 5900–5903, 5910–5911 (6 nëntor 2006).

¹³⁸⁷ P1969 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 28 mars 1999).

¹³⁸⁸ 5D339 (Urdhër i Komandës së PrK-së, 28 mars 1999).

për njësitë e tij që të ndihmonin forcat e MPB-së në zonën e Rahovecit dhe në afërsi të fshatit Dobërdolan. Ky urdhër gjithashtu theksonte se njësi të tjera, si Brigada e 243-të e Mekanizuar, do të mbështesnin njësitë e MPB-së në zonën e Suharekës, duke përfshirë fshatrat Duhël, Bellanicë, Semetishtë, dhe Bajë, që gjenden në pjesën veriore të komunës. Operacioni do të fillonte më 30 mars.¹³⁸⁹

528. Në orët e hershme të mëngjesit më 1 prill 1999, vija e frontit e UÇK-së u thye nga forcat e përbashkëta të RFJ-së.¹³⁹⁰ Pas kësaj, Zyrapi lëshoi një urdhër që disa brigada të UÇK-së të tërhiqeshin më në veriperëndim nëpër Bellanicë dhe në malet e Berishës, të cilat gjenden mbi fshat.¹³⁹¹ Zyrapi gjithashtu urdhëroi evakuimin e popullatës civile nga Bellanica në Ngucat dhe në malet e Berishës për shkaqe sigurie. Sidoqoftë, shumica e popullatës nuk iu bindën urdhrorit dhe vendosën të qëndronin në Bellanicë.¹³⁹² Kur u pyet nga Dhoma pse ishte më e sigurtë për popullatën që të largohej bashkë me UÇK-në se sa të lihej vetëm, Zyrapi u përgjigj se UÇK-ja donte ta largonte popullatën nga vija e frontit dhe tha se ishte procedurë e zakonshme e UÇK-së.¹³⁹³

529. Më 1 prill 1999 rreth orës 11:45, forcat e RFJ-së/Serbisë filluan të granatonin skajet e Bellanicës.¹³⁹⁴ Rreth orës 13:00, policia dhe paraushtarakët, të dytët kishin shirita, shami, dhe mjekra, hynë në Bellanicë ndërsa UJ-ja e rrethoi.¹³⁹⁵ Zogaj shkoi shtëpi më shtëpi duke u thënë njerëzve të hipnin në makina dhe traktorë dhe të niseshin. Sidoqoftë, sipas Zogajt, "forcat serbe"

¹³⁸⁹ P2000 (Urdhër i Brigadës së 549-të të Motorizuar, 29 mars 1999), f. 2–4. *Shih gjithashtu* Kërsman Jelliq, T. 18849 (22 nëntor 2007); 5D1284 (Urdhër për mbrojtje të Brigadës së 243-të të Mekanizuar, 26 mars 1999), f. 3; P2021 (Ditari i Luftës i Brigadës së 243-të të Mekanizuar), f. 7–10.

¹³⁹⁰ Pas këtij operacioni, Deliqi përgatiti një raport analizues në të cilin vëren se "FTSH" ishin shkatërruar në zonën Malishevë-Pagarushë-Bllace, se Dobërdolani dhe Semetishta ishin marrë nga forcat e përbashkëta, dhe se operacioni e kishte zbutur presionin e UÇK-së në qytetet e Rahovecit dhe Suharekës. Bozhidar Deliq, T. 19561–19562 (5 dhjetor 2007); P2002 (Analizë e operacioneve të Brigadës së 549-të të Motorizuar, 30 mars [sic] 1999); 4D371 (Raport luftimi i Komandës së PrK-së, 1 prill 1999).

¹³⁹¹ Bislim Zyrapi, T. 5995–6001, 6004 (7 nëntor 2006), 6151–6153 (8 nëntor 2006); P2447 (hartë që tregon pozicionet e UÇK-së, vija në mes B-së dhe C-së tregon vendin e tërheqjes së dytë të UÇK-së); P2457 (Urdhër i lëshuar nga Bislim Zyrapi, 1 prill 1999); IC106 (harta e Suharekës e shënuar nga Zyrapi që tregon malet e Berishës dhe rrugën e përdorur nga UÇK-ja për në malet e Berishës). *Shih gjithashtu* Shefqet Zogaj, T. 3781–3787 (22 shtator 2006), P2323 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 qershor 2001), f. 3.

¹³⁹² P2457 (Urdhër i lëshuar nga Bislim Zyrapi, 1 prill 1999); Bislim Zyrapi, T. 6005–6006 (7 nëntor 2006), T. 6150–6151 (8 nëntor 2006).

¹³⁹³ Bislim Zyrapi, T. 6001–6003 (7 nëntor 2006).

¹³⁹⁴ Shefqet Zogaj, T. 5912–5914, 5921 (6 nëntor 2006), P2322 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 prill 1999), f. 4, P2323 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 qershor 2001), f. 4; P2457 (urdhër i UÇK-së, 1 prill 1999).

¹³⁹⁵ Shefqet Zogaj, T. 3791–3793 (22 shtator 2006), T. 5861, 5866–5873 (3 nëntor 2006), T. 5898–5899 (6 nëntor 2006), P2322 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 prill 1999), f. 4, P2323 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 qershor 2001), f. 2–4; P1325 (automjetet në fotografitë 5, 6, 7, dhe 8 u identifikuan nga Zogaj se janë përdorur në Bellanicë); IC103 (fotografi e bërë nga Zogaj në vitin 1997 që tregon llojin e automjeteve të përdorura nga policia në Bellanicë). Sidoqoftë, gjatë fazës së pyetjeve nga Mbrojtja, doli se identifikimi i mëhershëm nga Zogaj i tankut në ngjyrë të gjelbër kamuflimi në fotografinë 5 si automjet policie, nuk përputhej me dëshminë e mëvonshme të Zogajt dhe fotografinë e tij (IC103). *Shih* Shefqet Zogaj, T. 5873–5877 (3 nëntor 2006). *Shih gjithashtu* Hamide Fondaj, T. 3829 (25 shtator 2006), P2283 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 qershor 2001), f. 3.

hynë në Bellanicë dhe filluan të digjnin shtëpitë, të vrisnin bagëtinë, dhe të shtinin drejt njerëzve që po largoheshin.¹³⁹⁶ Mbrojtja i sugjeroi Zogajt se jo forcat serbe, po ai u kishte thënë njerëzve të largoheshin, në zbatim të urdhrin të Bislim Zyrapit të përmendur më lart. Zogaj e mohoi këtë pretendim.¹³⁹⁷

530. Duke lëvizur ngadalë me kolonën që ishte formuar, Zogaj u keqtrajtua nga "policë" të ndryshëm dhe iu morën paratë.¹³⁹⁸ Pjesëtarët të "policisë" i provokuan shqiptarët kosovarë në kolonë, duke iu thënë "shkoni te babë Klintoni" dhe "shkoni në Shqipëri." Edhe pse e drejtuan kolonën në dy drejtime të ndryshme, konkretisht, në përfundim në drejtim të Malishevës dhe Rahovecit, dhe në jug në drejtim të Bllacës dhe Suharekës, në fund të dy grupet kaluan nëpër Prizren. Zogaj shkoi në drejtimin Bllacë-Suharekë dhe, duke dalë nga Bellanica, pa trupa dhe tanke me armët e drejtuara nga fshati.¹³⁹⁹ Kur pjesa e kolonës në të cilën ishte Zogaj mbërriti në Lubizhdë afër qytetit të Prizrenit, ata u provokuan përsëri nga serbë me uniforma të rregullta të policisë dhe ushtrisë, të cilët u thanë "shkoni te NATO-ja," "shkoni në Shqipëri," "Kosova ka qenë dhe do të jetë tokë serbe," dhe gjëra të ngjashme. Disa nga këta njerëz kishin uniforma dhe maska të zeza dhe mbanin thika në brez. Në kalimin kufitar në Morinë, policia serbe u konfiskoi Zogajt dhe familjes së tij targat e kamionit dhe letërnjoftimet, pasaportat, dhe patentat e shoferit e tij. Zogaj dhe familja e tij e kaluan kufirin më 2 prill 1999, në orën 17:00. "Policët kufitarë serbë" u thanë se nuk do ta shihnin më Kosovën. Zogaj u kthye në Bellanicë më 21 qershor 1999, dhe e gjetur 70 për qind të fshatit të djegur, përfshirë edhe shtëpinë e tij.¹⁴⁰⁰

531. Hamide Fondaj e përshkroi largimin e saj nga Bellanica në mënyrë përgjithësisht të ngjashme. Më 1 prill ndërsa ishte në qendër të fshatit me familjen e saj dhe shumë të tjerë, u përhap fjala se të gjithë duhej të hipnin në traktorë. Disa burra të veshur me rroba të zeza dhe me maska të zeza shkuan traktor më traktor duke rrëmbyer para. Atë natë rreth orës 02:00 ose 03:00, Fondaj pa zjarre të shkaktuara nga bombat e NATO-s që godisnin objektiva në zonat përreth.¹⁴⁰¹ Të nesërmen në mëngjes, në fshat erdhën "policë" me uniforma të ndryshme dhe me fytyra të ngjyrosura dhe shami në kokë. Ata shkuan traktor më traktor duke kërkuar para. Rreth 20 prej tyre me maska iu

¹³⁹⁶ Shefqet Zogaj, P2322 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 prill 1999), f. 4–5, P2323 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 qershor 2001), f. 4–5.

¹³⁹⁷ Shefqet Zogaj, T. 5914–5915 (6 nëntor 2006); P2457 (urdhër i UÇK-së, 1 prill 1999).

¹³⁹⁸ Shefqet Zogaj, T. 3793–3794 (22 shtator 2006), T. 5863–5865, 5885–5887 (3 nëntor 2006), T. 5903–5904 (6 nëntor 2006), P2322 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 prill 1999), f. 5–6.

¹³⁹⁹ Shefqet Zogaj, T. 3795–3796 (22 shtator 2006), P2322 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 prill 1999), f. 6–7, P2323 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 qershor 2001), f. 5–6.

¹⁴⁰⁰ Shefqet Zogaj, T. 3795–3798 (22 shtator 2006), P2322 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 prill 1999), f. 8–9, P2323 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 qershor 2001), f. 6–7; P2345 (fotografi të bëra nga Zogaj që tregojnë shtëpinë e tij të djegur).

¹⁴⁰¹ Hamide Fondaj, T. 3829–3831, 3858 (25 shtator 2006), P2283 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 qershor 2001), f. 3.

afruan traktorit të Fondajt dhe kërkuan para nga ajo dhe dy pleqtë në traktor. Edhe pse të gjithë u dhanë para, ata prapëseprapë i rrahën pleqtë.¹⁴⁰² Pas pak, njerëzit në traktorë filluar të largoheshin nga Bellanica në drejtim të qytetit të Suharekës. Ata u ndaluan afërsisht 10 herë dhe vazhdimisht iu kërkonin para. Duke u larguar nga fshati, Fondaj pa ushtarë të UJ-së duke ia bërë kolonës me dorë në shenjë lamtumire. Në një postbllok, UJ-ja i urdhëroi që të mos shkonin në qytetin e Suharekës, por në drejtim të kundërt, për në Malishevë dhe Rahovec.¹⁴⁰³ Jashtë Astrazupit, ata u ndaluan në një postbllok të UJ-së ku një ushtar i kërkoi Fondajt 100 marka gjermane. Pasi ia dha paratë, ata u lejuan të vazhdonin me kolonën. Fondaj pa "ushtarë," moshën e të cilëve nuk mund ta përcaktonte dhe emblemat e të cilëve nuk mundi t'i shihte, që hynë në Astrazup dhe u vunë zjarrin shtëpive me flakëdhës.¹⁴⁰⁴ Ajo gjithashtu dëshmoi se në një moment "ushtarët serbë" ua hoqën plisat burrave shqiptarë kosovarë në kolonë dhe i hodhën përtokë. Pastaj burrat u detyruan t'i shkelnin me makina.¹⁴⁰⁵ Kolona shkoi në Malishevë, pastaj u kthye në Rahovec, e më pas në Prizren. Para se të arrinte në fshatin Zhur, kolona u ndalua për rreth shtatë ose tetë orë. Fondaj tha se gjatë rrugës për në kufi, ajo pa shpesh forca ushtarake. Më në fund kolona arriti në kufi dhe e kaloi kufirin më 4 prill 1999, në orën 02:00. Sipas Fondajt, policia kufitare u tha se duhej të largoheshin për shkak të Ibrahim Rugovës dhe NATO-s. Kolona nuk u kontrollua dhe u lejua të kalonte. Një polic u tha se i vinte keq.¹⁴⁰⁶ Në pritje të kalimit në Shqipëri, ajo pa kolonën tjetër që hyri në Shqipëri dhe vuri re se njerëzit në të ishin rrahur dhe u ishin marrë të gjitha dokumentet e identifikimit.¹⁴⁰⁷

532. Një raport i Bozhidar Deliqit dërguar Komandës së Korpusit të Prishtinës e mbështet pjesërisht këtë rrëfim të lëvizjes së popullatës më 3 prill 1999 sa i përket zonës së tij të përgjegjësisë. Ai theksoi se me fillimin e fushatës së NATO-s, gjendja u keqësua me shpejtësi. Përveç luftimeve me Brigadën e 124-t të UÇK-së në zonën Rahovec-Suharekë, gjithashtu doli edhe problemi i "refugjatëve" të shumtë. Sipas Deliqit, "dyndja e refugjatëve, sidomos në këtë numër, erdhi si befasi." Më tej ai përmendi disa arsye për lëvizjen e tyre, përfshirë frikën se mos gjendeshin në mes dy zjarreve, frikën nga rekrutimi në UÇK, frikën nga forcat e UJ-së/MPB-s dhe "trupave të Arkanit," dhe frikën nga bombardimet e NATO-s.¹⁴⁰⁸ Deliqi gjithashtu tha se autoritetet vendore i

¹⁴⁰² Hamide Fondaj, T. 3830–3833 (25 shtator 2006), P2283 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 qershor 2001), f. 4.

¹⁴⁰³ Hamide Fondaj, T. 3833 (25 shtator 2006), P2283 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 qershor 2001), f. 4.

¹⁴⁰⁴ Hamide Fondaj, T. 3838–3839 (25 shtator 2006), P2283 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 qershor 2001), f. 4.

¹⁴⁰⁵ Hamide Fondaj, P2283 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 qershor 2001), f. 4.

¹⁴⁰⁶ Hamide Fondaj, T. 3834–3835 (25 shtator 2006), P2283 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 qershor 2001), f. 4–5.

¹⁴⁰⁷ Hamide Fondaj, T. 3861 (25 shtator 2006), P2283 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 qershor 2001), f. 5.

¹⁴⁰⁸ 5D885 (Raport i Brigadës së 549-të të Motorizuar dërguar Komandës së PrK-së, 3 prill 1999), f. 1, 2. Duhet theksuar se Aleksandar Vasileviqi ka dëshmuar se në një mbledhje më 17 maj, në të cilën morën pjesë Millosheviqi, Shainoviqi, Ojdaniqi, Rade Markoviqi, Farkashi, Pavkoviqi, Gajiqi, dhe vetë Vasileviqi, Radomir Markoviqi pranoi praninë e Akrepave si dhe të disa pjesëtarëve të "trupave të Arkanit" në Kosovë. Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 janar 2007), para. 65–67, P2589 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 15999–16004.

kishin shprehur mendimin e tyre për numrin e madh të refugjatëve, që ishte skenar i parapërgatitur i "katastrofës humanitare," dhe largimi bëhej për të mundësuar që NATO-ja të bombardonte lirisht dhe pa dallime.¹⁴⁰⁹ Ai gjithashtu përmendi se pjesëtarët e kompanisë së 5-të të PJP-së dhe ushtarët e Brigadës së 15-të të Blinduar "u bashkuan në fshatin Bellanicë, ku evakuuan dhe u kujdesën afërsisht për 3,000 refugjatë."¹⁴¹⁰ Millosh Vojnoviqi, i cili ishte shef i SPB-së së Prizrenit në atë kohë, mohoi se kishte dijeni që PJP ishte kujdesur për "refugjatë" në Bellanicë dhe dëshmoi se kujdesi për civilët e shpërngulur ishte "çështje me të cilën merrej policia e rregullt." Sidoqoftë, ai gjithashtu dëshmoi se kishte parë "mijëra refugjatë" në rrugën Suharekë-Prizren.¹⁴¹¹

533. Gjeneral Kërsman Jelliqi, i cili ishte komandant i Brigadës së 243-të të Mekanizuar e vendosur në Duhël në atë kohë, gjithashtu iu referua dëshmive të Hamide Fondajt dhe Shefqet Zogajt gjatë dëshmisë së tij. Jelliqi dëshmoi se forcat e tij nuk e granatuan asnjëherë Bellanicën dhe nuk i detyruan civilët të largoheshin në drejtim të Shqipërisë nëpër rrugën e Suharekës. Ai sqaroi se kjo do të thoshte se njerëzit do të detyroheshin të lëviznin në drejtim të forcave të UJ-së e jo në drejtim të kundërt prej tyre, që do të ishte absurde. Jelliqi pranoi se në bazë të një urdhri të 28 marsit 1999 në atë zonë u krye një operacion për të eliminuar bllokimin prej UÇK-së të rrugës që lidh Suharekën me Malishevën dhe që kalon nëpër Bellanicë. Sipas Jelliqit, kjo zonë ishte bastion e UÇK-së dhe njësitë e tij nuk mundën të arrinin në Bellanicë.¹⁴¹²

6. Konkluzione

a. Vrasjet e familjes Berisha në qytetin e Suharekës

534. Prokuroria pretendon se përgjegjës për vrasjen e familjes Berisha ishin si UJ-ja, po ashtu edhe MPB-ja, meqenëse krimi ndodhi gjatë aksionit të përbashkët të UJ-së dhe MPB-së.¹⁴¹³ Nga ana e tyre, Mbrojtja e Pavkoviqit dhe Llazareviqit pretendojnë se dëshmitë tregojnë qartë se ushtarët e UJ-së nuk u implikuan në këto vrasje.¹⁴¹⁴ Nga ana e saj, Mbrojtja e Llukiqit, pranon se Berishët u vranë nga pjesëtarë të policisë, por pretendon se vrasjet u kryen për arsye tërësisht personale nga individë të dehur, të cilat u mbuluan ngutshëm, duke mos informuar as shefin e DPB-së së

¹⁴⁰⁹ 5D885 (Raport i Brigadës së 549-të të Motorizuar dërguar Komandës së PrK-së, 3 prill 1999), f. 3.

¹⁴¹⁰ P2002 (Analizë e operacioneve të Brigadës së 549-të të Motorizuar, 30 mars [sic] 1999), f. 3.

¹⁴¹¹ Millosh Vojnoviq, T. 24239–24241 (13 mars 2008).

¹⁴¹² Kërsman Jelliq, T. 18951–18953 (23 nëntor 2007), T. 19026–19032 (26 nëntor 2007); IC144 (Hartë e shënuar nga Jelliqi që tregon lëvizjet e njësisë së tij); P1969 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 28 mars 1999).

¹⁴¹³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 388–389.

¹⁴¹⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 571–572; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 109–112.

Suharekës as shefin e SPB-së së Prizrenit. Sipas Mbrojtjes së Llukiqit, kjo ishte arsyeja se pse as Shtabi i MPB-së, as i Shtabi i RDB-së nuk kishin asnjë të dhënë në lidhje me këtë krim.¹⁴¹⁵

535. Pas shqyrtimit të kujdesshëm të provave, Dhoma është bindur se UÇK-ja nuk vepronte në qytet në kohën kur Detashmenti i 37-të i PJP-së së bashku me policinë vendore filluan aksionin e tyre. Rrjedhimisht, Dhoma konkludon se këto forca vepruan kundër civilëve, fakt që konfirmohet nga dëshmia e K83-shit në lidhje me kufomat e përhapura me rroba civile, të gjetura në rrugën e Reshtanit, që është drejtimi në të cilin PJP-ja u pa duke shkuar. Dhoma gjithashtu është bindur se më 26 mars 1999, policë vendorë Suharekë vranë 45 anëtarë të familjes Berisha në afërsi të shtëpisë së Shyhrete Berishës, në stacionit e afërt të autobusëve, në qendrën tregtare, dhe brenda një picerie. Meqenëse këto vrasje ndodhën gjatë aksionit të PJP-së, Dhoma mendon se pjesëtarët e Detashmentit të 37-të të PJP-së kanë luajtur rol kyç në fillimin e këtij aksioni nga policët vendorë. Sidoqoftë, nuk ka prova për implikimin e forcave të UJ-së.

536. Dhoma nuk e pranon pretendimin e Mbrojtjes së Llukiqit se shefi i DPB-së së Suharekës dhe shefi i SPB-së së Prizrenit nuk kishin dijeni për vrasjet, të cilat ndodhën shumë afër godinës së DPB-së. Numri i madh i njerëzve të përfshirë në largimin e kufomave nga piceria tregon se shumë njerëz në qytet dinin për vrasjet. Gjithashtu, K83-shi konfirmoi se banorët e Suharekës kishin folur për incidentin me Berishët pas ngjarjes dhe se ai foli për këtë incident me kolegët e tij. Ai gjithashtu mendonte se eprori i tij i drejtpërdrejtë, Jovanoviqi, u vu në dijeni më vonë për incidentin. Së fundi fund, siç është përmendur më lart, hetimi i mangët i kryer nga ekipi i SPB-së së Prizrenit gjithsesi rezultoi në gjetjen e disa kufomave me rroba civile, duke përfshirë edhe kufomën e një plake, të shpërndara nëpër Suharekë, gjë që duhej të kishte alarmuar autoritetet. Rrjedhimisht Dhoma mendon se shefi i DPB-së së Suharekës dhe shefi i SPB-së së Prizrenit duhet të kenë pasur dijeni për ngjarjet që ndodhën më 26 mars 1999. Fakti se Berishët u zhvarrosën më vonë nga Prizreni dhe u transportuan në Batajnicë gjatë një operacioni të fshehtë të përmasave të mëdha të kryer nga MPB-ja, siç përshkruhet më poshtë,¹⁴¹⁶ gjithashtu tregon se zyrtarë të lartë të MPB-së duhet të kenë pasur dijeni për vrasjet.

537. Përshkrimi i provave kriminalistike dhe provave të tjera në lidhje me viktimat nga Suhareka është përfshirë në Shtojcën A të këtij Aktgjykimi. Në bazë të këtyre provave dhe dëshmive të Shyhrete Berishës, Hysni Berishës, Halit Berishës, dhe K83-shit, Dhoma konkludon se më 26 mars

¹⁴¹⁵ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 897–901; Argumentet Përmbyllëse të Llukiqit, T. 27335–27336 (26 gusht 2008).

¹⁴¹⁶ *Shih* Pjesën VII.P.

1999 në qytetin e Suharekës u vranë 45 njerëz ose me armë zjarri ose, nga shpërthimi në një hapësirë të mbyllur ku ndodheshin.

538. Gjashtë persona, konkretisht Nexhat Berisha, Fatime Berisha, Faton Berisha, Bujar Berisha, Sedat Berisha, dhe Nexhmedin Berisha u vranë pa kurrfarë provokimi ose arsyeje në afërsi të shtëpisë së Berishëve më 26 mars 1999, siç ka dëshmuar Shyhrete Berisha dhe siç është konfirmuar nga ekspertë të ndryshëm mjeko-ligjorë. Pesë prej tyre u varrosën në varrezën e Suharekës, kufoma e Nexhmedin Berishës u gjet në varrin e përbashkët në Batajnicë.

539. Shyhrete Berisha gjithashtu tregoi se edhe disa anëtarë të tjerë të familjes Berisha ishin në picerinë ku ndodhën vrasjet dhe ajo i pa kur u vranë. Nga këto prova, Dhoma përfundon se të gjitha këta persona patën vdekje të dhunshme dhe të paprovokuar. Viktimat ishin: katër fëmijët e Shyhrete Berishës, Majlinda, Herolinda, Altin, dhe Redon Berisha; Avdi Berisha; Besim Berisha; Dafina Berisha; Doruntina Berisha; Drilon Berisha; Edon Berisha; Eron Berisha; Fatime Berisha; Fatmire Berisha; Flora Berisha; Genci Berisha; Granit Berisha; Hajdin Berisha; Hanumsha Berisha; Hava Berisha; Ismet Berisha; Kushtrim Berisha; Lirije Berisha; Mevlude Berisha; Mihrije Berisha; Musli Berisha; Sebahate Berisha; Sherine Berisha; Sofije Berisha; Vesel Berisha; dhe Vlorjan Berisha. Gjithashtu, siç u përmend më lart, lidhur me gjysmën e këtyre viktimave Dhoma disponon si prova një sasi të konsiderueshme të materialit mjekësor që identifikon kufomat e tyre të gjetura në Batajnicë.

540. Dhoma vëren se dy nga viktimat, konkretisht Afrim Berisha dhe Hamdi Berisha, nuk u identifikuan nga Shyhrete Berisha që kishin qenë në piceri në ditën e incidentit, por kufomat e tyre u gjetën në Batajnicë së bashku me ato të anëtarëve të tjerë të familjes Berisha të vrarë atë ditë. Dhoma është bindur se edhe këta dy burra u vranë së bashku me Berishët e tjerë më 26 mars 1999 dhe se vrasja e tyre ishte e paprovokuar dhe pa bazë ligjore.

541. Dhoma është bindur se dëshmia e Shyhrete Berishës se i pa dy vajzat e Hamdi Berishës në piceri, si dhe provat e ADN-së që kanë identifikuar vajzat e Hamdi Berishës, tregojnë se dy motrat e tjera i futën gjithashtu me forcë në piceri më 26 mars dhe i vranë atje. Kjo konfirmohet nga lista e ZPZHK-së të personave të zhdukur, që përmban emrat e të katër vajzave. Rrjedhimisht Dhoma është bindur se Arta Berisha, Hanumsha Berisha, Merita Berisha, dhe Zana Berisha u vranë më 26 mars 1999 në Suharekë.

542. Dhoma gjithashtu thekson se Hysni Berisha dëshmoi se edhe nëna e vajzave, Zelihe Berisha, u vra atë ditë. Edhe pse Shyhrete Berisha nuk e pa Zelihe Berishën në piceri në kohën e vrasjes dhe kufoma e saj nuk u gjet në Batajnicë, ajo është zhdukur që nga ajo ditë, së paku dy nga vajzat e saj

u identifikuan nga Shyhrete Berisha se kishin qenë në piceri atë ditë, dhe Dhoma ka përfunduar se të katër vajzat e saj u vranë në atë kohë. Në mënyrë të ngjashme, edhe pse nuk ka dëshmitarë okularë apo prova kriminalistike në lidhje me Mirat Berishën, djalin 10-vjeçar të Zelihe Berishës, trikoja e tij u gjet në varrin e përbashkët në Prizren dhe ai është ende i zhdukur. Nuk ka prova që sugjerojnë se Zelihe ose Mirat Berisha nuk patën të njëjtin fat si anëtarët e tjerë të familjes. Në bazë të provave të paraqitura, Dhoma konkludon se i vetmi përfundim logjik është se ata ishin midis viktimave më 26 mars 1999 në Suharekë.

543. Duke u bazuar në dëshminë e Shyhrete dhe Hysni Berishës dhe në identifikimin me ADN të kufomës së tij në Batajnicë, Dhoma është bindur se edhe Jashar Berisha u vra më 26 mars 1999 në Suharekë pa asnjë provokim apo bazë ligjore.

544. Duke marrë parasysh provat e pakta në lidhje me dy viktimat në Listën D, konkretisht Nafije Berishën dhe Sait Berishën, Dhoma nuk është bindur jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se këta dy persona u vranë më 26 mars 1999, në Suharekë.

b. Shpërngulja nga qyteti i Suharekës

545. Prokuroria pretendon se policët shkuan shtëpi më shtëpi në qytetin e Suharekës duke i kërcënuar dhe dëbuar njerëzit nën kërcënimin e armëve dhe plaçkitën e dogjën shtëpitë e tyre.¹⁴¹⁷ Nga ana e vet, Mbrojtja e Pavkoviqit pretendon se dëshmia e Hysni Berishës është në kundërshtim me pretendimin e ekzistencës së një plani për dëbimin e popullatës nga Kosova, meqenëse ai qëndroi në Prizren dhe as nuk u shpërngul me dhunë, e as nuk u dëbua. Gjithashtu, atij i tha më shumë se një herë të kthehej në shtëpi.¹⁴¹⁸ Mbrojtja e Llukiqit ka paraqitur të njëjtat argumente dhe pretendon se dëshmia e tij tregon se SPB-ja e Prizrenit i nxiti shqiptarët kosovarë të ktheheshin në shtëpi.¹⁴¹⁹

546. Dhoma është bindur se në fund të marsit dhe në fillim të prillit 1999 Berishët bashkë me banorët e tjerë të qytetit, u detyruan të largoheshin nga shtëpitë e tyre dhe të shkonin ose në Shqipëri, ose në ndonjë vend tjetër. Hysni Berisha, i cili përfundoi në Prizren e jo në Shqipëri, dëshmoi se policët vendës dhe "paraushtarakët" ishin forcat kryesore që morën pjesë në dëbimin e njerëzve nga qyteti i Suharekës. Dëshmia e Halit Berisha gjithashtu fajëson të njëjtët policë vendës për dëbimin e tij nga qyteti i Suharekës, që në fund rezultoi në vajtjen e tij në Shqipëri. Shyhrete

¹⁴¹⁷ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 380–382.

¹⁴¹⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 416–417.

¹⁴¹⁹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 902–907.

Berisha u dëbua nga qyteti si rezultat i vrasjes të familjes së saj, që sikurse është konkluduar, u nxit nga PJP-ja dhe u krye nga policë vendës të qytetit.

547. Gjithashtu Dhoma është bindur se shumë shtëpi në qytetin e Suharekës u dogjën dhe u plaçkitën nga policia, ashtu siç kanë dëshmuar këta dëshmitarë. Veç këtyre K83-shi foli për punën e plaçkitjeve dhe dëshmoi se, gjatë periudhës nga marsi deri në maj 1999, u arrestuan disa "civilë" për plaçkitjen e shtëpive në qytetin e Suharekës dhe u burgosën në Prizren. Sipas K83-shit, shumica e këtyre personave ishin serbë etnikë.¹⁴²⁰

c. Dëmtimet e xhamisë në qytetin e Suharekës

548. Duke u bazuar në dëshminë e Halit Berishës dhe Andrés Riedlmayer-it, Prokuroria pretendon se minareja e xhamisë në Suharekë u shkatërrua me dinamit nga "ushtarët" dhe sugjeron se nuk ka pasur arsye legjitime ushtarake për këtë shkatërrim.¹⁴²¹ Mbrojtja e Llazareviqit e cila kundërshton implikimin e UJ-së, pretendon se UJ-ja nuk ishte e vendosur në qytet dhe vëren se automjeti që pa Halit Berisha pas shkatërrimit të minaresë përdorej nga pjesëtarët e policisë.¹⁴²² Gjithashtu, Mbrojtja e Llukiqit e kundërshton dëshminë e Halit Berishës sepse ai nuk pa sesi u shkatërrua dhe argumenton se MPB-ja nuk mund ta shkatërronte sepse nuk dispononte pajisjet e nevojshme për këtë qëllim.¹⁴²³

549. Dhoma është bindur se minareja e xhamisë në Suharekë u shkatërrua më 28 mars 1999, siç ka dëshmuar Halit Berisha i cili dëgjoi shpërthimin, vuri re se minareja e xhamisë ishte zhdukur, dhe më pas pa një automjet "Gazik" duke shkuar në drejtim të Biraçit, që është gjithashtu edhe drejtimi në të cilin ndodhet ndërtesa e DPB-së. Dhoma gjithashtu pranon dëshminë e Riedlmayer-it i cili shkoi personalisht në qytetin e Suharekës dhe e fotografoi dëmin, se dëmi ishte shkaktuar nga një shpërthim brenda minaresë. Bazuar në të gjitha provat në lidhje me xhaminë, Dhoma është bindur se ajo u dëmtua nga pjesëtarët e MPB-së.

d. Shpërnguljet nga Bellanica

550. Prokuroria pretendon se krimet në Bellanicë u kryen gjatë operacionit të përbashkët të UJ-së/MPB-së dhe deklaroi se forcat që hynë në fshat, menjëherë pasi e kishin zmbarsur UÇK-në nga ajo zonë, ishin ose "pjesë e vijës së sulmit të forcave serbe ose forca që ishin pjesë a manovrimit taktik për sigurimin e zonës." Prokuroria pranon se UÇK-ja i dha urdhër popullatës të

¹⁴²⁰ K83, T. 3985 (26 shtator 2006).

¹⁴²¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 382, 392.

¹⁴²² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 109.

largohej me UÇK-në, por vëren se kjo u bë për shkaqe sigurie dhe se gjithsesi popullata vendosi të qëndronte.¹⁴²⁴ Mbrojtja e Llazareviqit argumenton se luftimi në Bellanicë ishte brenda kuadrit të një operacioni legjitim kundër UÇK-së dhe i kundërshton dëshmitë e Zogajt dhe të Fondajt se janë të njëanshme. Ajo gjithashtu i referohet urdhrin të UÇK-së drejtuar popullatës që të largohej nga zona.¹⁴²⁵ Mbrojtja e Pavkoviqit pretendon se dëshmia e Shefqet Zogajt duhet të hidhet poshtë plotësisht për shkak të mospërputhjeve dhe anshmërisë dhe armiqësisë së tij. Gjithashtu, ajo vë në dukje urdhrin e Zyrapit për largimin e popullatës si dëshmi se UÇK-ja e përdorte popullatën civile si mburojë.¹⁴²⁶ Mbrojtja e Llukiqit pretendon se ngjarjet në Bellanicë ishin pasojë e veprimeve të UÇK-së dhe se qëllimi i operacionit të përbashkët të UJ-së/MPB-së ishte kundërpërgjigje ndaj këtyre veprimeve. Në lidhje me lëvizjen e njerëzve, Mbrojtja e Llukiqit mbështetet në raportet e luftimit të Deliqit dhe pretendon se nuk ishte dëbim, por evakuim i popullatës. Mbrojtja e Llukiqit gjithashtu thekson faktin se Fondaj nuk u urdhërua asnjëherë që të shkonte në Shqipëri dhe se njerëzve në kolonën e saj nuk iu morën dokumentet.¹⁴²⁷

551. Siç u tha më lart, Dhoma nuk e konsideron krejtësisht të besueshme dëshminë e Shefqet Zogajt në lidhje me Bellanicën për shkak të paqartësive në shumë aspekte dhe disa mospërputhjeve.¹⁴²⁸ Ndërkaq Dhoma e pranon dëshminë e Bislim Zyrapit se më 1 prill 1999 UÇK-ja u tërhoq duke kaluar përmes Bellanicës dhe se i tha popullatës së fshatit të largohej. Dhoma e pranon dëshminë e tij se një pjesë e popullatës e injoroi këtë urdhër dhe vendosi të rrinte, por nuk është në gjendje të përcaktojë se sa njerëz qëndruan në Bellanicë në atë kohë. Meqenëse e gjithë komuna kishte 50.000-60.000 banorë, Dhoma nuk e pranon dëshminë e Zogajt se në Bellanicë u mbledhën rreth 80,000 njerëz. Hamide Fondaj dëshmoi se në Bellanicë ishin mijëra njerëz, kurse në një analizë pas operacionit të përgatitur nga Deliqi përmendet se UJ-ja gjeti 30.000 persona të shpërngulur në fshat.¹⁴²⁹ Rrjedhimisht, Dhoma konkludon se edhe pse disa dhjetëra mijëra, numri i të shpërngulurve ishte shumë më i pakët se 80.000 dhënë nga Zogaj.

552. Në lidhje me granatimin e Bellanicës, Dhoma nuk e pranon pretendimin e Zogajt se ata mijëra njerëz të mbledhur atje u granatuan nga forcat e përziera të RFJ-së, meqë nuk ka prova për numër të madh viktimash që do pritej në një rast të tillë. Faktikisht gjatë pyetjeve nga Mbrojtja,

¹⁴²³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 908–909.

¹⁴²⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 393.

¹⁴²⁵ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 113–124.

¹⁴²⁶ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 419–425.

¹⁴²⁷ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 914–923.

¹⁴²⁸ *Shih* para. 467 më lart.

¹⁴²⁹ P2002 (Analizë e operacioneve të Brigadës së 549-të të Motorizuar, 30 mars [sic] 1999), f. 3.

Zogaj më në fund pranoi se u granatuan skajet e fshatit. Edhe pse ai mohoi se kjo ndodhi për shkak të pranisë së UÇK-së, Dhoma pranon dëshminë e Bislim Zyrapit së bashku me urdhrin e lëshuar prej tij atë ditë, se UÇK-ja u sulmua dhe u tërhoq përmes Bellanicës për në malet e Berishës, që ndodhen mbi fshat. Granatimi i dëgjuar nga Zogaj dhe Fondaj atë ditë mund të ketë pasur lidhje me luftimet midis forcave të RFJ-së/Serbisë dhe UÇK-së. Kjo mbështetet edhe nga analiza pas operacionit e Bozhidar Deliqit.

553. Sa i përket shpërnguljeve nga Bellanica, Dhoma vëren se Zogaj dhe Fondaj thanë se forcat në fshat dhe përreth përbëheshin prej ushtarëve të UJ-së, policëve, dhe paraushtarakëve. Dhoma konkludon se atë ditë UJ-ja dhe MPB-ja ishin të pranishme në atë zonë, siç konfirmohet nga urdhri i Deliqit më 29 mars 1999,¹⁴³⁰ dhe raporti i tij i datës 3 prill 1999.¹⁴³¹ Faktikisht në këtë raport ai përmend se pjesëtarët e kompanisë së 5-të të PJP-së dhe ushtarët e Brigadës së 15-të të Blinduar ishin "u bashkuan në fshatin Bellanicë, ku evakuuan dhe u kujdesën për rreth 30.000 refugjatë."¹⁴³² Sidoqoftë, Dhoma nuk është në gjendje të nxjerrë përfundim mbi praninë e paraushtarakëve në fshat atë ditë.

554. Gjithashtu, Dhoma vëren se këto forca nuk urdhëruan shprehimisht as Zogajn e as Fondajn që të largoheshin. Zogaj vendosi vetë të largohej dhe madje udhëzoi edhe të tjerët të bënin të njëjtën gjë, kurse Fondaj dëshmoi se "ishte përhapur fjala" se të gjithë duhej të niseshin. Kjo përputhet me përshkrimin në atë kohë të Deliqit të evakuimit të njerëzve nga Bellanica. Sidoqoftë, Dhoma vëren se Zogaj dhe Fondaj dëshmuuan se ndërsa po largoheshin nga Bellanica, u grabitën nga policët dhe është bindur se këto grabitje kanë ndodhur dhe u kryen nga policia. Nuk ka prova të mjaftueshme për implikimin e ushtarëve të UJ-së në këto veprime.

555. Rrjedhimisht Dhoma nuk është në gjendje të konkludojë jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se shqiptarët kosovarë të pranishëm në Bellanicë më 1 prill 1999 u larguan nga ajo zonë për shkak të granatimit nga forcat e RFJ-së dhe Serbisë, siç pretendohet në Aktakuzë. Sidoqoftë, Dhoma nuk ka dyshim se shumë shqiptarë kosovarë lëvizën në grupe nga ky vend dhe nëpër të dhe se njerëzit u kërcënuan, fyen dhe plaçkitën nga forcat policore që vepronin në atë zonë. Gjithashtu, shumicës së tyre iu morën dokumentet e identifikimit gjatë kalimit të kufirit me Shqipërinë.

¹⁴³⁰ P2000 (Urdhër i Brigadës së 549-të të Motorizuar, 29 mars 1999).

¹⁴³¹ P2002 (Analizë e operacioneve të Brigadës së 549-të të Motorizuar, 30 mars [sic] 1999), f. 3.

¹⁴³² P2002 (Analizë e operacioneve të Brigadës së 549-të të Motorizuar, 30 mars [sic] 1999), f. 3.

G. SKËNDERAJ

1. Akuzat në Aktakuzë

556. Aktakuza i ngarkon të Akuzuarit me përgjegjësi për katër kategori të ndryshme të krimeve kundër njerëzimit që pretendohet se janë kryer në komunën e Skënderajt: dëbim, zhvendosje të dhunshme, vrasje, dhe përndjekje. Vrasjet e pretenduara figurojnë edhe si shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës.

557. Pretendimet konkrete janë parashtruar në paragrafët 72(c) dhe 75(f) të Aktakuzës, si vijon:

Duke filluar më 25 mars 1999 apo rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë sulmuan dhe shkatërruan me anë të granatimeve dhe djegies fshatrat Vojnikë, Leqinë, Klladërnice, Turiçec dhe Izbicë. Shumë shtëpi, dyqane dhe xhami u shkatërruan, duke përfshirë xhaminë në qendrën e fshatit Qirez. Disa gra dhe fëmijë u morën nga anëtarë të forcave të RFJ-së dhe të Serbisë dhe u mbajtën në një hambar në Qirez. Gratë u dhunuan seksualisht dhe atyre iu vodhën të holla dhe sende. Së paku tetë prej grave u vranë pasi ishin dhunuar seksualisht dhe kufomat e tyre u hodhën në tri puse në fshatin Qirez. Më 28 mars 1999 apo rreth kësaj date, së paku 4.500 shqiptarë kosovarë prej këtyre fshatrave u mblodhën në fshatin Izbicë, ku pjesëtarët e forcave të RFJ-së dhe të Serbisë kërkuan të holla prej shqiptarëve kosovarë dhe i ndanë burrat nga gratë dhe fëmijët. Më tej, u vranë një numër i madh burrash. Gratë dhe fëmijët u çuan me dhunë si grup në drejtim të Klinës, Gjakovës dhe më në fund në kufirin me Shqipërinë.¹⁴³³

Më 27 mars 1999 apo rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë granatuan fshatin Izbicë në komunën e Skënderajt me armë të rënda. Së paku 4.500 fshatarë nga Izbica dhe fshatrat përreth u strehuan në një lëndinë në Izbicë. Më 28 marsit 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë rrethuan fshatarët dhe iu afruan atyre, duke u kërkuar para. Pasi forcat e RFJ-së dhe të Serbisë u vodhën fshatarëve artikujt me vlerë, i ndanë burrat nga gratë dhe fëmijët e vegjël. Pastaj burrat u ndanë në dy grupe. Një grup u dërgua në një kodër të afërt kurse tjetri u dërgua në shtratin e një përroi të afërt. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë hapën zjarr mbi të dy grupet e burrave duke vranë së paku rreth 116 shqiptarë kosovarë. Gjithashtu më 28 mars 1999, gratë dhe fëmijët e mbledhur në Izbicë u detyruan të largoheshin dhe të ecnin në këmbë drejt Shqipërisë. Dy plaka invalide ishin ulur në rimorkion e një traktori dhe nuk mund të ecnin. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i vunë zjarrin rimorkios dhe të dyja plakat u dogjën të gjalla. (Të vranët në Izbicë të cilëve u dihet emri janë renditur në Listën F që i bashkëngjitet kësaj aktakuze si shtojcë.)¹⁴³⁴

558. Pretendohet se përndjekja ka ndodhur në formën e vrasjeve në Izbicë, që përmenden në paragrafin 75(f),¹⁴³⁵ të dhunës seksuale përmendur në paragrafin 72(c),¹⁴³⁶ dhe "dëmtim ose shkatërrim pa shkak të objekteve fetare të shqiptarëve kosovarë" duke përfshirë edhe xhaminë në Qirez, përshkruar në paragrafin 72(c) dhe 77(d) të Aktakuzës.

¹⁴³³ Aktakuza, para. 72(c).

¹⁴³⁴ Aktakuza, para. 75(f).

¹⁴³⁵ Aktakuza, para. 76.

¹⁴³⁶ Aktakuza, para. 77(c).

2. Dëshmitarët kryesorë

559. Prokuroria dhe nga Mbrojtja paraqitën disa dëshmitarë për të dëshmuar në lidhje me krimet konkrete që pretendohet se janë kryer në Skënderaj dhe për gjendjen që mbretëronte atje më 1998 dhe 1999. Gjatë formulimit të konkluzioneve në lidhje me vrasjet e ngarkuara në Izbicë, Dhoma ka marrë parasysh dëshmitë e tre mbijetuesve, konkretisht të Milazim Thaqit, Mustafa Dragës, dhe Sadik Januzit, si dhe të Dr. Liri Loshit, i cili shkoi në vendin e ngjarjes pas vrasjeve. Edhe pse në dëshmitë e tyre kishte disa dallime, veçanërisht përsa i përket përshkrimit të forcave të implikuara në incident, dëshmitë e mbijetuesve përputheshin në elementët e rëndësishëm dhe Dhoma i konsideron përgjithësisht të besueshme.

560. Dhoma vëren se Sadik Januzi vdiq para se t'i jepej mundësia të dëshmonte me gojë, por dy dëshmitë e tij me shkrim u pranuan si prova.¹⁴³⁷ Dëshmia e tij për vrasjet përputhet pak a shumë me dëshmitë e Thaqit dhe Dragës dhe rrjedhimisht u përdor si konfirmim i ngjarjeve të përshkruara nga ata. Deklaratat e Januzit gjithashtu përmbajnë edhe dëshminë e shpërnguljes së tij në Shqipëri pas vrasjeve në Izbicë. Sidoqoftë, meqenëse kjo pjesë e dëshmisë së tij nuk konfirmohet nga dëshmi të tjera, Dhoma nuk është në gjendje të nxjerrë asnjë konkluzion kundër të akuzuarve në bazë të saj.

561. Dr. Liri Loshi pranoi se kishte qenë pjesëtar i UÇK-së dhe shpesh ishte i mjegullt në lidhje me praninë e UÇK-së në disa pjesë të komunës. Rrjedhimisht, Dhoma e konsideron dëshminë e tij jobindëse në lidhje me veprimet e UÇK-së në këtë zonë. Sidoqoftë, përsa i përket varrimit të kufomave në Izbicë, dëshmia e Loshit konsiderohet e besueshme dhe konfirmohet si e tillë nga filmimi i varrimit dhe sasia e madhe e materialit mjeko-ligjor në lidhje me vrasjet në Izbicë.

562. Dëshmitë e drejtpërdrejta në lidhje me akuzat e dhunës seksuale në fshatin Qirez rreth mesit të prillit 1999 janë dhënë nga dy dëshmitare okulare, Xhevahire Rrahmani dhe K24. Dëshmitë e tyre kryesisht u pranuan pa kundërshtime dhe përgjithësisht përputheshin, me përjashtim të disa mospërputhjeve në lidhje me identifikimin e uniformave të autorëve të këtyre krimeve. Dhoma gjithashtu pranoi si prova disa të dhëna kriminalistike në lidhje me fatin e disa viktimave të pretenduara, që përputhen me dëshmitë e Rrahmanit dhe K24-ës. Rrjedhimisht Dhoma i pranon dëshmitë e tyre.

563. Dy dëshmitarë dëshmuar në lidhje me shpërnguljen e tyre nga fshatrat e komunës së Skënderajt, konkretisht, Hadije Fazliu dhe Abdullah Salihu. Dëshmia e Fazliut flet për periudhë të ndryshme kohore nga dëshmia e Salihut. Salihu gjithashtu dëshmoi në lidhje me shkatërrimin e

¹⁴³⁷ Vendimi në lidhje me Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Provave në Bazë të Rregullës 92 *quater*, i lëshuar më 16 shkurt 2007.

xhamisë në Qirez. Dhoma konkludon se të dy janë përgjithësisht të besueshëm përse i përket ngjarjeve që i përshkruajnë.

564. Dhoma gjithashtu dëgjoji dëshmitë e disa dëshmitarëve që kanë qenë pjesëtarë të UJ-së apo të MPB-së, si Lubisha Dikoviqi, Sllagjan Pantiqi, Petar Damjanaci, Nebojsa Bogunoviqi, dhe Dragan Zhivanoviqi, dëshmitë e të cilëve kundërshtuan aspekte të ndryshme të dëshmive të dëshmitarëve në lidhje me Skënderajn të paraqitur nga Prokuroria. Ato pjesë të dëshmive të tyre që konsiderohen të besueshme janë dhënë më poshtë.

3. Rrethanat

565. Skënderaj është komuna e madhe që gjendet në Kosovën qendrore.¹⁴³⁸ Ajo është pjesë e zonës gjeografike të Drenicës, që është një zonë në formë trekëndëshi ku përfshihen komunat Skënderaj, Klinë, dhe Gllogoc.¹⁴³⁹ Shumica dërrmuese e popullatës së komunës së Skënderajt janë shqiptarë kosovarë.¹⁴⁴⁰

566. Qyteti kryesor i komunës, që gjithashtu quhet Skënderaj, gjendet afërsisht në qendër të komunës. Fshatrat Izbicë, Burojë, dhe Turiçec shtrihen në perëndim dhe jugperëndim të qytetit,¹⁴⁴¹ kurse Qirezi është në pjesën lindore të komunës, afër komunës së Vushtrrisë dhe Gllogocit.¹⁴⁴² Zona e njohur me emrin malet e Çiçavicës shtrihet pjesërisht në pjesën lindore të komunës së Skënderajt.¹⁴⁴³

567. Dhoma dëgjoji dëshmi se në vitin 1998 dhe në fillim të vitit 1999 UÇK-ja ishte veçanërisht aktive në Zonën Operative të Drenicës, që përfshinte komunat e Skënderajt dhe Gllogocit.¹⁴⁴⁴ Faktikisht, në vitin 1998, pjesë të Skënderajt u bënë arenë luftimesh të ashpra midis UÇK-së dhe forcave të RFJ-së/Serbisë¹⁴⁴⁵ dhe, sipas Petar Damjanacit, shef i DPB-së së Gllogocit në atë kohë,

¹⁴³⁸ P39 (harta e Skënderajt).

¹⁴³⁹ Lubinko Cvetiq, T. 8088 (7 dhjetor 2006); P39 (harta e Skënderajt).

¹⁴⁴⁰ Helge Brunborg, P1960 (Raport mbi madhësinë dhe përbërjen etnike të popullsisë së Kosovës, 14 gusht 2002), f. 9.

¹⁴⁴¹ Hadije Fazliu dëshmoi se Turiçeci është afërsisht 12 kilometra nga qyteti i Skënderajt. Hadije Fazliu, P2241 (deklarata e dëshmitarit e datës 21 tetor 2001), f. 2. Milazim Thaqi dëshmoi se Izbica është rreth 5-6 kilometra nga Buroja. Milazim Thaqi, P2246 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 nëntor 1999), f. 3.

¹⁴⁴² P39 (harta e Skënderajt).

¹⁴⁴³ Abdullah Salihu dëshmoi se malet e Çiçavicës shtrihen rreth tri kilometra nga fshati i tij Baks. Abdullah Salihu, T. 1987 (21 gusht 2006).

¹⁴⁴⁴ Bislim Zyrapi, T. 5934, 5967 (6 nëntor 2006), T. 6258 (10 nëntor 2006); P2469 (hartë që tregon zonat e ndryshme operative të UÇK-së). *Shih gjithashtu* Dragan Zhivanoviç, T. 20440 (17 janar 2008); Sllagjan Pantiq, T. 23674–23676 (5 mars 2008); P950 (intervistë e Vlladimir Llazareviqit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 189–190.

¹⁴⁴⁵ *Shih* Pjesët VI.B dhe VI.C. *Shih gjithashtu* Sllagjan Pantiq, T. 23675–23676 (5 mars 2008); Petar Damjanac, T. 23719–23738 (5 mars 2008); 6D1114 (Lista e viktimave civile të terrorizmit në Kosovë në vitin 1998); 6D1108 (Lista e

rreth 90 për qind e komunës së Glllogocit ishte nën kontrollin e UÇK-së, duke përfshirë shumicën e rrugëve kryesore, siç ishte rruga Skënderaj-Glllogoc.¹⁴⁴⁶ Deri në fund të tetorit 1998, shumica e zonave që mbaheshin nga UÇK-ja u vunë nën kontrollin e forcave të RFJ-së/Serbisë, që përkoi me ardhjen e verifikuesve të KVM-së.¹⁴⁴⁷ Pas kësaj, UÇK-ja rifitoi kontrollin mbi disa nga zonat që i kishte mbajtur më parë.¹⁴⁴⁸ Pra, ajo ishte veçanërisht e përqendruar në zonën e Drenicës,¹⁴⁴⁹ me disa brigada që vepronin në Gradicë, Likoc, Prekaz të Poshtëm, Glllogoc, qytetin e Skënderaj, dhe Vojnikë.¹⁴⁵⁰ Bislim Zyrapit konfirmoi se në fund të marsit 1999, UÇK-ja kontrollonte thuhet të gjithë komunën e Skënderajt, duke përfshirë Izbicën, Turëcin, Klladërnice, dhe Qirezit, dhe se "vija e frontit" midis UÇK-së dhe RFJ-së/Serbisë kalonte nëpër Izbicë.¹⁴⁵¹ Gjithashtu, Nebojsa Bogunoviqi, zëvendëshefi i SPB-së në Mitrovicë që ishte përgjegjës për DPB-në e Skënderajt, i quajti të njëjtat fshatra bastione të UÇK-së dhe dëshmoi se MPB-ja nuk kishte qenë në gjendje të hynte në këtë zonë shumë më parë se të fillonte fushata e NATO-s.¹⁴⁵² Kjo gjithashtu konfirmohet në një raport të KVM-së, ku lexohet se më 4 mars 1999 UÇK-ja informoi verifikuesit se nuk do të pranonte praninë policore në territorin që ajo kontrollonte, konkretisht zonën në mes Skënderajt dhe Glllogocit dhe se do të sulmonte çdo kolonë policore që do të tentonte të kalonte nëpër të.¹⁴⁵³

568. Dhoma gjithashtu dëgjoi dëshmi në lidhje me pozicionet dhe lëvizjet e forcave të RFJ-së/Serbisë në komunën e Skënderajt para se të fillonte bombardimi i NATO-s. Përforcimet e PJP-së nga Serbia ishin vendosur në fabrikën e hekur-nikelit në Glllogoc që në maj 1998, kurse forcat e UJ-së dhe të MPB-së ishin të përqendruara afër fshatit Polac, i cili ndodhet pranë qytetit të

viktimave policore të terrorizmit në Kosovë); 6D1113 (Lista e policëve të zhdukur në Kosovë); 6D202 (Raport zbulimi i RDB-së, 6 janar 1999), f. 2.

¹⁴⁴⁶ Petar Damjanac, T. 23738 (5 mars 2008).

¹⁴⁴⁷ Bislim Zyrapit, T. 5940–5941 (6 nëntor 2006), T. 6020 (7 nëntor 2006); Sllagjan Pantiq, T. 23674–23675, 23692 (5 mars 2008). *Shih gjithashtu* Petar Damjanac, T. 23738–23739 (5 mars 2008); Dragan Paunoviq, T. 21873–21881 (7 shkurt 2008), T. 21908–21911 (8 shkurt 2008); 6D700 (Urdhër i PrK-së, 24 shtator 1998).

¹⁴⁴⁸ Klaus Naumann, T. 8263–8266, 8277–8280 (13 dhjetor 2006), P1767 (shënime të intervistave të Prokurorisë), para. 28. *Shih gjithashtu* Petar Damjanac, T. 23740–23742 (5 mars 2008), T. 23779–23780 (6 mars 2008).

¹⁴⁴⁹ Radojko Stefanoviq, T. 21648–21650 (5 shkurt 2008); 4D332 (Urdhër i Armatës së 3-të, 27 janar 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 2.

¹⁴⁵⁰ P2808 (Urdhër i PrK-së, 16 shkurt 1999), f. 3; 5D1178 (Urdhër i Brigadës së 125-të të Motorizuar, 21 shkurt 1999), f. 1. Sipas John Crosland-it, i cili ishte atashe ushtarak në ambasadën e Mbretërisë së Bashkuar në atë kohë, UÇK-ja e kishte shtabin në Vojnikë dhe Likoc. Crosland-i gjithashtu dëshmoi se "serbët" kishin të dhëna të mira për UÇK-në. John Crosland, T. 9898–9899 (8 shkurt 2007), P2645 (deklarata e dëshmitarit e datës 31 tetor 2006), para. 22.

¹⁴⁵¹ Bislim Zyrapit, T. 5990–5991 (7 nëntor 2006), T. 6242–6244 (9 nëntor 2006); P2447 (hartë që tregon pozicionet e UÇK-së). *Shih gjithashtu* IC105 (Hartë e shënuar nga Zyrapit që tregon pozicionet e UÇK-së).

¹⁴⁵² Nebojsa Bogunoviq, T. 25128 (10 prill 2008), 6D1614 (deklarata e dëshmitarit e datës 2 prill 2008), para. 84.

¹⁴⁵³ 6D112 (Raport i OSBE-së në lidhje me përmbushjen e kushteve nga palët, 12 mars 1999), f. 2. *Shih gjithashtu* Petar Damjanac, T. 23770–23771 (6 mars 2008).

Skënderajt.¹⁴⁵⁴ Sipas të Akuzuarit Llazareviq, operacionet e përbashkëta të UJ-së dhe MPB-së në vitin 1999 ishin shumë më pak të gjera se në vitin 1998 dhe u zhvilluan në "vatrat" e UÇK-së si zona e Drenicës dhe zona e gjerë e maleve të Çiçavicës. Në këto operacione, MPB-ja hyri në luftim të drejtpërdrejtë me UÇK-në, kurse UJ-ja ofroi "manovrimin, lëvizjen, dhe mbështetjen me zjarr."¹⁴⁵⁵

569. Lubisha Dikoviqi, i cili ishte komandant i Brigadës së 37-të të Motorizuar të UJ-së, zona e përgjegjësisë e së cilës përfshinte Drenicën, dëshmoi se një grup luftarak i brigadës së tij, Grupi Luftarak 37, arriti më 7 mars 1999, kurse pjesa tjetër e brigadës, e përforcuar me rreth 100 deri 150 vullnetarë, iu bashkua grupit në fillim të prillit.¹⁴⁵⁶ Grupi luftarak fillimisht u ngarkua me detyrë të stërvitej intensivisht në kazermën e Mitrovicës dhe në rrethinë. Meqenëse grupi luftarak u sulmua nga UÇK-ja që nga momenti i mbërritjes, ai u urdhërua nga Komanda e Korpunit të Prishtinës që të vepronte.¹⁴⁵⁷

570. Dragan Zhivanoviqi, komandant i Brigadës së 125-të të Motorizuar, e cila në atë kohë gjithashtu ishte në atë zonë, dëshmoi se në gjysmën e dytë të marsit 1999 u shtua intensiteti i sulmeve të UÇK-së kundër forcave të UJ-së në Drenicë.¹⁴⁵⁸ Më 18 mars 1999, i Akuzuari Llazareviq përpiloi një plan veprimi për mposhtjen e UÇK-së në sektorin e Drenicës veriore dhe Podujevës.¹⁴⁵⁹ Më 19 mars, Komanda e Përbashkët lëshoi një urdhër që i udhëzonte njësitë e Brigadës së 37-të të Motorizuar, së bashku me njësitë e Brigadës së 125-të të Motorizuar dhe njësitë e PJP-së nga Mitrovica dhe Peja, që të sulmonin UÇK-në përgjatë vijës së fshatrave Mikushnicë, Prekaz i Poshtëm, Polac, diku rreth tri kilometra nga Qirezi.¹⁴⁶⁰ Sipas raportit ditor mbi operacionet të Dikoviqit të datës 20 mars 1999, njësitë e Brigadës së 37-të të Motorizuar ishin angazhuar në "shtypjen e terrorizmit përgjatë vijës së fshatrave Balincë, Lipovec, Polac... me urdhër të Komandantit të PrK-së."¹⁴⁶¹ Forcat e përbashkëta arritën në atë zonë diku me 20 ose 21 mars 1999. Ata nuk panë civilë në atë kohë. Në atë operacion u përdorën gjashtë tanke për të shkatërruar

¹⁴⁵⁴ Abdullah Salihu, T. 1990 (21 gusht 2006), P2255 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 tetor 2000), f. 3; Lubisha Dikoviq, T. 19907, 19957 (10 dhjetor 2007); Petar Damjanac, T. 23742–23744 (5 mars 2008), T. 23807–23810, 23820 (6 mars 2008). *Shih gjithashtu* P3116 (Plani i DPB-së së Gllgocit për parandalimin e terrorizmit, 4 dhjetor 1998), f. 4; 6D1416 (Plani i veprimit i PrK-së, 18 mars 1999).

¹⁴⁵⁵ P950 (intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 218–220.

¹⁴⁵⁶ Lubisha Dikoviq, T. 19870–19872 (10 dhjetor 2007), T. 19987–19995 (11 dhjetor 2007). *Shih gjithashtu* 3D680 (Urdhër i Shtabit të Përgjithshëm për Ndryshimin e Vartësisë së Brigadës së 37-të të Motorizuar të Armatës së 2-të, 6 mars 1999).

¹⁴⁵⁷ Lubisha Dikoviq, T. 19926–19931, 19939–19940 (10 dhjetor 2007); P2039 (Raport i Operacioneve të Brigadës së 37-të të Motorizuar, 20 mars 1999).

¹⁴⁵⁸ Dragan Zhivanoviq, T. 20460–20461 (17 janar 2008); 5D1241 (Videofilmim i ceremonisë së UÇK-së).

¹⁴⁵⁹ 6D1416 (Plani i Veprimit të PrK-së, 18 mars 1999), f. 1. *Shih gjithashtu* P2808 (Urdhër i PrK-së, 16 shkurt 1999).

¹⁴⁶⁰ P3049 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 19 mars 1999), f. 4.

¹⁴⁶¹ P2039 (Raport i Operacioneve të Brigadës së 37-të të Motorizuar dërguar PrK-së, 20 mars 1999), f. 2.

llogoret e UÇK-së dhe pikat e tjera të fortifikuara të zjarrit.¹⁴⁶² Njësitë e Brigadës së 125-të të Motorizuar kishin për detyrë të ngrinin një postëkomandë në fabrikën e municionit në Skënderaj dhe në bashkëveprim me Brigadën e 37-të Motorizuar dhe forcat e MPB-së, të zhblloktonin vijën Klinë-Skënderaj dhe qytetin e Skënderajt. Më tej ata duhej të vazhdonin thyerjen e forcave të UÇK-së në zonën e Prekazit të Poshtëm dhe Polacit.¹⁴⁶³

4. Provat për krimet e akuzuara

571. Aktakuza përmban dy incidente kryesore të veçanta, konkretisht vrasjet e pretenduara në Izbicë në mars 1999 dhe dhuna seksuale, duke mos përfshirë vrasjet që lidhen me to, të cilat pretendohet se janë kryer në Qirez në prill 1999. Gjithashtu, Aktakuza përmban akuza për shpërngulje me dhunë në lidhje me sulmet e pretenduara në Vojnikë, Leqinë, Klladërnice, Turiçec, dhe Qirez.

a. Vrasjet në Izbicë

572. Siç është përmendur në paragrafin 559, Dhoma ka dëgjuar dëshmi në lidhje me incidentin në Izbicë të përshkruar në paragrafin 75(f) të Aktakuzës nga tre mbijetues, konkretisht nga Milazim Thaqi, Mustafa Draga, dhe Sadik Januzi. Sa i përket ngjarjeve pas vrasjeve, Dhoma dëgjoji dëshminë e Liri Loshit dhe gjithashtu mori mjeko-ligjor material voluminoz. Dhoma gjithashtu ka pranuar si prova disa dokumente të UJ-së në lidhje me atë zonë. Siç është përshkruar në Pjesën VII.P dhe Shtojcën A, kufomat e disa prej personave të vrarë në Izbicë më 28 mars 1999 u gjetën në një varr të përbashkët në Petrovo Sellë, në Serbinë lindore.

i. Dëshmitë e dëshmitarëve okularë

573. Në fillim të vitit 1999, Milazim Thaqi që në atë kohë ishte 53 vjeç, banonte në Burojë me gruan dhe fëmijët. Sipas tij, më 25 mars 1999, policia vendosi postblloqe afër Jashanicës, afërsisht tri kilometra nga Buroja. Të nesërmen në mëngjes, Thaqi dhe familja e tij shkuan me fshatarët e tjerë në Izbicë nga frika se "çfarë do të bënin serbët" në mungesë të verifikuesve të KVM-së.¹⁴⁶⁴ Thaqi mohoi se ishin shkuar në Izbicë sepse ashtu u kishte thënë UÇK-ja.¹⁴⁶⁵ Dhoma nuk e gjykon të besueshëm këtë mohim duke marrë parasysh dëshminë e Bislim Zyrapit i cili konfirmoi praninë e

¹⁴⁶² Lubisha Diković, T. 19947–19951 (10 dhjetor 2007).

¹⁴⁶³ P3049 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 19 mars 1999), f. 4; Dragan Zhivanović, T. 20565–20568 (18 janar 2008).

¹⁴⁶⁴ Milazim Thaqi, T. 2293 (24 gusht 2006), P2246 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 nëntor 1999), f. 2. *Shih gjithashtu* Sadik Januzi, P2525 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 6.

¹⁴⁶⁵ Milazim Thaqi, T. 2331–2332 (24 gusht 2006).

asokohshme të UÇK-ja në Izbicë dhe praktikën e saj për largimin e civilëve së bashku me luftëtarët e saj.¹⁴⁶⁶

574. Mustafa Draga i cili në vitin 1999 ishte 69 vjeç ishte nga fshati Leqinë i cili shtrihet në veriperëndim të qytetit të Skënderajt.¹⁴⁶⁷ Ai dëshmoi se më 25 mars 1999 fshati i tij dhe fshatrat përreth u granatuan, por ai nuk pa se kush e kreu granatimin. Sidoqoftë, provat e tjera në këtë çështje tregojnë se ishte UJ-ja.¹⁴⁶⁸ Të nesërmen granatimi filloi para agimit dhe fshatarët vendosën të shkonin në Izbicë sepse, sipas Dragës, ata besonin se do të ishin më të sigurt atje.¹⁴⁶⁹ Gjatë pyetjeve nga Mbrojtja, Draga mohoi se gjatë asaj periudhe kishte shumë luftëtarë të UÇK-së në male dhe pyje, por pranoi se ishin disa. Ai gjithashtu mohoi se UÇK-ja kishte qenë e pranishme në Izbicë.¹⁴⁷⁰ Mirëpo duke marrë parasysh dëshminë e lartpërmendur të Zyrapit, Dhoma nuk është bindur nga mohimi i pranisë së UÇK-së në fshat prej Dragës.

575. Më 26 mars të dy burrat panë një numër të madh të shpërngulurish që ishin mbledhur në një arë në skaj të Izbicës. Njerëzit në atë arë kishin ardhur nga fshatra të ndryshme të komunës dhe shumica ishin fëmijë, gra, dhe pleq. Djemtë e ri, duke përfshirë djemtë e Dragës, kishin shkuar në male sepse kishin menduar se do t'i vrisnin nëse rrinin aty. Granatimi dhe të shtënat u dëgjuan edhe gjatë dy netëve të tjera. Thaqi mohoi se ishte për shkak të luftimeve midis UÇK-së dhe forcave të RFJ-së/Serbisë. Ai gjithashtu dëshmoi se dëgjoi "zërat e serbëve në pyll" kur filluan të rrethonin fshatin. Ata erdhën në këmbë nga drejtimi i Jashanicës dhe Belicës. Më 27 mars, Draga pa duke u djegur fshatrat përreth Izbicës, konkretisht Buroja, Vojnika, Klina e Poshtme, Jashanica, dhe Ozrimi.¹⁴⁷¹

576. Në mëngjesin e 28 marsit 1999, Thaqi pa tre "paraushtarakë" me uniforma të zeza kur i vunë zjarrin një mullari sane rreth 150 metra nga ara në të cilën ishin mbledhur ai dhe fshatarët e tjerë. Më pas paraushtarakë shkuan te ta dhe u kërkuan para.¹⁴⁷² Pas pak, erdhën në këmbë rreth 80 të tjerë, të cilët Thaqi i përshkroi në gjyq si policë, ushtarë të UJ-së, dhe paraushtarakë që vepronin së bashku, dhe i rrethuan njerëzit në arë. Të gjithë kishin automatikë dhe shumë prej tyre kishin bomba

¹⁴⁶⁶ Bislim Zyrapit, T. 5990–5991, 6002–6003 (7 nëntor 2006), T. 6242–6244 (9 nëntor 2006); P2447 (Hartë që tregon pozicionet e UÇK-së). *Shih gjithashtu* IC105 (Hartë e shënuar nga Zyrapit që tregon pozicionet e UÇK-së).

¹⁴⁶⁷ Mustafa Draga, T. 2345 (25 gusht 2006), P2244 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 nëntor 1999), f. 2.

¹⁴⁶⁸ *Shih* para. 594–600 më poshtë.

¹⁴⁶⁹ Mustafa Draga, T. 2347–2348 (25 gusht 2006), P2244 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 nëntor 1999), f. 2–3.

¹⁴⁷⁰ Mustafa Draga, T. 2376–2380 (25 gusht 2006).

¹⁴⁷¹ Milazim Thaqi, T. 2293, 2321 (24 gusht 2006), P2246 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 nëntor 1999), f. 3; Mustafa Draga, T. 2350 (25 gusht 2006), P2244 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 nëntor 1999), f. 3.

¹⁴⁷² Milazim Thaqi, T. 2294, 2334 (24 gusht 2006), P2246 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 nëntor 1999), f. 3.

dore dhe thika të varura në uniformë. Thaqi dëgjoi njerëz të tjerë në pyll përreth arës.¹⁴⁷³ Në deklaratën e tij me shkrim në procesin *Milloseviq*, Thaqi përmendi të tre burrat si dhe forcat e tjera si policë. Ai gjithashtu tha se shumë prej tyre kishin uniforma kamuflimi të kaltra dhe sërish i quajti këto forca polici.¹⁴⁷⁴ Në procesin *Milloseviq*, Thaqi nuk u pyet se çfarë forca kishin qenë.¹⁴⁷⁵ Meqenëse gjatë dëshmisë së tij në gjyq ishte hera e parë që ai përmendi ushtarët e UJ-së në këtë kontekst, Thaqi u pyet nga Mbrojtja në lidhje me këtë aspekt të dëshmisë së tij, por ai këmbënguli se kishte qenë i saktë gjatë tërë kohës.¹⁴⁷⁶

577. Draga përshkroi të njëjtin moment dhe tha se pa rreth 200-300 "forca serbe" duke përparuar në këmbë në drejtim të arës i rrethuan njerëzit e më pas u kërkuan para. Një "polic" i kërkoi para Dragës, i cili tha se nuk kishte dhe u godit me armë.¹⁴⁷⁷ Në deklaratë Draga shprehet se disa nga këto forca kishin uniforma kamuflimi të gjelbra, kurse të tjerët uniforma kamuflimi të kaltra, por të gjithë kishin fjalën "Milicija" në mëngë të uniformave afër supeve, dhe se të gjithë ishin pjesëtarë të policisë.¹⁴⁷⁸ Gjithsesi gjatë dëshmisë së tij në gjyq, Draga tha se ishin forca policore dhe ushtarake, por ai dhe njerëzit përreth tij nuk guxuan t'i shikonin. Kur u pyet më tej nga Prokuroria, ai tha se burrat më afër tij, ata që mund të shihje, kishin uniforma kamuflimi të gjelbra.¹⁴⁷⁹ Gjatë pyetjeve nga Mbrojtja, ai tha se nuk e dinte se çfarë ishte shkruar në deklaratë dhe se vetëm kishte thënë se forcat në fjalë ishin forca policore.¹⁴⁸⁰

578. Pasi u morën paratë njerëzve në arë, ata i ndanë burrat nga gratë dhe fëmijët dhe i detyruan të uleshin në rrugë në katër radhë. Grave u thanë se të gjitha do të shkonin në Shqipëri. Thaqi u shkëlmuar dhe pa një djalë të ri që e goditën me kondak pushke. Nga gjithsej mbi 150 burra që ishin ulur në rrugë, Thaqi ishte ndër më të rinjtë, meqenëse të tjerët ishin mbi moshën 50 vjeç.¹⁴⁸¹ Njëri që dukej se ishte komandant, ecte poshtë e lart duke u dhënë urdhra të tjerëve. Herë pas here ai tallej me ta duke i pyetur "Ku është NATO-ja tani? Ku është Klintoni?" Ai gjithashtu i urdhëroi

¹⁴⁷³ Thaqi tha se 25 nga 80 burrat kishin uniforma kamuflimi të kaltra, kurse të tjerët ishin të veshur si "paraustarakë," gjegjësisht, kishin "kapela me syze." Sipas tij ishte edhe një grup i tretë me pasur uniforma të rregullta ushtarake. Ai gjithashtu përmendi një grup tjetër burrash me shami të zeza rreth qafe. Milazim Thaqi, T. 2295–2296, 2325 (24 gusht 2006).

¹⁴⁷⁴ Milazim Thaqi, P2246 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 nëntor 1999), f. 3–4.

¹⁴⁷⁵ P2447 (transkript nga *Prokurori kundër Milloseviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T).

¹⁴⁷⁶ Milazim Thaqi, T. 2325 (24 gusht 2006).

¹⁴⁷⁷ Mustafa Draga, T. 2352–2353 (25 gusht 2006), P2244 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 nëntor 1999), f. 3–4.

¹⁴⁷⁸ Mustafa Draga, P2244 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 nëntor 1999), f. 3. Dhoma tërheq vëmendjen në provat e mëhershme se uniformat me fjalën "Milicija" që do të thotë "policia" u hoqën në vitin 1997 dhe u zëvendësuan me uniforma që kishin fjalën "Policija." Sidoqoftë, Dhoma gjithashtu vëren se ka marrë prova se uniformat e vjetra vazhduan të përdroreshin në vitin 1998 dhe madje edhe në vitin 1999. *Shih* Nën pjesën VI.A.3.

¹⁴⁷⁹ Mustafa Draga, T. 2351–2352 (25 gusht 2006).

¹⁴⁸⁰ Mustafa Draga, T. 2399–2400 (25 gusht 2006).

¹⁴⁸¹ Milazim Thaqi, P2246 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 nëntor 1999), f. 3; Mustafa Draga, T. 2351–2354 (25 gusht 2006), P2244 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 nëntor 1999), f. 3–4.

burrat t'i hiqnin plisat, t'i hidhnin në tokë e pastaj t'i vinin plisat me baltë përsëri në kokë. Gjithashtu ata u detyruan të bënin përshëndetjen serbe me tre gishta lart. Një nga policët i vuri thikën në fyt duke i thënë se ishte thikë e mirë për të prerë fytyrën.¹⁴⁸² Sipas deklaratës së Thaqit, ky njeri ishte "polic" i moshës rreth 27 vjeç dhe kishte uniformë kamuflimi ngjyrë të gjelbër ose ulliri. Ai kishte emblema në të dy krahët afër supeve dhe kishte pasur armë. Ai gjithashtu kishte y radio në gjoks dhe fliste vazhdimisht me to.¹⁴⁸³ Kur bëri përshkrimin e këtij njeriu në gjyq, Thaqi tha se emblemat në krahë ishin të "ushtarëve jugosllavë." Kur u pyet se pse nuk e kishte thënë këtë në deklaratat e tij të mëhershme, dhe pse e kishte quajtur këtë individ "polic," Thaqi tha se ky person kishte uniformë me ngjyra jugosllave dhe nuk ishte polic. Më tej ai tha se nuk njihnte këtë njeri, por se ai fliste serbisht dhe duhej të ketë qenë ushtar.¹⁴⁸⁴ Nga ana tjetër përshkrimi i të njëjtit njeri në deklaratën e Dragës jep se ai ishte pak më i vjetër se të tjerët dhe se kishte pasur uniformë kamuflimi të kaltër dhe helmetë të kaltër.¹⁴⁸⁵ Në dëshminë e tij me gojë, Draga tha se personat që i ndanë kishin uniforma kamuflimi të gjelbra dhe se njëri prej tyre kishte uniformë të zezë. Gjithashtu, ai përsëriti se kishte frikë t'i shikonte dhe se nuk u kushtoi vëmendje uniformave të tyre.¹⁴⁸⁶ Mbrojtja i bëri Dragës pyetje të tjera në lidhje me personin dhe ai tha se nuk e pa atë apo uniformën e tij me vëmendje. Përgjithësisht ai tha të njëjtën gjë për forcat në Izbicë, por megjithatë këmbënguli se forcat përbëheshin nga policia dhe ushtria.¹⁴⁸⁷

579. Më pas personi që komandonte i numëroi burrat shqiptarë kosovarë, i ndau në dy grupe dhe i nisi në dy drejtime duke u thënë njerëzve të tij se i dinin "detyrat" e veta. Thaqi ishte në grupin më të vogël me rreth 33 vetë, kurse Draga dhe Januzi në grupin më të madh me rreth 70 vetë. Draga mbante mend emrat e 14 burrave të tjerë në grupin e tij, konkretisht Rustem Draga, Hajriz Draga, Ali Draga, Cen Draga, Murat Draga, Ismet Draga, Idriz Shala, Zymer Shala, Sali Shala, Halim Shala, Kujtim Shala, Smajl Çela, Metush Çela, dhe Rexhë Çela.¹⁴⁸⁸ Me përjashtim të Kujtim Shalës, të gjithë të tjerët janë në Listën F të Aktakuzës.¹⁴⁸⁹

¹⁴⁸² Milazim Thaqi, P2246 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 nëntor 1999), f. 3–4; Mustafa Draga, T. 2352, 2355 (25 gusht 2006), P2244 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 nëntor 1999), f. 4. *Shih gjithashtu* Sadik Januzi, P2525 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 6–7.

¹⁴⁸³ Milazim Thaqi, P2246 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 nëntor 1999), f. 4.

¹⁴⁸⁴ Milazim Thaqi, T. 2297, 2313–2317 (24 gusht 2006).

¹⁴⁸⁵ Mustafa Draga, P2244 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 nëntor 1999), f. 4.

¹⁴⁸⁶ Mustafa Draga, T. 2355 (25 gusht 2006).

¹⁴⁸⁷ Mustafa Draga, T. 2386–2387 (25 gusht 2006).

¹⁴⁸⁸ Milazim Thaqi, P2246 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 nëntor 1999), f. 4; Mustafa Draga, T. 2353–2354 (25 gusht 2006), P2244 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 nëntor 1999), f. 4; Sadik Januzi, P2525 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 7. Dhoma vëren se deklarata e Dragës gjithashtu përmban edhe emrat "Sofije Draga" dhe "Zade Draga" midis burrave të cilët ishin me të kur u ekzekutuan. Sidoqoftë, këta dy emra i referohen dy grave të cilat, sipas Dragës dhe provave të tjera, u vranë po atë ditë, por nuk ishin në grupin e burrave që u morën me Dragën. Siç tregohet më poshtë, vetë Draga dëshmoi se e pa kufomën e "Zade Dragës" më vonë,

580. Grupit të Thaqit i thanë se ata do të shkonin në Pejë. Pastaj ata u morën në rresht për dy nga një prej "policëve" me uniformë kamuflimi të gjelbër me doreza të zeza. Ai kishte automatik dhe thika dhe një sëpatë të lidhur në uniformë. Pas rreth 200 metrash, ata erdhën pranë një kanali uji dhe "polici" i urdhëroi si grup që të ndalonin dhe të gjunjëzoheshin, gjë që ata e bënë në dy radhë. Thaqi ishte në radhën e parë, me një radhë tjetër burrash pas tij. Të gjithë ishin me fytyrë drejt pyllit, i cili ishte vetëm disa metra larg tyre. Më pas "polici" hapi zjarr drejt burrave, duke shkrepur tri breshëri nga automatiku i tij.¹⁴⁹⁰

581. Dy burra pas Thaqit u rrëzuan dhe u përplasën me të duke e rrëzuar përtokë dhe ranë mbi të duke e mbuluar plotësisht. Njëri prej tyre ishte kushëriri i tij, Ukë Uka, 74-vjeçar nga Buroja, kurse tjetri ishte Isuf Shala, 63-vjeçar gjithashtu nga Buroja. Të dy janë në listën e viktimave në Aktakuzë. Thaqi dëshmoi se më vonë pa vrima nga plumbat në rroba, por ai vetë nuk u godit apo plagos.¹⁴⁹¹ Pas pak minutash, ai dëgjoi rënkime që vinin nga një njeri të cilin ai e njohu se ishte Demush Asllani nga Izbica, i cili vdiq pas pak çastesh. Në atë moment, Shaqir Halili nga Vojnika i tha Thaqit të mos lëvizte dhe ai qëndroi ashtu edhe për një gjysmë ore. Gjatë kësaj kohe, Thaqi dëgjoi krisma automatiku që vinin nga drejtimi nga ishte dërguar grupi tjetër i burrave.¹⁴⁹² Rreth orës 11:30, ai, Halili, dhe një mbijetues tjetër ikën në pyll, prej ku panë rreth 100 policë që ishin afërsisht 100 metra më larg.¹⁴⁹³

582. Grupi i dytë i burrave, përfshirë edhe Dragën e Januzin, ecën rreth 500 metra përpjetë kodrës prej ku Draga pa tanket në pyllin e afërt. Policët ishin afërsisht një për çdo pesë burra të kapur. Një nga policët u bërtiti burrave të ndaleshin dhe të ktheheshin nga ai. Kur kthye nga ai, Draga pa rreth 30 policë që ishin afër tri metra më larg, të cilët hapën zjarr. Draga ishte diku në mes të grupit; Hajriz Draga ishte në të djathtë të tij. Me të filluar të shtënat, ai u rrëzua përtokë dhe Hajriz Draga u rrëzua mbi të. Krismat e automatikut vazhduan për rreth dy minuta. Pasi ndaluan të

kurse Dhoma ka marrë prova të tjera në lidhje me Sofije Dragën. Rrjedhimisht Dhoma mendon se përfshirja e emrave të këtyre dy femrave ndërmjet emrave të burrave duhet të ketë qenë gabim i bërë nga ata që kanë marrë deklaratën nga Draga.

¹⁴⁸⁹ Dhoma vëren një mospërputhje midis versionit shqip të deklaratës së Dragës, ku përmendet "Smajl Çela" dhe versionit anglisht ku përmendet "Smajc Çela." Meqenëse "Çela" nganjëherë shkruhet "Qelaj" dhe meqenëse versioni shqip është me gjasë më i saktë, Dhoma mendon se "Smajl Çela" është në fakt emri i viktimës në listë "Ismajl Qelaj." Për të njëjtat arsye, "Metush Çela" dhe "Rexhë Çela" janë në listën e viktimave si "Metush Qelaj" dhe "Rexhep Qelaj."

¹⁴⁹⁰ Milazim Thaqi, T. 2297–2298 (24 gusht 2006), P2246 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 nëntor 1999), f. 4–5.

¹⁴⁹¹ Milazim Thaqi, P2246 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 nëntor 1999), f. 5; P227 (Fotografi të këmishës së Thaqit me vrimat nga plumbat).

¹⁴⁹² Milazim Thaqi, T. 2299–2304 (24 gusht 2006), P2246 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 nëntor 1999), f. 5, P2246 (deklarata e dëshmitarit e datës 20 tetor 2001), f. 2–3; P244 (Fotografi ajrore që tregon vende të ndryshme të ekzekutimit të më shumë se 150 vetëve).

¹⁴⁹³ Milazim Thaqi, T. 2298–2300 (24 gusht 2006), P2246 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 nëntor 1999), f. 5.

shtënat, Draga i cili nuk ishte plagosur, qëndroi pa lëvizur rreth 20-30 minuta dhe gjatë asaj kohe dëgjoi krisma automatiku nga njëfarë largësie dhe pa "policë" duke u vënë zjarrin shtëpive në Izbicë. Ai dëgjoi Hajriz Dragën që kërkonte ujë, i cili ishte plagosur dhe vdiq pak më vonë.¹⁴⁹⁴ Januzi përshkroi të njëjtën ngjarje në deklaratën e dëshmitarit dhe shpjegoi se kishte shpëtuar sepse ishte rrëzuar në tokë para se të qëllohej dhe sepse mbi të ranë tri kufoma.¹⁴⁹⁵

583. Kur menduan se nuk kishte më rrezik, Draga dhe Januzi shkuan duke u zvarritur deri në pyll dhe u takuan me mbijetuesit e tjerë. Januzi tregoi konkretisht se e kishte parë Dragën dhe, dy ditë më vonë, edhe Thaqin. "Policia" u largua nga Izbica më 30 mars. Mëngjesin e nesërm erdhën njerëz për të varrosur të vdekurit. Përveç burrave të ekzekutuar në këtë mënyrë, në arë afër traktorëve u gjetën edhe kufomat e dy pleqve dhe dy plakave. Sipas Dragës, ata u vranë sepse nuk ishin në gjendje të ecnin. Njëra nga këto viktime ishte një grua 70-vjeçare me emrin Zojë Osmanaj, e cila u gjet e djegur në një rimorkio.¹⁴⁹⁶ Draga gjithashtu identifikoi Shaban Musliun dhe Zeqir Salihin, dhe dëshmoi se kufoma e katërt ishte një grua nga Vojnika. Ai gjithashtu përmendi se kishte parë edhe dy viktime të tjera femra, konkretisht Zade Dragaj dhe Aishe Dragaj, të cilat sipas tij u vranë "gjatë rrugës."¹⁴⁹⁷ Dëshmitë e të tre mbijetuesve tregojnë se gjithsej 14 vetë mbetën gjallë në këtë incident.¹⁴⁹⁸

584. Nga vendi ku ishte fshehur në pyll, Thaqi pa zjarret në një fshat rreth dy deri tri kilometra larg dhe supozoi se i kishin vënë policët të cilët ata i kishin parë në pyll. Në orën 19:00 atë mbrëmje, ai dhe Halili u nisën për në shtëpinë e Halilit në Vojnikë. Kur kaluan pranë shkollës së Izbicës, ata panë policë në të dhe përreth saj. Kur mbërritën në Vojnikë, e gjetën shtëpinë e Halilit duke u djegur. Fshati ishte tërësisht i braktisur me përjashtim të dy plakave.¹⁴⁹⁹

585. Më 31 mars, Thaqi mësoi se "serbët" ishin larguar nga Izbica dhe se kishte filluar varrimi i viktimave organizuar nga UÇK-ja. Për këtë arsye ai shkoi në Izbicë që të ndihmonte. Atje ai pa rreth 150-200 njerëz duke hapur varre dhe duke bartur kufomat.¹⁵⁰⁰ Varrimi u filmua nga një shok i Liri Loshit.¹⁵⁰¹ Sipas Thaqit dhe Dragës, në atë vend u varrosën gjithsej 144-147 vetë, kurse

¹⁴⁹⁴ Mustafa Draga, T. 2355–2358 (25 gusht 2006), P2244 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 nëntor 1999), f. 4–5.

¹⁴⁹⁵ Sadik Januzi, P2525 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 7.

¹⁴⁹⁶ Mustafa Draga, T. 2359–2360 (25 gusht 2006), P2244 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 nëntor 1999), f. 5; Sadik Januzi, P2525 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 7.

¹⁴⁹⁷ Mustafa Draga, T. 2360 (25 gusht 2006).

¹⁴⁹⁸ Të 14 burrat përfshijnë Thaqin, Dragën, dhe Januzin, si dhe 11 burra të tjerë.

¹⁴⁹⁹ Milazim Thaqi, P2246 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 nëntor 1999), f. 5–6.

¹⁵⁰⁰ Milazim Thaqi, P2246 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 nëntor 1999), f. 6.

¹⁵⁰¹ Liri Loshi, P2436 (Paketa e Rregullit 92 *bis*), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 13.

kufomat e tjera u morën nga familjet e tyre dhe u dërguan tjetërkund.¹⁵⁰² Sadik Xhemajli përpiloi një listë të hollësishme të të vrarëve.¹⁵⁰³ Çdo varr u shënua me nga një shkop druri me numër.¹⁵⁰⁴ Kur u pyet se a pa të rinj midis të vrarëve, Draga tha se ishin disa të rinj, por asnjë prej tyre nuk ishte pjesëtar i UÇK-së.¹⁵⁰⁵ Pas varrimit, ata që mbetën shkuan në male. Sipas Dragës, më 10 maj 1999, "serbët" vranë edhe burra të tjerë në Izbicë. Ata u varrosën në të njëjtin vend si edhe viktimat e mëhershme. Edhe kufomat e tjera të sjella nga vende të tjera u varrosën në atë vend gjatë një periudhe disamujore.¹⁵⁰⁶

586. Draga dhe qindra të tjerë qëndruan për disa javë në pyjet afër Izbicës. Nganjëherë mbetën pa ushqime me ditë të tëra.¹⁵⁰⁷ Edhe pse nuk e pa me sytë e vetë, Draga dëshmoi se e dinte se më 28 maj 1999 "policia dhe ushtria serbe" filluan zhvarrosjen e kufomave nga varreza dhe se zgjati katër ose pesë ditë. Pas zhvarrosjes, Draga shkoi atje dhe pa se asnjë nga kufomat nuk kishte mbetur, edhe pse ai gjeti gjurmë si rroba dhe një dorë të këputur.¹⁵⁰⁸ Ai dhe të tjerët u larguan nga pylli në qershor 1999 me ardhjen e forcave të NATO-s në Kosovë. Kur u kthye në fshat pa se shtëpia i ishte djegur. Familja e tij u bashkua pak më vonë me të dhe i treguan se u ishin dashur 12 ditë të shkonin këmbë deri në Shqipëri.¹⁵⁰⁹

587. Thaqi dhe familja e tij e gjetën njëri-tjetrin në Tushilë, më 7 prill 1999. Ata i treguan se kishin ecur gjashtë ditë në drejtim të Shqipërisë para se të ktheheshin mbrapa nga "serbët" dhe ishin detyruar të ecnin edhe gjashtë ditë të tjera deri në Klladërnice. Ata u kthyen në Burojë nga mesi i qershorit ku e gjetën shtëpinë e djegur dhe pronën e shkatërruar.¹⁵¹⁰ Pas pak kohësh, Thaqin e vizituan gazetarët e BBC-së. Ai i çoi në Izbicë për t'u treguar vendin e varrimit, por kur mbërritëm atje panë se kufomat ishin zhvarrosur dhe larguar. Sidoqoftë, kishin mbetur pjesë kufomash dhe eshtra. Pas disa javësh, një burrë i tregoi Thaqit se kishte qenë në male mbi vendin e varrimit rreth 28 majit 1999 dhe se e kishte parë "ushtrinë dhe policinë serbe" kur kishin larguar kufomat.¹⁵¹¹

¹⁵⁰² Mustafa Draga, P2244 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 nëntor 1999), f. 5; Milazim Thaqi, P2246 (deklarata e dëshmitarit 12 nëntor 1999), f. 6.

¹⁵⁰³ Deklarata e Dragës thotë se Sadik Xhemajli ishte komandant vendës i UÇK-së. Sidoqoftë, kur u pyet nga Mbrojtja, Draga tha se ishte bërë ndonjë gabim sepse ai kurrë nuk kishte thënë se ky person kishte qenë komandant vendës i UÇK-së. Mustafa Draga, T. 2371–2372 (25 gusht 2006), P2244 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 nëntor 1999), f. 5.

¹⁵⁰⁴ Milazim Thaqi, T. 2292–2293, 2304–2305, 2311 (24 gusht 2006), P2246 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 nëntor 1999), f. 6; Mustafa Draga, T. 2361–2362 (25 gusht 2006), P2244 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 nëntor 1999), f. 5.

¹⁵⁰⁵ Mustafa Draga, T. 2404–2405 (25 gusht 2006).

¹⁵⁰⁶ Mustafa Draga, T. 2362, 2388 (25 gusht 2006), P2244 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 nëntor 1999), f. 5.

¹⁵⁰⁷ Mustafa Draga, P2244 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 nëntor 1999), f. 5.

¹⁵⁰⁸ Mustafa Draga, T. 2362–2364, 2389–2390, 2405, 2407–2408 (25 gusht 2006).

¹⁵⁰⁹ Mustafa Draga, T. 2364–2365 (25 gusht 2006), P2244 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 nëntor 1999), f. 5.

¹⁵¹⁰ Milazim Thaqi, T. 2292 (24 gusht 2006), P2246 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 nëntor 1999), f. 6.

¹⁵¹¹ Milazim Thaqi, T. 2312, 2326–2329, 2336 (24 gusht 2006).

588. Dëshmitë e mbijetuesve të vrasjeve në Izbicë janë konfirmuar nga Liri Loshi, i cili nuk ishte i pranishëm në këto vrasje, por ai dhe shoku i tij filmuan kufomat dhe varrimin e tyre. Sipas Loshit, më 25 mars 1999, njerëzit nga komuna e Skënderajt filluan të mblidheshin në luginën e Izbicës dhe se më 26 mars aty ishin mbledhur rreth 25.000 njerëz. Gjithsesi ai shpjegoi edhe se në ditën kur i ndanë burrat nga gratë, atje ishin rreth 3.500-4.000 njerëz meqenëse shumë prej tyre kishin vendosur të shkonin në fshatin e afërt të Tushilës. Loshi ishte në Tushilë rreth asaj kohe dhe atje gjeti rreth 30.000 njerëz të shpërngulur, "99%" e të cilëve ishin civilë, por kishte edhe disa ushtarë të UÇK-së.¹⁵¹²

589. Loshi dëshmoi se kishte dëgjuar për vrasjet në Izbicë në ditën që ndodhën nga gratë dhe fëmijët që erdhën në Tushilë dhe treguan se çka kishte ndodhur. Më 29 mars, dikur nga mbrëmja kur "forcat serbe" iu afruan Tushilës, ai vendosi të shkonte në fshatin e afërt Kopiliq i Epërm. I fshehur në malet mbi fshat, ai pa "kamionë dhe tanke me ngjyrë të gjelbër të ushtrisë serbe" në "kodrën e Vojnikës." Në mbrëmjen e 30 marsit Tushila u granatua. Atë mbrëmje Loshi shkoi në Izbicë me Shaban Dragën, i cili ishte komandant i Brigadës së 112-të të UÇK-së. Kur mbërritën, ata u pritën nga Naim Rexhepi, "kryeplak i fshatit Izbicë," i cili i çoi në vendin e vrasjeve. Meqenëse ishte vonë në mbrëmje, ata vendosën të ktheheshin në mëngjes dhe të filmonin varrimin me videokamerën e Sefedin Thaqit.¹⁵¹³

590. Të nesërmen në mëngjes, Loshi u kthye në luginën e Izbicës dhe pa kufoma të shpërndara përreth në dy vende të ndryshme. Ndërsa Loshi u kujdes për njerëzit në atë zonë, Sefedin Thaqi filmoi kufomat atje ku ishin varur dhe kur u pranë varreve. Ai shkoi nga njëra kufoma te tjetra, i shoqëruar nga të afërmit e viktimave dhe të tjerë që ishin në gjendje t'i identifikonin. Kur ishte e mundur ai thoshte emrin, moshën, dhe vendbanimin e viktimave. Gjithashtu u intervistua Milazim Thaqi i cili shpjegoi çfarë i kishte ndodhur. Në tërësi, filmimi u bë gjatë dy ditëve. Ky filmim që mbështet dëshminë e Loshit, u transmetua pjesërisht në sallën e gjyqit dhe u pranua si provë.¹⁵¹⁴ Gjithashtu, Afrim Xhemajli bëri një listë të viktimave dhe ia dha Loshit. Nga 127 emrat në atë listë, 111 janë të viktimave të përfshirë në Listën F.¹⁵¹⁵

¹⁵¹² Liri Loshi, P2436 (Paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 13, P2437 (transkript nga Prokurori kundër Millosheviqit, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 9448-9450.

¹⁵¹³ Liri Loshi, T. 5355-5357 (26 tetor 2006), P2436 (Paketa e Rregullit 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 13, P2437 (transkript nga Prokurori kundër Millosheviqit, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 9457.

¹⁵¹⁴ Liri Loshi, T. 5355-5359 (26 tetor 2006), P2436 (Paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 13-38, P2437 (transkript nga Prokurori kundër Millosheviqit, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 9441, 9451; P232 (kasetë filmike që tregon kufomat dhe varrimin); P230 (fotografi të kufomave të gjetura në Izbicë të bëra nga filmimi); P231 (fotografi të kufomave të gjetura në Izbicë).

¹⁵¹⁵ P2436 (Paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8-9.

591. Sipas Loshit, burrat e vdekur ishin shumica të moshuar, mesatarisht të moshës 60-70 vjeç. Plagët e tyre ishin shkaktuar në shumicën e rasteve nga plumbat, dhe si rezultat fytyrat e tyre ishin të dëmtuara. Loshi konstatoi se në vendin e parë ndodheshin 60-70 kufoma dhe se ai njohu shumë prej tyre, edhe pse nuk i dinte emrat e të gjithëve. Ai dha emrat e Ilaz Bajrës, Metush Qelajt, dhe përmendi kushërinjtë e Ilaz Bajrës. Në grupin e dytë të kufomave Loshi njohu tre kushërinj të tij: 82-vjeçarin Selman Loshi; djalin e Selmanit, 50-vjeçarin Jashar Loshi; dhe djalin e Jasharit, 25-vjeçarin Sami Loshi. Gjithashtu Loshi pa kufomën e një femre e cila duke se ishte djegur në një traktor.¹⁵¹⁶

592. Loshi dëshmoi se përgjegjës për varrimin ishin Naim Rexhepi, Afrim Xhemajli, dhe Sadik Xhemajli.¹⁵¹⁷ Ai gjithashtu konfirmoi praninë e pjesëtarëve të UÇK-së, por këmbënguli se asnjë nga burrat e vrarë më 28 mars nuk ishte në UÇK. Kufomat u varrosën në 127 varre të hapura shumë afër luginës në të cilën popullata e shpërngulur ishte mbledhur para arritjes së forcave të RFJ-së/Serbisë. Ndërmjet 127 kufomave të varrosura ishin edhe disa kufoma të tjera të gjetura në vende të tjera brenda Izbicës, përfshirë dy ushtarë të UÇK-së (Ajet Beqiri dhe Zaim Bajrami) të vrarë më 27 mars 1999. Loshi vlerësoi se numri i përgjithshëm i viktimave nga dy vendet e ekzekutimit ishte afërsisht 110-120.¹⁵¹⁸

593. Loshi qëndroi në Izbicë edhe një muaj pas varrimit. Ai u largua nga fshati më 3 maj 1999 dhe shkoi në Shqipëri përmes Malit të Zi. Me të mbërritur atje, u dha kopje të kasetës filmike Qeverisë së Përkohshme të Kosovës dhe përfaqësuesit të CNN-it në Tiranë. Më 19 maj 1999, ai i dh kasetën filmike origjinale një hetuesi të Tribunalit që e takoi në Tiranë.¹⁵¹⁹ Kur u kthye në Izbicë në qershor 1999, nuk gjeti as varret, as kufomat. I treguan se forcat e RFJ-së/Serbisë i kishin larguar kufomat pare hyrjes së forcave të NATO-së në Kosovë.¹⁵²⁰

¹⁵¹⁶ Liri Loshi, T. 5360–5363 (26 tetor 2006), P2437 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 9428–9429, 9482–9483.

¹⁵¹⁷ Liri Loshi, P2436 (Paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 15.

¹⁵¹⁸ Liri Loshi, T. 5364–5369, 5392–5394 (26 tetor 2006), P2436 (Paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 37, P2437 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 9438–9439. Sipas Loshit, vetëm Ajet Beqiri, njëri nga pjesëtarët e UÇK-së të vrarë më 27 mars dhe të varrosur në këtë vend, kishte uniformë të UÇK-së kur ishte varrosur. Kur u ballafaqua me deklaratën e vet e cila përmban një tabelë me përshkrimet e të gjitha kufomave dhe, më konkretisht, me përshkrimin e dy kufomave rrobat e të cilave mund të përshkruhen si pjesë uniforme, Loshi shpjegoi se përshkrimet nuk i kishte bërë ai vetët, por hetuesi që pa kasetën filmike siç shpjegohet në deklaratën e tij, dhe ai nuk ishte i sigurt se rrobat e dy burrave ishin uniforma. Liri Loshi, T. 5397–5403 (26 tetor 2006); P2436 (Paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 34, P2437 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 9478–9479, 9483. Dhoma e ka analizuar filmimin në fjalë me kujdes dhe vëren se të dy përshkrimet i referohen një kufome, atë të një plaku me pallto të gjelbër, e cila nuk duket të jetë uniforme. Gjithashtu, burri në fjalë është tepër i moshuar për të qenë ushtar i UÇK-së.

¹⁵¹⁹ Liri Loshi, P2436 (Paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 14–15.

¹⁵²⁰ Liri Loshi, T. 5369–5370 (26 tetor 2006).

ii. Veprimet e UJ-së/MPB-së në atë zonë në kohën kur ndodhën vrasjet

594. Disa urdhra të UJ-së dhe raporte luftarake të pranuar si prova konfirmojnë se në kohën kur ndodhën vrasjet në Izbicë, UJ-ja dhe MPB-ja po kryenin një operacion të përbashkët në komunën e Skënderajt. Më 22 mars 1999, Komanda e Përbashkët lëshoi një "vendim" për shkatërrimin e "FTSH-së" në sektorin e Drenicës së Poshtme. "Vendimi" parashikonte një sulm në pjesën lindore të Skënderajt në vijën e fshatrave Polac-Tërstenik-Prellloc-Likoshan. Forcat e UJ-së të cilat morën pjesë në këtë sulm në komunën e Skënderajt ishin Brigada e 37-të e Motorizuar dhe Brigada e 125-të e Motorizuar. Në operacion morën pjesë edhe shtatë kompani të PJP-së, dy nga të cilat duhej të koordinoheshin me Brigadën e 37-të të Motorizuar.¹⁵²¹

595. Më 24 mars 1999 Komanda e Përbashkët lëshoi një urdhër tjetër për njësitë e UJ-së që t'a ndihmonin MPB-së në thyerjen dhe shkatërrimin e "FTSH-së" në sektorin e Drenicës ("Operacioni Drenica"). Sipas urdhrit, objektivi ishte që "FTSH-ja" të izolohej në sektorin e përgjithshëm të disa fshatrave, përfshirë Klladërnice, Turiçecin, Vojnikën, dhe Burojën.¹⁵²² Dikoviqi veprroi sipas këtij urdhri, duke e lëvizur postëkomandën e tij në zonën e Runikut, fshat në pjesën veriperëndimore të komunës së Skënderajt. Ai gjithashtu angazhoi grupin e tij luftarak përgjatë vijës së fshatrave Runik, Vitak, Klladërnice, Vojnikë, dhe Burojë, siç është shënuar në urdhër dhe në raportet ditore të operacioneve të brigadës.¹⁵²³ Grupi luftarak ishte në atë zonë për disa ditë dhe ndaloi në një pikë mbi Vojnikë.¹⁵²⁴ Dikoviqi dëshmoi se grupi luftarak e sulmoi UÇK-në në zonën e paracaktuar në mbështetje të MPB-së dhe ka të ngjarë të ketë përdorur tanket për të shkatërruar pikat e zjarrit të UÇK-së të vendosura përgjatë vijës së sulmit.¹⁵²⁵

596. Sipas të njëjtit urdhër, njësitë e tjera të UJ-së që kishin prani të konsiderueshme në atë zonë gjatë "Operacionit Drenica" ishin Brigada e 125-të e Motorizuar dhe Brigada e 15-të e Blinduar. E para kishte për detyrë t'i mbështeste forcat e MPB-së në vijën e fshatrave Klinë e Epërme-Llaushë-

¹⁵²¹ Lubisha Dikoviq, T. 19879, 19955–19960, 19964–19966 (10 dhjetor 2007), T. 20018–20020 (11 dhjetor 2007); P2031 (Vendim i Komandës së Përbashkët, 22 mars 1999), f. 2–4; 5D276 (Plani i Veprimit i Komandës së PrK-së, 22 mars 1999), f. 1; P2042 (Raport Operativ i Brigadës së 37-të të Motorizuar dërguar PrK-së, 23 mars 1999); P2043 (Raport Operativ i Brigadës së 37-të të Motorizuar dërguar PrK-së, 25 mars 1999); 5D463 (Raport Operativ i Brigadës së 125-të të Motorizuar dërguar PrK-së, 24 mars 1999); IC159 (Hartë e shënuar nga Dikoviqi për të treguar lëvizjet e forcave të tij dhe forcave të tjera të UJ-së dhe vija që është arritur gjatë operacionit); IC160 (Hartë e shënuar nga Dikoviqi që tregon pozicionet e UÇK-së); IC161 (Hartë e shënuar nga Dikoviqi që tregon pozicionet e UÇK-së në lidhje me vijën që kishte arritur njësitë e Dikoviqit).

¹⁵²² Lubisha Dikoviq, T. 19981 (11 dhjetor 2007); P1968 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 24 mars 1999).

¹⁵²³ Lubisha Dikoviq, T. 19969–19972 (10 dhjetor 2007); P1968 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 24 mars 1999), f. 4–5; P2043 (Raport Operativ i Brigadës së 37-të të Motorizuar dërguar PrK-së, 25 mars 1999); P2045 (Raport Operativ i Brigadës së 37-të të Motorizuar dërguar PrK-së, 27 mars 1999).

¹⁵²⁴ Lubisha Dikoviq, T. 19887–19888 (10 dhjetor 2007); IC157 (Hartë e shënuar nga Dikoviqi që tregon lëvizjet e brigadës së tij).

¹⁵²⁵ Lubisha Dikoviq, T. 19971–19977 (10 dhjetor 2007).

Turiçec-Krushec-Rezallë, Kopiliq i Poshtëm në jug të Izbicës.¹⁵²⁶ Zhivanoviçi dëshmoi se dy nga grupet e tij luftarake mbërritën në fshatin Rezallë, por ndaluan aty dhe pastaj u kthyen në pikën fillestare në zonën e Klinës së Epërme. Sipas Zhivanoviçit, gjatë këtij operacioni forcat e UÇK-së ishin të pranishme, midis të tjerash në fshatrat Izbicë, Vojnikë, Burojë, Llaushë, dhe Tushilë. Në atë kohë, forcat e përgjithshme të UÇK-së ishin më të shumta në numër se 700 trupat e UJ-së dhe të MPB-së në atë zonë.¹⁵²⁷

597. Sipas raportit ditor operativ të 27 marsit 1999 të Brigadës së 37-të të Motorizuar, gjatë këtij operacioni u hap zjarr kundër Grupit Luftarak 37 përgjithësisht prej zonës veriperëndimore të Drenicës, që ishte zonë nën kontrollin e UÇK-së duke përfshirë edhe Izbicën.¹⁵²⁸ Raporti operativ ditor i 28 marsit bënte të ditur se në 24 orët e shkuara UÇK-ja kishte hapur zjarr mbi grupin luftarak në gjithë zonën e lëvizjes dhe se zjarri më i fuqishëm kishte ardhur nga Vojnika.¹⁵²⁹ Dikoviçi shpjegoi se qëllimi i përgjithshëm ishte neutralizimi i UÇK-së e jo sulmimi apo pushtimi i fshatrave. Sidoqoftë, ai shpjegoi se, nëse UÇK-ja sulmonte nga fshatrat, atëherë njësitë e tij hapnin zjarr kundër tyre për t'i neutralizuar. Pozicionet e zjarrit të artilerisë gjithmonë ishin jashtë zonave të banuara, meqenëse kjo ishte mënyra e vetme që ato të funksionin.¹⁵³⁰ Dikoviçi mohoi se kishte hyrë në Izbicë apo Vojnikë me njësitë e veta dhe gjithashtu mohoi se njësitë e tij kishin hapur zjarr mbi Izbicën. Ata ishin ndalur së paku një kilometër nga Izbica në një vend prej të cilit nuk ishin në gjendje të shihnin fshatin.¹⁵³¹

598. Raporti i 28 marsit gjithashtu shënon se "gjatë operacioneve të ardhshme në sektorin e fshatit Vojnikë presim të shohim strehimore me mijëra refugjatë civilë."¹⁵³² Si rrjedhojë Dikoviçi kërkoi udhëzime se "çfarë të bëjë me ta sepse njësia nuk kishte as njerëz e as mjete që t'i izolojë strehimoret dhe t'i nxjerrë refugjatët jashtë zonës [së veprimeve luftarake]."¹⁵³³ Ai shpjegoi se vetëm shprehu një mundësi të cilën e konsideronte reale duke marrë parasysh madhësinë e forcave të UÇK-së në atë zonë dhe strategjinë e tyre për të përdorur civilët si mburojë.¹⁵³⁴ Pas kësaj kërkese

¹⁵²⁶ P1968 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 24 mars 1999), f. 5.

¹⁵²⁷ Dragan Zhivanoviçi, T. 20467–20470 (17 janar 2008); IC164 (Hartë e shënuar nga Zhivanoviçi që tregon pozicionet e forcave të Brigadës së 125-të të Motorizuar dhe të UÇK-së); P2033 (Raport Operativ i Brigadës së 125-të të Motorizuar dërguar PrK-së, 28 mars 1999).

¹⁵²⁸ Lubisha Dikoviçi, T. 19884–19887 (10 dhjetor 2007); P2045 (Raport Operativ i Brigadës së 37-të të Motorizuar dërguar PrK-së, 27 mars 1999), f. 1; IC156 (Harta e Zyrarit e shënuar nga Dikoviçi që tregon zonën e kontrolluar nga UÇK-ja rreth Izbicës).

¹⁵²⁹ P2046 (Raport Operativ i Brigadës së 37-të të Motorizuar dërguar PrK-së, 28 mars 1999), f. 1.

¹⁵³⁰ Lubisha Dikoviçi, T. 19953–19954 (10 dhjetor 2007), T. 19981–19983, 20005–20007 (11 dhjetor 2007).

¹⁵³¹ Lubisha Dikoviçi, T. 20016–20017 (11 dhjetor 2007).

¹⁵³² P2046 (Raport Operativ i Brigadës së 37-të të Motorizuar dërguar PrK-së, 28 mars 1999), f. 2.

¹⁵³³ P2046 (Raport Operativ i Brigadës së 37-të të Motorizuar dërguar PrK-së, 28 mars 1999), f. 2.

¹⁵³⁴ Lubisha Dikoviçi, T. 19888–19889 (10 dhjetor 2007), T. 19983–19984 (11 dhjetor 2007).

nga Korpusi i Prishtinës erdhi një oficer dhe i tha Dikoviçit se në rast se do të hasnin në civilë njësia e tij duhej të ndalte të gjitha veprimet dhe të gjente rrugë të sigurtë për t'i dërguar në ndonjë zonë jashtë rrezikut. Përgjegjëse për këtë dhe për ndihmë civilëve do të ishte MPB-ja si. Kur u pyet se a kishte ndodhur kjo ndonjëherë, ai tha fillimisht se grupi i tij luftarak nuk hasi asnjëherë civilë në atë zonë.¹⁵³⁵ Sidoqoftë më vonë ai pohoi se në Izbicë "ndalëm të shtënat dhe nxorëm civilët jashtë" dhe pastaj shtoi se në atë kohë një njësi e MPB-së kishte qenë përpara tij.¹⁵³⁶ Ai e konfirmoi sërish kontaktin me civilë duke thënë se i ndaloi veprimet sepse forcat kishin hasur në civilë në zonën e Izbicës dhe se, për këtë arsye, ai u kthye mbrapa në drejtim të Skënderajt në vend që të vazhdonte përpara për në Burojë, siç ishte parashikuar.¹⁵³⁷

599. Sllagjan Pantiqi, polic nga fshati Runik në pjesën veriperëndimore të komunës, konfirmoi dëshminë e Dikoviçit së paku sa i përket faktit se disa nga forcat e UJ-së nuk hynë në Vojnikë e as nuk shkuan në Burojë. Pantiqi u ngarkua nga shefi i tij si udhërrëfyes për forcat e PJP-së dhe UJ-së gjatë këtij operacioni.¹⁵³⁸ Më 25 mars 1999 ai dhe një kompani e PJP-së, së bashku me një tank të UJ-së dhe ekuipazhin e tankut i përbërë nga ushtarë të UJ-së u nisën nga Runiku në drejtim të jugut.¹⁵³⁹ Kompania e PJP-së kishte afërsisht 100 pjesëtarë që kishin uniforma të gjelbra me mbishkrimin "policia" që shihej qartë. Sidoqoftë, Pantiqi nuk qe në gjendje të thoshte se cila njësi e PJP-së ishte dhe nuk dinte se cilës brigadë i përkiste ekuipazhi i tankut të UJ-së.¹⁵⁴⁰ Pasi u informua nga komandanti i togës së PJP-së mbi vendmbërritjen, Pantiqi zgjodhi rrugën më të mirë. Ai nuk e mbante mend emrin e oficerit në fjalë dhe nuk e dinte se si komunikonte ai me pjesëtarët e UJ-së që merrnin pjesë në aksion.¹⁵⁴¹ Kur u pyet nga Dhoma se kush e kishte komandën e përgjithshme, fillimisht Pantiqi tha se nuk i kujtohej. Kur u pyet më shumë, ai tha se ishin tre komandantë togash brenda kompanisë së PJP-së, por ai nuk e dinte se cili prej tyre kishte komandën mbi të gjithë, përveç se komandanti i togës i cili komunikonte me të përgjithshëm printe dhe të tjerët e ndiqnin. Pantiqi gjithashtu shpjegoi se në fillim tanku shkonte paralelisht me forcat e këmbësorisë, meqenëse rruga ishte mjaft e gjerë. Më vonë, gjatë ditës së dytë dhe të tretë, tanku mbeti pas forcave.¹⁵⁴²

600. Pasi hynë në Kosterc, rreth 700-800 metra nga Runiku, forcat hasën në "llogore dhe llogore komunikuese," dhe më pas u sulmuan nga UÇK-ja. Ata iu përgjigjën zjarrit dhe luftimi zgjati rreth

¹⁵³⁵ Lubisha Dikoviç, T. 19890–19891 (10 dhjetor 2007), T. 19984–19985 (11 dhjetor 2007).

¹⁵³⁶ Lubisha Dikoviç, T. 19984–19986 (11 dhjetor 2007).

¹⁵³⁷ Lubisha Dikoviç, T. 20016 (11 dhjetor 2007).

¹⁵³⁸ Sllagjan Pantiq, T. 23676, 23683 (5 mars 2008).

¹⁵³⁹ Sllagjan Pantiq, T. 23676–23677 (5 mars 2008).

¹⁵⁴⁰ Sllagjan Pantiq, T. 23684, 23687, 23693–23694 (5 mars 2008).

¹⁵⁴¹ Sllagjan Pantiq, T. 23683–23685 (5 mars 2008).

¹⁵⁴² Sllagjan Pantiq, T. 23694–23697 (5 mars 2008).

1-3 orë. Pas mbarimit të luftimit, Pantiqi dhe forcat e tjera vazhduan dhe gjatë natës u vendosën në Mëhallën e Dervishëve. Të nesërmen u nisën në drejtim të Klladërnicsës. Kur mbërritën në skaj të fshatit, ata u kthyen në drejtim të Leqinës dhe me ta u ishte bashkua një skuadër e UJ-së prej 7-10 vetësh.¹⁵⁴³ Edhe pse dëgjoheshin krisma përreth tyre, ata nuk u angazhuan në luftime atë ditë. Në mëngjesin e 27 marsit ata u sulmuan nga drejtimi i Izbicës; ata iu përgjigjën zjarrit dhe i shpërngulën në një pozicion më të mirë në kodrën e afërt. Pas përfundimit të sulmit, ata lëvizën në drejtim të Vojnikës dhe hasën në një kolonë civilësh që lëvizte në drejtim të jugut. Pantiqi nuk ishte në gjendje të thoshte sa civilë kishin qenë, por shpjegoi se ata mund të shihnin vetëm një pjesë të rrugës e për pasojë vetëm një pjesë të kolonës; sidoqoftë, edhe ajo pjesë kishte rreth 1.000 vetë. Pak para se të hynin në Vojnikë, skuadra e UJ-së dhe tanku u kthyen mbrapsht, kurse Pantiqi dhe kompania e PJP-së vazhduan më tej në drejtim të fshatit. Pasi kaluan nëpër Vojnikë, grupi mbërriti në Burojë dhe e kaluar natën atje. Të nesërmen i morën me autobusë dhe i dërguan në Klinë, ku roli i Pantiqit si udhërrëfyes përfundoi.¹⁵⁴⁴ Pyetjes së Prokurorisë se a hynë në Izbicë forcat me të cilat kishte qenë, ai u përgjigj negativisht, duke shpjeguar se ata kishin përdorur rrugën e epërme midis Izbicës dhe Klladërnicsës, rreth 800 metra nga Izbica, dhe për këtë arsye ishin në gjendje të shihnin civilët duke ecur në drejtim të luginës së Izbicës. Ai gjithashtu tha kur u sulmuan më 27 mars ata nuk e përdorën tankun.¹⁵⁴⁵

iii. Hetimet e kryera nga autoritetet e RFJ-së/Serbisë

601. Dikoviqi, i cili ishte me njësinë e tij në zonën e përgjithshme të Izbicës më 27 dhe 28 mars 1999, u pyet se a kishte marrë pjesë ai ose forcat e tij në largimin e kufomave nga varret dhe a kishte marrë pjesë në hetimet në lidhje me to. Ai u përgjigj se nuk kishte dijeni për ndonjë varr masive në Izbicë dhe se ai nuk ishte angazhuar në hetime në lidhje me të e as nuk ishte autorizuar të bënte një gjë të tillë.¹⁵⁴⁶

602. I Akuzuari Llazareviq u pyet në lidhje me incidentin e Izbicës gjatë marrjes në pyetje nga Prokuroria. Ai tha se ku problem u përmend fillimisht nga mediat e huaja në fillim të prillit 1999. Siç është diskutuar më poshtë në Pjesën VIII.G, ai urdhëroi Brigadën e 125-të të Motorizuar, të hetonte këto pretendime së bashku me MPB-në dhe autoritetet civile. Meqenëse zona e gjerë e

¹⁵⁴³ Sllagjan Pantiq, T. 23676–23678, 23684–23685 (5 mars 2008).

¹⁵⁴⁴ Sllagjan Pantiq, T. 23678–23679, 23687–23689 (5 mars 2008).

¹⁵⁴⁵ Sllagjan Pantiq, T. 23680–23682 (5 mars 2008).

¹⁵⁴⁶ Lubisha Dikoviq, T. 19986–19987 (11 dhjetor 2007).

Drenicës ishte ende arenë e luftimeve të ashpra, brigada u udhëzua të siguronte vendin dhe t'u mundësonte autoritetet civile që të hetonin zonën.¹⁵⁴⁷

603. Nebojsa Bogunoviç, zëvendëseshf i SPB-së në Mitrovicë, dhe Gvozden Gagiç, i cili kishte qenë shf i degës për vrasje dhe krime seksuale në drejtorinë e policisë për krime të MPB-së, dëshmuuan se për varret në Izbicë mësuan nga mediat. Si rezultat, më 27 maj 1999 SPB-ja e Mitrovicës dërgoi një grup hetimor në fshat. Pas mbërritjes grupi takoi ushtarë të UJ-së që nuk dinin asgjë për varrin e përbashkët, por u thanë hetuesve se në fshat ishte një varrezë e re. Kur ekipi shkoi në vend, kundër tyre u hap zjarr dhe atyre iu desh të largoheshin. Prokurori publik dhe një gjykatës hetues u informuan më pas në lidhje me këtë dhe urdhëruan zhvarrosjen e kufomave. Sipas raportit të ekipit të SPB-së së Mitrovicës, nga vendvarrimi u zhvarrosën 101 kufoma. Për arsye të panjohura për Dhomën, ky numër është më i vogël se numri i civilëve që pretendohet se janë varur në Izbicë, siç është përshkruar nga dëshmitarët okularë. Ata u ekzaminuan së jashtmi nga ekspertët e Akademisë Mjekësore Ushtarake (VMA), siç përshkruhet më poshtë, dhe më pas u varrosën në disa varreza në komunitat e Mitrovicës dhe Vushtrrisë.¹⁵⁴⁸

604. Pas përfundimit të sulmeve të NATO-s, Stanimir Radosavleviq, prokuror ushtarak në Nish, përgatiti një raport për Komandën e Armatës së 3-të në të cilën paraqiti të dhënat në lidhje me veprat penale të kryera në Kosovë gjatë periudhës 1 mars 1998 - qershor 1999.¹⁵⁴⁹ Ky dokument përmbante edhe një referencë në lidhje me hetimet për "zbulimin e 144 varreve të reja në sektorin e fshatit Izbicë më 29 maj 1999" dhe përmendte se "dosjet nuk përmbajnë prova të besueshme në lidhje me rrethanat e vrasjes së këtyre personave."¹⁵⁵⁰ Radosavleviq e konfirmoi këtë përfundim dhe se në kohën kur përgatiti raportin, ai nuk dispononte prova që tregonin se si kishin vdekur këta njerëz ose se UJ-ja ishte përgjegjëse për vdekjet. Për këtë arsye, ai ua kaloi çështjen autoriteteve civile.¹⁵⁵¹

¹⁵⁴⁷ P950 (Intervista e Vladimir Lazareviçit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 484–487.

¹⁵⁴⁸ Nebojsa Bogunoviç, T. 25128–25129 (10 prill 2008), 6D1614 (deklarata e dëshmitarit e datës 2 prill 2008), para. 83; Gvozden Gagiç, T. 24447–24450, 24483–24484 (18 mars 2008); 6D613 (Dokument i SPB-së së Mitrovicës në lidhje me Izbicën). *Shih gjithashtu* 6D116 (Raport i MPB-së në lidhje me ekzaminimin kriminalistik të vendvarrimit në Izbicë, 2 qershor 1999); 6D115 (Notë e MPB-së në lidhje me vizitën në vendvarrimin e Izbicës, 27 maj 1999).

¹⁵⁴⁹ Stanimir Radosavleviq, 4D502 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 shtator 2007), para. 24; 4D171 (Informacion në Lidhje me Procedimet Penale për Krimet e Kryera në Kosovë, 6 prill 2001).

¹⁵⁵⁰ 4D171 (Informacion në Lidhje me Procedimet Penale për Krimet e Kryera në Kosovë, 6 prill 2001), f. 8.

¹⁵⁵¹ Stanimir Radosavleviq, T. 17494–17495 (23 tetor 2007); Gjura Bllagojeviç, T. 21559, 21574–21583 (1 shkurt 2008); 6D115 (Notë e MPB-së në lidhje me vizitën në vendvarrimin në Izbicë, 27 maj 1999).

iv. Prova që identifikojnë viktimat.

605. Dhoma ka marrë një sasi të madhe materialesh kriminalistike që ka lidhje me identifikimin e personave të vrarë në Izbicë. Këto prova u përgatitën në kohë të ndryshme dhe në vende të ndryshme, për shkak të zhvendosjes së kufomave nga vendvarrimi në Izbicë. Këto raporte gjithashtu tregojnë se disa nga 118 viktimat emrat e të cilëve janë në Listën F, dhe një viktimë që nuk është në të, u dërguan në Petrovo Sellë, kurse të tjerët u varrosën në varrezën e Mitrovicës. Analiza e të gjitha këtyre provave për çdo viktimë në listë gjendet në Shtojcën A të Aktgjykimit.

606. Deklarata si dëshmitar e Loshit jep listën e emrave të njerëzve të identifikuar përmes kasetës filmike të bërë nga Sefedin Thaqi. Ata janë: Hetem Tahi, Brahim Bajra, Bajram Osman Dervishi, Selman Loshi, Ilaz Bajra, Isuf Shala, “Tahir R...?”, Metush Qelaj, Rexhë Qelaj, Fazli Bajra, Hamdi Doqi, Beqir Shpati, Brahim Krasniqi, Brahim Shabani, “[emri nuk dihet] (Milaim?) Kadria”, Sadik Hoti, “Muharrem (?) Thaqi”, Hysen Shala, Hamzi Qupeva, Bajram Hasan Bajra, Qazim Sadik Bajrami, “[emri nuk dihet] Dragaj (?)”, Muhamet Refat Hoti, Pajazit [mbiemri nuk dihet], Selman Loshi, Jashar Loshi, dhe Sami Loshi.¹⁵⁵² Tetëmbëdhjetë prej tyre janë në Listë dhe disa janë identifikuar nga dëshmitarët se ishin midis burrave dhe grave të vrara në Izbicë më 28 mars 1999.

607. Dhoma gjithashtu ka marrë si prova disa fotografi të kufomave të nxjerra nga videofilmimi.¹⁵⁵³ Disa nga këto fotografi tregojnë kufomave në vendvarrim me etiketat me emra në to. Deklarata e Loshit përmban gjithashtu listën e personave me etiketa me emra në kufomat e tyre si vijon: Brahim (R) Bajra, Ilaz (S) Bajra, Bajram (S) Bajra, Fazli (S) Bajra, Asllan (H) Bajra, Bajram (H) Bajra, Rustem (B) Dragaj, Cen (A) Dragaj, Ali (Z) Dragaj, Murat (S) Dragaj, Hajriz (J) Dragaj, Sofie (H) Dragaj, “Halim (J) Shala (?)”, “Isuf [mbiemri nuk dihet]”, Zymer (J) Shala, Ali (I) Shala,¹⁵⁵⁴ Mujë Shala, Sali (H) Dervishi, Bajram (M) Bajra, Sami (G) Bajra, Ilaz (Sh) Dervishi, Rexhep (I) Qelaj, Metush Qelaj, dhe Ajet (H) Beqiri.¹⁵⁵⁵ Nga personat emrat e të cilëve janë në deklaratën e tij, 17 janë viktimat të përfshira në Listë. Dhoma vëren se disa nga këto viktimat janë përfshirë edhe në paragrafin e mëparshëm. Kjo nuk është e habitshme sepse etiketat u vendosën në kufoma pasi ishin sjellë te vendvarrimi. Për këtë arsye, disa nga kufomat u filmuan dy herë. Dhoma gjithashtu thekson se disa nga këto viktimat me etiketa me emra u identifikuan nga mbijetuesit se kishin qenë midis burrave dhe grave të ekzekutuara në Izbicë më 28 mars 1999.

¹⁵⁵² Liri Loshi, P2436 (Paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 17–28, 36.

¹⁵⁵³ P231 (fotografi të kufomave të gjetura në Izbicë).

¹⁵⁵⁴ Dhoma vëren se Loshi ka shënuar një koment në tabelë ku thotë se ai beson se emri i këtij personi është Idriz Shala dhe se ai u vra në male.

¹⁵⁵⁵ Liri Loshi, P2436 (Paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 29–33. Sipas Loshit, Beqiri ishte ushtar i UÇK-së i vrarë pas incidentit të Izbicës dhe se Sami Bajra nuk u vra gjatë atij incidenti. Inicialet në mes të emrit dhe mbiemrit i referohen inicialit të emrit të babait.

608. Siç u përmend më lart, Afrim Xhemajli përgatiti një listë të viktimave gjatë varrimit në Izbicë dhe ia dha Loshit. Ajo përmban emrat e 111 viktimave të përfshira në Listën F.¹⁵⁵⁶

609. Dr. Gordana Tomasheviqi, specialiste mjeko-ligjore e punësuar në VMA në Serbi,¹⁵⁵⁷ dëshmoi në lidhje me 101 autopsitë që u bëri kufomave të Izbicës. Duke konfirmuar dëshmitë e lartpërmendura të Gagiqit dhe Bogunoviqit, ekipi i Tomasheviqit mori urdhër zyrtar nga Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, i datës 31 maj 1999, në lidhje me varret në fshatin Izbicë ku urdhërohej zhvarrosja i kufomave me qëllim që ekipi të kryente ekzaminimin mjeko-ligjor për konstatimin e kohës dhe shkakut të vdekjes. Urdhri gjithashtu kërkonte që kufomat të rivarroseshin pas ekzaminimit.¹⁵⁵⁸ Punëtorët civilë sollën 101 thasë kufomash me një kamion. Gjatë autopsive ishte e pranishme edhe policia civile. Ekzaminimi i kufomave u krye në Mitrovicë gjatë tri ditëve prej 3 deri më 5 qershor 1999. Meqenëse ekipi nuk i kishte pajisjet e nevojshme, për të kryer ekzaminimin e plotë patologjik, autopsitë u kufizuan vetëm në ekzaminimin e jashtëm. Tomasheviqi përpiloi një raport të plotë.¹⁵⁵⁹

610. Kufomat ishin në një fazë të përafërt të përparuar të shpërbërjes dhe kishin kaluar muaj e jo vite që nga vdekja e tyre. Tomasheviqi konkludoi se të gjithë personat me vetëm një përjashtim, me gjasë ishin vrarë nga plumba të shkrepur nga armë zjarri dore. Ajo gjithashtu shënoi se disa nga kufomat kishin tabelë druri mbi varr me emrat e tyre. Shumica ishin të veshur në rroba civile, por "disa kufoma" kishin "uniforma të zeza të UÇK-së."¹⁵⁶⁰ Raporti identifikonte pesë persona, emrat e të cilëve janë në Listën F të Aktakuzës, ose përmes tabelave të varreve të përmendura më lart ose prej dokumenteve të gjetura te viktimat, konkretisht, Beqir Musliu, Ali Dragaj, Azem Osmani, Idriz Xhemajli, dhe Zymer Shala.¹⁵⁶¹ Siç do të shihet më poshtë, asnjë nga këta pesë nuk u dërgua në Petrovo Sellë, që është në përputhje me urdhrin për varrosjen e kufomave në Mitrovicë. Kjo dhe prova të tjera në lidhje me numrin e viktimave sugjerojnë se kufomat e gjetura në Petrovo Sellë nuk iu dërguan Tomasheviqit.

¹⁵⁵⁶ Liri Loshi, P2436 (Paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8–9.

¹⁵⁵⁷ Gordana Tomasheviq, P2490 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 mars 2003), para. 1.

¹⁵⁵⁸ Gordana Tomasheviq, T. 7028–7029 (21 nëntor 2006); P2496 (Urdhër i Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës në lidhje me varret në Izbicës).

¹⁵⁵⁹ Gordana Tomasheviq, T. 7028–7030, 7032–7034 (21 nëntor 2006), P2490 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 mars 2003), para. 50, 52–53, P2507 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 korrik 2006), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 2–3; P248 (aktautopsitë e Gordana Tomasheviqit).

¹⁵⁶⁰ Gordana Tomasheviq, T. 7031–7034, 7051–7052 (21 nëntor 2006), P2490 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 mars 2003), f. 9, P2507 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 korrik 2006), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 3.

¹⁵⁶¹ Gordana Tomasheviq, T. 7036–7037 (21 nëntor 2006); P248 (aktautopsitë e Gordana Tomasheviqit), kufomat e shënuara përkatësisht S-55/99/1, S-83/99/1, S-84/99/1, S-88/99/1, dhe S-93/99/1.

611. Dhoma dëgjoi nga dëshmitari ekspert Dr. Eric Baccard se nga data 28 deri më 30 qershor 1999, një mision kriminalistik francez shkoi në Izbicë për të bërë hetime në vendin e ngjarjes.¹⁵⁶² Ekipi francez përgatiti disa raporte që analizojnë vendvarrimin si dhe tri vendet e ekzekutimit.¹⁵⁶³ Në raportin për vendvarrimin, ekipi vëren se vendi ishte arë dhe se mund të dalloheshin gropat e varreve. Ekipi mblodhi rroba, pjesë kufomash dhe municion, por jo kufoma të plota.¹⁵⁶⁴ Sa i përket vendeve të ekzekutimeve, ekipi konstatoi se ishin tri vende ekzekutimi, si dhe pika mbledhëse për rrobat e viktimave, batanijeve, dhe tabelave të varreve, të cilat ishin lënë aty pas zhvarrosjes së kufomave.¹⁵⁶⁵ Raporti i fundit përmend 28 pjesë kufomash nga vendvarrimi, të cilat përbëheshin nga copëra eshtrash, pjesë trupore, dhe tufa flokësh, si dhe 84 copëra plumbash. Përfundimi i raportit se viktimat ose ishin qëlluar në shpinë me armë zjarri të kalibrit të madh me breshëri nga afër, ose ishin goditur me mitraloz nga një distancë më e largët është kritikuar nga Baccard-i, siç do të shihet në paragrafin e ardhshëm. Dhoma kujton se përdorimi i mitralozit gjatë incidentit të Izbicës është përmendur nga Milazim Thaqi. Së fundi raporti nuk përmend kryerjen e provës së ADN-së në pjesët e gjetura të kufomave.¹⁵⁶⁶

612. Baccardi-i analizoi këto raporte së bashku me videokasetën e Liri Loshit dhe ka dhënë konkluzionet e veta në një raport të veçantë. Ai mori parasysh mostrat e marra nga ekipi francez, por konkludoi se, duke marrë parasysh sasinë e vogël të materialit të gjetur, ishte e vështirë të përcaktohej përfundimisht dhe pa mëdyshje shkaku i vdekjes së viktimave. Gjithsesi nga rrobat e gjetura dhe videofilmimi, Baccard-i mundi të përcaktonte se dukej se plagët e dukshme në kufoma në disa raste duhet të jenë rezultat i goditjes me armë zjarri dhe shihej se koka ishte pjesa anatomike më e lënduar. Nga videofilmimi ai mundi të konstatoje 36 lëndime të dukshme në kokë, dy në qafë, dy në trup, 11 në gjymtyrë të epërme, dhe gjashtë në gjymtyrë të poshtme. Këto plagë përputhen me plumba të kalibrit 7.62 ose 12 milimetra. Gjithashtu Baccard- konstatoi se me gjithë sasinë e vogël të mostrave, "nga këqyrjet balistike të rrobave të mbledhura, të shtënat në të shumtën e rasteve ishin në shpinë, ndonjëherë nga afërsia, dhe në disa raste arma ka qenë e puthitur në trup."¹⁵⁶⁷

613. Meqenëse disa nga viktimat e vrasjeve në Izbicë u gjetën në Petrovo Sellë, Dhoma gjithashtu mori shumë raporte dhe dëshmi të atyre që kanë qenë të pranishëm, kanë mbikëqyrur,

¹⁵⁶² Eric Baccard, T. 10123 (19 shkurt 2007); P1809 (Raport përmbledhës i Eric Baccard-it), f. 16.

¹⁵⁶³ P207 (Inventari – Vendvarrimi në Izbicë), P208 (Inventari – Vendet e ekzekutimit në Izbicë), P209 (Autopsitë e Izbicës të bëra nga misioni kriminalistik francez).

¹⁵⁶⁴ P207 (Inventari – Vendvarrimi në Izbicë), f. 3.

¹⁵⁶⁵ P208 (Inventari – Vendet e ekzekutimeve në Izbicë), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 3.

¹⁵⁶⁶ P209 (Autopsitë e Izbicës të bëra nga misioni kriminalistik francez), f. 15–16.

¹⁵⁶⁷ P1809 (Raport përmbledhës i Eric Baccard-it), f. 44–48.

dhe kanë marrë pjesë në zhvarrosjen dhe identifikimin e kufomave nga varri i përbashkët atje, siç është përshkruar në Pjesën VII.P. Personat e përfshirë janë William Fulton, Jon Sterenberg, dhe Jose-Pablo Baraybar. Gjithashtu, Dhoma ka pranuar si prova aktautopsitë e përgatitura nga Instituti mjeko-ligjor i Nishit që kanë lidhje me kufomat e zhvarrosura nga varri i përbashkët në Petrovo Sellë. Më pas në to u kryen analizat e ADN-së, rezultatet e të cilave u evidentuan në listën e personave të zhdukur të ZPZH-së.¹⁵⁶⁸ Ato konfirmojnë vdekjen e këtyre personave të cilët janë përfshirë në Listën F:¹⁵⁶⁹ Fatmir Osmanaj,¹⁵⁷⁰ Jashar Loshaj,¹⁵⁷¹ Hamdi Temaj,¹⁵⁷² Sami Loshaj,¹⁵⁷³ Dibran Pani,¹⁵⁷⁴ Halit Haliti,¹⁵⁷⁵ Mehmet Hajraj,¹⁵⁷⁶ Rexhë Duraku,¹⁵⁷⁷ Qerim Hoti,¹⁵⁷⁸ Zojë Osmani,¹⁵⁷⁹ Bajram Dervishi,¹⁵⁸⁰ Metush Qelaj,¹⁵⁸¹ Hajzer Kotorri,¹⁵⁸² Muhamet Behrami,¹⁵⁸³ Zade Dragaj,¹⁵⁸⁴ Hajrullah Fetahu,¹⁵⁸⁵ Selman Loshi,¹⁵⁸⁶ Ilaz Musliu,¹⁵⁸⁷ dhe Muhamet Emra.¹⁵⁸⁸ Po ashtu ato konfirmojnë vdekjen a një viktime tjetër, konkretisht të Sofie Dragajt, kufoma e së cilës u filmua nga shokut i Liri Loshit.¹⁵⁸⁹

614. Shumë prej viktimave të Izbicës u varrosën në Mitrovicë e jo në Petrovo Sellë. Jon Sterenberg, shef i njësisë së zhvarrosjeve dhe ekzaminimeve të KNPZH-së, dëshmoi se kufomat e personave të varrosur në Kosovë gjithashtu u ekzaminuan nga KNPZH-ja për identifikim përmes ADN-së. UNMIK-u i dha KNPZH-së mostrat e kufomave për t'i mundësuar që të bënte krahasimet

¹⁵⁶⁸ P2798 (Lista e ZPZH-së të personave të zhdukur). *Shih gjithashtu* Kërkesa e Tretë e Prokurorisë për Pranimin e Provave Materiale në sallën e gjyqit, 6 mars 2007, f. 8, 9.

¹⁵⁶⁹ Dhoma qëllimisht nuk e përmend Zenel Veliqin. Shpjegimi për këtë gjendet në Shtojcën A të Aktgjykimit ku provat që kanë lidhje me këtë viktimitë diskutohet në imtësi. Dhoma gjithashtu vëren se ka mospërputhje të vogla midis emrave në këto raporte dhe emrave në Listën F. Këto janë mospërputhje të vogla dhe mund të shpjegohen me faktin se kështu shkruhen emrat shqiptarë në serbisht.

¹⁵⁷⁰ P213 (vërtetimi i vdekjes i Fatmir Osmanajt); P214 (aktautopsi për PS/II-18).

¹⁵⁷¹ P217 (vërtetimi i vdekjes i Jashar Loshajt); P218 (aktautopsi për PS/II-25).

¹⁵⁷² P219 (vërtetimi i vdekjes i Hamdi Temajt); P220 (aktautopsi për PS/II-32).

¹⁵⁷³ P221 (vërtetimi i vdekjes i Sami Loshajt); P222 (aktautopsi për PS/II-34).

¹⁵⁷⁴ P223 (vërtetimi i vdekjes i Dibran Panit); P224 (aktautopsi për PS/II-20).

¹⁵⁷⁵ P225 (vërtetimi i vdekjes i Halit Halitit); P226 (aktautopsi për PS/II-15).

¹⁵⁷⁶ P2419 (aktautopsi për PS/II-1 dhe PS/II-4), f. 1–4, 16–19.

¹⁵⁷⁷ P2419 (aktautopsi për PS/II-2), f. 7–10; P2604 (aktautopsi për PS/II-6).

¹⁵⁷⁸ P2428 (aktautopsi për PS/II-9).

¹⁵⁷⁹ P2429 (aktautopsi për PS/II-13).

¹⁵⁸⁰ P2431 (aktautopsi për PS/II-30).

¹⁵⁸¹ P2433 (aktautopsi për PS/II-45).

¹⁵⁸² P2605 (aktautopsi për PS/II-22).

¹⁵⁸³ P2606 (aktautopsi për PS/II-27).

¹⁵⁸⁴ P2607 (aktautopsi për PS/II-29).

¹⁵⁸⁵ P2608 (aktautopsi për PS/II-33).

¹⁵⁸⁶ P2609 (aktautopsi për PS/II-39).

¹⁵⁸⁷ P2610 (aktautopsi për PS/II-42).

¹⁵⁸⁸ P2611 (aktautopsi për PS/II-46).

¹⁵⁸⁹ P215 (vërtetimi i vdekjes i Sofie Dragajt); P216 (aktautopsi për PS/II-8A).

e ADN-së me mostrat e marra nga anëtarët e familjes për qëllime identifikimi.¹⁵⁹⁰ Krahasimi i mostrave rezultoi në identifikimin e disa viktimave të Izbicës.

615. Dhoma gjithashtu vëren se Dr. Zoran Stankoviqi, specialist i mjekësisë ligjore i cili u ftua të dëshmonte për të gjithë të Akuzuarit, kundërshtoi aspekte të ndryshme të provave kriminalistike dhe dëshmime në lidhje me vrasjet në Izbicë.¹⁵⁹¹ Për shembull, ai kundërshtoi dëshminë e Milazim Thaqit se rrobat e tij ishin dëmtuar nga plumbat, ndërsa ai nuk ishte lënduar, duke argumentuar se kjo ishte e pamundshme dhe se vrimat në këmishën e Thaqit nuk ishin shkaktuar nga armët e përshkruara nga ai dhe se personi që kishte qëlluar duhej të kishte qenë në një "kënd shumë të çuditshëm." Gjithashtu, nëse rrëfimi i tij ishte i saktë, trupi i Thaqit do të ishte gërvishtur nga plumbat. Gjithsesi Stankoviqi pranoi se analiza e tij ishte e bazuar vetëm në fotografitë e këmishës.¹⁵⁹²

616. Dhoma pranon se dëshmia e Thaqit se ishte gërvishtur nga plumbat është e çuditshme. Sidoqoftë, për arsyet e përmendura më lart,¹⁵⁹³ Dhoma beson se Thaqi ishte dëshmitar okular dhe mbijetues i vrasjeve në Izbicë. Ajo pranon se vrimat në këmishën e Thaqit nuk janë vrime nga plumbat. Në fakt, ajo nuk e konsideron të besueshëm shpjegimin e tij të vrimave. Është e mundshme që Thaqi të ketë nxjerrë përfundimin mbi shkakun e dëmtimit të këmishës së tij si pasojë e përvojave tronditëse që ka përjetuar. Nuk është gjithashtu e pamundshme që ai t'a ketë zbukuruar dëshminë e tij.

617. Stankoviqi gjithashtu kundërshtoi dëshminë e Thaqit se burrat u qëlluan me breshëri mitralozi dhe dëshmoi se kjo nuk përputhej me përfundimet e Gordana Tomasheviqit se asnjë nga kufomat e zhvarrosura nuk kishte lëndime dhe plagë që janë karakteristike për plagë të shkaktuara nga mitralozi. Gjithashtu, po të ishte hapur zjarr i dendur mitralozi, Thaqin do të duhej më shumë se një kufomë për t'ia shpëtuar jetën. Së fundi, pasi pa videofilmimin e Liri Loshit të kufomave, Stankoviqi vuri në dukje se nuk kishte asnjë gëzhgjë plumbi askund përreth kufomave, që binte në kundërshtim me dëshminë në lidhje me breshëri mitralozi. Stankoviqi pranoi se nuk e kishte analizuar dëshminë gojore të Thaqit apo të ndonjë tjetri, por vetëm deklaratat dhe raportet e tyre.¹⁵⁹⁴

618. Stankoviqi gjithashtu dëshmoi se ishte e qartë se kufomat në videofilmim ishin lëvizur nga vendi ku kishin vdekur. Ai gjithashtu vuri në dukje se videofilmimi nuk tregonte kufoma në grupe,

¹⁵⁹⁰ Jon Sterenberg, T. 8217, 8227 (11 dhjetor 2006).

¹⁵⁹¹ *Shih gjithashtu* Dosja Përfundimtare e Llukiqit, para. 1392–1407.

¹⁵⁹² Zoran Stankoviq, T. 26157, 26197–26198 (14 maj 2008); 6D670 (Aktekspertiza e Zoran Stankoviqit për Izbicën), para. 8.

¹⁵⁹³ *Shih* para. 559.

që është në kundërshtim me dëshminë e Mustafa Dragës, dhe se nuk kishte sasi të mëdha të gjakut në zonën rreth kufomave, gjëra të cilat dëshmojnë se kufomat ishin lëvizur. Më në fund, Stankoviqi përshkroi disa skena nga videofilmimi të cilat tregojnë qartë se kufomat ishin lëvizur ose ishin duke u lëvizur dhe gjithashtu tha nga filmimi ishte e pamundshme të përcaktohej pozicioni i viktimave në momentin e vdekjes.¹⁵⁹⁵

619. Dhoma e ka parë videofilmimin në fjalë dhe vëren se aty shihen qartë kufomat në grupe në vendet e ekzekutimit. Gjithashtu shihet se ato janë lëvizur, siç ka dëshmuar Stankoviqi. Sidoqoftë, Dhoma nuk mendon se ato janë sjellë në atë vend nga diku tjetër, por se vetëm janë rrotulluar, kur ka qenë e nevojshme, për të identifikuar çdo viktimë dhe për t'i filmuar fytyrën. Fakti se nuk shihen gëzhoja të plumbave në videofilmim, i cili u bë tri ditë pas vrasjeve, nuk i komprometon dëshmitë e përputhëse të mbijetuesve në lidhje me ngjarjen. Në periudhën midis vrasjeve dhe filmimit gëzhojat mund të jenë hequr nga vendi i ngjarjes.

620. Stankoviqi gjithashtu theksoi se nuk ishte e mundshme që në bazë të konkluzioneve të Gordana Tomasheviqit e cila mundi t'i ekzaminonte kufomat vetëm nga jashtë, të përcaktohen pozicionet e sulmuesve dhe të viktimave dhe nëse viktimat u vranë nga një apo më shumë qitës. Ai gjithashtu theksoi se ekzaminimi i jashtëm i kufomave nuk zbuloi lëndime që sugjerorin keqtrajtim para vdekjes.¹⁵⁹⁶ Së fundi, po ashtu si Baccard-i, ai shprehu rezerva për aftësinë e misionit kriminalistik francez për të përcaktuar shkakun dhe mënyrën e vdekjes së viktimave vetëm në bazë të 28 pjesëve të kufomave të gjetura në vendvarrim.¹⁵⁹⁷

621. Pas ka analizuar provat e shumta kriminalistike të përshkruara më lart, si dhe kundërshtimet ndaj tyre, Dhoma konkludon se këto prova mund të përdoren për identifikimin e njerëzve që vdiqën në rrethinën e Izbicës më 28 mars 1999, edhe pse, siç diskutohet më poshtë, ato nuk ndihmojnë për të përcaktuar se cilat nga viktimat u vranë në incidentet e pretenduara në Aktakuzë. Gjithsesi Dhoma, nuk bazohet në konkluzionet e misionit kriminalistik francez sa i përket shkakut të vdekjes të këtyre viktimave, meqenëse edhe Eric Baccard edhe Zoran Stankoviqi shprehën rezerva në lidhje me to. Në vend të tyre, Dhoma mbështetet në dëshmitë përgjithësisht të përputhëse të mbijetuesve të përmendur më lart, videofilmimin e bërë nga shoku i Liri Loshit, dhe përfundimet e Baccard-it të

¹⁵⁹⁴ Zoran Stankoviq, T. 26156, 26171 (14 maj 2008); 6D670 (Aktekspertiza e Zoran Stankoviqit për Izbicën), f. 9.

¹⁵⁹⁵ Zoran Stankoviq, T. 26157–26163 (14 maj 2008); 6D670 (Aktekspertiza e Zoran Stankoviqit për Izbicën), para. 5–6; 6D1663 (Pjesë nga videofilmimi i Liri Loshit të analizuar nga Zoran Stankoviqi).

¹⁵⁹⁶ 6D670 (Aktekspertiza e Zoran Stankoviqit për Izbicën), para. 1–4.

¹⁵⁹⁷ Zoran Stankoviq, T. 26164–26165 (14 maj 2008); P209 (Autopsitë e Izbicës të bëra nga misioni kriminalistik francez), f. 16.

bazuara në atë regjistrim. Ajo gjithashtu mbështetet në raportet e përgatitura nga Gordana Tomasheviqi dhe në shkaqet e vdekjeve të përcaktuara në to. Në këtë mënyrë Dhoma konkludon se afërsisht 93 nga 118 personat e përfshirë në Listën F të Aktakuzës u vranë me armë zjarri në Izbicë më 28 mars 1999. Detajet e këtyre vrasjeve mund të gjenden në Shtojcën A të kësaj Aktakuze.

b. Dhuna seksuale në Qirez

622. Dëshmi të drejtpërdrejta në lidhje me akuzat për dhunë seksuale në fshatin Qirez rreth mesit të prillit 1999 janë dhënë nga dy dëshmitare, konkretisht, Xhevahire Rrahmani dhe K24. Edhe pse dëshmitë e tyre ishin përputhëse në lidhje me ngjarjet që ndodhën në atë fshat, dy gratë nuk dhanë të njëjtin përshkrim për identifikimin e forcave që kishin marrë pjesë, siç do të përshkruhet më poshtë. Dhoma gjithashtu ka pranuar disa të dhëna kriminalistike në lidhje me fatin e femrave që pretendohet se u dhunuan seksualisht.

i. Rrëfimet e dëshmitarëve okularë

623. Më 26 mars 1999, Xhevahire Rrahmani dhe familja e saj shkuan nga shtëpia e tyre në fshatin Duboc, komuna e Vushtrisë, në shtëpinë e një të afërmi në fshatin Kozhicë në komunën e Skënderajt.¹⁵⁹⁸ Ata kishin qenë në fshat tri net kur "forcat serbe" filluan të granatonin fshatin nga Qirezi dhe, si rezultat, të gjithë burrat, duke përfshirë edhe burrin e Rrahmanit, shkuan të fshiheshin në malin e Çiçavicës. Kur u pyet nga Mbrojtja, Rrahmani mohoi se UÇK-ja kishte qenë e pranishme në Kozhicë.¹⁵⁹⁹ Ajo gjithashtu shpjegoi se burrat u larguan pa u vërejtur nga "ushtarët" sepse mali ishte shumë afër vendit ku ata kishin qenë. Ajo gjithashtu mohoi se dinte se mali njihej si bastion i UÇK-së.¹⁶⁰⁰ Sidoqoftë, duke u bazuar në sasinë e madhe të provave dokumentare dhe dëshmime të paraqitura më lart që i referohen zonën së gjerë të Drenicës dhe maleve të Çiçavicës si bastione të UÇK-së, si dhe dëshmisë së K24-ës se burri i saj luftoi për UÇK-në në malin e Çiçavicës, Dhoma nuk është bindur nga dëshmia e Rrahmanit në lidhje me mospraninë e UÇK-së në atë zonë.

624. Më 29 mars 1999 ose rreth kësaj date, rreth 300 persona nga Kozhica, përfshirë edhe Rrahmanin dhe fëmijët e saj, u mbledhën në oborrin e një shtëpie. Një predhë ra në oborr duke vrarë dhe plagosur disa njerëz. Rreth 30 "ushtarë" të veshur me uniforma të gjelbra, disa prej tyre me shirita të kuq në krah, erdhën në oborr dhe kishin filluar t'i ndihmonin të plagosurit dhe t'ua

¹⁵⁹⁸ Xhevahire Rrahmani, T. 1818–1819 (17 gusht 2006), P2239 (deklarata e dëshmitarit e datës 11 qershor 2001), f. 2.

¹⁵⁹⁹ Xhevahire Rrahmani, T. 1862 (17 gusht 2006), P2239 (deklarata e dëshmitarit e datës 11 qershor 2001), f. 2.

¹⁶⁰⁰ Xhevahire Rrahmani, T. 1863–1864 (17 gusht 2006).

lidhnin plagët.¹⁶⁰¹ Rrahmani pa kur ushtarët vranë një të sëmure mendor. Më pas ushtarët filluan t'i digjnin shtëpitë e fshatit me benzinë. Ata gjithashtu kontrolluan fshatarët dhe u kërkuan gjëra me vlerë.¹⁶⁰²

625. Më në fund, "ushtarët" u thanë Rrahmanit dhe të tjerëve të largoheshin nga fshati për shkak të "luftimeve" dhe të shkonin në qytetin e Skënderajt. Ata vepruan sipas urdhrit urdhëruar dhe u përcollën nga ushtarët në kamionë. Të nesërmen, në një postbllok policie në hyrje të Skënderajt, ata u urdhëruan të shkonin në Glllogoc. Gjatë rrugës panë ushtrinë duke lëvizur poshtë e lart me kamionë. Rrahmani kaloi 10 ditë në Glllogoc në shtëpinë e një të afërmi e pastaj ajo dhe familja e saj shkuan përsëri në Kozhice në kërkim të ushqimit. Atje ajo takoi përsëri burrin e saj. Fshati ishte i zbrazët dhe shtëpitë ishin djegur. Kjo ndodhi dikur në prill 1999.¹⁶⁰³

626. Rrahmani dëshmoi se, nga Kozhica e cila gjendet lart në kodër mbi Qirez, ajo mundi të shihte një tank dhe tre ose katër kamionë të vendosur në Qirez. Ditën e tretë në Kozhice, filloi përsëri granatimi dhe burrat ikën sërish në mal. Ajo dhe tre fëmijët e saj shkuan në shtëpinë e Xhafer Dakës, po ashtu si edhe K24-a. Të dy gratë dëshmuan se edhe disa gra dhe fëmijë të tjerë nga Kozhica bënë të njëjtën gjë. Ndërkohë, babai i K24-ës dhe vëllezërit e saj shkuan të fshiheshin në male, kurse burri i saj luftonte në radhët e UÇK-së në malin e Çiçavicës.¹⁶⁰⁴

627. Si K24-a, po ashtu edhe Rrahmani dëshmuan se forcat policore dhe të UJ-së i larguan nga shtëpia e Dakës dhe ato shkuan në një shtëpi tjetër ku qëndruan dy ose tri ditë. Sidoqoftë, dëshmitë e dy grave në lidhje me identifikimin e individëve që i dëbuan nga shtëpia dhe mënyrën e dëbimit, nuk përputheshin. Rrahmani dëshmoi se gjysmë ore pasi kishte filluar granatimi, gratë në shtëpinë e Dakës dëgjuan krisma. Pas kësaj në oborr erdhën "ushtarë" me uniforma të gjelbra dhe të tjerë me uniforma të zeza dhe ngjyrë kafe. Ushtarët dërguan një djalë që t'u thoshte grave të shkonin në një shtëpi tjetër, gjë që ato e bënë të shoqëruara nga "ushtarët" me uniforma të zeza dhe ngjyrë kafe. Kur mbërritën atje, ato u kontrolluan nga ushtarët me uniforma të gjelbra. Aty u prunë edhe gra të tjera, kështu që u bënë afërsisht 60 gra e fëmijë në atë shtëpi.¹⁶⁰⁵ Sidoqoftë K24-a tha se kjo ndodhi

¹⁶⁰¹ Xhevahire Rrahmani, T. 1819–1820 (17 gusht 2006), P2239 (deklarata e dëshmitarit e datës 11 qershor 2001), f. 2.

¹⁶⁰² Xhevahire Rrahmani, T. 1820–1821, 1828, 1864 (17 gusht 2006), P2239 (deklarata e dëshmitarit e datës 11 qershor 2001), f. 2, P2240 (Transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4589. Mbrojtja e pyeti Rrahmanin se pse nuk e kishte përmendur vrasjen e të sëmurit mendor në deklaratë, por e përmendi tani në gjyq. Ajo u përgjigj se kishte harruar t'u tregonte hetuesve për atë incident. Xhevahire Rrahmani, T. 1873 (17 gusht 2006).

¹⁶⁰³ Xhevahire Rrahmani, T. 1821–1822, 1827–1829 (17 gusht 2006), P2239 (deklarata e dëshmitarit e datës 11 qershor 2001), f. 2–3.

¹⁶⁰⁴ Xhevahire Rrahmani, P2239 (deklarata e dëshmitarit e datës 11 qershor 2001), f. 3; K24, P2548 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 nëntor 1999), f. 2–3. *Shih gjithashtu K24*, P2529 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 8172–8173.

¹⁶⁰⁵ Xhevahire Rrahmani, T. 1829–1833 (17 gusht 2006), P2239 (deklarata e dëshmitarit e datës 11 qershor 2001); f. 3–4.

të nesërmen rreth orës 07:00, kur gjashtë ose shtatë "ushtarë të ushtrisë jugosllave" erdhën në shtëpi duke u bërtitur grave që të shkonin në Qirez. Këta ushtarë kishin uniforma kamuflimi "të gjelbra me të verdhë," shirita të kuq në krah, dhe kapela kamuflimi me "strehë të madhe rrumbullake." Ata i kontrolluan gratë dhe ua morën paratë, stolitë, dhe dokumentet e identifikimit.¹⁶⁰⁶

628. Të dy gratë dëshmuan se pasi hynë në shtëpi, ato u trajtuan mirë dhe u dhanë ushqime, ujë, rroba, dhe barna. Pas natës së dytë apo të tretë, disa grave u thanë se duhej të shkonin në Qirez dhe të fshiheshin në xhami që të mos vriteshin nga NATO-ja dhe sepse do të fillonte një ofensivë. Sipas K24-ës, një ushtar tjetër i tha njëres prej grave e cila fliste serbisht se duhej të shkonin në Qirez sepse "kanë kërkuar një grup prej jush."¹⁶⁰⁷ Ato u shoqëruan për në Qirez nga tre "ushtarë" me uniforma kamuflimi të gjelbra.¹⁶⁰⁸

629. Dhoma vëren se ekzistojnë disa mospërputhje në dëshmitë e dy dëshmitareve në lidhje me numrin e grave të dërguara në Qirez. Rrahmani dëshmoi për një grup prej 27 grash dhe e inkuadroi edhe K24-ën në atë listë.¹⁶⁰⁹ Mirëpo sipas deklaratës së K24-ës si dëshmitare, gjithsej 22 gra nga Kozhica u shoqëruan për në Qirez. Më tej K24-a jepte emrat e 16 grave në deklaratën e saj, por kjo listë nuk përfshinte Rrahmanin.¹⁶¹⁰ Gjatë pyetjeve të Mbrojtjes, K24 u pyet nëse Rrahmani kishte qenë me të dhe ajo u përgjigj: "Po, ishte me mua për një kohë, por më vonë u ndamë. Ajo nuk ishte me mua më vonë."¹⁶¹¹ Dhoma mendon se kjo mospërputhje e vogël në lidhje me numrin e grave të marra nuk e cenon besueshmërinë e dëshmisë së K24-ës dhe Rrahmanit. Fakti se K24 nuk e përmendi Rrahmanin në listën e 16 grave në deklaratën e saj jo domosdoshmërisht tregon se Rrahmani nuk ka qenë atje, meqë, sipas K24-ës 22 gra u shoqëruan për në Qirez. Gjithashtu gjatë dëshmisë së saj me gojë, K24-a konfirmoi se Rrahmani kishte qenë me të por ishin ndarë më vonë. Rrjedhimisht Dhoma mendon se të dy gratë janë të besueshme dhe dëshmitë e tyre në lidhje me ngjarjet në Qirez të sakta.

630. Gratë iu dorëzuan një grupi tjetër burrash dhe u dërguan në një stallë në Qirez. Sipas K24-ës, ato iu dorëzuan tre burrave me uniforma kamuflimi me përzierje të ngjyrës të gjelbër të mbylltë,

¹⁶⁰⁶ K24, P2548 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 nëntor 1999), f. 3.

¹⁶⁰⁷ K24, P2548 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 nëntor 1999), f. 4, P2529 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 8174–8176; Xhevahire Rrahmani, T. 1866–1867 (17 gusht 2006), P2239 (deklarata e dëshmitarit e datës 11 qershor 2001); f. 4–5, P2240 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4590.

¹⁶⁰⁸ Xhevahire Rrahmani, T. 1830 (17 gusht 2006), P2239 (deklarata e dëshmitarit e datës 11 qershor 2001), f. 4–5; K24, P2548 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 nëntor 1999), f. 4.

¹⁶⁰⁹ Xhevahire Rrahmani, P2239 (deklarata e dëshmitarit e datës 11 qershor 2001); f. 4, P2240 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4591–4592.

¹⁶¹⁰ K24, P2548 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 nëntor 1999), f. 2–3.

¹⁶¹¹ K24, T. 4792 (13 tetor 2006) (seancë e mbyllur).

verdhë, dhe të kuqe dhe me emblemën e tigrin në mëngë, të cilët i çuan në stallë.¹⁶¹² Gjithsesi Rrahmani dëshmoi se ato iu dorëzuan një grupi burrash, dy prej të cilëve i çuan në një stallë, kurse i treti erdhi më vonë. Dy burrat ishin më të moshuar, me mjekra, dhe kishin uniforma të zeza dhe ngjyrë kafe.¹⁶¹³

631. Dëshmia e K24-ës dhe e Rrahmanin ishin relativisht përputhëse në lidhje me ngjarjet që ndodhën brenda dhe jashtë stallës. Sipas Rrahmanit, pasi kishin hyrë të gjitha në stallë, dy ushtarët i urdhëruan t'i dorëzonin paratë, stolitë, dhe dokumentet e identifikimit dhe pastaj filluan t'i nxirrnin një nga një nga stalla. Gruaja e parë që u kthye në stallë i tha Rrahmanit se e detyruan t'i hiqte rrobat. Kur e nxorën Rrahmanin jashtë, e kontrolluan, e pyetën se ku e kishte burrin, e më tej i thanë të ngrinte bluzën dhe gjoksmbajtësen. Ushtari që e kontrolloi ia preku gjinjtë dhe e ngacmoi me komente seksuale. Pas rreth 20 minutash i thanë të kthehej në stallë. Erdhi edhe një ushtar i tretë, i cili sipas Rrahmanit ishte shumë i gjatë dhe biond dhe fliste shqip. Afërsisht për dy orët e tjera të gjitha gratë, përveç dy plakave, u nxorën nga stalla një nga një dhe u kontrolluan në të njëjtën mënyrë. Disa, sidomos ato më të rejat, u nxorën jashtë vazhdimisht.¹⁶¹⁴

632. K24 gjithashtu tha se një burrë biond i gjatë i mori gratë nga stalla dhe i kontrolloi një nga një duke i detyruar t'i hiqnin rrobat. Së fundi gjatë një periudhe dyorëshe ai nxori pesë jashtë disa herë vajza të reja. Këto vajza ishin: tri motrat Antigona, Bukurie, dhe Mirishahe Dibrani; Lumnije Zymeri; dhe Zahide Xhema. Ato dolën jashtë një nga një dhe u kthyen me rroba të shprishura, të tmerruara, dhe refuzonin të tregonin se çfarë u kishte ndodhur. Njëra tha se i kishin zhveshur lakuriq.¹⁶¹⁵ Në një moment edhe K24-a u nxor jashtë, ku pa dy burrat e tjerë me emblemën e tigrin. Biondi e urdhëroi të zhvishej dhe i uli pantallonat e tij deri në gjunjë. Ai filloi t'i prekte gjinjtë dhe vaginën dhe në atë moment ajo e humbi vetëdijen. Kur erdhi në vete e kuptoi se nuk e kishin përdhunuar. Më tej ajo u urdhërua të çohet dhe të nisej për në stallë. Pak para se të hynte në stallë, ushtari që e shoqëronte i tha të ulej dhe të pushonte. Pas pesë minutash ai i tha të shkonte pas tij dhe e urdhëroi të zhvishej. Ai hoqi pantallonat dhe brekët e tij dhe filloi t'a prekte. Pastaj e kërcënoi me thikë, por shpejt e humbi durimin dhe i tha të shkonte në stallë, dhe ajo shkoi.¹⁶¹⁶ Të dy gratë

¹⁶¹² K24, T. 4774, 4777–4778, 4784–4786 (seancë e mbyllur) (12 tetor 2006), P2548 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 nëntor 1999), f. 4; P390 (fotografi të ndryshme të stallës dhe vendit përreth), f. 12, 15; P1323 (vizatime të emblemave të ndryshme), K24 identifikoi vizatimet 3 (shkaba) dhe 8 (tigrin) si emblemat që pa te këta burra.

¹⁶¹³ Xhevahire Rrahmani, T. 1830–1834, 1868 (17 gusht 2006), P2239 (deklarata e dëshmitarit e datës 11 qershor 2001), f. 5.

¹⁶¹⁴ Xhevahire Rrahmani, P2239 (deklarata e dëshmitarit e datës 11 qershor 2001), f. 5–7.

¹⁶¹⁵ K24, P2548 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 nëntor 1999), f. 4–6.

¹⁶¹⁶ K24, P2548 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 nëntor 1999), f. 6–7.

dëshmuar se, gjatë gjithë këtyre vuajtjeve burrat i ngacmonin me fjalë si "pra, doni republikë, doni pavarësi," dhe, "doni NATO-n, Thaçin, e Rugovën."¹⁶¹⁷

633. Kur vajzat e reja u nxorën jashtë për herë të fundit, ushtarët i lidhën dyert e stallës me tel. Pas pak, ushtari biond u kthye dhe urdhëroi Miradije Dibranin, Tahire Shalakun (nënë e Rrahmanit), dhe Fahrie Ademin të shkonin me të. Ato vepruan sipas urdhrorit, dera u mbyll dhe K24-a dhe Rrahmani dëgjuan tri krisma. Asnjë nga tetë gratë nuk u pa më e gjallë më pas.¹⁶¹⁸ Rrahmani dëshmoi se afërsisht pas 15 minutash, një ushtar që nuk e kishin parë më herët i cili kishte uniformë të njëjtë të zezë dhe ngjyrë kafe erdhi në stallë dhe u tha grave të ktheheshin në Kozhicë.¹⁶¹⁹ Mirëpo sipas K24-ës, personi që i lironi gratë nga stalla ishte polic me uniformë kamuflimi të kaltër të mbylltë, i cili u tha të iknin shpejt.¹⁶²⁰

634. Rrahmani dëshmoi se kur gratë u kthyen në Kozhicë ato u treguan "forcave serbe" çfarë kishte ndodhur dhe u pyetën se a ishin pjesëtarët e "Dorës së Zezë" ata që e kishin bërë këtë. Midis "ushtarëve" të pranishëm në Kozhicë, Rrahmani pa për pak kohë edhe ushtarin që e kishte çuar grupin në Qirez më herët.¹⁶²¹ Disa orë më vonë ushtarë me uniforma të gjelbra i çuan gratë në Qirez për të hetuar se çfarë u kishte ndodhur tetë grave. Rrahmani u tregoi stallën dhe ata i thanë se kishin dijeni për këtë.¹⁶²² K24-a shtoi se, kur u kthyen në Qirez me këta ushtarë, gratë i vendosën në një shtëpi tjetër, u dhanë ushqime dhe gjëra të tjera të nevojshme dhe u thanë mos të dilnin jashtë "për shkak të paraushtarakëve".¹⁶²³

635. Gratë qëndruan në Qirez disa ditë.¹⁶²⁴ Kohë pas kohe, një komandant me uniformë kamuflimi të gjelbër dhe shirit të kuq e kapelë të gjelbër erdhi për të marrë më shumë të dhëna nga K24-a për sulmin. Ai madje u tha një herë se i vinte keq për çfarë kishte ndodhur.¹⁶²⁵ Rrahmani dëshmoi se i kishin trajtuar mirë. Ushtarët e rregullt u dhanë ushqime dhe miell, si dhe pelena për

¹⁶¹⁷ Xhevahire Rrahmani P2239 (deklarata e dëshmitarit e datës 11 qershor 2001), f. 6; K24, P2548 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 nëntor 1999), f. 4-5.

¹⁶¹⁸ Xhevahire Rrahmani, P2239 (deklarata e dëshmitarit e datës 11 qershor 2001), f. 7; K24, P2548 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 nëntor 1999), f. 7.

¹⁶¹⁹ Xhevahire Rrahmani, T. 1868 (17 gusht 2006), P2239 (deklarata e dëshmitarit e datës 11 qershor 2001), f. 7.

¹⁶²⁰ K24, P2548 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 nëntor 1999), f. 7.

¹⁶²¹ Xhevahire Rrahmani, T. 1868-1869 (17 gusht 2006), P2239 (deklarata e dëshmitarit e datës 11 qershor 2001), f. 7.

¹⁶²² Xhevahire Rrahmani, T. 1839-1841 (17 gusht 2006), P2239 (deklarata e dëshmitarit e datës 11 qershor 2001), f. 7-8.

¹⁶²³ K24, P2548 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 nëntor 1999), f. 7-8, P2529 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 8176-8178.

¹⁶²⁴ K24-a dëshmoi se ato qëndruan atje 10 ditë, kurse Rrahmani dëshmoi se qëndruan tri javë. Duke marrë parasysh rrethanat e tyre në atë kohë, Dhoma nuk e konsideron thelbësor këtë dallim në dëshmitë e tyre.

¹⁶²⁵ K24, P2548 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 nëntor 1999), f. 8.

fëmijët.¹⁶²⁶ Pastaj grave u thanë të shkonin në Glllogoc sepse pritej që të fillonte një ofensivë në Qirez; në Glllogoc do të mund të hipnin në autobus për në Maqedoni. Ato vepruan sipas udhëzimit; ato nuk u shoqëruan dhe keqtrajtuat prej askujt.¹⁶²⁷ Petar Damjanaci mohoi se ishte në dijeni të autobusëve të organizuar për dërgimin e shqiptarëve kosovarë në Maqedoni nga Glllogoci.¹⁶²⁸

636. Kufomat e tetë grave u gjetën në tri puse afër stallës në Qirez dhe u ekzaminuan nga misioni kriminalistik francez dikur në korrik 1999. Ato u varrosën fillimisht në Qirez e pastaj në "Varrezat e Dëshmorëve" në Likoshan.¹⁶²⁹

ii. Veprimet e UJ-së/MPB-së në zonë

637. Disa urdhra dhe raporte luftimi të UJ-së konfirmojnë se përpara dhe gjatë kohës së kryerjes së dhunës seksuale në Qirez, UJ-ja dhe MPB-ja po kryenin një operacion të përbashkët në komunën e Skënderajt. Më 22 mars 1999, Brigada e 37-të e Motorizuar u udhëzua të ngrinte një postëkomandë në fshatin Krasaliq në kufirin midis komunave të Vushtrisë dhe Skënderajt dhe pastaj të sulmonte në vijën e fshatrave Krasaliq-Kozhicë-Likoshan, të gjitha fshatra fqinje me Qirez. Më tej brigada u urdhërua që të bashkohej me njësitë e Brigadës së 15-të të Blinduar në Glllogoc.¹⁶³⁰ Brigada e 125-të e Motorizuar mori urdhër që të sulmonte në zonën në perëndim të Qirezit e pastaj të bashkohej me njësitë e Brigadës së 15-të të Blinduar në komunën e Glllogocit.¹⁶³¹ Në operacion morën pjesë edhe shtatë kompani të PJP-së, dy nga të cilat koordinonin me Brigadën e 37-të të Motorizuar.¹⁶³² Në thelb, kjo nënkuptonte se në fund të marsit Qirezi ishte i rrethuar nga forcat e UJ-së dhe PJP-së. Dikoviqi dëshmoi se më 22-23 mars grupi i tij luftarak mbërriti në Qirez ku hasi në civilë. Grupi luftarak qëndroi atje deri më 24 mars, dhe më tej kaloi në zonën e komunës së Vushtrisë.¹⁶³³ Sa i përket pranisë policore në Qirez, Nebojsja Bogunoviqi dëshmoi se forcat

¹⁶²⁶ Xhevahire Rrahmani, T. 1870–1871 (17 gusht 2006), P2239 (deklarata e dëshmitarit e datës 11 qershor 2001), f. 8.

¹⁶²⁷ Xhevahire Rrahmani, T. 1841 (17 gusht 2006), P2239 (deklarata e dëshmitarit e datës 11 qershor 2001), f. 8.

¹⁶²⁸ Petar Damjanac, T. 23823–23826 (6 mars 2008).

¹⁶²⁹ K24, T. 4779 (12 tetor 2006) (seancë e mbyllur), P2548 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 nëntor 1999), f. 9; Xhevahire Rrahmani, P2239 (deklarata e dëshmitarit e datës 11 qershor 2001), f. 8; IC85 (vizatim i vendit ku ishte stalla e shënuar nga K24 që tregon stallën, vendin ku u dhunua seksualisht, dhe pusin).

¹⁶³⁰ Lubisha Dikoviqi, T. 19955–19960 (10 dhjetor 2007); P2031 (Vendim i Komandës së Përbashkët, 22 mars 1999), f. 3–4.

¹⁶³¹ P2031 (Vendim i Komandës së Përbashkët, 22 mars 1999), f. 2–3. Dikoviqi shpjegoi se bashkimi me Brigadën e 15-të të Blinduar nuk donte të thoshte se të dy komandantët duhej të takoheshin personalisht, por se duhej t'i afroheshin njëri-tjetrit në një distancë të sigurtë për të kontrolluar zonën para tyre me zjarr. Lubisha Dikoviqi, T. 19964 (10 dhjetor 2007). *Shih gjithashtu* 5D463 (Raport Operativ i Brigadës së 125-të të Motorizuar dërguar PrK-së, 24 mars 1999).

¹⁶³² Lubisha Dikoviqi, T. 19959 (10 dhjetor 2007); P2031 (Vendim i Komandës së Përbashkët, 22 mars 1999).

¹⁶³³ Lubisha Dikoviqi, T. 19964–19967 (10 dhjetor 2007), T. 20018–20020 (11 dhjetor 2007); P2042 (Raport Operativ i Brigadës së 37-të të Motorizuar dërguar PrK-së, 23 mars 1999); P2043 (Raport Operativ i Brigadës së 37-të të Motorizuar dërguar PrK-së, 25 mars 1999); IC159 (Hartë e shënuar nga Dikoviqi që tregon lëvizjet e forcave të tij dhe forcave të tjera të UJ-së dhe vija që u arrit gjatë operacionit); IC160 (Hartë e shënuar nga Dikoviqi që tregon pozicionet

policore nuk ishin të pranishme në fshat në data 24-28 mars 1999.¹⁶³⁴ Nga 28 marsi, Brigada e 37-të e Motorizuar duhej të përqendronte forcat a saj në drejtimin Burojë-Turiçec-Llaushë dhe gjithashtu kishte detyrë të siguronte rrugët Skënderaj-Gllogoc dhe Skënderaj-Klinë.¹⁶³⁵ Sipas raportit ditor të brigadës të datës 29 mars, "njësia" kishte detyrë të pushtonte ditën e nesërme sektorin Skënderaj-Krushec-Prekaz i Poshtëm.¹⁶³⁶ Sidoqoftë, edhe pse Krusheci dhe Prekazi i Poshtëm janë fshatra në afërsi të Qirezit, kur u pyet nga Prokuroria Dikoviçi mohoi se forcat e tij ishin të pranishme në Qirez më 29 mars 1999.¹⁶³⁷

638. Në periudhën prej 30 marsit deri më 18 prill 1999, pjesa tjetër e Brigadës së 37-të të Motorizuar arriti në sektorin e Drenicës dhe u dislokua atje. Në atë moment efektiv i brigadës ishte 4.500 pjesëtarë dhe 31 tanke, si dhe u përforcua me rreth 100-150 vullnetarë. Ajo kishte detyrë bashkërendimin e veprimeve me MPB-në.¹⁶³⁸ Më 1 prill 1999, një grup luftarak i Brigadës së 125-të të Motorizuar u vendos në territorin e fshatrave Klinë e Poshtme dhe e Epërme dhe Prekaz i Epërm.¹⁶³⁹ Më 2 prill, i Akuzuari Llazareviq nënshkroi një urdhër të Korpusit të Prishtinës që urdhëronte Brigadën e 37-të të Motorizuar të dërgonte njësitë e saj në zonën e "fshatit Abri-Gllogoc-Vushtri-Mitrovicë (deri në Mitrovicë por pa të)."¹⁶⁴⁰ Si rrjedhojë më 4 prill Dikoviçi lëshoi një urdhër për njësinë e tij duke e urdhëruar q, në bashkërendim me Brigadat 252 dhe 15 të Blinduara, si dhe me forcat e MPB-së, të shkatërronte "FTSH-në" në zonën e Drenicës, duke përfshirë Prekazin e Epërm, Likocin, dhe Abrinë e Poshtme. Njëri prej batalioneve të brigadës kishte për detyrë të ngrinte postëkomandë në hyrje të fshatit Qirez.¹⁶⁴¹

639. Më 13 prill 1999, Dikoviçi lëshoi një "urdhër për mbrojtje" ku urdhëronte batalionin e dytë të motorizuar të brigadës së tij që të siguronte dhe mbronte sektorin e fshatit Likoc si dhe disa

e UÇK-së); IC161 (Hartë e shënuar nga Dikoviçi që tregon pozicionet e UÇK-së krahasuar me vijën e arritur nga njësia e Dikoviçit). *Shih gjithashtu* Petar Damjanac, T. 23761–23763 (6 mars 2008).

¹⁶³⁴ Nebojsa Bogunoviç, 6D1614 (deklarata e dëshmitarit e datës 2 prill 2008), para. 97.

¹⁶³⁵ Lubisha Dikoviçi, T. 19996–20000 (11 dhjetor 2007); P1969 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 28 mars 1999), f. 8; 5D339 (Urdhër Përgatitor i PrK-së i nënshkruar nga Llazareviçi, 28 mars 1999); P2047 (Raport Operativ i Brigadës së 37-të të Motorizuar dërguar PrK-së, 29 mars 1999); P2048 (Shtesë e Raportit Operativ të Brigadës së 37-të të Motorizuar, 29 mars 1999). *Shih gjithashtu* P2616 (Ditari i Luftës i Brigadës së 125-të të Motorizuar), f. 8–9, që konfirmon se brigada zbatoi urdhrat e Komandës së Përbashkët në lidhje me sektorin e Drenicës.

¹⁶³⁶ P2048 (Shtesë e Raportit Operativ të Brigadës së 37-të të Motorizuar, 29 mars 1999), f. 2.

¹⁶³⁷ Lubisha Dikoviçi, T. 19897–19898 (10 dhjetor 2007). *Shih gjithashtu* P2049 (Raport Operativ i Brigadës së 37-të të Motorizuar dërguar PrK-së, 30 mars 1999).

¹⁶³⁸ Lubisha Dikoviçi, T. 19870–19872 (10 dhjetor 2007), T. 19987–19995, 20001–20003 (11 dhjetor 2007). *Shih gjithashtu* 3D680 (Urdhër i Shtabit të Përgjithshëm për ndërrimin e varësisë së Brigadës së 37-të të Motorizuar/Armata e 2-të, 6 mars 1999); 5D1027 (Urdhër i Brigadës së 37-të të Motorizuar, 1 prill 1999).

¹⁶³⁹ P2038 (Raport luftimi i Brigadës së 125-të të Motorizuar dërguar PrK-së, 1 prill 1999).

¹⁶⁴⁰ P2030 (Urdhër i PrK-së, 2 prill 1999).

¹⁶⁴¹ P2813 (Urdhër i Brigadës së 37-të të Motorizuar, 4 prill 1999).

fshatra në komunën e Glllogocit afër kufirit të komunës së Skënderajt.¹⁶⁴² Kompania e 37-të Zbuluese kishte detyrë të bënte rikonjicionin dhe kontrollimin e terrenit në vijën e fshatrave Likoc dhe Rezallë, në jug të qytetit të Skënderajt dhe në perëndim të fshatrave Qirez dhe Baks.¹⁶⁴³ Më 18 prill 1999, Dikoviqi lëshoi një urdhër për vendosjen e postbloqeve në vende të ndryshme në zonën e tij të përgjegjësisë, njëri prej të cilëve ishte postbloku në "sektorin e Kralicës", jo shumë larg nga Qirezi.¹⁶⁴⁴ Sipas raportit të rregullt të luftimit të brigadës të datës 19 prill, më 18 prill NATO-ja kreu sulme ajrore kundër njësisë së tij zonën e Qirezit; njësitë e brigadës ishin dislokuar në sektorin e Çiçavicës dhe PJP-ja po kryente operacione në pjesët veriore të Malit të Drenicës.¹⁶⁴⁵

640. Më 20 prill 1999, Dikoviqi u dha urdhër njërive e tij për mbrojtjen e popullatës civile dhe parandalimin e "lëvizjeve ose përhapjes", dhe gjithashtu në urdhër thuhej se, nëse civilët gjendeshin në zonën e "veprimeve luftarake" ose nëse rrezikoheshin nga bombardimet e NATO-s, ata duhej të evakuoeshin në vendet më të përshtatshme ku prania e tyre nuk do të ndikonte në veprimet luftarake; në fund urdhri kërkonte që komandës së brigadës t'i dërgohej "menjëherë" një raport në lidhje me masat e marra dhe vendet më të mira të mundshme për civilët.¹⁶⁴⁶ Të njëjtën ditë, ai gjithashtu i dërgoi një kërkesë Komandës së Korpusit të Prishtinës për shpërndarjen e ndihmës humanitare popullatës vendore në bashkëpunim me Kryqin e Kuq të komunave të Skënderajt dhe Glllogocit.¹⁶⁴⁷ Më 21 prill, sipas një raporti tjetër që Dikoviqi i dërgoi Komandës së Korpusit të Prishtinës, Batalioni i 3-të i Motorizuar i Brigadës së 37-të të Motorizuar u vendos në zonën e Qirezit. Ky raport gjithashtu përmendte faktin se forcat e MPB-së në atë zonë nuk kishin marrë pjesë në asnjë aksion dhe nuk kishin bërë asgjë për të kontrolluar terrorin, po merreshin "vetëm me therjen e bagëtive dhe mbledhjen e plaçkës së luftës."¹⁶⁴⁸

641. Më 25 prill, Dikoviqi i raportoi Komandës së Korpusit të Prishtinës se njësitë e tij nuk ishin në gjendje të vinin nën kontroll të plotë zonën e Malit Çiçavicë dhe Malit Drenicë. Ai gjithashtu thoshte se mbështetja e MPB-së ishte e papërshtatshme dhe e pamjaftueshme dhe i quante forcat e MPB-së "uzurpatorë."¹⁶⁴⁹ Po atë ditë ai gjithashtu bëri një analizë të veprimeve në zonën e

¹⁶⁴² 5D1029 (Urdhër i Brigadës së 37-të të Motorizuar, 13 prill 1999), f. 4.

¹⁶⁴³ 5D1029 (Urdhër i Brigadës së 37-të të Motorizuar, 13 prill 1999), f. 8; 5D1055 (Urdhër i Brigadës së 37-të të Motorizuar, 16 prill 1999).

¹⁶⁴⁴ 5D1031 (Urdhër i Brigadës së 37-të të Motorizuar, 18 prill 1999).

¹⁶⁴⁵ 5D1023 (Raport luftimi i Brigadës së 37-të të Motorizuar, 19 prill 1999); 5D1411 (Raport luftimi i PrK-së dërguar Komandës së Armatës së 3-të, 19 prill 1999), f. 2.

¹⁶⁴⁶ 5D1033 (Urdhër i Brigadës së 37-të të Motorizuar, 20 prill 1999).

¹⁶⁴⁷ Lubisha Dikoviqi, T. 19908–19910 (10 dhjetor 2007); 5D1034 (Kërkesë e Brigadës së 37-të të Motorizuar dërguar PrK-së për ndihmë humanitare, 20 prill 1999). *Shih gjithashtu* 5D1059 (Raport luftimi i Brigadës së 37-të të Motorizuar, 5 maj 1999), f. 2.

¹⁶⁴⁸ 5D1087 (Raport i Brigadës së 37-të të Motorizuar dërguar Komandës së PrK-së, 21 prill 1999).

¹⁶⁴⁹ 5D1088 (Raport i Brigadës së 37-të të Motorizuar dërguar Komandës së PrK-së, 25 prill 1999).

Çiçavicës dhe Kosmaçit, në të cilën përmendte një numër dobësish dhe mangësish, ndër të cilat: mungesa e komunikimit, bashkëpunimit, dhe bashkërendimit midis njërive të UJ-së dhe MPB-së; fakti se numri i njërive dhe trupave të angazhuara në këto operacione ishte jo i përshtatshëm sepse operacionet mbulonin zona të mëdha, por kishin efekt "relativisht të kufizuar;" mungesa e stërvitjes së forcave rezerviste të UJ-së në kryerjen e "spastrimit" të "vendeve të populluara, pyjeve, bllokadave, bastisjeve, etj," angazhimi i "forcave relativisht të mëdha për të luftuar grupe të vogla terroristësh ('përdorimi i elefantit për të vrarë mizën');" mungesa e të dhënave të zbulimit gjithëpërfshirëse dhe në kohë për gjendjen dhe madhësinë e "FTSH-së" në rajone konkrete; dhe përdorimi i papërshtatshëm dhe jorezultativ i njërive të MPB-së, të cilët, në operacionin e Çiçavicës për shembull, thjesht "bënë një shëtitje rreth Çiçavicës pa arritur asgjë."¹⁶⁵⁰

642. Më 29 prill, Llazareviqi u dërgoi një urdhër komandantëve të Korpusit të Prishtinës, dhe rrjedhimisht edhe komandantit të Brigadës së 37-të të Motorizuar, në të cilin ai shprehej se "lëvizjet e pakontrolluara të trupave pa asnjë drejtim dhe në një mënyrë që nuk i ka hije ushtarit" ishin bërë dukuri e përditshme, përkundër përpjekjeve të Komandës së Korpusit të Prishtinës për ndalimin e tyre dhe përmendte Brigadën e 37-të të Motorizuar dhe disa brigada të tjera si shembull të këtij lloji sjelljeje. Si rrjedhojë ai i urdhëronte të gjithë komandantët që të këmbëngulnin "pa asnjë lëshim" për "paraqitjen e duhur e të gjithë pjesëtarëve të Korpusit," dhe të parandalonin çfarëdo forme të "sjelljes kryeneçe" të individëve apo grupeve.¹⁶⁵¹ Në zbatim të këtij urdhri, Dikoviqi lëshoi një urdhër më të ashpër për njësitë e tij ku kërkonte që, përveç atyre që përmenden më lart, "në mënyrë energjike të parandalojnë të gjitha krimet, plaçkitjet, dhe keqtrajtimin e popullatës civile dhe të paraqesin kallëzime penale të dokumentuara kundër përgjegjësve për incidente të tilla."¹⁶⁵²

643. Më 3 maj 1999, Dikoviqi i dërgoi një raport Komandës së Korpusit të Prishtinës në të cilin ankohej se forcat e MPB-së në zonën e tij të përgjegjësisë ende nuk kishin kaluar në vartësinë e tij dhe se UÇK-ja ishte ende aktive në atë zonë. Ai tha se si rezultat ai nuk ishte në gjendje të kontrollonte të gjithë zonën në mënyrë të suksesshme me njësitë që kishte në dispozicion.¹⁶⁵³ Më 4 maj, ai i raportoi Llazareviqit se të gjithë civilëve në zonën e përgjegjësisë së brigadës u "është dhënë strehim në godina të përshtatshme dhe askush nuk është lënë jashtë;" civilët janë nën

¹⁶⁵⁰ P2591 (Analizë e operacionit të Brigadës së 37-të të Motorizuar, 25 prill 1999).

¹⁶⁵¹ 5D385 (Urdhër i Komandës së PrK-së dërguar Komandantëve të PrK-së, 29 prill 1999). *Shih gjithashtu* 5D384 (Dokument i Komandës së PrK-së i nënshkruar nga Llazareviqi në lidhje me operacionet e Brigadës së 37-të të Motorizuar, 29 prill 1999).

¹⁶⁵² 5D1020 (Urdhër i Brigadës së 37-të të Motorizuar, 1 maj 1999).

¹⁶⁵³ 5D1080 (Raport i Brigadës së 37-të të Motorizuar në të cilën kërkohet vartësia mbi MPB-në, 3 maj 1999), gjithashtu e pranuar si 4D302.

kontrollin të njëjësive, njerëzit janë regjistruar ... Ata po trajtohen njerëzisht."¹⁶⁵⁴ Raporti gjithashtu theksonte se në zonën e përgjegjësisë së brigadës ishin 23.000 civilë dhe se rezervat e ushqimeve po mbaronin.¹⁶⁵⁵

644. Dikoviqi pranoi se, me gjithë masat e marra prej tij, disa nga ushtarët e tij kryen krime në gjysmën e parë të prillit. Të dhënat e Korpusit të Prishtinës tregojnë se nga data 10 deri më 15 prill, disa persona nga njësia e Dikoviqit morën pjesë në vrasjen e meshkujve shqiptarë kosovarë në zonën e Klinës së Epërme dhe më pas i hodhën kufomat në puse. Dokumentet tregojnë gjithashtu se një person tjetër, vullnetar nga njësia e Dikoviqit, vrau disa meshkuj shqiptarë kosovarë dhe mori gra nga kolonat e refugjatëve në fshatin Krasimirofc dhe rreth tij, jo shumë larg nga Qirezi.¹⁶⁵⁶

iii. Provat që identifikojnë viktimat

645. Misioni kriminalistik francez shkoi në Qirez në korrik 1999. Ai nxori tetë kufoma nga tri pusët dhe i ekzaminoi imtësisht. Rrobat u evidentuan në inventar dhe pastaj iu treguan njerëzve që i njihnin viktimat. Pas identifikimit, kufomat iu dhanë fshatarëve, të cilët i varrosën në varrezën vendore.¹⁶⁵⁷ Raporti i përgatitur nga misioni identifikon gratë si vijon Lumnie Zymeri, Bukurie Dibrani, Antigona Dibrani, Mirishahe Dibrani, Zahide Xhema, Fahrie Ademi, Miradie Dibrani, dhe Tahire Shalaku. Katër të parat u gjetën në një pus, e pesta në pusin e dytë, dhe tri të fundit u gjetën në pusin e tretë.¹⁶⁵⁸ Autopsitë treguan se të gjitha gratë kishin vdekur si rezultat i mbytjes dhe duhet të janë hedhur në pus të gjalla. Në kufomat e tyre nuk u gjetën plagë të shkaktuara para vdekjes. Dy nga kufomat, Lumnie Zymeri dhe Bukurie Dibrani kishin shenja të dhunës seksuale.¹⁶⁵⁹ U përcaktua se të gjitha kufomat kishin qenë në ujë rreth dy muaj e gjysmë, që sugjeronte se incidenti kishte ndodhur nga mesi i prillit.¹⁶⁶⁰ Dhoma vëren se fakti që në tetë gratë nuk u zbuluan plagë të

¹⁶⁵⁴ 4D303 (Raport i Brigadës së 37-të të Motorizuar dërguar Komandës së PrK-së, 4 maj 1999).

¹⁶⁵⁵ 4D303 (Raport i Brigadës së 37-të të Motorizuar dërguar Komandës së PrK-së, 4 maj 1999).

¹⁶⁵⁶ Lubisha Dikoviq, T. 20012–20016 (11 dhjetor 2007); 5D726 (Lista e kallëzimeve penale të paraqitura kundër ushtarëve të PrK-së, pa datë), f. 8–9. Kjo provë gjithashtu përmban hetimet e vrasjes së fshatarëve në Ticë të kryera nga vullnetarët e Brigadës së 37-të të Motorizuar, 5D726 (Lista e kallëzimeve penale të paraqitura kundër ushtarëve të PrK-së, pa datë), f. 4–5. *Shih gjithashtu* 4D171 (Të dhëna në lidhje me Procedimin Penal të Shkeljeve të Kryera në Kosovë, 6 prill 2001); P830 (Raport në lidhje me në lidhje me Procedimin Penal të Shkeljeve të Kryera nga UJ-ja, 9 prill 2002), f. 1–2.

¹⁶⁵⁷ P383 (Aktekzaminimi i vendngjarjes dhe aktautopsia – Qirez), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 3; P384 (Raporti Shtesë i Eric Baccard).

¹⁶⁵⁸ P383 (Aktekzaminimi i vendngjarjes dhe aktautopsia – Qirez), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 4–7; P384 (Raporti Shtesë i Eric Baccard-it).

¹⁶⁵⁹ P383 (Aktekzaminimi i vendngjarjes dhe aktautopsia – Qirez), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 56–71; P384 (Raporti Shtesë i Eric Baccard).

¹⁶⁶⁰ P383 (Aktekzaminimi i vendngjarjes dhe aktautopsia – Qirez), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 74; P384 (Raporti Shtesë i Eric Baccard).

shkaktuara para vdekjes tregon se ato nuk u vranë nga të shtënat e dëgjua nga K24-a dhe Rrahmani.

c. Shpërngulja nga fshatrat e Skënderajt

646. Në fillim të vitit 1999, Hadije Fazliu banonte me familjen e saj në Turiçec. Ajo dëshmoi se në mars të vitit 1999 UÇK-ja ishte e pranishme në fshat dhe disa nga fshatarët ishin anëtarë të saj. Shtabi i UÇK-së ishte vendosur në shkollën e fshatit. Fazliu nuk ishte në gjendje të thoshte se sa pjesëtarë të UÇK-së ishin të pranishëm në fshat sepse "njerëzit i bashkoheshin gjatë tërë kohës."¹⁶⁶¹ Liri Loshi, i cili punonte në Turiçec, dëshmoi se më 20 mars 1999 u sulmua qyteti i Skënderajt dhe shumë nga banorët e saj u shpërndanë në drejtime të ndryshme, një grup i madh i të cilëve shkoi në Turiçec. Loshi mjekoi dhe u kujdes për shumë prej tyre dhe mësoi se në shtëpi të ndryshme në qytet ishin vrarë 16 vetë, duke përfshirë edhe një profesor të tij të dikurshëm.¹⁶⁶² Kjo dëshmi mbështetet pjesërisht nga urdhri i Komandës së Përbashkët i 19 marsit i cili urdhëronte Brigadën e 125-të të Motorizuar, si dhe njësitë e PJP-së të zhblokoni qytetin e Skënderajt.¹⁶⁶³ Gjithashtu, sipas Loshit, më 24 mars 1999 u granatua fshati i afërt i Klladërnicsës dhe për pasojë u vranë tre persona.¹⁶⁶⁴

647. Fazliu dëshmoi se në mëngjesin e 26 marsit 1999, pasi "forcat serbe" filluan granatimin e Turiçecit nga drejtimi i Burojës, ajo dhe familja e saj vendosën të largoheshin.¹⁶⁶⁵ Prania e trupave të UJ-së dhe të PJP-së në zonën përreth në atë datë u konfirmua edhe nga një urdhër i Komandës së Përbashkët i datës 24 mars 1999 dhe nga dëshmia e Dikoviqit.¹⁶⁶⁶ Njerëzit nga fshati formuan një kolonë që u nis në drejtim të Tushilës, afërsisht tri kilometra nga Turiçeci. Me të arritur në Tushilë, ata panë shumë të tjerë të mbledhur atje, duke përfshirë njerëz nga komunat e Skënderajt, Klinës, dhe Glllogocit. Më 28 mars, në mbrëmje arriti një kolonë me gra nga Izbica. Fazliu takoi disa nga to dhe ato i treguan se në Izbicë ishte bërë "masakër." Ajo gjithashtu dëgjoi se kolona e grave ishte granatuar dhe ishte ndarë në dy pjesë, njëra prej të cilave kishte ardhur në Tushilë, dhe se si rezultat ishin vrarë një grua dhe dy fëmijë.¹⁶⁶⁷

648. Sipas Fazliut, më 29 mars 1999, rreth orës 08:00, "forcat serbe" erdhën në Tushilë në këmbë dhe kishin rrethuar njerëzit që ishin mbledhur aty. Në fillim erdhi policia e më pas erdhi ushtria me

¹⁶⁶¹ Hadije Fazliu, T. 1968, 1971 (18 gusht 2006), P2241 (deklarata e dëshmitarit e datës 21 tetor 2001), f. 2.

¹⁶⁶² Liri Loshi, P2436 (Paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 12.

¹⁶⁶³ P3049 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 19 mars 1999), f. 4.

¹⁶⁶⁴ Liri Loshi, P2436 (Paketa e Rregullës 92 bis), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 13, P2437 (transkript nga Prokurori kundër Millosheviqit, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 9481.

¹⁶⁶⁵ Hadije Fazliu, T. 1952–1954 (18 gusht 2006), P2241 (deklarata e dëshmitarit e datës 21 tetor 2001), f. 2.

¹⁶⁶⁶ P1968 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 24 mars 1999).

¹⁶⁶⁷ Hadije Fazliu, T. 1952–1957 (18 gusht 2006), P2241 (deklarata e dëshmitarit e datës 21 tetor 2001), f. 2–3.

tanke dhe automjete të tjera. Forcat e kombinuara iu afruan fshatit nga drejtimi i qyteteve të Klinës dhe Skënderajt dhe hapën zjarr drejt njerëzve në fshat. Fazliu pa shumë njerëz të lënduar dhe njërin të përgjakur. Më tej forcat i mbajtën njerëzit të rrethuar për rreth dy orë dhe i fyen e i shanë gjatë tërë kohës.¹⁶⁶⁸ Prania e UJ-së në atë zonë për të siguruar rrugën Skënderaj-Klinë, në të cilën gjendet Tushila, konfirmohet edhe në raportin operativ ditor të Brigadës së 37-të të Motorizuar të datës 30 mars, ku lexohet se njësia e kishte kryer vendosjen e forcave në zonën e përgjithshme të Skënderajt "ku mori pikat e përshtatshme për inspektimin e territorit dhe vijave që çojnë nga Glllogoci në Glinë [sic] në drejtim të Skënderajt dhe Mitrovicës."¹⁶⁶⁹

649. Në orën 10:00, kolona "u lejua" të largohej në drejtim të qytetit të Klinës. Fazliu pranoi se askush nuk i tha saj të largohej dhe se Klina ishte i vetmi opsion drejt të cilit mund të lëvizte kolona. Ndërkohë që u nisën, burrat u ndanë nga gratë. Më vonë Fazliu mësoi nga vëllai i saj se më shumë se 1.500 meshkuj i dërguan në një shkollë në Skënderaj, ku i morën në pyetje dhe tetë prej tyre i vranë.¹⁶⁷⁰ Meqenëse këto vrasje nuk janë përfshirë në Aktakuzë, Dhoma nuk do të nxjerrë konkluzione në lidhje me to.

650. Duke udhëtuar në drejtim të Klinës, Fazliu pa shumë ushtarë me tanke dhe autobllinda në rrugën kryesore. Ajo gjithashtu pa kufomat e gruas dhe dy fëmijëve për të cilët kishte dëgjuar më herët. Kur kolona kaloi pranë Turiçecit, ajo dhe femrat e tjera të familjes vendosën të ktheheshin në shtëpi. Atyre iu desh të rrinin në garazh sepse shtëpia ishte djegur. Ato qëndruan në fshat rreth dy ditë pa ushqime.¹⁶⁷¹

651. Më 1 prill 1999, në Turiçec erdhi "policia" me makina civile. Sapo panë që ishte policia, Fazliu dhe fshatarët e tjerë të mbetur ikën në drejtim të pyllit dhe ndaj tyre u hap zjarr. Më vonë ajo dëgjoji se atë ditë ishin vranë tre burra dhe i pa kufomat e tyre kur u kthye në fshat më vonë. Ajo ishte në një grup prej rreth 40 grash dhe ato u kapën nga disa policë, të cilët i fyen dhe u thanë të shkonin në drejtim të rrugës për në Klinë. Fillimisht ato shkuan në shkollën e Turiçecit, ku ishin mbledhur një numër i madh grash dhe fëmijësh. Meqë policia nuk i lejonte të ktheheshin në shtëpitë

¹⁶⁶⁸ Hadije Fazliu, T. 1954, 1972 (18 gusht 2006), P2241 (deklarata e dëshmitarit e datës 21 tetor 2001), f. 3. Sipas Fazliut, policia kishte uniforma kamuflimi ngjyrë të kaltër të mbyllët, kurse ushtarët kishin uniforma kamuflimi të gjelbra; të dy palët kishin armë të rënda. Disa policë kishin shami në kokë dhe fytyra të ngjyroshura.

¹⁶⁶⁹ P2049 (Raport luftimi i Brigadës së 37-të të Motorizuar dërguar PrK-së, 30 mars 1999), f. 2.

¹⁶⁷⁰ Hadije Fazliu, T. 1959–1960, 1972–1975 (18 gusht 2006), P2241 (deklarata e dëshmitarit e datës 21 tetor 2001), f. 3.

¹⁶⁷¹ Hadije Fazliu, T. 1957–1960 (18 gusht 2006), P2241 (deklarata e dëshmitarit e datës 21 tetor 2001), f. 3.

e tyre, të gjithë ata u nisën drejt rrugës kryesore. Ata kaluan nëpër fshatin Burojë dhe më pas morën drejt qytetit të Klinës.¹⁶⁷²

652. Nga Buroja, grupi shkoi në fshatin Jashanicë në komunën e Klinës. Në kolonë ishin më shumë se 1.000 gra e fëmijë dhe dy burra të moshuar. Përgjatë rrugës Fazliu pa disa kufoma. Ajo gjithashtu pa "forcat" duke plaçkitur dhe duke djegur shtëpi dhe bagëti në fshatrat nëpër të cilët kaluan. Kolona e kaloi natën në Jashanicë dhe të nesërmen më 2 prill 1999, u kthyen në Burojë nga frika se do të dërgoheshin në një fabrikë e cila mund të bombardohej më vonë. Në fshat, "forcat" i kthyen sërish në drejtim të Klinës.¹⁶⁷³

653. Në Klinë "policia" u tha të hipnin në kamionë, të cilët i transportuan në Volljakë, rreth pesë kilometra në jug të qytetit. Gjatë rrugës për në Volljakë, Fazliu pa pjesëtarë të ushtrisë me tanke. Nga Volljaka kolona shkoi në drejtim të Gjakovës. Natën e 4 prillit kolona arriti në kalimin kufitar të Qafës së Prushit. Fazliu dëshmoi se, për shkak se ushtria dhe policia kishte frikë se NATO-ja do ta bombardonte zonën, ata u lejuan të kalonin pa iu kërkuar dokumente apo para. Atë natë ajo dhe anëtarët e familjes së saj kaluan në Shqipëri.¹⁶⁷⁴

654. Dëshmitari i dytë i cili dëshmoi për shpërnguljet në komunën e Skënderajt ishte Abdullah Salihu, i cili ishte banor i Baksit, një apo dy kilometra në perëndim të Qirezit. Në atë kohë ai ishte 44 vjeç. Sipas tij, në mars 1999 pas tërheqjes së KVM-së, "ushtria serbe" dhe "parashtarakët" erdhën në fshatin fqinj të Qirezit.¹⁶⁷⁵ Ata erdhën me autobusë dhe kamionë dhe sollën armatime të rënda, duke përfshirë tanke dhe armë artilerike. Fshati i Salihut ishte plot me "parashtarakë," të cilët kishin shami në kokë dhe fytyrat e ngjyrosura. Ai dhe fshatarët e tjerë u strehuan në pyllin e afërt.¹⁶⁷⁶

655. Ndërsa ishte i fshehur në pyll me 10 meshkuj të tjerë, kushërinj të tij, më 28 prill 1999 Salihu pa kur NATO-ja bombardoi fabrikën e hekur-nikelit në Gillogoc, në të cilën ishte vendosur

¹⁶⁷² Hadije Fazliu, T. 1959–1960 (18 gusht 2006), P2241 (deklarata e dëshmitarit e datës 21 tetor 2001), f. 3.

¹⁶⁷³ Hadije Fazliu, T. 1961–1962 (18 gusht 2006), P2241 (deklarata e dëshmitarit e datës 21 tetor 2001), f. 3–4; IC11 (Hartë nga P615, faqe 17, që tregon Turuçecin, Tushilën, dhe Klinën).

¹⁶⁷⁴ Hadije Fazliu, T. 1962–1964 (18 gusht 2006), P2241 (deklarata e dëshmitarit e datës 21 tetor 2001), f. 4–5; IC12 (Hartë e marrë nga P615, faqe 22, që tregon qytetin e Gjakovës dhe fshatin Volljakë); P18 (Hartë që tregon rrugën që përshkoi Fazliu për të arritur në kufi).

¹⁶⁷⁵ Salihu dëshmoi se gjatë luftës kishte parë tri lloje të ndryshme uniformash. Ushtarët e rregullt të UJ-së kishin uniforma kamuflimi të gjelbra dhe zakonisht ishin të rinj. Rezervistët e UJ-së kishin uniforma ngjyrë hiri. Dhe në fund, parashtarakët kishin uniforma kamuflimi të gjelbra sikurse edhe ushtarët e rregullt, por gjithashtu mbanin shami në kokë dhe në krahë kishin shirita me ngjyra të ndryshme (të kuq, të kaltër, të verdhë). Ata zakonisht ishin më të vjetër, rreth 35-50 vjeç dhe kishin flokë të gjatë dhe mjekra të gjata. Abdullah Salihu, T. 1988–1990 (21 gusht 2006).

¹⁶⁷⁶ Abdullah Salihu, T. 1988, 1990 (21 gusht 2006), P2255 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 tetor 2000), f. 3.

PJP-ja.¹⁶⁷⁷ Më 29 prill, në atë zonë filloi edhe një ofensivë tjetër "serbe". Atë mëngjes "forcat serbe" filluan të granatonin vendin ku ishte fshehur Salihu. Ai i pa tanket kur erdhën ndërkohë që u afruan forcat e këmbësisë dhe rrethuan atë dhe shokët e tij. Ata u kapën nga një njësi "paraushtarake" e përbërë nga 30-40 burra me fytyra të ngjyrosura, uniforma kamuflimi të gjelbra dhe shami apo shirita me ngjyra në krahë, dhe emblema me shqiponjë ngjyrë të kaltër. Bazuar në uniformat e tyre ai mendoi se ishin njerëzit e Sheshelit. Shumica prej tyre kishin flokë të gjatë dhe mjekra dhe Salihut i thanë se disa prej tyre ishin serbë vendës.¹⁶⁷⁸

656. Pasi ishin kapur, ata i urdhëruan të shkonin në një lëndinë ku i kontrolluan dhe i rrahën me pushkë dhe copa druri. Ata u morën të gjitha gjërat me vlerë dhe dokumentet e identifikimit. Salihu u detyrua t'u jepte 600 marka gjermane dhe orën e dorës. Pastaj i çuan në Qirez me duar pas koke të shoqëruar nga 15 "ushtarë", të cilët nuk i keqtrajtuuan. Atyre iu bashkua edhe një grup burrash të kapur; gjithsej grupi kishte afërsisht 55 burra.¹⁶⁷⁹

657. Kur mbërritën në Qirez, Salihu pa shumë "forca" në të gjitha anët, nëpër shtëpi dhe jashtë tyre; thuajse të gjitha shtëpitë ishin të zëna nga "ushtria." Në orën 15:00, burrat erdhën para xhamisë së fshatit e cila ishte djegur, por muret nuk ishin rrëzuar. Burrat i dorëzuan te një grup prej 30-40 "paraushtarakësh" të cilët i rrahën me kondakë pushke. Paraushtarakët gdhendën kryqin me thikë në ballin e një burri. Keqtrajtimi vazhdoi për një orë në oborrin e xhamisë. Burrat e zënë robër i futën në xhaminë e djegur për t'i numëruar. Gjatë pasdites sollën edhe dy grupe burrash të kapur. Në atë moment ata ishin gjithsej 176 burra. Gjatë pyetjeve nga Mbrojtja, Salihu pranoi se kishte dëgjuar se UÇK-ja luftonte me forcat e RFJ-së/Serbisë në atë zonë, por këmbënguli se të gjithë burrat e kapur ishin civilë, sepse pjesëtarët e UÇK-së "më mirë vdisnin se të binin në duart e tyre."¹⁶⁸⁰

658. Të nesërmen më 30 prill 1999, erdhën katër "xhipa ushtarakë" pa shenja, tre prej të cilëve kishin "ngjyrë të gjelbër të UJ-së" dhe i katërti ishte i bardhë. Xhipat e gjelbër kishin targa ushtarake, kurse xhipi i bardhë nuk kishte as shenja, e as targa. Të gjithë burrat e kapur i urdhëruan të dilnin nga xhamia dhe të rreshtoheshin me fytyrë nga muri. Kur po dilnin nga xhamia, katër ose pesë ushtarë nga xhipat që ishin te porta, i rrahën. "Paraushtaraku" në komandë kishte flokë të zinj të gjatë dhe gradën në xhepin e gjoksit. Ai tha se kërkonte një luftëtar të UÇK-së me emrin Mirsad.

¹⁶⁷⁷ *Shih* para. 568 më lart.

¹⁶⁷⁸ Abdullah Salihu, T. 1990–1993, 2005–2006 (21 gusht 2006), P2255 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 tetor 2000), f. 4; IC13 (harta e komunës së Skenderajt e shënuar nga dëshmitari dhe që tregon zonën ku ishte fshehur me burrat e tjerë).

¹⁶⁷⁹ Abdullah Salihu, T. 2006 (21 gusht 2006), P2255 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 tetor 2000), f. 4.

Pasi i këqyri të gjithë burrat, ai u bind se Salihu ishte Mirsad dhe e nxori nga rreshti. Më pas tre ushtarë filluan ta rrihnin Salihun derisa humbi ndjenjat. Ata e tërhoqën zvarrë deri te një çezmë dhe i hodhën ujë. Më tej, njëri nga ushtarët i vuri Salihut revolen në qafë dhe e kërcënoi se do t'a vriste. Në fund ushtarët u kthyen te rreshti i burrave dhe morën shtatë burra të tjerë, të cilët i trajtuan në të njëjtën mënyrë.¹⁶⁸¹

659. Pas pak, në xhami erdhën tre "kamionë ushtarakë" të vegjël. Burrat e kapur u detyruan të hipnin në ta. Salihu hipi në kamionin e tretë në të cilin ishin 20 burra dhe tre ushtarë. Personi përgjegjës i urdhëroi shoferët që të niseshin në drejtim të Glllogocit. Kamionët ndaluan te "një vend i quajtur Shavarinë" afër Çikatovës së Vjetër. Salihu pa se kolonën e udhëhiqte një "xhip ushtarak". Kamioni i parë u zbraz dhe 27-30 vetë u rreshtuan në tri rreshta afër një grope me fytyrë nga ushtarët. Në secilën anë dhe përpara çdo grupi ishte nga një grup prej katër apo pesë ushtarësh me armë automatike. Personi përgjegjës i urdhëroi tre personat e armatosur përballë rreshtave të hapnin zjarr. Ata shtinë dhe Salihu pa njerëzit duke rënë në gropë. Menjëherë pas kësaj erdhi edhe një "xhip ushtarak" nga drejtimi i Glllogocit. Një "pjesëtar i ushtrisë së rregullt" doli nga xhipi dhe foli 20 minuta me personin përgjegjës për ekzekutimet dhe pas kësaj bisede dy kamionët e tjerë të mbushur me njerëz vazhduan në drejtim të Glllogocit.¹⁶⁸² Dhoma vëren se gjatë qëndrimit të saj në Kosovë, Gordana Tomasheviqi ekzaminoi 12 kufoma të djegura në një shtëpi në Çikatovë të Vjetër.¹⁶⁸³ Në mungesë të ndonjë prove tjetër, është e pamundshme për Dhomen që të konkludojë se këto 12 kufoma janë personat që u ekzekutuan në praninë e Salihut. Gjithashtu, këto vrasje nuk janë të përfshira në Aktakuzë. Rrjedhimisht, Dhoma nuk do të nxjerrë konkluzion në lidhje me to.

660. Kur arritën në Glllogoc, burrat nga kamioni i parë u urdhëruan të shkonin në sallën e kinemasë, kurse ata të kamionit të dytë përfshirë Salihun, u lanë në duart e policisë në oborrin e stacionit të policisë matanë rrugës. "Ushtarët" u larguan në atë moment dhe "policët" morën kontrollin. Salihu dëgjoi nga vëllai i tij i cili ishte në grupin tjetër, se rreth një orë pas mbërritjes atje, grupi i tij u dërgua në policinë e Prishtinës. Salihu dhe të tjerët që ishin me të u rrahën deri në mbrëmje, kur i dërguan në ndërtesën e kinemasë të ruajtur nga një polic me uniformë kamuflimi.¹⁶⁸⁴

¹⁶⁸⁰ Abdullah Salihu, T. 1993–1995, 2020–2021, 2027 (21 gusht 2006), P2255 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 tetor 2000), f. 4–5; P1801 (fotografi e xhamisë së Qirezit).

¹⁶⁸¹ Abdullah Salihu, T. 2037–2038 (21 gusht 2006); P2255 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 tetor 2000), f. 5.

¹⁶⁸² Abdullah Salihu, T. 1995–1996, 1999 (21 gusht 2006), P2255 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 tetor 2000), f. 5–6; IC14 (hartë e zonës e shënuar nga Salihu që tregon zonën ku ishin bërë ekzekutimet).

¹⁶⁸³ Gordana Tomasheviq, P2490 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 mars 2003), para. 17–22.

¹⁶⁸⁴ Abdullah Salihu, T. 1996, 2027–2028 (21 gusht 2006), P2255 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 tetor 2000), f. 6.

661. Të nesërmen, në kinema erdhi një "paraushtarak" me uniformë kamuflimi të gjelbër i cili ishte rreth 50 vjeç dhe kishte një shishe me raki në njëren dorë dhe pushkë automatike në dorën tjetër. Ai foli me policin përgjegjës dhe kërkoi të merrte një burrë që "i përkiste" atij. Polici i tha paraushtarakut të zgjidhte kë të donte. Më tej paraushtaraku iu drejtua Rrahman Topillës, e ndau nga të tjerët dhe e vrau me katër të shtëna. Pas vrasjes, polici u tha Salihut dhe të tjerëve se kështu do t'i vrisnin të gjithë.¹⁶⁸⁵ Petar Damjanaci, shef i DPB-së së Glllogocit, u pyet se a dinte gjë për këtë incident, por ai mohoi çfarëdo dijenie për të.¹⁶⁸⁶

662. Salihu dhe burrat e tjerë qëndruan atje edhe gjashtë ditë të tjera dhe u rrahën çdo ditë. Nuk u dhanë as ushqim. Në ditën e tretë, Salihun e mori në pyetje një inspektor policie, të cilin ai e njohte dhe i tha edhe emrin dhe ndihmësi i të cilit e rrahu këmbëve dhe shputave me shkop.¹⁶⁸⁷ Damjanaci u pyetur për këtë inspektor dhe ai dëshmoi se as në DPB-në e tij, as në SPB-në e Prishtinës nuk ekzistonte ndonjë person me këtë emër.¹⁶⁸⁸ Ai gjithashtu mohoi keqtrajtimin e personave të dyshuar si pjesëtarë të UÇK-së, për të cilët ai pranoi se ishin mbajtur në Glllogoc gjatë tërë vitit 1998 dhe deri në maj 1999.¹⁶⁸⁹

663. Në ditën e shtatë, tre "kamionë ushtarakë" i morën burrat në godinën e kinemasë. Kamioni i Salihut ndaloi në Vukofc, ku burrat u mbajtën deri në tërheqjen e forcave të RFJ-së/Serbisë, pas 37-40 ditësh. Ata i detyruan të punonin për forcat rezerviste të UJ-së, të cilët kishin uniforma "të ndyta ngjyrë të verdhë," në hapjen e llogoreve. Ata i vendosën në një shtëpi gjysmë të djegur dhe u dhanë ushqim dhe cigare. Ata u trajtuan përgjithësisht mirë nga rezervistët e UJ-së, me përjashtim të katër "paraushtarakëve."¹⁶⁹⁰ Ditën e tërheqjes së forcave të RFJ-së/Serbisë nga Kosova, të gjithë ata u çuan në një shkollë në Krajkovë dhe prej atje shkuan në këmbë në Baks.¹⁶⁹¹

664. Dëshmia e Salihut për mbajtjen e mbi 170 burrave mbështetet pjesërisht nga një raport luftimi i Dikoviçit i datës 1 maj 1999, ku ai i raportonte Komandës së Korpusit të Prishtinës se më 30 prill ishte ndërmarrë "operacion për thyerjen dhe shkatërrimin e FTSH-në" brenda zonës së përgjegjësisë së Brigadës. Operacioni ishte shtrirë në zonën midis Malit të Çiçavicës dhe "vijës së

¹⁶⁸⁵ Abdullah Salihu, T. 1996–1998, 2002, 2008–2009, 2029–2032 (21 gusht 2006), P2255 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 tetor 2000), f. 6–7.

¹⁶⁸⁶ Petar Damjanac, T. 23769–23770 (6 mars 2008).

¹⁶⁸⁷ Abdullah Salihu, T. 1998 (21 gusht 2006), P2255 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 tetor 2000), f. 7.

¹⁶⁸⁸ Petar Damjanac, T. 23769–23770 (6 mars 2008).

¹⁶⁸⁹ Petar Damjanac, T. 23811–23813, 23817–23818 (6 mars 2008). Gjatë pyetjeve, nga Prokuroria Damjanaci gjithashtu mohoi se kishte dijeni për incidentin në Abri të Poshtme në shtator 1998, edhe pse ky fshat ishte nën juridiksionin e DPB-së së Glllogocit. Damjanaci shpjegoi mospasjen e dijenisë me faktin DPB-ja kishte mbingarkesë dhe se zona ishte tepër e rrezikshme që policët e tij të shkonin atje; Petar Damjanac, T. 23813–23817 (6 mars 2008).

¹⁶⁹⁰ Abdullah Salihu, T. 1998–1999, 2006, 2010–2011 (21 gusht 2006), P2255 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 tetor 2000), f. 7; IC14 (hartë e shënuar nga Abdullah Salihu që tregon fshatin ku kishin punuar burrat në hapjen e llogoreve).

komunikimit" Skënderaj-Gllogoc, duke përfshirë fshatin Kralicë afër Qirezit dhe Baksit. Në raportin e tij Dikoviqi gjithashtu shënonte se ishin likuiduar 148 pjesëtarë të UÇK-së dhe ishin kapur "172 persona" që do të "procedoheshin sipas rregullit" nga organet e sigurimit të UJ-së.¹⁶⁹²

665. Disa dëshmitarë të thirrur nga Mbrojtja folën për lëvizje të mëdha të civilëve në komunën e Skënderajt dhe zonave përreth gjatë kësaj periudhe. Për shembull, Petar Damjanaci dëshmoi se UÇK-ja kishte arritur të mbillte aq shumë frikë në popullatën vendëse shqiptare kosovare sa që njerëzit ndiheshin të detyruar t'i bindeshin asaj. Si rezultat kur UÇK-ja i urdhëronte civilët të krijonin përshtypjen e katastrofës humanitare, njerëzit vepronin sipas urdhrit. Ky fakt së bashku me sulmet ajrore të NATO-s, rezultoi në lëvizjen e njerëzve nga një fshat në tjetrin, në pyje dhe kodra, apo kudo që ata mendonin se do të ishin të sigurtë nga sulmet e NATO-s. Damjanaci gjithashtu dëshmoi se kishte "urdhra nga lart" që të provonte të bindte njerëzit të rrinin në shtëpi, gjë të cilën ai u përpoq ta bënte; ai pati sukses vetëm sa u përket lagjeve të Gllogocit.¹⁶⁹³ Më pas ai deklaroi se nuk pati largime të grupeve të mëdha nga Gllogoci, por kryesisht "largime individuale" siç i përshkroi ai të njerëzve me makina private.¹⁶⁹⁴

666. Një tjetër dëshmitar që dëshmoi për këtë ishte Dikoviqi, i cili deklaroi se popullata filloi të lëvizte gjatë fushatës së NATO-s, jo vetëm për shkak të sulmeve ajrore të saj, por gjithashtu UÇK-ja donte të kishte sa më shumë civilë në lëvizje nëpër zonë, për t'i siguruar asaj mburojë, pjesëtarët e së cilës i fshihnin armët dhe përziheshin me popullatën civile dhe pastaj hapnin zjarr kundër forcave të RFJ-së/Serbisë.¹⁶⁹⁵ Nebojsa Bogunoviqi dëshmoi se ishte normale që njerëzit të largoheshin nga fshatrat që ishin bastione të UÇK-së apo nga fshatrat afër tyre, si për shembull Vojnika, Qirezi, dhe Turiçeci, për shkak të luftimeve të vazhdueshme midis forcave të RFJ-së/Serbisë dhe UÇK-së. Ai gjithashtu deklaroi se UÇK-ja mbajti kontrollin e asaj zone deri në fund të bombardimeve të NATO-s.¹⁶⁹⁶

d. Shkatërrimi i xhamisë së Qirezit

667. Pas qëndrimit të tij në xhaminë e Qirezit, siç është përshkruar më lart, Salihu gjithashtu dëshmoi se më vonë dëgjoi se ajo u shkatërrua plotësisht nga "serbët" rreth 15 ditë para tërheqjes së

¹⁶⁹¹ Abdullah Salihu, P2255 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 tetor 2000), f. 7.

¹⁶⁹² 5D1036 (Raport i Brigadës së 37-të të Motorizuar dërguar Komandës së PrK-së, 1 maj 1999), f. 1.

¹⁶⁹³ Petar Damjanac, T. 23755–23757 (6 mars 2008).

¹⁶⁹⁴ Petar Damjanac, T. 23821–23823 (6 mars 2008).

¹⁶⁹⁵ Lubisha Dikoviq, T. 19006 (10 dhjetor 2007).

¹⁶⁹⁶ Nebojsa Bogunoviq, 6D1614 (deklarata e dëshmitarit e datës 2 prill 2008), para. 84.

forcave të RFJ-së/Serbisë nga Kosova. Ai gjithashtu dëgjoi se ato kishin përdorur mina dhe bomba për shkatërrimin.¹⁶⁹⁷

668. Prova të tjera në lidhje me shkatërrimin e xhamisë së Qirezit u paraqitën nga eksperti i Prokurorisë, András Riedlmayer.¹⁶⁹⁸ Ndërmjet objekteve të diskutuara në aktekspertizën e tij ishte edhe xhamia e Qirezit, të cilën raporti e përshkruan si "thuajse të shkatërruar," që do të thotë se ndërtesa ishte praktikisht e shkatërruar, por ende kishte pjesë të identifikueshme të strukturës që qëndronin.¹⁶⁹⁹ Riedlmayer-i nuk e pa këtë xhami asnjëherë, po analizoi fotografi të saj të paraluftës dhe të pasluftës, të cilat sipas tij ishin bërë nga Sabri Bajgora i cili ishte zëvendësmyfti i Kosovës. Komentet në raport në lidhje me mënyrën e shkaktimit të dëmeve (granatim) dhe autorësinë e dëmtimit (sulmet serbe) gjithashtu janë bërë nga Bajgora. Riedlmayer-i mendonte se nga fotografitë ishte e vështirë të përcaktohej nëse dëmtimet janë bërë nga efekti i jashtëm i predhave apo nga shpërthimet nga brenda.¹⁷⁰⁰

5. Konkluzione

a. Shpërnguljet nga komuna

669. Prokuroria pretendon se më 25 mars 1999, forcat e RFJ-së dhe Serbisë granatuan disa fshatra në komunën e Skënderajt përfshirë edhe Vojnikën, Leqinën, Klladërnicën, Turiqecin, Qirezit dhe Izbicën, si rezultat i të cilit mijëra civilë ikën në Izbicë, ku u thanë se duhej të shkonin në Shqipëri. Prokuroria argumenton se atje të shpërngulurit u urdhëruan të shkonin në Klinë e më tej ata udhëtuan për në Gjakovë dhe kaluan në Shqipëri.¹⁷⁰¹

670. Mbrojtja e Llazareviqit e kundërshton dëshminë e Hadije Fazliut dhe pretendon se UJ-ja nuk granatoi fshatrat, por luftoi me UÇK-në në atë pjesë të komunës dhe përfundoi pjesëmarrjen në operacion më 28 mars 1999.¹⁷⁰² Mbrojtja e Llazareviqit gjithashtu i referohet dëshmisë së Abdullah Salihut në lidhje me "paraushtarakët" si provë se UJ-ja nuk u implikua në shpërngulje dhe kapje të njerëzve.¹⁷⁰³ Ajo gjithashtu vë në dukje provat se UJ-ja u shpërndau ndihma humanitare civilëve në komunën e Glllogocit dhe mënyrën e trajtimit të grave në Qirez pas përvojave të hidhura që kishin

¹⁶⁹⁷ Abdullah Salihu, T. 1994–1995 (21 gusht 2006); P1801 (fotografia e xhamisë së dëmtuar rëndë në Qirez).

¹⁶⁹⁸ P1789 (Aktekspertiza e András Riedlmayer-it).

¹⁶⁹⁹ András Riedlmayer, T. 5425–5426, 5476 (30 tetor 2006); P1778 (Pjesë nga P1789 në lidhje me xhaminë në Qirez).

¹⁷⁰⁰ András Riedlmayer, T. 5473, 5476–5477 (30 tetor 2006).

¹⁷⁰¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 371–375.

¹⁷⁰² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 162–170.

¹⁷⁰³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 153–156.

pasur, si provë se UJ-ja tregoi kujdes të madh për civilët.¹⁷⁰⁴ Mbrojtja e Pavkoviqit i kundërshton pretendimet për shpërnguljen e dhunshme të organizuar në këtë komunë duke theksuar se dëshmitarët e ftuar nga Prokuroria ose qëndruan në komunë (Draga dhe Thaqi), ose nuk ofruan dëshmi se UJ-ja u tha të largoheshin nga Kosova (Rrahmani dhe Fazliu).¹⁷⁰⁵

671. Bazuar në të gjitha provat, Dhoma konkludon se më 26 mars 1999 fshati Turiçec u granatua nga forcat e RFJ-së/Serbisë nga Buroja dhe banorët e tij formuan një kolonë ku ishte Hadije Fazliu, e cila u nis drejt Tushilës në lindje. Prania e këtyre forcave në atë zonë në kohën që lidhet me Aktakuzën konfirmohet nga urdhri i Komandës së Përbashkët i 24 marsit dhe dëshmia e Dikoviqit se ai kishte përdorur grupin e tij luftarak dhe tanket në atë zonë. Dhoma gjithashtu kujton se Zhivanoviqi dëshmoi se brigada e tij, konkretisht, Brigada e 125-të e Motorizuar, u angazhuar në atë zonë vetëm në anën lindore të Turiçecit. Sidoqoftë, Dhoma vëren se Fazliu e Zyrapit dëshmuar se UÇK-ja ishte e pranishme në Turiçec në atë kohë dhe se kishte një shtab atje. Gjithashtu, Zhivanoviqi dëshmoi se forcat e UÇK-së ishin vendosur në Tushilë.

672. Dhoma gjithashtu konkludon se në fund forcat e MPB-së edhe të UJ-së erdhën në Tushilë, siç dëshmoi Fazliu, dhe se më pas u formua një kolonë e re, e cila u nis drejt Klinës. Fazliu u bashkua me kolonën edhe pse askush nuk i tha të largohet. Kjo dëshmi e Fazliut konfirmohet pjesërisht nga Dikoviqi, i cili dëshmoi se në atë kohë ai priste të kishte shumë civilë në atë zonë për shkak të luftimeve me UÇK-në dhe se si rrjedhojë mori urdhër t'i largonte në ndonjë zonë më të sigurtë.

673. Dhoma Gjyqësore e pranon dëshminë e Abdullah Salihut se rreth datës 20 ose 21 mars UJ-ja arriti në Qirez ose së paku në zonat përreth Qirezit, siç konfirmohet nga urdhrat e Komandës së Përbashkët të datave 19 dhe 22 mars, si dhe nga dëshmia e Lubisha Dikoviqit. Këto burime gjithashtu mbështesin dëshminë e Salihut në lidhje me praninë e tankeve në atë zonë, meqenëse Dikoviqi pranoi se grupi i tij luftarak kishte në dispozicion gjashtë tanke. Dëshmia e Salihut në lidhje me një tjetër "ofensivë serbe" që u zhvillua në atë zonë më 29 prill gjithashtu mbështetet nga raporti i Brigadës së 37-të të Motorizuar i 1 majit 1999, ku përmendet se brigada ndodhej afër fshatit të Salihut, Baksit. Dhoma gjithashtu konkludon se Salihu u kap rob nga njerëz që ai i quajti "paraushtarakë," të cilët e keqtrajtuan, ia morën dokumentet e identifikimit dhe paratë, dhe më pas e çuan në Qirez së bashku me 170 burra të tjerë, ku vazhduan të keqtrajtoheshin. Dhoma vëren se "paraushtarakët" nuk vepronin të pavarur nga UJ-ja dhe MPB-ja, por bashkëpunonin me ta dhe ata

¹⁷⁰⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 149–150, 171–173.

mund të kenë qenë rezervistë të UJ-së apo forca të tjera speciale. Raportet e luftimit prej Dikoviqit të Dikoviqit gjithashtu përmendin njësitë e tij në atë zonë, madje në një raport përmendet arrestimi i 172 pjesëtarëve të UÇK-së. Sa i përket mbajtjes të Salihut në Glllogoc, Dhoma e pranon dëshminë e tij dhe vëren se shefi i DPB-së së Glllogocit, Petar Damjanac, konfirmoi se në qytet mbaheshin njerëz. Edhe pse Damjanaci mohoi keqtrajtimin e çfarëdoshëm të të mbajturve, Dhoma konkludon se gjatë mbajtjes së tij në Glllogoc Salihu u keqtrajtua nga "paraushtarakët" dhe policia.

674. Dhoma konkludon se, edhe pse Rrahmanit i thanë të shkonte në Glllogoc për shkak të ofensivës së afërme në Qirez, kur autobusi në të cilin ndodhej mbërriti në Glllogoc, forcat a atjeshme e drejtuan për në Maqedoni.

675. Rrjedhimisht, Dhoma konkludon se Fazliu, Salihu, dhe Rrahmani, si dhe shumë të tjerë, u dëbuar prej shtëpive të tyre nga forcat e UJ-së dhe MPB-së. Ata u dërguan në drejtim të kufirit e më pas kaluan ose në Shqipëri, ose në Maqedoni.

b. Vrasjet në Izbicë

676. Prokuroria argumenton se forcat e RFJ-së dhe Serbisë ishin përgjegjëse për vrasjet në Izbicë, meqenëse ato ndërmorën një operacion të përbashkët në atë kohë, në zonën në fjalë.¹⁷⁰⁶ Duke u mbështetur në dëshminë e Milazim Thaqit, Prokuroria gjithashtu argumenton se ishte një komandant në UJ-ja, personi që urdhëroi ekzekutimin në atë ditë dhe vë në dukje se viktimat ishin kryesisht burra të moshuar e jo ushtarë të UÇK-së.¹⁷⁰⁷

677. Asnjë nga ekipet mbrojtëse nuk pretendon se nuk ka pasur vrasje, edhe pse Mbrojtja e Llukiqit kundërshton faktin se ato ndodhën në Izbicë dhe se viktimat ishin civilë. Duke u mbështetur në Lubisha Dikoviqin, Sllagjan Pantiqin, Mustafa Dragën dhe provat dokumentare të UJ-së, Mbrojtja e Llazareviqit argumenton se UJ-ja nuk ishte e implikuar në këto vrasje. Ajo gjithashtu pretendon se fshati Izbicë ishte çerdhe "terroriste", duke e përligjur operacionin e përbashkët dhe ngre pikëpyetje ndaj besueshmërisë së Liri Loshit, Milazim Thaqit, dhe Mustafa Dragës.¹⁷⁰⁸ Edhe Mbrojtja e Pavkoviqit mohon implikimin e UJ-së në vrasjet dhe kundërshton dëshminë gojore të Thaqit në këtë aspekt duke u bazuar në mospërmendjen e UJ-së në deklaratën e

¹⁷⁰⁵ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 410–413. *Shih gjithashtu* Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 989–990, 994, Argumentet Përmbyllëse të Llukiqit, T. 27377–27379 (26 gusht 2008).

¹⁷⁰⁶ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 373–379.

¹⁷⁰⁷ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 375; Argumentet Përmbyllëse të Prokurorisë, T. 26876–26787 (19 gusht 2008), T. 26920–26922 (20 gusht 2008).

¹⁷⁰⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 131–137.

tij të mëparshme.¹⁷⁰⁹ Duke u mbështetur në dëshminë e Pantiqit, Mbrojtja e Llukiqit pretendon njësitë e PJP-së nuk hynë në Izbicë por kaluan pranë saj dhe rrjedhimisht e kundërshton dëshminë e Dikoviqit se MPB-ja ishte përgjegjëse për problemin e civilëve afër Izbicës. Ajo gjithashtu argumenton se Izbica dhe fshatrat përreth kishin prani të madhe të UÇK-së dhe se natyra dhe ashpërsia e luftimeve midis UÇK-së dhe forcave serbe atje duhet t'i ketë shkaktuar UÇK-së viktima të shumta. Mbrojtja e Llukiqit i kundërshton dëshminë e Thaqit dhe Dragës në lidhje me identifikimin prej tyre të forcave në Izbicë, sidomos përshkrimin e tyre jopërputhës të personit që urdhëroi ekzekutimin, si dhe disa mospërputhje të tjera të brendshme në dëshminë e Dragës. Mbrojtja e Llukiqit gjithashtu pretendon se vendvarrimi në Izbicë u rregullua në atë mënyrë që të paraqiste pamje të pavërtetë të ngjarjeve. Në mbështetje të këtij pretendimi, ajo ngre çështjen e kufomave të varrosura në atë vend para dhe pas incidentit të 28 marsit 1999, dhe thekson faktin se për një kohë pas 28 marsit 1999, zona ishte nën kontrollin e UÇK-së dhe si pasojë ishte objektiv katër operacioneve të tjera të përbashkëta të UJ-së/MPB-së në prill dhe maj, të cilat duhet të kenë rezultuar në më shumë viktima të UÇK-së.¹⁷¹⁰ Së fundi Mbrojtja e Llukiqit thekson se, menjëherë pas zbulimit të varrit të përbashkëta në Izbicë, SPB-ja e Mitrovicës filloi hetimet dhe bëri një zhvarrim.¹⁷¹¹

678. Dhoma është bindur se dëshmitë e dhëna nga mbijetuesit e vrasjeve në Izbicë janë të besueshme dhe të sakta në shumë aspekte. Ngjarjet e përjetuara nga mbijetuesit janë tejet tronditëse dhe Dhoma gjykon se është e pamundshme që ata të kenë kujtime plotësisht të njëjta të ngjarjeve. Gjithsesi ata mund të jenë ndjerë të obliguar ta ndihmojnë Dhomën dhe, në ndonjë rast, si rezultat i kësaj, mund të kenë bërë gabime në lidhje me imtësitë, siç është për shembull përshkrimi i individëve konkretë. Rrjedhimisht, Dhoma nuk gjykon se ndryshimet midis rrëfimit të ngjarjeve të asaj dite së Thaqit dhe Dragës e komprometojnë dëshminë e tyre.

679. Dhoma konkludon se, më 28 mars 1999, mbi 100 burra u ndanë nga gratë dhe fëmijët në një arë në Izbicë. Këta burra u ndanë në dy grupe dhe u pushkatuan, siç u përshkrua nga mbijetuesit e ngjarjes. Edhe Draga, edhe Januzi vlerësuan se një grup kishte rreth 70 vetë kurse Thaqi dëshmoi se ai numëroi 33 vetë në grupin e dytë, duke përfshirë edhe veten. Dhoma ka dëgjuar dëshmi se nga ky incident mbetën gjallë 14 vetë. Përveç burrave të vrarë në dy grupet, katër të tjerë të moshuar u vranë në arë. Shumica e njerëzve të vrarë atë ditë ishin të moshuar, fakt që rrëzon pretendimin se ata ishin pjesëtarë aktivë të UÇK-së. Faktikisht në raportin e saj Gordana Tomasheviqi vëren se shumica e viktimave ishin me rroba civile. Dhoma e ka analizuar videofilmimin lidhur me dy

¹⁷⁰⁹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 573–577.

¹⁷¹⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 947–988, 991–994, 1392–1407.

kufomat e përshkruara nga Mbrojtja e Llazareviqit se kishin të veshura pjesë uniformash dhe vëren se të dy përshkrimet i referohen të njëjtës kufomë të një burri të moshuar, palltoja e gjelbër e të cilit nuk duket si uniformë.

680. Duke shqyrtuar një nga kundërshtimet e Mbrojtjes së Llukiqit, Dhoma pranon se fillimisht Draga dëshmoi se burrat në Izbicë u ndanë në dy grupe, por më pas përmendi gjithsej katër grupe. Sidoqoftë, Dhoma gjithashtu vëren se grupi më i madh i burrave, në të cilin ishte Draga, duket se është ndarë në tri grupe më të vogla sepse, sipas Dragës, vendet ku këto tri grupe u ekzekutuan janë afër njëri-tjetrit dhe në fakt, misioni kriminalistik francez i ekzaminoi si një vend ekzekutimi i vetëm.

681. Rrjedhimisht, duke marrë parasysh se rreth 103 u ndanë në dy grupe dhe u pushkatuan dhe se 14 prej tyre mbijetuan, Dhoma konkludon se më 28 mars u vranë afërsisht 89 burra ashtu siç është përshkruar në Aktakuzë. Për më tepër duke u bazuar në dëshminë e njërit prej mbijetuesve, Dhoma gjithashtu konkludon se ekzekutimit të përshkruar më lart, në arën në Izbicë u panë edhe kufomat e katër burrave të moshuar.

682. Prokuroria i ka përfshirë emrat e 118 personave në Listën F midis të vrarëve në Izbicë gjatë këtyre ngjarjeve. Sidoqoftë, dëshmitë për vërtetimin se këta 118 emra janë persona nga dy grupet e ekzekutuara dhe të moshuarit e vrarë në arë u paraqitën në mënyrë të tillë që e bëjnë të pamundshme për Dhomën që t'i identifikojë të gjithë të vrarët atë ditë në mënyrën e përshkruar në Aktakuzë. Kjo vlen veçanërisht duke marrë parasysh se në vendvarrimin në Izbicë u pranë njerëz të tjerë dhe se disa nga ata ishin pjesëtarë të UÇK-së. Rrjedhimisht për identifikimin e këtyre viktimave, Dhoma do të mbështetet vetëm në dëshmitë e mbijetuesve dhe videofilmin e Liri Loshit që tregon vendet e ekzekutimit, por jo të vendvarrimit.

683. Njëzet e një personat e mëposhtëm të përfshirë në Listën F, u përmendën nga Thaqi, Draga, dhe/ose Januzi se, ose ishin në këto dy grupe ose kufomat e tyre u panë nga Draga në arë në Izbicë pas vrasjes së tyre: Ilaz Bajra, Ali Draga, Cen Draga, Hajriz Draga, Ismet Draga, Murat Draga, Rrustem Draga, Sami Loshi, Jashar Loshi, Selman Loshi, Shaban Musliu, Ismajl Qelaj, Rexhep Qelaj, Metush Qelaj, Idriz Shala, Isuf Shala, Sali Shala, Zymer Shala, Halim Shala, Ukë Uka, dhe Zojë Osmani. Të 21 personat janë përmendur edhe në listën e përgatitur nga Afrim Xhemajli dhe Liri Loshi gjatë varrimit më 31 mars 1999. Kufomat e pesë prej këtyre 21 personat, konkretisht të Sami Loshit, Jashar Loshit, Selman Loshit, Metush Qelajt, dhe Zojë Osmanit u gjetën më vonë në

¹⁷¹¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 995–1000.

varrin e përbashkët në Petrovo Sellë në Serbi dhe Dhoma disponon si prova materialin përkatës mjeko-ligjor në lidhje me këto viktime. Gjithashtu, siç është përshkruar më lart, në lidhje me 16 kufomat e tjera Dhoma ka prova të tjera, përfshirë edhe fotografi të nxjerra prej videofilmimit të Loshit, dhe që të gjitha mbështesin dëshmitë e dëshmitarëve okularë. Rrjedhimisht, Dhoma është bindur jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se 21 viktimat e identifikuar me emër u vranë më 28 mars 1999 në Izbicë ashtu siç u përshkrua nga mbijetuesit.

684. Për gjashtë viktimat që vijnë të përmendur me emër në Listën F, provat kryesore që i lidhin ata me vendin e ekzekutimit në Izbicë janë videofilmimi dhe fotografitë e kufomave të tyre të bëra nga Loshi dhe shoku i tij: Brahim Bajra, Fazli Bajra, Bajram Dervishi, Hamdi Doqi, Sadik Hoti, dhe Hysen (A) Shala. Rrjedhimisht, duke marrë parasysh këto prova dhe prova të tjera, si dhe faktin se Dhoma mundi t'i shihte këto kufoma, duke konstatuar se shumica ishin të moshuar, ajo është bindur jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se ata u vranë më 28 mars 1999 në Izbicë në mënyrën e përshkruar nga mbijetuesit e ekzekutimit.

685. Sa për viktimat e tjera të përmendura me emër në Listën F, Prokuroria nuk ka arritur të tregojë lidhjen e mjaftueshme me vendet e ekzekutimit ose me dy personat që pretendohet se janë vrarë në arë. Si rrjedhojë, megjithëse Dhoma konkludon se u vranë afërsisht 93 persona, ajo nuk është në gjendje të thotë me saktësi se cilat nga viktimat e mbetura të identifikuar me emër në Listën F kanë qenë midis tyre, edhe pse është e qartë se shumica e tyre ishin midis të vrarëve.¹⁷¹²

686. Sa i përket autorëve të vrasjeve në Izbicë, edhe Thaqi, edhe Draga dëshmuan për implikimin e forcave të MPB-së. Gjatë dëshmisë para Dhomës, ata përmendën për herë të parë se edhe ushtarët e UJ-së ishin të pranishëm në luginë gjatë vrasjeve. Sidoqoftë, Dhoma vëren se në mbështetje të mendimit të tij, Thaqi dëshmoi se ushtarët e UJ-së ishte atje dhe kishin veshur "ngjyra jugosllave" dhe emblema në të dy krahët. Provat tregojnë se emblema e PJP-së në atë kohë përmbante ngjyrat e flamurit jugosllav, se njësitë e PJP-së e mbanin në të dy krahët dhe se kishin uniforma kamuflimi të gjelbra. Si rezultat përshkrimi i Thaqit tregon se këto forca ishin njësi të PJP-së. Sa i përket Dragës, në deklaratën e tij si dëshmitar ai përmend konkretisht uniforma kamuflimi të kaltra dhe të gjelbra, por thotë se të gjithë kishin emblemat policore në to. Gjithashtu, gjatë pyetjeve nga Mbrojtja ai pranoi se kishte shumë frikë t'i shikonte forcat. Rrjedhimisht, Dhoma nuk është bindur me identifikimin e ushtarëve të UJ-së nga këta dy dëshmitarë dhe përfundon se është bindur vetëm për implikimin e forcave të MPB-së.

¹⁷¹² Përshkrim më i imtë i provave kriminalistike dhe provave të tjera në lidhje me viktimat konkrete të Izbicës gjendet në Shtojcën A të këtij Aktgjykimi.

687. Gjithashtu, edhe pse pranoi se njësia e tij ishte në atë zonë, Dikoviqi mohoi qartësisht vajtjen e saj në fshatin Izbicë ose ndonjë kontakt me civilët. Dëshmia e tij mbështetet edhe nga urdhrat e UJ-së në lidhje me këtë operacion dhe, në njëfarë mase, nga Pantiqi, polici që shërbeu si udhërrëfyes për disa forca të UJ-së dhe PJP-së, megjithëse dëshmia e tij u përqendrua vetëm në një njësi të PJP-së dhe një numër të vogël ushtarësh të UJ-së. Dhoma gjithashtu thekson dëshminë e Dikoviqit se në atë operacion konkret, MPB-ja kishte detyrë të kujdesej për civilët dhe se ata e bënë këtë në afërsi të Izbicës. Rrjedhimisht Dhoma përfundon se ekzekutimi i së paku 93 vetëve në Izbicë më 28 mars 1999 u krye nga forcat e MPB-së, konkretisht, nga PJP-ja, kurse njësitë e UJ-së ishin në afërsi.

c. Dhuna seksuale në Qirez

688. Prokuroria pretendon se forcat e RFJ-së dhe Serbisë e sulmuan Qirezit në fund të marsit 1999 dhe se "disa ushtarë dhe paraushtarakë" dhunuan seksualisht një grup grash dhe vranë së paku tetë prej tyre.¹⁷¹³ Mbrojtja e Llazareviqit mohon pjesëmarrjen e UJ-së në këtë incident dhe thekson dëshminë e dëshmitarit okular se personat e përfshirë mbanin uniforma të zeza dhe ngjyrë kafe, uniforma të kaltra, dhe uniforma kamuflimi të gjelbra me shirita në krahë. Mbrojtja e Llazareviqit gjithashtu kundërshton dëshminë e Rrahmanit në lidhje me granatimin e Kozhicës në fund të marsit duke vënë në dukje dokumentet dhe dëshmitarët e UJ-së si Lubisha Dikoviqi, që sugjerojnë se më 29 mars 1999 UJ-ja ishte në luftime larg fshatit.¹⁷¹⁴ Mbrojtja e Pavkoviqit mohon pjesëmarrjen e UJ-së në incidentin e Qirezit dhe i referohet trajtimit të mirë të këtyre grave nga persona me uniforma të gjelbra, si dhe faktit se ato u keqtrajtuuan nga burra me uniforma si të paraushtarakëve.¹⁷¹⁵ Mbrojtja e Llukiqit është e vetmja që kundërshton incidentin e dhunës seksuale dhe/ose përdhunimeve në Qirez. Për këtë, ajo bazohet në faktin Rrahmani nuk ka pa se çfarë u ndodhi vajzave më të reja që u morën nga stalla. Mirëpo Mbrojtja e Llukiqit nuk është në gjendje t'i përgjigjet dëshmisë së K24ës dhe provave kriminalistike të përmendura më lart.¹⁷¹⁶ Gjithashtu, duke u mbështetur në dëshminë e Bogunoviqit dhe dokumente të UJ-së Mbrojtja e Llukiqit kundërshton praninë e forcave të MPB-së në Qirez në fillim të prillit 1999 dhe përmend praninë e

¹⁷¹³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 372.

¹⁷¹⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 142–148.

¹⁷¹⁵ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 650–652.

¹⁷¹⁶ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 375. Dhoma vëren se ky paragraf i dosjes përfundimtare është hequr nga Mbrojtja e Llukiqit, por konsideron se nuk përmban të dhëna konfidenciale dhe rrjedhimisht është në gjendje t'u referohet argumenteve të tij.

Batalionit të 3-të të Motorizuar të Brigadës së 37-të të Motorizuar të UJ-së në fshat gjatë tërë prillit.¹⁷¹⁷

689. Dhoma është bindur se dëshmia e K24-ës, si dhe e Rrahmanit, janë të sakta dhe të besueshme. Rrjedhimisht, Dhoma mendon se rreth mesit të prillit 1999, si K24-a, po ashtu edhe Rrahmani u prekën në mënyrë seksuale dhe kërcënuese. Gjithashtu, së paku dy gra të tjera u dhunuan seksualisht dhe më pas u hodhën të gjalla në pus së bashku me gjashtë gra të tjera. Të tetë gratë vdiqën si pasojë e mbytjes. Dhoma vëren se këto vrasje nuk janë përfshirë në Aktakuzë dhe rrjedhimisht nuk do të ketë vendim fajësie në lidhje me to.

690. Në lidhje me autorët e dhunës seksuale, Dhoma vëren se, gjatë tërë prillit forcat e UJ-së dhe të MPB-së ishin në Qirez, siç konfirmohet nga disa urdhra të prillit 1999 dhe raporte luftimi të Brigadës së 37-të të Motorizuar. Duke u bazuar në të njëjtat urdhra dhe raporte, Dhoma është bindur se edhe forcat e MPB-së ishin të pranishme në atë zonë dhe se siç raporton Dikoviqi ato sillëshin keq dhe plaçkitnin. Gjithashtu, Dhoma i referohet dëshmisë së Dikoviqit se pjesëtarë të njësisë së tij ishin hetuar për vrasjen e shqiptarëve kosovarë dhe për fshehjen e kufomave të tyre duke i hedhur në puse. Sidoqoftë, Dhoma vëren se burrat e përshkruar si keqbërësit nga K24-a dhe Rrahmani kishin ose uniforma të zeza dhe ngjyrë kafe, ose uniforma kamuflimi të gjelbra me shirita të kuq dhe emblemat e tigris. Po ashtu K24-a përmendi një burrë me uniformë kamuflimi të kaltër të mbyllët, i cili liroi atë dhe gratë e tjera nga stalla. Edhe Salihu dëshmoi për praninë e "paraushtarakëve" në Qirez. Pranimi i këtyre dëshmive hedh dyshime mbi pretendimin se keqbërësit ishin pjesëtarë të rregullt të UJ-së. Edhe më shumë dyshime ndjell fakti se, kur u kthyen në Kozhicë, gratë shkuan te ushtarët e UJ-së dhe u treguan se çfarë kishte ndodhur. Pas kësaj ushtarët u përpoqën të hetonin dhe të gjenin tetë gratë e tjera, të cilat në atë kohë me siguri ishin dhunuar seksualisht dhe ishin hedhur në puse. Rrjedhimisht Dhoma nuk mund të konkludojë me saktësi se kush i dhunoi seksualisht këto gra, por konstaton se autorët vepronin në bashkëpunim me forcat e UJ-së të pranishme në atë zonë në atë kohë dhe se ata ishin burra me uniforma dhe të armatosur, të cilët ishin pjesë e forcave të RFJ-së dhe Serbisë.

d. Shkatërrimi i xhamisë së Qirezit

691. Prokuroria pretendon se, gjatë sulmeve të lartpërmendura kundër fshatrave në komunë, forcat e RFJ-së/Serbisë shkatërruan xhaminë e Qirezit.¹⁷¹⁸ Nga ana tjetër, Mbrojtja e Llazareviqit

¹⁷¹⁷ Argumentet Përmbyllëse të Llukiqit, T. 27379–27380 (26 gusht 2008).

¹⁷¹⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 371.

pretendon në anën tjetër se i vetmi dëshmitar që ka dëshmuar në lidhje me këtë ishte Abdullah Salihu, i cili nuk është dëshmitar okular i ngjarjes.¹⁷¹⁹

692. Dhoma Gjyqësore është bindur se xhamia u dëmtua në fund të marsit 1999, siç përshkruhet nga Abdullah Salihu. Salihu dëgjoi më vonë se xhamia u shkatërrua plotësisht nga "serbët" dhe në bazë të fotografive Andrés Riedlmayer-i konkludoi se faktikisht ajo ishte thujse e shkatërruar. rrjedhimisht Dhoma nuk dyshon se xhamia u shkatërrua. Sidoqoftë, provat nuk i ofrojnë Dhomës vërtetim bindës mbi mënyrën dhe autorët e shkatërrimit.

H. MITROVICA

1. Akuzat në Aktakuzë

693. Aktakuza i ngarkon të Akuzuarit me përgjegjësi për tri kategori të ndryshme të krimeve kundër njerëzimit që pretendohet se janë kryer në komunën e Mitrovicës: dëbim, zhvendosje të dhunshme, dhe përndjekje. Akuza e përndjekjes pretendohet se është kryer në formën e "dhunës seksuale nga forcat e RFJ-së dhe Serbisë kundër shqiptarëve kosovarë, veçanërisht kundër grave, dhe "shkatërrim apo dëmtim pa shkak të objekteve fetare të shqiptarëve kosovarë," duke përfshirë dëmtimin dhe/ose shkatërrimin e xhamive në Mitrovicë.¹⁷²⁰

694. Akuzat në lidhje me Mitrovicën paraqiten në paragrafin 72(f) të Aktakuzës, si vijon:

Duke filluar më 25 mars 1999 ose rreth kësaj date, dhe gjatë mesit të prillit të vitit 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë filluan të lëviznin sistematikisht nëpër qytetin e Mitrovicës. Ata hynë në shtëpitë e shqiptarëve të Kosovës dhe i urdhëruan banorët që t'i lëshonin menjëherë shtëpitë dhe të shkonin në stacionin e autobusëve. Disa shtëpive iu vu zjarri, kështu që banorët u detyruan të iknin në lagje të tjera të qytetit. Së paku njëra prej xhamive të qytetit u dogj dhe u dëmtua. Gjatë një periudhe trejavore, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë vazhduan të dëbonin banorët shqiptarë kosovarë të qytetit. Gjatë kësaj periudhe, objektet që ishin pronë e shqiptarëve kosovarë u shkatërruan dhe shqiptarëve kosovarë iu grabitën të holla, automjete dhe artikuj të tjerë me vlerë, kurse gratë shqiptare kosovare u dhunuan seksualisht. Një praktikë e ngjashme u zbatua në fshatrat e tjera të komunës së Mitrovicës ku forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i dëbuan shqiptarët kosovarë nga shtëpitë dhe i shkatërruan fshatrat. Banorët shqiptarë kosovarë të kësaj komune u detyruan t'u bashkoheshin kolonave drejt kufirit me Shqipërinë duke kaluar përmes qyteteve Skënderaj, Pejë, Gjakovë dhe Prizren. Gjatë rrugës për në kufi, oficerët e forcave të RFJ-së dhe të Serbisë u grabitën artikuj me vlerë dhe u konfiskuan letërnjoftimet.¹⁷²¹

¹⁷¹⁹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 157.

¹⁷²⁰ Aktakuza, para. 77(c) dhe (d).

¹⁷²¹ Aktakuza, para. 72(f).

2. Rrethanat

695. Komuna e Mitrovicës gjendet në pjesën veriore të Kosovës në skaj të vargmaleve të Kopaonikut, e kufizuar ndër të tjera me komunën e Podujevës në lindje, të Vushtrisë në juglindje, dhe të Skenderajt në jugperëndim.¹⁷²² Qyteti kryesor është Mitrovica, e cila gjendet në jug të komunës.¹⁷²³ Fshatrat Zhabar dhe Shipol janë afër Mitrovicës në jugperëndim të saj.

696. Dhoma Gjyqësore dëgjoi tre dëshmitarë të paraqitur nga Prokuroria në lidhje me krimet që pretendohet se janë kryer në Mitrovicë: Mahmut Halimi, avokat shqiptar kosovar i cili jetonte dhe punonte në Mitrovicë; Afërdita Hajrizi, grua shqiptare kosovare e cila banonte në qytet me familjen dhe e cila punon si mësuese e anglishtes; dhe Sadije Sadiku, grua shqiptare kosovare nga Zhabari. Dhoma e ka shqyrtuar me kujdes besueshmërinë e këtyre dëshmitarëve, duke marrë parasysh ndër të tjera kundërshtitë ndaj dëshmimeve të tyre gjatë pyetjeve nga Mbrojtja dhe përputhjen me dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë dhe me provat dokumentare. Gjatë dëshmisë së tij, Mahmut Halimi u pyet nga Mbrojtja në lidhje me implikimin tij në dhënien e ryshfetit gjyqtarëve kur punonte si avokat për të pandehur. Ai pranoi se kishte marrë pjesë në këto veprime, duke shpjeguar se kështu punonte sistemi në atë kohë.¹⁷²⁴ Dhoma e beson dëshmitarin në lidhje me këtë dhe e konsideron Halimin të sinqertë dhe të ndershëm në dëshminë e tij. Mbrojtja nuk ngriti kundërshtime ndaj besueshmërisë së Hajrizit dhe Dhoma e konsideron të besueshme dhe të saktë dëshminë e saj për vrasjen e burrit dhe djalit të saj dhe largimin e saj të mëpastajshëm nga qyteti. Dëshmia e Sadije Sadikut për ngjarjet në komunë në mes të prillit 1999 përgjithësisht përputhej me dëshminë e Halimit, edhe pse me ndryshime të vogla në data, që nuk janë thelbësore. Ajo konsiderohet dëshmitare e besueshme dhe e saktë.

697. Bislim Zyrapi dëshmoi se në vitin 1998 dhe 1999 komuna e Mitrovicës u nda midis dy zonave operative to UÇK-së, zonës së Shalës ose zonës së katërt operative në pjesën perëndimore të komunës dhe zonës së Llapit ose zonës së pestë operative në pjesën lindore.¹⁷²⁵ Të dyja zonat mbulonin disa komuna.¹⁷²⁶ Është e pakundërshtueshme se në shtator 1998 forcat e MPB-së të

¹⁷²² P615 (Atlasi i Kosovës), f. 2, 6.

¹⁷²³ P615 (Atlasi i Kosovës), f. 6.

¹⁷²⁴ Mahmut Halimi, T. 4472–4475 (9 tetor 2007).

¹⁷²⁵ Bislim Zyrapi, T. 5967 (6 nëntor 2006), T. 6258–6259 (10 nëntor 2006); P2469 (Hartë që tregon zonat operative të UÇK-së).

¹⁷²⁶ Zona Operative e Shalës përfshinte komunat e Zveçanit, Zubin Potokut, Leposaviqit, Mitrovicës, dhe pjesë të Vushtrisë. Zona Operative e Llapit mbulonte pjesë të Mitrovicës, si dhe të komunave të Podujevës, Lipjanit, Kamenicës, Prishtinës, Obiliqit, dhe Fushë-Kosovës, *Shih* P2469 (Hartë që tregon zonat operative të UÇK-së).

mbështetura nga UJ-ja kryen disa operacione në verilindje të qytetit të Mitrovicës "për pastrimin e terrenit nga pjesëtarët e UÇK-së."¹⁷²⁷

698. Në dosjen përfundimtare, Prokuroria pretendon se, duke filluar rreth shkurtit e deri në mars 1999, forcat e UJ-së shtuan praninë në zonën e Mitrovicës dhe se, rreth datës 17 mars, në atë zonë u mobilizuan shumë forca të MPB-së duke përfshirë edhe pjesëtarët e PJP-së, të cilët u sollën në Kosovë nga Serbia.¹⁷²⁸ Procesverbal i mbledhjes së kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së të 11 marsit 1999 tregon se Gjorgje Qurçini, i cili ishte shef i Administratës së Parë në Sektorin për Çështje Operative dhe të Personelit, raportoi se Brigada e 37-të e Motorizuar ishte zhvendosur nga Rashka në Serbinë jugperëndimore, në Mitrovicë.¹⁷²⁹ Gjatë dëshmisë me gojë, Qurçini shpjegoi se pjesa e Brigadës së 37 të Motorizuar që ishte zhvendosur në Mitrovicë përbëhej afërsisht prej 375 pjesëtarëve dhe se zhvendosja u bë për ta mbrojtur vijën nga Mitrovica deri te kufiri me Maqedoninë nga një sulm i përbashkët tokësor i UÇK-së dhe NATO-s.¹⁷³⁰ Gjithashtu, shefi i atëhershëm i SPB-së së Mitrovicës, Lubinko Cvetiq, dëshmoi se pas 17 marsit 1999 në Kosovë u dërguan pjesëtarë shtesë, rezervistë dhe të rregullt, të MPB-së nga pjesë të tjera të Serbisë.¹⁷³¹

699. Dhoma kujton se operacionet sipas planit Grom 3 u kryen nga fundi i marsit 1999 nga forcat e UJ-së dhe MPB-së në zonat e Podujevës, Bajgorës, dhe Stantërgut në lindje dhe verilindje të qytetit të Mitrovicës.¹⁷³² Sidoqoftë, provat e paraqitura nga Prokuroria në lidhje me ngjarjet në këtë komunë, që analizohen më poshtë, kanë lidhje me vendet në perëndim dhe jugperëndim të qytetit, në fshatrat Zhabar dhe Shipol si dhe brenda në qytetin e Mitrovicës. Lubomir Saviqi, i ishte komandant i Brigadës së 58-të të Këmbësores së Lehtë, shpjegoi se MPB-ja dhe UJ-ja fillimisht vendosën të ndërmerrnin operacione në zonën e Bajgorës dhe Stantërgut në verilindje të komunës dhe se vetëm nga mesi i majit 1999 u angazhuan në një operacion të quajtur *Bajgora-2*, që mbulonte qytetin e Mitrovicës dhe zonat në perëndim të saj.¹⁷³³

700. Me gjithë mungesën e provave për operacione luftarake në qytet dhe zonat në perëndim të tij para mesit të majit 1999, ka prova për dislokimin e forcave të MPB-së dhe UJ-së në këtë zonë. Një

¹⁷²⁷ K79, T. 9609–9610 (1 shkurt 2007); P1718 (Vendim për bashkimin forcave të MPB-së dhe UJ-së për të shkatërruar Forcat Terroriste Sabotatore në rajonin e fshatit Bajgorë).

¹⁷²⁸ Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 407, citon Millorad Obradoviçin, T. 15108 (6 shtator 2007).

¹⁷²⁹ P935 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Jugosllave (UJ) për 11 mars 1999), f. 11.

¹⁷³⁰ Gjorgje Qurçin, T. 16943–16944 (5 tetor 2007).

¹⁷³¹ Lubinko Cvetiq, T. 8049–8050 (7 dhjetor 2006).

¹⁷³² P2808 (Urdhër i PrK-së, 16 shkurt 1999); P3049 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 19 mars 1999); P1966 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 22 mars 1999), f. 8; P2616 (Ditari i Luftës i Brigadës së 125-të të Motorizuar); P2056 (Ditari i Luftës i Brigadës së 125-të të Motorizuar); 5D464 (Ditari i Luftës i Brigadës së 125-të të Motorizuar); 5D465 (Ditari i Luftës i Brigadës së 125-të të Motorizuar); 5D466 (Ditari i Luftës i Brigadës së 125-të të Motorizuar).

dokument i datës 17 prill 1999, të cilit nuk i dihet autori, përmend vendet e njësisive të ndryshme të PJP-së dhe evidenton se Kompania e 1-rë dhe e 5-të e Detashmentit të 35-të të PJP-së ishin të dislokuara në fshatin Shipol, Kompania e 2-të ishte e dislokuar në fshatin Zhabar, dhe Kompania e 4-të ishte e dislokuar në Tavnik, lagje e qytetit të Mitrovicës.¹⁷³⁴ Kur iu tregua ky dokument, Nebojsa Bogunoviqi konfirmoi se Detashmenti i 35-të dhe 85-të i PJP-së ishin të dislokuar në Mitrovicë, ashtu siç thuhej në dokument.¹⁷³⁵ Gjithashtu, Bogunoviqi tha se në zonën e Shipolit ishte një postbllok i përbashkët i UJ-së dhe MPB-së.¹⁷³⁶

3. Qyteti i Mitrovicës

701. Prokuroria pretendon se më 24 mars 1999 ose rreth kësaj date policia serbe filloi të vinte në shënjestër figurat e shquara shqiptare në qytetin e Mitrovicës. Ajo gjithashtu pretendon se oficerë të MPB-së nga SPB-ja e Mitrovicës hynë në shtëpinë e Agim Hajrizit dhe vranë atë, nënën e tij Nazmie Hajrizin, dhe djalin e tij Ilir Hajrizin.¹⁷³⁷ Prokuroria gjithashtu pretendon se kryetari i LDK-së në komunë, Latif Berisha, u vra në të njëjtën natë.

702. Afërdita Hajrizi dëshmoi me imtësi për vrasjen e burrit të saj, Agim Hajrizi, udhëheqës i njohur i sindikatave, dhe djalit të saj Ilirit dhe vjehrrës Nazmies në shtëpinë e tyre në qytetin e Mitrovicës në natën e 24-25 marsit 1999. Të nesërmen ajo kishte dëgjuar në radion lokale se ishte vrasë edhe Latif Berisha.¹⁷³⁸ Mahmut Halimi konfirmoi se Berisha u vra atë natë.¹⁷³⁹ Asnjë nga këto vrasje nuk është përfshirë në Aktakuzë, por ato kanë rëndësi për gjendjen në qytet dhe për ikjen e Afërdita Hajrizit dhe Mahmut Halimit nga shtëpitë e tyre.

703. Hajrizi dëshmoi se, natën e 24-25 marsit, gjashtë burra me uniforma kamuflimi ngjyrë të kaltër të mbyllët dhe me bereta të zeza, erdhën me dy makina në shtëpinë e saj.¹⁷⁴⁰ Ata hynë me forcë në shtëpi dhe vranë burrin, djalin, dhe vjehrrën e saj, kurse ajo u fsheh në tavan me dy fëmijët

¹⁷³³ Lubomir Saviq, T. 20983–20984 (24 janar 2008).

¹⁷³⁴ 5D1417 (dislokimi i PJP-së më 17 prill 1999). Duhet theksuar se dëshmitarët dhe dokumentet në serbisht përmendin një lagje të Mitrovicës si Tamnik. Dëshmitarët që flisnin shqip e quajtën Tavnik. Edhe pse Dhoma nuk ka prova që konfirmojnë se është e njëjta lagje, gjithsesi duket se është.

¹⁷³⁵ Nebojsa Bogunoviq, T. 25121–25123 (10 prill 2008).

¹⁷³⁶ Nebojsa Bogunoviq, 6D1614 (deklarata e dëshmitarit e datës 6 prill 2008), para. 89.

¹⁷³⁷ Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 408.

¹⁷³⁸ Afërdita Hajrizi, T. 4042–4073 (26 shtator 2006), P2319 (deklarata e dëshmitarit e datës 31 janar 2002), P2320 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 mars 2002), P2321 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02–54–T), T. 3887–3911.

¹⁷³⁹ Mahmut Halimi, T. 4446 (9 tetor 2006).

¹⁷⁴⁰ Afërdita Hajrizi, T. 4047–4053 (26 shtator 2006).

e tjerë.¹⁷⁴¹ Hajrizi identifikoi qartë dy prej autorëve si pjesëtarë të policisë së rregullt, të cilët ajo i njihnte. Sidoqoftë, ajo tha se ata dhe autorët e tjerë nuk kishin uniforma të policisë së rregullt, por uniforma të cilat ajo i përshkroi si të "policisë paraushtarake." Dhoma kujton se uniformat e kamuflimit në ngjyrë të kaltër ishin uniforma standarde që përdorehin nga policia e rregullt dhe nga PJP-ja.¹⁷⁴² Dhoma gjithashtu vëren se, edhe pasi PJP-ja u pajis me uniformat e reja të kamuflimit në ngjyrë të gjelbër, pjesëtarët e PJP-së i mbajtën uniformat e kamuflimit në ngjyrë të kaltër.¹⁷⁴³

704. Pas largimit të keqbërësve, Hajrizi i dërgoi fëmijët në një shtëpi të afërt në lagjen Tavnik. Të nesërmen në mëngjes, ajo u takua me vëllain e saj dhe shkoi e bujti tri ditë te ungji i saj në fshatin Zhabar. Ajo dëshmoi se, duke ikur nga shtëpia e saj pa shumë "forca serbe" nëpër rrugë me uniforma kamuflimi të gjelbra dhe maska të gjelbra.¹⁷⁴⁴ Hajrizi kishte frikë se ata që kishin vlarë burrin e saj, sidomos njëri prej tyre që e njihnte atë nga pamja, mund të ishin duke e kërkuar dhe mund t'i bënin ndonjë gjë asaj dhe fëmijëve të saj të tjerë. Më 27 mars 1999, ajo u kthye në Mitrovicë në shtëpinë e vëllait.¹⁷⁴⁵

705. Më tej Hajrizi dëshmoi në lidhje me çfarë kishte parë dhe përjetuar më 28 mars 1999. Atë ditë, "serbët" filluan t'i digjin shtëpitë dhe t'i dëbonin njerëzit nga lagja Tavnik në qytetin e Mitrovicës. Forcat i urdhëruan njerëzve të largoheshin, duke bërë titur "Ky nuk është vendi juaj. Kjo është Serbi. Shkoni në Shqipëri," dhe "Keni dashtë NATO-n, thirrni NATO-n pra të vijë e t'ju ndihmojë. Do t'ju vrasim të gjithëve."¹⁷⁴⁶ Shtëpia e një aktivisti vendor, Halit Barani, që ishte afër shtëpisë së vëllait të saj në Tavnik, ishte djegur.¹⁷⁴⁷ Ajo i përshkroi keqbërësit si forca të përbëra nga "policia e rregullt," "paraushtarakët," dhe UJ-ja, dhe tha se ata e urdhëruan popullatën vendore të largoheshin për në Shqipëri.¹⁷⁴⁸ Hajrizi shpjegoi se ajo mendonte se këto forca kishin edhe pjesëtarë të UJ-së sepse "... policia kishte uniforma të kaltra. Ushtria kishte uniforma të gjelbra."¹⁷⁴⁹ Ajo

¹⁷⁴¹ Afërdita Hajrizi, T. 4047–4053 (26 shtator 2006).

¹⁷⁴² K86, T. 7349–7351, 7356 (24 nëntor 2006) (seancë e mbyllur); K25, T. 4664 (11 tetor 2006).

¹⁷⁴³ K86, T. 7349–7351, 7356 (24 nëntor 2006) (seancë e mbyllur).

¹⁷⁴⁴ Afërdita Hajrizi, P2320 (deklarata e dëshmitarit e datës 20 gusht 2001), f. 3, P2319 (deklarata e dëshmitarit e datës 31 janar 2002), f. 8.

¹⁷⁴⁵ Afërdita Hajrizi, P2319 (deklarata e dëshmitarit e datës 31 janar 2002), f. 8.

¹⁷⁴⁶ Afërdita Hajrizi, T. 4065–4066 (26 shtator 2006); P2320 (deklarata e dëshmitarit e datës 20 gusht 2001), f. 4.

¹⁷⁴⁷ Afërdita Hajrizi, P2320 (deklarata e dëshmitarit e datës 20 gusht 2001), f. 4.

¹⁷⁴⁸ Afërdita Hajrizi, P2320 (deklarata e dëshmitarit e datës 20 gusht 2001), f. 3, T. 4054–4055 (26 shtator 2006) ("Ne na detyruan. E përsëris, na detyruan të iknim. Shumë vrasje ndodhën rreth nesh. Shumë shtëpive iu vu zjarri. Shumë njerëz u morën dhe u burgosën. Dëgjoheshin shumë zëra njerëzish që tregonte se dikush i detyronte të largoheshin."). Dëshmitarja përshkroi se forcat paraushtarake i kishin fytyrat e ngjyrosura, mbanin doreza pa gishta, dhe kishin thika në majë të pushkëve. *Shih* Afërdita Hajrizi, T. 4068, 4070 (26 shtator 2006). Ajo përshkroi se forcat e UJ-së të kishin uniforma të gjelbra, por jo ato të zakonshmet sepse ata kishin maska në fytyrë kështu që iu shiheshin vetëm sytë dhe kishin bajoneta në pushkë. *Shih gjithashtu* Afërdita Hajrizi, T. 4072 (26 shtator 2006).

¹⁷⁴⁹ Afërdita Hajrizi, T. 4068, 4070–4072 (26 shtator 2006).

gjithashtu tha se forcat të cilat ajo i kishte identifikuar si ushtri e rregullt nuk ishin ushtri e rregullt që kishte parë para 25 marsit 1999, por persona "me uniforma të gjelbra... me simbole ushtarake" me maska në fytyrë që iu shiheshin vetëm sytë, dhe me pushkë me bajoneta.¹⁷⁵⁰ Si rezultat, Hajrizi dhe familja u larguan nga Mitrovica së bashku me një grup të madh njerëzish dhe përsëri u nisën drejt fshatit Zhabar.¹⁷⁵¹ "Forcat serbe" të pranishme në rrugë shkrepnin armët dhe e drejtonin kolonën e njerëzve në drejtim të Zhabarit. Hajrizi vlerësoi se, si pasojë më 28 mars 1999, 70.000 banorë të qytetit të Mitrovicës u detyruan të largoheshin nga shtëpitë.¹⁷⁵²

706. Mbrojtja e Llukiqit pretendon se është e mundshme që Agim Hajrizi dhe nëna e djali i tij të jenë vrarë nga UÇK-ja, "sidomos duke marrë parasysh faktin se po atë natë u vra një tjetër aktivist politik shqiptar që ishte kundër UÇK-së," duke iu referuar vrasjes së Latif Berishës.¹⁷⁵³ Mbrojtja e Llukiqit sugjeron si alternativë se një polic nga Mitrovica, i cili u dënua në mungesë për vrasje, e kreu krimin për arsye personale, e jo gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare.¹⁷⁵⁴ Ky argument alternativ është paraqitur edhe nga Mbrojtja e Pavkoviqit.¹⁷⁵⁵

707. Një raport i Shtabit të MPB-së i datës 26 mars 1999 përmend vrasjen e Agim Hajrizit, Nazmie Hajrizit, dhe Ilir Hajrizit, dhe sugjeron se autorët ishin "terroristët shqiptarë."¹⁷⁵⁶ Mirëpo Dhoma Gjyqësore e kundërshton këtë përfundim duke marrë parasysh dëshminë e qartë të Afërdita Hajrizit për vrasjen e burrit të saj dhe për personat përgjegjës. Dhoma gjithashtu vëren se për këtë krim u dënuan dy burra, njëri prej të cilëve punonte për MPB-në,¹⁷⁵⁷ por i kushton pak rëndësi këtij fakti sepse këto dënime u dhanë në mungesë para një trupi gjykues të kryesuar nga dëshmitari Mahmut Halimi, mik i ngushtë i viktimës.¹⁷⁵⁸

708. Afërdita Hajrizi gjithashtu dëshmoi se më 1 prill "serbët" urdhëruan atë dhe njerëzit e tjerë të strehuar në Zhabar që të ktheheshin në qytetin e Mitrovicës, dhe ajo e familja e saj u kthyen.¹⁷⁵⁹ Më 3 prill ungji i saj i tha se "serbët" kishin organizuar autobusë për transportimin e shqiptarëve jashtë Kosovës. Ajo dhe familja e saj vendosën "të hipnin në autobusë". Kur të nesërmen mbërritën

¹⁷⁵⁰ Afërdita Hajrizi, T. 4072 (26 shtator 2006).

¹⁷⁵¹ Afërdita Hajrizi, T. 4055 (26 shtator 2006).

¹⁷⁵² Afërdita Hajrizi, T. 4055, 4072 (26 shtator 2006).

¹⁷⁵³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 1003.

¹⁷⁵⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 1003, që i referohet P51-shit (Aktgjykimi në lidhje me vrasjet e familjes Hajrizi).

¹⁷⁵⁵ Dosja Përfundimtare e Pavkoviqit, (versioni publik) para. 435.

¹⁷⁵⁶ 6D1234 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 26 mars 1999). *Shih gjithashtu* Nebojsa Bogunoviq, 6D1614 (deklarata e dëshmitarit e datës 6 prill 2008), para. 88 edhe T. 25194–25195 (11 prill 2008).

¹⁷⁵⁷ P51 (Aktgjykimi në lidhje me vrasjet e familjes Hajrizi).

¹⁷⁵⁸ P51 (Aktgjykimi në lidhje me vrasjet e familjes Hajrizi).

¹⁷⁵⁹ Afërdita Hajrizi, P2320 (deklarata e dëshmitarit e datës 20 gusht 2001), f. 5.

në stacionin e autobusëve, stacioni ishte i rrethuar nga "forcat serbe." Pas kësaj ajo dhe familja e saj shkuan në Mal të Zi me autobus. Pas një jave në Mal të Zi, ata shkuan në Shqipëri.¹⁷⁶⁰

709. Mahmut Halimi dëshmoi se ai dhe familja e tij u larguan nga qyteti në mëngjesin e 25 marsit, pasi ishin paralajmëruar me telefon nga një grua që foli serbisht.¹⁷⁶¹ Edhe ata udhëtuan për në Zhabar, prej nga e kishte prejardhjen Halimi, dhe atje ai mori edhe një telefonatë nga a njëjta grua, e cila i tha se persona, të cilët, sipas tij, ishin pjesëtarë të forcave ushtarake dhe paraushtarake. i ishin afruar shtëpisë së tij në Mitrovicë. Fakti se Halimi ishte i kërcënuar në atë kohë mbështetet edhe nga vrasja e burrit të Hajrizit dhe të Latif Berishës, që tregon se shqiptarë kosovarë me emër në qytet ishin në shënjestër.

710. Më poshtë përshkruhet çfarë ndodhi me Halimin dhe familjen e tij. Kur u kthye në Mitrovicë në korrik 1999, ai e gjeti shtëpinë e djegur dhe të katër xhamitë në qytet të shkatërruara.¹⁷⁶² Shkatërrimi i njëres prej këtyre xhamive është konfirmuar nga Andrés Riedlmayer, i cili paraqiti fotografi të xhamisë së Ibrit në Mitrovicë, që tregojnë gjendjen e saj para konfliktit dhe në verën e vitit 1999. Ai vizitoi vendndodhjen e saj në vitin 2001. Në raportin e tij ai e përshkruan xhaminë si "plotësisht të shkatërruar," dhe në dëshminë e tij thotë se vendi ishte rrafshuar me buldozer.¹⁷⁶³ Sidoqoftë, ai ishte në gjendje të dëshmonte në lidhje me rrethanat e shkatërrimit dhe nuk shqyrtoi gjendjen e xhamive të tjera në qytet.

4. Fshatrat e tjera në komunën e Mitrovicës

711. Zhabari është rreth tri kilometra larg qytetit të Mitrovicës. Halimi dëshmoi se kohë pas kohe në fshat funksiononte një klinikë mjekësore e UÇK-së dhe se kishte prani të UÇK-së.¹⁷⁶⁴ Nga ana e tij, Nebojsa Bogunoviç dëshmoi se Zhabari ishte nën kontrollin e UÇK-së gjatë tërë fushatës së NATO-s.¹⁷⁶⁵

712. Halimi dhe familja e tij qëndruan me vëllain e tij në Zhabar të Poshtëm. Më 28 mars, dy pjesëtarë të UÇK-së i thanë se e kërkonin forcat e sigurimit dhe se duhej të largohej nga fshati për

¹⁷⁶⁰ Afërdita Hajrizi, P2320 (deklarata e dëshmitarit e datës 20 gusht 2001), f. 6.

¹⁷⁶¹ Mahmut Halimi, T. 4445–4446 (9 tetor 2006).

¹⁷⁶² Mahmut Halimi, T. 4461 (9 tetor 2006).

¹⁷⁶³ Andrés Riedlmayer, T. 5484–5486 (30 tetor 2006). *Shih gjithashtu* Andrés Riedlmayer, P1780 (Pjesë nga P1789 në lidhje me xhaminë e Mitrovicës).

¹⁷⁶⁴ Mahmut Halimi, T. 4447–4448 (9 tetor 2006).

¹⁷⁶⁵ Nebojsa Bogunoviç, 6D1614 (deklarata e dëshmitarit e datës 6 prill 2008), para. 96; 4D511 (Letër e Grupit të Kundërzbulimit të Armatës së 3-të e datës 15 prill 1999), f. 1; 5D1124 (Urdhër i Brigadës së 58-të të Këmbësisë së Lehtë, 27 maj 1999).

sigurinë e vet dhe për sigurinë e fshatarëve të tjerë.¹⁷⁶⁶ Atëherë ai shkoi të fshihej në malet afër fshatit dhe qëndroi atje gjashtë ditë para se të kthehej sërish në Zhabar të Poshtëm.¹⁷⁶⁷

713. Më 14 prill 1999, rreth orës 10:00, Halimi pa "forca serbe" me autoblanda kur iu afruan fshatit dhe hapën zjarr drejt tij nga drejtimi i Suhadollit, i cili gjendet në veri.¹⁷⁶⁸ Për këtë arsye, ai dhe familja e tij udhëtuan përgjatë lumit në Zhabarin e Epërm. Të nesërmen në mëngjes, nga shtëpia ku ndodheshin, Halimi pa shumë njerëz duke ardhur në këmbë nga Suhadolli, lagjja Tavnik e Mitrovicës, dhe Shipoli dhe e gjitha kjo shihej nga pika ku ishte ai. Njerëzit që erdhën nga Zhabari i Poshtëm i thanë se forcat serbe po i dëbonin banorët e këtyre fshatrave.¹⁷⁶⁹

714. Halimi gjithashtu dëshmoi se u formua një kolonë me rreth 25.000-30.000 vetë, e cila u nis në drejtim të jugut përgjatë rrugës kryesore nga qyteti i Mitrovicës për në Shipol.¹⁷⁷⁰ Në hotel Valoni në Zhabar të Poshtëm kishte forca "paraushtarake." Halimi pa automjete duke u djegur dhe dëgjoi krisma pushkësh.¹⁷⁷¹ Njerëzit në kolonë u detyruan të kalonin natën e 15 prillit jashtë dhe të nesërmen u lejuar të vazhdonin udhëtimin në rrugën kryesore.¹⁷⁷²

715. Mbrojtjet e Llazareviqit dhe Pavkoviqit theksojnë se Halimi nuk i pa vetë forcat e implikuara në dëbimin e shqiptarëve nga Suhadolli, Tavniku, Shipoli, dhe Zhabari i Poshtëm dhe se nuk mund t'i identifikonte me siguri.¹⁷⁷³ Gjithashtu, duke u bazuar në dëshminë e Dragan Zhivanoviqit Mbrojtja e Llazareviqit argumenton se në zonën e Tavnikut dhe Zhabarit nuk kishte forca të UJ-së. Gjithashtu, duke u bazuar në dokumentet e 17 prillit 1999 të përmendura më lart, ajo pretendon se në atë kohë nuk kishte forca të PJP-së të dislokuara në Zhabar.¹⁷⁷⁴

716. Sipas Halimit, më 16 prill, pak pas orës 11:00, "forcat serbe" e detyruar kolonën me njerëz të shkonte rrugës kryesore për në Pejë. Këto forca, që përbëheshin nga policia, forcat e rregullta ushtarake, dhe "paraushtarakët," hynë në Zhabar të Epërm dhe filluan t'i digjinin shtëpitë në një pjesë të fshatit.¹⁷⁷⁵ Njerëzit që ishin ende në atë kohë në atë pjesë të Zhabarit të Epërm, shkuan drejt

¹⁷⁶⁶ Mahmut Halimi, T. 4447 (9 tetor 2006).

¹⁷⁶⁷ Mahmut Halimi, T. 4447–4448 (9 tetor 2006).

¹⁷⁶⁸ Mahmut Halimi, T. 4448–4449 (9 tetor 2006).

¹⁷⁶⁹ Mahmut Halimi, T. 4448–4451, 4478–4483 (9 tetor 2006).

¹⁷⁷⁰ Mahmut Halimi, T. 4456 (9 tetor 2006).

¹⁷⁷¹ Mahmut Halimi, T. 4452 (9 tetor 2006). Dëshmitari tha se këto forca paraushtarake ishin të ndryshme nga forcat e policisë dhe ushtrisë për nga rrobat dhe pajisjet. "Ata kishin shami, shami në kokë, dhe jo kapela. Shumica prej tyre kishin koka të rruara dhe mjekra, dhe ndillinin frikë e terror. Armët e tyre ishin shumë të sofistikuar."

¹⁷⁷² Mahmut Halimi, T. 4452–4456 (9 tetor 2006).

¹⁷⁷³ Dosja Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 185; Dosja Përfundimtare e Pavkoviqit, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 436–440.

¹⁷⁷⁴ 5D1417 (Dislokimi i PJP-së më 17 prill 1999).

¹⁷⁷⁵ Mahmut Halimi, T. 4453 (9 tetor 2006).

një zdrukthëtarie të quajtur te Gaterat. Më pas, Halimi dhe familja e tij u nisën me tri makina duke provuar të dilnin në rrugën kryesore prej veriperëndimit të Mitrovicës për në Zubin Potok, e cila çon në Mal të Zi.¹⁷⁷⁶ Mirëpo ata u ndaluan nga dy ushtarë të rinj të UJ-së, të cilët i urdhëruan të zbrisnin nga makinat, por i lejuan të vazhdonin në këmbë.¹⁷⁷⁷ Në atë moment Halimi pa dy kamionë të vegjël dhe pesë a gjashtë "paraushtarakë" të cilët i kishte parë në hotel Valon, si dhe një xhip ushtarak me mitraloz në kulm. "Paraushtarakët" merrnin pajisje nga shtëpitë e braktisura në Zhabar dhe i ngarkonin nëpër kamionë.¹⁷⁷⁸

717. Pasi kaluan një natë në punishten e zdrukthëtarisë, policët urdhëruan Halimin dhe familjen e tij së bashku me njerëz të tjerë nga Zhabari i Epërm që ndodheshin atje aty, që të largoheshin.¹⁷⁷⁹ Me urdhër të këtyre forcave policore, u formua një kolonë e cila u nis përgjatë rrugës kryesore në drejtim të Pejës. Prej atje, ajo lëvizi në drejtim të jugut për në Shqipëri, duke kaluar nëpër disa komuna. Gjatë rrugës, një i afërm i Halimit i cili ishte mekanik, mundi të riparonte njërin nga dy makinat të cilat i kishin gjetur të braktisura në anë të rrugës. Familja udhëtoi me njërin makinë dhe duke e tërhequr tjetrën deri në kufi. Në Klinë, Halimi pa pjesëtarë të UJ-së që kërkonin para dhe sende me vlerë nga njerëzit në kolonë, kurse në hyrje të Prizrenit pa paraushtarakë duke rrahur njerëz.¹⁷⁸⁰ Sidoqoftë, ai gjithashtu tha se ushtarët e UJ-së i paralajmëruan të mos i ndizte dritat e makinës që të mos goditej nga bombat e NATO-s dhe gjithashtu i treguan se të dy anët e rrugës ishin minuar.¹⁷⁸¹ Ai dhe familja e tij e kaluan natën e 17 prillit në kalimin kufitar në Vërbnicë (Morinë). Të nesërmen, duke kaluar për në Shqipëri, policia u tha të hidhnin në një kuti pasaportat, letërnjoftimet, targat e makinave dhe patentat e shoferit. Familja e Halimit veproi sipas urdhrat, por ai mundi të mbante patentën e shoferit dhe pasaportën.¹⁷⁸²

718. Sadije Sadiku, shqiptare kosovare nga Zhabari, dha një përkthim të ngjarjeve të mesit të prillit 1999 që përputhej me dëshminë e Halimit. Siç është theksuar më herët, dallimet në kujtesën e tyre mbi datat konkrete Dhoma nuk i konsideron thelbësore.¹⁷⁸³ Ajo dëshmoi se më 13 prill 1999 "policia" filloi të digjte shtëpitë në njërin skaj të fshatit dhe t'i dëbonte njerëzit nga shtëpitë. Ajo dhe

¹⁷⁷⁶ Mahmut Halimi, T. 4457 (9 tetor 2006).

¹⁷⁷⁷ Mahmut Halimi, T. 4455 (9 tetor 2006).

¹⁷⁷⁸ Mahmut Halimi, T. 4455–4456 (9 tetor 2006).

¹⁷⁷⁹ Mahmut Halimi, T. 4495–4496 (9 tetor 2006). Ai tha se këta policë kishin uniforma kamuflimi të kaltër të mbyllët me emblema të verdha në supe që tregonin gradat e tyre dhe me shqiponja të bardha dhe fjalët "MUP Srbija" në krahë.

¹⁷⁸⁰ Mahmut Halimi, T. 4491–4493 (9 tetor 2006).

¹⁷⁸¹ Mahmut Halimi, T. 4513 (9 tetor 2006). Ai dëshmoi se forcat e UJ-së se kishin veshje të rregullt ushtarake me një emblemë në formë harku me mbishkrimin Vojska Jugosllavija/Ushtria e Jugosllavisë, një shqiponjë të bardhë, dhe flamurin serb. *Shih gjithashtu* Mahmut Halimi, T. 4515 (9 tetor 2006).

¹⁷⁸² Mahmut Halimi, T. 4459, 4490 (9 tetor 2006).

¹⁷⁸³ Sadije Sadiku, T. 1890–1950 (18 gusht 2006), P2256 (deklarata e dëshmitarit e datës 15 gusht 2006), P2252 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 gusht 2001).

familja e saj së bashku me shumë të tjerë ikën nga shtëpitë dhe u strehuan në një zonë pyjore në afërsi, ku kaluan natën.¹⁷⁸⁴ Të nesërmen, gratë dhe fëmijët u kthyen në shtëpi për të marrë ushqime dhe rroba të thata. Rreth orës 08:00, një grup prej shtatë policësh me uniforma të kaltra dhe të zeza shkuan nëpër shtëpi dhe u thanë të largoheshin menjëherë, duke i kërcënuar fizikisht. Kur dolën jashtë, ata u udhëzuan t'i bashkoheshin një kolone me njerëz të tjerë të dëbuar dhe së bashku vazhduan përgjatë rrugës kryesore në drejtim të Shqipërisë. Kolona kishte rreth 8.000-9.000 shqiptarë kosovarë që ecnin në këmbë. Ata kaluan nëpër disa postblloqe gjatë rrugës dhe "policia" u tha të "ecin shpejt," "të zhduken nga Kosova dhe të shkojnë në Shqipëri."¹⁷⁸⁵ Kur mbërritën në fshatin Lushët, që është shumë afër nga Zhabari i Epërm, burrat e fshatit të fshehur në pyll iu bashkuan kolonës. Në postbllokun në fshatin Shipol, "policia" u tha të shkonin në drejtim të Pejës.¹⁷⁸⁶

719. Mbrojtja e Llukiqit pretendon se dëshmitë e Halimit dhe Sadikut për ngjarjet e 13 prillit 1999 në Zhabar nuk përputhen.¹⁷⁸⁷ Sidoqoftë, pas shqyrtimit të kujdesshëm të provave, Dhoma konkludon se dallimet e vogla në dëshmitë e tyre janë të parëndësishme dhe mund të shpjegohen lehtë me vendndodhjen e ndryshme të dëshmitarëve në momentin përkatës, kohën e gjatë që kur kanë ndodhur ngjarjet, dhe mënyrën e dhënies së dëshmisë. Dëshmitë e tyre për ngjarjet në Zhabar janë përgjithësisht përputhëse dhe Dhoma i konsideron të dy dëshmitarë të besueshëm.

720. Sadiku dëshmoi se, gjata rrugës kolona kaloi nëpër shume postblloqe policore dhe ushtarake. Ajo tha se policia i "keqtrajtoi" njerëzit në kolonë, por jo ushtarakët të cilët nganjëherë u jepnin të shpërngulurve.¹⁷⁸⁸ Kushtet ishin shumë të këqija për shkak të motit të keq, mungesa e ushqimit dhe ujit, dhe, për disa, mungesa e këpucëve. Gjithashtu, njerëzit ishin të frikësuar dhe të lodhur sepse policia i detyronte të vazhdonin rrugën.¹⁷⁸⁹

721. Kolona eci dy ditë e dy net. Kur mbërritën në Klinë të Epërme, një polic i ndau në dy pjesë, duke urdhëruar një grup prej 2.000 njerëzish të ktheheshin në drejtim të Mitrovicës.¹⁷⁹⁰ Sadiku dhe familja e saj ishin në grupin e dytë prej rreth 6.000 njerëzish, të cilët u urdhëruan të vazhdonin për në Pejë. Ajo pa një polic në Klinë të Epërme kur ua shkuli vathët nga veshët tri-katër grave në kolonë, duke u shkaktuar gjakderdhje. Natën e tretë të udhëtimit, ata u lejuan të pushonin në një

¹⁷⁸⁴ Sadije Sadiku, T. 1893 (18 gusht 2006).

¹⁷⁸⁵ Sadije Sadiku, P2256 (deklarata e dëshmitarit e datës 15 gusht 2006), para. 16.

¹⁷⁸⁶ Sadije Sadiku, P2256 (deklarata e dëshmitarit e datës 15 gusht 2006), para. 17.

¹⁷⁸⁷ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 1010–1043.

¹⁷⁸⁸ Sadije Sadiku, P2256 (deklarata e dëshmitarit e datës 15 gusht 2006), para. 17.

¹⁷⁸⁹ Sadije Sadiku, P2252 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 gusht 2006), f. 4.

¹⁷⁹⁰ Sadije Sadiku, P2256 (deklarata e dëshmitarit e datës 15 gusht 2006), para. 20.

fushë pranë rrugës diku afër Skënderajt. Të nesërmen ata vazhduan në drejtim të Zabllaqit në komunën e Istogut dhe të Zllakuqanit në komunën e Klinës, ku qëndruan për rreth një orë në oborrin e kishës ku prifti u dha pak ushqim.¹⁷⁹¹ Sidoqoftë, policia i urdhëroi të ktheheshin në Zabllaq.¹⁷⁹²

722. Sadiku e përshkroi Zabllaqin të braktisur nga popullata vendore dhe me shtëpi të rrënuara nga granatimi. Fakti se zona ishte skenë e operacioneve të forcave të UJ-së dhe MPB-së në atë kohë që mund të shpjegojë për dëmet e shkaktuara nga granatimi, mbështetet edhe nga një urdhër i Brigadës së 7-të Këmbësorike të UJ-së të datës 5 maj 1999, ku lexohet se më 6 maj 1999 do të fillonte një operacion që përfshinte edhe sektorin Zabllaq-Turbuhovc.¹⁷⁹³ Një polic urdhëroi Sadikun dhe të tjerët në kolonë të qëndronin në këto shtëpi. Ata qëndruan atje tri javët e ardhshme nën mbikëqyrjen e policisë. Nuk kishte vend të mjaftueshëm për të gjithë dhe policia nuk u dha ushqime.¹⁷⁹⁴

723. Sadiku dëshmoi se nganjëherë policët hapnin zjarr kundër atyre që tentonin të dilnin nga shtëpitë dhe të hynin në oborre. Në rrethana të ngjashme, edhe ajo u qëllua në shpinë më 6 maj 1999.¹⁷⁹⁵ Ajo e përshkroi këtë incident me hollësi, i cili ndodhi kur ajo doli nga shtëpia ku qëndronte për të mbledhur patate. Plumbi i dëmtoi shtyllën kurrizore dhe si pasojë ajo tani i ka këmbët e paralizuar. Gjatë dëshmisë së saj Sadiku tha se mendonte ishte qëlluar nga disa policë, edhe pse nuk mundi të shihte kush e qëlloi.¹⁷⁹⁶ Megjithëse Mbrojtja e Llukiqit u përpoq ta përgënjeshtronte dëshminë e saj në lidhje me këtë, Dhoma vëren se plagosja nuk përfshihet në Aktakuzë dhe rrjedhimisht nuk ka nevojë të nxjerrë konkluzion mbi individët përgjegjës.

724. Pas incidentit, Sadiku u dërgua në fshatin Zahaq në komunën e Pejës, ku qëndroi katër ditë para se të dëbohej përsëri nga policia së bashku me banorët vendorë.¹⁷⁹⁷ Ata formuan kolonë me traktorë dhe makina dhe u nisën në drejtim të Pejës. Policët u kërkuan para njerëzve që udhëtonin në traktor me Sadikun. Ata u lejuan të vazhdonin pasi paguan 300 marka gjermane. Më pas vazhduan për në Pejë dhe pastaj drejt kufirit me Shqipërinë, duke kaluar nëpër postbllaqe gjatë rrugës, në të cilat u morën sërish para. Në kufi, policë me uniforma në ngjyrë të kaltër të mbyllët

¹⁷⁹¹ Sadije Sadiku, P2256 (deklarata e dëshmitarit e datës 15 gusht 2006), para. 22; IC10 (Hartë e shënuar nga Sadije Sadiku); P32 (hartë e Pejës).

¹⁷⁹² Sadije Sadiku, P2252 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 gusht 2006), f. 5.

¹⁷⁹³ 5D794 (Urdhër i Brigadës së 7-të të Këmbësorisë, 5 maj 1999), f. 2.

¹⁷⁹⁴ Sadije Sadiku, P2252 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 gusht 2006), f. 5.

¹⁷⁹⁵ Sadije Sadiku, P2256 (deklarata e dëshmitarit e datës 15 gusht 2006), para. 24.

¹⁷⁹⁶ Sadije Sadiku, T. 1929 (18 gusht 2006).

¹⁷⁹⁷ IC10 (Hartë e shënuar nga Sadije Sadiku); P32 (Hartë e Pejës).

kërkuan 500 marka gjermane nga secili traktor dhe stoli ari.¹⁷⁹⁸ Sadiku shpjegoi se, gjatë rrugës ata dhanë të gjitha paratë që kishin, por ajo dhe familja e saj kishin arritur t'i shpëtonin arturinat duke i fshehur.¹⁷⁹⁹ Gjithashtu, ajo tha se policia kufitare u mori dokumentet e identifikimit njerëzve në kolonë, të cilat i grisën dhe i dogjën. Njerëzit që nuk dorëzuan dokumentet, u rrahën. Mbrojtja e Llukiqit paraqiti prova se Sadiku kurrë nuk kishte pasur dokumente identifikimi të cilat do të mund t'i merreshin në kufi. Mirëpo Dhoma vëren se ajo nuk pretendoi se i morën dokumentet.¹⁸⁰⁰

725. Nebojsa Bogunoviçi pretendoi se shqiptarët kosovarë po largoheshin nga zona sepse udhëheqësit e tyre politikë u kishin bërë thirrje për këtë përmes fletushkave të shpërndara nëpër rrugë.¹⁸⁰¹ Sidoqoftë, Halimi, Hajrizi, dhe Sadiku nuk u pyetën nëse kishin parë fletushka të tilla, ndërsa arsyet të cilat ata dhanë për largimin nga Kosova nuk ishin arsyet e sugjeruara nga Bogunoviçi, por ato të paraqitura më lart. Në deklaratën e tij me shkrim, Bogunoviçi sugjeroi se njerëzit u larguan nga Zhabari më 14 prill për shkak të bombardimeve të NATO-s në zonën a Bairit afër Zhabarit.¹⁸⁰² Sidoqoftë, dëshmitarët nuk u pyetën nëse u larguan nga Mitrovica për shkak të bombardimeve të NATO-s dhe ata nuk i përmendën bombardimet e NATO-s si faktor që kontribuoi në largimin e tyre nga shtëpitë.

5. Konkluzione

726. Dhoma konkludon se në vitin 1998 dhe 1999, UÇK-ja ishte mjaft aktive në disa pjesë të komunës së Mitrovicës. Nga viti 1998 e deri në fund të prillit 1999, forcat e UJ-së dhe të MPB-së kryen disa operacione në këtë zonë. Sidoqoftë nuk del se këto operacione përfshinë edhe qytetin e Mitrovicës apo fshatrat Shipol dhe Zhabar, me gjithë pretendimin e Bogunoviçit se Zhabari ishte nën kontrollin e UÇK-së.

727. Dhoma konkludon se me fillimin e sulmeve ajrore të NATO-s, shqiptarë e shquar kosovarë të Mitrovicës u ndoqën dhe disa prej tyre u vranë. Forcat e MPB-së dëbuan mijëra shqiptarë

¹⁷⁹⁸ Sadije Sadiku, P2256 (deklarata e dëshmitarit e datës 15 gusht 2006), para. 38.

¹⁷⁹⁹ Sadije Sadiku, P2252 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 gusht 2006), f. 7.

¹⁸⁰⁰ Sadije Sadiku, T. 1903 (18 gusht 2006). *Shih* T. 23422 (28 shkurt 2008); 6D1234 (Përgjigje ndaj Kërkesës së Mbrojtjes dërguar Këshillit Kombëtar për Bashkëpunim me TPNJ-në); 6D1666 (Kërkesë e Mbrojtjes së Llukiqit dërguar Këshillit Kombëtar për Bashkëpunim me TPNJ-në, 2 korrik 2007); P3141 (Certifikata e Lindjes e Sadije Sadikut).

¹⁸⁰¹ Nebojsa Bogunoviçi, 6D1614 (deklarata e dëshmitarit e datës 6 prill 2008), para. 65, T. 25183–25184 (11 prill 2008).

¹⁸⁰² Nebojsa Bogunoviçi, 6D1614 (deklarata e dëshmitarit e datës 6 prill 2008), para. 96; 5D985 (Raport luftimi i Komandës së Qarkut Ushtarak, i datës 17 prill 1999). Në raportet e Shtabit të MPB-së, 15 dhe 16 prill thuhet se më 14 prill 1999, forcat e NATO-s bombarduan "magazinën në kazermën nr. 2" në Mitrovicë, dhe se më 15 prill 1999, NATO-ja e bombardoi sërish kazermën. U raportua se godinat e banimit afër kazermës pësuan dëmtime të konsiderueshme. *Shih* 6D1251 (Pasqyrë e MPB-së e ngjarjeve të lidhura me sigurinë, 15 prill 1999), f. 3; 6D1252 (Pasqyrë e MPB-së e ngjarjeve të lidhura me sigurinë, 16 prill 1999), f. 1.

kosovarë nga disa pjesë të qytetit, disa prej të cilëve u dërguan në Mal të Zi. Gjithashtu Dhoma se identifikimi i forcave të UJ-së bërë nga Hajrizi bazohej në supozimin e saj se forcat e UJ-së mbanin gjithmonë uniforma të gjelbra kurse forcat e MPB-së vetëm uniforma të kaltra, supozim që gjatë gjykimit rezultoi i pasaktë.¹⁸⁰³ Rrjedhimisht Dhoma nuk është bindur se UJ-ja mori pjesë në dëbimet nga qytetit i Mitrovicës.

728. Gjithashtu, Dhoma Gjyqësore konkludon se në mesin e prillit 1999, shumë shqiptarë kosovarë nga Zhabari dhe fshatrat e afërta së bashku me të tjerë që ishin strehuar aty, u dëbuan nga shtëpitë nga forcat e MPB-së dhe UJ-së dhe u detyruan të largoheshin nga Kosova. Megjithëse ka prova që tregojnë se në atë kohë UÇK-ja ishte aktive në Tavnik dhe Shipol,¹⁸⁰⁴ dëshmitë e Halimit dhe Sadikut në lidhje me djegien e shtëpive dhe plaçkitjen e pronave në Zhabar dhe kërcënimin dhe dëbimin me dhunë të banorëve duke përfshirë gratë dhe fëmijët, nuk tregojnë operacione luftarake kundër UÇK-së.

729. Shumë nga këta njerëz u detyruan të ecnin disa ditë deri në kufi pa ushqime dhe ujë. Gjatë rrugës deri në kalimin kufitar, pjesëtarët e kolonës u plaçkitën dhe u keqtrajtuat nga policia dhe forcat me uniformë që bashkëvepronin me policinë. Me të arritur në kufi, policia detyroi shumë nga njerëzit e dëbuar që të dorëzonin dokumentet personale, të cilët nuk iu kthyen.

730. Dhoma nuk ka dëgjuar asnjë dëshmi në lidhje me dhunë seksuale kundër njerëzve nga komuna e Mitrovicës dhe rrjedhimisht këto akuza nuk janë vërtetuar. Po ashtu, Dhoma nuk ka marrë asnjë provë në lidhje me autorët e shkatërrimit të xhamisë së Ibrit apo të xhamive të tjera në Mitrovicë dhe, si pasojë nuk është në gjendje të nxjerrë ndonjë konkluzion në lidhje me këtë çështje.

I. VUSHTRRIA

1. Akuzat në Aktakuzë

731. Pretendimet faktike në lidhje me komunën e Vushtrrisë kanë të bëjnë me ngjarjet që thuhet sa kanë ndodhur nga 27 marsi deri në fund të majit ose fillim të qershorit 1999. Shkeljet bazë të dëbimit dhe zhvendosjes me dhunë, të përfshira përkatësisht në Pikat 1 dhe 2, janë përshkruar në paragrafin 72(m) të Aktakuzës si vijon:

¹⁸⁰³ *Shih* Nën pjesën VI.A.3.

¹⁸⁰⁴ 4D511 (Letër e Grupit të Kundërzbulimit të Armatës së 3-të, 15 prill 1999); 6D1251 (Pasqyrë e MPB-së e ngjarjeve të lidhura me sigurinë, 15 prill 1999), f. 4.

Më 27 mars 1999 ose rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë filluan të digjnin shtëpi në qytetin e Vushtrrisë dhe dogjën xhaminë kryesore në këtë qytet. Më 2 maj 1999 ose rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë sulmuan një numër fshatrash në verilindje të qytetit të Vushtrrisë, duke përfshirë fshatrat Skromë, Sllakofc, Ceceli dhe Studime e Epërme. Fshatarët u dëbuan nga shtëpitë e tyre dhe shumë shtëpi, dyqane dhe objekte fetare u dogjën plotësisht. Fshatarët, bashkë me njerëz të shpërngulur më parë nga vendbanime të tjera në komunën e Vushtrrisë, u detyruan të formonin një kolonë prej rreth 20.000 njerëzish që udhëtonin në rrugën e Grykës së Studimes, në drejtim të qytetit të Vushtrrisë. Gjatë natës së datave 2-3 maj 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë keqtrajtuuan, rrahën dhe vranë afërsisht 104 shqiptarë kosovarë dhe u vodhën artikuj me vlerë shumë të tjerëve. Mijëra shqiptarë kosovarë në këtë kolonë u ndaluan nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë në kooperativën bujqësore afër qytetit të Vushtrrisë. Më 3 maj 1999 apo rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë në kooperativën bujqësore i ndanë burrat shqiptarë kosovarë të moshës për shërbim ushtarak nga gratë, fëmijët dhe të moshuarit. Gratë, fëmijët dhe të moshuarit shqiptarë kosovarë u udhëzuan të shkonin në Shqipëri dhe një numër burrash shqiptarë kosovarë u detyruan të ngisnin automjete që transportonin gratë, fëmijët dhe të moshuarit për në kufirin me Shqipërinë. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë transportuan qindra burra shqiptarë kosovarë të moshës për shërbim ushtarak nga kooperativa bujqësore në një burg në fshatin Smrekonicë. Pas disa javësh ndalimi në kushte çnjerëzore, ku iu nënshtruan rrahjeve, torturave dhe vrasjeve, shumë nga këta burra shqiptarë të Kosovës u transportuan në fshatin Zhur, afër kufirit me Shqipërinë dhe u detyruan të kalonin në Shqipëri.

732. Pretendimet për vrasjet të përfshira në paragrafin 72(m) janë përsëritur në paragrafin 75(i) të Aktakuzës dhe, lidhur më këto, të Akuzuarit janë akuzuar në Pikat 3 dhe 4 për vrasje si krim kundër njerëzimit dhe si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës. Personat që pretendohet se janë vrarë në komunën e Vushtrrisë më 2 maj 1999, emrat e të cilëve dihen, janë të përfshirë në Listën I të Aktakuzës. Gjithashtu të Akuzuarit janë ngarkuar me përgjegjësi për përndjekje në lidhje pretendimet për vrasjet të përfshira në paragrafin 75(i) dhe "shkatërrim ose dëmtim pa shkak të objekteve fetare të shqiptarëve kosovarë," duke përfshirë xhamitë në Vushtri.¹⁸⁰⁵

2. Rrethanat

733. Komuna e Vushtrrisë gjendet në veri të Kosovës qendrore në cep të vargmaleve të Kopaonikut dhe kufizohet, ndër të tjera, me komunën e Mitrovicës në veri, të Skënderajt në perëndim, dhe të Prishtinës në juglindje.¹⁸⁰⁶ Qyteti kryesor, i cili gjithashtu quhet Vushtri, gjendet në pjesën në qendër të komunës. Fshatrat Skromë, Sllakofc, Ceceli, Studime e Poshtme, dhe Studime e Epërme janë në lindje dhe verilindje të qytetit të Vushtrrisë.¹⁸⁰⁷

734. Shumica e dëshmive në lidhje me ngjarjet që kanë ndodhur në Vushtri nga viti 1998 deri në qershor të vitit 1999 u dhanë nga katër dëshmitarë: Fedrije Xhafa, shqiptare kosovare nga Sfraçaku i Poshtëm, fshat në juglindje të qytetit të Vushtrrisë; Sabit Kadriu, shqiptar kosovar nga fshati

¹⁸⁰⁵ Aktakuza, para. 75(i), 77(d).

¹⁸⁰⁶ P615 (Atlasi i Kosovës). *Shih gjithashtu* 3D424 (Profili komunal i Vushtrrisë, qershor 2006).

Brusnik, fshat në jugperëndim të qytetit të Vushtrrisë, i cili ishte mësues dhe anëtar i degës së Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ);¹⁸⁰⁸ Shukri Gërzhaliu, mjek shqiptar kosovar dhe banor i Studimes së Poshtme, i cili deri më 26 mars 1999 punoi në spitalin e qytetit të Vushtrrisë dhe i cili gjithashtu ishte pjesëtar i UÇK-së dhe shërbente si mjek për forcat e UÇK-së në atë zonë; dhe Nebojsa Bogunović, i cili ishte zëvendësshef i SPB-së së Mitrovicës, që mbulonte territorin e komunës së Vushtrrisë.

735. Përgjithësisht Mbrojtja nuk paraqiti asnjë kundërshtim konkret ndaj besueshmërisë së Xhafës; dëshmia e saj në lidhje me ngjarjet që pa gjatë gjysmës së parë të vitit 1999 në Vushtrri konsiderohet përgjithësisht e saktë. Mbrojtjet e Llazareviqit dhe Pavkoviqit kundërshtuan besueshmërinë a Sabit Kadriut për shkak të lidhjeve të tij me partinë politike, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës si dhe për shkak të hezitimit për ta identifikuar Ramush Haradinajn si kryetar të kësaj partie.¹⁸⁰⁹ Besueshmëria e tij gjithashtu u kundërshtua për shkak të mospranimit të tij se UÇK-ja u implikua në dëbimin e familjeve serbe nga Kosova dhe keqtrajtimin e popullatës vendore dhe mospranimit të tij se disa nga aksionet e UÇK-së ishin sulme, duke thënë se aksionet e UÇK-së ishin aksione mbrojtëse.¹⁸¹⁰ Megjithëse Dhoma është skeptike për disa aspekte të dëshmisë së Kadriut në lidhje me veprimet e UÇK-së dhe sidomos për anësinë e sistemit të raportimit të KMDLNJ-së, ajo nuk mendon se kjo e komprometon të gjithë dëshminë e tij. Përndryshe, Dhoma mendon se dëshmitari ishte mbresëlënës dhe gjykon se ai dha dëshmi të besueshme dhe të saktë në lidhje me ngjarjet në komunë.

736. Mbrojtja e Llazareviqit kundërshtoi edhe besueshmërinë e Shukri Gërzhaliut, duke pretenduar se anësia e tij doli qartë kur komentoi videofilmimin e bërë në afërsi të Studimes së Epërme më 3-4 maj 1999 në të cilën shihen burra shqiptarë kosovarë të veshur me rroba civile.¹⁸¹¹ Edhe pas shumë pyetjeve, Gërzhaliu nuk pranoi të konfirmonte se këta burra të armatosur ishin pjesëtarë të UÇK-së, duke këmbëngulur se këta persona ishin civilë të cilët mund të kenë qenë duke mbajtur armë të të njohurve të tyre.¹⁸¹² Dhoma konkludon se dëshmia e Gërzhaliut në lidhje me veprimet e UÇK-së në Vushtrri ishte e mjegullt dhe jo e besueshme, por pjesë të dëshmisë së tij në

¹⁸⁰⁷ P615 (Atlasi i Kosovës), f. 6.

¹⁸⁰⁸ Sabit Kadriu, T. 5103 (18 tetor 2006).

¹⁸⁰⁹ Dosja Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 344–345; Dosja Përfundimtare e Pavkoviqit, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 543–544.

¹⁸¹⁰ Sabit Kadriu, T. 5145–5150, 5164–5166, 5173–5174 (19 tetor 2006); Shih gjithashtu 3D147 (Raporti Humanitar Javor i EU KDOM-it, 22 dhjetor 1998); 3D151 (Raport i Misionit Monitorues të Bashkësisë Evropiane, e 24 janar 1999).

¹⁸¹¹ Dosja Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 340, 345.

¹⁸¹² Shukri Gërzhaliu, T. 2569–2577 (30 gusht 2006), duke iu referuar P4 (Videofilmim i Studimes së Epërme filmuar më 3 maj 1999), në 3 min. 30 sekonda.

lidhje me çështje të tjera përputheshin me rrëfimet e dëshmitarëve të tjerë (këto çështje do të diskutohen më poshtë) janë pranuar nga Dhoma si të besueshme.

737. Dhoma e konsideron Nebojshta Bogunoviçin, dëshmitar të Mbrojtjes së Llukiqit, përgjithësisht të besueshëm. Sidoqoftë, ajo ka dyshime rreth disa aspekteve të dëshmisë së Bogunoviçit dhe këto aspekte do të shqyrtohen në aktgjykim.

738. Është e pamohueshme se komuna e Vushtrisë ishte një zonë e rëndësishme veprimi e UÇK-së më 1998 dhe në fillim të vitit 1999. Bislim Zyrapit dëshmoi se gjatë vitit 1998 dhe 1999 në këtë komunë vepronin disa brigada, në atë që quhej Zona Operative e Shalës në pjesën perëndimore të komunës dhe në Zonën Operative të Llapit në pjesën lindore të komunës.¹⁸¹³ Shukri Gërxhaliu gjithashtu pranoi se në vitin 1998 dhe deri kur filloi fushata ajrore e NATO-s, një pjesë e madhe e komunës ishte nën kontrollin e UÇK-së.¹⁸¹⁴ Sipas Fedrije Xhafës, në prill dhe maj 1999, veçanërisht Studimja e Epërme dhe Cecelia ishin bastione të UÇK-së,¹⁸¹⁵

739. Sabit Kadriu tregoi se pas ofensivës verore të vitit 1998 në Vushtrri vërshuan shqiptarë kosovarë të shpërngulur nga rajoni i Drenicës,¹⁸¹⁶ dhe tha se në shtator të atij viti u ndërmorën operacione të tjera në pjesë të kësaj komune, duke përfshirë edhe fshatin e tij.¹⁸¹⁷ Kjo dëshmi mbështetet nga një raport luftimi i UJ-së ku shënohej se nga 22 deri më 23 shtator 1998, forcat e UJ-së dhe të MPB-së zhvilluan operacione të koordinuara në pjesën perëndimore të komunës së Vushtrisë.¹⁸¹⁸

740. Në shkurt 1999 forcat e UJ-së dhe të MPB-së kryen operacione të tjera në komunë. Sipas Kadriut, kjo rezultoi në më shumë njerëz të shpërngulur.¹⁸¹⁹ Xhevahire Rrahmani, shqiptare kosovare nga fshati Bukosh (në jugperëndim të qytetit të Vushtrisë), dëshmoi se më 22 shkurt 1999 ushtria granatoi në malet e Taraxhit, që gjenden në afërsi të shtëpisë së saj. Ajo dëgjoi zhurmën e granatimit dhe gjithashtu "plumbat që arritën deri në oborr [të shtëpisë së saj]."¹⁸²⁰ Si pasojë, ajo dhe familja e saj shkuan në Vushtrri për t'i ikur granatimit. Sidoqoftë kur u pyet nga Mbrojtja, ajo

¹⁸¹³ Bislim Zyrapit, T. 5967 (6 nëntor 2006), T. 6258-6259 (10 nëntor 2006). *Shih gjithashtu* P2469 (Hartë që tregon zonat operative të UÇK-së sipas dëshmitarit Bislim Zyrapit).

¹⁸¹⁴ Shukri Gërxhaliu, P2275 (deklarata e dëshmitarit e datës 19 shkurt 2000), para. 6; IC22 (Harta e Vushtrisë e shënuar nga Shukri Gërxhaliu).

¹⁸¹⁵ Fedrije Xhafa, T. 2459 (28 gusht 2006).

¹⁸¹⁶ Sabit Kadriu, P2377 (deklarata e dëshmitarit e datës 10 dhjetor 2000), f. 7, T. 5065-5067 (18 tetor 2006).

¹⁸¹⁷ Sabit Kadriu, P2377 (deklarata e dëshmitarit e datës 10 dhjetor 2000), f. 8, T. 5067-5070 (18 tetor 2006).

¹⁸¹⁸ P1162 (Analizë e Operacioneve Luftarake të Zhvilluara të Brigadës së 125-të të Motorizuar, 25 shtator 1998).

¹⁸¹⁹ Sabit Kadriu, P2377 (deklarata e dëshmitarit e datës 10 dhjetor 2000), f. 11. *Shih gjithashtu* 5D783 (Raport Javor i Brigadës së 125-të të Motorizuar, 25 shkurt 1999); P2808 (Urdhër i PrK-së, 16 shkurt 1999).

¹⁸²⁰ Xhevahire Rrahmani, T. 1813 (17 gusht 2006).

pranoi se në atë kohë e kishte ditur se në atë zonë po zhvillohej një stërvitje ushtarake.¹⁸²¹ Gjithashtu Rrahmani e pranoi sugjerimin e Mbrojtjes se UÇK-ja vrau disa serbë në Bukosh para fushatës së NATO-s dhe se madje UÇK-ja kishte shtënë edhe kundër verifikuesve të atjeshëm të KVM-së.¹⁸²²

741. Në mars 1999, Kadriu vuri re përforcime të konsiderueshme të "forcave serbe" në komunë dhe përshkroi vendosjen e postblloqeve speciale nga forcat ushtarake në fshatrat përreth Vushtrrisë.¹⁸²³ Oficeri i UJ-së, Millan Koturi, konfirmoi se në shkurt ose mars 1999, u rrit numri i trupave në terren dhe se një grup ushtarësh të rinj të UJ-së u dërguan në Bukosh për stërvitje.¹⁸²⁴ Komandanti i atëhershëm i Brigadës së 37-të të Motorizuar të UJ-së, Lubisha Dikoviq, gjithashtu dëshmoi se në fillim të marsit 1999 një pjesë e brigadës bëri stërvitje në Bukosh dhe se iu përgjigjën sulmeve të UÇK-së.¹⁸²⁵ Më 12 mars 1999, KVM-ja raportoi se, për shkak të stërvitjes së UJ-së me municion luftarak afër fshatit Bukosh, gjendje në terren midis UJ-së dhe UÇK-së u bë shumë e nderë dhe e paqëndrueshme me shkëmbime sporadike zjarri.¹⁸²⁶

3. Ngjarjet në qytetin e Vushtrrisë

742. Sabit Kadriu, i cili në fund të marsit qëndroi në qytetin e Vushtrrisë, dëshmoi se më 27 mars 1999 shumë njerëz, të cilët ai i përshkroi si "serbë," me uniforma të ndryshme erdhën në qytet dhe u vendosën në shkollën përballë shtëpisë në të cilën ndodhej ai. Më vonë, në të njëjtën ditë, ai pa dy "serbë" me rroba civile duke hyrë në shtëpinë fqinje. Menjëherë pasi ata dolën jashtë, ai vuri se shtëpia dhe tjetra afër saj ishin në flakë. Në atë moment, Kadriu pa në rrugë shume "serbë," shumica me uniforma të gjelbra, përpara shtëpive që digjeshin. Nga frika, Kadriu dhe familja e tij shkuan në shtëpinë e një kushëriri në afërsi të pjesës së vjetër të qytetit. Sipas Kadriut, "serbët" filluan të digjinin edhe pjesën e vjetër të qytetit. Ai e pa xhaminë e vjetër në qendër të qytetit si dhe godinat përreth saj duke u djegur si dhe pa minarenë kur u rrëzuar si rezultat i djegies. Gjatë djegies së shtëpive dhe dyqaneve Kadriu dëgjoi krismë.¹⁸²⁷

¹⁸²¹ Xhevahire Rrahmani, T. 1851–1854 (17 gusht 2006).

¹⁸²² Xhevahire Rrahmani, T. 1855–1861, 1881–1885 (17 gusht 2006), P2240 (Transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4584.

¹⁸²³ Sabit Kadriu, P2377 (deklarata e dëshmitarit e datës 10 dhjetor 2000), f. 11. Nuk është e qartë nëse Kadriu e kishte fjalën për fshatrat përreth qytetit të Vushtrrisë apo për fshatrat përreth tërë komunës.

¹⁸²⁴ Millan Kotur, T. 20634–20638 (18 janar 2008).

¹⁸²⁵ Lubisha Dikoviq, T. 19927–19928, T. 19870 (10 dhjetor 2007); P2039 (Raport operativ i Brigadës së 37-të të Motorizuar dërguar PrK-së, 20 mars 1999), f. 3. *Shih gjithashtu* 3D179 (Raport i KVM-së në lidhje me respektimin e armëpushimit prej palëve në Kosovë, 12 mars 1999), f. 1, gjithashtu e pranuar si P444; P407 (Libri i Kaltër i OSBE-së/KVM-së), shënimet për datat 25 shkurt–3 mars 1999.

¹⁸²⁶ 3D179 (Raport i KVM-së në lidhje me respektimin e armëpushimit prej palëve në Kosovë, 12 mars 1999), f. 1, gjithashtu e pranuar si P444; P407 (Libri i Kaltër i OSBE-së/KVM-së), shënimet për 25 shkurt–3 mars 1999.

¹⁸²⁷ Sabit Kadriu, P2377 (deklarata e dëshmitarit e datës 10 dhjetor 2000), f. 12.

743. Dy ditë më pas, Kadriu mori informacion se afër urës së vjetër ndodheshin tri ose katër kufoma, edhe pse duket se ai nuk i pa vetë kufomat, e as nuk dinte si kishin përfunduar atje. Në mëngjesin e 1 prillit disa kushërinj të tij erdhën nga një pjesë tjetër e qytetit dhe thanë se policia i kishte dëbuar nga shtëpitë.¹⁸²⁸ Pas pak Kadriu pa dhe dëgjoi policë në rrugë, njërin prej të cilëve e identifikoi si komandantin e stacionit të policisë në Vushtrri, të cilët u bërtisnin njerëzve të dilnin menjëherë nga shtëpitë dhe të shkonin në drejtim të varrezave.¹⁸²⁹ Mbrojtja e Llukiqit pretendon se "Kadriu nuk ka vërtetuar në asnjë mënyrë se policia urdhëroi familjen e tij të largohet nga shtëpia."¹⁸³⁰ Dhoma e hedh poshtë këtë pretendim duke pasur parasysh dëshminë e Kadriut – të cilën ajo e pranon – se policët bërtisnin në rrugë duke i urdhëruar njerëzit të dilnin nga apartamentet e tyre.

744. Ai dhe familja e tij u bashkuan me turma të mëdha të shqiptarëve kosovarë të cilët largoheshin nga shtëpitë e tyre dhe shkonin në drejtim të varrezave me makinë apo në këmbë.¹⁸³¹ Kur mbërriti atje, ai pa tre autobusë privatë të parkuar, në të cilët filluan të hipnin shqiptarët kosovarë të dëbuar. Në varreza nuk kishte policë. Njëri nga shoferët u tha se policia e kishte urdhëruar t'i dërgonte njerëzit në Maqedoni. Kadriu e kishte futi familjen e vet në njërin nga autobusët dhe me disa shokë vendosi të shkonte në Studime të Epërme që ndodhej në zonën e cila ishte bastion i UÇK-së.¹⁸³² Kur familja e tij kuptoi se ai nuk kishte hipur në autobus, ata zbritën nga autobusi dhe qëndruan në Vushtrri deri në fund të luftës.¹⁸³³

745. Mbrojtja e Llukiqit argumenton se dëshmia se në varreza nuk kishte policë dhe fakti se Kadriu dhe familja e tij në fund të fundit nuk shkuan në Maqedoni tregojnë se policia nuk detyroi "askënd të bëjë gjë në varreza."¹⁸³⁴

746. Dëshmia e Kadriut në lidhje me shkatërrimin e godinave në qytetin e Vushtrrisë në atë kohë mbështetet edhe nga dëshmia e Andrés Riedlmayer-it, i cili e vizitoi qytetin në tetor 1999. Ai paraqiti fotografi të tri xhamive në qytet, të cilat i kishte bërë gjatë vizitës. E para nga këto, Xhamia e Pazarit, Riedlmayer e ka përshkruar në raportin e tij si "tërësisht të shkatërruar." Ajo rrethohej

¹⁸²⁸ Sabit Kadriu, P2377 (deklarata e dëshmitarit e datës 10 dhjetor 2000), f. 12.

¹⁸²⁹ Sabit Kadriu, T. 5121–5123, 5071–5072 (18 tetor 2006), P2377 (deklarata e dëshmitarit e datës 10 dhjetor 2000), f. 13.

¹⁸³⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 1268–1269.

¹⁸³¹ Sabit Kadriu, P2377 (deklarata e dëshmitarit e datës 10 dhjetor 2000), f. 13.

¹⁸³² Sabit Kadriu, P2377 (deklarata e dëshmitarit e datës 10 dhjetor 2000), f. 13.

¹⁸³³ Sabit Kadriu, T. 5133 (18 tetor 2006).

¹⁸³⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 1270–1271.

prej tregut historik të artarëve i cili ishte djegur tërësisht.¹⁸³⁵ Dy xhamitë e tjera, Gazi Ali Bej dhe Karamanli, u përshkruan nga Riedlmayer-i si "të dëmtuara lehtë."¹⁸³⁶ Raporti i tij bënte të ditur se Abdullah Mulaku, arkivisti i qytetit nga Vushtrria, i cili u intervistua nga Riedlmayer-i dhe kolegu i tij, tregoi se Xhamia e Pazarit dhe dyqanet e tregut afër saj ishin djegur me benzinë dhe pastaj ishin rënë me buldozer.¹⁸³⁷ Në raport gjithashtu lexohet se Mehmet Mejzini i cili banon përballë Xhamisë së Pazarit, tha se xhamia dhe shtëpia e tij ishin djegur nga "paraushtarakë serbë" me maska të cilëve u printe një politikan vendor serb, "kreu i degës vendore të partisë politike të Arkanit." Sipas tij, vendndodhja e xhamisë u rrafshua me buldozer më 28 mars 1999.¹⁸³⁸ Dhoma vëren se këto deklaratat përputhen me dëshminë e Kadriut. Pavarësisht nga disa kundërshti të përgjithshme të Branimir Jokiqit, dëshmitar ekspert i ftuar nga Mbrojtja, kundrejt metodologjisë së Riedlmayer-it, dëshmia e Riedlmayer-it në lidhje me Vushtrrinë nuk komprometohet dhe Dhoma nuk ka dyshim se Xhamia e Pazarit në qytet dhe godinat përreth saj u shkatërruan ashtu siç u përshkrua nga Kadriu.

4. Sulmet kundër fshatrave në verilindje të qytetit të Vushtrrisë dhe vrasjet në kolonë

747. Përveç dëshmive në lidhje me ngjarjet në qytetin e Vushtrrisë në fund të marsit 1999, Dhoma dëgjoi nga Kadriu, Fedrije Xhafa, dhe Shukri Gërxfhaliu edhe për shpërnguljen e shqiptarëve kosovarë nga fshatra të tjera të komunës gjatë javëve në vijim. Këto dëshmi mbështeten deri diku nga dëshmia e Mihajlo Gergarit, ish-komandant i Brigadës së 211-të të Blinduar të UJ-së, Lubomir Saviqit, komandant i atëhershëm i Brigadës së 58-të të Këmbëorisë së Lehtë, Vladimir Marinkoviç, komandant i atëhershëm i Brigadës së 15-të të Blinduar, dhe dokumente të ndryshme ushtarake që përshkruajnë operacionin e përbashkët të UJ-së/MPB-së në rajonin e Bajgorës në fund të prillit dhe fillim të majit 1999.

748. Kadriu dëshmoi se, deri në fund të prillit 1999 UÇK-ja u rezistoi fuqishëm "forcave serbe" në komunë.¹⁸³⁹ Deri në fund të prillit Studimja e Epërme dhe Cecelia ishin në duart e UÇK-së, por "serbët" kishin pozicione të fuqishme më në jug në kazermën e vjetër ushtarake në Studimen e Poshtme, në një kompleks midis Studimes së Epërme dhe Studimes së Poshtme, në Pasomë, dhe në

¹⁸³⁵ Andrés Riedlmayer, T. 5441–5442 (30 tetor 2006). *Shih gjithashtu* P1799 (Fotografi të xhamive në Vushtrri), f. 1–2; IC87; IC88; P1788 (Pjesë nga P1789 në lidhje me xhaminë e Vushtrrisë). Dhoma vëren se i ka marrë parasysh kundërshtimet në lidhje me fotografitë e kësaj xhamie që janë ngritur nga mbrojtja e Lazareviqit në T. 5571–5576 më 31 tetor 2006.

¹⁸³⁶ Andrés Riedlmayer, T. 5443–5444 (30 tetor 2006). *Shih gjithashtu* P1799 (Fotografi të xhamive në Vushtrri), f. 3–5, dhe P2456 (Pjesë nga P1789 në lidhje me xhaminë Karamanli në Vushtrri), f. 1–6.

¹⁸³⁷ P1788 (Pjesë nga P1789 në lidhje me xhaminë e Vushtrrisë); Andrés Riedlmayer, T. 5458 (30 tetor 2006).

¹⁸³⁸ P1788 (Pjesë nga P1789 në lidhje me xhaminë e Vushtrrisë), f. 2.

¹⁸³⁹ Sabit Kadriu, P2377 (deklarata e dëshmitarit e datës 10 dhjetor 2000), f. 14.

Dumnicë të Poshtme. Kadriu shtoi se "forcat serbe" ishin të pranishme në pjesën verilindore të qytetit të Vushtrrisë deri në Samodrezhë, por UÇK-ja kishte pozicione në male më në veri në drejtim të komunës së Mitrovicës.¹⁸⁴⁰

749. Kadriu gjithashtu dëshmoi se rreth datës 28 prill 1999 "forcat serbe" përparuan me sukses kundër pozicioneve të UÇK-së në komunën e Mitrovicës.¹⁸⁴¹ Gjatë dy ditëve, ato konsoliduan pozicionet e veta dhe në të njëjtën kohë filluan një ofensivë të madhe kundër UÇK-së nga disa anë në drejtim të Vushtrrisë.¹⁸⁴² Gjatë përparimit të këtyre forcave, shqiptarët kosovarë të shpërngulur që fshiheshin në rajonin malor të Shalës dhe Bajgorës filluan të lëviznin drejt jugut, në drejtim të Samodrezhës, Sllakofcit, dhe Cecelisë. Më 1 maj, "forcat serbe" arritën deri në fshatin Vesekofc, një pikë strategjike e UÇK-së që gjendet lart në male në veri të komunës së Vushtrrisë. Atëherë UÇK-ja i këshilloi civilët shqiptarë kosovarë të largoheshin nga Sllakofci dhe të përpiqeshin të shkonin në qytetin e Vushtrrisë. Granatimi i Sllakofcit filloi në mbrëmjen e 1 majit. Të nesërmen në mëngjes granatimi u intensifikua dhe, si rezultat, njerëzit filluan të lëviznin në kolonë në drejtim të jugut për në Ceceli me qëllim që të shkonin në Studime të Epërme dhe më tej në qytetin e Vushtrrisë.¹⁸⁴³

750. Kadriu dhe miku i tij Fadil Beqiri ishin ndër të fundit që u larguan nga Cecelia dhe iu bashkuan kolonës për në Studime të Epërme. Nga maja e kodrës afër fshatit, ata panë rrugët plot me njerëz dhe traktorë. Ata mbërritën në Studime të Epërme rreth orës 15:00, Kadriu pa tym duke u ngritur nga shtëpitë në Ceceli.¹⁸⁴⁴

751. Mihajllo Gergari konfirmoi dëshminë e Kadriut se në fund të prillit 1999 forcat e UJ-së dhe MPB-së filluan një operacion në rajonin në veri dhe lindje të qytetit të Vushtrrisë. Ai tha se operacioni i përbashkët i UJ-së/MPB-së u ndërmor për shkak të pranisë së madhe të luftëtarëve të UÇK-së në zonën e Bajgorës, në veri të komunës së Vushtrrisë.¹⁸⁴⁵ Më vonë, më 15 prill 1999 Komanda e Përbashkët lëshoi një urdhër "për thyerjen dhe shkatërrimin e FTSH-së në zonën e Bajgorës-Bairit" (operacioni *Bajgora*). Qëllimi i këtij operacioni të përbashkët ishte vendosje në kontroll zona brenda trekëndëshit midis fshatit Tunel i Parë në veriperëndim, fshatit Bajgorë në verilindje (të dy në komunën e Mitrovicës), dhe fshatit Samodrezhë në komunën e Vushtrrisë në juglindje. Urdhri i ndante detyrat ndërmjet Brigadës së 211-të të Blinduar, Brigadës së 15-të të

¹⁸⁴⁰ Sabit Kadriu, T. 5125 (18 tetor 2006), P2377 (deklarata e dëshmitarit e datës 10 dhjetor 2000), f. 14.

¹⁸⁴¹ Sabit Kadriu, P2377 (deklarata e dëshmitarit e datës 10 dhjetor 2000), f. 14.

¹⁸⁴² Sabit Kadriu, T. 5125 (18 tetor 2006), P2377 (deklarata e dëshmitarit e datës 10 dhjetor 2000), f. 14.

¹⁸⁴³ Sabit Kadriu, P2377 (deklarata e dëshmitarit e datës 10 dhjetor 2000), f. 14.

¹⁸⁴⁴ Sabit Kadriu, P2377 (deklarata e dëshmitarit e datës 10 dhjetor 2000), f. 14.

¹⁸⁴⁵ Mihajllo Gergar, 5D1400 (deklarata e dëshmitarit e datës 28 janar 2008), para. 30–31.

Blinduar, dhe Brigadës së 58-të të Këmbëtorisë së Lehtë të UJ-së. Konkretisht, Brigada e 211-të e Blinduar duhej të dislokohej në vijën Bajgorë-Vesekofc-Samodrezhë (të gjitha në verilindje ose lindje të qytetit të Vushtrrisë), Brigada e 15-të e Blinduar duhej të ngrinte bllokadë përgjatë vijës Breznicë (komuna e Obiliqit)-Samodrezhë-Gojbulë-Smrekonicë (vijë që fillonte nga juglindja e qytetit të Vushtrrisë dhe përfundonte në veriperëndim të qytetit) për të "thyer dhe shkatërruar" "FTSH-në" në Skromë, Pasomë, Shlivovicë, dhe Ceceli. Brigada e 58-të e Këmbëtorisë së Lehtë duhej të dislokohej në vijën veriperëndimore, duke mbuluar kryesisht fshatrat e komunës së Mitrovicës.¹⁸⁴⁶ Duke u bazuar në analizën e një harte operacioni të UJ-së, duhej të merrnin pjesë edhe disa detashmente të PJP-së dhe të SAJ-së. UJ-ja duhej të dislokohej në pozicionet e jashtme, kurse forcat e MPB-së duhej të angazhoheshin në zmbrajsjen e UÇK-së në drejtim të jugperëndimit të Kosovës.¹⁸⁴⁷ Urdhri saktëson se operacioni duhej të fillonte më 25 prill 1999.¹⁸⁴⁸

752. Gergari dëshmoi se Brigada e 211-të e Blinduar mori pjesë në operacionin *Bajgora* dhe në disa raste i dha MPB-së mbështetje me zjarr duke përdorur mortajat kundër pozicioneve të fortifikuara të UÇK-së.¹⁸⁴⁹ Sipas tij, UJ-ja u angazhua në mbajtjen e bllokadës, duke mbajtur pozicione pasive (statike), kurse MPB-ja u angazhua në veprime aktive luftarake.¹⁸⁵⁰

753. Lubomir Saviqi, i cili nga 16 prilli 1999 ishte komandant i Brigadës së 58-të të Këmbëtorisë së Lehtë, dëshmoi se nga 25 prilli deri afërsisht më 2 maj 1999, një pjesë e kësaj brigade mori pjesë në mbështetjen e forcave të MPB-së në operacionin *Bajgora*. Njësia e tij u dislokua nga Stantërgu në drejtim të fshatrave Bair dhe Bajgorë më tej në veriperëndim.¹⁸⁵¹ Kur u pyet për ngjarjet e 2 majit në Studime të Epërme, ai u përgjigj se kjo zonë ishte nën kontrollin e Brigadës së 15-të të Blinduar, dhe jo të brigadës së tij.¹⁸⁵²

754. Ditari i luftës i Brigadës së 15-të të Blinduar tregon se, më 21 prill 1999, njësia filloi përgatitjet dhe lidhjen me forcat e MPB-së për zbatimin e detyrave të operacionit *Bajgora* dhe se më 24 dhe 25 prill njësitë e brigadës u angazhuan në një rrethim në mbështetje të MPB-së gjatë këtij operacioni.¹⁸⁵³ Ditari gjithashtu tregon se, më 29 prill, Brigada e 15-të e Blinduar, së bashku me Brigadën e 2-të të Motorizuar dhe Brigadën e 1-rë të Motorizuar, vazhduan të kryenin detyrat e

¹⁸⁴⁶ P1975 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 15 prill 1999), f. 3; 5D1329 (Harta dhe Vendimi i Brigadës së 211-të të Blinduar).

¹⁸⁴⁷ Mihajllo Gergar, T. 21487–21489 (31 janar 2008); 5D1329 (Harta dhe Vendimi i Brigadës së 211-të të Blinduar).

¹⁸⁴⁸ P1975 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 15 prill 1999), f. 3; 5D1329 (Harta dhe Vendimi i Brigadës së 211-të të Blinduar).

¹⁸⁴⁹ Mihajllo Gergar, 5D1400 (deklarata e dëshmitarit e datës 28 janar 2008), para. 31, T. 21534–21535 (1 shkurt 2008).

¹⁸⁵⁰ Mihajllo Gergar, T. 21534–21535 (1 shkurt 2008).

¹⁸⁵¹ Lubomir Saviq, 5D1392 (deklarata e dëshmitarit e datës 20 janar 2008), para. 17.

¹⁸⁵² Lubomir Saviq, T. 21012–T. 21013 (24 janar 2008).

planifikuara të operacionit. Në ditar gjithashtu thuhet se njësi të ndryshme të Brigadës së 15-të të Blinduar zunë pozicione në fshatrat Zhilivodë dhe Strofc në jug të komunës së Vushtrrisë dhe se më 30 prill kolona "refugjatësh" kaluan nga kodrat e Bajgorës në vargmalet e Kopaonikut.¹⁸⁵⁴ Aty gjithashtu thuhet se forcat e MPB-së u angazhuan në "filtrimin" dhe drejtimin e kolonave.¹⁸⁵⁵ Një raport i Brigadës së 15-të të Blinduar i datës 2 maj 1999 tregon se batalionet e kësaj brigade u angazhuan në "kryerjen e detyrave të Vendimit të planit 'Bajgora'"¹⁸⁵⁶ Vladimir Marinkoviqi, komandanti i atëhershëm i Brigadës së 15-të të Blinduar, dëshmoi se, në fillim të majit pa kolona civilësh duke lëvizur përgjatë rrugës.¹⁸⁵⁷

755. Forca të tjera që morën pjesë në operacionin *Bajgora* ishin Detashmenti i 35-të i PJP-së dhe Brigada e 122-të për Ndërhyrje e PJP-së të MPB-s, siç u bë e ditur nga komandantët e tyre përkatës, kolonel Branko Perleviq dhe nënkolonel Dragan Nikolliq, në një mbledhje të mbajtur në Shtabin e MPB-së më 11 maj 1999.¹⁸⁵⁸ Bogunoviqi konfirmoi se PJP-ja mori pjesë në operacion. Ai tha se, më 2 maj 1999, një kompani e PJP-së nga SPB-ja e Mitrovicës lëvizi përgjatë vijës Bare-Tërstenë-Pasomë-Kçiq i Madh deri në verilindje të Studimes së Epërme. Pikërisht para muzgut, ata përfunduan veprimet e tyre dhe u kthyen në Mitrovicë.¹⁸⁵⁹

756. Fedrije Xhafa me familjen e saj qëndruan në fshatin Vesekofc në veri të komunës së Vushtrrisë nga fundi i marsit deri në fund të prillit 1999 për shkak të granatimit të fshatit të saj, Sfraçakut të Poshtëm nga "forcat serbe" në fund të marsit.¹⁸⁶⁰ Rreth datës 30 prill, ata u larguan nga Vesekofci dhe shkuan në Sllakofc, i cili ndodhej afër dhe në atë kohë ishte nën kontrollin e UÇK-së.¹⁸⁶¹ Ajo tregoi se në pjesën verilindore të qytetit të Vushtrrisë duke përfshirë Skllakofcin, u mbledhën shumë njerëz të shpërngulur duke kërkuar mbrojtje nga UÇK-ja.¹⁸⁶²

757. Pasi kaluan dy net në Sllakofc, UÇK-ja lajmëroi Xhafën dhe familjen e saj se "serbët" po afroreshin nga veriu dhe se ata duhej të provonin të shkonin në qytetin e Vushtrrisë.¹⁸⁶³ Ata iu

¹⁸⁵³ P2572 (Ditari i Luftës i Brigadës së 15-të të Blinduar të UJ-së), shënim i datës 21, 24, 25 prill 1999.

¹⁸⁵⁴ P2572 (Ditari i Luftës i Brigadës së 15-të të Blinduar të UJ-së), shënim i datës 29 prill 1999.

¹⁸⁵⁵ P2572 (Ditari i Luftës i Brigadës së 15-të të Blinduar të UJ-së), shënim i datës 30 prill 1999.

¹⁸⁵⁶ 5D1437 (Raport i Brigadës së 15-të të Blinduar dërguar PrK-së, 2 maj 1999), para. 2, 8.

¹⁸⁵⁷ Vladimir Marinkoviqi, T. 20325–20326 (14 dhjetor 2007).

¹⁸⁵⁸ P1993 (Procesverballi i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 11 maj 1999) f. 2, 4–5.

¹⁸⁵⁹ 6D1614 Nebojsha Bogunoviqi, (deklarata e dëshmitarit e datës 2 prill 2008), para. 67.

¹⁸⁶⁰ Fedrije Xhafa, T. 2420 (25 gusht 2006); Fedrije Xhafa, P2274 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 gusht 2006), para. 2.

¹⁸⁶¹ Fedrije Xhafa, T. 2456 (28 gusht 2006).

¹⁸⁶² Fedrije Xhafa, P2274 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 gusht 2006), para. 4.

¹⁸⁶³ Fedrije Xhafa, T. 2421 (25 gusht 2006), P2274 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 gusht 2006), para. 4.

bashkuan një kolone e cila lëvizte nga Sllakofci në jug për në Ceceli dhe pastaj në Studime të Epërme.

758. Nga fillimi i prillit dhe deri në fillim të majit 1999, Shukri Gërxhaliu dhe familja e tij gjithashtu ishin në Sllakofc, ku ai punoi në "spitalin" e UÇK-së.¹⁸⁶⁴ Sikurse edhe Xhafa, ai tha se, në fillim të majit UÇK-ja u tha të gjithë njerëzve që ishin në Sllakofc se "serbët" e kishin thyer vijën e frontit dhe se duhej të largoheshin.¹⁸⁶⁵ Gërxhaliu dhe familja e tij iu bashkuan një kolone me traktorë dhe rimorkio që shkonte në jug në drejtim të Studimes së Poshtme.¹⁸⁶⁶

759. Kadriu, Xhafa, dhe Gërxhaliu vlerësuan se kolona në të cilën ishin, kishte afërsisht 30.000-50.000 njerëz.¹⁸⁶⁷ Xhafa dëshmoi se më 2 maj, rreth orës 16:00, kolona ndaloi për shkak të ndalim-qarkullimit dhe u rrethua nga "ushtria serbe." Kur ndodhi kjo, ajo ishte në një rimorkio afër Studimes së Epërme.¹⁸⁶⁸ Rreth orës 21:00, katër burra, të cilët ajo i përshkroi si "policë serbë," erdhën duke shkrepur automatikë në ajër dhe duke i sharë njerëzit në kolonë. Forca të tjera me uniforma kamuflimi të kaltra dhe të tjerë me maska dhe doreza të zeza të cilët Xhafa i përshkroi si "paraushtarakë," i urdhëruan me zë të lartë shoferët e traktorëve që të lironin rrugën, sepse do të kalonin ata me automjetet e tyre.¹⁸⁶⁹ Xhafa shpjegoi se me përshkrimet "policë" dhe "paraushtarakë" ajo e kishte fjalën për të njëjtin grup njerëzish, sidoqoftë, "paraushtarakë" ajo quante ata persona që, përveç uniformave të kaltra të kamuflimit, kishin edhe maska e doreza të zeza.¹⁸⁷⁰ Disa nga "policët" kapën nipin e saj Ismetin dhe filluan ta rrihnin. Ata e akuzuan se ishte luftëtar i UÇK-së. Në fakt, ai kishte qenë në UÇK deri në fillim të fushatës së NATO-s. Pas kësaj ata kërkuan para dhe kërcënuan se do të vrisnin Ismetin nëse nuk merrnin para. Xhafa u dha 200 marka gjermane dhe ata e liruan Ismetin.¹⁸⁷¹

760. Më tej Xhafa dëshmoi se traktorit të saj iu afrua një grup "policësh/paraushtarakësh" serbë me uniforma kamuflimi të kaltra dhe maska të zeza. Një prej tyre mori vëllain e saj Jetishin nga

¹⁸⁶⁴ Shukri Gërxhaliu, P2275 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 shkurt 2002), para. 6–9.

¹⁸⁶⁵ Shukri Gërxhaliu, P2275 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 shkurt 2002), para. 11.

¹⁸⁶⁶ Shukri Gërxhaliu, P2275 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 shkurt 2002), para. 9.

¹⁸⁶⁷ Sabit Kadriu, T. 5077, 5097–5098 (18 tetor 2006); P2377 (deklarata e dëshmitarit e datës 10 dhjetor 2000), f. 15; Fedrije Xhafa, T. 2431–2432 (25 gusht 2006), P2274 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 gusht 2006), para. 4; Shukri Gërxhaliu, T. 2510, 2559–2562 (30 gusht 2006), P2275 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 shkurt 2002), para. 11; P2386 (Kërkesë e Këshillit Komunal të Vushtrisë për ndihmë humanitare për rreth 30,000 refugjatë, 3 maj 1999).

¹⁸⁶⁸ Fedrije Xhafa, T. 2437 (28 gusht 2006), P2274 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 gusht 2006). *Shih gjithashtu* IC21 (Harta e Vushtrisë e shënuar nga Fedrije Xhafa).

¹⁸⁶⁹ Fedrije Xhafa, T. 2467–2468, 2478–2479 (28 gusht 2006). *Shih gjithashtu* Fedrije Xhafa, P2274 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 gusht 2006), para. 5.

¹⁸⁷⁰ Fedrije Xhafa, T. 2363–2469, 2478–2479 (28 gusht 2006). *Shih gjithashtu* Fedrije Xhafa, P2274 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 gusht 2006), para. 5.

¹⁸⁷¹ Fedrije Xhafa, P2274 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 gusht 2006), para. 5.

traktori dhe filloi ta rrihte me shkop druri.¹⁸⁷² Në fund polici e liroi Jetishin, por jo pa kërkuar dhe marrë stolitë e gruas së tij.¹⁸⁷³ Sipas Xhafës, Jetishi nuk ishte pjesëtar i UÇK-së.¹⁸⁷⁴

761. Rreth orës 23:30, një grup i tretë "policësh" erdhi te traktori i familjes së Xhafës.¹⁸⁷⁵ Këta njerëz kishin maska të zeza në fytyrë dhe uniforma kamuflimi të kaltra.¹⁸⁷⁶ Njëri nga ta i drejtoi automatikun në gjoks nënës së Xhafës.¹⁸⁷⁷ Një polic tjetër tërhoqi zvarrë në shkurre vëllain e saj Jetishin.¹⁸⁷⁸ Xhafa tregoi më pas dëgjoji një krismë dhe e pa vëllain e saj të rrëzohej.¹⁸⁷⁹ Kur "policët" filluan të largoheshin, babai i Xhafës, Mirani, u tha diçka në serbisht. Policët u kthyen, e tërhoqën zvarrë dhe shtinë mbi të.¹⁸⁸⁰ Pastaj ata urdhëruan Xhafën dhe familjen e saj të hipnin në traktor pa u dhënë mundësi të shihnin gjendjen e dy burrave.¹⁸⁸¹ Më vonë Xhafa mësoi se babai i saj ishte vrarë, por vëllai kishte shpëtuar.¹⁸⁸² Shukri Gërxhaliu konfirmoi se më vonë e mjekoi Jetish Xhafën, i cili ishte i plagosur në kokë nga një armë zjarri; Gërxhaliu dëshmoi se ai mendonte se Jetishi ishte qëlluar nga "njëfarë largësie."¹⁸⁸³

762. Mbrojtja e Llukiqit pretendon se ekziston mospërputhje midis dëshmisë së Xhafës, e cila sipas Mbrojtjes tha se vëllai i saj u qëllua nga afër, dhe dëshmisë së Gërxhaliut, i cili më vonë e mjekoi Jetish Xhafën dhe mendonte se ai ishte qëlluar nga "një farë largësie."¹⁸⁸⁴ Dhoma gjykon se Mbrojtja e Llukiqit ka bërë interpretim të tepruar të dëshmisë së Xhafës, e cila asnjëherë nuk tha se vëllai i saj u qëllua nga afër, por vetëm se "policët" i drejtuan armën në kokë dhe se më pas ajo dëgjoji një krismë. Gjithashtu, Dhoma konstaton se Gërxhaliu nuk është i kualifikuar të japë mendim për largësinë prej së cilës u qëllua Jetish Xhafa, se ai u pyet se çfarë donte të thoshte me "një farë largësie," dhe se ai ishte dëshmitar okular i plagosjes, kurse Xhafa po, dhe Dhoma i beson asaj.

¹⁸⁷² Fedrije Xhafa, T. 2441, 2479 (28 gusht 2006). *Shih gjithashtu* Fedrije Xhafa, P2274 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 gusht 2006), para. 6.

¹⁸⁷³ Fedrije Xhafa, P2274 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 gusht 2006), para. 6.

¹⁸⁷⁴ Fedrije Xhafa, T. 2474 (28 gusht 2006).

¹⁸⁷⁵ Fedrije Xhafa, P2274 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 gusht 2006), para. 7.

¹⁸⁷⁶ Fedrije Xhafa, T. 2469 (28 gusht 2006). *Shih gjithashtu* Fedrije Xhafa, P2274 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 gusht 2006), para. 7.

¹⁸⁷⁷ Fedrije Xhafa, P2274 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 gusht 2006), para. 7.

¹⁸⁷⁸ Fedrije Xhafa, T. 2443 (28 gusht 2006); Fedrije Xhafa, P2274 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 gusht 2006), para. 7.

¹⁸⁷⁹ Fedrije Xhafa, T. 2421–2422 (25 gusht 2006); Fedrije Xhafa, P2274 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 gusht 2006), para. 7.

¹⁸⁸⁰ Fedrije Xhafa, P2274 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 gusht 2006), para. 8.

¹⁸⁸¹ Fedrije Xhafa, P2274 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 gusht 2006), para. 9.

¹⁸⁸² Fedrije Xhafa, T. 2422 (25 gusht 2006); Shukri Gërxhaliu, T. 2605–2607 (30 gusht 2006).

¹⁸⁸³ Shukri Gërxhaliu, T. 2605–2607 (30 gusht 2006).

¹⁸⁸⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 1243.

763. Më pas nipi 13-vjeçar i Xhafës provoi të ngiste traktorin, por nuk ishte në gjendje dhe një "polic" e rrahu me kondak pushke. Familja shkoi përpara rreth 100 metra me traktor dhe pastaj e braktisën nga frika se do të sulmoheshin përsëri. Kur "serbët" i urdhëruan të lëviznin përsëri, ata vazhduan në këmbë, duke i lënë të gjitha gjërat pas.¹⁸⁸⁵ Policët i drejtuan te godinat e një kooperative bujqësore në skaj të qytetit të Vushtrrisë, ku mbërritën më 3 maj 1999, në orën 02:00.¹⁸⁸⁶

764. Më tej Xhafa dëshmoi se ajo dhe familja e saj atë natë qëndruan në kooperativën bujqësore dhe të nesërmen në mëngjes erdhi zëvendëskomandanti i policisë së Vushtrrisë. Të tjerët i treguan se kooperativa ishte e rrethuar nga policia, të cilët nuk i lejonin njerëzit të largoheshin. Burrat u ndanë nga gratë dhe të gjithë meshkujt e moshës 15-60 vjeç u dërguan në burgun e Smrekonicës. Njerëzit e mbetur që kishin automjete u urdhëruan të shkonin në Shqipëri. Ata të cilët nuk kishin automjete – përfshirë familjen e Xhafës – u urdhëruan të shkonin në fshatin Kçiq në komunën e Mitrovicës.¹⁸⁸⁷ Familja qëndroi katër ditë në një shtëpi të braktisur në Kçiq.¹⁸⁸⁸

765. Lubomir Saviqi dëshmoi se, më 2 maj 1999 në afërsi të Kçiqit, pjesëtarët e Brigadës së 58-të të Këmbëorisë së Lehtë hasën në një grup prej 2.000-3.000 "refugjatësh," shumica gra, fëmijë, dhe të moshuar. Pasi kontaktuan SPB-në e Mitrovicës, u mor vendim që t'i strehonin në Kçiq derisa të bëhej i mundur kthimi në shtëpitë e tyre. Sipas Saviqit, njerëzit e pranuan ofertën e tij.¹⁸⁸⁹

766. Pasi kaluan katër ditë në Kçiq, Xhafa dhe familja e saj shkuan në Dobërllukë.¹⁸⁹⁰ Më 15 maj, pjesëtarë të policisë, disa prej të cilëve ajo i njihte nga incidenti i Studimes së Epërme, erdhën në shtëpinë në Dobërllukë ku ishin Xhafa dhe familja e saj dhe i morën meshkujt. Gratë u urdhëruan që të shkonin në një vend në Smrekonicë, për t'u regjistruar. Policia i dha Xhafës një kartë, në të cilën shkruhej se ajo lejohej të qëndronte në shtëpinë në Dobërllukë.¹⁸⁹¹ Ajo qëndroi atje deri në fund të konfliktit. Kur u kthye në shtëpi në Sfraçak të Poshtëm, e gjeti shtëpinë e djegur.¹⁸⁹²

767. Dëshmia e Shukri Gërxhaliut për ngjarjet e 2 majit 1999 ishte e ngjashme. Sipas tij, rreth orës 13:00 të asaj dite, kolona lëvizi ngadalë nga veriu, duke u shtyrë drejt jugut nga "serbët" të

¹⁸⁸⁵ Fedrije Xhafa, T. 2423 (25 gusht 2006).

¹⁸⁸⁶ Fedrije Xhafa, T. 2423 (25 gusht 2006), P2274 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 gusht 2006), para. 10.

¹⁸⁸⁷ Fedrije Xhafa, P2274 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 gusht 2006), para. 11.

¹⁸⁸⁸ Fedrije Xhafa, P2274 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 gusht 2006), para. 11. *Shih gjithashtu* Fedrije Xhafa, T. 2423–2424 (25 gusht 2006).

¹⁸⁸⁹ Lubomir Saviq, 5D1392 (deklarata e dëshmitarit e datës 27 dhjetor 2007), para. 33.

¹⁸⁹⁰ Fedrije Xhafa, P2274 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 gusht 2006), para. 11. *Shih gjithashtu* IC20 (Prova materiale P38 i shënuar nga Fedrije Xhafa).

¹⁸⁹¹ Fedrije Xhafa, P2274 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 gusht 2006), para. 11–13.

¹⁸⁹² Fedrije Xhafa, T. 2424 (25 gusht 2006).

cilët granatonin nga veriu në drejtim të kolonës.¹⁸⁹³ Si rezultat i këtij granatimi, u plagosën shumë njerëz në kolonë.¹⁸⁹⁴ Kolona ndaloi rreth orës 16:00 kur u thanë se ishte vendosur ndalim-qarkullimi.¹⁸⁹⁵ Me t'u ndalur, kolona u rrethua nga të gjitha anët "nga forcat serbe."¹⁸⁹⁶ Gërxhaliu dhe familja e tij ishin diku në mes të kolonës, më afër Studimes së Epërme.¹⁸⁹⁷

768. Rreth orës 17:00, një numër i madh "forcash ushtarake dhe paraushtarake serbe" me uniforma kamuflimi të kaltra dhe të gjelbra iu afruan kolonës nga veriu.¹⁸⁹⁸ Nga frika se mos e njihnin, Gërxhaliu u fsheh nën mbulesën e mushamasë që mbulonte një pjesë të rimorkios.¹⁸⁹⁹ "Ushtarët," disa nga të cilët kishin maska dhe fytyra të ngjyrosura, iu afruan traktorëve dhe kërkuan para prej njerëzve.¹⁹⁰⁰ Gërxhaliu dëshmoi se gruaja e tij u kërcënua nga një "paraushtarak" i cili i kërkoi para. Te traktori në të cilin ishte i fshehur, "serbët" erdhën tri ose katër herë dhe çdo herë gruaja e tij u shtrëngua t'u jepte para.¹⁹⁰¹

769. Kunati i Gërxhaliut u rrahur keqas nga një grup "paraushtarakësh," disa prej të cilëve kishin uniforma të zeza, disa uniforma kamuflimi të kaltra, dhe disa uniforma kamuflimi të gjelbra.¹⁹⁰² Ai gjithashtu vuri re se "paraushtarakët" kishin maska; disa kishin kryqe të vegjël ortodoks në ballë, kurse të tjerët vetulla dhe mustaqe të vizatuara në fytyrë.¹⁹⁰³

770. Më vonë atë natë, kur kolona ishte a palëvizshme, një kolonë tjetër me "ushtarë serbë" erdhi nga veriu me xhipa dhe autoblanda.¹⁹⁰⁴ Këta ushtarë i përdorën makinat e tyre që të shtynin në përrua traktorët që ua zinin rrugën. Pas kësaj ata filluan të ecnin pranë kolonës duke kërkuar para. Ata të cilët nuk dhanë ose nuk kishin para, u vranë.¹⁹⁰⁵ Ai pa kur një burrë me mbiemrin Bunjaku u vra nga këta ushtarë. I fshehur në traktorin e tij, Gërxhaliu dëgjoi dy "ushtarë" duke me njëri-tjetrin për numrin e viktimave që kishin vranë atë ditë. Njëri nga "ushtarët" tha se kishte vranë rreth 50 vetë, kurse tjetri shtoi se duhej të vazhdonin të vrisnin deri sa të mbërrinin në 100.¹⁹⁰⁶ Gërxhaliu

¹⁸⁹³ Shukri Gërxhaliu, P2275 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 shkurt 2000), para. 12–13.

¹⁸⁹⁴ Shukri Gërxhaliu, P2275 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 shkurt 2000), para. 12–13.

¹⁸⁹⁵ Shukri Gërxhaliu, P2275 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 shkurt 2000), para. 14.

¹⁸⁹⁶ Fedrije Xhafa, P2274 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 gusht 2006), para. 5.

¹⁸⁹⁷ Shukri Gërxhaliu, T. 2510 (28 gusht 2006).

¹⁸⁹⁸ Shukri Gërxhaliu, P2275 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 shkurt 2000), para. 15.

¹⁸⁹⁹ Shukri Gërxhaliu, P2275 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 shkurt 2000), para. 15.

¹⁹⁰⁰ Shukri Gërxhaliu, P2275 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 shkurt 2000), para. 15–16.

¹⁹⁰¹ Shukri Gërxhaliu, P2275 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 shkurt 2000), para. 15.

¹⁹⁰² Shukri Gërxhaliu, P2275 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 shkurt 2000), para. 16–17.

¹⁹⁰³ Shukri Gërxhaliu, P2275 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 shkurt 2000), para. 16.

¹⁹⁰⁴ Shukri Gërxhaliu, T. 2513–2514 (28 gusht 2006); T. 2578–2579, 2584–2587 (30 gusht 2006). *Shih gjithashtu* Shukri Gërxhaliu, P2275 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 shkurt 2000), para. 18.

¹⁹⁰⁵ Shukri Gërxhaliu, P2275 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 shkurt 2000), para. 18.

¹⁹⁰⁶ Shukri Gërxhaliu, P2275 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 shkurt 2000), para. 21.

shpjegoi se disa nga këta ushtarë kishin shami rreth kokës, disa kishin fytyrat e ngjyrosura dhe gjithashtu kishin uniforma të ndryshme. Sidoqoftë, kur u pyet nga Mbrojtja ai pranoi se nuk kishte parë shumë sepse ishte gjysmë i fshehur në traktor; ai më tepër kishte dëgjuar se çfarë po ndodhte.¹⁹⁰⁷

771. Kur "ushtarët" iu afruan automjetit ku ishte fshehur Gërxhaliu, ai dhe kunati i tij vendosën të iknin.¹⁹⁰⁸ Ata kërcyen nga rimorkioja. Gërxhaliu ra mbi kufomën e kushëririt të tij, Haki Gërxhaliu, i cili duhej të ishte vrarë më herët. Ata vrapuan deri në një përrua dhe u fshehën. Më vonë, bashkëshortja e tij i tregoi Gërxhaliut se disa anëtarë të një familjeje, të cilët kishin qenë në traktorin para tyre, ishin tërhequr zvarrë nga "policët" dhe ishin vrarë.¹⁹⁰⁹

772. Rreth orës 23:45, kolona u lejua të vazhdonte rrugën.¹⁹¹⁰ Nga vendi ku ishte fshehur, ai pa rreth 10 automjete duke ardhur nga drejtimi i Studimes së Poshtme, duke përfshirë makina policie Zastava 101 dhe autoblanda.¹⁹¹¹ Makinat i kishin dritat e përparme të ndezura dhe njerëzit brenda dukeshin sikur gjurmonin terrenin.¹⁹¹² Pas largimit të tyre, Gërxhaliu dhe kunati i tij ecën në këmbë në drejtim të Studimes së Epërme dhe pastaj u kthyen në Sllakofc.¹⁹¹³

773. Kadriu dëshmoi se ishte më afër kreut të kolonës kur ndaloi më 2 maj pas vendosjes së ndalim-qarkullimit. Ai mendonte se ndalim-qarkullimi filloi në orën 18:00 e jo në orën 16:00.¹⁹¹⁴ Sidoqoftë, Dhoma e konsideron këtë ndryshim të papërfillshëm. Kur u errësua, Kadriu dëgjoi krisma automatiku dhe pa shtëpi që digjeshin në Studime të Epërme. Rreth orës 21:00, ai dëgjoi njerëz, të cilët ai i identifikoi si "serbë," duke bërë titur, "shtyj, shtyje!" Pas pak, Kadriu pa tre "serbë" me armë automatike duke ardhur nga drejtimi i Studimes së Epërme. Këta "serbë" u bërë titur njerëzve në kolonë, duke i urdhëruar që t'u shkonin pas. Kadriu shkoi pas këtyre njerëzve në drejtim të Studimes së Epërme. Rrugës pa njërin prej tyre kur hapi zjarr. Kadriu pa një kufomë në tokë në vendin ku ishte hapur zjarr, por në terr nuk ishte në gjendje të dallonte se ishte femër apo mashkull. Në vendin ku degëzohej rruga, grupi u në degëzimin drejt qytetit të Vushtrrisë. Kur pas tyre filluan të binin predha, Kadriu kuptoi se ishte në një grup prej rreth 1.000 vetësh që ishte ndarë nga kolona kryesore pas tyre. Duke vazhduar, ai pa kufoma anash rrugës, por "serbët" që shoqëronin grupin u

¹⁹⁰⁷ Shukri Gërxhaliu, T. 2578–2579, 2584–2587 (30 gusht 2006).

¹⁹⁰⁸ Shukri Gërxhaliu, P2275 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 shkurt 2000), para. 21.

¹⁹⁰⁹ Shukri Gërxhaliu, P2275 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 shkurt 2000), para. 22.

¹⁹¹⁰ Shukri Gërxhaliu, T. 2513 (28 gusht 2006). *Shih gjithashtu* Shukri Gërxhaliu, P2275 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 shkurt 2000), para. 24.

¹⁹¹¹ Shukri Gërxhaliu, T. 2513–2514 (28 gusht 2006), P2275 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 shkurt 2000), para. 24. *Shih gjithashtu* Fedrije Xhafa, T. 2483 (28 gusht 2006), P2274 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 gusht 2006), para. 9.

¹⁹¹² Shukri Gërxhaliu, P2275 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 shkurt 2000), para. 24.

¹⁹¹³ Shukri Gërxhaliu, P2275 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 shkurt 2000), para. 25.

thanë të nguteshin. Ata i çuan në një kooperativë bujqësore e cila kishte disa hangarë. Sikurse edhe Xhafa, grupi i Kadriut u urdhërua të kalonte natën në këta hangarë.¹⁹¹⁵

774. Të nesërmen, njerëzit u nxorën nga hangarët. Kadriu pa se burra me uniforma kamuflimi të kaltra e kishin rrethuar vendin.¹⁹¹⁶ Disa nga grupi i shqiptarëve kosovarë i fshehën kufomat e pjesëtarëve të familjeve të tyre nëpër traktorë. Në atë zonë kishte edhe njerëz të lënduar. Kadriu dhe burra të tjerë u urdhëruan të shkonin në një arë aty afër, e cila ishte e rrethuar me policë, kurse gratë dhe fëmijët qëndruan në kooperativë për t'u regjistruar. Kadriu e identifikoi policin i cili mbikëqyrte lëvizjen dhe regjistrimin e grave e fëmijëve si komandanti i stacionit policor në Vushtrri. Ai gjithashtu pa dy policë kur morën një të njohurin e tij, Ali Mërnica, dhe e larguan dhe pas pak u dëgjuan dy krisma. Edhe pse në atë kohë nuk e pa kufomën e tij, pas mbarimit të konfliktit mësoi se kufoma e Mërnica ishte gjetur e varrosur me katër kufoma të tjera në fshatin Pestovë.¹⁹¹⁷

775. Më pas "serbët" i urdhëruan burrat me patentë shoferi të rreshtoheshin. Rreth 30 prej tyre u dërguan përsëri në kooperativë. Kadriu mendoi se ata ishin urdhëruar t'i dërgonin gratë dhe fëmijët në Shqipëri.¹⁹¹⁸ Atë dhe burrat e tjerë i urdhëruan të vraponin në drejtim të disa kamionëve nëpër një korridor të formuar nga "policët." Policët i rrahën me shkopinj druri ndërsa ata vraponin pranë tyre. Kamionët i çuan në burgun që gjendet në fshatin Smrekonicë.¹⁹¹⁹

776. Bogunoviçi dëshmoi se në fund të prillit dhe fillim të majit 1999 shkoi me makinë nga Mitrovica në drejtim të Vushtrrisë për vëzhgim në terrenin situatën dhe për të raportuar në lidhje me kolonën e "refugjatëve" që lëvizte në drejtim të Samodrezhës, që ndodhet fill në lindje të Studimes së Epërme në drejtim të Vushtrrisë.¹⁹²⁰ Ai përshkroi se kishte takuar civilë dhe policë të DPB-së së Vushtrrisë, pa shpjeguar se ku i kishte takuar. Ai u mundua t'i bindte civilët që të ktheheshin, por pa sukses. Pas kësaj, pjesëtarët e DPB-së së Vushtrrisë propozuan që civilët të strehoheshin në lokalet e kooperativës bujqësore dhe ata pranuan. Më tej Bogunoviçi tha se kur pyeti se a kishte të plagosur në mesin e civilëve, askush nuk i tha se kishte të plagosur apo të vrarë. Ai pranoi se civilët i kërkuan barna për të sëmurët, që ai ua dha.¹⁹²¹ Gjithashtu ai tha se të nesërmen dëgjoji se civilët

¹⁹¹⁴ Sabit Kadriu, P2377 (deklarata e dëshmitarit e datës 10 dhjetor 2000), f. 15.

¹⁹¹⁵ Sabit Kadriu, P2377 (deklarata e dëshmitarit e datës 10 dhjetor 2000), f. 16.

¹⁹¹⁶ Sabit Kadriu, P2377 (deklarata e dëshmitarit e datës 10 dhjetor 2000), f. 17.

¹⁹¹⁷ Sabit Kadriu, P2377 (deklarata e dëshmitarit e datës 10 dhjetor 2000), f. 17.

¹⁹¹⁸ Sabit Kadriu, P2377 (deklarata e dëshmitarit e datës 10 dhjetor 2000), f. 17.

¹⁹¹⁹ Sabit Kadriu, P2377 (deklarata e dëshmitarit e datës 10 dhjetor 2000), f. 18.

¹⁹²⁰ Nebojsa Bogunoviç, 6D1614 (deklarata e dëshmitarit e datës 6 prill 2008), para. 67.

¹⁹²¹ Nebojsa Bogunoviç, 6D1614 (deklarata e dëshmitarit e datës 6 prill 2008), para. 67.

ishin larguar nga lokalet e kooperativës bujqësore, ku disa ishin kthyer në shtëpitë e tyre dhe disa ishin strehuar në fshatrat e afërta.¹⁹²²

777. Mbrojtjet e Llukiqit dhe Pavkoviqit pretendojnë se civilët e dërguar në kooperativën bujqësore ishin të lirë të largoheshin, siç tregon edhe dëshmia e Xhafës, përveç atyre që dyshoheshin se kishin marrë pjesë në sulme terroriste. Këta u dërguan në burgun e Smrekonicës, "ku ata kundër të cilëve nuk kishte prova, u liruan më pas."¹⁹²³ Dhoma i hedh poshtë këto argumente duke u bazuar në dëshmitë e Xhafës dhe të Kadriut, të cilët dëshmuar se forca të armatosura serbe i çuan në kooperativë dhe se lokalet e kooperativës ishin të rrethuara nga policë.

778. Në burgun e Smrekonicës, burrave të burgosur u kontrolluan dokumentet persona që Kadriu i përshkroi si "njerëz të policisë sekrete serbe me rroba civile," dy nga të cilët ai i njohu. Duke hyrë në godinën e burgut, burrat u rrahën nga policë të cilët përdorën shkopinj dhe kondakët e pushkëve.¹⁹²⁴ Kadriu u mbajt rreth 20 ditë në një qeli të tejmbushur; dy ose tri ditët e para nuk i dhanë as ushqim, as ujë.¹⁹²⁵ Më 7 maj 1999, Bogunoviçi raportoi në mbledhjen e Shtabit të MPB-së në Prishtinë se 827 "terroristë" mbaheshin në burgun e Smrekonicës. Sipas një raporti të stacionit policor të Vushtrrisë të 16 majit 1999 dërguar SPB-së në Mitrovicë, në burg mbaheshin rreth 830 të burgosur. Sidoqoftë, Kadriu vlerësoi se numri shkoi në rreth 2.000.¹⁹²⁶ Të burgosurit rriheshin rregullisht nga policët, disa prej të cilëve Kadriu i njihte nga Vushtrria. Rreth ditës së dymbëdhjetë të burgosjes së Kadriut, një "burrë serb" me rroba civile i dha Kadriut një dokument për ta nënshkruar në zyrën e drejtorit të burgut. Edhe pse në këtë dokument ai pranonte se kishte qenë pjesëtar i grupit "terrorist" që vepronte kundër qeverisë, Kadriu gjykoj se nuk kishte zgjedhje tjetër veçse ta nënshkruante. Pas kësaj ngjarjeje, u bë e zakonshme që policë me uniforma kamuflimi të kaltra, disa nga të cilët Kadriu i njihte personalisht që më parë, të merrnin të burgosur të caktuar dhe t'i dërgonin teposhtë shkallëve të një godine të vogël në oborrin e burgut dhe t'i rrihnin.¹⁹²⁷

779. Në një rast, gjatë qëndrimit në burg të burgosurit u morën nga burgu dhe u dërguan me kamionë në dy vende të ndryshme në Mitrovicë.¹⁹²⁸ Grupi i Kadriut u dërgua në Shkollën Teknike,

¹⁹²² Nebojsa Bogunoviç, 6D1614 (deklarata e dëshmitarit e datës 6 prill 2008), para. 70.

¹⁹²³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 1254–1257; Dosja Përfundimtare e Pavkoviqit, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 546.

¹⁹²⁴ Sabit Kadriu, P2377 (deklarata e dëshmitarit e datës 10 dhjetor 2000), f. 18.

¹⁹²⁵ Sabit Kadriu, P2377 (deklarata e dëshmitarit e datës 10 dhjetor 2000), f. 18. *Shih gjithashtu* Sabit Kadriu, T. 5074–5075 (18 tetor 2006).

¹⁹²⁶ Sabit Kadriu, T. 5076–5077, 5096–5098 (18 tetor 2006); P53 (Raport i Stacionit Policor të Vushtrrisë dërguar SPB-së së Mitrovicës, 16 maj 1999); P1231 (Raport i Stacionit Policor të Vushtrrisë dërguar SPB-së së Mitrovicës, 3 maj 1999).

¹⁹²⁷ Sabit Kadriu, P2377 (deklarata e dëshmitarit e datës 10 dhjetor 2000), f. 19.

¹⁹²⁸ Sabit Kadriu, P2377 (deklarata e dëshmitarit e datës 10 dhjetor 2000), f. 19.

ku ata u rrahën nga pjesëtarë dhe kadetë të policisë. Kadriu u fut në një klasë, ku dy "serbë" me rroba civile filluan ta pyesnin dhe e akuzuan si pjesëtar i UÇK-së dhe se i kishte dhënë NATO-s të dhëna sekrete. Ata e pyetën edhe për lidhjet e tij me OSBE-në. Kur Kadriu mohoi lidhje me UÇK-në, njëri nga serbët u ngrit dhe filloi ta rrihte me shkop dhe e kërcënoi se do t'i vriste familjen. Pastaj ai u dërgua në sallën e fizkulturës ku vazhdoi rrahja. Më vonë atë pasdite, të burgosurit u dërguan sërish në burgun e Smrekonicës. Atje Kadriu mësoi se edhe të tjerët që ishin në kamionin e dytë ishin rrahur.¹⁹²⁹

780. Bogunoviçi tha se të burgosurit në burgun e Smrekonicës nuk u keqtrajtuat apo u vranë, veçanërisht për faktin se ata u regjistruan në mënyrë të rregullt kur ishin arrestuar.¹⁹³⁰ Sipas tij, disa persona u liruan menjëherë me të ardhur në burg, kurse të tjerët u liruan pasi ishin "përpunuar."¹⁹³¹ Bogunoviçi shpjegoi se ai personalisht nuk kishte hyrë në burg; burgu ishte nën juridiksionin e Ministrisë së Drejtësisë dhe jo të MPB-së.¹⁹³² Sidoqoftë, ai kishte marrë raporte për burgun në mbledhjet e kolegjiut të SPB-së së Mitrovicës.¹⁹³³ Ai gjithashtu shpjegoi se pjesëtarëve të SPB-së të Mitrovicës u duhej të marrin autorizim nga gjykata për të hyrë në burg. Pas marrjes së një autorizimi të tillë, burgun e kishte vizituar një "patrullë" me pjesëtarë të OKP-së (Dega e Policisë për Krime) së Mitrovicës dhe teknikë të kriminalistikës.¹⁹³⁴

781. Megjithëse Dhoma pranon se burgu ka qenë nën juridiksionin e Ministrisë së Drejtësisë, ajo nuk pranon dëshminë e Bogunoviçit se asnjë nga të burgosurit nuk u keqtrajtua nga pjesëtarë të MPB-së. Përkundrazi, provat tregojnë se MPB-ja ishte e implikuar në arrestimin e personave në fjalë, dërgimin e tyre në burg, dhe marrjen në pyetje dhe keqtrajtimin e tyre gjatë burgimit.

782. Në mëngjesin e 23 majit 1999, Kadriu dhe të burgosurit e tjerë u thirrën me emër. Ata i hipën në autobusë dhe i çuan pranë qytetit të Vushtrrisë ku Kadriu pa shumë shtëpi në flakë. Kur mbërritën në Shtime, atyre iu bashkuan edhe tre kamionë me "parausharakë" të cilët i shoqëruan deri në kufi me Shqipërinë. Parausharakët kishin shami të ndryshme në kokë; disa nga ata kishin flokë dhe mjekra të gjata. Në Zhur, afër kalimit kufitar, të burgosurit u urdhëruan të dilnin nga autobusët. Ata u rrahën sërish dhe pastaj u thanë të vraponin në drejtim të kufirit me duart mbi

¹⁹²⁹ Sabit Kadriu, P2377 (deklarata e dëshmitarit e datës 10 dhjetor 2000), f. 19–20.

¹⁹³⁰ Nebojsja Bogunoviçi, 6D1614 (deklarata e dëshmitarit e datës 6 prill 2008), para. 87; T. 25170–25171 (10 prill 2008).

¹⁹³¹ Nebojsja Bogunoviçi, 6D1614 (deklarata e dëshmitarit e datës 6 prill 2008), para. 69.

¹⁹³² Nebojsja Bogunoviçi, T. 25170–25171 (10 prill 2008).

¹⁹³³ Nebojsja Bogunoviçi, 6D1614 (deklarata e dëshmitarit e datës 6 prill 2008), para. 69.

¹⁹³⁴ Nebojsja Bogunoviçi, T. 25170–25171 (10 prill 2008).

kokë. Në kufi, Kadriut dhe atyre që ishin me të u morën letërnjoftimet para se t'i lejonin të kalonin në Shqipëri.¹⁹³⁵

783. Shukri Gërxhaliu dëshmoi se, pasi ikën nga kolona më 2 maj, ai dhe kunati i tij u kthyen në Sllakofc, i cili ishte djegur dhe së paku 90 lopë ishin vrarë. Pas kësaj, ata shkuan në Studime të Epërme, te vendi ku kishin ndodhur vrasjet në kolonë dhe mbërritën atje më 3 maj 1999. Atje ishin të pranishëm pjesëtarë të UÇK-së të cilët po ndihmonin në varrimin e të vdekurve. Nga kufomat që pa në atë kohë, Gërxhaliut iu duk se shumica ishin qëlluar në kokë nga afër. Shumica ishin meshkuj, por ishin edhe pesë ose gjashtë femra.¹⁹³⁶ Xhafa dëshmoi se kufomat e rreth 115 njerëzve të vrarë në kolonë u varrosën më 4 maj nga civilë vendorë të ndihmuar nga pjesëtarë të UÇK-së.¹⁹³⁷ Një raport i MPB-së shënon se më 3 maj 1999 policë nga SPB-ja e Mitrovicës provuan të bënin hetime në vendin e ngjarjes në zonën midis Studimes së Epërme dhe Studimes së Poshtme, por u sulmuan nga UÇK-ja nga lagja e epërme e Studimes së Poshtme e cila quhet Kodra e Rashicës.¹⁹³⁸

784. Edhe pse UÇK-ja mori pjesë në varrimin e të vrarëve në kolonë më 2 maj, Gërxhaliu dhe Xhafa thanë se kolona përbëhej vetëm nga civilë kur ishte sulmuar, edhe pse nipi i Xhafës, Ismeti, kishte qenë në UÇK më parë. Të dy dëshmitarët thanë se faktikisht UÇK-ja ishte tërhequr nga zona e Sllakofcit dhe Cecelisë në drejtim të Dumnicës në juglindje të qytetit të Vushtrrisë.¹⁹³⁹

785. Mbrojtja e Llukiqit i kundërshton dëshmitë e Xhafës dhe Gërxhaliut se kolonës iu afruan njerëz me uniforma kamuflimi të kaltra. Sipas Mbrojtjes së Llukiqit, këta persona nuk mund të kenë qenë policë sepse Bogunoviçi dëshmoi se forcat e MPB-së që merrnin pjesë në operacionin *Bajgora* kishin uniforma kamuflimi të gjelbra, kurse ai dhe Obrad Stevanoviçi ishin të vetmit pjesëtarë të MPB-së në zonë me uniforma të kaltra policie.¹⁹⁴⁰ Mbrojtja e Llukiqit gjithashtu argumenton se ishte e "habitshme dhe e pabesueshme" që dëshmitarët nuk thanë se policët kishin shirita me mbishkrim fosforeshent "policia," të cilat përdorëshin zakonisht nga policë "që merrnin pjesë në aksione antiterroriste," ose se policët kishin shirita me ngjyra të ndryshme.¹⁹⁴¹ Dhoma nuk i pranon këto argumente. megjithëse uniformat dhe jelekët e gjelbër të kamuflimit me mbishkrimin "policia"

¹⁹³⁵ Sabit Kadriu, P2377 (deklarata e dëshmitarit e datës 10 dhjetor 2000), f. 20.

¹⁹³⁶ Shukri Gërxhaliu, P2275 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 shkurt 2000), para. 25.

¹⁹³⁷ Shukri Gërxhaliu, T. 2470-2472 (28 gusht 2006).

¹⁹³⁸ Shukri Gërxhaliu, T. 2548-2550 (30 gusht 2006); 3D70 (Notë Zyrtare e SPB-së së Mitrovicës, 3 korrik 2001).

¹⁹³⁹ Shukri Gërxhaliu, T. 2579, (30 gusht 2006); Fedrije Xhafa, T. 2448-2449 (28 gusht 2006). *Shih gjithashtu* Sabit Kadriu, T. 5125-5127 (18 tetor 2006), P2377 (deklarata e dëshmitarit e datës 10 dhjetor 2000), f. 14.

¹⁹⁴⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 1236-1240. Mbrojtja e Llukiqit i referohet deklaratës së dëshmitarit të Nebojsa Bogunoviçit, 6D1614 (deklarata e dëshmitarit e datës 6 prill 2008), para. 67-68.

¹⁹⁴¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 1241-1242. Mbrojtja e Llukiqit i referohet 6D579 (Udhëzimet për Shiritat Identifikues Policorë, maj 1999).

ishin dhe me të vërtetë karakteristika identifikuese të forcave të PJP-së, janë paraqitur prova se forcat e rregullta të policisë dhe pjesëtarë të PJP-së në detyra të zakonshme vazhduan të përdornin uniforma kamuflimi të kaltra gjatë tërë konfliktit. Gjithashtu, pas shqyrtimit të dëshmisë së Bogunoviqit, Dhoma konstaton se ai vetëm tha se forcat e PJP-së që morën pjesë në këtë operacion kishin uniforma kamuflimi të gjelbra, gjë që nuk përjashton praninë e pjesëtarëve të tjerë jo të PJP-së së MPB-së në atë zonë. Në fakt, vetë Bogunoviqi deklaroi se në mbrëmjen e 2 majit 1999, në rrugën nga Samodrezha në Vushtri takoi një grup civilësh shqiptarë kosovarë që udhëtonin në kolonë dhe policë të DPB-së së Vushtrrisë, që konfirmon praninë e pjesëtarëve të MPB-së në atë zonë të cilët nuk ishin pjesëtarë të PJP-së. Dhoma gjithashtu konkludon se mospërmendja prej dëshmitarëve e shiritave me ngjyra, nuk komprometon besueshmërinë e identifikimeve prej tyre.

786. Më tej, Mbrojtja e Llukiqit pretendon se Xhafa, Gërxfhaliu, dhe Kadriu nuk ishin në gjendje të dallonin ngjyrat në errësirë.¹⁹⁴² Kur Xhafës iu parashtruan argumente të ngjashme, ajo shpjegoi se ishte natë e ndritshme me hënë, duke shtuar se gjithashtu dritat e përparme të traktorëve ishin të ndezura, që i mundësoi asaj të shihte qartë.¹⁹⁴³ Edhe Gërxfhaliu deklaroi se, edhe pse gjysmë i fshehur nën mbulesë plastike në traktor, ai mundi të shihte pak nga çfarë po ndodhte.¹⁹⁴⁴ Dhoma konstaton se, në dëshminë e tij Kadriu u referohet personave që sulmuan kolonën si "serbë," duke mos përmendur ngjyrën e uniformave të tyre.

5. Vrasjet e tjera

787. Një tërësi provash u paraqitën në lidhje me vrasjen e disa pjesëtarëve të familjes së Gërxfhaliut, ndër të cilët dhe disa fëmijë, në Studime të Poshtme më 31 maj 1999. Çështja u hetua nga një ekip i cili përbëhej nga pjesëtarë të UJ-së dhe MPB-së me urdhër të gjykatësit hetues. Sidoqoftë, meqenëse vrasja e familjes Gërxfhaliu nuk përfshihet në Aktakuzë dhe asnjë dënim nuk mund të rezultojë nga kjo, Dhoma nuk ka nxjerrë konkluzione në lidhje me këto ngjarje.

788. Pas vrasjes së të afërmeve të tij, Gërxfhaliu vendosi të largohej për në Mal të Zi së bashku me pjesën tjetër të familjes. Kur u kthye në shtëpi pas konfliktit, ai e gjeti shtëpinë të plaçkitur. Gjithashtu kishte shenja se dikush ishte munduar t'i vinte zjarrin, por pa sukses.¹⁹⁴⁵

¹⁹⁴² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 1244–1245, 1273–1274.

¹⁹⁴³ Fedrije Xhafa, T. 2447 (28 gusht 2006).

¹⁹⁴⁴ Shukri Gërxfhaliu, T. 2585 (30 gusht 2006).

¹⁹⁴⁵ Shukri Gërxfhaliu, P2275 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 shkurt 2000), para. 36.

6. Hetimi i vrasjeve në kolonë

789. Në lidhje me numrin e të vrarëve në kolonë, Mbrojtja e Llukiqit pretendon se, për shkak se Xhafa, Gërxhaliu, dhe Kadriu dëshmuan vetëm për pak të vrarë që panë, nuk janë paraqitur prova të mjaftueshme për të vërtetuar vdekjen e 104 viktimave, siç pretendohet në Listën I, apo shkakun dhe natyrën e vdekjes së tyre.¹⁹⁴⁶

790. Sabit Kadriu dëshmoi se, pas mbarimit të konfliktit, dhe në funksionin e tij si kryetar vendor i komisionet të krimeve të luftës, ai kreu një hetim të sulmit mbi kolonën më 2 dhe 3 maj 1999. Si rezultat i këtij hetimi, ai konkludoi se 104 pjesëtarë të kolonës ishin vrarë nga "serbët."¹⁹⁴⁷ Në deklaratën me shkrim si dëshmitar, Kadriu paraqiti një listë të të gjitha viktimave, të cilën duket se e ka bërë pjesërisht në bazë të intervistave me dëshmitarë. Ai i ka regjistruar emrat e viktimave si vijon: Musa Abazi; Rahman Ademi; Ramadan Aliu; Remzi Aliu; Afrim Bekteshi; Nezir Beqiri, Hysni Bunjaku; Qamile Fejzullahu; Istref Ferati; Milazim Ferati; Rifat Ferati; Bislim Ferizi; Mihrije Ferizi; Ruzhdi Ferizi; Agim Gërguri; Enver Gërguri; Musli Gërguri; Fahri Gërxhaliu; Haki Gërxhaliu; Kadri Gërxhaliu; Shaban Gërxhaliu; Skënder Gërxhaliu; Zejnullah Gërxhaliu; Shukri Gërguri; Skënder Gërguri; Naman Gërguri; Ramush Gërguri; Avdyl B. Gërxhaliu; Avdyl F. Gërxhaliu; Bajram Gërxhaliu; Fatmir A. Gërxhaliu; Fatmir U. Gërxhaliu; Imer Gërxhaliu; Nuhi Gërxhaliu; Sejdi Gërxhaliu; Xhevdet Gërxhaliu; Meriton Gjata; Sevdie Gjata; Tefik Gjata; Bahri Haxhaj; Nafije Haziri; Agim Hyseni; Ali Hyseni; Beqir Hyseni; Kade Hyseni; Hysen Hyseni;¹⁹⁴⁸ Qazim Hyseni; Ramadan Hyseni; Rahman Hyseni, Xhevdet Hyseni; Selman Ibishi; Sylejman Ibishi; Rrahim Ibishi, Tafil Ibishi; Bajram Kurti; Afrim Konjuhi; Rexhep Konjuhi; Shaban Krasniqi; Sylë Krasniqi; Ibadete Lushaku; Shehide Lushaku; Driton Maxhuni; Sabri Maxhuni; Ali Mërnica; Remzi Morina; Ekrem Mulaku.; Xhavit Mulaku; Gani Muli; Asllan Muli; Hazir Muli; Bajram Muliqi; Islam Musa; Kadrush Musa; Nexhmi Musa; Mehdi Musliu; Ragip Musliu; Besim Muzaqi; Salih Muzaqi; Shehide Parduzy; Murat Peci; Ismajl Popova; Enver Prronaj; Zymer Prronaj; Ali Rashica; Deli Rashica; Eshref Rashica; Ahmet Rexhepi; Ilaz Rexhepi; Ismet Rexhepi; Agim Sadiku; Hamdi Shala; Shehide Sfarqa; Sherif Sfarqa; Skënder Sfarqa; Fetah Tahiri; Fehmi Ternava; Sahit Tiku; Azemine Vërshevc; Faik Vidishiqi; Driton Xhafa; Nazif Xhafa; Veli Xhafa; Naser Zhegrova.

791. Dhoma konstaton se lista e viktimave e paraqitur nga Prokuroria në Shtojcën I është identike me listën e viktimave të paraqitur nga Sabit Kadriu.

¹⁹⁴⁶ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 1276.

¹⁹⁴⁷ Sabit Kadriu, P2377 (deklarata e dëshmitarit e datës 10 dhjetor 2000), f. 20–24.

792. Përveç përfundimit të Kadriut në lidhje me identitetin e viktimave të vrara në kolonë, Dr. Eric Baccard dëshmo, duke iu referuar raportit të tij të hetimeve kriminalistike të kryera nga ekipi kriminalistik francez që ekzaminoi vendin e krimit në Studime të Epërme në korrik 1999.¹⁹⁴⁹

793. Ekipi kriminalistik francez përgatiti një raport ku evidentohet se ekzistonin dy varreza, të cilat ata i emërtuan L1 dhe L2.¹⁹⁵⁰ Sipas raportit, varreza L1, e cila ishte më e vogla nga të dyja, kishte shumë varre, 17 prej të cilave ishin të freskëta. Secili nga këto 17 varre ishte varr individual që ishte i shënuar me pllakë druri me emrin e viktimës. Varreza e emërtuar L2 dukej se ishte hapur më vonë. Ajo kishte 102 kufoma, 76 prej të cilave u zhvarrosën. Në varrezën L2, kufomat ishin varrosur në varre të përbashkëta me katër deri gjashtë kufoma në çdo varr. Varret e përbashkëta ishin hapur në formë llogoresh, kurse kufomat ishin vendosur njëra pranë tjetrës dhe në shumicën e rasteve kishin pllaka druri me emrat e të vdekurve.¹⁹⁵¹

794. Ekipi francez identifikoi 84 nga gjithsej 93 kufoma me ndihmën e fshatarëve vendorë.¹⁹⁵² Ata fotografuan kufomën e çdo viktime dhe më pas bënë autopsinë.¹⁹⁵³ 75 për qind e viktimave ishin nën moshën 50-vjeçare në momentin e vdekjes.¹⁹⁵⁴ Dy nga shkaqet më të zakonshme të vdekjes ishin lëndimet e organeve të brendshme dhe lëndimet e kafkës-trurit. Nga 93 kufomat e ekzaminuara, me gjasë shtatë kishin pasur vdekje natyrale.¹⁹⁵⁵ Midis atyre që kishin pasur vdekje të dhunshme, 97 për qind ishin viktima të plagëve të shkaktuara nga armët e zjarrit, përgjithësisht nga afër, kurse të tjerët ishin goditur me mjete të forta ose të mprehta.¹⁹⁵⁶

7. Konkluzione

795. Dhoma Gjyqësore konkludon se më 27 mars 1999 forcat e UJ-së dhe MPB-së dogjën shtëpi dhe së paku një xhami në qytetin e Vushtrrisë. Dhoma gjithashtu konkludon se forcat e MPB-së

¹⁹⁴⁸ SHËNIM: Kjo viktimë u përmend nga Sabit Kadriu dy herë. *Shih* Sabit Kadriu, P2377 (deklarata e dëshmitarit e datës 10 dhjetor 2000), f. 23–24 (viktimat numër 53 dhe 94).

¹⁹⁴⁹ P1809 (Raport përmbledhës i Eric Baccard-it), f. 64; Eric Baccard, T. 10104–10105 (19 shkurt 2007). *Shih gjithashtu* P333 (Raport i misionit kriminalistik francez për "Varrezën 1 në Studimen e Epërme").

¹⁹⁵⁰ P333 (Raport i misionit kriminalistik francez për "Varrezën 1 në Studimen e Epërme"), f. 6. P1809 (Raport përmbledhës i Eric Baccard-it), f. 64.

¹⁹⁵¹ P333 (Raport i misionit kriminalistik francez për "Varrezën 1 në Studimen e Epërme"), f. 6.

¹⁹⁵² P333 (Raport i misionit kriminalistik francez për "Varrezën 1 në Studimen e Epërme"): përfshin fotografi të pjesëve të kufomave, rrobave, dhe provave balistike), f. 6 (versioni anglisht i dokumentit); P1809 (Raport përmbledhës i Eric Baccard-it), f. 64–65; P210 (raporti balistik i misionit kriminalistik francez), f. 40.

¹⁹⁵³ P333 (Raport i misionit kriminalistik francez për "Varrezën 1 në Studimen e Epërme: përfshin fotografi të pjesëve të kufomave, rrobave, dhe provave balistike), f. 6 (versioni anglisht i dokumentit).

¹⁹⁵⁴ P1809 (Raport përmbledhës i Eric Baccard-it), f. 65.

¹⁹⁵⁵ P1809 (Raport përmbledhës i Eric Baccard-it), f. 66.

dëbuan disa shqiptarë kosovarë nga shtëpitë e tyre në qytetin e Vushtrrisë dhe i urdhëruan të shkonin në varreza, ku shumë prej tyre hipën në autobusë të cilët duhej t'i çonin në Maqedoni. Nuk ka prova në lidhje me vendmbërritjen e vërtetë të këtyre autobusëve, sepse Kadriu shkoi në Studime të Epërme, kurse familja e tij zbriti nga autobusi dhe qëndroi në qytet.

796. Bazuar në urdhrat ushtarakë dhe raportet luftarake, Dhoma gjithashtu konkludon se më 2 maj 1999, forcat e MPB-së dhe të UJ-së u angazhuan në një operacion rreth fshatrave Sllakofc, Ceceli, Studime e Poshtme, dhe Studime e Epërme, ku kishte prani të madhe të UÇK-së. Operacioni rezultoi në shpartallimin e UÇK-së. Si rezultat i konfliktit, u formua një kolonë prej rreth 30.000 shqiptarësh kosovarë të cilët lëvizën drejt jugut të komunës. Këta njerëz u larguan nga shtëpitë së paku pjesërisht për shkak të udhëzimeve ose urdhrave të UÇK-së. Me të filluar largimi, lëvizja e tyre u kontrollua nga MPB-ja, e cila i grabiti dhe keqtrajtoi. Dëshmitë nuk tregojnë se UJ-ja ka pjesë në kontrollimin e kolonës apo në grabitjen, keqtrajtimin, dhe vrasjen e njerëzve në të.

797. Dhoma nuk është bindur nga mohimet e dëshmitarëve okularë se në kolonë nuk kishte pjesëtarë të UÇK-së. Faktikisht vetë Shukri Gërxfhaliu ishte pjesëtar i UÇK-së, edhe pse nuk mbante armë, kurse nipi i Fedrije Xhafës gjithashtu kishte qenë në UÇK për një kohë. Sidoqoftë, Dhoma gjykon se kolona ishte e përbërë kryesisht nga civilë, edhe pse mund të ketë pasur pjesëtarë të UÇK-së brenda saj ose në afërsi.

798. Dhoma konkludon se dëshmia e Sabit Kadriut se 104 persona, të cilat janë përmendur në deklaratën e tij dhe përfshirë nga Prokuroria në Listën I, udhëtuan në kolonë dhe u vranë nga "serbët," përbën dëshmi të dorës së dytë, me përjashtim të dëshmisë në lidhje me Ali Mërniceën., Duke marrë parasysh rrethanat, Dhoma mendon se kjo nuk përbën provë të mjaftueshme për dënim për krime të rënda. Dëshmia e Kadriut gjithashtu kundërshtohet nga raporti i ekipit kriminalistik francez, ku tregohet se tre persona të përfshirë në listë, konkretisht, Agim Hyseni; Kada Hyseni; dhe Shehide Sfarqa, patën vdekje natyrale dhe rrjedhimisht nuk është e mundshme të jenë "vranë" nga serbët, siç deklaroi Kadriu. Për më tepër, Prokuroria nuk la të kuptohej se kishte provuar të hetonte se a kishin udhëtuar në kolonë më 2 maj 1999 viktimat në listën e Kadriut, kufomat e të cilëve, me përjashtim të Haki Gërxfhaliut, u gjetën në varrezat L1 dhe L2.

799. Dhoma konkludon se, duke u bazuar në dëshmitë e dëshmitarëve okularë Shukri Gërxfhaliu dhe Sabit Kadriu, në natën e 2 majit 1999, forcat e MPB-së duke përfshirë njësi speciale dhe jo të

¹⁹⁵⁶ P1809 (raport përmbledhës i Eric Baccard-it), f. 66; P210 (aktekspertiza balistike e misionit kriminalistik francez), f. 40.

rregullta, vranë Haki Gërxfhaliun dhe Ali Mërniciën, viktima nga Lista I. Gjithashtu, Dhoma Gjyqësore konkludon se, duke u bazuar në dëshminë e dëshmitares okulare Fedrije Xhafa, më 2 maj 1999 policia serbe ose forcat paraushtarake vranë Miran Xhafën duke udhëtuar në kolonë, viktimë që nuk është përfshirë në Listën I.¹⁹⁵⁷

800. Dhoma gjithashtu konkludon se, midis datave 1-3 maj, forcat e MPB-së e ndanë kolonën në tri grupe. Grupi i parë që përbëhej nga gra, fëmijë dhe të moshuar që kishin automjete, u dërgua në Shqipëri; grupi i dytë i përbërë nga gra, fëmijë dhe të moshuar pa mjete transporti, u dërgua në fshatrat e afërta, si Kçiq dhe Dobërllukë, kurse grupi i tretë, i përbërë nga burra të moshës së aftë për luftë, u dërgua në burgun e Smrekonicës, ku u burgosën dhe u keqtrajtuat. Pasi u mbajtën në burg në kushte të rënda për rreth tri javë, të burgosurit u dërguan në kufi me Shqipërinë, ku i detyruan të dorëzonin dokumentet e identifikimit dhe të kalonin në Shqipëri.

J. PRISHTINA

1. Akuzat në Aktakuzë

801. Aktakuza i ngarkon të Akuzuarit me përgjegjësi për tri kategori të ndryshme të krimeve kundër njerëzimit që pretendohet se janë kryer në komunën e Prishtinës: dëbim, zhvendosje e dhunshme, dhe përndjekje. Akuzohet se përndjekja është kryer në formën e dhunës seksuale kundër grave shqiptare kosovare në komunën e Prishtinës, siç është përshkruar në paragrafin 72(g).¹⁹⁵⁸

802. Pretendimet faktike janë dhënë në Paragrafin 72(g) të Aktakuzës, si vijon:

Duke filluar më 24 mars 1999 apo rreth kësaj date dhe deri në fund të majit të vitit 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë shkonin në shtëpitë e shqiptarëve kosovarë në qytetin e Prishtinës dhe i detyronin banorët që të largoheshin. Gjatë këtyre dëbimeve me forcë, u vranë një numër njerëzish. Shumë prej të dëbuarve shkuan drejt në stacionin e trenit, kurse të tjerët kërkuan strehim në lagje të tjera të afërta. Qindra shqiptarë etnikë, të cilëve policët serbë i drejtonin në çdo udhëkryq, u mblodhën në stacionin e trenit dhe pastaj hipën në trena dhe në autobusë të tejmbushur. Ata në tren u çuan deri në Han të Elezit, fshat afër kufirit me Maqedoninë. Gjatë rrugë për në kufi, shumë njerëzve u morën letërnjoftimet. Pasi zbritën nga trenat, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë u thanë shqiptarëve kosovarë të ecnin përgjatë binarëve hekurudhorë deri në Maqedoni, sepse toka përreth ishte e minuar. Ata që u përpoqën të fshiheshin në Prishtinë u dëbuan në një mënyrë të ngjashme disa ditë më vonë. Gjatë këtyre dëbimeve me dhunë, u vranë një numër njerëzish dhe disa gra u dhunuan seksualisht.

- (i) Gjatë po kësaj periudhe, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë hynë në fshatrat e komunës së Prishtinës, ku rrahën dhe vranë shumë shqiptarë kosovarë, duke ua grabitur të hollat dhe

¹⁹⁵⁷ Fedrije Xhafa, T. 2421–2422 (25 gusht 2006). *Shih gjithashtu* Fedrije Xhafa, P2274 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 gusht 2006), para. 8.

¹⁹⁵⁸ Aktakuza, para. 77(c).

pasurinë dhe duke ua djegur shtëpitë. Shumë prej fshatarëve u çuan me kamion në Gllgoc në komunën e Lipjanit. Nga andej hipën në tren për në Han të Elezit dhe ecën deri në kufirin me Maqedoninë. Të tjerët, pasi arritën në qytetin e Ferizajt, morën urdhra nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë të hipnin në tren për në Han të Elezit, prej ku kaluan në këmbë kufirin me Maqedoninë.¹⁹⁵⁹

2. Rrethanat

803. Komuna e Prishtinës gjendet në lindje të Kosovës dhe përfshin qytetin e saj më të madh, i cili gjithashtu quhet Prishtinë, me disa lagje dhe paralagje. Ky qytet ka qenë dhe është qendra ekonomike, kulturore, politike, dhe administrative e Kosovës. Ashtu si edhe pjesa tjetër e Kosovës, në fillim të vitit 1999 popullata e Prishtinës ishte me shumicë shqiptare kosovare. Sidoqoftë, meqenëse ishte qendër administrative e krahinës, pakica serbe aty ishte më e madhe se në komunat e tjera.¹⁹⁶⁰

804. Dhoma Gjyqësore dëgjoji dëshmi nga disa dëshmitarë në lidhje me gjendjen në qytetin e Prishtinës gjatë fushatës ajrore të NATO-s dhe në lidhje me ngjarjet që çuan në largimin e një pjese të konsiderueshme të banorëve të saj. Fakti se një numër i madh njerëzish u larguan nga Prishtina gjatë fushatës së NATO-s nuk është kundërshtuar nga Mbrojtja, e cila u përqendrua në shkaqet e eksodit, duke pretenduar se largimi erdhi kryesisht si pasojë e bombardimeve të NATO-s e jo të aksioneve të forcave të RFJ-së/Serbisë.

805. Midis atyre që dëshmuan ishin Nazlie Bala, K63, K62, Baton Haxhiu, Adnan Merovci, dhe Emin Kabashi, të gjithë shqiptarë kosovarë banorë të qytetit apo të fshatrave të afërta, të paraqitur nga Prokuroria. Gjithashtu, në pajtim me Rregullën 92 *quater* Dhoma pranoi një deklaratë me shkrim nga Antonio Russo, gazetar italian i cili ishte i pranishëm në Prishtinë në atë kohë, por i cili vdiq para fillimit të gjykimit.¹⁹⁶¹ Drejtori i Qendrës Mediatike në Prishtinë, Millivoje Mihajllloviq, oficeri i MPB-së, Bozhidar Filliq, dhe oficeri i UJ-së, Millutin Fillipoviq, ishin ndër dëshmitarët e thirrur nga Mbrojtja për të kundërshtuar dëshmitë e dhëna nga dëshmitarët e ftuar nga Prokuroria. Dëshmitë përputhëse të dhëna nga Bala, K62, K63, dhe Kabashi në lidhje me dëbimin e tyre nga shtëpitë në fund të marsit 1999, të mbështetura nga deklaratat e Russo, nuk u komprometuan as nga kundërshtimet e Mbrojtjes e as nga dëshmitë e paraqitura nga Mbrojtja, dhe Dhoma i konsideron

¹⁹⁵⁹ Aktakuza, para. 72(g).

¹⁹⁶⁰ *Shih* 3D422 (profili prej OSBE-së i komunës së Prishtinës, qershor 2006), f. 2; P1960 (Raport për madhësinë dhe përbërjen etnike të popullatës së Kosovës, 14 gusht 2002), f. 9; P906 (regjistrimi i popullsisë më 1991), f. 10; *Shih gjithashtu* P1893 (tema e diplomës së Bozhidar Deliqit, "Përgatitja dhe Angazhimi i Forcave Mbrojtëse të RFJ-së në Parandalimin dhe Shtypjen e Kryengritjes së Armatosjes në Kosovë dhe Metohi", 1997).

¹⁹⁶¹ Dhoma pranoi deklaratën e dëshmitarit të Antonio Russo me një vendim gojor të datës 24 gusht 2006. T. 2288 (24 gusht 2006).

këta dëshmitarë të besueshëm në lidhje me ngjarjet që kanë lidhje me Aktakuzën. Edhe pse Haxhiu është shpallur fajtor për shpërfillje të Tribunalit, Dhoma nuk e konsideron këtë arsye për të mos i besuar dëshmisë së tij në lidhje me ngjarjet në Prishtinë, veçanërisht duke marrë parasysh se dënimi i tij kishte të bënte me rrethanat e nxjerrjes së informacionit e jo me pandershmërinë ose me sjelljen e tij si dëshmitar para Tribunalit. Dhoma do të merret me aspekte konkrete të besueshmërisë në kontekst të ngjarjeve që shqyrtohen.

806. Nazlie Bala, e cila në fund të vitit 1998 dhe në fillim të 1999 punoi për KVM-në në Prishtinë i tha Dhomës se në periudhën para se fillimit të fushatës ajrore të NATO-s, situata në qytet ishte përgjithësisht e qetë por e tensionuar.¹⁹⁶² Dëshmitari K63, burrë shqiptar kosovar i cili kishte një dyqan në Prishtinë së bashku me gruan e tij, dëshmoi se një mik serb i kishte thënë se, nëse NATO-ja do të fillonte bombardimin, "të gjithë shqiptarët do të mbaronin dhe do të spastroheshin nga Kosova."¹⁹⁶³ K63 gjithashtu tha se më 1999 në qytetin e Prishtinës kishte shumë njerëz të shpërngulur, të ardhur nga rajoni i Fushë-Kosovës dhe Drenicës nga frika që ndillte policia dhe UJ-ja në fshatrat e tyre.¹⁹⁶⁴ Gruaja e K63-shit, dëshmitarja K62, konfirmoi se gjatë marsit 1999 shumë njerëz erdhën në qytetin e Prishtinës nga fshatrat sepse ishin dëbuar nga shtëpitë e tyre dhe ishin të frikësuar.¹⁹⁶⁵ Banorët e qytetit i pranuan të shpërngulurit në banesat e tyre dhe si rezultat qyteti ishte i mbipopulluar. Sidoqoftë, në të njëjtën kohë, ata të cilët kishin mundësi, filluan të largoheshin nga qyteti.¹⁹⁶⁶ Adnan Merovci, i cili ishte sekretar personal i udhëheqësit të LDK-së, Ibrahim Rugova, dëshmoi se, më 21 mars 1999, duke u kthyer me makinë nga Maqedonia në Prishtinë në një kolonë makinash, pa shumë njerëz duke lëvizur në kahun e kundërt për në kufirin me Maqedoninë.¹⁹⁶⁷ Kur mbërriti në Prishtinë më 21 mars, situata atje ishte e tmerrshme dhe mbretëronte një atmosferë paniku.¹⁹⁶⁸

807. Në prill 1998, një shoqatë gazetarësh nga Serbia hapi në Prishtinë një Qendër Mediatike. Millivoje Mihajloviqi, i cili në fillim të vitit 1999 ishte drejtor i Qendrës Mediatike, e vendosur në Hotel Grand dhe i cili kishte marrë pjesë në krijimin e saj, tha se qëllimi i kësaj qendre ishte t'u ofronte ndihmë shumë gazetarëve të huaj të cilët vinin në Kosovë në atë kohë.¹⁹⁶⁹ Sipas

¹⁹⁶² Nazlie Bala, P2262 (deklarata e dëshmitarit e datës 16 gusht 2006), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 5, 11; *Shih gjithashtu* K63, P2443 (deklarata e dëshmitarit e datës 28 maj 2003), para. 4–5, 11.

¹⁹⁶³ K63, P2443 (deklarata e dëshmitarit e datës 28 maj 2003), para. 11.

¹⁹⁶⁴ K63, P2443 (deklarata e dëshmitarit e datës 28 maj 2003), para. 13.

¹⁹⁶⁵ K62, T. 2269–2270 (24 gusht 2006).

¹⁹⁶⁶ K62, T. 2269 (24 gusht 2006).

¹⁹⁶⁷ Adnan Merovci, P2588 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 prill 2000), para. 40, 42.

¹⁹⁶⁸ Adnan Merovci, T. 8575–8576 (17 janar 2007).

¹⁹⁶⁹ Millivoje Mihajloviq, T. 24051–24054, 24063–24066 (11 mars 2008), 6D1530 (deklarata e dëshmitarit e datës 6 mars 2008), para. 10.

Mihajloviqit, me fillimin e bombardimeve të NATO-s në qendër mbetën fare pak gazetarë. Ata lejoheshin të lëviznin lirisht dhe të filmonin çfarë të donin, por dalja jashtë qytetit ishte e rrezikshme.¹⁹⁷⁰ Sipas Antonio Russo-s, më 23 mars 1999, gazetarët e huaj që ende ishin në qytet u ftuan në Ministrinë për Informacionin dhe u thanë se qeveria nuk mund t'u garantonte më siguri dhe se, nëse donin të rrinin, duhej ta merrnin vetë përgjegjësinë për këtë.¹⁹⁷¹ Mihajloviqi deklaroi se nuk mori asnjë njoftim nga Sekretariati për Informacion se gazetarët e huaj ishin urdhëruar të largoheshin, por konfirmoi se pa disa nga gazetarët duke u larguar pas mbledhjes së 23 marsit.¹⁹⁷²

808. Ndërsa gazetarët e huaj po largoheshin nga Prishtina, forcat e MPB-së dhe UJ-së po shtoheshin. Merovci dëshmoi se, para se të fillonte bombardimi i NATO-s, të gjithë meshkujt serbë u mobilizuan në këto forca në një mënyrë apo tjetër.¹⁹⁷³ Po ashtu edhe K63-shi përshkroi se si të gjithë civilët serbë të aftë për luftë u mobilizuan si policë dhe mbanin uniforma policore e bartnin armë.¹⁹⁷⁴ Në deklaratën e tij, Russo tregonte se në fund të shkurtit 1999 UJ-ja filloi të dislokonte shumë tanke, autoblanda, dhe trupa përreth Prishtinës dhe ngriti postblloqe.¹⁹⁷⁵ Më 20 mars 1999, kur KVM-ja u largua nga Prishtina, Nazlie Bala shkoi në qendër të qytetit për të parë se çfarë po ndodhte.¹⁹⁷⁶ Ajo foli me njerëz, të cilët i treguan se kishin parë shtim të veprimtarisë së policisë dhe UJ-së përreth dhe duke mos ditur qëllimet e këtyre forcave, kishin frikë për sigurinë e tyre.¹⁹⁷⁷ Merovci gjithashtu konfirmoi se pa dhe takoi disa grupe të MPB-së dhe UJ-ës që vepronin në Prishtinë pas kthimit të tij nga Parisi më 21 mars 1999.¹⁹⁷⁸

809. Dhoma Gjyqësore dëgjoi dëshmi nga oficerë të ndryshëm të UJ-së dhe MPB-së dhe pranoi dokumente që konfirmojnë praninë e forcave të MPB-së dhe UJ-së në Prishtinë dhe përreth saj në mars 1999. Para bombardimit të NATO-s, postëkomanda pararojë e Armatës së 3-të ishte e vendosur në kazermën Kosovski Junaci në Prishtinë. Ajo u zhvendos disa herë gjatë bombardimeve, por gjithmonë në vende afër qytetit.¹⁹⁷⁹ Para bombardimeve, Komanda e Korpusit të Prishtinës dhe

¹⁹⁷⁰ Millivoje Mihajloviq, 6D1530 (deklarata e dëshmitarit e datës 6 mars 2008), para. 33.

¹⁹⁷¹ Antonio Russo, P2261 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 4; *Shih gjithashtu* P2900 (Raport i Këshillit Ekzekutiv të Përkohshëm dërguar Zyrës së Presidentit Serb, 16 prill 1999), f. 13.

¹⁹⁷² Millivoje Mihajloviq, T. 24090 (11 mars 2008).

¹⁹⁷³ Adnan Merovci, T. 8439 (16 janar 2007), P2588 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 prill 2000), para. 49.

¹⁹⁷⁴ K63, P2443 (deklarata e dëshmitarit e datës 28 maj 2003), para. 22.

¹⁹⁷⁵ Antonio Russo, P2261 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 3–4.

¹⁹⁷⁶ Nazlie Bala, P2262 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 qershor 2001), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 5.

¹⁹⁷⁷ Nazlie Bala, T. 2151 (22 gusht 2006), P2262 (deklarata e dëshmitarit e datës 16 gusht 2006), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 11.

¹⁹⁷⁸ Adnan Merovci, T. 8435–8436 (16 janar 2007).

¹⁹⁷⁹ Miodrag Janković, 4D504 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 tetor 2007), para. 16; Lubisha Stojimiroviq, T. 17667 (26 tetor 2007); P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 44, 111; Mirko Starçeviq, T. 17436, 17438 (22 tetor 2007), 4D500 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 shtator 2007), para. 15.

Shtabi i MPB-së ishin vendosur në dy godina në qytet që ishin 500 metra larg midis tyre.¹⁹⁸⁰ Rreth 29 marsit 1999, Komanda e Korpusit të Prishtinës u zhvendos dhe pas kësaj edhe disa herë tjera gjatë fushatës ajrore të NATO-s.¹⁹⁸¹ Më 30 mars, i Akuzuari Llazareviq lëshoi një urdhër që një grup nga Komanda e Korpusit të Prishtinës të qëndronte në zonën e Prishtinës për të mbrojtur garnizonin e Prishtinës.¹⁹⁸² Ky grup udhëhiqej nga Millutin Filipoviqi. Ai këmbënguli se gjatë bombardimeve të NATO-s në qytetin e Prishtinës nuk kishte njësi luftarake të UJ-së, por vetëm batalioni i policisë ushtarake me 350-400 pjesëtarë të armatosur, i cili ruante garnizonin e Korpusit të Prishtinës.¹⁹⁸³ Dhoma konstaton se në një urdhër të Qarkut Ushtarak të Prishtinës i datës 27 mars 1999 lexohet se Detashmenti i 50-të i Ushtarak Territorial, i cili herë pas herë mund të ketë pasur detyra luftarake, gjithashtu ishte i dislokuar në qytetin e Prishtinës, ku kishte për detyrë të ruante objektet ushtarake dhe të mbronte spitalet, postat, stacionet e radios dhe televizionit, dhe "popullatën serbe në pjesën jugore të qytetit të Prishtinës."¹⁹⁸⁴

810. Dhoma Gjyqësore ka marrë prova se Batalioni i 52-të i Policisë Ushtarake ishte i dislokuar në kazermën Kosovski Junaci në Prishtinë së bashku me Brigadën e 72-të Speciale deri më 24 mars 1999, kur u zhvendos në Graçanicë në jug të qytetit.¹⁹⁸⁵ Afërsisht pas një jave, ata u kthyen në zonën e Gërmisë afër qytetit të Prishtinës, por më pas iu desh të vendoseshin më afër qytetit.¹⁹⁸⁶ Brigada e 15-të e Blinduar zuri pozicione jashtë qytetit pak para se të fillonin bombardimet e NATO-s.¹⁹⁸⁷ Një urdhër i Komandës së Korpusit të Prishtinës i datës 1 prill 1999 e urdhëronte Brigadën të "vendoste kontroll mbi territorin dhe të mbante ligjin dhe rendin në zonën e përgjithshme të Prishtinës,"¹⁹⁸⁸ e cila sipas ditarit të luftës përfshinte aeroportin e Sllatinës jashtë qytetit.¹⁹⁸⁹

811. Dhoma gjithashtu dëgjoi dëshmi se ndër forcat e RFJ-së/Serbisë që vepronin në qytetin e Prishtinës në atë kohë kishte edhe grupe "paraushtarake". Adnan Merovci dëshmoi se, më 21 mars 1999, në një kohë që rrugët ishin zbrazur nga shqiptarët kosovarë, kishte shumë "paraushtarakë

¹⁹⁸⁰ P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 109; *Shih gjithashtu* P616 (Karol John Drewienkiewicz, Vizatim i katër godinave të autoriteteve kryesore serbe në Prishtinë).

¹⁹⁸¹ Millutin Filipoviq, T. 19162 (27 nëntor 2007), T. 19203–19204 (28 nëntor 2007); Momir Stojanoviq, T. 19733 (6 dhjetor 2007).

¹⁹⁸² 5D348 (Urdhër i PrK-së, 30 mars 1999); Millutin Filipoviq, T. 19151 (27 nëntor 2007), T. 19209 (28 nëntor 2007).

¹⁹⁸³ Millutin Filipoviq, T. 19153 (27 nëntor 2007), T. 19242 (28 nëntor 2007).

¹⁹⁸⁴ 6D1470 (Urdhër i Qarkut Ushtarak të Prishtinës i datës 27 mars 1999), f. 3.

¹⁹⁸⁵ K73, P2440 (deklarata e dëshmitarit), para. 35.

¹⁹⁸⁶ P2297 (Ditari i Luftës i Batalionit të 52-të të Policisë Ushtarake), f. 2, 4; K73, P2440 (deklarata e dëshmitarit), para. 36–37.

¹⁹⁸⁷ Miodrag Simiq, T. 15686 (14 shtator 2007); Millutin Filipoviq, T. 19177 (27 nëntor 2007); Vladimir Marinkoviq, T. 20303 (14 dhjetor 2007); P2572 (Ditari i Luftës i Brigadës së 15-të të Blinduar), f. 19, 25, 28;

¹⁹⁸⁸ P2029 (Urdhër i PrK-së, 1 prill 1999), f. 1–2.

¹⁹⁸⁹ P2619 (Pjesë nga Ditari i Luftës i Brigadës së 15-të të Blinduar), f. 3.

serbë" që ndalnin automjetet dhe vidhnin. Merovci tha se "paraushtarakët" ishin kryesisht vendës, por tha se nuk përjashtonte se disa prej tyre kishin ardhur nga vende të tjera në Serbi. Ai gjithashtu tha se "në shumë raste ata dukeshin sikur sapo i kishin veshur uniformat ushtarake ose veshje të ngjashme, i kishin hequr targat nga automjetet e tyre, dhe kishin marrë armë. Sidoqoftë, gjithçka dukej shumë e organizuar."¹⁹⁹⁰ Ai shpjegoi se shumica e "paraushtarakëve" në Prishtinë kishin kryesisht rroba civile dhe xhaketa ushtarake të gjelbra ose xhaketa lëkure të zeza. Disa prej tyre kishin uniforma të zeza ose kamuflimi. Ai ishte në gjendje të bënte dallimin midis tyre dhe forcave të rregullta të UJ-së dhe MPB-së sepse ai i njihnte uniformat e policisë dhe ushtrisë së rregullt dhe të gjithë të tjerët me uniforma të tjera ai i konsideronte paraushtarakë.¹⁹⁹¹ Merovci i njohu disa prej tyre si punëtorë vendës të ndërmarrjeve të shërbimeve publike, të cilët kishin njohuri të hollësishme të qytetit dhe të banorëve.¹⁹⁹²

812. Nazlie Bala gjithashtu i përshkroi forcat jo të rregullta, të veshur krejt në të zeza në të zeza, pa emblema, dhe kishin thika të lidhura për këmbë. Këta burra kishin maska dhe fytyrat i kishin të ngjyrosura. Ajo tha se prania e tyre në qytet ishte shumë frikësuese dhe se ata bashkëpunonin me policinë dhe UJ-në.¹⁹⁹³ K62-shi gjithashtu dëshmoi se pa "paraushtarakë" dhe policët duke rrahur dhe grabitur njerëzit përpara dyqanit të saj.¹⁹⁹⁴

813. Emin Kabashi, shqiptar kosovar që punonte si hulumtues në Institutin Albanologjik në Prishtinë dhe i cili ishte gjithashtu pjesëtar i UÇK-së, dëshmoi se në Fushë-Kosovë dhe Prishtinë pa forca të cilat i identifikoi si njerëzit e Arkanit ose të Frenki Simatoviqit. Sipas Kabashit, këto grupe ishin të armatosura dhe kishin uniforma me ngjyrë më të mbyllët se uniformat e veshura nga formacionet e tjera. Disa prej tyre kishin kapela kurse të tjerët bereta me një shirit të kuq përreth.¹⁹⁹⁵

814. Ndoshta sepse ishte qendra administrative e krahinës dhe se aty ishin të vendosura komandat e UJ-së dhe të MPB-së, duket se prania e UÇK-së në qytetin e Prishtinës nuk ka qenë e madhe në periudhën para fillimit të fushatës ajrore të NATO-s. Sidoqoftë, UÇK-ja ishte e pranishme në zonat përreth. Siç është diskutuar në Pjesën VI.B më lart, Bislim Zyrapi dëshmoi se UÇK-ja në Kosovë kishte shtabe operative në shtatë zona. Zona e Llapit apo Zona e 5-të Operative, përfshinte komunën

¹⁹⁹⁰ Adnan Merovci, T. 8433–8434 (16 janar 2007), P2588 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 prill 2000), para. 44.

¹⁹⁹¹ Adnan Merovci, T. 8433 (16 janar 2007), P2588 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 prill 2000), para. 48.

¹⁹⁹² Adnan Merovci, P2588 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 prill 2000), para. 48.

¹⁹⁹³ Nazlie Bala, P2262 (deklarata e dëshmitarit e datës 16 gusht 2006), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 12.

¹⁹⁹⁴ K62, T. 2268–2269 (24 gusht 2006).

¹⁹⁹⁵ Emin Kabashi, T. 2048–2049, 2061–2062 (21 gusht 2006), 2083, 2086–2087, 2114 (22 gusht 2006), P2251 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4017–4021.

e Prishtinës.¹⁹⁹⁶ Prania më e fuqishme e UÇK-së në zonën e Llapit ishte në rajonin e Podujevës.¹⁹⁹⁷ Emin Kabashi tha se ai ishte pjesëtar i një "formacioni apo njësie logjistike" të UÇK-së e cila e kishte shtabin në Prishtinë, dhe ishte përgjegjëse për "detyra guerile" dhe shtoi se ai i furnizonte pjesëtarët e UÇK-së me letër, barna, uniforma, rroba, ushqime, dhe pajisje sanitare, por jo me armë.¹⁹⁹⁸ Sipas Kabashit, UÇK-ja nuk kishte shtab në qytetin e Prishtinës, por kishte njerëz në disa lagje të cilët jepnin ndihmë logjistike, duke përfshirë një grup në Vranjec¹⁹⁹⁹ i cili bënte uniforma për ushtarët e UÇK-së.²⁰⁰⁰ Mirëpo, Dhoma Gjyqësore nuk e konsideron të besueshme dëshminë e Kabashit në lidhje me UÇK-në. Për më tepër, bindja e autoriteteve ishte pakëz më ndryshe; një raport i RDB-së së MPB-së i datës 28 janar 1999 parashtron se "pretendohet se në Prishtinë kanë hyrë grupe terroriste," duke përfshirë edhe një grup të vogël në Vranjec, detyrë e së cilave ishte "to kryejnë sulme së shpejti dhe të ekzekutojnë pjesëtarë të zgjedhur të organeve të sigurisë."²⁰⁰¹

815. Dhoma ka dëgjuar dëshmi se, pas largimit të verifikuesve të KVM-së në mars 1999, UÇK-ja kreu disa sulme në pjesët urbane të qytetit të Prishtinës.²⁰⁰² Filipoviqi dëshmoi se para fushatës së NATO-s, UJ-ja nuk iu përgjigj sulmeve "terroriste" në Prishtinë, sepse nuk ishte ngarkuar me detyrë për këtë.²⁰⁰³ Dhoma konkludon se me fillimin e fushatës së NATO-s në Prishtinë nuk pati veprime luftarake.

3. Ngjarjet në qytetin e Prishtinës gjatë bombardimeve të NATO-s

816. Nazlie Bala, e cila nga fundi i nëntorit 1998 deri më 2001 punoi në OSBE si ndihmëse e të drejtave të njeriut, si dhe me KVM-në nga fillimi i vitit 1999 deri në tërheqjen e KVM-së nga Kosova, qëndroi në Prishtinë pas tërheqjes në mars 1999. Ajo pa zhvillimin e ngjarjeve gjatë disa ditëve nga kulmi i godinës pesëkatëshe ku banonte në pjesën e vjetër të qytetit.²⁰⁰⁴ Si rezultat i

¹⁹⁹⁶ Bislim Zyrapi, T. 5934, 5967 (6 nëntor 2006), 6018 (7 nëntor 2006), 6258 (10 nëntor 2006); P2469 (hartë që tregon zonat e ndryshme të UÇK-së).

¹⁹⁹⁷ *Shih* Shukri Gërxhaliu, T. 2529–2530 (30 gusht 2006); Shaun Byrnes, T. 12232 (17 prill 2007); Bislim Zyrapi, T. 6258 (10 nëntor 2006); *Shih gjithashtu* 6D1016 (Raport i RDB-së së Prishtinës), f. 2; Millutin Filipoviq, T. 19165 (27 nëntor 2007).

¹⁹⁹⁸ Emin Kabashi, T. 2083, 2086–2087, 2114 (22 gusht 2006).

¹⁹⁹⁹ Emin Kabashi dëshmoi se emri i lagjes tani është "Kodra e Trimave." Emin Kabashi, P2251 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4048.

²⁰⁰⁰ Emin Kabashi, T. 2084–2085 (22 gusht 2006).

²⁰⁰¹ 6D1017 (Raport i MPB-së së Prizrenit, 28 janar 1999), f. 15.

²⁰⁰² Michael Philips, T. 12016–12017 (20 mars 2007); Bozhidar Filiq, T. 23951–23953 (10 mars 2008); Millutin Filipoviq, T. 19164 (27 nëntor 2007); Danica Marinkoviq, 6D1495 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 shkurt 2008), para. 28–30; 6D1523 (Raport i hetimit të vendit të ngjarjes nga Danica Marinkoviq, 21 mars 1999); 6D1524 (Raport i hetimit të vendit të ngjarjes nga Danica Marinkoviq, 22 mars 1999); 6D1525 (Raport i hetimit të vendit të ngjarjes nga Danica Marinkoviq, 22 mars 1999); P407 (Libri i Kaltër i OSBE/KVM-së), f. 820.

²⁰⁰³ Millutin Filipoviq, T. 19218–19219 (28 nëntor 2007).

²⁰⁰⁴ Nazlie Bala, T. 2135, 2137 (22 gusht 2006).

vrojtimeve dhe pyetjeve që kishte bërë, Bala ishte në gjendje t'i jepte Dhomës përshkrime të hollësishme të ngjarjeve në Prishtinë dhe disa nga lagjet e saj – Arbëri, Vranjec, Kolovicë,²⁰⁰⁵ dhe Taslixhe – në fund të marsit 1999 para se të dëbohej nga qyteti, siç është përshkruar më poshtë.²⁰⁰⁶ Dëshmia e saj gjithashtu është mbështetur nga rrëfimet e K62-shit, K63-shit, Baton Haxhiut, dhe deklarata me shkrim e Antonio Russo-s.

817. Bala dëshmoi se në mbrëmjen e 24 marsit 1999, në pjesë të ndryshme të qytetit u ndërpre rryma elektrike. Të nesërmen në mëngjes, ajo pa serbët vendës duke lëvizur me makina nëpër qytet dhe duke qëlluar në ajër me armë automatike dhe revole.²⁰⁰⁷ Ajo gjithashtu pa kur shkatërronin shtëpitë dhe dyqanet e shqiptarëve kosovarë dhe kur i detyronin njerëzit të shkonin në qendër të qytetit.²⁰⁰⁸ Ajo i parë këto gjëra që kishin vazhduar natën dhe ditën. Natën, ajo përdorte një palë dylbi për shikim natën, të cilat i kishin lënë në makinën e saj pjesëtarët e KVM-së.²⁰⁰⁹ Me gjithë kundërshtimet e Mbrojtjes së Llukiqit, ndër të tjera të tjerash se Bala nuk mund të dinte me siguri se personat që qëllonin nga makinat ishin serbë sepse nuk kishte drita dhe ajo ndodhej në shtëpinë e saj, Dhoma Gjyqësore e konsideron dëshminë e Balës të besueshme në këtë aspekt.²⁰¹⁰

818. Më 26 mars, Bala pa "ushtrinë, policinë, dhe... civilët serbë," të cilët ajo i dallonte nga uniformat – "UJ-ja kishte uniforma të gjelbra, policia të kaltra"²⁰¹¹ – se si shkatërronin shtëpitë dhe dyqanet e shqiptarëve kosovarë në lagjet Arbëria, Vranjec, Kolovicë, dhe Taslixhe. Gjithashtu ajo dëgjoji shpërthime në këto zona. Më tej ajo tha se pa dy autobinda duke shkuar në drejtim të Arbërisë rreth orës 22:00 dhe, pas pak, dy shtëpi duke u djegur në vendin ku kishin qenë autobindat.²⁰¹² Edhe pse Mbrojtjet e Llazareviqit dhe Pavkoviqit vunë në dyshim aftësinë e Balës

²⁰⁰⁵ Fshati Kolovicë gjendet në verilindje të Prishtinës në cep të qytetit. P615 (Atlasi i Kosovës), f. 7; 3D388 (Harta e Kosovës).

²⁰⁰⁶ Për hollësitë e punës së Balës për Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut dhe për OSBE-në, shih Nazlie Bala, T. 2123–2124 (22 gusht 2006), 2175 (23 gusht 2006), P2262 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 qershor 2001), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 5, P2262 (deklarata e dëshmitarit e datës 16 gusht 2006), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 11.

²⁰⁰⁷ Nazlie Bala, T. 2200 (23 gusht 2006), P2262 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 qershor 2001), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 5. Filiqi gjithashtu dëshmoi se energjia elektrike ishte ndërprerë gjatë bombardimeve të NATO-s. Bozhidar Filiq, T. 23958 (10 mars 2008).

²⁰⁰⁸ Nazlie Bala, P2262 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 qershor 2001), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 6.

²⁰⁰⁹ Nazlie Bala, T. 2153–2154, 2160–2161 (22 gusht 2006), 2179–2180 (23 gusht 2006).

²⁰¹⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 1043.

²⁰¹¹ Nazlie Bala, T. 2139, 2161–2164 (22 gusht 2006), P2262 (deklarata e dëshmitarit e datës 16 gusht 2006), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 12.

²⁰¹² Nazlie Bala, T. 2137 (22 gusht 2006), P2262 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 qershor 2001), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 6.

për vrojtimin e ngjarjeve nga kulmi i shtëpisë,²⁰¹³ Dhoma është bindur nga shpjegimi i saj se si mundi të shihte çfarë pa.²⁰¹⁴

819. Në mëngjesin e 28 marsit, ajo dëgjoi krisma në Vranjec dhe më vonë pa disa shtëpi duke u djegur.²⁰¹⁵ Millutin Filipoviqi konfirmoi se më 28 mars pati të shtëna në Vranjec; ndodhi një sulm i UÇK-së kundër dy gazetarëve rusë, që përfundoi me vrasjen e shoferit të tyre.²⁰¹⁶ Një raport i MPB-së i datës 28 mars 1999 gjithashtu përmend këtë incident, por thekson se gazetarët u sulmuan në fshatin Leban, i cili gjendet në veri të Prishtinës.²⁰¹⁷ Bozhidar Filiqi dëshmoi se, pas sulmit, "terroristët" u strehuan në Vranjec dhe se gjatë dy ose tri ditëve të ardhshme policia bëri disa orvatje për t'i arrestuar.²⁰¹⁸ Policia nuk pati sukses për shkak të "rezistencës së ashpër të grupeve terroriste që gjendeshin në Vranjec."²⁰¹⁹ Dhoma Gjyqësore nuk është në gjendje të përcaktojë mënyrën dhe autorët e djegies së shtëpive në Vranjec më 28 mars.

820. Më vonë atë ditë, Bala dëgjoi granatimet në Kolovicë dhe pa një tank dhe "forca serbe me artileri" duke qëlluar nga kodra e Vranjecit në drejtim të kodrës së Kolovicës. Këto "forca serbe" qëllonin kundër civilëve shqiptarë të paarmatosur që ishin duke u larguar; granatimi vazhdoi gjatë tërë ditës dhe natës. Bala foli me disa nga njerëzit që kishin ikur nga Kolovica kur po kalonin pranë shtëpisë së saj. Ata treguan për "vrasjet e shqiptarëve, plaçkitjet, dhe djegien e shtëpive nga forcat serbe në atë zonë."²⁰²⁰ Në kundërshtim me këtë dëshmi, Millutin Filipoviqi dëshmoi se nuk kishte artileri të UJ-së në Vranjec që ishte "bazë e rëndësishme logjistike për terroristët," dhe, edhe po të kishte pasur, ata nuk do të kishin përdorur kurrë artilerinë kundër civilëve, sidomos duke marrë parasysh faktin se Kolovica ishte e banuar me serbë dhe me shqiptarë.²⁰²¹ Deklarata e Antonio Russo-s se "bombardimet e NATO-s u shoqëruan nga granatime më të rënda të qytetit nga forcat e UJ-së në rrethinat e qytetit, përveç djegieve dhe shkatërrimit të godinave në qytet prej tyre,"

²⁰¹³ Nazlie Bala, T. 2152–2160 (22 gusht 2006); Millutin Filipoviqi, T. 19178–19180 (27 nëntor 2007); IC148 (Shënime të bëra nga dëshmitari Filipoviqi në faqen 31 të P615, 27 nëntor 2007); Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 209–210.

²⁰¹⁴ Shih Nazlie Bala, T. 2135, 2137, 2152–2160 (22 gusht 2006), P2262 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 qershor 2001), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 5–6, P2262 (deklarata e dëshmitarit e datës 16 gusht 2006), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 11; P13 (Harta e rrugëve të qytetit të Prishtinës dhe fshatrave përreth); IC17 (Shënime të bëra nga Nazlie Bala në P13); IC15 (Shënime të bëra nga Nazlie Bala në faqen 31 të P615).

²⁰¹⁵ Nazlie Bala, P2262 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 qershor 2001), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 6.

²⁰¹⁶ Millutin Filipoviqi, T. 19165, 19181 (27 nëntor 2007). Filipoviqi nuk sqaroi se a kishte qenë dëshmitar i incidentit apo kishte dëgjuar për të nga burime të tjera.

²⁰¹⁷ P1099 (raport i MPB-së i datës 28 mars 1999), f. 3–4; *Shih* P615 (Atlas i Kosovës), f. 7.

²⁰¹⁸ Bozhidar Filiqi, T. 23955–23958 (10 mars 2008).

²⁰¹⁹ Bozhidar Filiqi, T. 23957 (10 mars 2008). *Shih gjithashtu* Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 1038, 1046.

²⁰²⁰ Nazlie Bala, T. 2166–2167, 2177–2179, 2183 (23 gusht 2006), P2262 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 qershor 2001), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 6.

²⁰²¹ Millutin Filipoviqi, T. 19180–19181 (27 nëntor 2007).

mbështet përshkrimin prej Balës të granatimit nga UJ-ja të pjesëve të qytetit të Prishtinës pas fillimit të bombardimit të NATO-s.²⁰²²

821. K63-shi dëshmoi se, pas fillimit të bombardimeve të NATO-s, banorët e Prishtinës kishin frikë se çfarë do t'u bënin atyre forcat e MPB-së dhe të UJ-së, edhe pse frika më e madhe ishte nga "paraushtarakët me bereta të kuqe dhe nga Forcat Speciale."²⁰²³ Në ditët e mëpasme, ai u përpoq të vazhdonte jetën si zakonisht me aq sa ishte e mundshme. Ai vazhdoi ta hapte dyqanin në orën 08:00, por ishte i detyruar ta mbyllte më herët për shkak se energjia elektrike ndërpritej në mbrëmje.²⁰²⁴ Ai gjithashtu pa njerëz duke u larguar nga shtëpitë në drejtim të stacionit hekurudhor me çanta, të cilët thoshin se po i largonin familjet dhe po i dërgonin në Maqedoni.²⁰²⁵ K62-shi shtoi se më 31 mars 1999, njerëz me uniforma, të cilët nuk ishin policë, plaçkitën shtëpinë e saj. Kjo u ndodhi të gjitha shtëpive në lagjen e saj.²⁰²⁶

822. Dëshmitari K14 gjithashtu dëshmoi për ngjarjet në qytet në mars dhe prill 1999, duke paraqitur një version që kryesisht përputhej me dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë, por dëshmia e tij nuk është diskutuar në hollësi këtu për shkak të masave mbrojtëse për këtë dëshmitar.²⁰²⁷

823. Adnan Merovci dëshmoi se, kur filluan bombardimet e NATO-s, forcat e UJ-së dhe të MPB-së në Prishtinë u shpërndanë nëpër shtëpitë e zbrazëta të shqiptarëve kosovarë dhe vinin mbishkrime në dyer si, "Ky është apartament i MPB-së."²⁰²⁸ Serbët vendës vunë emrat e tyre në dyer të shtëpive që të mos kishin probleme kur policia vinte të dëbonte njerëzit. Pati edhe raste kur serbët lejuan fqinjët e tyre shqiptarë të vinin emrat e tyre në dyer.²⁰²⁹ Sipas Merovcit, në natën e parë të bombardimeve të NATO-s, disa shqiptarë kosovarë të shquar – si Agim Hajrizi, Latif Berisha, dhe Bajram Kelmendi me dy djemtë – u rrëmbyen dhe u vranë nga "paraushtarakët,"²⁰³⁰ të mbështetën në njohjen prej tyre të vendit për t'i gjetur.²⁰³¹ Merovci mendonte se këto vrasje "ishin kumt i qartë se udhëheqësit shqiptarë ishin në shënjestër të forcave serbe dhe shërbyen për

²⁰²² Antonio Russo, P2261 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 4–5.

²⁰²³ K63, P2443 (deklarata e dëshmitarit e datës 28 maj 2003), para. 22.

²⁰²⁴ K63, P2443 (deklarata e dëshmitarit e datës 28 maj 2003), para. 23.

²⁰²⁵ K63, P2443 (deklarata e dëshmitarit e datës 28 maj 2003), para. 24.

²⁰²⁶ K62, T. 2284–2285 (24 gusht 2006).

²⁰²⁷ K14, P2643 (deklarata e dëshmitarit e datës 31 maj 1999), f. 2–4 (e mbyllur me vulë); K14, T. 10991 (2 mars 2007) (seancë e mbyllur).

²⁰²⁸ Adnan Merovci, P2588 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 prill 2000), para. 75.

²⁰²⁹ Adnan Merovci, P2588 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 prill 2000), para. 75.

²⁰³⁰ Adnan Merovci, T. 8436–8437 (16 janar 2007), T. 8577 (17 janar 2007), P2588 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 prill 2000), para. 46; *Shih gjithashtu* Ibrahim Rugova, P2613 (deklarata e dëshmitarit e datës 3 nëntor 2001), f. 9; Baton Haxhiu, T. 6096 (8 nëntor 2006).

²⁰³¹ Adnan Merovci, P2588 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 prill 2000), para. 48.

frikësimin e qytetarëve të zakonshëm që kishin dëgjuar për vrasjet."²⁰³² U përhapën thashetheme se kryetari i LDK-së Ibrahim Rugova ishte vrarë.²⁰³³ Po atë natë, zyrat e Rugovës dhe Merovcit u sulmuan me bomba dhe u dogjën, veprim për të cilën Merovci fajësoi paraushtarakët.²⁰³⁴

824. Nga 24 deri më 29 mars, Merovci e vizitoi Rugovën në shtëpinë e tij çdo ditë për ta informuar për situatën në Prishtinë dhe për të parë se a ishte mirë.²⁰³⁵ Më 25 mars, Merovci e zhvendosi familjen e tij nga shtëpia e tij në apartamentin e vëllait të tij.²⁰³⁶ Më vonë ai dëgjoji nga një fqinj i tij se "paraushtarakët serbë" kishin shkuar në shtëpinë e tij atë natë dhe e kishin kërkuar.²⁰³⁷ Më 29 mars, Merovci dhe gruaja e tij u strehuan në shtëpinë e Rugovës.²⁰³⁸

825. Ibrahim Rugova, i cili i dha Prokurorisë deklaratë me shkrim në vitin 2001 dhe i cili dëshmoi në procesin *Milloshëviq*, vdiq para fillimit të këtij gjykimi. Deklarata e tij dhe transkripti i dëshmisë së tij në procesin *Milloshëviq* janë pranuar si dëshmi në këtë çështje.²⁰³⁹ Në deklaratën e tij, Rugova shpjegonte se një ditë para se të fillonin bombardimet e NATO-s, u ndërpre në të gjitha linjat telefonike në qytet dhe se pati shpërthime sepse "shkatërroheshin kafenetë dhe dyqanet."²⁰⁴⁰ Natën e parë të bombardimeve, "policia dhe ushtria hynë në veprim:" zyrat e LDK-së dhe "zyra e ShBA-së" në qytet u dogjën nga "forcat serbe;" Bajram Kelmendin e vranë së bashku me dy djemtë e tij; dhe u përhapën fjalë se ishin marrë dhe ishin vrarë njerëz të caktuar.²⁰⁴¹

826. Edhe Adnan Merovci, edhe Ibrahim Rugova përshkruan ngjarjet në shtëpinë e Rugovës më 31 mars 1999, kur forca të mëdha të UJ-së dhe MPB-së erdhën në shtëpi dhe i mbajtën ata dhe personat e tjerë në shtëpi nën kërcënimin e armëve. Ata gjithashtu përshkruan komunikimin e tyre me Lubivoje Joksiqin, që atëherë ishte ndihmëskoordinator i RDB-së, me të cilin ranë dakord që të

²⁰³² Adnan Merovci, P2588 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 prill 2000), para. 46; *Shih gjithashtu* Baton Haxhiu, T. 6093, 6096 (8 nëntor 2006).

²⁰³³ Adnan Merovci, P2588 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 prill 2000), para. 76.

²⁰³⁴ Adnan Merovci, T. 8438–8439 (16 janar 2007), P2588 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 prill 2000), para. 46; *Shih gjithashtu* Ibrahim Rugova, P2613 (deklarata e dëshmitarit e datës 3 nëntor 2001), f. 9, P2612 (transkript nga *Prokurori kundër Milloshëviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4222–4223.

²⁰³⁵ Adnan Merovci, P2588 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 prill 2000), para. 50.

²⁰³⁶ Adnan Merovci, P2588 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 prill 2000), para. 47.

²⁰³⁷ Adnan Merovci, P2588 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 prill 2000), para. 47.

²⁰³⁸ Adnan Merovci, P2588 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 prill 2000), para. 51–52.

²⁰³⁹ Vendim në lidhje me Mocionin e Dytë të Prokurorisë për Pranimin e Provave Sipas Rregullës 92 *Quater*, 5 mars 2007; Korrigjim i Vendimit në Lidhje me Mocionin e Dytë të Prokurorisë për Pranimin e Provave Sipas Rregullës 92 *Quater*, 6 mars 2007.

²⁰⁴⁰ Ibrahim Rugova, P2613 (deklarata e dëshmitarit e datës 3 nëntor 2001), f. 9.

²⁰⁴¹ Ibrahim Rugova, P2613 (deklarata e dëshmitarit e datës 3 nëntor 2001), f. 9, P2612 (transkript nga *Prokurori kundër Milloshëviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4222.

takonin Sllobodan Millosheviqin në Beograd më 1 prill 1999.²⁰⁴² Merovci dhe Rugova përshkruan gjendjen në shtëpinë e Rugovës në prill, sidomos faktin se ata – së bashku me 15 apo 20 vetë të tjerë, kryesisht anëtarë të familjeve të tyre – u mbajtën në arrest shtëpiak derisa u lejuan të largoheshin nga Kosova në fillim të majit.²⁰⁴³ Mirëpo, oficeri i RDB-së, Lubivoje Joksiqi, mohoi se Rugova dhe Merovci, apo ndokush tjetër që ishte në shtëpinë e Rugovës në atë kohë, u mbajtën në arrest shtëpiak.²⁰⁴⁴ Dhoma Gjyqësore pranon dëshmitë e Merovcit dhe Rugovës, të cilat i konsideron përputhëse dhe të besueshme. Dhoma nuk e pranon versionin e ngjarjeve të dhënë nga Joksiqi dhe gjykon se RDB-ja u përfshi aktivisht në arrestin shtëpiak të Rugovës, Merovcit, dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre në prill 1999.

827. Baton Haxhiu, gazetar shqiptar kosovar dhe themelues i gazetës *Koha Ditore*, përshkroi frikën që kishte pasur se mos sulmohej nga ushtarët me uniforma kamuflimi të gjelbra të cilët i përshkroi si "parausharakë," pas fillimit të sulmeve ajrore të NATO-s, meqenëse ai ishte person publik. Ai vendosi të mos flinte në shtëpi, por të lëvizte nga një pjesë e Prishtinës në tjetrën, duke qëndruar në bodrume dhe shtëpi të ndryshme.²⁰⁴⁵ Duket se frika e tij ka qenë e justifikuar, sepse Dhoma Gjyqësore dëgjoi nga dëshmitarja K62 e cila e njihte Haxhiun, se e kishte takuar babanë e tij në fillim të bombardimeve dhe se ai ishte rrahur keqas nga forcat që kërkonin djalin e tij.²⁰⁴⁶ Më në fund Haxhiu u largua nga Prishtina më 2 prill 1999 së bashku me shumë njerëz të tjerë kur forcat që ai i identifikoi si "parausharakë", i dëbuan njerëzit nga shtëpitë.²⁰⁴⁷

828. Emin Kabashi, i cili kishte banonte në Fushë-Kosovë, që është rreth gjashtë kilometra nga qyteti i Prishtinës, dëshmoi për ngjarjet në afërsi të shtëpisë së tij. Edhe pse Fushë-Kosova nuk është pjesë e komunës së Prishtinës, duke marrë parasysh afërsinë e saj me Prishtinën, Dhoma Gjyqësore konsideron se ngjarjet e përshkruara nga Kabashi ndihmojnë për të demonstruar gjendjen e përgjithshme në atë zonë. Kabashi dëshmoi se, më 25 maj 1999, pa shumë policë dhe njerëz të tjerë të armatosur duke lëvizur në rrugën afër shtëpisë së tij. Policët, dy prej të cilëve i njihte, kishin të veshura uniforma të zakonshme policie të kaltra dhe ishin të shoqëruar nga forca të tjera me "uniforma të tipit ushtarak," disa prej të cilëve kishin emblema me shqiponjë të bardhë në krahë dhe

²⁰⁴² Adnan Merovci, T. 8441–8450 (16 janar 2007), 8548–8550 (17 janar 2007), P2588 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 prill 2000), para. 52–56; Ibrahim Rugova, P2613 (deklarata e dëshmitarit e datës 3 nëntor 2001), f. 9–11, P2612 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4225–4229, 4233.

²⁰⁴³ Adnan Merovci, P2588 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 prill 2000), para. 52, 59–74; Ibrahim Rugova, P2613 (deklarata e dëshmitarit e datës 3 nëntor 2001), f. 10–12, P2612 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4226–4227, 4234–4236, 4253–4255.

²⁰⁴⁴ Lubivoje Joksiqi, T. 21989–21997 (8 shkurt 2008), T. 22069–22070 (11 shkurt 2008).

²⁰⁴⁵ Baton Haxhiu, T. 6090, 6092–6094 (8 nëntor 2006).

²⁰⁴⁶ K62, T. 2270–2271 (24 gusht 2006).

²⁰⁴⁷ Baton Haxhiu, T. 6090, 6092–6094 (8 nëntor 2006).

bereta me emblemë me shqiponjë të bardhë, si dhe civilë të armatosur. Më vonë atë pasdite, ai mori tri thirrje telefonike anonime dhe në thirrjen e tretë dëgjoji një zë mashkulli që tha në serbisht, "Ju që po prisni NATO-n do të vriteni, ikni në Shqipëri."²⁰⁴⁸ Pas këtyre telefonatave, Kabashi dërgoi tetë pjesëtarë të familjes në dy shtëpi të ndryshme në lagje të ndryshme të Prishtinës; një pjesë e familjes qëndruan me të në shtëpi.²⁰⁴⁹ Me gjithë kundërshtimet r bëra nga Mbrojtja e Llukiqit,²⁰⁵⁰ një karakteristikë e rëndësishme e kësaj dëshmie për Dhomën është fakti se Kabashi njohu dy nga policët.

829. Rreth një orë më vonë, në Fushë-Kosovë u ndërpre rryma elektrike. Më vonë atë natë, dikush hodhi një mjet shpërthyes në shtëpinë e Kabashit i pasuar nga tri breshëri automatiku nga oborri drejt dritares së shtëpisë.²⁰⁵¹ Pas pak, Kabashi dëgjoji sulmuesit kur u larguan me vrap dhe ikën me një makinë që iu duk si "xhip policie" me ngjyrë "të kaltër të mbyllët me një mitraloz të vendosur mbrapa," dhe të cilin Kabashi e kishte parë disa herë duke patrulluar rrugëve.²⁰⁵² Ai pa së paku tetë vetë – disa prej të cilëve i njihte personalisht – duke u larguar.²⁰⁵³ Kabashi e kaloi natën e 25 marsit në tavanin e një shtëpie trekatëshe, prej nga pa kur u dogjën katër dyqane dhe tri shtëpi – të gjitha pronë e shqiptarëve kosovarë.²⁰⁵⁴ Më vonë dëgjoji se atë natë në lagjen e tij ishin vrarë 44 shqiptarë kosovarë, 10 prej të cilëve i njihte personalisht, duke përfshirë Hamit Krasniqin, fqinjin e tij, gruan e Krasniqit, djalin Agron Krasniqin, një çift pleqsh që jetonte dy dyer më larg, dhe një avokat të quajtur Ajet Muharremi.²⁰⁵⁵

830. Të nesërmen më 26 mars 1999, Kabashi u kthye në shtëpinë e tij për të parë dëmtimet. Ai mori disa plaçka dhe së bashku me familjen shkoi në qytetin e Prishtinës.²⁰⁵⁶ Ai dhe disa pjesëtarë të familjes shkuan në lagjen Arbëria.²⁰⁵⁷ Pjesa tjetër e familjes qëndruan në lagje të tjera të Prishtinës. Pas tri ditëve në Arbëri, "policia speciale" dhe "ushtarët" e urdhëruan Kabashin që të shkonte në lagjen Vranjec, ku qëndroi edhe dy ditë e dy net të tjera para se të dëbohej nga Prishtina

²⁰⁴⁸ Emin Kabashi, T. 2044–2045 (21 gusht 2006).

²⁰⁴⁹ Emin Kabashi, T. 2044–2045 (21 gusht 2006), P2250 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 prill 1999), f. 2.

²⁰⁵⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 1033.

²⁰⁵¹ Emin Kabashi, T. 2094–2095 (22 gusht 2006), P2250 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 prill 1999), f. 2; P2251 (transkriptim nga *Prokurorja kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4047.

²⁰⁵² Emin Kabashi, T. 2062–2063 (21 gusht 2006), 2093–2096 (22 gusht 2006), P2250 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 prill 1999), f. 2.

²⁰⁵³ Emin Kabashi, P2251 (transkriptim nga *Prokurorja kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4038–4039.

²⁰⁵⁴ Emin Kabashi, P2250 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 prill 1999), f. 2; P2251 (transkriptim nga *Prokurorja kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4047–4048.

²⁰⁵⁵ Emin Kabashi, T. 2045 (21 gusht 2006), T. 2096–2097 (22 gusht 2006), P2250 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 prill 1999), f. 3.

²⁰⁵⁶ Emin Kabashi, P2250 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 prill 1999), f. 3.

²⁰⁵⁷ Emin Kabashi, P2251 (transkriptim nga *Prokurorja kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4048.

siç përshkruhet më poshtë.²⁰⁵⁸ Kur ishte në Arbëri, Kabashi pa njerëz duke i dëbuar nga shtëpitë e tyre. Ai gjithashtu pa edhe ndërtesa të dëmtuara, që kishte dëgjuar se ishin rezultat i granatimit nga një tank i vendosur në urën hekurudhore.²⁰⁵⁹

831. Dëbimin e shqiptarëve kosovarë nga Prishtina, e konfirmoi edhe Llakiq Gjoroviqi, i cili ishte prokuror ushtarak për kohë luftime në Qarkun Ushtarak të Beogradit e gjatë kohës që lidhet me Aktakuzën në Qarkun Ushtarak të Prishtinës, i cili dëshmoi se, kur mbërriti në Prishtinë më 22 maj 1999 për të filluar punë si prokuror i ri ushtarak i Komandës së Qarkut Ushtarak të Prishtinës, së bashku me prokurorin e ri të Komandës së Korpusit të Prishtinës, Millosh Spasojeviq, ata u ftuan nga "organet e sigurimit shtetëror," të cilët ishin vendosur në dy apartamente që iu përkisnin shqiptarëve kosovarë të dëbuar.²⁰⁶⁰ Millosh Spasojeviqi e kundërshtoi dëshminë e Gjoroviqit, duke thënë se atyre nuk u ofruan apartamente të shqiptarëve kosovarë të dëbuar dhe shtoi se ai bujti në shtëpinë e zëvendësit të tij, Dragan Zhivica, kurse Gjoroviqi bujti me kolegët e vet.²⁰⁶¹ Sidoqoftë, fakti se organet zyrtare i përdornin shtëpitë e braktitura të shqiptarëve kosovarë është konfirmuar nga Miomir Bogosavleviqi, i cili atëherë ishte komandant i policisë në stacionin hekurudhor të Fushë-Kosovës dhe i cili tha se, kur filluan bombardimet e NATO-s, stacioni i tij policor u vendos në shtëpinë e braktitur të një shqiptari kosovar dhe qëndroi atje deri në fund të luftës.²⁰⁶²

832. Edhe K73-shi dëshmoi se, pasi qëndroi rreth një javë në Graçanicë në fillim të prillit 1999, njësia e tij e UJ-së u zhvendos në zonën e Gërmisë – në afërsi të qytetit të Prishtinës – ku qëndruan në "dy shtëpi të braktitura të shqiptarëve kosovarë." Më pas ata u zhvendosën përsëri në brendësi të qytetit të Prishtinës dhe u fshehën nga NATO-ja në shtëpi të tjera të braktitura të shqiptarëve kosovarë.²⁰⁶³ Këto të dhëna konfirmohen edhe nga ditari i luftës i Batalionit të 52-të të Policisë Ushtarake.²⁰⁶⁴ K73-shi qartësoi se, para se të vendoseshin në shtëpitë në sektorin e Gërmisë, ata morën urdhër të kontrollonin zonën se mos kishte civilë të mbetur dhe t'i dëbonin nga shtëpitë e tyre.²⁰⁶⁵ Gjatë bastisjes së shtëpive, forcat e UJ-së gjithashtu kërkuan për mallra dhe konfiskuan "municion, armë, material propagandistik shqiptar si flamuj shqiptarë dhe... iu thanë që të vidhnin gjërat me vlerë, si para, flori, dhe argjend."²⁰⁶⁶ Forcat ia dorëzuan sendet e grabitura "Togës së

²⁰⁵⁸ Emin Kabashi, P2250 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 prill 1999), f. 3–4.

²⁰⁵⁹ Emin Kabashi, T. 2046 (21 gusht 2006), P2250 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 prill 1999), f. 3, 5.

²⁰⁶⁰ Llakiq Gjoroviq, P2671 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2006), para. 32.

²⁰⁶¹ Millosh Spasojeviq, 3D532 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 janar 2007), para. 3.

²⁰⁶² Miomir Bogosavleviq, T. 23849 (6 mars 2008), 23875–23876 (7 mars 2008); IC190 (Hartë e shënuar nga Miomir Bogosavleviqi).

²⁰⁶³ K73, T. 3371 (14 shtator 2006) (seancë e mbyllur), P2440 (deklarata e dëshmitarit), para. 36.

²⁰⁶⁴ P2297 (Ditari i Luftës i Batalionit të 52-të të Policisë Ushtarake), f. 4, 7.

²⁰⁶⁵ K73, P2440 (deklarata e dëshmitarit), para. 36.

²⁰⁶⁶ K73, P2440 (deklarata e dëshmitarit), para. 37.

Shërbimeve të Policisë Ushtarake," e cila mbante një listë të të gjitha sendeve të marra.²⁰⁶⁷ K73-shi dhe një pjesë e batalionit të tij u larguan nga Prishtina në drejtim të Junikut në fund të marsit 1999.²⁰⁶⁸ Pas pjesëmarrjes në një operacion në fund të prillit në komunën e Gjakovës, njësia e K73-shit u dërgua përsëri në Prishtinë.²⁰⁶⁹ Në dritën e kësaj dëshmie, Dhoma hedh poshtë mohimet e Spasojeviqit në lidhje me situatën në Prishtinë dhe pranon dëshminë e Gjoroviqit.

833. Në kundërshtim me të gjitha këto përshkrime të gjendjes në Prishtinë që nga fillimi i sulmeve ajrore të NATO-s, Millutin Filipoviqi dhe dëshmitari SD3, shqiptar kosovar i cili punonte për UJ-në në Prishtinë, dëshmuar se jeta në qytet ishte normale.²⁰⁷⁰ Dhoma nuk i konsideron të besueshme dëshmitë e tyre për këtë çështje; ato nuk përputhen me dëshmitë e dëshmitarëve të paraqitur nga Prokuroria që janë diskutuar më lart dhe as me pranimin e vet dëshmitarit SD3 se shumë njerëz po largoheshin nga qyteti.²⁰⁷¹ Dhoma është bindur se jeta në qytet ishte larg "normales."

834. Dhoma dëgjoji nga disa dëshmitarë për bombardimin e objektivave në Prishtinë dhe rreth saj prej NATO-s, që filloi më 24 mars 1999. Ndër dëshmitarët, Zoran Angjelkoviqi, ish-ministër në qeverinë e Republikës së Serbisë dhe kryetar i Këshillit Ekzekutiv të Përkohshëm të Kosovës në fillim të vitit 1999, dëshmoi se qyteti dhe rrethina bombardoheshin nga NATO-ja çdo natë.²⁰⁷² Këto bombardime shkaktuan "shkatërrim, kaos, ndjenjën e pasigurisë midis shumë njerëzve, frikë, dhe largime."²⁰⁷³ Danica Marinkoviqi, e cila në fillim të vitit 1999 punonte si gjykatëse hetuese në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës, tha se forcat e NATO-s goditën objekte civile në qytetin e Prishtinës dhe në zonën përreth, si postën, institutin e sigurimeve të pensioneve, një qendër sportive, dhe shtëpi private.²⁰⁷⁴

835. Midis objekteve që raportohet se u goditën nga NATO-ja ishin: godina e policisë në Hajvali, e cila ndodhet në rrugën për në Graçanicë,²⁰⁷⁵ aeroporti i Prishtinës,²⁰⁷⁶ kazerma e UJ-së jashtë

²⁰⁶⁷ K73, P2440 (deklarata e dëshmitarit), para. 37.

²⁰⁶⁸ K73, P2440 (deklarata e dëshmitarit), para. 38.

²⁰⁶⁹ K73, P2440 (deklarata e dëshmitarit), para. 47, 49.

²⁰⁷⁰ Millutin Filipoviq, T. 19196 (28 nëntor 2007); SD3, T. 20815 (22 janar 2008), 5D1444 (deklarata e dëshmitarit e datës 27 dhjetor 2007), para. 1–2, 7–8.

²⁰⁷¹ SD3, 5D1444 (deklarata e dëshmitarit e datës 27 dhjetor 2007), para. 9, 11.

²⁰⁷² Zoran Angjelkoviq, T. 14678 (30 gusht 2007).

²⁰⁷³ Zoran Angjelkoviq, T. 14678 (30 gusht 2007).

²⁰⁷⁴ Danica Marinkoviq, T. 23457, 23462–23463 (29 shkurt 2008).

²⁰⁷⁵ K63, P2443 (deklarata e dëshmitarit e datës 28 maj 2003), para. 22.

²⁰⁷⁶ Emin Kabashi, P2250 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 prill 1999), f. 6, P2251 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4016–4017; Miomir Bogosavleviq, T. 23856 (6 mars 2008).

Prishtinës rrugës për në Fushë-Kosovë;²⁰⁷⁷ "objekti i SAJ-së;"²⁰⁷⁸ "ndërtesat e kampusit të të rinjve" ku ishin të vendosura forcat e MPB-së;²⁰⁷⁹ godina e SPB-së së Prishtinës;²⁰⁸⁰ dhe godina e postës.²⁰⁸¹ Angjellkoviqi, i cili ishte në Prishtinë më 7 prill kur u godit ndërtesa e postës, dëshmoi se atë ditë pati shumë viktima, ndër të cilët serbë, turq, dhe shqiptarë kosovarë.²⁰⁸² Ai gjithashtu dëshmoi se, si rezultat i bombardimeve, shumë njerëz ndiheshin të pasigurtë dhe shumë prej tyre u larguan; ky ishte "rezultat i zakonshëm" i çdo shkatërrimi të asaj shkalle.²⁰⁸³ Filipoviqi shtoi se 90 për qind e objekteve të sulmuara në qytet dhe rrethinë ishin objekte civile,²⁰⁸⁴ dhe përfshinin institutin krahinor të përkrahjes sociale, i cili u godit në të njëjtën kohë si edhe posta, së bashku me shumë objekte të tjera përreth që ishin kryesisht godina banimi. Disa nga këto godina u dëmtuan shumë, si godina e KEP-it, banka kombëtare, dhe godina e Kuvendit Komunal. Në këto sulme u vranë mbi 10 civilë dhe mbi 20 u plagosën.²⁰⁸⁵

836. Mirëpo, asnjë nga shqiptarët kosovarë që dëshmuar e as Antonio Russo nuk përmendën bombardimet e NATO-s si një ndër shkaqet e largimit të tyre dhe të tjerëve nga Prishtina. Dhoma Gjyqësore gjithashtu vëren se, në fakt, dëshmitarët dëshmuar se ishin larguar nga Prishtina që para fillimit të prillit, kur u godit posta. Për më tepër, Emin Kabashi dëshmoi se, kur në fund të marsit ndodhej në lagjen Arbëria, e cila është në kodër, ai ishte në gjendje të shihte të gjithë qytetin e Prishtinës dhe ishte i sigurt se bombardimet e NATO-s nuk kishin prekur zonat e banuara.²⁰⁸⁶

837. Sulmet e NATO-s kundër objekteve të UJ-së në Prishtinë dhe përreth përmenden në shumë dokumente, por aty nuk përmenden sulme kundër objekteve civile. Në ditarin e luftës të Batalionit të 52-të të Policisë Ushtarake thuhet se në natën e 29 marsit NATO-ja bombardoi kazermën e Batalionit të 52-të të Policisë Ushtarake në qytetin e Prishtinës duke shkaktuar "dëme të mëdha", por jo viktima.²⁰⁸⁷ Bombardimi i kazermës Kosovski Junaci në Prishtinë më 12 prill është raportuar

²⁰⁷⁷ Emin Kabashi, P2250 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 prill 1999), f. 6, P2251 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4016–4017; Dragan Zhivaleviq, 6D1606 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 mars 2008), para. 33; Miomir Bogosavleviq, T. 23856 (6 mars 2008).

²⁰⁷⁸ Bozhidar Filiq, T. 23970 (10 mars 2008).

²⁰⁷⁹ Bozhidar Filiq, T. 23970 (10 mars 2008).

²⁰⁸⁰ Bozhidar Filiq, T. 23970, 24035–24036 (10 mars 2008); Miroslav Mijatoviq, T. 22176–22177 (12 shkurt 2008); Millosh Dereti, T. 22577–22578 (15 shkurt 2008), 22585 (18 shkurt 2008); Zoran Angjellkoviq, T. 14673–14674 (30 gusht 2007).

²⁰⁸¹ Bozhidar Filiq, T. 23970 (10 mars 2008); P2297 (Ditari i Luftës i Batalionit të 52-të të Policisë Ushtarake), f. 5.

²⁰⁸² Zoran Angjellkoviq, T. 14675–14676 (30 gusht 2007); *Shih gjithashtu* Millutin Filipoviq, T. 19175–19176 (27 nëntor 2007).

²⁰⁸³ Zoran Angjellkoviq, T. 14678 (30 gusht 2007).

²⁰⁸⁴ Millutin Filipoviq, T. 19192–19193 (28 nëntor 2007).

²⁰⁸⁵ Millutin Filipoviq, T. 19174 (27 nëntor 2007); *Shih gjithashtu* 5D1242 (Videofilmim. Pjesa e përdorur mban etiketën "Prishtina 03-06-1999").

²⁰⁸⁶ Emin Kabashi, T. 2074–2077 (22 gusht 2006).

²⁰⁸⁷ P2297 (Ditari i Luftës i Batalionit të 52-të të Policisë Ushtarake), f. 3.

në një dokument të dërguar nga dega e sigurimit e Komandës së Armatës së 3-të për Administratën e Sigurimit në Shtabin e Komandës së Lartë.²⁰⁸⁸ Faktikisht janë pranuar si prova shumë raporte të hartuara në atë kohë dhe asnjë prej tyre nuk konfirmon dëshmitë e Marinkoviqit dhe Filipoviqit për bombardimin e ndërtesave civile.²⁰⁸⁹

a. Largimi i shqiptarëve kosovarë nga qyteti i Prishtinës

838. Gjatë ditëve që vijuan pas fillimit të fushatës ajrore të NATO-s shumë njerëz u larguan nga Prishtina, shumica prej të cilëve përfunduan në Maqedoni. Palët kundërshtojnë shkakun e këtij largimi, ku argumenti i Prokurorisë është se shqiptarët kosovarë u dëbuan prej shtëpive nga forcat e RFJ-së dhe Serbisë, kurse Mbrojtja pretendon se ata ikën nga sulmet e NATO-s.

839. K63-shi dëshmoi se, gjatë ditëve të para të bombardimit, ai pa pjesëtarë të policisë duke shkuar nëpër apartamente në lagjen e tij dhe duke i kërcënuar banorët, të cilët ishin shqiptarë kosovarë, dhe duke i urdhëruar të largoheshin me fjalë si, "Shkoni në Shqipëri, Kosova nuk është toka juaj," ose "Shqiptarët e kanë vendin në Shqipëri dhe duhet të ikin, Kosova nuk është e juaja."²⁰⁹⁰ Shpesh në raste të tilla, fqinjët e njerëzve të dëbuar shihnin se çfarë po ndodhte dhe edhe ata iknin. Mirëpo, kur shqiptarët kosovarë refuzonin të largoheshin pas urdhrave, policia i kërcënonte me dhunë. Në këtë mënyrë ndërmjet popullatës shqiptare kosovare u krijua atmosferë frike.²⁰⁹¹ K63-shi kujtoi konkretisht se më 1 prill 1999 rreth orës 12:00, kur po shkonte nga dyqani në shtëpi, ai pa grupe njerëzish duke u larguar me çanta kurse policia u kishte drejtuar armë të gjata dhe i shante e u thoshte të iknin nga Kosova. Sipas K63-shit, gjatë javës pas 24 marsit 1999, rreth 50 për qind e popullatës në lagjen së tij u dëbuan për në Maqedoni ose për në Shqipëri dhe po largoheshin me çdo mjet të mundshëm.²⁰⁹²

840. Nazlie Bala dëshmoi ngjashëm se më 29 mars 1999 "UJ-ja, MPB-ja, civilë serbë, dhe romë, ku romët ishin me uniforma policie" shkuan në shtëpitë e shqiptarëve kosovarë në pjesë të

²⁰⁸⁸ 5D1310 (Raport i Armatës së 3-të dërguar Administratës së Sigurimit të Shtabit të Komandës së Lartë, 13 prill 1999), f. 2.

²⁰⁸⁹ 3D820 (Raport luftimi i Shtabit të Komandës së Lartë, 15 prill 1999), f. 1; P2004 (Raport luftimi i Komandës së PrK-së, 13 prill 1999), f. 1; P1997 (Raport luftimi i Armatës së 3-të, 3 prill 1999), f. 2; 3D821 (Raport luftimi i Shtabit të Komandës së Lartë, 16 prill 1999), f. 1–3; 3D832 (Raport luftimi i Shtabit të Komandës së Lartë, 27 prill 1999), f. 1; P2005 (Raport luftimi i Armatës së 3-të, 27 prill 1999), f. 1; P1693 (Pasqyrë prej MPB-së e gjendjes së sigurisë, 1 maj 1999), f. 2; 3D843 (Raport luftimi i Shtabit të Komandës së Lartë, 8 maj 1999), f. 1; 3D850 (Raport luftimi i Shtabit të Komandës së Lartë, 15 maj 1999), f. 5; 5D305 (Raporti Ditor i Qendrës Krahinore për Informim, 27–28 maj 1999, dhe për 29 e 30 maj 1999); 5D308 (Raporti Ditor i Qendrës Krahinore për Informim, 30–31 maj 1999).

²⁰⁹⁰ K63, P2443 (deklarata e dëshmitarit e datës 28 maj 2003), para. 24.

²⁰⁹¹ K63, P2443 (deklarata e dëshmitarit e datës 28 maj 2003), para. 24–26.

²⁰⁹² K63, P2443 (deklarata e dëshmitarit e datës 28 maj 2003), para. 25, 27–28.

ndryshme të qytetit dhe i detyruan banorët të largoheshin.²⁰⁹³ Më vonë atë ditë, një oficer i UJ-së dhe një person tjetër të cilin ajo e njohu si polic vendës i qarkullimit rrugor dhe të cilin e përshkroi si "rom,"²⁰⁹⁴ që të dy të armatosur, erdhën në shtëpinë e saj. Oficeri i UJ-së u tha njerëzve që ishin në shtëpinë e saj se duhej të largoheshin për pesë minuta. Pas këtyre dyve erdhën një grup policësh, ushtarësh, civilësh dhe forca të tjera të armatosura, të cilët shkuan nëpër shtëpitë e lagjes.²⁰⁹⁵ Bala tha se ata që qëndronin, vriteshin ose rriheshin;²⁰⁹⁶ faktikisht ajo nuk pa ndonjë vrasje, por dëgjoji njerëz që flisnin për incidente të tilla. Ajo pa fqinjën e saj 80-vjeçar duke u rrahur keqas dhe dëgjoji se ai kishte vdekur më vonë nga rrahja.²⁰⁹⁷ Sipas Balës, "shumica e banorëve të Prishtinës u larguan nga qyteti... Shumica dërrmuese u dëbuan."²⁰⁹⁸

841. Pasi u dëbua nga shtëpia, Bala shkoi në këmbë në drejtim të qendrës së Prishtinës së bashku me mijëra shqiptarë kosovarë të tjerë. Ajo pa njerëz me uniforma të zeza me emblema me shqiponjë në krahë që kontrollonin postbllokun kryesor. Ajo pa edhe policë e ushtarë të armatosur, dhe "persona të tjerë me uniforma," të rreshtuar në një rën anë të rrugës dhe "civilë të armatosur" në anën tjetër me armët e drejtuara nga kolona e njerëzve, të gjithë duke e sharë kolonën që kalonte. Civilët serbë nëpër blloqe apartamentesh i gjuajtën me shishe shqiptarët kosovarë që po largoheshin lëshonin muzikë me zë të lartë, dhe thoshin, "Çka po prisni? Çka po prisni? Vritini, vritini."²⁰⁹⁹ Bala shtoi se burrave në grupin e saj ua morën paratë. Ajo gjithashtu kujtoi se dëgjoji krisma pas saj pasi një burrë i paralizuar pas saj, të cilin e bartte djali i tij, filloi të bërtiste. Gjithsesi nuk pa të vritej kush në atë kaos.²¹⁰⁰

842. Emin Kabashi dëshmoi se në fund të marsit 1999, u fsheh për tri ditë në një shtëpi në lagjen Arbëria deri kur katër pjesëtarë të ushtrisë dhe tetë pjesëtarë të "forcave speciale" erdhën dhe e thyen derën e shtëpisë.²¹⁰¹ Këto forca u kërkuan grave në shtëpi letërnjoftimet, disa prej të cilëve i grisën dhe i hodhën në dysheme. Ata gjithashtu ia hoqën shaminë kumatës së Kabashit dhe e hodhën në dysheme. Ata kërkuan para nga burrat dhe njëri prej tyre tha, "Shkoni në Shqipëri, NATO-ja do

²⁰⁹³ Nazlie Bala, P2262 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 qershor 2001), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 7.

²⁰⁹⁴ Nazlie Bala, T. 2139 (22 gusht 2006), P2262 (deklarata e dëshmitarit e datës 16 gusht 2006), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 12.

²⁰⁹⁵ Nazlie Bala, T. 2183–2184 (23 gusht 2006), P2262 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 qershor 2001), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 7, P2262 (deklarata e dëshmitarit e datës 16 gusht 2006), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 12.

²⁰⁹⁶ Nazlie Bala, P2262 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 qershor 2001), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 7.

²⁰⁹⁷ Nazlie Bala, T. 2171 (23 gusht 2006).

²⁰⁹⁸ Nazlie Bala, T. 2187–2188 (23 gusht 2006).

²⁰⁹⁹ Nazlie Bala, T. 2141 (22 gusht 2006), 2204–2205 (23 gusht 2006), P2262 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 qershor 2001), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 7–8.

²¹⁰⁰ Nazlie Bala, T. 2141 (22 gusht 2006), P2262 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 qershor 2001), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 7.

²¹⁰¹ Emin Kabashi, T. 2055 (21 gusht 2006), P2250 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 prill 1999), f. 3.

t'ju mbrojë atje."²¹⁰² Kabashi i quajti "forca speciale" dhe tha se ishin të veshur me uniforma kamuflimi në ngjyrë të kaltër të mbyllët, maska, jelekë kundërplumb, kapela bejsbolli, çizme deri te kofshët, dhe thika në brez. Kabashi dëshmoi se këto forca kishin shkronjat "SJ" në mëngë, që tregonin se i përkisnin "policisë speciale."²¹⁰³ "Policia speciale" kishte pushkë automatike dhe disa snajperë me dylbi. Ushtarët dhe "policia speciale" i nxorën personat në shtëpi jashtë dhe i dërguan në lagjen Vranjec, ku Kabashi kaloi një natë.²¹⁰⁴

843. Më tej Kabashi dëshmoi se, gjatë qëndrimit në Vranjec, pa luftime gjatë ditës dhe natës dhe dëgjoi se ishin vrarë katër vetë. Njerëzit i kapi paniku për shkak të krismave dhe shpërthimeve dhe ai pa shtëpi duke u djegur në pjesët ku kishte luftime.²¹⁰⁵ Policia e rrethoi të gjithë lagjen dhe filloi dëbimin, duke bërë komente si, "Dilni jashtë, kërkuat NATO-n, shkoni në Maqedoni ose Shqipëri, do t'i zëmë ata që nuk largohen dhe do t'i djegim. Këtu është Serbi" dhe "Ikni, shkoni në Shqipëri."²¹⁰⁶ Atë së bashku me të tjerët policia i dëboi nga shtëpia ku kishte kaluar natën dhe i dërguan në qendër të qytetit. Policia ndaloi atë dhe vëllain e tij në rrugën kryesore dhe u kërkoi para.²¹⁰⁷

844. Kabashi kaloi përmes qytetit në një kolonë të gjatë njerëzish. Një tank i vendosur në urën e Vranjecit e ndau kolonën në dysh. Një grup u urdhërua të shkonte te medreseja, kurse tjetri u urdhërua të shkonte në stacionin hekurudhor dhe prej andej për në Shqipëri. Rrugës për në stacionin hekurudhor, grupi i Kabashit u ndal në një postbllok nga një "patrullë tjetër policore," e cila kishte një listë të njerëzve të bërë në kompjuter. Kabashi mundi ta shihte emrin e tij në listë dhe pa emrat e katër-pesë personave të tjerë me të cilët kishte punuar. Kur policët e pyetën si e kishte emrin, ai dha një emër tjetër me shpresë se ai emër nuk do të ishte në listë.²¹⁰⁸ Pas kësaj i kërkuan sërish para. Policët e kërcënuan se do ta vrisnin nëse nuk largohej menjëherë për në Shqipëri.²¹⁰⁹

845. Millutin Filipoviqi mohoi mundësinë e kësaj ndodhie. Ai dëshmoi se nuk ishte e mundshme që ndonjë njësi e UJ-së të ishte dislokuar në urën e Vranjecit, aq më pak me tank, sepse të gjitha njësitë luftarake të UJ-së ishin larguar nga qyteti "fill para agresionit" për të zënë pozicione të tjera. Tanku nuk mund të ishte në atë vend sepse "do të ishte shenjë e lehtë për aeroplanët e NATO-s dhe

²¹⁰² Emin Kabashi, T. 2046, 2048, 2055 (21 gusht 2006), P2250 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 prill 1999), f. 3–4.

²¹⁰³ Emin Kabashi, T. 2046–2047 (21 gusht 2006), T. 2097–2098 (22 gusht 2006).

²¹⁰⁴ Emin Kabashi, P2250 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 prill 1999), f. 4.

²¹⁰⁵ Emin Kabashi, T. 2049 (21 gusht 2006), P2250 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 prill 1999), f. 4.

²¹⁰⁶ Emin Kabashi, T. 2049 (21 gusht 2006), P2250 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 prill 1999), f. 4.

²¹⁰⁷ Emin Kabashi, P2250 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 prill 1999), f. 4.

²¹⁰⁸ Emin Kabashi, T. 2050, 2057–2060 (21 gusht 2006), P2250 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 prill 1999), f. 4.

²¹⁰⁹ Emin Kabashi, P2250 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 prill 1999), f. 4–5.

terroristët shqiptarë, që ishin shumë në Vranjec."²¹¹⁰ Sidoqoftë, Dhoma konstaton se Nazlie Bala gjithashtu tha se më 28 mars pa një tank duke granatuar nga kodra e Vranjecit në drejtim të kodrës së Kolovicës.

846. Kabashi pa snajperë që vrojtonin kolonën nga një godinë e lartë në afërsi. Ai dëshmoi se pa një "djalosh" duke tentuar të ikte nga kolona i cili shkoi në një nga rrugët anësore dhe u orvat të hapte një derë, pastaj u dëgjua një krismë arme dhe djaloshi u rrëzua. Mirëpo ai nuk ishte i sigurt nëse djaloshi ishte vrarë. Ai gjithashtu pa një djalosht tjetër të cilin e arrestuan. Kur i ati shkoi në ndihmë të të birit, atë e rrahën.²¹¹¹

847. Adnan Merovci dëshmoi se, më 31 mars 1999 rreth 11:45, nga kati i parë i shtëpisë së Rugovës pa forca të "armatosura rëndë" të UJ-së dhe MPB-së me autoblanda dhe makina të tjera të blinduara, duke shkuar derë më derë dhe duke i dëbuar njerëzit nga shtëpitë e afërta.²¹¹²

848. Këto dëshmi në lidhje me kontrollimin e lëvizjes së njerëzve mbështeten nga deklaratat me shkrim e Antonio Russo-s, i cili përshkroi largimin e vet nga Prishtina në mesin e një grupi të madh shqiptarësh kosovarë në fund të marsit 1999. Russo kujtoi se në mëngjesin e 31 marsit, forcat e UJ-së dhe të MPB-së filluan të hynin në lagjen e Dodonës. Pati edhe granatime në atë zonë, që dukej se ishte në mbështetje të përparimit të forcave. Ai i pa forcat duke bastisur shtëpitë një nga një dhe duke i dëbuar banorët. Atë pasdite, Russo-ja iu bashkua një grupi prej rreth 400 vetash që i kishin dëbuar nga shtëpitë dhe u mblodhën afër Hotelit Park. Turma qëndroi atje për një kohë të gjatë, ndërkohë që njerëz të tjerë dëboheshin dhe u urdhëruan t'u bashkoheshin atyre. Ai e përshkroi atmosferën si "shumë shqetësuese," sepse njerëzit besonin se i kishin mbledhur atje që të ishte më për ekzekutim masiv. Pas pak, erdhi një ushtar i UJ-së i cili filloi të bërtiste dhe të bënte me shenjë që turma të lëvizte.²¹¹³

849. Gjithashtu Russo pa "njerëz të MPB-së të veshur me uniforma të njëjta si ato të UJ-së, por me emblema, dhe me 4-5 minahedhës në shpinë" duke i bastisur shtëpitë përreth dhe duke dëbuar edhe njerëz të tjerë, të cilët formuan turmën e dytë. Turma e dytë udhëhiqej nga një xhip i gjelbër me mbishkrimin në cirilik, "milicia", një autoblandë me ngjyra kamuflimi, dhe trupat e UJ-së të veshur me uniforma kamuflimi të gjelbra. Dikur, të dy turmat, të cilat kishin gjithsej rreth 2.000

²¹¹⁰ Millutin Fillipoviq, T. 19177 (27 nëntor 2007).

²¹¹¹ Emin Kabashi, P2250 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 prill 1999), f. 5.

²¹¹² Adnan Merovci, T. 8441–8442 (16 janar 2007), P2588 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 prill 2000), para. 52.

²¹¹³ Antonio Russo, P2261 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 5.

njerëz, i detyruan të bashkoheshin dhe i urdhëruan të vazhdonin rrugën. Grupi i bashkuar u nis rrugës kryesore, pranë stacionit të policisë në drejtim të stacionit hekurudhor.²¹¹⁴

850. Rrugës për në stacion hekurudhor, Russo pa se të gjitha udhëkryqet dhe rrugët anësore ishin bllokuar dhe se kishte grupe të armatosura policësh dhe ndonjëherë civilë në çdo 10-15 metra që ruanin rrugën për ta mbajtur lëvizjen e njerëzve në rrugën kryesore. Gjithashtu ai vuri re banorët civilë serbë që shikonin nga anët e rrugës dhe dritaret dhe ndonjëherë "bënin shenja ofenduese me gisht në drejtim të turmës." Ndërkohë që kolona vazhdonte rrugën, me të u bashkua një turmë tjetër e madhe. Gjatë tërë rrugës në drejtim të stacionit hekurudhor, policia bërtiste "Raus" në gjermanisht dhe "Marsh" në serbisht për ta mbajtur turmën në lëvizje.²¹¹⁵

851. Baton Haxhiu, K63-shi, K62-shi, dhe K14-a gjithashtu u dëbuan nga Prishtina në fillim të prillit 1999. Haxhiu dëshmoi se, më 2 prill, kur ndodhej në lagjen Kodra e Diellit, "paraushtarakë" me uniforma kamuflimi të gjelbra, maska dhe pushkë, i urdhëruan banorët e lagjes të largoheshin nga shtëpitë dhe i drejtuan në drejtim të rrugës, kurse makinat ushtarake dhe policore ruanin rrugët dhe udhëkryqet që popullata të lëvizte në drejtimin e dëshiruar.²¹¹⁶

852. K63-shi dhe gruaja e tij, K62-shi, u dëbuan nga shtëpia më 3 prill. K63-shi dëshmoi se kishte dëgjuar dikë në rrugë duke bërtitur në serbisht: "Shqiptarët të largohen nga godina," dhe kur doli jashtë pa rreth 20 policë. Vetëm shqiptarët kosovarë u dëbuan dhe u urdhëruan të shkojnë te stacioni hekurudhor. Ai dhe gruaja e tij filluan të ecnin me një grup prej 30-40 vetësh. Gjatë tërë rrugës deri në stacionin hekurudhor kishte policë në çdo katër-pesë metra.²¹¹⁷ Në çdo udhëkryq atyre u bashkoheshin më shumë shqiptarë kosovarë. Ai pa policët duke rrahur një të ri.²¹¹⁸ Megjithëse K63 kishte problem me dallimin dhe identifikimin e ngjyrave, në atë masë sa nuk ishte në gjendje t'i përshkruante saktë ngjyrat dhe motivet në uniformat e forcave që dëbuan atë dhe gruan e tij, Dhoma e konsideron të besueshëm përshkrimin e tij të ngjarjeve në lidhje me dëbimin dhe identifikimin e forcave pjesëmarrëse duke marrë parasysh përputhjen e dëshmisë së tij me dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë. Edhe pse K62-shi përshkroi forcat që dëbuan atë me burrin e saj nga shtëpia dhe i urdhëruan të shkonin në stacionin hekurudhor se ishin "paraushtarakë" e jo policë, dëshmia e saj i ngjarjeve nuk kishte dallime të dukshme nga dëshmia e bashkëshortit të saj.²¹¹⁹

²¹¹⁴ Antonio Russo, P2261 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 6.

²¹¹⁵ Antonio Russo, P2261 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 6.

²¹¹⁶ Baton Haxhiu, T. 6091, 6094–6095 (8 nëntor 2006).

²¹¹⁷ K63, T. 2232, 2239 (23 gusht 2006), P2443 (deklarata e dëshmitarit e datës 28 maj 2003), para. 33, 36.

²¹¹⁸ K63, T. 2232–2233 (23 gusht 2006), P2443 (deklarata e dëshmitarit e datës 28 maj 2003), para. 34.

²¹¹⁹ K62, T. 2277–2278, 2283–2285 (24 gusht 2006).

Sidoqoftë, ajo tha se nuk pa asnjë polic gjatë rrugës për në stacion hekurudhor.²¹²⁰ Dhoma vëren se dy ditë më parë, K62-shi ishte përdhunuar nga tre burra (diskutohet më poshtë) dhe mund të ketë qenë e traumatizuar gjatë dëbimit. Rrjedhimisht mospërputhjet midis dëshmisë së saj dhe të K63-shit e dëshmitarëve të tjerë okularë nuk konsiderohen thelbësore.

853. K14-a dëshmoi se ajo dhe familja e saj u dëbuan nga policët dhe ushtarët afërsisht gjashtë ditë pas fillimit të bombardimit. Ata u rreshtuan në kolonë dhe disa prej burrave u rrahën. K14-a ishte me një grup njerëzish që u ndanë nga kolona dhe shkuan në drejtim tjetër.²¹²¹

854. Nazlie Bala dëshmoi se, pasi u dëbua nga shtëpia e saj më 29 mars, ajo arriti në stacionin hekurudhor rreth mesditës, ku mijëra njerëz ishin duke pritur. Ajo i identifikoi pjesëtarët e MPB-së në stacion si policë nga rajoni i Arbërisë të veshur me uniforma kamuflimi të kaltra. "Civilët serbë" gjithashtu i kishin rrethuar njerëzit në stacion hekurudhor. Rreth orës 17:00, mbërriti një tren me 30 vagonë, i pari dhe i fundit prej të cilëve kishte pjesëtarë të armatosur të MPB-së dhe të UJ-së dhe civilë; ajo arriti të hipte.²¹²² Treni ishte aq shumë i mbushur me njerëz sa që ishte e vështirë të merrje frymë. Ai u nis në drejtim të Maqedonisë.²¹²³ Miomir Bogosavleviqi, i cili ishte komandant i policisë në stacionin hekurudhor në Fushë-Kosovë, kundërshtoi dëshminë e Balës duke thënë se asnjë tren apo lokomotivë në atë kohë nuk mund të tërhiqte 30 vagonë, por vetëm 10, 12, ose "më së shumti 15."²¹²⁴ Ai gjithashtu mohoi sugjerimin që iu parashtrua nga Prokuroria se ata mund të shtonin lokomotiva të tjera, në mënyrë që treni të tërhiqte më shumë vagonë.²¹²⁵ Gjithsesi Bogosavleviqi megjithatë konfirmoi se, pas 29 marsit 1999, gjatë disa ditëve deri në fund të marsit dhe fillim të prillit, pati më shumë trena se zakonisht me më shumë vagonë se zakonisht.²¹²⁶ Duke u bazuar në këto dëshmi, Dhoma Gjyqësore është bindur se nga fundi i marsit deri në fillim të prillit qarkulluan trena me më shumë vagonë se zakonisht.

855. Emin Kabashi dëshmoi ngjashëm se mbërriti në stacionin hekurudhor në një kolonë shumë të gjatë njerëzish. Ai përshkroi se si njerëzit në kolonë u çuan në fushë të madhe përpara stacionit hekurudhor, që ndan stacionin nga Arbëria. Pas pak kohe, erdhën policë dhe u thanë njerëzve të largoheshin nga ai vend sepse në Arbëri kishte luftime dhe mund të vriteshin.²¹²⁷ Ata i zhvendosën

²¹²⁰ K62, T. 2285–2286 (24 gusht 2006).

²¹²¹ K14, P2643 (deklarata e dëshmitarit e datës 31 maj 1999), f. 3 (e mbyllur me vulë).

²¹²² Nazlie Bala, P2262 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 qershor 2001), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 7–8.

²¹²³ Nazlie Bala, T. 2141 (22 gusht 2006), P2262 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 qershor 2001), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 7.

²¹²⁴ Miomir Bogosavleviq, T. 23862, 23874 (7 mars 2008).

²¹²⁵ Miomir Bogosavleviq, T. 23874–23875 (7 mars 2008).

²¹²⁶ Miomir Bogosavleviq, T. 23872–23873, 23881, 23884 (7 mars 2008); P1331 (Ditari i trafikut i datës 1 janar 1999).

²¹²⁷ Emin Kabashi, P2250 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 prill 1999), f. 5.

në një vend midis hekurudhës dhe godinës së stacionit hekurudhor. Pas gjysmë ore i zhvendosën përsëri dhe i çuan në anën tjetër të stacionit hekurudhor midis godinës së stacionit dhe rrugës së asfaltuar me pretext se mund të bombardoheshin nga NATO-ja dhe të vriteshin. Kabashi pa kolona të gjata njerëzish duke ardhur nga qyteti. Atyre u thanë të nxirrnin nga xhepat çdo gjë metalike dhe se nëse dikujt i gjendej ndonjë gjë metalike do ta vrisnin.²¹²⁸

856. Kabashi qëndroi në stacionin hekurudhor tri ditë dhe tri net duke pritur dhe duke shpresuar se do të mbërrinte pjesa tjetër e familjes, derisa policët e futën me dhunë në një tren mallrash që e çoi në kufirin me Maqedoninë.²¹²⁹ Gjatë kohës që ishte në stacion, ai pa autobusë që erdhën dhe morën njerëz; askush nuk e dinte se ku shkonin. Gjithashtu ai pa 5-12 trena që mbërrinin në stacion hekurudhor çdo ditë dhe largoheshin të mbushur me njerëz, kryesisht gjatë natës. Policia i ngjeshte njerëzit nëpër trena "si bagëtinë."²¹³⁰

857. Kur K63-shi së bashku me gruan e tij, K62, mbërritën në stacionin hekurudhor në Prishtinë më 3 prill 1999, ai pa rreth 2.000 njerëz, kryesisht shqiptarë kosovarë, por gjithashtu edhe "disa turq dhe romë." Policët i drejtonin njerëzit në trena duke u thënë se duhej të shkonin.²¹³¹ K62-shi dëshmoi se njerëzit ishin aq afër njëri-tjetrit në stacion hekurudhor sa që nuk ishte në gjendje të merrte frymë. Atyre u kërkuan para. Pasi nuk e dinin sa duhej të paguanin, të gjithë dorëzuan çfarë kishin, që ishte shumë më tepër se çmimi normal i biletës.²¹³² K63-shi dhe gruaja e tij hipën në një tren, në të cilin "gjendja... ishte me të vërtetë katastrofike" sepse "në çdo vagon kishte tri herë më shumë njerëz se lejohej."²¹³³ Pas rreth 30 minutash, treni u nis nga stacioni.²¹³⁴

858. Antonio Russo gjithashtu përshkroi mbërritjen e tij në stacionin hekurudhor në kolonë më 31 mars, ku ishte mbledhur një turmë. Turmën e detyruan të qëndronte në një shesh aty afër, pa strehë mbi kokë, dhe të ruajtur nga pjesëtarët e policisë që të mos mund të largoheshin. Gjatë natës, Russo pa disa shtëpi në lagjen Dardania duke u djegur.²¹³⁵ Të nesërmen, njerëzit në shesh nxituan të hipnin në trenin që mbërriti, edhe pse mijëra mbetën pa hipur, Russo arriti të hipte. Disa në shesh u ofruan para punëtorëve të hekurudhës për të shtuar edhe dy vagonë. Punëtorët pranuan përkundrejt

²¹²⁸ Emin Kabashi, P2250 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 prill 1999), f. 5.

²¹²⁹ Emin Kabashi, P2250 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 prill 1999), f. 5–6.

²¹³⁰ Emin Kabashi, T. 2052–2053 (21 gusht 2006), P2250 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 prill 1999), f. 5–6.

²¹³¹ K63, T. 2232–2233 (23 gusht 2006), P2443 (deklarata e dëshmitarit e datës 28 maj 2003), para. 35–36; K62, T. 2278 (24 gusht 2006).

²¹³² K62, T. 2278 (24 gusht 2006).

²¹³³ K63, P2443 (deklarata e dëshmitarit e datës 28 maj 2003), para. 36.

²¹³⁴ K63, T. 2232 (23 gusht 2006), P2443 (deklarata e dëshmitarit e datës 28 maj 2003), para. 37; K62, T. 2278 (24 gusht 2006).

²¹³⁵ Antonio Russo, P2261 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 6–7.

pagesës së 15.000 markave gjermane dhe më shumë njerëz hipën në vagonët shtesë. Kaluan edhe dy orë të tjera derisa u nis treni.²¹³⁶

859. Nazlie Bala përshkroi udhëtimin e saj me tren për në Maqedoni më 29 mars. Gjatë tërë udhëtimit, dhe gjatë ndaljeve të trenit në Fushë-Kosovë, Lipjan, Ferizaj, dhe Han i Elezit, ai ishte rrethuar nga "forcat serbe," të cilat ajo i përshkroi si "policë, ushtarë, dhe forcat e tjera që nuk ishin pjesë e... forcave të rregullta të Serbisë" dhe të cilat "kishin uniforma të zeza me flamuj, flamuj me ngjyrat bardh, kuq, e kaltër, dhe... emblema në pjesë të ndryshme të.. uniformave serbe."²¹³⁷ Pak para se treni të mbërrinte në stacionin hekurudhor në Fushë-Kosovë, ajo pa tri ose katër kufoma të djegur në vende të ndryshme midis shtëpive dhe në anën e majtë të hekurudhës. Edhe pse treni lëvizte shumë ngadalë, ajo i parë këto vetëm me bisht të syrit. Ajo nuk guxonte të shikonte përreth nga frika meqenëse hekurudha ishte e rrethuar nga pjesëtarë të UJ-së dhe MPB-së me armë të drejtura nga treni. Këto forca gjithashtu lëshonin fyerje nacionaliste me zë të lartë si, "Ju shqiptarë shkërdhata. Kosova nuk është e juaja, shqiptarëve, është e serbëve" dhe "Do t'ju vrasim ju shqiptarëve."²¹³⁸ Ndërkohë që treni qëndroi në Fushë-Kosovë, ai ishte i rrethuar dhe dritaret ishin mbajtur të mbyllura. Forcat rrethuese vazhduan t'i ofendonin me zë të lartë dhe t'i kërcënonin.²¹³⁹

860. Treni mbërriti përpara fabrikës së çimentos në Han të Elezit rreth orës 22:00.²¹⁴⁰ Udhëtarëve u thanë të dilnin nga treni, të formonin radhë, dhe të ecnin në drejtim të Maqedonisë. Bala dëshmoi se ecën rreth 45 minuta nëpër hekurudhë sepse u thanë se kishte mina në të dyja anët. Një radhë e gjatë e "forcave serbe," të cilët ajo i përshkroi si policë, ushtarë, dhe të tjerë me uniforma të zeza me flamuj,²¹⁴¹ ishin vendosur përpara fabrikës së çimentos në Han të Elezit, duke bërë rojë mbi grupin. Këto forca i ndanë mbi 100 burra nga grupi dhe u kërkuan para dhe dokumentet e identifikimit. Pasi i dorëzuan çfarë u ishte kërkuar, burrat u liruan dhe u lejuan t'i bashkoheshin grupit.²¹⁴² Rreth orës 22:30 ose 23:00, grupi i Balës mbërriti në një hambar të madh gruri ku ishin shumë njerëz, disa prej të cilëve kishin qenë aty që prej ditësh. Ajo e kaloi natën atje dhe ishte e para që u largua të

²¹³⁶ Antonio Russo, P2261 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 7.

²¹³⁷ Nazlie Bala, T. 2141, 2161–2162 (22 gusht 2006), P2262 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 qershor 2001), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 7–8.

²¹³⁸ Nazlie Bala, T. 2172 (23 gusht 2006), P2262 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 qershor 2001), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 7–8.

²¹³⁹ Nazlie Bala, P2262 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 qershor 2001), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8.

²¹⁴⁰ Nazlie Bala, P2262 (deklarata e dëshmitarit e datës 16 gusht 2006), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 12.

²¹⁴¹ Nazlie Bala, T. 2140–2141 (22 gusht 2006).

²¹⁴² Nazlie Bala, T. 2173, 2191–2192 (23 gusht 2006), P2262 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 qershor 2001), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8.

nesërmen. Ajo priti tri-katër ditë për t'u regjistruar dhe hipi në një nga 50-60 autobusët që shkuan në drejtim të Ohrit në Maqedoni.²¹⁴³

861. Treni në të cilin hipën K63-shi dhe gruaja e tij më 3 prill së pari ndaloi në stacionin hekurudhor në Fushë-Kosovë, ku askush nuk u lejua të zbriste. K63-shi dëshmoi se ai pa shumë policë dhe civilë serbë në stacion duke bërëtitur, "Ikni, ikni, ku është NATO-ja juaj tani." Më tej treni shkoi në Ferizaj, ku ndaloi vetëm për disa minuta para se të nisej përsëri në drejtim të kufirit me Maqedoninë.²¹⁴⁴ K63-shin dhe K62-shin i dërguan në Bllacë, ku kaluan natën duke fjetur jashtë.²¹⁴⁵ Sipas K63-shit, kur treni mbërriti në kufirin me Maqedoninë, forcat e UJ-së i urdhëruan njerëzit në tren të zbrisnin dhe të ecnin në një shteg shumë të ngushtë sepse "kishte mina gjithkund." Pastaj ata i urdhëruan nën kërcënimin e armëve të kalonin kufirin në Maqedoni. K63-shi shtoi se në kufi ishin mijëra njerëz dhe se atë dhe gruan e tij i ndanë kur atë e hipën në një autobus tjetër.²¹⁴⁶ Ata u ribashkuan me ndihmën e Kryqit të Kuq pas njëfarë kohe.²¹⁴⁷

862. Treni në të cilin kishte udhëtoi Emin Kabashi gjithashtu ndaloi në Han të Elezit, prej ku i urdhëruan njerëzit të ecnin nëpër hekurudhë sepse zona ishte minuar në të dyja anët.²¹⁴⁸ Kabashi mbërriti në Bllacë dhe pa se atje ishin shumë njerëz të tjerë. Ai qëndroi në Bllacë gjashtë ditë e gjashtë net, duke pritur familjen e tij që të vinte nga Prishtina. Çdo ditë pa autobusë dhe trena duke ardhur dhe duke sjellë më shumë njerëz.²¹⁴⁹ Kur mbërriti familja e Kabashit, ata u nisën së bashku në autobus dhe shkuan në Shqipëri me ndihmën e Kryqit të Kuq.²¹⁵⁰ Dëshmia e Antonio Russo-s në lidhje me udhëtimin me tren për në Bllacë ishte tejet e ngjashme me dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë.²¹⁵¹

863. Pasi K14-a u dëbua nga qyteti i Prishtinës në fund të marsit 1999, ajo u kthye në qytet pas dy ditësh. Sidoqoftë, meqenëse e kishte përdhunuar një polic, i cili i kishte thënë se do të kthehej përsëri (lexo më poshtë), ajo u largua nga qyteti në këmbë gjatë natës nga fundi i majit 1999 së bashku me familjen e saj dhe mbërriti në stacionin hekurudhor të Fushë-Kosovës rreth orës 07:00. Në stacion kishte shumë njerëz. Meqenëse nuk kishte vend për të gjithë, vetëm një pjesë e familjes së saj ishte në gjendje të hipte në trenin e parë që kishte mbërritur. Sikurse edhe dëshmitarët të

²¹⁴³ Nazlie Bala, T. 2189–2190 (23 gusht 2006), P2262 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 qershor 2001), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8.

²¹⁴⁴ K63, P2443 (deklarata e dëshmitarit e datës 28 maj 2003), para. 36–37.

²¹⁴⁵ K62, T. 2278 (24 gusht 2006).

²¹⁴⁶ K63, T. 2233, 2237 (23 gusht 2006), P2443 (deklarata e dëshmitarit e datës 28 maj 2003), para. 38, 41.

²¹⁴⁷ K62, T. 2278 (24 gusht 2006).

²¹⁴⁸ Emin Kabashi, T. 2102 (22 gusht 2006), P2250 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 prill 1999), f. 5.

²¹⁴⁹ Emin Kabashi, P2250 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 prill 1999), f. 5–6.

²¹⁵⁰ Emin Kabashi, P2250 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 prill 1999), f. 6.

përmendur më lart, K14-a mbërriti në Bllacë ku kaloi natën para se të lejohej të kalonte në Maqedoni.²¹⁵²

864. Baton Haxhiu gjithashtu udhëtoi për në Maqedoni pas dëbimit nga Prishtina më 2 prill 1999. Ai dëshmoi se iu bashkua një kolone makinash që shkonte për në Tetovë. Në kufi, kolona ishte mbi 15 kilometra e gjatë dhe përfshinte mijëra të shpërngulur.²¹⁵³ Haxhiu kaloi katër ditë në kufi para se të lejohej të kalonte në Maqedoni. Të tjerët u detyruan të prisnin edhe më gjatë që të kalonin sepse autoritetet maqedonase fillimisht nuk i lejuan të hynin.²¹⁵⁴

865. Në kundërshtim me të gjithë këto dëshmi, Millutin Filipoviqi dëshmoi se njerëzit u larguan nga qyteti i Prishtinës pikërisht para fillimit të sulmeve ajrore të NATO-s nga frika e bombardimeve dhe se kjo vazhdoi në masë më të vogël gjatë tërë fushatës.²¹⁵⁵ Largimi nga Prishtina u intensifikua pas bombardimit të qendrës së Prishtinës më 7 prill, ku u bombarduan objekte kyçe, si transformatori dhe ujësjellësi që furnizonte qytetin me ujë, dhe u dëmtuan objektet e tjera, si ato të komunikimit. Njerëzit ishin në panik sepse linjat telefonike ishin ndërprerë.²¹⁵⁶ Ai pa kolona civilësh duke lëvizur nëpër qytet, që vinin nga disa drejtime, sidomos nga drejtimi i Lupçit të Poshtëm dhe nga Grashtica. Sidoqoftë, ai mendoi se ata bënë sikur po largoheshin. Ata krijuan kolona me qëllim që "terroristët" të cilët donin të fshiheshin, të mund të bashkoheshin dhe të iknin para se t'i vrisnin forcat e RFJ-së/Serbisë. Sipas Filipoviqit, ishte "imitim i emigrimit."²¹⁵⁷

866. Edhe drejtori i Qendrës së Medias në Prishtinë, Millivoje Mihajloviq, i cili banonte në Fushë-Kosovë, dëshmoi se, disa ditë para se të fillonin bombardimet e NATO-s, shumë "serbë" filluan t'i dërgonin familjet në Serbi, Maqedoni, ose Hungari. Me të filluar bombardimet e NATO-s, shqiptarët kosovarë filluan të largoheshin në grupe të mëdha nga qyteti i Prishtinës, kurse serbët vazhduan të largoheshin.²¹⁵⁸ Ai e dërgoi familjen e vet në Kopaonik pas bombardimit të postës, "duke menduar se atje ishte më sigurt."²¹⁵⁹ Gjithashtu, Mihajloviqi dëshmoi se "kishte shumë konfuzion. Frika nga bombat, frika nga UÇK-ja, shqiptarët kishin frikë nga policia dhe ushtria që

²¹⁵¹ Antonio Russo, P2261 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 6–7.

²¹⁵² K14, P2643 (deklarata e dëshmitarit e datës 31 maj 1999), f. 7 (e mbyllur me vulë).

²¹⁵³ Baton Haxhiu, T. 6092–6093 (8 nëntor 2006), P2479 (transkript nga *Prokurori kundër Milloseviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 5419–5420.

²¹⁵⁴ Baton Haxhiu, T. 6091, 6093 (8 nëntor 2006).

²¹⁵⁵ Millutin Filipoviq, T. 19194–19195 (28 nëntor 2007).

²¹⁵⁶ Millutin Filipoviq, T. 19192 (28 nëntor 2007).

²¹⁵⁷ Millutin Filipoviq, T. 19193 (27 nëntor 2007).

²¹⁵⁸ Millivoje Mihajloviq, 6D1530 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 mars 2008), para. 32, 35.

²¹⁵⁹ Millivoje Mihajloviq, 6D1530 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 mars 2008), para. 35.

luftonin kundër UÇK-së... Në atë kaos pati plaçkitje dhe vrasje."²¹⁶⁰ Ai theksoi se, edhe pse shumicën e mbrëmjeve në mars dhe prill 1999 ndodhej në Prishtinë, ai nuk pa civilë që i dërgonin në drejtim të stacionit hekurudhor. Sidoqoftë, ai i pa "duke shkuar" në drejtim të stacionit hekurudhor të Fushë-Kosovës dhe në stacionin e autobusëve në qytetin e Prishtinës.²¹⁶¹

867. SD3-shi dëshmoi se gjatë bombardimeve të NATO-s pa kolona "refugjatësh" duke u larguar nga Prishtina dhe duke shkuar në drejtim të Maqedonisë. Sidoqoftë, në atë kohë u larguan edhe serbë dhe joshqiptarë të tjerë që shkuan për në Serbi. SD3-shi pretendoi se nuk e dinte nëse dikush i detyroi këta njerëz të largoheshin nga shtëpitë e tyre,²¹⁶² por e hodhi poshtë pretendimin se forcat e MPB-së dhe/ose të UJ-së ishin përgjegjëse për largimin e kolonave, meqë njerëzit "lëviznin me vullnetin e tyre."²¹⁶³ Më tej SD3-shi shtoi se pa numrin më të madh të njerëzve që largoheshin nga Prishtina në gjysmën e dytë të prillit, "pas bombardimit të postës."²¹⁶⁴

868. Oficeri i RDB-së, Lubivoje Joksiqi, gjithashtu dëshmoi se pa kolona shqiptarësh kosovarë duke lëvizur në drejtim të hekurudhës dhe stacionit të autobusëve në Prishtinë për t'u larguar nga Kosova, por tha se nuk kishte parë askënd duke i detyruar apo urdhëruar ta bënin këtë.²¹⁶⁵ Përkundrazi, në fillim të prillit ai mori një telefonatë nga Rade Markoviqi, shefi i atëhershëm i RDB-së, që e urdhëronte të "përpiqej të bënte gjithçka që të parandalonte këto ikje."²¹⁶⁶ Sidoqoftë, përpjekjet e tij ishin të pasuksesshme, meqë ai nuk ishte në gjendje të ndalte njerëzit që të shkonin në Shqipëri ose në Maqedoni.²¹⁶⁷

869. Emin Kabashi, i cili tha qartë se ai nuk kishte dashur të largohet nga Kosova, por u detyrua ta bënte këtë nga veprimet dhe fjalët e policisë serbe dhe të UJ-së, deklaroi se atij nuk i ishte dhënë apo ofruar ndonjë asistencë apo ndihmë humanitare nga autoritetet jugosllave.²¹⁶⁸ Nga ana e tij Millutin Filipoviqi dëshmoi se ai ndihmoi disa njerëz që largoheshin nga Prishtina nga frika e bombardimeve të NATO-s në përputhje me kërkesat e komandantit të Korpusit të Prishtinës për të ndihmuar civilët.²¹⁶⁹

²¹⁶⁰ Millivoje Mihajllloviq, 6D1530 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 mars 2008), para. 36.

²¹⁶¹ Millivoje Mihajllloviq, T. 24080 (11 mars 2008).

²¹⁶² SD3, T. 20827 (22 janar 2008) (seancë private), 5D1444 (deklarata e dëshmitarit e datës 27 dhjetor 2007), para. 9-10.

²¹⁶³ SD3, T. 20821–20825 (22 janar 2008).

²¹⁶⁴ SD3, T. 20821 (22 janar 2008).

²¹⁶⁵ Lubivoje Joksiq, T. 22051–22052, 22054–22055 (11 shkurt 2008).

²¹⁶⁶ Lubivoje Joksiq, T. 22052 (11 shkurt 2008).

²¹⁶⁷ Lubivoje Joksiq, T. 22052 (11 shkurt 2008).

²¹⁶⁸ Emin Kabashi, P2250 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 prill 1999), f. 6.

²¹⁶⁹ Millutin Filipoviqi, T. 19259–19262 (28 nëntor 2007).

870. Mbrojtja e Llukiqit paraqiti dëshmi nga Miomir Bogosavleviqi për të kundërshtuar dëshmitarët që dëshmuuan për dëbimin e tyre nga Prishtina me tren. Ai shpjegoi se zyra e tij ekzistonte "për të garantuar siguri për udhëtarët, për të parandaluar shkeljen e ligjit dhe kryerjen e krimeve... dhe për të ndihmuar punëtorët e hekurudhës në tren."²¹⁷⁰ Kur u pyet se a kishte ofruar UJ-ja "siguri për hekurudhën dhe drejtimit në territorin e Kosovës," ai u përgjigj thjesht "jo".²¹⁷¹ Bogosavleviqi dëshmoi se zyra policore në stacionin hekurudhor në Fushë-Kosovë duhej të kishte 66 policë, por gjatë kohës që ka lidhje me Aktakuzën ishin vetëm 37 dhe ky numër nuk ndryshoi gjatë bombardimeve të NATO-s.²¹⁷² Në çdo tren ishte nga një patrullë e përbërë nga dy policë: ata qëndronin në tren deri në momentin që treni mbërrinte në vendin e paracaktuar.²¹⁷³ Nga 29 marsi deri më 15 prill, disa nga patrullat policore në trena, sidomos ata që kishin nga 12 deri 15 vagonë, u përforcuan, kështu që mund të ketë pasur deri në gjashtë policë në çdo tren.²¹⁷⁴ Ai gjithashtu shoi se nuk kishte marrë asnjë kallëzim penal për veprime kriminale të policëve të tij gjatë vitit 1999.²¹⁷⁵

871. Më tej Bogosavleviqi shpjegoi se, pas fillimit të bombardimit, trenat për në Maqedoni ndaluan në kufi.²¹⁷⁶ Më 24 mars, dhe katër ose pesë ditët në vijim, " asnjë tren nuk u nis nga Prishtina apo Fushë-Kosova për në Maqedoni,"²¹⁷⁷ sepse nuk kishte makinistë të trenave.²¹⁷⁸ Ai pranoi se nga 29 marsi kishte "trena specialë" që shkonin një herë apo dy herë në ditë, përveç trenave të rregullt, për shkak të numrit të madh të njerëzve që largoheshin;²¹⁷⁹ nga 31 marsi deri më 2 prill mund të ketë pasur dy apo tre trena specialë në ditë që niseshin nga Prishtina.²¹⁸⁰ Sidoqoftë, ai mohoi se mund të kenë qenë mijëra veta në ata trena, duke shpjeguar se një tren me 10 vagonë mund të merrte më së shumti 1.000 njerëz.²¹⁸¹

872. Në dy raste gjatë periudhës 29 mars-15 prill, Bogosavleviqi mori trena për në Han të Elezit, të cilët ishin plot, kryesisht me shqiptarë kosovarë. Në tren ishte vetëm "patrulla policore"; nuk kishte pjesëtarë të UJ-së. Sidoqoftë kur trenat mbërritën në Han të Elezit, ai pa njerëz duke ecur përgjatë hekurudhës në drejtim të kufirit," dhe atje kishte pjesëtarë të UJ-së. Ai nuk e dinte nëse ata

²¹⁷⁰ Miomir Bogosavleviq, T. 23847 (6 mars 2008).

²¹⁷¹ Miomir Bogosavleviq, T. 23864 (7 mars 2008).

²¹⁷² Miomir Bogosavleviq, T. 23844–23846 (6 mars 2008), 23866, 23869 (7 mars 2008).

²¹⁷³ Miomir Bogosavleviq, T. 23847 (6 mars 2008), 23869 (7 mars 2008).

²¹⁷⁴ Miomir Bogosavleviq, T. 23875 (7 mars 2008).

²¹⁷⁵ Miomir Bogosavleviq, T. 23851 (6 mars 2008).

²¹⁷⁶ Miomir Bogosavleviq, T. 23852 (6 mars 2008).

²¹⁷⁷ Miomir Bogosavleviq, T. 23862 (7 mars 2008).

²¹⁷⁸ Miomir Bogosavleviq, T. 23863 (7 mars 2008).

²¹⁷⁹ Miomir Bogosavleviq, T. 23873–23874 (7 mars 2008).

²¹⁸⁰ Miomir Bogosavleviq, T. 23881 (7 mars 2008).

²¹⁸¹ Miomir Bogosavleviq, T. 23873–23874 (7 mars 2008).

po i drejtonin njerëzit apo jo.²¹⁸² Bogosavleviqi e hodhi poshtë pretendimin se në fund të marsit dhe në fillim të prillit disa trena kaluan nëpër stacionin hekurudhor të Ferizajt pa u ndalur për t'i dërguar shqiptarët kosovarë përtej kufirit.²¹⁸³ Ai gjithashtu nuk pranoi se trenat ishin "të tejmbushur" me njerëz.²¹⁸⁴

873. Dhoma Gjyqësore nuk është bindur nga orvatjet e Bogosavleviqit për të përgënjeshtuar dëshmitë përputhëse të dëshmitarëve okularë në lidhje me mënyrën e transportimit të tyre në Maqedoni. Ai pranoi se shumë njerëz u larguan nga Prishtina me tren dhe se ai vetëm dy herë kishte hipur në tren deri në Maqedoni. Gjithashtu, Dhoma nuk e pranon pretendimin e Mbrojtjes së Llukiqit se fakti që Kabashi mundi të qëndronte në stacionin hekurudhor në Prishtinë për tri ditë para se të hipte në tren tregon se njerëzit u larguan nga Prishtina vullnetarisht.²¹⁸⁵

b. Dhuna seksuale

874. Tri dëshmitare dëshmuan në lidhje me dhunën seksuale që pësuan në Prishtinë në prill dhe maj 1999. K62-shi, K14-a, dhe K31-shi, të gjitha gra shqiptare kosovare, rrëfyan në hollësi për vuajtjet e tyre në duart e ushtarëve dhe policëve serbë, që nuk u kundërshtuan në thelb nga Mbrojtja. Dhoma konkludon se dëshmitë e tyre ishin të besueshme dhe sakta.

875. K62-shi dëshmoi se më 1 prill 1999 ndodhej vetëm në shtëpi kur erdhën tre persona me uniforma kamuflimi të gjelbra dhe "me kapela dhe maska në fytyrë."²¹⁸⁶ Dy nga ata filluan të bastisnin apartamentin, kurse i treti e hodhi K62-shin në dysHEME dhe e përdhunoi. Pastaj e përdhunoi i dyti, kurse i treti ia futi penisin në gojë.²¹⁸⁷ Pas largimit të këtyre personave, K62-shi arriti të kontaktonte burrin me ndihmën e një fqinji dhe ai u kthye në shtëpi menjëherë. Ata qëndruan në apartamentin e tyre edhe dy net të tjera pas incidentit derisa u dëbuan nga shtëpia më 3 prill 1999 siç është përshkruar më lart. Më pas ajo takoi një grua e cila i kishte thënë se e njëjta gjë u kishte ndodhur shumë grave të tjera në Prishtinë në atë kohë.²¹⁸⁸ K63-shi e mbështeti pjesërisht dëshminë e gruas së tij. Edhe pse nuk ishte i pranishëm gjatë përdhunimit të saj dhe nuk i pa

²¹⁸² Miomir Bogosavleviq, T. 23871 (7 mars 2008).

²¹⁸³ Ai tha se "çdo tren duhej të ndalonte në këto stacione." Miomir Bogosavleviq, T. 23885 (7 mars 2008).

²¹⁸⁴ Miomir Bogosavleviq, T. 23885 (7 mars 2008).

²¹⁸⁵ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 1039.

²¹⁸⁶ K62, T. 2274–2275 (24 gusht 2006) (seancë private).

²¹⁸⁷ K62, T. 2271–2272, 2274 (24 gusht 2006) (seancë private).

²¹⁸⁸ K62, T. 2274–2275 (24 gusht 2006) (seancë private).

përdhunuesit, ai e kishte dëgjuar rrëfimin e saj menjëherë sapo kishte ndodhur dhe i tregoi Dhomës se çfarë kishte thënë ajo.²¹⁸⁹ Rrëfimi i tij ishte i ngjashëm me dëshminë e saj në gjykatë.

876. Në maj 1999 K14-a ishte në mes të adoleshencës së saj kur u përdhunua në Prishtinë. Megjithëse pjesë të dëshmisë së saj në lidhje me incidentin janë kontradiktore, duke marrë parasysh moshën e saj dhe natyrën e traumës së pësuar, si dhe kalimin e kohës, Dhoma gjykon se kjo është tërësisht e kuptueshme dhe e konsideron dëshminë e saj përgjithësisht të besueshme.

877. K14-a tregoi në fund të majit 1999 një grup policësh shkuan në shtëpinë e saj. Ata kishin uniforma kamuflimi të kaltra dhe të gjelbra me shirita të kaltër të lidhur në krahun e djathtë.²¹⁹⁰ Të nesërmen dy nga policët u kthyen së bashku me një person vendës, të cilin ajo e njihte dhe i cili ishte me uniformë policie.²¹⁹¹ K14-a dëgjoji kur u përmend emri i njërit prej policëve. Të tre burrat flisnin serbisht dhe dy prej tyre dinin pak shqip.²¹⁹² Policët i çuan K14-ën dhe motrën e saj në një makinë të parkuar jashtë. Gjithsesi motrën e lejuan të kthehej në shtëpi para se të nisej makina.²¹⁹³ K14-ën e futën në ulësen e pasme me njërin nga policët, i cili e goditi në ije me kondakun e pushkës. Ai gjithashtu e goditi me shpullë në fytyrë, e kafshoi në qafë dhe ia spërkati fytyrën me një lëng pa ngjyrë nga një shishe plastike e tejdukshme. Pas pesë minutash, ajo u ndje e shtendosur dhe filloi të qeshte.²¹⁹⁴ Dhoma Gjyqësore konkludon se, megjithëse ka prova dokumentare që sugjerojnë se disa forca policore në Kosovë u udhëzuan të mbanin shirita të kuq e jo të kaltër në atë datë, kjo nuk e ndryshon konkluzionin e saj se K14-a paraqiti dëshmi të besueshme të incidentit dhe ishte në gjendje të identifikonte keqbërësit si policë.²¹⁹⁵

878. Në Hotel Bozhur në qendër të Prishtinës, K14-ën e çuan përmes bodrumit në një dhomë në katin e dytë, ku njëri nga policët e përdhunoi. Polici tjetër qëndroi jashtë.²¹⁹⁶ Më pas, ai i cili e përdhunoi i tha se nuk do ta linte policin tjetër brenda nëse do t'i premtonte se do të kthehej përsëri të hënën dhe nëse do ta sillte motrën e saj për shokun e tij. K14-a pranoi sepse donte të largohej.²¹⁹⁷

²¹⁸⁹ K63, T. 2231 (23 gusht 2006), P2443 (e datës 27–28 maj 2003), para. 27–31.

²¹⁹⁰ K14, T. 10981–10982 (2 mars 2007) (seancë e mbyllur), P2643 (deklarata e dëshmitarit e datës 31 maj 1999), f. 4 (e mbyllur me vulë).

²¹⁹¹ K14, T. 10981–10982 (2 mars 2007) (seancë e mbyllur).

²¹⁹² K14, T. 10984, 10994 (2 mars 2007) (seancë e mbyllur), P2643 (deklarata e dëshmitarit e datës 31 maj 1999), f. 4 (e mbyllur me vulë).

²¹⁹³ K14, T. 10985–10986 (2 mars 2007) (seancë e mbyllur), P2644 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 1429 (e mbyllur me vulë), P2643 (deklarata e dëshmitarit e datës 31 maj 1999), f. 5 (e mbyllur me vulë).

²¹⁹⁴ K14, P2643 (deklarata e dëshmitarit e datës 31 maj 1999), f. 5 (e mbyllur me vulë).

²¹⁹⁵ 6D579 (Udhëzime për policinë në maj 1999). *Shih gjithashtu* Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 1064.

²¹⁹⁶ K14, P2643 (deklarata e dëshmitarit e datës 31 maj 1999), f. 5–6 (e mbyllur me vulë).

²¹⁹⁷ K14, P2643 (deklarata e dëshmitarit e datës 31 maj 1999), f. 6 (e mbyllur me vulë).

Në makinë gjatë rrugës për në shtëpinë e saj, ai vazhdoi ta kujtonte që të kthehej të hënën.²¹⁹⁸ Kur u kthye në shtëpi, ajo i tregoi një shoqeje se çfarë i kishte ndodhur. Shoqja e saj i tha se e njëjta gjë i kishte ndodhur edhe asaj dhe se e kishin çuar në një shtëpi civile ku e kishin përdhunuar katër burra, që e kishin sjellë në shtëpi pas dy ditësh.²¹⁹⁹ K14-a shtoi se të nesërmen personi vendës i cili i kishte shoqëruar policët një ditë më parë, erdhi përsëri në shtëpinë e saj dhe i tha të mos brengosej se nuk do të mbeste shtatzënë dhe se, nëse kishte frikë, mund të rrinte në shtëpinë e tij. Po atë ditë dhe të nesërmen, polici i cili e kishte përdhunuar dhe tjetri që nuk e kishte përdhunuar, kaluan me makinë pranë shtëpisë së saj disa herë duke i rënë borisë. Në orën 04:00 të hënën tjetër, kur duhej të shkonte në hotel, K14-a dhe familja e saj u larguan nga Prishtina në këmbë, siç është përshkruar më lart.²²⁰⁰

879. Në maj 1999, K31-shi, femër shqiptare kosovare nga komuna e Kaçanikut, ishte në moshën 16-18 vjeçare kur e përdhunuan tre "ushtarë serbë" në spitalin e qytetit të Prishtinës.²²⁰¹ Nga fundi i majit 1999, atë dhe vëllain e saj të lënduar i dërguan nga komuna e Kaçanikut në spitalin e qytetit të Prishtinës. K31 dëshmoi se gjatë rrugës një ushtar e dhunoi seksualisht në makinë.²²⁰²

880. Kur mbërritën në spital në Prishtinë, K31-shin e çuan në bodrum dhe e futën në një dhomë të errët të kyçur pa orendi, ku ishin edhe rreth 10-15 gra, të gjitha shqiptare kosovare. Rreth 20 minuta më vonë erdhi një ushtar me elektrik dore i cili zgjodhi K31-shin dhe e çoi në një dhomë tjetër në bodrum.²²⁰³ Ai dhe dy ushtarë të tjerë e rrahën dhe e detyruan të pinte diçka me shije të hidhur dhe pastaj ajo u ndje sikur të ishte goditur në kokë.²²⁰⁴ Pasi dy ushtarë u larguan nga dhoma, K31-shin e përdhunuar ushtari që e kishte përzgjedhur në fillim; ai i kafshoi supet, krahët dhe gjinjat dhe ia mbylli gojën me dorë.²²⁰⁵ Ndërsa K31-shi ishte ende në dysheme, një ushtar tjetër erdhi në dhomë dhe e përdhunoi dy herë.²²⁰⁶ Pas kësaj, ky ushtar ftoi të tretin në dhomë. Më pas K31-shi humbi vetëdijen. Edhe ky ushtar mund ta ketë përdhunuar kur ajo dergjej pa ndjenja, por e vetmja gjë që i kujtohej pas kësaj ishte se kur u përmend ajo ishte lakuriq e shtrirë në shpinë në

²¹⁹⁸ K14, P2643 (deklarata e dëshmitarit e datës 31 maj 1999), f. 6 (e mbyllur me vulë).

²¹⁹⁹ K14, P2643 (deklarata e dëshmitarit e datës 31 maj 1999), f. 6-7 (e mbyllur me vulë).

²²⁰⁰ K14, P2643 (deklarata e dëshmitarit e datës 31 maj 1999), f. 7 (e mbyllur me vulë).

²²⁰¹ K31, T. 9244 (25 janar 2007) (seancë e mbyllur), P2596 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 mars 2002), f. 5-6 (e mbyllur me vulë).

²²⁰² K31, T. 9251-9253 (25 janar 2007) (seancë e mbyllur), P2596 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 mars 2002), f. 2-3 (e mbyllur me vulë), P2595 (deklarata e dëshmitarit e datës 16 tetor 1999), f. 3-4 (e mbyllur me vulë); *kr.* K31, T. 9241 (25 janar 2007) (seancë e mbyllur), P2597 (transkriptim nga *Prokurorja kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 8158-8160 (e mbyllur me vulë).

²²⁰³ K31, T. 9254, 9256-9257 (25 janar 2007) (e mbyllur me vulë), P2596 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 mars 2002), f. 4 (e mbyllur me vulë).

²²⁰⁴ K31, P2596 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 mars 2002), f. 4 (e mbyllur me vulë).

²²⁰⁵ K31, P2596 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 mars 2002), f. 4-5 (e mbyllur me vulë).

²²⁰⁶ K31, P2596 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 mars 2002), f. 5 (e mbyllur me vulë).

dhomën e zbrazët. Kur më në fund u ngrit në këmbë, ajo u largua nga dhoma dhe shkoi në katin e parë, i cili ishte i braktisur.²²⁰⁷

881. Më tej K31 gjeti vëllain në katin e pestë dhe u fsheh afër tij gati dy javë, sepse i kishin thënë se, nëse dilte nga spitali, nuk do ta lejonin të kthehej. Gjatë qëndrimit në spital, ajo pa policë dhe ushtarë me armë automatike. Ajo dhe vëllai i saj u larguan nga spitali në mes të qershorit 1999.²²⁰⁸

4. Fshatrat në komunën e Prishtinës

882. Përveç akuzave në lidhje me qytetin e Prishtinës, Aktakuza pretendon se forcat e RFJ-së dhe Serbisë hynë në fshatrat e komunës dhe keqtrajtuuan banorët shqiptarë kosovarë. Konkretisht pretendohet se shumë fshatarë u dërguan me kamionë në Gllogoc dhe prej aty me tren në Maqedoni. Prokuroria nuk ka paraqitur dëshmi për këtë pretendim konkret dhe shumë pak dëshmi janë dëgjuar në lidhje me ngjarjet në fshatrat e komunës gjatë fushatës së NATO-s.

883. K14-a paraqiti dëshmi në lidhje me dëbimin e parë të familjes së saj në fund të marsit 1999 nga shtëpia e tyre në qytetin e Prishtinës.²²⁰⁹ Ajo përmendi granatimin dhe krismat e pushkëve në fshatin e afërt nëpër të cilin kaloi.²²¹⁰ K14-a dhe familja e saj vendosën të ktheheshin në Prishtinë për shkak të granatimeve dhe të shtënave në atë zonë. Gjatë rrugës për në Prishtinë, K14-a pa policë duke vjedhur makina të shqiptarëve kosovarë në kolonë në të cilën udhëtonte.²²¹¹ Ajo dhe familja e saj u kthyen në Prishtinë në fillim të prillit dhe qëndruan aty deri në fund të majit 1999, siç është përshkruar më lart.²²¹²

884. Përveç këtyre dëshmive, Dhoma dëgjoi nga K73-shi se më 24 maj 1999 njësia e tij u dislokua në fshatin Graçanicë, në jug të qytetit, për rreth një javë.²²¹³ K73-shi dëshmoi se ai ishte atje me njësinë e tij gjatë një periudhe të bombardimeve të NATO-s dhe se fshati ishte braktisur më herët.²²¹⁴ Sidoqoftë, Millutin Filipoviç i cili dëshmoi se Graçanica ishte fshati më i madh në

²²⁰⁷ K31, P2596 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 mars 2002), f. 5–6 (e mbyllur me vulë).

²²⁰⁸ K31, P2596 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 mars 2002), f. 6 (e mbyllur me vulë), P2595 (deklarata e dëshmitarit e datës 16 tetor 1999), f. 5 (e mbyllur me vulë).

²²⁰⁹ K14, T. 10970 (2 mars 2007) (seancë e mbyllur), P2643 (deklarata e dëshmitarit e datës 31 maj 1999), f. 3 (e mbyllur me vulë).

²²¹⁰ K14, P2643 (deklarata e dëshmitarit e datës 31 maj 1999), f. 3 (e mbyllur me vulë).

²²¹¹ K14, P2643 (deklarata e dëshmitarit e datës 31 maj 1999), f. 4 (e mbyllur me vulë).

²²¹² K14, P2643 (deklarata e dëshmitarit e datës 31 maj 1999), f. 4, 7 (e mbyllur me vulë).

²²¹³ K73, T. 3336, 3358–3359 (13 shtator 2006) (seancë e mbyllur), P2440 (deklarata e dëshmitarit), para. 35–36, 49; *Shih gjithashtu* Millutin Filipoviç, T. 19162 (27 nëntor 2007); Mirko Starçeviç, T. 17435–17436 (22 tetor 2007); Vladimir Llazareviç, T. 17916, 17960 (8 nëntor 2007).

²²¹⁴ K73, T. 3375 (14 shtator 2006) (seancë e mbyllur).

Kosovë i banuar me serbë,²²¹⁵ tha se jeta në fshat gjatë bombardimeve ishte relativisht normale, përveç faktit se pati shumë bombardime të objekteve ushtarake shumë afër fshatit, që i shqetësuan qytetarët.²²¹⁶ Gjithashtu Filipoviqi shtoi se shërbesat fetare mbaheshin rregullisht në xhaminë e qytetit, e cila mbeti e padëmtuar dhe se madje pleqësia e fshatit pranoi refugjatë “shqiptarë” nga fshatrat përreth.²²¹⁷

5. Konkluzione

885. Dhoma Gjyqësore konkludon se duke filluar nga 24 marsi 1999, një numër i madh i shqiptarësh kosovarë u dëbuan nga qyteti i Prishtinës. Shumë nga këta njerëz u transportuan me tren – ose shkuan vetë – në Maqedoni. Disa prej tyre u dëbuan nga shtëpitë e tyre nga UJ-ja, MPB-ja, dhe forcat e tjera të armatosura, kurse të tjerët u larguan për shkak të atmosferës së frikës që mbretëronte në qytet krijuar nga dëbimet e dhunshme të fqinjëve të tyre dhe nga kërcënimet, vrasjet, rrahjet, dhe veprimet e tjera të frikësimit të kryera nga këto forca.

886. Dhoma dëgjoi nga disa dëshmitarë të ftuar nga Mbrojtja se qytetarët shqiptarë kosovarë ikën nga qyteti për shkak të sulmeve ajrore të NATO-s.²²¹⁸ Dhoma gjithashtu dëgjoi dëshmi se mediat në Shqipëri u bënë thirrje shqiptarëve kosovarë të largoheshin nga shtëpitë dhe se thirrjet propagandistike – kryesisht përmes fletushkave – u bënë vazhdimisht në qytetin e Prishtinës dhe rrethinë për t'i nxitur njerëzit të largoheshin nga Kosova gjatë bombardimeve të NATO-s.²²¹⁹ Mirëpo asnjë nga dëshmitarët shqiptarë kosovarë nuk dëshmoi se kishte dëgjuar ose parë transmetime apo propagandë të tillë ose se u larguan nga Prishtina për këto arsye. Në fakt, Mbrojtja madje as nuk sugjeroi diçka të tillë kur i pyeti.

887. Dhoma konkludon se, edhe pse bombardimet e objektivave në qytetin e Prishtinës dhe përreth prej NATO-s patën ndikim ndaj civilëve në qytet, për shembull ndërprerja e rrymës elektrike dhe ujit dhe dëmtimi i objekteve civile, kjo nuk është arsyeja e largimit të mijëra shqiptarëve kosovarë në ditët dhe javët pas fillimit të sulmeve ajrore. Në të vërtetë, shqiptarët kosovarë u dëbuan nga shtëpitë e tyre nga fjalët dhe veprimet e forcave të UJ-së dhe MPB-së dhe forcave të tjera që vepronin me to. Edhe nëse disa njerëz u larguan për shkak të luftimeve të UÇK-

²²¹⁵ Millutin Filipoviq, T. 19200 (28 nëntor 2007); *Shih gjithashtu* Sandra Mitchell, T. 559 (11 korrik 2006).

²²¹⁶ Millutin Filipoviq, T. 19200 (28 nëntor 2007).

²²¹⁷ Millutin Filipoviq, 19200–19201 (28 nëntor 2007).

²²¹⁸ *Shih, e.g.*, Millutin Filipoviq, T. 19181–19183 (27 nëntor 2007), T. 19194–19195 (28 nëntor 2007); SD3, T. 20821 (22 janar 2008), 5D1444 (deklarata e dëshmitarit e datës 27 dhjetor 2007), para. 9–10; Millivoje Mihajloviq, 6D1530 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 mars 2008), para. 32, 35; *Shih gjithashtu* Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 1047.

së, bombardimeve të NATO-s, ose për shkak të propagandës që i ftonë ata të largoheshin nga Kosova, kjo nuk ka ndikim në konkluzionet e Dhomës. Fakti se njerëzit mund të jenë kthyer në Prishtinë disa herë gjatë kësaj kohe siç pretendon Mbrojtja e Llazareviqit, gjithashtu nuk ndikon në konkluzionet e Dhomës Gjyqësore në lidhje me këtë aspekt.²²²⁰

888. Dhoma ka dëgjuar dëshmi përputhëse se UJ-ja, policia, civilët e armatosur serbë e forcat e tjera jo të rregullta vepruan së bashku në Prishtinë për të mundësuar dhe kontrolluar drejtimin e largimit të banorëve shqiptarë kosovarë. Operacione si këto nuk mund të kryhen pa planifikim dhe koordinim të konsiderueshëm. Rrjedhimisht Dhoma konkludon se dëbimi i popullatës shqiptare kosovare të qytetit u krye në mënyrë të organizuar, duke përdorur forcat dhe burimet nën kontrollin e institucioneve shtetërore të RFJ-së dhe Serbisë, duke përfshirë UJ-në, policinë, dhe shërbimin hekurudhor.

889. Dhoma gjithashtu konkludon se është provuar përdhunimi i tri grave gjatë operacionit për largimin e shumë shqiptarëve kosovarë nga qytetit i Prishtinës – K62-shi nga dy pjesëtarë të UJ-së ose të MPB-së, K14-a nga një polic, dhe K31-shi nga tre ushtarë të UJ-së.

890. Nuk ka dëshmi në mbështetje të pretendimeve në lidhje me keqtrajtimin dhe vrasjen e shqiptarëve kosovarë nga fshatrat e tjera të komunës së Prishtinës, largimin e shqiptarëve kosovarë dhe transportimin e tyre me kamion në Gllogoc në komunën e Lipjanit, prej nga morën trenin për në Han të Elezit dhe ecën deri në kufirin me Maqedoninë, ose lidhur me plaçkitjen dhe djegien e pronave në fshatrat e komunës së Prishtinës, siç pretendohet në paragrafin 72(g)(i) të Aktakuzës.

K. GJILANI

1. Akuzat në Aktakuzë

891. Aktakuza i ngarkon të Akuzuarit me përgjegjësi për tri kategori të ndryshme të krimeve kundër njerëzimit, që pretendohet se janë kryer në komunën e Gjilanit: dëbim, zhvendosje e dhunshme dhe përndjekje. Përndjekja pretendohet se ka ndodhur në formën e "shkatërrimit apo dëmtimit pa shkak të objekteve fetare të shqiptarëve kosovarë," përfshirë edhe dëmtimin dhe/ose shkatërrimin e xhamisë në Llashticë.²²²¹

²²¹⁹ Millutin Filipoviq, T. 19181–19183 (27 nëntor 2007), T. 19194–19195 (28 nëntor 2007); Millivoje Mihajllloviq, 6D1530 (deklarata e dëshmitarit e datës 6 mars 2008), para. 36.

²²²⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 231.

²²²¹ Aktakuza, para. 72(i) dhe 77(d). Aktakuza pretendon se "shtëpitë, dyqanet, dhe monumentet kulturore e fetare" ishin "djegur dhe shkatërruar," duke përfshirë dhe xhaminë në Llashticë.

892. Pretendimet konkrete janë dhënë në paragrafin 72(i) të Aktakuzës, si vijon:

Më 6 prill 1999 apo rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë hynë në fshatin Përlepnice dhe u dhanë urdhër banorëve që të largoheshin. Banorët u larguan dhe u përpoqën të hynin në një fshat tjetër, por i kthyen forcat e RFJ-së dhe të Serbisë. Më 13 prill 1999, banorët e Përlepnices përsëri u lajmëruan se fshati duhej të zbrazej deri të nesërmen. Në mëngjesin e të nesërmes, banorët shqiptarë kosovarë u larguan në një kolonë prej afro 500 automjetesh. Pak pas largimit të banorëve, shtëpive në Përlepnice iu vu zjarri nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë. Në tërë komunën e Gjilanit, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë sistematikisht dogjën dhe shkatërruan shtëpi, dyqane, monumente kulturore dhe objekte fetare të shqiptarëve të Kosovës, duke përfshirë një xhami në Llashticë. Shqiptarët kosovarë në fshatra të tjera në komunën e Gjilanit gjithashtu u dëbuan nga shtëpitë e tyre. Mijëra njerëz të shpërngulur nga fshatrat si Zhegër, Nosalë dhe Lladovë kërkuan strehim në fshatin Stubëll e Poshtme në komunën e Vitisë. Shumë prej këtyre njerëzve të shpërngulur nga Gjilani kaluan kufirin e Kosovës me Serbinë, ku pësuan keqtrajtime të ngjashme me ato që kishin përjetuar në Kosovë, para se të hynin në Maqedoni. Të tjerët shkuan drejt në Maqedoni. Kur shqiptarët kosovarë erdhën në kufirin me Maqedoninë, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë u konfiskuan letërnjoftimet.²²²²

2. Rrethanat

893. Komuna e Gjilanit gjendet në Kosovën juglindore. Qyteti kryesor në komunë gjithashtu quhet Gjilan dhe gjendet në qendër të komunës.²²²³ Përlepnica gjendet rreth shtatë kilometra në verilindje të qytetit të Gjilanit dhe është e rrethuar me kodra dhe male.²²²⁴ Në vitin 1999, ajo kishte 3.000 banorë, shumica e të cilëve ishin shqiptarë kosovarë me pak familje rome dhe serbe.²²²⁵ Lladova është në pjesën jugore të komunës, rreth 10 kilometra në jug të qytetit të Gjilanit, në drejtim të Maqedonisë. Llashtica dhe Nosala janë afër dhe në lindje dhe perëndim të Lladovës, kurse Zhegra është një kilometër në jug të Lladovës.²²²⁶ Në vitin 1999, Zhegra kishte rreth 4.000 banorë, shumica prej të cilëve shqiptarë kosovarë, por edhe disa familje serbe.²²²⁷

894. Dhoma Gjyqësore dëgjoi dëshmi nga Abdylhaqim Shaqiri, Qamil Shabani, dhe dëshmitari K81, të paraqitur nga Prokuroria, në lidhje me krimet që pretendohet se janë kryer në komunën e Gjilanit. Mbrojtja paraqiti, ndër të tjerë Bozhidar Deliqin, Franjo Gllonçakun, dhe Dushan Gavraniqin për të dëshmuar për gjendjen në komunë dhe për ngjarjet e atjeshme. Dhoma gjykon se Shaqiri, Shabani, dhe K81-shi ishin përgjithësisht të besueshëm dhe të saktë duke marrë parasysh përputhshmërinë e gjerë të dëshmive të tyre në lidhje me ngjarjet në të cilat ishin dëshmitarë dhe i përjetuan në atë kohë si dhe duke marrë parasysh përshtypjen që Dhoma krijoi për ta në gjyq, duke

²²²² Aktakuza, para. 72(i).

²²²³ P615 (Atlasi i Kosovës).

²²²⁴ Abdylhaqim Shaqiri, 4D6 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 qershor 2001), f. 2.

²²²⁵ Abdylhaqim Shaqiri, 4D4 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 prill 1999), f. 2, 4D6 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 qershor 2001), f. 2, 4D10 (deklarata e shkruar me dorë e datës tetor 1999), f. 13, T. 2770, 2915–2917 (5 shtator 2006).

²²²⁶ P615 (Atlasi i Kosovës); K81, T. 7079 (21 nëntor 2006).

theksuar se pati vështirësi në lidhje me mënyrën se si Prokuroria e paraqiti dëshminë e K81-shit. Gjithashtu, dëshmia e Shaqirit në masë të madhe përputhej me dëshminë e Gavraniqit, i cili u ftua nga Mbrojtja e Llukiqit. Dhoma gjithashtu vëren se, edhe pse disa mospërputhje midis dëshmisë së Shaqirit dhe Shabanit u shqyrtuan gjatë pyetjeve nga mbrojtja, duke marrë parasysh shpjegimet e dhëna, Dhoma është bindur se ato nuk i bëjnë dëshmitë e tyre të pabesueshme në çështjet kryesore të diskutuara më poshtë. Në rast se një mospërputhje ka qenë jo e parëndësishme, Dhoma e ka hequr nga dëshmia atë pjesë të rrëfimit të dëshmitarit.²²²⁸ Dhoma gjithashtu konkludon se mund të mbështetet në pjesën më të madhe të dëshmisë së Dushan Gavriqit, por e hedh poshtë në disa pika të rëndësishme, siç shpjegohet më poshtë. Dhoma nuk krijoi përshtypje të mirë për Gllonçakun dhe e konsideron pjesën më të madhe të dëshmisë së tij të pabesueshme. Dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë që dëshmuuan në lidhje me gjendjen në komunë janë shqyrtuar kur ka qenë e nevojshme.

895. Ka dëshmi se në mars dhe prill 1999, Brigada e 175-të e Këmbëisorisë së UJ-së ishte dislokuar në komunën e Gjilanit dhe ishte e pranishme, për shembull, në fshatrat Zhegër dhe Lladovë.²²²⁹ Më 27 mars, Komanda e Qarkut Ushtarak të Prishtinës urdhëroi Detashmentin Ushtarak Territorial të Gjilanit të mbronte popullatën serbe dhe të ruante rrugët dhe objektet ushtarake në koordinim me Brigadën e 175-të të Këmbëisorisë, Brigadën e 78-të të Motorizuar, dhe forcat e MPB-së. Detashmenti i 58-të i Ushtarak Territorial, në koordinim me Brigadën e 52-të të Përzierë Artilerike, Brigadën e 175-të të Këmbëisorisë, dhe forcat e MPB-së u dislokua, ndër të tjera, në qytetin e Gjilanit dhe fshatin Kmetofc.²²³⁰

896. Bislim Zyrapi dëshmoi se Zona e Shtatë Operative e UÇK-së përfshinte zonën e komunës së Gjilanit.²²³¹ Sipas një harte të shënuar nga Zyrapi që tregon zonat e kontrolluara nga UÇK-ja dhe drejtimet e sulmeve nga "forcat serbe" në fund të marsit 1999, Gjilani nuk ishte ndër zonat e

²²²⁷ Qamil Shabani, P2263 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 qershor 2001), f. 2, P2264 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 1513, P2280 (shitesë e deklaratës së dëshmitarit të datës 27 gusht 2006), f. 2, T. 2699–2700 (1 shtator 2006). *Shih gjithashtu* Dushan Gavraniq, T. 22681 (18 shkurt 2008).

²²²⁸ *Shih, për shembull*, Abdyhaqim Shaqiri, T. 2930, 2933, 2938, 2940, 2973–2974 (7 shtator 2006), 4D10 (deklaratë e shkruar me dorë e datës 25 prill 1999), f. 10–11, 4D6 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 qershor 2001), f. 4.

²²²⁹ Franjo Gllonçak, 5D1395 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 dhjetor 2007), para. 4–5, T. 21133–21134 (25 janar 2008). *Shih gjithashtu* P407 (Libri i Kaltër i OSBE/KVM), f. 812.

²²³⁰ 6D1470 (Urdhër i Komandës së Qarkut Ushtarak të Prishtinës, 27 mars 1999), f. 5–6. *Shih gjithashtu* 5D545 (Raport luftimi i Brigadës së 175-të Këmbësorike, 21 prill 1999). *Shih gjithashtu* 4D349 (Urdhër i Komandës së Armatës së 3-të në lidhje me ndërrimin e vartësisë së Brigadës së 175-të Këmbësorike dërguar PrK-së, 14 prill 1999).

²²³¹ Bislim Zyrapi, T. 5934, 5967 (6 nëntor 2006); P2469 (hartë që tregon zonat e ndryshme operative të UÇK-së).

sulmuara në atë kohë.²²³² Sidoqoftë, disa dokumente tregojnë se në fillim të prillit 1999, UÇK-ja ishte aktive në pjesë të caktuara të komunës, për shembull, afër kufirit me Lipjanin.²²³³

897. Sipas një urdhri të Komandës së Përbashkët të datës 13 prill 1999, përqendrimi dhe aktiviteti luftarake i UÇK-së ishin shtuar në Vërbicë të Zhegofcit në fillim të prillit. Korpusi i Prishtinës mori urdhër që t'u jepte mbështetje forcave të MPB-së në zbrapsjen dhe shkatërrimin e UÇK-së në zonën e tyre të përgjegjësisë, kurse Brigada e 175-të Këmbësorike duhej të bllokonte Cërnicën, Kravaricën, dhe Ballancën dhe të mbështeste forcat e MPB-së përgjatë vijës së fshatrave Pasjak dhe Sllakovë e Epërme.²²³⁴ Një raport i Armatës së 3-të i datës 13 prill 1999 vëren se shumica e "terroristëve" ishin në trekëndëshin midis Muçibabës, Uglarës, dhe Pogragjes.²²³⁵ Gjithsesi këto fshatra, nuk janë të përfshirë në Aktakuzë si vende të pretenduara të krimeve.

898. Abdylhaqim Shaqiri, banor shqiptar kosovar i Përlepnicës dhe hoxhë i fshatit, dëshmoi se në fshatin e tij e as në tërë pjesën juglindore të Kosovës, duke përfshirë Gjilanin, Vitinë, dhe Kamenicën nuk kishte prani të UÇK-së.²²³⁶ Sidoqoftë, Dushan Gavraniqi, ish-shef i SPB-së së Gjilanit, deklaroi se UÇK-ja ishte e pranishme në Gjilan, edhe pse më vonë dëshmoi se në vitin 1998 në Gjilan nuk ndodhën "aksione terroriste"; kishte "terroristë," por ata nuk ishin aktivë si në zonat e tjera.²²³⁷

3. Përlepnica

899. Shaqiri dëshmoi se më 6 prill 1999, kur ishte në shtëpinë e nënës së tij në Përlepnicë, ai dëgjoi të shtëna armësh nga të gjitha anët dhe vendosi të hetonte.²²³⁸ Duke ecur rrugës kryesore, ai takoi një "ushtar" me uniformë "ngjyrë ulliri në të gjelbër dhe hirtë" dhe shami të zezë, i cili kishte ndaluar dy fshatarë në mes të rrugës.²²³⁹ Shaqiri e pyeti ushtarin se pse kishte dëgjuar të shtëna, e ai iu përgjigj se "ata" kishin marrë informacion se UÇK-ja ishte e pranishme në fshat dhe se fshati

²²³² P2447 (Hartë që tregon zonat në kontroll të UÇK-së), *kr.*, P1991 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 21 dhjetor 1998), f. 6.

²²³³ P1971 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 13 prill 1999); 5D1354 (Raport luftimi i Brigadës së 175-të Këmbësorike, 12 prill 1999). *Shih gjithashtu* 5D476 (Urdhër i PrK-së, 9 prill 1999); 3D822 (Raport luftimi dërguar Shtabit të Komandës së Lartë, 17 prill 1999), f. 3.

²²³⁴ P1971 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 13 prill 1999), f. 1–2, 4–5.

²²³⁵ 5D1310 (Raport i Komandës së Armatës së 3-të, 13 prill 1999), f. 3. Dhoma Gjyqësore vëren se në dokument përmendet fshati Pregragje e jo fshati Pogragje.

²²³⁶ Abdylhaqim Shaqiri, T. 2823 (5 shtator 2006).

²²³⁷ Dushan Gavraniq, T. 22738–22784 (19 shkurt 2008).

²²³⁸ Abdylhaqim Shaqiri, T. 2768, 2771–2772 (5 shtator 2006), T. 2836 (6 shtator 2006), 4D4 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 prill 1999), f. 2, 4D6 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 qershor 2001), f. 2; IC28 (hartë e shënuar e Gjilanit (P36)).

²²³⁹ Abdylhaqim Shaqiri, 4D4 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 prill 1999), f. 2, T. 2772–2773 (5 shtator 2006), T. 2837–2838, 2840–2843, 2847 (6 shtator 2006); 4D8 (faqe plotësuese me të dhëna e datës 28 gusht 2006), f. K0532301.

duhej të zbrazej që "ata" të luftonin kundër UÇK-së. Pastaj ushtari e urdhëroi Shaqirin që t'u thoshte të gjithëve të largoheshin nga fshati brenda dy orësh dhe të shkonin në drejtim të Ferizajt.²²⁴⁰

900. Shaqiri gjithashtu dëshmoi se në atë moment, në qendër të Përlepnicës ishin të pranishëm 10-15 ushtarë, të cilët nga një herë shtinin në ajër. Shumica prej tyre kishin armë automatike dhe kishin uniforma të njëjta SMB "ngjyrë ulliri në të gjelbër dhe hirtë", edhe pse një ose dy prej tyre kishin uniforma kamuflimi në ngjyrë të gjelbër-kaltër-verdhë.²²⁴¹ Shaqiri shpjegoi se uniformat SMB përdoreshin nga rezervistët ushtarakë.²²⁴² Duke u bazuar në dëshminë e Shaqirit, Dhoma Gjyqësore pranon se këta ushtarë ishin rezervistë të UJ-së dhe nuk ka shumë rëndësi se a ishin duke shërbyer në ushtri apo jo, duke marrë parasysh ngjarjet e 14 prillit 1999, në të cilat përfshirja e UJ-së është e qartë, siç diskutohet më poshtë.

901. Ndërsa i ftoi të gjithë të largoheshin nga Përlepnica përmes altoparllantit në minarenë e xhamisë, Shaqiri dëgjoi të shtëna armësh në fshat. Fshatarët dolën nga shtëpitë dhe u mbledhën në rrugë, njëra në lindje dhe tjetra në perëndim të fshatit. Shaqiri i priu grupit që u nis drejt perëndimit.²²⁴³ Pastaj ai u kthye te ushtari i cili "mbante peng dy fshatarët" dhe kërkoi të fliste me eprrorët që kishin dhënë urdhrin për zbrazjen e Përlepnicës. Ai e shoqëroi ushtarin deri në skaj të fshatit ku takoi tre oficerë, të cilit u paraqitën si oficerë të rregullt. Ata kishin veshur uniforma kamuflimi të gjelbra dhe të verdha me "rripa të ushtrisë së rregullt."²²⁴⁴ Shaqiri dëshmoi se foli serbisht me këta ushtarakë, të cilët nuk i kishte parë më parë, dhe ata i thanë se në Përlepnice kishte prani të UÇK-së dhe se krismat vinin nga UÇK-ja. Ata kërcënuan se do ta ekzekutonin Shaqirin kur ai provoi t'i bindte se nuk kishte UÇK në fshat.²²⁴⁵ Njëri nga oficerët, të cilin të tjerët e quanin "rus," e mori Shaqirin mënjanë dhe i shpjegoi se "njerëzit duhet të largohen nga Përlepnica" se përndryshe fshati dhe diga e tij do të minoheshin të nesërmen në mesditë sepse ekzistonte rreziku që NATO-ja të bombardonte fshatin.²²⁴⁶ Sipas "rusit", urdhri kishte ardhur nga lart, nga Beogradi.²²⁴⁷ Kur mori Shaqirin në pyetje, Mbrojtja e Pavkoviqit theksoi se ishte hera e parë që Shaqiri përmendi se urdhri kishte ardhur nga Beogradi.²²⁴⁸

²²⁴⁰ Abdylhaqim Shaqiri, 4D4 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 prill 1999), f. 3, 4D10 (deklaratë e shkruar me dorë e datës tetor 1999), f. 4, T. 2771–2774 (5 shtator 2006).

²²⁴¹ Abdylhaqim Shaqiri, T. 2772–2774 (5 shtator 2006), T. 2841–2843 (6 shtator 2006).

²²⁴² Abdylhaqim Shaqiri, T. 2808–2810 (5 shtator 2006).

²²⁴³ Abdylhaqim Shaqiri, T. 2772, 2774–2775 (5 shtator 2006).

²²⁴⁴ Abdylhaqim Shaqiri, T. 2775 (5 shtator 2006), 4D4 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 prill 1999), f. 3.

²²⁴⁵ Abdylhaqim Shaqiri, T. 2774–2778 (5 shtator 2006).

²²⁴⁶ Abdylhaqim Shaqiri, T. 2778–2783 (5 shtator 2006), T. 2849–2855 (6 shtator 2006), 4D4 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 prill 1999), f. 3.

²²⁴⁷ Abdylhaqim Shaqiri, T. 2778–2783 (5 shtator 2006), T. 2849–2858 (6 shtator 2006).

²²⁴⁸ Abdylhaqim Shaqiri, T. 2856–2857 (6 shtator 2006).

902. "Rusi" e mori Shaqirin deri te makina e vet dhe ata shkuan atje ku ishin mbledhur fshatarët, në pjesën perëndimore të Përlepticës. Fshatarët që po largoheshin ishin ndaluar në rrugë ndërsa ishin ende në fshat. Midis tyre ishin rreth 20-30 ushtarë. Kur arriti me "rusin", një nga fshatarët i tha Shaqirit se ua kishin marrë dokumentet personale. Shaqiri i tregoi "Rusit" dhe ai urdhëroi që dokumentet t'u ktheheshin të zotëve. Pas kësaj, ushtarët që kishin marrë dokumentet i hodhën ato në tokë afër një muri.²²⁴⁹

903. Pas plagosjes së një ushtari prej një plumbi qorr nga një portë e hekurt kur ushtarët kishin shtënë në ajër, grupi i ushtarëve u urdhërua të tërhiqej dhe u nis në drejtim të qytetit të Gjilanit. Fshatarët mbetën në Përlepticë dhe diskutuan se si të vepronin. Shaqiri dhe disa të tjerë, duke përfshirë dhe një banor serb të armatosur të fshatit, shkuan në Gjilan dhe u orvatën të kontaktonin shefin e policisë së atjeshme për të marrë leje qëndrimi. Mirëpo në qytet ata u ndaluan nga ushtarë, të cilët i kërcënuan dhe ata u kthyen në Përlepticë.²²⁵⁰

904. Me tu kthyer në Përlepticë, Shaqiri bëri sërish lajmërim me altoparlantin e xhamisë se popullata duhej të largohet nga fshati. Pastaj ai shkoi në rrugën kryesore Gjilan-Bujanoc dhe i priu një kolonë prej 400 automjetesh me afërsisht 3.000 njerëz në drejtim të lindjes nëpër fshatin Dobërçan.²²⁵¹ Ai zgjodhi këtë drejtim në vend të drejtimit të Ferizajt sepse e dinte rrugën dhe mendoi se ishte më sigurt për ta të shkonin në atë drejtim.²²⁵²

905. Sipas Shaqirit, në fshatin Kmetofc kishte forca policore dhe ushtarake në një postbllok në rrugë. Policët kishin uniforma të rregullta të kaltra dhe shirita të bardhë në krahë. Ushtarët kishin uniforma ngjyrë ulliri në të gjelbër dhe hirtë.²²⁵³ Ushtarët e ndaluan kolonën në postbllok, dhe i pyetën pse po largoheshin. Pastaj ata i lejuan të vazhdonin. Nga Kmetofci ata vazhduan për në fshatin Dobërçan dhe më pas kaluan nëpër fshatrat Ranllug dhe Kormnjan i Epërm, duke vazhduar në drejtim të Konçulit dhe Bujanocit, përtej kufirit krahinor nga Kosova.²²⁵⁴

906. Afërsisht katër apo pesë kilometra pa mbërritur në Konçul, pasi tashmë ishin larguar nga Kosova, policë nga Kamenica e informuan Shaqirin se kishin urdhra nga shefi i policisë së Gjilanit që fshatarët të ktheheshin në Përlepticë. Ai gjithashtu tha se nuk do t'i gjente gjë. Shaqiri ua kaloi

²²⁴⁹ Abdylhaqim Shaqiri, T. 2779–2780 (5 shtator 2006).

²²⁵⁰ Abdylhaqim Shaqiri, T. 2781–2786 (5 shtator 2006), T. 2858 (6 shtator 2006).

²²⁵¹ Abdylhaqim Shaqiri, T. 2788–2791 (5 shtator 2006), T. 2870 (6 shtator 2006).

²²⁵² Abdylhaqim Shaqiri, T. 2801–2802 (5 shtator 2006).

²²⁵³ Abdylhaqim Shaqiri, T. 2788–2789 (5 shtator 2006). *Shih gjithashtu* Momir Stojanoviq, T. 19758 (7 dhjetor 2007); Dushan Gavranic, T. 22676–22678 (18 shkurt 2008); IC188 (Hartë e shënuar nga Dushan Gavranic).

²²⁵⁴ Abdylhaqim Shaqiri, T. 2789–2793, 2801 (5 shtator 2006); IC29 (hartë e shënuar e Kosovës (P615) që tregon rrugën që bëri kolona më 6 prill).

këtë informacion të tjerëve në kolonë, të cilët n kthyen dhe u shpërndanë – disa u kthyen në Përlepnice atë natë, kurse të tjerët qëndruan te farefisi dhe miqtë në fshatrat e afërta. Shaqiri e kaloi natën në fshatin Dobërçan dhe u kthye në Përlepnice në mbrëmjen e 7 prillit 1999. Kur mbërriti në shtëpi pa se 70-80 për qind e popullatës ishte kthyer.²²⁵⁵ Pjesa perëndimore e fshatit ishte bastisur dhe plaçkitur dhe disa fshatarë ishin rrahur.²²⁵⁶

907. Dushan Gavraniqi konfirmoi se më 2, 3, dhe 4 prill 1999 pati lëvizje të mëdha të njerëzve që largoheshin nga shtëpitë e tyre në komunë. Gjatë kësaj periudhe, bombardimet e NATO-s u intensifikuan. Më 6 prill, popullata e Përlepnices u largua nga fshati dhe një delegacion i udhëhequr nga hoxhë Abdylhaqim Shaqiri foli me shefin e degës së policisë, Dragan Rizanoviq. Ata kërkuan ndihmë nga SPB-ja për të qëndruar në fshat, meqë ushtria u kishte thënë të largoheshin. Gavraniqi foli me kolonel Millinoviqin te "udhëkryqi afër pusit," por nuk mundi të merrte konfirmim se me të vërtetë ushtria i kishte urdhëruar apo kërkuar banorëve të largoheshin. Në atë kohë ata po shkonin në drejtim të Vranjës dhe Gavraniqi dërgoi një patrullë që të fliste me ta dhe t'u thoshte se ishte dizinformacion.²²⁵⁷ Më në fund banorët u kthyen dhe SPB-ja u dha garanci se nuk do të ishin më viktimë e "propagandave të ndryshme," "dizinformatave," dhe "njerëzve me uniforma të rreme."²²⁵⁸ Gjatë javës vijuese, SPB-ja dërgoi një patrullë të cilën fshatarët e quanin "postbllok," e cila u vendos në udhëkryqin afër Përlepnices. Gavraniqi tha se i mbante mend këto ngjarje sepse ishin të "pazakonta."²²⁵⁹

908. Shaqiri gjithashtu dëshmoi për ngjarjet e 13 prillit 1999. Rreth orës 12:30, kur ishte në oborrin e shtëpisë së nënës së tij në Përlepnice, atij iu afruan dy rezervistë të UJ-së të cilët ai i njihnte, Luba Pallamareviq dhe Gjillas Mlladenoviq. Atyre më vonë iu bashkua një ushtar i tretë.²²⁶⁰ Dy prej tyre kishin uniforma ushtarake kamuflimi ngjyrë të gjelbër-verdhë dhe nuk ishin të armatosur, por ushtari i tretë i u bashkua me ta kishte me vete tre kallashnikovë dhe u dha dy të tjerëve nga një. Mlladenoviqi i tha Shaqirit se "kishte ardhur urdhër nga Shtabi i Lartë në Beograd" se Përlepnica duhej të evakuohej. Kur Shaqiri pyeti për arsyen, ata i thanë se "ne vetëm zbatojmë urdhra, por nuk e dimë arsyen për to." Fshatarët e tjerë erdhën për të dëgjuar lajmet dhe i pyetën të dy rezervistët hollësisht. Gjatë bisedës, Mlladenoviqi u tha se duhej të largoheshin përmes rrugës

²²⁵⁵ Abdylhaqim Shaqiri, T. 2793–2797 (5 shtator 2006), T. 2868–2871 (6 shtator 2006), T. 2960–2962 (7 shtator 2006); P2288 (Raport i intervistës së OSBE-së), gjithashtu e pranuar si 4D9.

²²⁵⁶ Abdylhaqim Shaqiri, T. 2779–2780, 2793–2797 (5 shtator 2006), T. 2868–2871 (6 shtator 2006), T. 2960–2962 (7 shtator 2006); P2288 (Raport i intervistës së OSBE-së).

²²⁵⁷ Dushan Gavraniq, T. 22703–22705, 22794 (19 shkurt 2008).

²²⁵⁸ Dushan Gavraniq, T. 22704 (19 shkurt 2008).

²²⁵⁹ Dushan Gavraniq, T. 22704–22706 (19 shkurt 2008).

²²⁶⁰ Abdylhaqim Shaqiri, T. 2798–2800, 2802–2803 (5 shtator 2006). *Shih gjithashtu* Dushan Gavraniq, T. 22794 (19 shkurt 2008).

kryesore të nesërmen në orën 09:00.²²⁶¹ Ai gjithashtu u tha se ata që i kishin urdhëruar të largoheshin më 6 prill 1999 kishin qenë "ushtri paraushtarake", por ky urdhër vinte nga "ushtria e rregullt" sepse fshatarët nuk kishin shkuar në drejtim të Ferizajt.²²⁶²

909. Në lidhje me burimin e urdhrit, Dhoma Gjyqësore vëren se pas pyetjeve të shumta nga Mbrojtja, Shaqiri më në fund tha se Pallamareviqi përmendi urdhra të ardhura nga Gjilani, kurse Mlladenoviqi përmendi urdhra nga Beogradi.²²⁶³ Megjithatë, Shaqiri pranoi se ishte i sigurt se oficerët flisnin në emër të ushtrisë, në emër të Beogradit, dhe se ata arsyetuan se urdhri vinte nga "Shtabi i Lartë" në Beograd.²²⁶⁴ Dhoma e ka marrë veçanërisht parasysh këtë kur vlerësoi besueshmërinë e Shaqirit në përgjithësi. Meqë në deklaratat e mëparshme ai nuk ka përmendur se iu tha se urdhrat për ta zbrazur fshatin vinin nga Beogradi dhe meqenëse dëshmia e tij në lidhje me aspektin nëse ishte përmendur Beogradi ishte e paqartë, Dhoma nuk është e gatshme të pranojë se në kohën e kësaj ngjarjeje ishte përmendur Beogradi. Me gjithë mospërputhjet në dëshminë e Shaqirit në këtë aspekt, përshkrimi që u bëri ai ushtarëve të UJ-së ishte i qartë dhe Dhoma konsideron se është nuk është thelbësore nëse urdhrat erdhën nga Beogradi apo nga ndonjë vend në Kosovë.

910. Shaqiri tha se në fillim refuzoi të largohej nga Përlepnica, por më vonë pranoi të organizonte largimin nëse kolona do të shoqërohej nga policia ose ushtria. Atij i thanë se kjo kërkesë do t'i përcillej "shtabit" dhe se do të merrte përgjigje më vonë. Më vonë atë ditë, ai dëgjoi se grupi shoqëruar do të vinte te pusi i fshatit të nesërmen në mëngjes, në orën 08:00. Atë moment, tre fshatarë nga Përlepnica shkuan në polici në Gjilan në përpjekje për t'a parandaluar dëbimin. Kur u kthyen, e njoftuan Shaqirin se policia u kishte thënë se "ushtria e kishte marrë situatën në dorë dhe se policia nuk mund të bënte asgjë."²²⁶⁵ Në atë kohë, ushtria e kishte rrethuar fshatin sepse njerëzit kishin filluar të largoheshin dhe i pengoi njerëzit të largoheshin deri në kohën e caktuar mëngjesin e nesërm.²²⁶⁶

911. Më 14 prill 1999, në orën 07:30, grupi prej rreth 3.000 fshatarësh u bë gati të largohej. Rrugës për të takuar shpurën shoqëruese, grupi kaloi nëpër Kosaçë të Epërme. Kolonës iu bashkuan rreth 300-600 njerëz nga fshati, të cilët gjithashtu ishin urdhëruar të largoheshin nga

²²⁶¹ Abdylhaqim Shaqiri, T. 2798–2802 (5 shtator 2006), T. 2932, 2937–2938 (7 shtator 2006), 4D4 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 prill 1999), f. 5.

²²⁶² Abdylhaqim Shaqiri, T. 2798–2804 (5 shtator 2006).

²²⁶³ Abdylhaqim Shaqiri, T. 2940, 2973–2974 (7 shtator 2006). *Shih gjithashtu* 4D10 (deklaratë e shkruar me dorë e datës 25 prill 1999), f. 10–11, 4D6 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 qershor 2001), f. 4.

²²⁶⁴ Abdylhaqim Shaqiri, T. 2930, 2933, 2938 (7 shtator 2006).

²²⁶⁵ Abdylhaqim Shaqiri, T. 2804 (5 shtator 2006).

²²⁶⁶ Abdylhaqim Shaqiri, T. 2803–2805 (5 shtator 2006).

shtëpitë së bashku me 200 njerëz nga fshatrat përreth.²²⁶⁷ Një polic të cilin Shaqiri e njihte e shoqëroi kolonën nga pusi në drejtim të Ferizajt. Kur mbërritën në Livoç të Epërm, policin e zëvendësoi një grup prej katër policësh në një makinë Zastava të bardhë, të cilët e shoqëruan kolonën deri në kufirin me Maqedoninë. Në Livoç të Epërm, Shaqiri pa banorët e fundit të fshatit duke hipur në autobus. Ai autobus dhe një autobus tjetër nga Zhegra iu bashkuan kolonës gjatë një pjese të rrugës për në Maqedoni.²²⁶⁸

912. Gjatë rrugës për në Maqedoni, kolona kaloi nëpër qytetin e Gjilanit, Livoç të Epërm, Partesh, Radivojc, Kllokot, Viti, dhe Doganaj. Shaqiri vuri re se shumica e fshatrave nëpër të cilët kaluan ishin të braktisura.²²⁶⁹ Ai tha se udhëtimi deri në kufi me Maqedoninë zgjati afërsisht një ditë. Ata kaluan nëpër disa postblloqe në të cilat ishin njerëz me uniforma policie të kaltra dhe uniforma ngjyrë ulliri në të hirtë.²²⁷⁰ Pesë ose gjashtë kilometra nga kufiri, kolona ndaloi te një postbllok. Aty, një ushtar me uniformë "ngjyrë ulliri në të hirtë" e rrahu Shaqirin pa ndonjë arsye të dukshme.²²⁷¹ Një nga policët shoqërues dhe një oficer në postbllok ndërhyjnë për të ndaluar rrahjen dhe kolona u lejua të vazhdonte rrugën.²²⁷² Sidoqoftë, shefi i policisë kufitare i kishte detyruar fshatarët t'i linin makinat në një arë – rreth 518 makina – me çelësat dhe lejet. Asnjë nga këto automjete nuk u gjet më.²²⁷³

913. Pasi i kishin humbur makinat, njerëzit në kolonë e kaluan kufirin në këmbë, por e kaluan natën në zonën kufitare. Të nesërmen, autobusë nga Maqedonia i çuan në kampe të ndryshme. Shaqiri dëshmoi se më 25 qershor 1999 u kthye në Përlepnice dhe pa se disa nga shtëpitë ishin djegur dhe të gjitha ishin plaçkitur, kurse xhamia së bashku me bibliotekën ishin djegur.²²⁷⁴ Kur u ballafaqua me këto të dhëna, Dushan Gavranici dëshmoi se me sa dinte ai ishin djegur vetëm disa shtëpi plaçkat e të cilave ishin grabitur; ata madje arrestuan disa persona që ishin kapur në flagrancë.²²⁷⁵

²²⁶⁷ Abdylhaqim Shaqiri, T. 2805–2806 (5 shtator 2006), T. 2886–2887 (6 shtator 2006).

²²⁶⁸ Abdylhaqim Shaqiri, T. 2805–2807, 2811–2812 (5 shtator 2006), T. 2886 (6 shtator 2006).

²²⁶⁹ Abdylhaqim Shaqiri, T. 2812–2816, 2823 (5 shtator 2006); IC30 (hartë e shënuar e Kosovës (P615) që tregon rrugën e bërë nga kolona për në Maqedoni më 14 prill); IC31 (hartë e shënuar e Kosovës (P24) që tregon rrugën e bërë nga kolona për në Maqedoni më 14 prill).

²²⁷⁰ Abdylhaqim Shaqiri, T. 2811, 2816–2817 (5 shtator 2006), T. 2895–2896 (6 shtator 2006).

²²⁷¹ Abdylhaqim Shaqiri, T. 2812–2816 (5 shtator 2006), T. 2896 (6 shtator 2006).

²²⁷² Abdylhaqim Shaqiri, 4D6 (deklarata e dëshmitarit e datës 22 qershor 2001), f. 6, T. 2820 (5 shtator 2006), T. 2897–2901 (6 shtator 2006).

²²⁷³ Abdylhaqim Shaqiri, T. 2821–2822 (5 shtator 2006), T. 2870 (6 shtator 2006).

²²⁷⁴ Abdylhaqim Shaqiri, 4D5 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 shkurt 2002), f. 2, T. 2821 (5 shtator 2006), T. 2901–2904 (6 shtator 2006).

²²⁷⁵ Dushan Gavranici, T. 22795 (19 shkurt 2008).

914. Gavraniqi konfirmoi se rreth 13-14 prillit 1999 njerëzit ishin sërish "në lëvizje". Gjatë rrugës për në Kaçanik dhe në kufi me Maqedoni, banorët e Përlepnicës iu bashkuan një kolone prej disa mijëra njerëzish, me banorë nga Muçibaba. Sipas Gavraniqit, njerëzit u larguan nga frika e bombardimeve të NATO-s.²²⁷⁶ Me këtë rast, banorët e Përlepnicës kontaktuan Dragan Rizanoviçin, shefin e degës së policisë. Këtë herë askush nuk arriti t'i bindte që të qëndronin; ata ishin të vendosur të shkonin në Maqedoni. Sidoqoftë, hoxha kërkoi që policia t'u jepte një patrullë që të mos keqtrajtoheshin. Gavraniqi gjithashtu konfirmoi rrethanat e shoqërimit të kolonën për në Maqedoni nga policia.²²⁷⁷

915. Sidoqoftë, Dhoma Gjyqësore konkludon se Gavraniqit nuk iu kërkua të komentonte dëshminë e Shaqirit në lidhje me përfshirjen e ushtrisë në këtë incident. Kur e pyetën Shaqirin se pse ishte larguar nga fshati, ai tha, "Nuk kishim rrugëdalje tjetër – ose t'u bindeshim urdhrave ose të luftonim. Meqë nuk ishim në gjendje të luftonim, ne iu bindëm urdhrave sa më qetë që ishte e mundshme." Ai gjithashtu hodhi poshtë pretendimin se ata ishin të frikësuar nga bombardimet e NATO-s.²²⁷⁸ Dhoma gjithashtu thekson dëshminë e dhënë nga Spasoje Smilaniqi, komandant i Forcave Ajrore dhe Mbrojtjes Kundërajrore, i cili dëshmoi se pjesët e Kosovës më të bombarduara prej NATO-s ishin zonat kufitare me Shqipërinë dhe Maqedoninë dhe vija Han i Elezit/Kaçanik/Ferizaj/Prishtinë, asnjë prej të cilave nuk përfshin komunën e Gjilanit.²²⁷⁹ Duke marrë parasysh dëshminë e Shaqirit, të cilën Dhoma e pranon, dhe në mungesë të dëshmive për bombardimet e NATO-s në atë zonë në atë kohë, që diskutohet më poshtë, Dhoma nuk e pranon pretendimin e Gavraniqit se njerëzit u larguan nga Përlepnica për shkak të bombardimeve të NATO-s. Duke marrë parasysh përfshirjen e ushtrisë, Dhoma hedh poshtë deklaratën e Gavraniqit se ushtria nuk ishte në dijeni të arsyes së largimit të njerëzve nga fshati.

916. Gjithashtu Dhoma Gjyqësore nuk dëgjoi dëshmi për operacione konkrete të ushtrisë kundër UÇK-së apo sulme të saj kundër ushtrisë në atë kohë, dhe konkludon se kjo përforcon dëshminë e Shaqirit se ushtria e dëboi popullatën e fshatit me dhunë.

4. Zhegra, Lladova, Llashtica, dhe Nosala

917. Dëshmitari K81, shqiptar kosovar dhe banor i Lladovës, dëshmoi se rreth 25 marsit 1999 UJ-ja dhe njerëz të armatosur me rroba civile erdhën në fshatin e tij. Ata u vendosën në depon e

²²⁷⁶ Dushan Gavraniq, T. 22704–22706, 22794 (19 shkurt 2008).

²²⁷⁷ Dushan Gavraniq, T. 22705–22707 (19 shkurt 2008).

²²⁷⁸ Abdylhaqim Shaqiri, T. 2822 (5 shtator 2006), T. 2930 (7 shtator 2006).

²²⁷⁹ Spasoje Smilaniq, T. 15750–15751, 15777 (17 shtator 2007).

fabrikës së baterive e cila gjendet në hyrje të Zhegrës, një fshat i afërt.²²⁸⁰ Ushtarët e UJ-së kishin uniforma në ngjyrë të gjelbër të mbyllët me emblema ushtarake dhe erdhën në fshat me automjete ushtarake. Automjetet e tyre përfshinin 8-10 autobusë dhe kamionë të rëndë, të gjithë me targa ushtarake.²²⁸¹ Banorëve vendës u thanë se njerëzit me rroba civile ishin Tigrat e Arkanit, edhe pse nuk u bë e qartë se kush ua dha këtë informacion. Sipas K81-shit, ata njerëz ishin shumë më të moshuar se ushtarët e UJ-së, me mjekra të gjata, dhe të armatosur me armë automatike. Disa prej tyre kishin uniforma të pjesshme dhe ngisnin makina civile, disa prej të cilave kishin targa të Leskovcit. K81-shi pa se civilët serbë dhe UJ-ja vepronin së bashku dhe mendonte se civilët ishin nën urdhrat e UJ-së. Gjendja në fshat u keqësua me ardhjen e tyre për shkak të sjelljes së tyre kërcënuese.²²⁸²

918. Qamil Shabani, mësues shqiptar kosovar nga Zhegra, konfirmoi dëshminë e K81-shit dhe dëshmoi se dy apo tri javë para se të fillonte fushata ajrore e NATO-s, "policia dhe ushtria serbe" erdhën në Zhegër me tanke, autoblanda, topa, dhe pajisje të tjera, si mortaja dhe mitraloza. Këto forca u vendosën në hyrje dhe dalje të fshatit, mirëpo shtabin e vendosën në kooperativën bujqësore, në fabrikën e baterive, në disa shtëpi shqiptare, dhe në lokalet e shkollës fillore. Ata patrullonin vazhdimisht në rrugët e Zhegrës, ndalonin fshatarët për t'u kontrolluar letërnjoftimet dhe i shanin e i ofendonin.²²⁸³

919. Prania e UJ-së në Zhegër u konfirmua edhe nga Franjo Gllonçaku, i cili tha se, kur hyri në ushtri si vullnetar më 25 mars 1999, e dërguan në Brigadën e 175-të Këmbësorike në Zhegër.²²⁸⁴

920. Shabani gjithashtu dëshmoi se në mbrëmjen e 28 marsit (festë myslimane e njohur si dita e Bajramit) ai dhe banorët e tjerë të Zhegrës dëgjuan të shtëna nga armë të rënda automatike nga Pasjani, që dukej se ishin të drejtuara kundër Llashticës dhe të cilat zgjatën rreth një orë.²²⁸⁵ Po atë ditë, familjet serbe në Zhegër filluan të shënonin shtëpitë e tyre me lecka të bardha për t'i dalluar

²²⁸⁰ K81, P2526 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 maj 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 6, T. 7079–7081 (21 nëntor 2006).

²²⁸¹ K81, P2526 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 maj 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 6, T. 7066 (21 nëntor 2006).

²²⁸² K81, P2526 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 maj 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 6, T. 7066, 7075, 7079–7082 (21 nëntor 2006).

²²⁸³ Qamil Shabani, P2263 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 qershor 2001), f. 2, T. 2682 (31 gusht 2006), T. 2716 (1 shtator 2006), P2264 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 1514, 1518–1519, P2263 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 qershor 2001), f. 2.

²²⁸⁴ Franjo Gllonçak, 5D1395 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 dhjetor 2007), para. 4-5, T. 21122 (25 janar 2008).

²²⁸⁵ Qamil Shabani, P2264 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 1527–1528.

nga shtëpitë shqiptare.²²⁸⁶ Rreth orës 18:00, "paraushtarakët," të ndihmuar nga serbët vendës shkuan në disa shtëpi në Zhegër duke kërkuar njerëzit më me reputacion të fshatit për t'i vrarë.²²⁸⁷

921. Shabani dëshmoi se më 29 mars 1999 mbërritën forca të tjera plotësuese, përfshirë edhe "paraushtarakë" që bashkëvepronin me policinë dhe ushtrinë. Së bashku, ata filluan "spastrimin" e shqiptarëve nga fshati.²²⁸⁸ Shabani pa dhe dëgjoi "ushtarët" duke e granatuar Zhegërën, duke shkuar me autoblanda poshtë e lart dhe duke qëlluar në shtëpitë për t'i dëbuar banorët.²²⁸⁹ Ai gjithashtu pa në Zhegër edhe automjete që i përkisnin UJ-së së rregullt.²²⁹⁰ Shabani tha se me termin "paraushtarak" nënkuptonte dikë që bashkëvepronte me policinë por nuk ishte polic i rregullt. Ai i dallonte ata nga uniformat e tyre të parregullta si dhe shamitë në kokë.²²⁹¹ Gjatë pyetjeve nga Mbrojtja, ai gjithashtu sqaroi se me "ushtri" ai nënkuptonte ushtrinë e rregullt, policinë e rregullt, rezervistët policorë dhe ushtarakë.²²⁹²

922. Shabani dëshmoi se ushtarët e armatosur shkuan në shtëpitë në hyrje të Zhegërës dhe filluan të dëbonin njerëzit duke i urdhëruar të largoheshin nga fshati. Ushtria e rregullt, paraushtarakët dhe civilët serbë me armët e veta shtinin në ajër për ta frikësuar popullatën shqiptare kosovare dhe për t'i dëbuar nga fshati.²²⁹³ Ata gjithashtu rrihnin njerëzit që zinin në rrugë. Ai dëgjoi se disa nga fshatarët ishin vranë.²²⁹⁴ Njerëzit i kapi paniku kur dëgjuan zjarrin e armëve dhe u larguan nga shtëpitë dhe u nisën për në male.²²⁹⁵ Rreth orës 19:00 ose 20:00, Shabani së bashku me familjen e

²²⁸⁶ Qamil Shabani, P2263 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 qershor 2001), f. 2, P2264 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 1514, 1592–1593, T. 2700–2703 (1 shtator 2006).

²²⁸⁷ Qamil Shabani, P2263 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 qershor 2001), f. 3, P2264 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 1528–1530, 1560, P2280 (shitesë e deklaratës së dëshmitarit e datës 27 gusht 2006), f. 2, T. 2683 (31 gusht 2006). *Shih gjithashtu* K81, P2268 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 maj 1999), f. 00799042–00799043 (e mbyllur me vulë), T. 7071–7072, 7084–7086 (21 nëntor 2006).

²²⁸⁸ Qamil Shabani, P2263 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 qershor 2001), f. 2-3, P2264 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 1528-1529, 1556, T. 2682 (31 gusht 2006); K81, T. 7071–7072 (21 nëntor 2006).

²²⁸⁹ Qamil Shabani, P2263 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 qershor 2001), f. 3, T. 2683–2684, 2688–2689 (31 gusht 2006).

²²⁹⁰ Qamil Shabani, T. 2688–2689 (31 gusht 2006); P1325 (fotografi të automjeteve të ndryshme ushtarake).

²²⁹¹ Qamil Shabani, P2280 (shitesë e deklaratës së dëshmitarit e datës 27 gusht 2006), f. 2–3.

²²⁹² Qamil Shabani, 2751–2752 (1 shtator 2006). *Shih gjithashtu* Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 1192.

²²⁹³ Qamil Shabani P2263 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 qershor 2001), f. 2–3, T. 2683 (31 gusht 2006).

²²⁹⁴ Qamil Shabani, P2264 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 1561–1562, 1572–1574, 1581–1582, 1585–1588, P2263 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 qershor 2001), f. 2, T. 2705–2711, 2759–2761 (1 shtator 2006), P2280 (shitesë e deklaratës së dëshmitarit e datës 27 gusht 2006), f. 3, 6; Dushan Gavranic, T. 22691 (18 shkurt 2008).

²²⁹⁵ Qamil Shabani, P2263 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 qershor 2001), f. 3.

tij dhe njerëz të tjerë të lagjes u detyruan të largoheshin nga Zhegra. Kundër tij shtinë por nuk e goditën.²²⁹⁶

923. Gavraniqi dëshmoi se largimi më i madh i njerëzve nga Zhegra ndodhi gjatë ditëve të para të bombardimeve të NATO-s dhe se "refugjatët" e parë nga Zhegra ishin serbë, të cilin ishin pakicë në fshat.²²⁹⁷

924. Pasi u dëbuan nga Zhegra, Qamil Shabani me familjen e tij dhe rreth 1.300 fshatarë të tjerë shkuan në një kodër të quajtur Kushlevicë, e cila gjendet në drejtim të Stubllës së Poshtme në komunën e Vitisë dhe e kaluan natën atje në shi.²²⁹⁸ Ai dhe fshatarët e tjerë vendosën të ktheheshin në Zhegër të nesërmen në mëngjes sepse nuk kishin dëgjuar më të shtëna nga fshati.²²⁹⁹

925. Pasi u kthyen në shtëpitë e tyre më 30 mars, fshatarët u detyruan të largoheshin nga Zhegra përsëri atë ditë sepse "forcat paraushtarake" dhe "forcat ushtarake serbe" vazhduan të qëllonin me armë mbi shtëpitë e tyre kur kalonin me autoblanda nëpër fshat. Këto forca vazhduan keqtrajtimin e banorëve të fshatit, vrasjet, rrahjet, dhe lëndimet e tyre. Gjithashtu, ata hynë në shtëpitë në Zhegër, duke i frikësuar banorët dhe duke i dëbuar nga shtëpitë.²³⁰⁰

926. Si pasojë, më 30 mars, i njëjti grupi me rreth 1.300 fshatarë u largua përsëri nga Zhegra në këmbë dhe u nis në drejtim të Stubllës së Poshtme,²³⁰¹ ku qëndruan pesë javë. Sipas Shabanit, në Stubllën e Poshtme nuk kishte "forca apo polici serbe", por ata zunë pozicione përreth fshatit nëpër kodra dhe vëzhgonin gjendjen dhe popullatën.²³⁰² Gjithashtu, "forcat serbe" sulmuan fshatrat përreth, si Nosalën dhe Lladovën dhe kjo rezultoi në ardhjen e gati 20.000 njerëzve në Stubëll të Poshtme gjatë prillit.²³⁰³ Gjatë pesë javëve që grupi i Shabanit qëndroi në Stubëll të Poshtme, kushtet e tyre të jetesës ishin shumë të vështira sepse nuk kishte ushqim dhe strehim të mjaftueshëm dhe disa nga njerëzit u detyruan të flinin në çadra najloni të ngritura në faqe të malit në afërsi të

²²⁹⁶ Qamil Shabani, P2263 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 qershor 2001), f. 3, P2264 ((transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 1528–1530, 1557, T. 2684, 2714 (31 gusht 2006).

²²⁹⁷ Dushan Gavraniq, T. 22681 (18 shkurt 2008), T. 22795–22796 (19 shkurt 2008).

²²⁹⁸ Qamil Shabani, P2263 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 qershor 2001), f. 3, P2264 ((transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 1530–1531, 2684–2685 (31 gusht 2006), 2714 (1 shtator 2006).

²²⁹⁹ Qamil Shabani, T. 2715, 2716 (1 shtator 2006).

²³⁰⁰ Qamil Shabani, P2263 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 qershor 2001), f. 3, P2264 ((transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 1531, T. 2717 (1 shtator 2006).

²³⁰¹ Qamil Shabani, T. 2686–2687 (31 gusht 2006); IC27 (hartë e shënuar e Gjilanit (P36) që tregon rrugën e marrë nga Shabani për në Stubëll të Poshtme).

²³⁰² Qamil Shabani, P2263 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 qershor 2001), f. 4, P2264 ((transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 1596.

²³⁰³ Qamil Shabani, P2263 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 qershor 2001), f. 4, P2264 ((transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 1533–1534.

fshatit.²³⁰⁴ Ata jetonin në frikë të vazhdueshme se mund të sulmoheshin dhe vriteshin nga "forcat serbe."²³⁰⁵ Si rezultat, njerëzit u organizuan në grupe të ndryshme dhe u nisën në drejtim të kufirit me Maqedoninë.²³⁰⁶

927. Shabani dëshmoi se në fillim të majit 1999 ai u largua nga Stublla e Poshtme, së bashku me një grup prej afërsisht 600 njerëzish, dhe u nisën për në Maqedoni. Kolona vendosi të nisej natën për të mos u zbuluar nga "forcat serbe." Ata udhëtuan nëpër kodra dhe rrugë dytësore, duke u ikur rrugëve kryesore nëpër të cilat lëviznin ato forca.²³⁰⁷ Pasditen e 3 majit, ata mbërritën në lagjen e Rrustajve në komunë – ku është një vendkalim kufitar – ku hasën një grup ushtarësh dhe "paraushtarakësh", të cilët i kontrolluan dhe i ndanë burrat nga gratë. Burrat u rrethuan nga ushtarët e paraushtarakët me armët në drejtim të tyre për rreth dy-tri orë. Gjatë kësaj kohe, ata i kërcënuan se do t'i vrisnin, por më në fund i lanë të bashkoheshin sërish me grupin e grave.²³⁰⁸

928. Kolonën e urdhëruan të vazhdonte rrugën e shoqëruar nga rreth 30-40 ushtarë dhe "paraushtarakë" deri në një kodër afër kufirit me Maqedoninë, ku i detyruan të uleshin në një arë. Njëri nga ushtarët, të cilin Shabani e përshkroi si komandantin e tyre, e nxori nga grupi dhe e kërcënoi dhe e akuzoi se kishte ndërmend t'i bashkohej UÇK-së në Shqipëri. Më në fund kolona u urdhërua të shkonte në drejtim të Preshevës, ku, sipas ushtarëve, do t'i priste një grup tjetër "ushtarësh" dhe "paraushtarakësh". Sidoqoftë, pjesëtarët e kolonës vendosën të merrnin një rrugë tjetër nëpër Malin e Thatë dhe më në fund kaluan kufirin me Maqedoninë.²³⁰⁹

929. Kur u kthye në Zhegër më 26 qershor 1999, Shabani pa se disa nga shtëpitë e banorëve shqiptarë kosovarë ishin djegur plotësisht, të tjerat ishin djegur pjesërisht; dhe vetëm disa kishin mbetur të padëmtuara. Të gjitha shtëpitë serbe ishin të padëmtuara.²³¹⁰ K81-shi konfirmoi se të

²³⁰⁴ Qamil Shabani, P2263 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 qershor 2001), f. 5, P2280 (shtesë e deklaratës së dëshmitarit e datës 27 gusht 2006), f. 4, P2264 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 1532, 1533, 1535; P2280 (shtesë e deklaratës së dëshmitarit e datës 27 gusht 2006), f. 4, T. 2719–2722 (1 shtator 2006).

²³⁰⁵ Qamil Shabani, P2263 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 qershor 2001), f. 5, P2280 (shtesë e deklaratës së dëshmitarit e datës 27 gusht 2006), f. 4, T. 2719–2722 (1 shtator 2006).

²³⁰⁶ Qamil Shabani, P2263 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 qershor 2001), f. 4, P2264 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 1534, 1565; T. 2720 (1 shtator 2006).

²³⁰⁷ Qamil Shabani, P2263 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 qershor 2001), f. 5, P2264 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 1534–1535, T. 2723 (1 shtator 2006).

²³⁰⁸ Qamil Shabani, P2263 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 qershor 2001), f. 5, P2264 transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 1536–1537, 1599, T. 2723–2724 (1 shtator 2006); P36 (hartë e Gjilanit); IC27 (hartë e shënuar e Gjilanit (P36) që tregon rrugën e marrë nga Qamil Shabani për në Maqedoni).

²³⁰⁹ Qamil Shabani, P2263 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 qershor 2001), f. 6, P2264 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 1536–1538, T. 2685–2687 (31 gusht 2006), T. 2762 (1 shtator 2006); IC27 (hartë e shënuar e Gjilanit (P36) që tregon rrugën e marrë nga Shabani për në Maqedoni).

²³¹⁰ Qamil Shabani, P2264 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 1540, 1569, P2280 (shtesë e deklaratës e dëshmitarit e datës 27 gusht 2006), f. 4, T. 2731 (1 shtator 2006).

gjitha shtëpitë e shqiptarëve kosovarë në Zhegër ishin djegur, përveç atyre në të cilat kishin qëndruar ushtarët, por të gjitha shtëpitë serbe mbetën të padëmtuara.²³¹¹

930. Në vitin 1999, Lladova kishte afërsisht 100 shtëpi dhe ishte e ndarë në tri lagje.²³¹² K81-shi dëshmoi se UÇK-ja nuk ishte e pranishme në këtë fshat dhe se kurrë nuk i kishin kërkuar të hynte në UÇK.²³¹³ Më 29 dhe 30 mars 1999, ai vendosi të largohej nga fshati së bashku me familjen e tij, për shkak të pranisë së madhe të UJ-së në afërsi. Ata shkuan në drejtim të zonës së Karadakut që është tri deri katër kilometra larg nga Lladova, në afërsi të Llashticës dhe Zhegrës.²³¹⁴ K81-shi kaloi dy javë duke u fshehur në male me burra, gra, fëmijë, pleq, dhe të rinj të tjerë.²³¹⁵

931. Gjatë dy javëve që kaloi në male, K81 mundi të vrojtonte me dylbi ushtarët dhe "paraushtarakët" të cilët plaçkitnin, vidhnin, dhe u vinin zjarrin shtëpive në Lladovë.²³¹⁶ Me dylbi, ai dalloj qartësisht uniformat e ushtarëve dhe çfarë ndodhte në fshat.²³¹⁷ Ai gjithashtu dëgjoi se ushtarët kishin ekzekutuar tre burra.²³¹⁸ Dhoma Gjyqësore nuk e pranon argumentin e Mbrojtjes së Llazareviqit se, meqenëse ai nuk ishte në gjendje të identifikonte emblemat në uniformat e keqbërësve nga largësia, rrjedhimisht nuk është i saktë.²³¹⁹

932. Veprimtarinë e UJ-së në atë zonë në atë kohë e konfirmoi edhe Gllonçaku, i cili dëshmoi se, kur e dërguan në Brigadën e 175-të, ai mori pjesë në zmbropsjen e një sulmi këmbësorie të UÇK-së nga fshati Lladovë. Të shtënat zgjatën rreth gjysmë ore dhe nuk pati viktima në anën e tyre. Nuk ishte "aksion," por më shumë provokim nga ana e UÇK-së, të cilit brigada iu përgjigj me zjarr.²³²⁰

933. K81-shi dëshmoi se më 2 prill ose rreth kësaj date, në orën 15:30, anëtarë të familjes së tij, duke përfshirë gra e fëmijë, u larguan nga malet dhe vendosën të ktheheshin në Lladovë. Ai pa se kur ata ishin rreth 500-600 metra nga fshati, ushtarë të UJ-së me uniforma në të gjelbër të mbyllët

²³¹¹ K81, P2526 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 maj 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8.

²³¹² K81, P2268 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 maj 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 6 (e mbyllur me vulë).

²³¹³ K81, T. 7077–7078 (21 nëntor 2006).

²³¹⁴ K81, T. 7070, 7075, 7081–7082 (21 nëntor 2006), P2268 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 maj 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 6 (e mbyllur me vulë); IC111 (hartë e shënuar e Gjilanit (P36) që tregon vendin në mal ku ishte fshehur K81); IC112 (Harta e zonës së Karadakut të shënuar nga K81).

²³¹⁵ K81, T. 7079 (21 nëntor 2006).

²³¹⁶ K81, P2268 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 maj 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 7 (e mbyllur me vulë), T. 7082 (21 nëntor 2006).

²³¹⁷ K81, T. 7074–7075 (21 nëntor 2006).

²³¹⁸ K81, P2268 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 maj 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 7 (e mbyllur me vulë), T. 7082 (21 nëntor 2006).

²³¹⁹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (dokumentacioni gjyqësor publik), para. 240.

²³²⁰ Franjo Gllonçak, T. 21133–21134 (25 janar 2008).

hapën zjarr kundër tyre me armë automatike. Dy prej tyre u vranë, një burrë i moshës 28-vjeçare dhe një grua e moshës 22-vjeçare, kurse të tjerët u plagosën.²³²¹

934. Ai gjithashtu dëshmoi se, pas qëndrimit dy javë në male, ai mbeti pa ushqime dhe vendosi të shkonte në Preshevë për të parë se a mund ta dërgonte familjen e tij atje. Ai kaloi një natë në Preshevë dhe të nesërmen shkoi përsëri në Llashticë me traktor. Rrugës për në Llashticë, ai pa ushtarë të "rregullt" të UJ-së me uniforma në ngjyrë të gjelbër të mbyllët duke rrethuar një kodër afër fshatit. Ai gjithashtu pa njerëz me traktorë nga kjo zonë duke u larguar në drejtim të Preshevës.²³²² K81-shi iu fsheh ushtarëve. Ai pa tre ose katër prej tyre duke hapur zjarr kundër tre burrave të paarmatosur që bartnin babanë e tyre me batanije. Plumbat goditën plakun dhe burrat që ishin duke e bartur e lëshuan dhe vrapuan për t'u fshehur. Ata shkuan te vendi ku ishte fshehur K81-shi dhe natën të gjithë së bashku shkuan dhe e morën kufomën e plakut dhe e varrosën në fshatin e quajtur Beqir.²³²³

935. Pastaj, K81-shi u largua nga Beqiri dhe shkoi në Zhub për të gjetur ushqim. Kur ishte atje disa fshatarë vendës i thanë se ushtria ishte në afërsi dhe se duhej të largoheshin. Ai pa rreth 70 fshatarë duke u larguar për shkak të sulmeve të UJ-së, por ai qëndroi në Zhub atë natë. Të nesërmen dëgjoi krisma armësh dhe vendosi të largohesh nga fshati. Kur po largohesh së bashku me të tjerë, UJ-ja i pikasi dhe hapi zjarr kundër tyre.²³²⁴ K81-shi dhe shoqëruesit e tij shkuan në fshatin Sefer, ku ndaluan të gjenin ushqim dhe të pushonin. Pastaj udhëtuan në këmbë për 12 orë në drejtim të Preshevës me një grup njerëzish që u larguan nga shtëpitë përreth. K81 dëshmoi se nuk pa më pjesëtarë të ushtrisë deri në momentin e mbërritjes në Preshevë.²³²⁵

936. Kur mbërriti në Preshevë, K81-shi mësoi se familja e tij ishte atje dhe e kaloi natën me ta. Të nesërmen rreth orës 11:00 ata u bashkuan me një kolonë prej 1.000 njerëzish që udhëtonte në drejtim të Maqedonisë. Kolonën e shoqëronin policë me uniforma në ngjyrë të kaltër të mbyllët dhe UJ-ja. Disa nga ushtarët e UJ-së ngisnin traktorë që u kishin konfiskuar shqiptarëve kosovarë.²³²⁶ Në fshatin Miratoc afër kufirit me Maqedoninë, kolona ndaloi dhe policët shoqërues i kontrolluan

²³²¹ K81, P2268 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 maj 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 7 (e mbyllur me vulë).

²³²² K81, P2268 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 maj 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8 (e mbyllur me vulë).

²³²³ K81, P2526 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 maj 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8.

²³²⁴ K81, P2526 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 maj 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8-9, T. 7072 (21 nëntor 2006).

²³²⁵ K81, P2268 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 maj 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 9 (e mbyllur me vulë), T. 7076 (21 nëntor 2006).

²³²⁶ K81, P2268 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 maj 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 9 (e mbyllur me vulë).

dhe ua morën letërnjoftimet dhe pasaportat. Kur arritën në kufi, autoritetet maqedonase fillimisht nuk i lejuan të kalonin. Më në fund, kufiri u hap dhe kolona kaloi në Maqedoni nëpërmjet fshatit Tabanovc.²³²⁷

937. K81 gjithashtu dëshmoi se kur më 6 prill 1999 ose rreth kësaj date, u fshehën në Karadak. ai pa "paraushtarakë" dhe ushtarë të UJ-së duke plaçkitur dhe djegur fshatin Llashticë.²³²⁸ Ata së pari dogjën xhaminë, e cila gjendej në qendër të fshatit, e pastaj plaçkitën dhe dogjën shtëpitë. Ushtarët kishin uniforma në ngjyrë të gjelbër të mbyllët dhe shtinin vazhdimisht, edhe pse nuk fshatarët nuk bënë kurrfarë rezistencë.²³²⁹ K81-shi njohu shumë civilë që "punonin" me ushtarët në Llashticë, shumica e të cilëve ishin nga Zhegra. Edhe pse të gjithë ata njerëz ishin civilë, ata ishin të armatosur dhe K81-shi pa se dy nga ata kishin uniformë policësh në ngjyrë të kaltër të mbyllët.²³³⁰ Dhoma Gjyqësore gjykon se dëshmitë okulare përputhëse të K81-shit dhe Shabanit tregojnë se civilë të armatosur bashkëpunuan me UJ-në në Zhegër dhe përreth saj.

938. Bozhidar Deliqi mohoi se forcat e tij shkatërruan xhaminë në Llashticë.²³³¹ Dushan Gavraniqi konfirmoi se në zonën e Llashticës ishte djegur një xhami, por nuk e dinte se si kishte ndodhur. Me të marrë raportin për incidentin, ai shkoi në vendin e ngjarjes sepse një shqiptar kishte thënë se prindërit e tij ishin nën gërmadha. U nxorën disa kufoma. U krye hetimi i vendit të ngjarjes dhe SPB-ja depozitoi kallëzim penal kundër autorëve të panjohur.²³³²

939. Përveç dëshmimeve të këtyre dëshmitarëve, Dhoma gjithashtu dëgjoi dëshminë e Andrés Riedlmayer-it, i cili paraqiti fotografi të brendësisë së xhamisë në Llashticë, të bëra në gusht 1999, që tregojnë se xhamia ishte dëmtuar rëndë.²³³³ Riedlmayer-i shprehu mendimin se dëmet ishin shkaktuar nga zjarri i madh, i cili kishte shkatërruar të gjitha gjërat e djegshme në godinë.²³³⁴ Gjithsesi ai nuk ishte në gjendje të dëshmonte për kohën dhe shkakun e djegies. Dhoma Gjyqësore konstaton se Riedlmayer-i nuk e vizitoi personalisht xhaminë në Llashticë, porse i mori fotografitë nga zyrat e bashkësisë islamike të Kosovës.

²³²⁷ K81, P2526 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 maj 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 9.

²³²⁸ K81, P2268 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 maj 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 7–8 (e mbyllur me vulë), T. 7070–7071 (21 nëntor 2006); IC111 (Hartë e shënuar nga K81).

²³²⁹ K81, P2268 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 maj 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 7–8 (e mbyllur me vulë), T. 7070–7071, 7074, 7078 (21 nëntor 2006); P1785 (fotografi e brendësisë së xhamisë në Llashticë).

²³³⁰ K81, P2268 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 maj 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8 (e mbyllur me vulë), T. 7081 (21 nëntor 2006).

²³³¹ Bozhidar Deliq, T. 19391 (29 nëntor 2007).

²³³² Dushan Gavraniqi, T. 22795–22797 (19 shkurt 2008).

²³³³ P1798 (fotografi e xhamisë në Llashticë).

²³³⁴ Andrés Riedlmayer, P1785 (fotografi e brendësisë së xhamisë në Llashticë); T. 5487–5488 (30 tetor 2006), T. 5569–5570 (31 tetor 2006).

940. Dëshmitarit ekspert për trashëgimi kulturore i Mbrojtjes së Përbashkët, Branimir Jokić, iu treguan fotografi të xhamisë në Llashticë dhe ai tha se nuk mund t'i komentonte sepse, sipas tij, godina nuk mund të identifikohet me vetëm një pjesë të brendësisë së saj të fotografuar. Ai gjithashtu parashtrroi se fotografitë duhej të ishin të dokumentuara dhe të shoqëruara me të dhënat përkatëse.²³³⁵ Dhoma Gjyqësore pranon dëshminë e Riedlmayer-it se si e siguroi fotografinë, që sipas Dhomës është fotografi autentike e xhamisë.

941. Duke dhënë një shpjegim tjetër për arsyen e largimit të njerëzve nga komuna, Gavraniqi tha se NATO-ja bombardoi zonën e Gjilanit për 39 ditë pa pushim.²³³⁶ Raportet e policisë dhe të UJ-së shënojnë se në mars, prill dhe maj 1999 NATO-ja bombardoi kryesisht objekte ushtarake dhe të infrastrukturës në Gjilan.²³³⁷ Gavraniqi dëshmoi se, kur filluan bombardimet e NATO-s, gra, fëmijë, dhe pleq nga zona e tij e përgjegjësisë u nisën në drejtim të rajoneve të tjera në Serbi; shumë shkuan në Vranjë dhe, më vonë, kur ndodhën "largimet e tjera masive," ata shkuan edhe në drejtime të tjera, për shembull në drejtim të Maqedonisë. Sipas tij, njerëzit u larguan nga frika e bombardimeve të NATO-s dhe shumica e njerëzve u larguan nga territori i qytetit të Gjilanit, rrethina e Muçibabës, dhe zona mbi Zhegër, në drejtim të kufirit me Maqedoninë.²³³⁸

942. Sidoqoftë, siç është theksuar më lart në lidhje me Përlepnicën, Dhoma nuk pranon se frika nga bombardimet e NATO-s ishte arsyeja e largimit të shumë njerëzve nga shtëpitë në komunën e Gjilanit në këtë atë kohë, meqenëse nuk ka dëshmi se NATO-ja goditi zonat e banuara me civilë, as K81 e as Shabani nuk përmendën frikën nga NATO-ja si arsye për ikjen e tyre dhe të familjeve të tyre, dhe komuna nuk u bombardua intensivisht nga NATO-ja, siç shpjegoi Smilaniqi.

²³³⁵ Branimir Jokić, T. 25878–25879 (23 prill 2008); P1785 (fotografi e brendësisë së xhamisë në Llashticë).

²³³⁶ Dushan Gavraniq, T. 22715 (19 shkurt 2008), 4D123 (Raport luftimi nga Komanda e Armatës së 3-të, 2 maj 1999).

²³³⁷ *Shih, p.sh.*, P1099 (Raport nga Shtabi i MPB-së, 26 mars 1999), ku thuhet se ishin bombarduar kazerma e UJ-së dhe kombinati bujqësor industrial; P1100 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar MPB-së së Serbisë, 27 mars 1999), ku thuhet se ishin bombarduar kazerma e UJ-së dhe NSh Kosmetprevoz (ndërmarrje shoqërore) në Gjilan; 4D363 (Raport nga Komanda e Armatës së 3-të, 25 mars 1999), që shënon se ishte goditur kazerma *Knez Lazar*; P2617 (Raport nga PrK-ja, 4 prill 1999), ku lexohet se NATO-ja hapi zjarr kundër kazerms në Gjilan dhe goditi radio-stacionin teknik; P1997 (Raport luftimi nga Komanda e Armatës së 3-të, 13 prill 1999), ku lexohet se më 12 dhe 13 prill 1999, forcat ajrore të NATO-s sulmuan pikën e "izoluar" Saz në afërsi të Gjilanit, por pa pasoja; 4D123 (Raport luftimi nga Komanda e Armatës së 3-të, 2 maj 1999), ku lexohet se më 2 maj 1999, NATO-ja sulmoi "zonën e përgjithshme" të Gjilanit; P1996 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 7 maj 1999), f. 9, raportohet se në Gjilan kishin ndodhur 31 "bombardime" të NATO-s; 3D853 (Raport luftimi i Shtabit të Komandës së Lartë, 18 maj 1999), ku lexohet se në shënjestër të sulmeve të NATO-s ishin element të formacioneve luftarake të njëjstive dhe objekte të infrastrukturës së energjisë, ekonomisë, dhe të tjera në Gjilan.

²³³⁸ Dushan Gavraniq, T. 22680 (18 shkurt 2008), T. 22700–22702, 22739–22740 (19 shkurt 2008). *Shih gjithashtu* 5D1100 (Urdhër i Brigadës së 52-të Artilerike të Përzierë, 7 prill 1999); 5D1101 (Urdhër i Brigadës së 52-të Artilerike të Përzierë, 22 prill 1999); P1099 (Raport nga Shtabi i MPB-së në Prishtinë, 28 mars 1999).

5. Konkluzione

943. Dhoma Gjyqësore konkludon se, duke u bazuar në dëshminë okulare të Abdylhaqim Shaqirit, e konfirmuar pjesërisht nga Dushan Gavraniqi, më 6 prill 1999 rezervistët e UJ-së i urdhëruan banorët e Përlepnicës të largoheshin nga fshati. Një kolonë prej afërsisht 3,000 njerëzish u largua, por pasi e kishin kaluar kufirin krahinor, pjesëtarë të policisë i urdhëruan të ktheheshin në Përlepnicë. Në bazë të dëshmisë së të njëjtit dëshmitar, Dhoma konkludon se më 13 prill, pjesëtarët e UJ-së i urdhëruan banorët e Përlepnicës të largoheshin nga fshati dhe se, edhe një herë, u formua kolona me rreth 3.000 njerëz që u shoqërua nga policia deri në kufi me Maqedoninë. Dhoma thekson se ka dëshmi nga Shaqiri, e cila pjesërisht mbështetet nga Gavraniqi, se shtëpitë e fshatit u bastisën, u plaçkitën dhe u dogjën, por konkludon se nuk ka dëshmitarë okularë të këtyre ngjarjeve, dhe rrjedhimisht nuk mund të nxjerrë përfundim mbi shkaktarët e djegieve.

944. Nga dëshmitë e Qamil Shabanit dhe K81-shit të konfirmuara nga Franjo Gllonçaku, Dhoma Gjyqësore është bindur se UJ-ja dhe MPB-ja, të përforcuar me civilë të armatosur dhe forca të tjera jo të rregullta, ishin të pranishme në Zhegër në fund të marsit 1999. Dhoma konkludon se UJ-ja dhe MPB-ja, si dhe forcat e tjera jo të rregullta, i dëbuan shqiptarët kosovarë nga fshati me anë të kërcënimeve, rrahjeve, dhe vrasjeve, duke krijuar atmosfere frike. Rrugës për në Maqedoni, ata u keqtrajtuuan sërish. Gjithashtu Dhoma i beson dëshmisë së K81-shit në lidhje me ngjarje të ngjashme në Lladovë, ku ushtarët e UJ-së dogjën shtëpi dhe vranë fshatarë. Shqiptarët kosovarë ikën në male dhe më në fund shkuan në Maqedoni, të shoqëruar nga pjesëtarët të MPB-së dhe të UJ-së.

945. Dëshmitë e Qamil Shabanit dhe K81-shi gjithashtu tregojnë se shtëpitë në Zhegër u plaçkitën dhe dogjën nga UJ-ja, të përforcuar me civilë të armatosur dhe forca të tjera jo të rregullta. Edhe pse Dhoma Gjyqësore nuk dëgjoi dëshmitarë okularë të këtyre ngjarjeve, të dy dëshmitarët dëshmuuan se ishin djegur vetëm shtëpitë e shqiptarëve kosovarë, kurse shtëpitë e serbëve kishin mbetur të padëmtuara. Sidoqoftë, në mungesë të dëshmitarëve okularë të këtyre ngjarjeve, Dhoma nuk mund të nxjerrë konkluzion në lidhje me shkaktarët e djegieve.

946. Duke u bazuar në dëshminë e K81-shit në lidhje me këtë pikë dhe të Andrés Riedlmayer-it, e cila pjesërisht konfirmohet nga Dushan Gavraniqi, Dhoma konkludon se është vërtetuar se xhaminë në Llashticë e dogjën ushtarët e UJ-së dhe vendësit e armatosur, disa prej të cilëve kishin uniformë në ngjyrë të kaltër të mbyllët.

947. Dhoma Gjyqësore gjithashtu konkludon se disa mijëra të shpërngulur nga fshatrat Zhegër, Nosalë, dhe Lladovë kërkuan strehim në fshatin Stubëll e Poshtme, në komunën e Vitisë. Sidoqoftë, Dhoma nuk ka dëgjuar dëshmi të tjera në lidhje me ngjarjet në Nosalë dhe rrjedhimisht konkludon

se nuk është vërtetuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se banorët e fshatit u shpërngulën dhunshëm si rezultat i veprimeve të forcave të RFJ-së dhe Serbisë.

948. Duke u bazuar në dëshmitë e Shaqirit dhe Shabanit, Dhoma Gjyqësore gjithashtu konkludon se shqiptarët kosovarë të kësaj komune u keqtrajtuuan në postblloqet e UJ-së para kufirit me Maqedoninë, se u detyruan t'i linin makinat e tyre para kufirit, dhe se ushtarët u drejtuan armët dhe i kërcënuan se do t'i vrisnin. Në kufirin me Maqedoninë, policia serbe i kontrollloi dhe u mori letërnjoftimet dhe pasaportat.

949. Edhe pse Dhoma dëgjoji dëshmi për vrasjen e njerëzve, nuk ka akuza për vrasje në këtë komunë.

L. FERIZAJ

1. Akuzat në Aktakuzë

950. Aktakuza i ngarkon të Akuzuarit me përgjegjësi për dy kategori të ndryshme të krimeve kundër njerëzimit që pretendohet se janë kryer në komunën e Ferizajt prej 24 marsit deri më 14 prill 1999: dëbim dhe zhvendosje të dhunshme. Pretendimet konkrete janë paraqitur në paragrafin 72(j) të Aktakuzës si vijon:

Gjatë periudhës prej 24 marsit deri më 14 prill 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë granatuan dhe sulmuan fshatrat në komunën e Ferizajt, duke përfshirë fshatrat Bibaj, Prelez i Muhaxherëve, Rakaj dhe Katund i Vjetër, dhe vranë një numër banorësh. Pas granatimit, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë hynë në disa fshatra duke përfshirë Papazin dhe Sojevën dhe urdhëruan banorët të largoheshin. Shqiptarë kosovarë të tjerë nga Varoshi dhe Mirosala ikën nga fshatrat e tyre kur hynë forcat e RFJ-së dhe të Serbisë. Pasi banorët kishin lëshuar shtëpitë e tyre, ushtarët dhe policët i dogjën ato. Personat e shpërngulur shkuan në qytetin e Ferizajt, ku shumica hipën në trenat të cilët i çuan në vendkalimin kufitar me Maqedoninë në Han të Elezit. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i drejtuan udhëtarët e trenave të ecnin në binarët hekurudhorë deri në kufi. Të tjerët udhëtuan në kolona prej Ferizajt deri në këtë vendkalim kufitar. Në kufi, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë ua konfiskuan letërnjoftimet.

951. Akuzat e vrasjeve të përfshira në këtë paragraf nuk figurojnë veçazi si vrasje.

2. Rrethanat

952. Komuna e Ferizajt gjendet në pjesën jugore të Kosovës, me Suharekën në perëndim dhe Kaçanikun në jug. Bibaj, Starasella, dhe Sojeva gjenden në lindje të qytetit të Ferizajt, i cili është në qendër të komunës. Bibaj, që është rreth tri kilometra nga qyteti i Ferizajt, kishte rreth 1.000 banorë

me 100-120 shtëpi para bombardimeve të NATO-s dhe të gjithë ishin shqiptarë etnikë.²³³⁹ Fshati Sojevë gjendet dy kilometra në lindje të Bibajt.²³⁴⁰ Dhoma Gjyqësore nuk dëgjoi dëshmi në lidhje me madhësinë dhe përbërjen etnike të Sojevës. Para 24 marsit 1999, Starasella, e cila është në jug të Bibajt, ishte etnikisht e përzier, me 103 familje shqiptare me gjithsej 800-1.000 anëtarë, 13 familje serbe dhe disa familje rome.²³⁴¹

953. Prelezi i Muhaxherëve gjendet në pjesën veriore të komunës, kurse Papazi dhe Mirosala gjenden në verilindje.²³⁴² Mirosala kishte rreth 3.000 banorë që jetonin në 160 shtëpi.²³⁴³ Me përjashtim të pesë serbëve, e gjithë popullata e fshatit ishte shqiptare.²³⁴⁴

954. Fshati Varosh gjendet në rrugën dhe hekurudhën që çon në Kaçanik, në jug të qytetit të Ferizajt, dhe Rakaj është në kufi me komunën e Kaçanikut.²³⁴⁵

955. Dhoma Gjyqësore dëgjoi dëshmi në lidhje me incidentin konkret të përshkruar në paragrafin 72(j) të Aktakuzës nga Bedri Hyseni, Florim Krasniqi, dhe Bajram Bucaliu. Disa dëshmitarë të tjerë gjithashtu dëshmuar në lidhje me situatën e përgjithshme në komunën e Ferizajt në atë kohë. Dhoma i konsideron Hysenin, Krasniqin, dhe Bucaliun dëshmitarë të besueshëm dhe të saktë. Dhoma konstaton disa kundërshtime të dëshmisë së Hysenit nga ana e Mbrojtjes bazuar në mospërputhjet në dëshminë e tij. Sidoqoftë, ai ishte në gjendje të jepte shpjegime bindëse për çdo rast,²³⁴⁶ dhe Krasniqi, ekonomist të cilin Dhoma gjithashtu e konsideron përgjithësisht të besueshëm dhe të saktë, mbështeti Hysenin në lidhje me disa aspekte thelbësore të dëshmisë së tij.

956. Mbrojtja paraqiti ndër të tjerë Kërsman Jelliqin, komandantin e atëhershëm të Brigadës së 243-të të Mekanizuar të UJ-së, për të dëshmuar për ngjarjet në Ferizaj dhe rrethinë, si dhe disa dëshmitarë të tjerë të cilët dëshmuar në lidhje me situatën e përgjithshme në komunë në fund të marsit 1999 dhe fillim të prillit 1999. Dhoma konstaton se Jelliqi e ndërroi shpesh dëshminë e tij kur ballafaqohej me dëshmitë e tjera që ishin në kundërshtim me të tijën. Ai i mohonte akuzat me

²³³⁹ Bedri Hyseni, P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 maj 1999), f. 2, P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2001), f. 2. *Shih gjithashtu* Kërsman Jelliq, T. 18950 (23 nëntor 2007).

²³⁴⁰ Bedri Hyseni, P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 maj 1999), f. 2, P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2001), f. 5. *Shih gjithashtu* P615 (Atlasi i Kosovës 2), f. 12.

²³⁴¹ Bajram Bucaliu, T. 2981–2982 (7 shtator 2006), P2298 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 prill 1999), f. 2.

²³⁴² P615 (Atlasi i Kosovës 2), f. 12.

²³⁴³ Florim Krasniqi, P2269 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 prill 1999), f. 2.

²³⁴⁴ Florim Krasniqi, P2269 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 prill 1999), f. 2. Dhoma Gjyqësore nuk dëgjoi dëshmi mbi përbërjen etnike të Prelezit të Muhaxherëve dhe të Papazit.

²³⁴⁵ P615 (Atlasi i Kosovës 2), f. 12.

²³⁴⁶ *Shih e.g.* Bedri Hyseni, T. 3107, 3110–3111, 3121, 3130, 3135–3136 (11 shtator 2006).

deklarata të përgjithshme, të cilët më vonë dolën të pasakta.²³⁴⁷ Shpjegimet e tij të përgjithshme shpesh ishin jo të besueshme dhe e bënë Dhomën të dyshojë në besueshmërinë e dëshmisë së tij për pikat ku kundërshton dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë.²³⁴⁸

957. Bedri Hyseni, banor shqiptar kosovar i Bibajt, ishte veprimtar i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) nga viti 1991 deri në vitin 1999 dhe gjatë kohës kur dha dëshminë punonte si profesor i së drejtës.²³⁴⁹ Si anëtar i KMDLNJ-së, Hyseni kishte për detyrë të vëzhgonte situatën politike dhe shkeljet e të drejtave të njeriut në komunën e tij.²³⁵⁰ Ai gjithashtu kishte lidhje me LDK-në, parti e udhëhequr nga Ibrahim Rugova.²³⁵¹ Hyseni tha se dikur në mars 1999 pati shtim të forcave në komunë. Këto forca përbëheshin nga policë rezervistë, të cilët bashkëpunonin me forcat e rregullta të UJ-së dhe të MPB-së. Përmes mediave ai mësoi se UJ-ja dhe MPB-ja u kishin shpërndarë armë banorëve civilë serbë të komunës dhe gjatë bombardimeve të NATO-s, pa serbë vendës që kishin uniforma dhe mbanin armë.²³⁵²

958. Bislim Zyrap i dëshmoi se Zona e 6-të Operative e UÇK-së, zona e Nerodimes, përfshinte zonën e komunës së Ferizajt.²³⁵³ Komandant i kësaj zone ishte Shukri Buja.²³⁵⁴ Zyrap i gjithashtu dëshmoi se në janar 1999 pati luftime të një shkalle të ulët midis UÇK-së dhe forcave të RFJ-së/Serbisë në komunë. Gjatë këtyre përleshjeve, UÇK-ja sulmoi postbolloqet e vendosura nga MPB-ja dhe UJ-ja, të cilat pengonin lëvizjet e UÇK-së.²³⁵⁵ Sidoqoftë, një hartë e shënuar nga Zyrap i që tregon zonat e kontrolluara nga UÇK-ja dhe drejtimin e sulmeve të "forcave serbe" në fund të marsit 1999 nuk përfshin Ferizajn ndër zonat e sulmuara në atë kohë.²³⁵⁶

959. Kërsman Jelliqi dëshmoi se Ferizaj, Bibaj, Prelezi i Muhaxherëve, Rakaj, Starasella, Papazi, Varoshi, dhe Mirosala ishin në zonën e përgjegjësisë të brigadës së tij.²³⁵⁷ Ai gjithashtu dëshmoi se

²³⁴⁷ *Shih p.sh.* Kërsman Jelliq, T. 18901–18905, 18916–18918, 18946–18947 (23 nëntor 2007), T. 18977–18980, 19006, 19011, 19057–19062 (26 nëntor 2007).

²³⁴⁸ *Shih p.sh.* Kërsman Jelliq, T. 18938, 18941, 18943–18945, 18948 (23 nëntor 2007), T. 19052 (26 nëntor 2007).

²³⁴⁹ Bedri Hyseni, T. 3092, 3127, 3131–3132 (11 shtator 2006), P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2001), f. 3.

²³⁵⁰ Bedri Hyseni, P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2001), f. 3.

²³⁵¹ Bedri Hyseni, P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2001), f. 3.

²³⁵² Bedri Hyseni, T. 3092–3093 (11 shtator 2006); P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2001), f. 4.

²³⁵³ Bislim Zyrap i, T. 5932, 5934, 5967 (6 nëntor 2006), T. 6259 (10 nëntor 2006); P2469 (hartë që tregon zonat e ndryshme operative të UÇK-së). *Shih gjithashtu* P2453 (Procesverbal i mbledhjes së punës së Shtabit të Zonës Operative të Rrafshit të Dukagjinit të UÇK-së), f. 2.

²³⁵⁴ Bislim Zyrap i, T. 6209 (9 nëntor 2006).

²³⁵⁵ Bislim Zyrap i, T. 5987–5989 (7 nëntor 2006).

²³⁵⁶ P2447 (Hartë që tregon zonat e kontrolluara nga UÇK-ja).

²³⁵⁷ Kërsman Jelliq, T. 18847–18848 (22 nëntor 2007), T. 18966 (23 nëntor 2007), T. 19125 (27 nëntor 2007). *Shih gjithashtu* 5D1337 (Hartë që tregon zonën e përgjegjësisë të Brigadës së 243-të të Mekanizuar); IC141 (Hartë e shënuar nga Kërsman Jelliqi).

gjatë marsit dhe prillit 1999, forcat e tij u përforcuan me vullnetarë.²³⁵⁸ Sipas Jelliqit, gjatë shkurtit dhe marsit 1999 "terrorizmi" u përshkallëzua sidomos në zonat e Kaçanikut dhe Ferizajt.²³⁵⁹ Forcat e tij u bënë pre e sulmeve të përhershme deri në largimin nga Kosova.²³⁶⁰ Edhe Millan Koturi dëshmoi se në gjysmën e dytë të shkurtit 1999 Ferizaj u sulmua nga UÇK-ja, që rezultoi në vdekjen e 14-15 banorëve vendës dhe shumë të plagosur.²³⁶¹

3. Fshatrat Bibaj dhe Sojevë

960. Bedri Hyseni dëshmoi se, edhe pse kishte përgjithësisht prani të UÇK-së në zonë, sidomos në fshatrat Jezerc dhe Nerodime, në Bibaj dhe Sojevë nuk kishte pjesëtarë aktivë të UÇK-së deri në fillimin e bombardimeve të NATO-s.²³⁶² Kur bombardimet e NATO-s filluan më 24 mars 1999 rreth orës 20:00, shumica e banorëve të Bibajt kaluan në shtëpitë në qendër të fshatit, larg rrugës kryesore.²³⁶³ Në orën 23:00, Hyseni pa dy autoblanda, njëra prej të cilave shkoi në Sojevë ku e granatoi fshatin vazhdimisht.²³⁶⁴ Më vonë, dy autobлиндat hapën zjarr mbi shtëpitë në Bibaj. Hyseni vuri re se autobлиндat ishin ose të MPB-së, ose UJ-së, por nuk ishte në gjendje të thoshte se cilës prej të dyjave. Shtëpia e Hysenit u godit, por babai i tij i cili ishte i vetmi person në shtëpi në atë kohë, nuk u plagos.²³⁶⁵

961. Duke konfirmuar pjesërisht këtë dëshmi, Jelliqi deklaroi se ishte "thujse i sigurt" se autobлиндat e UJ-së ose të MPB-së kaluan nëpër Bibaj më 24 mars sepse atë ditë të gjitha njësitë dolën nga kazerma dhe zunë pozicione. Sidoqoftë, autobлиндat lëviznin zakonisht nga tri së bashku, asnjëherë nga dy, dhe Jelliqi nuk kishte të dhëna se autobлиндat kishin hapur zjarr. Ai tha se, po ta kishin bërë këtë, do ta kishin zbuluar pozicionin e tyre dhe do të ishin objektiva të sulmeve ajrore.²³⁶⁶

²³⁵⁸ Kërsman Jelliq, T. 18878–18879 (23 nëntor 2007); P2021 (Ditari i Luftës i Brigadës së 243-të të Mekanizuar), f. 7.

²³⁵⁹ Kërsman Jelliq, T. 18845 (22 nëntor 2007). Jelliqi dëshmoi se aktiviteti i UÇK-së kishte filluar të zhvendosej ngadalë nga zonat rurale në zonat urbane dhe në Ferizaj ndodhën tri ose katër shpërthime në qendër të qytetit.

²³⁶⁰ Kërsman Jelliq, T. 18885 (23 nëntor 2007); *Shih e.g.* P2021 (Ditari i Luftës i Brigadës së 243-të të Mekanizuar), f. 12.

²³⁶¹ Millan Kotur, T. 20647 (21 janar 2008). *Shih gjithashtu* 6D1, T. 25671–25672 (21 prill 2008) (seancë e mbyllur); Branislav Debelković, 6D1533 (deklarata e dëshmitarit e datës 7 mars 2008), para. 57 dhe 66; 6D412 (Dokumente të kriminalistikës, 13 shkurt 1999); 6D614 (Pasqyrë prej MPB-së e veprave penale të evidentuara, 1 korrik 1998 to 20 qershor 1999), f. 667, para. 448. *Por shih* Bedri Hyseni, T. 3131–3132 (11 shtator 2006).

²³⁶² Bedri Hyseni, T. 3133–3134 (11 shtator 2006), P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2001), f. 4; P615, (Atlasi i Kosovës 2), f. 11. *Shih gjithashtu* P2021 (Ditari i Luftës i Brigadës së 243-të të Mekanizuar), f. 21–23, 25–29.

²³⁶³ Bedri Hyseni, T. 3096 (11 shtator 2006); P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2001), f. 2.

²³⁶⁴ Bedri Hyseni, T. 3096 (11 shtator 2006). Hyseni tha, "Në Sojevë nuk e pamë, por ajo granatonte pa pushim të gjitha shtëpitë. Ajo gjithashtu granatoi lagjen e re në Sojevë." *Shih gjithashtu* Bedri Hyseni, P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 maj 1999), f. 2.

²³⁶⁵ Bedri Hyseni, T. 3096 (11 shtator 2006), P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2001), f. 5.

²³⁶⁶ Kërsman Jelliq, T. 18946 (23 nëntor 2007).

962. Hyseni dëshmoi se ai kishte veçanërisht frikë se mos sulmohej nga "serbët" sepse ishte anëtar i KMDLNJ-së në Ferizaj. Për shkak të këtij fakti dhe për shkak se Bibaj ishte mbushur me popullatë të shpërngulur, ai u largua nga shtëpia më 27 mars 1999 dhe shkoi së bashku me familjen te daja në Sojevë, të cilën e konsideronte më të sigurtë.²³⁶⁷

963. Më 2 prill 1999, Hyseni pa tre tanke dhe dy topa kundërajrorë të vendosur afër shtëpisë së dajës në Sojevë.²³⁶⁸ Më 4 prill, ai gjithashtu pa një njësi të UJ-së të vendosur afër rrugës kryesore jashtë fshatit, e cila bllokonte rrugën nga Sojeva për në qytetin e Ferizajt.²³⁶⁹ Jelliqi gjithashtu konfirmoi praninë e njësisë së tij në këtë komunë dhe dëshmoi se një detashment kundërtank, si dhe dy njësitë më të fuqishme të brigadës, u vendosën në rrugën që çon nga Gërlica në drejtim të komunës së Vitisë për të parandaluar hyrjen e forcave të NATO-s në Kosovë. Ai deklaroi se "pajisjet taktike" ishin në pikat e larta, prej nga "mund të hapnin zjarr mbi çdo agresor të mundshëm."²³⁷⁰

964. Më 6 prill, Hyseni pa se njësia e UJ-së e vendosur afër shtëpisë së dajës u zhvendos në shkollën e Sojevës, duke iu bashkuar një njësie tjetër të UJ-së që tashmë ishte atje.²³⁷¹ Sidoqoftë duke mos e mohuar shprehimisht praninë e njërive të tij, Jelliqi dëshmoi se "nuk kishte nevojë" që ushtria të ishte brenda fshatit, sepse fshatrat janë kryesisht në luginë dhe si rrjedhojë të papërshtatshme për mbrojtje.²³⁷²

965. Hyseni gjithashtu dëshmoi se më 6 prill, në orën 08:00, një grup prej 18 "paraushtarakësh" dhe dy "policësh" hynë në Sojevë nga drejtimi i Gjilanit.²³⁷³ "Paraushtarakët" kishin uniforma të gjelbra dhe armë automatike e thika, kurse policët kishin uniforma në ngjyrë të kaltër e të zezë dhe mbanin pushkë automatike.²³⁷⁴ Hyseni gjithashtu tha se po atë ditë ai pa vrasjen e dajës dhe dajeshës së tij, Nazmi dhe Haxhere Nebihu, nga dy prej "paraushtarakëve" me uniforma kamuflimi

²³⁶⁷ Bedri Hyseni, T. 3096, 3108–3110 (11 shtator 2006), P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 maj 1999), f. 2, (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2001), f. 5.

²³⁶⁸ Bedri Hyseni, T. 3096, 3096–3097 (11 shtator 2006).

²³⁶⁹ Bedri Hyseni, T. 3097 (11 shtator 2006), P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 maj 1999), f. 2, P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2001), f. 5. Dhoma konkludon se në deklaratën e tij të dhënë në vitin 2001, dëshmitari ka deklaruar se më 1 prill 1999 njësia u vendos afër rrugës kryesore. Megjithatë, në deklaratën e mëvonshme të dhënë në vitin 2006 si dhe në dëshminë gojore, dëshmitari tha se kjo kishte ndodhur më 3 ose 4 prill.

²³⁷⁰ Kërsmen Jelliq, T. 18947 (23 nëntor 2007). Sipas P615 (Atlasi i Kosovës 2), f. 12, Gërlica gjendet në jugperëndim të Sojevës.

²³⁷¹ Bedri Hyseni, T. 3096–3097 (11 shtator 2006), P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2001), f. 5.

²³⁷² Kërsmen Jelliq, T. 18947 (23 nëntor 2007). Sipas P615 (Atlasi i Kosovës 2), f. 12, Gërlica gjendet në jugperëndim të Sojevës.

²³⁷³ Bedri Hyseni, T. 3097–3098 (11 shtator 2006). *Shih gjithashtu* Bedri Hyseni, P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 maj 1999), f. 2, (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2001), f. 5.

²³⁷⁴ Bedri Hyseni, P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 maj 1999), f. 2.

ushtarake ngjyrë të gjelbër dhe bereta të kuqe.²³⁷⁵ "Paraushtarakët" dhe policët shkuan në lagjen e Limanajve në Sojevë, ku dogjën 90 për qind të shtëpive dhe vranë dy shqiptarë kosovarë, Qerim Ajvazin dhe Hamit Halimin, kufomat e të cilëve Hyseni i pa dy ditë pas ngjarjes.²³⁷⁶ Hyseni e pa lagjen në flakë dhe shkoi të ndihmonte në evakuimin e popullatës.²³⁷⁷

966. Florim Krasniqi, banor shqiptar kosovar i Mirosalës, e mbështeti pjesërisht këtë dëshmi duke dëshmuar se rreth asaj kohe pa zjarre në largësi dhe mendoi se po digjeshin shtëpitë në Sojevë.²³⁷⁸ Krasniqi gjithashtu konfirmoi praninë e forcave ushtarake në Sojevë në atë kohë; duke ikur nga Mirosala më 8 prill 1999 (shih më poshtë), ai pa një postbllok ushtarak në Sojevë me pesë tanke M-84.²³⁷⁹ Ushtarët në atë postbllok i ofenduan me fyerje nacionaliste.²³⁸⁰ Krasniqi mendoi se ishin ushtarë "paraushtarakë", të cilët kishin shirita të kuq dhe të kaltër në spaletat e tyre në supin e djathtë.²³⁸¹ Ai më vonë shpjegoi se, kur kishte përmendur paraushtarakët, kishte dashur të thoshte "rezervistët" u UJ-së.²³⁸² Disa prej tyre kishin uniforma të gjelbra njëngjyrëshe të përdorura më parë nga UJ-ja, kurse ushtarët e tjerë kishin uniforma kamuflimi të gjelbra.²³⁸³ Krasniqi gjithashtu dëshmoi se "të gjithë këta burra që kanë armë, në luftë mobilizohen nën një uniformë, nën një komandë pa marrë parasysh a janë paraushtarakë apo ushtri e rregullt. Rrjedhimisht nuk është i rëndësishëm dallimi midis paraushtarakëve dhe ushtarakëve. E rëndësishme është se ata ishin të mobilizuar nën flamurin jugosllav."²³⁸⁴ Dhoma konkludon se këto forca vepronin si forca të shtetit.

967. Sidoqoftë, kur u ballafaqua me këtë dëshmi, Jelliqi dëshmoi se fshatrat Sojevë dhe Komogllavë nuk ishin sulmuar asnjëherë nga ushtria, porse ato fshatra dhe zonat përreth bombardoheshin thuajse çdo ditë nga NATO-ja. Ai tha se ka të ngjarë që zjarret e para nga Hyseni dhe Krasniqi të jenë shkaktuar nga sulmet ajrore të NATO-s.²³⁸⁵ Dhoma thekson se nuk ka marrë

²³⁷⁵ Bedri Hyseni, T. 3097, 3135–3137 (11 shtator 2006), P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 maj 1999), f. 2–3.

²³⁷⁶ Bedri Hyseni, T. 3097–3098, 3135 (11 shtator 2006), P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 maj 1999), f. 3, P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2001), f. 5.

²³⁷⁷ Bedri Hyseni, T. 3135 (11 shtator 2006).

²³⁷⁸ Florim Krasniqi, P2269 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 prill 1999), f. 4.

²³⁷⁹ Florim Krasniqi, P2269 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 prill 1999), f. 5.

²³⁸⁰ Florim Krasniqi, P2269 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 prill 1999), f. 6. Ushtarët shanin me zë të lartë, "Do t'ua qijmë nënat shqiptare."

²³⁸¹ Florim Krasniqi, P2269 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 prill 1999), f. 6.

²³⁸² Florim Krasniqi, T. 3052 (8 shtator 2006).

²³⁸³ Florim Krasniqi, T. 3052–3031 (8 shtator 2006), P2269 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 prill 1999), f. 6.

²³⁸⁴ Florim Krasniqi, T. 3053–3054 (8 shtator 2006).

²³⁸⁵ Kërsman Jelliq, T. 18945 (23 nëntor 2007).

asnjë provë tjetër në lidhje me sulmet e NATO-s në Sojevë gjatë kësaj periudhe. Ajo nuk e konsideron të besueshme dëshminë e Jelliqit në lidhje me këtë pikë.²³⁸⁶

968. Dhoma Gjyqësore është bindur se Hyseni ishte në gjendje të bënte dallimin midis policëve dhe individëve që ai i quajti "paraushtarakë." Dhoma thekson dëshminë e disa dëshmitarëve të tjerë, që i përshkruan uniformat e policisë si të zeza dhe kujton se uniformat e policisë ngjyrë të kaltër të mbyllët mund të përshkruhen si thujtë të zeza.²³⁸⁷ Rrjedhimisht Dhoma nuk e pranon argumentin e Mbrojtjes së Llukiqit se përshkrimi i tij i uniformave të policisë nuk u referohet uniformave të policisë të përdorura në atë kohë.²³⁸⁸ Duke u bazuar në dëshminë e dhënë nga Krasniqi, Dhoma konkludon se rezervistët e UJ-së ishin ndër forcat e dislokuara në Sojevë në atë kohë.

969. Hyseni dhe familja e tij ikën në pyll në malet e Lugut të Zenës, ku iu bashkuan një grupi prej rreth 230 fshatarësh të tjerë.²³⁸⁹ Më pas ky grup u nda në dy grupe më të vogla. Grupi i Hysenit, i cili përbëhej prej 80 vetësh, arriti të ikte, kurse grupin tjetër e grabitën "paraushtarakët" dhe i detyruan të shkonte në këmbë në qytetin e Ferizajt.²³⁹⁰ Mirëpo Hyseni nuk e saktësoi burimin e këtij informacioni në lidhje me grupin e dytë. Gjatë katër ditëve, Hyseni dhe të tjerët në grupin e tij e kalonin natën në male dhe gjatë ditës ktheheshin në shtëpitë e tyre në Sojevë. Gjatë këtyre katër ditëve, ai dëgjoi vazhdimisht të shtëna nga armët kundërajrore.²³⁹¹

970. Më 10 prill 1999, kur ishin ende në male, Hyseni dhe të tjerët me të takuan një grup tjetër fshatarësh nga Sojeva. Ata u treguan se komandanti i njësisë tankiste të UJ-së e vendosur në shkollë u kishte dhënë urdhër të gjithë banorëve të Sojevës të largoheshin nga fshati brenda dy orësh dhe të

²³⁸⁶ Ka prova mbi sulmet e NATO-s në komunën e Ferizajt më 24 mars 1999 (Shih më lart). Ka gjithashtu prova se kazerma *Car Urosh* u sulmuar më 2 prill dhe 13 prill; P2021 (Ditari i Luftës i Brigadës së 243-të të Mekanizuar), f. 9; 5D660 (Komunikatë e Brigadës së 243-të të Mekanizuar dërguar Komandës së PrK-së, 13 prill 1999). Më 14 prill 1999, u sulmuan edhe kazerma *Car Urosh* dhe fshati Doganaj, por pa pasoja. 6D1251 (pasqyrë e ngjarjeve të sigurisë, 15 prill 1999), f. 3. Më 16 prill 1999, NATO-ja sulmoi fshatrat Varosh dhe Nekodim. 5D1286 (Komunikatë e Brigadës së 243-të të Mekanizuar dërguar Komandës së PrK-së, 16 prill 1999), f. 1. Më 24 prill, sulmet ajrore të NATO-së ishin kundër sektorit të Sojevës. P2021 (Ditari i Luftës i Brigadës së 243-të të Mekanizuar), f. 24. Më 5 maj 1999, u regjistruan sulme mbi sektorin e Sojevës dhe mbi automjetet ushtarake në fshatin Starasellë. 4D325 (Urdhër i Armatës së 3-të, 10 maj 1999). Më 15 maj 1999, u sulmua Kazerma *Car Urosh*. 5D683 (Komunikatë e Brigadës së 243-të të Mekanizuar dërguar Komandës së PrK-së, 15 maj 1999). Më 27 maj 1999, 17 raketa goditën fshatrat Starasellë dhe Bibaj, kurse më 29 maj 1999 u sulmuan fshatrat Nerodime e Epërme dhe Varosh. 5D307 (Raport Ditor i Qendrës Krahinore për Informim, 27–28 maj 1999), f. 3, 5, 7; 5D232 (Raport paraprak luftimi i PrK-së dërguar Armatës së 3-të, 28 maj 1999). *Shih gjithashtu* 5D1336 (Pasqyrë e aksioneve të NATO-s në Kosovë).

²³⁸⁷ *Shih për shembull* Reshit Salih, P2336 (deklarata e dëshmitarit e datës 29 prill 1999), f. 2–3, T. 4204–4205 (28 shtator 2006); Lutfi Ramadani, T. 4323–4324 4285–4286, 4294–4295, (28 shtator 2006). Ramadani shpjegoi se uniformat e zeza nuk ishin tamam të zeza; sidoqoftë, ai i quajti të zeza. T. 4364 (29 shtator 2006); Mehmet Krasniqi, P2341 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 prill 1999, 5 tetor 2001, dhe 7 mars 2002), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 8. *Shih nënpjesën* VI.A.3.

²³⁸⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 1131–1132.

²³⁸⁹ Bedri Hyseni, P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 maj 1999), f. 3, P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2001), f. 5.

²³⁹⁰ Bedri Hyseni, P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2001), f. 5.

shkonin në qytetin e Ferizajt.²³⁹² Përsëri, Jelliqi e mohoi këto dëshmi dhe tha se "nuk kishte dëbime. Ushtria nuk dërgoi askënd askund, nga ky fshat apo nga ndonjë fshat tjetër. Ata nuk dërguan askënd në qytetin e Ferizajt."²³⁹³

971. Më 10 prill në orën 10:00, Hyseni dhe grupi i tij shkuan rrugës për në Sojevë dhe iu bashkuan një grupi prej rreth 300 njerëzish që ishte duke pritur aty.²³⁹⁴ Pastaj, grupi i bashkuar u largua nga Sojeva me traktor dhe automjete të tjera në drejtim të qytetit të Ferizajt.²³⁹⁵ Në Bibaj, Hyseni pa shumë njësi të UJ-së, duke përfshirë tanke dhe armë kundërajrore. Ai vlerësoi se atje duhej të kenë qenë rreth 70 ushtarë.²³⁹⁶ Gjithashtu ai pa tanke dhe llogore në oborret e shtëpisë së tij dhe të babait të tij, si dhe armë kundërajrore dhe një Pincgauer pranë shtëpisë së kushëririt të tij.²³⁹⁷

972. Rrugës për në Ferizaj, Hyseni pa ushtarë të UJ-së edhe policë, të cilët e lejuan kolonën të kalonte pa e ndaluar.²³⁹⁸ Kur iu afruan qytetit, kolonën e ndalën "policë serbë të trafikut" dhe e kthyen mbrapsht. Policët i urdhëruan të vazhdonin për në Gjilan, i cili gjendet rreth 38 kilometra në juglindje të Ferizajt.²³⁹⁹ Meqenëse pjesëtarët e kolonës kishin frikë se do të mbesnin pa benzinë nëse do të vazhdonin, ata vendosën të ktheheshin në fshatin Sllatinë, i cili gjendet në jug të qytetit të Ferizajt.²⁴⁰⁰ Hyseni, gruaja e tij, dhe katër fëmijët e tyre qëndruan në këtë fshat 10-12 ditë dhe pastaj, më 22 prill 1999, shkuan në Ferizaj për t'u kujdesur për vjehrrin dhe kunatin e tij, të cilët ishin plagosur në fund të marsit dhe sepse shumë njerëz të shpërngulur ishin strehuar në Sllatinë dhe ai kishte frikë se "diçka mund të ndodhte."²⁴⁰¹

973. Hyseni dhe familja e tij qëndruan në qytetin e Ferizajt rreth pesë ditë, por pastaj vendosën të largoheshin. Arsyeja ishte sepse ishin të frikësuar, meqë çdo natë dëgjonin krisma armësh dhe

²³⁹¹ Bedri Hyseni, P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2001), f. 6.

²³⁹² Bedri Hyseni, T. 3099, 3120–3122 (11 shtator 2006); P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2001), f. 6.

²³⁹³ Kërsman Jelliq, T. 18948 (23 nëntor 2007).

²³⁹⁴ Bedri Hyseni, P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 maj 1999), f. 3; P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2001), f. 6.

²³⁹⁵ Bedri Hyseni, P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2001), f. 6.

²³⁹⁶ Bedri Hyseni, P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 maj 1999), f. 3.

²³⁹⁷ Bedri Hyseni, P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2001), f. 6.

²³⁹⁸ Bedri Hyseni, P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2001), f. 6.

²³⁹⁹ Bedri Hyseni, T. 3100, 3140–3141 (11 shtator 2006), P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 maj 1999), f. 3, (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2001), f. 6.

²⁴⁰⁰ Bedri Hyseni, T. 3100 (11 shtator 2006), P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 maj 1999), f. 3, P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2001), f. 6.

²⁴⁰¹ Bedri Hyseni, T. 3102, 3142–3145 (11 shtator 2006), P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2001), f. 6. *Shih gjithashtu* Kërsman Jelliq, T. 18948–18949 (23 nëntor 2007).

gjithashtu donin të gjenin mjekim për kunatin e tij.²⁴⁰² Qyteti ishte i zbrazët sepse "shqiptarët ishin spastruar."²⁴⁰³ Fakti se Hyseni dhe familja e tij qëndruan në komunën e Ferizajt edhe pas fillimit të bombardimeve të NATO-s tregon se arsyeja e largimit të tij nga ajo zonë nuk ishte frika nga bombat e NATO-s, siç sugjeroi Mbrojtja e Llukiqit.²⁴⁰⁴

974. Më 27 Prill, Hyseni u takua me një grup prej 30 të shpërngulurish, të cilët kishin ardhur në qytet pasi ishin dëbuar nga Nerodimja, fshat në perëndim të qytetit.²⁴⁰⁵ Mëngjesin e nesërm, ai dhe familja e tij iu bashkuan këtij grupi dhe shkuan në stacionin e autobusëve, ku ai parë katër autobusë të mbushur me njerëz.²⁴⁰⁶ Shoferi i një autobusi i lejoi Hysenin dhe familjen e tij të hipnin në autobus, por vetëm pasi kishin paguar nga 20 marka gjermane për secilin.²⁴⁰⁷ Më pas autobusët shkuan për në Maqedoni përmes komunës së Kaçanikut.²⁴⁰⁸ Në stacion e autobusëve kishte ushtarë dhe policë, por ata nuk u morën me mbushjen e autobusëve me njerëz.²⁴⁰⁹

975. Në qytetin e Kaçanikut, të katër autobusët ndaluan në një postbllok të kontrolluar nga ushtarët e UJ-së, policia, dhe rezervistë policorë e ushtarakë.²⁴¹⁰ Dy ushtarë me uniforma të gjelbra dhe pushkë automatike hipën në autobusin ku ndodhej Hyseni dhe i urdhëruan pasagjerët që të dorëzonin aparatet fotografike dhe telefonat celularë.²⁴¹¹ Hyseni njohu dy ushtarët: njëri prej tyre punonte në furrë buke, kurse tjetri në "policinë financiare" në qytetin e Ferizajt.²⁴¹² Pastaj, ushtarët zbritën tre ose katër djem të rinj nga autobusi dhe i pyetën se a ishin pjesëtarë të UÇK-së.²⁴¹³ Njëri nga djemtë e rinj u nda nga grupi, u mbajt nën kërcënimin e armëve, dhe u kërcënua me ekzekutim.

²⁴⁰² Bedri Hyseni, T. 3102, 3111–3112 (11 shtator 2006); P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 maj 1999), f. 3, (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2001), f. 7.

²⁴⁰³ Bedri Hyseni, P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 maj 1999), f. 3, P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2001), f. 7.

²⁴⁰⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 1134.

²⁴⁰⁵ Bedri Hyseni, T. 3102–3103 (11 shtator 2006), P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2001), f. 7.

²⁴⁰⁶ Bedri Hyseni, T. 3102–3103 (11 shtator 2006), P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2001), f. 7.

²⁴⁰⁷ Bedri Hyseni, P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2001), f. 7. Ai tha se autobusët mbanin mbishkrimin "Kosovatrans" në të dyja anët.

²⁴⁰⁸ Bedri Hyseni, P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2001), f. 7.

²⁴⁰⁹ Bedri Hyseni, P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 maj 1999), f. 3.

²⁴¹⁰ Bedri Hyseni, P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2001), f. 7.

²⁴¹¹ Bedri Hyseni, P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 maj 1999), f. 4, P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2001), f. 7.

²⁴¹² Bedri Hyseni, P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2001), f. 7, P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 maj 1999), f. 3, P2270 (korrigjim i deklaratës së dëshmitarit të datës 31 janar 2002), f. 2.

²⁴¹³ Bedri Hyseni, P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 maj 1999), f. 4, P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2001), f. 7.

Hyseni i dëgjoi ushtarët kur thanë se të gjithë shqiptarët kosovarë do të dërgoheshin në Shqipëri, sepse ai ishte vendi i tyre e jo Kosova.²⁴¹⁴ Në fund djali i ri u lejua të kthehej në autobus.²⁴¹⁵

976. Më në fund autobusi arriti në kalimin kufitar të Hanit të Elezit, ku kishte shumë policë. Hyseni pa shumë të shpërngulur të tjerë që vinin nga drejtimi i stacionit të trenit.²⁴¹⁶ Ai dhe të tjerët u lejuan të kalonin kufirin në grupe nga 10 vetë. Ata e kaluan kufirin më 28 prill 1999. Hysenit nuk ia morën dokumentet e identifikimit.²⁴¹⁷ Kur u kthye në Bibaj pas një viti, pa se shtëpia e tij ishte djegur.²⁴¹⁸

4. Mirosala dhe fshatrat përreth

977. Florim Krasniqi dëshmoi se rreth 200 banorë të Mirosalës, duke përfshirë dhe atë, ishin anëtarë të LDK-së.²⁴¹⁹ Si anëtar i LDK-së, ai merrej me punë humanitare.²⁴²⁰ Kur në vitin 1998 në komunën e Ferizajt mbërriti një valë të shpërngulurish, LDK-ja filloi t'i regjistronte. Pas fillimit të fushatës së NATO-s, regjistrimi i duhur i gjithë të shpërngulurve u bë u pamundshëm, por gjithsesi LDK-ja vazhdoi me punën e saj humanitare.²⁴²¹

978. Më 4 prill 1999 rreth mesditës, Krasniqi pa nga "afërsia" e fshatit të tij një kolonë shumë të madhe me automjeteve ushtarake të gjelbra duke udhëtuar në rrugën kryesore nga Gjilani për në qytetin e Ferizajt.²⁴²² Edhe pse Mbrojtja e Llazareviqit vuri në dyshim çfarë mund të ketë parë Krasniqi nga ajo largësi,²⁴²³ Dhoma vëren se kur e pyeti Krasniqin, Mbrojtja nuk i sugjeroi atij se ai nuk do të ishte në gjendje ta shihte kolonën dhe madhësinë e saj. Kolona përbëhej nga katër kamionë të mëdhenj që tërhiqnin topa, të cilët në fund u vendosën afër fshatit Softoviq.²⁴²⁴ Pastaj, topat filluar të shtinin në drejtim të fshatrave Rahovicë dhe Zllatar, të cilët gjenden afër Mirosalës.²⁴²⁵ Kur e pyetën për këtë dëshmi, Jelliqi tha se afër Softoviqit ndodhej një njësi e UJ-së. Mirëpo ai deklaroi se kjo njësi nuk do të kishte mundur të godiste Softoviqin dhe Zllatarin sepse në

²⁴¹⁴ Bedri Hyseni, P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 maj 1999), f. 4, P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2001), f. 7.

²⁴¹⁵ Bedri Hyseni, P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 maj 1999), f. 4.

²⁴¹⁶ Bedri Hyseni, P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2001), f. 7.

²⁴¹⁷ Bedri Hyseni, P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2001), f. 7.

²⁴¹⁸ Bedri Hyseni, T. 3103 (11 shtator 2006).

²⁴¹⁹ Florim Krasniqi, T. 3068–3069 (8 shtator 2006).

²⁴²⁰ Florim Krasniqi, T. 3057–3059 (8 shtator 2006).

²⁴²¹ Florim Krasniqi, T. 3057–3059 (8 shtator 2006).

²⁴²² Florim Krasniqi, P2269 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 prill 1999), f. 2.

²⁴²³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 261.

²⁴²⁴ Florim Krasniqi, P2269 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 prill 1999), f. 2. Dhoma vëren se dëshmitari përdor emrin Softaj, që është emri i ri shqiptar i Softoviqit.

²⁴²⁵ Florim Krasniqi, P2269 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 prill 1999), f. 2.

afërsi të këtyre fshatrave ndodhen njësi të UJ-së dhe, po ta kishin bërë këtë, do të kishin goditur forcat e veta.²⁴²⁶

979. Më 5 prill 1999, pasi bisedoi me banorët e Rahovicës dhe Zllatarit, Krasniqi mësoi se, si rezultat i granatimit, ishin vrarë katër njerëz ishin vrarë dhe pesë ishin plagosur. Ai mori pjesë në varrimin e tyre. Rreth orës 13:00, ai dëgjoi të shtëna automatiku nga drejtimi i fshatit Pojatishtë. Pas pak, rreth 1.000 të shpërngulur nga Pojatishta, si dhe nga qyteti i Ferizajt, Prelezi i Muhaxherëve, Muhoci, dhe shumë fshatra të tjera mbërritën në Mirosalë, meqë atje ishte qetësi dhe "forcat serbe" nuk kishin hyrë në fshat.²⁴²⁷ Krasniqi i ndihmoi të gjenin strehim në Mirosalë. Ai pyeti rreth 20-30 prej tyre; ata i thanë se forcat "ushtarake serbe" kishin hyrë në Pojatishtë dhe fshatrat përreth me tanke dhe se ushtarët kishin bastisur shtëpitë në këtë fshat (Pojatishtë); ata "ishin dëbuar me forcë nga fshati nga ushtria serbe" dhe thanë se kishin ardhur në Mirosalë për siguri.²⁴²⁸

980. Kur u ballafaqua me këto të dhëna, Jelliqi tha se "nuk ka dyshim" që në atë periudhë UJ-ja nuk hyri apo bastisi shtëpi, ose dëboi njerëz nga Pojatishta apo ndonjë fshat tjetër i afërt, sepse ishte e angazhuar në vetëmbrojtje duke mbajtur pozicionet me tanke që nga 24 marsi 1999. Sipas tij, "nuk ndodhi dëbim nga fshatrat."²⁴²⁹

981. Më 8 prill, Krasniqi pa disa automjete ushtarake të gjelbra, përfshirë një tank dhe disa autoblinda, duke shkuar drejt Mirosalës nga drejtimi i Sojevës. Krasniqi kishte përvojë ushtarake si ushtar në APJ dhe ai vuri re se tanket ishin M-84 dhe autoblindat M60, edhe pse nuk mundi të dallonte shenjat në to. Dhoma vëren se identifikimi i tankeve prej Krasniqit nuk u shqyrtua nga Mbrotjtja gjatë pyetjeve të saj për dëshmitarin. Kur kolona iu afrua periferisë së Mirosalës, disa ushtarë dolën nga autoblindat dhe vrapuan në drejtim të shtëpive të fshatit. Krasniqi hipi në një makinë dhe shkoi në drejtim të qendrës së Mirosalës, kurse vëllai i tij mori traktorin e tyre dhe bëri të njëjtën gjë. Atje ata u takuan me fshatarë të tjerë, të cilët gjithashtu po iknin dhe së bashku shkuan në drejtim të rrugës kryesore, duke u larguar nga ushtarët që po afroheshin. Kur kolona e tij, që përbëhej afërsisht prej 20 automjetesh, mbërriti të degëzimi i rrugëve, makina në ballë u kthye majtas dhe vazhdoi për një kohë të shkurtër në drejtimin e fshatit Tankosiq. Atje Krasniqi pa një

²⁴²⁶ Kërsman Jelliq, T. 18943–18944 (23 nëntor 2007).

²⁴²⁷ Florim Krasniqi, P2269 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 prill 1999), f. 2–3.

²⁴²⁸ Florim Krasniqi, T. 3063 (8 shtator 2006); P2269 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 prill 1999), f. 3–4.

²⁴²⁹ Kërsman Jelliq, T. 18944–18945 (23 nëntor 2007). Ai dëshmoi: "Njësitë kishin zënë pozicionet dhe nuk kishte kuptim që të ngiteshin tanket vërdallë. Kjo do të ishte çmenduri dhe kush do të guxonte ta bënte? Sepse, tanket do të shkatërroheshin menjëherë."

postblllok ushtarak të kontrolluar nga dy ushtarë.²⁴³⁰ Ushtarët ndaluan makinën e parë të kolonës dhe e konfiskuan.²⁴³¹ Pastaj kolona u kthye në rrugën që çon në drejtim të Ferizajt.²⁴³²

982. Jelliqi dëshmoi se në brigadën e tij ai nuk kishte asnjë tank M-84, por vetëm tanke T-55. Gjithsesi ai pranoi se njësia e tij i përdori tanket në Kosovë.²⁴³³ Dhoma nuk dyshon se Krasniqi ka parë tanke, pa marrë parasysh se a ishte në gjendje të dallonte tipat e ndryshëm e tyre apo jo. Gjithashtu Dhoma kujton dëshminë tjetër në lidhje me këtë të dhënë nga John Crosland, i cili tha se UJ-ja kishte përdorur në Kosovë tanket T-55 dhe M-84.²⁴³⁴ Jelliqi tha se, as brigada e tij e as ndonjë njësi tjetër e UJ-së nuk kishin ngritur postbllloqe. Dhoma e hedh poshtë këtë dëshmi duke u bazuar në disa dëshmi dhe dokumente, të cilat tregojnë se postbllloqet e kontrolluara nga UJ-ja ekzistonin anembanë Kosovës.²⁴³⁵

983. Pasi kaloi përmes fshatit Sojevë, kolona vazhdoi në drejtim të qytetit të Ferizajt. Rrugës Krasniqi pa shumë automjete të shkatërruara që iu dukën si të shtypur nga tanket.²⁴³⁶ Ai gjithashtu pa shumë shtëpi duke u djegur dhe shtëpi të shkatërruara.²⁴³⁷ Përgjatë rrugës kishte shumë ushtarë; disa prej tyre dukeshin se i kishin drejtuar armët në drejtim të kolonës. Kolona vazhdoi rrugën pa u penguar deri në qytetin e Ferizajt. Në hyrje të qytetit ata hasën në një postblllok policor që kontrollohej nga dy policë trafiku, të cilët i urdhëruan të shkonin në drejtim të Shkupit në Maqedoni.²⁴³⁸ Pastaj kolona u kthye, u nda dhe hyri në Ferizaj nëpër rrugë dytësore. Krasniqi dhe familja e tij mbërritën atje më 8 prill dhe qëndruan shtatë ditë në shtëpinë e një miku.²⁴³⁹

984. Më 14 prill, Krasniqi vendosi të largohej nga qyteti sepse dëgjonte vazhdimisht për vrasje të kryera nga "ushtria serbe" dhe mendonte se qëndrimi atje ishte tepër i rrezikshëm. Ai dhe familja e tij shkuan në stacion të trenit, por nuk arritën të hipnin në tren meqenëse ishte i tejmbushur. Pas largimit të trenit erdhën disa autobusë; ai dhe familja e tij hipën në njërin me të cilin shkuan deri në kalimin kufitar të Hanit të Elezit pasi kishin paguar 30 marka gjermane për person. Gjatë rrugës Krasniqi pa shumë llogore, të cilat iu dukën si llogore tankesh. Në Han të Elezit, në autobus hipën

²⁴³⁰ Florim Krasniqi, P2269 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 prill 1999), f. 5.

²⁴³¹ Florim Krasniqi, T. 3075–3077 (8 shtator 2006), P2269 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 prill 1999), f. 5.

²⁴³² Florim Krasniqi, T. 3076 (8 shtator 2006), P2269 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 prill 1999), f. 5.

²⁴³³ Kërsman Jelliq, T. 18946 (23 nëntor 2007).

²⁴³⁴ John Crosland, T. 9764–9765 (7 shkurt 2007). *Shih gjithashtu* Dragan Zhivanoviq, T. 20550 (18 janar 2008).

²⁴³⁵ *Shih për shembull* 5D1031 (Urdhër i Brigadës së 37-të të Motorizuar, 18 prill 1999); Hamide Fondaj, P2283 (deklarata e dëshmitarit e datës 9 qershor 2001), f. 4; Dragan Zllatkoviq, T. 25292–25294 (15 prill 2008); Nebojsa Bogunoviq, 6D1614 (deklarata e dëshmitarit e datës 2 prill 2008), para. 89; Agim Jemini, T. 4278 (28 shtator 2006).

²⁴³⁶ Florim Krasniqi, T. 3054–3055 (8 shtator 2006), P2269 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 prill 1999), f. 6.

²⁴³⁷ Florim Krasniqi, P2269 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 prill 1999), f. 6.

²⁴³⁸ Florim Krasniqi, T. 3055 (8 shtator 2006), P2269 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 prill 1999), f. 6.

²⁴³⁹ Florim Krasniqi, P2269 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 prill 1999), f. 6.

policë të cilët u kërkuan pasagjerëve letërnjoftimet. Krasniqit ia kthyen letërnjoftimin pasi e kishin kontrolluar. Pas kësaj autobusi vazhdoi për në stacion të trenit në Han të Elezit, ku pasagjerëve u thanë të zbrisnin.²⁴⁴⁰ Ai dhe familja e tij u detyruan të prisnin gjashtë orë ndërsa policia i ndau njerëzit dhe mblodhi paratë pre tyre që të "paganin për largimin nga vendi." Më në fund e kaluan kufirin pasi policia filloi të lejonte familjet me fëmijë të kalonin pa pasur nevojë të paganin.²⁴⁴¹

5. Starasella

985. Bajram Bucaliu, shqiptar kosovar i cili nga viti 1987 deri më 25 mars 1999 punoi si arkëtar në stacionin hekurudhor të Ferizajt, dëshmoi se më 25 mars 1999 ai u pushua nga puna. Më tej ai dëshmoi se, një javë para se të fillonin sulmet ajrore të NATO-s, ai vuri re një shtim jo të zakonshme të numrit të oficerëve ushtarakë që vinin të takonin shefin e stacionit.²⁴⁴²

986. Sipas Bucaliut, deri më 2 prill 1999, në Starasellë nuk kishte prani ushtarake e as bombardim të ndonjë objekti në fshat prej NATO-s.²⁴⁴³ Sidoqoftë, më 2 prill në orën 08:30, fshatin e pushtuan forcat e "UJ-së" të cilat kishin ardhur nga rruga Ferizaj-Gjilan.²⁴⁴⁴ Ishin rreth 40 ushtarë dhe pesë tanke ushtarake. Tanket ishin të gjelbër dhe pa tytat e gjata.²⁴⁴⁵ Ushtarët kishin uniforma kamuflimi ngjyrë të gjelbër dhe kafe pa emblema dhe bereta të gjelbra me emblemat metalike të "UJ-së" në to.²⁴⁴⁶ Ata zunë gjashtë shtëpi të e shqiptarëve kosovarë, dhe shënuan njëren prej shtëpive serbe në fshat me shkronjën "S" për identifikim.²⁴⁴⁷

987. Jelliqi e mohoi këtë dëshmi, duke thënë se UJ-ja nuk kishte qenë kurrë në Starasellë. Sidoqoftë, ai pranoi se në juglindje të fshatit ishte një njësi, e cila përgatiste mbrojtjen nga "agresioni." Me sa dinte ai, as forcat e MPB-së nuk kryen ndonjë aksion "antiterrorist" në Starasellë në atë kohë. Në mbështetje të dëshmisë së tij, Jelliqi theksoi se ushtria nuk kishte zënë pozicione në

²⁴⁴⁰ Florim Krasniqi, P2269 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 prill 1999), f. 6.

²⁴⁴¹ Florim Krasniqi, P2269 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 prill 1999), f. 6–7.

²⁴⁴² Bajram Bucaliu, P2299 (deklarata e dëshmitarit e datës 31 gusht 2001), f. 2–3. *Shih gjithashtu* Shaban Fazlia, T. 25218 (11 prill 2008).

²⁴⁴³ Bajram Bucaliu, T. 2983–2984 (7 shtator 2006).

²⁴⁴⁴ Bajram Bucaliu, T. 2981 (7 shtator 2006), P2298 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 prill 1999), f. 2, P2287 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 2059–2060. *Shih gjithashtu* P43 (Hartë e Starasellës e vizatuar me dorë, 24 prill 1999).

²⁴⁴⁵ Bajram Bucaliu, T. 2982 (7 shtator 2006), P2298 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 prill 1999), f. 2.

²⁴⁴⁶ Bajram Bucaliu, T. 2982 (7 shtator 2006), P2298 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 prill 1999), f. 2.

²⁴⁴⁷ Bajram Bucaliu, P2298 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 prill 1999), f. 2.

zonat e banuara sepse detyra e saj ishte të mbronte territorin, jo qytetet dhe fshatrat.²⁴⁴⁸ Jelliqi gjithashtu tha se kapelat e ushtarëve të UJ-së nuk kishin emblema me shkronja.²⁴⁴⁹

988. Kur pa UJ-në duke hyrë në fshat, Bucaliu dhe djali i tij tentuan të iknin nga fshati. Sidoqoftë ata u ndaluan nga njëri prej ushtarëve, i cili u prezantua si major dhe u tha se ai dhe ushtarët e tij ishin pjesë e ushtrisë së rregullt dhe se ata nuk duhej të iknin.²⁴⁵⁰ Bucaliu gjithashtu tha se më 4 prill njëri nga ushtarët i konfiskoi kamionin e tij të tipit Mercedes, i cili në atë kohë ishte i parkuar në oborrin e shtëpisë së një fqinji serb. Kamionin nuk ia kthyen më.²⁴⁵¹

989. Sipas Jelliqit, ushtria nuk i bastisi fshatrat sepse nuk ishte e autorizuar për këtë e as të kontrollonte letërnjoftimet e njerëzve. Jelliqi gjithashtu deklaroi se për çdo automjet të marrë nga individët për qëllime mobilizimi ishte lëshuar dokument.²⁴⁵²

990. Më tej Bucaliu dëshmoi se, më 5 prill 1999, rreth orës 08:30, UJ-ja u largua nga Starasella në drejtim të Gjilanit.²⁴⁵³ Kur u larguan, ata u vunë zjarrin shtëpive në të cilat kishin qëndruar.²⁴⁵⁴ Në të njëjtën ditë diku midis orës 15:00 dhe 16:00, në fshat erdhën rreth 80 "paraushtarakë" me pesë tanke ushtarake dhe dy autobusë.²⁴⁵⁵ Bucaliu shpjegoi se tanket ishin të njëjta si të ushtarëve të "rregullt."²⁴⁵⁶ Ata vendosën ndalim-qarkullimin në fshat prej orës 19:00 deri në orën 07:00 të mëngjesit tjetër. Tre nga "paraushtarakët" hynë në shtëpinë e Bucaliut dhe njëri prej tyre i drejtoi revolen njërit prej kushërinjve të tij, një djali të ri. Ata i kërkuan Bucaliut letërnjoftimin; pastaj kontrolluan traktorin e tij.²⁴⁵⁷ Pas kontrollit, ata e urdhëruan që të mos largohej nga fshati sepse donin t'i përdornin shqiptarët kosovarë si mburoja njerëzore kur të vinte "këmbësoria e Klintonit."²⁴⁵⁸ Gjithashtu "paraushtarakët" i urdhëruan burrat vendës të hapnin llogore.²⁴⁵⁹

²⁴⁴⁸ Kërsman Jelliq, T. 18938, 18941 (23 nëntor 2007).

²⁴⁴⁹ Kërsman Jelliq, T. 18939 (23 nëntor 2007).

²⁴⁵⁰ Bajram Bucaliu, T. 2983 (7 shtator 2006), P2298 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 prill 1999), f. 2, P2287 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 2060–2062.

²⁴⁵¹ Bajram Bucaliu, T. 2984, (7 shtator 2006), T. 3020–3023 (8 shtator 2006), P2298 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 prill 1999), f. 2; P2287 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 2062.

²⁴⁵² Kërsman Jelliq, T. 18938–18939, 18941–18942 (23 nëntor 2007).

²⁴⁵³ Bajram Bucaliu, T. 2984 (7 shtator 2006).

²⁴⁵⁴ Bajram Bucaliu, T. 2984 (7 shtator 2006), T. 3035 (8 shtator 2006), P2298 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 prill 1999), f. 3, P2287 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 2063.

²⁴⁵⁵ Bajram Bucaliu, T. 2985 (7 shtator 2006), P2287 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 2064, P2298 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 prill 1999), f. 3.

²⁴⁵⁶ Bajram Bucaliu, P2298 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 prill 1999), f. 4.

²⁴⁵⁷ Bajram Bucaliu, P2298 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 prill 1999), f. 3.

²⁴⁵⁸ Bajram Bucaliu, T. 2987 (7 shtator 2006), P2298 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 prill 1999), f. 3–4, P2299 (deklarata e dëshmitarit e datës 31 gusht 2001), f. 3.

²⁴⁵⁹ Bajram Bucaliu, T. 2987 (7 shtator 2006), P2298 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 prill 1999), f. 4.

991. Bucaliu dëshmoi se "paraushtarakët" e quanin veten "forca vullnetare." Ata kishin të veshur uniforma ushtarake kamuflimi me ngjyrë të gjelbër, dhe së paku disa prej tyre kishin emblema në krahun e majtë me mbishkrimin "Sërpski Çetnički Pokret" (Lëvizja Çetnike Serbe),²⁴⁶⁰ kjo emblemë përmbante shqiponjë të bardhë, kafkë, dhe dy kryqe.²⁴⁶¹ Ata gjithashtu kishin emblema tradicionale serbe të quajtura "kokarda" në kapela dhe pushkë automatike dhe thika të gjata të kasapëve.²⁴⁶² Disa prej tyre kishin mjekra dhe flokë të gjatë. Mosha e tyre ishte prej 18 deri në 60.²⁴⁶³ Ata i thanë Bucaliut se ishin serbë nga Sombori dhe Apatini dhe se ishin njerëz të Sheshelit.²⁴⁶⁴ Ata konfiskuan automjete të ndryshme dhe u zhvaten para vendësve; Bucaliut iu desh t'u jepte 300 marka gjermane.²⁴⁶⁵

992. Jelliqi tha se nuk kishte dijeni se në Starasellë kishin hyrë paraushtarakë kishin hyrë, siç dëshmoi Bucaliu. Në brigadën e tij nuk kishte forca paraushtarake.²⁴⁶⁶ Ai gjithashtu dëshmoi se ushtarët e UJ-së ishin stërvitur që të visheshin në pajtim me rregullat. Ai përjashtoi mundësinë që ndonjëri mund të ketë pasur mjekër të gjatë, flokë të gjatë, ose të mbante "kokardë" në uniformë sepse kjo do të ishte në kundërshtim me rregullat e shërbimit.²⁴⁶⁷

993. Një "prift" mysliman i tha Bucaliut se në mbrëmjen e 13 prillit 1999 tre "ushtarë paraushtarakë" kishin vrarë Emin Zekën dhe djemtë e tij Habib dhe Faruk Zekën, të gjithë civilë, dhe kishin marrë katër civilë të tjerë në drejtim të panjohur.²⁴⁶⁸ Të nesërmen, nga frika, 500-600 vetë, përfshirë edhe gruan dhe fëmijët e Bucaliut, u mbledhën në qendër të fshatit dhe filluan të largoheshin në këmbë, sepse automjetet ua kishin konfiskuar.²⁴⁶⁹ Mbetën vetëm katër familje si edhe Bucaliu, i cili vendosi të rrinte me nënën e sëmurë. Sidoqoftë, më vonë atë ditë edhe ai vendosi të largohej dhe shkoi në qytetin e Ferizajt me biçikletë.²⁴⁷⁰ Te ura te degëzimi me rrugën

²⁴⁶⁰ Bajram Bucaliu, T. 2986–2987 (7 shtator 2006).

²⁴⁶¹ Bajram Bucaliu, P2298 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 prill 1999), f. 3.

²⁴⁶² Bajram Bucaliu, T. 2985–2986 (7 shtator 2006), P2298 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 prill 1999), f. 3.

²⁴⁶³ Bajram Bucaliu, T. 2985–2986 (7 shtator 2006).

²⁴⁶⁴ Bajram Bucaliu, T. 2987 (7 shtator 2006), P2298 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 prill 1999), f. 3.

²⁴⁶⁵ Bajram Bucaliu, P2298 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 prill 1999), f. 4.

²⁴⁶⁶ Kërsman Jelliq, T. 18940 (23 nëntor 2007).

²⁴⁶⁷ Kërsman Jelliq, T. 18940 (23 nëntor 2007).

²⁴⁶⁸ Personat në fjalë janë Hasan dhe Fatime Zeka, Asllan Zeka dhe gruaja e tij Safete Zeka. Bajram Bucaliu, P2298 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 prill 1999), f. 4. *Shih gjithashtu* Bajram Bucaliu, T. 2988 (7 shtator 2006).

²⁴⁶⁹ Bajram Bucaliu, T. 2989–2990 (7 shtator 2006), T. 3024 (8 shtator 2006), P2298 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 prill 1999), f. 5, P2299 (deklarata e dëshmitarit e datës 31 gusht 2001), f. 3.

²⁴⁷⁰ Bajram Bucaliu, T. 2989 (7 shtator 2006), P2298 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 prill 1999), f. 5, P2299 (deklarata e dëshmitarit e datës 31 gusht 2001), f. 3.

Shkup-Prishtinë ishte një postbllok i përbashkët i ushtrisë dhe policisë ku e lejuan të kalonte.²⁴⁷¹
Atë natë ai u bashkua me pjesën tjetër të familjes në Ferizaj.²⁴⁷²

994. Në mëngjesin e 15 prillit, ai dhe familja e tij së bashku me 2.500-3.000 shqiptarë kosovarë të tjerë hipën në një tren me 10 vagonë, i cili shkonte nga Ferizaj për në Han të Elezit.²⁴⁷³ Kur kishin arritën në kufi, nuk u lejuan të zbrisnin nga treni.²⁴⁷⁴ Pas katër orësh, trenin e kthyen përsëri në Ferizaj, ku zbritën të gjithë pasagjerët.²⁴⁷⁵ Në stacion të trenit në Han të Elezit, një punëtor që e njihnte i tha se maqedonasit nuk donin të lejonin shqiptarët kosovarë të kalonin kufirin.²⁴⁷⁶ Në të njëjtën kohë, Bucaliu pa autobusë që vinin me të shpërngulur, të cilët u lejuan të kalonin kufirin.²⁴⁷⁷

995. Më 16 prill, Bucaliu dhe familja e tij hipën në një tren tjetër në Ferizaj.²⁴⁷⁸ Në tren ishin 10 "policë serbë" me uniforma dhe kapela të kaltra.²⁴⁷⁹ Policët ishin në vagonin e parë të trenit.²⁴⁸⁰ Ata shoqëronin familjet serbe nga vendet e panjohura, të cilat zbritën në Ferizaj.²⁴⁸¹ Pastaj policët vazhduan udhëtimin me Bucaliun dhe të tjerët deri në Han të Elezit. Gjysmë ore pas mbërritjes së trenit, shqiptarët kosovarë u lejuan të zbrisnin dhe të vazhdonin në këmbë përgjatë hekurudhës deri në kufi.²⁴⁸² Policia u tha pasagjerëve që të mos largoheshin nga hekurudha sepse zona ishte e minuar.²⁴⁸³ Kur po ecnin përgjatë hekurudhës, ushtarët me uniforma të zakonshme kamuflimi dhe policë në traktorë i ofenduan me zë të lartë.²⁴⁸⁴ Ata e kaluan kufirin me Maqedoninë në orën 10:00 të asaj dite dhe Bucaliut nuk ia morën dokumentet e identifikimit.²⁴⁸⁵

²⁴⁷¹ Bajram Bucaliu, P2299 (deklarata e dëshmitarit e datës 31 gusht 2001), f. 3.

²⁴⁷² Bajram Bucaliu, P2299 (deklarata e dëshmitarit e datës 31 gusht 2001), f. 3-4.

²⁴⁷³ Bajram Bucaliu, T. 3001 (7 shtator 2006), P2298 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 prill 1999), f. 5, P2299 (deklarata e dëshmitarit e datës 31 gusht 2001), f. 4; P1331 (Ditari i trafikut i datës 1 janar 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 124.

²⁴⁷⁴ Bajram Bucaliu, P2298 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 prill 1999), f. 5, P2299 (deklarata e dëshmitarit e datës 31 gusht 2001), f. 4.

²⁴⁷⁵ Bajram Bucaliu, T. 2990, 3002 (7 shtator 2006), P2298 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 prill 1999), f. 5, P2299 (deklarata e dëshmitarit e datës 31 gusht 2001), f. 4; P1331 (Ditari i trafikut i datës 1 janar 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 124.

²⁴⁷⁶ Bajram Bucaliu, T. 2990 (7 shtator 2006); P2299 (deklarata e dëshmitarit e datës 31 gusht 2001), f. 4.

²⁴⁷⁷ Bajram Bucaliu, P2299 (deklarata e dëshmitarit e datës 31 gusht 2001), f. 4.

²⁴⁷⁸ Bajram Bucaliu, T. 2991 (7 shtator 2006), P2298 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 prill 1999), f. 5, P2287 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T) T. 2071; P25 (Hartë që tregon rrugët e dëbimeve nga Ferizaj).

²⁴⁷⁹ Bajram Bucaliu, P2298 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 prill 1999), f. 5.

²⁴⁸⁰ Bajram Bucaliu, P2298 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 prill 1999), f. 5.

²⁴⁸¹ Bajram Bucaliu, T. 2991 (7 shtator 2006), P2298 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 prill 1999), f. 5.

²⁴⁸² Bajram Bucaliu, T. 2992 (7 shtator 2006), P2298 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 prill 1999), f. 5, P2299 (deklarata e dëshmitarit e datës 31 gusht 2001), f. 4-5.

²⁴⁸³ Bajram Bucaliu, T. 2992 (7 shtator 2006), P2298 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 prill 1999), f. 5.

²⁴⁸⁴ Bajram Bucaliu, T. 2992 (7 shtator 2006); P2298 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 prill 1999), f. 5; P2299 (deklarata e dëshmitarit e datës 31 gusht 2001), f. 5.

²⁴⁸⁵ Bajram Bucaliu, P2298 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 prill 1999), f. 5.

996. Dhoma Gjyqësore merr parasysh dëshmitë e diskutuara më lart në pjesën për Prishtinën në lidhje me transportimin e shqiptarëve kosovarë me tren deri në kufi me Maqedoninë.

6. Konkluzione

997. Dhoma Gjyqësore është bindur se më 24 mars 1999 fshati Bibaj u sulmua nga forcat e UJ-së ose të MPB-së. Në lidhje me këtë, Dhoma thekson dëshminë e Jelliqit se fshatrat Bibaj, Prelez i Muhaxherëve, Rakaj, dhe Starasellë ndodheshin në zonën e përgjegjësisë së Brigadës së 243-të të Mekanizuar të Korpusit të Prishtinës, por ai nuk ishte i pranishëm personalisht në këto vende gjatë ngjarjeve që pretendohen në Aktakuzë.²⁴⁸⁶

998. Dhoma Gjyqësore gjithashtu konkludon se në fillim të prillit 1999, njësitë e UJ-së, policisë, dhe forcat shoqëruese të armatosura u dislokuan në fshatin e afërt të Sojevës. Shtëpive iu vu zjarri dhe së paku dy civilë u vranë në Sojevë nga policia dhe forca të tjera të paidentifikuara, kurse fshatarët u dëbuan dhe u detyruan të shkonin në këmbë deri në qytetin e Ferizajt. Qindra njerëz u larguan në kolona me traktorë dhe automjete të tjera, si dhe në këmbë. Policia dhe forcat e tjera të armatosura u vunë zjarrin shumë shtëpive në Sojevë.

999. Dhoma Gjyqësore është bindur se elemente të Brigadës së 243-të të Mekanizuar të Korpusit të Prishtinës, rezervistë, dhe pjesëtarë të MPB-së ishin midis forcave që morën pjesë në dëbimin e shqiptarëve kosovarë nga Sojeva.

1000. Dhoma Gjyqësore gjithashtu konkludon se në fillim të prillit 1999, njësitë e UJ-së zunë pozicione në fshatin Softaj dhe granatuan në drejtim të fshatrave Rahovicë dhe Zllatar, që gjenden afër Mirosalës. Siç është theksuar më lart, Dhoma e konsideroi jobindëse orvatjen e Jelliqit për të përgënjeshtuar dëshmitë e dëshmitarëve okularë. Dhoma konkludon se nuk është provuar se më 5 prill forcat e UJ-së rrethuan fshatin Pojatishtë me tanke dhe hynë e kontrolluan shtëpitë si dhe dëbuan popullatën civile, sepse të vetmet prova që janë paraqitur në lidhje me këtë janë vetëm dëshmi të dorës së dytë. Sidoqoftë, Dhoma pranon se në fillim të prillit 1999, në Mirosalë erdhën afërsisht 1.000 njerëz.

1001. Dhoma Gjyqësore është bindur se trupat e UJ-së hynë në Mirosalë më 8 prill 1999 me një tank dhe se njerëzit që ishin në fshat kishin ikur në atë moment.

²⁴⁸⁶ Provat tregojnë se Jelliqi ishte i pranishëm në komunën e Kaçanikut më 24 mars 1999, *Shih* 6D1, T. 25677 (21 prill 2008) (seancë e mbyllur).

1002. Dhoma konkludon se më 5 prill 1999 një grup prej rreth 80 "paraushtarakësh" hynë në fshatin Starasellë dhe vendosën ndalim-qarkullimin. Duke u bazuar në dëshmitë në lidhje me pajisjet e tyre dhe si e prezantuan veten, Dhoma është bindur se këta "paraushtarakë" ishin përfshirë në UJ si vullnetarë. Kur midis banorëve të fshatit u përhap lajmi se ata kishin vlarë së paku tre vetë, shumë prej njerëzve vendosën të largoheshin nga shtëpitë e tyre.

1003. Duke u bazuar në dëshmitë e dëshmitarëve okularë Bedri Hyseni, Florim Krasniqi, Bajram Bucaliu, dhe Mimir Bogosavleviq, Dhoma Gjyqësore konkludon se nga qyteti i Ferizajt, njerëzit u dërguan me autobusë dhe trena në Maqedoni dhe në kalimin kufitar në Han të Elezit. Shumë prej tyre u detyruan të zbrisnin nga treni para kufirit dhe të ecnin në këmbë përgjatë hekurudhës. Teksa ecnin, policë dhe ushtarë i fyenin me zë të lartë.

1004. Dhoma Gjyqësore nuk ka dëgjuar dëshmi se forcat e RFJ-së dhe Serbisë konfiskuan dokumente identifikimi nga njerëzit e shpërngulur në kalimin kufitar dhe as dëshmi në lidhje me akuzat në lidhje me Rakajn, Papazin, dhe Varoshin. Gjithashtu nuk u paraqit asnjë dëshmi në lidhje me pretendimet për granatimin e Prelezit të Muhaxherëve dhe Starasellës nga forcat e RFJ-së/Serbisë.

M. KAÇANIK

1. Akuzat në Aktakuzë

1005. Pretendimet konkrete në lidhje me ngjarjet në komunën e Kaçanikut përfshijnë ngjarjet që thuhet se kanë ndodhur aty prej marsit deri në maj 1999. Shkeljet bazë të dëbimit dhe zhvendosjes së dhunshme të përfshira përkatësisht në Pikat 1 dhe 2, janë të përshkruara në paragrafin 72(k) të Aktakuzës si vijon:

Prej muajit mars deri në maj të vitit 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë sulmuan fshatra në komunën e Kaçanikut dhe vetë qytetin e Kaçanikut. Ky sulm rezultoi në shkatërrimin e shtëpive dhe të objekteve fetare, duke përfshirë, ndër të tjera, xhamitë e Kotlinës dhe të Ivajës.

- a. Më 8 mars 1999 ose rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë sulmuan dhe dogjën pjesërisht fshatin Kotlinë. Më 24 mars 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë përsëri sulmuan Kotlinën me sisteme të armatimit të rëndë dhe ushtarë. Shumë burra, banorë të Kotlinës, ikën në pyje të afërta gjatë këtij sulmi, ndërsa forcat e RFJ-së dhe të Serbisë urdhëruan gratë, fëmijët dhe pleqtë që të hipnin në kamionë, të cilët i çuan në qytetin e Kaçanikut. Ata për të cilët nuk kishte vend nëpër kamionë u detyruan të ecnin pas tyre drejt Kaçanikut. Një numër burrash, banorë të Kotlinës, u vranë gjatë këtij sulmi, duke përfshirë së paku 17 burra, kufomat e të cilëve u hodhën në puse. Para se të largoheshin nga Kotlina, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë e dogjën pjesën e mbetur të fshatit. Shumë nga ata që mbetën gjallë ikën në Maqedoni.

- b. Më 27 dhe 28 mars 1999 ose rreth kësaj kohe, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë sulmuan qytetin e Kaçanikut. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë keqtrajtuuan, arrestuan, rrahën dhe pushkatuan shumë banorë shqiptarë kosovarë të Kaçanikut. Mijëra njerëz ikën në pyje të afërta dhe më në fund kaluan në këmbë kufirin me Maqedoninë. Personat e tjerë të shpërngulur nga qyteti i Kaçanikut dhe fshatrat përreth shkuan në këmbë në fshatin Stagovë, ku hipën në trena të cilët i çuan në kufirin me Maqedoninë.
- c. Më 13 prill 1999 apo rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë rrethuan fshatin Sllatinë dhe lagjen e Vatës. Pasi granatuan fshatin, trupat e këmbësoresë dhe ato policore hynë në fshat dhe i plaçkitën dhe i dogjën shtëpitë. Gjatë këtij aksioni, 13 civilë u vranë me armë zjarri. Pas këtij sulmi, një pjesë e madhe e popullatës së Sllatinës ikën në Maqedoni.
- d. Më 25 maj 1999 ose rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë sulmuan fshatin Lisnajë në komunën e Kaçanikut. Gjatë sulmit, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë vranë disa shqiptarë kosovarë, banorë të Lisnajës. Shumë banorë të Lisnajës formuan një kolonë traktorësh me rimorkio dhe ikën në Maqedoni. Banorët e tjerë ikën në fshatra të tjera ose në pyje para se të kalonin më në fund kufirin me Maqedoninë.

1006. Të akuzuarit gjithashtu akuzohen për vrasje në Pikat 3 dhe 4, në lidhje me ngjarjet e përshkruara në paragrafin 75(k) të Aktakuzës si vijon:

- a. Më 24 mars 1999 apo rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë sulmuan fshatin Kotlinë. Gjatë sulmit, shumica e shtëpive u dogjën dhe se paku 17 persona u vranë. Disa prej këtyre të vranëve u kapën në pyll, u ekzekutuan dhe u hodhën në puse. Në puse u hodhën lëndë shpërthyes.
- b. Më 13 prill 1999 apo rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë rrethuan fshatin Sllatinë dhe lagjen e Vatës. Pasi granatuan fshatin, trupat e këmbësoresë dhe ato policore hynë në fshat dhe plaçkitën dhe dogjën shtëpitë. Gjatë këtij aksioni, u vranë me armë zjarri 13 civilë.
- c. Më 21 maj 1999 ose rreth kësaj date, fshati Stagovë u rrethua nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë. Popullata u përpoq të ikte drejt maleve në lindje të fshatit. Gjatë këtij aksioni, u vranë së paku 12 persona. Pjesa më e madhe e fshatit u plaçkit dhe u dogj.
- d. Më 25 maj 1999 ose rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë rrethuan fshatin Lisnajë. Kur forcat hynë në fshat, popullatës iu dha urdhri që të mblidhej në shkollë dhe të largohej nga fshati me traktorë. Pastaj u ndanë burrat nga gratë dhe fëmijët. Gjatë këtij aksioni, u vranë 4 burra. Gjithashtu, 4 anëtarë të familjes Qorri u vranë në përpjekje për të ikur drejt pyjeve.

1007. Personat që pretendohet se janë vranë në komunën e Kaçanikut, emrat e të cilëve dihen, janë përfshirë në Listën K të Aktakuzës. Në Pikën 5, të Akuzuarit janë ngarkuar me përgjegjësi për përndjekje në formën e vrasjeve të përshkruara në paragrafin 75(k) dhe "shkatërrim apo dëmtim pa shkak të objekteve fetare të shqiptarëve kosovarë," duke përfshirë xhamitë në Kotlinë dhe Ivajë, siç është përshkruar në paragrafët 72(k) dhe 77(d) të Aktakuzës.

2. Rrethanat

1008. Komuna e Kaçanikut gjendet në pjesën jugore të Kosovës, në kufi me Maqedoninë. Dhoma Gjyqësore dëgjoji dëshmi se, në periudhën që ka lidhje me Aktakuzën, popullata e komunës ishte kryesisht shqiptare kosovare, por kishte edhe grupe të tjera etnike në numër të vogël. Në veçanti kishte banorë serbë në fshatin Kaçanik i Vjetër.²⁴⁸⁷ Fshatrat Kotlinë dhe Ivajë janë në jug dhe jugperëndim të qytetit të Kaçanikut, afër kufirit me Maqedoninë. Sllatina dhe Vataj janë më tutje në veriperëndim në kufi me komunën e Shtërpçës. Stagova është në veri të qytetit të Kaçanikut pranë hekurudhës nga Maqedonia veriore për në Prishtinë. Kalimi kryesor kufitar për në Maqedoni në këtë komunë është Hani i Elezit.²⁴⁸⁸

1009. Dhoma Gjyqësore dëgjoji tre dëshmitarë të paraqitur nga Prokuroria në lidhje me ngjarjet në fshatin Kotlinë dhe në qytetin e Kaçanikut, konkretisht Hazbi Loku, Isa Raka, dhe Muharrem Dashi. I fundit gjithashtu dëshmoi në lidhje me fshatin e tij, Stagovën. Sejdi Lami dëshmoi për ngjarjet në Sllatinë dhe Vataj, kurse Fadil Vishi dhe dëshmitari K31 në lidhje me fshatin Lisnajë. Dhoma ka shqyrtuar me kujdes besueshmërinë e këtyre dëshmitarëve, duke marrë parasysh midis të tjerash edhe kundërshtimet e dëshmimeve të tyre gjatë pyetjeve nga Mbrojtja dhe përputhjen e dëshmimeve të tyre me dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë dhe provat dokumentare. Në përgjithësi, Dhoma i konsideron këta dëshmitarë të besueshëm, por nuk pranon të gjithë dëshminë e tyre në lidhje me praninë e UÇK-së në atë zonë. Dhoma i ka diskutuar më poshtë në më shumë hollësi shqetësimet e saj në lidhje me dëshminë e dhënë nga Hazbi Loku për ngjarjet në Kotlinë më 24 mars 1999. Gjithashtu Dhoma dëgjoji dëshmi në lidhje me situatën e përgjithshme në komunë nga dëshmitarët K73, Bislim Zyrapi, dhe Klaus Naumann dhe konkludoi se mund të mbështetet në to.

1010. Kërsman Jelliqi, ish-komandanti i Brigadës së 243-të të Mekanizuar të UJ-së, dha dëshmi që kundërshtonte dëshmitë e dëshmitarëve të paraqitur nga Prokuroria. Dhoma tashmë e ka bërë të qartë në Pjesën VII.L më lart se Jelliqi ka lënë përshtypje jo të mirë dhe se i konsideron disa pjesë të dëshmisë së tij jo të besueshme. Dëshmi të tjera për situatën e përgjithshme në komunë kanë dhënë, ndër të tjerë edhe Karol John Drewienkiewicz dhe Millan Kotur. Ndërsa Dhoma ka rezerva për saktësinë e disa pjesëve të dëshmisë së Koturit, ajo e konsideron Drewienkiewicz-in të besueshëm dhe të saktë.²⁴⁸⁹

²⁴⁸⁷ Muharrem Dashi, T. 4617 (11 tetor 2006).

²⁴⁸⁸ P615 (Atlasi i Kosovës), f. 12, 16. *Shih gjithashtu* Petar Dujković, T. 23315 (27 shkurt 2008).

²⁴⁸⁹ *Shih për shembull* Millan Kotur, T. 20646 (21 janar 2008).

1011. Bislim Zyrap i sqaroi se zona e Kaçanikut ishte në zonën e gjashtë operative të UÇK-së të quajtur Nerodime.²⁴⁹⁰ Më tej Zyrap i dëshmoi se në vitin 1999, Brigada e 162-të e UÇK-së ishte e vendosur në zonën e Kaçanikut dhe përbëhej nga shqiptarë kosovarë nga ajo zonë.²⁴⁹¹ Muharrem Dashi, banor shqiptar kosovar i fshatit Stagovë, dëshmoi se Brigada e 162-të e UÇK-së, e cila njihej gjithashtu si "njësia Agim Bajrami," vepronte në zonën e Maleve të Sharrit (në perëndim dhe veriperëndim të komunës së Kaçanikut).²⁴⁹² Ai tha se UÇK-ja mund të ketë hyrë në fshatrat e zonës, si Gërllicë, Doganaj, Kaçanik i Vjetër, Dubravë, Runjevë, Kovaçec, Gajre, Ivajë, dhe Gjurgjedoll për t'u furnizuar me ushqime, por përndryshe nuk ishte aktive në këto fshatra.²⁴⁹³

1012. Një raport i KVM-së që përshkruan ngjarjet para 28 shkurtit 1999, parashtron se duket se UÇK-ja kishte depërtuar në masë të konsiderueshme në rajonin e Kaçanikut dhe së bashku me "milicinë" përbënin një forcë prej 120-160 vetësh. Sipas këtij raporti, UÇK-ja u tha fshatarëve në atë rajon të largoheshin, dhe thuajse shumica prej tyre ishin larguar brenda 27 shkurtit 1999.²⁴⁹⁴

1013. Jelliqi dëshmoi se fshatrat Kotlinë, Ivajë, Stagovë, Sllatinë, Vataj, dhe Dubravë ishin në zonën e përgjegjësisë së brigadës së tij.²⁴⁹⁵ Ai tha se njësitë e tij sulmoheshin vazhdimisht, sidomos në vijat Ferizaj, Kaçanik, Han i Elezit, Gilloboçicë, dhe në zonën e kufirit me Maqedoninë.²⁴⁹⁶ Ai gjithashtu tha se UÇK-ja kishte elementë territorialë të cilat nuk ishin pjesë e brigadave, të pranishme në fshatra dhe mëhalla, dhe ai besonte se ekzistonin rreth 40 elementë të tillë me gjithsej 4.000-6.000 pjesëtarë.²⁴⁹⁷ Elementët territorialë ishin "roja vendëse" të cilat mobilizonin njerëzit për të shërbyer si mbrojtës të fshatrave përkatës.²⁴⁹⁸

1014. I Akuzuari Llazareviq gjithashtu dëshmoi se fshatrat në komunën e Kaçanikut shpejt u transformuan në "vatra terroriste" në fund të shkurtit 1999.²⁴⁹⁹ Në atë kohë, ai i raportoi komandantit të Armatës së 3-të, Pavkoviqit, se kishte një përqendrim të "terroristëve" shqiptarë në

²⁴⁹⁰ Bislim Zyrap, T. 5967 (6 nëntor 2006); P2469 (Hartë që tregon shtatë zonat operative të UÇK-së siç i ka treguar Bislim Zyrap). *Shih gjithashtu* Karol John Drewienkiewicz, P2508 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 qershor 2000), para. 191.

²⁴⁹¹ Bislim Zyrap, T. 6046-6047 (7 nëntor 2006), 6259 (10 nëntor 2006); P2469 (Hartë që tregon shtatë zonat operative të UÇK-së siç i ka treguar Bislim Zyrap). *Shih gjithashtu* Hazbi Loku, T. 3185 (12 shtator 2006), P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 2; Muharrem Dashi, T. 4628-4629 (11 tetor 2006).

²⁴⁹² Muharrem Dashi, T. 4628-4629 (11 tetor 2006), 5D8 (deklarata e dëshmitarit e datës 6 qershor 1999), f. 2.

²⁴⁹³ Muharrem Dashi, T. 4628-4629 (11 tetor 2006).

²⁴⁹⁴ P680 (Dokumente Pune të Bashkuara të OSBE-së/KVM-së, 4 mars 1999), f. 4.

²⁴⁹⁵ Kërsman Jelliq, T. 18967 (23 nëntor 2007).

²⁴⁹⁶ Kërsman Jelliq, T. 18885, 18932 (23 nëntor 2007). *Shih gjithashtu* Branislav Debelkoviq, 6D1533 (deklarata e dëshmitarit e datës 7 mars 2008), para. 63-64; 6D357 (Kallëzim penal, 25 prill 1999); 5D680 (Raport paraprak luftimi i Komandës së Brigadës së 243-të të Mekanizuar, 6 qershor 1999).

²⁴⁹⁷ Kërsman Jelliq, T. 18839-18840 (22 nëntor 2007).

²⁴⁹⁸ Kërsman Jelliq, T. 18840 (22 nëntor 2007). *Shih gjithashtu* 6D1018 (Raport i MPB-së, 15 shkurt 1999).

brezin kufitar në vijën Kaçanik-Hani i Elezit-Doganaj-Glloboçicë. Sipas mendimit të tij, detyra e këtyre forcave ishte të krijonin një korridor për "infiltrimin e terroristëve" dhe armëve e pajisjeve ushtarake nga Maqedonia.²⁵⁰⁰

1015. Jelliqi tha se njerëzit u larguan nga zona në jug të Ferizajt para dhe gjatë bombardimeve të NATO-s për shkak të presionit të UÇK-së dhe mobilizimit të detyruar të popullatës për t'iu bashkuar UÇK-së.²⁵⁰¹ Millan Koturi, komandant i këmbësisë në Korpusin e Prishtinës, gjithashtu pretendoi se njëra prej arsyeve që UÇK-ja u bëri presion banorëve vendës që të largoheshin, mund të ketë qenë që largimi i tyre të paraqitej si rezultat i aksioneve të forcave të RFJ-së/Serbisë.²⁵⁰²

1016. K73-shi dëshmoi për operacionet në komunën e Kaçanikut, në të cilat kishte marrë pjesë.²⁵⁰³ Njësia e tij kreu një aksion të përbashkët me Brigadën e 72-të Speciale kundër UÇK-së në fund të janarit ose fillim të shkurtit 1999. Në atë operacion ata shkëmbyen zjarr me UÇK-në në Han të Elezit.²⁵⁰⁴ Një urdhër i Komandës së Armatës së 3-të i datës 16 mars 1999 gjithashtu e urdhëronte Batalionin Sabotues e Zbulues të Brigadës së 72-të Speciale të merrte pjesë në operacionet kundër UÇK-së në zonën e gjerë të Kaçanikut përgjatë vijave Tetovë-kufiri shtetëror-Glloboçicë-Dubravë; Shkup-Han i Elezit-Kaçanik.²⁵⁰⁵

1017. Gjatë javës nga 26 shkurti deri më 4 mars 1999, vëzhguesit e KVM-së në zonën e Kaçanikut raportonin se "autoritetet serbe" kishin kryer stërvitje në vende ku mund të kishin shkaktuar konflikt, i kishin shtuar patrullimet në zonat me ndikim të fortë të UÇK-së, "duke imponuar autoritetin e tyre në" pjesëtarët e KVM-së. Ata gjithashtu theksonin se dukej se UÇK-ja kishte "kaluar në ofensivë kundër serbëve" me disa prita dhe sulme, sidomos në periferi të Hanit të Elezit, zonë e cila kishte qenë e qetë deri atëherë. Raporti gjithashtu pohonte se pjesëtarët e UÇK-së e

²⁴⁹⁹ Vlladimir Llazareviq, T. 17858 (7 nëntor 2007). *Shih gjithashtu* 3D1048 (Komanda e Armatës së 3-të – Raport i Degës së Sigurimit dërguar Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 2 mars 1999), f. 1–2.

²⁵⁰⁰ Vlladimir Llazareviq, T. 17869–17870 (7 nëntor 2007); 5D253 (Letër e Komandës së PrK-së dërguar Komandës së Armatës së 3-të, nënshkruar nga Llazareviqi, 28 shkurt 1999), f. 1. *Shih gjithashtu* Kërsman Jelliq, T. 18845 (22 nëntor 2007).

²⁵⁰¹ Kërsman Jelliq, T. 18934–18935 (23 nëntor 2007).

²⁵⁰² Millan Kotur, T. 20646 (21 janar 2008).

²⁵⁰³ K73, T. 3295, 3297–3298, 3301–3302 (13 shtator 2006) (seancë e mbyllur).

²⁵⁰⁴ K73, P2307 (deklarata e dëshmitarit e datës 2 dhjetor 2005), para. 31–33 (e mbyllur me vulë), T. 3312–3313 (13 shtator 2006) (seancë e mbyllur).

²⁵⁰⁵ P531 (Urdhër i Armatës së 3-të, 16 mars 1999), f. 1.

kishin kaluar kufirin dhe ishin bashkuar me këtë milici, duke i inkurajuar vendësit që të largoheshin.²⁵⁰⁶

1018. Një raport tjetër i KVM-së theksonte se nga 23 shkurti deri më 11 mars 1999, një zonë tjetër luftimesh ishte bërë gradualisht më aktive kur UÇK-ja nga zonat e tjera hyri në fshatrat në jugperëndim të Kaçanikut afër kufirit me Maqedoninë. Kjo iu pasua me shtim të përqendrimit të shtuar të forcave të UJ-së dhe të policisë. Raportet për luftime në atë zonë u morën më 28 shkurt 1999, kur UÇK-ja sulmoi forcat e sigurisë në Gajre. U vra komandanti i stacionit të policisë në Kaçanik dhe katër policë u plagosën. Gjithashtu, rreth 2.000 njerëz ikën nga fshatrat e zonës së Kaçanikut për shkak të konfliktit dhe disa tentuan të kalonin kufirin me Maqedoninë.²⁵⁰⁷

1019. Karol John Drewienkiewicz, shef i operacioneve dhe zëvendës-shef i KVM-së, gjithashtu konfirmoi se, gjatë periudhës nga fundi i shkurtit deri në mes të marsit 1999, u kryen dy operacione të mëdha në zonat e Kaçanikut dhe Vushtrisë. Sipas vlerësimit të tij, këto dy operacione duhet të kenë qenë urdhëruar dhe planifikuar së paku në nivel të Korpusit të UJ-së sepse ndodhën në zonat e përgjegjësisë së më shumë se një brigade. Sipas Drewienkiewicz-it, UJ-ja dhe MPB-ja ishin në ofensivë në këtë fazë dhe i izoluan zonat në të cilat kryenin operacione, duke i pamundësuar hyrje verifikuesve të KVM-së. UJ-ja krijonte një kordon, kurse MPB-ja bënte spastrimin e terrenit përbrenda.²⁵⁰⁸ Më tej Drewienkiewicz-i dëshmoi se operacioni i UJ-së në Kaçanik filloi më 8 mars 1999 dhe ishte i suksesshëm në zbrapsjen e UÇK-së nga pikat e larta në të dyja anët e grykës, por sidomos në anën perëndimore. Pasi gryka e Kaçanikut u siguroi, UJ-ja vendosi toga apo njësi më të vogla në pikat kyçe përgjatë rrugës deri në kalimin kufitar të Hanit të Elezit.²⁵⁰⁹ Drewienkiewicz-i gjithashtu dëshmoi se, kur u largua nga Kosova më 20 mars 1999 nëpër rrugën Prishtinë-Ferizaj-Kaçanik dhe nëpërmjet kalimit kufitar të Hanit të Elezit, e gjithë rruga ishte nën kontroll të forcave të RFJ-së/Serbisë.²⁵¹⁰

1020. John Crosland-i dëshmoi se gjatë periudhës pak para fillimit të bombardimeve të NATO-s, pikat më të "nxehta" – të quajtura kështu për shkak të kombinimit të veprimeve të UÇK-së në to dhe faktit që serbët i konsideronin zona kyçe – ishin, midis të tjerash zona e Podujevës, zona e

²⁵⁰⁶ P680 (Letra të Përbashkëta Pune të OSBE-së/KVM-së), f. 1, 5. *Shih gjithashtu* Karol John Drewienkiewicz, T. 7932–7933 (5 dhjetor 2006).

²⁵⁰⁷ 3D179 (Raport i KVM-së mbi respektimin e armëpushimit prej palëve në Kosovë, 12 mars 1999), f. 2, gjithashtu i pranuar si P444. *Shih gjithashtu* Vladimir Lazareviq, T. 17869–17870 (7 nëntor 2007); Kërsman Jelliq, T. 18904 (23 nëntor 2007); P634 (Kronologji e ngjarjeve kryesore në Kosovë nga 15 tetori deri më 18 prill 1999), f. 5; 6D347 (Ankesë e MPB-së nga Dega e Hetimeve Kriminale, 28 shkurt 1999).

²⁵⁰⁸ Karol John Drewienkiewicz, P2508 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 qershor 2000), para. 190.

²⁵⁰⁹ Karol John Drewienkiewicz, P2508 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 qershor 2000), para. 191.

²⁵¹⁰ Karol John Drewienkiewicz, T. 7931 (5 dhjetor 2006).

Vushtrrisë, dhe zona e Kaçanikut.²⁵¹¹ Dhoma Gjyqësore është bindur se, pa marrë parasysh se ishte planifikuar ndonjë sulm tokësor i NATO-s nga Maqedonia, UJ-ja përgatitej për një mundësi të tillë dhe kjo ishte arsyeja pse zona e Kaçanikut kishte rëndësi të veçantë sa i përket mbrojtjes.²⁵¹²

3. Kotlina

1021. Kotlina gjendet në një luginë në jug të qytetit të Kaçanikut dhe në veriperëndim të Hanit të Elezit, rreth tre-katër kilometra nga rruga kryesore prej kalimit kufitar në drejtim të qytetit.²⁵¹³

1022. Hazbi Loku, shqiptar kosovar i cili në fillim të vitit 1999 ishte banor i Kotlinës, dëshmoi në lidhje me ngjarjet që ndodhën në fshat në mars 1999.²⁵¹⁴ Sipas Lokut, në atë kohë Kotlina ishte tërësisht e banuar me shqiptarë kosovarë, gjithsej 450-500 banorë.²⁵¹⁵ Në fshat nuk kishte pjesëtarë të UÇK-së,²⁵¹⁶ asnjë burrë nuk ishte i armatosur apo me uniformë të UÇK-së, e në fshat nuk kishte armë.²⁵¹⁷ Sidoqoftë, të rinjtë që donin t'i bashkoheshin UÇK-së mund ta bënin këtë duke shkuar në male.²⁵¹⁸ Ai gjithashtu deklaroi se e dinte se në fshatin Ivajë ishin disa pjesëtarë të UÇK-së dhe se besonte se ata i rezistonin "forcave serbe." Më vonë gjatë dëshmisë, ai tha se kur u sulmua Ivaja UÇK-ja u bëri rezistencë jo brenda fshatit por në skaj të tij.²⁵¹⁹

1023. Kërsman Jelliçi dëshmoi se Kotlina ishte "bastion terrorist,"²⁵²⁰ me rreth 200 deri në 600 "terroristë."²⁵²¹ Më tej ai deklaroi se Grupet Luftarake 3 dhe 21 të Brigadës së 243-të të Mekanizuar u pozicionuan në të dyja anët e Kotlinës dhe Ivajës para dhe gjatë marsit 1999.²⁵²²

²⁵¹¹ John Crosland, P2645 (deklarata e dëshmitarit e datës 31 tetor 2006), para. 71.

²⁵¹² *Shih, për shembull*, Vladimir Llazareviq, T. 17869–17870 (7 nëntor 2007), 18785 (22 nëntor 2007); Vlade Nonkoviq, T. 16214 (24 shtator 2007); Gjorgje Çurqin, T. 16945–16946, 16951 (5 tetor 2007); Kërsman Jelliçi, T. 18845 (22 nëntor 2007), 18906 (23 nëntor 2007), 19121 (27 nëntor 2007); Lubomir Saviq, T. 20987 (24 janar 2008); Petar Damjanac, T. 23831 (6 mars 2008); Spasoje Smilaniq, T. 15751–15752 (17 shtator 2007); P1920 (Urdhër i Shtabit të Komandës së Lartë, 29 maj 1999). *Shih gjithashtu* Christopher John Clark, 3D386 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 korrik 2001), f. 8–9; Klaus Naumann, T. 8297 (13 dhjetor 2006); Bislum Zyrapi, T. 6047 (7 nëntor 2006).

²⁵¹³ P615 (Atlas i Kosovës), f. 12; Kërsman Jelliçi, T. 19118 (27 nëntor 2007).

²⁵¹⁴ Hazbi Loku, T. 3149–3178 (11 shtator 2006), 3179–3250 (12 shtator 2006), P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999). *Shih gjithashtu* P358 (Harta e Komunës së Kaçanikut që tregon vende të ndryshme të vrasjeve, ka të shënuar Kotlinën dhe Ivajën siç i ka përshkruar Hazbi Loku gjatë dëshmisë së tij).

²⁵¹⁵ Hazbi Loku, T. 3149 (11 shtator 2006), P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 2.

²⁵¹⁶ Hazbi Loku, T. 3183–3185, 3191, 3227, 3234, 3241 (12 shtator 2006).

²⁵¹⁷ Hazbi Loku, T. 3174–3176 (11 shtator 2006), 3192 (12 shtator 2006). *Kr.* 6D1, T. 25677–25678, 25718 (21 prill 2008); 3D74 (Raport mbi ekzaminimin mjeko-ligjor); 3D179 (Raport i KVM-së mbi respektimin e armëpushimit prej palëve në Kosovë, 12 mars 1999), gjithashtu i pranuar si P444.

²⁵¹⁸ Hazbi Loku, T. 3185 (12 shtator 2006).

²⁵¹⁹ Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 2, 4D12 (transkript nga *Prokurori kundër Milloshëviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 1925, T. 3208–3209 (12 shtator 2006).

²⁵²⁰ Kërsman Jelliçi, T. 18902 (23 nëntor 2007). *Shih gjithashtu* 4D296 (Raport i Administratës së Zbulimit të Shtabit të Komandës së Lartë, 31 maj 1999).

²⁵²¹ Kërsman Jelliçi, T. 18975 (26 nëntor 2007).

a. Ngjarjet më 9 mars 1999

1024. Hazbi Loku dëshmoi se prej 1 deri më 9 mars 1999 u granatuan fshatrat afër Kotlinës, duke përfshirë dhe fshatin fqinj të Ivajës.²⁵²³ Më 9 mars 1999, rreth orës 04:00, u shkrepën dy raketa mbi Kotlinë. Nga frika se do të sulmoheshin, fshatarët u bënë gati të iknin. Ishin bërë dy plane për evakuim, një për të shkuar në qytetin e Kaçanikut dhe tjetri për t'u larguar në drejtim të Maqedonisë. Sidoqoftë, meqenëse fshatarët nuk e dinin se ku ishin vendosur "forcat serbe," nuk mund të vendosnin në cilin drejtim të shkonin. Rrjedhimisht, rreth 30 njerëz në grupe nga dy ose tre u shpërndanë të shihnin se ku ishin këto forca serbe. Midis tyre ishte vëllai i Lokut, Milaim Loku dhe një burrë me emrin Emërllah Kuçi.²⁵²⁴ Ata nuk kishin pushkë apo armë të tjera dhe ishin të veshur me rroba normale civile.²⁵²⁵ Këta njerëz u kthyen në fshat kur kundër tyre u hap zjarr dhe raportuan se rruga për në Ivajë ishte bllokuar nga "forcat serbe" dhe se e vetmja rrugë që mund të merrej ishte në drejtim të Glloboçicës, afër kufirit me Maqedoninë.²⁵²⁶

1025. Loku dëshmoi se "u vendos" që meshkujt e moshave 16-45 vjeç duhej të fshiheshin sepse kishte të ngjarë që po të kapeshin, do të vriteshin apo do të torturoheshin.²⁵²⁷ Ai vlerësoi se rreth 60 deri 70 meshkuj të kësaj grupmoshe, duke përfshirë dhe atë vetë, shkuan të fshiheshin në kanalet dhe shtretërit e thellë të përroskave, kurse fshatarët e tjerë u larguan në drejtim të Glloboçicës.²⁵²⁸ Në "Dreshec," lagje e Kotlinës, rrugën ua bllokuan pjesëtarë të UJ-së dhe të policisë me uniforma që Loku i përshkroi si "uniforma kamuflimi të kaltra të policisë." Nga vendi ku ishte, Loku ishte në gjendje të shihte se çfarë po ndodhte.²⁵²⁹ UJ-ja dhe policia filluan të qëllonin në drejtimin e përgjithshëm të grupit që të mos i linin të vazhdonin rrugën dhe si pasojë fshatarët ndaluan dhe u kthyen pas në drejtim të qendrës së Kotlinës.²⁵³⁰ Në të njëjtën kohë, Loku pa tre tanke të cilët ai i përshkroi si tanke të mëdhenj ushtarakë në ngjyrë të gjelbër të shoqëruar nga ushtarë të UJ-së, dhe dy autobllinda në ngjyrë të kaltër të mbyllët të shoqëruara nga policë duke u prirë "forcave serbe" që ishin në këmbë. Ai gjithashtu pa shtëpi duke u djegur. Ai më vonë pa se të gjitha shtëpitë në lagjen

²⁵²² Kërsman Jelliq, T. 18906–18907 (23 nëntor 2007); IC142 (Hartë e shënuar nga Kërsman Jelliq).

²⁵²³ Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 2.

²⁵²⁴ Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 2–3.

²⁵²⁵ Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 4.

²⁵²⁶ Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 2, 4D12 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 1925–1928.

²⁵²⁷ Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 2, 4D12 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 1929.

²⁵²⁸ Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 3, 4D12 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 1929.

²⁵²⁹ Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 3.

²⁵³⁰ Hazbi Loku, T. 3238 (12 shtator 2006), P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 3, 4D12 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 1929–1930.

"Dreshec" ishin djegur dhe erdhi në përfundimin se u ishte vënë zjarri nga brenda sepse shtëpitë ishin shumë larg nga njëra-tjetra e zjarri nuk mund të përhapej nga shtëpia në shtëpi.²⁵³¹ Atë ditë nuk u vra askush, por e gjithë lagjja u dogj dhe u plaçkit.²⁵³²

1026. Loku tregoi se një grup fshatarësh shkoi rreth 300 metra mbrapa në drejtim të Kotlinës para se të ktheheshin e të fshiheshin në kanal. Në të njëjtën kohë, "forcat serbe" iu afruan Kotlinës nga drejtimi i Ivajës. Ai shkoi më thellë në kanal me burrat e tjerë nga fshati dhe prej këtij vendi dëgjonte krismat e armëve dhe automjetet që kalonin pranë. Ai qëndroi i fshehur derisa nuk dëgjonte më lëvizje të automjeteve dhe krisma dhe pastaj u ngjitur në majë të kanalit dhe shkoi në fshat. Ai pa se disa shtëpi ishin shkatërruar kur tanket kishin hyrë përmes tyre. Ndërsa ai mundohej të fikte zjarret në disa nga shtëpitë që po digjeshin, meshkujt e tjerë shkuan për të kërkuar njerëzit e grupit më të madh.²⁵³³ Loku gjithashtu pa se dyqanet e fshatit ishin plaçkitur, makinat dhe traktorët ishin vjedhur ose dëmtuar, dhe shtëpitë ishin plaçkitur dhe dëmtuar nga jashtë dhe nga brenda me plumba. Shumë kafshë, përfshirë edhe bagëtinë, ishin vrarë ose plagosur nga plumbat.²⁵³⁴

1027. Më vonë atë mbrëmje, shumica e njerëzve u kthyen në fshat, por 15 prej burrave që kishin shkuar të vrojtonin në mëngjes nuk u kthyen. Gjatë disa ditëve të ardhshme, shumica prej këtyre burrave u kthyen përveç vëllait të Lokut, Milaimit, dhe Emërllah Kuçit.²⁵³⁵

1028. Përfaqësuesit e KVM-së mbërritën në Kotlinë më 10 mars 1999. Loku deklaroi se, sa kohë që ata ndodheshin atje, fshatarët ndiheshin të sigurtë.²⁵³⁶ Gjashtë ditë pas sulmit të 9 marsit, Loku dhe të tjerët mundën të dilnin dhe të kërkonin dy burrat e zhdukur dhe i gjetën kufomat e tyre afër njëra-tjetrës. Kufoma e Milaim Lokut ishte në një lum të vogël; ai ishte qëlluar në pjesën e pasme të kokës në anën e djathtë; gjithashtu kishte një plagë në anën e djathtë. Kufomën e Emërllah Kuçit e kishin ngrënë pjesërisht kafshët, por gjithsesi Loku pa dy vrime plumbash në xhaketen e tij në anën e djathtë të shpinës dhe dy vrime të tjera në anën e majtë të xhaketes.²⁵³⁷ Më vonë gjatë asaj dite, fshatarët i varrosën viktimat në varrezat e Kotlinës.²⁵³⁸

²⁵³¹ Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 3.

²⁵³² Hazbi Loku, T. 3151 (11 shtator 2006), T. 3238 (12 shtator 2006), P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 3, 4D12 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 1929–1930, 1932–1933.

²⁵³³ Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 3.

²⁵³⁴ Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 4.

²⁵³⁵ Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 3.

²⁵³⁶ Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 3–4.

²⁵³⁷ Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 3.

²⁵³⁸ Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 4.

1029. Kur Jelliqi u ballafaqua me dëshminë e Lokut, ai mohoi se ishte sulmuar Kotlina. Ai deklaroi se UJ-ja asnjëherë nuk kishte sulmuar "ndonjë fshat."²⁵³⁹ Jelliqi konfirmoi se, për shkak se UÇK-ja vrau një komandant policie në Gajre (shih më lart) në fund të shkurtit, forcat e MPB-së e kontrolluan zonën në kërkim të "terroristëve" dhe se rreth 8 ose 9 marsit 1999 ndodhi një konfrontim.²⁵⁴⁰

1030. Edhe pse Jelliqi mohoi pjesëmarrjen e UJ-së, KVM-ja raportoi se më 8 dhe 9 mars 1999, forcat e sigurimit u ndeshën me UÇK-në në fshatrat Strazhë, Halil Mahallë, Ivajë, dhe Gajre në jugperëndim të Kaçanikut, në një operacion relativisht të madh. Forcat e KVM-së që u panë nga verifikuesit e KVM-së kishin tanke, mortaja, dhe artileri kundërajrore, por verifikuesit u penguan nga forcat e sigurisë dhe nga UÇK-ja që t'i afroreshin zonës. Gjatë gjithë ditës më 9 mars, dëgjoheshin herë pas here krisma nga armë të vogla dhe mortaja dhe në atë zonë u panë lëvizje të përforcimeve të policisë dhe të UJ-së. Më 10 mars, policia informoi KVM-në se operacionet në atë zonë kishin përfunduar dhe i kishin treguar një grumbull armësh, municioni dhe uniformash ushtarake që sipas policisë ishin konfiskuar në Kotlinë dhe Ivajë.²⁵⁴¹

b. Ngjarjet më 24 mars 1999

1031. Loku dëshmoi se, më 24 mars 1999, rreth orës 06:30, "forcat serbe" granatuan Kotlinën nga katër pozicione përreth fshatit: nga drejtimi i Glloboçicës (në perëndim); nga fshati Gorancë (në jug); nga lokaliteti "Kashan;" dhe nga një zonë në veri të qytetit të Kaçanikut. Granatimi vazhdoi deri në orën 09:00. Sipas mendimit të Lokut, dukej se sulmi ishte kundër një zone ngjitur me fshatin për t'i penguar njerëzit që të iknin.²⁵⁴² Askush nga fshati nuk u përgjigj me zjarr; banorët vendës nuk kishin armë për t'i rezistuar sulmit.²⁵⁴³

1032. Rreth orës 09:00, "forcat serbe," të cilat Loku i identifikoi se përbëheshin nga UJ-ja dhe policia, filluan të përparonin në drejtim të Kotlinës dhe e rrethuan fshatin. Për shkak se ndiheshin në rrezik, fshatarët vendosën të largoheshin dhe ikën në vende të ndryshme.²⁵⁴⁴ Loku ishte në një grup prej 30 burrash që u fshehën në një grykë të thellë në anën jugore të fshatit. Ai qëndroi në majë të

²⁵³⁹ Kërsman Jelliq, T. 18904 (23 nëntor 2007).

²⁵⁴⁰ Kërsman Jelliq, T. 18904–18905 (23 nëntor 2007).

²⁵⁴¹ 3D179 (Raport i KVM-së mbi respektimin e armëpushimit prej palëve në Kosovë, 12 mars 1999), f. 2–3, gjithashtu e pranuar si P444. *Shih gjithashtu* P634 (Kronologji e ngjarjeve kryesore në Kosovë nga 15 tetori deri më to 18 prill 1999), f. 6; P407 (Libri i Kaltër i OSBE/KVM-së), f. 662, 673.

²⁵⁴² Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 4, 4D12 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 1926.

²⁵⁴³ Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 4, T. 3167 (11 shtator 2006), 4D12 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 1936–1937.

²⁵⁴⁴ Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 4, T. 3158 (11 shtator 2006).

grykës në një vend të quajtur "kalaja."²⁵⁴⁵ Grupe të tjera ikën në drejtime të ndryshme; njëri shkoi në një kodër me pyll në anën veriore të fshatit. Loku vlerësoi se në atë moment rreth 100 burra nga fshati ishin fshehur.²⁵⁴⁶ Ishte bërë një marrëveshje paraprakisht që gratë, fëmijët, dhe pleqtë të mblihdeshin në një vend të hapët ku mund të shiheshin lehtë dhe kështu mundësia që të vriteshin do të ishte më e vogël.²⁵⁴⁷

1033. Ndërsa qëndronte i fshehur në majë të grykës në jug të fshatit, Loku pa mbërritjen e tankeve dhe Pinzgauerëve. Tanket shkrepën predha mbi fshat.²⁵⁴⁸ Në majë të kodrës në anën veriore të fshatit ai pa shumë "ushtarë serbë" të cilët kishin rrethuar dhe zënë rreth 20 burra të fshatit.²⁵⁴⁹ Ata ishin rreth 400-600 metra nga vendi ku ishte Loku në kodrën në jug të fshatit. Ai deklaroi se kishte pamje të papenguar të kodrës në anën tjetër dhe të fshatit poshtë.²⁵⁵⁰ Ai gjithashtu deklaroi se asnjë nga këta burra të fshatit nuk ishte i armatosur apo anëtar i UÇK-së.²⁵⁵¹

1034. Gjithashtu Loku pa një grup të madh të grave, fëmijëve, dhe pleqve që ishin mbledhur në një fushë afër qendrës së fshatit, rreth 150 metra nga vendi ndodhej ai. Kushëriri i tij që ishte me të kishte një palë dylbi, të cilat i përdorën së bashku për të parë më mirë se çfarë po ndodhte në fshat dhe përreth. Loku tha se ishte në gjendje të shihte qartë edhe me sy të lirë se çfarë po ndodhte me gratë dhe fëmijët si dhe në kodrën në anën veriore të fshatit.²⁵⁵²

1035. Ai pa kur burrat e zënë i rrahën me kondakë pushke, i shkelmuan dhe i hodhën tatëpjetë kodrës. Në të njëjtën kohë, ushtarë të tjerë hapën zjarr në drejtim të përgjithshëm të grave dhe fëmijëve, si për t'i frikësuar. Ata gjithashtu i bënë ndërtesat shoshë me breshëri automatiku. Paniku midis fshatarëve u shtua më shumë kur burrat e zënë u rrahën në prani të grave dhe fëmijëve, duke përfshirë dhe familjet e tyre.²⁵⁵³

1036. Loku tha se forcat pjesëmarrëse kishin uniforma policie dhe jelekë kundërplumb që ishin ngjyrë të kaltër kamuflimi. Disa nga policët gjithashtu kishin maska të zeza me vrima për sytë dhe gojën. Ai pa se disa prej tyre kishin fjalën "POLICIJA" të shkruar me shkronja të bardha në shpinë.

²⁵⁴⁵ Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 4, T. 3152, 3154, 3158 (11 shtator 2006). Loku vizatoi një hartë e cila i është bashkangjitur kësaj deklarate; ai shpjegoi hartën në gjyq dhe shënoi fortesën si "Kalaja." Hazbi Loku, T. 3154 (11 shtator 2006), P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 9.

²⁵⁴⁶ Hazbi Loku, T. 3156 (11 shtator 2006).

²⁵⁴⁷ Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 4.

²⁵⁴⁸ Hazbi Loku, T. 3211 (12 shtator 2006), P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 4, 4D12 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 1939–1940.

²⁵⁴⁹ Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 4–5, T. 3158 (11 shtator 2006).

²⁵⁵⁰ Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 4, T. 3159 (11 shtator 2006).

²⁵⁵¹ Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 5.

²⁵⁵² Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 4, T. 3195 (12 shtator 2006).

²⁵⁵³ Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 5.

Të tjerët kishin shami të kuqe në kokë. Në rrahje morën pjesë edhe ushtarë me uniforma kamuflimi të gjelbra të UJ-së dhe bereta të gjelbra. Policët dhe ushtarë të UJ-së ishin ndarë në grupe: disa prej tyre rrinin me burrat e zënë; të tjerë ruanin gratë, fëmijët, dhe pleqtë; kurse një grup tjetër plaçkiste shtëpitë në fshat. Kur po bastisnin fshatin, ata gjetën gra e fëmijë të cilët nuk kishin qenë në gjendje të dilnin në fushë për t'iu bashkuar të tjerëve. Ata i dërguan në fushë dhe i bashkuan me gratë dhe fëmijët e tjerë.²⁵⁵⁴

1037. Rreth mesditës, forcat e policisë dhe të UJ-së i mblodhën në një vend të gjithë njerëzit e mbetur nga fshati.²⁵⁵⁵ Pastaj Loku i pa duke i ndarë gratë e fëmijët nga burrat pleq. Burrat u çuan në një pjesë tjetër të fushës dhe u detyruan të shtriheshin barkas përtokë. Ai pa se si disa prej tyre u shkelmuan dhe disa u goditën me kondakë pushke.²⁵⁵⁶ Disa burra me uniforma policie morën Idriz Kuçin, fshatar i moshës 55-60 vjeç.²⁵⁵⁷

1038. Rreth orës 15:00, në fshat mbërritën dy kamionë të vjetër ushtarakë të UJ-së me ngjyrë të gjelbër të mbuluar dhe rreth 400 njerëz, shumica gra e fëmijë u futën me forcë në ta. Pas kësaj kamionët u nisën në drejtim të Kaçanikut. Ata për të cilët nuk kishte vend në kamionë ecën pas tyre nën kërcënimin e armëve.²⁵⁵⁸ Edhe burrat e moshuar i detyruan të ecnin në të njëjtin drejtim, por të ndarë nga gratë dhe fëmijët.²⁵⁵⁹ Loku pa njerëzit që u rrahën, keqtrajtuat dhe kërcënuat gjatë tërë rrugës deri në Kaçanik.²⁵⁶⁰ Atyre u thoshin, "Nëse nuk ecni do t'ju vrasim këtu në rrugë."²⁵⁶¹ Sipas Lokut, në të njëjtën kohë policë dhe ushtarë të tjerë të UJ-së lëviznin nëpër fshat dhe dukej se bëheshin gati të digjnin çdo shtëpi.²⁵⁶² Më pas ai pa se të gjitha shtëpitë në fshat, duke përfshirë dhe shkollën, filluan të digjeshin thuajse njëkohësisht.²⁵⁶³

²⁵⁵⁴ Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 5.

²⁵⁵⁵ Hazbi Loku, T. 3155 (11 shtator 2006), P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 5; *Shih gjithashtu* IC34 (Kopje e hartës së vizatuar me dorë që i është bashkangjitur P2296, të përdorur nga Hazbi Loku për të treguar vendin ku ishte mbledhur popullata).

²⁵⁵⁶ Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 5, 4D12 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 1940–1941.

²⁵⁵⁷ Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 5, 4D12 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 1941.

²⁵⁵⁸ Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 5, T. 3156–3157 (11 shtator 2006), 4D12 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 1944.

²⁵⁵⁹ Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 5.

²⁵⁶⁰ Hazbi Loku, T. 3156 (11 shtator 2006), P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 5.

²⁵⁶¹ Hazbi Loku, T. 3157 (11 shtator 2006).

²⁵⁶² Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 5.

²⁵⁶³ Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 6, T. 3165–3167 (11 shtator 2006). *Shih gjithashtu* P48 (Fotografi e bërë nga Hazbi Loku që tregon vendin e shkollës së djegur në Kotlinë); P49 (Fotografi e bërë nga Hazbi Loku që tregon një shtëpi të djegur nga forcat serbe); P50 (Fotografi e bërë nga Hazbi Loku që tregon pamjen e P49, por nga një kënd tjetër).

1039. Më tej Loku pa se grupi prej 20 burrash i zënë rob u çua në drejtim të një kodre në veri të fshatit ku ishin dy gropat të mëdha, të cilat ishin hapur më herët për të bërë puse.²⁵⁶⁴ Gropat ishin rreth pesë deri gjashtë metra larg nga njëra-tjetra afërt hyrjes së fshatit.²⁵⁶⁵ Loku përsëri deklaroi se nga vendi ku ishte fshehur, i cili ishte rreth 500-600 metra nga gropat, ishte në gjendje të shihte se çfarë po ndodhte.²⁵⁶⁶ Fillimisht Loku tha se burrat i kishin duart e lidhura, por më vonë shpjegoi se pa vetëm se ata i mbanin duart mbi kokë.²⁵⁶⁷ Kur burrat e zënë rob kishin filluan t'u afroreshin gropave e kuptuan se do t'i vrisnin dhe filluan të rezistonin. Sidoqoftë, rreth 150 policë dhe ushtarë të UJ-së i rrahën dhe i tërhoqën zvarrë.²⁵⁶⁸

1040. Rreth orës 15:30, Loku pa kur hodhën dy ose tre burrat e parë në gropat, ndërsa vazhduan t'i rrihnin brutalisht. Ai dëshmoi se njëri ose dy nga burrat mund të jenë vrarë me armë zjarri. Pastaj i morën të gjithë dhe i hodhën në gropat. Rreth 30 minuta më vonë, ai dëgjoi një shpërthim të zhurmshëm nga vendi ku ishin gropat dhe pa pluhur dhe tym që ngrihej.²⁵⁶⁹ Si rezultat i "minimit" të gropave në këtë mënyrë, Loku tha se vendi ishte "rrafshuar."²⁵⁷⁰

1041. Mbrojtja e Pavkoviçit e pyeti Lokun se pse në deklaratën e tij me shkrim kishte përdorur termin "gropë" në vend të "pus" dhe kishte përmendur një "gropë" në vend të "gropave," dhe pse e ka vizatuar vetëm një gropë në hartën e vizatuar me dorë që i është bashkangjitur deklaratës.²⁵⁷¹ Loku u përgjigj se "gropë" dhe "pus" janë fjalë me kuptim të ngjashëm në gjuhën e tij dhe se ai i shënoi të dy gropat me një rreth në vizatim sepse gropat ishin shumë afër njëra-tjetrës. Mbrojtja e kundërshtoi këtë shpjegim duke i treguar një fotografi të dy gropave, ku shihej se ato ishin dy objekte të mëdha të veçanta e të dallueshme. Loku theksoi se fotografia i tregonte gropat ashtu siç ishin pasi i kishin zgjeruar për të nxjerrë kufomat prej tyre.²⁵⁷² Mbrojtja e Ojdaniçit gjithashtu bëri një sërë pyetjesh në lidhje me pamjen e gropave që Loku pa prej pikës së tij të vrojtimit, duke përdorur fotografi të vendit të gropave dhe të bimisë përreth, të bëra në maj 2006. Loku tha se

²⁵⁶⁴ Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 5, 9; Hazbi Loku, T. 3158–3159 (11 shtator 2006), T. 3229–3233 (12 shtator 2006).

²⁵⁶⁵ Hazbi Loku, T. 3158–3159, 3161 (11 shtator 2006). *Shih gjithashtu* P360 (Fotografi nga afër e gropave në kodër).

²⁵⁶⁶ Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 6, T. 3159 (11 shtator 2006), 3197–3200, 3220–3221 (12 shtator 2006); *Shih gjithashtu* Hazbi Loku, 4D13 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviçit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 2018; 4D14 (Raport nga arkivi elektronik i intervistës së ICG/OSBE-së me Hazbi Lokun), f. 1.

²⁵⁶⁷ Hazbi Loku, T. 3160 (11 shtator 2006), T. 3229–3230 (12 shtator 2006).

²⁵⁶⁸ Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 6, T. 3160 (11 shtator 2006), 3229–3230 (12 shtator 2006).

²⁵⁶⁹ Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 6; Hazbi Loku, T. 3160 (11 shtator 2006); Hazbi Loku, T. 3233 (12 shtator 2006).

²⁵⁷⁰ Hazbi Loku, T. 3160 (11 shtator 2006); P360 (Fotografi nga afër të gropave në kodër).

²⁵⁷¹ Hazbi Loku, T. 3218–3220 (12 shtator 2006); *Shih gjithashtu* Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 9.

²⁵⁷² Hazbi Loku, T. 3220–3221 (12 shtator 2006); *Shih gjithashtu* P360 (Fotografi nga afër të gropave në kodër).

pamja që kishte pasur ai kishte qenë shumë më e qartë se çfarë duket në fotografi, sepse në mars nuk kishte bimësi.²⁵⁷³

1042. Pas largimit të forcave të policisë dhe të UJ-së në drejtim të Kaçanikut, Loku dhe të tjerët që kishin mbetur, dolën nga vendet ku ishin fshehur dhe shkuan në fshat për të larguar bagëtinë.²⁵⁷⁴ Ai pa kufomën e Idriz Kuçit në oborr të një shtëpie dhe konstatoi se ai ishte qëlluar nga afër në pjesën e pasme të kokës.²⁵⁷⁵ Një grup tjetër burrash gjetën kufomën e Vejsel Vlashit, rreth 58 vjeç, në njërën nga dhomat e të njëjtës shtëpi. Ata i thanë Lokut se ai ishte qëlluar disa herë në gjoks dhe se pjesa e poshtme e kufomës së tij ishte djegur keqazi.²⁵⁷⁶ Atje, ata gjetën edhe Zimer Lokun, i cili ishte ende gjallë, por i plagosur rëndë. Ai kishte plagë në gjoks dhe këmba e tij ishte thujse e prerë nën gju. Më herët atë ditë, Hazbi Loku e kishte parë Zimer Lokun duke u rrëzuar përtokë kur po ecte në drejtim të grave dhe fëmijëve në fushë, por nuk mundi të kuptonte arsyen e rrëzimit. Zimer Loku vdiq më pas nga plagët.²⁵⁷⁷

1043. Kur u pyet pse kishin shkuar në fshat në vend që të shikonin mos kishte të shpëtuar te gropat, Loku deklaroi se burrat që u kthyen në fshat ishin ndarë; disa liruan bagëtitë, kurse të tjerët kërkuan për kufoma dhe njerëz të plagosur. Edhe pse ai nuk shkoi te gropat për të parë se mos kishte të shpëtuar, shkuan të tjerë.²⁵⁷⁸

1044. Tre fshatarë pranuan të qëndronin për të varrosur Vejselin, Idrizin, dhe Zimerin, kurse të tjerët vendosën të shkonin në Maqedoni. Grupi që shkoi në Maqedoni, përfshirë edhe Lokun, përbëhej nga 48 vetë. Ata u nisur në orën 22:00 të asaj nate dhe mbërritën në kalimin kufitar në orën 05:00 të nesërmen në mëngjes. Kishte qenë e vështirë të përcaktohej numri i njerëzve të zënë rob që ishin hedhur në gropa, sepse rreth tyre kishte shumë ushtarë të cilët ishin në lëvizje gjatë tërë kohës. Kur mbërritën në Maqedoni dhe pasi foli me njerëz të tjerë, Loku erdhi në përfundim se nuk dihej fati i 22 ose 23 vetëve në lidhje me incidentin te pusët në Kotlinë.²⁵⁷⁹

1045. Loku gjithashtu dëshmoi se, kur mbërritën në Kaçanik, njerëzit nga Kotlina, të cilët i kishin marrë me kamionë ose kishin shoqëruar kamionët në këmbë, i shpërndanë nëpër shtëpitë e banorëve vendës. Këta njerëz, duke përfshirë edhe familjen e Lokut, qëndruan në qytet për një kohë, por

²⁵⁷³ Hazbi Loku, T. 3197–3200 (12 shtator 2006); *Shih gjithashtu* 3D88 (Fotografi të fshatit Kotlinë).

²⁵⁷⁴ Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 6, T. 3212–3213 (12 shtator 2006).

²⁵⁷⁵ Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 5, 4D12 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 1941.

²⁵⁷⁶ Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 5.

²⁵⁷⁷ Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 6.

²⁵⁷⁸ Hazbi Loku, T. 3212–3213 (12 shtator 2006).

²⁵⁷⁹ Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 6.

pastaj vendosën të shkonin në Maqedoni sepse "forcat serbe" po a sulmonin qytetin. Ata ecën për disa net nëpër shtigje malore derisa më në fund arritën në Bllacë në Maqedoni.²⁵⁸⁰

1046. Një urdhër i datës 21 mars 1999 i komandës së Brigadës së 243-të të Mekanizuar, i nënshkruar nga Kërsman Jelliqi, për bllokimin dhe thyerjen dhe shkatërrimin e "terroristëve" shqiptarë në zonën e Kotlinës konfirmon se ishte urdhëruar një operacion i përbashkët i UJ-s dhe MPB-së midis tjerash edhe në fshatrat Kotlinë dhe Ivajë më 24 mars 1999. Sipas urdhrorit, Grupi Luftarak 3 në koordinim me njësitë e PJP-së duhej të thyente dhe shkatërronte trupat e "FTSH-së" përgjatë vijës së fshatrave të përmendur dhe të merrte nën kontroll atë territor.²⁵⁸¹ Një togë e SAJ-së dhe IO [skuadra zbuluese] duhej të merrnin pjesë në thyerjen dhe shkatërrimin e "forcave sabotatore dhe terroriste" përgjatë vijës së Kotlinës.²⁵⁸² Gjithashtu, një kompani e PJP-së, në koordinim me skuadrën zbuluese kishin detyrë thyerjen dhe shkatërrimin e "FTSH-së" përgjatë vijës Gajre-Ivajë, në mbrojtje të trupave, dhe për marrjen e territorit.²⁵⁸³

1047. Jelliqi, i cili konfirmoi se Grupet Luftarake 3 dhe 21 të Brigadës së 243-të të Mekanizuar ishin vendosur në të dy anët e Kotlinës dhe Ivajës para dhe gjatë marsit 1999, dëshmoi se këto njësi ishin në vijën e parë të mbrojtjes dhe nuk kishin leje të përdornin armët e rënda përveç nëse sulmoheshin.²⁵⁸⁴ Ai gjithashtu shpjegoi se, me fillimin e sulmeve ajrore të NATO-s, "forcat terroriste" filluan një sulm të madh kundër të gjitha njësisive të tij. Sidoqoftë, në zbrapsjen e këtyre sulmeve nuk u përdorën tanke.²⁵⁸⁵

1048. Kur Jelliqit iu paraqitën pjesë të dëshmisë së Lokut, fillimisht ai mohoi prerazi hyrjen ose sulmin e UJ-së në Kotlinë më 24 mars 1999 ose se kishte lëshuar ndonjë urdhër në lidhje me këtë operacion.²⁵⁸⁶ Sidoqoftë, kur iu tregua urdhri i tij, ai e ndërroi dëshminë dhe pranoi se në fakt kishte qenë vendim i tij që të planifikohej shkatërrimi i "forcave terroriste" në rajonin e gjerë të Kotlinës dhe Ivajës nga forcat e UJ-së dhe MPB-së më 23 dhe 24 mars 1999.²⁵⁸⁷ Pastaj ai shpjegoi se ishte bërë një plan me MPB-në për të "shpartalluar forcat terroriste" në atë zonë. Madhësia e njësisë

²⁵⁸⁰ Hazbi Loku, T. 3157 (11 shtator 2006).

²⁵⁸¹ 6D1465 (Komanda e Brigadës së 243-të të Mekanizuar, 21 mars 1999), f. 2.

²⁵⁸² 6D1465 (Komanda e Brigadës së 243-të të Mekanizuar, 21 mars 1999), f. 2. *Shih gjithashtu* Kërsman Jelliq, T. 18983–18984 (26 nëntor 2007).

²⁵⁸³ 6D1465 (Komanda e Brigadës së 243-të të Mekanizuar, 21 mars 1999), f. 2. *Shih gjithashtu* 6D1466 (Raport luftimi i Brigadës së 243-të të Mekanizuar, 24 mars 1999).

²⁵⁸⁴ Kërsman Jelliq, T. 18906–18907, 18909 (23 nëntor 2007); *Shih gjithashtu* IC142 (Hartë e shënuar nga Kërsman Jelliq).

²⁵⁸⁵ Kërsman Jelliq, T. 18908 (23 nëntor 2007).

²⁵⁸⁶ Kërsman Jelliq, T. 18907, 18969 (23 nëntor 2007).

²⁵⁸⁷ Kërsman Jelliq, T. 18977–18980 (26 nëntor 2007); *Shih gjithashtu* 6D1465 (Komanda e Brigadës së 243-të të Mekanizuar, 21 mars 1999).

policore u përcaktua nga shefi i SPB-së.²⁵⁸⁸ Jelliqi konfirmoi se ky operacion antiterrorist u krye nga njësitë e MPB-së dhe të UJ-së, por me më pak njësi se planifikimi fillestar. Forcat e MPB-së hynë në fshat, e bastisën dhe kontrolluan letërnjoftimet e banorëve. Ushtria nuk hyri në fshat meqë ajo e kishte rreptësisht të ndaluar të hynte në zonat e banuara.²⁵⁸⁹ Më tej ai dëshmoi se nuk kishte komanduar forcat e MPB-së që morën pjesë në operacion.²⁵⁹⁰

1049. Sipas një raporti luftimi të Brigadës së 243-të të Mekanizuar të datës 24 mars 1999, një pjesë e forcave të Grupit Luftarak 3, së bashku me një pjesë të forcave të Batalionit të 57-të Kufitar dhe dy kompanive të PJP-së, bllokuan zonën e gjerë ku ishin përqendruar "forcat terroriste" shqiptare. "Forcat terroriste" u shpartalluan, 26 "terroristë" "u likuiduan," u konfiskuan rreth 20 arka me armë, dhe në kuadër të operacion u çaktivizuan disa mina. Veprimet u kryen në zonën e fshatrave të Strzhës dhe Kotlinës në vijën Bojevë-Glloboçicë.²⁵⁹¹ Jelliqi shpjegoi se ata u informuan për numrin e viktimave pas përfundimit të operacionit kur mbërriti gjykatësi hetues dhe kur u bënë përpjekje për të identifikuar kufomat, u kryen kontrole, dhe u konfiskuan dhe u mblodhën armë.²⁵⁹²

1050. Kur u përball me dëshminë e Lokut në lidhje me vrasjet në puse, Jelliqi tha se kishte dëgjuar për incidentin më vonë nga mediat dhe gjatë procesit në Tribunal. Meqenëse njerëzit e tij nuk ishin atje, ata nuk ishin në gjendje t'ia informonin për këtë dhe nuk u informuan nga askush tjetër se kishte ndodhur diçka e tillë. Atje nuk shkuan as policia ushtarake, e as gjykatësi hetues ushtarak.²⁵⁹³ Sipas të dhënave që kishte ai, atje ishin rreth 600-700 "terroristë" dhe njerëzit në puse "me siguri" ishin vrarë në betejë që kishte ndodhur atje, edhe pse pranoi se mund të ketë pasur viktima të pafajshme. Kur Prokuroria i parashtrroi se këta njerëz kishin pësuar lëndime nga shpërthimet dhe se kufomat e tyre ishin gjetur në gropa, puse, në një rrëpirë, ai tha se, nëse kjo kishte ndodhur gjatë betejës, ai i dënonte aksionet të tilla si "çnjerëzore" dhe "të neveritshme". Ai gjithashtu dëshmoi se forcat e MPB-së kishin sjellë një gjykatës hetues dhe teknikë kriminalistë.²⁵⁹⁴

1051. Dëshmitari 6D1 dëshmoi në lidhje me hetimin e vendit të ngjarjes në Kotlinë më 24 mars 1999. Rrugës për në fshat në rrugën Ferizaj-Hani i Elezit te kryqëzimi për në Kotlinë, ekipi hetimor

²⁵⁸⁸ Kërsman Jelliq, T. 18981–18985 (26 nëntor 2007), T. 19143 (27 nëntor 2007).

²⁵⁸⁹ Kërsman Jelliq, T. 18988–18991 (26 nëntor 2007).

²⁵⁹⁰ Kërsman Jelliq, T. 19115–19118 (27 nëntor 2007).

²⁵⁹¹ 6D1466 (Raport luftimi i Brigadës së 243-të të Mekanizuar, 24 mars 1999); *Shih gjithashtu* Kërsman Jelliq, T. 18994–18997 (26 nëntor 2007).

²⁵⁹² Kërsman Jelliq, T. 18997–18998 (26 nëntor 2007).

²⁵⁹³ Kërsman Jelliq, T. 19113–19114 (27 nëntor 2007).

²⁵⁹⁴ Kërsman Jelliq, T. 19115–19118 (27 nëntor 2007). *Shih gjithashtu* Branislav Debelkoviq, T. 24268–24274, 24280–24281, 24283 (13 mars 2008); 6D502 (Notë zyrtare e MPB-së, 6 qershor 2003).

u takua me Jelliqin, i cili i informoi se operacioni në fshat kishte përfunduar dhe se ata mund të vazhdonin.²⁵⁹⁵ Ekipi mbërriti në Kotlinë në orën 17:00 në një shtëpi lart në kodër dhe jashtë hapësirës së ngushtë të fshatit, ku u thanë se kishte qenë shtabi i UÇK-së. Në shtëpi ata gjetën sasi të mëdha të pajisjeve ushtarake, pushkë, municione, thasë gjumi, dhe uniforma.²⁵⁹⁶ Kur vazhduan rrugën kodrës përpjetë, 6D1-shi parë llogore dhe disa kufoma, pranë të cilave kishte armë zjarri.²⁵⁹⁷ Ata dëgjuan krisma që vinin nga malet dhe, pasi komandanti i njësisë së PJP-së i kishte informuar se nuk mund të garantonin sigurinë e tyre, ata vendosën të largoheshin dhe të ktheheshin pas. 6D1-shi u informua nga i njëjti komandant se në atë zonë kishte pasur shumë "terroristë" dhe se pas luftimeve ata ishin larguar në drejtime të ndryshme në kodra, prej nga mund të hapnin zjarr përsëri në çdo moment.²⁵⁹⁸ Teknikët kriminalistë panë dy strehimore që dukeshin si puse dhe në afërsi të tyre ishin shumë kufoma. Në njërin nga strehimoret ishin një palë shkallë.²⁵⁹⁹ 6D1-shi pa gjashtë kufoma dhe 10 të tjera u fotografuan.²⁶⁰⁰ Të nesërmen u kthyen përsëri në vendin e ngjarjes por u ishte dashur të ktheheshin për shkak të të shtënave të dendura.²⁶⁰¹ Të gjitha këto të dhëna u shënuan në raport. Ky raport, i cili është pranuar si provë nga Dhoma, përmbante fjalën "Ivaja" të shkruar me dorë aty ku përmendej Kotlina.²⁶⁰² Kur iu tregua ky raport në gjykatë, 6D1-shi deklaroi se fjala "Ivaja" nuk kishte qenë aty më parë.²⁶⁰³

1052. Kur Lokut ia treguan fotografitë e raportit të përgatitura nga ekipi hetimor, ai mohoi se ishin të njëjtat gropat të përdorura në incident. Ai shpjegoi se gropat ishin në një vend malor plot me gurë, kurse gropat në fotografi "nuk u ngjajnë atyre në fshat." Ai gjithashtu dëshmoi se në fund të gropave në fotografi kishte ujë, mirëpo gropat që njihte ai ishin të thata.²⁶⁰⁴ Në lidhje me këtë Dhoma Gjyqësore thekson se ajo nuk ka vënë re ujë në gropat që shihen në fotografi. Gjithashtu gjatë pyetjeve nga Mbrojtja, Lokut iu kërkua që të identifikonte shtëpitë që shihen në fotografitë e

²⁵⁹⁵ 6D1, T. 25677 (21 prill 2008) (seancë e mbyllur).

²⁵⁹⁶ 6D1, T. 25677–25678, 25718 (21 prill 2008) (seancë e mbyllur); 3D74 (Raport mbi ekzaminimin kriminalistik), f. 12.

²⁵⁹⁷ 6D1, T. 25679 (21 prill 2008) (seancë e mbyllur).

²⁵⁹⁸ 6D1, T. 25679–25680 (21 prill 2008) (seancë e mbyllur).

²⁵⁹⁹ 6D1, T. 25681–25682, 25685, 25722 (21 prill 2008) (seancë e mbyllur). *Shih gjithashtu* Branisllav Debelković, T. 24282–24283 (13 mars 2008).

²⁶⁰⁰ 6D1, T. 25739–25740 (21 prill 2008) (seancë e mbyllur).

²⁶⁰¹ 6D1, T. 25682–25684 (21 prill 2008) (seancë e mbyllur).

²⁶⁰² 6D501 (Dosje e një çështjeje lidhur me një akt terrorist në Kotlinë, 24 mars 1999).

²⁶⁰³ 6D1, T. 25712 (21 prill 2008).

²⁶⁰⁴ Hazbi Loku, T. 3180–3181 (12 shtator 2006).

raportit. Për të gjitha fotografitë që iu treguan, Loku mohoi se në to kishte shtëpi të fshatit të tij.²⁶⁰⁵
Loku mohoi se kishte parë ndonjë pjesëtar të ekipit hetimor të vendit të ngjarjes.²⁶⁰⁶

1053. Duke marrë në konsideratë të gjitha provat, Dhoma Gjyqësore përfundon se më 24 mars 1999 ka pasur njëfarë pranie të UÇK-së në Kotlinë ose në afërsi. Megjithëse mund të mos ketë pasur pjesëtarë të UÇK-së në qendër të fshatit, dëshmitë tregojnë se fshati gjendet në një vend kodrinor dhe pyjor dhe UÇK-ja gjithsesi kishte pozicione në kodrat shumë afër fshatit.

1054. Në vjeshtën e vitit 1999, kur tashmë banorët e Kotlinës ishin kthyer në fshat, një ekip kriminalistësh austriakë shkoi në vendin e ngjarjes dhe ekzaminoi 22 viktima të gjetura në gropat e përshkruara nga Loku. Familjet e viktimave e ndihmuar ekipin në përpjekjet për të identifikuar viktimat. Loku gjithashtu deklaroi se shumë të tjerë erdhën të hetonin dhe fshatarët i çonin te gropat.²⁶⁰⁷ Pas nxjerrjes së kufomave nga gropat, shumica prej tyre u varrosën në oborrin e shkollës në Kotlinë, kurse të tjerët u varrosën në "varrezën e Kaçanikut."²⁶⁰⁸

1055. Sipas Lokut, varreza e Kaçanikut ishte për "heronjtë" ose "dëshmorët."²⁶⁰⁹ Megjithëse ai pranoi se varreza ishte kryesisht për UÇK-në, ai gjithashtu tha se jo të gjithë të varrosurit atje kishin qenë në UÇK.²⁶¹⁰ Nga njerëzit e vrarë në Kotlinë më 9 dhe 24 mars 1999, shtatë ose tetë prej tyre u varrosën në varrezën e Kaçanikut.²⁶¹¹ Gjatë pyetjeve nga Mbrojtja, Loku dëshmoi se disa nga këta njerëz u varrosën në varrezën e "dëshmorëve" sepse i kishin kontribuar çështjes kombëtare para 24 marsit 1999; për shembull, tre prej tyre kishin qenë mësues dhe i kishin kontribuar çështjes kombëtare përmes arsimit.²⁶¹² Sipas Lokut, këta njerëz ishin "viktima të luftës," "dëshmorë të luftës."²⁶¹³

1056. Loku i dorëzoi Dhomës fotografitë e njerëzve të vrarë në Kotlinë së bashku me fotografitë e bëra gjatë varrimit të tyre.²⁶¹⁴ Ai i identifikoi personat e vrarë në mars 1999 si vijon: Adnan Loku, Ibush Loku, Mina Kuci, Bajram Loku, Zija Loku, Ismet Loku, Sali Vasliu, Naser Loku, Mahi Loku, Danush Idriz Kuçi, Sherif Kuci, Xhemal Muradem Kuçi, Vesel Vlasi, Nexhat Ferid Kuçi, Sabri

²⁶⁰⁵ Hazbi Loku, T. 3177 (11 shtator 2006).

²⁶⁰⁶ Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 6, T. 3182, 3233 (12 shtator 2006).

²⁶⁰⁷ Hazbi Loku, T. 3161–3162 (11 shtator 2006).

²⁶⁰⁸ Hazbi Loku, T. 3167–3168 (11 shtator 2006). *Shih gjithashtu* Hazbi Loku, 4D16 (faqe shitesë me të dhëna, 5 shtator 2006), f. 2.

²⁶⁰⁹ Hazbi Loku, T. 3170–3171 (11 shtator 2006).

²⁶¹⁰ Hazbi Loku, T. 3170 (11 shtator 2006).

²⁶¹¹ Hazbi Loku, T. 3170 (11 shtator 2006), T. 3188 (12 shtator 2008). *Shih gjithashtu* 3D72 (Fotografi të gurëve të varreve, që tregojnë se, për shembull, Neshat Rexha, Mahim Loku dhe Xhemajl Kuçi ishin varrosur aty.)

²⁶¹² Hazbi Loku, T. 3191–3192 (12 shtator 2006).

²⁶¹³ Hazbi Loku, T. 3205–3206 (12 shtator 2006). *Shih gjithashtu* 3D72 (Fotografi të gurëve të varreve).

²⁶¹⁴ P380 (Komplet i 24 fotografive të dorëzuara nga Hazbi Loku).

Hamit Loku, Naser Fadil Loku, Sabit Loku, Garip Loku, Agim Loku, Ismajl Loku, Ismajl Kuçi, Zymer Loku, Milaim Loku, dhe Neshat Rexha.²⁶¹⁵

1057. Provat kriminalistike në lidhje me kufomat e gjetura në Kotlinë u paraqitën përmes raportit të Dr. Eric Baccard-it, i cili përmban një pjesë që analizon provat e mbledhura në Kotlinë nga ekipi kriminalist austriak, si dhe raportin e tyre.²⁶¹⁶

1058. Sipas Baccard-it, provat u mbledhën nga vendi i krimit me numër XX-I (pusi i epërm dhe i poshtëm) dhe një tjetër me numër XXI-2 (xhamia), nga data 7 deri 15 shtator 1999, të mbledhura nga ekipi austriak. Autopsitë e 25 individëve nga këto vende u kryen më pas në varrezën e Kaçanikut nga Dr. Christopher Markwalder dhe Dr. Daniel Wyler të Ekipit të Identifikimit të Viktimave të Fatkeqësive nga Zvicra.²⁶¹⁷ Në pusin e epërm dhe të poshtëm ishin 22 viktima në xhami ishin tre.²⁶¹⁸ 21 kufoma u përshkruan si tejet të shpërbëra; gjendja e katër kufomave të tjera nuk u evidentua.²⁶¹⁹ Sipas raportit të Baccard-it, 21 persona u identifikuan nga pjesët e trupit dhe sende të tjera të gjetura. Në rastet e tjera kufomat ose pjesë të kufomave mbetën të paidentifikuara.²⁶²⁰ Gjinia e viktimave nuk u evidentua, përveç pesë rasteve. Baccard-i shënoi se 68 për qind e viktimave ishin nën moshën 40-vjeçare.²⁶²¹

1059. Shenja dhe cifla të shpërthimit u gjetën në 21 kufoma ose pjesë të kufomave nga gropat. Për tri kufomat nga xhamia, si shkak i vdekjes u identifikuan plagët nga armë zjarri.²⁶²² Plagë nga armë zjarri u gjetën edhe në 10 kufoma të tjera. Shumica nga këto 13 kufoma kishin vetëm nga një plagë nga armë zjarri. Plagët nga armët e zjarrit përgjithësisht ndodheshin në trungun e kufomave në fjalë, kurse lëndimet nga shpërthimet ishin në të gjitha pjesët e trupit. Baccard-i gjithashtu shënon se raporti austriak identifikonte edhe tri raste të lëndimeve në kokë me mjet të fortë, por nuk kishte qenë në gjendje të përcaktonte se këto lëndime ishin shkaktuar para vdekjes apo pas. U evidentua edhe një plagë në fyt e shkaktuar me mjet të mprehtë.²⁶²³

²⁶¹⁵ Hazbi Loku, T. 3163–3164 (11 shtator 2006); Hazbi Loku, P380 (Komplet i 24 fotografive të dorëzuara nga Hazbi Loku).

²⁶¹⁶ P1809 (Raport përmbledhës i Eric Baccard-it), f. 48–52; *Shih gjithashtu* P361 (Raporti i ekipit kriminalist austriak për Kotlinën).

²⁶¹⁷ P1809 (Pasqyrë e raportit të Eric Baccard-it), f. 16, 48; P361 (Raporti i ekipit kriminalist austriak për Kotlinën), f. 5.

²⁶¹⁸ P1809 (Raport përmbledhës i Eric Baccard-it), f. 48.

²⁶¹⁹ P1809 (Raport përmbledhës i Eric Baccard-it), f. 48.

²⁶²⁰ P1809 (Raport përmbledhës i Eric Baccard-it), f. 49; Eric Baccard, T. 10129 (19 shkurt 2007).

²⁶²¹ P1809 (Raport përmbledhës i Eric Baccard-it), f. 17.

²⁶²² Eric Baccard, T. 10129, 10134 (19 shkurt 2007); P1809 (Raport përmbledhës i Eric Baccard-it), f. 50.

²⁶²³ P1809 (Raport përmbledhës i Eric Baccard-it), f. 49–50.

1060. Raporti austriak përshkruan dy puse, rreth 10 metra larg njëri tjetrit, në anën e një kodre mbi Kotlinë, afërsisht 300 metra nga qendra e fshatit.²⁶²⁴ Raporti gjithashtu përmend se 27 nga 31 shtëpitë në qendër të fshatit ishin "shkatërruar në luftë." Më tej raporti përmend se dy gropat e puseve ishin shembur, duke përcaktuar si shkak shpërthimet, dhe vëren se "fragmente të mbuluara me blozë" ishin gjetur në afërsi. Evidentohet edhe fakti i gjetjes së rreth 10 gëzhoja të armëve AK47 afër pusit të epërm.²⁶²⁵ Mostrat e rrobave të gjetura te puset u dërguan për analizë kimike për gjurmë të lëndëve shpërthyesë. Baccard-i konfirmoi se ishte praktikë e zakonshme në ekzaminimet kriminalistike që sendet e gjetura në vendin e ngjarjes të dërgoheshin për analiza shkencore. Raporti austriak përmban edhe një rezultat të nxjerrë nga shefi i njësisë kimike të ekipit kriminalist austriak se disa nga mostrat kishin gjurmë të TNT-së.²⁶²⁶ Baccard-i dëshmoi se ai nuk ishte ekspert i lëndëve shpërthyesë apo i kimisë dhe se nuk ishte i sigurt nëse i kishte shqyrtuar analizat kimike kur përgatiti raportin e vet. Ai u përqendrua në të dhënat për autopsitë për shkak të profilit të tij profesional. Sidoqoftë, ai ishte i bindur se lëndimet anatomike shkaktuar nga ciflat në këto kufoma ishin të mjaftueshme për të konfirmuar se ta kishin pësuar shpërthim, pa marrë parasysh shqyrtimin e analizave kimike.²⁶²⁷

1061. Dr. Zoran Stankoviqi, specialist mjeko-ligjor, i cili u ftua si dëshmitar ekspert i Mbrojtjes së përbashkët, kundërshtoi aspekte të ndryshme të provave në lidhje me ngjarjet në Kotlinë. Ai nuk pati mundësi që të ekzaminonte kufomat, por shqyrtoi materialet në dispozicion dhe i bazonte pikëpamjet e tij në to. Edhe pse kishte përvojë të gjerë në patologjinë mjeko-ligjore, ai nuk kishte qenë asnjëherë pjesëtar i ndonjë ekipi mjeko-ligjor ndërkombëtar që kishte bërë autopsi.²⁶²⁸ Stankoviqi shprehu mendimin se deklarata e Hazbi Lokut në lidhje me mënyrën e vdekjes së viktimave nuk ishte e vërtetë dhe nuk konfirmohej nga dokumentet kriminalistike dhe fotografike.²⁶²⁹

1062. Stankoviqi tha se ishte shumë e vështirë të nxirren përfundime për lëndimet në kufomat në të cilat nuk ka mbetje të indeve të buta, përveç nëse ekzistojnë lëndime që kanë lënë gjurmë në eshtra.²⁶³⁰ Sipas mendimit të tij, gjatë zhvarrosjes dhe autopsive nuk ishin respektuar standardet e

²⁶²⁴ P361 (Raport i ekipit kriminalist austriak për Kotlinën), f. 7.

²⁶²⁵ P361 (Raport i ekipit kriminalist austriak për Kotlinën), f. 7–8.

²⁶²⁶ P361 (Raport i ekipit kriminalist austriak për Kotlinën), f. 42, 91; Eric Baccard, T. 10130 (19 shkurt 2007).

²⁶²⁷ Eric Baccard, T. 10129–10134 (19 shkurt 2007); P1809 (Raport përmbledhës i Eric Baccard-it), f. 50–51. Edhe pse Baccard-i tha se lëndimet anatomike e shkaktuara nga ciflat e predhave në këto kufoma ishin të mjaftueshme për të konfirmuar diagnozën e vdekjes nga mjetet shpërthyesë, nga leximi i dëshmisë dhe raportit të tij shihet qartë se në lidhje me disa nga kufomat e ekzaminuara nuk është përcaktuar shkaku i saktë i vdekjes, nga plumbat apo shpërthimi.

²⁶²⁸ Zoran Stankoviq, T. 26179 (14 maj 2008).

²⁶²⁹ Zoran Stankoviq, T. 26150–26151 (14 maj 2008).

²⁶³⁰ Zoran Stankoviq, T. 26123 (14 maj 2008).

pranuara gjerësisht të kriminalistikës.²⁶³¹ Shënimet e autopsive në raportin austriak ishin shumë të shkurta, vetëm me përshkrimet e lëndimeve dhe me shpjegime të shkakut të vdekjes të disa prej individëve.²⁶³²

1063. Stankoviqi pretendoi se viktimat e Kotlinës ishin vrarë diku tjetër dhe pastaj ishin sjellë te gropat dhe se lëndimet nga shpërthimet kishin ndodhur para se të hidheshin në gropa.²⁶³³ Ai madje tha se ishte e mundshme që, gjatë inspektimit të kufomave nga ana e MPB-së, pusët mund të kenë qenë të zbrazët dhe se kufomat mund të mos kenë qenë hedhur në to. Ai erdhi në këtë përfundim pas krahasimit të autopsive dhe përshkrimit të rrobave si dhe nga çfarë mund të deduktohet nga dokumentacioni i MPB-së, sipas raportit të vendit të ngjarjes.²⁶³⁴ Stankoviqi përmendi disa aspekte që, sipas mendimit të tij, mbështesin përfundimin se kufomat u hodhën në pus pasi ishin vrarë. Për shembull, raporti austriak nuk ka konstatuar gjurmët e predhave ose ciflave të shpërthimit në bimësinë përreth puseve, që me gjasë ishte provë se viktimat nuk kishin vdekur në atë vend po diku tjetër, ose se disa nga kufomat ishin viktimat të konfliktit të armatosur dhe ishin sjellë aty nga ndonjë vend tjetër.²⁶³⁵

1064. Gjatë pyetjeve nga Prokuroria, Stankoviqi sqaroi se, edhe gjashtë muaj pas dëmtimit dhe zhvarrosjes, dëmtimet e bimësisë nga cifat e predhave apo plumbat, për shembull të lëvozhgave të drunjte, nuk do të zhdukeshin gjatë asaj kohe.²⁶³⁶ Edhe pse jashtë puseve u gjetën gjurmë rrobash, nuk ishte shënuar se sa larg prej tyre ishin gjetur. Sipas Stankoviqit, kjo shkon në mbështetje të supozimit se kufomat mund të jenë sjellë aty nga ndonjë territor tjetër dhe janë hedhur në pus.²⁶³⁷ Ai tha se ishte e pamundshme që copa të kufomave kishin fluturuar jashtë puseve duke marrë parasysh gjerësinë e tyre.²⁶³⁸ Gjithashtu, në zonën përreth puseve u gjetën vetëm 12 gëzhoja, por në kufomat e personave të vrarë u gjetën së paku 26 plagë nga plumbat, që tregon se plagët janë shkaktuar diku tjetër dhe se kufomat u hodhën në pus më vonë.²⁶³⁹ Ai hodhi poshtë sugjerimin se dikush mund të ketë hequr gëzhojat nga vendi i ngjarjes.²⁶⁴⁰

²⁶³¹ Zoran Stankoviç, T. 26137–26138, 26155, 26164 (14 maj 2008).

²⁶³² Zoran Stankoviç, T. 26138 (14 maj 2008). *Shih gjithashtu* 6D670 (Aktekspertizë e Zoran Stankoviqit për Kotlinën), para. 1.

²⁶³³ Zoran Stankoviç, T. 26154 (14 maj 2008).

²⁶³⁴ Zoran Stankoviç, T. 26139 (14 maj 2008).

²⁶³⁵ Zoran Stankoviç, T. 26140–26142 (14 maj 2008); 6D670 (Aktekspertizë e Zoran Stankoviqit për Kotlinën), para. 3. Ai dëshmoi se kjo ishte sidomos e vërtetë në lidhje me kufomat që kishin pësuar shkatërrime të rënda, si mungesë të gjymtyrëve të poshtme, gjë që sugjeron lëndime të shkaktuara nga predhat dhe shpërthimi.

²⁶³⁶ Zoran Stankoviç, T. 26185–26186 (14 maj 2008).

²⁶³⁷ Zoran Stankoviç, T. 26143 (14 maj 2008); 6D670 (Aktekspertizë e Zoran Stankoviqit për Kotlinën), para. 4.

²⁶³⁸ Zoran Stankoviç, T. 26144 (14 maj 2008).

²⁶³⁹ Zoran Stankoviç, T. 26149 (14 maj 2008); 6D670 (Aktekspertizë e Zoran Stankoviqit për Kotlinën), para. 6.

²⁶⁴⁰ Zoran Stankoviç, T. 26192 (14 maj 2008).

1065. Stankoviqi paraqiti edhe arsye të tjera se pse lëndimet nga shpërthimet mund të jenë shkaktuar para se kufomat të hidheshin në puse. Po të ishin përdorur mjetet shpërthyesë më pas, lëndimet më të rënda do të ishin mbi kufomat në shtresën sipërfaqësore të pusit, të përcjella nga ato në shtresën e mesme, dhe me më pak të lënduar në pjesën më të thellë. mirëpo realiteti ishte ndryshe.²⁶⁴¹ Ai gjithashtu konkludoi se nëse pjesët e kufomave ishin gjetur në thellësi ti ndryshme dhe nëse kishte pasur shtresa dheu midis tyre, që në fakt ishte kështu, atëherë kjo tregonte se mbetjet e kufomave ishin hedhur aty në periudha të ndryshme kohore.²⁶⁴²

1066. Kur e pyetën Stankoviqin më gjatë për fjalën "Ivaja" të shkruar me dorë në raportin hetimor kriminalist, ai pranoi se kishte mundësi që çfarë ishte shkruar në të, mund të ishte ndonjë vend tjetër i ngjarjes nga ai prej të cilit ekipi kriminalist austriak nxori kufomat.²⁶⁴³

c. Konkluzione

1067. Bazuar në dëshminë e Lokut që mbështetet nga Jelliqi dhe provat dokumentare të KVM-së, Dhoma Gjyqësore konkludon se më 9 mars 1999 forcat e UJ-së dhe të MPB-së ishin të pranishme në Kotlinë dhe rreth saj dhe se këto forca sulmuan dhe pjesërisht e dogjën fshatin. Gjithashtu, më 24 mars 1999, pjesë të Brigadës së 243-të të Mekanizuar, në bashkëpunim me forcat e MPB-së, duke përfshirë edhe njësitë e PJP-së, granatuan dhe rrethuan fshatin. Edhe nëse qëllimi i operacionit ishte "shkatërrimi" i UÇK-së, shumë fshatarë të pafajshëm u detyruan të iknin. Gra dhe fëmijë u detyruan të hipnin në kamionë ushtarakë ose të ecnin në këmbë prapa kamionëve në drejtim të Kaçanikut. Fshatarët të cilët e shmangën dëbimin me dhunë, ikën në Maqedoni pas sulmit mbi fshat.

1068. Sidoqoftë, në lidhje me ngjarjet te pusët, Dhoma Gjyqësore ka rezerva që ngjallin dyshime të arsyeshme nëse Loku pa se çfarë ndodhi. Në rrethanat e paraqitura konkretisht, Dhoma mund t'i konsiderojë vrasjet si të faktuara vetëm nëse pranon jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm dëshminë e Lokut mbi mënyrën si ndodhi. Problemi kryesor është se dëshmia e tij nuk është plotësisht në përputhje me provat kriminalistike që palët i kanë paraqitur Dhomës. Për shembull, ekipi kriminalist austriak përmend plagë nga armët e zjarrit të gjetura në kufomat e 10 viktimave, që nuk përputhet me dëshminë e Lokut se ai pa vetëm një apo dy burra që u vranë, kurse të tjerët u hodhën në puse ku u vranë nga shpërthimet. Gjithashtu, Loku fillimisht dëshmoi se njerëzit që u dërguan në kodër mbi Kotlinë i kishin pasur duart e lidhura, kurse provat kriminalistike nuk tregojnë praninë e

²⁶⁴¹ Zoran Stankoviq, T. 26150, 26193 (14 maj 2008); 6D670 (Aktekspertizë e Zoran Stankoviqit për Kotlinën), para. 7.

²⁶⁴² Zoran Stankoviq, T. 26151 (14 maj 2008); 6D670 (Aktekspertizë e Zoran Stankoviqit për Kotlinën), para. 11.

²⁶⁴³ Zoran Stankoviq, T. 26187–26188 (14 maj 2008); 6D501 (Dosje e një çështjeje lidhur me një akt terrorist në Kotlinë, 24 mars 1999), f. 2; P361 (Raport i ekipit kriminalist austriak për Kotlinën).

ndonjë shenje të lidhjes me litar. Më vonë Loku e ndërroi dëshminë e tij duke dëshmuar se burrat i kishin çuar deri në vendin e ngjarjes me duart e ngritura mbi kokë.

1069. Siç është përshkruar më lart, Zoran Stankoviqi paraqiti disa kundërshtime, si fakti se midis dy shtresave të kufomave kishte një shtresë dheu siç u gjet nga ekipi austriak, mund të sugjerojë se kufomat ishin varrosur atje në kohë të ndryshme. Ai gjithashtu kundërshtoi idenë se gjurmët organike të pjesëve të kufomave të shkëputura nga shpërthimi ishin zhdukur plotësisht nga hapësira e mbyllur e puseve dhe nga zona përreth, duke pretenduar rrjedhimisht se këto viktime mund të kenë vdekur në ndonjë vend tjetër.

1070. Gjithashtu, Dhomës nuk iu shpjeguan rrethanat e hetimit të vendit të ngjarjes nga ekipi austriak. Para se të vinte ekipi, duket se fshatarët duke se ishin marrë me gjurmimin e vendit. Fakti se vendi i ngjarjes mund të jetë trazuar nga fshatarët para ardhjes së ekipit austriak është një gjë që shkakton shqetësime dhe mund të shpjegojë disa nga mangësitë e raportit të ekipit austriak. Shkalla e kësaj ndërhyrjeje është e vështirë për t'u përcaktuar nga Dhoma pa dëgjuar asnjë nga fshatarët që kanë qenë atje në atë kohë.

1071. Përveç problemeve në lidhje me mospërputhjet midis provave kriminalistike dhe dëshmimeve okulare, Dhoma gjithashtu thekson se Loku e vrojtoi ngjarjen në pyll nga një largësi prej së paku 400 metrash. Një nga aspektet e diskutueshme ishte se a kishte pasur bimësi në drurë në atë kohë. Ai tha se zona kishte dru ah dhe në atë kohë nuk kishte bimësi të dendur që t'i pengonte pamjen. Nga fotografitë e bëra në fund të majit nuk duket kështu. Fatkeqësisht, Dhoma nuk disponon fotografi që tregojnë gjendjen e bimësisë në fund të marsit edhe pse kanë ekzistuar shumë mundësi për fotografi të tilla.

1072. Dhoma gjithashtu vëren se Loku nuk shkoi në vendin e ngjarjes për të hetuar. Ai tha se disa fshatarë të tjerë shkuan, por Dhoma nuk ka dëgjuar dëshmitë e tyre. Nuk ka as dëshmi të dorës së dytë se çfarë panë fshatarët të cilët shkuan në vendin e ngjarjes.

1073. Dhoma Gjyqësore pati gjithashtu rezerva për hezitimin e Lokut që të pranonte se në atë vend kishte forca të konsiderueshme të UÇK-së dhe se disa nga viktimat mund të kenë qenë pjesëtarë të UÇK-së. Në fillim ai ishte shumë hezitues rreth pyetjeve se a ishin varrosur disa nga viktimat në varrezën e UÇK-së. Më në fund ai pranoi se ajo ishte varrezë e "dëshmorëve" por nuk ishte në gjendje të thoshte se çfarë shërbimi i kishin bërë ata që ishin varrosur aty çështjes së shqiptarëve të Kosovës për të merituar epitetin "dëshmor" përveç që kishin punuar në sistemin shqiptar paralel arsimor. Dhoma dyshon se kjo përgjigje nuk është e mjaftueshme, sidomos duke marrë parasysh se

një nga viktimat e varrosura aty, konkretisht Neshat Rexha, thuhet se ishte vetëm 16 vjeç kur u vra.²⁶⁴⁴

1074. Dëshmitari 6D1 dëshmoi se e vizitoi Kotlinën më 24 mars, rreth orës 17:00, në lidhje me vrasjet e atjeshme për të cilat ekipit hetimor i kishin thënë se ishin rezultat i luftimeve midis UÇK-së dhe forcave të RFJ-së/Serbisë. Vajtja e ekipit për të hetuar rezultatet e luftimeve tregon për praninë e UÇK-së në atë zonë, gjë që shihet edhe nga pamundësia e tyre në kryerjen e hetimeve për shkak të luftimeve atë ditë dhe ditëve në vijim. Dëshmitë e tjera për aktivitetin e UÇK-së në atë zonë janë edhe fotografitë e bëra nga teknikët e vendit të krimit në një shtëpi në të cilën u gjetën armë dhe uniforma të UÇK-së dhe në një zonë pyjore më lart në kodër, ku u gjetën kufoma dhe gëzhoja të plumbave afër gropave në tokë.

1075. Kur ia treguan fotografitë, Loku mohoi se ato ishin fotografi të Kotlinës ose se gropat ishin të njëjtat që përshkroi ai. Duke u bazuar në dëshminë bindëse të 6D1-shit se kishte qenë në Kotlinë dhe në mungesë të dëshmimeve të tjera në lidhje me vendin e shtëpive në fotografi dhe fotografive të qarta të gropave të përmendura nga të dy dëshmitarët, shtëpitë mund të jenë në Kotlinë dhe mund të jenë të njëjtat gropa. Fakti se fotografitë janë bërë natën mbështet edhe më shumë dëshminë e 6D1-shit se ekipi mbërriti atje më vonë se në orën 17:00. Edhe pse në raportin zyrtar është shkruar emri i fshatit fqinj "Ivaja" afër shënit "fshati Kotlinë," Dhoma nuk sheh arsye pse 6D1-shit i thanë se do të shkonin në Kotlinë nëse në fakt ishin dërguar në Ivajë. Faktikisht, 6D1-shi e përshkroi qartë rrugën në të cilën kishin udhëtuar dhe kthesën që kishin marrë e që çon në Kotlinë. Gjithashtu, para hyrjes në Kotlinë. 6D1 kujtoi takimin me Jelliqin, që është konfirmuar pjesërisht nga Jelliqi, i cili përmendi ekipin hetimor të MPB-së që shkoi në Kotlinë në ditën në fjalë.

1076. Rrjedhimisht, Dhoma Gjqësore ka dyshime nëse Loku ka parë ngjarjen që pretendon se ka parë në lidhje me pusët në Kotlinë. Dhoma pranon se nga pusët janë zhvarrosur njerëz, por nuk është në gjendje të thotë përtej dyshimit të arsyeshëm se ata u vranë në mënyrën e përshkruar nga Loku. Gjithsesi ky konkluzion nuk është rezultat vetëm i mangësive në dëshminë e Lokut. Është rezultat i mosshqyrtimi të tyre prej Prokurorisë.

1077. Dhoma konkludon se personat në vijim u vranë gjatë sulmit në Kotlinë në mars 1999 (në vendet e tjera përveç puseve): Milaim Loku, Emërllah Kuçi, Idriz Kuqi, Vesel Vlashi, dhe Zymer Loku. Sidoqoftë, autorët e vrasjes së këtyre njerëzve nuk janë identifikuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm.

²⁶⁴⁴ Hazbi Loku, T. 3188 (12 shtator 2006). *Shih gjithashtu* Shtojcën A.

1078. Për arsyet e përmendura më lart, Dhoma nuk është bindur përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se ndonjë nga viktimat e përmendura në Listën K të Aktakuzës apo në Certifikatat e Vdekjes të Prokurorisë ka vdekur si rezultat i ngjarjeve në Kotlinë në mars 1999 në mënyrën e pretenduar në Aktakuzë.

4. Shkatërrimi i xhamisë në Kotlinë

1079. Përveç dëshmisë së Lokut në lidhje me djegien e fshatit Kotlinë, Dhoma Gjyqësore dëgjoi edhe nga Andrés Riedlmayer-i në lidhje me shkatërrimin e xhamisë së fshatit.²⁶⁴⁵ Raporti i Riedlmayer-it e përshkruan gjendjen e xhamisë si "të dëmtuar lehtë" dhe vërente se "brendësia e xhamisë ishte dëmtuar nga vandalizmi gjatë luftës së vitit 1999."²⁶⁴⁶ Meqenëse Riedlmayer-i nuk e inspektoi xhaminë personalisht, ai dëshmoi se ishte bazuar në një fotografi nga arkivi i EU/IMG të bërë në vitin 2000.²⁶⁴⁷

1080. Duke marrë parasysh se kjo është e vetmja dëshmi në lidhje me xhaminë, Dhoma Gjyqësore konkludon se nuk është vërtetuar se xhamia u dëmtua ose u shkatërrua nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë, siç pretendohet në Aktakuzë.

5. Shkatërrimi i xhamisë në Ivajë

1081. Muharrem Dashi, banor shqiptar kosovar i Stagovës, dëshmoi se Brigada e 162-të e UÇK-së vepronte në disa fshatra të komunës, duke përfshirë Ivajën.²⁶⁴⁸ Në deklaratën e tij me shkrim, edhe Hazbi Loku ka deklaruar se edhe ai dinte se UÇK-ja ishte e pranishme në Ivajë dhe se ai besonte se ata i kishin rezistuar "forcave serbe."²⁶⁴⁹ Kërsman Jelliqi e përshkroi Ivajën si "çerdhe terroristësh."²⁶⁵⁰

1082. Siç është përmendur më lart, edhe KVM-ja raportoi se, më 8 dhe 9 mars 1999, forcat e sigurimit u konfrontuan me UÇK-në në fshatin Ivajë.²⁶⁵¹ Loku e konfirmoi këtë dhe dëshmoi se, më

²⁶⁴⁵ P1789 (Aktekspertizë e Andrés Riedlmayer). *Shih gjithashtu* Andrés Riedlmayer, T. 5419 (30 tetor 2006).

²⁶⁴⁶ P1786 (Pjesë nga P1789 në lidhje me xhaminë e Kotlinës).

²⁶⁴⁷ Andrés Riedlmayer, T. 5477–5478 (30 tetor 2006), T. 5571 (31 tetor 2006). Riedlmayer-i shpjegoi se ky arkiv të dhënash ishte përpiluar nga Grupi Ndërkombëtar Menaxhues, një agjenci ndërqeveritare, me kërkesë të Këshillit të Evropës. Andrés Riedlmayer, T. 5428 (30 tetor 2006).

²⁶⁴⁸ Muharrem Dashi, T. 4628–4629 (11 tetor 2006).

²⁶⁴⁹ Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 2, 4D12 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 1925, T. 3208–3209 (12 shtator 2006).

²⁶⁵⁰ Kërsman Jelliqi, T. 18902 (23 nëntor 2007).

²⁶⁵¹ 3D179 (Raport i KVM-së mbi respektimin e armëpushimit prej palëve në Kosovë, 12 mars 1999), f. 2–3, gjithashtu e pranuar si P444. *Shih gjithashtu* P634 (Kronologji e ngjarjeve kryesore në Kosovë nga 15 tetori deri më 18 prill 1999), f. 6.

8 mars 1999, "forcat serbe" filluan një ofensivë kundër Ivajës.²⁶⁵² Pati luftime midis UÇK-së dhe forcave serbe dhe sulmi zgjati një ditë.²⁶⁵³ Forcat serbe fillimisht e granatuan Ivajën nga pozicionet e tyre të përhershme, nga lindja, perëndimi dhe veriu. Tanket hynë më vonë.²⁶⁵⁴ Sidoqoftë, në kohën kur ndodhi sulmi, Loku nuk ishte në Ivajë, po në Kotlinë. Prej atje ai dëgjoi predhat dhe shpërthimet dhe zhurmën dhe pa shumë tym duke u ngritur nga Ivaja.²⁶⁵⁵

1083. Pas pak ditësh, më 11 dhe 12 mars 1999, Loku shkoi në Ivajë, ku pa se disa nga shtëpitë ende digjeshin. Sipas vlerësimit të tij, rreth gjysma e shtëpive në fshat ishin shkatërruar, shumica prej tyre të djegura nga brenda kurse të tjerat të rrëzuara nga tanket.²⁶⁵⁶ Ai gjithashtu pa se xhamisë së fshatit i ishte vënë zjarri dhe minareja ishte gjysmë e shkatërruar.²⁶⁵⁷ Gjithsesi ai nuk pa se si ishin shkaktuar këto dëme në fshat.²⁶⁵⁸ Përsëri, Jelliqi mohoi se UJ-ja mund të kishte hyrë në fshat dhe gjithashtu mohoi se ajo kishte shkatërruar ndonjë objekt fetar apo objekt tjetër në Ivajë.²⁶⁵⁹

1084. Millan Koturi dëshmoi se pretendimet se Ivaja dhe fshatrat përreth ishin plaçkitur dhe djegur dhe të gjithë banorët ishin vrarë nga forcat e RFJ-së/Serbisë ishin në kundërshtim me një raport të marrë nga Richard Ciaglini. Në një mbledhje me Ciaglini-n më 10 mars 1999, ky raportoi se një anëtar i KVM-së kishte qenë në Ivajë dhe Kaçanik dhe konstatoi se atje kishte pasur "luftime" dhe "të shtëna" dhe se disa shtëpi ishin dëmtuar, por nuk kishte pasur plaçkitje. Faktikisht, disa shtëpi ishin kontrolluar, gjë që Ciaglini e konsideronte "procedurë normale."²⁶⁶⁰ Sidoqoftë, Ciaglini nuk u pyet për këtë takim dhe për kujtimet e Koturit të raportit të tij në këtë takim.

1085. András Riedlmayer-i e përshkroi gjendjen e xhamisë në Ivajë si "thuajse të shkatërruar." Riedlmayer-i nuk e vizitoi vendin, por nga fotografitë që i ishin dhënë konstatoi se xhamia ishte "plotësisht e djegur, ku kishin mbetur vetëm muret e jashtme" dhe se kulmi mungonte dhe

²⁶⁵² Hazbi Loku, T. 3209 (12 shtator 2006).

²⁶⁵³ Hazbi Loku, T. 3209–3210 (12 shtator 2006), 4D13 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 2026.

²⁶⁵⁴ Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 2.

²⁶⁵⁵ Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 2, T. 3152 (11 shtator 2006), 4D12 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 1922–1924.

²⁶⁵⁶ Hazbi Loku, P2296 (deklarata e dëshmitarit e datës 4 qershor 1999), f. 2, T. 3152 (11 shtator 2006), 4D12 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 1925.

²⁶⁵⁷ Hazbi Loku, T. 3152 (11 shtator 2006), 4D12 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 1925.

²⁶⁵⁸ Hazbi Loku, T. 3152 (11 shtator 2006), 4D12 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 1925.

²⁶⁵⁹ Kërsman Jelliq, T. 18907–18909 (23 nëntor 2007).

²⁶⁶⁰ Millan Kotur, T. 20632–20633 (18 janar 2008); 5D1387 (Raport i Zyrës në Terren të Ministrisë së Jashtme nga takimi midis M. Koturit dhe R. Ciaglini-t, 10 mars 1999), f. 1; *Shih gjithashtu* P680 (Dokument i Përbashkët Pune i OSBE/KVM-së), f. 1.

brendësia ishte e shkrumbuar.²⁶⁶¹ Raporti i tij gjithashtu bënte të ditur se xhamia ishte "goditur me armë zjarri nga afërsia dhe ishte djegur nga forcat serbe më 10 mars 1999 para se të fillonte lufta ajrore."²⁶⁶² Riedlmayer-i shpjegoi se këto të dhëna i kishte marrë nga lajmet në media, sidomos nga reportazhe të dorës së parë të agjencisë Reuter, korrespondenti i së cilës ishte në fshat në fillim të marsit 1999.²⁶⁶³ Riedlmayer-i përfundoi se dëmtimet e xhamisë ishin bërë në dy faza; në fillim ishte hapur zjarr mbi xhaminë, që është e qartë nga shenjat e dëmtimeve nga predhat të dukshme në fotografi; dhe pastaj ishte djegur.²⁶⁶⁴

1086. Përsëri, në mungesë të provave, përveç dëshmive të dorës së dytë, në lidhje me mënyrën e shkaktimit të dëmtimeve në xhami, nuk janë vërtetuar akuzat përkatëse në Aktakuzë.

6. Kaçanik

1087. Isa Raka i lindur në qytetin e Kaçanikut dhe banor i atij qyteti në vitin 1999, dëshmoi për ngjarjet e marsit 1999 dhe largimin e tij nga shtëpia në atë kohë.²⁶⁶⁵ Sipas Rakës, askush nga familja e tij, e as ai, nuk ishin anëtarë të UÇK-së. Ai dëshmoi se, në fillim të marsit 1999, forcat e MPB-së e shtuan veprimtarinë e tyre në qytet. Në disa raste nga 24 marsi deri më 27 mars, ai dëgjoi krisma që vinin nga stacioni i policisë. Ai i dëgjoi këto nga shtëpia e ungjit, ku ai dhe familja e tij kalonin netët. Ai gjithashtu dëshmoi se, në atë kohë, në qytet ishte vendosur ndalim-qarkullimi dhe se banorët nuk mund të dilnin rrugëve.²⁶⁶⁶

1088. Më 27 mars 1999, vëllai i Rakës, i cili punonte në godinën komunale që ishte përballë stacionit të policisë, i tha se "komuna" ishte plot me policë.²⁶⁶⁷ Pastaj Raka pa dhe dëgjoi gjurmët e predhave të shkrepara nga granatahedhësi apo mortaja nga zona e stacionit të policisë në drejtim të një shtëpie në fshatin Bob.²⁶⁶⁸ Rreth gjashtë "predha" u shkrepen nga raketahedhësi në drejtim të asaj shtëpie, e cila më parë ishte përdorur nga KVM-ja.²⁶⁶⁹

1089. Më vonë atë mëngjes, Raka shkoi të vizitonte fqinjin e tij i cili e kishte shtëpinë përprjetë kodrës.²⁶⁷⁰ Nga shtëpia e fqinjit, ai pa dy xhipa ushtarakë dhe një Niva të bardhë që arritën në

²⁶⁶¹ Andrés Riedlmayer, T. 5478–5479 (30 tetor 2006), P1787 (Pjesë nga P1789 në lidhje me xhaminë e Ivajës).

²⁶⁶² P1787 (Pjesë nga P1789 në lidhje me xhaminë e Ivajës).

²⁶⁶³ Andrés Riedlmayer, T. 5479 (30 tetor 2006).

²⁶⁶⁴ Andrés Riedlmayer, T. 5479–5480 (30 tetor 2006).

²⁶⁶⁵ Isa Raka, T. 3514–3551 (19 shtator 2006); Isa Raka, P2301 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 shtator 2006).

²⁶⁶⁶ Isa Raka, P2301 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 shtator 2006), para. 7–10.

²⁶⁶⁷ Isa Raka, P2301 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 shtator 2006), para. 9.

²⁶⁶⁸ Isa Raka, T. 3531, 3536, 3549 (19 shtator 2006).

²⁶⁶⁹ Isa Raka, P2301 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 shtator 2006), para. 11; Isa Raka, T. 3518 (19 shtator 2006).

²⁶⁷⁰ Isa Raka, P2301 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 shtator 2006), para. 12.

fabrikën e çimentos, rreth 100 metra nga shtëpia e tij, në anën tjetër të lumit. Automjetet ndaluan afër fabrikës dhe rreth 20 policë zbritën prej tyre, të gjithë me uniforma kamuflimi të policisë. Dy oficerë kishin uniforma të tjera, konkretisht, uniforma kamuflimi të rregullta të UJ-së ngjyrë të gjelbër dhe kafe.²⁶⁷¹ Raka e njohur personin që dukej se komandonte grupin dhe i cili u jepte urdhra të tjerëve si "zëvendëskomandant" i stacionit policor në Kaçanik, të cilin e njihte.²⁶⁷²

1090. Grupi shkoi rreth e rrotull fabrikës e pastaj hynë në të dhe zunë pozicione në dritaret në katin e sipërm. Dy ushtarët me uniforma të gjelbra hipën me një palë shkallë në një platformë në majë të dy cisternave në fabrikë dhe zunë pozicionet atje. Raka vazhdoi të vrojtonte operacionin nga dritarja në shtëpinë e fqinjit të tij.²⁶⁷³

1091. Policët dhe ushtarët filluar të qëllonin kohë pas kohe me pushkë dhe me një raketahedhës në drejtim të shtëpive në anën e lumit ku ishte Raka. Kjo vazhdoi për rreth 30 minuta deri një orë. Një "granatë" goditi shtëpinë e tij dhe përshkoi kulmin. Bazuar në dëmet që pa më vonë në muret e shtëpisë së tij, ai mendonte se dy ushtarët në platformë kishin qëlluar edhe me pushkë snajper.²⁶⁷⁴ Raka dëshmoi se në atë kohë askush nuk hapi zjarr nga drejtimi i shtëpisë së tij në drejtim të fabrikës.²⁶⁷⁵ Mbrojtja e Llukiqit pretendon se njerëzit me uniforma që Loku pa në fabrikë ishin pjesëtarë të UÇK-së që sulmuan nga fabrika për t'i detyruar njerëzit të largoheshin nga komuna, dhe i referohet një raporti të MPB-së ku bëhet e ditur se në pasditen e 27 marsit, një kolonë e automjeteve të UJ-së u sulmua prej "terroristëve" nga fabrika e gëlqeres në Bob.²⁶⁷⁶ Edhe nëse raporti i MPB-së pasqyron saktë ngjarjet e asaj pasdite, Dhoma nuk është bindur nga pretendimi i Mbrojtjes së Llukiqit se personat me uniforma që pa Loku në fabrikë ishin pjesëtarë të UÇK-së.

1092. Në vitin 2002, Raka bëri disa fotografi që tregonin vendin ku kishte qenë ai dhe ku kishin qenë policët në kohën kur kishte ndodhur sulmi.²⁶⁷⁷ Në fotografinë e parë ai identifikoi vendin mbërritjes së xhipave, vendin ku u vendosën policët, fabrikën e gëlqeres, dhe pozicionet e zëna nga dy ushtarët – dy pozicionet nga erdhën të shtënat.²⁶⁷⁸ Ai gjithashtu identifikoi dhe shënoi vendin e shtëpisë së tij dhe të shtëpisë së fqinjit, prej nga vrojtoi ngjarjet që ndodhën në fabrikën e

²⁶⁷¹ Isa Raka, P2301 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 shtator 2006), para. 12; Isa Raka, T. 3519 (19 shtator 2006).

²⁶⁷² Isa Raka, T. 3520 (19 shtator 2006); Isa Raka, P2301 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 shtator 2006), para. 13.

²⁶⁷³ Isa Raka, P2301 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 shtator 2006), para. 14; Isa Raka, T. 3520–3523, 3538 (19 shtator 2006).

²⁶⁷⁴ Isa Raka, P2301 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 shtator 2006), para. 15; T. 3520–3521, 3525 (19 shtator 2006).

²⁶⁷⁵ Isa Raka, T. 3521 (19 shtator 2006).

²⁶⁷⁶ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 1174; P1099 (Raport i MPB-së, 28 mars 1999), f. 3.

²⁶⁷⁷ P2310 (Fotografi të paraqitura nga Isa Raka të shtëpisë dhe të fabrikës së gëlqeres në Kaçanik).

²⁶⁷⁸ Isa Raka, T. 3523 (19 shtator 2006); Isa Raka, IC38 (Fotografi e shënuar nr. K0223167 (P2310)).

gëlqeres.²⁶⁷⁹ Raka tha se fotografia e tretë paraqiste në plan të parë vendin e shtëpisë së tij dhe të fqinjët të tij.²⁶⁸⁰

1093. Ndërsa ai ishte në shtëpinë e fqinjët, gruaja shtatzënë e Rakës ishte e fshehur në bodrumin e shtëpisë së tyre së bashku me anëtarë të tjerë të familjes. Në një moment kur vazhdonin krismat, ajo doli nga bodrumi dhe duke ecur nëpër oborr u godit nga një plumb që i përshkoi ijën dhe u ngul në mur.²⁶⁸¹ Kur ndalën të shtënat nga fabrika, Raka u kthyen në shtëpi dhe pa se gruaja e tij ishte plagosur.²⁶⁸²

1094. Më 28 mars 1999, disa banorë të një lagjeje tjetër në Kaçanik kaluan nëpër lagjen e Rakës dhe i thanë se po largoheshin nga qyteti sepse policët po shkonin shtëpi më shtëpi. Ata gjithashtu i thanë se policët kishte hyrë në një shtëpi dhe kishin marrë tre vetë dhe kishin vrarë njërin prej tyre. Për këtë arsye, familja e Rakës dhe e gjithë lagjja vendosën të largoheshin nga shtëpitë para se të arrinte policia.²⁶⁸³

1095. Raka shpjegoi se kishte ecur me një grup prej 500-1.000 njerëzve nëpër pyll në drejtim të Maqedonisë përmes fshatit Gjurgjedell, i cili shtrihet në juglindje të qytetit. Grupi u nda në tri grupe më të vogla dhe Raka udhëtoi me një grup prej 13-14 burrash të cilët ndihmuan në bartjen e gruas së tij me vig. Pjesa tjetër e familjes shkuan me grupet e tjera.²⁶⁸⁴ Ata kaluan një natë në Gjurgjedell dhe më 29 mars vazhduan për në Maqedoni. Kufirin e kaluan vetëm në përpjekjen e tretë. Në përpjekjen e parë dhe të dytë forcat ushtarake maqedonase i ndaluan që të hynin në Maqedoni.²⁶⁸⁵ I gjithë udhëtimi zgjati dy ditë, prej momentit kur u plagos gruaja e Rakës deri në momentin kur mbërritën në Maqedoni.²⁶⁸⁶

1096. Në Maqedoni, gruaja e Rakës u dërgua menjëherë në Spitalin Shtetëror në Shkup. Pas dy operacioneve, ajo vdiq më 5 prill 1999.²⁶⁸⁷ Kur u kthyer në shtëpi në Kaçanik në qershor 1999, Raka e gjeti shtëpinë të dëmtuar.²⁶⁸⁸

²⁶⁷⁹ Isa Raka, T. 3524 (19 shtator 2006); Isa Raka, IC39 (Fotografi e shënuar nr. K0223169 (P2310)).

²⁶⁸⁰ Isa Raka, T. 3525 (19 shtator 2006); P2310 (Fotografi të paraqitura nga Isa Raka të shtëpisë dhe të fabrikës së gëlqeres në Kaçanik), fotografia nr. K0223168.

²⁶⁸¹ Isa Raka, P2301 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 shtator 2006), para. 20; Isa Raka, T. 3525–3526, 3528 (19 shtator 2006).

²⁶⁸² Isa Raka, P2301 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 shtator 2006), para. 21, T. 3526 (19 shtator 2006).

²⁶⁸³ Isa Raka, P2301 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 shtator 2006), para. 22, T. 3526–3527 (19 shtator 2006).

²⁶⁸⁴ Isa Raka, P2301 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 shtator 2006), para. 22–23, T. 3526–3527 (19 shtator 2006).

²⁶⁸⁵ Isa Raka, T. 3527–3528, 3546 (19 shtator 2006). *Shih gjithashtu* 5D1221 (Raport luftimi i Batalionit të 57-të Kufitar, 30 mars 1999).

²⁶⁸⁶ Isa Raka, T. 3527–3528 (19 shtator 2006).

²⁶⁸⁷ Isa Raka, P2301 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 shtator 2006), para. 27; Isa Raka, T. 3528 (19 shtator 2006).

1097. Dëshmia e Rakës iu paraqit Kërsman Jelliqit, i cili deklaroi se forcat e UJ-së nuk e kishin sulmuar qytetin e Kaçanikut. Gjithashtu ai deklaroi se ushtria nuk kishte pozicione luftarake në qytet.²⁶⁸⁹ Jelliqi dëshmoi se më 27 ose 28 mars 1999 në Kaçanik ishin vetëm forcat e MPB-së dhe kujtoi se u krye një "aksion antiterrorist" i nisur nga MPB-ja në atë kohë, pasi një patrullë e MPB-së ishte sulmuar nga "terroristët."²⁶⁹⁰

1098. Gjatë pyetjeve nga Prokuroria, Jelliqi dëshmoi se ishte në dijeni se nga fundi i marsit deri në përfundim të fushatës së NATO-s ndodhën disa sulme "terroriste" në zonën e fshatit Bob. Sidoqoftë, ai nuk mbante mend nëse kishte ndonjë fabrikë në Bob ose nëse UJ-ja ishte e vendosur atje. Ai deklaroi se kishte pasur sulme thujtë të përditshme kundër kolonave të UJ-së midis rrugëve që shkojnë nga Doganaj në Gllloboçicë dhe nga Doganaj në Han të Elezit.²⁶⁹¹

a. Konkluzione

1099. Duke marrë parasysh rezervat e veta në lidhje me besueshmërinë e dëshmisë së Jelliqit, Dhoma Gjyqësore konsideron se mohimet e tij të përgjithësuara të përfshirjes së UJ-së në aksione në qytetin e Kaçanikut në fund të marsit 1999 nuk e komprometojnë dëshminë e hollësishme dhe të besueshëm të Rakës. Rrjedhimisht, Dhoma konkludon se forcat e UJ-së dhe të MPB-së hynë në qytet dhe hapën zjarr kundër disa shtëpive. Të nesërmen, disa qindra banorë të qytetit u larguan nga shtëpitë nga frika prej forcave policore ose sepse policia i dëboi nga shtëpitë e tyre dhe më në fund kaluan kufirin për në Maqedoni.

1100. Dhoma Gjyqësore gjithashtu dëgjoi dëshmi në lidhje me vrasjen e gruas së Isa Rakës. Sidoqoftë, meqenëse ky incident nuk është përfshirë në Aktakuzë, Dhoma nuk nxjerr asnjë konkluzion në lidhje me këtë.

7. Fshatrat Sllatinë dhe Vataj

1101. Sllatina dhe Vataj janë fshatra afër njëri tjetrit në veriperëndim të qytetit të Kaçanikut.²⁶⁹² Sejdi Lami është lindur në Lamë që është pjesë e fshatit Vataj, dhe në fillim të vitit 1999 banonte

²⁶⁸⁸ Isa Raka, P2301 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 shtator 2006), para. 28.

²⁶⁸⁹ Kërsman Jelliq, T. 18910 (23 nëntor 2007); *Shih gjithashtu* 5D1337 (Hartë e operacionit mbrojtës të Komandës së PrK-së).

²⁶⁹⁰ Kërsman Jelliq, T. 18912 (23 nëntor 2007).

²⁶⁹¹ Kërsman Jelliq, T. 19000 (26 nëntor 2007). *Shih gjithashtu* 6D1638 (Raport dërguar Departamentit të Shtetit të SHBA-së, prill 1999), f. 3–4.

²⁶⁹² P615 (Atlasi i Kosovës), f. 12.

atje.²⁶⁹³ Ai dëshmoi në lidhje me ngjarjet që ndodhën në Vataj në vitin 1999, konkretisht për sulmin e "forcave serbe" më 13 prill 1999.²⁶⁹⁴

1102. Sipas Jelliqit, UÇK-ja ndërmerre sulme të shpeshta në rrugët e kësaj zone nga pjesët pyjore afër fshatrave. Për shembull, kolonat e automjeteve që sillnin furnizime logjistike për Grupin Luftarak 3 sulmoheshin shpesh.²⁶⁹⁵ Jelliqi dëshmoi se njerëzit u larguan nga zona para dhe gjatë fushatës së NATO-s. Përpara, njerëzit shkonin në drejtim të Ferizajt, kurse gjatë sulmeve ajrore shkuan në Maqedoni dhe disa në Serbi. Jelliqi fajësoi UÇK-në për lëvizjen e popullatës.²⁶⁹⁶ Ai tha se në Sllatinë, në jug të Ferizajt, dhe deri në Han të Elezit ishte një brigade "terroriste" e UÇK-së.²⁶⁹⁷

1103. Në janar 1999, shumica e grave dhe fëmijëve në Vataj, duke përfshirë edhe familjen e Lamit, shkuan në Ferizaj. Sidoqoftë, burrat qëndruan pas. Kur më 23 mars ai dëgjoi se do të sulmohej qyteti i Ferizajt, Lami vendosi ta sillte familjen e tij përsëri në Vataj. Kur të nesërmen filluan sulmet e NATO-s, "ushtria serbe" filloi granatimin e fshatrave në atë zonë. Shumica e popullatës së këtyre fshatrave i kaluan ditët në vijim në pyll duke u fshehur prej granatimeve.²⁶⁹⁸

1104. Lami dëshmoi se ai nuk ishte pjesëtar i UÇK-së dhe se në Vataj nuk pati prani të UÇK-së afërsisht deri më 6 prill 1999, kur rreth 20 ushtarë të UÇK-së erdhën në fshat dhe u vendosën në një shtëpi aty. Ata hapën llogore në një kodër rreth 200 metra mbi shtëpinë e tij. Rreth asaj kohe, familja e Lamit, së bashku me shumicën e banorëve të fshatit, u nisën në këmbë nëpër pyll në drejtim të Malit Luboten për të shkuar në Maqedoni. Ndërsa ata shkonin në drejtim të kufirit, "ushtria serbe" granatonte drejt malit. Për këto arsye Lami vendosi të kthehej në fshat me disa nga fëmijët, kurse shumë të tjerë vazhduan për në Maqedoni.²⁶⁹⁹ Të nesërmen, ai provoi sërish të shkonte në Maqedoni, këtë herë me makinë së bashku me disa fqinjë të tij. Mirëpo, ata u ndaluan nga UJ-ja. Pasi e kaluan natën në makinë, atyre u thanë se autoritetet maqedonase nuk pranonin më refugjatë dhe se duhej të ktheheshin.²⁷⁰⁰ Më 12 prill, ushtarët e UÇK-së që ishin në fshatin e tij

²⁶⁹³ Sejdi Lami, P2271 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 korrik 2000), f. 2.

²⁶⁹⁴ Sejdi Lami, P2271 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 korrik 2000), f. 2, T. 3257 (12 shtator 2006).

²⁶⁹⁵ Kërsman Jelliq, T. 18914 (23 nëntor 2007).

²⁶⁹⁶ Kërsman Jelliq, T. 18915 (23 nëntor 2007). Shih gjithashtu IC142 (Hartë e shënuar nga Kërsman Jelliq).

²⁶⁹⁷ Kërsman Jelliq, T. 18915 (23 nëntor 2007).

²⁶⁹⁸ Sejdi Lami, P2271 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 korrik 2000), f. 3. Shih gjithashtu P680 (Dokument i Përbashkët Pune i OSBE/KVM-së), f. 4.

²⁶⁹⁹ Sejdi Lami, P2271 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 korrik 2000), f. 2–3.

²⁷⁰⁰ Sejdi Lami, P2271 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 korrik 2000), f. 3.

morën urdhër që të tërhiqeshin dhe të nesërmen kur u sulmua Vataj, atje nuk kishte ushtarë të UÇK-së.²⁷⁰¹

1105. Lami dëshmoi gjithashtu se gjatë marsit dhe prillit 1999, UJ-ja granatoi disa fshatra rreth shtëpisë së tij nga një vend në një pyll të vogël të quajtur "Picrrak" në fshatin "Banicë," ku kishin tanke dhe bunkerë. Më 26 mars 1999, ky vend u shkatërrua nga bombat e NATO-s.²⁷⁰²

a. Sulmi më 13 prill 1999

1106. Më 13 prill 1999, rreth orë 05:00, UJ-ja hyri në Vataj me katër Praga dhe gjashtë kamionë ushtarakë me rreth 100 ushtarë. Shumica e ushtarëve kishin uniforma kamuflimi të UJ-së, por disa prej tyre kishin shami të kuqe dhe të zeza dhe Lami i konsideroi paraushtarakë.²⁷⁰³ Gjithashtu Lami pa dy grupe të tjera ushtarësh më larg fshatit: një grup me rreth 150 vetë afër fshatit Sllatinë dhe një tjetër që erdhi nga drejtimi i Brodit në komunën e Shtërpcës.²⁷⁰⁴

1107. Kur Jelliqi u pyet në lidhje me këtë dëshmi, ai mohoi se forcat e tij kishin hyrë në Vataj dhe Sllatinë.²⁷⁰⁵ Ai gjithashtu dëshmoi se pjesëtarët e brigadës së tij kishin vetëm një lloj uniforme pa simbole të veçanta ose shami.²⁷⁰⁶

1108. Në orën 05:45, ushtarët e UJ-së hapën zjarr mbi Vatajn nga Pragat dhe me armët që mbanin.²⁷⁰⁷ Kur ushtarët hynë në fshat, banorët vendës u larguan nga shtëpitë së bashku me njerëz nga fshatrat e tjera që ishin atje dhe u nisën drejt malit Luboten dhe të një gryke aty afër, ku kishin bërë gati ushqime dhe strehim në rast të ndonjë sulmi. Ushtarët shtinin vazhdimisht drejt tyre, por ata qëllonin mbi kokat e tyre, kështu që askush nuk u plagos. Sipas mendimit të Lamit, ata synonin ushtarët e UÇK-së.²⁷⁰⁸

1109. Ai dhe anëtarët e familjes së tij u fshehën në grykë afër një përroi. Mirëpo gruaja e tij ishte në një grup prej 150 vetësh, përfshirë fëmijë dhe pleq, të mbledhur në një lëndinë mbi vendin ku ishte ai.²⁷⁰⁹ Nga vendi ku ishte fshehur, ai nuk mundi të shihte asnjë ushtar, por gruaja i tregoi se rreth orës 06:30 ajo pa kur ata kapën katër burra të fshatit. Ushtarët i plagosën burrat dhe në fund i

²⁷⁰¹ Sejdi Lami, P2271 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 korrik 2000), f. 2–3.

²⁷⁰² Sejdi Lami, P2271 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 korrik 2000), f. 3.

²⁷⁰³ Sejdi Lami, P2271 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 korrik 2000), f. 3; Sejdi Lami, T. 3265 (12 shtator 2006).

²⁷⁰⁴ Sejdi Lami, P2271 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 korrik 2000), f. 3.

²⁷⁰⁵ Kërsman Jelliq, T. 18913 (23 nëntor 2007).

²⁷⁰⁶ Kërsman Jelliq, T. 18915 (23 nëntor 2007).

²⁷⁰⁷ Sejdi Lami, P2271 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 korrik 2000), f. 3–4; Sejdi Lami, T. 3267–3268 (12 shtator 2006).

²⁷⁰⁸ Sejdi Lami, P2271 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 korrik 2000), f. 4.

²⁷⁰⁹ Sejdi Lami, T. 3259 (12 shtator 2006).

vranë.²⁷¹⁰ Ajo mundi ta shihte incidentin sepse ndodhi në një kodër rreth 300 metra mbi vendin ku ishte ajo. Ajo pa se ata kishin uniforma kamuflimi.²⁷¹¹

1110. Rreth orës 15:30 ose 16:00, pas largimit të ushtarëve nga fshati, Lami dhe vëllezërit e tij dolën nga vendi ku ishin fshehur në grykë dhe shkuan te vendi i quajtur "Gurët e Kripës," ku gjetën katër kufoma pranë shtegut. Ata njohën kufomat e Mahmut Cakës, Habib Lamit, Rrahman Lamit,²⁷¹² dhe Brahim Lamit.²⁷¹³ Ata i mblodhën kufomat dhe i çuan në një shtëpi në fshat. Lami dëshmoi se këta burra ishin të gjithë civilë dhe të paarmatosur.²⁷¹⁴

1111. Shtatë kufoma të tjera të njerëzve të vrarë në lagjet Cakë dhe Tifek u pranë atë ditë në të njëjtën shtëpi në fshat, për shkak të afërsisë me varrezat.²⁷¹⁵ Ai qe në gjendje të kujtonte vetëm emrat e katër nga shtatë viktimat: kufoma e parë që ishte sjellë ishte Ilir Osman Caka, djali 15-vjeçar i Osman Cakës; i dyti ishte Jakup Caka, kushëri i Ilirit; i treti "Shyqyriu," mik i dy të parëve i cili ishte strehuar në shtëpinë e Cakës,²⁷¹⁶ dhe kufoma e katërt ishte Ramadan Xhokli.²⁷¹⁷

1112. Jelliqi deklaroi se vetëm një aksion antiterrorist u krye në atë kohë në drejtimin Doganaj, Baicë, dhe Baicë e Vjetër, dhe pastaj më tej në Shtërpce, sepse ekzistonte rreziku se rruga mund të bllokohej. Ai aksion konkret u krye nga MPB-ja, por disa elemente të njësisë së Jelliqit i dhanë mbështetje.²⁷¹⁸ Sidoqoftë, një raport luftimi të Brigadës së 243-të të Mekanizuar i datës 13 prill 1999, thuhet se ishte bërë një bllokadë në një aksion të koordinuar me PJP-në, dhe UÇK-ja në sektorin Firajë, Brod, dhe Sllatinë ishte "shtypur dhe shkatërruar," në zbatim të vendimit të prillit 1999. Katërmbëdhjetë "terroristë" ishin "likuiduar."²⁷¹⁹ Jelliqi tha se ishte në dijeni të vrasjes së 13 civilëve në atë zonë gjatë këtij sulmi, e as të hyrjes së MPB-së në këto fshatra, sepse ata u përqendruan vetëm në rrugë gjatë operacionit të tyre.²⁷²⁰ Ai kujtoi se operacioni bazohej në një

²⁷¹⁰ Sejdi Lami, P2271 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 korrik 2000), f. 4; Sejdi Lami, T. 3259–3260 (12 shtator 2006).

²⁷¹¹ Sejdi Lami, T. 3260 (12 shtator 2006).

²⁷¹² Emri "Rrahman Lami" është përdorur nga Sejdi Lami në deklaratën e tij me shkrim. Sejdi Lami, P2271 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 korrik 2000), f. 4. *Shih gjithashtu* Sejdi Lami, T. 3262 (12 shtator 2006).

²⁷¹³ Sejdi Lami, P2271 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 korrik 2000), f. 4, T. 3261 (12 shtator 2006). Sejdi Lami dëshmoi se Rrahman Lamit ia kishin nxjerrë të dy sytë; Habib Lamit i kishin bërë shenjën e kryqit në gjoks; Brahim Lami ishte "vranë në ballë"; dhe Jakup Caka kishte shtatë ose tetë plumba në trup dhe ishte therur me thikë.

²⁷¹⁴ Sejdi Lami, P2271 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 korrik 2000), f. 5.

²⁷¹⁵ Sejdi Lami, P2271 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 korrik 2000), f. 5.

²⁷¹⁶ Sejdi Lami, T. 3261 (12 shtator 2006).

²⁷¹⁷ Sejdi Lami, P2271 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 korrik 2000), f. 5; Sejdi Lami, T. 3261 (12 shtator 2006).

²⁷¹⁸ Kërsman Jelliq, T. 18916 (23 nëntor 2007).

²⁷¹⁹ 6D736 (Raport luftimi i Brigadës së 243-të të Mekanizuar, 13 prill 1999), f. 1.

²⁷²⁰ Kërsman Jelliq, T. 18916–18918 (23 nëntor 2007), T. 19006, 19010–19011 (26 nëntor 2007).

vendim me shkrim për shpartallimin e forcave "terroriste" në këtë zonë dhe se kjo detyrë duhej të kryhej nga UJ-ja në aksion të përbashkët me PJP-në.²⁷²¹

1113. Më 14 prill 1999, kufomat e 11 të vrarëve një ditë më parë u varrosën në varrezën myslimane.²⁷²² Disa ditë pas kthimit të Lamit në fshat në korrik 1999, kufomat u zhvarrosën nga KFOR-i dhe u ekzaminuan nga ekspertë mjeko-ligjorë e pastaj u rivarrosën. Njëri nga ta, Ramadan Xhokli, u varros në varrezën e UÇK-së, e cila gjithashtu quhej varreza e "heronjve" ose e "dëshmorëve."²⁷²³ Sipas Lamit, Ramadan Xhokli kishte qenë anëtar i UÇK-së përgjegjës për furnizim me ushqim për UÇK-në,²⁷²⁴ kurse të tjerët ishin civilë.²⁷²⁵ Sidoqoftë, Lamit ia tregua një fotografi e varrezës së dëshmorëve gjatë dëshmisë së tij dhe ai njohu varret e Rrahman Lamit, Habib Lamit, dhe Mahmut Cakës.²⁷²⁶ Gjithsesi ai këmbënguli se këta burra nuk kishin qenë anëtarë të UÇK-së dhe se ai nuk i kishte parë të armatosur më 13 prill 1999.²⁷²⁷ Lami shpjegoi se njerëzit e varrosur në varrezën e dëshmorëve ishin civilë dhe nuk kishin pasur lidhje me UÇK-në apo ndonjë organizatë tjetër. Ata quheshin "dëshmorë" sepse nuk kishin pasur vdekje të natyrshme, po ishin vrarë nga ushtria gjatë luftës.²⁷²⁸

1114. Pas varrimit të kufomave më 14 dhe 15 prill 1999, e tërë popullata e Vatajt dhe Lami së bashku me familjen e tij shkuan në Maqedoni me traktorë. Ata u ndaluan nga UJ-ja te vendi i quajtur Dragomas dhe u kërkuan 1.000 marka gjermane për t'i lejuar të kalonin kufirin. Më në fund i lejuan të kalonin kufirin pasi paguan 500 marka. Kur u kthye në fshat në korrik, Lami e kishte gjetur shtëpinë e tij dhe të tjerat të plaçkitura.²⁷²⁹

1115. Dhoma Gjyqësore mori dëshmi në lidhje me kufomat e gjetura në Vataj nga Dr. Eric Baccard. Raporti i Baccard-it përmban një pjesë që analizon provat kriminalistike të mbledhura në Vataj nga një ekip kriminalist kanadez.²⁷³⁰ Autopsitë e 10 kufomave u kryen nga Prof. Markenstein

²⁷²¹ Kërsman Jelliq, T. 19007 (26 nëntor 2007).

²⁷²² Sejdi Lami, P2271 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 korrik 2000), f. 5.

²⁷²³ Sejdi Lami, T. 3266 (12 shtator 2006), 3286 (13 shtator 2006).

²⁷²⁴ Sejdi Lami, T. 3266 (12 shtator 2006). Në deklaratën e tij me shkrim, ai tha se "Ramadan Xhokli u varros në varrezën e UÇK-së sepse kishte qenë pjesëtar aktiv i UÇK-së." Sejdi Lami, P2271 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 korrik 2000), f. 5. Sidoqoftë gjatë dëshmisë së tij, ai e ndryshoi qëndrimin e tij dhe sqaroi se për t'u varrosur në këtë varrezë duhej të ishte vrarë nga ushtria e jo të kishte vdekur nga shkaqe natyrore. Sejdi Lami, T. 3266 (12 shtator 2006), 3286 (13 shtator 2006).

²⁷²⁵ Sejdi Lami, P2271 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 korrik 2000), f. 5.

²⁷²⁶ Sejdi Lami, T. 3284 (13 shtator 2006); *Shih gjithashtu* 3D95 (Fotografi të varrezave).

²⁷²⁷ Sejdi Lami, T. 3285–3286 (13 shtator 2006).

²⁷²⁸ Sejdi Lami, T. 3286 (13 shtator 2006).

²⁷²⁹ Sejdi Lami, P2271 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 korrik 2000), f. 5.

²⁷³⁰ P1809 (Raport përmbledhës i Eric Baccard-it), f. 56. *Shih gjithashtu* P364 (Aktekspertiza kriminalistike për Lamën); P363 (Raport i ekipit kriminalist kanadez, 22 korrik 1999).

nga 22 deri më 24 korrik 1999.²⁷³¹ Sipas Baccard-it, të gjitha kufomat ishin në fazën e kalbëzimit dhe të gjitha ishin meshkuj nga mosha 15 deri 52 vjeç. Në të gjitha rastet shkaku i vdekjes ishte një ose më shumë plagë nga armët e zjarrit.²⁷³² Dhoma Gjyqësore gjithashtu mori dokumente të tri autopsive të tjera të një vendvarrimi në "Sllatinë" të kryera nga patologu Hans P. Hougen në lidhje me tre viktime: Qemajl Deda, Nazmi Elezi, dhe Vesel Elezi.²⁷³³

b. Konkluzione

1116. Në bazë të dëshmive të dhëna nga Sejdi Lami dhe Kërsman Jelliqi si dhe të raportit të luftimit të Brigadës së 243-të të Mekanizuar, Dhoma Gjyqësore konkludon se njësitë e Brigadës së 243-të të Mekanizuar, së bashku me forcat e MPB-së, përfshirë dhe pjesëtarët e PJP-së dhe forca të tjera të paidentifikuara, ishin të pranishme në Sllatinë dhe Vataj më 13 prill 1999. Me gjithë dëshminë e Jelliqit, për të cilën Dhoma tashmë i ka shprehur dyshimet e saj, dëshmia okulare e Sejdi Lamit konfirmon se forcat hynë në fshatin Vataj më 13 prill 1999. Gjatë këtij aksioni u dogjën dhe u plaçkitën shtëpi dhe banorët ikën dhe më vonë shkuan në Maqedoni. Sidoqoftë, nuk ka prova të tilla në lidhje me fshatin Sllatinë.

1117. Një përshkrim i provave mjeko-ligjore në lidhje me çdo kufomë të identifikuar nga Vataj është në Shtojcën A. Në bazë të këtyre provave si edhe të dëshmisë së Sejdi Lamit, Dhoma konkludon se personat në vijim u vranë me armë zjarri më 13 prill 1999: Mahmut Hasan Caka, Habib Lami, Rrahman Lami, Brahim Lami, Ilir Osman Caka, Jakup Mustafë Caka, Izahir Ilaz Salihu, Kemajl Ilaz Salihu, Sabri Ilaz Salihu, Shiqeriber Halili, dhe Ramadan Xhokli. Lami i pa kufomat dhe që në gjendje të përshkruante pjesë të incidentit që çoi në vrasjen e këtyre meshkujve, por ai nuk pa vetë aktin e vrasjeve; ai dëgjoi për katër prej tyre nga gruaja e tij, e cila i tregoi çfarë kishte parë. Dhoma Gjyqësore nuk e gjykon këtë dëshmi të mjaftueshme për të konkluduar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se vrasjet u kryen nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë.

1118. Dhoma nuk ka marrë asnjë dëshmi të drejtpërdrejtë në lidhje me vrasjen e tri viktimave të përfshira në Listën K, konkretisht, Qemajl Deda, Nazmi Elezi, dhe Vesel Elezi, dhe rrjedhimisht nuk është në gjendje të nxjerrë konkluzion se kush i ka vrarë. Gjithashtu nuk është vërtetuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se është vrarë personi i quajtur Ibrahim Lama.

²⁷³¹ P364 (Aktekspertiza kriminalistike për Lamën); P1809 (Raport përmbledhës i Eric Baccard-it), f. 56.

²⁷³² P1809 (Raport përmbledhës i Eric Baccard-it), f. 17, 59.

²⁷³³ P365 (Aktautopsi nga varreza e Sllatinës).

8. Stagovë

1119. Muharrem Dashi, mësues shqiptar kosovar nga fshati Stagovë, në veri të qytetit të Kaçanikut,²⁷³⁴ dëshmoi në lidhje me ngjarjet që ndodhën në fshatin e tij në maj 1999.²⁷³⁵ Sipas Dashit, në fillim të vitit 1999 Stagova banohej vetëm nga banorë shqiptarë kosovarë.²⁷³⁶ Ai vlerësoi se fshati kishte 182 shtëpi dhe rreth 1.600 banorë në atë kohë. Në maj 1999, fshati u mbush përkohësisht me njerëz nga qytetet dhe fshatrat e tjera, të cilët kishin ikur nga shtëpitë "për shkak të situatës së vështirë," dhe si rezultat fshati u bë me rreth 3.000 banorë.²⁷³⁷ Arsyeja e ardhjes së tyre pikërisht në Stagovë ishte se Stagova kishte stacion hekurudhor, prej të cilit mund të shkohej për në Shkup në Maqedoni. Kur të shpërngulurit erdhën në fshat, banorët vendës i ndihmuan dhe i strehuan në shtëpitë e tyre para se ata të merrnin trenin për në Shkup.²⁷³⁸

1120. Dashi dëshmoi se UÇK-ja nuk ishte e pranishme në Stagovë në fillim të vitit 1999. Sidoqoftë, rreth 10 ditë para fillimit të ofensivës më 21 maj 1999, u formua një njësi e UÇK-së me rreth 10-12 vetë për të mbrojtur popullatën nga "represioni." Gjithashtu disa të rinj nga Stagova, të cilët ishin pjesëtarë të UÇK-së, vepronin në zona të tjera. Njësia vendore e UÇK-së në Stagovë u furnizua me pushkë automatike, një mitraloz, dhe një V-500.²⁷³⁹ Dashi deklaroi se ai nuk u përfshi në njësinë e UÇK-së, por në ditën e ofensivës më 21 maj 1999 u bashkua me ta dhe kishte një kallashnikov.²⁷⁴⁰

1121. Dashi shpjegoi se ai merrte pjesë në një grup të pavarur "vëzhgues" dhe me sa duket të veçantë në Stagovë.²⁷⁴¹ Ky grup, i cili përbëhej vetëm prej civilëve, u formua spontanisht rreth 10 ditë para fillimit të ofensivës më 21 maj 1999. Pjesëtarët e grupit punonin me ndërrime për të vrojtuar ardhjen e forcave të RFJ-së/Serbisë nga një pikë vrojtuese në dalje të fshatit. Grupi kishte vetëm një armë (pushkë M-48), por nuk e përdorën asnjëherë.²⁷⁴² Detyra kryesore e tyre ishte të vrojtonin rrugët që çonin në fshat për të parë se mos vinte UJ-ja dhe të kujdeseshin për civilët.²⁷⁴³

²⁷³⁴ P615 (Atlasi i Kosovës), f. 12.

²⁷³⁵ Muharrem Dashi, T. 4521–4525 (9 tetor 2006), T. 4602–4647 (11 tetor 2006), 5D8 (deklarata e dëshmitarit e datës 6 qershor 1999).

²⁷³⁶ Muharrem Dashi, T. 4617 (11 tetor 2006).

²⁷³⁷ Muharrem Dashi, T. 4522 (9 tetor 2006), T. 4632 (11 tetor 2006).

²⁷³⁸ Muharrem Dashi, T. 4634 (11 tetor 2006).

²⁷³⁹ Muharrem Dashi, T. 4522–4524 (9 tetor 2006).

²⁷⁴⁰ Muharrem Dashi, T. 4602–4603, 4622–4623 (11 tetor 2006), 5D8 (deklarata e dëshmitarit e datës 6 qershor 1999), f. 2.

²⁷⁴¹ Muharrem Dashi, T. 4602–4603 (11 tetor 2006). *Shih gjithashtu* Muharrem Dashi, 5D8 (deklarata e dëshmitarit e datës 6 qershor 1999), f. 2.

²⁷⁴² Muharrem Dashi, T. 4602–4603 (11 tetor 2006).

²⁷⁴³ Muharrem Dashi, T. 4604, 4622, 4629–4630 (11 tetor 2006).

1122. Jelliqi dëshmoi se një pjesë e "forcave terroriste" ishin në zonën e fshatit Stagovë, sidomos brenda në fshat dhe në lindje të tij.²⁷⁴⁴ Ai gjithashtu dëshmoi se jashtë Stagovës, në zonën e Kaçanikut të Vjetër dhe Komogllavës, batalioni i tij i blinduar dhe një detashment i blinduar u sulmoheshin shpesh nga pylli në anën tjetër të lumit Nerodime.²⁷⁴⁵

a. Ngjarjet e 21 majit 1999

1123. Në mëngjesin e 21 majit 1999, në Stagovë kishin mbetur vetëm rreth 150 njerëz.²⁷⁴⁶ Banorët e tjerë të fshatit dhe ata që ishin fshehur përkohësisht aty u larguan për në vende të tjera, kryesisht në Shkup me tren. Familja e Dashit u largua nga fshati më 1 maj dhe shkoi në Shkup.²⁷⁴⁷

1124. Më 21 maj në orën 04:00, Dashi ishte në pikën vrojtuese që ishte në hyrje të fshatit.²⁷⁴⁸ Prej atje ai mund të shihte vetëm një pjesë të fshatit, por ishte në gjendje të shihte rrugën kryesore Ferizaj-Kaçanik.²⁷⁴⁹ Ai dëgjoi zhurmën e shumë automjeteve nga rruga. Një orë më vonë, forcat e policisë dhe të ushtrisë hynë në Stagovë.²⁷⁵⁰ Automjetet ndaluan dhe forca me uniforma policore në ngjyrë të kaltër ose të gjelbër të mbyllët me fjalën "milicija" në krah zbritën dhe okupuan zonën e Mëhallës së Gudaqëve, ku ndodhej pika e vrojtimit. Ai i kishte parë edhe më parë policë me këtë lloj uniforme në komunë.²⁷⁵¹ Ndërkohë UJ-ja u vendos përreth fshatit, por nuk hyri në fshat. Dashi pa tanke ushtarake të pozicionuar në ara.²⁷⁵²

1125. Kur ai i pa këto forca duke ardhur, njësia vendore e UÇK-së ndodhej në fshat. Kjo njësi nuk hapi zjarr kundër forcave të UJ-së dhe të MPB-së.²⁷⁵³ Ata u larguan për qark Stagovës dhe u strehuan në Kullën e Cakës, një vend që forcat e UJ-së dhe të MPB-së nuk mund ta shihnin.²⁷⁵⁴ Diku rreth orës 08:00 ose 09:00, Dashi shkoi te Kulla e Cakës dhe u bashkua me ta.²⁷⁵⁵ Prej atje ai

²⁷⁴⁴ Kërsman Jelliq, T. 18931–18932 (23 nëntor 2007).

²⁷⁴⁵ Kërsman Jelliq, T. 18932–18933 (23 nëntor 2007), T. 19020–19021 (26 nëntor 2007).

²⁷⁴⁶ Muharrem Dashi, T. 4633 (11 tetor 2006).

²⁷⁴⁷ Muharrem Dashi, T. 4634 (11 tetor 2006).

²⁷⁴⁸ Muharrem Dashi, T. 4604, 4620 (11 tetor 2006). *Shih gjithashtu* Muharrem Dashi, 5D8 (deklarata e dëshmitarit e datës 6 qershor 1999), f. 2.

²⁷⁴⁹ Muharrem Dashi, T. 4620, 4639 (11 tetor 2006).

²⁷⁵⁰ Muharrem Dashi, T. 4607–4608 (11 tetor 2006).

²⁷⁵¹ Muharrem Dashi T. 4605–4606, 4641 (11 tetor 2006).

²⁷⁵² Muharrem Dashi, T. 4607 (11 tetor 2006).

²⁷⁵³ Muharrem Dashi, T. 4618 (11 tetor 2006).

²⁷⁵⁴ Muharrem Dashi, T. 4618–4619 (11 tetor 2006), 5D8 (deklarata e dëshmitarit e datës 6 qershor 1999), f. 2–3.

²⁷⁵⁵ Muharrem Dashi, T. 4613, 4645–4646 (11 tetor 2006).

mund të shihte të gjithë fshatin, por jo zonën rreth rrugës kryesore Ferizaj-Kaçanik.²⁷⁵⁶ Disa nga ushtarët e UÇK-së kishin uniforma, kurse të tjerët ishin me rroba civile, siç ishte edhe Dashi.²⁷⁵⁷

1126. Dashi shpjegoi se njësia e UÇK-së kishte planifikuar të luftonte, por u paralajmëruan nga një fshatar se një grup i cili kishte tentuar të ikte në veri ishte rrethuar nga paraushtarakët dhe policët. Kur mësuan këtë, ata vendosën të mos hapnin zjarr sepse nuk donin t'i ekspozonin këta njerëz ndaj rrezikut të keqtrajtimit.²⁷⁵⁸

1127. Megjithëse Dashi theksoi se UÇK-ja nuk shkrepiti asnjë plumb, Fadil Vishi, banor i fshatit Dubravë që gjendet në juglindje të Stagovës, dëshmoi se dëgjoi për "luftime" midis UÇK-së dhe policisë në Stagovë në atë datë.²⁷⁵⁹ Sidoqoftë, duket se Vishi nuk e pa vetë këtë "luftim" dhe nuk dha asnjë hollësi për këtë gjatë dëshmisë së tij.

1128. Dashi deklaroi se nga pika e tij e vrojtimit ai pa policë duke patrulluar përgjatë hekurudhës dhe kur hapën zjarr mbi "gjithçka": civilë, shtëpi, dhe kafshë.²⁷⁶⁰ Rreth orës 10:00, ai pa se shtëpitë në fshat filluan të digjeshin. Rreth 96 nga gjithsej 182 shtëpi u dogjën tërësisht, kurse të tjerat u dogjën por nuk u shkatërruan plotësisht.²⁷⁶¹ Pas tërheqjes së forcave të UJ-së dhe MPB-së, ai shkoi në fshat dhe pa se shtëpitë dhe godinat e tjera në fshat ishin djegur nga brenda; disa nga godinat ishin goditur edhe nga jashtë. Godina e shkollës ishte djegur nga brenda dhe xhamia ishte dëmtuar nga predhat.²⁷⁶² Dashi pa disa njerëz duke lëvizur në drejtim të fshatit Nerodime në komunën e Ferizajt, por pastaj ndaluan.²⁷⁶³

1129. Dashi dëshmoi se rreth 50 nga 150 njerëzit që kishin mbetur në Stagovë u kapën nga "forcat serbe." Prej tyre, 14 u vranë dhe rreth 12 u plagosën.²⁷⁶⁴ Ai nuk mundi të shihte vrasjet nga vendi ku kishte qenë, por dëgjoi për to nga të tjerët.²⁷⁶⁵ Me t'u kthyer në fshat pas tërheqjes së forcave, ai pa rreth 10 kufoma, disa prej të cilëve ishin të njerëzve nga Stagova, të cilët i njihnte.²⁷⁶⁶ Ai kujtoi emrat

²⁷⁵⁶ Muharrem Dashi, T. 4613, 4620–4621, 4639 (11 tetor 2006).

²⁷⁵⁷ Muharrem Dashi, T. 4643 (11 tetor 2006).

²⁷⁵⁸ Muharrem Dashi, 5D8 (deklarata e dëshmitarit e datës 6 qershor 1999), f. 3, T. 4636–4637 (11 tetor 2006).

²⁷⁵⁹ Fadil Vishi, T. 3562–3563 (19 shtator 2006).

²⁷⁶⁰ Muharrem Dashi, T. 4613–4614, 4641 (11 tetor 2006).

²⁷⁶¹ Muharrem Dashi, T. 4614 (11 tetor 2006).

²⁷⁶² Muharrem Dashi, T. 4614–4616 (11 tetor 2006).

²⁷⁶³ Muharrem Dashi, T. 4614 (11 tetor 2006).

²⁷⁶⁴ Muharrem Dashi, T. 4623–4625, 4633 (11 tetor 2006).

²⁷⁶⁵ Muharrem Dashi, T. 4623, 4639 (11 tetor 2006).

²⁷⁶⁶ Muharrem Dashi, T. 4614–4616 (11 tetor 2006).

e këtyre viktimave, kufomat e të cilëve i njohu: Fitim Gudaqi (shtatë vjeç),²⁷⁶⁷ Ramadan Dashi, Ibrahim Dashi (30 vjeç),²⁷⁶⁸ Hamdi Dashi,²⁷⁶⁹ gjyshja e Fitim Gudaqit (mbi 80 vjeçe), Bela, dhe Rushi.²⁷⁷⁰ Sipas Dashit, të gjithë ishin civilë.²⁷⁷¹ Ishin edhe dy kufoma të tjera, të Ramush Jahës (80-90 vjeç) dhe Fahri Mani (rreth 60 vjeç), të cilat ishin pak më larg, por ai nuk i pa personalisht.²⁷⁷²

1130. Fakti se forcat e UJ-së kryen një aksion në Stagovë konfirmohet nga një raport luftimi i Armatës së 3-të, ku shënohet se më 21 maj 1999, "elementë" të Brigadës së 243-të të Mekanizuar rrethuan Runjevën dhe Stagovën, i "shpartalluan" forcat shqiptare në këto fshatra dhe likuiduan pesë "terroristë."²⁷⁷³

1131. Jelliqi dëshmoi se pjesëtarët e brigadës së tij nuk kishin hyrë, rrethuar, apo rrezikuar fshatin Stagovë më 21 maj 1999. Ai fillimisht pretendoi se UJ-ja nuk ndodhej fare në afërsi të fshatit.²⁷⁷⁴ Mirëpo pasi i treguan raportin e luftimit të Armatës së 3-të të 22 majit, Jelliqi deklaroi se forcat "terroriste" kishin sulmuar një pjesë të forcave të MPB-së në Kaçanik dhe se MPB-ja i kishte zbrapsur forcat "terroriste" nëpër Runjevë dhe Stagovë gjatë një aksioni legjitim. Njësia e tij ndodhej në Kaçanik të Vjetër, rreth një kilometër nga fshati Stagovë, por meqë ushtria përdorte automjete "vetëlëvizëse," ajo nuk kishte mundësi të hynte në fshat edhe po të donte, për shkak të terrenit moçalor të atjeshëm.²⁷⁷⁵ Më vonë Jelliqi pranoi se ushtria hapi zjarr mbi fshatrat Runjevë dhe Stagovë, por vetëm gjatë luftimeve me "terroristët." Ai sqaroi se pesë "terroristë" u vranë në pozicionet e tyre në male, rreth një kilometër në veri të Stagovës, dhe se në ato luftime u vra edhe një nga ushtarët e tij.²⁷⁷⁶

1132. Një raport luftimi i Komandës së Korpunit të Prishtinës konfirmonte se UÇK-ja kishte hapur zjarr me armë këmbësorie dhe raketahedhës në sektorët e fshatrave Runjevë dhe Stagovë dhe se

²⁷⁶⁷ Në deklaratën me shkrim, Dashi dëshmoi për lëndimet e disa prej viktimave dhe tha se kishte parë se Fitim Gudaqi kishte një vrimë nga plumbi në fyt. Nëna e Fitim Gudaqit i tregoi më vonë se i biri ishte vrarë kur ajo po e bartte në krah. Muharrem Dashi, 5D8 (deklarata e dëshmitarit e datës 6 qershor 1999), f. 4.

²⁷⁶⁸ Dashi tha se Ibrahim Dashit i mungonin balli dhe mjekra dhe se kishte plagë në stomak. Muharrem Dashi, 5D8 (deklarata e dëshmitarit e datës 6 qershor 1999), f. 4.

²⁷⁶⁹ Dashi tha se fytyra e Hamdi Dashit ishte e lënduar. Muharrem Dashi, 5D8 (deklarata e dëshmitarit e datës 6 qershor 1999), f. 4.

²⁷⁷⁰ Muharrem Dashi, T. 4615–4616 (11 tetor 2006); 5D8 (deklarata e dëshmitarit e datës 6 qershor 1999), f. 4. Shih gjithashtu P368 (aktautopsi i Interpolit të Identifikimit të Viktimave të Fatkeqësive), f. 494, 553.

²⁷⁷¹ Muharrem Dashi, T. 4616 (11 tetor 2006).

²⁷⁷² Muharrem Dashi, T. 4616 (11 tetor 2006); *Shih gjithashtu* 5D8 (deklarata e dëshmitarit e datës 6 qershor 1999), f. 4.

²⁷⁷³ 4D270 (Raport luftimi i Armatës së 3-të, 22 maj 1999), f. 1, 3.

²⁷⁷⁴ Kërsman Jelliq, T. 18931 (23 nëntor 2007).

²⁷⁷⁵ Kërsman Jelliq, T. 19020–19021 (26 nëntor 2007).

²⁷⁷⁶ Kërsman Jelliq, T. 19021–19022 (26 nëntor 2007). *Shih gjithashtu* 6D1313 (Raport luftimi i Komandës së PrK-së, 22 maj 1999), f. 1–3.

fshatrat ishin "izoluar" nga Brigada e 243-të e Mekanizuar, e cila kishte "shkatërruar" forcat shqiptare kosovare në këto fshatra.²⁷⁷⁷ Jelliqi deklaroi se kjo kishte kuptimin se Brigada ishte "në zonën" e fshatrave, jo "brenda" në fshatra, dhe se gjatë "shkatërrimit" të terroristëve ata nuk sulmuan brenda fshatrave dhe nuk hynë në to për të kontrolluar, e as MPB-ja nuk kishte hyrë.²⁷⁷⁸

1133. Përpjekjet e Jelliqit për të mohuar përfshirjen e UJ-së në operacione në Stagovë dhe qëndrimi i tij fillestar se më 21 maj 1999 njësitë e tij nuk ishin askund afër fshatit, me gjithë provat dokumentare dhe dëshmitë okulare për të kundërtën, edhe një herë provojnë jobesueshmërinë e dëshmisë së tij.

1134. Dhoma Gjyqësore ka marrë nga Dr. Eric Baccard prova mjeko-ligjore në lidhje me kufomat e gjetura në Stagovë. Raporti i Baccard-it përmban një pjese ku analizohen autopsitë e kryera në kufomat e zhvarrosura në Stagovë nga pjesëtarët e ekipit zviceran për Identifikimin e Viktimave të Fatkeqësive, dhe të paraqitura me shkrim në aktautopsinë e Interpolit të Identifikimit të Viktimave të Fatkeqësive.²⁷⁷⁹

1135. Sipas Baccard-it, në dhjetë kufoma nga vendvarrimi në Stagovë u kryen autopsi më 24 dhe 25 shtator 1999.²⁷⁸⁰ Të dhjetë kufomat u identifikuan nga familjarët e tyre; gjashtë prej tyre ishin meshkuj dhe katër femra, dhe mosha e tyre ishte prej shtatë deri 83 vjeç. Të gjithë kishin së paku një plagë plumbi dhe shkaku i vdekjes iu atribuua lëndimeve të organeve të brendshme ose të kafkës/trurit. Gjithashtu, Baccard-i vëren se në tri raste kufomat kishin pësuar lëndime nga mjete të forta.²⁷⁸¹

1136. Gjithashtu, Dhoma Gjyqësore ka marrë edhe raportin e vendvarrimit në "Stagovë," i cili përmban autopsitë e dy vetëve, konkretisht të Fahri Manit dhe Ramush Jahës, të kryera nga patologu Hans P. Hougen.²⁷⁸²

b. Konkluzione

1137. Dhoma Gjyqësore konkludon se më 21 maj 1999 njësitë e Brigadës së 243-të të Mekanizuar në një aksion të përbashkët me forcat e MPB-së, sulmuan Stagovën. Edhe pse Muharrem Dashi pa kur gjatë aksionit pjesëtarët e MPB-së shtinë kundër civilëve, shtëpive dhe kafshëve në fshat dhe

²⁷⁷⁷ 6D1313 (Raport luftimi i Komandës së PrK-së, 22 maj 1999), f. 1–2; Kërsman Jelliq, T. 19024 (26 nëntor 2007).

²⁷⁷⁸ Kërsman Jelliq, T. 19023–19024 (26 nëntor 2007). *Shih gjithashtu* Kërsman Jelliq, T. 19054 (26 nëntor 2007).

²⁷⁷⁹ P1809 (Raport përmbledhës i Eric Baccard-it), f. 59; *Shih gjithashtu* P368 (Aktautopsi e Interpolit të Identifikimit të Viktimave të Fatkeqësive).

²⁷⁸⁰ P1809 (Raport përmbledhës i Eric Baccard-it), f. 60.

²⁷⁸¹ P1809 (Raport përmbledhës i Eric Baccard-it), f. 17, 63.

²⁷⁸² P369 (Aktautopsi për vendvarrimin në Stagovë, 7 tetor 1999).

më pas pa 10 kufoma të njerëzve të vranë, Dhoma konkludon se ai nuk ishte dëshmitar okular i asnjë vrasjeje. Provat tregojnë se Baki Bela, Hamdi Dashi, Ibrahim Avdi Dashi, Ramadan Dashi, Bahrije Elezi, Fitim Gudaqi, Hanife Gudaqi, Sevdie Gauri, Elife Jaha, Ramush Jaha, Fahri Mani, dhe Ibush Rrushi u vranë me armë zjarri në Stagovë më 21 maj 1999. Sidoqoftë, duke marrë parasysh mungesën e provave në lidhje me rrethanat e këtyre vrasjeve, Dhoma nuk mund të nxjerrë konkluzion jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se këta njerëz u vranë nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë.

9. Lisnajë

1138. Fshati Lisnajë gjendet rreth tetë kilometra në veriperëndim të qytetit të Kaçanikut.²⁷⁸³ Fadil Vishi i përshkroi ngjarjet në fshat në maj 1999, duke përfshirë rrëmbimin e pastaj vrasjen e Rrahim Vishit, Milaim Vishit dhe Sylejman Gurit.²⁷⁸⁴

a. Ngjarjet më 5 maj 1999

1139. Vishi tregoi se në fillim të vitit 1999 banorët e Lisnajës mbaheshin nën vëzhgim të vazhdueshëm nga forcat e UJ-së dhe MPB-së të vendosura afër fabrikës "Silkapor" dhe në malin "Sharr." Nga këto pozicione, ata ishin në gjendje të shihnin të gjitha lëvizjet në fshat dhe të ndalonin çdokënd që shkonte brenda apo jashtë zonës.²⁷⁸⁵ Ushtarët që Vishi i pa të vendosur në Silkapor kishin uniforma ushtarake kamuflimi.²⁷⁸⁶ Gjithsesi Jelliqi mohoi se ushtria kishte qenë në fabrikën Silkapor gjatë bombardimeve të NATO-s, duke thënë se ajo ishte më në veri, jashtë Doganajt.²⁷⁸⁷

1140. Gjatë natës së 5 majit 1999, Fadil Vishi, Rrahim Vishi (18 vjeç), dhe Milaim Vishi (55-vjeç) kishin shkuar të blinin sheqer dhe cigare te Ramadan Lami.²⁷⁸⁸ Duke shkuar në drejtim të rrugës kryesore, Fadil Vishi takoi Sylejman Gurrin dhe pastaj erdhën dy njerëz të tjerë, të cilët ai nuk i njihnte.²⁷⁸⁹ Më pas Vishi pa "tre ushtarë të ushtrisë" me uniforma kamuflimi dhe me armë

²⁷⁸³ Fadil Vishi, P2285 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4446. *Shih gjithashtu* IC142 (Hartë e shënuar nga Kërsmen Jelliqi); P615 (Atlasi i Kosovës), f. 12.

²⁷⁸⁴ Fadil Vishi, T. 3553 (19 shtator 2006), P2284 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 tetor 1999), f. 2, P2285 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4448.

²⁷⁸⁵ Fadil Vishi, P2284 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 tetor 1999), f. 2, P2285 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4451, 4454–4455.

²⁷⁸⁶ Fadil Vishi, P2285 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4454, 4472.

²⁷⁸⁷ Kërsmen Jelliq, T. 18927–18928 (23 nëntor 2007).

²⁷⁸⁸ Fadil Vishi, P2284 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 tetor 1999), f. 2, P2285 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4456–4460, 4462–4463.

²⁷⁸⁹ Fadil Vishi, P2284 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 tetor 1999), f. 3.

automatike që iu afruan befasisht Gurrit nga drejtime të ndryshme.²⁷⁹⁰ Ata i bërtitën që të ngrinte duart lart dhe e urdhëruan që të vazhdonte të ecte në "drejtim të kundërt" nga rruga kryesore.²⁷⁹¹ Kur u kthye në Lisnajë, Vishit i thanë se Rrahim Vishi dhe Milaim Vishi kishin shkuar në të njëjtin drejtim si Sylejman Guri.²⁷⁹² Vishi dëshmoi se pas këtij incidenti askush nuk i pa më të gjallë Rrahim Vishin, Milaim Vishin, dhe Sylejman Gurrit dhe askush nuk e dinte se çfarë u kishte ndodhur.²⁷⁹³ Rreth 25-26 majit 1999, Rrahim Vishi, Milaim Vishi, Sylejman Gurri, dhe Ramadan Lami u gjetën të vdekur (shih më poshtë).²⁷⁹⁴ Sipas Vishit, asnjëri prej tyre nuk ishte anëtar i UÇK-së.²⁷⁹⁵

b. Ngjarjet më 25 maj 1999

1141. Gjithashtu Fadil Vishi dëshmoi se, më 25 maj 1999, rreth orës 03:30, "forcat serbe," ushtria dhe paraushtarakët, rrethuan Lisnajën.²⁷⁹⁶ Këto forca ishin të pajisura me armë të rënda, Praga, dhe autobllinda.²⁷⁹⁷ Sikurse në Stagovë, banorët e Lisnajës kishin organizuar "roja" të paarmatosura për të ruajtur fshatin dhe për të paralajmëruar të gjithë në rast se ndodhte ndonjë gjë.²⁷⁹⁸ Personat që ishin në detyrë atë natë e zgjuan Vishin, kurse ai i zgjoi të gjithë në lagje.²⁷⁹⁹ Sipas Vishit, në Lisnajë nuk kishte prani të UÇK-së, por shtabi i Brigadës së 162-të të UÇK-së ndodhej rreth tri kilometra më larg.²⁸⁰⁰ Sidoqoftë, në atë kohë nuk pati luftime midis UÇK-së dhe ushtrisë në atë kohë.²⁸⁰¹

1142. Pasi ishin zgjuar, fshatarët u mblodhën afër shkollës. Vishi i këshilloi të largoheshin the të niseshin në drejtim të Maqedonisë.²⁸⁰² Fshatarët pranuan sepse e dinin dhe kishin frikë nga çfarë kishte ndodhur në fshatrat e tjera.²⁸⁰³ Ata formuan një kolonë me gra, pleq, dhe fëmijë dhe u nisën

²⁷⁹⁰ Fadil Vishi, P2284 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 tetor 1999), f. 3, T. 3554, 3561 (19 shtator 2006).

²⁷⁹¹ Fadil Vishi, P2284 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 tetor 1999), f. 3.

²⁷⁹² Fadil Vishi, P2284 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 tetor 1999), f. 3.

²⁷⁹³ Fadil Vishi, P2284 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 tetor 1999), f. 3.

²⁷⁹⁴ Fadil Vishi, P2284 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 tetor 1999), f. 2–4, P2285 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4448, 4460, 4467.

²⁷⁹⁵ Fadil Vishi, P2285 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4467–4468.

²⁷⁹⁶ Fadil Vishi, T. 3555–3556 (19 shtator 2006), P2284 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 tetor 1999), f. 3–4, P2285 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4461.

²⁷⁹⁷ Fadil Vishi, T. 3556–3557, 3564–3565 (19 shtator 2006).

²⁷⁹⁸ Fadil Vishi, P2284 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 tetor 1999), f. 3, T. 3562 (19 shtator 2006).

²⁷⁹⁹ Fadil Vishi, P2284 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 tetor 1999), f. 4, T. 3562 (19 shtator 2006).

²⁸⁰⁰ Fadil Vishi, P2285 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4467–4468.

²⁸⁰¹ Fadil Vishi, T. 3563, 3565 (19 shtator 2006).

²⁸⁰² Fadil Vishi, P2284 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 tetor 1999), f. 4, P2285 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4464–4466.

²⁸⁰³ Fadil Vishi, P2285 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4469.

në drejtim të Maqedonisë.²⁸⁰⁴ Më të rinjtë, përfshirë edhe Vishin, shkuan drejt pyllit, përveç disave që ngisnin traktorët me gra, fëmijë, dhe pleq. Vishi qëndroi në pyll afër fshatit dhe mundi të shihte çfarë ndodhi më pas.²⁸⁰⁵ Kolona u ndalua nga ushtarët rreth një kilometër më tutje dhe gjashtë vetë u arrestuan.²⁸⁰⁶ Dy nga ata u liruan pas pak kohe, por katër të tjerët u dërguan në Ferizaj, ku, siç dëgjoi Vishi më vonë, ishin mbajtur katër ditë në stacionin e policisë ku ishin torturuar.²⁸⁰⁷

1143. Fadil Vishi dëshmoi se në mbrëmjen e 25 majit 1999, nga vendi ku ishte fshehur në pyllin e afërt ai pa shtëpinë e tij në Lisnajë duke u djegur. Kur disa njerëz u munduan të fiknin zjarrin, ata gjetën në oborrin e tij kufomat e Rrahim Vishit dhe Milaim Vishit. Rreth 50 metra nga shtëpia e tij, u gjetën të vdekur edhe dy njerëz, të quajtur Ali Tusha dhe Xhemail Tusha. Të nesërmen gjetën kufomën e Sylejman Gurrit në pyll, rreth dy kilometra nga fshati. Ata gjithashtu gjetën kufomat e fshatarëve të tjerë, konkretisht të Hajrush Qorrit, djalit të tij Arbenit, dhe vajzës Fetijes, dhe të Rexhep Qorrit. Sidoqoftë, Vishi nuk pas asnjë nga këto kufoma me sytë e tij sepse ai qëndroi në pyll deri më 26 maj 1999 e pastaj eci në drejtim të Maqedonisë.²⁸⁰⁸

1144. Dëshmitarja K31, grua shqiptare kosovare nga komuna e Kaçanikut, e konfirmoi pjesërisht dëshminë e Vishit. Dhoma Gjyqësore vë në dukje se ekzistojnë masa për fshehjen e identitetit të K31-shit dhe për këtë arsye hollësitë e dëshmisë së saj në lidhje me Kaçanikun nuk parashtrohen këtu. Sidoqoftë, Dhoma e konsideron atë dëshmitare të besueshme të ngjarjeve që ajo përjetoj në maj 1999.²⁸⁰⁹

1145. Kërsman Jelliqi, i cili u ballafaqua me dëshminë e Vishit, mohoi se forcat e tij rrethuan dhe sulmuan fshatrat Lisnajë dhe Rekë në maj 1999.²⁸¹⁰ Ai gjithashtu dëshmoi se zona ishte bastion i fuqishëm "terrorist" dhe se Brigada e 162-të "terroriste" ndodhej atje. Ai gjithashtu konfirmoi se MPB-ja kishte konflikte në atë zonë dhe se njësia e tij kishte pozicione mbrojtëse atje, por vetëm

²⁸⁰⁴ Fadil Vishi, P2284 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 tetor 1999), f. 4, P2285 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4466.

²⁸⁰⁵ Fadil Vishi, P2284 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 tetor 1999), f. 4.

²⁸⁰⁶ Fadil Vishi, P2284 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 tetor 1999), f. 4, T. 3563 (19 shtator 2006). *Shih gjithashtu* Kërsman Jelliq, T. 18928 (23 nëntor 2007).

²⁸⁰⁷ Fadil Vishi, P2284 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 tetor 1999), f. 4. *But Shih* Fadil Vishi, P2285 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4447–4448, 4466, 4471.

²⁸⁰⁸ Fadil Vishi, P2284 (deklarata e dëshmitarit e datës 18 tetor 1999), f. 4.

²⁸⁰⁹ K31, P2595 (deklarata e dëshmitarit e datës 16 tetor 1999), f. 2–4 (e mbyllur me vulë), P2596 (deklarata e dëshmitarit e datës 10 dhe 12 mars 2002), f. 2, T. 9239–9240 (25 janar 2007) (seancë e mbyllur).

²⁸¹⁰ Kërsman Jelliq, T. 18919 (23 nëntor 2007).

mbronte pozicionet e veta.²⁸¹¹ Ai nuk kishte tanke në këtë zonë, vetëm obusë që duhej të tërhiqeshin.²⁸¹²

1146. Sidoqoftë, gjatë pyetjeve nga Prokuroria Jelliqi konfirmoi se "forcat terroriste" sulmuan njësitë e brigadës së tij në Kovaçec, Nikaj, Biçec, dhe Lisnajë.²⁸¹³ Ai gjithashtu konfirmoi se, më 25 maj 1999, pjesë të Brigadës së 243-të të Mekanizuar kryen një "operacion të përbashkët" të quajtur "Dubrava" së bashku me forcat e MPB-së, ku i shpartalluan "terroristët" dhe i bllokuan nga pozicionet e tyre luftuese.²⁸¹⁴ Jelliqi konfirmoi se si rezultat i këtij operacioni pati viktima dhe se njësia e tij dhe MPB-ja konfiskuan dhjetëra armë në atë zonë.²⁸¹⁵

1147. Dhoma Gjyqësore ka marrë nga Baccard-i prova mjeko-ligjore në lidhje me kufomat e gjetura në Lisnajë. Raporti i tij përmban një pjesë ku analizohen autopsitë e kryera në tetë kufoma të zhvarrosura nga "varreza islame në Dubravë" nga pjesëtarët e ekipit zviceran për Identifikimin e Viktimave të Fatkeqësive më 20 dhe 21 shtator 1999 dhe të përshkruara në një raport.²⁸¹⁶ Sipas Baccard-it, u hetuan shtatë varre të rriturish dhe një fëmije dhe u zhvarrosën tetë kufoma.²⁸¹⁷ Shtatë nga kufomat ishin meshkuj, kurse një ishte femër. Ata u identifikuan nga të afërmit.²⁸¹⁸ Çdo kufomë kishte së paku një plagë nga armët a zjarrit, që kishin shkaktuar vdekjen në shumicën e rasteve.²⁸¹⁹ Baccard-i gjithashtu vërejti se njëra nga kufomat ishte në pozicion të kërrusur, të gjunjëzuar, kurse një tjetër kishte qenë e shtrirë përtokë.

c. Konkluzione

1148. Dhoma Gjyqësore konkludon se më 25 maj 1999, Brigada e 243-të e Mekanizuar së bashku me forcat e MPB-së dhe forca të tjera të pidentifikuara, sulmuan fshatin Lisnajë, duke i detyruar banorët që të largoheshin nga fshati, fillimisht për në fshatrat e tjera, e pastaj për në Maqedoni.

1149. Një përshkrim i provave mjeko-ligjore në lidhje me kufomat e vendvarrimit të Lisnajës, që u përpilua dhe u paraqitën nga Baccard-i, janë përfshirë në Shtojcën A. Në bazë të këtyre provave, së bashku me dëshminë e Fadil Vishit, Dhoma konkludon se Milaim Misim Vishi dhe Rrahim Beqir

²⁸¹¹ Kërsman Jelliq, T. 18919–18920 (23 nëntor 2007); *Shih gjithashtu* 5D666 (Urdhër i Brigadës së 243-të të Mekanizuar, 4 maj 1999).

²⁸¹² Kërsman Jelliq, T. 18923–18924 (23 nëntor 2007).

²⁸¹³ Kërsman Jelliq, T. 19014 (26 nëntor 2007).

²⁸¹⁴ Kërsman Jelliq, T. 19015–19016 (26 nëntor 2007).

²⁸¹⁵ Kërsman Jelliq, T. 18920–18922 (23 nëntor 2007).

²⁸¹⁶ P1809 (Raport përmbledhës i Eric Baccard-it), f. 52. *Shih gjithashtu* P371 (Raport kriminalistik i ekipit zviceran për Identifikimin e Viktimave të Fatkeqësive në lidhje me vrasjet në Lisnajë, mars 2000).

²⁸¹⁷ P1809 (Raport përmbledhës i Eric Baccard-it), f. 52.

²⁸¹⁸ P1809 (Raport përmbledhës i Eric Baccard-it), f. 52.

²⁸¹⁹ P1809 (Raport përmbledhës i Eric Baccard-it), f. 16, 56.

Vishi u vranë rreth 5 majit 1999; kufomat e tyre u gjetën më 25 maj 1999. Personat në vijim u vranë më 25 maj 1999: Arton Hajrush Qorri, Fatije Hajrush Qorri, Hajrush Mehmet Qorri, Rexhep Zejnullah Qorri, Ali Tusha, Xhemajl Tusha, dhe viktimat që nuk është përfshirë në Listë, Sylejman Gurri. Dhoma Gjyqësore ka pranuar dëshmi të drejtpërdrejt se si dhe nga kush janë vranë Fatije Hajrush Qorri dhe Rexhep Zejnullah Qorri; sidoqoftë, Dhoma nuk ka marrë dëshmi të drejtpërdrejt se si dhe nga kush janë vranë viktimat në vijim: Arton Hajrush Qorri, Hajrush Mehmet Qorri, Ali Tusha, Xhemajl Tusha, Rrahim Beqir Vishi, Milaim Misim Vishi, dhe Sylejman Gurri. Rrjedhimisht Dhoma nuk mund të konkludojë jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se këta njerëz janë viktimat të krimeve të kryera nga forcat e RFJ-së/Serbisë. Sidoqoftë, Dhoma konkludon se Fatije Hajrush Qorri dhe Rexhep Zejnullah Qorri, të cilët ishin civilë, u vranë nga pjesëtarët e forcave të RFJ-së/Serbisë.

N. PASQYRË E PËRGJITHSHME E NGJARJEVE

1150. Përgjithësisht nuk kundërshtohet se një numër i konsiderueshëm i njerëzve nga Kosova u larguan nga shtëpitë e tyre gjatë bombardimeve të NATO-s, shumë prej të cilëve kanë kaluar kufirin me Shqipërinë dhe Maqedoninë. Provat dokumentare dhe dëshmitarët e paraqitur nga Prokuroria dhe Mbrojtja konfirmojnë këtë migrim të shpejt, kryesisht të shqiptarëve kosovarë.²⁸²⁰ Për shembull, një varg raportesh të dërguara nga Shtabi i MPB-së dërguar selisë së MPB-së në Beograd nga 24 marsi deri më 1 maj 1999 përmbajnë shënime për numrin e shqiptarëve kosovarë që kaluan kufijtë në atë periudhë, duke mos dhënë asnjë arsye për largimin e tyre.²⁸²¹ Sipas këtyre raporteve, në javën e parë të bombardimeve të NATO-s, mbi 300.000 shqiptarë kosovarë kaluan në Shqipëri

²⁸²⁰ *Shih, p.sh.*, P2438 (Deklarata e redaktuar e Neill Wright-it të UNHCR-së); P738 (Vlerësimet e UNHCR-së të Shpërnguljeve dhe të Kthimeve); 5D885 (raport i komandantit të Brigadës së 549-të të Motorizuar dërguar Komandës së PrK-së, 3 prill 1999); P2019 (Ditari i luftës i Batalionit të 2-të të Motorizuar të Brigadës së 549-të të Motorizuar), f. 5 (e mbyllur me vulë); Bozhidar Deliq, T. 19310 (29 nëntor 2007); K54, T. 10513–10514 (26 shkurt 2007); Knut Vollebaek, T. 9522–9524 (31 janar 2007); Momir Stojanoviq, T. 19730–19731 (6 dhjetor 2007); Millosh Vojnoviq, T. 24239 (13 mars 2008).

²⁸²¹ 6D1232 (pasqyrë e ngjarjeve të sigurisë, 24 mars 1999); 6D1236 (pasqyrë e ngjarjeve të sigurisë, 28 mars 1999); 6D1238 (pasqyrë e ngjarjeve të sigurisë, 2 prill 1999); 6D1239 (pasqyrë e ngjarjeve të sigurisë, 3 prill 1999); 6D1240 (pasqyrë e ngjarjeve të sigurisë, 4 prill 1999); 6D1241 (pasqyrë e ngjarjeve të sigurisë, 5 prill 1999); 6D1242 (pasqyrë e ngjarjeve të sigurisë, 6 prill 1999); 6D1244 (pasqyrë e ngjarjeve të sigurisë, 8 prill 1999); 6D1254 (pasqyrë e ngjarjeve të sigurisë, 18 prill 1999); 6D1255 (pasqyrë e ngjarjeve të sigurisë, 19 prill 1999); 6D1256 (pasqyrë e ngjarjeve të sigurisë, 20 prill 1999); 6D1257 (pasqyrë e ngjarjeve të sigurisë, 21 prill 1999); 6D1259 (pasqyrë e ngjarjeve të sigurisë, 23 prill 1999); 6D1260 (pasqyrë e ngjarjeve të sigurisë, 24 prill 1999); 6D1261 (pasqyrë e ngjarjeve të sigurisë, 25 prill 1999); P1693 (pasqyrë e ngjarjeve të sigurisë, 1 maj 1999)

ose Maqedoni.²⁸²² Deri më 6 prill ky numër u dyfishua, kurse deri më 1 maj arriti shifrën prej 715.158 njerëz.²⁸²³

1151. Prokuroria argumenton se mijëra shqiptarë kosovarë ikën nga krahina për shkak të veprimeve të dhunshme dhe shtrënguese të forcave të RFJ-së dhe të Serbisë, të cilat ndërmorën një fushatë terrori kundër popullatës shqiptare kosovare për t'i dëbuar nga shtëpitë dhe për t'i detyruar që të kalonin kufijtë me Shqipërinë dhe Maqedoninë. Ky argument mbështetet nga dëshmitë përputhëse të shumë dëshmitarëve shqiptarë kosovarë, si dhe të disa ish-pjesëtarëve të UJ-së dhe MPB-së të paraqitur nga Prokuroria. Sidoqoftë, dëshmitarët e paraqitur nga Mbrojtja vazhdimisht mohuan se u krye dëbim i organizuar të shqiptarëve kosovarë nga shtëpitë e tyre, dhe shumë prej tyre dhanë arsye alternative për lëvizjen masive të shqiptarëve kosovarë përtej kufirit në Shqipëri dhe Maqedoni.

1152. Nebojsa Ognjenoviqi, i cili ishte komandant i stacionit policor kufitar në kalimin kufitar të Vërbnicës (Morinës) në fillim të vitit 1999, dëshmoi se, që nga fillimi i bombardimeve të NATO-s, shumë njerëz kishin filluar të vinin atje duke kërkuar të kalonin. Ai regjistroi gjithsej 430.000 njerëz që kaluan atje gjatë fushatës së NATO-s, ku kolonat e njerëzve që prisnin të kalonin arrinin edhe deri 20 kilometra.²⁸²⁴ Njerëzit që kërkonin të kalonin kufirin i dhanë arsye të ndryshme të largimit të tyre, kryesisht bombardimet e NATO-s dhe konflikti midis UÇK-së dhe UJ-së.²⁸²⁵

1153. Bozhidar Deliqi hartoi një raport për Komandën e Korpusit të Prishtinës, në të cilën parashtronte se "shfaqja e refugjatëve... erdhi si befasi." Më tej ai ofronte arsyet në vijim për lëvizjen e civilëve, të nxjerra në bazë të "bisedave me individë në kolonat e refugjatëve": (1) frika nga luftimet midis forcave të RFJ-së dhe Serbisë në njërën anë dhe NATO-s e UÇK-së në anën tjetër; (2) ikja prej mobilizimit të detyruar nga UÇK-ja; (3) frika nga UJ-ja, MPB-ja, dhe "sidomos" nga "trupat e Arkanit"; dhe (4) frika nga bombardimet e NATO-s.²⁸²⁶ Deliqi shtonte se frika nga bombardimet e NATO-s theksohej si arsyeja kryesore nga "refugjatët" shqiptarë kosovarë për shkak se kryheshin pa dallim .²⁸²⁷ Vlatko Vukoviqi dëshmoi se, kur i kishte pyetur civilët se pse

²⁸²² 6D1238 (pasqyrë e ngjarjeve të sigurisë, 2 prill 1999), f. 5.

²⁸²³ 6D1242 (pasqyrë e ngjarjeve të sigurisë, 6 prill 1999), f. 6; P1693 (pasqyrë e ngjarjeve të sigurisë, 1 maj 1999), f. 8. Megjithëse P1693 evidenton se nga 24 prilli deri më 1 maj nga Kosova u larguan 715.158 shqiptarë kosovarë, Dhoma mendon se duhet të jetë gabim shtypi sepse është e qartë prej raporteve të tjera të marra si provë se periudha në fjalë është 24 mars deri më 1 maj 1999.

²⁸²⁴ Nebojsa Ognjenoviq, T. 22888 (20 shkurt 2008).

²⁸²⁵ Nebojsa Ognjenoviq, T. 22882–22884 (20 shkurt 2008).

²⁸²⁶ 5D885 (Dokument i Komandës së Brigadës së 549-të të Motorizuar, 3 prill 1999), f. 1–2; *Shih gjithashtu* 3D1052 (Raport i Degës së Sigurimit të Komandës së Armatës së 3-të, 13 mars 1999), para. 2.2 (që raporton se pjesëtarë të armatosur të UÇK-së "hynë nëpër shtëpitë e pjesëtarëve të pakicës etnike shqiptare për të bërë mobilizim me forcë më 11 dhe 12 mars 1999).

²⁸²⁷ Bozhidar Deliq, T. 19303–19304 (29 nëntor 2007).

largoheshin nga shtëpitë, ata "pa përjashtim" kishin përmendur frikën nga bombardimet e NATO-s.²⁸²⁸ Edhe oficeri i UJ-së Sasha Antiqi tha se civilët shqiptarë kosovarë nga qyteti i Prishtinës i thanë se ishin detyruar të largoheshin për shkak të presionit nga UÇK-ja ose nga frika e bombardimeve të NATO-s.²⁸²⁹

1154. Kërsman Jelliqi dëshmoi se lëvizja e civilëve në zonën në "jug të Ferizajt" u shkaktua kryesisht nga mobilizimi i detyruar nga UÇK-ja si dhe nga motivimi për të "pastruar" zonën nga civilët për të krijuar korridor për kalimin e forcave tokësore të NATO-s.²⁸³⁰ Sidoqoftë, ai nuk u pyet dhe nuk shpjegoi se si kishte ardhur në këtë përfundim. Zdravko Vintari dëshmoi se një numër i madh i banorëve të qytetit të Gjakovës ikën në Shqipëri për shkak të sulmeve ajrore të NATO-s. Ai gjithashtu dëshmoi se UÇK-ja bënte presion mbi shqiptarët kosovarë që të largoheshin nga Kosova për të "krijuar përshtypjen e katastrofës humanitare."²⁸³¹ Millutin Fillipoviqi dëshmoi se gjatë bombardimeve të NATO-s, UÇK-ja shpërndau fletushka në rrugët e qytetit, duke i bërë thirrje popullatën shqiptare që të largohej nga qyteti në drejtim të Shqipërisë dhe Maqedonisë;²⁸³² dhe Nebojsa Bogunoviqi tha se fletushka ku i bëhej thirrje popullatën shqiptare kosovare që të largoheshin nga Kosova u shpërndanë në qytetin e Mitrovicës.²⁸³³ Sidoqoftë, asnjë nga dëshmitarët të cilët dëshmuuan për largimin e tyre nga Prishtina dhe Mitrovica nuk përmendën se kishin parë pamflete të tilla ose se u larguan nga shtëpitë për shkak të tyre. Bogunoviqi dhe Lubisha Dikoviqi thanë se njerëzit u larguan nga Kosova për shkak të UÇK-së dhe sulmeve ajrore të NATO-s.²⁸³⁴ Edhe në këtë rast ata nuk u pyetën dhe nuk sqaruan arsyen se pse kishin ardhur në këtë përfundim.

1155. Oficeri i MPB-së, Dushan Gavraniqi, dëshmoi se civilët shqiptarë kosovarë që u larguan nga fshati Zhegër në komunën e Gjilanit vepruan kështu në ditët e para të fushatës së NATO-s nga frika e bombardimeve të NATO-s, duke marrë parasysh afërsinë e fshatit me pozicionet e UJ-së në grykën malore të Muçibabës.²⁸³⁵ Lubivoje Jokshiqi, gjithashtu i MPB-së, dëshmoi se njerëzit e të gjitha përkatësive etnike të frikësuar nga bombardimet e NATO-s, filluan të largoheshin nga qyteti i Prishtinës.²⁸³⁶

²⁸²⁸ Vllatko Vukoviç, T. 21335 (29 janar 2008).

²⁸²⁹ Sasha Antiq, 5D1398 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 janar 2008), para. 13–14.

²⁸³⁰ Kërsman Jelliqi, T. 18934 (23 nëntor 2007).

²⁸³¹ Zdravko Vintari, 5D1394 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 dhjetor 2007), para. 15.

²⁸³² Millutin Fillipoviqi, T. 19183–19184 (27 nëntor 2007); *Shih gjithashtu* 5D1364 (Fletushkë e UÇK-së).

²⁸³³ Nebojsa Bogunoviqi, 6D1614 (deklarata e dëshmitarit e datës 2 prill 2008), para. 65.

²⁸³⁴ Nebojsa Bogunoviqi, 6D1614 (deklarata e dëshmitarit e datës 2 prill 2008), para. 49–50; Lubisha Dikoviqi, T. 19906 (10 dhjetor 2007).

²⁸³⁵ Dushan Gavraniqi, T. 22680–22681 (18 shkurt 2008).

²⁸³⁶ Lubivoje Jokshiq, T. 21958 (8 shkurt 2008).

1156. Me gjithë këto pretendime dhe pasi ka nxjerrë konkluzionet përkatëse të mësipërme në lidhje me secilën nga 13 komunat në të cilat akuzohet se u kryen krime konkrete, Dhoma Gjyqësore është bindur se gjatë sulmeve ajrore të NATO-s u krye një fushatë e gjerë dhune kundër popullatës civile shqiptare kosovare, e kryer nga forcat e kontrolluara nga autoritetet e RFJ-së dhe Serbisë. Dëshmitarët të cilët dëshmuuan për përjetimet e tyre dhe të familjeve, miqve, dhe fqinjëve të tyre gjatë disa javëve prej 24 marsit deri në fillim të qershorit 1999, dhanë dëshmi përgjithësisht përputhëse për frikën që mbretëronte në qytete dhe fshatra anembanë Kosovës, jo për shkak të bombardimeve të NATO-s, por për shkak të veprimeve të forcave të UJ-së dhe MPB-së që ndodhën gjatë asaj periudhe. Dhoma konkludoi se në të 13 komunat, forcat e RFJ-së dhe Serbisë dëbuan me qëllim shqiptarët kosovarë nga shtëpitë, ose duke i urdhëruar të largoheshin ose duke krijuar atmosferë terrori për të shkaktuar largimin e tyre. Kur njerëzit u larguan nga shtëpitë e tyre dhe u shpërngulën brenda Kosovës ose në drejtim dhe përtej kufijve, shumë prej tyre u kërcënuan u plaçkitën, u keqtrajtuat, dhe u abuzuan në mënyra të tjera. Në shumë vende, burrat i ndanë nga gratë dhe fëmijët, u vodhën ose u shkatërruan automjetet, u dogjën shtëpitë qëllimisht, u zhvatën paratë dhe i detyruan të dorëzonin dokumentet personale të identifikimit.

1157. Për shembull, në fund të marsit 1999, në qytetin e Pejës u krijuar një atmosferë e skajshme kërcënuese dhe e dhunshme nga forcat e policisë dhe të ushtrisë, duke djegur shtëpi, shkrepur armët, dhe duke keqtrajtuar popullatën vendëse shqiptare kosovare. Shumë banorë të qytetit ikën ose u urdhëruan të largoheshin nga shtëpitë, disa prej të cilëve i nisën drejt Malit të Zi dhe të tjerët i dërguan në qendër të qytetit ku i futën në autobusë dhe i transportuan në kufi me Shqipërinë. Siç është diskutuar më lart, Ndrec Konaj përshkroi frikën dhe panikun e krijuar ndërmjet banorëve vendës, duke përfshirë atë dhe familjen e tij, të cilët nuk dinin se çfarë do t'u ndodhte. Kur shqiptarët kosovarë u kthyen në Pejë pas mbarimit të konfliktit, ata i gjetën shumicën e shtëpive të djegura, edhe pse shtëpitë e serbëve kishin mbetur të padëmtuara.

1158. Në komunën e Deçanit, që gjendet saktësisht në jug të komunës së Pejës, ngjarje të ngjashme ndodhën në fshatin Beleg, në fund të marsit 1999. Banorët shqiptarët kosovarë të atjeshëm u grumbulluan nga policët dhe ushtarët, duke përfshirë edhe rezervistë të UJ-së, e gjatë këtij aksioni u vranë disa burra. Një grup i madh shqiptarësh kosovarë i përbërë kryesisht nga gra dhe fëmijë u ndaluan dhe u keqtrajtuat: disa gra u dhunuan seksualisht; dhe disa burra u keqtrajtuat fizikisht. Të nesërmen, shumicën e njerëzve në grup i urdhëruan të shkonin në Shqipëri, kurse ata që mbetën pas, nuk janë parë më.

1159. Në jug të Deçanit, në qytetin e Gjakovës, me të filluar fushat e bombardimeve të NATO-s forcat e policisë dhe UJ-së krijuan një atmosferë të rëndë terrori. Këto forca ndërmorën plaçkitjen

dhe djegien e godinave të shënuara, kurse forcat e MPB-së vranë banorët shqiptarë kosovarë të qytetit, duke përfshirë dhe një grup prej 20 grash dhe fëmijësh në një bodrum në rrugën Millosh Gilliq në fillim të prillit. Si rezultat, shumë shqiptarë kosovarë u larguan nga qyteti dhe udhëtuan e kaluan kufirin me Shqipërinë. Gjatë udhëtimit, forcat e UJ-së dhe të MPB-së ua morën dokumentet personale të identifikimit. Gjithashtu, banorët shqiptarë kosovarë të komunës së Gjakovës u dëbuan nga shtëpitë e tyre nga forcat e ushtrisë dhe policisë në prill 1999, sidomos gjatë operacionit të përbashkët në Luginën e Caragojt në fund të muajit. Gjatë këtij operacioni forcat e policisë dhe të UJ-së vranë disa shqiptarë kosovarë dhe kufomat e 287 njerëzve që u zhdukën në Mejë dhe zonat përreth në atë kohë u gjetën më vonë në varret e përbashkëta në Batajnicë afër Beogradit.

1160. Nuk mohohet se në fund të marsit 1999 UJ-ja dhe MPB-ja ndërmorën një operacion të gjerë në zonën që mbulonte pjesë të komunave të Prizrenit, Suharekës, dhe Rahovecit. Gjatë këtij operacioni, më 25 mars 1999, fshatarët shqiptarë kosovarë të Piranës (komuna e Prizrenit) ikën nga shtëpitë si rezultat i granatimit të fshatit dhe djegies së shtëpive nga forcat e UJ-së dhe të MPB-së. Më të njëjtën ditë, forcat e MPB-së dhe të UJ-së sulmuan fshatin Celinë (komuna e Rahovecit), dhe plaçkitën e u vunë zjarrin shumicës së shtëpive. Gjithashtu policët shkatërruan qëllimisht xhaminë e fshatit. Këto forca i terrorizuan banorët e fshatit, duke vrarë disa njerëz. Dhoma Gjyqësore thekson faktin se dëshmitarët e sulmit në Celinë, si dhe të sulmeve në disa qytete dhe fshatra të tjera në Kosovë, treguan për përdorimin e një arme speciale si flakëdhës, nga ana e forcave të RFJ-së dhe të Serbisë, për të djegur godina. Duke u bazuar në këto dëshmi përputhëse, Dhoma nuk pranon se këto armë UJ-ja i kishte nxjerrë nga përdorimi në vitet '50, siç pretendoi Bozhidar Deliqi.²⁸³⁷ Njerëzit nga Celina që kishin ikur nga shtëpitë e tyre dhe ishin strehuar në pyjet e afërta më vonë i tubuan dhe ua grabitën gjërat me vlerë dhe dokumentet e identifikimit. Disa prej tyre u keqtrajtuat fizikisht dhe më pas u dërguan në drejtim të kufirit me Shqipërinë.

1161. Në të njëjtën ditë që u sulmuan Celina dhe Pirana, forcat e UJ-së dhe të MPB-së sulmuan edhe Bellacërkën (komuna e Rahovecit), të cilat granatuar fshatin dhe dogjën shtëpitë, duke i detyruar banorët të iknin. Gjatë këtij sulmi, forcat policore vranë shtazërisht disa burra, gra, dhe fëmijë që ishin munduar të fshiheshin. Më 25 mars 1999, fshati Krushë e Vogël që gjendet në jug të Celinës dhe Bellacërkës dhe në veri të Piranës, u rrethua nga forcat e UJ-së dhe të MPB-së dhe më pas MPB-ja hyri në fshat dhe plaçkiti e u vuri zjarrin shtëpive me ndihmën e serbëve vendës. Banorët shqiptarë kosovarë të fshatit u fshehën në një zonë pyjore dhe më vonë i tubuan, kurse grave dhe fëmijëve u thanë të shkonin në Shqipëri. Mbi 100 burrave u grabitën gjërat me vlerë dhe dokumentet e identifikimit dhe pastaj i keqtrajtuat dhe i mbyllën në një stallë dhe policia vendore

²⁸³⁷ Bozhidar Deliq, T. 19356 (29 nëntor 2007).

hapi zjarr mbi ta dhe i vuri zjarrin stallës. Vetëm tetë burra shpëtuan. Lutfi Ramadani, njëri nga mbijetuesit, tregoi për incidentin pasi u kthye në Krushë të Vogël,

ishte në gjendje të mjerueshme. Të gjitha shtëpitë ishin djegur. Ishte pamje dëshpëruese. Asnjë shtëpi – asnjë shtëpi nuk ishte e padëmtuar. Disa ishin – vetëm kulmet ishin djegur. Disa kishin të djegura pjesë të tjera, por i gjithë fshati ishte djegur... shtëpitë e shqiptarëve, jo shtëpitë e serbëve.²⁸³⁸

1162. Rreth po kësaj kohe, banorët e Dushanovës, lagje e qytetit të Prizrenit, u dëbuan nga shtëpitë, u rrahën, u kërcënuan dhe u grabitën e pastaj u dërguan në drejtim të Shqipërisë. Më vonë në prill 1999, njerëzit e shpërngulur nga Pirana gjatë operacionit dhe të cilët ishin strehuar në Sërbicën a afërme gjithashtu u urdhëruan të largoheshin nga fshati dhe të shkonin në Shqipëri.

1163. Në operacionin e fundit të marsit 1999, forcat e PJP-së u angazhuan në qytetin e Suharekës dhe përreth tij. Më 26 mars, policët vendës të MPB-së sulmuan pjesëtarët e familjes Berisha në këtë qytet, duke vrarë 45 burra, gra, dhe fëmijë afër shtëpisë së tyre dhe teksa tentuan të iknin pranë stacionit të autobusëve dhe u strehuan në një piceri të afërt. Kufomat e shumicës prej këtyre njerëzve gjithashtu u gjetën më vonë në një varr të përbashkët në Batajnicë afër Beogradit. Në ditët pas vrasjeve u dëmtua xhamia e Suharekës dhe shumë nga banorët shqiptarë kosovarë të mbetur në qytet u larguan nga shtëpitë ndërsa forcat e policisë dhe të UJ-së u vunë zjarrin shtëpive, u grabitën paratë dhe gjërat me vlerë, dhe i urdhëruan të shkonin në Shqipëri.

1164. Në fund të marsit dhe në prill 1999, civilët shqiptarë kosovarë u shpërngulën me dhunë nga fshatrat e komunës së Skënderajt. Më 26 mars 1999 u granatua fshati Turiçec dhe banorët e tij formuan një kolonë dhe u larguan në drejtim të Tushilës në lindje. Më pas forcat e MPB-së dhe të UJ-së erdhën në Tushilë dhe atje u formua një kolonë tjetër e cila shkoi në drejtim të Klinës. Rreth kësaj kohe, shumë njerëz të shpërngulur ishin mbledhur në një arë në skaj të Izbicës. Forcat policore e rrethuan grupin dhe i urdhëruan gratë e fëmijët të shkonin në Shqipëri, kurse burrat i mbajtën. Më pas ata i rreshtuan burrat dhe i pushkatuan në dy grupe, duke vrarë së paku 89 vetë. Rreth mesit të prillit, pas granatimit të fshatit Kozhicë forcat e UJ-së ose të MPB-së ndaluan një grup grash në këtë fshat të cilat i çuan në fshatin Qirez. Së paku katër prej këtyre grave u dhunuan seksualisht dhe tetë prej tyre u vrarë duke i hedhur në tri puse. Në fund të prillit u ndërмор një tjetër ofensivë në Baks afër Qirezit. Gjatë këtij sulmi, u ndaluan dhe u keqtrajtuuan shumë burra shqiptarë kosovarë.

1165. Menjëherë pas fillimit të fushatës së NATO-s, shqiptarë e shquar kosovarë në qytetin e Mitrovicës në veri të krahinës u vunë në shënjestër dhe disa prej tyre u vranë nga policia. Gjithashtu

policia dogji shtëpi të shqiptarëve kosovarë dhe shumë shqiptarë kosovarë u dëbuan nga pjesë të qytetit. Disa prej tyre u kthyen më vonë në qytet dhe u larguan përsëri në fillim të prillit, duke udhëtuar me autobusë për në Mal të Zi. Në mes të prillit 1999 shqiptarë kosovarë që jetonin ose që ishin strehuar përkohësisht në Zhabar dhe fshatrat e afërta u detyruan me dhunë nga forcat e MPB-së dhe të UJ-së që të formonin kolona dhe të largoheshin nga Kosova kurse shtëpitë e tyre në fshatra u dogjën. Shumë nga këta njerëz u detyruan të ecnin në këmbë përmes Kosovë drejt jugut deri në kufirin shqiptar dhe gjatë rrugës u plaçkitën dhe u keqtrajtuat.

1166. Më 27 mars 1999, forcat e UJ-së dhe të MPB-së dogjën shtëpi dhe së paku një xhami në qytetin e Vushtrrisë dhe i dëbuan banorët shqiptarë kosovarë të qytetit. Gjithashtu forcat e MPB-së grabitën dhe keqtrajtuat shqiptarë kosovarë në një kolonë të madhe që lëvizte nga fshatrat e komunës së Vushtrrisë në drejtim tu jugut. Më 2 maj 1999, forcat e MPB-së vranë së paku dy njerëz në kolonë, e cila më tej ishte drejtuar te disa godina në afërsi, ku pjesëtarët e saj u mbajtën gjatë natës. Të nesërmen, nga ky grup u vra edhe një person dhe MPB-ja i urdhëroi gratë, fëmijët, dhe pleqtë të vazhdonin për në Shqipëri. Ata mbajtën dhe keqtrajtuat meshkuj shqiptarë kosovarë të moshës së aftë për ushtri në burgun e Smrekonicës rreth tri javë e pastaj i detyruan të kalonin kufirin në Shqipëri.

1167. Në qytetin e Prishtinës, qendra administrative e Kosovës, u përsërit praktika e dëbimeve të shqiptarëve kosovarë. Shumë njerëz u dëbuan në mënyrë të drejtpërdrejt nga shtëpitë e tyre, kurse të tjerët ikën nga frika e dhunës që ushtrohej përreth tyre nga forcat e RFJ-së dhe Serbisë. Dëbimi nga Prishtina u krye në mënyrë të organizuar ku qindra shqiptarë kosovarë u drejtuan për në stacionin hekurudhor dhe në trenat e stërmbushur që i transportuan në kufi me Maqedoninë. Gjatë këtij operacioni, së paku tri gra shqiptare kosovare u dhunuan seksualisht nga pjesëtarët e UJ-së dhe të MPB-së.

1168. Fshatarët nga Zhegra dhe Përlepnica në komunën e Gjilanit u dëbuan me forcë nga shtëpitë e tyre. Në Zhegër, në fund të marsit 1999, UJ-ja, MPB-ja, dhe forcat e tjera jo të rregullta, duke përfshirë edhe civilët serbë vendës, i dëbuan banorët shqiptarë kosovarë me kërcënime, rrahje, dhe vrasje. Shumë nga të shpërngulurit shkuan në Maqedoni. Kur në fund të konfliktit u kthyen në vatrën e tyre, ata gjetën shumicën e shtëpive të shqiptarëve kosovarë në fshat të djegura dhe të dëmtuara në një farë mase, kurse shtëpitë e serbëve kishin mbetur të padëmtuara. Rreth asaj kohe, xhamia në Llashticën e afërt u dogj nga rezervistët e UJ-së dhe të MPB-së vendëse; kurse në Lladovë shtëpitë u plaçkitën dhe u dogjën kurse banorët e saj ikën dhe shkuan në Maqedoni të

²⁸³⁸ Lutfi Ramadani, T. 4310 (28 shtator 2006).

shoqëruar nga forca të MPB-së dhe të UJ-së. Banorët e Përlepnicsës u urdhëruan të largoheshin nga fshati së pari më 6 prill dhe pastaj më 13 prill 1999.

1169. Në komunën e Ferizajt në jugperëndim të Gjilanit, gjithashtu u sulmuan fshatra në fund të marsit dhe gjatë prillit 1999. Në Sojevë, UJ-ja dhe policia dhe individë të tjerë të armatosur që bashkëpunonin me ta, dogjën shtëpi dhe vranë disa njerëz dhe banorët vendës u detyruan të udhëtonin në kolona, në këmbë dhe me automjete, në drejtim të qytetit të Ferizajt. Disa nga këta njerëz vazhduan me autobusë për në kufi me Maqedoninë. Në fillim të prillit rreth 1.000 njerëz të shpërngulur mbërritën në Mirosalë. Kur forcat ushtarake iu afruan Mirosalës, banorët e saj dhe të tjerët që ishin strehuar atje, formuan kolona dhe udhëtuan në drejtim të Ferizajt me autobus duke kaluar pranë makinave të shkatërruara dhe shtëpive që po digjeshin. Disa prej tyre u larguan nga Ferizaj me autobus në jug deri te kufiri dhe pastaj kaluan në Maqedoni. Gjithashtu në fillim të prillit fshati Starasellë u okupua nga forcat e UJ-së, të cilat qëndruan atje për disa ditë dhe më pas u larguan dhe gjatë largimit, dogjën shtëpi. Pas pak kohe në fshat erdhi një grup vullnetarësh të UJ-së të cilët urdhëruan burrat vendës të hapnin llogore, konfiskuan automjete dhe zhvatën para nga banorët vendës. Fshatarët u larguan nga shtëpitë e tyre nga frika dhe shkuan në këmbë në qytetin e Ferizajt. Më tej shumë prej tyre hipën në tren për në kufirin me Maqedoninë.

1170. Së fundi, në komunën e Kaçanikut në jug të Kosovës pranë kufirit me Maqedoninë, shqiptarët kosovarë u dëbuan nga qyteti dhe fshatrat përreth që në fillim të fushatës së NATO-s. Më 24 mars, forcat e UJ-s dhe të MPB-së sulmuan Kotlinën dhe i dërguan gratë dhe fëmijët me kamionë dhe në këmbë në drejtim të qytetit të Kaçanikut. Fshatarët e tjerë që nuk u pikasën, ikën në drejtim të Maqedonisë gjatë sulmit. Pas disa ditësh forcat e UJ-së dhe të MPB-së hynë në Kaçanik dhe hapën zjarr mbi disa shtëpi prej pozicioneve në një fabrikë të afërt. Isa Raka, shqiptar kosovar i cili ishte dëshmitar i këtyre ngjarjeve në qytetin e Kaçanikut, tregoi se gruaja e tij shtatzënë u plagos me armë zjarri gjatë këtij sulmi dhe më vonë vdiq si rezultat i plagëve. Të nesërmen, banorët e kësaj pjese të qytetit vendosën të largoheshin nga shtëpitë e tyre nga frika prej forcave të MPB-së dhe shkuan në këmbë në Maqedoni.

1171. Në prill 1999, njësi të UJ-së dhe të MPB-së hynë në fshatin Vataj dhe plaçkitën shtëpi. Më 21 maj 1999, forcat e UJ-së dhe të MPB-së sulmuan Stagovën dhe më 25 maj, sulmuan edhe Lisnajën. Banorët e Lisnajës vendosën të shkonin në Maqedoni nga frika sepse e dinin çfarë kishte ndodhur në fshatrat e tjera. Gratë, pleqtë, dhe fëmijët formuan një kolonë, kurse meshkujt më të rinj u fshehën në pyllin e afërt. Gjatë këtij sulmi, nga të shtënat u goditën disa njerëz afër Rekës në afërsi të Lisnajës përfshirë dhe një vajzë, e cila vdiq dhe një djalë 12-vjeçar, i cili u plagos rëndë.

1172. Përveç dëshmime në lidhje me vendet konkrete të krimeve të përmendura në Aktakuzë, Dhoma ka dëgjuar dëshmi në lidhje me praktikën e përgjithshme të dhunës dhe frikësimit të popullatës shqiptare kosovare gjatë fushatës së NATO-s, nga dëshmitarë të cilët në atë kohë ishin pjesëtarë të forcave të UJ-së ose të MPB-së në atë kohë. Për shembull, tre ish-pjesëtarë të UJ-së, dëshmitarët K90, K73, dhe K54, pranuan se kishin marrë pjesë në dëbimin e shqiptarëve kosovarë nga shtëpitë e tyre gjatë fushatës së NATO-s. K90-a tregoi njësi e tij kishte dëbuar – më vonë ai këmbënguli në përdorimin e fjalës "zhvendosur" – shqiptarët kosovarë nga shtëpitë e tyre në komunën e Gjakovës gjatë prillit 1999.²⁸³⁹ Ai zbotoi urdhrat e marra gojarisht.²⁸⁴⁰ Edhe K73-shi përshkroi pjesëmarrjen e tij në dëbimin e civilëve shqiptarë kosovarë dhe djegien e qëllimshme të shtëpive në fshatrat e komunës së Gjakovës gjatë prillit 1999.²⁸⁴¹ Ai tha,

të gjithë ne që morëm pjesë në atë operacion, mund të them se patëm të vështirë të dëbonim gra, fëmijë, pleq, dhe invalidë. E njoh UÇK-në shumë mirë dhe nuk kam parë asnjë grua 70-vjeçe apo fëmijë në UÇK, njerëz të tillë nuk mund të jenë luftëtarë dhe terroristë. Ose njerëzit në karrocë. Mirëpo ne i dëbuam të gjithë, nga fëmijët në djep e deri te pleqtë në karrocë dhe ky është problemi që unë kam sot.²⁸⁴²

K54-a dëshmoi se njësi e tij dëboi njerëz nga një vendbanim afër Prizrenit i quajtur Petrovasellë pas bombardimit të kazermës në Prizren, për të bërë vend për UJ-në.²⁸⁴³

1173. Goran Stopariqi, ish-pjesëtar i grupit paraushtarak i njohur si Akrepat, tregoi se në fund të marsit 1999 njësi e tij iu bashkua radhëve të SAJ-së dhe u dërgua në Kosovë. Pjesëtarët e kësaj njësie vranë së paku 12 civilë në qytetin e Podujevës.²⁸⁴⁴ Dëshmitari K54 dhe K82 treguan për një aksion në fshatin Tërm (komuna e Suharekës), në të cilin kishin marrë pjesë, gjithashtu në fund të marsit 1999, gjatë të cilit njësi e tyre dogji shtëpi dhe vrau një grup prej 15 burrash, grash dhe fëmijësh shqiptarë kosovarë.²⁸⁴⁵ Të dy dëshmitarët dëshmuan se këto vrasje nuk ishin incident i izoluar por se vrasje të tjera ndodhën në gjithë fshatin gjatë spastrimit të tij nga ana e UJ-së dhe

²⁸³⁹ Dëshmia e K90ës përputhet me dëshminë e Fuat Haxhibeqirit, K73-shit, Nikë Perajt, Merita Dedës, dhe Lizane Malajt. Përpyekjet për komprometimin e besueshmërinë e K90-ës nga Vllatko Vukoviqi ishin të pabazuara. Kundërshtimet e paraqitura në lidhje me praninë e K90-ës gjatë operacionit të Luginës së Caragojt bazoheshin në deklaratat e individëve që nuk ishin ftuar si dëshmitarë ose në dokumentacion të papranuar që ishte i përgjithshëm dhe i mungonin hollësitë. Rrjedhimisht, Dhoma e konsideron K90-ën përgjithësisht të besueshëm dhe të saktë në lidhje me çështjet në deklaratën e tij të dëshmitarit, të cilën ai e rikonfirmoi gjatë dëshmisë me gojë.

²⁸⁴⁰ K90, P2460 (deklarata e dëshmitarit), para. 41.

²⁸⁴¹ K73, T. 3328–3335 (13 shtator 2006) (seancë e mbyllur), T. 3381–3383 (14 shtator 2006) (seancë e mbyllur), P2440 (deklarata e dëshmitarit e datës 2 dhjetor 2005), para. 42.

²⁸⁴² K73, T. 3381–3382 (14 shtator 2006) (seancë e mbyllur).

²⁸⁴³ K54, T. 10598 (27 shkurt 2007).

²⁸⁴⁴ Goran Stopariq, T. 702–703 (12 korrik 2006), P2224 (deklarata e dëshmitarit e datës 6 korrik 2006), para. 35, 51–56. *Shih gjithashtu* Aleksandar Vasileviq, T. 8717 (19 janar 2007); 3D1055 (Shtabi i Komandës së Lartë, Raport mbi Aktivitetet e Formacionit Paraushtarak Sllobodan Mediq-Boce, 13 maj 1999).

²⁸⁴⁵ K82, T. 11747–11748 (15 mars 2007), P2863 (deklarata e dëshmitarit), para. 7–23; K54, T. 10585–10588 (27 shkurt 2007) (seancë private), P2883 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 prill 2002), f. 5–6, P2884 (deklarata e dëshmitarit e datës 16 korrik 2002), f. 1. *Shih* para. 470 më lart për vlerësimin e besueshmërisë së tyre prej Dhomës.

MPB-së.²⁸⁴⁶ K54-a gjithashtu përshkroi pjesëmarrjen e tij në vjedhjen e automjeteve në Kosovë,²⁸⁴⁷ dhe në djegien e pronave civile me urdhër të eprorëve të tij.²⁸⁴⁸

1174. Ish-shefi i SPB-së në Mitrovicë, Lubinko Cvetiqi, gjithashtu konfirmoi se në ditët e para të fushatës së NATO-s, pjesëtarë të policisë, sidomos rezervistët, morën pjesë në dëbimin e shqiptarëve kosovarë nga shtëpitë e tyre. Gjithsesi ai dëshmoi se këto dëbime nuk ishin pjesë e ndonjë politike apo plani dhe se kishte arsye të tjera për lëvizjen masive të popullatës shqiptare kosovare në atë kohë, siç ishin për shembull bombardimet e NATO-s dhe presioni nga UÇK-ja.²⁸⁴⁹

1175. Dhoma Gjyqësore është e vetëdijshme për faktin se në disa pjesë të Kosovës, edhe në 13 komunat e përmendura në Aktakuzë dhe gjetiu, njerëzit mund të jenë larguar nga shtëpitë e tyre për arsye të ndryshme, si për shembull të udhëzuar nga UÇK-ja, dëshira për t'iu shmangur betejave midis UÇK-së dhe forcave të RFJ-së dhe të Serbisë, ose sepse NATO-ja bombardonte objektiva afër shtëpive të tyre. Sidoqoftë, me gjithë argumentet e Mbrojtjes se këto ishin arsyet kryesore për lëvizjen masive të popullsisë brenda Kosovës dhe përtej kufirit në Shqipëri dhe Maqedoni, asnjë nga shqiptarët kosovarë që dëshmoi nuk përmendi bombardimet e NATO-s si arsye për largim dhe Dhoma ka konkluduar se vetëm në një zonë të komunës së Vushtrisë dhe një tjetër në komunën e Suharekës njerëzit u larguan si rezultat i aksioneve të UÇK-së. Dhoma u kushton pak rëndësi thashethemeve anonime të oficerëve të UJ-së dhe të MPB-së në lidhje me arsyet për largimin e shqiptarëve kosovarë nga shtëpitë e tyre dhe gjithashtu thekson se këta oficerë duhet të kenë qenë me uniformë kur kanë biseduar me shqiptarë kosovarë të shpërngulur, të cilët duhet të kenë hezitur t'u tregojnë oficerëve arsyet e vërteta për largimin e tyre. Dëshmitarët shqiptarë kosovarë që dëshmuuan në lidhje me dëbimin e tyre dhe të shumë të tjerëve nga Kosova vinin nga shtesa të ndryshme shoqërore, përgjithësisht pa ndonjë lidhje me njëri tjetrin përveç viktimizimit të tyre dhe është e paimagjinueshme se ata ishin në gjendje të trillonin ose i kanë trilluar rrëfimet e tyre të hollësishme dhe përputhëse të ngjarjeve që përjetuan dhe panë.

1176. Gjithashtu, bombat e NATO-s goditën objektiva në të gjithë RFJ-në ku Beogradi pësoi më së shumti dëmtime sipas Spasojë Smilaniqit, ish-komandant i Forcave Ajrore dhe Mbrojtjes Kundërajrore të UJ-së, dhe gjithsesi njerëzit nuk u larguan nga Beogradi apo pjesë të tjera të RFJ-së

²⁸⁴⁶ K54, P2883 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 prill 2002), f. 5–6; K82, P2863 (deklarata e dëshmitarit), para. 13–14, 16, 26, 28–29.

²⁸⁴⁷ K54, T. 10514 (seancë e hapur), T. 10515 (seancë private), T. 10516 (seancë e hapur) (26 shkurt 2007), P2883 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 prill 2002), f. 7.

²⁸⁴⁸ K54, T. 10590 (27 shkurt 2007), P2883 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 prill 2002), f. 6.

²⁸⁴⁹ Lubinko Cvetiq, T. 8179–8180 (8 dhjetor 2006).

masivisht, sikurse u larguan nga Kosova.²⁸⁵⁰ Rrjedhimisht, Dhoma konkludon se bombardimet e NATO-s nuk ishin arsyeja kryesore e shpërnguljes masive të shqiptarëve kosovarë nga Kosova.

1177. Megjithëse gjatë fushatës ajrore të NATO-s ekzistonte konflikt i vazhdueshëm i armatosur midis UÇK-së dhe forcave të RFJ-së dhe Serbisë, Dhoma nuk gjykon se ky konflikt ishte shkaku kryesor i largimit të qindra mijëra shqiptarëve kosovarë nga fundi i marsit deri në fillim të qershorit 1999. Faktikisht, ashtu sikurse është diskutuar gjetiu në këtë Aktgjykim, konflikti midis UÇK-së dhe UJ-së e MPB-së filloi në mes të vitit 1998 dhe u intensifikua në korrik, gusht, dhe shtator të atij viti. Megjithëse në atë kohë u shpërngulën shumë shqiptarë kosovarë, shumica qëndruan brenda kufijve të Kosovës dhe nuk pati vërshim masiv të njerëzve përtej kufijve që filloi më 24 mars 1999. Dhoma gjithashtu kujton se, megjithëse UÇK-ja përbënte forcë të konsiderueshme në kohë dhe vende të ndryshme, ajo ishte e vogël në numër në krahasim me numrin e efektivit të UJ-së dhe MPB-së të dislokuar në Kosovë nga marsi deri në qershor 1999, e as nuk dispononte armatim të rëndë si forcat shtetërore.²⁸⁵¹

1178. Mënyra e trajtimit të problemit të UÇK-së nga UJ-ja dhe MPB-ja shpesh ishte e ashpër dhe karakterizohej nga dhunë pa kriter dhe dëmtim të personave civilë dhe pronave të tyre, duke e keqësuar në vend që ta përmirësonte situatën në Kosovë. Dëshmitë përprthëse të dëshmitarëve okularë për terrorizimin sistematik të civilëve shqiptarë kosovarë nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë, dëbimin e tyre nga shtëpitë dhe plaçkitjen dhe shkatërrimin e qëllimshëm të pronave të tyre, e kanë bindur Dhomën për ekzistencën e një fushate dhune kundër popullatës civile shqiptare kosovare, gjatë së cilës u kryen vrasje, dhunë seksuale, dhe shkatërrim i qëllimshëm i xhamive. Veprimet e qëllimshme të këtyre forcave gjatë kësaj fushate shkaktuan largimin e së paku 700.000 shqiptarëve kosovarë nga Kosova në një periudhë të shkurtër kohore prej fundit të marsit deri në fillim të qershorit 1999. Përprjekjet e MPB-së për të fshehur vrasjet e shqiptarëve kosovarë duke i transportuar kufomat në zona të tjera të Serbisë, sikurse diskutohet në hollësi më poshtë, gjithashtu sugjerojnë se këto incidente kishin natyrë kriminale.

O. KONKLUSIONE LIGJORE

1179. Pas formulimit të konkluzionet e lartpërmendura faktike në lidhje me ngjarjet nga marsi deri në maj 1999 në 13 komuna të Kosovës, më tej Dhoma Gjyqësore do të analizojë nëse janë plotësuar

²⁸⁵⁰ Spasoje Smilaniq, T. 15776–15777 (17 shtator 2007).

²⁸⁵¹ *Shih* Pjesën VI.B.

elementet ligjore të krimeve të pretenduara në Aktakuzë në lidhje me çdo vend krimesh ku janë vërtetuar faktet përkatëse.

1180. Prokuroria i ka paraqitur të gjitha incidentet e veçanta të diskutuara më lart si krime kundër njerëzimit, të ndëshkueshme sipas Nenit 5 to Statutit, dhe vrasjet i ka paraqitur si shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës, të ndëshkueshme sipas Nenit 3. Për të dy kategoritë e krimeve, Prokuroria duhet të provojë ekzistencën e konfliktit të armatosur gjatë kohës në fjalë dhe "lidhje objektive" midis konfliktit dhe krimeve të akuzuar. Dhoma ka konkluduar më lart se nga mesi i vitit 1998 dhe deri në fund të fushatës ajrore të NATO-s në qershor 1999, në territorin e Kosovës ekzistonte konflikt i armatosur. Dhoma është bindur se të gjitha këto akte kriminale të përshkruara më lart në secilën nga 13 komunat ishin objektivisht të lidhura si gjeografikisht po ashtu edhe në aspektin kohore, me konfliktin e armatosur. Gjithashtu Dhoma është bindur për ekzistencën e lidhjes midis këtyre "krimeve" dhe konfliktit të armatosur.

1. Peja

1181. Më 27 mars 1999, forcat e UJ-së dhe të MPB-së, në bashkëpunim me forcat jo të rregullta, sulmuan civilë shqiptarë kosovarë nëpër qytetin e Pejës. Pjesë të qytetit u granatuan nga UJ-ja, u konfiskuan automjete, u vodhën para, u dogjën shtëpi dhe shumë shqiptarë kosovarë ose u dëbuan drejtpërsëdrejti, ose ikën nga frika. Dhoma është bindur se këto ngjarje përbënin sulm kundër popullatës civile të qytetit, se ky sulm u krye në mënyrë sistematike dhe se këto veprime të forcave të UJ-së dhe të MPB-së ishin pjesë e një sulmi gjerësisht të përhapur dhe sistematik kundër civilëve shqiptarë kosovarë në së paku 13 komuna të Kosovës. Autorët fizikë, disa prej të cilëve bënë komente si "Shkoni në Shqipëri, ky nuk është vendi juaj, kjo është Serbia e Madhe", ishin padyshim të vetëdijshëm se ishin duke vepruar në kontekst të një sulmi më të madh kundër popullatës shqiptare kosovare, së paku në Pejë.

1182. Sikurse është përmendur më lart, UJ-ja, MPB-ja, dhe forcat e armatosura të lidhura me to që vepronin në Pejë në atë kohë, ose i urdhëruan drejtpërsëdrejti shqiptarët kosovarë të largoheshin nga shtëpitë e tyre ose i detyruan të largoheshin nëpërmjet sjelljes së tyre të dhunshme dhe kërcënuese. Është gjithashtu e qartë nga komentet e tyre gjatë debimeve se qëllimi i autorëve fizikë ishte që shqiptarët kosovarë të kalonin kufirin me Shqipërinë. Nuk ekzistonte asnjë arsye legjitime për dëbimin masiv të shqiptarëve kosovarë, të cilët ndodheshin në Pejë në mënyrë të ligjshme. Shumë prej tyre u transportuan qëllimisht me autobusë, ose shkuan me makinat e tyre ose në këmbë deri në kufi me Shqipërinë, kurse të tjerët shkuan në Mal të Zi. Në kufi, shqiptarët kosovarë që kishin udhëtuar me autobusë u urdhëruan të zbrisnin dhe të kalonin kufirin në këmbë.

1183. Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore konkludon se janë përmbushur të gjithë elementët e dëbimit si krim kundër njerëzimit i ndëshkueshëm sipas Nenit 5(d) të Statutit. Duke arsyetuar në mënyrë të ngjashme dhe në bazë të dëshmive të dëshmitarëve të ndryshëm për dhunën, frikën, dhe kërcënimet të ushtruara sistematikisht nga forcat e RFJ-së dhe Serbisë në qytetin e Pejës, Dhoma është bindur se janë përmbushur edhe elementët e krimit “veprime të tjera çnjerëzore” (zhvendosje e dhunshme), e ndëshkueshme sipas Nenit 5(i).

2. Deçani

1184. Dhoma ka konkluduar se më 28 mars 1999 ose rreth kësaj date, forcat e MPB-së dhe të UJ-së sulmuan civilë shqiptarë kosovarë në fshatin Beleg në Deçan. Këta civilë u ndaluan, u dhunuan fizikisht dhe më pas u dëbuan nga fshati në mënyrë të organizuar nga forcat e MPB-së dhe UJ-së. Më në fund, ata kaluan kufirin dhe shkuan në Shqipëri. Dhoma është bindur se këto ngjarje përbëjnë sulm mbi popullatën civile të fshatit, se ky sulm u krye në mënyrë sistematike, dhe se ishte pjesë e një sulmi gjerësisht të përhapur dhe sistematik kundër civilëve shqiptarë kosovarë në së paku 13 komuna të Kosovës. Këto veprime të forcave të UJ-së dhe të MPB-së ishin qartësisht pjesë e një sulmi më të gjerë kundër popullatës civile, meqenëse njerëzve të shpërngulur u morën dokumentet e identifikimit, i keqtrajtuat dhe i urdhëruan të shkonin në Shqipëri. Për më tepër autorët fizikë të cilët bënë komente si "Shkoni në Shqipëri – ju e kërkuat NATO-n," ishin padyshim të vetëdijshëm se ishin duke vepruar në kontekst të një sulmi më të madh kundër popullatës shqiptare kosovare.

1185. Sikurse është përmendur më lart, forcat e MPB-së dhe të UJ-së në bashkëveprim dëbuan civilë nga fshati Beleg në mënyrë të organizuar. Është gjithashtu e qartë nga komentet e tyre gjatë këtyre dëbimeve se autorët fizikë kishin qëllim që shqiptarët kosovarë të kalonin kufirin me Shqipërinë. Nuk ekzistonte asnjë arsye legjitime për dëbimin e shqiptarëve kosovarë, të cilët ndodheshin në Beleg në mënyrë të ligjshme.

1186. Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore konkludon se janë përmbushur të gjithë elementët e dëbimit si krim kundër njerëzimit i ndëshkueshëm sipas Nenit 5(d) të Statutit. Duke arsyetuar në mënyrë të ngjashme dhe në bazë të dëshmive të dëshmitarëve të ndryshëm për dhunën, frikën, dhe kërcënimet e ushtruara sistematikisht nga këto forca në Beleg, Dhoma është bindur se janë përmbushur edhe elementët e krimit “veprime të tjera çnjerëzore” (zhvendosje e dhunshme), e ndëshkueshme sipas Nenit 5(i).

1187. Dhoma nuk ka dyshim se së paku dy gra të cilat u ndaluan në Beleg nga forcat e UJ-së dhe të MPB-së u shtrënguan të kryenin marrëdhënie seksuale dhe dy gra të tjera iu nënshtuan akteve të

natyrës seksuale për të cilat ato qartësisht nuk dhanë pëlqim dhe dhunuesit e tyre e dinin se ato nuk dhanë pëlqimin. Rrjedhimisht është shkelur e drejta e tyre themelore e paprekshmërisë fizike që përmbush elementët e dhunës seksuale.

1188. Meqenëse Aktakuza e paraqet dhunën seksuale vetëm si formë e përndjekjes, Prokuroria duhet të vërtetojë se autorët vepruan me qëllim për të diskriminuar shqiptarët kosovarë si grup etnik. Autorët fizikë të këtyre përdhunimeve dhe dhunës seksuale bënë komente si "UÇK-ja ka bërë edhe më keq se këta. Mundeni t'i duroni." Rrjedhimisht, Dhoma konkludon se ata i kryen përdhunimet dhe dhunën seksuale me paramendim, me qëllim për të diskriminuar shqiptarët kosovarë si grup etnik. Si rrjedhojë janë përmbushur të gjithë elementët e dhunës seksuale si formë e përndjekjes, që është krim kundër njerëzimit i ndëshkueshëm sipas Nenit 5(h) të Statutit.

3. Gjakova

a. Qyteti i Gjakovës

1189. Që nga fillimi i fushatës ajrore të NATO-s dhe duke vazhduar deri në maj 1999, forcat e UJ-së dhe të MPB-së sulmuan civilët shqiptarë kosovarë në qytetin e Gjakovës. Shtëpitë e banorëve shqiptarëve kosovarë u plaçkitën dhe u dogjën sistematikisht. Forcat e MPB-së dhe UJ-së dëbuan shumë shqiptarë kosovarë nga qyteti sistematikisht dhe mënyrë të organizuar përtej kufirit me Shqipërinë. Gjithashtu, disa banorë të qytetit u vranë. Dhoma është bindur se këto ngjarje përbëjnë sulm mbi popullatën civile të qytetit, se ky sulm u kryen në mënyrë sistematike dhe se ishte pjesë e një sulmit të përhapur gjerësisht dhe sistematik kundër civilëve kosovarë në së paku 13 komuna të Kosovës. Gjithashtu, aksionet e UJ-së, MPB-së, dhe të forcave të tjera që bashkëpunonin me to ishin padyshim pjesë e një sulmi më të gjerë kundër popullatës civile, sepse shtëpitë e shqiptarëve kosovarë u dogjën në mënyrë përzgjedhëse, të shpërngulurve u morën dokumentet e identifikimit, dhe i urdhëruan të largoheshin për në Shqipëri. Për më tepër, autorët fizikë, disa prej të cilëve bënë komente si, "e keni prej NATO-s" ose "dilni jashtë, do t'ua qijmë nënat shqiptare," ishin padyshim të vetëdijshëm se po vepronin në kontekst të një sulmi më të madh mbi popullatën shqiptare kosovare.

1190. Sikurse është përmendur më lart, MPB-ja, UJ-ja, dhe forcat e tjera i dëbuan civilët nga qyteti i Gjakovës ose duke i urdhëruar drejtpërsëdrejti që të largoheshin ose duke i larguar me sjelljet e tyre të dhunshme dhe kërcënuese. Është gjithashtu e qartë nga komentet që bënë gjatë dëbimeve, përfshirë urdhrat që të shkonin në kalimin kufitar dhe në Shqipëri, se synimi i autorëve fizikë ishte largimi i shqiptarëve kosovarë. Nuk ekzistonte asnjë arsye legjitime për dëbimin e shqiptarëve kosovarë, të cilët ndodheshin në qytetin e Gjakovës në mënyrë të ligjshme.

1191. Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore konkludon se janë përmbushur të gjithë elementët e dëbimit si krim kundër njerëzimit, të ndëshkueshme sipas Nenit 5(d) të Statutit. Duke arsyetuar në mënyrë të ngjashme dhe në bazë të dëshmive të dëshmitarëve të ndryshëm për dhunën, frikën, dhe kërcënimet e ushtruara sistematikisht nga këto forca në qytetin e Gjakovës, Dhoma është bindur se janë përmbushur edhe elementët e krimit “veprime të tjera çnjerëzore” (zhvendosje e dhunshme), e ndëshkueshme sipas Nenit 5(i).

1192. Në lidhje me vrasjen e 20 personave nga forcat e MPB-së në bodrumin e një shtëpie në rrugën Millosh Gilliq, Lagjja e Qerimit, në qytetin e Gjakovës, në natën e 1 prillit 1999, është vërtetuar se autorët fizikë i shkaktuan këto vdekje me paramendim. Rrjedhimisht Dhoma konkludon se janë përmbushur të gjithë elementët e vrasjes, si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës, e ndëshkueshme sipas Nenit 3 të Statutit. Gjithashtu, këto vrasje u kryen në kontekst të sulmit të përhapur gjerësisht dhe sistematik kundër popullatës civile; veprimet e autorëve fizikë ishin pjesë e sulmit; dhe autorët fizikë ishin të vetëdijshëm për këtë. E gjithë kjo shihet nga fakti se keqbërësit i vranë gratë dhe fëmijët edhe pse ishte e qartë se nuk ishin pjesëtarë të UÇK-së, dhe pastaj i vunë zjarrin shtëpisë në kuadër të fushatës për djegien e shtëpive të shqiptarëve kosovarë në qytetin e Gjakovës në atë kohë. Rrjedhimisht, Dhoma konkludon se janë përmbushur të gjitha elementët e vrasjes si krim kundër njerëzimit, e ndëshkueshme sipas Nenit 5(a).

1193. Dhoma thekson faktin se duke ditur se viktimat ishin shqiptarë kosovarë, autorët fizikë i vranë të gjithë gratë e fëmijët e pranishëm (përveç njërit) edhe pse ishte e qartë se nuk ishin pjesëtarë të UÇK-së, që tregon se ata i kishin përzgjedhur për shkak të etnisë së tyre. Rrjedhimisht, Dhoma konkludon se ata i kryen vrasjet me paramendim për t'i diskriminuar shqiptarët si grup etnik dhe si pasojë janë përmbushur elementët e vrasjes si formë e përndjekjes që është krim kundër njerëzimit, i ndëshkueshëm sipas Nenit 5(h) të Statutit.

b. Fshatrat e komunës së Gjakovës

1194. Dhoma gjithashtu ka konkluduar se forcat e UJ-së dhe të MPB-së sulmuan civilët shqiptarë kosovarë në disa fshatra të komunës së Gjakovës gjatë fushatës ajrore të NATO-s, sidomos përmes operacionit të përbashkët të UJ-së dhe MPB-së në Luginën e Caragojt më 27 dhe 28 prill 1999. Shqiptarët kosovarë u dëbuan sistematikisht nga fshatrat e tyre, të cilat më pas u dogjën. Shumë prej tyre u dërguan përtej kufirit në Shqipëri, kurse të tjerët u vranë. Dhoma është bindur se këto ngjarje përbënin sulm mbi popullatën civile të komunës, se u kryen në mënyrë sistematike, dhe se gjithashtu ishin pjesë e një sulmi të përhapur gjerësisht dhe sistematik kundër civilëve shqiptarë kosovarë në së paku 13 komuna të Kosovës. Veprimet e forcave të UJ-së dhe të MPB-së ishin padyshim pjesë e një sulmi më të gjerë kundër popullatës civile dhe autorët fizikë, të cilët u thanë

shqiptarëve kosovarë se duhej të largoheshin nga Kosova ose do të ekzekutoheshin, ishin të vetëdijshëm se ishin duke vepruar në kontekst të një sulmi më të madh kundër popullatës shqiptare kosovare.

1195. Sikurse është përmendur më lart, forcat e UJ-së dhe të MPB-së dëbuan shqiptarët kosovarë në mënyrë sistematike nga fshatrat e tyre në këtë komunë. Është gjithashtu e qartë nga komentet që bënë gjatë dëbimeve se autorët fizikë synonin largimin e shqiptarëve. Nuk ekzistonte asnjë arsye legjitime për dëbimin e shqiptarëve kosovarë, të cilët ndodheshin në Gjakovë në mënyrë të ligjshme.

1196. Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore konkludon se, në fshatrat Korenicë, Dobrosh, Ramoc, dhe Mejë, si dhe në fshatrat e tjera të Luginës së Caragojt, janë përmbushur elementët e dëbimit si krim kundër njerëzimit, i ndëshkueshëm sipas Nenit 5(d) të Statutit. Duke arsyetuar në mënyrë të ngjashme dhe në bazë të dëshmive të dëshmitarëve të ndryshëm për dhunën, frikën, dhe kërcënimet e ushtruara sistematikisht nga këto forca në këto fshatra, Dhoma është bindur se janë përmbushur edhe elementët e krimit “veprime të tjera çnjerëzore” (zhvendosje e dhunshme), e ndëshkueshme sipas Nenit 5(i).

1197. Në lidhje me vrasjen e së paku 287 shqiptarëve kosovarë, shumë prej të cilëve ishin civilë, në Korenicë dhe Mejë dhe rreth këtyre fshatrave më 27 prill 1999 nga forcat e MPB-së dhe UJ-së që vepronin së bashku, është konkluduar se autorët fizikë i shkaktuan me paramendim këto vdekje. Rrjedhimisht Dhoma konkludon se janë përmbushur të gjithë elementët e vrasjes si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës, e ndëshkueshme sipas Nenit 3 të Statutit. Gjithashtu, këto vrasje u kryen gjatë operacionit të përbashkët të UJ-së dhe MPB-së në Luginën e Caragojt, që ishte sulm gjerësisht i përhapur dhe sistematik kundër popullatës civile. Aksionet e autorëve fizikë ishin pjesë e këtij sulmi dhe ata ishin të vetëdijshëm për këtë, siç del nga mënyra e organizuar e kryerjes dhe numri i madh i vrasjeve. Rrjedhimisht, Dhoma është bindur se janë përmbushur të gjithë elementët e vrasjes si krim kundër njerëzimit, i ndëshkueshëm sipas Nenit 5(a) të Statutit.

1198. Së fundi autorët fizikë që sulmuan shqiptarët kosovarë gjatë operacionit në Luginën e Caragojt bënë komente se "po i thernin shqiptarët." Dhoma konkludon se ata i kryen vrasjet me paramendim, me qëllim për t'i diskriminuar shqiptarët kosovarë si grup etnik, dhe rrjedhimisht janë përmbushur të gjithë elementët e vrasjes si formë e përndjekjes, e ndëshkueshme si krim kundër njerëzimit sipas Nenit 5(h) të Statutit.

4. Prizreni

1199. Në fund të marsit 1999, UJ-ja dhe MPB-ja kryen një operacion të përbashkët në një zonë të gjerë që mbulonte pjesë të komunave Prizren, Rahovec, dhe Suharekë. Ndërsa në dukje ky operacion ishte kundër UÇK-së, Dhoma ka konkluduar se, në të njëjtën kohë u sulmuan edhe civilët shqiptarë kosovarë që jetonin në atë zonë. Midis fshatrave të sulmuara ishte Pirana. Më 25 mars, Pirana u granatua nga UJ-ja dhe më pas forcat e MPB-së hynë në fshat dhe u vunë zjarrin shtëpive. Si pasojë, banorët shqiptarë kosovarë ikën në fshatrat e afërta, ku disa u vranë ose u plagosën gjatë largimit. Më vonë, në prill 1999, shqiptarët kosovarë të strehuar në Sërbicë, duke përfshirë shumë nga Pirana, u urdhëruan nga policia dhe forcat e tjera që të largoheshin për në Shqipëri, dhe ata vepruan sipas urdhrorit. Dhoma është bindur se këto ngjarje përbëjnë sulm mbi popullatën civile të këtyre fshatrave, që u krye gjerësisht dhe në mënyrë sistematike dhe ishte pjesë e sulmit të gjerësisht të përhapur dhe sistematik kundër civilëve shqiptarë kosovarë në së paku 13 komuna të Kosovës. Këto veprime të këtyre forcave ishin pjesë e një sulmi më të gjerë kundër popullatës civile dhe autorët fizikë të përfshirë në këtë sulm, ose ata me urdhër të të cilëve vepronin, ishin padyshim të vetëdijshëm se vepronin në kontekst të një sulmi më të madh kundër popullatës shqiptare kosovare në atë rajon.

1200. Sikurse është përmendur më lart, forcat e UJ-së dhe të MPB-së të përfshira në sulmin në Piranë dhe Sërbicë me sjelljet e tyre të dhunshme dhe kërcënuese shkaktuan ikjen e banorëve. Fakti se u vunë zjarrin shtëpive në Piranë dhe oficerët e MPB-së i urdhëruan shqiptarët kosovarë të strehuar në Sërbicë të dërgoheshin në Shqipëri gjithashtu tregon për dëbimin masiv të shqiptarëve kosovarë të cilët ndodheshin në këto fshatra në mënyrë të ligjshme. Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore konkludon se janë përmbushur të gjitha këto elementët e dëbimit si krim kundër njerëzimit, i ndëshkueshëm sipas Nenit 5(d) të Statutit. Duke arsyetuar në mënyrë të ngjashme dhe duke marrë parasysh mënyrën e dhunshme dhe kërcënuese të shpërnguljes së shqiptarëve kosovarë nga shtëpitë e tyre në Piranë dhe më pas në Sërbicë, Dhoma është bindur se janë përmbushur edhe elementët e krimit “veprime të tjera çnjerëzore” (zhvendosje e dhunshme), e ndëshkueshme sipas Nenit 5(i).

1201. Dhoma gjithashtu ka konkluduar më lart se, më 28 mars 1999, shumë shqiptarë kosovarë nga Dushanova, lagje e qytetit të Prizrenit, u dëbuan me dhunë nga shtëpitë nga policia dhe u urdhëruan të shkonin për në Shqipëri. Gjatë dëbimit, ata u rrahën, u kërcënuan dhe u plaçkitën, kurse shtëpive iu vu zjarri. Shumë nga të dëbuarit shkuan drejt kufirit dhe u keqtrajtuat edhe më tej gjatë rrugës. Dhoma është bindur se ky sulm në Dushanovë përbën sulm mbi popullatën civile të kësaj zone, se u krye në mënyrë gjerësisht të përhapur dhe sistematike, dhe se ishte pjesë e sulmit të përhapur gjerësisht dhe sistematik kundër civilëve shqiptarë kosovarë në së paku 13 komuna. Veprime e forcave të përfshira në këtë sulm ishin pjesë e një sulmi më të gjerë kundër popullatës

civile dhe autorët fizikë të përfshirë në të ishin padyshim të vetëdijshëm se ishin duke vepruar në kontekst të një sulmi më të madh kundër popullatës shqiptare kosovare të atij rajoni meqë ata bënë komente si "Ikni në Shqipëri," "Nuk ka vend për ju këtu," dhe "Kosova është e Serbisë, ju e keni vendin në Shqipëri."

1202. Sikurse është përmendur më lart, MPB-ja i dëboi shqiptarët kosovarë nga shtëpitë e tyre në Dushanovë. Është gjithashtu e qartë nga komentet që bënë gjatë dëbimeve se autorët fizikë synonin largimin e shqiptarëve kosovarë nga Kosova. Nuk ekzistonte asnjë arsye legjitime për këtë dëbim dhe shqiptarët kosovarë të cilët ndodheshin në Dushanovë, nuk ishin atje në mënyrë të paligjshme.

1203. Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore sërish konkludon se janë përmbushur të gjithë elementët e dëbimit si krim kundër njerëzimit, i ndëshkueshëm sipas Nenit 5(d) të Statutit në lidhje me Dushanovën, pjesë e qytetit të Prizrenit. Duke arsyetuar në mënyrë të ngjashme dhe në bazë të dëshmive të dëshmitarëve për kërcënimet, keqtrajtimin fizik dhe frikësimin e ushtruar nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë të cilët dëbuan banorët e Dushanovës, Dhoma është bindur se janë përmbushur edhe elementët e krimit "veprime të tjera çnjerëzore" (zhvendosje e dhunshme), e ndëshkueshme sipas Nenit 5(i) të Statutit.

5. Rahoveci

1204. Paraprakisht, Dhoma Gjyqësore konkludon se paragrafi 72(a)(i) i Aktakuzës përmban disa pretendime në lidhje me shpërnguljen e shqiptarëve kosovarë nga fshatrat e komunës së Rahovecit, duke mos saktësuar se prej cilave fshatra u shpërngulën këta njerëz. E vetmja akuzë konkrete e shpërnguljes me dhunë është në lidhje me një grup të madh njerëzish të mbledhur në një mal afër Nagafcit më 25 mars 1999, për të cilën Dhoma ka konkluduar më lart se nuk është provuar me fakte. Në lidhje me ngjarjet e 2 prillit 1999, Aktakuza përshkruan granatimin e "fshatrave" nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë, ku u vranë disa njerëz që flinin në traktorë dhe të tjerët u detyruan të iknin në Shqipëri. Sidoqoftë, dëshmitë e paraqitura nga Prokuroria i referohen vetëm një sulmi ajror mbi fshatin Nagafc më 2 prill, për të cilin Dhoma ka konkluduar më lart se nuk është provuar se është kryer nga forcat e RFJ-së dhe Serbisë.

1205. Rrjedhimisht të vetmet akuza të dëbimit dhe veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) nga kjo komunë për të cilat Dhoma duhet të nxjerrë konkluzione ligjore janë në lidhje me fshatin Celinë, siç është parashtruar në paragrafin 72(a). Edhe pse në paragrafin 75(b) dhe (c) pretendohet se vrasjeve në Bellacërkë dhe Krushë të Vogël u parapriu largimi i popullatës, nuk janë paraqitur akuza për dëbim ose zhvendosje të dhunshme në lidhje me asnjërën prej tyre. Si pasojë, në

lidhje me këto dy fshatra, Dhoma do të nxjerrë konkluzione ligjore vetëm në lidhje me akuzat për vrasje.

a. Celina

1206. Siç është diskutuar më lart, në fund të marsit 1999, UJ-ja dhe MPB-ja ndërmorën një operacion të përbashkët në zonën e gjerë që mbulonte pjesë të komunave të Prizrenit, Rahovecit, dhe Suharekës. Ndërsa në dukje ky operacion ishte kundër UÇK-së, Dhoma ka konkluduar se, në të njëjtën kohë u sulmuan sistematikisht edhe civilët shqiptarë kosovarë që jetonin në atë zonë. Ndërmjet fshatrave të sulmuar ishte edhe Celina. Më 25 mars, Celina u granatua nga UJ-ja dhe pastaj forcat e përziera të UJ-së dhe MPB-së hynë në fshat, duke plaçkitur dhe djegur shtëpitë. Si rezultat, banorët ikën nga frika. Forcat e MPB-së gjithashtu rrahën dhe plaçkitën fshatarët që po iknin, duke ua marrë gjërat me vlerë dhe dokumentet e identifikimit, dhe vranë disa njerëz. Burrat u detyruan nën kërcënimin e armëve të shkonin në Prizren e më pas në Shqipëri dhe policia i keqtrajtoi edhe më tej gjatë rrugës. Dhoma është bindur se këto ngjarje përbënin sulm mbi popullatën civile të Celinës, i cili u krye në mënyrë sistematike dhe ishte pjesë e një sulmi gjerësisht të përhapur dhe sistematik kundër shqiptarëve kosovarë në atë zonë, si dhe kundër civilëve shqiptarë kosovarë në së paku 13 komuna të Kosovës. Veprimet e këtyre forcave ishin pjesë e një sulmi më të gjerë kundër popullatës civile dhe autorët fizikë të përfshirë në këtë sulm, ose ata me urdhër të cilëve vepronin, ishin padyshim të vetëdijshëm se ishin duke vepruar në kontekst të një sulmi më të gjerë kundër popullatës shqiptare kosovare në atë rajon.

1207. Siç është theksuar më lart, është e qartë se forcat e UJ-së dhe të MPB-së shkaktuan largimin e banorëve të Celinës të cilët banonin atje në mënyrë të ligjshme, dhe nuk kishte asnjë arsye legjitime për këtë largim. Dhoma Gjyqësore është bindur se këto forca synonin që banorët shqiptarë kosovarë të Celinës të shkonin në Prizren e më tej në Shqipëri.

1208. Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore konkludon se janë përmbushur të gjithë elementët e dëbimit si krim kundër njerëzimit, i ndëshkueshëm sipas Nenit 5(d) të Statutit. Duke arsyetuar në mënyrë të ngjashme dhe duke marrë parasysh mënyrën e dhunshme të sulmit që shkaktoi terror mbi popullatën vendëse të cilit kishin frikë për jetën e tyre, Dhoma është bindur se janë përmbushur elementët e krimit të veprimeve çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme), e ndëshkueshme sipas Nenit 5(i) to Statutit.

1209. Menjëherë pas këtij sulmi fillestar mbi Celinën, xhamia e fshatit u shkatërrua nga forcat e MPB-së me lëndë shpërthyes. Dhoma është bindur se ky shkatërrim ishte pjesë e sulmit kundër popullatës civile të Celinës, se xhamia nuk përdorej për qëllime ushtarake dhe se autorët fizike e

kryen shkatërrimin qëllimisht, për t'i diskriminuar shqiptarët kosovarë si grup etnik. Rrjedhimisht, janë përmbushur të gjithë elementët e shkatërrimit ose dëmtimit të objekteve fetare si formë e përndjekjes, që përbën krim kundër njerëzimit, i ndëshkueshëm sipas Nenit 5(h) të Statutit.

b. Bellacërka

1210. Dhoma Gjyqësore gjithashtu konkludoi se më 25 mars 1999, si pjesë e sulmit më të gjerë kundër fshatrave shqiptare kosovare në atë rajon, tanket e UJ-së hynë në Bellacërkë dhe forcat e UJ-së dhe të MPB-së hapën zjarr drejt fshatit, duke i detyruar fshatarët të largoheshin. Qindra fshatarë ikën përgjatë lumit Belajë ku policët kishin vranë disa njerëz, duke përfshirë gra e fëmijë. Dhoma është bindur se këto ngjarje përbëjnë sulm mbi popullatën civile të Bellacërkës, se u krye gjerësisht dhe sistematikisht, dhe se ishte pjesë e sulmit gjerësisht të përhapur dhe sistematik kundër shqiptarëve kosovarë në atë zonë, si dhe të sulmit më të gjerë në së paku 13 komuna. Veprimet e forcat të përfshira ishin pjesë e sulmit gjerësisht të përhapur dhe sistematik kundër popullatës civile dhe autorët fizikë të përfshirë në sulm, ose ata me urdhër të të cilëve vepronin, padyshim ishin të vetëdijshëm se ishin duke vepruar në kontekst të sulmit më të madh kundër popullatës shqiptare kosovare në atë rajon.

1211. Gjatë këtij sulmi, forcat e MPB-së vranë së paku 10 vetë në lumin Belajë, përfshirë edhe gra e fëmijë, duke i fyer me zë të lartë. Një grupi burrash u grabitën gjërat me vlerë dhe i detyruan të zbrisnin në shtratin e lumit ku i pushkatuan. Në këtë incident u vranë së paku 42 meshkuj. Më vonë, shtatë të tjerë u vranë nga të njëjtët policë. Meqenëse nuk ka dyshim se autorët fizikë shkaktuan qëllimisht vdekjen e këtyre njerëzve, Dhoma konkludon se janë përmbushur të gjithë elementët e vrasjes si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës, e ndëshkueshme sipas Nenit 3 të Statutit. Gjithashtu, duke marrë parasysh se këto vrasje u kryen në kontekst të sulmit gjerësisht të përhapur dhe sistematik kundër popullatës civile, se veprimet e autorëve fizikë ishin pjesë atij sulmi, dhe se autorët fizikë ose personat me urdhër të të cilëve vepronin e dinin këtë gjë, Dhoma është bindur se janë përmbushur të gjithë elementët e vrasjes si krim kundër njerëzimit, i ndëshkueshëm sipas Nenit 5(a) të Statutit. Së fundi, Dhoma është bindur se autorët fizikë të këtyre vrasjeve i sulmuan viktimat për shkak se ishin të kombësisë shqiptare kosovare. Sipas Dhomës, autorët fizikë i kryen vrasjet qëllimisht për t'i diskriminuar shqiptarët kosovarë si grup etnik. Rrjedhimisht, janë përmbushur të gjithë elementët e vrasjes si formë e përndjekjes, që është krim kundër njerëzimit i ndëshkueshëm sipas Nenit 5(h) të Statutit.

c. Krusha e Vogël

1212. Gjithashtu më 25 maj 1999, forcat e UJ-së dhe të MPB-së sulmuan fshatin Krushë e Vogël. UJ-ja e granatoi fshatin e më pas MPB-ja hyri në fshat dhe plaçkiti e dogji shtëpitë së bashku me serbët vendës të armatosur. Të nesërmen, forcat e MPB-së i urdhëruan të gjithë njerëzit në fshat dhe ata që fshiheshin në pyllin e afërt të dilnin në rrugën kryesore, ku gratë e fëmijët i ndanë nga burrat. Ata mblodhën më shumë se 100 meshkuj, duke përfshirë edhe djem të moshës 13-18 vjeç, pleq, dhe burra me të meta mendore e fizike, të cilët i keqtrajtuuan, ua grabitën gjërat me vlerë dhe dokumentet e identifikimit, dhe i çuan në një stallë të zbrazët të shoqëruar nga policia. Në stallë, policia hapi zjarr mbi ta duke vrarë shumicën e pastaj i vunë zjarrin stallës. Në këtë incident u vranë 111 meshkuj. Dhoma është bindur se këto ngjarje përbëjnë sulm mbi popullatën civile të Krushës së Vogël dhe autorët fizikë të përfshirë në këtë sulm ose ata me urdhër të të cilëve vepruan, ishin padyshim të vetëdijshëm se ishin duke vepruar në kontekst të një sulmi më të madh kundër popullatës shqiptare kosovare në atë rajon.

1213. Meqenëse nuk ka dyshim se autorët fizikë e shkaktuan qëllimisht vdekjen e këtyre 111 vetëve, Dhoma konkludon se janë përbushur të gjithë elementët e vrasjes, që përbën shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës e ndëshkueshme sipas Nenit 3 të Statutit. Gjithashtu, duke marrë parasysh se këto vrasje u kryen në kontekst të sulmit gjerësisht të përhapur dhe sistematik kundër popullatës civile në atë rajon, se veprimet e autorëve fizikë ishin pjesë e atij sulmi, dhe se autorët fizikë ose personat me urdhër të të cilëve vepronin e dinin këtë gjë, Dhoma është bindur se janë përbushur të gjithë elementët e vrasjes si krim kundër njerëzimit, i ndëshkueshëm sipas Nenit 5(a) të Statutit. Së fundi, në kryerjen e këtyre vrasjeve, autorët fizikë i sulmuan meshkujt shqiptarë kosovarë për shkak të kombësisë së të tyre. Sipas Dhomës, autorët fizikë i kryen vrasjet qëllimisht për t'i diskriminuar shqiptarët kosovarë si grup etnik. Rrjedhimisht, janë përbushur të gjithë elementët e vrasjes si formë e përndjekjes, që përbën krim kundër njerëzimit, i ndëshkueshëm sipas Nenit 5(h) të Statutit.

6. Suhareka

1214. Më 26 mars 1999, PJP-ja së bashku me policët vendorë, zhvilluan një aksion në qytetin e Suharekës kundër civilëve të qytetit, duke vrarë anëtarët e familjes Berisha dhe civilë të tjerë. Në ditët pas aksionit, policët u vunë zjarrin shtëpive dhe dëbuan shqiptarë kosovarë nga shtëpitë, ose drejtpërsëdrejti, ose nëpërmjet krijimit të atmosferës së frikës që i detyroi njerëzit të largoheshin. Dhoma është bindur se këto ngjarje përbënin sulm mbi popullatën civile të qytetit, se ky sulm u krye gjerësisht dhe sistematikisht dhe se ishte pjesë e sulmit gjerësisht të përhapur dhe sistematik kundër civilëve shqiptarë kosovarë në atë rajon, si dhe në së paku 13 komuna të Kosovës. Aksionet

e forcave të MPB-së në fjalë ishin pjesë e sulmit më të gjerë kundër popullatës civile dhe autorët fizikë, disa prej të cilëve bënë komente si, "Keni 15 minuta për t'u larguar për në Shqipëri dhe kurrë nuk do ta shihni më këtë tokë", ishin padyshim të vetëdijshëm se ishin duke vepruar në kontekst të një sulmi më të gjerë kundër popullatës shqiptare kosovare në zonën e Suharekës.

1215. Siç është theksuar më lart, më 26 mars 1999, policët vendës vranë qëllimisht 45 anëtarë të familjes Berisha të cilët ishin të gjithë civilë. Pak para se t'i vrisnin, policët vendës kishin bërë deklaratë se do të vrisnin të gjithë shqiptarët. Kjo ngjarje, së bashku me aksionet e mëvonshme të forcave të MPB-së që vepronin në qytetin e Suharekës në atë kohë, të cilët ose urdhëruan shqiptarët kosovarë të largoheshin nga shtëpitë, ose i detyruan të largoheshin me sjelljen e tyre të dhunshme dhe kërcënuese, rezultuan në eksodin e shqiptarëve kosovarë nga qyteti. Nuk kishte asnjë arsye për këtë dëbim masiv të shqiptarëve kosovarë të cilët ndodheshin në qytetin e Suharekës në mënyrë të ligjshme. Shumë prej tyre shkuan në Shqipëri, kurse të tjerët u shpërngulën brenda Kosovës.

1216. Rrjedhimisht Dhoma konkludon se janë përmbushur të gjithë elementët e dëbimit si krim kundër njerëzimit, i ndëshkueshëm sipas Nenit 5(d) të Statutit. Duke arsyetuar në mënyrë të ngjashme dhe duke marrë parasysh dëshmitë e dëshmitarëve të ndryshëm për dhunën, frikën, dhe kërcënimet që forcat vendëse dhe të MPB-së ushtruan sistematikisht në qytetin e Suharekës, Dhoma është bindur se janë përmbushur elementet e krimit të veprimeve çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme), e ndëshkueshme sipas Nenit 5(i).

1217. Meqenëse nuk ka dyshim se autorët fizikë shkaktuan qëllimisht vdekjen e 45 anëtarëve të familjes Berisha, Dhoma konkludon se janë përmbushur të gjithë elementët e vrasjes si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës, e ndëshkueshme sipas Nenit 3 të Statutit. Gjithashtu, duke marrë parasysh se këto vrasje u kryen në kontekst të sulmit gjerësisht të përhapur dhe sistematik kundër popullatës civile, se veprimet e autorëve fizikë ishin pjesë e atij sulmi, dhe se autorët fizikë, ose ata me urdhër të të cilëve vepronin, e dinin këtë, Dhoma është bindur se janë përmbushur të gjithë elementët e vrasjes si krim kundër njerëzimit, i ndëshkueshëm sipas Nenit 5(a). Edhe pse u paraqitën prova se autorët fizikë gjithashtu kishin motive personale për të sulmuar familjen në fjalë, Dhoma thekson se krimet kundër njerëzimit mund të kryhen për arsye tërësisht personale mjafton që shkelja bazë të jetë kryer në kontekst të sulmit kundër popullatës civile, si rasti në fjalë. Së fundi fund, autorët fizikë sulmuan një familje shqiptare kosovare dhe ndërkohë bënë deklaratë se do t'i vrisnin të gjithë shqiptarët kosovarë. rrjedhimisht Dhoma konkludon se ata i kryen vrasjet qëllimisht për t'i diskriminuar shqiptarët kosovarë si grup etnik, që përmbush elementët e vrasjes si formë e përndjekjes, që është krim kundër njerëzimit.

1218. Në lidhje me akuzën e shkatërrimit të objekteve fetare, Dhoma ka konkluduar se minareja e xhamisë në Suharekë u shkatërrua nga forcat e MPB-së. Ky incident ndodhi gjatë sulmit mbi popullatën civile të përshkruar më lart. Gjithashtu, Dhoma është bindur se xhamia nuk përdorej për qëllime ushtarake dhe se u sulmua sepse ishte objekt fetar mysliman. Meqenëse minareja u shkatërrua me lëndë shpërthyes, autorët fizikë synonin ta dëmtonin xhaminë dhe, si rrjedhojë vepruan me synim diskriminues. Së fundi, Dhoma e konsideron shkatërrimin e minaresë si dëmtim të rëndë të xhamisë. Rrjedhimisht, Dhoma konkludon se janë përmbushur të gjithë elementët e shkatërrimit ose dëmtimit të objekteve fetare si formë e përndjekjes, e ndëshkueshme sipas Nenit 5(h) të Statutit.

7. Skënderaj

1219. Dhoma ka konkluduar se, me fillimin e fushatës së bombardimeve të NATO-s forcat e UJ-së dhe MPB-së ndërmorën sulme në tërë komunën e Skënderajt. Sulmet u kryen në pjesën perëndimore të komunës, në zonën e Turiçecit dhe fshatrave përreth, si Izbica dhe Tushila. Sulme të ngjashme u kryen edhe në pjesën lindore të komunës, në zonën rreth Qirezit. Edhe pse pjesërisht i drejtuar kundër UÇK-së, sulmi ishte i ashpër dhe pa dallim, duke qenë se u sulmuan edhe fshatrat e shqiptarëve kosovarë dhe grupe civilësh, duke i detyruar shumë nga ata të iknin nga ajo zonë. Gjithashtu, menjëherë pas aksionit në pjesën perëndimore të komunës, forcat e MPB-së hynë në fshatrat në fjalë dhe vepruan në mënyrë kërcënuese dhe shtrënguese, duke sulmuar popullatën civile që jetonte apo ishte grumbulluar atje, duke plaçkitur objekte civile, dhe duke djegur shtëpi. Në Izbicë, këto forca vranë së paku 93 shqiptarë kosovarë shumë të moshuar, dhe ndoshta edhe shumë të tjerë. Në Qirez dhe zonën përreth, forcat e UJ-së, duke përfshirë dhe rezervistë të UJ-së, si dhe MPB-në, sulmuan meshkuj shqiptarë kosovarë, duke ndaluar dhe keqtrajtuar 150 prej tyre, të cilët pastaj i dërguan në Glllogoc ku u mbajtën shtatë ditë dhe u rrahën përsëri nga policia.

1220. Rrjedhimisht Dhoma është bindur se këto ngjarje përbënin sulm mbi popullatën civile të komunës, se ky sulm u krye gjerësisht dhe sistematikisht dhe se ishte pjesë e sulmit gjerësisht të përhapur dhe sistematik kundër civilëve shqiptarë kosovarë në së paku 13 komuna të Kosovës. Aksionet e forcave të përfshira ishin pjesë e sulmit më të gjerë kundër popullatës civile dhe, duke marrë parasysh shkallën e aksioneve në këtë komunë dhe në 13 komunat e Kosovës, autorët fizikë, ose personat nën urdhrat e të cilëve vepronin, ishin padyshim të vetëdijshëm se ishin duke vepruar në kontekst të sulmit më të madh kundër popullatës shqiptare kosovare.

1221. Siç është përmendur më lart, UJ-ja, MPB-ja, dhe forcat e tjera shoqëruese të armatosura që vepronin në komunë nga fundi i marsit dhe gjatë tërë prillit, i detyruan shqiptarët kosovarë të

largoheshin nga shtëpitë e tyre nëpërmjet sjelljes së dhunshme dhe kërcënuese. Gjithashtu, më 28 mars 1999, forcat e MPB-së vranë 93 shqiptarë kosovarë në Izbicë, shumica e të cilëve ishin pleq. Lajmi për këtë incident u përhap shpejt dhe kontribuoi në largimin e njerëzve nga shtëpitë dhe nga vetë komuna. Dhoma thekson se nuk ekzistonte asnjë arsye legjitime për këtë shpërngulje masive të shqiptarëve kosovarë të Skënderajt. Shumë prej tyre u drejtuan qëllimisht drejt kufirit për në Shqipëri ose Maqedoni, kurse të tjerët u shpërngulën brenda Kosovës.

1222. Rrjedhimisht Dhoma konkludon se janë përmbushur të gjithë elementët e dëbimit si krim kundër njerëzimit, i ndëshkueshëm sipas Nenit 5(d) të Statutit. Duke arsyetuar në mënyrë të ngjashme dhe duke marrë parasysh dëshmitë e dëshmitarëve të ndryshëm për dhunën, frikën, dhe kërcënimet që forcat e UJ-së dhe të MPB-së ushtruan në komunë, Dhoma është bindur se janë përmbushur elementët e krimit të veprimeve çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme), e ndëshkueshme sipas Nenit 5(i).

1223. Në lidhje me vrasjen e së paku 93 shqiptarëve kosovarë në Izbicë, meqenëse nuk ka dyshim se autorët fizikë i shkaktuan qëllimisht vrasjet e këtyre njerëzve, Dhoma konkludon se janë përmbushur të gjithë elementët e vrasjes, si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës, e ndëshkueshme sipas Nenit 3 të Statutit. Gjithashtu, duke marrë parasysh se këto vrasje u kryen në kontekst të sulmit gjerësisht të përhapur dhe sistematik kundër popullatës civile, se veprimet e autorëve fizikë ishin pjesë e atij sulmi, dhe se autorët fizikë, ose personat me urdhrat e të cilëve vepronin, e dinin këtë, Dhoma është bindur se janë përmbushur të gjithë elementët e vrasjes si krim kundër njerëzimit, i ndëshkueshëm sipas Nenit 5(a). Së fundi, gjatë kryerjes së këtyre vrasjeve, autorët fizikë i sulmuan shqiptarët kosovarë për shkak të prejardhjes së tyre etnike, duke i fyer dhe duke i detyruar t'i hiqnin kapelat e tyre tradicionale, duke përdhosur në këtë mënyrë simbolet e kombësisë së tyre. Sipas mendimit të Dhomës, autorët fizikë i kryen vrasjet qëllimisht për t'i diskriminuar shqiptarët kosovarë si grup etnik. Rrjedhimisht, janë përmbushur të gjithë elementët e përndjekjes përmes vrasjes, e ndëshkueshme si krim kundër njerëzimit sipas Nenit 5(h).

1224. Dhoma nuk ka dyshim se, gjatë sulmit kundër popullatës shqiptare kosovare të komunës në Qirez, së paku katër gra iu nënshtuan veprimeve të natyrës seksuale, duke cenuar paprekshmërinë e tyre fizike ose që përbënin dhunim të dinjitetit personal. Duke marrë parasysh se të gjitha këto gra u mbajtën nga keqbërësit fizikë dhe disa nga to u vranë më vonë, është e qartë se asnjëra prej tyre nuk dha pëlqimin për veprimet seksuale. Dhoma gjithashtu është bindur se autorët fizikë i kryen me paramendim këto veprime dhe ishin të vetëdijshëm se viktimat nuk kishin dhënë pëlqimin. Meqenëse gratë u keqtrajtuuan edhe në mënyrë verbale nga autorët fizikë të cilët përmendën emra konkretë të udhëheqësve shqiptarë kosovarë, Dhoma është bindur se autorët fizikë ushtruan dhunë

seksuale me qëllim për t'i diskriminuar shqiptarët kosovarë si grup etnik. Rrjedhimisht, janë përmbushur të gjithë elementët e dhunës seksuale si formë e përndjekjes, e ndëshkueshme si krim kundër njerëzimit sipas Nenit 5(h).

8. Mitrovica

1225. Prej fillimit të fushatës ajrore të NATO-s e deri në fillim të prillit 1999, civilë të shquar shqiptarë kosovarë që jetonin në qytetin e Mitrovicës u sulmuan nga MPB-ja, shtëpitë e shqiptarëve kosovarë u dogjën sistematikisht, dhe MPB-ja dëboi shumë shqiptarë kosovarë nga qyteti në mënyrë të organizuar. Disa njerëz, përfshirë Afërdita Hajrizin, ikën në Zhabarin e afërt, por më pas i urdhëruan të ktheheshin në qytetin e Mitrovicës më 1 prill. Pas dy ditësh, ata udhëtuan me autobus për në Mal të Zi, prej nga Hajrizi dhe familja e saj më në fund shkuan në Shqipëri.

1226. Dhoma është bindur se këto ngjarje përbënin sulm kundër popullatës civile të qytetit, se ky sulm u krye në mënyrë sistematike, dhe se ishte pjesë e sulmit gjerësisht të përhapur dhe sistematik kundër civilëve shqiptarë kosovarë në së paku 13 komuna të Kosovës. Veprimet e forcave të përfshira në sulm ishin pjesë e sulmit më të gjerë kundër popullatës civile, meqenëse shtëpitë e shqiptarëve kosovarë u dogjën në mënyrë përzgjedhëse dhe ata u urdhëruan të largoheshin nga Kosova, ndërsa pjesëtarët e MPB-së u bërtisnin, "Ky nuk është vendi juaj. Kjo është Serbi. Shkoni në Shqipëri." Këto deklarata si dhe fakti që shqiptarët kosovarë u urdhëruan të largoheshin ose ndryshe do t'i vrisnin, tregojnë se autorët fizikë të përfshirë në këto dëbime nga qyteti i Mitrovicës ishin të vetëdijshëm se ishin duke vepruar në kontekst të sulmit më të madh kundër popullatës shqiptare kosovare.

1227. Siç është përmendur më lart, forcat e MPB-së dëbuan shqiptarët kosovarë nga Mitrovica. Gjithashtu, deklaratat që bënë gjatë dëbimeve tregojnë qartë se autorët fizikë synonin largimin e njerëzve nga qyteti. Nuk ekzistonte asnjë arsye legjitime për këto dëbime të shqiptarëve kosovarë, të cilët ndodheshin në qytet në mënyrë të ligjshme.

1228. Rrjedhimisht Dhoma konkludon se, në lidhje me qytetin e Mitrovicës, janë përmbushur të gjithë elementët e dëbimit si krim kundër njerëzimit, i ndëshkueshëm sipas Nenit 5(d) të Statutit. Gjithashtu, autorët u shkaktuan qëllimisht viktimave shqiptare kosovare vuajtje mendore dhe fizike, që përbënte dhunim të dinjitetit të tyre. Si rezultat, Dhoma është bindur se janë përmbushur të gjithë elementët e krimit të veprave të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme), e ndëshkueshme sipas Nenit 5(i).

1229. Dhoma gjithashtu ka konkluduar se, në mes të prillit 1999, forcat e UJ-së dhe të MPB-së sulmuan civilët shqiptarë kosovarë të fshatit Zhabar dhe të fshatrave përreth. Në një operacion kundër popullatës civile, shqiptarët kosovarë u dëbuan sistematikisht nga shtëpitë e tyre, të cilat më pas u plaçkitën dhe u dogjën. Dhoma është bindur se këto ngjarje përbënin sulm mbi popullatën civile të fshatrave, se ky sulm u krye në mënyrë sistematike dhe se ishte pjesë e një sulmi gjerësisht të përhapur dhe sistematik kundër civilëve shqiptarë kosovarë në së paku 13 komuna të Kosovës.

1230. Dhoma ka konkluduar se UJ-ja dhe MPB-ja dëbuan shumë shqiptarë kosovarë nga Zhabari dhe fshatrat përreth në komunën e Mitrovicës. Veprimet e këtyre forcave ishin pjesë e sulmit më të gjerë kundër popullatës civile, meqenëse fshatrat e shqiptarëve kosovarë u dogjën në mënyrë përzgjedhëse; banorët e tyre u urdhëruan të shkonin në këmbë drejt kufirit me Shqipërinë, disa prej të cilëve të shoqëruar nga policia ku ua morën dokumentet e identifikimit. Gjithashtu, autorët fizikë nga UJ-ja dhe MPB-ja, ose ata nën urdhrat e të cilëve vepronin, ishin të vetëdijshëm se ishin duke vepruar në kontekst të një sulmi më të madh kundër popullatës shqiptare kosovare. Nuk ekzistonte asnjë arsye legjitime për këto dëbime të shqiptarëve kosovarë, të cilët ndodheshin në mënyrë të ligjshme në këto fshatra.

1231. Rrjedhimisht, Dhoma konkludon se, në fshatin Zhabar si dhe në fshatrat fqinje në komunën e Mitrovicës, janë përmbushur të gjithë elementët e dëbimit si krim kundër njerëzimit, i ndëshkueshëm sipas Nenit 5(d) të Statutit. Duke arsyetuar në mënyrë të ngjashme dhe duke marrë parasysh dëshmitë e dëshmitarëve të ndryshëm për dhunën, frikën, dhe kërcënimet që forcat e UJ-së dhe të MPB-së ushtruan në komunë, Dhoma është bindur se janë përmbushur elementët e krimit të veprimeve çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme), e ndëshkueshme sipas Nenit 5(i).

9. Vushtrria

a. Qyteti i Vushtrrisë

1232. Dhoma ka konkluduar se, në fund të marsit 1999, forcat e MPB-së dhe të UJ-së sulmuan civilët shqiptarë kosovarë në qytetin e Vushtrrisë, dhe dogjën shtëpitë dhe dyqanet e shqiptarëve kosovarë, si dhe një xhami në qytet. Dhoma është bindur se këto ngjarje përbënin sulm kundër popullatës civile të qytetit, se ai u krye në mënyrë sistematike, dhe se ishte pjesë e sulmit gjerësisht të përhapur dhe sistematik kundër civilëve shqiptarë kosovarë në së paku 13 komuna të Kosovës. Veprime e forcave të përfshira ishin qartësisht pjesë e sulmit më të gjerë kundër popullatës civile, meqenëse shtëpitë, dyqanet, dhe xhamitë u dogjën në mënyrë përzgjedhëse. Gjithashtu, autorët fizikë, ose ata me urdhër të të cilëve vepronin, ishin padyshim të vetëdijshëm se veprimet e tyre ishin pjesë e sulmit më të madh kundër popullatës shqiptare kosovare.

1233. Siç është përmendur më lart, Dhoma ka konkluduar se forcat e MPB-së dëbuan shumë shqiptarë kosovarë nga shtëpitë e tyre në qytetin e Vushtrrisë. Veprimet e këtyre forcave ishin qartësisht pjesë e sulmit më të gjerë kundër popullatës civile, meqenëse shtëpitë e shqiptarëve kosovarë u dogjën në mënyrë përzgjedhëse. Këto veprime tregojnë se autorët fizikë synonin dëbimin e njerëzve nga qyteti. Gjithashtu, autorët fizikë, ose ata me urdhrin e të cilëve vepronin, ishin padyshim të vetëdijshëm se ishin duke vepruar në kontekst të një sulmi më të gjerë kundër popullatës shqiptare kosovare. Nuk ekzistonte asnjë arsye legjitime për dëbimin e shqiptarëve kosovarë, të cilët ndodheshin në mënyrë të ligjshme në Vushtri. Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore konkludon se, në lidhje me qytetin e Vushtrrisë, janë përmbushur të gjithë elementët e dëbimit të dhunshëm si krim kundër njerëzimit, i ndëshkueshëm sipas Nenit 5(i) të Statutit.

1234. Në lidhje me xhaminë në Vushtri, sjellja e zjarrvënësve dhe fakti se ata sulmuan një objekt fetar mysliman tregon se qëllimi i tyre ishte diskriminimi i grupit etnik shqiptar kosovar. Dhoma gjithashtu është bindur se xhamia në Vushtri nuk përdorej për qëllime ushtarake dhe se shkatërrimi i saj u shkaktua nga veprimet e pjesëtarëve të MPB-së dhe UJ-së, të cilët kishin synimin e qartë të shkatërrimit të saj. Rrjedhimisht Dhoma konkludon se janë përmbushur të gjithë elementët e shkatërrimit ose dëmtimit të objekteve fetare si formë e përndjekjes, që është krim kundër njerëzimit i ndëshkueshëm sipas Nenit 5(h) të Statutit.

b. Pjesët e tjera të komunës së Vushtrrisë

1235. Sa i përket vrasjes së tre njerëzve që udhëtonin në kolonë afër fshatit Studime e Epërme më 2 dhe 3 maj 1999 nga forcat e MPB-së, Dhoma konkludon se, meqenëse është e qartë se autorët fizikë të këtyre vrasjeve i shkaktuan qëllimisht këto vdekje, janë përmbushur të gjithë elementët e vrasjes si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës, e ndëshkueshme sipas Nenit 3 të Statutit.

1236. Këto vrasje u kryen në kontekst të një sulmi kundër një kolone njerëzish e përbërë kryesisht nga civilë dhe gjithashtu në kontekst të sulmit gjerësisht të përhapur dhe sistematik kundër civilëve shqiptarë kosovarë në së paku 13 komuna të Kosovës. Veprimet e autorëve fizikë ishin pjesë e sulmit. Autorët fizikë, ose ata që i urdhëruan veprimet e tyre, e dinin këtë siç provohet nga mënyra e organizuar në të cilën pjesëtarët e MPB-së iu afruan viktimave, keqtrajtimit, dhe më vonë vrasjes së tyre. Rrjedhimisht, Dhoma është bindur se janë përmbushur të gjithë elementët e vrasjes si krim kundër njerëzimit, e ndëshkueshme sipas Nenit 5(a) të Statutit.

1237. Së fundi fakti se duke ditur se viktimat ishin shqiptarë kosovarë, autorët fizikë vranë së paku tre prej tyre edhe pse ishte e qartë se ishin civilë, tregon se ata u vranë për shkak të përkatësisë etnike. Rrjedhimisht, Dhoma konkludon se ata i kryen vrasjet qëllimisht për t'i diskriminuar

shqiptarët kosovarë si grup etnik dhe rrjedhimisht janë përmbushur të gjithë elementët e vrasjes si formë e përndjekjes, që është krim kundër njerëzimit i ndëshkueshëm sipas Nenit 5(h) të Statutit.

1238. Megjithëse Prokuroria nuk ka provuar se njerëzit që përbënin kolonën u dëbuan nga shtëpitë e tyre nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë, pas ndalimit të kolonës më 2 maj 1999, forcat e MPB-së i urdhëruan njerëzit që të shkonin te disa godina bujqësore në periferi të qytetit të Vushtrisë, ku i mbajtën gjatë natës. Të nesërmen, MPB-ja i ndau gratë nga burrat dhe më pas mbajti disa qindra burra në burgun e Smrekonicës, ku ata u keqtrajtuuan fizikisht rreth tri javë e pastaj u dërguan në kufirin me Shqipërinë. Këto forca të MPB-së i fyen burrat, u thanë të shkonin në Shqipëri, dhe ua morën letërnjoftimet. Pasi e kaluar natën në godinën bujqësore, gratë, fëmijët, dhe pleqtë e grupit që kishin makina u urdhëruan të shkonin në Shqipëri, kurse ata pa makina u dërguan në një fshat të afërt.

1239. Siç është përmendur më lart, Dhoma konkludon se kolona e sulmuar më 2 maj përbëhej kryesisht nga civilë dhe ky sulm vazhdoi më 3 maj me mbajtjen e njerëzve në kolonë në godinën bujqësore. Forcat e MPB-së që mbajtën këta njerëz, ose ata me urdhrin e të cilëve vepronin, ishin të vetëdijshëm se ishin duke vepruar në kuadër të këtij sulmi dhe i detyruan ata ose të shkonin në Shqipëri (menjëherë ose pasi i mbajtën për një kohë), ose të shkonin në zonat e tjera të Kosovës. Nuk ekzistonte asnjë arsye legjitime për këtë shpërngulje të shqiptarëve kosovarë, të cilët ndodheshin në atë zonë në mënyrë të ligjshme. Rrjedhimisht Dhoma konkludon se janë përmbushur të gjithë elementët e dëbimit si krim kundër njerëzimit, i ndëshkueshëm sipas Nenit 5(d) të Statutit. Duke arsyetuar në mënyrë të ngjashme dhe bazuar në dëshmitë e dëshmitarëve të ndryshëm për dhunën, frikën, dhe kërcënimet që forcat e MPB-së ushtruan ndaj njerëzve në kolonë, Dhoma është bindur se janë përmbushur të gjithë elementët e krimit të veprave të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme), e ndëshkueshme sipas Nenit 5(i).

10. Prishtina

1240. Me fillimin e fushatës ajrore të NATO-s më 24 mars 1999, forcat e UJ-së dhe të MPB-së, si dhe serbët vendës të armatosur, sulmuuan shqiptarët kosovarë në gjithë qytetin e Prishtinës. Pjesë të qytetit u granatuan nga UJ-ja, godinave iu vu zjarri, shtëpitë u plaçkitën dhe shumë shqiptarë kosovarë u dëbuan drejtpërsëdrejti nga shtëpitë e tyre, ose ikën nga frika. Dhoma është bindur se këto ngjarje përbënin sulm mbi popullatën civile të qytetit, se ky sulm u krye në mënyrë sistematike, dhe se ishte pjesë e sulmit gjerësisht të përhapur dhe sistematik kundër civilëve shqiptarë kosovarë në së paku 13 komuna të Kosovës.

1241. Është e qartë se veprimet e forcave të përfshira ishin pjesë e një sulmi më të gjerë kundër popullatës civile dhe se autorët fizikë, disa prej të cilëve bënë komente si, "Shkoni në Shqipëri, Kosova nuk është toka juaj," ose, "Shqiptarët e kanë vendin në Shqipëri dhe duhet të largohen, Kosova nuk është e juaja," ishin pa dyshim të vetëdijshëm se po vepronin në kontekst të një sulmi më të madh kundër popullatës shqiptare kosovare, së paku në Prishtinë.

1242. Siç është përmendur më lart, UJ-ja, MPB-ja, dhe forcat e tjera të armatosura që vepronin në Prishtinë në atë kohë, ose i urdhëruan shqiptarët të largoheshin nga shtëpitë e tyre ose i detyruan të largoheshin nëpërmjet sjelljes së tyre të dhunshme dhe kërcënuese. Nuk ekzistonte asnjë arsye legjitime për këtë dëbim masiv të shqiptarëve kosovarë nga Prishtina, të cilët ndodheshin atje në mënyrë të ligjshme. Shumë prej tyre u transportuan qëllimisht me tren deri në kufi me Maqedoninë, ku i zbritën dhe i urdhëruan herë pas here nën kërcënimin e armëve, që të kalonin kufirin në këmbë.

1243. Rrjedhimisht, Dhoma konkludon se janë përmbushur të gjithë elementët e dëbimit si krim kundër njerëzimit, i ndëshkueshëm sipas Nenit 5(d) të Statutit. Duke arsyetuar në mënyrë të ngjashme dhe bazuar në dëshmitë e dëshmitarëve të ndryshëm për dhunën, frikën, dhe kërcënimet që forcat e RFJ-së dhe të Serbisë ushtruan sistematikisht në qytetin e Prishtinës, Dhoma është bindur se janë përmbushur të gjithë elementët e krimit të veprave të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme), që është i ndëshkueshëm sipas Nenit 5(i).

1244. Në lidhje me tri gratë të cilat deklaruan se ishin përdhunuar gjatë sulmit mbi popullatën shqiptare kosovare të Prishtinës, Dhoma nuk dyshon se ato u detyruan të kryenin marrëdhënie seksuale pa pëlqimin e tyre dhe përdhunuesit e dinin se ato nuk dhanë pëlqimin dhe rrjedhimisht u shkel e drejta e tyre themelore e paprekshmërisë fizike që përmbush të gjithë elementët e dhunës seksuale. Në njërin nga këto tri raste, keqbërësit hynë me forcë në shtëpinë e viktimës dhe e përdhunuan; në rastin tjetër, viktima ishte vajzë e re, e cila u mor nga shtëpia, u sulmua fizikisht e më pas u përdhunua në një hotel; dhe në rastin e tretë viktima ishte grua e re e cila shoqëroi vëllain e saj të lënduar në spital dhe u mbajt në bodrum para se të rrihej dhe përdhunohej disa herë.

1245. Meqenëse Aktakuza e paraqet dhunën seksuale vetëm si formë e përndjekjes, Prokuroria duhet të provojë se autorët vepruan me qëllim për t'i diskriminuar shqiptarët kosovarë si grup etnik. Sidoqoftë, ajo nuk paraqiti dëshmi në lidhje me këto tri raste prej të cilave mund të nxirret përfundim mbi ekzistencën e synimit diskriminues. Rrjedhimisht, Dhoma konkludon se Prokuroria nuk ka vërtetuar se forcat e RFJ-së dhe Serbisë në Prishtinë kryen dhunë seksuale si formë përndjekjeje.

11. Gjilani

1246. Dhoma ka konkluduar se, në fund të marsit 1999, forcat e UJ-së dhe të MPB-së së bashku me forcat jo të rregullta, i dëbuan shqiptarët kosovarë nga Zhegra dhe Lladova në komunën e Gjilanit, ose në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose përmes kërcënimeve, rrahjeve, dhe vrasjeve. Dhoma gjithashtu konkludon se, më 6 prill 1999, rezervistët e UJ-së i urdhëruan banorët e Përlepnicës të largoheshin nga fshati dhe ata vepruan sipas urdhrit. Meqenëse atyre u thanë se po i largonin për hir të sigurisë së tyre dhe më vonë ata u kthyen në fshat, Prokuroria nuk ka vërtetuar se në atë moment këta njerëz u shpërngulën pa arsye sipas të drejtës ndërkombëtare. Sidoqoftë, situata ishte e ndryshme më 13 prill, kur fshatarëve u thanë të largoheshin, këtë herë forcat e rregullta të UJ-së. Në atë kohë në fshat nuk kishte prani të UÇK-së, nuk kishte asnjë provë të bombardimeve të NATO-s, e rrjedhimisht asnjë arsye të dukshme për të evakuuar përsëri 3.000 njerëz. Rrjedhimisht, Dhoma është bindur se këto ngjarje përbënin sulm mbi popullatën civile të këtyre fshatrave, se ky sulm u krye në mënyrë të gjerë dhe sistematike, dhe se ishte pjesë e sulmit gjerësisht të përhapur dhe sistematik kundër civilëve shqiptarë kosovarë në së paku 13 komuna të Kosovës të përmendura më lart. Veprimet e forcave në fjalë ishin pjesë e sulmit më të gjerë kundër popullatës civile dhe autorët fizikë, ose personat nën urdhrat e të cilëve vepronin, ishin pa dyshim të vetëdijshëm se ishin duke vepruar në kontekst të një sulmi më të gjerë kundër popullatës shqiptare kosovare në fshatrat e përmendur.

1247. Siç është theksuar më lart, UJ-ja dhe MPB-ja, si dhe forcat e lidhur me to që vepronin në këto fshatra, ose i urdhëruan drejtpërsëdrejti shqiptarët kosovarë që të largoheshin, ose i detyruan të largoheshin me sjelljen e tyre të dhunshme dhe kërcënuese. Dhoma thekson se nuk ekzistonin arsye për këtë shpërngulje masive të shqiptarëve kosovarë, të cilët ndodheshin në ato zona në mënyrë të ligjshme. Shumë prej tyre ose u shoqëruan, ose u drejtuan qëllimisht në drejtim të kufirit për në Maqedoni, kurse të tjerët u mblodhën në Stubëll të Poshtme dhe mbetën në Kosovë.

1248. Rrjedhimisht, Dhoma konkludon se janë përmbushur të gjithë elementët e dëbimit si krim kundër njerëzimit, i ndëshkueshëm sipas Nenit 5(d) të Statutit. Duke arsyetuar në mënyrë të ngjashme dhe duke marrë parasysh dëshmitë e dëshmitarëve të ndryshëm për dhunën, frikën, dhe kërcënimet që UJ-ja, MPB-ja, dhe forcat e tjera ushtruan sistematikisht në fshatrat e përmendura, Dhoma është bindur se gjithashtu janë përmbushur të gjithë elementët e krimin të veprimeve çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme), e ndëshkueshme sipas Nenit 5(i).

1249. Në lidhje me akuzën e shkatërrimit të objekteve fetare, Dhoma ka konkluduar se xhamia në Llashticë, fshat afër Zhegrës dhe Lladovë, u dëmtua rëndë nga ushtarët e UJ-së dhe vendësit nga Zhegra, disa prej të cilëve ishin me uniforma policie. Kjo ngjarje ndodhi gjatë sulmit mbi

popullatën civile të përshkruar më lart. Gjithashtu, Dhoma është bindur se në atë kohë xhamia nuk përdorej për qëllime ushtarake dhe se ajo u sulmua sepse ishte objekt fetar mysliman. Meqenëse keqbërësit e dogjën xhaminë, është e qartë se kishin qëllim ta dëmtonin dhe, rrjedhimisht vepruan me qëllime diskriminuese. Si pasojë Dhoma konkludon se janë përmbushur elementet e shkatërrimit ose dëmtimit të objekteve fetare si formë e përndjekjes, i ndëshkueshëm sipas Nenit 5(h) të Statutit.

12. Ferizaj

1250. Dhoma ka konkluduar se, me fillimin e bombardimeve të NATO-s, UJ-ja, MPB-ja, dhe forcat e armatosura të lidhura me to nisën një sulm kundër fshatrave përreth qytetit të Ferizajt, duke i detyruar fshatarët të largoheshin nga shtëpitë e tyre. Konkretisht, në fillim të prillit 1999, ata sulmuan fshatin Sojevë, duke u vënë zjarrin shtëpive, vranë civilë, dhe duke i dëbuar fshatarët e duke i detyruar të ecnin në këmbë deri në qytetin e Ferizajt. Më pas, më 8 prill, ata hynë në Mirosalë, duke shkaktuar largimin e njerëzve nga shtëpitë. Gjithashtu, më 5 prill, vullnetarët e UJ-së shkuan në Starasellë, ku vranë së paku tre vetë dhe krijuan atmosferë kërcënuese dhe si rezultat njerëzit u larguan me shumicë. Njerëzit nga këto fshatra fillimisht u shpërngulën në qytetin e Ferizajt e më pas prej andej në Maqedoni. Dhoma është bindur se këto ngjarje përbëjnë sulm mbi popullatën civile të këtyre fshatrave, se ky sulm u krye në mënyrë të gjerë dhe sistematike dhe se ishte pjesë e sulmit gjerësisht të përhapur dhe sistematik kundër civilëve shqiptarë kosovarë në së paku 13 komuna të Kosovës të përmendura më lart. Veprimet e forcave në fjalë ishin pjesë a sulmit më të gjerë kundër popullatës civile dhe autorët fizikë, të cilët bënë komente se shqiptarët kosovarë do të dërgoheshin në Shqipëri sepse nuk e kishin vendin në Kosovë, ishin pa dyshim të vetëdijshëm se ishin duke vepruar në kontekst të një sulmi të gjerë kundër popullatës kosovare shqiptare në fshatrat në fjalë.

1251. Siç është theksuar më lart, UJ-ja, MPB-ja, dhe forcat e armatosura të lidhura me to që vepronin në ato fshatra në atë kohë ose i urdhëruan drejtpërsëdrejti shqiptarët kosovarë të largoheshin nga shtëpitë ose shkaktuan ikjen e tyre me sjellje të dhunshme dhe kërcënuese. Dhoma thekson se nuk ekzistonte arsye për këtë shpërngulje masive të shqiptarëve kosovarë, të cilët ndodheshin në ato zona në mënyrë të ligjshme. Shumë prej tyre u orientuan qëllimisht drejt kufirit e më tej në Maqedoni.

1252. Rrjedhimisht, Dhoma konkludon se janë përmbushur të gjithë elementët e dëbimit si krim kundër njerëzimit, i ndëshkueshëm sipas Nenit 5(d) të Statutit. Duke arsyetuar në mënyrë të ngjashme dhe duke marrë parasysh dëshmitë e dëshmitarëve të ndryshëm për dhunën, frikën, dhe kërcënimet që UJ-ja, MPB-ja, dhe forcat e tjera ushtruan sistematikisht në fshatrat e përmendura,

Dhoma është bindur se gjithashtu janë përmbushur elementet e krimit të veprave të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme), e ndëshkueshme sipas Nenit5(i).

13. Kaçaniku

a. Kotalina

1253. Dhoma ka konkluduar se, në fillim të marsit 1999, para nisjes së fushatës së bombardimeve të NATO-s, forcat e UJ-së dhe të MPB-së sulmuan dhe pjesërisht dogjën fshatin Kotlinë në komunën e Kaçanikut. Kotalina u sulmua përsëri më 24 mars 1999, kur forcat e UJ-së dhe të MPB-së e granatuan e pastaj e rrethuan fshatin, duke shkaktuar largimin e banorëve. Pas kësaj, shtëpitë e fshatit u plaçkitën dhe iu vu zjarri dhe një grup kryesisht me gra dhe fëmijë u fut në kamionë, të cilët i çuan drejt qytetit të Kaçanikut. Pas sulmit mbi fshat të tjerët që i shpëtuan kapjes nga frika ikën në Maqedoni. Dhoma është bindur se këto ngjarje përbënin sulm kundër popullatës civile të zonës, se ky sulm u krye në mënyrë të gjerë dhe sistematike, dhe se ishte pjesë e sulmit gjerësisht të përhapur dhe sistematik kundër civilëve shqiptarë kosovarë në së paku 13 komuna të Kosovës. Veprimet e forcave të përfshira ishin pjesë e sulmit më të gjerë kundër popullatës civile, dhe autorët fizikë, ose personat nën urdhrat e të cilëve vepronin, ishin të vetëdijshëm se ishin duke vepruar në kontekst të sulmit më të gjerë kund popullatës shqiptare kosovare në atë rajon.

1254. Siç është theksuar më lart, është e qartë se forcat e UJ-së dhe të MPB-së shkaktuan largimin e banorëve të Kotlinës. Fakti i zjarrvënies shtëpive dhe keqtrajtimit të njerëzve tregon se qëllimi i autorëve fizikë ishte që banorët shqiptarë kosovarë të Kotlinës të shkonin në Maqedoni, gjë që shumë prej tyre e bënë. Gjithashtu, nuk ekzistonte arsye për këtë shpërngulje të shqiptarëve kosovarë, të cilët ndodheshin në atë zonë në mënyrë të ligjshme

1255. Rrjedhimisht, Dhoma konkludon se janë përmbushur të gjithë elementët e dëbimit si krim kundër njerëzimit, i ndëshkueshëm sipas Nenit 5(d) të Statutit. Duke arsyetuar në mënyrë të ngjashme dhe duke marrë parasysh dhunën, frikën, dhe kërcënimet që forcat e UJ-së, MPB-së ushtruan në komunë, Dhoma është bindur se janë përmbushur të gjithë elementët e krimit të veprimeve çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme), i ndëshkueshëm sipas Nenit 5(i).

b. Qyteti i Kaçanikut

1256. Dhoma gjithashtu konkludoi se më 27 mars 1999, forcat e UJ-së edhe të MPB-së hynë në qytetin e Kaçanikut dhe hapën zjarr kundër shtëpive. Të nesërmen, disa qindra banorë të qytetit u larguan nga shtëpitë nga frika prej forcave të policisë ose për shkak se ishin dëbuar drejtpërsëdrejti nga shtëpitë nga ana e policisë dhe më në fund kaluan kufirin për në Maqedoni. Dhoma është

bindur se këto ngjarje përbëjnë sulm kundër popullatës shqiptare kosovare të Kaçanikut, se ky sulm u krye në mënyrë të gjerë dhe sistematike dhe se ishte pjesë e sulmit të përhapur gjerësisht dhe sistematik në së paku 13 komuna të Kosovës të përmendura më lart. Veprimet e këtyre forcave ishin pjesë e sulmit më të gjerë kundër popullatës civile dhe autorët fizikë, ose ata që urdhëruan ato veprime, ishin të vetëdijshëm se po vepronin në kontekst të një sulmi më të madh.

1257. Siç është theksuar më lart, forcat e UJ-së dhe të MPB-së shkaktuan largimin e banorëve të Kaçanikut përmes akteve të dhunës dhe kërcënimit me qëllim që t'i dëbonin në Maqedoni, gjë të cilën shumë njerëz e bënë. Gjithashtu, nuk ekzistonin arsye për këtë shpërngulje të shqiptarëve kosovarë, të cilët ishin në atë zonë në mënyrë të ligjshme. Rrjedhimisht, Dhoma konkludon se gjithashtu janë përmbushur të gjithë elementët e dëbimit, sipas Nenit 5(d) të Statutit, dhe veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme), sipas Nenit 5(i), në lidhje me këto ngjarje.

c. Vataj

1258. Së fundi, siç është diskutuar më lart, Sejdi Lami dëshmoi se UÇK-ja ishte e pranishme në Vataj më 6 prill 1999, kur UJ-ja filloi granatimin. Më 13 prill, UJ-ja hapi zjarr në drejtim të Vatajt dhe pastaj hyri në fshat dhe në atë moment civilët e mbetur u larguan. Lami tregoi se forcat qëlluan mbi kokat e njerëzve që po largoheshin dhe shprehu mendimin se ata kërkonin pjesëtarë të UÇK-së. Lami nuk ishte dëshmitar i shkatërrimit të pronave civile në fshat, edhe pse kur u kthye në fshat në korrik 1999, pa se shtëpia e tij dhe shtëpitë e tjera ishin plaçkitur. Duke marrë parasysh se kjo ishte dëshmia e vetme e paraqitur nga Prokuroria në lidhje me sulmin në Vataj, Dhoma nuk është bindur se përbënte sulm kundër popullatës civile të atij fshati ose se kishte lidhje me një sulm më të gjerë në atë zonë, ose me sulmin gjerësisht të përhapur dhe sistematik kundër popullatës shqiptare kosovare në 13 komuna të Kosovës. Rrjedhimisht, në lidhje me Vatajn rrëzohen akuzat e dëbimit dhe zhvendosjes së dhunshme.

d. Lisnaja

1259. Dhoma konkludoi se më 25 maj 1999, UJ-ja së bashku me forcat e MPB-së sulmuan fshatin Lisnajë duke i detyruar banorët të largoheshin nga fshati, fillimisht për në fshatrat e tjera dhe pastaj për në Maqedoni. Gjatë këtij sulmi u vranë së paku dy civilë. Dhoma është bindur se këto ngjarje përbënin sulm kundër fshatit, se ky ishte sulm kundër popullatës civile shqiptare kosovare të fshatit, dhe se u krye gjerësisht dhe sistematikisht si pjesë e sulmit më të gjerë kundër civilëve shqiptarë kosovarë në së paku 13 komuna të Kosovës. Forcat e UJ-së dhe të MPB-së të përfshira në këtë sulm, ose urdhëruesit e sulmit, ishin të vetëdijshëm se ishin duke vepruar në kontekst të sulmit më të gjerë kundër popullatës shqiptare kosovare.

1260. Siç është theksuar më lart, veprimet e forcave të UJ-së dhe të MPB-së shkaktuan ikjen e shqiptarëve kosovarë nga shtëpitë e tyre në Lisnajë nga frika e pasojave nëse do të qëndronin aty. Dhoma gjithashtu është bindur se këto force synonin t'i dëbonin banorët e Lisnajës për në Maqedoni. Gjithashtu, nuk ekzistonte arsye për këtë shpërngulje të shqiptarëve kosovarë, të cilët ishin në Lisnajë ligjshmërisht.

1261. Rrjedhimisht, duke marrë parasysh rrethanat e tmerrshme e largimit të detyruar të viktimave, Dhoma Gjyqësore konkludon se janë përmbushur të gjithë elementët e dëbimit si krim kundër njerëzimit, i ndëshkueshëm sipas Nenit 5(d) të Statutit, si dhe elementet e veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme), e ndëshkueshme sipas Nenit 5(i).

1262. Në lidhje me dy shqiptarë kosovarë të cilët u vranë gjatë sulmit në Lisnajë, meqenëse autorët fizikë shkaktuan qëllimisht vdekjen e këtyre dy njerëzve, Dhoma konkludon se janë përmbushur të gjithë elementët e vrasjes si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës, e ndëshkueshme sipas Nenit 3 të Statutit. Gjithashtu, duke marrë parasysh se këto vrasje u kryen në kontekst të sulmit më të gjerë dhe sistematik kundër popullatës civile, se veprimet e autorëve fizikë ishin pjesë e këtij sulmi, dhe se autorët fizikë, ose urdhëruesit e veprimeve, e dinin këtë, Dhoma është bindur se janë përmbushur të gjithë elementët e vrasjes si krim kundër njerëzimit, e ndëshkueshme sipas Nenit 5(a). Së fundi në kryerjen e vrasjeve, autorët fizikë i kishin vënë në shënjestër shqiptarët kosovarë për shkak të përkatësisë së tyre etnike. Sipas mendimit të Dhomës, autorët fizikë i vranë shqiptarët kosovarë për shkak të kombësisë së tyre. Rrjedhimisht, janë përmbushur të gjithë elementët e vrasjes si formë e përndjekjes, që është krim kundër njerëzimit, i ndëshkueshëm sipas Nenit 5(h) të Statutit.

P. PËR PJEKJET PËR FSHEHJEN E KRIMEVE

1263. Prokuroria argumenton se fshehja e kufomave të shqiptarëve kosovarë të vrarë gjatë zbatimit të planit të përbashkët kriminal është dëshmi plotësuese për ekzistencën e kësaj ndërmarrjeje të përbashkët kriminale.²⁸⁵² Kjo fshehje thuhet se ishte planifikuar në nivelet e larta nga disa pjesëtarë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, konkretisht, Slobodan Millosheviqi, Vllastimir Gjorgjeviqi, Vllajko Stojilkoviqi, Radomir Markoviqi, Dragan Iliqi, Sreten Llukiqi, dhe Nikolla Shainoviqi.²⁸⁵³ Kufomat u zhvarrosën nga varret e përbashkëta dhe varret individuale në Kosovë dhe u transportuan në pjesët e tjera të Serbisë, ku u fshehën në vende të ndryshme, të cilat

²⁸⁵² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 278.

²⁸⁵³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 279–281.

ishin nën juridiksionin e MPB-së dhe të UJ-së.²⁸⁵⁴ Prokuroria gjithashtu pretendon se provat e shumta në lidhje me zhvarrosjen e këtyre kufomave, duke përfshirë identifikimin me ADN dhe rezultatet mjeko-ligjore në lidhje me shkakun e vdekjes, çojnë pashmangshëm në përfundimin se këta persona u vranë gjatë zbatimit të planit të përbashkët kriminal.²⁸⁵⁵

1264. Mbrojtja pranon pak a shumë faktin e fshehjes së kufomave, por e kundërshton hipotezën e Prokurorisë për arsye të ndryshme. Për shembull, ushtarakët e akuzuar (Pavkoviqi, Ojdaniqi, dhe Llazareviqi) pretendojnë se UJ-ja nuk u implikua në këtë çështje dhe se, jo vetëm që nuk tentoi t'i fshihte krimet, por u përpoq t'i zbulonte ato.²⁸⁵⁶ Mbrojtja e Llukiqit kundërshton pretendimin e Prokurorisë se kufomat e gjetura ishin të vrarë si rezultat i zbatimit të planit të përbashkët kriminal, dhe pretendon se vrasja e tyre ishte rezultat i pjesëmarrjes në UÇK dhe pasojave të sulmeve të UÇK-së dhe të luftimeve të ligjshme të forcave të RFJ-së dhe Serbisë kundër UÇK-së.²⁸⁵⁷ Mbrojtja e Llukiqit argumenton se Llukiqi i hetoi në tërësi të gjitha krimet e kryera nga MPB-ja në Kosovë dhe rrjedhimisht nuk është e mundshme të ketë qenë pjesëmarrës në krime të tilla apo në ndonjë përpjekje për t'i fshehur.²⁸⁵⁸ Konkretisht, Llukiqi krijoi grupin e punës i cili zbuloi pamjen e plotë të "transportimit klandestin të kufomave nga Kosova-Metohija nga pjesëtarët e MPB-së serbe në disa vende brenda Serbisë."²⁸⁵⁹

1265. Dhoma i ka analizuar me kujdes dëshmitë e paraqitura nga palët në lidhje me këtë çështje dhe paraqet provat e mëposhtme, duke filluar nga vendvarrimet në Kosovë, transportimin e kufomave të gjetura në to, dhe hetimin e mëvonshëm të kryer nga MPB-ja dhe ekipe të ndryshme kriminaliste. Dhoma thekson se disa nga dëshmitarët e këtyre ngjarjeve ishin të shqetësuar për sigurinë e tyre personale. Për këtë arsye, Dhoma e ka parë të arsyeshme që japë më pak hollësi në lidhje me disa çështje më qëllim që të minimizojë rrezikun për sigurinë e dëshmitarëve. Gjithsesi janë përfshirë referencat për materiale gjyqësore konfidenciale në rastet kur nuk ka rrezik për dëshmitarët. Sidoqoftë, është dashur të lihen jashtë disa referenca në lidhje me dëshmitë e rëndësishme. Natyrisht, janë shqyrtuar të gjitha dëshmitë që kanë lidhje me çështjen.

²⁸⁵⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 282–287.

²⁸⁵⁵ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 288.

²⁸⁵⁶ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 215–217; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 289–290; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 692–696.

²⁸⁵⁷ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 597–602.

²⁸⁵⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 1485.

²⁸⁵⁹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 1471.

1. Zhvarrosja i kufomave

1266. Dhoma dëgjoi dëshmitë e dy dëshmitarëve, konkretisht, K72 dhe Ali Gjogaj, të cilët morën pjesë në zhvarrosjen e kufomave nga varret e përbashkëta dhe varret individuale në Kosovë. K72-shi banonte në Gjakovë, ku punonte si makinist ekskavatori. Ai dëshmoi për pjesëmarrjen e tij në zhvarrosjen e kufomave në tri vende të ndryshme në komunën e Gjakovës, konkretisht, ura e Bistrzhinit, varreza e Brekocit që gjendet në dalje të qytetit të Gjakovës, dhe në fshatin Guskë, si dhe në pyllin e afërt.

1267. K72-shi dëshmoi se, gjatë bombardimeve të NATO-s e urdhëruan të punonte si makinist ekskavatori për UJ-në, MPB-në, dhe mbrojtjen civile. Ai hapi llogore për UJ-në, për të maskuar automjetet ushtarake. Ai paguhej me mëditje në kazermën e UJ-së, por nuk i jepnin dëshmi pagese. Në të njëjtën kohë, K72-shi punonte edhe për MPB-në, gjithashtu me mëditje, të cilën e merrte nga stacioni i MPB-së në Gjakovë. Se punonte për MPB-në, apo UJ-në varej nga fakti se kush e merrte i pari në ditë të caktuar.²⁸⁶⁰

1268. Për punën për MPB-në, K72-në e merrnin nga shtëpia e tij me makinë me apo pa shenja policie dhe e dërgonin te ekskavatori i tij. Shoferët të cilët vinin për ta marrë kishin uniforma të kaltra kamuflimi.²⁸⁶¹ Një ditë në prill 1999, rreth orës 09:00, K72-in e mori një polic i panjohur me uniformë të kaltër kamuflimi për të kryer një "punë delikate" pa dhënë hollësi të tjera. Ata morën ekskavatorin e K72-it dhe shkuan në zonën e urës së Bistrzhinit, e cila gjendet në lindje të qytetit të Gjakovës.²⁸⁶²

1269. Kur mbërritën, K72 pa 10-15 policë që ruanin zonën në të cilën duhej të gërmonte. Kur filloi, ai e kuptoi nga kutërbimi se ishte duke zhvarrosur kufoma. Ai pa krahë dhe koka duke dalë jashtë kur goditeshin me ekskavator. Si rezultat, atij i erdhi për të vjellë. Kur pyeti një polic se a kishte shumë punë për të bërë, përgjigja ishte se ishin 100 ose 120 kufoma që duhej të zhvarroseshin.²⁸⁶³ K72-shi vuri re se kufomat ende mund të njiheshin dhe se ishin të gjithë meshkuj me rroba civile. Gjithashtu ai pa 4-6 vetë me rroba civile të cilët ndihmonin në ngarkimin e kufomave në dy kamionë pa shenja identifikuese.²⁸⁶⁴ Njëri kamion ishte kamion-frigorifer, tjetri ishte kamion i zakonshëm dhe të dy ishin me madhësi të përafërt. Kur u pyet se a ishte kamioni-

²⁸⁶⁰ K72, T. 5318–5320 (25 tetor 2006), T. 5322–5323, 5336–5341 (26 tetor 2006), P2551 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 tetor 2005), para. 10–12.

²⁸⁶¹ K72, T. 5323 (26 tetor 2006).

²⁸⁶² K72, T. 5323–5324, 5338–5339 (26 tetor 2006), P2551 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 tetor 2005), para. 13.

²⁸⁶³ K72, T. 5325, 5339 (26 tetor 2006), P2551 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 tetor 2005), para. 13–14.

²⁸⁶⁴ K72, T. 5326 (26 tetor 2006), P2551 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 tetor 2005), para. 13–15.

frigorifer i njëjti që u gjet më vonë në lumin Danub, siç përshkruhet më poshtë, K72-shi shpjegoi se ishin të ngjashëm, por nuk ishte në gjendje të thoshte nëse ishte i njëjti.²⁸⁶⁵

1270. Rreth një muaj më vonë, rreth dy-tri javë para përfundimit të fushatës së NATO-s, policia e mori një mbrëmje K72-shin në shtëpi. Ai mori ekskavatorin dhe shkoi pas makinës së policisë, këtë herë deri në varrezën publike në Brekoc.²⁸⁶⁶ Kur K72-shi hyri në varrezë, ai pa disa makina dhe rreth 20 police me uniforma të kaltra kamuflimi. Atij i treguan varret individuale që duhej t'i hapte. Disa nga këto varre ishin të shënuara me hunj druri me emër të shkruar mbi to. Gati të gjithë emrat ishin shqiptarë.²⁸⁶⁷ Jashtë varrezës ishte një kamion i madh, dy herë më i madh se kamioni-frigorifer që ishte përdorur në Bistrazhin. Gjithashtu, të pranishëm ishin po ata katër deri në gjashtë persona, të cilët përsëri ndihmuan në ngarkimin e kufomave në kamion.²⁸⁶⁸ Në atë vend u zhvarrosën më shumë kufoma se në Bistrazhin. K72-shi pa se të gjithë ishin meshkuj me rroba civile. Ai vuri re vrima plumbash në disa nga kufomat dhe se një prej tyre i kishte shkronjat "UÇK" të rruara në flokët e tij.²⁸⁶⁹

1271. Pak kohë më pas, K72-shi u dërgua në Guskë që të zhvarroste kufoma të tjera. Sikurse edhe në rastet e mëparshme, ai u shoqërua nga policia deri në vend dhe përsëri ndodhi në mbrëmje. me të mbërritur atje, ai hapi 10-12 varre. Zona ruhej nga 10-15 policë me uniforma të kaltra kamuflimi. Kufomat u ngarkuan në një kamion të vogël që u largua. U zhvarrosën edhe kufoma të tjera nga pjesë të ndryshme të një pylli të afërt nëpër të cilin ishin të shpërndara. Viktimat ishin të gjitha meshkuj me rroba civile. K72-shi vuri re hematoma në disa prej tyre. Ai nuk mbante në mend se sa kufoma kishte nxjerrë at! herë, por besonte se ishin më shumë se 10.²⁸⁷⁰ Gjatë zhvarrosjeve në Guskë, një polic iu afrua dhe i tha K72-shit që mos t'i tregonte askujt për këto se përndryshe do të vritej.²⁸⁷¹

1272. Puna e K72-shit në zhvarrosjen e kufomave zgjati 15- 20 ditë dhe përfunduar dikur në maj 1999. Të gjitha kufomat ishin meshkuj me rroba civile të moshave 30-50 vjeç. ishte operacion i madh operacion i madh dhe dukej i mirorganizuar, që sugjeron se ishte autorizuar në nivele të larta.²⁸⁷² K72-shi gjithashtu dëshmoi se nuk "mori pjesë në largimin e kufomave të shqiptarëve

²⁸⁶⁵ K72, T. 5326–5327 (26 tetor 2006).

²⁸⁶⁶ K72, T. 5328 (26 tetor 2006); IC86 (hartë e shënuar nga dëshmitari K72 që tregon vendndodhjen e Brekocit).

²⁸⁶⁷ K72, T. 5328–5329 (26 tetor 2006), P2551 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 tetor 2005), para. 16–17.

²⁸⁶⁸ K72, T. 5329–5330 (26 tetor 2006), P2551 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 tetor 2005), para. 17.

²⁸⁶⁹ K72, T. 5330–5332, 5343 (26 tetor 2006), P2551 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 tetor 2005), para. 17.

²⁸⁷⁰ K72, T. 5333–5334 (26 tetor 2006), P2551 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 tetor 2005), para. 19.

²⁸⁷¹ K72, T. 5334, 5342–5343 (26 tetor 2006), P2551 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 tetor 2005), para. 20.

²⁸⁷² K72, P2551 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 tetor 2005), para. 21–22.

kosovarë që ishin vrarë në Mejë dhe Korenicë në prill 1999²⁸⁷³ dhe se UJ-ja nuk i kërkoi asnjëherë që të zhvarroste kufoma.²⁸⁷⁴

1273. Mbrojtja e Llukiqit ftoi Radovan Zllatkoviçin, i cili në atë kohë punonte si inspektor në SPB-në e Gjakovës, për të përgënjeshtuar dëshminë e K72-shit. Zllatkoviçi mohoi ekzistencën e një varri të përbashkët në zonën e Bistrzhinit. Ai tha se kjo ishte hapësirë e madhe dhe e hapur afër kishës katolike dhe shtëpive private, ku çdo varr i përbashkët do të ishte pikasur lehtë, dhe shtoi se do të kishte qenë e pamundur për të bërë zhvarrosjen e përkruar nga K72-shi me makinerinë e zhurmshme, e cila do të duhej të ndriçohej fort gjatë bombardimeve të NATO-s. Zllatkoviçi gjithashtu tha se NATO-ja e bombardonte rregullisht zonën e urës së Bistrzhinit, dhe deklaroi se kufomat e civilëve të identifikuar u jepeshin familjeve, kurse kufomat e paidentifikuara varroseshin në një varrezë myslimane në qytetin e Gjakovës. Ai mohoi se policia kishte ndonjë informacion në lidhje me ekzistencën e varrit të përbashkët në atë vend.²⁸⁷⁵ Zllatkoviçi gjithashtu tha se ai nuk ishte në dijeni se K72-shi kishte kryer gërmim me makineri apo ndonjë punë tjetër për SPB-në e Gjakovës nga 1997 deri në maj 1999.²⁸⁷⁶

1274. Pasi shqyrtimit të kundërshtimeve ndaj dëshmisë së K72-shit të bëra nga Zllatkoviçi, Dhoma pranon dëshminë e K72-shit në këtë aspekt. Nga vlerësimi i të dy dëshmitarëve dhe duke kujtuar mënyrën e rrëfimit të ngjarjes, Dhoma e konsideron dëshminë e K72-shit bindëse dhe të besueshme. Besimi i Dhomës në dëshminë e tij nuk është lëkundur nga asgjë çfarë tha Zllatkoviçi. Sidoqoftë, të dy dëshmitë nuk janë tërësisht jopërputhëse.

1275. Ali Gjogaj ishte punëtor në ndërmarrjen për pastrim të quajtur "Higjiena" në Prizren. Ai dëshmoi për zhvarrosjet që kishte bërë në poligonin e qitjes në rrugën midis Suharekës dhe Prizrenit,²⁸⁷⁷ dhe gjithashtu në fshatin Pastasellë në komunën e Rahovecit. Dhoma e konsideron dëshminë e tij bindëse dhe të besueshme.

1276. Gjogaj dëshmoi se zhvarrosja në poligonin e qitjes jashtë Prizrenit ndodhi në prill 1999. Një mbrëmje, ka të ngjarë në dy javët e para pas fillimit të bombardimeve të NATO-s, dhe në një kohë jo të zakonshme, rreth orës 20:00, Budimir Spasiqi, shefi i Gjogajt, i shkoi në shtëpi së bashku me tre kolegë të tij. Sipas Gjogajt, Spasiqi kishte uniformë të gjelbër kamuflimi të UJ-së.²⁸⁷⁸ Ata i thanë

²⁸⁷³ K72, P2551 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 tetor 2005), para. 26.

²⁸⁷⁴ K72, P2551 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 tetor 2005), para. 27.

²⁸⁷⁵ Radovan Zllatkoviçi, 6D1627 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 prill 2008), para. 37.

²⁸⁷⁶ Radovan Zllatkoviçi, 6D1627 (deklarata e dëshmitarit e datës 13 prill 2008), para. 36.

²⁸⁷⁷ P120 (fotografi të poligonit të qitjes jashtë Prizrenit).

²⁸⁷⁸ Ali Gjogaj, T. 3726–3729 (21 shtator 2006), P2317 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 qershor 2000), f. 2.

Gjogajt të shkonte me ta dhe më në fund shkuan me makinë në poligonin e qitjes afër Prizrenit. Kur mbërritën atje, Gjogaj pa dy ekskavatorë që punonin në dy vende të ndryshme, tre kamionë, dhe katër ose pesë Pinzgauerë policie. Ai gjithashtu pa disa policë të veshur me uniforma të kaltra kamuflimi, por nuk i njohu.²⁸⁷⁹

1277. Kur u pyet nga Mbrojtja se kur kishte dhënë deklaratë për prokurorin e Beogradit për krime lufte,²⁸⁸⁰ për çfarë arsyeje nuk e përmendi fare faktin se Spasiqi kishte uniformë të UJ-së, Gjogaj u përgjigj se nuk u pyet asnjëherë për atë pikë. Sidoqoftë, ai pranoi se uniforma nuk do të thotë detyrimisht se Spasiqi ishte ushtar i UJ-së, duke marrë parasysh se shumë civilë në atë zonë mbanin uniforma të vjetra ushtarake në atë kohë.²⁸⁸¹ Vetë Spasiqi nuk u ftua të dëshmonte. Duke marrë parasysh pranimin e Gjogajt gjatë pyetjeve nga Mbrojtja, si dhe faktin se ai nuk e kishte përmendur uniformën e UJ-së në raste e mëhershme dhe se uniformat e gjelbra përdorëshin në atë kohë edhe nga PJP-ja, Dhoma gjykon se kjo nuk mjafton për të konkluduar se UJ-ja ishte e përfshirë në këtë operacion.

1278. Më pas Spasiqi i urdhëroi Gjogajn dhe tre burrat e tjerë që të punonin në njërin nga vendet dhe të ngarkonin kufomat e varrosura atje në njërin nga kamionët në dispozicion. Ata kishin në dispozicion një ekskavator, të cilin e drejtonte një ish-punëtor i ndërmarrjes *Higjiëna* i cili kishte uniformë të gjelbër kamuflimi dhe armë automatike.²⁸⁸² Ai gërmoi rreth dy metra derisa mbërriti te kufomat, të cilët pastaj Gjogaj dhe kolegët e tij i ngarkuan në kamion.²⁸⁸³ Gjogaj vlerësoi se nga ky varr i përbashkët u zhvarrosën rreth 80-90 kufoma. Të gjitha viktimat kishin rroba civile dhe ishin burra, gra, dhe shtatë ose tetë fëmijë. Sidoqoftë, ai nuk pa plagë në kufoma e as nuk njohu ndonjë nga viktimat. Ai vlerësoi se ata ishin varrosur atje para dy javësh.²⁸⁸⁴

1279. Ekskavatori tjetër punonte rreth 20 metra larg varrit të përbashkët të Gjogajt. Atje e bënë punën pjesëtarë të policisë e jo punonjësit e ndërmarrjes *Higjiëna*. Gjogaj pa burra me uniforma të

²⁸⁷⁹ Ali Gjogaj, T. 3729–3730, 3734–3735, 3739–3740 (21 shtator 2006), P2317 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 qershor 2000), f. 2; IC42 (fotografi e shënuar nga Gjogaj që tregon uniformat e kaltra të kamuflimit që i kishin pasur të veshura policët që pa në poligonin e qitjes); IC43 (fotografi e shënuar nga Gjogaj që tregon uniformat e kaltra të kamuflimit që i kishin pasur të veshura policët që pa në poligonin e qitjes). Gjatë pyetjeve nga Mbrojtja, Gjogaj shpjegoi se poligoni i qitjes është një hapësirë e madhe e hapur ose lëndinë. Ali Gjogaj, T. 3750–3751 (22 shtator 2006).

²⁸⁸⁰ 4D21 (deklarata e Ali Gjogajt dhënë Gjykatës së Posaçme të Beogradit).

²⁸⁸¹ Ali Gjogaj, T. 3743–3750 (22 shtator 2006).

²⁸⁸² Ali Gjogaj, T. 3728–3729 (21 shtator 2006), P2317 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 qershor 2000), f. 3.

²⁸⁸³ Ali Gjogaj, T. 3735–3736 (21 shtator 2006), P2317 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 qershor 2000), f. 3.

²⁸⁸⁴ Ali Gjogaj, T. 3736–3737 (21 shtator 2006), P2317 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 qershor 2000), f. 3.

kaltra kamuflimi duke zhgroposur kufomat dhe duke i ngarkuar në një kamion-frigorifer tjetër, i cili ishte i njëjtë me atë që përdorte ai. Sipas tij, ishin më shumë se 30 kufoma.²⁸⁸⁵

1280. Dhoma thekson këtu se është vërtetuar se kufomat e anëtarëve të familjes Berisha, përfshirë edhe disa gra e fëmijë, u transportuan në Prizren pas vrasjeve në Suharekë më 26 mars 1999.²⁸⁸⁶ Dhoma gjithashtu kujton dëshminë e Hysni Berishës, i cili dëshmoi se, në gusht 1999, shoqëroi një ekip kriminalist britanik, i cili vizitoi vendndodhjen e varrit të përbashkët në poligonin e qitjes. Atje, ata gjetën disa rroba, këpucë, dhe sende të tjera të anëtarëve të familjes Berisha të vrarë në qytetin e Suharekës më 26 mars 1999, siç është përshkruar më lart.²⁸⁸⁷ Rrjedhimisht, ka mjaft të ngjarë që Berishët të kenë qenë midis kufomave të zhvarrosura nga Gjogaj dhe të tjerët në atë vend.

1281. Pasi përfundimit të punës Gjogaj dhe burrat e tjerë u urdhëruan të hipnin në kamionin e tretë frigorifer dhe u dërguan në depozitën e plehrave në anën tjetër të rrugës kryesore për në Suharekë. Njëri nga ekskavatorët tashmë ndodhej atje duke gërmuar një gropë tjetër, e cila ishte rreth tri metra a thellë dhe dy metra e gjatë dhe e gjerë. Kufomat u zbuluan në thellësi prej një metër e gjysmë. Përsëri, të gjitha ishin me rroba civile dhe kishte burra e gra, por këtë herë nuk kishte fëmijë. Ai vlerësoi se nga ajo gropë zhvarrosën rreth 20 kufoma. Gjogaj dhe të tjerët e mbaruan punën rreth orës 04:00 dhe Spasiqi i ktheu në shtëpi me makinë.²⁸⁸⁸

1282. Pas kësaj ngjarjeje, Gjogaj mori pjesë në një zhvarrim tjetër në Pastasellë, në komunën e Rahovecit. Sidoqoftë, këtë herë rrethanat ishin të ndryshme, që tregonin për një operacion më legjitim. Për shembull, ndryshe nga rastet e tjera, Gjogaj ishte së bashku me 15 punëtorë të ndërmarrjes së tij, ata shoqëroheshin nga policë, ushtarë të UJ-së ishin të pranishëm në vendngjarje, zhvarrosjet u bënë gjatë ditës, kufomat e zhvarrosura ndodheshin në 90 varre individuale dhe u fotografuan dhe u futën në thasë kufomash e pastaj u dërguan në spitalin e Prizrenit ku u ekzaminuan dhe në fund u dërguan në morgun e Prishtinës. Një roje në morg i tha Gjogajt se "gjykata i kishte kërkuar policisë në Prizren që t'i ekzaminonte kufomat," ku në fund u kryen edhe autopsitë. Më pas, kufomat u rivarrosën në varre individuale në Prizren, Rahovec, Xërxë, dhe Dushanovë.²⁸⁸⁹ rrjedhimisht duket se shërbimet e Gjogajt u përdorën si për rivarrosje ilegale, po ashtu edhe për pastrim të ligjshëm të terrenit.

²⁸⁸⁵ Ali Gjogaj, T. 3735, 3738 (21 shtator 2006), P2317 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 qershor 2000), f. 3.

²⁸⁸⁶ *Shih* Pjesën VII.F.

²⁸⁸⁷ Hysni Berisha, P2282 (deklarata e dëshmitarit e datës 20 gusht 2001), f. 8–9.

²⁸⁸⁸ Ali Gjogaj, T. 3737 (21 shtator 2006), P2317 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 qershor 2000), f. 4.

²⁸⁸⁹ Ali Gjogaj, T. 3752–3757 (22 shtator 2006), P2317 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 mars 2000), f. 2–7, dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 16–17, P2318 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 7392–7394, 7396–7411. Gvozden Gagiqi, i cili në atë kohë kryesonte degën e MPB-së kundër vrasjeve dhe

2. Transporti dhe rivarrosja i kufomave

1283. Dhoma dëgjoi disa dëshmitarë në lidhje me mënyrën e transportimit të fshehtë të kufomave në pjesë të ndryshme të Serbisë dhe varrosjen në tri vende të ndryshme atje. Dhoma gjithashtu dëgjoi se si ky operacion i fshehtë për pak dështoi kur një nga kamionët që transportonte kufoma përfundoi në lumin Danub dhe si rezultat më shumë njerëz u implikuan në ruajtjen e sekretit. Dëshmitë e këtyre dëshmitarëve ishin përgjithësisht përputhëse, të cilat jepen më poshtë.

a. Incidenti i lumit Danub

1284. Në vitin 1999, Boshko Radojkoviç punonte në degën e policisë për krime në stacionin e policisë në Klladovë, qytet në Serbinë lindore.²⁸⁹⁰ Më 5 prill 1999,²⁸⁹¹ ai u thirr në vend në lumin Danub afër fshatit Tekija pasi një peshkatar kishte raportuar se në ujë gjendej një arkë e madhe që i ngjante pjesës së pasme së një kamioni. Radojkoviç shkoi në vendin e ngjarjes me zhytësin Zhivojin Gjorgjeviç, i cili konfirmoi se bëhej fjalë për kamion, se në kabinën e tij nuk kishte kufoma dhe as shofer ose pasagjer, dhe se në pedalën e gazit ishte vendosur një gur i madh.²⁸⁹² Radojkoviç pruri një vinç për ta nxjerrë kamionin dhe për ta hetuar. Sidoqoftë, kamionin mundën ta nxirrin vetëm pjesërisht sepse vinçi ishte shumë i vogël. Njerëzit u larguan nga vendngjarja gjatë natës pasi e shënuan qartë me pluskues dhe pasi e lidhën kamionin pas një peme. Radojkoviç u kthye në stacionin policor. Një koleg e tij i dërgoi mesazh SPB-së në Bor se një qytetar kishte raportuar atë që kishte zbuluar në lumë, se me gjasë ishte aksident trafiku, se një ekip ishte caktuar për të hetuar, dhe se puna po vazhdonte.²⁸⁹³

1285. Të nesërmen herët në mëngjes, Radojkoviç dhe ekipi i tij, gjithsej rreth 15 njerëz, u kthyen te vendi. Rreth mesditës, ata arritën të nxirrin nga uji rimorkionin e kamionit, por jo tërë kamionin.

krimeve seksuale, konfirmoi se shkoi në Pastasellë që të hetonte vendvarrimin dhe të siguronte logjistikën e nevojshme për specialistët kriminalistë dhe mjekët. Sipas Gagiçit, procedurat që u ndoqën gjatë këtij hetimi ishin të rregullta dhe në pajtim me Ligjin e Procedurës Penale (ZKP) të RFJ-së. Si rezultat u bënë raporte në lidhje me viktimat individuale si dhe një raport i vetëm që përmbledhte veprimet e të gjithë hetuesve. Gvozden Gagiç, T. 24442–24444 (18 mars 2008).

²⁸⁹⁰ Boshko Radojkoviç, T. 7432 (27 nëntor 2006).

²⁸⁹¹ Radojkoviç dëshmoi se kjo ndodhi më 4 prill 1999. *Shih* Boshko Radojkoviç, T. 7433 (27 nëntor 2006). Sidoqoftë, ai ishte pak i ngatërruar sa i përket datave në përgjithësi dhe në deklaratën e tij për grupin e punës së MPB-së kishte thënë se kamioni doli në sipërfaqe më 5 prill dhe se e kishte pikasur një polic në rrugë më 4 prill. Një tjetër dëshmitar i prokurorisë, i cili ishte edhe eprori i Radojkoviçit, Çasllav Golluboviç dëshmoi se kjo ndodhi më 5 prill dhe ishte përgjithësisht më bindës sa i përket datave në lidhje me këtë incident. *Shih* Çasllav Golluboviç, T. 7401–7402 (27 nëntor 2007).

²⁸⁹² Boshko Radojkoviç, T. 7432–7433 (27 nëntor 2006).

²⁸⁹³ Boshko Radojkoviç, T. 7434–7435 (27 nëntor 2006); P573 (Shënimet e Grupit të Punës të intervistës me Boshko Radojkoviçin), f. 1. *Shih gjithashtu* Çasllav Golluboviç, T. 7402 (27 nëntor 2006).

Gjatë nxjerrjes, Radojkoviqi bëri fotografi.²⁸⁹⁴ Ai vuri re se kamioni nuk kishte targa dhe se dera e rimorkios ishte e thyer në këndin e poshtëm të djathtë. Dy këmbë dhe një krah kishin dalë nga pjesa e thyer e derës.²⁸⁹⁵ Kur më në fund e hapën derën, Radojkoviqi pa një piring kufomash në rimorkio. Në atë moment ishin të pranishëm zyrtarë të ndryshëm, duke përfshirë edhe shefin e njësisë së parandalimit të krimeve të Klladovës, zëvendësprokurorin komunal, gjykatësin hetues nga Gjykata e Qarkut të Klladovës, një teknik i kriminalistikës, dhe një patolog nga qendra mjekësore në Klladovë. Gjykatësi hetues u informua se çfarë kishte në kamion dhe tha Radojkoviqit që të informonte Gjykatën e Qarkut në Negotin sepse ishte në juridiksionin e saj.²⁸⁹⁶

1286. Meqë gjykatësi hetues refuzoi të bënte hetime,²⁸⁹⁷ Radojkoviqi i dërgoi mesazh SPB-së së Borit, duke i informuar eprorët për ngjarjet që kishin ndodhur atë pasdite. Gjithashtu ai informoi shefin e stacionit policor në Klladovë, Vukashin Sperliqin, për zbulimin.²⁸⁹⁸ Atë mbrëmje u mbajt një mbledhje në stacionin policor, në të cilën mori pjesë Sperliqi dhe ku u diskutua se si të parandalohej rrjedhja e informatave. U ra dakord që mbishkrimi në kamion të mbulohej me bojë dhe që kamionit t'i viheshin targa të Borit për të fshehur faktin se kamioni ishte nga Prizreni. Gjithashtu, Radojkoviqi propozoi që njerëzve t'u thuhej se kufomat kurdë që kishin kaluar ilegalisht në Serbi nga Rumania.²⁸⁹⁹ Pas mbledhjes, Radojkoviqi shkoi në vendngjarje për të maskuar kamionin siç ishin marrë vesh.²⁹⁰⁰

1287. Të nesërmen më 7 prill 1999 sollën një vinç më të madh dhe kamioni u nxor. Shefi i stacionit policor të Klladovës nuk erdhi, por dërgoi gjashtë ose shtatë arkivole. Rreth orës 14:00 ose 15:00, Radojkoviqi i telefonoi Toma Milladinoviqit në SPB-në e Borit për t'i pyetur se a ishin në dijeni për çfarë kishte ndodhur. Pas pak, ai mori udhëzim nga shefi i tij në Klladovë që të ndërpriteshin të gjitha punët dhe të sigurohej zona. Ai u kthye në stacion policor dhe priti për shefin e SPB-së së Borit, Çasllav Golluboviqin, një tjetër dëshmitar në këtë çështje.²⁹⁰¹

²⁸⁹⁴ Boshko Radojkoviq, T. 7435–7436 (27 nëntor 2006); P594 (fotografi e bërë nga Radojkoviqi e kamionit të nxjerrë pjesërisht).

²⁸⁹⁵ Boshko Radojkoviq, T. 7437–7438 (27 nëntor 2006); P596 (fotografi e bërë nga Radojkoviqi ku shihen këmbë dhe një krah të dala); IC113 (fotografia P596 e shënuar nga Radojkoviqi ku shihet një këmbë e dalë).

²⁸⁹⁶ Boshko Radojkoviq, T. 7438–7439 (27 nëntor 2006); *Shih gjithashtu* Çasllav Golluboviq, T. 7402–7403 (27 nëntor 2006).

²⁸⁹⁷ Çasllav Golluboviq, T. 7404–7405 (27 nëntor 2006).

²⁸⁹⁸ Boshko Radojkoviq, T. 7439–7440 (27 nëntor 2006).

²⁸⁹⁹ Boshko Radojkoviq, T. 7440–7442 (27 nëntor 2006); P573 (Shënimet e Grupit të Punës të intervistës me Boshko Radojkoviqin), f. 4.

²⁹⁰⁰ Boshko Radojkoviq, T. 7441–7443 (27 nëntor 2006); P600 (fotografi në të cilën shihet kabina e kamionit); P603 (fotografi në të cilën shihen targat e kamionit).

²⁹⁰¹ Boshko Radojkoviq, T. 7443–7446 (27 nëntor 2006).

1288. Dëshmia e Radojkoviçit u konfirmua nga Golluboviçiqi, i cili dëshmoi se mori një telefonatë nga Toma Milladinoviçiqi, i cili i tha se kishte marrë mesazh se në Danub ishte gjetur një kamion i mbushur me kufoma. Ata të dy shkuan në stacionin policor të Klladovës²⁹⁰² ku u mbajt një mbledhje, në të cilën morën pjesë shefi i stacionit policor në Klladovë, Sperliçiqi, prokurori komunal nga Klladovë, gjykatësi hetues, kryetari i gjykatës që merrej me hetimet, përfaqësuesi i RDB-së, dy burra nga DPB-ja e Klladovës, dhe një komandant nga kalimi i afërt kufitar me Rumaninë.²⁹⁰³ Radojkoviçiqi shkoi në mbledhje disa orë më vonë dhe i raportoi Golluboviçit për situatën në vendngjarje.²⁹⁰⁴ Midis të tjerash, Golluboviçit iu tha se kufomat ishin meshkuj dhe femra, se femrat kishin dimi dhe se kishte shumë të ngjarë të ishte kamion i Prizrenit.²⁹⁰⁵

1289. Petar Dujkoviçiqi, i cili në atë kohë ishte shef i Administratës së Policisë Kufitare në MPB, dhe pas bombardimeve të NATO-s u bë zëvendës i të Akuzuarit Llukiq, dëshmoi se u informua për mbledhjen nga njëri prej pjesëmarrësve, Branisllav Mitroviçiqi, i cili ishte komandant i stacionit policor kufitar të Klladovës.²⁹⁰⁶ Ai mohoi se Mitroviçiqi i kishte thënë se kamioni përmbante kufoma, duke thënë se këtë të dhënë e dëgjoi për herë të parë dikur në vitin 2001. Ai sqaroi se nga biseda me Mitroviçiqin, ai mësoi se disa njerëz kishin vdekur pasi kamioni kishte rrëshqitur nga rruga dhe kishte përfunduar në Danub. Më tej ai shpjegoi se nuk ishte marrë asnjëherë në pyetje nga grupi i punës i MPB-së në vitin 2001 që hetonte këto ngjarje në atë kohë.²⁹⁰⁷

1290. Pasi ishte informuar, Golluboviçiqi i telefonoi eprorit të tij në MPB, Vllastimir Gjorgjeviçit, duke kërkuar udhëzime se si të vepronte më tej.²⁹⁰⁸ Sipas Golluboviçit, Gjorgjeviçiqi u befusua dhe i tha se do t'i telefononte pasi të konsultohet me ministrin e Brendshëm, Vllajko Stojilkoviçiq. Pesëmbëdhjetë minuta më vonë, Gjorgjeviçiqi i telefonoi Golluboviçit dhe i tha që të provonte t'i mblidhte të gjitha kufomat dhe t'i varroste në Klladovë. Sipas Golluboviçit, në atë moment mendohej se ishin vetëm 30 kufoma në kamion.²⁹⁰⁹ Më tej, Golluboviçiqi shpjegoi se midis tij dhe Gjorgjeviçiqi u ra dakord që incidenti të mos bëhej publik, kryesisht që të mos "shqetësoheshin

²⁹⁰² Çasllav Golluboviçiq, T. 7400–7401 (27 nëntor 2006); P569 (Shënimet e Grupit të Punës të intervistës me Çasllav Golluboviçiqin), f. 1.

²⁹⁰³ Çasllav Golluboviçiq, T. 7401 (27 nëntor 2006).

²⁹⁰⁴ Boshko Radojkoviçiq, T. 7447–7448 (27 nëntor 2006); Çasllav Golluboviçiq, T. 7402–7405 (27 nëntor 2006).

²⁹⁰⁵ Çasllav Golluboviçiq, T. 7411–7412 (27 nëntor 2006).

²⁹⁰⁶ Petar Dujkoviçiq, T. 23413–23414 (28 shkurt 2008). *Shih gjithashtu* P584 (Shënimet e Grupit të Punës të intervistës me Branisllav Mitroviçiq), f. 2.

²⁹⁰⁷ Petar Dujkoviçiq, T. 23414–23417 (28 shkurt 2008).

²⁹⁰⁸ Çasllav Golluboviçiq, T. 7406 (27 nëntor 2006).

²⁹⁰⁹ Çasllav Golluboviçiq, T. 7406–7408 (27 nëntor 2006).

qytetarët" e jo për ta mbajtur sekret. Rrjedhimisht, Golluboviqi u dha urdhra vartësve të tij për zbatimin e urdhrave të Gjorgjeviqit.²⁹¹⁰

1291. Ndërsa i gjithë ekipi u nis për në Tekija, Golluboviqi qëndroi në një zyrë atje afër.²⁹¹¹ Sidoqoftë, shpejt kuptuan se ishin më shumë se 30 kufoma dhe i raportuan Atëherë ai i telefonoi Gjorgjeviqit dhe i tha se nuk kishin mjete të mjaftueshme për të përballuar situatën dhe i propozoi që do të ishte më mirë që kufomat të transportoheshin në ndonjë qendër kryesore urbane, Nish ose Beograd, ku do të mund të bëhej ekzaminimi dhe hetimi i mirëfilltë. Më në fund, Gjorgjeviqi e pranoi këtë sugjerim dhe urdhëroi që kufomat të transportoheshin në Beograd.²⁹¹²

1292. Ndërkohë Radojkoviqi vazhdonte punën në vendngjarje. Ai dëshmoi se ndër kufomat e nxjerra pa dy fëmijë, si dhe burra e gra. Asnjë nuk kishte uniformë. Ai vlerësoi se kufomat nuk ishin më shumë se tri-katër ditë të vdekura dhe pa plagë të shkaktuara kryesisht nga objekte si thika të mëdha. Ai pa plagë nga armë zjarri në njërin nga kufomat, një mashkull, duart e të cilit ishin të lidhura me tel.²⁹¹³

1293. Atë natë u nxorën 30 kufoma, të cilat u mbështollën me çarçaf dhe u ngarkuan në një kamion e pastaj u transportuan për në Beograd.²⁹¹⁴ Golluboviqi bëri disa biseda me Gjorgjeviqin gjatë natës dhe iu desh të bindte shoferin e vet që të ngiste kamionin deri në Beograd. Marrëveshja ishte që shoferi do të pritej nga dikush në hyrje të Beogradit, i cili do ta drejtonte deri në vendmbërritjen e fundit; kamioni gjithashtu duhej të shoqërohej deri në Beograd nga policia e trafikut.²⁹¹⁵ Kur shoferi u kthye, ai i tha Golluboviqit se një makinë Golf Volkswagen e kishte takuar në hyrje të Beogradit dhe e kishte shoqëruar deri në rrugën për në Novi Sad, ku e kishin marrë përsipër persona të tjerë. Diku rreth datës 15 prill 1999, shoferi shkoi përsëri në Beograd për të marrë kamionin nga parkimi i Ministrisë së Brendshme.²⁹¹⁶

1294. Pas largimit të kamionit nga vendi ku ishte bërë zbulimi fillestar, Golluboviqi bisedoi përsëri me Gjorgjeviqin dhe i kërkoi të sigurate edhe një kamion për kufomat e mbetura. Pasi u organizua gjithçka dhe u ndanë detyrat, më 7 prill 1999, rreth orës 05:00 ose 06:00, Golluboviqi dhe Milladinoviqi u nisën për në Bor.²⁹¹⁷ Më vonë atë natë, Radojkoviqi dhe njerëzit e tij vazhduan me

²⁹¹⁰ Çasllav Golluboviq, T. 7417–7418 (27 nëntor 2006).

²⁹¹¹ Çasllav Golluboviq, T. 7408–7409 (27 nëntor 2006); Boshko Radojkoviq, T. 7446–7448 (27 nëntor 2006).

²⁹¹² Çasllav Golluboviq, T. 7409–7410, 7412 (27 nëntor 2006).

²⁹¹³ Boshko Radojkoviq, T. 7449–7450 (27 nëntor 2006).

²⁹¹⁴ Boshko Radojkoviq, T. 7447–7449 (27 nëntor 2006); Çasllav Golluboviq, T. 7412–7413 (27 nëntor 2006).

²⁹¹⁵ Çasllav Golluboviq, T. 7413–7414 (27 nëntor 2006).

²⁹¹⁶ Çasllav Golluboviq, T. 7414–7415 (27 nëntor 2006).

²⁹¹⁷ Çasllav Golluboviq, T. 7415 (27 nëntor 2006).

shkarkimin e kufomave. Nga kamioni-frigorifer u shkarkuan edhe 53 kufoma dhe 3 koka të prera. Asnjë prej tyre nuk ishte me uniformë.²⁹¹⁸ Ato i ngarkuan në një kamion tjetër, gjithashtu me targa të Beogradit, të cilin e ngau për në Beograd një dëshmitar tjetër në këtë çështje, Bozhdar Protiq, siç diskutohet më poshtë. Rreth datës 8 ose 9 prill 1999, kamioni-frigorifer u transportua në Petrovo Sellë, afër Klladovës, ku u shkatërrua nga Radojkoviçiq me urdhër të Toma Milladinoviçiqit, shef i policisë për krime në Bor. Golluboviçiq dëshmoi se Gjorgjeviçiq udhëzoi t'a shkatërronte kamionin.²⁹¹⁹ Golluboviçiq gjithashtu dëshmoi se më vonë lexoi në media se vendmbërritja e fundit e kufomave ishte Batajnica.²⁹²⁰ Personat që nuk kishin lidhje me DPB-në e Klladovës, si punëtorët e ndërmarrjes së shërbimeve publike, u paguan me mëditje nga Ministria. Gjorgjeviçiq i siguroi paratë duke i dërguar nga Beogradi përmes dikujt. Sipas Golluboviçiqit, kjo nuk ishte e pazakontë, por vetëm po vetëm një linjë e zakonshme komunikimi ndërmjet Ministrisë dhe SPB-ve.²⁹²¹

b. Rivarrosja e kufomave

1295. Dhoma dëgjoji dëshmitë e dy dëshmitarëve, K87 dhe K88, në lidhje me rivarrosjen e kufomave në qendrën e Batajnicës. Edhe pse rrëfimet e këtyre dy dëshmitarëve përmbajnë mospërputhje të vogla, Dhoma mendon se ato kryesisht përputhen me njëra tjetrën. Gjithashtu, Dhoma vë në dukje se K87-a nuk u mor në pyetje nga Mbrojtja dhe mendon se me gjithë kundërshtime e ngritura nga Mbrojtja ndaj dëshmisë së K88-ës, ai, ishte dëshmitar mjaft i besueshëm.

1296. Siç është diskutuar në nënpjesën VI.A.3, SAJ-ja ishte e RJB-së që drejtohej nga Vllastimir Gjorgjeviçiq, i cili i raportonte ministrit të Brendshëm Vllajko Stojilkoviçiqit. SAJ-ja kishte një qendër stërvitore që gjendej në rrugën kryesore të Batajnicës afër Beogradit. Rreth 500 metra përpara portës kryesore të qendrës ishte kazerma e UJ-së, por sipas K87-ës dhe K88-ës, këto ishin plotësisht të ndara dhe të pavarura nga qendra.²⁹²² Për të hyrë në qendër duhej të kalohej nëpër dy postbllqe. I pari kontrollohej nga UJ-ja dhe i dyti nga MPB-ja.²⁹²³

1297. Pasi kishin filluar bombardimet e NATO-s, forcat e SAJ-së që ishin të stacionuara në Batajnicë u zhvendosën në një vend rreth tri-katër kilometra më larg. Pas kësaj zhvendosjeje, qendra mbeti tërësisht e zbrazët dhe pa rojë, por personeli shkante herë pas here për t'i kontrolluar

²⁹¹⁸ Boshko Radojkoviçiq, T. 7450–7452 (27 nëntor 2006); Çasllav Golluboviçiq, T. 7416 (27 nëntor 2006).

²⁹¹⁹ Boshko Radojkoviçiq, T. 7453–7454 (27 nëntor 2006); Çasllav Golluboviçiq, T. 7417 (27 nëntor 2006).

²⁹²⁰ Çasllav Golluboviçiq, T. 7423 (27 nëntor 2006).

²⁹²¹ Çasllav Golluboviçiq, T. 7419–7420 (27 nëntor 2006).

²⁹²² K87, P2756 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 tetor 2004), para. 6–11 (e mbyllur me vulë); K88, P2800 (deklarata e dëshmitarit), para. 11–12. *Shih gjithashtu* Geza Farkash, T. 16383–16384 (25 shtator 2007).

²⁹²³ K84, T. 5200–5201 (19 tetor 2006) (seancë e mbyllur).

gjërat. Çdokush mund të hynte e dilte.²⁹²⁴ Sidoqoftë, nuk është e qartë nëse UJ-ja mbeti në postbllok.²⁹²⁵

1298. Dikur midis mesit dhe fundit të prillit 1999, K87-a mori një telefonatë nga Gjorgjeviqi, i cili tha të shkonte në zyrën e tij të nesërmen në orën 09:00, dhe ai shkoi. Askush tjetër nuk ishte i pranishëm. Gjorgjeviqi i shpjegoi se në qendër ishin parkuar dy kamionë, se ata përmbanin kufoma të viktimave të bombardimeve të NATO-s dhe se kufomat duhej të varroseshin përkohësisht në qendrën e SAJ-së në Batajnicë. Gjorgjeviqi gjithashtu i tha se, kur të mbaronte konflikti kufomat do të zhvarroseshin dhe do të identifikoheshin e pastaj do të varroseshin si duhet. Më tej ata të dy diskutuan logjistikën e kësaj detyre dhe Gjorgjeviqi tha se kufomat duhej të varroseshin në një varr të përbashkët. K87-a nuk mori urdhra me shkrim në lidhje me këtë detyrë.²⁹²⁶

1299. Mospërputhja kryesore midis dëshmive të K88-ës dhe K87-ës ka lidhje me datën konkrete në prill të rivarrimeve. Ndërsa K87-a dëshmoi se rivarrimet filluan në gjysmën e dytë të prillit, K88-a tha se ato filluan më 8 prill 1999. Dhoma e konsideron K88-ën më të saktë në këtë aspekt, meqenëse dëshmia e tij ishte më konkrete. Gjithashtu, ajo përputhet me datat në të cilat u zbuluan kufomat në Tekija dhe u transportuan nga Tekija në Batajnicë.

1300. K88-a dëshmoi se, dikur në fillim të prillit, ai pa tre kamionë civilë të parkuar në poligonin e qitjes në qendrën stërvitore, njëri prej të cilëve ishte i ngjashëm me automjetet që përdorte MPB-ja. Pasi ishin larguar dy nga tre kamionët, një roje i tha se nga kamioni i mbetur vinte erë e keqe. K88-a shpjegoi se ata supozuan se kamionët bartnin kufoma të serbëve të vrarë gjatë konfliktit dhe se qeveria përpiqej që të fshihte gjendjen e vështirë në Kosovë. Më vonë, K88-a dëgjoi nga një koleg përgjegjës për sigurinë se edhe dy kamionët që ishin larguar kishin kufoma, por ai nuk i pa më.²⁹²⁷

1301. K88-a dëshmoi se rreth 8 prillit 1999, i telefonoi K87-a dhe i tha se kamioni i mbetur kishte kufoma dhe se dikush më lart se komandantët e qendrës kishte urdhëruar varrimin e kufomave në

²⁹²⁴ K87, T. 11817 (16 mars 2007), P2847 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 tetor 2004), para. 8–9; K88, T. 10463–10464 (22 shkurt 2007), P2800 (deklarata e dëshmitarit), para. 11.

²⁹²⁵ K84, T. 5229–5230 (19 tetor 2006) (seancë e mbyllur).

²⁹²⁶ K87, T. 11815–11817 (16 mars 2007), P2756 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 tetor 2004), para. 12–14 (e mbyllur me vulë).

²⁹²⁷ K88, T. 10446–10448 (21 shkurt 2007), P2681 (deklarata e dëshmitarit), para. 14–16 (e mbyllur me vulë). *Shih gjithashtu* hartën 1 të bashkangjitur deklaratës (e mbyllur me vulë); IC124 (harta 1 e shënuar nga K88 për të sqaruar vendin e kamionit të parë) (e mbyllur me vulë).

qendër.²⁹²⁸ K87-a, K88-a, dhe dy oficerë të MPB-së që kishin qenë shoferë të zyrtarëve të lartë të MPB-së, vendosën që t'i varrosnin kufomat në pjesën më të largët të qendrës.²⁹²⁹

1302. Kur kufomat u hodhën në gropën që ishte hapur, as K87, e as K88 nuk mundën të dallonin gjininë dhe veshjet e tyre. K87 nuk ishte në gjendje të vlerësonte numrin e kufomave të varrosura në atë gropë.²⁹³⁰

1303. Sipas K87-ës, gjatë 10 ditëve të ardhshme, erdhën dy ose tre kamionë të tjerë me kufoma, pasi u mor i njëjti vendim. U zbatua e njëjta procedurë. K87-a rikujtoi se u hap një gropë e re, por nuk mbante mend nëse u hap edhe grupa e tretë. Sipas K87-ës, kamionët si dhe shoferët e tyre ishin gjithmonë të ndryshëm. Ai nuk njohu asnjë prej tyre.²⁹³¹

1304. Dëshmia e K88-ës përmban pak më shumë hollësi në lidhje me varrimet e mëvonshme. Ai shpjegoi se, tri deri në pesë ditë pas varrimit të parë, në qendër erdhi një kamion tjetër. K88 vuri re se ishte maune me rimorkio dhe pa targa. Ai pas se prej kamionit rridhte gjak, të cilin ai dhe të tjerët më vonë u munduar ta fshihnin duke hedhur benzinë mbi njollën e gjakut në tokë dhe duke e fshirë me zjarr.²⁹³²

1305. Kufomat e ngarkesës së re u varrosën në poligonin e qitjes në qendër. Teksa përpiqeshin të shkarkonin kufomat, rimorkioja ra në gropën që ishte hapur. Ajo mbeti atje deri në zhvarrosjen e kufomave vite më vonë.²⁹³³

1306. Sipas K88-ës, pati edhe raste të tjera kur varrosën kufoma në Batajnicë. Sidoqoftë, ata asnjëherë nuk rihapnin të njëjtën gropë për t'i varrosur. Në një nga këto raste u përdor një kamion Mercedes dhe shoferi i tregoi K88-ës se kamioni përmbante 35 kufoma, të cilat u varrosën në një gropë të tretë. Së bashku me këtë kamion ishte edhe një kamion-frigorifer i madh i cili u zbraz në një gropë të veçantë. Dy nga shoferët e kamionëve ishin me uniforma të kaltra kamuflimi të policisë.²⁹³⁴

²⁹²⁸ K88, P2681 (deklarata e dëshmitarit), para. 17 (e mbyllur me vulë).

²⁹²⁹ K88, T. 10451–10453 (21 shkurt 2007) (seancë private), T. 10466 (22 shkurt 2007) (seancë private), P2681 (deklarata e dëshmitarit), para. 18 (e mbyllur me vulë).

²⁹³⁰ K87, P2847 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 tetor 2004), para. 19; K88, T. 10447 (21 shkurt 2007), P2681 (deklarata e dëshmitarit), para. 20 (e mbyllur me vulë), P2800 (deklarata e dëshmitarit), harta 2 e bashkangjitur deklaratës.

²⁹³¹ K87, T. 11817–11818 (16 mars 2007), P2756 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 tetor 2004), para. 21–22 (e mbyllur me vulë).

²⁹³² K88, T. 10448–10449 (21 shkurt 2007), T. 10464 (22 shkurt 2007), P2681 (deklarata e dëshmitarit), para. 22 (e mbyllur me vulë), P2800 (deklarata e dëshmitarit), para. 22, harta 1 e bashkangjitur deklaratës.

²⁹³³ K88, P2800 (deklarata e dëshmitarit), para. 23–24.

²⁹³⁴ K88, T. 10450 (21 shkurt 2007), P2800 (deklarata e dëshmitarit), para 27–28.

1307. Në një moment gjatë lëvizjes së kufomave, K87-a u takua me Gjorgjeviqin në zyrën e të dytit dhe i kërkoi që ky operacion të ndërpritej për shkak të ndjenjës së keq që po krijonte. Shpejt pas kësaj, ardhja e kufomave u ndërpre. Më vonë K87-a informoi komandantin e tij të drejtpërdrejtë se atje ishin varrosur kufoma, por ai nuk reagoi dhe nuk donte të shihte vendin e varreve të përbashkëta.²⁹³⁵

1308. K88-a përfundoi se, në përgjithësi, kufomat u prunë në qendër brenda rreth 20 ditësh në intervale prej dy-tri ditësh. Nga fundi i këtyre 20 ditëve, erdhi një burrë për të cilin K88 mendoi se ishte nga RDB-ja, dhe i tha të heshte për këtë operacion përndryshe do të vritej.²⁹³⁶ Dëshmia e K88-ës në lidhje me kohën e rivarrimeve përputhet me dëshmitë se kufomat e njerëzve të vrarë në zonën e Mejës më 27 prill 1999 ishin midis kufomave të gjetura në varret e përbashkëta në Batajnicë.

c. Transportimi i kufomave

1309. Dhoma gjithashtu dëgjoi dëshmi nga dy persona të përfshirë në transportimin e kufomave për në Batajnicë dhe Petrovo Sellë në prill dhe maj 1999. Bozhidar Protiqi ngau kamionët me kufoma, kurse Çedomir Shakiqi ishte në rolin e shoqëruesit. Ndërsa Protiqi u thirr si dëshmitar nga Prokuroria, Shakiqi u ftua nga Mbrojtja e Llukiqit për të kundërshtuar besueshmërinë e Protiqit në lidhje me disa çështje, më e rëndësishmja e të cilave ishte implikimi i të Akuzuarit Llukiq në organizimin e transportimit të kufomave. Sidoqoftë, sa i përket mënyrës së transportimit të kufomave, gjë që i intereson kësaj pjese të aktgjykimit, dëshmitë e Shakiqit dhe Protiqit janë përgjithësisht përputhëse, siç përshkruhet më poshtë. Gjithashtu, dëshmia e Protiqit përputhet me dëshmitë e atyre që u përfshinë në gjetjen e kamionit në Danub dhe rivarrosjen e kufomave në Batajnicë, siç është përshkruar më lart.

1310. Protiqi ka qenë shofer për MPB-në nga viti 1975 deri në daljen e tij në pension në vitin 2001.²⁹³⁷ Ai deklaroi se transportoi kufoma në Batajnicë katër herë, një herë nga Tekija dhe tri herë nga Kosova, duke filluar që nga fillimi i fushatës së NATO-s. Për çdo udhëtim, Protiqi mori urdhra nga Petar Zekoviqi, i cili në atë kohë ishte ndihmësministër i Brendshëm. Në lidhje me udhëtimet në Kosovë, Zekoviqi e udhëzonte Protiqin që të shkonte në Prishtinë dhe të paraqitej në një vend të

²⁹³⁵ K87, P2847 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 tetor 2004), para. 23–25.

²⁹³⁶ K88, T. 10453–10454 (21 shkurt 2007) (seancë private), P2681 (deklarata e dëshmitarit), para. 35 (e mbyllur me vulë).

²⁹³⁷ Bozhidar Protiq, T. 11307–11308 (9 mars 2007).

caktuar prej nga duhej të bënte një telefonatë për të marrë udhëzime të mëtejshme.²⁹³⁸ Protiqi dëshmoi se gjatë udhëtimeve të veta në Kosovë ai shoqërohej nga një roje sigurimi nga Beogradi i cili ishte Çedomir Shakiqi.²⁹³⁹ Kjo më vonë u konfirmua nga Shakiqi. Shakiqi gjithashtu tha çdo udhëtim ai e bëri me urdhër nga eprori i tij, Mladen Shipovac.²⁹⁴⁰ Fillimisht, Shakiqi ngurroi mjaft që të pranonte se e dinte çfarë transportohej me kamionët, por pas ndërhyrjes së Dhomës, pranoi se u vu në dijeni se çfarë ndodhte dhe se ia raportoi këto aktivitete Shipovacit.²⁹⁴¹

1311. Sipas Protiqit, udhëtimi i parë i tij ishte në Tekija, në Serbinë lindore. Në lidhje me udhëtimet e tij në Kosovë, Protiqi tha se kishte shkuar në Janjevë, Mitrovicë, dhe në parkimin e *Rilindjes* në Prishtinë, sipas kësaj renditje.²⁹⁴² Nga ana e tij, Shakiqi tha se e kishte shoqëruar Protiqin në Kosovë katër herë. Herën e parë ishte deri te një treg në Prishtinë, vend që Protiqi nuk e përmendi.²⁹⁴³ Protiqi përmendi tri udhëtimet e tjera, por Shakiqi e ktheu mbrapsht renditjen e tyre kronologjike. Ai deklaroi se e së pari e shoqëroi Protiqin për në parkimin e *Rilindjes* në Prishtinë, më pas në Mitrovicë, dhe më në fund në Janjevë.²⁹⁴⁴

1312. Në lidhje me udhëtimin për në Tekija, Protiqi dëshmoi se shefi i tij e ftoi në zyrë dhe e pyeti se a mund të gjente një kamion për të bërë një detyrë të rëndësishme për vendin. Protiqi huazoi një kamion Mercedes nga fqinji i tij dhe, i shoqëruar nga një polic pensionist të cilin e njihte mirë, filloi udhëtimin rreth orës 17:00. Gjatë udhëtimit, Protiqit nuk iu tha shumë për vendmbërritjen, por vetëm se duhej të heshte për detyrën.²⁹⁴⁵ Kur mbërritën në Tekija, ai pa një kolonë automjetesh që prisnin në rrugë. Një makinë patrulluese policie u ndihmoi ta kalonin kolonën dhe i dërgoi në DPB-në e Klladovës. Aty u përshëndetën nga shefi i DPB-së, Vukashin Sperliqi, "tekniku Boshko," i cili ka shumë të ngjarë të ketë qenë Boshko Radojkoviqi, dhe disa policë. Të gjithë shkuan në një vendparkim ku panë një kamion-frigorifer. Protiqi pa disa punëtorë kur i zhvendosën kufomat nga kamioni-frigorifer në kamionin që e ngiste ai. Me të mbaruar kjo punë, rreth orë 01:00, Protiqi dhe shoqëruesi i tij u nisën për në Beograd.²⁹⁴⁶ Para se të nisej, punëtorët i thanë Protiqit se në kamion ishin rreth 54 kufoma. Ai vetë pa se midis kufomave kishte fëmijë dhe pleq dhe se rreth 10 kufoma

²⁹³⁸ Bozhidar Protiq, T. 11354–11359 (9 mars 2007); P2817 (Deklaratë e Protiqit dhënë Prokurorit të Beogradit Stankoviç), f. 2; P2816 (Transkript i intervistës së Protiqit me Dilpariqin), f. 5.

²⁹³⁹ Bozhidar Protiq, T. 11382 (9 mars 2007) (seancë private).

²⁹⁴⁰ Çedomir Shakiq, T. 22079 (11 shkurt 2008).

²⁹⁴¹ Çedomir Shakiq, T. 22121–22122 (11 shkurt 2008).

²⁹⁴² Bozhidar Protiq, T. 11321–11322, 11327–11328 (9 mars 2007).

²⁹⁴³ Çedomir Shakiq, T. 22079 (11 shkurt 2008).

²⁹⁴⁴ Çedomir Shakiq, T. 22084, 22088–22089, 22097, 22100 (11 shkurt 2008).

²⁹⁴⁵ Bozhidar Protiq, T. 11320, 11355 (9 mars 2007); P2816 (Transkript i intervistës së Protiqit me Dilpariqin), f. 1–2; P2817 (Deklaratë e Protiqit dhënë Prokurorit të Beogradit Stankoviç), f. 4.

²⁹⁴⁶ P2816 (Transkript i intervistës së Protiqit me Dilpariqin), f. 2–3.

ishin me uniforma.²⁹⁴⁷ Meqenëse dëshmia e Protiqit përputhet me dëshmitë e Golluboviqit dhe të Radojkoviqit në lidhje me kamionin e nxjerrë nga Danubi, siç është përshkruar më lart, Dhoma është bindur se Bozhidar Protiqi ishte shoferi që u dërgua për marrjen e kufomave e nxjerra nga Danubi në fillim të prillit 1999. Sipas mendimit të Dhomës, ky është një tregues më shumë se Protiqi ishte dëshmitar përgjithësisht i besueshëm.

1313. Protiqi i transportoi këto kufoma në qendrën stërvitore të SAJ-së në Batajnicë. Ai e parkoi kamionin në vendparkim, ku pa një kamion tjetër dhe ku një punonjës i MPB-së i tha se edhe ai kamion kishte kufoma, që ishte e qartë nga kutërbimi që vinte prej tij. Afër kamionit ai vuri re një njollë të madhe vaji ose nafte dhe gjurmën e diçkaje që ishte djegur. Punonjësi i MPB-së e mori kamionin dhe i tha Protiqit të vinte ta merrte pas dy ditësh. Ai u kthye pas dy ditësh dhe iu tha se kishin provuar "t'i digjinin por nuk digjeshin."²⁹⁴⁸ Edhe pse u kundërshtua në këto pika, Dhoma e konsideron dëshminë e Protiqit të besueshme.

1314. Çedomir Shakiqi dëshmoi se për herë të parë e shoqëroi Protiqin në Kosovë dikur në fund të prillit, ku e çoi me makinë deri në një treg në Prishtinë.²⁹⁴⁹ Protiqi nuk e përmendi këtë udhëtim në dëshminë e tij. Ata udhëtuan në një grup prej tetë vetësh të ndarë në dy xhipa Mercedes, duke përfshirë Shakiqin, Protiqin, dy shoferë, dhe katër policë.²⁹⁵⁰ Protiqi foli dy ose tri herë me celularin e tij, duke treguar çdo herë vendndodhjen e grupit.²⁹⁵¹ Shakiqi pretendoi se më vonë Protiqi tha se kishte folur me Gjorgjeviqin.²⁹⁵² Protiqi e drejtoi grupin deri te tregu, ku u takuan me një grup të sigurimit, që përfshinte persona me uniforma dhe pa uniforma. Pasi foli me pjesëtarët me uniforma të grupit, Protiqi mori kamionin-frigorifer.²⁹⁵³ Shakiqi dhe dy xhipat e shoqëruan kamionin të cilin e ngiste Protiqi për në Beograd, ku e lanë Protiqin te godina e urgjencës mjekësore të MPB-së.²⁹⁵⁴ Shakiqi tha se Protiqi nuk bëri asnjë telefonatë nga linja tokësore gjatë këtij udhëtimi.²⁹⁵⁵

1315. Protiqi dëshmoi se, pas udhëtimit të tij të parë në Tekija, ai mori edhe një telefonatë nga Zekoviqi, i cili i tha të merrte një kamion nga një ndërmarrje e quajtur *Gemaks* dhe të shkonte në

²⁹⁴⁷ Bozhidar Protiq, T. 11320–11321, 11391–11392 (9 mars 2007); P2816 (Transkript i intervistës së Protiqit me Dilpariqin), f. 6; P600 (fotografi e kabinës së kamionit). Protiqi dëshmoi se këtë kamion e pa edhe në Tekija, edhe në Petrovo Sellë më vonë, ku u shkatërrua me mjete shpërthyesë. Bozhidar Protiq, T. 11321–11322 (9 mars 2007).

²⁹⁴⁸ Bozhidar Protiq, T. 11310–11311 (9 mars 2007); P2816 (Transkript i intervistës së Protiqit me Dilpariqin), f. 3, 7; P2817 (Deklarata e Protiqit dhënë Prokurorit të Beogradit Stankoviq), f. 3–4.

²⁹⁴⁹ Çedomir Shakiq, T. 22079 (11 shkurt 2008).

²⁹⁵⁰ Çedomir Shakiq, T. 22079–22080 (11 shkurt 2008).

²⁹⁵¹ Çedomir Shakiq, T. 22081 (11 shkurt 2008).

²⁹⁵² Çedomir Shakiq, T. 22082 (11 shkurt 2008).

²⁹⁵³ Çedomir Shakiq, T. 22081 (11 shkurt 2008).

²⁹⁵⁴ Çedomir Shakiq, T. 22083 (11 shkurt 2008).

²⁹⁵⁵ Çedomir Shakiq, T. 22082 (11 shkurt 2008).

Prishtinë. Gjithashtu Zekoviqi i dha edhe një numër telefoni që duhej të kontaktonte kur të mbërrinte në shtabin e MPB-së në Prishtinë. Protiqi dëshmoi se telefonoi në atë numër sipas udhëzimit dhe personi në anën tjetër të linjës, për të cilin mendoi se ishte Llukiqi,²⁹⁵⁶ i tha të shkonte në drejtim të Shkupit dhe se do t'i printe një makinë Golf në ngjyrë të kuqe të mbyllët. Kështu ndodhi. Golfi e çoi Protiqin në fshatin Janjevë në komunën e Lipjanit, rreth 20 kilometra nga Prishtina. Shoqëruesit e Protiqit nga Beogradi vinin nga pas. Policia vendore në Janjevë e drejtoi Protiqin në një vend të hapur në kodrat mbi fshat. Disa minuta më vonë erdhi një traktor me rimorkio dhe një ekskavator. Rimorkio kishte qenë i mbushur me kufoma dhe, të cilat ishin transferuar në kamionin e Protiqit me ekskavator. Sipas Protiqit, në kamionin e tij u ngarkuan gjithsej 17-19 kufoma.²⁹⁵⁷ Më pas, Protiqi i transportoi kufomat në Petrovo Sellë në Serbi. Ai kaloi nëpër Klladovë, ku Vukashin Sperliqi e drejtoi deri te qendra stërvitore e MPB-së në Petrovo Sellë. Kur mbërritën në qendër, Protiqi pa një vend të hapur pas të cilit ishin dy gropa varrimi që ishin hapur më herët dhe atje ishin të pranishëm disa njerëz të veshur me përzierje të rrobave civile dhe uniformave të kamuflimit. Pasi i shkarkuan kufomat në gropë, Protiqi u kthye në Beograd. Ai e la kamionin e zbrazët në qendrën stërvitore në Batajnicë.²⁹⁵⁸ Me përjashtim të pohimit të Shakiqit se ky ishte udhëtimi i fundit që bënë së bashku dhe faktit se ai nuk e përmendi bisedën telefonike midis Llukiqit dhe Protiqit, dëshmia e Shakiqit përgjithësisht përputhet me dëshminë e Protiqit.²⁹⁵⁹

1316. Më vonë, Protiqi mori edhe një telefonatë nga Zekoviqi. Pas kësaj telefonate, ai mori një kamion plehrash të konfiskuar. Protiqi telefonoi në numrin që i kishte dhënë Zekoviqi më herët dhe i njëjti zë e udhëzoi të shkonte në Mitrovicë për të marrë kufoma dhe për t'i transportuar në Petrovo Sellë. Ai shkoi përsëri me shoqërues. Vendmbërritja e tij ishte një punishte për riparimin e makinerisë së rëndë të një ndërmarrjeje për përpunimin e drurit. Ai gjeti mbi 50 kufoma të grumbulluara në gropat që përdorin automekanikët për të ndrequr makinat. Aty, Protiqin e takuan nja 15 veta në rroba civile, të cilët ai i përshkroi se "shefat e sekretariateve të dërguar në Kosovë nga sekretariatet komunale të Serbisë."²⁹⁶⁰ Kufomat u ngarkuan në kamionin e tij dhe ai i

²⁹⁵⁶ Konkluzionet e Dhomës nëse faktikisht ishte Sreten Llukiqi mund të gjenden më poshtë në Pjesën VIII.H.

²⁹⁵⁷ Bozhidar Protiq, T. 11322, 11373–11375 (9 mars 2007); P2816 (Transkript i intervistës së Protiqit me Dilpariqin), f. 3; P2817 (Deklarata e Protiqit dhënë Prokurorit të Beogradit Stankoviq), f. 2–3; P2824 (Transkript i intervistës së Protiqit në Gjykatën e Qarkut të Beogradit), f. 4–5; 6D196 (pjesë nga deklarata e Protiqit dhënë MPB-së më 27 gusht 2002), f. 2.

²⁹⁵⁸ Bozhidar Protiq, T. 11373–11374 (9 mars 2007); P2816 (Transkript i intervistës së Protiqit me Dilpariqin), f. 3–4, 11–13; P2817 (Deklarata e Protiqit dhënë Prokurorit të Beogradit Stankoviq), f. 3; P2824 (Transkript i intervistës së Protiqit në Gjykatën e Qarkut të Beogradit), f. 5–14.

²⁹⁵⁹ Çedomir Shakiq, T. 22093–22094, 22097–22098 (11 shkurt 2008).

²⁹⁶⁰ Bozhidar Protiq, T. 11329 (9 mars 2007).

transportoi në qendrën stërvitore në Petrovo Sellë.²⁹⁶¹ Shakiqi konfirmoi se ky udhëtim kishte ndodhur dhe se e kishte shoqëruar Protiqin deri në Mitrovicë dhe te ndërmarrja për përpunimin e drurit.²⁹⁶²

1317. Udhëtimi i fundit i Protiqit ishte në Prishtinë, këtë herë me një makinë zyrtare Toyota, dhe përsëri me udhëzimet e Zekoviqit. Ai shkoi te godina e *Rilindjes* ku e takuan policë të cilët dhanë një kamion-frigorifer të konfiskuar me rreth 500 kufoma për ta transportuar në Batajnicë.²⁹⁶³ Sidoqoftë, Shakiqi tha se udhëtimi te godina e *Rilindjes* ishte i pari nga të tre udhëtimet për të cilat dëshmuar ai dhe Protiqi.²⁹⁶⁴ Ai dëshmoi se Protiqi i telefonoi dhe i kërkoi të takoheshin në një ndërmarrje afër godinës së Shërbimit të Urgjencës Mjekësore të MPB-së.²⁹⁶⁵ Prej andej ata u nisën me dy makina dhe shkuan në vendparkimin e godinës së *Rilindjes* në Prishtinë, që kishte gardh me tela dhe portë të ruajtur nga policia.²⁹⁶⁶ Ai kundërshtoi pretendimet e Protiqit se udhëtuan në një makinë Toyota pa shenja, duke thënë se të gjitha udhëtimet u bënë me xhipa Mercedes, që ishin makina zyrtare të policisë.²⁹⁶⁷ Me gjithë mospërputhjet në hollësi, Dhoma gjykon se dëshmitë e dy burrave japin një pamje përputhëse të një operacioni të fshehtë.

1318. Protiqi vlerësoi se kishte transportuar gjithsej rreth 600 kufoma. Sa për tri udhëtimet në Kosovë, në shumicën e rasteve u transportuan kufoma meshkujsh me rroba civile, por edhe me një lloj uniforme ushtarake kamuflimi.²⁹⁶⁸ Protiqi nuk ishte në gjendje të tregonte se sa ngarkesa me kufoma gjithsej u transportuan për në Batajnicë, por përmendi emrat e shoferëve të gjeneralëve të MPB-së të përmendur më lart nga K88-a.²⁹⁶⁹

1319. Dhoma konkludon se, përveç Shakiqit, Mbrojtja e Llukiqit ftoi disa dëshmitarë të cilët kishin folur me Protiqin gjatë hetimit të këtyre ngjarjeve nga autoritetet serbe. Shumica e këtyre dëshmitarëve dëshmuar se Protiqi ishte konfuz, e ndërronte dëshminë shpesh dhe jepte të dhëna

²⁹⁶¹ Bozhidar Protiq, T. 11322, 11327 (9 mars 2007); P2816 (Transkript i intervistës së Protiqit me Dilpariqin), f. 4, 11–12; P2817 (Deklarata e Protiqit dhënë Prokurorit të Beogradit Stankoviq), f. 2; P2824 (Transkript i intervistës së Protiqit në Gjykatën e Qarkut të Beogradit), f. 15–16.

²⁹⁶² Çedomir Shakiq, T. 22087–22089, 22091 (11 shkurt 2008).

²⁹⁶³ Bozhidar Protiq, T. 11322–11323, 11328 (9 mars 2007); P2816 (Transkript i intervistës së Protiqit me Dilpariqin), f. 4; P2817 (Deklarata e Protiqit dhënë Prokurorit të Beogradit Stankoviq), f. 4–5; *Shih gjithashtu* Çedomir Shakiq, T. 22085–22086 (11 shkurt 2008).

²⁹⁶⁴ Çedomir Shakiq, T. 22084 (11 shkurt 2008).

²⁹⁶⁵ Çedomir Shakiq, T. 22084 (11 shkurt 2008).

²⁹⁶⁶ Çedomir Shakiq, T. 22084, 22086 (11 shkurt 2008).

²⁹⁶⁷ Çedomir Shakiq, T. 22138–22139 (12 shkurt 2008).

²⁹⁶⁸ P2817 (Deklarata e Protiqit dhënë Prokurorit të Beogradit Stankoviq), f. 4.

²⁹⁶⁹ Bozhidar Protiq, T. 11333–11334 (9 mars 2007) (seancë private).

kontradiktor për ngjarjet.²⁹⁷⁰ Me gjithë këto rezerva të shprehura, Dhoma e konsideron dëshminë e Protiqit kryesisht përputhëse në vetvete dhe bindëse në lidhje me mënyrën e transportimit të kufomave nga Kosova në Serbi. Gjithashtu, Shakiqi në masë të madhe e konfirmon Protiqin. Mospërputhja më e madhe dhe më e rëndësishme midis këtyre dy dëshmitarëve ka të bëjë me identifikimin e Llukiqit si njeri i përfshirë në këtë operacion. E njëjta gjë mund të thuhet për kundërshtimet që iu bënë Protiqit nga dëshmitarët e tjerë të ftuar nga Llukiqi. Gjithsesi, problemi i implikimit të Llukiqit nuk ndikon në qëndrimin e Dhomës se dëshmia e Protiqit në lidhje me transportimin e kufomave është përshkrim përgjithësisht i saktë i mënyrës si u veprua. Në këto aspekte, Dhoma e konsideron Protiqin dëshmitar të besueshëm.

3. Hetimet e MPB-së

1320. Pas botimit të një artikulli më 1 maj 2001 në një gazetë vendore serbe ku pretendohet se në prill 1999 një kamion frigorifer që përmbante kufoma nga Kosova ishte zbuluar në Danub, ministri i Brendshëm dhe Llukiqi formuan një grup pune për hetimin e ngjarjes. Në atë kohë, Llukiqi ishte shef i RJB-së. Grupi përbëhej nga këta anëtarë: Dragan Karleusha, Dragan Furdulloviq, Millorad Veloviq, dhe Bora Banjac. Drejtues i grupit ishte Karleusha.²⁹⁷¹ Llukiqi e udhëzoi grupin e punës që të mundësonte që askush të mos përjashtohet nga hetimet apo të privilegjohej dhe i akordoi grupit të punës kompetenca dhe fuqi të plota për këtë hetim. Sipas Furdulloviqit, grupi i punës mund të punonte plotësisht i pavarur dhe pa pengesa për ndërmarrjen e masave ligjore kundër cilitdo pjesëtar të MPB-së.²⁹⁷² Grupi filloi mbledhjen e provave më 12 maj 2001.²⁹⁷³

1321. Gjatë hetimeve fillestare të grupit të punës doli se një artikull i ngjashëm ishte botuar në të njëjtën revistë dhe nga i njëjti autor rreth dy vite më parë. Sidoqoftë, artikulli nuk u lexua nga publiku i gjerë dhe në atë kohë nuk ishte bërë asgjë për ta hetuar incidentin më tej, megjithëse Çasllav Golluboviqi e informoi Gjorgjeviqin për ekzistencën e artikullit.²⁹⁷⁴

²⁹⁷⁰ Aleksandar Kostiq, T. 24112–24114, 24130–24133 (11 mars 2008); Gvozden Gagiq, T. 24466 (18 mars 2008), T. 24528–24529 (19 mars 2008); Dragan Furdulloviq, T. 24709–24711 (1 prill 2008).

²⁹⁷¹ Dragan Furdulloviq, 6D1605 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 mars 2008), para. 3; Çasllav Golluboviq, T. 7421–7422 (27 nëntor 2006); 6D91 (Deklaratë për shtyp e shërbimit të informacionit të MPB-së); P565 (artikull në “Revista e Krimin të Timokut” me titull: “50 Kufoma në Kamion-Frigorifer – Sekret Shtetëror.”). *Shih gjithashtu* Aleksandar Kostiq, T. 24098, 24125–24126 (11 mars 2008); Zoran Zhivkoviq, T. 24673–24674 (1 prill 2008).

²⁹⁷² Dragan Furdulloviq, 6D1605 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 mars 2008), para. 7. Fakti se grupi i punës kishte kompetencë të gjerë dhe ishte në gjendje të intervistonte çdokënd pavarësisht gradës u konfirmua nga Aleksandar Kostiqi. *Shih* Aleksandar Kostiq, T. 24101, 24110–24111 (11 mars 2008). Gjithashtu, Gvozden Gagiqi dëshmoi se RJB-ja dhe MPB-ja morën të gjitha masat e nevojshme për të hetuar transportimin e kufomave nga Kosova në Serbi. Gvozden Gagiq, T. 24463–24464 (18 mars 2008).

²⁹⁷³ Dragan Furdulloviq, 6D1605 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 mars 2008), para. 3.

²⁹⁷⁴ P566 (artikull në “Revista e Krimin të Timokut” me titull: “50 Kufoma në Kamion Frigorifer – Sekret Shtetëror.”); P569 (Shënimet e grupit të punës të intervistës me Çasllav Golluboviqin), f. 3.

1322. Në fazën fillestare të hetimeve grupi i punës pati një takim të shkurtër me Gjorgjeviqin, ku ai refuzoi t'u përgjigjej pyetjeve lidhur me dijeninë e tij për incidentin me kamionin-frigorifer. Grupi i tha se kur të kishin më shumë informata, do të flisnin me të përsëri, por kjo nuk ndodhi sepse më vonë nuk ishin në gjendje ta gjenin. Gjithashtu, grupi i punës u orvat tri herë që të merrte në pyetje Stojilkoviqin, por pa sukses. Disa kohë më vonë, pas nxjerrjes së aktakuzës nga Tribunali, Stojilkoviqi bëri vetëvrasje.²⁹⁷⁵

1323. Në periudhën 12-15 maj 2001, grupi i punës intervistoi mbi 30 policë dhe civilë, duke përfshirë punonjës të MPB-së nga DPB-ja e Klladovës, SPB-ja e Borit, dhe të tjerë që mund të kishin dijeni për kamionin-frigorifer, hetim që i çoi deri te vendndodhjet në Batajnicë dhe Petrovo Sellë. Grupi i punës përgatiti shënime të veçanta të intervistave, që iu dërguan Prokurorit Publik të Qarkut në Beograd.²⁹⁷⁶ Ndër të intervistuarit ishin edhe Boshko Radojkoviqi dhe Çasllav Golluboviqi.²⁹⁷⁷ Gjithashtu, grupi i punës foli me Sllobodan Borisavleviqin, i cili në atë kohë ishte ndihmësshef i kabinetit të Gjorgjeviqit. Ai ka dhënë një deklaratë në të cilën ka shpjeguar se ai ishte personi që mori telefonatën në lidhje me Klladovën dhe këtë informatë ia përcolli Gjorgjeviqit. Në deklaratën e tij ai gjithashtu thotë se Gjorgjeviqi e udhëzoi të kujdesej për pagesën e personave që punonin në transportimin e kufomave.²⁹⁷⁸ Borisavleviqi dha edhe një deklaratë tjetër në të cilën pohonte se në prill 1999 Gjorgjeviqi informoi Dragan Iliqin, shefin e Administratës së Policisë për Krime në Beograd dhe i akuzuar si pjesëtar i ndërmarrjes së përbashkët kriminale, se duhej të bëhej pastrimi i fushëbetejës në territorin e Kosovës dhe se duhej të dërgoheshin punëtorë në Shtabin e MPB-së në Prishtinë.²⁹⁷⁹

1324. Grupi i punës intervistoi edhe disa të tjerë. Gjatë hetimeve ata patën kontakte të shpeshta me Llukiqin, por çuditërisht, grupi nuk mori asnjë deklaratë prej tij e as nuk e trajtoi Llukiqin si pjesëmarrësit e tjerë në hetime, me gjithë faktin se ai kishte qenë shef i Shtabit të MPB-së në Kosovë gjatë transportimit të fshehtë të kufomave. Sipas Furdulloviqit, grupi i punës nuk kishte prova që lidhnin Llukiqin me kamionin-frigorifer.²⁹⁸⁰

1325. Grupi i punës publikoi dy komunikata në të cilat kishte përmbledhur konkluzionet e veta. E para u lëshua më 25 maj 2001 dhe trajtonte ngjarjet në lidhje me kamionin-frigorifer në fillim të

²⁹⁷⁵ Dragan Furdulloviq, 6D1605 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 mars 2008), para. 7; P590 (Notë zyrtare mbi përpjekjen e Grupit të Punës për të intervistuar Vllajko Stojilkoviq) (e mbyllur me vulë).

²⁹⁷⁶ Dragan Furdulloviq, T. 24714 (1 prill 2008), 6D1605 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 mars 2008), para. 5–6.

²⁹⁷⁷ Çasllav Golluboviq, T. 7422–7424 (27 nëntor 2006); P569 (Shënimet e Grupit të Punës të intervistës me Çasllav Golluboviqin); P573 (Shënimet e Grupit të Punës të intervistës me Boshko Radojkoviqin).

²⁹⁷⁸ P592 (Deklarata e dytë dhënë Grupit të Punës nga Sllobodan Borisavleviqi).

²⁹⁷⁹ P591 (Deklarata e parë dhënë Grupit të Punës nga Sllobodan Borisavleviqi) (e mbyllur me vulë).

²⁹⁸⁰ Dragan Furdulloviq, T. 24738–24742 (2 prill 2008).

prillit 1999. Në të gjithashtu thuhej se ish-ministri i Brendshëm Stojilkoviç dhe shefi i RJB-së Gjorgjeviç e kishin shpallur këtë rast sekret shtetëror dhe kishin filluar operacionin "Dubina 2" ("Thellësia 2") për t'u marrë me të. Kjo ishte arsyeja që Prokurori Publik i Qarkut në Negotin i përmendur më lart,²⁹⁸¹ ndërpreu hetimet. Punëtorët që zhvarrosën dhe bartën kufomat ishin paguar nga fondi i MPB-së për shpenzime të posaçme.²⁹⁸² Komunikata gjithashtu raportonte se në mars 1999 ishte mbajtur një mbledhje në zyrën e Sllobodan Millosheviçit, në të cilën morën pjesë Millosheviç, Stojilkoviç, Gjorgjeviç dhe Radomir Markoviç (shef i RDB-së) ku Gjorgjeviç ngriti çështjen e pastrimit të terrenit në Kosovë, të quajtur "*asanacija*." Millosheviç urdhëroi Stojilkoviçin për "marrjen e masave për fshirjen e të gjitha gjurmëve që mund të zbulonin prova të krimeve të kryera."²⁹⁸³ Sipas komunikatës, problemi u diskutua më tej në zyrën e Stojilkoviçit në mars 1999. Qëllimi ishte që të hiqeshin viktimat civile të cilët mund të bëheshin objekt i hetimeve të Tribunalit. Për kryerjen e kësaj detyrë Stojilkoviç urdhëroi Gjorgjeviçin dhe Iliqin.²⁹⁸⁴ Më vonë u mbajt edhe mbledhja e tretë ku Gjorgjeviç organizoi masa praktike për heqjen e kufomave nga Kosova.²⁹⁸⁵

1326. Gvozden Gagiç, i cili atëherë ishte vartës i Fliqit, konfirmoi se në maj 1999 Iliç vizitoi Kosovën dhe se më 5 maj 1999 u takua me shefat e degëve të policisë së krimeve për t'iu dhënë udhëzime se si duhej të vazhdonte puna e policisë së krimeve. U hartua plani për "restaurimin" e territorit ("*saniranje terena*") i cili me sa duket iu shpërnda të gjitha SPB-ve.²⁹⁸⁶ Gagiç, i cili nuk ishte i pranishëm në këtë mbledhje, fillimisht tha se nuk e pa asnjëherë këtë plan dhe se, po të kishte ekzistuar, ai do ta kishte parë patjetër.²⁹⁸⁷ Sidoqoftë, gjatë pyetjeve nga pala tjetër, ai pranoi se një shkresë e shkruar prej tij dhe i nënshkruar më vonë nga Iliç, mund të ketë qenë plani në fjalë. Ky dokument përmendte krime të rënda të kryera në Kosovë dhe udhëzonte shefat e SPB-ve që, të tjera, të mblidhnin të dhëna për krimet dhe të bashkëpunonin me organet ushtarake dhe civile për të parandaluar krimet e tjera.²⁹⁸⁸ Është e paqartë nëse Gjorgjeviç e kishte fjalën për pastrimin e ligjshëm apo të paligjshëm të terrenit, në bisedën e tij me Iliqin.

²⁹⁸¹ *Shih* më lart para. 1285.

²⁹⁸² P567 (Komunikatë e Grupit të Punës, 25 maj 2001).

²⁹⁸³ P567 (Komunikatë e Grupit të Punës, 25 maj 2001), f. 3.

²⁹⁸⁴ P567 (Komunikatë e Grupit të Punës, 25 maj 2001), f. 3; 6D92 (Transkript i konferencës për shtyp të MPB-së të mbajtur më 25 maj 2001), f. 5.

²⁹⁸⁵ P591 (Deklarata e parë dhënë Grupit të punës nga Sllobodan Borisavleviç) (e mbyllur me vulë).

²⁹⁸⁶ P1996 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 7 maj 1999), f. 9–10.

²⁹⁸⁷ Gvozden Gagiç, T. 24454–24457 (18 mars 2008), T. 24494–24499 (19 mars 2008). *Shih gjithashtu* Miroslav Mijatoviç, T. 22260–22262 (13 shkurt 2008), T. 22519–22520 (15 shkurt 2008).

²⁹⁸⁸ Gvozden Gagiç, T. 24523–24525 (19 mars 2008); 6D874 (Shkresë e Shtabit të MPB-së dërguar SPB-ve në Kosovë, 6 maj 1999).

1327. Komunikata e dytë u lëshua më 26 qershor 2001 dhe përmbante shumicën e të dhënave të marra nga Radojkoviqi, duke përfshirë edhe informacionin se kamioni-frigorifer përmbante kufoma me uniforma të UÇK-së, gjë që, sipas Radojkoviqit, ishte e pasaktë. Radojkoviqi mendonte se gabimi u bë sepse në atë kohë ai merrej me zhvarrosjen e kufomave në Petrovo Sellë, disa nga të cilat faktikisht kishin uniforma të UÇK-së. Grupi i punës thjesht i bashkoi të dhënat që u ofroi në lidhje me Petrovo Sellon me të dhënat që u dha në lidhje me kamionin-frigorifer. Pas kësaj Radojkoviqi i telefonoi ministrit të Brendshëm Dushan Mihajllloviq, për të cilin grupi i punës përgatiti një notë dhe e informoi për këtë gabim.²⁹⁸⁹ Komunikata e 26 qershorit gjithashtu bënte të ditur se kufomat ishin transportuar në qendrën stërvitore të SAJ-së në dy kamionë dhe se kamioni i dytë që ishte privat, drejtohej nga Bozhidar Protiqi.²⁹⁹⁰

1328. Pas kësaj komunikate, çështja iu raportua Prokurorit Publik të Qarkut në Beograd dhe më pas Goran Çavllina, gjykatës hetues në Gjykatën e Qarkut të Beogradit, urdhëroi hapjen e një varri të përbashkët të dyshimtë në Batajnicë dhe kryerjen e autopsisë së kufomave të gjetura. Për zbatimin e urdhrin, ai ngarkoi Institutin e Mjekësisë Ligjore në Beograd dhe urdhëroi MPB-në e Serbisë që ta siguronte vendin e ngjarjes.²⁹⁹¹ Në afërsi të qendrës stërvitore u zbuluan disa varre të përbashkëta; identifikimi i disa kufomave të zhvarrosura sugjeronte se viktimat ishin nga Kosova dhe, më konkretisht, nga Suhareka. Ky zbulim çoi në hetimin e vrasjes së familjes Berisha në qytetin e Suharekës. Hetimet zgjatën nga 2001 deri më 2003.²⁹⁹²

1329. Hetimet e grupit të punës gjithashtu çuan në zbulimin e varreve të tjera të përbashkëta në Serbi. Së pari, grupi mori të dhëna se dy varre të përbashkëta gjendeshin afër qendrës stërvitore të SAJ-së në Petrovo Sellë. Gjykatësi hetues nga Negotini urdhëroi zhvarrosjen e 75 kufomave të gjetura atje dhe Instituti i Mjekësisë Ligjore bëri autopsitë në Nish. Edhe këto kufoma ishin nga

²⁹⁸⁹ Boshko Radojkoviq, T. 7454–7455 (27 nëntor 2006).

²⁹⁹⁰ P568 (Komunikatë e Grupit të Punës, 26 qershor 2001).

²⁹⁹¹ Dragan Furdulloviq, 6D1605 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 mars 2008), para. 6.

²⁹⁹² Dragan Furdulloviq, T. 24699–24705 (1 prill 2008), 6D1605 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 mars 2008), para. 8; William Fulton, T. 5028–5030 (17 tetor 2006); 6D93 (Shënime të intervistës së grupit të punës me Radojko Repanoviqin); 6D94 (Shënime të intervistës së grupit të punës me Nenad Jovanoviqin); 6D95 (Shënime të intervistës së grupit të punës me Dobrivoje Vitosheviqin). *Shih gjithashtu* 6D1608 (Kërkesa e Dragan Furdulloviqit dërguar Sreten Llukiqit për të intervistuar Radojko Repanoviqin, 22 mars 2002); 6D1609 (Kërkesa e Dragan Furdulloviqit dërguar Sreten Llukiqit për të intervistuar Ramiz Papiqin, 28 mars 2002); 6D1610 (Kërkesa e Dragan Furdulloviqit dërguar Sreten Llukiqit për të intervistuar Millorad Obradoviqin, 28 mars 2002).

Kosova,²⁹⁹³ dhe përfshinin vëllezërit me mbiemrin Bytyqi, të cilët ishin vrarë pas konfliktit dhe jashtë Kosovës.²⁹⁹⁴

1330. Të dhënat e marra gjithashtu tregonin për ekzistencën e një varri të përbashkët në bregun e liqenit Peruqac në Serbinë perëndimore. Nga ai vend u zhvarrosën rreth 48 kufoma. Hetimet zbuluan se në lumin e afërt Drin ishte gjetur edhe një kamion-frigorifer tjetër me kufoma dhe se SPB-ja e Uzhices që ishte përgjegjëse për atë zonë, kishte kontaktuar Beogradin dhe kishte marrë urdhër t'i mblidhte kufomat dhe t'i varroste. Edhe në këtë rast u veprua me urdhër të Gjorgjeviqi dhe u supozua se edhe këto kufoma ishin nga Kosova.²⁹⁹⁵ Provat e kësaj çështjeje nuk lidhin asnjë nga kufomat e zhvarrosura afër liqenit Peruqac me krimet e pretenduara në Aktakuzë.

4. Implikimi i zyrtarëve jashtë MPB-së

1331. Shumë zyrtarë të lartë të UJ-së dëshmuar se nuk kishin dijeni për transportimin dhe rivarrosjen e kufomave gjatë kohës që ndodhi dhe se për këtë ngjarje mësuan më vonë. Për shembull, Geza Farkashi dëshmoi se kishte dëgjuar për këtë pas luftës.²⁹⁹⁶ Momir Stojanoviqi, i cili në atë kohë ishte zëvendësues i degës së sigurimit në Korpusin e Prishtinës, gjithashtu dëshmoi se dëgjoi për këtë nga mediat dhe deklaroi se shërbimi i zbulimit ushtarak nuk kishte të dhëna që sugjerorin implikimin e pjesëtarëve të UJ-së në transportimin e kufomave.²⁹⁹⁷

1332. Prokuroria pretendon se, përveç Llukiqit, edhe i Akuzuari Shainoviq u përfshi në operacionin për fshehjen e kufomave dhe ofron si provë dëshminë e Aleksandar Vasileviqit dhe një pjesë nga fletorja e shënimeve të Obrad Stevanoviqit, në të cilën ishte një shënim për një mbledhje (ka shumë të ngjarë në maj 1999) në të cilën thuhet se morën pjesë edhe Millosheviqi dhe Shainoviqi. Gjatë marrjes së tij në pyetje, Prokuroria i tregoi atij shënimin nga ditari i Vasileviqit, i cili më pas u mundua të shpjegonte rolin e Shainoviqit duke u bazuar në ditarin që ishte shumë i vështirë të lexohej. Edhe pse Stevanoviqi dëshmoi në procesin *Millosheviq*, ai nuk u ftua si dëshmitar në këtë gjykim.²⁹⁹⁸ Vasileviqi dëshmoi para kësaj Dhome se, meqenëse nuk mori pjesë në

²⁹⁹³ Dragan Furdulloviq, T. 24714 (1 prill 2008), 6D1605 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 mars 2008), para. 9.

²⁹⁹⁴ Dragan Furdulloviq, T. 24706–24707 (1 prill 2008), 6D1605 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 mars 2008), para. 9–10; 6D1611 (Kërkesa e Dragan Furdulloviqit dërguar Sreten Llukiqit për të intervistuar gjashtë zyrtarë të MPB-së, 28 mars 2002).

²⁹⁹⁵ Dragan Furdulloviq, 6D1605 (deklarata e dëshmitarit e datës 26 mars 2008), para. 11; Aleksandar Kostiq, T. 24098 (11 mars 2008); K84, T. 5202–5203 (19 tetor 2006) (seancë e mbyllur), P2387 (deklarata e dëshmitarit), f. 9 (e mbyllur me vullë).

²⁹⁹⁶ Geza Farkash, T. 16382 (25 shtator 2007).

²⁹⁹⁷ Momir Stojanoviqi, T. 19851–19853 (7 dhjetor 2007), T. 20089–20090 (12 dhjetor 2007).

²⁹⁹⁸ Aleksandar Vasileviq, T. 8778 (22 janar 2007), P2600 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 janar 2007), para. 72. *Shih gjithashtu* P1898 (Fletorja e shënimeve e Obrad Stevanoviqit), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 106.

mbledhjen në fjalë, nuk ishte i sigurt nëse Shainoviqi kishte marrë pjesë në mbledhje apo se Millosheviqi tha fjalët që i atribuoi Stevanoviqi.²⁹⁹⁹ Rrjedhimisht, Dhoma nuk i kushton shumë rëndësi kësaj prove materiale si provë për praninë e Shainoviqit në atë mbledhje.³⁰⁰⁰

5. Ekzaminimi i kufomave

1333. Dhoma ka marrë prova se të gjitha kufomat dhe/ose pjesët e kufomave të zbuluara në tre vende jashtë Kosovës u zhvarrosën dhe ekzaminuan nga ekspertët vendorë si nga ekspertët të organizatave të ndryshme ndërkombëtare. Gjithashtu, Dhoma ka marrë prova se disa nga kufomat e këtij operacioni të fshehtë ishin ekzaminuar më herët gjatë konfliktit kur ende ndodheshin në Kosovë. Këto prova kanë të bëjnë me disa viktime të gjetura në Petrovo Sellë e që ishin vrarë në Izbicë, të cilat më pas u ekzaminuan në Mitrovicë nga ekspertët mjeko-ligjorë të Akademisë Mjekësore Ushtarake (VMA).³⁰⁰¹

a. Ekzaminimet mjeko-ligjore në Kosovë

1334. Siç është thënë më lart, më 31 mars 1999, Llazareviqi lëshoi urdhër për pastrimin e fushëbetejës, të cilin komandantët e niveleve më të ulëta ua përcollën trupave të veta.³⁰⁰² Më 26 prill 1999, Llazareviqi gjithashtu i dërgoi kërkesë Armatës së 3-të dhe "Kryekomandantit" për një patolog kriminalist ushtarak, si vijon:

Për shkak të nevojës së shfaqur për zhvarrosjen dhe trajtimin profesional të kufomave të varrosura në varre në territor (të Korpusit të Prishtinës), ku personat të cilët bënë heqjen e kufomave nuk njihen dhe ka të dhëna se janë implikuar ushtarakë, kërkojmë që të dërgoni një ekspert të duhur -- patolog kriminalist ushtarak (dëshmitar ekspert).³⁰⁰³

1335. Të nesërmen, Komanda e Armatës së 3-të u përgjigj me telegram se do të dërgohej major Millosavleviqi, patolog kriminalist në VMA, për të marrë pjesë në zhvarrosjen e kufomave në Kosovë.³⁰⁰⁴ Gjatë pyetjeve nga Prokuroria, Llazareviqi u pyet për këtë telegram dhe për arsyet që e kishin shtyrë ta dërgonte. Ai u përgjigj se ishte iniciativa e tij e dytë e këtij lloji,³⁰⁰⁵ dhe u bë për ta përgatitur UJ-në për kryerjen e hetimeve në vendngjarje gjatë luftës dhe në këtë mënyrë për

²⁹⁹⁹ Aleksandar Vasileviq, T. 8829–8830 (22 janar 2007).

³⁰⁰⁰ P1898 (Fletorja e shënimeve e Obrad Stevanoviqit), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 106.

³⁰⁰¹ Këto prova janë analizuar imtësisht në Shtojcën A.

³⁰⁰² 5D352 (Urdhër për pastrimin e fushëbetejës i nënshkruar nga Llazareviqi, 31 mars 1999). *Shih gjithashtu* 5D1028 (Urdhër i Brigadës së 37-të të Motorizuar, 5 prill 1999).

³⁰⁰³ 5D379 (Kërkesë e Vladimir Llazareviqit dërguar komandës së PrK-së, 26 prill 1999).

³⁰⁰⁴ 5D383 (Përgjigje e Armatës së 3-të dërguar PrK-së, 27 prill 1999).

³⁰⁰⁵ Llazareviqi dëshmoi se kishte kërkuar ekspertë mjeko-ligjorë edhe një herë më parë dhe se një ekspert i tillë u dërgua në Kosovë më 20 prill 1999. Vladimir Llazareviq, T. 18127–18128 (12 nëntor 2007).

parandalimin e fshehjes së krimeve. Më tej ai sqaroi se sugjerimet e përmendura nga ai për implikimin e UJ-së në krime bazoheshin në burime të ndryshme, duke përfshirë banorët vendës, persona të pidentifikuar dhe MPB-në, por deklaroi se këto sugjerime shpesh ishin të gabuara sepse banorët vendës nuk ishin në gjendje të bënin dallimin midis uniformave dhe pajisjeve të përdorura nga UJ-ja dhe MPB-ja; ky telegram ishte rezultat i raporteve të para për përfshirjen e UJ-së, të cilat UJ-ja i hetoi së bashku me MPB-në. Llazareviqi përmendi dy vende në komunën e Lipjanit, ku specialistët e VMA-së zhvarrosën 36 kufoma. Ai gjithashtu deklaroi se kishte dijeni edhe për dy kërkesa të tjera për pjesëmarrjen e këtyre specialistëve të VMA-së dhe tha se ata morën pjesë në gjashtë vende brenda Kosovës.³⁰⁰⁶

1336. Dr. Gordana Tomasheviq, specialiste mjeko-ligjore e punësuar në VMA,³⁰⁰⁷ dëshmoi për ekzaminimet mjeko-ligjore që bëri në Kosovë në maj 1999. Vetëm një prej tyre kishte lidhje me një vend krimi të përmendur në Aktakuzë, konkretisht në Izbicë. Më 10 maj 1999, ajo mori një telefonatë nga Dr. Shtërbac i VMA-së, i cili i tha se ata të dy së bashku me ekspertë të tjerë të fushës duhej të shkonin në Spitalin Ushtarak të Nishit dhe t'i raportnin drejtorit të spitalit, Dr. Kostiq. Ata vepruan kështu dhe Kostiqi u tha se i gjithë ekipi do të udhëtonte të nesërmen për në Prishtinë. Tomasheviqi mori vetëm udhëzime gojore, si për të takuar Kostiqin, po ashtu edhe nga vetë Kostiqi. Ajo dëshmoi se nuk ishte procedurë e rregullt sepse zakonisht ajo merrte udhëzime me shkrime.³⁰⁰⁸ Pas kthimit nga Kosova më 14 qershor, ajo gjeti një telegram që përcaktonte detyrat e ekipit por vetëm pasi kishte këmbëngulur që të kishte një dokument me shkrim.³⁰⁰⁹

1337. Më 12 maj 1999, ekipi udhëtoi për në Prishtinë dhe pati një mbledhje me të Akuzuarit Pavkoviç dhe Llazareviq, ku nuk u diskutua shumë. Ekipi qëndroi atje 10 ditë pa bërë gjë dhe më pas më 22 maj 1999 pati një mbledhje me Pavkoviçin dhe Llazareviçin ku Pavkoviç i informoi se ekipi duhej të përdorte ekspertizën për "*asanacija-s*" ose, siç shpjegoi Pavkoviç, marrjen e masave higjienike, sanitare, dhe teknike në lidhje me kufomat e njerëzve dhe cofëtinat për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve. Kjo detyrë gjithashtu nënkuptonte marrjen e masave të nevojshme për identifikimin e viktimave dhe shkakun e vdekjes së tyre.³⁰¹⁰ Sidoqoftë, Tomasheviqi tha se

³⁰⁰⁶ Vladimir Llazareviq, T. 18645–18647 (20 nëntor 2007).

³⁰⁰⁷ Gordana Tomasheviq, P2490 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 mars 2003), f. 2.

³⁰⁰⁸ Gordana Tomasheviq, T. 7022–7023 (21 nëntor 2006), P2490 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 mars 2003), para. 11, 14.

³⁰⁰⁹ Gordana Tomasheviq, T. 7023 (21 nëntor 2006), P2490 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 mars 2003), para. 12; P2491 (Shtojca JZ-1: Telegram nga Momçillo Kërgoviç dërguar Pera Spasiqit, 10 maj 1999).

³⁰¹⁰ Gordana Tomasheviq, T. 7022–7025, 7044 (21 nëntor 2006), P2490 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 mars 2003), para. 15–16; P2507 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 korrik 2006), para. 2.

identifikimi zakonisht është i pamundshëm pa ndihmën e pjesëtarëve të familjes, të cilët ajo nuk mundi t'i kontaktonte gjatë qëndrimit të saj në Kosovë.³⁰¹¹

1338. Më mbledhjen e 22 majit, Pavkoviqi e udhëzoi Tomasheviqin të fillonte punën në një shtëpi të braktisur në Çikatovë të Vjetër.³⁰¹² Tomasheviqi e informoi Pavkoviqin se ajo punonte vetëm sipas urdhrave me shkrim nga gjykatësi hetues, kurse Pavkoviqi iu përgjigj, "Nuk ka urdhra, po të urdhëroj gojarisht."³⁰¹³ Radomir Gojoviqi, i cili në atë kohë ishte shef i departamentit juridik të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, dëshmoi se nuk kishte asgjë të jashtëzakonshme në këtë dhe se gjithçka u bë në përputhje me Ligjin për Procedurën Penale. Ai sqaroi se urdhri i gjykatësit hetues nuk ishte i nevojshëm në atë rast për shkak të urgjencës së problemit.³⁰¹⁴

1339. Në një shtëpi të braktisur në Çikatovë të vjetër u gjetën 12 kufoma të karbonizuara.³⁰¹⁵ Së paku disa prej këtyre kufomave i kishin këmbët dhe krahët e lidhura.³⁰¹⁶ Tomasheviqi nuk u bëri autopsitë këtyre kufomave për shkak të luftimeve që vazhdonin në atë zonë.³⁰¹⁷ Sidoqoftë, ajo kreu ekzaminim e plotë të jashtëm dhe të dhëmbëve të kufomave.³⁰¹⁸ Tomasheviqi përgatiti një raport me konkluzionet e veta, duke shpresuar se dikush do t'ia kërkonte, por askush nuk i kërkoj raport.³⁰¹⁹ Ajo nuk dinte se ku gjendet raporti tani.³⁰²⁰

1340. Pas ekzaminimit në Çikatovë të Vjetër, Tomasheviqi kreu dy ekzaminime të tjera pasi atë e kontaktuan gjykatësit hetues ushtarakë të Korpusit të Prishtinës.³⁰²¹ Urdhri i parë erdhi më 30 maj 1999 që e urdhëronte të kryente hetimet në varrezat e Bellopojës, në fshatin Lubeniq të Pejës.³⁰²² Ekipi mjeko-ligjor zhvarrosi dhe ekzaminoi kufomat nga 14 varre të veçanta. Duke marrë parasysh shkallën e kalbëzimit të tyre Tomasheviqi besonte se personat kishin vdekur rreth tre muaj më parë. Ajo dëshmoi se lëndimet e konstatuara prej saj kishin shumë të ngjarë të ishin shkaktuar me armë

³⁰¹¹ Gordana Tomasheviq, T. 7043 (21 nëntor 2006).

³⁰¹² Gordana Tomasheviq, T. 7025–7026 (21 nëntor 2006).

³⁰¹³ Gordana Tomasheviq, T. 7026 (21 nëntor 2006); *Shih* Gordana Tomasheviq, P2490 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 mars 2003), para. 17 (që citon komentën e Pavkoviqit si "Unë po e jap urdhrin").

³⁰¹⁴ Radomir Gojoviq, T. 16701-16702 (2 tetor 2007).

³⁰¹⁵ Gordana Tomasheviq, T. 7040–7041 (21 nëntor 2006), P2490 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 mars 2003), para. 18.

³⁰¹⁶ Gordana Tomasheviq, P2490 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 mars 2003), para. 19.

³⁰¹⁷ Gordana Tomasheviq, T. 7040 (21 nëntor 2006).

³⁰¹⁸ Gordana Tomasheviq, T. 7040 (21 nëntor 2006); P2490 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 mars 2003), para. 20.

³⁰¹⁹ Gordana Tomasheviq, T. 7026–7027 (21 nëntor 2006); P2490 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 mars 2003), para. 21.

³⁰²⁰ Gordana Tomasheviq, T. 7027 (21 nëntor 2006).

³⁰²¹ Gordana Tomasheviq, T. 7041–7042 (21 nëntor 2006).

³⁰²² Gordana Tomasheviq, P2490 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 mars 2003), para. 23; P2492 (Shtojca JZ-2: Urdhër për zhvarrosjen e kufomave në Lubeniq, 30 maj 1999).

zjarri.³⁰²³ Urdhri tjetër nga Korpusi i Prishtinës erdhi më 1 qershor 1999 dhe i dërgoi Tomasheviqin dhe ekipin e saj në fshatin Ribar i Vogël në komunën e Lipjanit.³⁰²⁴ Ekipi zhvarrosi dhe ekzaminoi 25 kufoma, të cilat ishin varrosur individualisht në një varrezë pranë xhamisë së fshatit. Përsëri, ajo e përcaktoi kohën e vdekjes diku rreth tre muaj më parë Mirëpo në atë kohë ajo shënoi se disa nga kufomat mund të kenë qenë të ekspozuara ndaj kushteve atmosferike para varrosjes, faktor që mund të shpejtonte kalbëzimin e tyre dhe ndikonte në saktësinë e vlerësimeve të saj.³⁰²⁵

1341. Tomasheviqi dëshmoi se hetuesit ushtarakë janë të detyruar t'i japin patologut kriminalist materiale si dokumente fotografike, dokumentacion filmik dhe planimetrinë e vendit të ngjarjes.³⁰²⁶ Sidoqoftë, teknikët kriminalistë ushtarakë në Çikatovë të Vjetër, Bellopojë, dhe Ribar i Vogël nuk ia dhanë këto materiale.³⁰²⁷ Edhe pse i kujtohej se jo të gjitha kufomat e ekzaminuara në tre vendet e lartpërmendura ishin meshkuj të moshës madhore, Tomasheviqit nuk i kujtohej se në cilat vendvarrime kishte gra e fëmijë.³⁰²⁸

1342. Në një moment, ekipi i Tomasheviqit mori një urdhër zyrtar edhe nga një gjykatë civile, konkretisht nga Gjykata e Qarkut të Mitrovicës i datës 31 maj 1999.³⁰²⁹ Aty urdhërohej zhvarrosja e kufomave të zbuluara në Izbicë për ekzaminim mjeko-ligjor me qëllim përcaktimin e kohës dhe shkakun e vdekjes. Urdhri gjithashtu kërkonte që kufomat të varroseshin pas ekzaminimit.³⁰³⁰ Tomasheviqi shpjegoi se nuk e dinte pse ishte ngarkuar me detyrë nga një gjykatë civile, edhe pse Gvozden Gagiqi shpjegoi se gjykatësit hetues kanë të drejtë të zgjedhin institucionin që do të kryejë ekzaminimin mjeko-ligjor.³⁰³¹ Ajo gjithashtu tha se, përveç Dr. Shtërbacit, ajo dhe ekipi nuk ishin të pranishëm gjatë zhvarrosjes së kufomave; ajo vetëm dëgjoi se ishin zhvarrosur nga varre individuale në Izbicë.³⁰³² Kufomat u ngarkuan në një kamion nga punëtorë civilë dhe ishin futur në thasë individuale për kufoma, gjithsej 101 thasë të tillë.³⁰³³ Kufomat ishin kryesisht me rroba civile,

³⁰²³ Gordana Tomasheviq, P2490 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 mars 2003), para. 30.

³⁰²⁴ Gordana Tomasheviq, P2490 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 mars 2003), para. 32; P2493 (Shtojca JZ-3: Urdhër për zhvarrosjen e kufomave në Ribar të Bardhë, 1 qershor 1999).

³⁰²⁵ Gordana Tomasheviq, P2490 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 mars 2003), para. 36.

³⁰²⁶ Gordana Tomasheviq, P2490 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 mars 2003), para. 26.

³⁰²⁷ Gordana Tomasheviq, P2490 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 mars 2003), para. 18, 26, 37.

³⁰²⁸ Gordana Tomasheviq, P2490 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 mars 2003), para. 19, 30, 37.

³⁰²⁹ P2496 (Urdhër i Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës në lidhje me varret e Izbicës).

³⁰³⁰ Gordana Tomasheviq, T. 7028–7029 (21 nëntor 2006), P2490 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 mars 2003), para. 43, 49; P2496 (Urdhër i Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës në lidhje me varret e Izbicës).

³⁰³¹ Gordana Tomasheviq, P2490 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 mars 2003), para. 46, P2507 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 korrik 2006), para. 2; Gvozden Gagiqi, T. 24483–24484 (18 mars 2008).

³⁰³² Gordana Tomasheviq, P2490 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 mars 2003), para. 50; P2507 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 korrik 2006), para. 3.

³⁰³³ *Shih* Pjesën VII.G.

por Tomasheviqi tha se "disa" prej tyre ishin me uniforma të zeza të UÇK-së.³⁰³⁴ Jo më shumë se pesë kufoma me uniformë të UÇK-së kishin të bashkangjitura edhe kokat e varreve me mbishkrime të UÇK-së.³⁰³⁵ Gjatë ekzaminimeve ishin të pranishëm edhe policë civilë. Ekzaminimi i jashtëm i kufomave u bë në Mitrovicë gjatë periudhës treditore, 3- 5 qershor 1999. Meqë ekipi nuk kishte pajisjet e nevojshme për ekzaminim të plotë mjeko-ligjor, nuk u bë asnjëherë ekzaminimi i brendshëm i kufomave. Tomasheviqi hartoi një aktekspertizë të plotë në lidhje me këto ekzaminime.³⁰³⁶ Nga pesë kufomat që i identifikoi përmes kokave të varreve dhe dokumenteve të identitetit, asnjë nuk u gjet në Petrovo Sellë. Gjithashtu, meqenëse shumica e viktimave të pretenduara të Izbicës faktikisht u gjetën në Mitrovicë, Dhoma gjykon se asnjë nga 101 kufomat e ekzaminuara nga Tomasheviqi nuk u transportua më vonë në Petrovo Sellë.

1343. Përfshirja e SPB-së së Mitrovicës në hetimet kriminalistike të Izbicës u konfirmua nga Nebojsa Bogunoviqi, zëvendësshef i SPB-së së Mitrovicës, dhe nga Gagiqi. Të dy dëshmuan se më 27 maj 1999 në fshat u dërgua një ekip hetimor i SPB-së, pasi mediat raportuan për ekzistencën e varreve në Izbicë. Kur ekipi mbërriti atje, ata hasën ushtarë të UJ-së të cilët nuk dinin asgjë për ndonjë varr të përbashkët, por u thanë hetuesve se në fshat ishte një varrezë të re. Kur ekipi shkoi në vendin e ngjarjes dikush shtiu kundër tyre dhe ekipi u detyrua të largohej. Prokurori publik dhe një gjykatës hetues u informuan për këtë dhe ata urdhëruan zhvarrosjen e kufomave. Gjithashtu, Gagiqi informoi eprorin e tij, Iliqin, për këtë hetim. Ai konfirmoi se kufomat u ekzaminuan së jashtmi nga ekspertët e VMA-së dhe më pas u varrosën në varrezën myslimane në Mitrovicë.³⁰³⁷

b. Ekzaminimet mjeko-ligjore jashtë Kosovës

1344. Nga tri vendet e gjetura jashtë Kosovës në të cilat kishte varre të përbashkëta, Dhoma dëgjoji dëshmi të hollësishme vetëm për dy prej tyre, konkretisht për Batajnicën dhe Petrovo Sellën. Këto dëshmi jepen më poshtë.

³⁰³⁴ Gordana Tomasheviq, T. 7032 (21 nëntor 2006), P2490 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 mars 2003), para. 50, 52, P2507 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 korrik 2006), para. 3, 5.

³⁰³⁵ Gordana Tomasheviq, T. 7053 (21 nëntor 2006).

³⁰³⁶ Gordana Tomasheviq, T. 7029–7030, 7032–7034 (21 nëntor 2006); P2490 (deklarata e dëshmitarit e datës 5 mars 2003), para. 53, 55–70; P2507 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 korrik 2006), para. 5, 7; P248 (Aktautopsitë e Gordana Tomasheviqit). Në të gjitha aktautopsitë është shënuar gabimisht data 3 qershor 1999 edhe pse autopsitë u bënë gjatë periudhës prej tri ditësh, 3-5 qershor 1999. P2507 (deklarata e dëshmitarit e datës 25 korrik 2006), para. 7. *Shih gjithashtu* Radomir Gojoviq, T. 16701-16702 (2 tetor 2007).

³⁰³⁷ Nebojsa Bogunoviq, T. 25128–25129 (10 prill 2008), 6D1614 (deklarata e dëshmitarit e datës 2 prill 2008), para. 83; Gvozden Gagiq, T. 24447–24450, 24483–24484 (18 mars 2008); 6D116 (Raport i MPB-së për ekzaminimin kriminalistik të vendvarrimit në Izbicë, 2 qershor 1999). *Shih gjithashtu* 6D613 (Dokument i SPB-së së Mitrovicës në lidhje me Izbicën), f. 655–658, gjithashtu i pranuar si 6D115.

i. Batajnica

1345. Siç është përmendur më lart, në zhvarrosjen dhe ekzaminimin e kufomave të gjetura në Batajnicë u përfshinë disa njerëz. Dhoma ka pranuar si prova shumë raporte në lidhje me to dhe ka dëgjuar dëshmi të personave që ishin të pranishëm, mbikëqyrën, dhe morën pjesë në zhvarrosjen dhe identifikimin e kufomave nga viti 2001 e këtej. Dr. Dushan Dunjiqi i cili në atë kohë ishte drejtor i Institutit të Mjekësisë Ligjore në Beograd, udhëhoqi punën për zhvarrosjen dhe identifikimin.³⁰³⁸ Dr. Branimir Aleksandriqi u caktua nga Dunjiqi që të merrte përsipër drejtimin e punës në vendvarrimin e Batajnicës, pasi ishte kryer një pjesë e punës.³⁰³⁹ Dhoma gjithashtu dëgjoji dëshmitë e William Fulton-it, pjesëtar i ekipit të Prokurorisë së Tribunalit, i cili mbikëqyri zhvarrosjet në Batajnicë, Jon Sterenberg-ut, i cili punonte për KNPZH-në dhe gjithashtu mbikëqyri zhvarrosjet në vendvarrimin e Batajnicës, dhe nga Jose-Pablo Baraybar, i cili është shef i ZPZHK - së së UNMIK-ut. Dhoma ka marrë dëshmi nga Dr. Antonio Alonso, ekspert në identifikimin gjenetik nga Ministria e Drejtësisë së Spanjës, i cili analizoi mostrat e mbledhura në Batajnicë për identifikimin e kufomave.

1346. Në Batajnicë u gjetën gjithsej pesë varre të përbashkëta, konkretisht vendvarrimet e shënuara si Batajnica I, II, III, V, dhe VII, që përafërsisht përputhet me numrin e ngarkesave të sjella në Batajnicë, sipas dëshmisë së K88-ës.³⁰⁴⁰ Dunjiqi mori pjesë në zhvarrosjet Batajnica I dhe Batajnica II dhe përgatiti raporte përmbledhëse për të dy rastet.³⁰⁴¹ Procedurat e përdorura në të dy vendvarrimet ishte si vijon: autopsitë bëheshin në një tendë në vendin e zhvarrosjes; një ose dy anëtarë të ekipit ekzaminonin kufomat kurse një tjetër shënonte konstatimet siç i diktoheshin; për çdo autopsi të kryer hartohej një aktautopsi përfundimtare; dhe në fund, merreshin mostrat e eshtrave nga çdo kufomë, ose pjesë trupore e cila nuk mund të përputhej me ndonjë kufomë, dhe i dorëzoheshin Alonso-s për analizën e ADN-së.³⁰⁴²

³⁰³⁸ Dushan Dunjiq, T. 5245 (25 tetor 2006); P2389 (deklarata e dëshmitarit e datës 11 maj 2006), para. 3; P2395 (Letër dërguar Dekanit të Fakultetit të Mjekësisë në Beograd nga ana e Gjykatësit Hetues të Gjykatës së Qarkut të Beogradit, 31 maj 2001); P2396 (Urdhër i Gjykatësit Hetues të Gjykatës së Qarkut të Beogradit dërguar Institutit të Mjekësisë Ligjore, 31 maj 2001).

³⁰³⁹ Branimir Aleksandriq, P2412 (deklarata e dëshmitarit e datës 2 qershor 2006), para. 3.

³⁰⁴⁰ Vendzhvarrosjet e mbetura, konkretisht Batajnica IV dhe VI nuk ishin varre të përbashkëta. P2476 (Aktekspertizë për zhvarrosjet: Batajnica, Petrovo Sella, Gryka e Derventës, Liqeni i Peruqacit, 24 nëntor 2005), f. 9; Branimir Aleksandriq, T. 5297–5298 (25 tetor 2006); William Fulton, T. 5014–5015 (17 tetor 2006).

³⁰⁴¹ Dushan Dunjiq, T. 5249, 5262 (25 tetor 2006); P2389 (deklarata e dëshmitarit e datës 11 maj 2006), para. 4, 13; P168 (Evidencë e Zhvarrosjeve të Kryera në Vendin nr. I); P2410 (Raport mbi Zhvarrosjet dhe Autopsitë e Kryera në Vendin nr. II). *Shih gjithashtu* P2405 (Raport mbi Gërmimin Arkeologjik, Batajnica 2001); P2406 (Regjistër i Gërmimit Arkeologjik); P2404 (Regjistër i matjeve të planit horizontal për Batajnicën I); P2401 (Regjistër i fotografive të terrenit nga Batajnica I).

³⁰⁴² Dushan Dunjiq, T. 5250 (25 tetor 2006); P2389 (deklarata e dëshmitarit e datës 11 maj 2006), para. 7–9. *Shih gjithashtu* P159 (Topografia e vendit të gërmimit në vendngjarjen Batajnica I).

1347. Në lidhje me vendvarrimin Batajnica I, të gjitha pjesët trupore dhe kufomat u shënuan me "Ba" dhe me numër nga 1 e lart; të gjitha rrobat e gjetura që nuk ishin në kufoma u shënuan me "BA-SG" dhe me numër; dhe të gjitha sendet e gjetura që nuk ishin në kufoma u shënuan me kodin "Ba-P" që gjithashtu shoqërohej me numër. Sendet/rrobat e gjetura në kufoma u shënuan me të njëjtin kod sikurse edhe kufoma.³⁰⁴³ Të gjitha sendet dhe kufomat dhe pjesët e kufomave të gjetura u fotografuan,³⁰⁴⁴ po ashtu si dhe vendvarrimi pas heqjes së sendeve dhe kufomave.³⁰⁴⁵ Në varrin e përbashkët Batajnica I ishin së paku 36 kufoma të të dy gjinive dhe moshave të ndryshme. Nga këto 36 kufoma, u konkluduar se nëntë ishin poshtë moshës 7-vjeçare dhe një ishte foshnje e palindur.³⁰⁴⁶ Më tej aktekspertizat kriminalistike dhe fotografitë iu dorëzuan Gjykatës së Qarkut të Beogradit.³⁰⁴⁷ Dhoma thekson se një nga viktimat nga Suhareka ishte grua shtatzënë.³⁰⁴⁸

1348. E njëjta procedurë u zbatua edhe në lidhje me vendvarrimin Batajnica II dhe mostrat iu dorëzuan Alonso-s dhe zyrtarëve të KNPZHH-së për analizë të ADN-së.³⁰⁴⁹ Së pakur 269 kufoma, të gjithë meshkuj, u shënuan me kodin "2Ba" dhe me numër rendor.³⁰⁵⁰ Pas analizimit të këtyre mostrave, Dunjiqi mori pjesë në identifikimin e kufomave të gjetura në Batajnicë I dhe II. Pas identifikimit, ato u riatdhësuan në Kosovë.³⁰⁵¹ Për shkak të angazhimeve të tjera, Dunjiqi nuk mori pjesë në zhvarrosjet e mëvonshme në vendvarrimet Batajnica III deri VIII, të cilat u drejtuan nga Aleksandriqi, dhe që çuan në zbulimin e rreth 400 kufomave të tjera.³⁰⁵² Aleksandriqi shpjegoi se metodologjia e përdorur për hapjen e këtyre vendvarrimeve dhe për shënimin e kufomave përputhej

³⁰⁴³ Dushan Dunjiq, T. 5250–5251 (25 tetor 2006); P168 (Evidencë e Zhvarrosjeve dhe Autopsive të Kryera në Vendin nr. I), f. 2.

³⁰⁴⁴ Dushan Dunjiq, T. 5259–5260 (25 tetor 2006). Mostra të fotografive të tilla janë pranuar si P139, P140, P141, P142, P143, P144, P145, P146, P147, P148, P149, P150, P151, P152, P153, P154, P155, dhe P156.

³⁰⁴⁵ Dushan Dunjiq, T. 5260–5261 (25 tetor 2006); P166 (Indeksi i përfundimit të procesit të zhvarrosjes në Batajnicë); P167 (Fotografi të vendngjarjes Batajnica I të gërmuar). Dhoma thekson se ekipi kriminalist gjeti trarë të hekurudhës në fund të gropës; P2405 (Raport mbi Gërmimin Arkeologjik, Batajnica 2001), f. 9.

³⁰⁴⁶ Dushan Dunjiq, T. 5253 (25 tetor 2006); William Fulton, T. 5018-5021 (17 tetor 2006); P2407 (raporte mjeko-ligjore individuale për kufomat nga Batajnica I); P2399 (Deklaratë për Shtyp e Gjykatës së Qarkut të Beogradit). *Shih gjithashtu* P2402 (Tabelë e rasteve të ndryshme të kompletuara – pjesë të kufomave); P2403 (Tabelë e ekzaminimit të viktimave të padëmtuara). Raporte mjeko-ligjore të personave që më vonë u identifikuan me anë të analizave të ADN-së gjithashtu janë pranuar veças nga P2407 si P169, P170, P171, P172, P173, P174, P175, P176, P178, P179, P180, P181, P182, P183, P184, P185, P186, P187, P188, *Shih* Dushan Dunjiq, T. 5251–5252, 5254–5255 (25 tetor 2006).

³⁰⁴⁷ P2397 (Urdhër drejtuar Institutit të Mjekësisë Ligjore për t'i dorëzuar Gjykatës së Qarkut të Beogradit fotografitë në lidhje me Batajnicën I, 20 dhjetor 2001); P2398 (Urdhër drejtuar Institutit të Mjekësisë Ligjore për t'i dorëzuar Gjykatës së Qarkut të Beogradit fotografitë në lidhje me Batajnicën I, 20 dhjetor 2001); P2400 (Njoftim për dorëzimin e provave nga Batajnica I Gjykatës së Qarkut të Beogradit).

³⁰⁴⁸ *Shih* Pjesën VII.F.

³⁰⁴⁹ Dushan Dunjiq, T. 5262–5263 (25 tetor 2006), P2389 (deklarata e dëshmitarit e datës 11 maj 2006), para. 13. *Shih gjithashtu* Antonio Alonso, T. 6680–6681 (16 nëntor 2006).

³⁰⁵⁰ P2410 (Raport mbi Zhvarrosjet dhe Autopsitë e Kryera në Vendin nr. II), f. 5, 7; P942 (Dokumente dhe raporte mjeko-ligjore në lidhje me Batajnica II). *Shih gjithashtu* William Fulton, T. 5032 (17 tetor 2006).

³⁰⁵¹ Dushan Dunjiq, T. 5263–5264, 5266–5267 (25 tetor 2006).

³⁰⁵² Branimir Aleksandriq, T. 5297 (25 tetor 2006); Dushan Dunjiq, P2389 (deklarata e dëshmitarit e datës 11 maj 2006), para. 15.

me metodologjinë e përdorur nga Dunjiqi.³⁰⁵³ Ai përmendi se ekipi gjeti shumë goma të djegur në varre, me kufomat mbi dhe nën goma, si një numër të madh fishekësh dhe gëzhojash. Sidoqoftë, fishekët dhe gëzhojat mund të mos kenë pasur lidhje me kufomat meqenëse ky vend ishte përdorur si poligon qitjeje për shumë vite dhe si pasojë ishte i mbushur më sende të tilla.³⁰⁵⁴ Përsëri, për secilën kufomë ose pjesë trupore u hartua aktautopsi e veçantë dhe mostrat e marra iu dorëzuan KNPZH-së për analizën e ADN-së. Më pas, kufomat e identifikuar u riadhesuan në Kosovë.³⁰⁵⁵

1349. Jon Sterenberg është arkeolog profesionist i cili, si shef i Seksionit të Gërmimit dhe Ekzaminimit të KNPZH-së, u angazhua në zhvarrosjet në Batajnicë. Përmes tij, Prokuroria paraqiti një raport të KNPZH-së në lidhje me gërmimin, ekzaminimin, dhe riadhesimin e kufomave dhe pjesëve të kufomave të lidhura me konfliktin në Kosovë,³⁰⁵⁶ si dhe raportet që trajtojnë metodologjinë e organizatës për analizat e ADN-së dhe rezultatet e tyre.³⁰⁵⁷

1350. Jose-Pablo Baraybar dëshmoi se zhvarrosjet në Batajnicë dhe ekzaminimet mjeko-ligjore të kryera nga autoritetet serbe u bënë para krijimit të ZPZHK-ja. Sidoqoftë, një ekspert i ZPZHK-së u dërgua për të vëzhguar rizhvarrosjen e kufomave prej vendit ku mbaheshin dhe për të siguruar transportimin e sigurt deri te kufiri me Kosovën. Më pas ZPZHK-ja bëri në Rahovec inspektimin mjeko-ligjor të secilës kufomë dhe lëshoi certifikatat e veta të vdekjes.³⁰⁵⁸ Baraybar-i gjithashtu tha se aktautopsitë në lidhje me Batajnicën e përgatitura nga autoritetet serbe tregonin se shkakun e vdekjes nuk ishte përcaktuar për asnjërën nga viktimat e zhvarrosura. Nga ana e tyre, ekspertët e ZPZHK-së mundën të përcaktonin shkakun e vdekjes për 506 nga 744 rastet e Batajnicës.³⁰⁵⁹ Duke marrë parasysh Batajnicën dhe Peruqacin së bashku, Baraybar dëshmoi se, nga 535 kufoma për të cilat ZPZHK-ja përcaktoi shkakun e vdekjes, u konkludua se 531 persona kishin vdekur nga plagët

³⁰⁵³ Branimir Aleksandriq, T. 5297–5298 (25 tetor 2006); Dushan Dunjiq, P2389 (deklarata e dëshmitarit e datës 11 maj 2006), para. 5–7, 10–11.

³⁰⁵⁴ Branimir Aleksandriq, T. 5312–5313 (25 tetor 2006), P2412 (deklarata e dëshmitarit e datës 2 qershor 2006), para. 9, 12.

³⁰⁵⁵ Branimir Aleksandriq, P2412 (deklarata e dëshmitarit e datës 2 qershor 2006), para. 13–15; P2414 (Aktautopsitë dhe fotografitë e 243 kufomave nga vendngjarja Batajnica V – pjesa 1); P2415 (Raportet e autopsisë dhe fotografitë e 243 kufomave nga vendngjarja Batajnica V – pjesa 2); P2416 (Aktautopsitë dhe fotografitë e 243 kufomave nga vendngjarja Batajnica V – pjesa 3); P2417 (Aktautopsitë dhe fotografitë e 243 kufomave nga vendngjarja Batajnica V – pjesa 4).

³⁰⁵⁶ Jon Sterenberg, T. 8203–8204 (11 dhjetor 2006); P2476 (Aktekspertizë për Zhvarrosjet: Batajnicë, Petrovo Sellë, Gryka e Derventës, Liqeni i Peruqacit, 24 nëntor 2005). Deklarata si dëshmitar e Sterenberg-ut jep hollësi për aktekspertizën; *Shih* P2475 (deklarata e dëshmitarit e datës 21 shtator 2006), para. 2.

³⁰⁵⁷ Jon Sterenberg, T. 8225–8227 (11 dhjetor 2006); P2557 (Raport Metodologjik 2001–2006, Procesi i ADN-së, 11 shtator 2006) (e mbyllur me vulë); P2558 (Njoftim për Raportet e ADN-së) (e mbyllur me vulë); P2559 (Shtesë e Aktekspertizës) (e mbyllur me vulë).

³⁰⁵⁸ Jose-Pablo Baraybar, T. 11001–11006 (6 mars 2007), P2794 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 nëntor 2006), para. 25–26; P943 (Raportet të ZPZHK-së); P944 (Raportet të ZPZHK-së); P2394 (Raportet të ZPZHK-së); P2454 (Raportet të ZPZHK-së).

³⁰⁵⁹ Jose-Pablo Baraybar, T. 11010–11012, P2794 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 nëntor 2006), Shtojca C; P2795 (Korrigjim i faqes 11 të Shtojcës C të P2794).

me armë zjarri, tre kishin plagë të shkaktuara nga ciflat e predhave, dhe një kishte të dy llojet e plagëve. Plagët nga armët e zjarrit në këto 535 kufoma nga këto dy vendvarrime ishin si vijon: 300 individë kishin së paku një plagë me armë zjarri në kokë, 323 në gjoks, 116 në gjymtyrët e epërme, dhe 153 në gjymtyrët e poshtme -- ku disa kufoma kishin më shumë se një plagë.³⁰⁶⁰

1351. Baraybar-i gjithashtu dëshmoi se ZPZHK-ja përpiloi një listë përmbledhëse të personave të zhdukur nga Kosova e cila aktualizohej rregullisht. Ajo u përpilua në bashkëpunim me KNKK-në dhe mëton të jetë evidencë e plotë për të gjithë të pagjeturit pas konfliktit në Kosovë.³⁰⁶¹ Siç është përmendur më herët, Dhoma gjithashtu dëgjoi dëshmi nga Antonio Alonso, ekspert në identifikim gjenetik, i cili analizoi mostrat nga disa kufoma të gjetura në Batajnicë. Gjatë vitit 2001, ai mori nga Dunjiqi 56 mbetje skeletore dhe mori për analizë gjenetike nga KNPZH-ja 13 mostra gjaku për krahasim, të pjesëtarëve të familjes së personave që pretendohet se ishin vrarë në Suharekë.³⁰⁶²

ii. Petrovo Sella

1352. Disa certifikata vdekjeje dhe aktautopsi të përgatitura nga Instituti i Mjekësisë Ligjore të Nishit dhe që kishin lidhje me kufomat e zhvarrosura nga varret e përbashkëta në Petrovo Sellë, kishin të bënin me viktimat nga Izbica.³⁰⁶³

1353. Jon Sterenberg hartoi një raport në lidhje me gjurmimet, ekzaminimet, dhe riatdhësimet e kufomave nga Petrovo Sella.³⁰⁶⁴ Sipas këtij raporti, ekzistonin dy vendvarrime të ndryshme, konkretisht Petrovo Sella I (PS/I) dhe Petrovo Sella II (PS/II). Këto vendvarrime u hetuan nga Gjykata e Qarkut të Negotinit me ndihmën e një ekipi ekspertësh nga Instituti i Mjekësisë Ligjore të Nishit, u nxorën 75 kufoma dhe gjendja e tyre si dhe shkalla a lartë e ruajtjes i mundësuan ekipit të Nishit të kryente "autopsi me cilësi të lartë."³⁰⁶⁵ Raporti gjithashtu thekson se gropa PS/I ishte mbështjellë me mushama plastike dhe se në fund të saj u gjet një qese plastike e zezë. Ajo përmbante shumë doreza mjekësore dhe rroba që nuk ishin të viktimave por të dikujt që ishte marrë

³⁰⁶⁰ Jose-Pablo Baraybar, P2794 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 nëntor 2006), Shtojca C, f. 14–15.

³⁰⁶¹ Jose-Pablo Baraybar, P2794 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 nëntor 2006), para. 31; P2798 (lista e personave të zhdukur të ZPZHK-së).

³⁰⁶² Antonio Alonso, T. 6664–6665 (16 nëntor 2006); P2486 (Raport për Shërbimin Biologjik, 17 nëntor 2004); P2487 (Letër dërguar Prokurorisë së Tribunalit nga Antonio Alonso, 13 qershor 2006).

³⁰⁶³ *Shih* Pjesën VII.G.

³⁰⁶⁴ Sterenberg, T. 8203–8204 (11 dhjetor 2006); P2476 (Aktekspertizë e Zhvarrosjeve: Batajnicë, Petrovo Sellë, Gryka e Derventës, Liqeni i Peruqacit, 24 nëntor 2005). Deklarata si dëshmitar e Sterenberg-ut jep hollësi për aktekspertizën; *Shih* P2475 (deklarata e dëshmitarit e datës 21 shtator 2006), para. 2.

³⁰⁶⁵ P2476 (Aktekspertizë e Zhvarrosjeve: Batajnicë, Petrovo Sellë, Gryka e Derventës, Liqeni i Peruqacit, 24 nëntor 2005), f. 28–29. *Shih gjithashtu* William Fulton, T. 5033–5034 (17 tetor 2006).

me kufomat.³⁰⁶⁶ Raporti konkludonte se kishte shumë shenja se kufomat mund të kishin ardhur nga vende të ndryshme dhe në kohë të ndryshme. Për shembull, në kufomat u gjetën thasë të ndryshëm kufomash. Edhe pse dukej se shumica e kufomave ishin civilë, një kufomë ishte me uniformë të UÇK-së, dy ishin pjesërisht me uniformë, dhe një ishte uniformë të "policisë speciale." Shtatë nga kufomat ishin femra. Në të dy varret u gjetën kufoma të lidhura, duke përfshirë edhe kufoma lidhura së bashku prej dore. U gjetën dy kufoma të lidhura së bashku me tel dhe me një litar të lidhur për teli. Tri kufoma ishin me sytë e lidhur dhe ishin qëlluar në kokë.³⁰⁶⁷

1354. Jose-Pablo Baraybar dëshmoi për përfshirjen e ZPZHK-së në identifikimin dhe riatdhësimin e kufomave të gjetura në Petrovo Sellë.³⁰⁶⁸ Si edhe në rastin e Batajnicës, një ekspert i ZPZHK-së u dërgua të vëzhgonte rishvarrosjen e kufomave nga vendi ku mbaheshin kufomat dhe për të siguruar transportimin e tyre të sigurt deri në kufi me Kosovën. Më tej, ZPZHK-ja kreu inspektimin e secilës kufomë në Rahovec dhe lëshoi certifikatat e vdekjes.³⁰⁶⁹

1355. Baraybar- theksoi se aktautopsitë në lidhje më Petrovo Sellën të përgatitura nga autoritetet serbe përcaktonin shkakun e vdekjes në 52.4% të 61 rasteve të dokumentuara. Nga ana e tyre, ekspertët e ZPZHK-së mundën të përcaktonin shkakun e vdekjes në 86.8% të rasteve (53 kufoma), duke lënë vetëm tetë raste të dokumentuara me shkakun e vdekjes të paidentifikuar.³⁰⁷⁰ ZPZHK-ja përcaktoi se të 53 personat për të cilët ishte identifikuar shkakun e vdekjes, kishin vdekur nga plagët me armë zjarri. Njëzet persona kishin së paku një plagë me armë zjarri në kokë, 21 në gjoks, pesë në gjymtyrët e sipërme, dhe 13 në gjymtyrët e poshtme.³⁰⁷¹

6. Konkluzion

1356. Pas shqyrtimit të provave të paraqitura më lart, Dhoma gjykon se nuk ka dyshim mbi kryerjen e një operacioni të fshehtë për zhvarrosjen e mbi 700 kufomave që fillimisht ishin varrosur në Kosovë dhe për transportimin e tyre në Serbi. Individët kryesorë të implikuar në organizimin e këtij operacioni të madh ishin ministri i Brendshëm Vllajko Stojilković; Presidenti i RFJ-së

³⁰⁶⁶ P2476 (Aktekspertizë e Zhvarrosjeve: Batajnicë, Petrovo Sellë, Gryka e Derventës, Liqeni i Peruqacit, 24 nëntor 2005), f. 30.

³⁰⁶⁷ P2476 (Aktekspertizë e Zhvarrosjeve: Batajnicë, Petrovo Sellë, Gryka e Derventës, Liqeni i Peruqacit, 24 nëntor 2005), f. 31–32. *Shih gjithashtu* William Fulton, T. 5033–5034 (17 tetor 2006).

³⁰⁶⁸ Jose-Pablo Baraybar, P2794 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 nëntor 2006), para. 16.

³⁰⁶⁹ Jose-Pablo Baraybar, T. 11001–11006 (6 mars 2007), P2794 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 nëntor 2006), para. 25–26; P943 (Raporte të ZPZHK-së); P944 (Raporte të ZPZHK-së); P2394 (Raporte të ZPZHK-së); P2454 (Raporte të ZPZHK-së).

³⁰⁷⁰ Jose-Pablo Baraybar, T. 11010–11011; P2794 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 nëntor 2006), Shtojca C, f. 14; P2795 (Korrigjim i faqes 11 të Shtojcës C të P2794).

³⁰⁷¹ Jose-Pablo Baraybar, P2794 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 nëntor 2006), Shtojca C, f. 14–15.

Sllobodan Millosheviq; dhe shefi i RJB-së i asaj kohe, Vllastimir Gjorgjeviq, që të gjithë të përfshirë në këtë Aktakuzë, të akuzuar si pjesëtarë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale. Ngjarjet e përshkruara më lart inkriminojnë rëndë MPB-në dhe shumë punonjës të saj, të cilët jo vetëm që punuan në zhvarrosjen, transportimin, dhe rivarrosjen e kufomave por gjithashtu morën pjesë në fshehjen institucionale të kamionit që përmbante kufoma i zbuluar në lumin Danub. Sidoqoftë, përveç dëshmisë së Gjogajt se Spasiqi kishte uniformë të UJ-së, dëshmitarët e përfshirë në këtë operacion nuk përmenden implikimin e UJ-së, dhe meqenëse gjatë kohës së rivarrosjeve qendra e Batajnicës ishte e braktisur si nga UJ-ja, po ashtu edhe nga MPB-ja, përfshirja e UJ-së nuk është provuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm. Dëshmia e Tomasheviqit sugjeron se Pavkoviqi mund të ketë ndërmarrë disa veprime jo të zakonshme. Sidoqoftë, kjo nuk e ndihmon shumë Prokurorisë, meqenëse pjesa më e madhe e punës së bërë nga Tomasheviqi nuk ishte e fshehtë për nga natyra dhe më vonë në Petrovo Sellë u gjetën vetëm një numër i vogël i viktimave të Izbicës, asnjë prej të cilave nuk duket se është ekzaminuar nga ajo. Implikimi i Llukiqit dhe Shainoviqit në këtë operacion të fshehtë analizohet më vonë në pjesët që analizojnë përgjegjësinë e tyre.

1357. Dhoma është bindur se qëllimi i këtij operacioni ishte fshehja e mbi 700 kufomave të shpërndara nëpër Kosovë si nga qytetarët e RFJ-së dhe Serbisë, po ashtu dhe nga bashkësia ndërkombëtare, përfshirë Tribunalin dhe forcat tokësore të NATO-s, prania në terren e të cilave pritej pas bombardimeve të NATO-s. Fakti se personat e përfshirë mendonin se fshehja ishte e nevojshme e bën Dhomën të konkludojë se ata ishin në dijeni se shumica dërrmuese e kufomave të zhvendosura ishin viktimat e krimeve siç ishin viktimat e zonës së Mejës dhe të qytetit të Suharekës, e jo luftëtarë ose njerëz që ishin vrarë gjatë veprimeve të ligjshme luftarake..